



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2020

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bekim Sejdiu, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Safet Hoxha, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi-Peci, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Radomir Laban, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Nexhmi Rexhepi, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Kontribuesit:

Anita Çavdarbasha
Veton Dula
Kreshnik Jonuzi
Resmije Loshi
Burim Hoxha

© 2020 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetes, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhjeje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjytimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqëson formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjytimeve të Gjykatës Kushtetuese.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2020

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e Përmbajtjes:

1.	Parathënie:	9
2.	KO197/19, Parashtrues: Gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, Gjykata Themelore në Prishtinë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat	11
3.	KO54/20, Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020	25
4.	KO61/20, Parashtrues: Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës	123
5.	MENDIM MOSPAJTUES NË AKTGJYKIMIN KO 61/20 TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	233
6.	Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të 30 prillit 2020	242
7.	KO72/20, Parashtrues: Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020	255
8.	KO116/19, Parashtrues: Ismet Kryeziu si përfaqësues i pretenduar i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës, Kërkesë për interpretim ligjor të Vendimit AC-I-13-0125-0001 dhe 0002 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 22 korrikut 2015	462
9.	Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik	473
10.	Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik	477
11.	KO203/19, parashtrues Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë	482
12.	Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik	554
13.	KO219/19, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik	563

14. KO139/18, Parashtrues: Komuna e Skënderajt, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, Nr. 05-3815, të 12 qershorit 2018 727
15. Rasti KO 98/20 Parashtruesi Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr.52/2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës, të 14 marsit 2020 753
16. Rasti nr. KO50/19, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafëve3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale dhe nenit 19 paragraf 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë 782
17. KI35/18 Parashtrues: “Bayerische Versicherungsverband”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr.18/2017, të 4 dhjetorit 2017803
18. KI07/18 Parashtrues: “Çeliku Rollers” sh.p.k. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 14/2017, të 14 shtatorit 2017844
19. KI14/18, Parashtrues, Hysen Kamberi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.241/2017, të 5 dhjetorit 2017886
20. KI 193/18, Parashtrues i kërkesës: Agron Vula, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mospërmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008 935
21. KI123/19, Parashtrues "Suva Rechtsabteilung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019, Aktgjykim i miratuar më 13 maj 2020 dhe i publikuar më 18 qershor 2020 969
22. Rasti nr. K38/19, Parashtrues: *Avdi Mujaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 285/2018, të 1 tetorit 2018 999
23. KI56/18, Parashtrues: Ahmet Frangu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ.UZVP.nr.67/2017, të 22 dhjetorit 2017 1023

24. KI214/19 Parashtrues: Murteza Koka, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.195/2019, të 23 korrikut 2019 1083
25. KI27/20 Parashtrues: Lëvizja Vetëvendosje!, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A-U.ZH.nr.16.2019] të 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës..... 1107
26. KI209/19, Parashtrues i kërkesës: Memli Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. Nr.664/2019, të 5 gushtit 2019.....1144
27. KI80/19, Parashtrues: Radomir Dimitrijević, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-18-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019.....1163
28. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, Parashtrues: Et-hem Bokshi dhe të Tjerët; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 1181
29. KI224/19, Parashtrues: Islam Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019 për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit 1221
30. KI227/19, Parashtrues: N.T. “Spahia Petrol”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr. 94/2019, të 1 gushtit 2019 1240
31. KI193/19, Parashtrues: Salih Mekaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019..... 1269
32. KI131/19, Parashtrues i kërkesës: Sylë Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AML.nr.1/2019, të 16 prillit 2019..... 1290
33. KI231/19, Parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila përfaqëson NSH-në „Kosova-Export”, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-15-0212-A0001 të 22 gushtit 2019.....1315

34.	KI158/19, Parashtrues: Fatos Dervishaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosveprimeve të autoriteteve publike në lidhje me kërkesat e parashtruesit të kërkesës	1340
35.	KI122/19, Parashtruesi i kërkesës: F.M., Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.49/2019 të 7 marsit 2019 lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.358/2018, të 19 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.927/14, të 15 janarit 2018	1372
36.	KI243/19, Parashtruesi i kërkesës: Muhamet Idrizi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 290/2019,të 21 tetorit 2019	1403
37.	KI71/20, Parashtrues, Etem Arifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 380/2019, të 30 janarit 2020	1418
38.	KI88/20, Parashtrues i kërkesës: Klubi i Futbollit “Liria”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, nr. 272/2, të 2 qershorit 2020.....	1452
39.	KI232/19, Parashtrues i kërkesës: Xhemajl Bajraktari, Kërkesë për për interpretim të nenit 35 pikat 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës	1461
40.	INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE	1468
41.	INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS.....	1479

Parathënie:

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, për herë të fundit në cilësinë e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, të shkruaj parathënien e Buletinit të parë jubilar të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, atë të 10-tin me rradhë. Buletini është bërë pikë referimi, i dobishëm dhe i cituar shpesh nga ata që punojnë në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të të drejtave e lirive themelore të njeriut. Edhe këtë herë jemi përkushtuar të tregojmë disa nga rezultatet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2020.

Ky edicion i Buletinit përmban të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2020 dhe një përzgjedhje të kujdesshme të aktvendimeve më të veçanta. Sikurse të gjitha gjykatat e tjera të rajonit dhe botës, edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës është përballur me sfidat e pa pritshme të pandemisë COVID-19, të cilat kanë kërkuar adaptim të menjëhershëm dhe vigjilent të ushtrimit të suksesshëm të detyrave tona kushtetuese. Përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia, Gjykata Kushtetuese ka vazhduar aktivitetin e saj të punës pa asnjë ndërprerje, me kombinim të punës në zyrë dhe nga distanca, në përputhje me rregullat dhe rekomandimet specifike të institucionet përkatëse shëndetësore në nivel të Republikës së Kosovës.

Përgjatë vitit 2020, Gjykata ka trajtuar një numër të madh të lëndëve, në mes të tyre (i) dy raste specifike që ndërlidheshim me masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19; (ii) dy raste të parashtruara nga Avokati i Popullit lidhur me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin për Zyrtarët Publik; (iii) rastin e parashtruar nga deputetët e Kuvendit, lidhur me Dekretin e Presidentit për propozimin e kandidatit për Kryeministër; si dhe (iv) raste të parashtruara nga gjykatat e rregullta në kuadër të kontrollit incidental.

Gjatë vitit, Gjykata po ashtu ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve sa i përket kërkesave individuale. Në këto të fundit, duke trajtuar pretendimet e parashtruesve dhe duke aplikuar parimet e vendosura nga praktika e saj e konsoliduar gjyqësore dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje të neneve të Kushtetutës përkitazi me: (i) mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural; (iii) të drejtën për qasje në gjykatë; (iv) mungesën e mbajtjes së seancës dëgjimore; (v) parimin e sigurisë juridike; (vi) parimin e paanësisë së gjykatës; (vii) parimin e sigurisë juridike si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të praktikës gjyqësore; (viii) mospërmbarimin e vendimit; (ix) pjesëmarrjen e dëshmitarëve; (x) të drejtën për jetë private në aspekt të regjistrimit të vdekjes së një personi, etj.

Është e rëndësishme të theksohet që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, të konsultojnë me vëmendje këtë Buletin jubilar, si dhe buletinët e mëparshëm, dhe të vlerësojnë nëse rasti i tyre mund të ketë mundësi suksesi, duke iu referuar vendimeve të ngjashme të Gjykatës. Gjithashtu, buletinët e Gjykatës dhe e gjithë praktika gjyqësore e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës është aty për t'i shërbyer institucioneve dhe personave fizikë e juridikë që të ndërtojnë sa më mirë argumentet e tyre kushtetuese dhe të realizojnë, në praktikë, të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutë.

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata dhe gjyqtarët e saj i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese, ashtu siç parashihet në Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, pa punën dhe përkrahjen e të cilëve nuk do të ishte i mundur publikimi i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KO197/19, Parashtrues: Gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, Gjykata Themelore në Prishtinë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat

KO197/19, Aktvendim i miratuar më 22 janar 2020, publikuar më 19 shkurt 2020

Fjalët kyçe: kërkesë institucionale, kontroll incidental, palë e autorizuar

Kjo kërkesë është dorëzuar nga gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Gjykatat), për të cilin pretendohet se është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Thelbi i kërkesës së parashtruesve të kërkesës konsiston në pretendimin se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat, duke përcaktuar që lëndët që bien në kompetencë të Departamentit Special, por për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të procedohen në gjykatat përkatëse, rrjedhimisht në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, ndërsa rastet e natyrës së njëjtë por për të cilat nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor, do të trajtohen në kuadër të Departamentin Special, cenon parimin për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë përbërëse e së drejtës për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës. Andaj, Gjykata fillimisht vlerësoi nëse parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë, respektivisht nëse kërkesa është dorëzuar nga një "gjykatë" siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 113 të Kushtetutës. Gjykata konsideroi se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e tyre si gjyqtarë të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një "gjykatë" që ka rastin në shqyrtim, siç përcaktohet në nenin 113, paragrafin 8 të Kushtetutës.

Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO197/19

Parashtrues

**Gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda,
Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, e nënshkruar nga Suzana Qerkini, Shpresa Hasaj Hyseni, Isuf Makolli, Shasivar Hoti, Violeta Namani, Naser Foniqi, Nushe Kukaj Meka, Beqir Kalludra, Vesel Ismajli, Lutfi Shala, Naime Jashanica (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesve për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatat), për të cilin pretendohet se është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 të

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.8 të Kushtetutës, në nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 77 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 4 nëntor 2019, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
5. Më 7 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
6. Më 15 nëntor 2019, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës: parashtruesit e kërkesës, Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Avokatin e Popullit, Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor të Republikës së Kosovës.
7. Më 22 janar 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 23 nëntor 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Gjykatat, i cili u shpall në Gazetën Zyrtare, më 18 dhjetor 2018.
9. Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat themelohet Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, që të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
10. Sipas nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit për Gjykatat: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës,*

për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të transferohen për shqyrtim në Departamentin Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre.”

11. Më 23 prill 2019, në bazë të Ligjit për Gjykatat, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) kishte miratuar Rregulloren (nr. 03/2019) për organizimin dhe funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

12. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
13. Thelbi i kërkesës së parashtruesve të kërkesës konsiston në pretendimin se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat, duke përcaktuar që lëndët që bien në kompetencë të Departamentit Special, por për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të procedohen në gjykatat përkatëse, rrjedhimisht në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, cenon nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së .
14. Parashtruesit e kërkesës argumentet e tyre lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit për Gjykatat i ndërtojnë duke u bazuar në parimin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor në çështje penale ku theksojnë se gjykimi i lëndëve që referohen nga Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PSRK) nga Departamenti i Krimeve të Rënda e jo nga Departamenti Special do ta vështirësonte gjykimin e këtyre çështjeve penale brenda afatit të arsyeshëm kohor. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës përmendin disa raste duke potencuar se “ [...] është rasti ‘Medikus, i cili është në gjykim më tepër se 10 vite, dhe gjykimi ende vazhdon, pastaj rastet “Tokat dhe 2”, “Syri i Popullit”, “Veteranët”, “Vizat” si dhe shumë lëndë të tjera të kësaj natyre.”
15. Në kontekstin e këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) *H kundër Francës*, kërkesa nr. 10073/82, Aktgjykim i 24 tetorit 1989. Parashtruesit e kërkesës, më tej sqarojnë se pranojnë ankesa nga palët në procedurë për shkak të tejzgjatjes së

procedurës për arsye se në Departamentin për Krime të Rënda, pjesë e të cilit janë parashtruesit e kërkesës, në të njëjtën kohë gjykohen raste të cilat bien në kompetencën e tyre lëndore, përfshirë edhe rastet që me dispozitat e Ligjit për Gjykatat bien edhe në kompetencën e Departamentit Special.

16. Parashtruesit e kërkesës po ashtu theksojnë se *“Departamenti special është themeluar për të shqyrtuar lëndët të cilët janë në kompetence të PSRK-se, e që janë raste që kanë të bëjnë me vepra penale të një natyre veçanërisht të rëndë, dhe në funksion të natyrës së këtyre rasteve edhe është zhvilluar një procedurë e veçantë e përzgjedhjes së gjyqtarëve, i cili proces është strukturuar mbi disa kushte, të cilat është dashur t'i plotësoj gjithsecili që ka pretenduar të perzgjedhet si gjyqtar në kuadër të këtij departamenti, andaj gjyqtarët të cilët janë përzgjedhur është vlerësuar se janë të vetmit që mund të gjykojnë lëndë të kësaj natyre.”* Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në këtë rast shkelet parimi i gjykimit të drejtë, për arsye se *“[...]të akuzuarit gjykohen nga një nivel gjyqësor jo kompetent, jo i përgatitur në nivel të mjaftueshëm profesional karshi këtyre lëndëve të kësaj natyre, pastaj shkelja e parimit të gjykimit të drejtë ndërlihet edhe me shkeljen e parimit të barazisë së palëve, pasi që persona të cilët kanë kryer vepra të një natyre të njëjtë gjykohen nga Departamente të ndryshme, e në këtë funksion nga gjyqtar të cilët supozohen se kanë nivel të ndryshme të përgatitjes profesionale, gjegjësisht qëndrojnë me lartë, në bazë të kriterëve të cilat janë zbatuar me rastin e përzgjedhjes se tyre.”*
17. Parashtruesit e kërkesës më tej specifikojnë se vazhdimi i gjykimit të rasteve që bien në kompetencën e Departamentit Special, nga Departamenti i Krimeve të Rënda përbën shkelje “të trajtimit të barabarte të palëve”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit të GJEDNJ-së *Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [kërkesa nr. 9074/07, Aktgjykim i 23 qershorit 2010, paragrafi 86], në të cilin rast GJEDNJ ndër të tjera kishte vlerësuar se *“[...] ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlihdura duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me sundimin e ligjit”*.
18. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat është në kundërshtim me nenin 18 [Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës] dhe nenin 19 [Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore], si dhe me nenin 42, paragrafët 3 dhe 5 të vetë Ligjit për Gjykatat, të cilat dispozita i referohen kompetencës

lëndore të Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë për të shqyrtuar rastet që bien në kompetencë të PSRK-së.

19. Më tej, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit të kontestuar “përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale” sipas nenit 384 [Shkelja esenciale e dispozitave të Procedurës Penale], paragrafi 1, pika 6 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës për arsye se *“aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.”* Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “[...] kompetenca lëndore asnjëherë më parë nuk ka ndodhë të shpërndahet në dy shkallë, dhe të gjykohet nga dy instanca të ndryshme gjyqësore.”
20. Në fund, parashtruesit e kërkesës duke iu referuar *“nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 18 dhe 22 të KPPRK-së, nenit 18 dhe 19 të Ligjit për Gjykata[t] [kërkojnë] nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës:*
 1. *Pranimin e kërkesës së Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda;*
 2. *Shfuqizimin e nenit 41 [42] par. 4 të Ligjit për Gjykata[t] në paragrafin e parë si të papajtueshëm me nen[in]et 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”*

Dispozitat relevante të Ligjit për Gjykatat

Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat

Neni 3

Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor

1. *Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj.*
[...]

Neni 18

Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

1. *Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë*

Speciale të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet pasuese.

2. Të gjitha çështjet në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të PSRK-së gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionistë, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Neni 19

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore

1. Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale.

2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

[...]

Neni 42

Caktimi i gjyqtarëve në Departamentin Special për Lëndët në Kompetencë, në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe zgjidhja e lëndëve të pakryera

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më së largu gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të përzgjedh gjyqtarët të cilët do të shërbejnë në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Departamentin për lëndët në kompetencë të PSRK-së, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi.

2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet gjithashtu të ndërmarrë të gjitha masat për të funksionalizuar Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, duke përfshirë rekrutimin e stafit mbështetës si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë

3. Gjyqtarët që caktohen të punojnë në Departamentin Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Departamentin për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në Gjykatën e Apelit, mund të angazhohen në trupe gjykuese për gjykimin e lëndëve në kuadër të Departamentit për

Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë, respektivisht në Gjykatën e Apelit.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të transferohen për shqyrtim në Departamentin Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, që janë në Gjykatën e Apelit, do të vazhdojnë të shqyrtohen nga kolegji përkatës, i cili e ka lëndën në shqyrtim në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës që pranohen në Gjykatën e Apelit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të shqyrtohen nga Departamenti për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 8, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

8. Gjykatat kanë të drejtë t’i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.”

23. Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, që përcaktojnë:

*Neni 51
Saktësimi i kërkesës*

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

*Neni 52
Procedura para Gjykatës*

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

*Neni 53
Vendimi*

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

24. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 77 të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit]

(1) Kërkesa e ngritur sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit.

(2) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë një kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

(a) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata në lidhje me çështjen në pritje; dhe

(b) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin lidhur me rastin në pritje të gjykatës.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën. Dokumenti i shqyrtuar nga Gjykata i bashkëngjitet kërkesës.

(4) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në rast dhe pavarësisht nëse një palë në rast ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

(5) Pas parashtrimi të kërkesës, Gjykata urdhëron gjykatën referuese që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë derisa të merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

25. Gjykata fillimisht thekson se parashtruesit e kërkesës në “Objektin” e kërkesës së dorëzuar në Gjykatë specifikojnë nenin 41, paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatat, si dispozitë që kontestojnë para Gjykatës. Megjithatë, Gjykata vëren se në tërë përmbajtjen e kërkesës së tyre, parashtruesit e kërkesës i referohen nenit 42, paragrafit 4 të Ligjit të kontestuar si dispozitë, kushtetutshmërinë e së cilës e kontestojnë para Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kontestojnë nenin 42, paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatat.
26. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar sipas nenit 113, paragrafit 8 të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t’i plotësojë kriteret në vijim, të cilat janë të ndërlidhura ngushtësisht me njëra tjetrën, dhe të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative:
 - a) kërkesa të jetë dorëzuar nga një “gjykatë”;
 - b) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj;
 - c) kushtetushmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim;
 - d) gjykata (referuese) duhet të mos jetë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën;
 - e) gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozitat të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën.
27. Andaj, Gjykata do të vlerësojë, fillimisht, nëse parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë, respektivisht nëse kërkesa është dorëzuar nga një “gjykatë” siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 113 të Kushtetutës, Ligj dhe Rregullore të Punës.

28. Lidhur me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore ku janë zbatuar kriteret e lartpërmendura, përkritazi me pranueshmërinë e kërkesave të paraqitura në bazë të paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KO59/14, parashtrues *Hilmi Hoxha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 qershorit 2014, KO126/16, parashtrues: *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 marsit 2017, paragrafi 62; KO142/16, parashtrues: *Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 58, si dhe rastin KO157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, të 13 marsit 2019, paragrafi 45).
29. Gjykata rikujton se në rastin KO157/18, të cekur më lart, në të cilin rast kërkesa ishte dorëzuar nga Gjykata Supreme dhe ishte nënshkruar nga Kryetari i saj, në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij. Kërkesa kishte theksuar qartë se ajo paraqitet nga Gjykata Supreme e cila duhet të vendoste për revizionin e një kompanie të sigurimit kundër një Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit dhe vendosja lidhur me revizionin lidhej drejtpërdrejt me kushtetutshmërinë e normës juridike që duhej të aplikohet në rastin para saj. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese kishte konsideruar se kërkesa ishte dorëzuar nga “gjykata” që ka rastin në shqyrtim para saj në kuptim të paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës (shih rastin e sipërcekur KO157/18, paragrafi 48).
30. Gjykata rikujton se në rastin KO126/16, të cekur më lart, kishte vlerësuar se “gjykatë” është gjithashtu, çdo gjyqtar ose koleg gjyqtarësh që ka kompetencë të plotë për të gjykuar meritat e një rasti ne pritje përpara saj. Në rastin e lartcekur gjyqtari që kishte referuar çështjen para Gjykatës Kushtetuese gjykonte çështjen nëpërmjet gjyqtarit të vetëm, si gjyqtar kompetent për të vendosur lëndën lidhur me të cilën kishte referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata kishte konstatuar se në pajtim me nenin 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, kërkesa në fjalë, ishte dorëzuar nga “gjykata” që ka rastin në shqyrtim në kuptim të nenit 113, paragrafit 8 të Kushtetutës (shih rastin e sipërcekur KO126/16, paragrafët 59 dhe 60).
31. Gjykata vëren se rasti i parashtruesve të kërkesës, dallon nga rastet e lartcekura. Gjykata rikujton se në rastin konkret, kërkesa nuk është dorëzuar as nga një koleg gjyqësor që ka rastin në shqyrtim e as nga

Kryetari i Gjykatës Themelore në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij/saj, por është dorëzuar dhe nënshkruar nga njëmbëdhjetë (11) gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht gjyqtarë të Departamentit për Krime të Rënda, të cilët e kontestojnë në mënyrë abstrakte përputhshmërinë e paragrafit 4, të nenit 42 të Ligjit për Gjykatat me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

32. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, nuk kanë saktësuar nëse ndonjë trup gjykues i Departamentit për Krime të Rënda, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka një “rast në shqyrtim” para saj e që sipas dispozitave të përgjithshme të Ligjit për Gjykatat, do të duhet të trajtohet nga Departamenti Special, dhe nëse po, cili është ai rast. Parashtruesit përmendin disa raste siç *“është rasti “Medikus”, i cili është në gjykim më tepër se 10 vite, dhe gjykimi ende vazhdon, pastaj rastet “Tokat dhe 2”, “Syri i Popullit”, “Veteranët”, “Vizat” si dhe shumë lëndë të tjera të kësaj natyre*” por pa saktësuar, rrethanat specifike të këtyre rasteve, nëse këto raste sipas natyrës së tyre do të duhej të trajtoheshin nga Departamenti Special e që aktualisht trajtohen nga Departamenti për Krime të Rënda, që do të dëshmonte para Gjykatës se kërkesa është dorëzuar nga një “gjykatë” që ka rastin në shqyrtim para saj, si dhe gjithashtu që do të dëshmonte se kriteret e tjera për pranueshmërinë e kërkesës janë plotësuar në rastin konkret.
33. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e tyre si gjyqtarë të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një “gjykatë”, siç përcaktohet në legjislacionin e përmendur me lart, me saktësisht, në nenin 113, paragrafin 8 të Kushtetutës, Ligjin dhe Rregulloren e Punës dhe si është specifikuar më tej në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate.
34. Për më tepër, Gjykata duke iu referuar kriterëve të tjera të papranueshmërisë të përcaktuara në nenit 113, paragrafit 8 të Kushtetutës, vlerëson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar gjithashtu, nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastet në shqyrtim para saj dhe nëse kushtetushmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim.
35. Në vijim, Gjykata, me gjithë përfundimet e nxjerra më lartë, vëren po ashtu se pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës është se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat cenon nenin 31 të Kushtetutës, konkretisht parimin për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë

përbërëse e së drejtës për një gjykim të drejtë. Lidhur me këtë, pa paragjykuar kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave ligjore, Gjykata i referohet parimeve kryesore të vendosura në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së sa i përket gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, sipas së cilave, pretendimet lidhur me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm vlerësohet në dritën e rrethanave të rasteve specifike, dhe jo në mënyrë abstrakte, në veçanti duke marrë për bazë: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58 dhe KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 majit 2018, paragrafi 43; shih gjithashtu Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 38).

36. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 51 të Ligjit dhe me rregullat 59 (b) dhe 77 (2) dhe të Rregullores së punës, më 22 janar 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO54/20, Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020

KO54/20, Aktgjykim i 31 marsit 2020, publikuar më 6 prill 2020

Fjalët kyç: Kërkesë institucionale, neni 113.2 (1) i Kushtetutës, liria e lëvizjes, liria e tubimit, e drejta e privatësisë, kufizim i pa “përcaktuar në ligj”, Qeveria, Kuvendi, Presidenti, dallimi në mes të nenit 55 dhe 56 të Kushtetutës, kufizim vs. shmangie,

Më 24 mars 2020, Presidenti parashtroi kërkesën KO54/20 në Gjykatë. Përmes kësaj kërrese, Presidenti kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 01/15 të 23 marsit 2020] të Qeverisë si dhe vendosjen e masës së përkohshme ndaj Vendimi të kontestuar të Qeverisë.

Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në pajtueshmëri me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 35 [Liria e Lëvizjes], 43 [Liria e Tubimit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës; nenin 2 [Liria e lëvizjes] të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; si dhe me nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Në titullin **VII – PËRFUNDIME** - të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 310-325), Gjykata përmbodhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Si çështje paraprake, Gjykata në këtë Aktgjykim sqaroi se nuk është roli i saj që të vlerësoj se a janë adekuate dhe të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjë palë në këtë rast. Përcaktimi i politikave rreth shëndetit publik nuk hyn në kompetencat dhe autorizimet e Gjykatës Kushtetuese. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese u referohet dhe bindet institucioneve përkatëse shëndetësore dhe profesionale në nivel shtetëror dhe botëror.

Çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Vendimit të kontestuar të Qeverisë, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij, Qeveria ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në përputhje me ligjin apo përtej autorizimeve të

përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, përkitazi me vlerësimin nëse kufizimet e bëra në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë janë të përcaktuara me ligj, Gjykata është fokusuar në vlerësimin e autorizimeve të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

Në këtë drejtim, Gjykata shqyrtoi: (i) kërkesën e parashtruesit dhe pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë; (ii) komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe palët e tjera të interesuara; (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-s dhe posaçërisht, parimeve të përgjithshme rreth aplikueshmërisë së kriterit “*e përcaktuar me ligj*” për sa i takon aspektit të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore; dhe (iv) praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në shqyrtimet dhe vlerësimet e sipërshënuara, Gjykata, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën KO54/20 të pranueshme për shqyrtim në merita meqë, në rrethanat e rastit konkret, ishin plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

Po ashtu, Gjykata vendosi njëzëri se Vendimi [nr. 01/15] i 23 marsit 2020 i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta për privatësi], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare) dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së.

Gjykata konstatoi se kufizimet që përmban Vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të “*përcaktuara me ligj*”, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNJ-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

Gjykata theksoi faktin që Vendimi i kontestuar i Qeverisë, i referohet zbatimit të dy ligjeve të lartcekura, të cilat e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë që të ndërmarrë masa të caktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, Gjykata konstatoi se ligjet e lartcekura, nuk e autorizojnë Qeverinë që të kufizojë të drejtat dhe liritë kushtetuese të përcaktuara me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.

Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se kufizimet e shqiptuara përmes Vendimit të kontestuar: (i) lidhur me lirinë e lëvizjes dhe të tubimit të përcaktuara përmes neneve 35 dhe 43 të Kushtetutës, tejkalojnë kufizimet e lejuara përmes ligjit të lartcekur të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) lidhur me *“tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura ose të mbyllura”* e që ngërthejnë aspekte të të drejtave të garantuara përmes nenit 36 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara në asnjë autorizim të përcaktuar me ligjin e lartcekur apo edhe ndonjë ligj tjetër të Kuvendit.

Gjykata sqaroi se Qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i të drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit. Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se ky nen nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, ngase i njëjti është i aplikueshëm vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Gjithsesi, lidhur me mos-pajtimin e palëve në kontest, Presidentit dhe Qeverisë, rreth kuptimit të termeve kushtetuese *“kufizim”* dhe *“shmangie”* që figurojnë në nenet 55 dhe 56 të Kushtetutës, Gjykata qartësoi se *“kufizimi”* i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet *“vetëm me ligj”* të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që *“kufizimi”* i të drejtave, mund të bëhet vetëm përmes dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjykata po ashtu sqaroi se termi *“kufizim”* i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Thënë ndryshe, *“kufizimi”* nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërkaq *“shmangia”* nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.

Për sa i takon kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se pas vendimit unanim të gjyqtarëve që të vendosin në tërësi për meritat e rastit dhe të nxjerrin këtë Aktgjykim, e njëjta ngeli e pa objekt shqyrtimi.

Duke u bazuar në nenet 116.3 të Kushtetutës, 20.5 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, Gjykata përcaktoi

datën 13 prill 2020, si datë të hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, respektivisht shfuqizimit të Vendimit të kontestuar të Qeverisë.

Gjykata ka përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, përjashtimisht dhe duke marrë parasysh: (i) rrethanat e krijuara me shpalljen e pandemisë COVID-19 në nivel botëror; (ii) rekomandimet përkatëse të institucioneve shëndetësore në nivel shtetëror dhe botëror; (iii) pasojat potencialisht të dëmshme për shëndetin publik si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të kufizimeve të përcaktuara përmes Vendimit të Qeverisë; dhe (iv) mbrojtjen e shëndetit dhe interesit publik deri në zbatimin e këtij Aktgjykimi nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kohore dhe në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës përkitazi me *“kufizimin”* e të drejtave dhe lirive themelore, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, dhe në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, janë bërë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim.

Në fund, Gjykata po ashtu thekson se Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerr vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO54/20

parashtrues

Presidenti i Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë
së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Presidenti i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës ose Presidenti).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), i 23 marsit 2020 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në pajtueshmëri me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe

Instrumenteve Ndërkombëtare], 35 [Liria e Lëvizjes], 43 [Liria e Tubimit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: Kushtetuta); nenin 2 [Liria e lëvizjes] të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshme: KEDNJ); nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshme: DUDNJ); si dhe me nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejshme: PNDKP).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të Vendimit të kontestuar, deri në vendosje përfundimtare nga ana e Gjykatës, duke arsyetuar se vendosja e së njëjtës *“është në interesin publik dhe eviton rreziqet dhe dëmet e pariparueshme.”*

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar nën-paragrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: Ligji); si dhe në rregullat 32, 56, dhe 57 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 24 mars 2020, në orën 12:03, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Në të njëjtën ditë, më 24 mars 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të Gjyqtarëve: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Në të njëjtën ditë, më 24 mars 2020, Gjykata, përmes komunikimit elektronik, e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj që për çdo ndryshim lidhur me kërkesën ta njoftojë Gjykatën me urgjencë.
9. Po të njëjtën ditë, më 24 mars 2020, rreth orës 16:00, Gjykata, përmes komunikimit elektronik, njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti; (ii) Kryetaren e

Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, me kërkesën që një kopje të kërkesës t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe, (iii) Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari.

10. Me këto shkresa, Gjykata i njoftojë palët e interesuara se kërkesa do të trajtohet me urgjencë dhe prioritet të lartë duke marrë parasysh rrethanat në të cilën gjendet shteti i Republikës së Kosovës. Për rrjedhojë, Gjykata caktoi afate të shkurtra për të paraqitur komente. Për sa i takon mundësisë për paraqitjen e komenteve lidhur me caktimin e masës së përkohshme, Gjykata, të gjitha palëve të lartcekura, u caktoi afat deri në orën 22:00 të po të njëjtës ditë kur edhe u dërguan shkresat njoftuese, respektivisht më 24 mars 2020. Ndërkaq, për paraqitjen e komenteve lidhur me kërkesën në përgjithësi dhe meritat e saj, Gjykata iu caktoi një afat prej tri (3) ditësh nga momenti i pranimit të shkresës së Gjykatës, respektivisht deri më 27 mars 2020.
11. Brenda afatit të përcaktuar për të paraqitur komente lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, respektivisht deri në orën 22:00 të datës 24 mars 2020, Gjykata pranoi komente nga Kryeministri i Qeverisë, z. Albin Kurti, në emër të Qeverisë; deputeti i Kuvendit, z. Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, dhe deputeti i Kuvendit, z. Abelard Tahiri, në emrin e tij personal (shih paragrafët 45-72 të këtij Aktgjykimi ku dhe reflektohen komentet e tyre përkitazi me masën e përkohshme).
12. Gjithashtu, brenda afatit të përcaktuar për të paraqitur komente lidhur me kërkesën në përgjithësi, respektivisht tri (3) ditë nga momenti i pranimit të shkresës së Gjykatës – që nënkuptonte datën 27 mars 2020, Gjykata pranoi komente nga: Kryeministri i Qeverisë, z. Albin Kurti, në emër të Qeverisë [tashmë në detyrë]; z. Hilmi Jashari, në emër të Avokatit të Popullit; deputeti i Kuvendit, z. Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!; dhe deputeti i Kuvendit, z. Abelard Tahiri, në emrin e tij personal (shih paragrafët 73-149 të këtij Aktgjykimi ku dhe reflektohen komentet e tyre përkitazi me kërkesën në përgjithësi, respektivisht meritat).
13. Më 28 mars 2020, duke marrë parasysh urgjencën e rastit dhe nevojës që kërkesa të trajtohet me prioritet të lartë, Gjykata vetëm i njoftoi palët e interesuara për komentet e pranuar dhe u dërgoi një kopje të tyre, për informatën e tyre, pa iu dhënë ndonjë afat shtesë për tu kundër-përgjigjur në komentet e pranuar ngase një proces i tillë do të vononte vendimmarrjen e Gjykatës edhe për një kohë të caktuar. Për më tepër që, Gjykata po ashtu konsideroi që për të vendosur për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës në fjalë komentet e pranuar

mjaftojnë dhe nuk ka asnjë paqartësi e cila do të duhet të adresohet përmes pyetjeve shtesë ose komenteve shtesë.

14. Më 29 mars 2020, Qeveria dorëzoi në Gjykatë edhe dy vendime shtesë, respektivisht: (i) Vendimin nr. 01/17 të 27 marsit 2020 – përmes së cilit ishte ndryshuar dhe plotësuar Vendimi i kontestuar i Qeverisë; dhe (ii) Vendimin nr. 01/18 të 28 marsit 2020 – përmes së cilit janë ndërmarrë disa veprime shtesë në kuadër të masave të Qeverisë për mbrojtje të shëndetit publik.
15. Më 31 mars 2020, në seancën e mbajtur nëpërmes pajisjeve elektronike, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
16. Po të njëjtën datë, Gjykata votoi, njëzëri, se kërkesa është e pranueshme, dhe se Vendimi i kontestuar i Qeverisë, përkatësisht Vendimi nr. 01/15 i 23 marsit 2020, nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të drejtave të njeriut] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e lëvizjes], 36 [E drejta e Privatësisë], 43 [Liria e tubimit] të Kushtetutës dhe nenet ekuivalente të KEDNJ-së, respektivisht nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit), nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
17. Po të njëjtën datë, Gjykata votoi, njëzëri, se neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.
18. Po të njëjtën datë, Gjykata vendosi që kërkesa për masë të përkohshme ka ngelë pa objekt shqyrtimi pas vendosjes së rastit në merita.

Përmbledhja e fakteve

19. Nga 11 marsi 2020 e tutje, Qeveria nxori disa vendime që ndërlidhen me pandeminë COVID-19. (Shih vendimet e përmendura nga Qeveria: nr. 01/07 të 11 marsit 2020; nr. 01/08 të 12 marsit 2020; nr. 01/09 të 13 marsit 2020; nr. 02/09 të 13 marsit 2020; nr. 01/10 të 14 marsit 2020; nr. 01/11 të 15 marsit 2020; nr. 01/12 të 17 marsit 2020; nr. 01/13 të 18 marsit 2020).
20. Më 15 mars 2020, Qeveria nxori Vendimin nr. 01/11, për shpalljen e “emergjencës për shëndetin publik.” [Sqarim i Gjykatës: *as vendimet e lartcekura e as ky Vendim nuk është kontestuar para kësaj Gjykate dhe kjo e fundit nuk është duke shqyrtuar kushtetutshmërinë e vendimeve të lartcekura e as të Vendimit nr. 01/11; mirëpo, i njëjti*

është referuar si një nga bazat ligjore mbi të cilin është nxjerrë Vendimi i kontestuar [nr. 01/15] – kushtetutshmëria e të cilit po vlerësohet me këtë Aktgjykim - dhe rrjedhimisht është e rëndësishme të shpaloset përmbajtja e tij edhe e Vendimit nr. 01/11, të 15 marsit 2020].

21. Vendimi i lartcekur i Qeverisë kishte gjithsej katër pika. Në pikën I, u aprovua kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë që Qeveria të shpallë “emergjencë për shëndetin publik.” Në pikën II, u obliguan Institucionet e Qeverisë që të veprojnë konform Planit të reagimit kombëtar dhe të aktivizohet funksioni mbështetës emergjent 8 (FME8 shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore). Në pikën III, u obligua Ministria e Shëndetësisë për menaxhimin e situatës së shpallur. Në pikën IV, u theksua se Vendimi në fjalë i Qeverisë, i nënshkruar nga Kryeministrit, hyn në fuqi menjëherë, respektivisht më 15 mars 2020.
22. Më 23 mars 2020, Qeveria nxori një Vendim tjetër, respektivisht Vendimin nr. 01/15, të kontestuar para kësaj Gjykate. Në hyrje të Vendimit të kontestuar u theksua të jetë marrë në mbështetje të bazës vijuese kushtetuese dhe ligjore (shih pjesën “Baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Qeverisë”, pas paragrafit 150 të këtij Aktgjykimi ku ceket përmbajtja e të gjitha neneve vijuese):
 - a) Neni 55 [Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore] të Kushtetutës;
 - b) Paragrafi 4 i nenit 92 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës;
 - c) Paragrafin 4 i nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës;
 - d) Nenin 41 [Pa titull] dhe nenin 44 [Pa titull] të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse (në tekstin e mëtejme: Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse);
 - e) Paragrafit 1.11 të nenit 12 [Masat dhe Veprimet] dhe nenin 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë] të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi (në tekstin e mëtejme: Ligji për Shëndetësi);
 - f) Nenin 4 [Qeveria] të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
 - g) Nenin 17 [Mbledhjet korresponduese] dhe 19 [Marrja e vendimeve] të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011; si dhe,
 - h) Në zbatim të Vendimit të Qeverisë nr. 01/11 të 15 marsit 2020 [të lartcekur] për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik.

23. Sipas Vendimit të kontestuar, Qeveria, pas aprovimit të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë miratoi ndërmarrjen e masave vijuese për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19:

“1. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private nga 24 mars 2020 gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00, përveç për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore;

2. Mundësohet qarkullimi i lirë për operatorët ekonomik të klasifikuar si me të rëndësishme sipas kodeve NACE që Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike lejon të operojnë në këtë periudhë emergjente lidhur me pandeminë COVID-19, si dhe transporti i lirë i mallërave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit.

3. Lëvizjet në rrugë bëhen jo më shumë se nga dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët.

4. Ndalohen tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Në rast të vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit.

5. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi. [...]”.

24. Sipas pikës 6 të Vendimit të kontestuar ku shprehimisht thuhet se “Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit”, i njëjti hyri në fuqi më 23 mars 2020.
25. Më 24 mars 2020, Vendimi i lartcekur i Qeverisë u kontestua nga parashtruesi i kërkesës pranë kësaj Gjykate.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar, respektivisht Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë, të 23 marsit 2020. Sipas parashtruesit të

kërkesës, Vendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me nenet 21, 22, 35, 43, 55, 56 të Kushtetutës; nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ; nenin 13 të DUDNJ; si dhe nenin 12 të PNDCP.

27. Në lidhje me pretendimet e lartcekura, parashtruesi i kërkesës dorëzoi argumente lidhur me: (i) pranueshmërinë e kërkesës; (ii) përmbajtjen/substancën e Vendimit të kontestuar; dhe (iii) caktimin e masës së përkohshme. Në vijim, Gjykata do të paraqes pretendimet e parashtruesit të kërkesës për të gjitha këto kategori.

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës dhe saktësimin e saj

28. Parashtruesi i kërkesës thekson se paragrafi (9) i nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës i jep shprehimisht kompetencë Presidentit për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë, sipas tij, *“është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.”*
29. Për rrethanat e rastit konkret, thekson parashtruesi i kërkesës, sipas nën-paragrafit (1) të paragrafit 2 të 113 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], Presidenti është palë e autorizuar që të kërkojë vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së Vendimit të kontestuar me Kushtetutën, *“lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore që mbrohen me Kushtetutë.”* Në zbatim të përgjegjësisë kushtetuese për garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, *“Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në rastet kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë, kur kërkohet të dihet se një ligj, dekret/vendim, rregullore a është në pajtim me Kushtetutën.”*
30. Për rrjedhojë, sipas parashtruesit të kërkesës, pranueshmëria e kësaj kërkesë është e *“vetëkuptueshme”* dhe Gjykata Kushtetuese ka juridiksion që të vendosë për çështjet që ndërlidhen me përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën. Pa dyshim, në këtë rast, sipas parashtruesit të kërkesës, këto dy kushte plotësohen dhe rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së Vendimit të kontestuar.
31. Lidhur me nevojën për saktësimin e kërkesës, siç kërkohet me nenin 29 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës thekson se kërkesa në fjalë është parashtruar *“për të shmangur çdo dilemë rreth kufizimit, nga*

Qeveria me akt administrativ, të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë.”

32. Sipas parashtresit të kërkesës, vendimet dhe veprimet e Qeverisë, duke përfshirë Vendimin e kontestuar, ku përfshihen masa për parandalimin dhe luftimin e virusit COVID-19, *“sa janë të mirëpritura, ato duhet të jenë të bazuara në Kushtetutë dhe ligje.”* Tutje, sipas pretendimit, në asnjë nga nenet e cekura në Vendimin e kontestuar *“nuk i jepë të drejtë Qeverisë nxjerrjen e një vendimi të tillë (paragrafi 1.11 i Nenit 12 dhe Neni 89 i Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësi [...]) si dhe neni 41 dhe neni 44 i Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse [...].”*
33. Përkundrazi, sipas pretendimit të parashtresit të kërkesës, *“në Republikën e Kosovës kjo çështje është shumë e qartë, ku në Nenin 56 të Kushtetutës, përcaktohet se shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas Kushtetutës dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna, ndërsa shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.*
34. Parashtresi i kërkesës përfundon duke theksuar se Qeveria, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar *“ka shmangë të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme sipas Kushtetutës dhe në këtë drejtim ka shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë”* andaj dhe *“kërkohet nga Gjykata Kushtetuese të vendos në mënyrë meritore lidhur me këtë kërkesë, duke anuluar këtë Vendim, për mos përputhje me Kushtetutën.”*

Pretendimet përkitazi me përmbajtjen/substancën e Vendimit të kontestuar

35. Lidhur me përmbajtjen e Vendimit të kontestuar, respektivisht meritat e kërkesës KO54/20 parashtresi i kërkesës konsideron se Qeveria *“e ka shpërfillur mandatin dhe përgjegjësitë e saja kushtetuese e ligjore, duke e tejkaluar kompetencat e saj dhe duke kufizuar në thelb lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit të garantuar sipas Nenit 35 dhe Nenit 43 të Kushtetutës”*. Kufizimi i këtyre të drejtave për të gjithë qytetarët pa dallim, sipas pretendimit të parashtresit të kërkesës, *“mund të bëhet me ligj dhe vetëm në rrethana të Gjendjes së Jashtëzakonshme, si dhe me kushte e rrethana që e arsyetojnë një kufizim të tillë, si dhe në masën që e arsyeton proporcionalisht esencën e të drejtës që kufizohet”*.

36. Të tillat kufizime, sipas parashtguesit të kërkesës mund të bëhen vetëm *“pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës së Kosovës, dhe me pëlqimin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës”*, ashtu siç shprehimisht parashihet me nenin 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] Kushtetutës.
37. Parashtguesi i kërkesës thekson se Kushtetuta me nenin 131 ka përcaktuar që liritë dhe të drejtat e individëve mund të kufizohen vetëm në rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe, sipas tij, *“në asnjë rrethanë, në çfarëdo gjendje tjetër.”* Përveç këtij fakti, vijon pretendimi i parashtguesit të kërkesës, *“Kushtetuta përcakton që kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë akt mund të bëhen deri në atë shkallë dhe për aq kohë sa është e nevojshme, dhe sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë.”* Rrjedhimisht, ai thekson se një gjë e tillë nënkupton që *“kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë nuk mund të vendosen në rastet kur gjendja e tillë nuk arsyeton kufizimin e vendosur.”*
38. Më tutje, parashtguesi i kërkesës, duke cituar nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës thekson se i njëjti garanton se çfarëdo kufizimi i të drejtave dhe lirive, me përjashtim të atyre në paragrafin 2 të këtij neni, mund të bëhen vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe vetëm në mënyrën e përcaktuar në Kushtetutë, si në vijim: *“1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna. 2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash”.*
39. Sipas parashtguesit të kërkesës, *“Kushtetuta shprehimisht e rregullon shmangien nga këto të drejta dhe liri, pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe zbatimi rigoroz i proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me kufizimin e së drejtës, duke e lejuar shmangien vetëm për aq sa është domosdoshme në rrethana të caktuara, pra vetëm në rrethana pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme.”* Sipas tij, kjo do të thotë se *“vlefshmëria e masave të shmangies nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është e kufizuar në kohë, dhe këto masa pushojnë me heqjen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, dhe asesi nuk mund të vendosen nga Qeveria, për aq sa Kushtetuta nuk parasheh asnjë*

përgjegjësi të Qeverisë, në vendosjen për masat e tilla të karakterit kufizues.”

40. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës përfundon pretendimet e tij lidhur me përmbajtjen e Vendimit të kontestuar duke theksuar se i njëjti *“ka kufizuar disa nga lirit dhe të drejtat e njeriut të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë siç janë Liria e Lëvizjes, Liria e Tubimit etj, edhe pse të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj dhe se shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas Kushtetutës.”*

Pretendimet përkitazi me nevojën e caktimit të masës së përkohshme

41. Duke theksuar nenin 116.2 të Kushtetutës dhe nenin 27 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës thekson se *“është në interesin e qytetareve që të mos shkelen të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara dhe mbrojtura me Kushtetutë”* dhe kjo është arsyeja për shkak të së cilës është kërkuar nga Gjykata *“që të vendosë masë të përkohshme ndaj çështjes së ngritur, deri në vendimin përfundimtarë.”*
42. Sipas parashtruesit të kërkesës, vendosja e masës së përkohshme në këtë rast *“është në interesin publik dhe eviton rreziqet dhe dëmet e pariparueshme.”* Sipas tij, *“zbatimi i vendimit të kontestuar të Qeverisë, do të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shkaktimin e pasojave juridike (ligjore, financiare, ekonomike, etj.), nga pamundësia e ushtrimit të të drejtave themelore të njeriut, si vlera të garantuara juridike në rendin kushtetues e ligjor Kosovar, si dhe pasoja të shumëfishta në ushtrimin e autorizimeve kushtetuese dhe ligjore nga institucionet dhe organet që vendimi i kontestuar i obligon për zbatimin e tij.”*
43. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se pezullimi i Vendimit të kontestuar është në interesin publik *“për arsye substanciale”* ngase pikërisht nga zbatimi ose jo i Vendimit të kontestuar të Qeverisë *“varet krijimi, ndryshimi apo shuarja e zbatimit të plotë të ushtrimit dhe realizimit efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.”*
44. Si rrjedhojë, në fund, lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që *“pa paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës, të miratojë menjëherë kërkesën për masë të përkohshme, përkitazi me vendimin e kontestuar të Qeverisë, në mënyrë që të parandalohen dëmet e*

pariparueshme për çdo person dhe shtetas të Republikës së Kosovës, si dhe dëmet e pariparueshme në aspektin e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv për të evituar e parandaluar abuzimet eventuale si pasojë e kufizimeve të të drejtave dhe lirive të kufizuara, gjatë gjendjes së emergjencës së shëndetit publikë, në emër të masave të Qeverisë për “mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të njerëzve” dhe jashtë kornizave kushtetues e ligjore të gjendjes së jashtëzakonshme.”

Komentet e dorëzuara lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, deri në orën 22:00 të datës 24 mars 2020

45. Siç është cekur në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit iu kishte dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme në rastin KO54/20 deri në orën 22:00 të datës 24 mars 2020. Në vijim, Gjykata do të paraqes të gjitha komentet e pranuar [gjithsej tri palë sosh] lidhur me masën e përkohshme brenda afatit të përcaktuar.

Komentet e dorëzuara nga Qeveria

46. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, Qeveria theksoi se paragrafi (4) i rregullit 57 të Rregullores së punës të Gjykatës *“përcakton tri kushte të domosdoshme që parashtruesi duhet të përmbushë në mënyrë që të miratohet kërkesa për masë të përkohshme”*. Para se Kolegji Shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, thekson Qeveria, duhet të konstatohet që: *“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës; (b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe (c) masa e përkohshme është me interes publik.”*
47. Qeveria, përmes komenteve të saj pretendon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, respektivisht Presidentit, *“nuk përmbush asnjërin nga këto tri kriteret e nevojshme për miratimin e masës së përkohshme, lëre më të gjitha prej tyre.”*
48. Lidhur me kriterin e parë, respektivisht argumentimin e kërkesës në nivel *prima facie*, Qeveria thekson se parashtruesi i kërkesës *“ka dështuar plotësisht që të tregojë rastin prima facie për meritat e kërkesës, për shkak se kërkesa e tij ndërtohet në një gabim elementar në fushën e të drejtave të njeriut”*. Sipas Qeverisë, kërkesa e

parashtruesit *“pretendon se Vendimi i Qeverisë është kundërkushtetues për shkak se, sipas tij, është e palejueshme që institucionet shtetërore të kufizojnë të drejtat e njeriut, përfshirë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, pa u shpallur më së pari Gjendja e Jashtëzakonshme”* dhe se një pretendim i tillë është *“i gabueshëm, jo vetëm se është qartazi i pabazuar në lidhje me Kushtetutën”* por edhe është *“qartazi i pabazuar në lidhje me të gjitha instrumentet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe qartazi i pabazuar në lidhje me jurisprudencën”* e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.

49. Qeveria thekson se pikërisht në dispozitat e cituara nga vet parashtruesi i kërkesës përcaktohet shprehimisht se *“edhe pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme, mund të kufizohen të drejta të njeriut, sikurse liria e lëvizjes dhe liria e tubimit.”* Për shembull, thekson Qeveria, sipas Aktgjykimit të kësaj Gjykatës Kushtetuese në rastin KO131/12, paragrafi 128, është theksuar se neni 55 i Kushtetutës *“është i dyfishtë: ai ofron arsyetim për kufizimin e të drejtave kushtetuese, por në të njëjtën kohë ofron edhe kufijtë e kufizimit të tillë”*. Sipas Qeverisë, kur Gjykata Kushtetuese ka shkruar këto fjalë, Republika e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të jashtëzakonshme mirëpo edhe pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme, *“neni 55, sipas Gjykatës, prapëseprapë e paska rolin për të ofruar "arsyetim" për kufizimin e të drejtave kushtetuese.”*
50. Duke cituar nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së dhe nenin 11 të KEDNJ-së, Qeveria pretendon se këto dispozita dëshmojnë se është qartazi i pabazuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës *“që Vendimi i Qeverisë është gjoja kundërkushtetues për shkak se ai kufizon të drejtat e njeriut pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.”* Ndonëse është e vërtetë se Vendimi i Qeverisë kufizon lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, thekson Qeveria; megjithatë, parashtresa e dorëzuar nga Presidenti si parashtrues *“nuk ofron as edhe një argument të vetëm pse këto kufizime janë kundërkushtetuese, përveç mungesës së shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme, që është totalisht jorelevant në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve të të drejtave të njeriut.”* Rrjedhimisht, përfundon Qeveria, kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk *“tregon rastin prima facie për meritat e kërkesës.”*
51. Më tutje, Qeveria thekson se kërkesa e dorëzuar nga Presidenti *“vuan nga një ngatërrim total ndërmjet dy koncepteve elementare në fushën e të drejtave të njeriut: (1) koncepti i kufizimit të të drejtave të njeriut dhe (2) koncepti i shmangies së të drejtave të njeriut.”* Sipas

Qeverisë, qëndron fakti se *“shmangia e të drejtave të njeriut nuk mund të bëhet pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme, por, siç u vërtetua më sipër, e njëjta nuk qëndron për kufizimin e të drejtave të njeriut.”* Në këtë aspekt, Qeveria thekson se, fakti që Presidenti si parashtrues kërkesë ka dështuar *“të respektojë dallimin thelbësor ndërmjet këtyre koncepte, dëshmohet me disa pretendime të tij të pasakta.”* Si shembull në këtë drejtim, jepet referenca e Presidentit në nenin 56 të Kushtetutës dhe në përjashtimet e parapara në paragrafin 2 të atij neni ku theksohet se kufizimet *“mund të bëhen vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe vetëm në mënyrën e përcaktuar në Kushtetutë.”* Sipas Qeverisë, ky pretendim është i gabuar ngase neni 56 i Kushtetutës *“nuk përmend fare konceptin e kufizimit, por vetëm konceptin e shmangies (“derogation”), që do të thotë, pezullimi i të drejtave të njeriut.”* Sa për ilustrim, vijon Qeveria, *“shmangia e nenit 30 të Kushtetutës [Të Drejtat e të Akuzuarit], do të nënkuptonte se asnjë nga kushtet e përcaktuara me nenin 30 (p.sh. që i akuzuari “të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh” (pika 5)), nuk do të kishte nevojë të përmbushej, nëse një masë e tillë është e domosdoshme në Gjendje të Jashtëzakonshme).”*

52. Në fund, lidhur me këtë pikë, Qeveria thekson se *“fakti që kërkesa e Presidentit keqkupton në thelb dallimin mes kufizimit dhe shmangies së të drejtave të njeriut, kjo nuk do të ishte detyrimisht problem për kërkesën presidentit, po të kishte ofruar edhe një argument të vetëm, se pse Vendimi i Qeverisë duhet të konsiderohet që paraqet shmangien, dhe jo vetëm kufizimin, e lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit.”* Me një argument të tillë të vlefshëm, thekson Qeveria, parashtruesi i kërkesës *“mbase do të mund të kishte arritur të përfundimi se Vendimi në fjalë është kundërkushtetues, për shkak se nuk është shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.”* Mirëpo, sipas Qeverisë, në tërë parashtrësën e Presidentit, nuk është ofruar asnjë argument në atë drejtim dhe për këtë arsye Qeveria konsideron se *“kërkesa e Presidentit përsëri dështon plotësisht të përmbushë kushtin e parë për miratimin e masës së përkohshme, për të treguar “rastin prima facie për meritat e kërkesës””*.
53. Lidhur me kriterin e dytë, respektivisht argumentimin e pësimit të dëmit të pariparueshëm, Qeveria thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të arsyetojë se si përmes zbatimit të Vendimit të kontestuar të Qeverisë pala në rastin konkret do të pësonte dëm të pariparueshëm. Në bazë të interpretimit gjuhësor të pikës (b) të paragrafit (4) të rregullit 57 të Rregullores së punës, ku përcaktohet që pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme, del në

sipërfaqe fakti i qartë, sipas Qeverisë, se parashtruesi i kërkesës “*nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me dëmin e pariparueshëm që ai — si palë në këtë procedurë — do të pësonte.*” Sipas praktikës së Gjykatës, duke cituar rastin KI56/09, thekson Qeveria, është detyrim i palës në procedurë që jo vetëm të ngritë si pretendim pësimin e dëmit të pariparueshëm, por të arsyetojë mjaftueshëm pësimin e një dëmi të tillë.

54. Tutje sipas Qeverisë, parashtruesi i kërkesës “*nuk e ka të qartë kuptimin e konceptit të “dëmit të pariparueshëm” në frymën e Kushtetutës*” sipas nenit 53 të saj dhe praktikës së GJEDNJ-së. Në lidhje me këtë të fundit, Qeveria theksoi disa vendime sipas të cilave, thekson Qeveria, “*dëmi ekonomik dhe financiar nuk mund të konsiderohen si “dëm i pariparueshëm” dhe se, në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës “nuk ka ofruar asnjë argument as për pretendimet për dëm financiar dhe ekonomik [...], por as dëmeve juridike të cilat i thekson.*”
55. Koncepti i dëmit të pariparueshëm është interpretuar, thekson Qeveria, në vendimin e GJEDNJ-së, *Abdollahi kundër Turqisë* (shih kërkesa nr. 23980/08), në të cilin rast parashtruesit i ishte aprovuar kërkesa për masën e përkohshme (ishte ndaluar deportimi i tij) pasi të njëjtit i cenohej e drejta në jetë, për shkak se kundër tij do të mund të zbatohesh dënimi me vdekje. Tutje, në rastin e GJEDNJ-së, *EH. kundër Suedisë* (shih kërkesa nr. 32621/06), GJEDNJ kishte aprovuar kërkesën për masën e përkohshme nën arsyetimin e shkaktimit të dëmit të pariparueshëm, sepse parashtruesi ishte në rrezik që ndaj tij të ushtrohej tortura apo madje edhe të vritej. Në rastin *Abraham Lunguli kundër Suedisë* (shih kërkesa nr. 33692/02), GJEDNJ kishte aprovuar kërkesën për vendosjen e masave të përkohshme për shkak se parashtruesja në të kundërtën do të mund t'i nënshtrohej keqtrajtimit dhe gjymtimit. Në rastet *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih kërkesë nr. 14038/88), *Ismoilov dhe të tjerët kundër Rusisë* (shih kërkesën nr. 2947/06) dhe *Otham (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih kërkesën nr. 8139/09), GJEDNJ ka theksuar se “dëm i pariparueshëm” konsiderohet rreziku që i kanoset një parashtruesi për realizimin e të drejtave të tij gjyqësore, respektivisht nëse parashtruesi ndodhet në një situatë kur mund të privohet në mënyrë flagrante nga drejtësia. Në këtë drejtim, Qeveria i referohet edhe disa raste të tjera të GJEDNJ ku është arsyetuar dëmi i pariparueshëm: *Kotsaftis kundër Greqisë* kërkesa nr. 39780/06; *Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar* kërkesa nr. 6339/05; *Öcalan kundër Turqisë* 46221/99; dhe *X.v. kundër Kroacisë* kërkesa nr. 11223/04.

56. Praktika gjyqësore e lartcekur e GJEDNJ-së, thekson Qeveria, dërgon në përfundimin se dëmet të cilat mund të konsiderohen si dëme të pariparueshme janë: *“privimi nga procedurat e drejta dhe të paanshme gjyqësore; privimi i parashtruesit nga qasja në drejtësi; rreziku që i kanoset parashtruesit se ai do të burgoset në mënyrë arbitrare; rreziku që i kanoset parashtruesit se ai do të mund t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor apo torturës; rreziku që i kanoset parashtruesit për jetën e tij.”*
57. Në këtë aspekt, Qeveria konsideron se parashtruesi i kërkesës, respektivisht pala në kuptim të pikës (b) të paragrafit (4) të rregullit 57 të Rregullores së punës *“jo vetëm që nuk ka parashtruar argumente se mund të pësoj ndonjërin nga dëmet e sipërpërmendura, por është fakt notor se vendimi i kontestuar nuk prodhon asnjë efekt juridik me pasoja të tilla.”*
58. Lidhur me kriterin e tretë, respektivisht argumentimin e kërkesës në nivel interesit publik, Qeveria konsideron se *“parashtruesi i kërkesës jo vetëm që nuk ka justifikuar interesin publik, si kërkesë për vendosjen e masave të përkohshme me efekt pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar, por ka deklaruar fakte të pavërteta në lidhje me efektin e vërtetë të akteve të Qeverisë.”*
59. Sipas Qeverisë, çështje të interesit publik, por pa u kufizuar në to, konsiderohen: siguria publike (e brendshme dhe nga jashtë); shëndeti publik; mbrojtja e ambientit; dhe siguri i stabilitetit financiar të shtetit. Është fakt notor, sipas Qeverisë, që parashtruesi i kërkesës *“nuk ka ofruar asnjë argument nëse si shkak i ekzekutimit të vendimit të kontestuar, rrezikohet siguria publike nga trazira të brendshme apo sulme të jashtme; rrezikohet shëndeti publik; dëmtohet ambienti apo rrezikohet stabiliteti financiar i Republikës së Kosovës.”*
60. Qeveria konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka justifikuar interesin publik si arsye për pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar; dhe për më tepër në këtë aspekt, sipas Qeverisë, *“pezullimi i Vendimit të Qeverisë, jo vetëm se nuk është në interes publik, por edhe paraqet kërcënim të interesit publik.”* Dhe kjo për faktin se, sipas Qeverisë, *“pezullimi i Vendimit, edhe vetëm përkohësisht, do të rrezikonte seriozisht shëndetin e qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës.”* Në këtë drejtim, Qeveria ka theksuar se: *“vërejmë se drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik [në tekstin e mëtejshëm: IKSH], Prof. Dr. Naser Ramadani, ka konstatuar publikisht se po hyjmë, tani dhe dy javët e ardhshme, në fazën më kritike në betejën kundër COVID-19. Pikërisht këtë arsye,*

dr. Ramadani, më 22 mars, i dërgoi ministrit të Shëndetësisë, rekomandime zyrtare me shkrim (shihni shkresën e bashkëngjitur), duke propozuar po ato masa që janë adoptuar tashmë me Vendimin e Qeverisë, përfshirë kufizimet në lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, në mënyrë që të luftohet përhapjen e virusit në këtë fazë kritike.” Vlerësimi shkencor i Prof. Dr. Ramadani, thekson Qeveria, “ishte se këto masa janë të domosdoshme, në këtë moment, “që të parandalojmë dhe zvogëlojmë dukshëm intensitetin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës” (f. 2 të Rekomandimeve). Kjo për shkak të (1) “përkeqësimit të situatës epidemiologjike me COVID-19 në botë dhe Europë” (po aty) dhe (2) rritjes së dukshme të rasteve të infektimit brenda Republikës së Kosovës.”

61. Rrjedhimisht, sipas Qeverisë, “pezullimi i Vendimit të Qeverisë do të pengonte, pikërisht në momentin më të ndjeshëm për qytetarët e Republikës, këtë parandalim dhe zvogëlim të intensitetit të pandemisë.” Fakti se Kosova po hyn tashmë në periudhën kritike të epidemisë, vetëm mori konfirmim të mëtijshëm prej faktit se, më 23 mars, rastet e infektimit në Kosovë janë gati dyfishuar. Në këto rrethana, sipas Qeverisë, “Kosova nuk mund të përballojë pezullimin e masave të rekomanduara nga drejtorit të IKPSH-së, në bazë të vlerësimit të tij profesional. Rreziqet që do të shkakttoheshin nga vonimi ose pezullimi i këtyre masave, edhe për pak ditë, mund të sjellë pasoja të rënda për qytetarët dhe banorët e Kosovës.” Tutje, theksohet se një fakt i tillë është dëshmuar nga rasti i Italisë, ku edhe një hezitim dhe vonesë e shkurtër në vendosjen e kufizimeve të rrepta, ka shkaktuar mijëra raste të vdekjes deri më sot.
62. Sipas Qeverisë, në mënyrë që shteti i Kosovës “t’i shmanget një fati të tillë, duhet të sigurohemi, sidomos në këtë moment, që masat e rekomanduara nga profesionistët dhe ekspertët tanë më të dalluar të shëndetit publik, mund të zbatohen pa ndërprerjen qoftë edhe më të shkurtër.” Rrjedhimisht dhe, sipas Qeverisë, “miratimi i masës së përkohshme, përkatësisht pezullimi i Vendimit të Qeverisë, jo vetëm se nuk është në interes publik, por edhe paraqet rrezik të madh për shëndetin e qytetarëve dhe banorëve të Kosovës.”
63. Gjykata rikujton që Qeveria, përveç komenteve të lartcekura, po ashtu ka dorëzuar në Gjykatë edhe një Rekomandim të lëshuar nga Drejtori i IKSHPK [Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës], Prof. Dr. Naser Ramadani në të cilin thuhet me sa vijon:

“Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Komiteti për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse të Ministrisë së

Shëndetësisë, bazuar në Vendimet e Qeverisë të ndërmarra deri tani:

Japim rekomandim për Ministrinë e Shëndetësisë që të ndërmerren masa konkrete në:

Ndalohet trafiku urban në tërë territorin;

Ndalohet qarkullimi i automjeteve në orar të caktuar (përjashtim automjetet zyrtare të cilat ndihmojnë në menaxhimin e pandemisë);

Ndalohet qarkullimi i qytetarëve (përveç rasteve urgjente dhe me nevoja të veçanta) Ndalohen çdo tubim: ahengje, ceremoni, dasma, party (në të gjitha ambientet), funeralet (vetëm familjarët e ngushtë), të cilat nuk garantojnë distancën 2 metra. [...]"

64. Si përfundim, Qeveria kërkoi nga Gjykata që “ta refuzojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vendosjen e masave të përkohshme”, ngase, sipas saj, Rregullorja e punës e Gjykatës përcakton se në mënyrë kumulative duhet të plotësohen kriteret e parapara e që në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

65. Grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme theksoi se: “Presidenti në kërkesën e tij për caktimin e masës së përkohshme, të cilën e bazon mbi thëniet që: “Zbatimi i Vendimit të Qeverisë do të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe ndikim të drejtpërdrejtë në shkaktimin e pasojave juridike ligjore, financiare, ekonomike etj. nga pamundësia e ushtrimit të të drejtave themelore të njeriut, nuk tregon exempli cause ku një gjë e tillë do gjente vend dhe cilat do ishin ato dëme të pariparueshme që do shkaktoheshin me zbatimin e Vendimit të Qeverisë.”
66. Si rrjedhojë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! kërkoi nga Gjykata që ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Komentet e dorëzuara nga z. Abelard Tahiri, deputet i Kuvendit

67. Deputeti Abelard Tahiri, lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, thekson se: “janë një varg faktesh që e arsyejnë miratimin e kërkesës për masë të përkohshme, me efekt të pezullimit të zbatimit të vendimit të kontestuar, deri në vendosjen meritore të

kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë, sipas procedurës respektive pranë kësaj Gjykate.”

68. Sipas deputetit në fjalë, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për caktim të masës së përkohshme bazohet në autorizimet kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 116.2 të Kushtetutës dhe nenit 27 të Ligjit. Sipas tij, në mënyrë kumulative janë plotësuar të tre kërkesat ligjore për miratim të kësaj mase të përkohshme nga ana e Gjykatës.
69. Së pari, parashtruesi i kërkesës, sipas pretendimit, e ka *“arsyetuar çështjen prima facie sipas meritave të cekura në lëndën e kërkesës, prandaj është i arsyeshëm masa [...] si mjet vendimtarë në situatën aktuale të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore nga Qeveria”*.
70. Së dyti, ai thekson se masa është në interes të publik *“për arsye se mos ushtrimi i plotë, respektivisht ushtrimi i kufizuar i këtyre të drejtave krijon reperkusione edhe për shtetin e Kosovës, të cilat janë të përcaktuara edhe me akte juridike të detyrueshme ndërkombëtare si: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, akte juridike ndërkombëtare, të cilat sipas nenit 22 të Kushtetutës, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”*
71. Së treti, mungesa e nxjerrjes së masës së përkohshme *“mund të shkaktojë një dëm të pakthyesëm e të pariparueshëm në shkeljen e garancive kushtetuese të të drejtave themelore dhe parimeve të qeverisjes demokratike”*. Në këtë aspekt, ai theksoi se faktet dhe pretendimet e prezantuara në kërkesën KO54/20, *“implikojnë çështje kushtetuese dhe evidentojnë pasoja konkrete në ushtrimin efektiv të të drejtave dhe lirive të garantuara kushtetuese dhe zbatimi i vendimit të kontestuar të Qeverisë do të ngrehë pas vete pasoja të jashtëzakonshme e të shumfishta, si dhe cenim të rënd të rendit kushtetues dhe parimit të ndarjes dhe kontrollit reciprok të pushteteve, sipas Kushtetutës.”*
72. Për rrjedhojë, sipas deputetit Abelard Tahiri, masa e përkohshme duhet të vendoset ngase *“zbatimi i vendimit të Qeverisë, do të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shkaktimin e pasojave juridike për shtetasit dhe*

qytetaret për shkak të pamundësisë së ushtrimit të të drejtave themelore nga ana e tyre”.

Komentet e dorëzuara lidhur me meritat e kërkesës brenda afatit tre (3) ditor, respektivisht deri më 27 mars 2020

73. Siç është cekur në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit iu kishte dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të paraqesin komentet e tyre lidhur me përmbajtjen ose meritat e kërkesës, në një afat prej tri (3) ditësh nga momenti i pranimit të shkresës së Gjykatës, respektivisht deri më 27 mars 2020. Në vijim, Gjykata do të paraqes të gjitha komentet e pranuar [gjithsej katër palë sosh] lidhur me përmbajtjen/substancën e Vendimit të kontestuar, respektivisht meritat e këtij rasti.

Komentet e dorëzuara nga Qeveria

Komentet e Qeverisë lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

74. Qeveria kërkon nga Gjykata që para se të vlerësojë meritat e kërkesë të vlerësojë se a janë përmbushur të gjitha kushtet e pranueshmërisë duke pretenduar se të njëjtat në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar. Në këtë drejtim Qeveria thekson se parashtruesi i kërkesës e ka bazuar kërkesën e tij në paragrafin (9) të nenit 84 të Kushtetutës dhe nën-paragrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës mirëpo nuk iu është referuar nenit 29 të Ligjit. Në këtë aspekt, Qeveria thekson se Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës, respektivisht Presidenti, është palë e autorizuar; nëse e ka “saktësuar kërkesën e tij” në kuptim të nenit 29 të Ligjit dhe nëse e ka “arsyetuar kërkesën e tij” mjaftueshëm që e njëjta të mos konsiderohet si “qartazi e pabazuar në baza kushtetuese”.
75. Në këtë drejtim, Qeveria thekson se “është jashtëzakonisht e rëndësishme që të saktësohet natyra e akteve të cilat mund të kontestohen nga Presidenti.” Kjo për faktin se, sipas Qeverisë, “aspekti procedural i një kontesti kushtetues — për dallim nga interpretimi i lirive dhe të drejtave themelore në kërkesat që ngritën nga individët — interpretohen në kuptim të ngushtë me qëllim që të parandalohet abuzimi me të drejtën e referimit kushtetues.”
76. Kushtetuta, vijon komenti i Qeverisë, thekson shprehimisht se Presidenti mund të kërkojë vlerësimin e përputhshmërisë së “dekreteve të Kryeministrit” dhe “rregulloreve të Qeverisë.” Në këtë aspekt, Qeveria pohon se “është më së e qartë që vendimi i kontestuar nuk është as dekret i Kryeministrit as rregullore e Qeverisë, por

është një vendim i këtij organi kushtetues i miratuar në përputhje me procedurat dhe autorizimet kushtetuese të tij.” Rrjedhimisht, Qeveria pretendon dhe pohon se “është më se e qartë dhe nuk ka asnjë dyshim se Kushtetuta nuk autorizon Presidentin [...] të kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Qeverisë.”

77. Në lidhje me këtë, Qeveria thekson se interpretimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KO73/16 *“me gjithë respektin ndaj Gjykatës, është i gabuar dhe jashtë kuadrit kushtetues të përcaktuar nga Kushtetutëdhënësi.”* Kjo sepse, sipas Qeverisë, *“Kushtetuta nuk len hapësirë për asnjë dyshim në lidhje me natyrën juridike të akteve të Kryeministrit apo Qeverisë të cilat mund të kontestohen nga palët e autorizuar.”*
78. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, KO73/16, thekson Qeveria se *“Gjykata është marrë me arsyetimin nëse akti i kontestuar është akt administrativ ose jo. Por në të njëjtin, Gjykata nuk ka trajtuar — në frymën dhe germën e Kushtetutës — nëse akti i kontestuar është dekret i Kryeministrit apo vendim i Qeverisë.”* Rrjedhimisht, përfundon në këtë aspekt Qeveria, në rastin në fjalë *“Gjykata nuk e ka orientuar arsyetimin e saj në raport me Kushtetutën, por në raport me pretendimet e palëve në procedurë.”* Në këtë aspekt, Qeveria kërkoi nga Gjykata që ta rishikojë praktikën e saj gjyqësore dhe ta rikthejë kushtetutshmërinë e procedurave të ndjekura sikurse ka bërë *“në rastet e njohura si “referimi i pyetjeve kushtetuese [KO79/18]”*”. Në të kundërtën, vijon pretendimi i Qeverisë, *“rrezikohet siguria juridike dhe krijohet, sikurse në rastin e procedurave të përmendura, mundësia që të abuzohet me Gjykatën Kushtetuese.”*
79. Më tutje, Qeveria po ashtu ka konsideruar se parashtuesi i kërkesës ka dështuar të saktësojë kërkesën e tij në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit *“për shkak se i njëjti nuk ka specifikuar nëse pretendon që i tërë akti apo një pjesë e tij të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe po ashtu, nuk ka specifikuar asnjë kundërshtim substancial në lidhje pretendimin e tij se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën.”* Qeveria pretendon se në faqen 10 të kërkesës së parashtuesit vetëm shkarazi përmendet titulli: *“Saktësimi i kërkesës”* dhe shkarazi përmenden disa dispozita ligjore por nuk saktësohet *“se si konkretisht konsideron se ky vendim cenon dispozitat kushtetuese (në lidhje me kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut).”* Për më tepër, konsideron Qeveria, në këtë pjesë të kërkesës e cila do duhet të shërbente për të saktësuar pretendimet e tij *“për shkelje kushtetuese — nuk përmend asnjë dispozitë të Kushtetutës apo akteve ndërkombëtare të zbatueshme në*

Republikën e Kosovës — të cilat do të mund të ishin shkelur.” Presidenti, sipas Qeverisë, vetëm thekson se “Vendimet dhe veprimet e Qeverisë duke përfshirë edhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/15, datë 23.03.2020, që përfshijnë masat në parandalimin dhe luftimin e Virusit Covid 19, sa janë të mirëpritura, ato duhet të jenë të bazuara në Kushtetutë dhe ligje”.

80. Sipas Qeverisë, parashtruesi i kërkesës jo vetëm që nuk ka arsyetuar substancialisht pretendimin e tij por nuk ka arritur *“të saktësojë as edhe një dispozitë të vetme kushtetuese apo konvencionale me të cilin ai konsideron se është në kundërshtim vendimi i kontestuar.”* Në lidhje me këtë, Qeveria rikujton dy vendime të Gjykatës, përkatësisht rastet KO118/16 dhe KO47/16, ka përcaktuar standard të pranueshmërisë argumentimin e mjaftueshëm të pretendimeve për shkelje kushtetuese në pjesët ku është theksuar se *“vetëm përmendja shkarazi e disa dispozitave kushtetuese, pa argumentuar substancialisht pretendimet, nuk është arsye e mjaftueshme që kërkesa të mos konsiderohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.”*
81. Si koment përfundimtar rreth pranueshmërisë së kërkesës, Qeveria thekson se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve të Qeverisë; nuk ka saktësuar kërkesën e tij; dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim substancial rreth pretendimeve të tij. Për të tilla arsye, Qeveria konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka plotësuar asnjërin nga kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

Komentet e Qeverisë lidhur me meritat e kërkesës

82. Për sa i takon meritave të kërkesës, Qeveria fillimisht pretendon se parashtruesi i kërkesës *“ka ngatërruar jo vetëm konceptet kushtetuese në lidhje me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore, por edhe ka paraqitur në mënyrë të shtrembëruar faktet në lidhje me vendimin e kontestuar.”* Kjo nga, Vendimi i kontestuar i Qeverisë është vetëm *“njëri në mesin e shumë vendimeve të nxjerra nga Qeveria”* me synim të parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19. Qeveria i referohet edhe vendimeve të Qeverisë: *“nr. 01/07 të 11 marsit 2020; nr. 01/08 të 12 marsit 2020; nr. 01/09 të 13 marsit 2020; nr. 02/09 të 13 marsit 2020; nr. 01/10 të 14 marsit 2020; nr. 01/11 të 15 marsit 2020; nr. 01/12 të 17 marsit 2020; nr. 01/13 të 18 marsit 2020”* [Sqarim i Gjykatës: Qeveria iu është referuar këtyre vendimeve por nuk i ka dorëzuar në Gjykatë].

83. Kësisoj, thekson Qeveria, *“kuptohet se vendimi i kontestuar është vendim i cili plotëson vendimet e mëhershme”* dhe se përmes Vendimit të kontestuar *“shtohen masat e rekomanduara nga IKSHPK me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik”* e të cilat *“janë në përputhje me masat që lejohet të ndermirën sipas Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Kapitulli IV i tij.”* Kjo rrjedhë logjike e procesit, pohon Qeveria, *“i jep përgjigje edhe pretendimit të ngritur, por të paarsyetuar, të parashtruesit të kërkesës në lidhje me kompetencat e Qeverisë”*. Duke iu referuar paragrafit (4) të nenit 93 të Kushtetutës, Qeveria thekson se ajo është e autorizuar *“që të nxjerrë vendime përmes të cilave zbatohen ligjet në fuqi”* dhe vetëm *“sikurse të mos ekzistonte një ligj që parasheh llojin e masave që mund t'i merr Qeveria, atëherë pretendimi i parashtruesit — ndonëse i paarsyetuar — të paktën do të ishte logjik.”* Mirëpo, sipas Qeverisë, ai nen i Kushtetutës ia lejon Qeverisë që të *“merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;”* dhe të *“udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës”*.
84. Qeverisë, si organ *“suprem në kuadër të organeve të administratës publike”* i lejohet në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që të ushtrojë funksione të organeve të saj vartëse në raste urgjente. Për më tepër, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në nenin 4 përcakton që *“Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin është detyrë e IKSHPK-së, Inspektoratit Sanitar të Kosovës, Inspektoratit Shëndetësorë të Kosovës, të gjithave institucioneve shëndetësore publike dhe private, institucioneve jo shëndetësore, komunave dhe vet qytetarëve nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë.”* Mbi këtë bazë, Qeveria sqaroi se *“kompetenca e saj për të nxjerrë këto vendime është e bazuar në Kushtetutë dhe ligjet në fuqi.”*
85. Më tutje, Qeveria thekson se Presidenti në kërkesën e tij pretendon se *“Vendimi i Qeverisë është kundërkushtetues për shkak se, sipas tij, është e palejueshme që institucionet shtetërore të kufizojnë të drejtat e njeriut, përfshirë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, pa u shpallur më së pari Gjendja e Jashtëzakonshme.”* Ky pretendim, sipas Qeverisë, është i gabuar dhe qartazi i pabazuar edhe në lidhje me Kushtetutën, me instrumentet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.
86. Përkundër pretendimeve të parashtruesit, thekson Qeveria, Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,

“pikërisht në dispozitat që vetë presidenti i ka cituar, përcaktojnë shprehimisht dhe qartazi se, edhe pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme, mund të kufizohen të drejta të njeriut, përfshirë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit.” Në këtë drejtim, Qeveria i referohet paragrafit 128 të rastit KO131/12 ku specifikisht thuhet se: *“neni 55 i Kushtetutës [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] “është i dyfishtë: ai ofron arsyetim për kufizimin e të drejtave kushtetuese, por në të njëjtën kohë ofron edhe kufijtë e kufizimit të tillë”.* Kur Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë këtë konstatim, Republika e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të jashtëzakonshme; por megjithatë, edhe pa qenë në gjendje të jashtëzakonshme, neni 55, sipas Gjykatës, *“prapëseprapë e paska luajtur rolin për të ofruar “arsyetim” për kufizimin e të drejtave kushtetuese.”* Të njëjtin rol, pohon Qeveria, ai nen *“vazhdon të luajë të njëjtin rol edhe në situatën aktuale me të cilën përballemi.”*

87. Duke cituar nenin 2 të Protokollit nr. 4 dhe nenin 11 të KEDNJ-së, Qeveria thekson se: *“këto dispozita dëshmojnë se është qartazi i pabazuar pretendimi i presidentit, që Vendimi i Qeverisë është gjoja kundërkushtetues për shkak se ai kufizon të drejtat e njeriut pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme. Është e vërtetë se Vendimi i Qeverisë kufizon lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit. Mirëpo, parashtresa e presidentit nuk ofron as edhe një argument të vetëm pse këto kufizime janë kundërkushtetuese, përveç mungesës së shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme, gjë që është totalisht jorelevante në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve të të drejtave të njeriut.”*
88. Më pas, Qeveria theksoi se cilat janë, sipas saj, kriteret kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve të lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit. Pyetja që duhet të bëhet, sipas Qeverisë, është *“nëse kufizimet e paraqitura me Vendimin e Qeverisë, në lirinë e tubimit dhe lirinë e lëvizjes, përmbushin kushtet e përcaktuara me nenin 55 të Kushtetutës.”* Nëse po, atëherë kjo do të ofronte *“arsyetim për kufizimin e të drejtave në fjalë”.*
89. Kriteret e nenit 55 duhet të lexohen edhe në përputhje me KEDNJ, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës thekson Qeveria.
90. Lidhur me lirinë e tubimit, sipas paragrafi 2 të nenit 11 të KEDNJ-së, thekson Qeveria paraqiten tri kritere për vlerësimin e lejueshmërisë së kufizimit të lirisë së tubimit duke theksuar që ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund tu nënshtrohet asnjë kufizimi tjetër përveç atyre që: parashikohen me ligj; janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike; janë në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë

publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Edhe paragrafi 3 i nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së po ashtu thekson *“me një gjuhë identike”* këto tri kritere për vlerësimin e lejueshmërisë së kufizimit të lirisë së lëvizjes.

91. Pas theksimit të këtyre kritereve, në nëntitullin e komenteve të titulluar: *“Zbatimi i kritereve kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve të lirisë së tubimit dhe lirisë së lëvizjes”*, Qeveria theksoi se *“kriteri i parë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve në fjalë është ai i ligjshmërisë”* dhe se, sipas Qeverisë, të gjitha kufizimet *“e paraqitura në Vendim, në lirinë e tubimit dhe lirinë e lëvizjes, janë të gjitha të parashikuara me ligji.”*
92. Për sa i përket lirisë së tubimit, sipas Qeverisë, neni 44 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, *“u jep autoriteteve shëndetësore diskrecion të gjerë për të ndaluar tubimet për qëllimin e kontrollit, parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse.”* Në këtë drejtim, Qeveria thekson se *“Diskrecioni i gjerë që përcaktohet me këto dispozita, që është diskrecion jo vetëm për të ndaluar të gjitha tubimet në vendet publike por gjithashtu për të urdhëruar “marrjen e masave të tjera të përgjithshme ose të posaçme të parashikuara tekniko-sanitare dhe higjienike”, është më se i mjaftushëm për të mbuluar kufizimin e lirisë së tubimit në Vendimin e Qeverisë, sidomos për shkak se ky Vendim nuk i ndalon të gjitha tubimet në mënyrë kategorike. Të përjashtuara nga ky ndalim janë ato tubime që janë “të domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë”, si dhe ato “ku lejohet distanca dy metra me të tjerët.”*
93. Për sa i përket lirisë së lëvizjes, Qeveria po ashtu thekson se neni 41 i Ligji për Parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse *“u jep autoriteteve shëndetësore diskrecion të gjerë për të ndaluar qarkullim në vendet e prekura ose të rrezikuara prej sëmundjeve ngjitëse”* në pjesën ku theksohet se: *“Për ta parandaluar futjen dhe përhapjen [...] sëmundjeve të tjera ngjitëse në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje, si vijon: b) Ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara.”*
94. Dispozita e lartcekur, thekson Qeveria, i *“jep diskrecion të gjerë për të ndaluar qarkullimin në mënyrë kategorike në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara”* dhe se me *“79 raste*

infektimi të zbuluara të shpërndara në rajone të ndryshme të vendit, është e pamohueshme se rreziku nga infektimi nga COVID-19, tashmë përfshin tërë territorin e Republikës së Kosovës, sidomos duke marrë parasysh studimet më të fundit në fushën mjekësore, të cilat dëshmojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që janë infektuar prej virusit COVID-19 deri më sot, ishin infektuar prej personave të cilët ende nuk kishin shfaqur simptoma.”

95. Mirëpo, thekson Qeveria, “me gjithë diskrecionin që jepet sipas ligjit për të ndaluar qarkullimin e qytetarëve në mënyrë kategorike, Vendimi i Qeverisë edhe një herë e ka ndaluar vetëm në disa aspekte, duke vendosur kufizime në qarkullim në aspektin e kohës (10:00—16:00 dhe 20:00—08:00) dhe mënyrës së qarkullimit (vetëm nga dy persona, me një distancë prej dy metrash).” Vlen të theksohet, sipas Qeverisë, “se ligji gjithashtu e autorizon Policinë e Kosovës për të bashkëpunuar me institucionet shëndetësore për të zbatuar këto kufizime” ku edhe vet neni 18 i Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, parashikon se: “Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t’ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t’i arritur objektivat legjitime të policisë [...]”, ku njëra prej këtyre “objektivave legjitime”, është edhe “mbrojtja e personave nga epidemitë”.
96. Për arsyet e lartpërmendura, thekson Qeveria, kufizimet e parapara në Vendimin e kontestuar janë në pajtim me ligjin, rrjedhimisht “të përcaktuara me ligj”.
97. Përveç aspektit të ligjshmërisë, Qeveria pohon se paragrafi 3 i nenit 55 të Kushtetutës po ashtu thekson se kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar. Ndërkaq që, sipas paragrafit 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, qëllimet e përcaktuara për të cilat lejohen kufizimet në lirinë e tubimit dhe lirinë e lëvizjes, përfshijnë edhe “ruajtjen e shëndetit”. Qëllimi i kufizimeve të vendosura nga Qeveria, thekson kjo e fundit: “e kanë për qëllim, sipas rekomandimeve të IKSHP-së, ruajtjen e shëndetit, përkatësisht, qëllimin që “të parandalojmë dhe zvogëlojmë dukshëm intensitetin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës.”” Rrjedhimisht, kufizimet në lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, me Vendimin e kontestuar të Qeverisë, thekson kjo e fundit, janë bërë për një qëllim legjitim sipas dispozitave përkatëse të KEDNJ-së.
98. Tutje, lidhur me kriterin e domosdoshmërisë në një shoqëri demokratike, Qeveria thekson se ky kriter paraqitet edhe në

paragrafin 2 të nenit 55 të Kushtetutës. Në rastin konkret, pohon Qeveria *“ekzistenca e një "nevoje shoqërore të rëndësishme të lartë" është e pamohueshme.”* Sipas IKSHIP-së, *“Virusi COVID-19 ka infektuar deri tani 445,982 persona në rang botëror, duke shkaktuar 19,795 vdekje, përfshi 79 të infektuar dhe 1 vdekje në Republikën e Kosovës.”* Nevoja për të parandaluar dhe luftuar përhapjen pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, është dukshëm me rëndësi tepër të lartë. Nëse i marrim për bazë rekomandimet e IKSHIP-së, ato na çojnë te përfundimi se nuk do të mund të arrihej qëllimi që *“të parandalojmë dhe zvogëlojmë dukshëm intensitetin e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës”,* pa vendosur kufizimet në fjalë, thekson Qeveria.

99. Përpara nxjerrjes së Vendimit të kontestuar në diskutim, Qeveria pohon të ketë *“marrë një sërë masash më të buta me vendime të mëparshme”* dhe në vend që t'i merrte të gjitha masat njëkohësisht, Qeveria *“i ka ndërmarrë hapat në mënyrë të përshkallëzuar në procesin e parandalimit dhe luftimit të COVID-19, gjithmonë duke marrë parasysh rekomandimet e ekspertëve të shëndetit publik, në bazë të situatës epidemiologjike në botë, në Evropë dhe në nivelin vendor.”*
100. Masat më të fundit, ato të parapara në Vendimin e kontestuar, *“janë marrë në bazë të arsytimit të IKSHIP-së, sipas të cilit këto masa ishin të domosdoshme të vendosen përveç masave të mëhershme”* dhe rrjedhimisht, pohon Qeveria, *“qëllimi i parandalimit dhe zvogëlimit të intensitetit të pandemisë COVID-19, nuk do të mund të arrihej me një kufizim më të vogël”* andaj dhe masat e marra janë *“të domosdoshme në një shoqëri demokratike”*.
101. Për sa i takon parimit të proporcionalitetit, Qeveria thekson se *“duhet të marrim parasysh raportin ndërmjet “rëndësisë së qëllimit të kufizimit” dhe “natyrës dhe vëllimit të kufizimit” (neni 55, par. 4), duke vlerësuar nëse masat e Qeverisë arrijnë një balancë proporcionale ndërmjet vëllimit të kufizimit dhe rëndësisë së qëllimit të kufizimit.”* Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, thekson Qeveria, shtetet kanë marginë të gjerë të vlerësimit *“në aspektin e politikave shëndetësore, në veçanti ato në lidhje me masat e përgjithshme parandaluese”*. Sipas këtij parimi, Qeveria duke vepruar në bazë të rekomandimeve të IKSHIP-së, *“është në pozicionin më të mirë për të vlerësuar rëndësinë e arritjes së qëllimit për të parandaluar dhe luftuar virusin COVID-19.”* Në këtë fushë, thekson Qeveria, *“diskrecioni i Qeverisë për të vepruar është në nivelin më të lartë të mundshëm.”*

102. Tutje, duke u thirrur në doktrinën e subsidiaritetit dhe të konsensusit në nivel evropian, Qeveria thekson se: *“autoritetet shtetërore gëzojnë më shumë diskrecion për të vendosur një kufizim të caktuar në të drejtat e njeriut, nëse nuk ekziston një konsensus mes shteteve anëtare të Këshillit të Evropës kundër vendosjes së atij kufizimi. Ndërsa, kur një konsensus i tillë ekziston, diskrecioni i autoriteteve shtetërore për të vepruar është, përkatësisht, më i ngushtë.”* Lidhur me këtë parim, Qeveria i referohet rasteve të GJEDNJ-së, *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih kërkesa nr. 28957/95, paragrafët 85-86); *Tekeli kundër Turqisë* (shih kërkesa nr. 29865/96, paragrafi 61) dhe *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih kërkesa nr. 5493/72, paragrafi 48).

103. Në rastin konkret, thekson Qeveria *“jo vetëm se nuk ka një konsensus evropian kundër përdorimit të kufizimeve të paraqitura me Vendimin e Qeverisë, por ka shumë shtete të Këshillit të Evropës që kanë vendosur kufizime të natyrës dhe vëllimit të njëjtë sikurse Vendimi i Qeverisë, dhe ndonjëherë edhe më të rrepta, në lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit.”*

104. Në Itali, për shembull, thekson Qeveria, *“Dekreti i Presidentit dhe Këshillit të Ministrave, Nr. 20A01558, i datës 8 mars 2020, neni 1 (2), ndalon në mënyrë kategorike tubime në vende publike dhe në hapësira private të hapura për publikun. Dhe me Dekretin e Ministrisë së Shëndetësisë, Nr. 20A01797 të datës 22 mars 2020, pika (l)(b), Qeveria italiane ka ndaluar, në mënyrë kategorike, aktivitete argëtuese dhe sportive në vende publike, përfshirë edhe ato që kryhen në bazë individuale.”*

105. Në Gjermani, po ashtu, thekson Qeveria, *“autoritetet shtetërore kanë vendosur, në nivel vendor, që të ndalohet qëndrimi në vende publike i më shumë se dy personave që nuk janë prej së njëjtës bashkësi familjare, si dhe të ndalohen tubime festive jo vetëm në vende publike, por edhe në banesa private (shih Besprechung der Bundeskanzlerin mit den Regierungschefinnen und Regierungschefs der Länder am 22. März 2020, pikat III dhe V).”*

106. Në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu, thekson Qeveria, se: *“përpara shpalljes së Gjendjes së fatkeqësisë natyrore më 24 mars 2020 kishte vendosur një sërë kufizimesh në lirinë e lëvizjes dhe të tubimit, disa prej të cilave janë më të rrepta sesa kufizimet e vendosura me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shembull, me Urdhrin Nr. 168/2 të datës 18 mars 2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Kufizimin e*

Lëvizjes me Automjetet Private ose Shtetërore të Administratës Publike, pika 1, Qeveria e Shqipërisë ka ndaluar lëvizje me automjete private apo shtetërore, përveç në raste që lidhen me punë në terren. Po ashtu, me Urdhrin Nr. 193 të së njëjtës Ministri, të datës 20 mars 2020, për Mbylljen apo Kufizimin e Lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë, pika 1, Qeveria e Shqipërisë ka kufizuar qarkullimin e qytetarëve, duke e lejuar qarkullimin për vetëm një periudhë kohore në ditë, prej orës 5:00 deri në orën 13:00.”

107. Tre shembujt e lartcekur, respektivisht ai i Italisë, Gjermanisë dhe Shqipërisë, pohon Qeveria, shërbejnë për të nxjerrë dy përfundime. Përfundimi i parë, thekson Qeveria, është se *“përballë një sëmundjeje të re ngjitëse dhe potencialisht vdekjeprurëse, rrezikshmëria dhe ngjitëshmëria e të cilit ende nuk kuptohen plotësisht nga ekspertët mjekësorë, shtete të ndryshme të Këshillit të Evropës kanë vendosur një sërë kufizimesh të ndryshme në lirinë e lëvizjes dhe të tubimit për të parandaluar përhapjen e mëtejshëm të COVID-19.”* Disa nga këto kufizime, thekson Qeveria *“janë po aq të rrepta, dhe në disa raste edhe më të rrepta sesa ato që janë paraqitur me Vendimin e Qeverisë”*.
108. Edhe vendimet e lartpërmendura, si ai i Shqipërisë për shembull, njëjtë si Vendimi i kontestuar i Qeverisë, thekson kjo e fundit, *“nuk kanë afat kohor, duke mbetur në fuqi deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.”* Edhe Vendimi i lartpërmendur i Gjermanisë, *“vendos të njëjtat kufizime për të gjithë qytetarët në të gjithë vendin, jo vetëm për një pjesë të kufizuar territoriale”* dhe GJEDNJ në rastin *Centrum för Rättvisa kundër Suedisë* (kërkesa nr. 35252/08 – lidhur me nenin 8 të KEDNJ) *“ka pranuar si të justifikuar kufizime në të drejtat e njeriut që zbatohen për të gjithë qytetarët dhe banorët e një vendi të caktuar”*.
109. Shembulli i vendeve të lartpërmendura, sipas Qeverisë *“përbën një arsye të fortë për të konstatuar se natyra dhe vëllimi i këtyre kufizimeve, ndonëse të rrepta, janë proporcionale me nivelin tepër të lartë të rëndësisë së qëllimit të synuar.”*
110. Së dyti, vlen të theksohet, sipas Qeverisë se *“të tria shtetet e lartcituara, kanë vendosur kufizime në lirinë e lëvizjes dhe tubimit pa pasur nevojë për t’iu shmangur (“derogate”) këtyre lirive themelore përmes njoftimit të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në përputhje me nenin 15, par. 3 të KEDNJ-së.”* Sipas faqes elektronike zyrtare të Këshillit të Evropës, thekson Qeveria, *“vetëm 6 shtete anëtare të Këshillit të Evropës (Armenia, Estonia, Gjeorgjia, Letonia, Moldavia dhe Rumania) iu janë*

shmangur të drejtave të njeriut për shkak të përhapjes së COVID-19”; ndërkohë që “të gjitha 41 shtetet e tjera të Këshillit të Evropës, përfshirë ato që janë prekur shumë më shumë prej përhapjes së COVID-19 sesa këto gjasthtë shtete, e kanë konsideruar se kufizimet e autorizuar të të drejtave të njeriut, sipas kritereve të zakonshme të KEDNJ-së, përbëjnë justifikim të mjaftueshëm për kufizimin e rreptë të këtyre të drejtave.”

111. Me këtë qëndrim, thekson Qeveria: *“këto 41 shtete kanë vendosur të ndjekin rekomandimin e Komitetit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili ka konstatuar se, kur kemi të bëjmë me fatkeqësi natyrore, “mundësia e kufizimit të lirisë së lëvizjes apo lirisë së tubimit, është në përgjithësi e mjaftueshme në situata të tilla dhe asnjë shmangie prej dispozitave në fjalë nuk do të ishte e justifikuar nga urgjenca e situatës.”* (Shih, sipas citimit të Qeverisë: Komentin e Përgjithshëm nr. 20 të CCPR lidhur me nenin 4: “Shmangia gjatë një Gjendje Emergjente, adoptuar në sesionin e 72-të të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, 31 gusht 2001, nr. CCPR C/21/Rev.1/Add.11, paragrafi 5).
112. Në fund, Qeveria thekson se: *“Dakordimi i një shumice të madhe të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, bashkë me rekomandimin e Komitetit të Përgjithshëm për të Drejtat Civile dhe Politike, mbi këtë pikë, jep konfirmim edhe të mëtejshëm se kufizimet e vendosura nga Vendimi i Qeverisë, ndonëse të rrepta, janë të justifikuara sipas kritereve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”*
113. Lidhur me esencën e të drejtave të garantuara si kriter që paraqitet në paragrafin 5 të nenit 55 të Kushtetutës, Qeveria thekson se *“kufizimet e paraqitura nga Vendimi i Qeverisë, nuk e mohojnë esencën e lirisë së tubimit dhe lirisë së lëvizjes.”*
114. Për sa i përket lirisë së tubimit, *“Vendimi i Qeverisë nuk i ndalon tubimet në mënyrë kategorike, por vetëm përcakton një rregull të distancës (prej dy metrash) gjatë çfarëdolloj tubimi në hapësirë fizike.”* Të gjitha *“format e tubimit në hapësirën kibernetike (siç po përdoren e më shumë në rang botërore gjatë pandemisë së COVID-19) vazhdojnë të jenë të pakufizuara në asnjë mënyrë.”*
115. Për sa i përket lirisë së lëvizjes, vlen i njëjti përfundim sipas Qeverisë ngase *“qytetarët vazhdojnë të kenë të drejtën e lëvizjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, por janë të obliguar me Vendimin e Qeverisë që të kryejnë këto lëvizje çdo ditë brenda*

8 orëve të caktuara kur lejohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve.”

116. Në përfundim, Qeveria konsideroi që: (i) kërkesa e parashtruesit ka dështuar të ndërtojë një kërkesë kushtetuese, ashtu si e parasheh Kushtetuta, Ligji dhe Rregullorja e punës dhe se nuk i ka plotësuar asnjë nga kushtet e pranueshmërisë; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që të ndërtojë edhe të paktën një argument të vetëm substancial në lidhje me pretendimet tij; (iii) Qeveria ka parashtruar argumente të mjaftueshme për të dëshmuar se të gjitha vendimet e saj në procedurën e parandalimin të përhapjes dhe kontrollimit të pandemisë COVID-19 janë ndërmarrë duke u bazuar në rekomandimet e IKSHPK dhe vetëm pas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë; (iv) Qeveria nuk ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi; (v) Qeveria nuk i ka kufizuar liritë dhe të drejtat themelore përmes një akti nënligjor, mirëpo ajo vetëm ka nxjerrë vendime të bazuara në Kushtetutë dhe ligje përmes të cilave i ka zbatuar po këto detyrime kushtetuese dhe ligjore; (vi) Qeveria nuk ka tejkaluar kufizimin e lejuar të lirive dhe të drejtave themelore, por i është përmbajtur në mënyrë strikte përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore në lidhje me llojin dhe masën e kufizimit.
117. Si rrjedhojë, Qeveria kërkoi nga Gjykata që të nxjerrë Aktvendim përmes së cilit kërkesa e parashtruesit do të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Komentet e dorëzuara nga Institucionit i Avokatit të Popullit

118. Institucioni i Avokatit të Popullit, i përfaqësuar nga Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, theksoi se komentet e tij, të paraqitura në formë të Opinionin, kanë për qëllim të shprehin pikëpamjet e Avokatit të Popullit *“shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës i cili ka kërkuar nga Gjykata që të bëjë: “Vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/15, datë 23.03.2020 me Kushtetutën e Republikës së Kosovës lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore që mbrohen me Kushtetutë.”*
119. Lidhur me çështjen kontestuese, Avokati i Popullit thekson se Vendimi i kontestuar, *“do të ishte e nevojshme të shihej i ndërlidhur edhe vendimi i Qeverisë për shpalljen emergjencës për shëndetin publik nr.01/11, i datës 15.03.2020.”* Avokati i Popullit thekson se

“është e rëndësishme që së pari të vërtetohet nëse të dy këto vendime të Qeverisë kanë mbështetje ligjore, dhe i përgjigjen kërkesave të konventave kur është fjala për kufizimin e të drejtave apo derogimin nga të drejtave.”

120. Në Opinion e tij dërguar në Gjykatë, Avokati i Popullit ka theksuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që i ka konsideruar si relevante për rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim ai ka cekur Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejshmë: KNDKP) dhe KEDNJ-në.
121. Në situata të tilla të kufizimeve, Avokati i Popullit thekson se *“duhet të këtë ligj të miratuar paraprakisht dhe se veprimet apo vendimet e kufizimit të të drejtave të kenë mbështetje në instrumente ligjore, për më tepër ato duhet të jenë të lejuara.”* Gjithashtu, thekson Avokati i Popullit, *“kjo nuk përjashton por për më tepër rekomandon mbikëqyrjen nga ana e parlamentit lidhur me zbatimin e masave të parashikuara në ligj.”*
122. Avokati i Popullit citon paragrafin 2 të nenit 11 të KEDNJ, i cili, sipas tij duhet të merret parasysh. Më tutje, ai thekson se *“KNDKP, vlerësohet si dokumenti bazë në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i cili përcakton kushtet dhe kriteret për kufizimin dhe derogimin nga të drejtat dhe liritë e njeriut.”* Edhe *“KEDNJ, gjithashtu, në tërësi ka pranuar përkufizimet nga KNDKP. Këto instrumente ndërkombëtare u lejojnë shteteve anëtare fushëveprim qenësor për tu përgjigjur ndaj situatave emergjente me kufizimin e të drejtave specifike në vend të shmangies nga këto të drejta.”*
123. Avokati i Popullit më tutje thekson se *“Shmangia nga e drejta ose, nga ndonjë aspekt i ndonjë të drejte është eliminim në tërësi apo i përsëritshëm i ndonjë obligimi ndërkombëtar.”* Sidoqoftë, sipas tij *“shmangia nga obligimet e KNDPC në rrethana emergjente, juridikisht dallon nga ndalesat apo kufizimet të cilat, sipas dispozitave të KNDPC, janë të lejueshme edhe në rrethana normale.”* Logjika e KNDPC, thekson Avokati i Popullit, *“është se, nëse është e mundur, shtetet duhet të kufizojnë të drejtat për aq sa është e nevojshme, në vend se të shmangen tërësisht nga ato.”* Mirëpo, *“kushti bazë për kufizimin e të drejtave mbetet kërkesa për ligj në fuqi që shërben si bazë juridike për lejimin e kufizimeve të tilla.”*
124. Sipas nenit 4 të KNDKP, thekson Avokati i Popullit, *“kriteri i parë për vlerësimin është nëse ekziston baza e përcaktuar në nenin e*

lartpërmendur për shpalljen e një gjendje emergjente e cila e kërcënon jetën e kombit.” Lidhur me këtë, “Avokati i Popullit konsideron se pandemia e virusit COVID 19, bie në domenin e përkufizimeve të kërcënimit dhe shëndetit dhe jetën e kombit.”

125. Kushti i dytë, vijon Avokati i Popullit, *“është që gjendja e emergjencës të jetë shpallur zyrtarisht.”* Një kërkesë e tillë *“për të shpallur publikisht dhe zyrtarisht gjendjen e emergjencës është esenciale për t’ju përmbajtur parimit të ligjshmërisë dhe sundimit të së drejtës në kohën kur më së shumti është e nevojshme.”*

126. Parimet e Sirakuzës për kufizimin dhe shmangien nga dispozitat e KNDKP, thekson Avokati i Popullit, *“bëjnë diferencimin e qartë të dispozitave të KNDKP në ato që kanë të bëjnë me kufizimet dhe në ato që kanë të bëjnë me shmangiet.”* Kur bëhet fjalë për shëndetin publik, Parimet e Sirakuzës përcaktojnë, si në vijim:

“Shëndeti publik mund të paraqet bazë për kufizimin e të drejtave të caktuara në mënyrë që tu lejohet shteteve për të ndërmarrë masa gjatë kërcënimeve serioze për shëndetin e popullatës apo pjesëtarëve të popullatës. Këto masa duhet specifikisht të orientohen në parandalimin e sëmundjes apo lëndimeve apo ofrimit të kujdesit për të sëmurit dhe të lënduarit.

Do t’i kushtohet vëmendje e duhur rregullave ndërkombëtare të shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetit.”

127. Më tutje, Avokati i Popullit thekson: *“Nëse shtetet pretendojnë të kërkojnë të drejtën për tu shmangur nga Konventa gjatë, për shembull, një katastrofe natyrore, një demonstrimi masiv përfshirë raste dhune, ose një aksident të madh industrial, ato duhet të jenë në gjendje të justifikojnë jo vetëm që një situatë e tillë përbën një kërcënim për jetën e kombit, por edhe që të gjitha masat e tyre që të shmangen nga Konventa në mënyrë strikte duhet të jenë të imponuara nga urgjenca e rrethanave të krijuara. Sipas mendimit të Komitetit, mundësia e kufizimit të të drejtave të caktuara të Konventës, për shembull, liria e lëvizjes (neni 12) ose liria e tubimit (neni 21) është përgjithësisht e mjaftueshme gjatë situatave të tilla dhe asnjë shmangie nga dispozitat në fjalë nuk do të justifikoheshin nga urgjenca e rrethanave të krijuara.”*

128. Për sa i takon Vendimit të Qeverisë më konkretisht, Avokati i Popullit thekson se është e rëndësishme të vlerësohet nëse Vendimi i kontestuar me të cilin është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe Vendimi tjetër i

Qeverisë për shpalljen emergjencës për shëndetin publik [Vendimi nr. 01/11 i 15 marsit 2020] janë të ndërlidhura meqë, sipas Avokatit të Popullit, ato vendime duhet *“trajtuar të ndërlidhura”*.

129. Avokati i Popullit konsideron se të dy vendimet e lartcekura të Qeverisë, përfshi Vendimin e kontestuar, *“kanë mbështetje në ligj.”* Përderisa, ekziston baza ligjore e një vendimi të tillë nga Qeveria lidhur me kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit, mbetet e paqartë pika 4 e Vendimit të kontestuar të Qeverisë *“që flet për ndalimi[n] i[e] tubimeve në mjediset private.”* Me këtë rast çështja e zbatimit të mbikëqyrjes mbetet qenësore.
130. Tutje, Avokati i Popullit thekson se *“për vlerësimin e masave ligjore nën dritën e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është jashtëzakonisht e rëndësishme për të vlerësuar mënyrën e zbatimit të masave të veçanta për kufizimin e të drejtave të njeriut.”*
131. Vendimi i kontestuar *“në vetvete nuk ofron përkufizime e as bazë ligjore për zbatimin e tij”*; ndërkaq që, *“ndalesat janë fuqizuar në vendim pa e përcaktuar pasojat për sjellje devijante (lex in perfecta).”*
132. Për sa i takon çështjeve kushtetuese, Avokati i Popullit thekson se pas analizimit të kërkesës në fjalë vëren që ka nevojë për interpretimin e dy koncepteve kushtetuese, respektivisht: *“Kufizimit të të Drejtave dhe Lirive Themelore, të përcaktuara me nenin 55 të Kushtetutës; dhe Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore, të përcaktuara me nenin 56 të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme].”*
133. Në rrethanat e rastit konkret, sipas Avokatit të Popullit, *“bëhet fjalë për dy çështje të ndara, sado që ato mund të duken të ngjashme, në mes tyre ka dallime qenësore juridike, të cilat nuk bënë të ngatërrohen, prandaj edhe ekzistojnë si dy dispozita të ndara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”*
134. Si përfundim, Avokati i Popullit theksoi se kufizimet e të drejtave të njeriut janë të parashikuara në Kushtetutë, instrumente ndërkombëtare dhe ligje të miratuara nga Kuvendi, të cilat specifikojnë kufizime të caktuara. Megjithatë, sipas Avokatit të Popullit, *“për zbatimin e dispozitave ligjore mbi të cilën është bazuar (neni 41, paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse) Vendimi i Kontestuar mungojnë aktet nënligjore dhe i mbetet Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse një gjë e tillë paraqet çështje kushtetuese apo jo.”* Vendimi i

kontestuar i Qeverisë “nuk parasheh mënyrën se si do të zbatohet neni 41.3 i Ligjit, sipas të cilit: “Për pjesëmarrjen në zbatimin e masave nga pikat a) deri d) të këtij neni, institucioneve shëndetësore, organizatave të tjera dhe qytetarëve u takon kompensimi adekuat nga organi kompetent.”

135. Krejt në fund, Avokati i Popullit, “vlerëson se Vendimi i Kontestuar duhet të ketë një afat dhe mundësinë e rishikimit të tij, në mënyrë periodike me mundësi të ndryshimit të tij me rrethanat të cilat do të mund të krijoreshin gjatë periudhës emergjente.”

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

136. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, lidhur me meritat e kërkesës fillimisht theksoi se Presidenti e ka anashkaluar në tërësi nenin 53 të Kushtetutës pavarësisht rëndësisë së tij “në interpretimin më të gjerë apo qartësimin e neneve të Konventës përmes praktikës së Gjykatës.” Për këtë arsye, thekson ky Grup Parlamentar, “përgjigjen lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore duhet kërkuar në rend të parë brenda KEDNJ-së dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare të listuara në nenin 22, e pastaj edhe brenda praktikës së Gjykatës.”
137. Sipas tyre, për të vlerësuar se a është Vendimi i kontestuar kundërkushtetues për shkak të pretendimit të Presidentit për cenim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë “duhet konsultuar KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së, në mënyrë që të qartësohet nëse dhe në cilën masë mund të bëhet kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore.”
138. Në këtë aspekt, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se “KEDNJ shprehimisht parasheh në nenin 15 kufizimin apo shmangien nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Konventë” dhe “asnjëherë si kusht brenda këtij neni nuk parashihet ekzistenca apo shpallja e “gjendjes së jashtëzakonshme”, në formën në të cilën e interpreton Presidenti.” Deputetët e Grupit Parlamentar në fjalë theksojnë se *prima facie* kuptohet mundësia për Palët Kontraktuese (Shtetet) që të bëjnë “kufizimin apo shmangien” nga liritë dhe të drejtat themelore. Një kufizim i këtyre të fundit, vijon komenti, “nuk mund të bëhet për çfarëdo arsye, por vetëm për ato të parapara në nenin 15 që tutje elaborohen nga GJEDNJ.” Kufizimin e lirive, shtetet, sipas nenit 15 të KEDNJ mund ta bëjnë në kohë “luftë ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit.”

139. Sipas Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nuk mund të mos vihet re se ajo çfarë u theksua për nenin 15 të KEDNJ *“korrespondon me tekstin e nenit 55 të Kushtetutës, në të cilin është bazuar Qeveria”* kur ka marrë Vendimin e kontestuar. Përderisa paragrafi (2) i nenit 55 të Kushtetutës thotë që: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi”*, edhe neni 15 i KEDNJ-së dikton që *“lidhur me masat për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore mund të merren masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë vetëm për atë që e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.”*
140. Bazuar në këtë që u tha më sipër, thekson Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! mund të vëren dy gjëra. E para është fakti që neni 55 i Kushtetutës përcjell në përpikëri nenin 15 të KEDNJ-së; dhe që Qeveria me nxjerrjen e Vendimit ka vepruar në tërësi në pajtueshmëri me nenin 15 të KEDNJ-së. *“Kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore është bërë në qëllim të parandalimit të kanosjes së një rreziku serioz apo emergjencës që rrezikon shëndetin publik e me atë edhe ka përmbushur kërkesën që buron nga neni 15 [KEDNJ].”* Në këtë aspekt theksohet që mund të konkludohet përtej çdo dyshimi se Kushtetuta e ka inkorporuar KEDNJ-në dhe se respektimi i kësaj të fundit *“është obligim kushtetues dhe njëkohësisht, shkelja e KEDNJ-së paraqet shkelje të Kushtetutës.”*
141. Rrjedhimisht, pohohet se në territorin e Republikës së Kosovës, kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut mund të bëhet në pajtim me tekstin e nenit 15 të KEDNJ-së. Marrë parasysh që ky nen mundëson *“derogimin”* nga liritë dhe të drejtat themelore në rast të *“rrezikut publik që i kanoset jetës së kombit”*, mund të nxjerrët përfundimi që, përtej çdo dyshimi, në rast të rrezikut publik që i kanoset popullit të Kosovës nga pandemia COVID-19, kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore, apo *“derogimi”* nga këto të drejta mundësohet me Kushtetutë.
142. Më tutje, theksohet në komentet e pranuar se, GJEDNJ, në rastin *Lawless kundër Irlandës* [nuk është cituar referenca], e definojnë *“emergjencën publike”* si një situatë të krizës apo emergjencës e cila afekton të gjithë popullatën dhe përbën kërcënim ndaj jetës së organizuar të komunitetit. Një *“emergjencë”* të tillë, theksohet tutje, në rastin *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* [nuk është cituar referenca], *“GJEDNJ e lejon edhe si aktuale apo imanente, si krizë e cila mund t'i kanoset edhe vetëm një regjioni të shtetit.”* Së fundmi,

GJEDNJ, në rastet *Brannigan kundër Mbretërisë së Bashkuar* [nuk është cituar referenca], thekson që nuk nënkupton që kriza të jetë e përkohshme, por lejon që masat e ndërmarra të mbeten në fuqi edhe për periudha më të gjata dhe një gjë e tillë iu lihet në dorë autoriteteve të shtetit. Në këtë aspekt thuhet se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së arsyetohet derogimi nga liritë dhe të drejtat themelore në rast të emergjencave – sikurse kjo e COVID-19, përmes një Vendimi të Qeverisë sikurse ky i kontestuari dhe se Qeveria në këtë aspekt përfiton nga një marginë e vlerësimit (“margin of appreciation”).

143. Neni 55 i Kushtetutës theksohet se “*lejon kufizimin nga liritë dhe të drejtat themelore me Ligj, që saktësisht është edhe qëndrimi i GJEDNJ-së dhe që është në përputhshmëri të plotë me veprimin e Qeverisë [...], e cila Vendimin e ka bazuar edhe në Ligjin Nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse [neni 42.2]*”. Së fundmi, neni 45 i Ligjit të cekur thekson që: “*masat nga nenet 41 deri në 44 të këtij Ligji, ndaj individëve dhe institucioneve urdhërohen me anë të aktvendimit më procedurë administrative*”.
144. Nga nenet e lartcekura të këtij Ligji theksohet se ekziston mundësia e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore në raste të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse siç është rasti me COVID-19, përmes akteve nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë. Në këtë aspekt, vijon pretendimi, “*vëmendje duhet kushtuar edhe nenit 45 i cili definon si zbatohen urdhërat ndaj individëve.*” Këto të fundit përmbledhen në aktvendim të nxjerrë në procedurë administrative, apo në rastin tonë thënë më shkurt, gjatë mbledhjeve të Qeverisë.
145. Në përfundim të komenteve të dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! u theksua se Qeveria, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, ka respektuar plotësisht Kushtetutën dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, “*konkretisht neneve 22 dhe 53, përfshirë edhe nenin 55, duke bazuar Vendimin në Ligj.*”

Komentet e dorëzuara nga z. Abelard Tahiri, deputet i Kuvendit

146. Deputeti Abelard Tahiri, konsideron se Qeveria, përmes nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, ka vepruar në kundërshtim me nenet 35, 43 dhe 55 të Kushtetutës.
147. Më tutje, ai thekson se Qeveria e ka bazuar Vendimin e kontestuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse ani pse i njëjti “*në asnjë dispozitë të tij, nuk e parasheh përgjegjësinë apo autorizimin e Qeverisë për të kufizuar të drejtat dhe liritë*

themelore.” Për më tepër, sipas deputetit në fjalë, Qeveria duke u thirrur në nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, “*ka rënë ndesh edhe me kreun XIX “Kujdesi shëndetësor gjatë gjendjeve emergjente” nënin 89 “Përgjegjësitë e Ministrisë”, të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, sipas të cilit ligj, në mënyrë shprehimore, gjatë gjendjes emergjente parashihen përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë, sikurse gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme edhe përgjegjësitë e Qeverisë, sipas nenit 90 të këtij ligji.*”

148. Në këtë drejtim, deputeti në fjalë pretendon se Ligji për Shëndetësi, në pajtim me Kushtetutën, “*në mënyrën e duhur e të qartë e ka ndarë “Gjendjen Emergjente” nga “Gjendja e Jashtëzakonshme”, dhe për më tepër, vetëm për këtë të dytën e ka rezervuar rolin e Qeverisë në aktivitetet që janë në kuadër të përgjegjësisë së saj dhe në pajtim me Kushtetutën.*” Sipas nenit 89.3 të Ligjit për Shëndetësi, vijon pretendimi, “*edhe gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje (e lëre më të drejtat e parapara me Kushtetutë), do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.*” Ai i referohet nenit 89 të Ligjit për Shëndetësi ku përcaktohen përgjegjësitë e Ministrisë dhe nenit 90 ku përcaktohen përgjegjësitë e Qeverisë.
149. Në fund, sipas pretendimit të deputetit në fjalë, Qeveria e ka tejkaluar mandatin e saj dhe përgjegjësitë e saj kushtetuese për zbatim të duhur të gjendjes emergjente të cilën vet e kishte shpallur me Vendimin 01/11 të 15 marsit 2020 (cituar më lart) sepse masat e marra “*kufizojnë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit të garantuar sipas nenit 35 dhe 43 të Kushtetutës, kufizimi i të cilave, me rregull mund të bëhet me ligj dhe vetëm në rrethana të Gjendjes së Jashtëzakonshme, si dhe me kushte e rrethana që e arsyetojnë një kufizim të tillë, dhe vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme me Dekret të Presidentit [...] dhe me pëlqimin e deputetëve të Kuvendit [...], sipas nenit 131 (paragrafi 1 (3), paragrafi 4), të Kushtetutës.*”

Baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Qeverisë

150. Gjykata rikujton paragrafin 22 të këtij Aktgjykimi ku specifikisht theksohet baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Qeverisë. Në vijim, Gjykata do të paraqes përmbajtjen e të gjitha neneve bazuar në të cilat është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Qeverisë dhe, më pas, në pjesën e meritave do të komentojë për

secilin prej tyre në dritë të kompetencave që ato nene i japin Qeverisë për të kufizuar të drejta dhe liri themelore. E gjithë kjo me qëllim që në fund të arrihet në përfundimin kyç të këtij rasti, se a e autorizon baza e referuar ligjore Qeverinë që të ndërmarrë veprimet e ndërmarra përmes Vendimit të kontestuar.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kapitulli II - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 55

[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.

Kapitulli VI - Qeveria e Republikës së Kosovës

Neni 92

[Parimet e Përgjithshme]

[...]

4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 93
[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

[...]

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

[...]

Ligji Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi, Gazeta Zyrtare nr. 13, 7 maj 2013

Neni 12
[Masat dhe veprimet]

1. Kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, si në vijim:

[...]

1.11. ndërmarrja e masave për parandalimin dhe eliminimin e pasojave shëndetësore të shkaktuara nga gjendjet emergjente;

[...]

KREU XIX [i Ligjit për Shëndetësi]
KUJDESI SHËNDETËSOR GJATË GJENDJEVE EMERGJENTE

Neni 89
[Përgjegjësitë e Ministrisë]

1. Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Aktivitetet e kujdesit shëndetësor në rastet e emergjencës nga paragrafi 1. i këtij neni përfshijnë:

2.1. zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;

2.2. adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent;

2.3. zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes;

2.4. sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët;

2.5. veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore;

2.6. aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave.

3. Gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.

4. Dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht, pavarësisht nga kufizimet që i përcakton paragrafi 3. i këtij neni.

Ligji nr. 02/l-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Gazeta Zyrtare nr. 40, 15 tetor 2008

MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E POPULLSISË NGA SËMUNDJET NGJITËSE

Neni 41
[Pa titull]

41.1 Për ta mbrojtur vendin nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, ethet e verdha, SARS-i, gripit i shpendëve dhe sëmundjet tjera ngjitëse, merren masat e parashikuara me këtë ligj dhe me konventa ndërkombëtare sanitare dhe me akte tjera ndërkombëtare.

41.2 Për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e kolerës, murtajës, variola vera, etheve hemorragjike virale, etheve të verdha, SARS-it, gripit të shpendëve dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje, si vijon:

- a) Ndalimi i udhëtimit në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjëres nga këto sëmundje;
- b) Ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara;
- c) Kufizimi ose ndalimi i qarkullimit të llojeve të veçanta të mallrave dhe të produkteve;
- d) Pjesëmarrja e detyrueshme e institucioneve shëndetësore, institucioneve të tjera dhe e qytetarëve në luftimin e sëmundjes dhe në shfrytëzimin e objekteve, të pajisjes dhe të mjeteve të transportit me qëllim të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;

41.3 Për pjesëmarrjen në zbatimin e masave nga pikat a) deri d) të këtij neni, institucioneve shëndetësore, organizatave të tjera dhe qytetarëve u takon kompensimi adekuat nga organi kompetent.

Neni 44
[Pa titull]

Për zbatimin e kontrollit të parandalimit dhe të luftimit të sëmundjeve ngjitëse, organet e ISK-së përveç masave të theksuara në nenin 41 deri 43 të këtij ligji, kryen edhe këto detyra:

- a) Personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe të tajueseve të bacileve të këtyre sëmundjeve (mikrob-bartësve) t'ua ndalojë veprimtarinë në punë dhe në detyra të caktuara, përkatësisht

në punët dhe në detyrat ku mund të rrezikojnë shëndetin e personave të tjerë;

b) Të ndalojnë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se janë të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse;

c) Të ndalojnë tubimin e personave në shkolla, në kinema, në lokalet publike dhe në vendet e tjera publike, derisa të mos kalojë rreziku nga epidemia;

d) Të urdhërojnë dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin me qëllim të parandalimit ose të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;

e) Të urdhërojnë izolimin e personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe mjekimin e tyre;

f) Të urdhërojnë marrjen e masave të tjera të përgjithshme ose të posaçme të parashikuara tekniko-sanitare dhe higjienike.

Rregullorja nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e miratuar në mbledhjen e 3-të të Qeverisë, me Vendimin nr. 01/03 të 19 shkurtit 2020

Neni 4
[Qeveria]

1. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të saj:

2.1. merr vendime me propozimin e anëtarëve të Qeverisë dhe institucioneve të tjera në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

2.2. nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

2.3. diskuton probleme dhe merr vendime për çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të saj;

2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të saj, si dhe

2.5. kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Rregullore nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 15, 12 shtator 2011

Neni 17
[Mbledhjet korresponduese]

1. Në raste urgjente kur nuk është e mundur të thirret mbledhja e Qeverisë, me propozim të Kryeministrit, Qeveria mund të vendosë mbi

ndonjë çështje pa u takuar në mbledhje (në mbledhje korresponduese).

[...]

4. Konsiderohet se materiali në mbledhje korresponduese të Qeverisë është miratuar nëse anëtarët e Qeverisë nuk kanë kundërshtuar materialin brenda kohës së dhënë.

[...]

Neni 19

[Marrja e vendimeve]

1. Qeveria mund të miratojë vendime, nëse më parë janë përgatitur në pajtim me këtë Rregullore.

2. Vendimet në mbledhjet e Qeverisë merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje në të cilën votohet për këto vendime.

[...]

4. Votimi në mbledhje të Qeverisë është i hapur.

5. Rezultati i votimit vërtetohet nga Kryeministri.

6 Pas përfundimit të shqyrtimit, Qeveria:

6.1. merr vendim mbi materialin dhe nëse është e nevojshme, udhëzon Sekretariatit që të bëjë plotësimet në pajtim me qëndrimet dhe vendimet e miratuara në mbledhje;

6.2. miraton projektligjin, apo aktet e përgjithshme që dërgohen për debatim në Kuvend, dhe akte tjera nënligjore dhe masa brenda kompetencave të veta;

[...]

Baza tjetër kushtetuese dhe ligjore (vendore dhe ndërkombëtare) e rëndësishme për analizën kushtetuese në rrethanat e rastit konkret

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kapitulli II - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3.Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

4.Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Neni 35

[Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.

4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Neni 36

[E Drejtat e Privatësisë]

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj

Neni 43

[Liria e Tubimit]

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Neni 56

[Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]

1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 8

(E drejta për respektim të jetës private dhe familjare)

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Neni 11

(Liria e tubimit dhe e organizimit)

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Neni 2 (Liria e lëvizjes) i Protokollit nr. 4 të KEDNJ

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.
3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.
4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 13 [pa titull]

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.
2. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 12 [pa titull]

1. Secili që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht brenda këtij territori si dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.
2. Secili është i lirë të braktisë cilindo vend, duke përfshirë edhe vendin e tij.
3. Të drejtat e sipërpërmendura mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj, dhe kur është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe kur këto kufizime janë nëpërputhje me të drejtat e tjera të njohura në këtë Pakt.
4. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga e drejta për të hyrë në vendin e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

151. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

152. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Presidenti.
153. Më specifikisht, Gjykata i referohet dispozitës përkatëse kushtetuese sipas të cilës Presidenti, në rrethanat e rastit konkret, mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...]

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

- (1) *çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.*

[...]

154. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit (9) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], të ndërlidhur me dispozitën e lartcekur, i cili përcakton:

Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;

[...]

155. Sipas Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, autoriteti i Presidentit për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese duhet të kuptohet vetëm në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës dhe se dispozita kushtetuese e përcaktuar me paragrafin (9) të nenit 84 të Kushtetutës ku thuhet se Presidenti mund të “referojë çështje kushtetuese” – është e ndërlidhur me nenin 113 të Kushtetutës. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO79/18, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 72, 74, 77, 78 dhe 82; shih po ashtu rastet KO181/18, parashtrues *Presidenti i Republikës së*

Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 47-48; dhe KO131/18, parashtues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 marsi 2019, paragrafi 90).

156. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson se nuk qëndron pretendimi i Presidentit se e drejta e tij për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit (9) të nenit 84 të Kushtetutës paraqet *“një kompetencë [të] gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës”*. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tashmë ka qartësuar saktë se neni 113 i Kushtetutës është e vetmja bazë mbi të cilën Presidenti mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese.
157. Për rrjedhojë, pranueshmëria e kësaj kërkesë do të trajtohet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës, më specifikisht nën-paragrafi (1) i paragrafit 2, të cituara më lart e që janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret siç do të shpjegohet në vijim.
158. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Presidenti, në cilësinë e parashtuesit ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë të 23 marsit 2020 bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës. Qeveria ka kontestuar pranueshmërinë e kërkesës duke pretenduar se nuk janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë për faktin se: (i) Presidenti nuk është palë e autorizuar për të kontestuar vendime të Qeverisë; (ii) nuk ka saktësuar kërkesën e tij; dhe, (iii) nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim substancial rreth pretendimeve të tij.

Lidhur me palën e autorizuar

159. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që paragrafi 2 i nenit 113 të Kushtetutës e autorizon, në mes të palëve të tjera të autorizuara, edhe Presidentin që të ngre rast lidhur me *“çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.”* Nga kjo rezulton se Presidenti, sipas këtyre dy dispozitave kushtetuese mund të kontestojë para kësaj Gjykate: (i) ligj të Kuvendit; (ii) dekret të Kryeministrit; ose (ii) rregullore të Qeverisë. Me rastin e kontestimit, Presidentit është i autorizuar të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësojë se të njëjtat a janë në pajtim me Kushtetutën ose jo.
160. Në rrethanat e rastit konkret, opsioni (i) dhe (iii) nuk janë të aplikueshme meqë Presidenti nuk është duke kontestuar as “ligj” të Kuvendit e as “rregullore” të Qeverisë. Presidenti, përmes kërkesës

KO54/20 ka kontestuar një Vendim të Qeverisë, të nënshkruar nga Kryeministri, respektivisht Vendimin nr. 01/15 të 23 marsit 2020. Ky Vendim i kontestuar hyn në përcaktimin “dekret” i Kryeministrit, opsioni (ii), i lartcekur si i mundshëm.

161. Për më tepër që Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, në thelb, veçse është vendosur që nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij. Vendimi i kontestuar rrjedhimisht hyn në fushëveprim të fjalës dekret i Kryeministrit. (Shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO12/18, parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafi 51 dhe paragrafët 84-88; dhe KO73/16, Avokati i Popullit, paragrafët 39-50). Lidhur me rastin e cituar nga Gjykata, KO73/16, Qeveria ka theksuar se kjo praktikë gjyqësore është e gabuar dhe se e njëjta duhet rishqyrtuar nga Gjykata. Sipas Qeverisë, Kushtetuta nuk parasheh që Presidenti mund të kontestojë vendime të Qeverisë ngase sipas tyre fjala “dekreteve të Kryeministrit” nuk mund të interpretohet se nënkupton Vendim të nënshkruar nga Kryeministri.
162. Nëse Gjykata do të pranonte interpretimin e Qeverisë që vendimet e Kryeministrit nuk mund të kontestohen nga Presidenti vetëm për faktin se nuk quhen “dekret” por “vendim” – kjo do të nënkuptonte se vendimmarrja e Qeverisë, respektivisht e Kryeministrit do të ngelej jashtë kontrollit kushtetues dhe se Gjykata Kushtetuese nuk do të mund të shqyrtonte kushtetutshmërinë e asnjë vendimi të Qeverisë në asnjë formë. Një përfundim i tillë qartazi nuk është qëllimi i nenit 113.2 (1) të Kushtetutës ku përveç Presidentit, edhe Kuvendi dhe Avokati i Popullit kanë të drejtë të kontestojnë “dekretet e Kryeministrit”, respektivisht vendimet e nxjerra nga Kryeministri.
163. Nëse Gjykata do të pranonte propozimin e Qeverisë për interpretim të kësaj dispozite kushtetuese do arrihej në situatën ku përveç Presidentit, as Kuvendi e as Avokati i Popullit nuk do të mund të kontestonin kushtetutshmërinë e vendimet të nënshkruara nga Kryeministri. Gjykata nuk mund të pajtohet me këtë propozim ngase qëllimi i nenit 113.2 (1) të Kushtetutës nuk është përjashtimi i kontrollit kushtetues vetëm për vendime të Kryeministrit. Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është që tu jepet mundësia kushtetuese të gjitha palëve që të kontestojnë aktet e njëri-tjetrit me qëllim të garantimit të kushtetutshmërisë së vendimmarrjes respektive të secilit institucion kushtetues, respektivisht Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë.

164. Për më tepër, Gjykata vëren se nenin 113.2 (1) i Kushtetutës përmend bashkërisht fjalët “*të dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit*” që qartazi nënkupton vendimeve që merren nga Presidenti dhe Kryeministri, pavarësisht emërimit specifik të tyre. Andaj, pretendimi i Qeverisë se Presidenti nuk është palë e autorizuar për të kontestuar vendime të Qeverisë, të nënshkruara nga Kryeministri – është i pabazuar. (Shih *mutatis mutandis*, KO12/18, parashtrues të kërkesës: *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafët 84-87).
165. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se Presidenti është palë e autorizuar për të ngritur çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të Vendimit të kontestuar të Qeverisë, të nënshkruar nga Kryeministri.

Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe specifikimin e kundërshtimeve

166. Më tutje, nën-paragrafi (1) i paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës precizohet më tutje me nenin 29 dhe 30 të Ligjit dhe me rregullin 67 të Rregullores së punës, të cilat specifikojnë si në vijim:

Neni 29 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

1. *Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga [...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...].*
2. *Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
3. *Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.*

Neni 30 i Ligjit
[Afatet]

1. *Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.*

Rregulli 67 i Rregullores së punës
[Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës
dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

167. Dispozitat e lartcekura të Ligjit dhe të Rregullores së punës, kërkojnë që kërkesat e dorëzuara sipas nën-paragrafit (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës duhet të plotësojnë edhe tri kushte shtesë, përveç atyre të parapara me Kushtetutë, ashtu që kërkesa të konsiderohet si e pranueshme për shqyrtim në merita nga ana e Gjykatës.
168. Kushti i parë është domosdoshmëria që parashtruesi i kërkesës të qartësojë nëse është kontestuar kushtetutshmëria e tërë aktit apo një pjesë të veçantë të aktit. Se çfarë mund të jetë ai akt, u shpjegua më lart. Ky kusht, në rrethanat e rastit konkret, është plotësuar nga Presidenti, në cilësi të parashtruesit, ngase ky i fundit qartazi ka specifikuar se e konteston tërë Vendimin e kontestuar të Qeverisë. Rrjedhimisht, pretendimi i Qeverisë se Presidenti nuk e ka saktësuar kërkesën e tij është i pabazuar.
169. Kushti i dytë është domosdoshmëria që parashtruesi i kërkesës të specifikojë kundërshtimet rreth kushtetutshmërisë ndaj aktit të kontestuar. Ky kusht, në rrethanat e rastit konkret, është plotësuar nga Presidenti, në cilësi të parashtruesit, ngase Presidenti qartazi ka specifikuar kundërshtimet e tij rreth kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë, duke specifikuar saktë nenet kushtetuese dhe duke arsyetuar mënyrën se si ai ka konsideruar që Vendimi i kontestuar bie ndesh me ato dispozita kushtetuese. Rrjedhimisht, pretendimi i Qeverisë se Presidenti nuk i ka saktësuar kundërshtimet e tij është i pabazuar.
170. Kushti i tretë është domosdoshmëria që parashtruesi i kërkesës të dorëzojë kërkesën brenda një afati prej gjashtë (6) muajsh nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Ky kusht, në rrethanat e rastit konkret, është plotësuar nga Presidenti, në cilësi të parashtruesit, ngase ky i fundit e ka dorëzuar kërkesën e tij një (1) ditë

pas marrjes së Vendimit të kontestuar – rrjedhimisht brenda afatit të përcaktuar.

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

171. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar; (ii) konteston akt të cilin ka të drejtë ta kontestojë; (iii) ka specifikuar se e konteston aktin në tërësi; (iv) ka paraqitur kundërshtimet kushtetuese kundrejt aktit të kontestuar; dhe, (v) e ka kontestuar aktin brenda afatit të përcaktuar.
172. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

173. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës, respektivisht Presidenti, pretendon se Vendimi i kontestuar [nr. 01/15] i Qeverisë i 23 marsit 2020, është në kundërshtim me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumentet Ndërkombëtare], 35 [Liria e Lëvizjes], 43 [Liria e Tubimit], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës; nenin 2 (Liria e Lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; nenin 13 [pa titull] të DUDNJ-së; si dhe nenin 12 [pa titull] të PNDKP-së. Përveç këtyre neneve, Gjykata ka marrë parasysh, për rrethanat e rastit konkret, edhe nenin 36 [E Drejtat e Privatësisë] të Kushtetutës dhe, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, edhe nenet 8 (E drejtat për respektim të jetës private dhe familjare) dhe 11 (E drejta e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së. Përmbajtja e të gjitha këtyre neneve është cituar më sipër. [Sqarim i Gjykatës: në vijim për qartësi leximi, Gjykata për *“lirinë e lëvizjes”* do t’i referohet nenit 35 të Kushtetutës; për të *“drejtën e privatësisë”* do t’i referohet nenit 36 të Kushtetutës; për *“lirinë e tubimit”* do t’i referohet nenit 43 të Kushtetutës – duke theksuar që të tri këto nene do të lexohen në kuptim të neneve respektive të KEDNJ-së, 8, 11 dhe 2 të Protokollit nr. 4 si dhe neneve ekuivalente të DUDNJ-së dhe PNDKP-së].
174. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se Qeveria në mënyrë kundër-kushtetuese ka bërë kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut përmes Vendimit të kontestuar meqë, sipas Presidentit, kufizimet e tilla të përgjithshme për të gjithë qytetarët pa

dallim mund të bëhen vetëm me ligj dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar në nenin 131 të Kushtetutës. Qeveria e kundërshton këtë pretendim të Presidentit, duke theksuar se të drejtat dhe liritë e njeriut, mund të kufizohen edhe pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme. Në këtë aspekt, Qeveria në thelb pretendon se kufizimi i të drejtave dhe lirive përmes Vendimit të kontestuar, është bërë në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës dhe se baza ligjore e cituar në këtë Vendim, i ka dhënë Qeverisë autorizimin e nevojshëm. Qeveria pajtohet se në rrethanat e rastit konkret ka pasur ndërhyrje në “lirinë e lëvizjes” dhe në “lirinë e tubimit”; mirëpo konsideron se kufizimi në fjalë është bërë në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjin për Shëndetësi, rrjedhimisht në përputhshmëri me nenin 55 të Kushtetutës.

175. Si rrjedhojë, në njërën anë, Presidenti kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë Vendimin e kontestuar si kundër-kushtetues ngase i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me, nenet 21, 22, 35, 43, 55 dhe 56 të Kushtetutës; dhe, në anën tjetër, Qeveria kërkon nga Gjykata që të lë në fuqi Vendimin e kontestuar ngase i njëjti është kushtetues dhe është nxjerrë në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 dhe 43 të Kushtetutës.
176. Gjykata në këtë drejtim thekson se çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Vendimit të kontestuar të Qeverisë, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij, Qeveria ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në përputhje me ligjin apo përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, përkitazi me vlerësimin nëse kufizimet e bëra në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë janë të përcaktuara me ligj, Gjykata do të fokusohet në vlerësimin e autorizimeve të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit për Shëndetësi. Përveç kësaj baze ligjore të cekur në Vendimin e kontestuar nga ana e Qeverisë, Gjykata, për të përcaktuar nëse kufizimet në të drejtat dhe liritë themelore përmes Vendimit të kontestuar janë të përcaktuara në ligj, do të vlerësojë edhe të gjitha nenet e tjera mbi bazën e së cilës theksohet se është nxjerrë Vendimi i kontestuar.
177. Para analizës dhe vlerësimit të çështjes që ngërthen ky rast, Gjykata, e vetëdijshme për situatën në të cilën gjendet shteti i Republikës së Kosovës pas përhapjes së pandemisë COVID-19 në nivel botëror dhe në vendin tonë, e sheh të nevojshme që të sqarojë për publikun dhe qytetarët e Republikës së Kosovës që:

- (i) Gjykata me këtë Aktgjykim nuk do të vlerësojë se a janë adekuate dhe të nevojshme, apo jo, masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Ky nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese. Politikat dhe vendimmarrja për shëndetin publik nuk hyjnë dhe nuk janë pjesë e kompetencave dhe autorizimeve të kësaj Gjykate. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese i referohet dhe bindet ekspertëve shëndetësor të fushës në nivel shtetëror dhe botëror. Për më tepër që, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjëra palë në këtë rast.
 - (ii) Gjykata me këtë Aktgjykim, siç është përcaktuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës, vetëm do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar të Qeverisë. Të gjitha institucionet e tjera publike duhet të luajnë rolin e tyre kushtetues në përputhje me autorizimet e tyre kushtetuese dhe ligjore.
 - (iii) Për rrjedhojë: në vijim dhe deri në fund të këtij Aktgjykimi, pa asnjë paragjykim rreth mendimeve dhe rekomandimeve të ekspertëve dhe profesionistëve shëndetësor të nivelit shtetëror dhe botëror rreth pandemisë COVID-19, Gjykata do të fokusohet vetëm në atë se a është respektuar Kushtetuta dhe ligji i aplikueshëm me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar nga ana e Qeverisë dhe faktit se a ka vepruar Qeveria vetëm “në zbatim të ligjit” me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive apo ka shkuar “përtej autorizimeve të dhëna përmes ligjit të aplikueshëm” të nxjerrë nga Kuvendi.
178. Për të vendosur lidhur me pretendimet e ngritura në këtë kërkesë dhe çështjen kushtetuese të definuar më lartë, Gjykata fillimisht duhet të qartësojë se mbi bazën e cilave nene duhet të bëhet analiza kushtetuese. Siç u tha më lart, Presidenti ka ngritur pretendime për shkelje të neneve 21, 22, 35, 43, 55, 56 të Kushtetutës dhe ka përmendur edhe nenin 131 të Kushtetutës për të mbështetur argumentet e tij. Qeveria, në anën tjetër, ka theksuar se neni 56 nuk është i aplikueshëm dhe se neni 35 dhe 43 në lidhje me nenin 55 janë të aplikueshme por të njëjtat nuk janë shkelur në rrethanat e rastit konkret.
179. Si rrjedhojë, Gjykata në vijim do të sqarojë: (i) aplikueshmërinë e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës; (i) aplikueshmërinë e nenit 56 të Kushtetutës; dhe (iii) aplikueshmërinë e nenit 55 të Kushtetutës në

lidhje me nenet e tjera relevante të Kushtetutës, respektivisht 35, 36 dhe 43. Më pas, parimet e përgjithshme të nenit 55 të Kushtetutës të mbështetura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, kjo e fundit do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret duke bërë analizimin e “përcaktueshmërisë me ligj”, përkatësisht bazës ligjore mbi të cilën është nxjerrë Vendimi i kontestuar, me qëllim të përgjigjes në çështjen kushtetuese të definuar më sipër. Pas këtij vlerësimi kushtetues, krejt në fund, Gjykata do të: (i) arsyetojë vendimmarrjen e saj lidhur me momentin juridik të hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, respektivisht datës 13 prill 2020; (ii) ngeljen e pa objekt të kërkesës për masë të përkohshme; dhe, (iii) para pjesës operative të këtij Aktgjykimi, do të paraqes përfundimet kryesore të Gjykatës për këtë rast.

II. Lidhur me nenet 21 dhe 22 të Kushtetutës

180. Në këtë aspekt, Gjykata qartëson se nenet 21 dhe 22 të Kushtetutës nuk janë nene që në vetvete ngërthejnë një të drejtë ose liri themelore.
181. Neni 21 përcakton që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë janë *“bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”* dhe se kjo e fundit mbron dhe garanton këto të drejta dhe liri. Sipas parimeve të nenit 21 të Kushtetutës, çdokush ka për detyrë t'i respektojë të drejtat dhe liritë themelore dhe të njëjtat vlejné, përveç për personat fizik, edhe për ata juridik, për aq sa janë të zbatueshme.
182. Neni 22 liston të gjitha marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që garantohen me Kushtetutë dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe përcakton që të njëjtat kanë prioritet ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, në rast të konfliktit.
183. Të dy nenet e lartcekura rrjedhimisht nuk janë nene që mund të interpretohen në mënyrë të pavarur nga dispozitat tjera kushtetuese relevante për këtë rast. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtij rasti, Gjykata i ka marrë parasysh edhe parimet e theksuara në nenin 21 të Kushtetutës por edhe marrëveshjet dhe instrumenteve ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës, posaçërisht nenet 2 të Protokollit nr. 4, 8 dhe 11 të KEDNJ-së të cilat, në ndërlidhje me nenet respektive të Kushtetutës, do të interpretohen për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar.

III. Lidhur me nenin 56 të Kushtetutës

184. Gjykata rikujton se, përderisa në njërën anë Presidenti në cilësi të parashtruesit pretendon se Qeveria ka shkelur nenin 56 të Kushtetutës ngase asnjë kufizim i të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të bëhet pa shpallje të Gjendjes së Jashtëzakonshme; Qeveria, në anën tjetër, thekson se neni 56 i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm ngase kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore është bërë mbi bazën e nenit 55 të Kushtetutës dhe se një kufizim i tillë është i mundshëm pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme.
185. Për sa i takon aplikueshmërisë së nenit 56 të Kushtetutës, Gjykata: (i) pajtohet me konstatimin e Qeverisë që ky nen nuk gjen aplikim në rrethanat e rastit konkret; dhe (ii) nuk pajtohet me pretendimin e Presidentit që kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. E vërteta është se, siç do të shpjegohet më tutje, kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që kufizimi i të drejtave mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, për aq sa është në pajtim me Kushtetutën, mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme.
186. Gjykata e sheh të nevojshme në këtë drejtim të sqarojë, *strictu sensu* vetëm për aq sa është e nevojshme për rrethanat e rastit dhe në përgjigje të pretendimeve kundërthënëse, kuptimin e termit “kufizim” të përdorur në nenin 55 të Kushtetutës dhe termit “shmangie” të përdorur në nenin 56 të Kushtetutës. Ky sqarim i shkurtër shërben për të treguar që, në rrethanat e rastit konkret, neni 56 i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm, ndërkah që neni 55 i Kushtetutës është.
187. Termi “kufizim” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të përcaktojë kufizime për të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, gjithnjë për aq sa është e lejuar me Kushtetutë. Qeveria në anën tjetër, nxjerrë vendime, rregullore ose akte të tjera juridike të nevojshme për zbatimin e këtyre ligjeve. Termi “shmangie”, në anën tjetër, i përdorur në nenin 56 të Kushtetutës, nënkupton shmangien nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sipas procedurës të përcaktuar në nenin 131 të Kushtetutës. Doktrina juridike njeh edhe “kufizimin” (*limitation*) edhe “shmangien” (*derogation*). I pari nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes ngase mund të bëhet edhe pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme; i dyti nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme. Madje,

edhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme, shmangia nga disa nene të Kushtetutës është e ndaluar. Paragrafi 2 i nenit 56 liston specifikisht të gjitha nenet e Kushtetutës nga të cilat shmangia nuk lejohet në *“kurrfarë rrethanash”*.

188. Duke qenë se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjë me “shmangie” sipas nenit 56 të Kushtetutës, por me “kufizim” sipas nenit 55 të Kushtetutës; rezulton që i pari nuk është i aplikueshëm, ndërsa i dyti është. Thënë këtë, Gjykata më tutje nuk do të lëshohet në interpretim të mëtutjeshëm të nenit 56 të Kushtetutës, por do të fokusohet në nenin 55 dhe do të vlerësojë nëse kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara përmes neneve 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës, përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë, janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës.

IV. Lidhur me nenin 55 të Kushtetutës

189. Përkitazi me zbatimin e nenit 55 të Kushtetutës në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, në vijim, do të shpjegojë: (i) përmbajtën e nenit 55 të Kushtetutës; parimet e përgjithshme që ngërthen ky nen, me fokus të veçantë në kriterin *“e përcaktuar me ligj”*; (ii) testin kushtetues të këtij neni; dhe, (iii) lidhshmërinë e këtij neni me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës.
190. Neni 55 është neni i parafundit i Kapitullit II të Kushtetutës ku parashihen “Të Drejtat dhe Liritë Themelore” dhe përmban gjithsej pesë paragraf.
191. Në paragrafin e parë të këtij neni, specifikisht thuhet se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë *“mund të kufizohen vetëm me ligj”*. Pra, kufizimi i të drejtave tashmë të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet *“vetëm me ligj”*. Gjykata thekson se fjala “ligj” e përdorur në paragrafin e parë të nenit 55 të Kushtetutës, nënkupton një ligj të nxjerrë nga Kuvendi, sipas procedurave përkatëse legjislative. Së pari, kjo nënkupton se asnjë kufizim i lirive dhe të drejtave nuk mund të bëhet nëse i kufizimi i tillë nuk është i “përcaktuar me ligj” të Kuvendit. Së dyti, kjo nënkupton që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj të Kuvendit ku parashihen kufizime mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është “përcaktuar me ligj” të Kuvendit. Ky rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të determinuar se a është kushtetues një “kufizim” i të drejtave dhe lirive themelore apo jo.

192. Në paragrafin e dytë të nenit 55 të Kushtetutës theksohen tri kushte shtesë, përveç kushtit të parë, sipas të cilave të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen. Kushti i dytë, pas të parit të lartcekur, është që kufizimet, përveç se duhet të jenë të bëra dhe të përcaktuara me “ligj” të Kuvendit; të njëjtat mund të kufizohen vetëm *“deri në atë masë sa është e domosdoshme”*. Këtu pra paraqitet kushtëzimi për vet Kuvendin që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë t’i kufizojë për aq sa është e domosdoshme. Kushti i dytë, në ndërlidhje me gjithë frymën e nenit 55 të Kushtetutës, reflekton “parimin e proporcionalitetit” që duhet të testohet në çdo rast kur kemi të bëjë me një kufizim të një të drejte apo lirie. Kushti i tretë është që përmes kufizimit të një lirie ose të drejte duhet *“të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi”*, pra, ndërhyrja dhe kufizimi i një të drejtë apo lirie duhet të ketë dhe të ndjekë një “qëllim legjitim”. Ky kusht, në ndërlidhje me gjithë frymën e nenit 55 të Kushtetutës, reflekton “parimin e legjitimitetit” të ndërhyrjes ose kufizimit e që po ashtu duhet të testohet në çdo rast kur kemi të bëjë me një kufizim të një lirie apo të drejte. Së fundmi, kushti i katërt është që kufizimet e bëra me ligj duhet të jenë të tilla që të konsiderohen si të nevojshme në një *“shoqëri të hapur dhe demokratike”*. Ky kusht, në ndërlidhje me gjithë frymën e nenit 55 të Kushtetutës, reflekton parimin e nevojës së kufizimit në një shoqëri demokratike e që po ashtu duhet të testohet në çdo rast kur kemi të bëjë me një kufizim ose ndërhyrje në të drejta dhe liri themelore.
193. Në paragrafin e tretë të nenit 55 të Kushtetutës theksohet fakti që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë *“nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.”* Ky paragraf nënkupton që qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të determinueshme dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin e Kuvendit në të cilin është lejuar kufizimi në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës.
194. Në paragrafin e katërt të nenit 55 të Kushtetutës theksohet fakti që me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet një përgjegjësi kushtetuese për institucionet e pushtetit publik, e sidomos për gjykatat që gjatë interpretimit dhe vendosjes në raste para tyre, t’i kushtojnë kujdes esencës së drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
195. Në paragrafin e pestë të nenit 55 të Kushtetutës theksohet kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk

bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar. Se çfarë është esenca e një të drejte të garantuar varet nga lloji i të drejtës ose lirisë në fjalë.

196. Në këtë drejtim, rezulton që substanca e testit kushtetues të nenit 55 të Kushtetutës është një test katër (4) hapësh i cili duhet të bëhet në të gjitha rastet kur është e nevojshme të konfirmohet se a kemi të bëjë me kufizim kushtetues të lirive ose të drejtave apo një kufizim i tillë është jo-kushtetues. Para se të theksohen në detaje të gjithë katër hapat e testit në fjalë dhe mënyrës së aplikimit të tyre, duhet të theksohet se testi në fjalë nuk është kumulativ. Kjo nënkupton që në të gjitha instancat që nuk kalohet kushti ose hapi i parë i testit, analiza kushtetuese përfundon aty dhe nuk është e nevojshme që të analizohet aplikueshmëria e tri, dy, apo një hapi tjetër të mbetur të testit. Këtë qasje interpretuese, siç do të shpjegohet më tutje, e përdorë edhe vet GJEDNJ në interpretim të kufizimeve të lirive dhe të drejtave të garantuara me KEDNJ.
197. Testi i nenit 55 të Kushtetutës nënkupton që menjëherë pas përcaktimit se a kemi të bëjë me një “kufizim” të një të lirie ose të drejte, respektivisht a kemi “ndërhyrje” në një liri ose të drejtë – e që duhet të determinohet në çdo rast - duhet të jepet përgjigje në katër (4) pyetjet vijuese, jo-kumulative [theks i veçantë], të nenit 55 të Kushtetutës:
 - (1) Pyetja 1 e testit: A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj”? Nëse përgjigja është negative, atëherë analiza kushtetuese përfundon këtu – meqë asnjë kufizim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë nuk mund të bëhet ndryshe përveç se me “ligj” të Kuvendit dhe deri në masën që lejon ai ligj – gjithnjë nën supozimin që i njëjti është në pajtim me Kushtetutën. Nëse përgjigja është afirmative, atëherë kalohet në pyetjen e dytë të testit ngase plotësohet kushti që kufizimi është bërë me ligj ose që kufizimi ka qenë i “përcaktuar me ligj” të Kuvendit.
 - (2) Pyetja 2 e testit: A ka ndjekur kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar një qëllim legjitim, respektivisht përmes kufizimit në fjalë, a përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi? Nëse përgjigja është negative, atëherë analiza kushtetuese përfundon këtu – meqë asnjë kufizim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë nuk mund të bëhet pa u determinuar dhe legjitimuar qëllimi legjitim i kufizimit të tillë dhe pa u përmbushur qëllimi për të cilin kufizimi në krye të herës është bërë. Nëse përgjigja është afirmative, pra, kalohet

testi i qëllimit legjitim, atëherë kalohet në pyetjen e tretë të testit.

- (3) Pyetja 3 e testit: A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar proporcional, respektivisht a është bërë kufizimi vetëm deri në masën sa ka qenë e domosdoshme? Nëse përgjigja është negative, atëherë analiza kushtetuese përfundon këtu – meqë asnjë kufizim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë nuk mund të bëhet përtej masës së domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Nëse përgjigja është afirmative, pra, kalohet testi i proporcionalitetit/domosdoshmërisë, atëherë kalohet në pyetjen e katërt dhe të fundit të testit katër-hapësh.
- (4) Pyetja 4 e testit: A është kufizimi i bërë i nevojshëm në një shoqëri të hapur dhe demokratike? Pavarësisht nëse përgjigja në këtë pyetje është negative ose afirmative, analiza kushtetuese përfundon këtu. Nëse përgjigja është negative, atëherë kjo nënkupton që kufizimi i asaj të drejte ose lirie nuk është kushtetues ngase asnjë kufizim nuk mund të bëhet nëse i njëjti nuk është i nevojshëm në një shoqëri të hapur dhe demokratike. Nëse përgjigja është afirmative, pra, kalohet testi, atëherë konsiderohet se i gjithë kufizimi i bërë ka qenë kushtetues ngase janë përmbushur në mënyrë afirmative të gjithë katër hapat e testit të paraparë me nenin 55 të Kushtetutës.

198. Në kontekstin e lartcekur dhe në përmbledhje, Gjykata thekson se testi i nenit 55 të Kushtetutës përcakton se kufizimi i një të drejte ose lirie: (i) mund të bëhet vetëm me “ligj” të Kuvendit; (ii) duhet të ketë një “qëllim legjitim”; (iii) duhet të jetë i “domosdoshëm dhe proporcional”; (iv) duhet të jetë “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”. Për qëllime interpretative të këtyre nocioneve dhe koncepteve, Gjykata thirret në faktin që edhe GJEDNJ përdorë të tilla teste për të vendosur se në një rast konkret a ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me KEDNJ. (Në këtë aspekt, shih Udhëzuesit e GJEDNJ-së për nenet 8 deri në 11 të KEDNJ-së dhe rastet e GJEDNJ-së të cituar aty – ku shpjegohen në mënyrë të qartë përdorimi i koncepteve: “*prescribed by law*” ose “përcaktuar me ligj”; “*legitimate aim*” ose “qëllimi legjitim”; “*proportionality*” ose “proporcionaliteti”; “*necessary in a democratic society*” ose “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, koncepte këto që pasqyrohen edhe në testin e nenit 55 dhe të disa neneve të tjera të Kushtetutës për të cilat parashihet se mund të ketë kufizim).

1. Lidhja e nenit 55 të Kushtetutës me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës

199. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, si parantezë të rëndësishme Gjykata thekson se neni 55 i Kushtetutës nuk ngërthen në vetvete të drejta që mund të interpretohen në mënyrë abstrakte pa pasur edhe një ndërlidhje me nene të tjera të Kushtetutës. Pra, neni 55 nuk ka një ekzistencë të pavarur – por është i varur nga nenet e tjera të Kushtetutës që garantojnë të drejta dhe liri themelore, e të cilat mund të kufizohen në pajtim me Kushtetutën.
200. Për rrethanat e rastit konkret, siç edhe do të sqarohet më tutje, kufizimi i të drejtave dhe lirive të bëra me Vendimin e kontestuar prek në të drejtën *“e lirisë së lëvizjes”*, të garantuar me nenin 35 të Kushtetutës; *“të drejtën e privatësisë”* të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës; dhe *“lirinë e tubimit”* të garantuar me nenin 43 të Kushtetutës. Për faktin se Vendimin i kontestuar “kufizon” dhe “ndërhyn” në të drejtat e garantuara me nenet 35 dhe 43 të Kushtetutës, respektivisht “lirinë e lëvizjes” dhe “lirinë e tubimit”, palët në kontest, Qeveria dhe Presidenti, nuk kanë pasur mospajtim. Që të dyja palët pohojnë se ekziston “kufizimi” si fakt në rrethanat e rastit konkret. Në këtë drejtim, edhe Gjykata pajtohet se në rrethanat e rastit konkret ka pasur një “kufizim” ose “ndërhyrje” me gëzimin e të drejtave të garantuara me nenet 35 dhe 43 të Kushtetutës.
201. Për sa i takon nenit 35 të Kushtetutës, respektivisht “lirisë së lëvizjes”, Gjykata rikujton se i njëjti ka gjithsej pesë paragrafët. Paragrafi i parë i këtij neni ia garanton shtetasve të Republikës së Kosovës dhe të huajve që janë banorë të ligjshëm në Republikën e Kosovës, *inter alia*, të drejtën e lëvizjes së lirë brenda vendit dhe të drejtën e tyre që të largohen nga vendi. Të gjitha kufizimet e kësaj të drejte sipas paragrafit 2 të nenit 35 të Kushtetutës, *“rregullohen me ligj”* në rastet kur kufizimet e tilla *“janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.”* Paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 35 të Kushtetutës nuk janë relevant për rrethanat e rastit konkret andaj dhe Gjykata nuk do të lëshohet në komentimin e tyre. Mirëpo, paragrafët 1 dhe 2 të sqaruar më lart, e që janë relevant për rrethanat e rastit konkret, shumë qartë e përcaktojnë që çdo kufizim i kësaj lirie “rregullohet me ligj”. Këtë nen Gjykata, bazuar në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës e lexon dhe interpreton në lidhje me nenin ekuivalent të KEDNJ-së, respektivisht nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
202. Për sa i takon nenit 43 të Kushtetutës, respektivisht “lirisë së tubimit”, Gjykata rikujton se i njëjti ka gjithsej një paragraf në të cilin

garantohet liria e tubimit paqësor. Secili person, sipas këtij neni, gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Të drejtat e tilla, sipas nenit 43 të Kushtetutës mund të kufizohen “vetëm me ligj” në rastet kur një gjë e tillë është e domosdoshme, *inter alia*, për të siguruar “shëndetin publik”. Këtë nen Gjykata, bazuar në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës e lexon dhe interpreton në lidhje me nenin ekuivalent të KEDNJ-së, respektivisht nenin 11 të KEDNJ-së.

203. Për sa i takon nenit 36 të Kushtetutës, respektivisht “të drejtës së privatësisë”, Gjykata rikujton se një pretendimin për kufizim të kësaj të drejte nuk është ngritur parashtruesi por është përmendur nga Avokati i Popullit në Opinionin e tij dorëzuar në formë komentesh. Rikujtojmë që Avokati i Popullit theksoi që pika e 4-të e Vendimit të kontestuar të Qeverisë “*që flet për ndalimi[n] i[e] tubimeve në mjediset private*” mbetet e paqartë dhe se çështja e zbatimit të mbikëqyrjes së këtij kufizimi mbetet qenësore. Lidhur me këtë aspekt, Gjykata rikujton se në pikën 4 të Vendimit të kontestuar theksohet: “*Ndalohen tubimet në të gjitha mjediset – private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura – përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Në rast të vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit.*” Edhe nenin 36 të Kushtetutës, Gjykata, bazuar në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës e lexon dhe interpreton në lidhje me nenin ekuivalent të KEDNJ-së, respektivisht nenin 8 të KEDNJ-së.
204. Përveç tri të drejtave dhe lirive themelore të lartcekura të garantuara me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës – e që qartazi janë të aplikueshme dhe për të cilat kufizimi dhe ndërhyrja qartazi ekziston, Gjykata thekson se nuk përjashtohet mundësia që Vendimi në fjalë të jetë i aplikueshëm edhe për ndonjë kufizim tjetër të lirive dhe të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, varësisht nga mënyra se si zbatohet Vendimi i kontestuar dhe varësisht nga pasojat juridike që personat (fizik dhe juridik) mund të pësojnë ose jo, si rezultat i zbatimit të tij.
205. Gjykata thekson se nenet respektive dhe ekuivalente të KEDNJ-së, nenit 2 i Protokollit nr. 4 dhe nenet 8 e 11 të KEDNJ-së, janë të ndërtuar në esencë mbi një strukturë të ngjashme, bazuar në të cilën, secili prej këtyre neneve, përcakton fillimisht të drejtën përkatëse dhe më pas qëllimet legjitime bazuar në të cilat një e drejtë e tillë mund të kufizohet, me kusht që ky i fundit të jetë “i përcaktuar me ligj”, të

ndjekë një qëllim legjitim, të jetë proporcional dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

206. “Ruajtja e shëndetit” është e përcaktuar specifikisht si një nga qëllimet legjitime mbi bazën e të cilës mund të kufizohen të drejtat përkatëse, megjithatë, gjithnjë me kushtin që një kufizim i tillë të ketë qenë “i përcaktuar në ligj”. Në të kundërtën, edhe nëse kufizimi mund të jetë bërë për qëllime të mbrojtjes së shëndeti publik, nëse autorizimi për një kufizim të tillë, nuk është i përcaktuar me ligj, ndërhyrja, përkatësisht kufizimi i të drejtës përkatëse nuk do të jetë në pajtim me KEDNJ-në. Kjo sepse, bazuar në strukturën e nenit 55 të Kushtetutës, edhe të neneve 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNJ-së, është “përcaktueshmëria me ligj” ajo që e përbën hallkën e parë të një testi jo-kumulativ të vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën dhe KEDNJ-së të kufizimit të një drejte, siç dhe është shpjeguar më sipër.
207. Rrjedhimisht, dhe marrë parasysh që “të përcaktuarit me ligj” i një kufizimi është pika e parë e vlerësimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të një kufizimi në të drejtat dhe liritë themelore, vetëm kalueshmëria e të cilës, rezulton në vlerësimin e aspekteve të tjera të testit që ngërthen nenin 55 i Kushtetutës dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e vet Gjykatës, Gjykata në vijim, do të fokusohet në: (i) shtjellimin e parimeve të përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës, për aq sa është e nevojshme për rrethanat e rastit konkret, përkitazi me “përcaktueshmërinë me ligj”; dhe (ii) aplikueshmërinë e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret. Kalueshmëria e këtij testi, do të rezultojë ose jo në vlerësimin e aspekteve tjera të testit, përkatësisht, ekzistimin e një qëllimi legjitim, proporcionalitetit, dhe nevojës së një kufizimi të tillë në një shoqëri demokratike.

1.1. Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së të reflektuar në praktikë gjyqësore lidhur me termin “parashikuar me ligj” (“prescribed by law”)

208. Gjykata në vijim do të paraqes katër raste të GJEDNJ-së, në mesin e shumë të tjerëve, ku specifikisht sqarohet kriteri “i përcaktuar me ligj” dhe mënyrën se si GJEDNJ e analizon se a është një kufizim ose ndërhyrje e ndërmarrë e përcaktuar me dhe në ligj apo jo. Ndonëse çështjet faktike të atyre rasteve dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, e rëndësishme ngelet interpretimi i përgjithshëm i kriterit “i përcaktuar me ligj” që GJEDNJ bën në praktikën e saj gjyqësore. Gjykata vëren se në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së akoma nuk ka ndonjë rast që trajton specifikisht ndërhyrjet dhe kufizimet e bëra në

të drejta dhe liri themelore përgjatë pandemisë COVID-19. Si rrjedhojë, Gjykata do të përdorë rastet e tjera të GJEDNJ-së në të cilat është shpjeguar koncepti “parashikuar me ligj” (“prescribed by law”).

209. Në rastin *Tommaso kundër Italisë*, GJEDNJ, në mes tjerash, kishte theksuar se: “shprehja “në pajtim me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai duhet të jetë i arritshëm për të personat në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij.” Më tutje, GJEDNJ, kishte theksuar se: “një rregull është “i parashikueshëm” kur siguron një masë të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike” dhe se një ligj “i cili jep një diskrecion duhet të tregojë fushën e këtij diskrecioni, megjithëse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen respektuar jo domosdoshmërisht duhet të përfshihen në rregullat e së drejtës materiale.” (Shih, *Tommaso kundër Italisë*, kërkesa nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty.)
210. Në rastin *Dubrovina dhe të tjerët kundër Rusisë*, GJEDNJ kishte ritheksuar se: “shprehja “e përcaktuar me ligj” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar të ketë një bazë ligjore në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, i cili duhet të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij. Që ligji i brendshëm të përmbushë kërkesat cilësore, ai duhet të sigurojë një masë të mbrojtjes ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike me të drejtat e garantuara nga Konventa. Në çështjet që prekin të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të parashikuar në Konventë, që diskrecioni ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehet në termat e një pushteti të papenguar. Si pasojë, ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Më tutje lidhur me substancën e rastit para saj, GJEDNJ kishte arsyetuar se autoritetet publike që kishin bërë ndërhyrjet nuk kishin sqaruar se si “ndërhyrja në të drejtën e parashtruesve për lirinë e tubimit ishte bazuar në një dispozitë ligjore që ishte e arritshme dhe e parashikueshme në zbatimin e saj.” Prandaj, GJEDNJ arriti në përfundimin se “ndërhyrja nuk ishte “e përcaktuar me ligj”” dhe se një fakt i tillë mjafton për të gjetur “shkelje të nenit 11.” Në fund, GJEDNJ theksoi se një konstatim i tillë e pengon atë të shkojë tutje me analizë për të përcaktuar nëse kufizimi apo ndërhyrja “ka ndjekur një qëllim legjitim dhe ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike.” (Shih, *Dubrovina dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesa

nr. 31333/07, Aktgjykim i 25 shkurtit 2020, paragrafët 43-46 dhe referencat e cituara aty).

211. Në rastin *Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë*, GJEDNJ ritheksoi praktikën e saj gjyqësore “për sa i përket shprehjeve “e përcaktuar me ligj” dhe “në pajtim me ligjin” në nenet 8 deri 11 i Konventës” duke theksuar që kjo shprehje “jo vetëm që kërkon që masa e kundërshtuar të ketë një bazë ligjore në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, i cili duhet të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm për sa i përket efekteve të tij.” GJEDNJ theksoi se: “një normë nuk mund të konsiderohet si “ligj” përveç nëse është formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’iu mundësuar qytetarëve të rregullojnë sjelljen e tyre; ata duhet të jenë në gjendje – nëse ka nevojë me këshilla të përshtatshme – për të parashikuar, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat e caktuara, pasojat të cilat mund t’i sjellë një veprim i caktuar.” Më tutje, GJEDNJ theksoi se: “Niveli i saktësisë së kërkuar nga legjislacioni i brendshëm - i cili në asnjë rast nuk mund të parashikojë çdo eventualitet – varet në një shkallë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, fusha e cila është dizajnuar për të mbuluar edhe numrin edhe statusin e atyre të cilëve u drejtohet.” (Shih, *Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 37553/05, Aktgjykim i 15 tetorit 2015, paragrafët 108-110 – dhe referencat e cituara aty).
212. Në rastin *Navalnyy kundër Rusisë*, GJEDNJ kishte ripërsëritur se: “në mënyrë që ligji i brendshëm të përmbushë kërkesat cilësore, ai duhet të sigurojë një masë të mbrojtjes ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike në të drejtat e garantuara me Konventë.” Lidhur me diskrecionin ligjor të pushtetit ekzekutiv, GJEDNJ kishte theksuar se: “Në çështjet që prekin të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të parashikuar në Konventë, që diskrecioni ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehet në termat e një pushteti të papenguar. Si pasojë, ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij”. (Shih, *Navalnyy kundër Rusisë*, kërkesat nr. 29580 dhe 4 të tjera, Aktgjykim i 15 nëntorit 2018, paragrafët 115-119 – dhe referencat e cituara aty).
213. Siç u theksua tashmë, pa marrë parasysh që rastet e referuara këtu, nuk ngërthejnë në vetvete rrethanat faktike të krahasueshme me ato të rastit në rrethanat e rastit konkret, emëruesi i përbashkët i vlerësimit të përcaktueshmërisë me ligj, rezulton të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) ekzistimi i një baze të qartë ligjore; (ii)

parashikueshmëria e kufizimit përkatës; (iii) ekzistenca e masave mbrojtëse nga ndërhyrja, përkatësisht kufizimi i të drejtave nga autoritetet publike; dhe (iv) qartësia e mjaftueshme në ligj përkitazi me diskrecionin e autoritetit publik lidhur me mundësinë e kufizimit dhe mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni.

214. Specifikisht për sa i takon ekzekutivit, respektivisht Qeverisë, për rrethanat e rastit konkret, është e rëndësishme që të theksohet qëndrimi i GJEDNJ-së se në çështjet të cilat prekin të drejta dhe liri themelore “*diskrecioni ligjor*” i dhënë përmes ligjit në favor të Qeverisë duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij. E kundërta, respektivisht mos qartësimi i një diskrecioni të tillë, do të ishte në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të garantuar me KEDNJ, por edhe me Kushtetutë.
215. Ky konstatim i GJEDNJ-së, i shprehur në më shumë se një rast, është i rëndësishëm për rrethanat e rastit konkret ngase Qeveria në komentet e dorëzuara në Gjykata disa herë ka potencuar që Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitetëse “*u jep autoriteteve shëndetësore diskrecion të gjerë për të ndaluar tubimet për qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitetëse.*” Diskutimit rreth këtij diskrecioni, Gjykata do t’i kthehet sërish dhe gjerësisht në pjesën e Aktgjykimit ku vlerësohen autorizimet që Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitetëse ia ka dhënë Qeverisë.
216. Praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese në aspekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë së kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, është e bazuar gjithashtu në këto parime, dhe e njëjta do të sqarohet në vijim.

1.2. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në interpretim të nenit 55 të Kushtetutës

217. Gjykata rikujton të paktën katër raste në të cilat ajo ka interpretuar kuptimin e nenit 55 të Kushtetutës dhe të njëjtin e ka aplikuar në rrethanat specifike të atyre rasteve. Ndonëse, njëjte sikur edhe në rastet e referuara të GJEDNJ-së, çështjet faktike të këtyre rasteve dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, e rëndësishme ngelet interpretimi i përgjithshëm i parimeve që ky nen ngërthen sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate.

218. Në rastin KO01/17, në paragrafin 90, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: *“kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Prandaj, Gjykata konsideron se kufizimi i tillë është në përputhje me kërkesat e përfshira në nenin 55 (1) të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata konkludon se kufizimi i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me ligj.”* (Shih, KO01/17, parashtrues Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese i 28 marsit 2017). Pra, në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar se përgjigja në pyetjen e parë të testit të nenit 55 ishte afirmative dhe si rrjedhojë Gjykata kishte vijuar me analizimin e pikave të tjera të testit – analiza këto që nuk janë relevante për rastin konkret.
219. Në rastin KO157/18, në paragrafët 93-96, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: *“Kushtetuta në kapitullin II të saj iu ka dhënë rëndësi të posaçme të drejtave dhe lirive të njeriut dhe gjithashtu ka paraparë edhe rastet kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe i Shtetit.”* Ndërkaq, në paragrafët vijues ku edhe e kishte bërë analizën se për rrethanat e atij rasti a ishte kufizimi i përshkruar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: *“95. Sa i përket kufizimit të paraparë me ligj, Gjykata vëren se kufizimi i të drejtave në rastin konkret ishte paraparë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili ishte miratuar nga Kuvendi, më 10 qershor 2010, institucion të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. 96. Prandaj, nisur nga fakti se një e drejtë e garantuar me kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet me ligj, kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtave është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1, të nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se obligimi i kompanive të sigurimit për të pagur një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, në rastin konkret, ka qenë i paraparë me ligj.”* Pra, në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar se përgjigja në pyetjen e parë të testit të nenit 55 ishte afirmative dhe si rrjedhojë Gjykata kishte vijuar me analizimin e pikave të tjera të testit – analiza këto që nuk janë relevante për rastin konkret. (Shih rastin KO157/18, parashtrues Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019).
220. Në rastin KO108/13, në paragrafët 133-134, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata iu ishte referuar

rastit të GJEDNJ-së, *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* (shih kërkesa nr. 38433/09, Aktgjykim i GJEDNJ-së 7 qershorit 2012), dhe kishte theksuar se: “një normë nuk mund të konsiderohet si një ‘ligj’ përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. [...]” (Shih rastin KO108/13, parashtrues Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i 3 shtatorit 2013).

221. Në rastin KO131/12, në paragrafin 130, përkritazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: “kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.” Pra, në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar se përgjigja në pyetjen e parë të testit të nenit 55 ishte afirmative dhe si rrjedhojë Gjykata kishte vijuar me analizimin e pikave të tjera të testit – analiza këto që nuk janë relevante për rastin konkret. (Shih rastin KO131/12, parashtrues Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit, Aktgjykim i 15 marsit 2013).

1.3. Aplikimi i parimeve të përgjithshme dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të Gjykatës Kushtetuese, në rastin konkret

222. Për tu kthyer tek rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton përfundimin e saj fillestar se në rrethanat e rastit konkret ka pasur “ndërhyrje” ose “kufizim” në të paktën tri të drejta ose liri, respektivisht, “lirinë e lëvizjes” sipas nenit 35; “të drejtën e privatësisë” sipas nenit 36, dhe “lirinë e tubimit” sipas nenit 43. Tanimë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në nxjerrjen e Vendimit të kontestuar, përmes të cilit është ndërhyrë në këto të drejta dhe liri themelore, Qeveria është bazuar në autorizimet ligjore të dhëna me ligj të Kuvendit.
223. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që Vendimi i kontestuar i Qeverisë është nxjerrë mbi bazën vijuese ligjore (shih pjesën “Baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë Vendimi i kontestuar” pas paragrafit 150 të këtij Aktgjykimi ku ceket përmbajtja e të gjitha neneve vijuese; shih po ashtu paragrafët 20-21 ku citohet Vendimi nr. 01/11 i Qeverisë dhe përmbajtja e tij):

- (i) Neni 55 [Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore] të Kushtetutës;
 - (ii) Paragrafi 4 i nenit 92 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës;
 - (iii) Paragrafin 4 i nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës;
 - (iv) Nenin 41 [Pa titull] dhe nenin 44 [Pa titull] të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse;
 - (v) Paragrafit 1.11 të nenit 12 [Masat dhe Veprimet] dhe nenin 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë] të Ligjit për Shëndetësi;
 - (vi) Nenin 4 [Qeveria] të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;
 - (vii) Nenin 17 [Mbledhjet korresponduese] dhe 19 [Marrja e vendimeve] të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011; si dhe,
 - (viii) Në zbatim të Vendimit të Qeverisë nr. 01/11 të 15 marsit 2020 [të lartcekur] për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik.
224. Gjykata vëren se Vendimi i kontestuar i Qeverisë është bazuar në tetë (8) baza ligjore dhe se të njëjtat, pretendon Qeveria, janë zbatuar në mënyrë të përpiktë. Përmbajtja e kësaj baze ligjore do të shtjellohet hollësisht në vijim me qëllim të arritjes në përfundimin kyç se a e autorizojnë bazat e lartcekura ligjore Qeverinë për të ndërmarrë kufizimet e të drejtave dhe lirive të bëra me Vendimin e kontestuar.
225. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se për sa i takon bazës së parë ligjore të paraparë në pikën (i), Gjykata veçse shpalosi analizën e saj për nenin 55 të Kushtetutës dhe autorizimet që Qeveria mund të ketë bazuar në atë nen. Më tutje, Gjykata vëren se bazat ligjore e referuar të specifikuara në pikat e lartcekura (ii), (iii), (vi), (vii), janë thjesht baza ligjore që tregojnë nenet specifike të Kushtetutës mbi të cilat Qeveria, *inter alia*, është e autorizuar të merr vendime “*në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje*” dhe se Qeveria ka kompetencë, *inter alia*, të merr “*merr vendime [...] të nevojshme për zbatimin e ligjeve*”. Ndërkaq, për sa i takon pikës (viii) të lartcekur, Gjykata vëren se Vendimi i Qeverisë përmes së cilit u shpall “emergjenca për shëndetin publik” nuk paraqet një bazë ligjore që justifikon kufizimet e bëra përtej asaj që është përcaktuar me ligj të Kuvendit.
226. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës, analiza duhet të fokusohet në bazën ligjore të cekur në pikat (iv) dhe (v) – të cituara më lart. Këto dy baza ligjore janë të nevojshme për të determinuar se a e ka pasur autorizimin në një “ligj” të Kuvendit, Qeveria për të ndërmarrë masat e ndërmarra. Andaj, Gjykata do ta fokusojë analizën e saj në ligjet e

cekura si bazë ligjore për kufizim të të drejtave, respektivisht: nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; dhe, nenet 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit për Shëndetësi.

1.4. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse – si bazë ligjore për Vendimin e kontestuar të Qeverisë: neni 41 [pa titull] dhe neni 44 [pa titull]

227. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se për rrethanat e rastit konkret relevante është “Pyetja e parë” e testit të nenit 55 të Kushtetutës, respektivisht se “A ka qenë kufizimi i një lirie apo të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj”?”. Andaj, në vijim, Gjykata do të përgjigjet në këtë pyetje fillimisht. Siç u tha dhe më sipër, nëse përgjigja do të jetë negative, atëherë nuk do të jetë e nevojshme përgjigja në pyetjet dy, tre dhe katër të testit të nenit 55 të Kushtetutës.
228. Gjykata rikujton që Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse është një ligj i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2008. Qëllimi i këtij Ligji, sipas nenit 1 të tij, është që të “përcaktohen sëmundjet ngjitëse si dhe rregullohen aktivitetet për zbulimin në kohë, evidencimin e shfaqjes, parandalimin, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.”
229. Neni 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse janë pjesë e Kapitullit IV të këtij Ligji që flet për “Masat e Sigurisë për Mbrojtjen e Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse” i cili ka gjithsej shtatë (7) nene. Përveç neneve 41 dhe 44, ky Kapitull që flet për masat e sigurisë përmban edhe nenet 42, 43, 45, 46 dhe 47.
230. Gjykata vëren se vetëm nenet 41 dhe 44 janë cituar si bazë ligjore dhe në detaje do të analizohen më poshtë. Megjithatë, për të kuptuar frymën legislative të këtij Kapitulli të Ligjit që rregullon masat e sigurisë është e nevojshme që të shikohet se çfarë rregullojnë edhe dispozitat e tjera të ndërlidhura me nenet 41 dhe 44.
231. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 42 i Ligjit parasheh që për të mbrojtur vendin nga futja dhe përhapja e sëmundjeve ngjitëse “organizohet dhe ushtrohet kontrolli sanitar i udhëtarëve dhe sendeve të tyre si dhe i mjeteve të transportit” në kufijtë e shtetit. Për mënyrën e ushtrimit të këtij kontrolli kufitar që synon parandalimin e futjes së sëmundjeve, ligjvënësi i referohet dispozitave të një tjetër ligji, respektivisht “Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës nr. 2003/22”.
232. Neni 43 i Ligjit thekson se për zbatim të kontrollit sanitar në kufi sipas paragrafit 41.2 [theks i veçantë] dhe nenit 42 të Ligjit, Inspektorati

Sanitar Shëndetësor ka për obligim që: të urdhërojë kontrollin sanitar të personave dhe të materialeve për qëllime të konstatimit të sëmundjeve ngjitëse; të ndalojë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se mund të infektohen nga sëmundjet e cituara specifikisht aty; dhe të urdhërojë ndërmarrjen e masave të tjera të parashikuara tekniko-sanitare dhe higjienike kundër sëmundjeve ngjitëse, në përputhje me këtë ligj dhe me detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe traktatet tjera ndërkombëtare sanitare. Referenca që neni 43 i Ligjit bën në nenin 41.2 të Ligjit është shumë e domethënëse. Kjo sepse neni 43 i Ligjit rregullon zbatimin e kontrollit sanitar në kufi me qëllimin të parandalimit të futjes dhe përhapjes sëmundjeve ngjitëse “në tërë vendin” dhe neni 41.2 të cilit i referohet nenin 43 thekson që: *“Për të parandaluar **futjen dhe përhapjen e [...]** dhe sëmundjeve tjera ngjitëse **në tërë vendin**, Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje, si vijon [...]”*. Pas fjalës si vijon ceken specifikisht masat kufizuese që mund të ndërmerren **jo** “në tërë vendin” por **në** rajone të caktuara të vendit ku është përhapur epidemia; **në** rajonet e infektuara; ose, **në** rajonet drejtpërdrejt të rrezikuara – me qëllim të parandalimit të futjes dhe përhapjes së këtyre sëmundjeve “në tërë vendin”. Pra, këto dispozita nuk flasin për instancën kur i tërë vendi është kapluar nga një epidemi por për masat kufizuese që mund të merren për të parandaluar kaplimin e tërë vendit nga një epidemi. Dhe kjo, bën diferencën kyçe në këtë Ligj për sa i takon autorizimeve të Qeverisë të “përcaktuara me ligj”, siç edhe do të shpjegohet më tutje.

233. Neni 45 i Ligjit specifikon që të gjitha masat e përshkruara në nenet 41 dhe 44 të këtij ligji [theks në faktin ku thuhet masat e përshkruara], ndaj individëve dhe institucioneve urdhërohen me anë të aktvendimit me procedurë administrative. Ky nen është relevant për të treguar se me çfarë procedure duhet të ndërmerren masat e përshkruara në nenet 41 dhe 44 për individë dhe institucione.
234. Neni 46 i Ligjit rregullon mënyrën e raportimit tek Ministria e Shëndetësisë nga ana e organeve komunale shëndetësore dhe administrata komunale e Inspektoratit Sanitar. Këto organe, të nivelit komunal ose lokal, janë të obliguara që të dërgojnë tek Ministria e Shëndetësisë *“raportet lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të tij, si dhe të dhënat lidhur me shfaqjen dhe me masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.”* Ky nen është relevant për të treguar që masat e autorizuara kufizuese të nenit 41 dhe 44 janë masa të nivelit lokal dhe jo të nivelit mbarë-shtetëror ngase këtu kërkohet raportim nga

organet komunale dhe administrata komunale e Inspektoratit Sanitar dhe jo raportim të nivelit qendror për të gjithë Republikën e Kosovës.

235. Neni 47 qartëson se Ministria e Shëndetësisë është kompetente për *“zbatimin e këtij ligji dhe për miratimin e dispozitave të parapara me të.”* Në përputhje me këtë autorizim, ligjvënësi i ka dhënë të drejtë dhe detyrë Ministrisë së Shëndetësisë që: tu jap instruksione të detyrueshme organeve të administratës së Kosovës kur një gjë e tillë është *“në interes të mbarë vendit”* dhe e domosdoshme për aplikim unik të dispozitave; si dhe, të njoftojë Qeverinë për moskryerjen e punëve të caktuara administrative në bazë të autorizimit me ligj nëse moskryerja e tyre mund të shkaktojë shfaqjen ose përhapjen e mëtutjeshme të epidemisë.
236. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë dhe analizojë dy bazat kyçe ligjore të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse mbi të cilat specifikisht është bazuar Vendimi i kontestuar i Qeverisë, respektivisht nenet 41 dhe 44 të këtij Ligji.

1.4.1. Neni 41 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse

237. Gjykata vëren se neni 41 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse nuk ka titull dhe përmban gjithsej tre paragrafë.
238. Në paragrafin e parë theksohet se për të mbrojtur vendin, respektivisht Republikën e Kosovës, edhe nga sëmundje të tjera ngjitëse, përveç atyre specifikisht të theksuara në këtë paragraf *“merren masat e parashikuara me këtë ligj dhe me konventa ndërkombëtare sanitare dhe me akte tjera ndërkombëtare.”* Në këtë pikë, Gjykata vëren se virusi COVID-19 nuk figuron në listën e sëmundjeve ngjitëse por që definicioni *“dhe sëmundjeve tjera ngjitëse”*, mjafton për të konstatuar se ky Ligj është i aplikueshëm edhe për COVID-19.
239. Në paragrafin 2 theksohet se për të parandaluar *“futjen dhe përhapjen”* e sëmundjeve ngjitëse *“në tërë vendin”*, Ministria e Shëndetësisë është e autorizuar që *“me akte nënligjore”* të përcaktojë *“masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje”*, e të cilat sipas Ligjit në fjalë janë gjithsej katër, respektivisht:

“a) Ndalimi i udhëtimit në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjëres nga këto sëmundje;

b) Ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara;

c) Kufizimi ose ndalimi i qarkullimit të llojeve të veçanta të mallrave dhe të produkteve;

d) Pjesëmarrja e detyrueshme e institucioneve shëndetësore, institucioneve të tjera dhe e qytetarëve në luftimin e sëmundjes dhe në shfrytëzimin e objekteve, të pajisjes dhe të mjeteve të transportit me qëllim të luftimit të sëmundjeve ngjitëse.”

240. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që pikat c) dhe d) nuk janë të aplikueshme meqë me Vendimin e kontestuar nuk është bërë ndalimi i qarkullimit të llojeve të veçanta të mallrave dhe të produkteve (siç do të mund të ndalohej p.sh. në rast se do të konsiderohej se përmes tyre do të mund të barteshin sëmundjet ngjitëse); dhe, nuk është urdhëruar pjesëmarrje e detyrueshme e institucioneve shëndetësore, institucioneve të tjera ose qytetarëve në luftimin e sëmundjes. Të tilla masa nuk janë propozuar në Vendimin e kontestuar.
241. Ndërkaq, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se të aplikueshme mund të jenë pikat a) dhe b) të nenit 41 të Ligjit të lartcekur, në kuptim të bazës ligjore dhe autorizimit të cilin ky Ligj ia jep Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht Qeverisë, për të vendosur kufizimet në fjalë.
242. Megjithatë, Gjykata vëren se përmes Vendimit të kontestuar nuk është bërë ndalimi i udhëtimit për të shkuar “në vendin” [theks në fjalën “në”] ku është përhapur epidemia, siç parasheh pika a) e nenit 41, mirëpo ndalimi i udhëtimit në orë të caktuara është bërë në “tërë vendin”, respektivisht në gjithë shtetin të Republikës së Kosovës dhe për të gjithë shtetasit dhe personat që jetojnë ose gjenden në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata vëren se qëllimi i pikës a) të lartcekur është që të ndalojë udhëtimin “në vendin” ku është përhapur epidemia, për shembull, të ndalojë shkuarjen apo udhëtimin në një fshat, qytet, vend ose lokacion të caktuar gjeografik ku është përhapur epidemia. Qëllimi i pikës a) nuk mund të kuptohet që i jep autorizim Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht Qeverisë për të kufizuar udhëtimin në të gjithë Republikën e Kosovës. Qëllimi i pikës a) është që të ndalojë udhëtimin “në vendin” ku është përhapur epidemia me qëllim të parandalimit të futjes dhe përhapjes së epidemisë “në tërë vendin”.
243. Sikurse Kuvendi të kishte zgjedhur të jepte një autorizim të tillë në ligj për Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë, do të mund ta bënte duke specifikuar qartazi që ndalimet e udhëtimit mund të bëhen

jo vetëm “në vendin” ku është përhapur epidemia por në “tërë vendin”. Në këtë aspekt, Gjykata vetëm po bën interpretimin e normës në fjalë në raport me autorizimet e Qeverisë dhe nuk po vlerëson se a është kjo normë adekuate apo jo për rrethanat në të cilat ndodhet shteti i Republikës së Kosovës. Andaj, në këtë pikë, Gjykata nuk mund të pajtohet me pretendimin e Qeverisë së fjalës “*ndalimin e udhëtimit në vendin ku është përhapur e epidemia*” nënkupton gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

244. Ky argument përforcohet edhe më tutje me faktin që ligjvënësi, respektivisht Kuvendi, aty ku ka zgjedhur që të përdorë togfjalëshin “tërë vendin” ose “mbarë vendin” në vend të fjalëve “në vendin” e ka bërë. Një analizë e Ligjit në fjalë tregon që Kuvendi në shtatë instanca përgjatë dispozitave specifike të Ligjit iu është referuar fjalëve “tërë vendin” ose “mbarë vendin”. (Shih nenet e Ligjit: 3.2; 4.1; 41.2; 47 a), 48 b); 48 c) dhe 49). Ndërkaq, kur ligjvënësi iu është referuar masave të posaçme dhe të jashtëzakonshme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse specifiku ka lejuar: (i) ndalimin e udhëtimit **në** vendin ku është përhapur epidemia; dhe (ii) ndalimin e qarkullimit **në** rajonet e infektuara ose **në** rajonet drejtpërsëdrejti të rrezikuara. Me një dispozitë tjetër, Kuvendi në mënyrë shumë të qartë do të mund të jepte autorizimin për ndalim të qarkullimit “**në tërë shtetin**” e Republikës së Kosovës për raste të pandemive botërore – por një gjë të tillë nuk e ka bërë dhe kjo ngelet thjesht një zgjedhje e Kuvendit për të cilën Gjykata nuk ka asnjë koment të mëtejshëm ngaqë nuk i takon t’ia përcaktojë zgjedhjet e as zgjidhjet legjislative Kuvendit – përderisa të njëjtat nuk kontestohet para kësaj Gjykate në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë.
245. Në këtë kontekst, ndërlidhja e fjalës “epidemi” dhe “në vendin ku është përhapur”, reflekton qëllimin e ligjvënësit që të autorizojë kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore në rajonet dhe vendet e infektuara dhe jo në nivel të tërë Republikës. Në këtë kontest Gjykata rikujton tri definicione të dhëna për fjalën “epidemi” të cilat sëmundjet ngjitëse epidemike i ndërlidhin me territor të caktuar ose rajon specifikisht të precizuar. Së pari, Gjykata i referohet definicionit të dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm: OBSH), në fjalorin zyrtar të saj, për fjalën epidemike, ku specifikisht thuhet: “*Epidemike: shfaqjet në një komunitet ose rajon rastet e një sëmundjeje, sjelljeve ose ngjarjeve të tjera të ndërlidhura qartazi më shumë se sa pritshmëritë. Komuniteti ose rajoni dhe periudha brenda të cilës rastet ndodhin janë specifikisht të precizuara.*” (Shih: *definicionet e bëra nga OBSH: <https://www.who.int/hac/about/definitions/en/>*.) Së dyti, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në nenin 2 të tij, e

definon fjalën epidemi me sa vijon: *“Epidemia: paraqitja e dy e më shumë rasteve të sëmundjeve ngjitëse të lidhura në kohë dhe territor apo rritje enorme e numrit të rasteve të sëmundjeve ngjitëse.”* Së treti, Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, në nenin 1 të tij, e definon fjalën epidemi si në vijim: *“e) Epidemia: paraqitja e dy apo më shumë rasteve të një sëmundjeve ngjitëse, të lidhura ngushtë mes veti në kohë dhe territor të caktuar apo rritjen enorme të numrit të rasteve të një sëmundjeve ngjitëse.”* Gjykata rikujton që përveç termit epidemi, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse e definon edhe termin “pandemi” sikur *“përhapja masive e sëmundjes ngjitëse e cila i tejkalon kufijtë e një shteti duke përfshirë disa shtete apo edhe kontinente”*; mirëpo, përtej faktit që e definon këtë term i njëjti nuk përdoret askund në Ligjin në fjalë.

246. Përdorimi i fjalës epidemi, dhe jo pandemi, në kontekst, të pikës a) të nenit 41 të këtij ligji, mund të shërbejë si argument shtesë për të treguar se ligjvënësi, respektivisht Kuvendi, ka kufizuar autorizimet e Ministrisë së Shëndetësisë në ndërhyrjen në të drejta dhe liri themelore “në vendin” ku është përhapur epidemia, duke nënkuptuar një territor ose rajon të caktuar dhe të precizuar brenda Republikës së Kosovës dhe jo ndërhyrjen në të drejta dhe liri themelore “në tërë vendin”. Në fakt, as vet Qeveria në Vendimin e kontestuar nuk i referohet fjalës “epidemi” por asaj “pandemi”.
247. Dispozita e lartcekur, përkatësisht pika a) e nenit 41 të Ligjit, saktësisht përcakton autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë, për të ndaluar udhëtimin *“në vendin ku është përhapur epidemia”*, duke e kufizuar autorizimin për të ndërhyrë vetëm në atë vend ku është përhapur epidemia dhe jo në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
248. Se a ka qenë kjo zgjidhje e mirë ligjore ose jo në kohën kur është hartuar Ligji në fjalë dhe se a është e mirë-bazuar në aspekt të politikave të shëndetit publik – nuk është në kompetencën e Gjykatës që ta përcaktojë. Kuvendi ka diskrecion kushtetues rreth çështjeve që zgjedhë të rregullojë dhe mënyrën se si zgjedhë të rregullojë çështje të caktuara – përfshi ato që kanë të bëjë me shëndetin publik dhe parandalimin e futjes dhe përhapjes së epidemive ose pandemive dhe luftimin e tyre. Në këtë pikë, është po ashtu e rëndësishme të theksohet që Gjykata nuk po bën vlerësimin e kushtetutshmërisë së ndonjë dispozite ligjore ngaqë rasti para saj nuk ka të bëjë me vlerësim të kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore në fjalë. Gjykata thjesht po bën vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Qeverisë i cili theksohet të jetë nxjerrë bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe të tjerat të referuara në bazën ligjore të Vendimit të kontestuar.

249. Siç është theksuar më lart, kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore, përtej përcaktueshmërisë me ligj, mund të bëhen vetëm për qëllimet për të cilat janë përcaktuar. Për më tepër, dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ligji përmes të cilit përcaktohet autorizimi për të ndërhyrë në një të drejtë, duhet të këtë masa mbrojtëse kundër ndërhyrjes së autoritetit publik, dhe në këtë kontekst Qeverisë, përtej qëllimit për të cilin është përcaktuar mundësia e ndërhyrjes. Gjithashtu, diskrecioni i kësaj ndërhyrjeje duhet të jetë mjaftueshëm i qartë së bashku me mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni. Një gjë të tillë, e konfirmon edhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së që flet për masën dhe sasinë e “*diskrecionit ligjor*” që mund t’i jepet Qeverisë në zbatim të një ligji. Në këtë aspekt, Gjykata nuk mund të pajtohet me pretendimet e Qeverisë “*diskrecioni i Qeverisë për të vepruar është në nivelin më të lartë të mundshëm*” ngase për çështjet që prekin të drejta dhe liri themelore “*diskrecioni ligjor*” i dhënë përmes ligjit në favor të Qeverisë duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Kuvendi, me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, as nuk i dhënë Qeverisë diskrecion të gjerë ligjor e as nuk ka treguar me qartësi fushën e diskrecionit dhe ushtrimit të tij. Në të tilla rrethana, lejimi i një diskrecioni të kërkuar nga ana e Qeverisë do të ishte në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ.
250. Rrjedhimisht, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se Qeveria ka vepruar përtej autorizimit të dhënë në pikën a) të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke ndaluar udhëtimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e saj.
251. I njëjti arsyetim vlen edhe për pikën b) të nenit 41 të Ligjit në fjalë ngase përmes Vendimit të kontestuar nuk është bërë ndalimi i qarkullimit vetëm “*në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”, mirëpo ndalimi i qarkullimit në orë të caktuara është bërë në nivel të të gjithë shtetit të Republikës së Kosovës dhe për të gjithë shtetasit dhe personat që jetojnë ose gjenden në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata vëren se qëllimi i pikës b) të lartcekur është që të ndalojë qarkullimin në “*rajonet e infektuara*” dhe në rajonet “*drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”, dhe duke u referuar specifikisht në kontekst rajonal, ka përjashtuar mundësinë e ndalimit të qarkullimit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e saj.

252. Përkatësisht, qëllimi i pikës b) nuk mund të kuptohet që i jep autorizim Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht Qeverisë, për të ndaluar qarkullimin në të gjithë Republikën e Kosovës. Andaj, në këtë pikë, Gjykata nuk mund të pajtohet me pretendimin e Qeverisë se “ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara” nënkupton gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Sikurse Kuvendi të kishte zgjedhur të jepte një autorizim të tillë në ligj për Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë – do të mund ta bënte.
253. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Qeveria ka vepruar përtej autorizimit të dhënë me pikat b) të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke ndaluar qarkullimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e saj.

1.4.2. Neni 44 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse

254. Gjykata tutje vëren se neni 44 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse nuk ka titull dhe përmban gjithsej një paragraf me gjashtë pika [a) b) c) d) e) dhe f)].
255. Në paragrafin e parë dhe të vetmin të këtij neni theksohet se për zbatimin e kontrollit dhe parandalimit të luftimit të sëmundjeve ngjitëse Inspektorati Sanitar i Kosovës, *inter alia*, kryen edhe detyra e të numëruara saktësisht në pikat a), b), c), d) e) dhe f) të Ligjit në fjalë. Pra, ky nen qartazi flet për detyrat shtesë që mund të kryej Inspektorati Sanitar i Kosovës, përveç atyre të paraparë në nenet 41-43 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, e të cilat konsistojnë në ndërmarrjen e masave vijuese:

“a) Personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe të tajueseve të bacileve të këtyre sëmundjeve (mikrob-bartësve) t’ua ndalojë veprimtarinë në punë dhe në detyra të caktuara, përkatësisht në punët dhe në detyrat ku mund të rrezikojnë shëndetin e personave të tjerë;

b) Të ndalojnë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se janë të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse;

c) Të ndalojnë tubimin e personave në shkollë, në kinema, në lokalet publike dhe në vendet e tjera publike, derisa të mos kalojë rreziku nga epidemia;

d) Të urdhërojnë dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin me qëllim të parandalimit ose të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;

e) Të urdhërojnë izolimin e personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe mjekimin e tyre;

f) Të urdhërojnë marrjen e masave të tjera të përgjithshme ose të posaçme të parashikuara tekniko-sanitare dhe higjienike.”

256. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që pikat d), e) dhe f) nuk janë të aplikueshme ngase përmes Vendimit të kontestuar nuk është urdhëruar ndërmarrja e këtyre masave nga ana e Institutit Sanitar të Kosovës. Në Vendimin e kontestuar nuk flitet për dezinfektim, dezinfektim ose deratizim me qëllim të parandalimit ose luftimit të sëmundjeve ngjitëse dhe as nuk flitet për izolimin e personave të sëmurë nga ndonjë sëmundje ngjitëse. Po ashtu, në Vendimin e kontestuar nuk flitet për ndërmarrjen e masave tekniko-sanitare dhe higjienike.
257. Ndërkaq, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se të aplikueshme mund të jenë pikat a), b) dhe c) të nenit 44 të Ligjit të lartcekur, në kuptim të bazës ligjore dhe autorizimit të cilin ky ligji ia jep Inspektoratit Sanitar të Kosovës, si një nga autoritetet që është i thirrur të zbatojë masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe IKSHP-në.
258. Pika a) përcakton që Inspektorati Sanitar i Kosovës mund t’ua ndalojë veprimtarinë, në punë dhe në detyra të caktuara, personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse – në rast se ata persona mund ta rrezikojnë shëndetin e personave të tjerë. Gjykata vëren se kjo pikë flet dhe jep autorizim për ndalim për persona të veçantë dhe të identifikueshëm dhe nuk flet për ndërmarrjen e një mase të përgjithshme ndaluese për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo masë po ashtu flet për ndalimin e kryerjes së punës dhe detyrave të caktuara për persona të caktuar dhe jo për ndalim të lëvizjes ose qarkullimit të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Andaj, Gjykata konstaton se pika a) nuk është dispozitë ligjore që i jep Qeverisë autorizimin për të bërë kufizimet e përgjithshme të bëra me Vendimin e kontestuar dhe se Qeveria nuk është përmbytur vetëm në zbatim të dispozitës në fjalë por ka shkuar përtej saj.
259. Pika b) përcakton që Inspektorati Sanitar i Kosovës mund ta ndalojë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se janë të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse. Gjykata vëren se edhe kjo pikë flet dhe jep autorizim për ndalim të qarkullimit për persona të veçantë dhe të identifikueshëm të cilët veçse janë konstatuar se janë të sëmurë nga një sëmundje ngjitëse ose dyshohet se janë të sëmurë. Andaj, Gjykata konstaton se pika b) nuk është dispozitë ligjore që i jep Qeverisë autorizimin për të bërë kufizimet e përgjithshme bëra me Vendimin e kontestuar dhe se Qeveria nuk është përmbytur vetëm në zbatim të dispozitës në fjalë por ka shkuar përtej saj. Kategorizimi i të

gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës si “të dyshuar” se janë të sëmurë, nuk mund të ketë qenë qëllimi i një norme e cila, nuk kufizon në asnjë mënyrë diskrecionin e autoritetit publik, respektivisht Inspektoratit Sanitar të Kosovës, dhe mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni. Rrjedhimisht, kuptimi dhe qëllimi i normës ndërlidhet me persona të identifikueshëm dhe jo më të gjithë qytetarët e Republikës.

260. Pika c) përcakton që Inspektorati Sanitar i Kosovës mund të ndalojë tubimin e personave në shkolla, në kinema, në lokalet publike dhe në vendet e tjera publike, derisa të mos kalojë rreziku nga epidemia. Gjykata vëren se përderisa kjo pikë e Ligjit flet specifikisht për kufizimin e tubimeve në: (1) “shkolla”; (2) “kinema”; (3) “lokale publike” dhe (4) “vende të tjera publike”; Vendimi i kontestuar flet në mënyrë të përgjithshme për të gjitha tubimet “*në të gjitha mjediset – private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura*”. Madje, përveç mjediseve publike, Vendimi i kontestuar flet edhe për mjedise private, qofshin ato të hapura ose të mbyllura. Ky lexim i kësaj dispozite dërgon qartazi në përfundimin se as pika c) nuk është dispozitë ligjore që i jep Qeverisë autorizimin për të bërë kufizimet e përgjithshme të bëra me Vendimin e kontestuar dhe se Qeveria nuk është përmbajtur vetëm në zbatim të dispozitës në fjalë por ka shkuar përtej saj.
261. Si përfundim dhe pas analizimit të secilës pikë dhe dispozitë ligjore të veçantë të neneve 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse – të konsideruara si bazë ligjore për ndërmarrjen e kufizimeve të lirive dhe të drejtave të bëra me Vendimin e kontestuar, Gjykata konstaton se këto dy dispozita ligjore nuk i japin Qeverisë autorizimin për të ndaluar në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës qarkullimin e “*qytetarëve dhe automjeteve private nga 24 mars 2020 gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00, përveç për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore*”; as autorizimin për të ndaluar në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës “*lëvizjet në rrugë*” me urdhëresën që të njëjtat të “*bëhen jo më shumë se nga dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët*”.
262. Ndërkaq, dhe më me rëndësi, për sa i takon autorizimit të Qeverisë që të ndalojë “*tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët*” dhe faktit se në “*rast të*

vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit”, Gjykata konsideron se këto kufizime të Qeverisë kërkojnë një analizë shtesë në dritë të nenit 36 të Kushtetutës, siç edhe me të drejtë u përmend nga Avokati i Popullit.

263. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se edhe përtej faktit që as Presidenti, as Qeveria, e as ndonjëra nga palët e interesuara përveç Avokatit të Popullit (shih paragrafët 130-132 të këtij Aktgjykimi) nuk e kanë përmendur faktin që Vendimi i kontestuar “ndërhyn” edhe në të drejtën e privatësisë të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, Gjykata vëren se një ndërhyrje e tillë ka ndodhur edhe për sa i takon kësaj të drejte. Avokati i Popullit me të drejtë e ka ngritur këtë argument.

264. Në këtë kontekst, dhe sipas paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 36 të Kushtetutës nuk janë relevant për rrethanat e rastit konkret andaj dhe Gjykata nuk do të lëshohet në komentimin e tyre. Tutje, sipas paragrafit 1 të nenit 8 të KEDNJ-së, çdokush gëzon, *inter alia*, të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare. Ndërkaq, sipas paragrafi 2 të nenit 8 të KEDNJ-së, autoritetet publike – përfshirë Qeverinë, për aq sa është e autorizuar me ligj, – mund të ndërhyjnë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm deri në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur një gjë e tillë, në mes tjerash, është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

265. Se çfarë nënkupton “privatësi”, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e ka përshkruar në një mori rastesh të saj ku, në thelb, është theksuar se koncepti i jetës private është një koncept i gjerë të cilit nuk mund t’i jepet një definicion shterrues. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *S dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat nr. 30562/04 dhe 30566/04, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2008; shih po ashtu Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ-së, II. Jeta Private, A. Sfera e jetës private). Në konceptin e jetës private dhe jetës familjare hyn edhe e drejta për të varrosur familjarët. (Shih, një nga rastet e GJEDNJ-së që konfirmon se e drejta për të marrë pjesë në varrimin e një anëtar të familjes hyn në garancitë që ofron neni 8 i KEDNJ-së, *Lozovyye kundër Rusisë*, kërkesa nr. 4587/09, Aktgjykim i 24 prillit 2018, paragrafët 31-35 dhe referencat e cituara aty).

266. Ndërhyrja, respektivisht kufizimi i kësaj të drejte në fjalë, është bërë nga Qeveria në pikën 4 të Vendimit të kontestuar ku specifikisht

thuhet se ndalohen tubimet në të gjitha mjediset “*private*” qofshin ato “*të hapura dhe të mbyllura*”, përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyra të punës për “*parandalim dhe luftimin të pandemisë*” si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Nga ky kufizim dhe nga mënyra se si është shkruar kufizimi në fjalë nga Qeveria në Vendimin e kontestuar, rezulton që qytetarëve të Republikës së Kosovës, përmes Vendimit të kontestuar, iu ndalohet të tubohen edhe në mjediset private brenda për brenda familjeve të tyre. Një lexim literal i këtij kufizimi nënkupton që Qeveria, përmes Vendimit të kontestuar ka ndaluar të gjitha tubimet në mjediset private, respektivisht edhe në familje dhe shtëpi ose banesa private të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përveç nëse ato tubime në mjedise private janë të domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Ngelet e paqartë se cilat tubime në mjedise private mund të konsiderohen si të domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Vendimi i kontestuar nuk dritëson instancat e tilla dhe se çfarë saktësisht kuptohet me ndalesën e tubimeve në mjedise private, të hapura ose të mbyllura. Ky formulim i vendosur në Vendimin e kontestuar tingëllon që kufizon të gjitha tubimet e mbyllura në mjedise private familjare dhe Avokati i Popullit me shumë të drejtë vë pikëpyetjen e përcjelljes së zbatimit të kësaj mase. Pas analizimit të tërësisë së Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Gjykata nuk ka arritur të gjejë asnjë dispozitë ligjore përmes së cilës Qeverisë i lejohet që të kontrollojë zbatueshmërinë e këtij Ligji për tubimet e bëra në mjediset private të mbyllura – që me fjalë të tjera nënkupton, të paktën, tubimet në familje ose të tjera të ngjashme.

267. Një kufizim i tillë nuk është i paraparë me ligjet e Kuvendit që Qeveria i ka cituar në Vendimin e kontestuar si bazë për ta nxjerrë atë. Askund në ato dispozita ligjore nuk përmenden kufizimet që mund të bëhen në “*mjedise private*”. Kjo tregon që ndonëse për kufizimet e tjera të parapara me nenin 41 të Ligjit, Gjykatës iu deshtë që të analizojë secilën dispozitë dhe të argumentojë saktë se përse ato nuk i japin autorizim specifik Qeverisë për të kufizuar të drejtat e garantuara me nenet 35 dhe 43 të Kushtetutës, për çështjen e kufizimit të drejtës së privatësisë dhe respektimit të jetës private dhe familjare të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës - mungesa e një autorizimit specifik në ligj është *prima facie* e dallueshme dhe kufizimi i bërë nga Qeveria rezulton të jetë arbitrar dhe i pabazuar në ligj. Gjykata vëren se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse në tërësinë e tij, në asnjë dispozitë, e as në këtë që po analizohet, nuk përmend kufizimet e mundshme për “*mjedise private*”. E mbrojtja nga arbitrariteti dhe ndërhyrja arbitrare në gëzimin e kësaj të drejte është ri-theksuar disa herë nga GJEDNJ si “qëllim esencial” i garancive të

ofruara me nenin 8 të KEDNJ-së. Obligimi parësor i shteteve është të përmbahen në mos-ndërhyje në këtë të drejtë – që nënkupton obligim negativ. (Shih, në mes tjerash, këtë parim të përgjithshëm të reflektuar në rastet e GJEDNJ-së: *Libert kundër Francës*, kërkesa nr. 588/13, Aktgjykim i 22 shkurtit 2018, paragrafët 40-42; shih po ashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 8 të KEDNJ-së).

268. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton dy raste të GJEDNJ-së në të cilat qartësohen rrethanat kur autoritetet publike në mënyrë arbitrare kufizojnë të drejta dhe liri, duke u thirrur në dispozita ligjore që qartazi nuk përkojnë me masat kufizuese të ndërmarra.
269. Në rastin *C.G. dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, GJEDNJ kishte gjetur shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së për shkak se kishte konsideruar që ndërhyrja që iu ishte bërë në gezimin e kësaj të drejte nuk kishte qenë “e përcaktuar me ligj” dhe për rrjedhojë parashtruesi në atë rast nuk kishte gëzuar as minimumin e mbrojtjes nga arbitrariteti i ushtruar nga autoritetet publike. (Shih, *C.G. dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 1365/07, Aktgjykim i 24 prillit 2008, paragrafët 49-50). Në këtë rast, GJEDNJ u ndal në këtë vlerësim ngase ndërhyrja nuk ishte e bazuar në ligj dhe rrjedhimisht nuk ishte e nevojshme të vazhdohet me pyetjet e tjera të vlerësimit të ndërhyrjes.
270. Në rastin rastet të ngjashme edhe për nene të tjera përveç nenit 8 të KEDNJ, siç është rasti *Hakobyan dhe të tjerët kundër Armenisë*, GJEDNJ, përsëriti faktin se: “*Hapi i parë në shqyrtimin e Gjykatës është për të përcaktuar nëse kjo masë e shqiptuar ndaj parashtruesve të kërkesës ishte "parashikuar me ligj", në kuptim të nenit 11. Kjo shprehje kërkon, para së gjithash, që ndërhyrja në fjalë të ketë një bazë në ligjin e brendshëm.*” Në aplikim të këtij parimi, GJEDNJ analizoi legjislacionin vendas mbi të cilin ishte bërë kufizimi dhe arriti në përfundimin se: “[...] *masa në fjalë u vendos duke u mbështetur në një dispozitë ligjore që nuk kishte asnjë lidhje me qëllimin e synuar të asaj mase. Gjykata nuk mund të mos pajtohet me parashtruesit e kërkesës se ndërhyrja në lirinë e tyre të tubimit paqësor në baza të tilla ligjore mund të karakterizohej vetëm si arbitrare dhe e paligjshme.*” (Shih, *Hakobyan dhe të tjerët kundër Armenisë*, kërkesa nr. 34320/04, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 106-109 – dhe referencat e cituara aty; shih po ashtu rastin *Huseynli dhe të tjerët kundër Azerbejxhanit*, kërkesat nr. 67360/11, 67964/11 dhe 69379/11, Aktgjykim i 11 shkurtit 2016, paragrafët 98-101 – dhe referencat e cituara aty).
271. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në dritë të faktit të vërtetuar rreth mungesë së plotë të autorizimit ligjor të Qeverisë për të kufizuar

tubime në mjedise private, e dërgojnë Gjykatën në përfundimin që kufizimi i të drejtës së paraparë me nenin 36 të Kushtetutës nuk mund të karakterizohet ndryshe veçse “arbitrar dhe i paligjshëm”, rrjedhimisht kundërkushtetues.

272. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Qeveria nuk është kufizuar vetëm në zbatim të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; mirëpo, ka shkuar përtej autorizimeve specifike të dhëna në atë Ligj të Kuvendit. Andaj dhe kufizimet nuk mund të konsiderohen të jenë “të përcaktuara me ligj”, siç kërkohet në nenin 55 të Kushtetutës.
273. Si përfundim, Gjykata konstaton se të gjitha kufizimet e të drejtave dhe lirive të theksuara më lart të bëra nga Qeveria janë bërë përmes një Vendimi i cili ka tejkaluar autorizimet e përcaktuara me nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

1.5. Ligji për Shëndetësi – si bazë ligjore për Vendimin e kontestuar të Qeverisë: nenit 12 (1.11) [Masat dhe Veprimet] dhe neni 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë]

274. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se për rrethanat e rastit konkret relevante është “Pyetja e parë” e testit të nenit 55 të Kushtetutës, respektivisht se “A ka qenë kufizimi i një lirie apo të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj”?”. Andaj, në vijim, Gjykata do të përgjigjet në këtë pyetje. Siç u tha dhe më sipër, nëse përgjigja do të jetë negative, atëherë nuk do të jetë e nevojshme përgjigja në pyetjet dy, tre dhe katër të testit të nenit 55 të Kushtetutës.
275. Gjykata rikujton që Ligji për Shëndetësi është një ligj i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013. Qëllimi i këtij Ligji, sipas nenit 1 të tij, është “sigurimi [...] i bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.”
276. Neni 12 [Masat dhe veprimet], paragrafi (1.11) i Ligjit është pjesë e Kreut IV “Zbatimi i Kujdesit Shëndetësor”; ndërkaq neni 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë] është pjesën e Kreut XIX “Kujdesi Shëndetësor Gjatë Gjendjeve Emergjente”.
277. Gjykata vëren se vetëm nenet 12 (1.11) dhe 89 janë cituar si bazë ligjore dhe si të tilla në detaje do të analizohen më poshtë.

1.5.1. Neni 12 [Masat dhe veprimet], paragrafi (1.11), i Ligjit për Shëndetësi

278. Gjykata vëren se paragrafi 1.11 i nenit 12 të këtij Ligji flet për masat dhe veprimet që mund të ndërmerren me ç'rast specifikisht thuhet se: *“Kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, si në vijim: [...] 1.11. ndërmarrja e masave për parandalimin dhe eliminimin e pasojave shëndetësore të shkaktuara nga gjendjet emergjente; [...]”*
279. Kjo dispozitë ligjore thjesht shpjegon që kujdesi shëndetësor zbatohet duke ndërmarrë masa dhe veprime të caktuara e ndër to edhe ndërmarrjen e masave të cilat konsiderohen si të nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e pasojave të shkaktuara nga gjendjet emergjente. Nuk ka asgjë kontestuese në këtë nen dhe është i saktë fakti që Kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmes masave të ndërmarrja për parandalim dhe eliminim të pasojave shëndetësore të shkaktuar nga një gjendje emergjente.
280. Megjithatë, është e paqartë se si ky nen specifik, në vetvete, i jep të drejtën dhe autorizimin ligjor Qeverisë që të bëjë kufizimin e të lirive dhe të drejtave themelore sipas Vendimit të kontestuar. Në interpretimin e Gjykatës, dhe në dritë të asaj se kufizimi i të drejtave duhet të bëhet vetëm me ligj të Kuvendit, asgjë në këtë dispozitë ligjore nuk dërgon në përfundimin se kufizimet e bëra përmes Vendimit të kontestuar janë në zbatim të kësaj norme ligjore dhe se të njëjtat nuk shkojnë përtej autorizimeve ligjore të lexuara në tërësi sipas Ligjit për Shëndetësi. Gjithsesi, Gjykata do ta lexojë këtë dispozitë edhe në dritë të dispozitës tjetër të këtij Ligji, respektivisht nenit 89.

1.5.2. Neni 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë] i Ligjit për Shëndetësi

281. Më tutje, Gjykata vëren se neni 89 i Ligjit për Shëndetësi flet për përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka gjithsej 4 nene.
282. Në paragrafin 1 përcaktohet që zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Ky paragraf thjesht tregon që gjatë një gjendje të emergjencës, Ministria e Shëndetësisë do të sigurojë që zbatimi i kujdesit mjekësor të jetë në pajtim me ligjin dhe legjislacion në fuqi. Këtu nuk parashihet ndonjë autorizim specifik për Qeverinë – në aspekt të justifikimit të kufizimeve të bëra me Vendim e kontestuar duke u thirrur në këtë paragraf.

283. Në paragrafin 2 theksohet që aktivitetet e kujdesit shëndetësor në raste të emergjencës përfshijnë: zbatimin e ligjeve në fuqi; adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent; zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes; sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët; veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore; aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave. As këtu, nuk parashihet ndonjë autorizim specifik për Qeverinë - në aspekt të justifikimit të kufizimeve të bëra me Vendimin e kontestuar duke u thirrur në këtë paragraf.
284. Në paragrafin 3 theksohet se gjatë *“gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.”* Ky paragraf, reflekton faktin që për arsye të shëndetit publik në rastin e gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje [përfshi të drejtat e konsideruara si të shkelura në rastin konkret] do të vazhdojnë të garantohen vetëm deri në masën që garantimi i tyre *“nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin”* e gjendjes emergjente. As këtu, nuk parashihet ndonjë autorizim specifik për Qeverinë - në aspekt të justifikimit të kufizimeve të bëra me Vendimin e kontestuar duke u thirrur në këtë paragraf.
285. Në paragrafin 4 theksohet se pavarësisht kufizimeve të parapara me nenin 89, dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht. As këtu, nuk parashihet ndonjë autorizim specifik për Qeverinë. Gjykata thekson se dinjiteti i njeriut, i cituar në këtë pikë të Ligjit për Shëndetësi, garantohet me nenin 23 të Kushtetutës dhe përbën bazën e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore. Si i tillë, përbën një të drejtë të pa-shmangshme në kurrfarë rrethane. Andaj, kjo dispozitë thjesht reflekton garancinë kushtetuese veçse të paraparë me nenin 23 të Kushtetutës që mbizotëron në çdo rast.
286. Si përfundim dhe pas analizimit të secilës pikë dhe dispozitë ligjore të veçantë të nenit 12 (1.11) dhe nenit 89 të Ligjit për Shëndetësi – të konsideruara si bazë ligjore për ndërmarrjen e kufizimeve të lirive dhe të drejtave të bëra me Vendimin e kontestuar, Gjykata konstaton se këto dy dispozita ligjore nuk i japin Qeverisë autorizimin për të ndaluar në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës qarkullimin e *“qytetarëve dhe automjeteve private nga 24 mars 2020 gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00, përveç për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga*

këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore”; as autorizimin për të ndaluar në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës “lëvizjet në rrugë” me urdhëresën që të njëjtat të “bëhen jo më shumë se nga dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët”; e as autorizimin që të ndalojë “tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Në rast të vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit”.

287. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Qeveria nuk është kufizuar vetëm në zbatim të Ligjit për Shëndetësi; mirëpo, ka shkuar përtej autorizimeve specifike të dhëna në atë Ligj të Kuvendit. Andaj dhe kufizimet nuk mund të konsiderohen të jenë “të përcaktuara me ligj”, siç kërkohet në nenin 55 të Kushtetutës.
288. Si përfundim, Gjykata konstaton se të gjitha kufizimet e të drejtave dhe lirive të theksuara më lart të bëra nga Qeveria janë bërë përmes një Vendimi i cili ka tejkaluar autorizimet e përcaktuara me nenet 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit për Shëndetësi.

1.6. Konkluzion lidhur bazën ligjore mbi të cilën është bazuar Vendimi i kontestuar

289. Pas analizimit të secilës bazë ligjore të referuara nga Qeveria si autorizim për të nxjerrë Vendimin e kontestuar, Gjykata konstaton se të njëjtat, e veçanërisht nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe nenet 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit për Shëndetësi – nuk i japin Qeverisë kompetencë që të kufizojë lirinë e lëvizjes, të tubimit dhe të drejtën e privatësisë/jetës familjare në nivel të të gjithë territorit të Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në mënyrë të përgjithshme. Për rrjedhojë, kufizimet e bëra përmes Vendimit të kontestuar nuk mund të konsiderohen se janë bërë me ligj të Kuvendit e as në përputhje me ligjin ose në zbatim të tij.
290. Më specifikisht, për kufizimet e bëra në liritë e garantuara me nenet 35 dhe 43 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se ndonëse ekzistojnë dispozita ligjore të Kuvendit që rregullojnë ndalimin e qarkullimit/lëvizjes dhe të tubimit për në vende ku është përhapur epidemia dhe në rajone të infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara – Qeveria ka tejkaluar autorizimet e saj ligjore duke mos u fokusuar vetëm në zbatim të tyre por duke shkuar përtej tyre me rastin e

kufizimit të këtyre lirive në nivel të të gjithë territorit të Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

291. Ndërkaq, për kufizimin e bërë në të drejtën e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se Qeveria ka kufizuar këtë të drejtë në mënyrë arbitrare dhe pa ndonjë bazë ligjore të dhënë me ligj të Kuvendit. Kjo sepse nenet e theksuara si bazë ligjore as nuk rregullojnë e as nuk përmendin askund kufizimet në “mjedise private, të hapura ose të mbyllura.”
292. Në interpretimin e kësaj Gjykate, Qeveria dhe rrjedhimisht, asnjë organ tjetër publik shtetëror, nuk mund asnjëherë të shkojë përtej kufizimeve dhe rregullimeve që parasheh një ligj i Kuvendit i cili kufizon lirinë e garantuar të lëvizjes dhe tubimit dhe të drejtën e privatësisë sipas neneve të lartcekura – e aq më pak të bëjë vet një kufizim pa e pasur asnjë autorizim ligjor të dhënë përmes një ligji të Kuvendit.
293. Qeveria, por edhe organet ose autoritetet e tjera ligj-zbatuese, mund të ndërmarrin, aplikojnë dhe zbatojnë masa kufizuese vetëm për aq sa ia përcakton ligji i Kuvendit dhe vetëm për aq sa ia lejon ligji i Kuvendit. Ky interpretimi është në përputhje të plotë me sistemin e kontrolleve dhe balanceve në aspekt të ndarjes së pushteteve ku pushteti legjislativ për të krijuar ligje në vend i takon vetëm Kuvendit; ndërkaq ai ekzekutiv për të zbatuar ligjet Kuvendi, i takon Qeverisë. Gjyqësori në këtë trekëndësh pushtetesh e ka rolin e vet për të kontrolluar, në mes tjerash, edhe kushtetutshmërinë e ligjeve të nxjerra nga Kuvendi por edhe kushtetutshmërinë e vendimeve të Qeverisë përmes së cilave zbatohen ligjet e Kuvendit.
294. Qeveria, si një nga tri pushtetet kryesore në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, nuk mund të shkojë përtej lejimeve dhe autorizimeve ligjore – e që në rrethanat e rastit konkret ka ndodhur, siç u shpjegua më sipër. Qeveria, si një nga tri pushtetet kryesore në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, nuk mund të kufizojë të drejta vetvetiu pa u bazuar në ligj të Kuvendit – e që në rrethanat e rastit konkret ka ndodhur, siç u shpjegua më sipër. Kjo ngase asnjë ligj e asnjë dispozitë ligjore nga ato që janë cekur si bazë ligjore për nxjerrjen e Vendimit të kontestuar nuk ia jep Qeverisë të drejtën për të kufizuar në mënyrën e përgjithshme në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, për të gjithë qytetarët dhe pa afat të caktuar: (i) të drejtën e lëvizjes dhe të qarkullimit; (ii) të drejtën e privatësisë; dhe (iii) të drejtën e tubimit.

295. Qeveria ka kompetencë të merr vendime të cilat konsiderohen si të nevojshme për zbatimin e ligjeve dhe është plotësisht në ingjencat e saj kushtetuese që të bëjë një gjë të tillë. Theksi i veçantë në këtë aspekt duhet të vihet tek togfjalëshi “zbatimin e ligjeve”. Kjo nënkupton që Qeveria nuk mund asnjëherë të merr vendime që shkojnë përtej asaj që konsiderohet e nevojshme për zbatim të një ligji të Kuvendit.
296. Gjykata rithekson që Kuvendi është i vetmi organ në Republikën e Kosovës i cili e ka kompetencën kushtetuese për të kufizuar, në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës, të drejta dhe liri themelore. Edhe vet Kuvendi është i kufizuar me Kushtetutë që kufizimin e të drejtave ta bëjë në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, as Kuvendi nuk i ka duart tërësisht të lira që të bëjë kufizim të të drejtave dhe lirive ngase neni 55 parasheh kushte të qarta të cilat udhëzojnë se si dhe deri në cilën masë mund të bëhet kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore.
297. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se Vendimi nr. 01/15 i Qeverisë i 23 marsit 2020, nuk është nxjerrë në pajtueshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta e Privatësisë], 43 [Liria e Tubimit]; të lexuar në kontekst të garancive ekuivalente të ofruara me nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), nenin 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
298. Për rrjedhojë, Vendimi i kontestuar i Qeverisë do të shfuqizohet përmes këtij Aktgjykimi, në datën e paraparë në dispozitiv.

V. Lidhur me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi

299. Siç u tha më sipër dhe siç theksohet në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, Gjykata ka konstatuar se Vendimi i kontestuar i Qeverisë duhet të shfuqizohet meqë i njëjti nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe KEDNJ, sipas arsyetimit të këtij Aktgjykimi.
300. Lidhur me momentin juridik të hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi të Gjykatës dhe rrjedhimisht me momentin juridik nga i cili shfuqizohet Vendimi i kontestuar i Qeverisë, Gjykata rikujton dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore të cilat i japin Gjykatës mundësinë që të caktojë një datë specifike për hyrje në fuqi të vendimeve të saj, respektivisht edhe të këtij Aktgjykimi.
301. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton paragrafin 3 të nenit 116 [Efekti juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton me sa

vijon: *“Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.”* Ky rregullim kushtetues ia mundëson Gjykatës që të caktojë një datë tjetër të hyrjes në fuqi të vendimit të saj përmes së cilit shfuqizohet një akt.

302. Më tutje, Gjykata rikujton paragrafin 5 të nenit 20 [Vendimet] të Ligjit ku specifikisht thuhet se: *“Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe”* dhe paragrafin (5) të rregullit 60 [Përmbajtja e vendimeve] të Rregullores së punës ku specifikisht thuhet se: *“Dispozitat operative do të theksojnë mënyrën e zbatimit të Aktgjykimit [...] dhe datën e hyrjes në fuqi të vendimit [...]”*.
303. Nisur nga ky autorizim që dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës ia japin Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit ka vendosur që Aktgjykimi për rastin KO54/20 do të hyjë në fuqi më 13 prill 2020. Rrjedhimisht, Vendimi i kontestuar i Qeverisë do të shfuqizohet në atë datë.
304. Vendim-marrjen përkitazi me datën e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, respektivisht datën e shfuqizimit të Vendimit të kontestuar, Gjykata e ka bazuar në rrethanat e krijuara me shpalljen e pandemisë COVID-19 në nivel botëror; rekomandimet përkatëse të institucioneve shëndetësore në nivel shtetëror dhe botëror; pasojat potencialisht të dëmshme për shëndetin publik si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të kufizimeve të përcaktuara me Vendimin e kontestuar; dhe, në dritë të mbrojtjes së shëndetit dhe interesit publik deri në zbatim të këtij Aktgjykimi. Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se është në interesin publik që t’i jepet kohë e nevojshme Qeverisë dhe Kuvendit, që të adresojnë të gjeturat e këtij Aktgjykimi dhe të përshtatin vendim-marrjen e tyre në aspekt të adresimit të nevojës për përballje me pandeminë në fjalë, në aspekt kushtetues dhe ligjor.
305. Gjykata konsideron se nëse Vendimi i kontestuar do të shfuqizohej në ditën e publikimit të këtij Aktgjykimi, ekziston rreziku për shkaktim të pasojave potencialisht të dëmshme për shëndetin publik si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të kufizimeve. Me shfuqizim të menjëhershëm të Vendimit të kontestuar shtetit i Republikës së Kosovës dhe qytetarët e saj do të ngeleshin pa asnjë lloj mase që do të adresonte gjendjen aktuale në vend. Një gjë e tillë do të mund të shkaktonte paqartësi rreth asaj se çfarë rregullash janë të aplikueshme në këtë kohë të ndjeshme për shëndetin publik.

306. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se deri në datën e shfuqizimit të Vendimit të kontestuar, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në rradhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin veprimet, në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, që i konsiderojnë si të duhura dhe adekuate për të vazhduar parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 – që në vetvete përbën një interes të lartë të shëndetit publik për të gjithë shtetasit dhe personat që jetojnë në Republikën e Kosovës.

VI. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

307. Gjykata rikujton që përmes kërkesës së tij të dorëzuar më 24 mars 2020, Presidenti kishte kërkuar që të vendoset masë e përkohshme përmes së cilës do të pezullohej zbatimit i Vendimit të kontestuar të Qeverisë deri në vendosjen e rastit në mënyrë meritore nga Gjykata.
308. Në të njëjtën ditë, Gjykata ia kishte dhënë mundësinë Qeverisë, Kuvendit (përfshi deputetëve) dhe Avokatit të Popullit që, deri në orën 22:00 të datës 24 mars 2020, të komentojnë në kërkesën e parashtruesit për caktim të masës së përkohshme. Qeveria, brenda afatit, e kishte kundërshtuar këtë propozim të Presidentit nën pretendimin se nuk janë plotësuar kushtet për të caktuar masën e përkohshme dhe se Presidenti nuk ka arritur që të dëshmojë se e njëjta është në interes të publikut dhe e domosdoshme për të evituar dëm të pariparueshëm. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! po ashtu kishte konsideruar se masa e përkohshme nuk duhet të caktohet. Deputeti i Kuvendit, z. Abelard Tahiri e kishte përkrahur propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktim të masës së përkohshme. (Shih paragrafët 42-72 të këtij Aktgjykimi ku reflektohen kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme; dhe komentet e dorëzuara në Gjykatë nga Qeveria dhe palët e tjera të interesuara përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme).
309. Duke qenë se Gjykata, me këtë Aktgjykim, tashmë ka vendosur për meritat e rastit në tërësi, kërkesa për masë të përkohshme ngelet e pa objekt shqyrtimi.

VII. Përfundime

310. Si çështje paraprake, Gjykata në këtë Aktgjykim sqaroi se nuk është roli i saj që të vlerësoj se a janë adekuate dhe të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjë palë në këtë rast. Përcaktimi i politikave rreth shëndetit publik nuk hyn në

kompetencat dhe autorizimet e Gjykatës Kushtetuese. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese u referohet dhe bindet institucioneve përkatëse shëndetësore dhe profesionale në nivel shtetëror dhe botëror.

311. Çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Vendimit të kontestuar të Qeverisë, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij, Qeveria ka kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në përputhje me ligjin apo përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, përkitazi me vlerësimin nëse kufizimet e bëra në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë janë të përcaktuara me ligj, Gjykata është fokusuar në vlerësimin e autorizimeve të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
312. Në këtë drejtim, Gjykata shqyrtoi: (i) kërkesën e parashtruesit dhe pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë; (ii) komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe palët e tjera të interesuara; (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-s dhe posaçërisht, parimeve të përgjithshme rreth aplikueshmërisë së kriterit *“e përcaktuar me ligj”* për sa i takon aspektit të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore; dhe (iv) praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Kushtetuese.
313. Bazuar në shqyrtimet dhe vlerësimet e sipërhënuara, Gjykata, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën KO54/20 të pranueshme për shqyrtim në merita meqë, në rrethanat e rastit konkret, ishin plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
314. Po ashtu, Gjykata vendosi njëzëri se Vendimi [nr. 01/15] i 23 marsit 2020 i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta për privatësi], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare) dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së.
315. Gjykata konstatoi se kufizimet që përmban Vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të *“përcaktuara me ligj”*, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNJ-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë që të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

316. Gjykata theksoi faktin që Vendimi i kontestuar i Qeverisë, i referohet zbatimit të dy ligjeve të lartcekura, të cilat e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë që të ndërmarrë masa të caktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, Gjykata konstatoi se ligjet e lartcekura, nuk e autorizojnë Qeverinë që të kufizojë të drejtat dhe liritë kushtetuese të përcaktuara me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.
317. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se kufizimet e shqiptuara përmes Vendimit të kontestuar: (i) lidhur me lirinë e lëvizjes dhe të tubimit të përcaktuara përmes neneve 35 dhe 43 të Kushtetutës, tejkalojnë kufizimet e lejuara përmes ligjit të lartcekur të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) lidhur me *“tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura ose të mbyllura”* e që ngërthejnë aspekte të të drejtave të garantuara përmes nenit 36 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara në asnjë autorizim të përcaktuar me ligjin e lartcekur apo edhe ndonjë ligj tjetër të Kuvendit.
318. Gjykata sqaroi se Qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i të drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit. Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës.
319. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se ky nen nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, ngase i njëjti është i aplikueshëm vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme.
320. Gjithsesi, lidhur me mos-pajtimin e palëve në kontest, Presidentit dhe Qeverisë, rreth kuptimit të termeve kushtetuese *“kufizim”* dhe *“shmangie”* që figurojnë në nenet 55 dhe 56 të Kushtetutës, Gjykata qartësoi se *“kufizimi”* i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet *“vetëm me ligj”* të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që *“kufizimi”* i të drejtave, mund të bëhet vetëm përmes dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjykata po ashtu sqaroi se termi *“kufizim”* i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në

një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Thënë ndryshe, “*kufizimi*” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërkaq “*shmangia*” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrsesi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.

321. Për sa i takon kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se pas vendimit unanim të gjyqtarëve që të vendosin në tërësi për meritat e rastit dhe të nxjerrin këtë Aktgjykim, e njëjta ngeli e pa objekt shqyrtimi.
322. Duke u bazuar në nenet 116.3 të Kushtetutës, 20.5 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, Gjykata përcaktoi datën 13 prill 2020, si datë të hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, respektivisht shfuqizimit të Vendimit të kontestuar të Qeverisë.
323. Gjykata ka përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, përjashtimisht dhe duke marrë parasysh: (i) rrethanat e krijuara me shpalljen e pandemisë COVID-19 në nivel botëror; (ii) rekomandimet përkatëse të institucioneve shëndetësore në nivel shtetëror dhe botëror; (iii) pasojat potencialisht të dëmshme për shëndetin publik si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të kufizimeve të përcaktuara përmes Vendimit të Qeverisë; dhe (iv) mbrojtjen e shëndetit dhe interesit publik deri në zbatimin e këtij Aktgjykimi nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.
324. Gjatë kësaj periudhe kohore dhe në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës përkitazi me “*kufizimin*” e të drejtave dhe lirive themelore, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, dhe në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, janë bërë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim.
325. Në fund, Gjykata po ashtu thekson se Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerr vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.2 (1) dhe 116 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 31 mars 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË SHPALLË që Vendimi nr. 01/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 23 marsit 2020, nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta e Privatësisë] dhe 43 [Liria e Tubimit] dhe nenet 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ;
- III. TË KONSTATOJË që neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret sepse nuk kemi të bëjë me “*shmangie*” nga të drejtat dhe liritë themelore;
- IV. TË KONSTATOJË që, bazuar në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet “*vetëm me ligj*” të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- V. TË SHPALLË të pavlefshëm, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, Vendimin e cekur në pikën II të këtij dispozitivi, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VI. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. Ky aktgjykim, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, nenin 20.5 të Ligjit dhe rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, hyn në fuqi më 13 prill 2020; dhe
- VIII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO61/20, Parashtrues: Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut

KO61/20, Aktgjykim i 1 majit 2020, publikuar më 5 maj 2020

Fjalët kyç: *pandemia COVID-19, kërkesë institucionale, kërkesa nga 30 deputetë, neni 113.2 (1) i Kushtetutës, liria e lëvizjes, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore, përcaktueshmëria me ligj, qëllimi legjitim, proporcionaliteti, e nevojshme në një shoqëri demokratike, Qeveria, Kuvendi.*

Më 17 prill 2020, 30 deputetë të Kuvendit parashtruan kërkesën KO61/20 në Gjykatë. Përmes kësaj kërkesë, parashtruesit kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së katër (4) Vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht: (i) Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; (ii) Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës së Prizrenit”; (iii) Vendimi [nr. 238/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës së Dragashit”; dhe (iv) Vendimi [nr. 239/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës së Istogut”.

Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së katër (4) Vendimeve të kontestuara për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet 35 [Liria e Lëvizjes] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan caktimin e masës së përkohshme për pezullim të vendimeve të kontestuara.

Në titullin **VI – PËRFUNDIME** - të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 246-263), Gjykata përmbledhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Më 31 mars 2020, Gjykata vendosi për rastin KO54/20 përmes të cilit Aktgjykim, e shpalli të pavlefshëm Vendimin nr. 01/15 të Qeverisë, duke konstatuar se i njëjti ishte në kundërshtim me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta e Privatësisë], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe nenet ekuivalente të KEDNJ-së, respektivisht nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit), dhe 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

Në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata kishte theksuar se (i) Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës; dhe se (ii) Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, është e autorizuar që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, vetëm për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Gjykata gjithashtu kishte theksuar se këto dy ligje, nuk e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë, që të kufizojë të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.

Pas Aktgjykimit KO54/20, më 14 prill 2020, përmes tridhjetë e tetë (38) vendimeve për *“parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”*, Ministria e Shëndetësisë vendosi kufizime në të gjitha Komunat e Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjykata në rastin e tanishëm, KO61/20, nuk është duke e bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë të të gjitha tridhjetë e tetë (38) Vendimeve të lartcekura, sepse parashtruesit e kërkesës nuk i kanë kontestuar të gjitha.

Para Gjykatës, janë kontestuar vetëm tri (3) prej tyre, Vendimet [nr. 229/IV/2020]; [nr. 238/IV/2020]; dhe [nr. 239/IV/2020] e datës 14 prill 2020, për Komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht. Para Gjykatës, gjithashtu është kontestuar edhe Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit *“zonë karantinë”*.

Si rrjedhojë, çështja kushtetuese që ngërthen Aktgjykimi KO61/20, është përputhshmëria me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës të katër (4) Vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjykata, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre, bazuar në nenin 55 të Kushtetutës, praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë Aktgjykimin KO54/20, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së,

ka vlerësuar nëse “*ndërhyrjet*”, përkatësisht kufizimet në lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht: (i) janë të “*përcaktuara në ligj*”, përkatësisht në Ligjin nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse; (ii) ndjekin një “*qëllim legjitim*”; dhe (iii) janë të “*domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.

Bazuar në shqyrtimet dhe vlerësimet e shkresave të dorëzuara para Gjykatës dhe praktikës së saj gjyqësore, Gjykata, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën KO61/20 të pranueshme për shqyrtim në merita meqë, ishin plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

Gjykata gjithashtu vendosi që Vendimet “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në Komunën e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, janë në përputhshmëri me Kushtetutën, me përjashtim të pikave përkatëse të dispozitivit të cilat përcaktojnë kundërvajtjet administrative, ndërsa Vendimin për shpalljen “*zonë karantinë*” në Komunën e Prizrenit, e shpalli në kundërshtim me Kushtetutën.

Më saktësisht, Gjykata, njëzëri, vendosi se: (i) Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në Komunën e Prizrenit (pikat I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII); dhe (ii) Vendimet [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në Komunitet e Dragashit dhe Istogut (pikat I, II, III, V, VI dhe VII), respektivisht, **janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, të gjitha pikat e saktësuara të Vendimeve të lartcekura, Gjykata i shpalli kushtetuese.

Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e Vendimeve të lartcekura, Ministria e Shëndetësisë, ka vepruar në përputhje me autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, përmes pikave të lartcekura, ishin “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata gjithashtu konstatoi se të njëjtat ndjekin një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht atë të mbrojtës së “*shëndetit publik*”, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; janë proporcionale në raport me “*qëllimin legjitim*” të ndjekur; dhe janë “*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.

Megjithatë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi se: (i) pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” për Komunën e Prizrenit; dhe (ii) pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në Komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ku përcaktohen kundërvajtjet administrative dhe sanksionet përkatëse, **nuk janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata arsyetoi se në përcaktimin e mosrespektimit të masave të parashikuara përmes Vendimeve të lartcekura si “*kundërvajtje administrative*”, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Gjykata theksoi se bazuar në Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, kundërvajtjet dhe sanksionet përkatëse, mund të përcaktohen vetëm me ligj të Kuvendit të Republikës ose me akte të Kuvendit të një Komune, dhe se ky autorizim nuk mund të bartet në organe të tjera. Rrjedhimisht, kundërvajtjet administrative të përcaktuara përmes këtyre tri Vendimeve të kontestuara, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*” dhe për pasojë, u shpallën jokushtetuese.

Gjykata, në anën tjetër, me shumicë votash, vendosi se Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, **nuk është** në përputhshmëri me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e këtij Vendimi, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes, përmes karantinimit të të gjithë Komunës së Prizrenit, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata qartësoi se “*karantina*” sipas Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mund të urdhërohet nga Ministria e Shëndetësisë, pas rekomandimit të IKSHPK-së, vetëm për persona fizikë për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshuar për sëmundje ngjitëse. Rrjedhimisht, Vendimi për shpalljen e Komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, u shpall jokushtetues.

Për sa i takon kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se pas vendimit të gjyqtarëve që të vendosin në tërësi për meritat e rastit dhe të nxjerrin këtë Aktgjykim, e njëjta ngeli e pa objekt shqyrtimi.

Gjykata gjithashtu rikujtoi që përmes Aktgjykimit KO54/20, kishte përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, duke theksuar se deri në këtë datë, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në radhë të parë Kuvendi, duhet të

ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, të bëhen në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO54/20.

Gjykata vë theks në faktin që përkundër kërkesës specifike drejtuar Kuvendit për të njoftuar Gjykatën *“lidhur me të gjithë hapat që janë ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas publikimit të Aktgjykimit KO54/20 të 31 marsit 2020”*, Gjykata nuk ka pranuar një përgjigje nga Kuvendi. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht potencon faktin që është detyrim ligjor i të gjitha organeve publike që *“të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj”*. Për më tepër, Gjykata vë theks në faktin se bazuar në Aktgjykimin KO54/20, Kuvendi është detyruar që, qoftë përmes plotësim-ndryshimit të legjislacionit ekzistues të zbatueshëm ose përmes miratimit të ndonjë ligji të ri, të përcakton mekanizmat dhe autorizimet më të përshtatshme, në mënyrë që autoritetet përkatëse, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë, të ndërmarrin masat e duhura dhe të nevojshme për luftimin dhe parandalimin e pandemisë COVID-19, në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO54/20. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vë theks në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, bazuar në të cilin vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Gjykata, në Aktgjykimin KO61/20, gjithashtu ka adresuar parashtresën e 23 prillit 2020 të Kryeministrit drejtuar Gjykatës në emër të Qeverisë, të titulluar *“parashtresë në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor dhe Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO61/20”*, përmes të cilës janë shprehur *“shqetësimet”* e Qeverisë për *“shkelje të dispozitave esenciale në lidhje me procedurën dhe afatet që duhet ndjekur”* nga ana e Gjykatës, duke theksuar gjithashtu që *“Qeveria do të shqyrtojë me kujdes shkeljet ligjore të deritanishme dhe varësisht nga kualifikimi juridik i tyre do të ndërmarr veprimet e nevojshme të bazuara në legjislacionin në fuqi.”*

Gjykata, këtë parashtresë, si dhe të gjitha të tjerat, e ka ndarë me palët e interesuara në këtë rast. E njëjta, do të publikohet në tërësinë e saj bashkë me Aktgjykimin KO61/20, i cili përmban edhe sqarimet e nevojshme përkitazi me këtë parashtresë. Megjithatë, Gjykata thekson fuqishëm se qasja e Qeverisë ndaj Gjykatës që reflekton kjo parashtresë, është e papranueshme dhe në kundërshtim me vlerat themelore të Kushtetutës së Republikës.

Gjykata rithekson se ajo është organ i pavarur në mbrojtje të Kushtetutës dhe është interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës. Gjykata gjithashtu rikujton se Kushtetuta i atribuon asaj pavarësi të plotë në kryerjen e përgjegjësisë të saj. Për më tepër, është detyrim kushtetues i Qeverisë dhe të gjitha

institucioneve të Republikës të respektojnë dhe të mos ndërhyjnë në këtë pavarësi. Gjykata gjithashtu i rikujton Qeverisë se Kushtetuta nuk i atribuon asaj asnjë kompetencë përkitazi me vendimmarrjen e pushtetit gjyqësor. Respektimi i vlerave themelore kushtetuese, lidhur me ndarjen e pushteteve, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, pavarësinë dhe autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit, është detyrim kushtetues i të gjitha degëve të pushtetit të Republikës së Kosovës.

Gjykata në fund, thekson faktin se pavarësisht situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, dhe e cila ka afektuar mbarë botën, sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës duhet të mbizotërojnë. Këtë e ka theksuar edhe Këshilli i Evropës në Dokumentin Informativ SG/Inf(2020)11 të 7 prillit 2020 për Respektimin e Demokracisë, Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut në kuadrin e Krizës Sanitare të COVID-19, por edhe Opinionet e Komisionit të Venecias, përfshirë atë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në raste të Emergjencave dhe Listën e Kontrollit të Shtetit të së Drejtës. Të gjitha institucionet e Republikës janë të detyruara të veprojnë në përputhje të plotë me kompetencat përkatëse kushtetuese dhe ligjore si dhe në përputhje me Aktgjykimet e Gjykatës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO61/20

parashtrues

Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga tridhjetë (30) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), respektivisht: Uran Ismaili, Kujtim Gashi, Gazmend Bytyqi, Abelard Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Bajrush Xhemaili, Eliza Hoxha, Bekim Haxhiu, Valdete Idrizi, Besa Ismaili, Sejdi Hoxha, Enver Hoxha, Ferat Shala, Ganimete Musliu, Memli Krasniqi, Elmi Reçica, Floretë Zejnullahu, Ariana Musliu Shoshi, Mërgim Lushtaku, Kadri Veseli, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Fatmir Xhelili, Albert Kinolli, Bedri Hamza, Veton Berisha, Duda Balje, Hajredin Kuçi, Haxhi Shala, Endrit Shala dhe Albulena Balaj-Halimaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

2. Parashtruesit e kërkesës u përfaqësuan në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), nga deputetja Besa Ismaili.

Vendimet e kontestuara

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e katër (4) Vendimeve të Ministrisë në detyrë të Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm: Ministria e Shëndetësisë), të nxjerra nga Ministri në detyrë i Shëndetësisë, z. Arben Vitia, (në tekstin e mëtejshëm: Ministri i Shëndetësisë) si në vijim: (i) Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; (ii) Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyeshme COVID-19 në territorin e Komunës së Prizrenit”; (iii) Vendimi [nr. 238/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyeshme COVID-19 në territorin e Komunës së Dragashit”; dhe (iv) Vendimi [nr. 239/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyeshme COVID-19 në territorin e Komunës së Istogut”.
4. Vendimeve të lartcekura në tekstin e mëtejshëm Gjykata do t’iu referohet si “Vendimet e kontestuara” kur flitet për tërësinë e tyre, ndërkaq, kur flitet për ndonjë vendim të veçantë, Gjykata do t’i referohet numrit specifik të atij vendimi.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së katër (4) Vendimeve të kontestuara për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet 35 [Liria e Lëvizjes] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
6. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se Vendimet e kontestuara janë në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO54/20 (shih, rasti KO54/20, parashtrues i kërkesës, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, “Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së

Kosovës”, Aktgjykim i 31 marsit 2020, publikuar më 6 prill 2020, i referuar përgjatë tekstit të mëtejme si: “Aktgjykimi KO54/20”).

7. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të *“vendosë si masë të përkohshme pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të vendimeve të kontestuara deri në përfundimin e procedurës së kontrollit kushtetues dhe zgjidhjes meritore të rastit.”*

Baza juridike

8. Kërkesa është e bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 27 (Masat e përkohshme), 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe në rregullat 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit), 56 (Kërkesa për masë të përkohshme), dhe 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

9. Më 17 prill 2020, ditë e premte, në orën 15:50, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
10. Në të njëjtën ditë, më 17 prill 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci.
11. Më 18 prill 2020, ditë e shtunë, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën origjinale edhe në format elektronik në adresën elektronike të Gjykatës përmes adresës së saj elektronike.
12. Në të njëjtën ditë, më 18 prill 2020, përmes komunikimit elektronik në adresën elektronike të përzgjedhur nga përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, duke e informuar atë që kërkesa KO61/20, nuk mund të konsiderohet e plotë ngase nuk është nënshkruar nga deputeti Gazmend Bytyqi, emri dhe numri personal i të cilit figuron në listën e deputetëve parashtrues. Bazuar në praktikën e më herëshme, Gjykata i ftoi parashtruesit e

kërkesës që të dorëzojnë në Gjykatë nënshkrimin e deputetit Gazmend Bytyqi ashtu që të konfirmohet pëlqimi i tij për të qenë njëri nga deputetët që kanë dorëzuar kërkesën KO61/20 në Gjykatë.

13. Në të njëjtën ditë, më 18 prill 2020, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë, përmes komunikimit elektronik, nënshkrimin e deputetit në fjalë.
14. Më 19 prill 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen e parashtruesve të kërkesës për pranimin e nënshkrimit dhe ia konfirmoi se tani e tutje do të komunikojë direkt me atë në cilësi të përfaqësueses së tridhjetë (30) deputetëve që kanë dorëzuar kërkesën KO61/20.
15. Përmes kësaj shkrese, Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që të sqarojnë për Gjykatën nëse përpos Vendimeve të specifikuara në kërkesën e tyre, përkatësisht Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyhtë COVID-19 në territorin” e komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, i kontestojnë gjithashtu edhe tridhjetë e pesë (35) Vendimet e tjera të Ministrisë së Shëndetësisë të datës 14 prill 2020, “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyhtë COVID-19”, meqenëse të njëjtave iu ishin referuar në përmbajtjen dhe arsyetimin e kërkesës përkatëse. Më saktësisht, Gjykata, në shkresën e saj drejtuar parashtruesve të kërkesës theksoi, ndër të tjera, si në vijim:

“Në kërkesën tuaj, ju keni kërkuar nga Gjykata që të bëjë: “Vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së Vendimeve të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës: Vendimin nr. 238/IV/2020, datë 14.04.2020; Vendimin nr. 229/IV/2020, datë 14.04.2020; Vendimin nr. 214/IV/2020, datë 12.04.2020; Vendimin nr. 239/IV/2020, datë 14.04.2020 me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. [...] Megjithatë, përgjatë arsyetimit dhe shpjegimeve të dhëna në përmbajtjen e kërkesës suaj, ju nuk iu jeni referuar vetëm katër (4) vendimeve të lartcekura të nxjerra nga Ministri në detyrë i Shëndetësisë, z. Arben Vitia, mirëpo iu jeni referuar edhe vendimeve të tjera të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht të gjitha tridhjetë e tetë (38) vendimeve të nxjerra nga kjo Ministri.”

16. Brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata për dorëzimin e sqarimeve të lartpërmendura, respektivisht deri në orën 10:00 të datës 20 prill 2020, parashtruesit e kërkesës nuk dorëzuan ndonjë sqarim në Gjykatë përkundër faktit që shkresën e Gjykatës, përmes komunikimit elektronik, e kanë pranuar në mënyrë të rregullt në emailin e përzgjedhur nga vet ata.
17. Më 20 prill 2020, Gjykata, përmes komunikimit elektronik, informoi parashtruesit e kërkesës, në adresën elektronike të përfaqësueses së përzgjedhur nga ata, se brenda afatit të përcaktuar nuk është pranuar ndonjë përgjigje nga ana e tyre. Rrjedhimisht, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës se *“procedurat për shqyrtimin e rastit KO61/20 do të vazhdojnë bazuar në dokumentacionin ekzistues.”*
18. Në të njëjtën ditë, më 20 prill 2020, Gjykata, përmes komunikimit elektronik, njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Presidentin e Republikës së Kosovës, Shkëlqesinë e Tij, z. Hashim Thaçi (në tekstin e mëtejme: Presidenti); (ii) Kryetaren e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu (në tekstin e mëtejme: Kryetarja e Kuvendit), me kërkesën që një kopje të kërkesës t’ua shpërndajë të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iii) Kryeministrin në detyrë, z. Albin Kurti (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iv) Ministrin e Shëndetësisë; dhe (v) Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari. Gjykata po ashtu i njoftoi të gjitha palët e lartcekura se parashtruesit e kërkesës nuk ishin përgjigjur ndaj kërkesës së Gjykatës për sqarim shtesë si dhe u dërgoi një kopje të kërkesës origjinale të dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës si dhe një kopje e të gjitha shkresave që ishin dorëzuar deri në ato momente.
19. Në letrën dërguar Kryetares së Kuvendit, përveç ftesës që të dorëzojë komentet e saj, të deputetëve të Kuvendit ose të Komisioneve Parlamentare lidhur me rastin KO61/20, Gjykata i dërgoi edhe një kërkesë specifike me sa vijon: *“E nderuara Kryetare e Kuvendit, në fund, po ashtu luteni që të njoftoni Gjykatën lidhur me të gjithë hapat që janë ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas publikimit të Aktgjykimit KO54/20 të 31 marsit 2020. Luteni që të dorëzoni në Gjykatë çdo informatë ose dokument relevant në këtë drejtim.”*
20. Ndërsa, në letrën njoftuese dërguar Ministrit të Shëndetësisë, përveç ftesës që të dorëzojë komentet e tij lidhur me rastin KO61/20, Gjykata i dërgoi edhe një kërkesë specifike me sa vijon: *“I nderuar Ministër, në fund, po ashtu luteni që të dorëzoni në Gjykatë rekomandimet e IKSHPK-së mbi bazën e të cilave janë nxjerrë vendimet e kontestuar.”*

21. Përmes këtyre shkresave, Gjykata i ftoi palët e interesuara, të lartcekura, që të dorëzojnë në Gjykatë komentet e tyre, nëse kanë, lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme dhe për merita të kërkesës. Për sa i takon mundësisë për paraqitjen e komenteve lidhur me caktimin e masës së përkohshme, Gjykata, të gjitha palëve të lartcekura, u caktoi afat deri në orën 16:00 të datës 21 prill 2020. Ndërkaq, për paraqitjen e komenteve lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata u caktoi afat deri në orën 16:00 të datës 23 prill 2020.
22. Pasi që Gjykata njoftoi të gjitha palët e interesuara në këtë rast për regjistrimin e kërkesës, përfaqësuesja e kërkesës dërgoi një email në adresën elektronike të Gjykatës përmes së cilës theksoi se *“Meqë kërkesa juaj nuk ka arritur në postën time dhe ne nuk kemi qenë të informuar për ekzistimin e kërkesës deri në këto momente, ju lusim që të keni mirëkuptimin që të na prisni për përgjigje deri nesër në ora 10:00hrs.”*
23. Pas pranimit të kësaj përgjigje, pas afatit të përcaktuar, Gjykata rikonfirmoi edhe një herë faktin që shkresa është dërguar në adresën elektronike të përzgjedhur nga vet përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës si dhe konfirmoi faktin që shkresa në fjalë është dërguar në mënyrë të rregullt dhe iu përgjigj përfundimisht përfaqësueses së parashtruesve të kërkesës duke e njoftuar që afati i përcaktuar për tu përgjigjur në shkresën e Gjykatës të datës 19 prill 2020 ka kaluar, dhe tashmë janë informuar të gjitha palët e interesuara lidhur me kërkesën e tyre dhe me të gjitha shkresat e Gjykatës deri në atë moment, dhe rrjedhimisht shtyerja e afatit nuk është e mundur.
24. Në të njëjtën ditë, më 20 prill 2020, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës u përgjigj ndaj komunikimit elektronik të Gjykatës duke theksuar, në mes të tjerash, më sa vijon: *“Sidoqoftë, siç është përcaktuar edhe në kërkesën që kemi dorëzuar ne qëndrojmë prapa katër vendimeve të kontestuara në kërkesë dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë për të cilat i kemi kërkuar. Dhe konsiderojmë se ato mjaftueshëm saktësojnë qëllimin e kërkesës së parashtruar.”*
25. Brenda afatit të përcaktuar për të paraqitur komente lidhur me masën e përkohshme, Gjykata pranoi komente vetëm nga Kryeministri.
26. Ndërsa, brenda afatit të përcaktuar për të paraqitur komente lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata pranoi komente vetëm nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!; komente shtesë nga parashtruesit e kërkesës; ndërkaq që, Avokati i Popullit dorëzoi një Opinion lidhur me rastin KO61/20, së bashku me disa dokumente shtesë për konsideratën e Gjykatës.

27. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata (i) nuk pranoi përgjigjen e kërkuar nga Kryetarja e Kuvendit, lidhur me hapat e ndërmarrë nga Kuvendi pas publikimit të Aktgjykimi KO54/20; dhe (ii) nuk pranoi përgjigjen e kërkuar nga Ministri i Shëndetësisë, lidhur me dorëzimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: IKSHPK) mbi bazën e të cilave janë marrë Vendimet e kontestuara.
28. Më 23 prill 2020, Gjykata pranoi nga Kryeministri, në emër të Qeverisë, një shkresë drejtuar Kryetares së Gjykatës dhe gjyqtarëve të Gjykatës të emërtuar si: *“Parashtresë në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor dhe Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO61/20”*. Përmbajtja e kësaj shkrese, është si vijon:

“Qeveria e Republikës së Kosovës ka rishqyrtuar edhe një herë me kujdes materialin e dërguar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) dhe përmes kësaj parashtrese shpreh shqetësimet e saj në lidhje me shkëljen e dispozitave ligjore në lidhje me afatet e përcaktuara nga ligjdhënësi, afate këto që nuk mund të tejkalohen nga Gjykata. Krahës kësaj shkelje, pas shqyrtimit të kujdesshëm të praktikës së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me aplikimin e Rregullit 35 (5) të Rregullores së Punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), Qeveria vëren se Gjykata është shmangur nga procedura që do duhej të ndiqte në rastin Nr. KO61/20.

Këto dy shkelje ligjore të një rëndësie esenciale në një procedurë gjyqësore kushtetuese arsyetohen si në vijim:

Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpërfaq faktin se refuzimi për qartësim, saktësim apo plotësim të kërkesës së dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese konsiderohet si shkak për refuzim të kërkesës në procedurë të shkurtër, për shkak se pala nuk i ka plotësuar kriteret procedurale për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Për këtë arsye, në të gjitha rastet kur pala nuk e ka qartësuar, saktësuar apo plotësuar kërkesën, Gjykata e ka refuzuar kërkesën në procedurë të shkurtër në përputhje me Rregullin 35 paragrafi 5 dhe as nuk e ka njoftuar autoritetin, vendimi i të cilit kontestohet. Për ne, refuzimi për të zbatuar rregullat e vendosura nga vet Gjykata Kushtetuese në rrethanat e rastit konkret, është shqetësim serioz në lidhje me profesionalizmin dhe paanshmërinë e Gjykatës.

Gjykata ka specifikuar në Rregullore këtë mënyrë të procedimit, sepse nuk mund t'i kërkohej përgjigje palës tjetër, kur Gjykata nuk ka fare objekt të procedurës. Ne nuk mund të sillemi në rastin konkret, sikurse parashtruesit kanë ndërtuar një kërkesë si duhet. Për të vërtetuar pretendimin tonë, ju lutem shihni vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet Nr. KI72/19, Nr. KI89/18, Nr. KI121/18, Nr. 74/18, Nr. 04/18, Nr. 89/17, Nr. KI130/17, Nr. 48/17, Nr. KI109/16, Nr. 71/16, Nr. KI94/15, në të cilat Gjykata i ka refuzuar në procedurë të shkurtër, pa e njoftuar asnjë autoritet publik, kërkesat të cilat nuk specifikonin cili akt i autoritetit publik po kontestohet dhe më pas nuk i janë përgjigjur Gjykatës për të plotësuar kërkesën. Jemi të vetëdijshëm se bëhet fjalë për Kërkesa Individuale, por Rregulli 35.5 nuk përbën përjashtim as në rastin e kërkesave të adresuara nga organet kushtetuese.

Së dyti, ligjdhënësi në nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës shprehimisht ka përcaktuar se pala kundërshtare në procedurë ka afat 45 ditë afat që t'i dorëzojë Gjykatës përgjigjen ndaj kërkesës.

Në njoftimin tuaj Nr. KK79/20 i datës 20 prill 2020, në kundërshtim me afatin ligjor, pra afat të përcaktuar në ligj dhe i cili nuk guxon dhe nuk mundet të shkelet nga Gjykata, na keni kërkuar komentet tona në lidhje me “meritat e kërkesës”, t'i paraqesim më së largu më datën 23 prill 2020 në orën 16:00.

Në lidhje me këtë, Qeveria vëren se bëhet fjalë për shkelje të dispozitave esenciale në lidhje me procedurën dhe afatet që duhet ndjekur nga dhe në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj këto shkelje të qarta të dispozitave juridike dhe vënia nën presion të Qeverisë me njoftime të kundërligjshme, është i papranueshëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës me tërë kapacitetin e saj është e përkushtuar në luftën kundër infeksionit COVID-19 dhe pret që Gjykata, ngjashëm sikurse institucionet ekuivalente me të në shtetet perëndimore, të tregojë kujdes të veçantë ndaj jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

Prandaj Qeveria përmes kësaj parashtrëse e njofton Gjykatën se komentet e saj në lidhje jo vetëm meritat, por edhe pranueshmërinë e kërkesës, do t'i dërgojë brenda afatit ligjor. Po ashtu i kërkon Gjykatës që të mos privilegjojë parashtruesit e kërkesës në raport me qytetarët tjerë të Republikës së Kosovës, të cilëve u janë refuzuar kërkesat për të njëjtat lëshime sikurse të parashtruesve, me procedurë të shkurtër.

Qeveria do të shqyrtojë me kujdes shkeljet ligjore të deritanishme dhe varësisht nga kualifikimi juridik i tyre do të ndërmarr veprimet e nevojshme të bazuara në legjisllacionin në fuqi.”

29. Më 24 prill 2020, Gjykata njoftoi: (i) parashtuesit e kërkesës; (ii) Presidentin; (iii) Kryetaren e Kuvendit, me kërkesën që një kopje të kërkesës t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iii) Kryeministrin; (iv) Ministrin e Shëndetësisë; dhe (v) Avokatin e Popullit, lidhur me: (i) komentet e pranuar nga Kryeministri, lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme; (ii) komentet e pranuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, lidhur me meritat e kërkesës; (iii) Opinionin e pranuar nga Avokati i Popullit, lidhur me meritat e kërkesës dhe dokumentet shtesë të dorëzuara nga ai; (iv) komentet shtesë të pranuar nga parashtuesit e kërkesës lidhur me Vendimet e kontestuara në rastin KO61/20; (v) parashtresën e pranuar nga Kryeministri, drejtuar Kryetares dhe gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të titulluar *“Parashtresë në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor dhe Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO61/20”*; (vi) faktin që Gjykata nuk ka pranuar përgjigjet e kërkuara nga Kryetarja e Kuvendit, lidhur me hapat e ndërmarrë nga Kuvendi pas publikimit të Aktgjykimit KO54/20; dhe (vii) faktin që Gjykata nuk ka pranuar përgjigjet e kërkuara nga Ministri i Shëndetësisë, lidhur me rekomandimet e IKSHPK-së, mbi bazën e të cilave janë nxjerrë Vendimet e kontestuara.

30. Gjykata, ashtu siç kishte vepruar në Aktgjykimin KO54/20, duke marrë parasysh situatën e krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe çështjen kushtetuese që ngërthen rasti, dhe të cilit, në vlerësimin e Gjykatës, *“i nevojitet trajtim i përsheptuar”*, vetëm i njoftoi palët e interesuara për komentet/dokumentet e pranuar dhe u dërgoi një kopje të tyre, për informatën e tyre. Gjykata konsideroi që për të vendosur për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës në fjalë, komentet/dokumentet e pranuar janë të mjaftueshme dhe nuk ka asnjë paqartësi e cila do të duhej të adresohet përmes pyetjeve ose komenteve shtesë.

31. Më 1 maj 2020, në seancën e mbajtur nëpërmes pajisjeve elektronike, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

32. Në të njëjtën datë, Gjykata votoi njëzëri, dhe vendosi se: (i) Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në komunën e Prizrenit (pikat I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII); dhe (ii) Vendimet [nr.238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në komunat e Dragashit dhe Istogut (pikat I, II, III, V, VI dhe VII), respektivisht, **janë në**

përputhshmëri me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

33. Në të njëjtën datë, Gjykata me shumicë votash, vendosi se: (i) pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyhtë COVID-19”* për komunën e Prizrenit; dhe (ii) pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjyhtë COVID-19”* në komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ku përcaktohen kundërvajtjet administrative dhe sanksionet përkatëse, **nuk janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
34. Gjykata, gjithashtu në të njëjtën datë, me shumicë votash, vendosi se Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit *“zonë karantinë”*, **nuk është në përputhshmëri** me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjyqtari Bekim Sejdiu, votoi kundër këtij konstatimi, dhe mendimi i tij mospajtues do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.
35. Gjykata gjithashtu vendosi që kërkesa për masë të përkohshme ka ngelë pa objekt shqyrtimi pas vendosjes së rastit në merita.

Përmbledhja e fakteve

36. Më 15 mars 2020, Qeveria nxori Vendimin [nr. 01/11] për shpalljen e *“emergjencës për shëndetin publik”*. Në pikën I të këtij Vendimi, u aprovua kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë që Qeveria të shpallë *“emergjencë për shëndetin publik.”* Në pikën II, u obliguan Institucionet e Qeverisë që të veprojnë konform planit të reagimit kombëtar dhe të aktivizohet funksioni mbështetës emergjent 8 (FME8 shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore). Në pikën III, u obligua Ministria e Shëndetësisë për menaxhimin e situatës së shpallur. Në pikën IV, u theksua se Vendimi në fjalë i Qeverisë, i nënshkruar nga Kryeministrit, hyn në fuqi menjëherë, respektivisht më 15 mars 2020.
37. Më 23 mars 2020, Qeveria nxori Vendimin [nr. 01/15], përmes të cilit, miratoi ndërmarrjen e masave të një numri masash kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19, në nivel të Republikës së Kosovës. [*Shënim i Gjykatës: ky Vendim është trajtuar në hollësi në Aktgjykimin KO54/20*].

38. Më 24 mars 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës parashtroi kërkesën KO54/20 në Gjykatë, përmes së cilës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të lartcekur të Qeverisë.
39. Më 31 mars 2020, Gjykata përmes Aktgjykimit KO54/20, vendosi se Vendimi i lartcekur i Qeverisë, përkatësisht [nr. 01/15] i 23 marsit 2020, nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta e Privatësisë], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe nenet ekuivalente të KEDNJ-së, respektivisht nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit), dhe 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. (Shih pjesën operative të Aktgjykimit KO54/20, cituar më lart, si dhe përfundimet e Gjykatës për atë rast, paragrafët 310-325 të tij).
40. Më 6 prill 2020, Gjykata publikoi Aktgjykimin KO54/20 dhe të njëjtin ia dërgoi të gjitha palëve të interesuara, ndërkohë që pjesa operative e Aktgjykimit dhe përfundimet e Gjykatës veçse ishin publikuar më 31 mars 2020.
41. Më 8 prill 2020, Qeveria në detyrë (në tesktin e mëtejme: Qeveria), nxori Vendimin [nr. 01/24] përmes së cilit Ministria e Shëndetësisë, u autorizua që të nxjerrë Vendimet e kontestuara. Specifikisht, në këtë Vendim të Qeverisë të nënshkruar nga Kryeministri, thuhet:

“1. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së sëmundjes COVID-19, në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

2. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë pas rekomandimeve të njësive përkatëse profesionale dhe në konsultim me Komunat respektive do ta përcaktojë orarin e lëvizjes/ndalimit të qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve, duke pasur mundësinë të bëjë përjashtime edhe të orareve të kufizimeve të përcaktuara në pikën 1.1 të Vendimit nr. 02/17 të dates 27.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.”

Arsyetim

Me qëllim të racionalizimit të kohës në procesin e marrjes së vendimeve, në funksion të parandalimit dhe luftimit të përhapjes

së epidemisë së sëmundjes COVID-19, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.”

42. Më 12 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë nxori Vendimin [nr. 214/IV/2020] përmes së cilit komuna e Prizrenit u shpall “zonë karantinë”. Me specifikisht, në këtë Vendim parashihet me sa vijon:

“I. Komuna e Prizrenit shpallet zonë karantinë, pasi që banorët e kësaj komune dyshohen që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejt me personat e infektuar me corona virus COVID 19;

II. Fshati Skorobisht në Komunën e Prizrenit shpallet Vatër e përhapjes së Infeksionit;

III. Ndalohen hyrjet dhe daljet në Komunën e Prizrenit;

IV. Obligohen të gjithë banorët e Prizrenit [të] respektojnë masat sipas udhëzimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK);

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.”

43. Më 14 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë nxori tridhjetë e tetë (38) Vendime “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”, tre (3) prej të cilave, siç është sqarua më lart, kontestohen para Gjykatës, Vendimet [nr. 229/IV/2020] [nr. 238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020], për komunat e Prizrenit, Dragashit, dhe Istogut, respektivisht.

44. Të tre Vendimet e lartcekura, [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020], përmbajnë të njëjtin dispozitiv dhe arsyetim. Thënë këtë, Gjykata sqaron që Vendimi [nr. 229/IV/2020] për komunën e Prizrenit është identik në përmbajtje me Vendimet [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] për komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, me përjashtim të një pike shtesë, përkatësisht pikës II, që është e aplikueshme vetëm për Prizrenin. Rrjedhimisht, (i) pikat I të tre Vendimeve të kontestuara janë identike; (ii) pika II e Prizrenit është e aplikueshme vetëm për Prizrenin; (iii) pikat II, III, IV, V, VI dhe VII janë identike për komunat e Dragashit dhe Istogut, dhe të njëjtat përputhen me pikat III, IV, V, VI, VII dhe VIII të Vendimit për komunën e Prizrenit.

45. Në vijim, Gjykata do të paraqet përmbajtjen e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020], për komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht:

“I. Prej datës 15 prill 2020 në orën 6:00, ndalohet qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunën e Dragashit [Istogut] përveç rasteve në vijim:

- (a) *Për personat fizikë mbi moshën 16 vjeçare lejohet qarkullimi për furnizim me mallëra të domosdoshme (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë, si dhe produkte higjienike) dhe për të kryer detyrat dhe nevojat financiare (pagesat, punët bankare), vetëm për 1 orë e gjysmë në ditë, sipas orarit të përcaktuar javor në bazë të shifrës së parafundit të numrit të tyre personal. Orari është i bashkëngjitur këtij vendimi (shih Aneksin 1) dhe do t'i nënshtrohet rotacionit dy herë në javë. Për shtetasit e huaj që nuk posedojnë numër personal të Republikës së Kosovës, orari i lejuar i daljes përcaktohet bazuar në shifrën e parafundit të numrit të pasaportës ose të letërnjoftimit të shtetit të huaj.*
- (b) *Gjatë qarkullimit të personave fizikë, nuk lejohet shoqërimi nga askush, përveç në tri raste:*
 - (1) *personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të shoqërohen vetëm nga një anëtar i së njëjtës bashkësi familjare, apo nga një asistent mjekësor/shëndetësor.*
 - (2) *personat nën moshën 16 vjeçare, me kusht që të jenë të shoqëruar nga një anëtar i së njëjtës bashkësie familjare.*
 - (3) *kafshët shtëpiake, me kusht që të mbahen të lidhur në çdo kohë gjatë orarit të lejuar të daljes.*
- (c) *Gjatë orarit 90-minutësh të lëvizjes së lirë në bazë të numrit personal, personat fizikë mund të dalin jashtë banesave/shtëpive të tyre për të kryer ushtrime fizike. Përveç përjashtimeve në pikën (b), nuk lejohet shoqërim nga askush gjatë kryerjes së ushtrimeve fizike.*
- (d) *Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të COVID-19 ndaj të moshuarve, rekomandohet që personat mbi moshën 65 vjeçare të mos dalin nga shtëpia/banesa, përveç për raste urgjente dhe kur është e domosdoshme.*
- (e) *Me dokument identifikimi nga ATK EDI dhe vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë apo institucioneve përkatëse, mundësohet:*
 - (1) *qarkullimi i lirë për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 të këtij vendimi.*
 - (2) *transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zingjirit të furnizimit – si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe*

shitja te konsumatori i fundit – për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.

- (f) *Lejohet qarkullimi i lirë për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi, vetëm për të kryer detyrat zyrtare.*
- (g) *Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.*
- (h) *Lejohet qarkullimi për personat fizikë në raste ku dalja nga shtëpia/banesa është e domosdoshme për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, ose për një ose më shumë persona me aftësi të kufizuara, vetëm nëse të sëmurët apo personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten.*
- (i) *Ndalimi i qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre nuk zbatohet në raste të viktimave të dhunës familjare. Viktimave të dhunës familjare u lejohet të dalin nga shtëpitë/banesat e tyre për të kërkuar strehim në një lokacion alternativ.*
- (j) *Në raste të vdekjes, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të marrë pjesë në varrim, por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit.*
- (k) *Ndalohet rreptësishtë dalja nga shtëpitë/banesat për çfarëdo arsye tjetër përveç për arsyet e lartcekura, duke përfshirë në këtë ndalim takime shoqërore, vizita familjare, etj.*

II. Prej datës 15 prill 2020 në orën 6:00, ndalohet qarkullimi i automjeteve në Komunën e [Prizrenit/Dragashit/Istogut], përveçse:

- (a) *Me dokument konfirmimi nga ATK sistemi EDI dhe vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë, mundësohet:*
 - (1) *Qarkullimi i automjeteve për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 i këtij vendimi.*
 - (2) *lëvizja e punëtorëve, vetëm për të shkuar në punë dhe për t'u kthyer nga puna, sipas orarit të operatorit përkatës ekonomik. Punëtori ka të drejtë të shfrytëzojë edhe veturën personale.*
 - (3) *transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zingjirit të furnizimit – si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit – për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.*
- (b) *Orari i qarkullimit për bujqit dhe punonjësit në fermë është 06:00 – 20:00. Për bujqit, në kohën e qarkullimit nevojiten: (i) Certifikata e*

Regjistrimit të Fermerit, (ii) Aneksi 1 i Certifikatës – Shënimet e Fermerit dhe (iii) Leternjoftimi.

- (c) *Punonjësit e fermave do të pajisen me dokument konfirmimi nga MBPZhR vetëm për të kryer nevojat e punës në fermën përkatëse.*
- (d) *Me leje të veçantë të qarkullimit dhe vetëm për të kryer nevojat e institucioneve shtetërore, lejohet qarkullimi i automjeteve për stafin esencial të këtyre institucioneve.*
- (e) *Lejohet qarkullimi me automjete për personat të cilët marketin/barnatoren/bankën/pikën e pagesës më të afërt e kanë më shumë se 2km larg. Në këto raste, nuk lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtuar te ndonjë market/barnatore/bankë/pikë e pagesës përveç atij më të afërt.*
- (f) *Vetëm për të kryer detyrat zyrtare, lejohet qarkullimi i automjeteve për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi.*
- (g) *Lejet për qarkullim në raste të specifikuara më sipër nga Aneksi 3 lëshohen nga MPBAP.*
- (h) *Lejohet qarkullimi i automjeteve për personat me aftësi fizike të kufizuara që e bëjnë të domosdoshëm përdorimin e automjeteve.*
- (i) *Lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtuar te një institucion shëndetësor për të kërkuar trajtim.*
- (j) *Në raste të vdekjes, lejohet përdorimi i automjetit për të marrë pjesë në varrim, por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit.*
- (k) *Përveç për arsyen e përcaktuar në pikën I, nuk lejohet më shumë se dy persona në një automjet.*
- (l) *Përjashtimisht, ekipet e mediave të cilat punojnë në terren lejohen të kenë deri në 3 persona në automjet me kusht që pasagjerët të kenë maskë speciale FFP2 plus dorëza të vendosura.*

III. Gjatë qarkullimit të lejueshëm sipas përjashtimeve të parashikuara në pikat I dhe II më lart, personat fizikë obligohen:

- (a) *të mbajnë të mbuluara vetëm gojën dhe hundën, përmes maskës, shallit, apo ndonjë mbulese tjetër;*
- (b) *në çdo kohë, të ruajnë distancën prej dy metrash nga persona të tjerë.*

IV. Mosrespektimi i masave të përcaktuara në këtë vendim konsiderohet, sipas ligjit, si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, prej 1,000 Euro deri 2.000 Euro për personat fizikë dhe prej 3,000 Euro deri në 8,000 Euro për personat juridikë, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet prej 500 Euro deri 1,500 Euro. Në përputhje me ligj, gjobat shqiptohen nga Inspektorati kompetent.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri më 4 maj 2020. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet çdo dispozitë e mëparshme që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Vendimi.

VI. Ky vendim do të rishqyrtohet jo më vonë se 30 prill 2020, në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertët dhe ministrinë e tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe për të vendosur për vazhdimin ose jo të masave përkatëse.

VII. Përveç pikës V dhe VI, Ministri i Shëndetësisë do ta ri-analizojë situatën epidemiologjike çdo ditë dhe në lidhje me secilën pikë të lartcekur dhe, pas konsultave paraprake, mund të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.”

46. Siç është sqaruar më lart, përmbajta e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] për komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, është identike me pikat I, III, IV, V, VI, VII dhe VIII, të Vendimit [nr. 229/IV/2020] për komunën e Prizrenit. Thënë këtë, ky i fundit përmban edhe pikën II, e cila përmban si në vijim:

II. Prej datës 15 prill në orën 06:00, ndalohet hyrje-dalja nga Komuna e Prizrenit përveç në këto raste:

(a) Me dokument konfirmimi nga ATK sistemi EDI dhe vetëm për të kryer transportin e mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit – si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit – lejohet hyrjedalja për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.

(b) Me dokument konfirmimi nga ATK sistemi EDI, përveç për kryerjen e transportit të mallrave dhe shërbimeve, hyrje-dalja u lejohet gjithashtu punëtorëve të punësuar nga operatorët ekonomikë, përveç për zonat e shpallura nga Ministria e Shëndetësisë si vatra të përhapjes së infeksionit.

(c) Lejohet hyrje-dalja e bujqve dhe punonjësve të fermerëve, përveç për zonat e shpallura nga Ministria e Shëndetësisë si vatra të përhapjes së infeksionit. Për bujqit, për hyrjedalje nevojiten: (i) Certifikata e Regjistrimit të Fermerit, (ii) Aneksi I i Certifikatës „Shënimet e Fermerit të Regjistruar dhe (iii) Letërnjoftimi.

(d) Vetëm për të kryer detyrat zyrtare, lejohet hyrje-dalja për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi.

(e) Lejet për qarkullim në raste të specifikuara më sipër nga Aneksi 3 lëshohen nga MPBAP.

(f) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet hyrje-dalja për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor, por vetëm nëse ky trajtim nuk ofrohet në komunën ku ndodhet personi për të cilin kërkohet trajtim.

47. Ndërsa, të tre Vendimet e lartcekura [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020], respektivisht, përmbajnë të njëjtin arsyetim i cili lexon më sa vijon:

“Më 11.03.2020, duke miratuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin nr. 01/07, përmes së cilit janë marrë masat e para për parandalimin dhe luftimin e infeksionit COVID-19. Pas konfirmimit të rasteve të para të personave të infektuar, në përputhje me rekomandimet e IKSHPK, Ministria ka kërkuar nga Qeveria nxjerrjen e vendimeve të tjera përmes të cilave janë marrë masa shtesë për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes COVID-19.

Më 23.03.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin nr. 01/15 përmes së cilit janë marrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Më 31.03.2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës ka njoftuar opinionin se pas kontestimit të vendimit të Qeverisë nr. 01/15 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, ka miratuar kërkesën e të njëjtit dhe ka shpallur të pavlefshëm vendimin e kontestuar. Mirëpo në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se Ministria e Shëndetësisë vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerr vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjes COVID-19, për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin e Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Sipas nenit 47.1 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, “Ministria e Shëndetësisë është kompetente për zbatimin e këtij ligji dhe për miratimin e dispozitave të parapara me të.”

Sipas nenit 41.2 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë është e autorizuar për “ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara”. Në datën 12.04.2020, IKSHPK i propozoi Ministrisë së Shëndetësisë marrjen e masave të theksuara në dispozitivin e këtij vendimi për komunën e Prizrenit/Dragashit/Istogut për shkak të IKSHPK konsideron se infeksioni është përhapur në atë komunë apo e njëjta konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar. Me qëllim që Ministria e Shëndetësisë t’i përmbushë obligimet ligjore për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve i aprovoi propozimet e IKSHPK sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, në përputhje me gjendjen faktike dhe juridike të përshkruar në këtë arsyetim, Ministri i Shëndetësisë vendosi si në dispozitiv.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur mund të ushtrojë padi të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamentin për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh pas publikimi të këtij vendimi.”

48. Më 17 prill 2020, parashtruesit e kërkesës, në Gjykatën Kushtetuese, kontestuan katër (4) Vendimet e lartcekura të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht Vendimin [nr.214/IV/2020] të 12 prillit 2020 dhe Vendimet [nr.229/IV/2020], [nr.238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020], të 14 prillit 2020, respektivisht.

Pretendimet e parashtruesëve të kërkesës

49. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimeve të kontestuara, respektivisht: (i) Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; (ii) Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës së Prizrenit; (iii) Vendimit [nr. 238/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunën e Dragashit”; dhe (iv) Vendimit [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunën e

Istogut”. Përmbajtja e të gjitha këtyre Vendimeve është cekur më lart në nëntitullin e këtij Aktgjykimi: “Përmbledhja e fakteve”.

50. Në kontekst të Vendimeve të kontestuara, parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, theksuan: *“Me respekt sqarojmë pranuesin e kësaj kërkesë, Gjykatën Kushtetuese, se vendimet për ndalimin e qarkullimit të personave fizik dhe automjeteve, në secilën komunë veç e veç, nuk janë evidentuar në listën e vendimeve të kontestuara nga parashtruesi i kërkesës vetëm për qëllime praktike, sepse për nga natyra juridike, si nga përmbajtja ashtu edhe nga forma janë identike. Vendimet e specifikuara dhe të kontestuara në këtë kërkesë, vetëm se i dedikohen komunave të Republikës së Kosovës, një nga një. Shih linkun në vijim: <https://msh.rks-gov.net/vendimet-per-komunat-e-rrezikuara-dhe-per-komunat-e-karantinuara/>.”*
51. Në vijim Gjykata do të paraqes, pretendimet e parashtruesëve të kërkesës përkitazi me: (i) pranueshmërinë e kërkesës; (ii) përmbajtjen/substancën e Vendimeve të kontestuara; dhe (iii) caktimin e masës së përkohshme.

(i) Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

52. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kërkesën KO61/20 e kanë parashtruar mbi bazën e nenit 113.2 (1) të Kushtetutës. Ky nen i Kushtetutës, theksojnë parashtruesit e kërkesës, në mënyrë shprehimore u jep kompetencë të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit që të ngrisin çështje në Gjykatën Kushtetuese *“për të vlerësuar çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.”*
53. Lidhur me kompetencën specifike të deputetëve të Kuvendit për të ngritur çështje të vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të një Ministrie, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: (i) bazuar në nenet 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, parashihet që *“Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat”* dhe që *“Ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë”*, dhe rrjedhimisht Ministria është pjesë e Qeverisë, aktet e së cilës hyjnë në fushëveprimin e *“rregulloreve të Qeverisë”*. Për qëllime të të njëjtit argumentim, përkatësisht se Qeveria përbëhet në tërësinë e saj nga Ministritë e saj, ata i referohen edhe neneve 3 (Përbërja e Qeverisë së Republikës së Kosovës) dhe 8 (Ministri) të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësiwe Administrative të Kryeministrit dhe

Ministrive; dhe theksojnë se (ii) *“Vendimet e kontestuara, hyjnë në kategorinë e akteve nënligjore të Qeverisë, respektivisht rregulloreve, dhe se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij.”* Në mbështetje të këtij argumenti ata i referohen praktikës së Gjykatës në Aktgjykimin në rastin nr. KO73/16, me parashtrues të kërkesës, Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO73/16); Aktgjykimin në rastin nr. KO12/18, me parashtrues Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO12/18); dhe Aktgjykimin KO54/20, cituar më lart, dhe i cili në paragrafët 161-163, ndër të tjera, thekson se *“Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese [113.2 (1)] është që tu jepet mundësia kushtetuese të gjitha palëve që të kontestojnë aktet e njëri-tjetrit me qëllim të garantimit të kushtetutshmërisë së vendimmarrjes respektive të secilit institucion kushtetues, respektivisht Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë”*. Në këtë kontekst, ata gjithashtu, argumentojnë që, kërkesa ngërthen çështje të rëndësishme kushtetuese, duke marrë parasysh ndërlidhjen me të drejtën e lëvizjes së qytetarëve e cila është kufizuar, sipas pretendimit, në mënyrë kundërkushtetuese përmes Vendimeve të kontestuara.

54. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu theksojnë se *“kushtet dhe kërkesat kushtetuese e ligjore plotësohen për parashtrim të kësaj kërkesë dhe rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucionet e mandatuara për referim.”* Në rastin konkret, sipas tyre, *“në mënyrë që të mbrohen shtetasit dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, nga kufizimet e pa baza dhe jo kushtetuese të Qeverisë, respektivisht të Ministrisë së Shëndetësisë, për sa i përket kufizimit të lirisë së lëvizjes (e cila sipas Kushtetutës mund të bëhet vetëm me ligj), të pranoni për shqyrtim në merita dhe brenda afateve të parapara të shpallni vendimet e kontestuara të Qeverisë në papajtueshmëri të plotë me Kushtetutën, në mënyrë që të evitohen sa më parë shkeljet flagrante nga kufizimi i kësaj të drejte si dhe të evitohet gjithashtu sa më parë, pasojat juridike dhe të tjera nga kufizimi i lirive themelore, mbrojtjen e të cilave, si autoriteti me i lartë dhe përfundimtar i interpretimit të Kushtetutës, ta bëjë sa parë Gjykata Kushtetuese.”*

(ii) *Lidhur me meritat e kërkesës*

55. Lidhur me përmbajtjen e Vendimeve të kontestuara, respektivisht meritat e kërkesës, parashtruesit e kërkesës theksojnë së Vendimet e kontestuar janë në kundërshtim me (i) nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës; (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO54/20; dhe (iii) nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
56. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës vënë theks në faktin se (i) liria e lëvizjes, mund të kufizohet vetëm me ligj, dhe se përmes Vendimeve të kontestuara, Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse (në tekstin e mëtejme: Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse), duke vepruar rrjedhimisht, në kundërshtim me nenin 35 e 55 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e lartcekur. Në mbështetje të këtij argumenti, parashtruesit e kërkesës i referohen paragrafit 197 të Aktgjykimit KO54/20 dhe i cili ka sqaruar testin kushtetues që ngërthen neni 55 i Kushtetutës, dhe sipas të cilit, një *“ndërrhyrje”* në të drejtat dhe liritë themelore, duhet të jetë e *“përcaktuar në ligj”*, të ndjek një *“qëllim legjitim”*, të jetë *“proporcionale”* dhe e *“nevojshme në një shoqëri demokratike”*; dhe se (ii) në kundërshtim me këto parime, *“të drejtat dhe liritë themelore janë kufizuar me akte nënligjore, pra vendime administrative, të karakterit arbitrar të një qeverie, përkatësisht të një ministri të saj”*.
57. Gjithashtu parashtruesit e kërkesës theksojnë se përkundër Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO54/20, nxjerrja e vendimeve në tridhjetë e tetë (38) komuna të Kosovës, duke kufizuar lirinë e lëvizjes për të gjithë territorin e saj, *“ka arritur efekt të njejtë juridik të kufizimeve për të gjithë qytetarët pa dallim, dhe për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në shpërputhje të plotë me Ligjin nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Aktgjykimin e kësaj Gjykate në rastin nr. KO54/20, datë 06 prill 2020”*.
58. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se (i) Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i cili ka hyrë në fuqi para Kushtetutës, nuk reflekton parimet themelore të kësaj të fundit; (ii) i njëjti Ligj, në nenet 41 dhe 44 të tij, nuk përcakton asnjë lloj autorizimi *“për ta ndaluar lëvizjen apo qarkullimin në nivel të përgjithshëm shtetëror e as gjithë komunal, pa përjashtim dhe me trajtim të njejtë për të gjitha komunat, pavarësisht shkallës së tyre nga infektimi; e as “nuk autorizojnë Ministrinë të nxjerr vendime që kanë efekt të përgjithshëm, në të gjithë qytetarët pa dallim, dhe rrjedhimisht vendimet përkatëse, kanë prodhuar efekte juridike të njëjta, uniforme për të gjithë qytetarët e vendit”*; dhe (iii) Ligji nr.

04/L-125 për Shëndetësi (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Shëndetësi), e ka bërë dallimin në mes “*Gjendjes Emergjente*” dhe “*Gjendjes së Jashtëzakonshme*”, duke saktësuar “*taksativisht*” kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë në rastin e të parës, dhe duke kufizuar autorizimet e së njëjtës brenda ligjit të aplikueshëm.

59. Më saktësisht dhe përkitazi me Vendimet e kontestuara, parashtruesit e kërkesës saktësojnë se (i) Vendimet e kontestuara nuk kanë trajtuar komunat përkatëse bazuar në specifikat e veçanta të këtyre komunave përkitazi me të infektuarit dhe të dyshuarit apo të rrezikuarit më COVID-19, por kanë trajtuar të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, në mënyrë të njëjtë; (ii) komuna e Dragashit, e cila i nënshtrohet kufizimeve të njëjta si në tërë pjesën tjetër të territorit të Kosovës, deri në momentin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar përkitazi me këtë komunë, nuk ka pasur asnjë të infektuar me COVID-19; (ii) komuna e Prizrenit, i është nënshtrohet kufizimeve të njëjta përmes Vendimit të kontestuar të datës 14 prill 2020, përkundër faktit që dy ditë më herët, përkatësisht më 12 prill 2020, e njëjta përmes Vendimit [nr.214/IV/2020] është shpallur gjithashtu “*zonë karantinë*”; ndërsa (iii) komuna e Istogut, i është nënshtrohet masave të njëjta, përmes Vendimit të kontestuar, përkundër faktit që në këtë komunë, deri në datën e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, është regjistruar vetëm një rast me COVID-19. Parashtruesit e kërkesës rrjedhimisht theksojnë se këto tri komuna me specifika të ndryshme janë trajtuar, “*krejtësisht njëjtë me vendimet e Ministrisë, të datës 14 prill, 2020, sikurse janë trajtuar pa asnjë dallim edhe 35 komuna të tjera të Republikës së Kosovës*”. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se Vendimet e kontestuara, dhe ato në tridhjet e pesë (35) komuna të tjera, “*përmbajnë një arsyetim të mangët, jo profesional, të pabazuar në rrethanat faktike të rastit*”, ndërsa ai për vendosjen e karantinës në Prizren, “*nuk përmban fare arsyetimin, si element konstituiv thelbësor i aktit administrativ*”, ndërsa mungesa e elementeve të aktit administrativ është bazë për nulitetin (pavlefshmërinë) e tij. Përkitazi me Vendimin e kontestuar që ndërlidhet me përcaktimin e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, parashtruesit e kërkesës vënë theks në faktin se bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse, karantina mund të vendoset vetëm “*ndaj personave për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje, por jo edhe ndaj një qyteti në tërësi, sic Vendimi kontestues e shpallë zonë karantinë Komunën e Prizrenit*”.

(iii) Lidhur me masën e përkohshme

60. Duke u thirrur në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 54 të Rregullores së punës, parashtruesit e kërkesës, kërkuan nga Gjykata *“që të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të vendimeve të kontestuarra deri në përfundimin e procedurës së kontrollit kushtetues dhe zgjidhjes meritore të rastit.”*
61. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës së pari theksojnë se kanë *“arsyetuar çështjen prima facie”*, ndërsa, së dyti, se masa e përkohshme është e nevojshme për të evituar *“dëm të pariparueshëm”* sepse (i) *“mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm e të pariparueshëm në shkeljen e garancive kushtetuese të të drejtave themelore dhe parimeve të qeverisjes demokratike”*; dhe (ii) *“mospezullimi i menjëhershëm i vendimeve të kontestuarra nga Gjykata, gjithashtu, do kishte për pasojë, edhe humbjen e vendeve të punës së punonjëseve të sektorit privat, të cilët për arsye që nuk lidhen me ata si punëmarrës, nuk do arrijnë të marrin lejet e nevojshme për qarkullim, si pasojë e pamundësisë, së nxjerrjes së dokumenteve të nevojshme nga institucionet shtetërore. Së treti, parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se masa e kërkuar e përkohshme është në “interes publik” sepse (i) përmes zbatimit ose jo të Vendimeve të kontestuarra “varet krijimi, ndryshimi apo shuarja e të drejtës në zbatimin e ushtrimit dhe realizimit efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.”; (ii) “kjo Qeveri, me qëllim është abuzuar me vendimin paraprak të kësaj Gjykate në rastin KO54/20, duke mos e zbatuar të njëjtin, dhe duke provuar që përmes këtyre vendimeve, të krijohet bindja e zbatimit të vendimit të kësaj Gjykate, duke i shmangur me qëllim, konstatimet dhe përfundimet e vlefshme të këtij aktgjykimi, dhe duke konsideruar gabimisht, se ky aktgjykim, vetëm ka kërkuar që me vendime për secilën komunë, të cilat mund të nxirren nga ministria, mund të bëhen kufizimet e të drejtave.”; dhe (iii) se një qasje e tillë, sipas parashtruesve të kërkesës *“mos përfillëse ndaj zbatimit të drejtë dhe në mënyrë efikase të aktgjykimit të kësaj gjykate, cenon rënd edhe besimin e madh të publikut në punën e kësaj Gjykate, dhe parimet e shtetit të së drejtës, dhe për më tepër në efektin juridik të vendimeve të kësaj Gjykate, të cilat vendime, përderisa janë edhe të detyrueshme sipas nenin 116 të Kushtetutës, ato respektohen po thuajse në tërësinë e tyre dhe nga të gjithë, prandaj, nuk duhet lejuar shkelja e standardit institucional për t’i respektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe jo për t’i bishtruar efektet e tyre, e aq me pak për të mos i zbatuar.”**

Komentet e dorëzuara lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

62. Siç është cekur në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit u kishte dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme në rastin KO61/20 deri në orën 16:00 të datës 21 prill 2020. Gjykata, brenda afatit të përcaktuar, ka pranuar komente vetëm nga Kryeministri, në emër të Qeverisë. Komentet e pranuar do të paraqiten në vijim.

Komentet e dorëzuara nga Kryeministri, në emër të Qeverisë

63. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, Kryeministri thekson se Rregullorja e punës parasheh tri kushte të domosdoshme që parashtruesit duhet t'i përmbushin në mënyrë që kërkesa e tyre për masë të përkohshme të miratohet nga Kolegji shqyrtues. Duke cituar pikat (a), (b) dhe (c) të rregullit 57 (4) të Rregullores së punës, Qeveria thekson se asnjë nga këto tri kushte nuk janë përmbushur në rrethanat e rastit konkret.
64. Në lidhje me argumentimin *prima facie* të kërkesës, Kryeministri pretendon se kërkesa e parashtruesëve të kërkesës është e papranueshme sepse (i) sipas nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë të kontestojë “*dekretet e Kryeministrit (vendimet që nxirren nga ai në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese si organ individual) apo rregulloreve të Qeverisë (rregulloret që miratohen nga Qeveria si organ kolegjial).*”; dhe (ii) sipas neneve 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesve “*duhet të refuzohet me procedurë të shkurtë*”.
65. Në lidhje me “*dëmin e pariparueshëm*”, Qeveria, duke cituar specifikisht pikën (b) të rregullit 57 (4) të Rregullores së punës, thekson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ngritur “*asnjë pretendim në lidhje me dëmin e pariparueshëm që ata – si palë në këtë procedurë – do ta pësonin.*” Duke u referuar në rastin e Gjykatës “*KI56/09, Vendim i 15 dhjetorit 2009*”, Kryeministri thekson se është detyrim i palës në procedurë që jo vetëm të ngritë si pretendim pësimin e dëmit të pariparueshëm, por të arsyetojë mjaftueshëm pësimin e një dëmi të tillë. Gjithashtu, në mbështetje të sqarimit të konceptit të “*dëmit të pariparueshëm*”, përmes të njejtës shkresë, u cituan edhe disa raste të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), si në vijim: (i) *Abdollahi kundër Turqisë*, kërkesa nr. 23980/08; (ii) *F.H. kundër Suedisë*, kërkesa nr.

32621/06; (iii) *Abraham Lunguli kundër Suedisë*, nr. 33692/02; (iv) *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 14038/88; (v) *Ismoilov dhe të tjerët kundër Rosisë*, kërkesa nr. 2947/06; (vi) *Otham (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 8139/09; *Kotsaftis kundër Greqisë*, kërkesa nr. 39780/06; (vii) *Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 6339/05; (viii) *Ocalan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 46221/99; dhe (ix) *X. kundër Kroacisë*, kërkesa nr. 11223/04.

66. Në lidhje me interesin publik, Kryeministri konsideron se parashtruesit e kërkesës *“nuk janë justifikuar interesin publik, si kërkesë për vendosjen e masave të përkohshme me efekt pezullimin”* e zbatimit të Vendimeve të kontestuara. Liritë dhe të drejtat themelore, sipas pretendimit, nuk krijohen me akte të ekzekutivit por ato burojnë nga Kushtetuta dhe, sipas nenit 22 të Kushtetutës, edhe nga KEDNJ. Çështje të interesit publik, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas shkresës, konsiderohen siguria publike; shëndeti publik; mbrojtja e ambientit; dhe sigurimi i stabilitetit financiar të shtetit. Në këtë kontekst, Qeveria, theksoi se parashtruesit e kërkesës *“nuk kanë si të ofrojnë ndonjë argument nëse si shkak i ekzekutimit të vendimit të kontestuar, rrezikohet siguria publike nga trazira të brendshme apo sulme të jashtme; rrezikohet shëndeti publik; dëmtohet ambienti apo rrezikohet stabiliteti financiar i Republikës së Kosovës.”*
67. Në përfundim të komenteve lidhur me masën e përkohshme, Kryeministri theksoi se Rregullorja e punës ka përcaktuar qartë se pikat (a), (b) dhe (c) të rregullit 57 (4), duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Për rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës, thekson Kryeministri, duhet që në mënyrë kumulative të ndërtojnë rastin *prima facie*; të dëshmojnë se ekzekutimi i vendimit i shkakton dëm të pariparueshëm; dhe, të dëshmojnë se masa e përkohshme është në interesin publik.

Komentet e dorëzuara lidhur me meritat e kërkesës

68. Siç është cekur në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit iu kishte dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara që të paraqesin komentet e tyre lidhur me meritat e kërkesës deri më 23 prill 2020, në orën 16:00. Kryeministri, Presidenti, Ministri i Shëndetësisë dhe Kuvendi, nuk dorëzuan komente në Gjykatë. Komente dorëzuan vetëm Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe Avokati i Popullit. Në vijim, Gjykata do të paraqes të gjitha komentet e pranuar.

Komentet e dorëzuara Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

(i) Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

69. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së katër (4) Vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë.
70. Në aspektin procedural, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, thekson se (i) duke qenë se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë qartësuar, saktësuar dhe plotësuar kërkesën, Gjykata, duhet ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër bazuar në rregullin 35 (5) të Rregullores së punës; dhe (ii) Vendimet e kontestuara nuk janë “rregullore të Qeverisë”, në kuptim të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata.

(ii) Lidhur me meritat e kërkesës

71. Lidhur me meritat e kërkesës, dhe duke iu referuar Aktgjykimit KO54/20, përkatësisht paragrafëve 189-198 të tij, në të cilin Gjykata ka sqaruar strukturën dhe testin që ngërthen neni 55 i Kushtetutës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ka theksuar se Vendimet e kontestuara (i) janë “të përcaktuara me ligj”, sepse janë nxjerrë bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përkatësisht në nenet 41 dhe 44 të tij, përmes të cilëve mund të kufizohet lëvizja “në zona të caktuara, të kërcënuara nga COVID-19, bazuar në paraqitjen e rasteve të sëmundjes nëpër këto komuna” dhe të cilat përcaktohen në bazë të rekomandimeve të IKSHPK-së; (ii) ndjekin një “qëllim legjitim”, përkatësisht “në qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, të kërcënuar me paraqitjen e COVID-19.”; (iii) janë të domosdoshme dhe proporcionale, “në qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe parandalimit të rritjes ekspansive të rasteve të infektuara, që është dëshmuar si realitet i hidhur nga përvoja e shteteve të rajonit, atyre perëndimore por edhe tejoqeanike”, duke theksuar gjithashtu se “se masat e ndërmarra do të rishikohen pas një afatit kohor prej tri (3) javësh, gjë që figuron po ashtu në vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë” dhe se “revidimi i këtillë nuk lejon arbitraritetin në veprim të institucioneve relevante dhe garantojnë shfuqizim të këtyre masave në momentin e dhënies së sinjaleve të para të uljes së numrit të rasteve të infektuara”; dhe në fund, (iv) janë gjithashtu të “nevojshme në një shoqërie demokratike”, duke theksuar, ndër të tjera se “nevoja e shoqërisë për imponimin e masave

të këtilla është e domosdoshme, në qëllim të ruajtjes së shëndetit e me këtë edhe vazhdimin të zhvillimit të shoqërisë.”

72. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! gjithashtu fokusohet në (i) rolin e Inspektoratit Sanitar të Kosovës për *“shqiptimin e gjobave për kundërvajtje administrative sanitare”*; dhe (ii) ndërlidhjen e kufizimeve të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara përkitazi me të drejtën për jetën të garantuar përmes nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës.
73. Përkitazi me çështjen e parë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se bazuar në pikën (m) të nenit 31 të Ligjit nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Inspektoratin Sanitar të Kosovës), *“mosrespektimi i pjesshëm ose i plotë i detyrave e vendimeve që merren nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës”* është kundërvajtje administrative sanitare dhe shqiptohet në bazë të vendimit/eve të nxjerra nga Inspektorati Sanitar të Kosovës. Ndërsa përkitazi me çështjen e dytë, theksojnë se *“mbrojtja e shëndetit domosdoshmërisht shpie te neni 25 i Kushtetutës ku garantohet e drejta për jetën”*. Sipas pretendimit, *“Udhëzuesi i GJEDNJ-së për nenin 2 të KEDNJ-së shpjegon që GJEDNJ “ka theksuar në shumë raste që e drejta për jetën kërcënohet edhe atëherë kur personi të cilit i është rrezikuar shkelja e kësaj të drejte nuk ka vdekur”*; dhe rrjedhimisht, *“shfuqizimi i masave të ndërmarra me vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht mos respektimi i tyre dhe lejimi i qarkullimit apo lëvizjes pa kusht, “kërcënon shkelje të së drejtës për jetën.”*

Opinion i dorëzuar nga Institucionit i Avokatit të Popullit

74. Institucioni i Avokatit të Popullit dorëzoi një Opinion në Gjykatë përmes së cilit, ndër të tjera, theksoi se (i) rrethanat e krijuara me pandeminë COVID-19 dhe rrezikshmërinë që paraqet për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, *“kërkojnë një balancim në mes të të drejtës për jetën, e cila nuk mund të kufizohet apo derogohet në asnjë rrethanë dhe të drejtave tjera për të cilat Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lejojnë kufizimet, në rrethana të caktuara”*; dhe (ii) pandemia COVID-19, *“bie në domenin e përkufizimeve të kërcënimit të shëndetit dhe jetës së qytetarëve dhe se shteti është i obliguar që të ndërmarrë masa në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre.”*
75. Avokati i Popullit vë theks në faktin se *“është evidente se ekziston nevoja për vendosjen e masave në parandalimin dhe luftimin e COVID-19”*; dhe se një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe vet Gjykata në

paragrafin 310 të Aktgjykimit KO54/20, në të cilin ka theksuar se “nuk është roli i saj që të vlerësojë se a janë adekuate dhe të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjë palë në këtë rast. Përcaktimi i politikave rreth shëndetit publik nuk hyn në kompetencat dhe autorizimet e Gjykatës Kushtetuese. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese u referohet dhe bindet institucioneve përkatëse shëndetësore dhe profesionale në nivel shtetëror dhe botëror.”

76. Për më tepër, duke iu referuar Aktgjykimit KO54/20, Avokati i Popullit thekson se Gjykata (i) “ka shqyrtuar hollësisht Ligjin për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe Ligjit për Shëndetësi, dhe në kuptimin e kompetencave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe në pikën 325 të Aktgjykimit, ka konstatuar se e njëjta vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi”; (ii) “ka theksuar se deri në datën e shfuqizimit të Vendimit të kontestuar, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në rradhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin veprimet, në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, që i konsiderojnë si të duhura dhe adekuate për të vazhduar parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19; (iii) “ekziston obligimi pozitiv i shtetit, që të ndërmarrë masa parandaluese në rrethana të situatave emergjente me të cilat vihet në rrezik shëndeti i qytetarëve, si dhe të ndërmarrë masa për trajtimin dhe kontrollin e epidemive, endemive dhe sëmundjeve tjera”; dhe (iv) duke iu referuar “Parimeve të Sirakuzës mbi Kufizimet dhe Shmangiet nga Dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike”, Avokati i Popullit thekson se “shëndeti publik mund të paraqet bazë për kufizimin e të drejtave të caktuara në mënyrë që t’u lejohet shteteve për të ndërmarrë masa gjatë kërcënimeve serioze për shëndetin e popullatës apo pjesëtarëve të popullatës.”
77. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit konsideron se (i) Vendimet e kontestuara janë “të përcaktuara në ligj”; duke theksuar megjithatë se (ii) “duhet të vlerësohet vetëm nëse ashpërsia e masave të ndërmarra është proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet, gjithnjë duke marrë parasysh rekomandimet e institucioneve të autorizuara me ligj për vlerësimin e situatës sanitare dhe epidemiologjike në vend”. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit i referohet Dokumentit Informativ nr. SG/Inf(2020)11 të publikuar nga Këshilli i Evropës më 7 prill 2020,

për respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19 (në tekstin e mëtejme: Dokumentit Informativ i Këshillit të Evropës), në raport me të cilin, ndër të tjera, vë theks në faktin se (i) *“autoritetet ekzekutive duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet”*; (ii) *“kjo mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta vendimmarrëse, si dhe lehtësimin e disa kontroleve dhe balancave”*; dhe (iii) *“megjithatë, parlamentet duhet të vazhdojnë të kenë pushtetin për të kontrolluar veprimet e ekzekutivit, duke verifikuar në veçanti, në intervale të arsyeshme kohe, nëse kompetencat e ekzekutivit për gjendjen e emergjencës janë ende të justifikuara, ose duke ndërhyrë në mënyrë ad hoc për të modifikuar apo anuluar vendimet e ekzekutivit.”*

78. Avokati i Popullit thekson se Aktgjykimi KO54/20 *“ka mbetur i pazbatuar nga ana e Kuvendit”* duke theksuar ndër të tjera se *“Kuvendi do të duhej të veprojë në pajtim me autorizimet e veta Kushtetuese, me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe me qëndrimet e Dokumentit Informativ nr. SG/Inf(2020)11 të publikuar nga Këshilli i Evropës më 7 prill 2020 përkitazi me rrethanat e shkaktuara nga COVID-19”*. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vë theks në rekomandimet e dokumentit të lartcituat, sipas të cilave (i) *“duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta dhe të paparashikueshme të kësaj krize, mund të lindë nevoja për delegime relativisht të gjera legjislative, por ato duhet të formulohen sa më ngushtësisht që të jetë e mundur në këto rrethana, me qëllim që të ulin çfarëdolloj potenciali për abuzime”*; si dhe (ii) *“nëse Parlamenti dëshiron ta autorizojë qeverinë të devijojë nga legjislacione të posaçme kryesore (apo legjislacione të miratuara sipas një procedure tjetër të posaçme), kjo duhet të bëhet me shumicën e kërkuar për miratimin e atij legjislacioni, apo duke ndjekur të njëjtën procedurë të posaçme.”*
79. Në fund dhe gjithashtu, Avokati i Popullit ka ofruar, përmes disa dokumenteve shtesë të dorëzuara në Gjykatë, edhe një pasqyrë të deklaratave të organizatave, mekanizmave dhe akterëve të ndryshëm nga fusha e të drejtave të njeriut, lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive gjatë pandemisë COVID-19, përfshirë deklaratën e (i) Avokatit të Popullit të Shqipërisë; (ii) Ombudsmanit të Bosnje dhe Hercegovinës; (iii) Ombudsmanit të Kroacisë; (iv) Institutit Danez për Drejtësi; (v) Institutit Gjerman për të Drejtat e Njeriut; (vi) Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Irlandës Veriore; (vii) Ombudsmanit të Portugalisë; (viii) Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Irlandës Veriore; (ix) Komisionit për të Drejtat e Njeriut e Skotlandës; (x) Qendrës Kombëtare për të Drejtat e Njeriut e Sllovakisë; (xi) Ombudsmanit të Spanjës; (xii) Institucionit për të Drejtat e Njeriut

dhe Barazi në Turqi; (xiii) Kryetarit të Komisionit Evropian; (xiv) OSBE-së drejtuar Komunitetit të OSBE; (xv) Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut; (xvi) Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut; (xvii) Komisionit Ndërkombëtarë të juristëve në Simpoziumi COVID-19; (xviii) “Amnesty International” lidhur me gjendjen emergjente; (xix) Qëndrim i Organizatave Joqeveritare të Bashkimit Evropian lidhur me kufizimet e të drejtave; (xx) deklaratë e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës; dhe letrat e (xxi) Komisionit të Barazisë dhe Drejtave të Njeriut të Britanisë së Madhe drejtuar Kryeministrit; dhe (xxii) Komisionit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut të Luksemburgut drejtuar Kryeministrit. Të gjitha këto dokumente në esencë dhe ndër të tjera, vënë theks në (i) rëndësinë e trajtimit të shpejtë dhe ndërmarrjes së masave për prandalimin e pandemisë COVID-19, por në të njëjtën kohë, në ekuilibrin midis mbrojtjes së jetës së qytetarëve dhe shëndetit dhe, nga ana tjetër, mbrojtjes së lirisë së qytetarëve dhe nevojave individuale.

Komentet shtesë të parashtruesve të kërkesës lidhur me Vendimet e kontestuara në rastin KO61/20

80. Siç është cekur në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit u kishte dhënë mundësinë të gjitha palëve të interesuara, përfshirë deputetëve të Kuvendit, që të paraqesin komentet e tyre lidhur me përmbajtjen ose meritat e kërkesës, deri më 23 prill 2020, në orën 16:00. Parashtruesit e kërkesës, në cilësi të deputetëve, kanë pranuar shkresën që Gjykata ia ka dërguar Kuvendit dhe kanë vendosur që të përgjigjen në atë shkresë për të dorëzuar sqarime shtesë lidhur me Vendimet e kontestuara.
81. Në komentet shtesë të dorëzuara në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës kanë ri-theksuar se (i) ata nuk e kanë pranuar kërkesën e Gjykatës për sqarime të dorëzuar tek ata, në adresën elektronike të përfaqësueses së tyre, më 19 prill 2020. Ata potencojnë që asnjëherë nuk e kanë pranuar atë shkresë dhe se *“qartazi ka pasur një dështim në trafikun e internetit”*; (ii) se *“siç e kemi theksuar edhe në kërkesë, por edhe siç e kam ritheksuar në emailin tim të fundit, ne parashtruesit e kërkesës për vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së vendimeve të Ministrit të Shëndetësisë (vendimi nr. 238/IV/2020, datë: 14.04.2020, vendimi nr. 229/IV/2020, datë: 14.04.2020, vendimi nr. 214/IV/2020, datë: 12.14.2020 dhe vendimi nr. 239/IV/2020, datë: 14.04.2020 me Kushtetutën e Republikës së Kosovës), asnjëherë nuk kemi kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese për ndonjë vendim apo akt tjetër.”*; (iii) *“dëshmi e specifikimit të*

vetëm katër (4) Vendimeve të cekura që në faqën e parë të kërkesës tonë, është edhe saktësimi i kërkesës dhe pretendimeve tona, kur kemi cituar në tërësi vendimet që përbëjnë lëndën e kësaj kërkesë, vendime me të cilat janë marrë masa të njëjta në tri komuna të ndryshme, dhe me specifika po ashtu të ndryshme, si Komuna e Dragashit e cila nuk e ka regjistruar asnjë rast të prekur me virusin “Covid 19”; dhe (iv) në zbatim të nenit 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, “ne parashtruesit e kërkesës, kemi specifikuar inter alia, se pse katër aktet e cekura në kërkesë pretendojmë të jenë në kundërshtim me Kushtetutën, duke i specifikuar në kërkesë edhe kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara.”

Baza ligjore mbi të cilën janë nxjerrë Vendimet e kontestuara

82. Në vijim, Gjykata do të paraqes përmbajtjen e të gjitha neneve që janë relevante për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve të kontestuara, dhe ato bazuar në të cilat janë nxjerrë Vendimet e kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe, më pas, në pjesën e meritave do të komentojë për secilin prej tyre në dritë të kompetencave e autorizimeve, që të njëjtat i japin kësaj Ministrie për të marrë Vendimet e kontestuara.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kapitulli VI - Qeveria e Republikës së Kosovës

Neni 92

[Parimet e Përgjithshme]

[...]

4.Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 93

[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

[...]

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

[...]

Kapitulli II - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 55

[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Neni 35

[Liria e Lëvizjes]

6. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
7. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
8. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.
9. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
10. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**Neni 2 (Liria e lëvizjes) i Protokollit nr. 4 të KEDNJ**

5. *Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.*
6. *Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.*
7. *Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.*
8. *Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.*

Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Gazeta Zyrtare nr. 7, 1 mars 2019

**KAPITULLI II – ADMINISTRATA SHETETËRORE
NËNKAPITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR
ADMINISTRATËN SHETETËRORE**

Neni 10**[Përgjegjësia për Administratën Shtetërore]**

1. *Ministri është përgjegjës para Qeverisë dhe Kuvendit për veprimtarinë e të gjithë sistemit ministror në fushën e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuar me legjislacionin përkatës.*
2. *Ministri (në vijim: ministri përgjegjës) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e sistemit ministror dhe mbikëqyr veprimtarinë e agjencive në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, në pajtim me këtë ligj.*
3. *Funksionimi i sistemit të përgjegjësisë të ministrit për performancën e sistemit ministror përcaktohet në pajtim me legjislacionin për funksionimin e Qeverisë.*
4. *Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për Zyrën e Kryeministrit lidhur me agjencitë ekzekutive në varësi të tij.*
5. *Fusha e përgjegjësisë shtetërore për çdo ministri, përcaktohet me ligj.*

Neni 11
[Ministria]

- 1. Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave publike, për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë.*
- 2. Ministria është përgjegjëse për të gjitha funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë, përveç nëse nuk u janë deleguar institucioneve të tjera të administratës shtetërore sipas ligjit.*
- 3. Organizimi i ministrisë përfshin ministrinë dhe degët e saj.*

Ligji Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi, Gazeta Zyrtare nr. 13, 7
maj 2013

Neni 12
[Masat dhe veprimet]

- 1. Kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, si në vijim:
[...]*
- 1.11. ndërmarrja e masave për parandalimin dhe eliminimin e pasojave shëndetësore të shkaktuara nga gjendjet emergjente;
[...]*

KREU XIX
KUJDESI SHËNDETËSOR GJATË GJENDJEVE
EMERGJENTE

Neni 89
[Përgjegjësitë e Ministrisë]

- 1. Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.*
- 2. Aktivitetet e kujdesit shëndetësor në rastet e emergjencës nga paragrafi 1. i këtij neni përfshijnë:*
 - 2.1. zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;*
 - 2.2. adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent;*
 - 2.3. zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes;*
 - 2.4. sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët;*
 - 2.5. veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore;*
 - 2.6. aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave.*

3. Gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.

4. Dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht, pavarësisht nga kufizimet që i përcakton paragrafi 3. i këtij neni.

Ligji nr. 02/l-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Gazeta Zyrtare nr. 40, 15 tetor 2008

MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E POPULLSISË NGA SËMUNDJET NGJITËSE

Kapitulli II

Neni 3 [Pa titull]

3.1 Sëmundjet ngjitëse në kuptim të këtij ligji ku parandalimi dhe pengimi i tyre është në interes përvendin janë: [Citohen lista e sëmundjeve]

3.2 Po qe se paraqitet rreziku nga sëmundjet ngjitëse, të cilat nuk gjenden në listën nga paragrafi 1 i këtij neni e që mund të rrezikojnë tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, në propozim të IKSHP përcakton masat profilaktike dhe kundërepidemike, të përshkruara me këtë ligj, masat tjera në mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse dhe masat e përshkruar si të obliguara sipas konventave ndërkombëtare shëndetësore dhe aktet tjera ndërkombëtare.

Neni 4 [Pa titull]

4.1 Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin është detyrë e IKSHP-së, Inspektoratit Sanitar të Kosovës, Inspektoratit Shëndetësorë të Kosovës, të gjithave institucioneve shëndetësore publike dhe private, institucioneve jo shëndetësore, komunave dhe vet qytetarëve nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë. 4.2 Masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse drejtpërdrejt i zbatojnë institucionet shëndetësore dhe profesionistët shëndetësorë konform këtij ligji.

KARANTINA**Neni 33**
[Pa titull]

33.1 Personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga murtaja, variola dhe ethet hemorragjike virale futen në karantinë.

33.2 Kohëzgjatja e mbajtjes së personave nga paragrafi 1 i këtij neni, në karantinë varet nga periudhamaksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse;

33.3 Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, i nënshtrohen kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatëgjithë kohës së karantinës;

33.4 Ministria e Shëndetësisë me propozim të IKSHPK merr vendim për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni;

33.5 Zbatimin e aktvendimit për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, e sigurojnë organet kompetente në nivel të vendit.

**MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E POPULLSISË
NGA SËMUNDJET NGJITËSE****Neni 41**
[Pa titull]

41.1 Për ta mbrojtur vendin nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, ethet e verdha, SARS-i, gripi i shpendëve dhe sëmundjet tjera ngjitëse, merren masat e parashikuara me këtë ligj dhe me konventa ndërkombëtare sanitare dhe me akte tjera ndërkombëtare.

41.2 Për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e kolerës, murtajës, variola vera, etheve hemorragjike virale, etheve të verdha, SARS-it, gripit të shpendëve dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje, si vijon:

- a) Ndalimi i udhëtimit në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjëres nga këto sëmundje;*
- b) Ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara;*
- c) Kufizimi ose ndalimi i qarkullimit të llojeve të veçanta të mallrave dhe të produkteve;*

d) *Pjesëmarrja e detyrueshme e institucioneve shëndetësore, institucioneve të tjera dhe e qytetarëve në luftimin e sëmundjes dhe në shfrytëzimin e objekteve, të pajisjes dhe të mjeteve të transportit me qëllim të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;*

41.3 *Për pjesëmarrjen në zbatimin e masave nga pikat a) deri d) të këtij neni, institucioneve shëndetësore, organizatave të tjera dhe qytetarëve u takon kompensimi adekuat nga organi kompetent.*

Neni 44 **[Pa titull]**

Për zbatimin e kontrollit të parandalimit dhe të luftimit të sëmundjeve ngjitëse, organet e ISK-së përveç masave të theksuara në nenin 41 deri 43 të këtij ligji, kryen edhe këto detyra:

a) *Personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe të tajueseve të bacileve të këtyre sëmundjeve (mikrob-bartësve) t'u ndalojë veprimtarinë në punë dhe në detyra të caktuara, përkatësisht në punët dhe në detyrat ku mund të rrezikojnë shëndetin e personave të tjerë;*

b) *Të ndalojnë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se janë të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse;*

c) *Të ndalojnë tubimin e personave në shkolla, në kinema, në lokalet publike dhe në vendet e tjera publike, derisa të mos kalojë rreziku nga epidemia;*

d) *Të urdhërojnë dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin me qëllim të parandalimit ose të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;*

e) *Të urdhërojnë izolimin e personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe mjekimin e tyre;*

f) *Të urdhërojnë marrjen e masave të tjera të përgjithshme ose të posaçme të parashikuara tekniko-sanitare dhe higjienike.*

Neni 47 **[Pa titull]**

47.1 *Ministria e Shëndetësisë është kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe për miratimin e dispozitave të parapara me të.*

47.2 *Në përputhje me përgjegjësitë nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë dhe detyrë që:*

a) *Organeve kompetente të administratës të Kosovës, t'i japi instruksionet e detyrueshme kur kjo është në interes të mbarë vendit dhe është e domosdoshme për aplikimin unik të dispozitave;*

b) *Në qoftë se organi kompetent i administratës në Kosovë nuk e kryen një punë të caktuar administrative në bazë të autorizimit nga ky ligj, kurse moskryerja e kësaj pune mund të shkaktojë shfaqjen ose*

përhapjen e epidemisë së ndonjë sëmundje ngjitëse, nëpërmjet raportit Ministria e Shëndetësisë e njofton Qeverinë.

Kapitulli VII – Dispozita Ndëshkimore

Neni 53 [Pa titull]

Për kundërvajtje administrative sanitare të parashikuara në bazë të këtij ligji, shqiptohen dënime me gjobë nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës, si vijon:

53.1 Personi fizik dënohet me gjobë prej 1.000€ deri 2.000 €, kurse personi juridik me gjobë prej 3.000€ deri 8.000€:

a) nëse konstaton dhe nuk paraqet sëmundjen, vdekjen nga sëmundja ngjitëse, epideminë, tajimin e shkaktarëve të sëmundjeve të caktuara ngjitëse, bartjen viruseve të hepatitit B dhe C, bartjen e virusit 17 të HIV-it, bartjen e parazitëve të malarjes, lëndimin ngakafsha e tërbuar ose nga kafsha për të cilin dyshohet se është e tërbuar; në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;

b) nëse nuk e bën imunizimin, seroprofilaksën dhe kimioprofilaksën, në pajtim me nenet 28 deri 32, të këtij ligji;

c) nëse nuk i merr masat e parashikuara për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së mëtejme të infeksionit ose masat e tjera më të domosdoshme kundërepidemike dhe higjienike që kushtëzohen nga natyra e sëmundjes;

d) nëse nuk i cakton masat, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse dhe nuk i zbaton masat përkatëse tekniko-sanitare, higjienike dhe të tjera për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse.

53.2 Personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej 500€ deri 1.500€, për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare nr. 20/21, 21 qershor 2016

PJESA III
VEPRIMET ADMINISTRATIVE

KAPITULLI I – AKTI ADMINISTRATIV

**NËNKAPITULLI I – PËRKUFIZIMI, FORMA DHE
ELEMENTET E DETYRUESHME TË AKTIT
ADMINISTRATIV**

Neni 44
[Akti administrativ]

1. *Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe:*
 - 1.1. *u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: “akti administrativ individual”, gjegjësisht “kolektiv”), apo*
 - 1.2. *i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme (në vijim: “akti administrativ i përgjithshëm”), apo*
 - 1.3. *përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku (në vijim: “akti administrativ in rem”).*

Neni 46
[Forma e aktit administrativ]

1. *Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ nxirret në formë të shkruar, verbale apo edhe çdo formë tjetër të përshtatshme, përfshirë shenja apo mjete të tjera teknike.*
2. *Forma e shkruar përmbushet edhe nga një dokument elektronik në pajtim me ligjin e posaçëm që rregullon dokumentin elektronik.*
3. *Me kërkesë, organi publik konfirmon pa vonesë, në formë të shkruar, përmbajtjen e aktit verbal apo aktit të miratuar në heshtje të përcaktuar në nenin 70 të këtij Ligji, pa i paragjykuar rregullat mbi pasojat juridike të akteve administrative. Paragrafi 2 i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.*
4. *Konfirmimi sipas paragrafit 3 të këtij neni, megjithëse nuk është akt administrativ i ri, duhet të jetë në pajtim me nenin 47 të këtij Ligji.*

Neni 47
**[Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit
administrativ të shkruar]**

1. Akti administrativ i shkruar përmban:

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjal.

3. Kërkesa e nënshkrimit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik duhet të bazohet në një certifikatë të kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik përkatës.

4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me vendim të posaçëm, mund të përcaktojë një mënyrë tjetër të sigurt, që garanton autenticitetin dhe integritetin e dokumentit elektronik të dërguar dhe veçantitë e tij. Një dokument elektronik i garantuar në pajtim me një vendim të tillë të Qeverisë, do të vlerësohet, gjithashtu, si i nënshkruar.

Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010

Neni 27
[Pa titull]

1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar aktiadministrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti.

Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

Neni 3

Parimi i ligjshmërisë

- 1. Askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje apo t'i shqiptohet sanksioni kundërvajtës për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës.*
- 2. Në procedurën për kundërvajtje askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë, për të njëjtën kundërvajtje.*
- 3. Përkufizimi i një kundërvajtje duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast të paqartësisë, përkufizimi i kundërvajtjes interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura për kundërvajtje.*

Neni 7

Përcaktimi i kundërvajtjes

- 1. Kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës.*
- 2. Kuvendi i Komunës mund të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje vetëm për shkeljet e akteve të organeve komunale të cilat ata i nxjerrin brenda fushës së kompetencave të tyre.*
- 3. Organi i cili është i autorizuar të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje këtë autorizim nuk mund ta bartë në organe e tjera.*
- 4. Nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, dispozitat për kundërvajtje ndaj personave fizik, zbatohen edhe ndaj personave përgjegjës në personin juridik dhe personave që ushtrojnë veprimtari të pavarur.*

Neni 167

Harmonizimi i dispozitave që nuk janë në pajtim me këtë ligj

Dispozitat për kundërvajtjen që nuk janë në pajtim me këtë ligj, do të harmonizohen brenda afatit prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 170

Pushimi i vlefshmërisë së legjislacionit ekzistues në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë legjislacioni në fuqi për kundërvajtjen.

Rregullorja nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e miratuar në mbledhjen e 3-të të Qeverisë, me Vendimin nr. 01/03 të 19 shkurtit 2020

Neni 4

[Qeveria]

1. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të saj:
 - 2.1. merr vendime me propozimin e anëtarëve të Qeverisë dhe institucioneve të tjera në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
 - 2.2. nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
 - 2.3. diskuton probleme dhe merr vendime për çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të saj;
 - 2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të saj, si dhe
 - 2.5. kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 8

[Ministri]

1. Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri:
[...]

- 1.4. *nxjerr vendime dhe akte nënligjore dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë; dhe [...]*

SHTOJCA 10
[Ministria e Shëndetësisë]

Ministria e Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm: MSH) ka përgjegjësitë si në vijim:

1. *Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, duke i respektuar standardet e rëndësishme ndërkombëtare;*

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

83. *Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.*
84. *Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore sipas të cilave Kuvendi, mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...]

2. *Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*

- (2) *çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.*
[...]

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

KREU III Procedurat e Veçanta

Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 29 [Saktësimi i kërkesës]

- 1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.*
- 2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
- 3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.*

Neni 30 [Afatet]

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese

VII. Dispozita të veçanta për procedura sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit]

- (1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.*
- (2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse*

përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

85. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e akteve të kontestuar, përkatësisht nëse të njëjtat kualifikohen si “*rregullore të qeverisë*”, siç është përcaktuar në paragrafin e lartcekur; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe paragrafëve (2) dhe (3) të Rregullit 67 të Rregullores së Punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit dhe paragrafin (4) të Rregullit 67 të Rregullores së punës.

(i) Lidhur me Palën e Autorizuar

86. Kuvendi, bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës është i autorizuar që para Gjykatës të ngrejë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit; (iii) dekreteve të Kryeministrit; dhe (iv) rregulloreve të Qeverisë. Neni 29 i Ligjit, saktëson që Kuvendi është palë e autorizuar para Gjykatës, nëse kërkesa përkatëse është parashtruar nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit. E njëjta kërkesë është e specifikuar në paragrafin 1 të rregullit 67 të Rregullores së punës. Në rrethanat e rastit konkret, është një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, përkatësisht tridhjetë (30) deputet, të cilët i kontestojnë katër (4) Vendimet e kontestuar të Ministrisë së Shëndetësisë para Gjykatës.
87. Gjykata rikujton që, më 19 prill 2020, bazuar në praktikën e saj të mëparshme, i është drejtuar përfaqësueses së parashtrueseve të kërkesës për të sqaruar mungesën e nënshkrimit të deputetit Gazmend Bytyqi, krahas emrit dhe numrit personal të tij në shkresat e dorëzuara para saj. Më 19 prill 2020, përfaqësuesja e parashtrueseve të kërkesës, ka sqaruar dhe dorëzuar në Gjykatë, nënshkrimin e deputetit përkatës.
88. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se para Gjykatës është një kërkesë e ngritur nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës, përkatësisht tridhjetë (30) deputetë, e të cilët bazuar në nenet e

lartcituar të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, janë palë e autorizuar që të ngrisin para Gjykatës, në mes të tjera, çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën, në rrethanat e rastit konkret, të “*rregulloreve të Qeverisë*”.

(ii) *Lidhur me aktet e kontestuara*

89. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë Vendimet e kontestuara të nxjerra nga Ministra e Shëndetësisë. Gjykata rikujton që ata pretendojnë para Gjykatës, që Vendimet e kontestuara, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kualifikohen si “*rregullore të Qeverisë*”. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! kundërshton këto pretendime. Pretendimet dhe arsyetimet përkatëse janë paraqitur në paragrafët 69-73 të këtij Aktgjykimi.
90. Në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Vendimet e kontestuara mund të kualifikohen si “*rregullore të Qeverisë*”, siç është përcaktuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës.
91. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës, Kuvendi, përkatësisht një e katërta (1/4) e deputetëve të tij, siç është sqaruar më lart, përpos “*ligjeve*” të Kuvendit, “*dekreteve të Presidentit*” dhe “*dekreteve të Kryeministrit*”, janë gjithashtu të autorizuar të ngrenë para Gjykatës çështjen e përputhshmërisë së “*rregulloreve të Qeverisë*” me Kushtetutën.
92. Gjykata në këtë kontekst rikujton që përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së “*dekreteve të Kryeministrit*” dhe “*rregulloreve të Qeverisë*”, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka përcaktuar se përtej terminologjisë të referuar në Kushtetutë, janë “*aktet*” e Kryeministrit dhe të Qeverisë, respektivisht, që mund të jenë objekt shqyrtimi para Gjykatës, në rast se përputhshmëria e tyre me Kushtetutën ngritet para Gjykatës përmes një pale të autorizuar, siç është përcaktuar me Kushtetutë (shih referencat përkitazi me “*akte*” të Kryeministrit e të Qeverisë, në paragrafët 82, 83, 84 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO12/18 dhe paragrafin 46 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO73/16).
93. Më specifikisht, përmes Aktgjykimeve në rastet KO73/16 dhe KO12/18, respektivisht, Gjykata ka përcaktuar se ajo mund të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë edhe të akteve të tjera të Qeverisë dhe të Kryeministrit, përveç “*rregulloreve*” dhe “*dekreteve*”, (i) nëse ato ngrenë “*çështje të rëndësishme kushtetuese*” (shih paragrafin 84 dhe 88 të Aktgjykimit KO12/18); dhe (ii) duke marrë parasysh efektet

juridike që prodhojnë aktet e Kryeministrit e të Qeverisë, pavarësisht emërimit formal të tyre (shih paragrafin 87 të Aktgjykimit KO12/18).

94. Gjykata gjithashtu rikujton se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë nr. 04/20 të 20 dhjetorit 2017, në rastin e Gjykatës KO12/18, ajo iu kishte drejtuar edhe Forumit të Komisionit të Venecias, duke pyetur, ndër të tjera, edhe (i) cilat akte të qeverive mund të kontestohen para gjykatave kushtetuese në sistemet e tyre respektive kushtetuese; dhe (ii) nëse aktet e qeverisë që mund të kontestohen para gjykatave kushtetuese janë të përcaktuara në një listë specifike, dhe/ose kushtetutat dhe ligjet respektive ofrojnë fleksibilitet përkitazi me aktet e qeverive, kushtetutshmëria e të cilave mund të kontestohet para gjykatave kushtetuese. (Shih paragrafët 18 dhe 22 të Aktgjykimit KO12/18). Nga përgjigjet e gjykatave kushtetuese respektive pjesëmarrëse në Forumin e Komisionit të Venecias, dhe gjithashtu duke marrë parasysh dallimet dhe specifikat e kushtetutave përkatëse, rezulton se, në parim, praktikat e tyre përkatëse gjyqësore, përcaktojnë se gjykatat përkatëse kushtetuese, vlerësojnë natyrën e aktit të kontestuar dhe jo domosdoshmërisht vetëm emërtimin formal të tyre. (Shih paragrafët 62-72 të Aktgjykimit KO12/18).
95. Gjykata në këtë kontekst rikujton që (i) në rastin KO12/18, ajo ka shpallur të pranueshme vlerësimin e kushtetutshmërisë së një “vendimi” të Kryeministrit, përkundër faktit që i njëjti nuk ka qenë i emërtuar “dekret”, duke marrë parasysh se në vlerësimin e Gjykatës, vendimi përkatës kishte ngritur “*çështje të rëndësishme kushtetuese*” (shih paragrafët 88 e 90 të Aktgjykimit KO12/18), ndërsa (ii) në rastin KO73/16, ka shpallur të pranueshme vlerësimin e kushtetutshmërisë së një “*Qarkoreje Administrative*”, përkatësisht Qarkores Administrative nr. 01/2016 të 21 janarit 2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike, duke marrë parasysh efektin e saj (shih paragrafët 46, 56 e 58 të Aktgjykimit KO73/16).
96. Kjo praktikë gjyqësore është konfirmuar edhe në rastin e fundit të Gjykatës, respektivisht Aktgjykimin KO54/20, përmes të cilit Gjykata, duke e shpallur të pranueshme kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të 23 marsit 2020 të Kryeministrit, kishte theksuar se (i) në përcaktimin nëse kontestohet një “dekret” i Kryeministrit në kuptim të nënparagrafit 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, “*nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij*” (shih paragrafin 161 të Aktgjykimit KO54/20); dhe (ii) nëse Gjykata do të fokusohet vetëm në emërtimin formal të akteve të kontestuara, përkatësisht “*dekret të Kryeministrit*” apo edhe “*rregullore të Qeverisë*”, vendimmarrja e

Qeverisë, do të ngelej jashtë kontrollit kushtetues, vetëm duke u bazuar në emërtimin të cilin të njëjtat kanë vendosur t'ia përcaktojnë aktit përkatës. (Shih në këtë kontekst, paragrafët 162-163 të Aktgjykimit KO54/20).

97. Gjykata gjithashtu rikujton që përpos referimit në *“dekretin e Kryeministrit”* në nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafët 4 të neneve 92 dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë], respektivisht, i referohen vendimmarrjes së Qeverisë përmes *“vendimeve”*, *“akteve juridike”* dhe *“rregulloreve”* të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Nxjerrja e *“dekreteve”* në kuptim të ushtrimit të kompetencave të Kryeministrit, është e përcaktuar vetëm në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të nenit 6 të Rregullores nr. 50/2020. Në këtë kontekst, dhe siç është sqaruar në Aktgjykimin KO54/20, nëse Gjykata do të kufizohej vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë të *“dekreteve të Kryeministrit”* dhe jo *“vendimeve”* të tij/saj, kjo do të nënkuptonte se vendimmarrja e një Kryeministri, do të ngelej jashtë kontrollit kushtetues dhe se Gjykata, nuk do të mund të shqyrtonte kushtetutshmërinë e asnjë vendimi të Kryeministrit në asnjë formë. E njëjta vlen edhe për *“rregulloret e Qeverisë”*.
98. Për pasojë, vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të Kryeministrit e të Qeverisë, i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj, dhe bazuar në vlerësimin e Gjykatës, sipas praktikës së saj gjyqësore, përkitazi me *“efektet”* e tyre dhe nëse të njëjtat ngrisin *“çështje të rëndësishme kushtetuese”*.
99. Në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës kontestohen vendimet e Ministrit të Shëndetësisë. Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 1 të nenit 92 të Kushtetutës, Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Të njëjtit, bazuar në paragrafin 2 të po të njëjtit nen, ushtrojnë pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se edhe vendimet e Ministrave, i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj, dhe bazuar në vlerësimin e Gjykatës përkitazi me efektin e tyre dhe nëse të njëjtat ngrisin *“çështje të rëndësishme kushtetuese”*. Kjo praktikë gjyqësore është përcaktuar fillimisht përmes rastit të Gjykatës KO73/16.
100. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Vendimet e kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, janë nxjerrë bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 01/24 të 8 prillit 2020, dhe i cili, ka autorizuar Ministrin

e Shëndetësisë, përkatësisht ka deleguar vendimmarrjen e Qeverisë tek Ministri i Shëndetësisë, që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së sëmundjes COVID-19, në zbatim të dispozitave të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, vetëm me *“qëllim të racionalizimit të kohës në procesin e marrjes së vendimeve, në funksion të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së epidemisë së sëmundjes COVID-19”*.

101. Rrjedhimisht, dhe bazuar në sqarimet e dhëna, përfshirë ato të ndërlydhura me praktikën e saj gjyqësore, Gjykata konsideron se Vendimet e kontestuara të Ministrit të Shëndetësisë, hyjnë në fushëveprimin e *“rregulloreve të qeverisë”*, sepse (i) janë akte përmbajtja e të cilave ka efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të Republikës së Kosovës, specifikisht përkritazi me lirinë e tyre të lëvizjes së garantuar përmes nenit 35 të Kushtetutës; dhe (ii) ngrisin *“çështje të rëndësishme kushtetuese”*, e të cilat për pasojë, i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës, duke marrë parasysh, që në rrethanat e rastit konkret, janë ngritur para saj nga një palë e autorizuar.
102. Rrjedhimisht, bazuar në sa më sipër, Gjykata gjithashtu konstaton se Vendimet e kontestuara, kualifikohen si *“rregullore të Qeverisë”*, dhe si të tilla i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës.

(iii) *Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe specifikimin e kundërshtimeve*

103. Gjykata rikujton që neni 29 i Ligjit dhe rregulli 76 i Rregullores së punës, përcaktojnë që (i) kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të specifikojë (i) nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
104. Kërkesa e parashtrueseve të kërkesës e dorëzuar më 17 prill 2020, ka përcaktuar se para Gjykatës kontestojnë dhe kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme të Vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, si në vijim: (i) nr. 238/IV/2020, datë: 14.04.2020; (ii) nr.229/IV/2020, datë: 14.04.2020; (iii) nr. 214/IV/2020, datë: 12.04.2020; dhe (iv) nr. 239/IV/2020, datë: 14.04.2020. Megjithatë, përmbajtja e kërkesës së dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, i është referuar edhe të gjitha vendimeve të tjera, përkatësisht tridhjet e tetë (38) sosh, të Ministrit të Shëndetësisë të nxjerra më 14 prill 2020. (Shih në këtë kontekst, gjithashtu paragrafët 15 të këtij Aktgjykimi).

105. Bazuar në paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe paragrafët (2) dhe (3) të rregullit 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit) të Rregullores së punës, Gjykata, më 19 prill 2020, ka kërkuar nga parashtruesit e kërkesës të sqarojnë para Gjykatës nëse kontestojnë vetëm (i) katër (4) Vendimet e lartcekura të Ministrisë së Shëndetësisë; apo (ii) kontestojnë të gjitha Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë të nxjerra për të gjitha komunat e Kosovës më 14 prill 2020. Përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës, nuk i është përgjigjur Gjykatës në afatin e përcaktuar nga kjo e fundit. Gjykata më tej, në të njëjtën datë, ka njoftuar të gjitha palët për regjistrimin e kërkesës, siç është sqaruar në procedurën para Gjykatës, duke i njoftuar edhe për korrespondencën me përfaqësuesen e parashtruesve të kërkesës lidhur me kërkesën për qartësimin e lartcekur, nëse përtej katër (4) Vendimeve të kontestuara, kontestohen edhe Vendimet e tjera të Ministrisë së Shëndetësisë të nxjerra më 14 prill 2020.
106. Duke marrë parasysh mungesën e përgjigjes nga përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës në afatin e përcaktuar nga Gjykata, kjo e fundit konstaton se para saj, kontestohet kushtetutshmëria e katër (4) Vendimeve të lartcituara të Ministrisë së Shëndetësisë.
107. Në shkresën e dorëzuar në Gjykatë, pas shkresës së Gjykatës të 19 prillit 2020, të dërguar deputetëve të Kuvendit për komentet e tyre përkitazi me meritat e kërkesës, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës, në shkresën e 23 prillit 2020, ka theksuar se këta të fundit para Gjykatës, kontestojnë dhe kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme dhe vlerësimin e meritave vetëm përkitazi me katër (4) Vendimet e kontestuara.
108. Më tej dhe në kontekst të saktësimit të kërkesës, Gjykata vëren se bazuar në parashtruesin e dorëzuar në Gjykatë më 23 prill 2020, Kryeministri, në emër të Qeverisë, përmes shkresës edhe e cila është paraqitur e plotë në paragrafin 28 të këtij Aktgjykimi, ndër të tjera, pretendon se (i) *“praktika e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpërfaq faktin se refuzimi për qartësim, saktësim apo plotësim të kërkesës së dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese konsiderohet si shkak për refuzim të kërkesës në procedurë të shkrutër, për shkak se pala nuk i ka plotësuar kriteret procedurale për shqyrtim të mëtutjeshëm”*; (ii) *“për këtë arsye, në të gjitha rastet kur pala nuk e ka qartësuar, saktësuar apo plotësuar kërkesën, Gjykata e ka refuzuar kërkesën në procedurë të shkurtër në përputhje me Rregullin 35 paragrafi 5 dhe as nuk e ka njoftuar autoritetin, vendimi i të cilit kontestohet. Për ne, refuzimi për të zbatuar rregullat e vendosura nga vet Gjykata Kushtetuese në rrethanat e rastit konkret, është shqetësim serioz në lidhje me profesionalizmin dhe*

paanshmërinë e Gjykatës"; dhe (iii) "për të vërtetuar pretendimin tonë, ju lutem shihni vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet Nr.KI72/19; Nr.KI89/18; Nr.KI121/18; Nr.KI74/18; Nr.KI04/18; Nr.KI89/19; Nr.KI130/17; Nr.KI48/17; Nr.KI109/16; Nr.KI71/16, Nr.KI94/15, në të cilat, Gjykata i ka refuzuar në procedurë të shkurtër, pa e njoftuar asnjë autoritet publik, kërkesat të cilat nuk specifikonin cili akt i autoritetit publik po kontestohet dhe më pas nuk i janë përgjigjur Gjykatës për të plotësuar kërkesës. Jemi të vetëdijshëm se bëhet fjalë për kërkesa individuale, por Rregulli 35.5 nuk përbën përjashtim as në rastin e kërkesave të adresuara nga organet kushtetuese". Komentet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, gjithashtu pretendojnë para Gjykatës, që kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në procedurë të shkurtër në përputhje me paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së Punës.

109. Në lidhje me pretendimet e Kryeministrit se Gjykata është e detyruar të refuzojë kërkesën e parashtruesëve të kërkesës bazuar në Rregullin 35 (5) të Rregullorës së punës, Gjykata thekson si në vijim: (i) paragrafi (5) i Rregullit 35 të Rregullores së punës, i përcakton Gjykatës mundësinë për të refuzuar një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë, dhe përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, e njëjta nuk e ka bërë një gjë të tillë. Bazuar në këtë rregull, Gjykata refuzon me procedurë të shkurtër të gjitha ato kërkesa në të cilat nuk është specifikuar akti i kontestuar i autoritetit publik, dhe kur ky akt, nuk është saktësuar para Gjykatës, edhe përkundër kërkesave të kësaj të fundit; dhe (ii) se rastet e referuara nga Kryeministri në parashtrësën e lartcekur të drejtuar Gjykatës janë të gjitha, pa përjashtim, raste në të cilat parashtruesit përkatës nuk kanë specifikuar **asnjë** akt të një autoritetit publik para Gjykatës, dhe të cilët, nuk e kanë bërë një gjë të tillë, as pas kërkesave specifike të Gjykatës. Kjo me përjashtim të rastit KI89/19, dhe i cili në fakt është rast bashkuar, nr. KI86/19, KI87/19, KI88/19, KI89/19, KI90/19 dhe KI91/19, dhe i cili, nuk është refuzuar me procedurë të shkurtër siç pretendon parashtrësja përkatëse, por është shpallur i papranueshëm si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese përmes Aktvendimit për Papranueshmëri të datës 18 shkurt 2020.
110. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti dhe se rastet e cekura nga Kryeministri, dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, sepse të njëjtat, siç u sqarua më lart, para Gjykatës nuk kanë kontestuar **asnjë** akt të një autoriteti publik. Për dallim, kërkesa e parashtruesëve të kërkesës e dorëzuar në Gjykatë me 18 prill 2020, ka saktësuar specifikisht se para Gjykatës kontestojnë Vendimet në vijim

(i) nr. 238/IV/2020, datë: 14.04.2020; (ii) nr. 229/IV/2020, datë: 14.04.2020; (iii) nr. 214/IV/2020, datë: 12.04.2020; dhe (iv) nr.239/IV/2020, datë: 12.04.2020, dhe përkitazi me të njëjtat kërkohet vendosja e masës së përkohshme.

111. Por, siç është sqaruar më lart, duke marrë parasysh që në përmbajtje dhe arsyetim të kërkesës, parashtruesit e kërkesës i janë referuar edhe tridhjet e pesë (35) Vendimeve të tjera të Ministrisë së Shëndetësisë të datës 14 prill 2020, Gjykata ka kërkuar nga parashtruesit e kërkesës të sqarojnë nëse para Gjykatës i kontestojnë (i) vetëm katër (4) Vendimet e lartcekura të Ministrisë së Shëndetësisë, apo (ii) të gjitha vendimet e nxjerra më 14 prill 2020 nga Ministria e Shëndetësisë për qëllime të parandalimit dhe luftimit të pandemisë. Në mungesë të një sqarimi nga parashtruesit e kërkesës brenda kohës së përcaktuar nga Gjykata, Gjykata ka konstatuar se kërkesa e parashtrueseve është e kufizuar vetëm në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së katër (4) Vendimeve të lartcekura.
112. Thënë këtë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë katër (4) Vendime të Ministrit të Shëndetësisë, dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueseve të kërkesës (i) specifikon aktin e kontestuar që konsideron të jetë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) specifikon kundërshtimet e ngritura rreth kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 29 të Ligjit dhe rregullin 76 të Rregullores së punës.

(iv) Lidhur me afatin

113. Gjykata rikujton që neni 30 i Ligjit dhe rregulli 76 i Rregullores së punës, përcaktojnë që kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të dorëzohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.
114. Gjykata thekson se Vendimet e kontestuar të Ministrisë së Shëndetësisë janë nxjerrë me 12 dhe 14 prill 2020, respektivisht, ndërsa janë kontestuar para Gjykatës më 17 prill 2020, dhe rrjedhimisht, janë dorëzuar në Gjykatë brenda afateve të përcaktuara përmes dispozitave të lartcituara.

(v) Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

115. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës: (i) janë palë e autorizuar para Gjykatës; (ii) kontestojnë akte të cilat kanë të drejtë t'i kontestojnë; (iii) kanë specifikuar se cilat akte i kontestojnë në tërësinë e tyre; (iv) kanë paraqitur kundërshtimet kushtetuese

kundrejt akteve të kontestuara; dhe, (v) kanë kontestuar aktet përkatëse brenda afatit të përcaktuar.

116. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

117. Gjykata fillimisht rikujton që parashtuesi i kërkesës, respektivisht një e katërta (1/4) e Kuvendit, pretendon se Vendimet e kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, janë në kundërshtim me nenet 35 [Liria e Lëvizjes] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
118. Gjykata rikujton që para Gjykatës kontestohen (i) Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë i datës 12 prill 2020 për shpalljen “zonë karantinë” për komunën e Prizrenit; dhe (ii) vetëm tre (3) nga tridhjet e tetë (38) Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë të nxjerra më 14 prill 2020 për të gjitha Komunitetet e Kosovës. Parashtuesit e kërkesës pretendon që katër (4) Vendimet e kontestuara: (i) kufizojnë të drejtën e lëvizjes së qytetarëve në kundërshtim me nenet 35 e 55 të Kushtetutës, përtej autorizimeve ligjore, përkatësisht atyre të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, sepse kufizimet përkatëse në lirinë e lëvizjes nuk janë të “përcaktuara me ligj”, nuk ndjekin një “qëllim legjitim”, nuk janë proporcionale sepse nuk janë kufizuar deri në masën e domosdoshme; dhe rrjedhimisht as nuk janë të “domosdoshme në një shoqëri demokratike”; dhe (ii) është në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO54/20. Në anën tjetër, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! i kundërshton këto pretendime. Ndërsa, Avokati i Popullit, në esencë pohon se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO54/20 (i) është zbatuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe se Vendimet e kontestuara janë të “përcaktuara në ligj”, por duke e lënë të hapur çështjen e proporcionalitetit të tyre; dhe (ii) nuk është zbatuar nga ana e Kuvendit.
119. Gjykata në këtë drejtim thekson se çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tyre, të njëjtat kanë “ndërhyrë” përkatësisht, kufizuar të drejtën e lëvizjes të garantuar përmes nenit 35 të Kushtetutës në kundërshtim me nenin 55 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin KO54/20. Në këtë kontekst, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve të

kontestuar, Gjykata bazuar në nenin 55 të Kushtetutës, praktikën e saj gjyqësore, përfshirë Aktgjykimin KO54/20, dhe atë të GJEDNJ-së në kontekst të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, do të vlerësojë nëse “*ndërhyrjet*”, dhe të cilat nuk janë kontestuese në rrethanat e rastit, në lirinë e lëvizjes së qytetarëve në rajonet e afektuara, përkatësisht komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, (i) janë të “*përcaktuara në ligj*”, përkatësisht në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; (ii) ndjekin një “*qëllim legjitim*”; dhe (iii) janë të “*domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.

120. Para vlerësimit të lartcekur, Gjykata rikujton që Vendimi paraprak i Qeverisë përkitazi me kufizimet në të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë si rezultat i pandemisë COVID-19, përkatësisht Vendimi [nr. 01/15] i 23 marsit 2020, u shpall në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht nenin 55 në lidhje me nenet 35, 36 dhe 43 të saj në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 4 dhe nenet 8 dhe 11 të KEDNJ-së.
121. Në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata, për aq sa është relevante edhe për rrethanat e këtij rasti, ka sqaruar (i) dallimin në mes nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] dhe 55 të Kushtetutës, respektivisht “*shmangies*” dhe “*kufizimit*” të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih paragrafët 184 deri më 188 të Aktgjykimit në rastin KO54/20); (ii) strukturën e nenit 55 të Kushtetutës dhe testin kushtetues që i njëjti ngërthen përkitazi me vlerësimin e kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih paragrafët 189 deri më 198 të Aktgjykimit në rastin KO54/20) dhe raportin e këtij neni me nenin 35 të Kushtetutës (shih paragrafin 201 të Aktgjykimit në rastin KO54/20); (iii) parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, përkitazi me vlerësimin e “*përcaktueshmërisë me ligj*” të një “*ndërhyrje*” në të drejtat dhe liritë themelore (shih paragrafët 208 deri më 221 të Aktgjykimit në rastin KO54/20); dhe (iv) përmbatjen dhe autorizimet që ngërthejnë, në veçanti nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse (shih paragrafin 227 deri më 273 të Aktgjykimit në rastin KO54/20). Gjykata, përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Vendimeve të kontestuar, do t’i referohet sqarimeve të lartcekura, për aq sa është e nevojshme për rrethanat e rastit konkret.
122. Thënë këtë, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit paraprak, përkatësisht Aktgjykimin KO54/20, duke marrë parasysh konstatimin e Gjykatës se “*ndërhyrjet*”, përkatësisht kufizimet në të drejtat dhe liritë përkatëse përmes Vendimit të kontestuar, nuk ishin “*të*

përcaktuara në ligj”, kishte ndaluar analizën kushtetuese në pjesën e parë të testit jokumulativ që ngërthen neni 55 i Kushtetutës dhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së. Në rrethanat e këtij rasti, për aq sa është e nevojshme dhe varësisht prej vlerësimeve të Gjykatës përkitazi me *“përcaktueshmërinë me ligj”* të *“ndërhyrjeve”* përkatëse, Gjykata gjithashtu do të shtjellojë edhe parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së përkitazi me *“qëllimin legjitim”* dhe *“domosdoshmërinë në shoqëri demokratike”*, përfshirë proporcionalitetin, duke i aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

123. Për më tepër, duke qenë se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rrethanat e rastit konkret ndërlidhen vetëm me nenin 35 të Kushtetutës, Gjykata në shtjellimin, aplikimin dhe vlerësimin e *“ndërhyrjes”* në të drejtën e lirisë së lëvizjes përmes Vendimeve të kontestuara, do t’i referohet praktikës së konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me interpretimin e nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, dhe e cila përkundër faktit që ende nuk është e plotësuar me raste që ndërlidhen me kufizimet e lirisë së lëvizjes si pasojë e pandemisë COVID-19, është e mjaftueshme në aspekt të parimeve të përgjithshme dhe mënyrës së aplikimit të tyre përkitazi me *“përcaktueshmërinë me ligj”*, *“qëllimin legjitim”*, *“proporcionalitetin”* dhe *“domosdoshmërinë në shoqëri demokratike”*.
124. Gjithashtu, njëjtë si në rastin KO54/20, Gjykata thekson se përveç nenit 35 të Kushtetutës që është ngritur nga parashtruesit e kërkesës në rrethanat e këtij rasti, nuk përjashtohet mundësia që përkitazi me Vendimet e kontestuara, të jetë i aplikueshëm edhe ndonjë kufizim tjetër i lirive dhe të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, varësisht nga mënyra se si zbatohen Vendimet e kontestuara dhe varësisht nga pasojat juridike që personat (fizikë dhe juridikë) mund të pësojnë ose jo, si rezultat i zbatimit të tyre. (Shih gjithashtu paragrafin 204 të Aktgjykimit në rastin KO54/20).
125. Si rrjedhojë, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata në vijim do të vlerësojë (i) *“përcaktueshmërinë me ligj”* të *“ndërhyrjes”* përmes Vendimeve të kontestuara, në të drejtën e lirisë së lëvizjes për qytetarët e komunave të Prizrenit, Dragashit, dhe Istogut, respektivisht; dhe në rast të një konstatimi afirmativ, do të vazhdojë më vlerësimin e (ii) *“qëllimit legjitim”* të ndjekur përmes *“ndërhyrjes”* përkatëse; dhe gjithashtu në rast të një konstatimi afirmativ, do të vazhdojë me vlerësimin e (iii) *“domosdoshmërisë në shoqëri demokratike”* të të njëjtës *“ndërhyrje”*.

II. Përputhshmëria e Vendimeve të kontestuara me nenin 35 dhe 55 të Kushtetutës

126. Gjykata rikujton që para saj kontestohen katër (4) Vendime të Ministrisë së Shëndetësisë. Ai i datës 12 prill 2020, përkatësisht Vendimi [nr. 214/IV/2020] për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, dhe tre të tjera, ato të datës 14 prill 2020, përkatësisht Vendimet [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020] [nr. 239/IV/2020] “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht.
127. Vendimi i 12 prillit 2020 për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, përcakton që (i) komuna e Prizrenit shpallet zonë karantinë sepse “*banorët e kësaj komune dyshohen që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejt me personat e infektuar me coronavirus COVID 19*”; (ii) shpallë fshatin Skorobisht vatër të përhapjes së Infeksionit; (iii) ndalon hyrjet dhe daljet në këtë komunë; (iv) obligon të gjithë banorët e Prizrenit të respektojnë masat sipas udhëzimeve të IKSHPK-së; dhe (v) përcakton hyrjen në fuqi të tij në po të njejtën datë.
128. Tri (3) Vendimet tjera, përkatësisht ato të datës 14 prill 2020, për “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, kanë përmbajtje identike. Kjo me një përjashtim, siç është sqaruar më lart, të një pike shtesë, përkatësisht pikës II, që është e aplikueshme vetëm për Prizrenin. Për thjeshtësi të leximit, Gjykata në vijim do të analizojë përmbajtjen e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Dragashit dhe Istogut, respektivisht, dhe vetëm do të saktësojë aty ku ka dallime përkitazi me Vendimin [nr. 229/IV/2020], “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit.
129. Këto Vendime, nga data 15 prill 2020: (i) ndalojnë qarkullimin e personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat përkatëse, siç është përcaktuar në pikën I; (ii) ndalojnë qarkullimin e automjeteve në komunat përkatëse, siç është përcaktuar në pikën II, përkatësisht III për Prizrenin; (iii) përcaktojnë kushtet që duhet plotësuar për personat fizikë gjatë qarkullimit të lejueshëm, siç është

përcaktuar në pikën III, përkatësisht IV për Prizrenin; (iv) përcaktojnë gjobat që shqiptohen në rast të mosrespektimit të masave të përcaktuara në Vendimet përkatëse, siç është përcaktuar në pikën IV, përkatësisht V për Prizrenin; (v) përcaktojnë hyrjen në fuqi të Vendimit dhe vlefshmërinë e tij deri më 4 maj 2020, siç është përcaktuar në pikën V, përkatësisht VI për Prizrenin; (vi) reflektojnë mundësinë e rishqyrtimit të tij deri më 30 prill 2020, siç është përcaktuar në pikën VI, përkatësisht VII për Prizrenin; dhe (vii) përcaktojnë mundësinë e Ministrisë së Shëndetësisë që në bazë të analizimit të situatës epidemiologjike të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara, siç është përcaktuar në pikën VII, përkatësisht VI për Prizrenin.

130. Përkitazi me ndalimin e qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat përkatëse të përcaktuar përmes pikën I të Vendimeve të kontestuara, këto të fundit, mundësojnë qarkullimin e të njejtëve *“vetëm për 1 orë e gjysmë në ditë, sipas orarit të përcaktuar javor në bazë të shifrës së parafundit të numrit të tyre personal”*, për arsyet e përcaktuara në pikën a) dhe c), duke e ndaluar shoqërimin gjatë ushtrimit të kësaj të drejte në mënyrën e përcaktuar në pikën b) dhe duke ndaluar *“rreptësishtë”* daljen nga shtëpitë/banesat për çfarëdo arsye tjetër përveç për arsyet e lartcekura, *“duke përfshirë në këtë ndalim takime shoqërore, vizita familjare”*, siç është përcaktuar në pikën k).
131. Ndalesat e lartcekura gjithashtu përcaktojnë përjashtimet përkatëse përkitazi me (i) mundësinë e shoqërimit; (ii) mundësinë e lëvizjes përtej afatit një orë e gjysmë gjatës ditës; (iii) rastet e dhunës familjare; (iv) personat mbi moshën 65 vjeçare; dhe (v) operatorët ekonomik dhe institucionet përkatëse.
132. Përkitazi me kategorinë e parë, Vendimet e kontestuara përcaktojnë mundësinë e shoqërimit gjatë orarit të lejuar, për personat me aftësi të kufizuara, personat nën moshën 16 vjeçare, dhe kafshët shtëpiake, sipas kushteteve të përcaktuara në nënpikat 1, 2, dhe 3 të pikës a). Përkitazi me kategorinë e dytë, Vendimet e kontestuara përcaktojnë mundësinë e lëvizjes (i) për nevoja të trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor, siç është përcaktuar në pikën g); (ii) në raste ku dalja nga shtëpia/banesa është e domosdoshme për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, siç është përcaktuar në pikën h); dhe (iii) në raste të vdekjes, vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit/ës, siç është përcaktuar në pikën j). Përkitazi me kategorinë e tretë, Vendimet e kontestuara përcaktojnë përjashtimin nga ndalimi i qarkullimit në raste të viktimave të dhunës familjare, siç është përcaktuar në pikën j). Përkitazi me kategorinë e katërt, Vendimet e

kontestuarra edhe pse mundësojnë lirinë e lëvizjes së personave mbi moshën 65 vjeçare gjatë orarit të përcaktuar përmes Vendimeve të kontestuarra, megjithatë rekomandojnë që një mundësi e tillë të shfrytëzohet vetëm në raste urgjente dhe kur është e domosdoshme, siç është përcaktuar në pikën d). Në fund dhe përkitazi me kategorinë e pestë, Vendimet e kontestuarra, gjithashtu mundësojnë lëvizjen e personave për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë apo institucioneve përkatëse, në rastet dhe kushtet e përcaktuara përmes pikave e) dhe f).

133. Përkitazi me ndalimin e qarkullimit të automjeteve në komunat përkatëse siç është përcaktuar përmes pikës II, përkatësisht pikës III për Prizrenin, të Vendimeve të kontestuarra, këto të fundit, ndalojnë qarkullimin e të gjitha automjeteve, megjithatë duke përcaktuar përjashtimet përkatëse përkitazi me (i) operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara, siç është përcaktuar në pikën a); dhe (ii) kryerjen e detyrave zyrtare, siç është përcaktuar në pikën d) dhe f). Gjithashtu, në kuptim të ndalimit të qarkullimit të automjeteve, Vendimet e kontestuarra përcaktojnë përjashtime specifike përkitazi me (i) bujqit dhe punonjësit në ferma, siç është përcaktuar në pikat b) dhe c); dhe (ii) mediet, personat me aftësi të kufizuara, rastet e nevojës për trajtim mjekësor, kryerjen e nevojave esenciale, e pjesëmarrjen në varrime, siç është përcaktuar në pikat l), h), e), i), dhe j), respektivisht.
134. Siç është theksuar më lart, Vendimet e kontestura përcaktojnë (i) afatin kohor për të cilin vlejnë ndalesat e lartcekura, përkatësisht deri më 4 maj 2020; (ii) mekanizmin për rishqyrtimin e tyre, jo më vonë së deri më 30 prill 2020, në konsultim me IKSHPK-në, ekspertët dhe ministrinë e tjera të linjës; dhe (iii) mundësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, që bazuar në analizimin e situatës epidemiologjike dhe pas konsultave paraprake, të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.
135. Gjykata gjithashtu thekson se për dallim nga Vendimet e kontestuarra përkitazi me komunat e Dragashit dhe të Istogut, Vendimi [nr.229/IV/2020] për komunën e Prizrenit, përmban një pikë shtesë, pikën II dhe përmes së cilës, në kuptim të ndalimit të qarkullimit të automjeteve, gjithashtu nga data 15 prill 2020, ndalohen hyrjet-daljet në komunën e Prizrenit, me përjashtim të (i) transportit të mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zingjirit të furnizimit, siç është përcaktuar në pikën a); (ii) punëtorëve përkatës nga operatorët ekonomik dhe të cilëve u është lejuar lëvizja, përveç në zonat e shpalluar vatër e përhapjes së infeksionit, siç është përcaktuar në pikën b); (iii) bujqit dhe fermerët në kushtet e përcaktuar në pikën c); kryerjen e detyrave zyrtare, siç është përcaktuar në pikën d); rastet

e lejeve të qarkullimit, siç është përcaktuar në pikën e); dhe raste urgjente të shëndetësisë, siç është përcaktuar në pikën f).

136. Gjykata gjithashtu vëren se Vendimet e kontestuara, përmbajnë arsyetim identik. Ky arsyetim, përtej përshkrimit faktik që ndërlidhet me (i) nxjerrjen e Vendimit të Qeverisë nr. 01/07 të datës 11 mars 2020; (ii) nxjerrjen e Vendimit të Qeverisë nr. 01/15 të 23 marsit 2020; dhe (iii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO54/20, “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lëvizjes e të specifikuara në Vendimet e kontestuara i arsyeton, duke u bazuar në (i) paragrafin 2 të nenit 41 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse; dhe (ii) propozimin e IKSHPK-së të datës 12 prill 2020 e cila “*konsideron se infeksioni është përhapur në atë komunë apo e njëjta konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar*”.
137. Bazuar në sqarimet e lartcekura përkitazi me përmbajtjen e Vendimeve të kontestura, Gjykata në vijim, do të shqyrtojë nëse “*ndërhyrja*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes është e “*përcaktuar me ligj*” fillimisht përkitazi me (i) Vendimet, [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] e 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, së bashku, duke marrë parasysh përmbajtjen identike të tyre; dhe më pas (ii) Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, duke marrë parasysh dallimin e tij me tri Vendimet e lartcekura.
 1. **Vlerësimi i kushtetushmërisë së Vendimit [nr. 229/IV/2020], Vendimit [nr. 238/IV/2020] dhe Vendimit [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës” së Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht**
 - (i) Nëse “*ndërhyrja*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes është e “*përcaktuar me ligj*”
138. Gjykata fillimisht rikujton që në Aktgjykimin KO54/20, ka sqaruar parimet përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përkitazi me vlerësimin nëse “*ndërhyrja*”, përkatësisht kufizimi i një të drejtë, është “*e përcaktuar me ligj*” (shih paragrafët 208 deri më 211 të Aktgjykimit në rastin KO54/20).

139. Siç është sqaruar në Aktgjykimin KO54/20, emëruesi i përbashkët i kriterëve të nevojshme për vlerësimin e “*përcaktueshmërisë me ligj*”, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, rezulton të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) “*ndërhyrja*” në një të drejtë dhe liri themelore duhet të ketë bazë ligjore; (ii) ligji përkatës, duhet të ketë cilësinë e duhur, përkatësisht, dhe në parim, duhet të jetë i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’u mundësuar qytetarëve të rregullojnë sjelljen e tyre; këta të fundit duhet të jenë në gjendje, nëse kanë nevojë me këshilla të përshtatshme, për të parashikuar, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat e caktuara, pasojat të cilat mund t’i sjellë një veprim i caktuar; (iii) saktësia dhe preciziteti i ligjit janë të nevojshme, por gjithashtu mund të rezultojnë në “*ngurtësi të tepërt*”, prandaj i njëjti duhet gjithashtu të ketë të mundur t’i përshtatet rrethanave të ndryshueshme, dhe i takon institucioneve përkatëse, gjykatave respektivisht, që të bëjnë interpretimin e tij; dhe (iv) në çështjet që afektojnë të drejtat dhe liritë themelore do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit, që diskrecioni ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehet në termat e një pushteti të papenguar. Si pasojë, “*ligji*” duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushën e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë*, kërkesa nr.37553/05, Aktgjykim i 15 tetorit 2015, paragrafët 108-110 dhe referencat e cituara aty; *Navalnyy kundër Rusisë*, kërkesat nr. 29580 dhe 4 të tjera, Aktgjykim i 15 nëntorit 2018, paragrafët 115-119 dhe referencat e cituara aty; *Tommaso kundër Italisë*, kërkesa nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty; dhe *Khlyustov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 11 tetorit 2013, paragrafët 68, 69 dhe 70 dhe referencat e përdorura aty).
140. Bazuar në sqarimet e lartcekura, dhe për të vlerësuar nëse Vendimet e kontestuara, plotësojnë kriterin e “*përcaktueshmërisë me ligj*”, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse në nxjerrjen e Vendimeve të kontestuara, përmes të cilit është “*ndërhyrë*” në lirinë e lëvizjes së qytetarëve të komunave të afektuara, të garantuar përmes nenit 35 të Kushtetutës, Qeveria është bazuar në autorizimet ligjore të dhëna me ligj të Kuvendit, përkatësisht Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
141. Gjykata rikujton që Vendimet e kontestuara janë nxjerrë mbi bazën vijuese ligjore (shih pjesën “Baza ligjore mbi të cilën janë nxjerrë Vendimet e kontestuara” pas paragrafit 82 të këtij Aktgjykimi, ku ceket përmbajtja e të gjitha neneve vijuese; shih po ashtu paragrafët 42-47 ku citohen Vendimet e kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe përmbajtja e tyre): (i) paragrafi 2 i nenit 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të

Aplikueshëm] të Kushtetutës; (ii) neni 10 (Përgjegjësia për administratën shtetërore) dhe neni 11 (Ministria) i Ligjit nr. 6/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavaruara; (iii) paragrafi 1.11 i nenit 12 (Masat dhe veprimet) dhe neni 89 (Përgjegjësitë e Ministrisë) i Ligjit për Shëndetësi; (iv) paragrafi 1.4 i nenit 8 (Ministri) dhe paragrafi 1 i Shtojcës 10 të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive; (v) nenet 3, 4, 33, 41, 44, 47 dhe 53 [pa tituj] të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; (vi) nenet 44 (Akti administrativ), 46 (Forma e aktit administrativ) dhe 47 (Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejme Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative); (vii) neni 27 [pa titull] i Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative; (viii) Vendimi i Qeverisë nr. 01/11 i datës 15 mars 2020; dhe (ix) Aktgjykimi KO54/20.

142. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se (i) paragrafi 2 i nenit 145 të Kushtetutës, përcakton se legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me të njëjtën, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë. Gjykata vëren se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse ka hyrë në fuqi më 15 maj 2008, dhe rrjedhimisht para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, megjithatë, nuk është kontestuese se ky ligj është në fuqi dhe i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret; (ii) nenet 10 e 11 të Ligjit nr. 6/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavaruara, përcaktojnë, ndër të tjera, çështje që ndërlidhen me përgjegjësinë e një Ministri para Qeverisë e Kuvendit, fushëveprimin e veprimtarisë së tij dhe përgjegjësinë për të gjithë sistemin ministror brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë, megjithatë, asnjëra prej këtyre dispozitave të referuara nuk janë relevante për të vlerësuar *“përcaktueshmërinë me ligj”* të *“ndërhyrjes”* në të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë; (iii) në Aktgjykimin KO54/20, Gjykata ka vlerësuar relevancën e paragrafit 1.11 të nenit 12 dhe nenin 89 të Ligjit për Shëndetësi, duke konstatuar se të njëjtit, nuk i japin Qeverisë, në rrethanat e rastit konkret, as Ministrisë së Shëndetësisë, autorizimin për të *“ndërhyrë”* në të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, siç është bërë përmes Vendimeve të kontestuara (shih paragrafët 274-288 të Aktgjykimit KO54/20); (iv) ngjashëm, paragrafët 1.4 të nenit 8 dhe paragrafit 1 të Shtojcës 10 të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, përcaktojnë mundësinë e Ministrit

përkatës për të *“nxjerr vendime dhe akte nënligjore në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë”* dhe kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë për, ndër tjerash, përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore dhe miratimin e akteve nënligjore, por të njëjtat, nuk përmbajnë autorizimin për të *“ndërhyrë”* në të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, siç është bërë përmes Vendimeve të kontestuara; (v) nenet 3, 4, 33, 41, 44, 47 dhe 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse janë relevante për vlerësimin nëse *“ndërhyrjet”* në të drejtat dhe liritë themelore përmes Vendimeve të kontestura të Ministrisë së Shëndetësisë, janë të *“përcaktuara në ligj”*. Gjykata rikujton që përmbajten e neneve 41, 44 dhe 47 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, e ka sqaruar në Aktgjykimin KO54/20 (shih paragrafët 227-273 të Aktgjykimit KO54/20), ndërsa nenet 3, 4 dhe 53 të këtij ligji do t'i analizojë në vijim në kontekst të vlerësimit të *“përcaktueshmërisë me ligj”*, përderisa nenin 33, do ta shqyrtojë në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Vendimit të 12 prillit 2020 për shpalljen e komunës së Prizrenit *“zonë karantinë”*; (vi) nenet 44, 46 dhe 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 27 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, përcaktojnë llojet e aktit administrativ, formën e strukturën e tij dhe afatet për paditë përkatëse, respektivisht, megjithatë, të njëjtat nuk përmbajnë autorizimin për të *“ndërhyrë”* në të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, siç është bërë përmes Vendimeve të kontestuara. Thënë këtë, Gjykata do të marrë parasysh nenin 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në lidhje me nenin 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në vlerësimin e *“përcaktueshmërisë me ligj”* të *“ndërhyrjes”* në të drejtat dhe liritë themelore; ndërsa (vii) Vendimi i Qeverisë nr. 01/11 i 15 marsit 2020, i delegon Ministrisë së Shëndetësisë kompetencën e vendimarrjes përkitazi me parandalimin dhe luftimin e pandemisë, por nuk është relevant në vlerësimin nëse Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse ia përcakton Ministrisë së Shëndetësisë autorizimin për të *“ndërhyrë”* në të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë. Siç është sqaruar në Aktgjykimin KO54/20, një autorizim i tillë mund t'i bartet pushtetit ekzekutiv vetëm përmes ligjit të miratuar nga Kuvendi.

143. Prandaj, Gjykata konsideron që relevante për të vlerësuar *“përcaktueshmërinë me ligj”* të *“ndërhyrjes”* në lirinë e lëvizjes së garantuar përmes nenit 35 të Kushtetutës, përmes Vendimeve të kontestuara, janë nenet 3, 4, 41, 44 e 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Në kontekst të këtyre neneve, dhe neneve 35 e 55 të Kushtetutës, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe

asaj të Gjykatës, me theks të veçantë, në Aktgjykimin KO54/20, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse në nxjerrjen e Vendimeve të kontestuara, Ministria e Shëndetësisë, ka vepruar bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

144. Gjykata rikujton që në Aktgjykimin KO54/20, Gjykata, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, kishte saktësuar: (i) se Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, është e autorizuar që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit për Shëndetësi (shih paragrafin 325 të Aktgjykimit KO54/20); (ii) përmbajtjen e neneve 41 dhe 44 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përkatësisht fushëveprimin e tyre dhe kufizimet përkatëse, brenda të cilave Ministria e Shëndetësisë është e autorizuar të veprojë në bazë të atij ligji (shih paragrafët 227-273 të Aktgjykimit të KO54/20); dhe (iii) se neni 45 i Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, specifikon që të gjitha masat e përshkruara në nenet 41 dhe 44 të këtij Ligji, ndaj individëve dhe institucioneve urdhërohen me anë të aktvendimit me procedurë administrative. Gjykata kishte theksuar se ky nen është relevant për të treguar se me çfarë procedure duhet të ndërmerren masat e përshkruara në nenet 41 dhe 44 për individë dhe institucione. (Shih paragrafin 233 të Aktgjykimit të KO54/20).
145. Gjykata gjithashtu rikujton se paragrafi 2 i nenit 41 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ndër të tjera, përcakton që me qëllim të parandalimit të “*futjes*” dhe “*përhapjes*” të një sëmundje ngjitëse në “*tërë vendin*”, Ministria e Shëndetësisë, mund të (i) ndalojë **udhëtimin** në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjërës sëmundje; dhe (ii) ndalojë **qarkullimin** në “*rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”, siç është përcaktuar në pikat a) dhe b) të nenit të lartcekur. Gjykata ka sqaruar përmbajtjen e këtij neni në Aktgjykimin KO54/20 (shih paragrafët 237-253 të të njëjtit Aktgjykim). Përkitazi me pikat a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të ligjit të lartcekur, e të aplikueshëm edhe në rrethanat e rastit konkret, Gjykata përkitazi me (i) pikën a) kishte sqaruar dhe arsyetuar, ndër të tjera, se qëllimi i saj nuk mund të kuptohet që i jep autorizim Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht Qeverisë, për të kufizuar udhëtimin në të gjithë Republikën e Kosovës dhe se qëllimi i saj është që të ndalojë udhëtimin “*në vendin*” ku është përhapur epidemia, për shembull, të ndalojë shkuarjen apo udhëtimin në një fshat, qytet, vend ose lokacion të caktuar gjeografik ku është përhapur epidemia (shih paragrafët 242, 243 e 247 të Aktgjykimit

KO54/20); ndërsa përkitazi me (ii) pikën b) kishte sqaruar dhe arsyetuar, ndër të tjerash se, qëllimi i saj është që të ndalojë qarkullimin në “*rajonet e infektuara*” dhe në “*rajonet drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”, dhe duke u referuar specifikisht në kontekst rajonal, ka përjashtuar mundësinë e ndalimit të qarkullimit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e saj (shih paragrafin 251-253 të Aktgjykimit KO54/20).

146. Rrjedhimisht, përmes Aktgjykimit KO54/20, Gjykata kishte njohur faktin që pikave a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ia njohin mundësinë Ministrisë së Shëndetësisë, për të ndaluar (i) **udhëtimin** dhe (ii) **qarkullimin** në “*vendin ku është përhapur epidemia*”, “*rajonet e infektuara*” dhe “*rajonet drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”. Këto masa, bazuar në nenin 3 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mund të ndërmerren nga Ministria e Shëndetësisë me propozimin e IKSHPK-së, dhe e cila bazuar në nenin 4 të të njejtë ligj, ndër institucionet e tjera shëndetësore të përcaktuara në këtë nen, ka kompetencën për “*mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin*”. Rrjedhimisht, përcaktimi i “*vendit ku është përhapur epidemia*”, “*rajoneve të infektuara*” dhe “*rajoneve drejtpërsëdrejti të rrezikuara*” është në kompetencë të institucioneve përkatëse shëndetësore me rekomandimin e të cilave më pas vepron Ministria e Shëndetësisë.
147. Prandaj, Gjykata thekson se (i) për qëllime të pikave a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe në linjë me Aktgjykimin KO54/20, komunat Prizren, Dragash dhe Istog, respektivisht, mund të kualifikohen si “*vende*” apo “*rajone*”; (ii) vlerësimi nëse të njëjtat kualifikohen si “*vende ku është përhapur epidemia*” apo “*rajone të infektuara*” e “*rajone drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”, është kompetencë e institucioneve shëndetësore të përcaktuara përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mbi bazën e rekomandimeve shëndetësore të të cilave, vepron Ministria e Shëndetësisë; dhe (iii) akti të cilit i referohet paragrafi 1 i nenit 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i cili përcakton mekanizimin përmes të cilit zbatohet procedura e përcaktuar në paragrafët a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të ligjit të lartcekur, lexuar së bashku me nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk pamundësojnë ndërmarrjen e masave përkatëse ndaj “*individëve*” dhe “*institucioneve*” në rajonet e afektuara. Më saktësisht, përdorimi i shumësit në raport me “*individët*” dhe “*institucionet*” në paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve

Ngjitëse, lexuar së bashku “vendet” e “rajonet” e referuara në pikat a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të të njejtit ligj, mundëson nxjerrjen e akti i cili i drejtohet një “grupi personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme” për qëllime të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

148. Duke rikujtuar që Vendimet e kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, janë nxjerrë me dhe pas propozimit të IKSHPK-së të datës 12 prill 2020, e cila “konsideron se infeksioni është përhapur në atë komunë apo e njëjta konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar”, dhe se, siç është sqaruar më lart, ndërmarrja e masave të përcaktuara përmes pikave a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse është e mundshme në këto “vende” dhe/ose “rajone”, Gjykata duhet të konstatojë se “ndërhyrjet”, përkatësisht kufizimi i lirisë së lëvizjes së qytetarëve në “rajonet” e Prizrenit, Dragashit, dhe Istogut, respektivisht, përmes Vendimeve të kontestuara, janë “të përcaktuara në ligj”.
149. Gjykata thekson se për qëllime të këtij konstatimi, nuk është e nevojshme edhe analiza e nenit 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, sqarime të mjaftueshme përkitazi me të cilin janë dhënë në Aktgjykimin KO54/20. (Shih paragrafët 254 deri më 261 të Aktgjykimit KO54/20). Thënë këtë, rasti nuk është i njëjtë përkitazi me nenin 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, bazuar mbi të cilin, janë saktësuar “kundërvajtjet administrative” të aplikueshme në rast të moszbatimit të Vendimeve të kontestuara. Gjykata duhet të vlerësojë rrjedhimisht nëse pika IV për komunat e Dragashit dhe Istogut dhe pika V për komunën e Prizrenit, të Vendimeve të kontestuara, janë gjithashtu të bazuara në ligj.
150. Gjykata në këtë kontekst, rikujton që pika V e dispozitivit të Vendimit [nr.229/IV/2020] për komunën e Prizrenit dhe pika IV e dispozitivit të Vendimeve [nr.238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020], për komunat e Dragashit dhe Istogut, përcaktojnë si vijon:

“IV. [V.] Mosrespektimi i masave të përcaktuara në këtë vendim konsiderohet, sipas ligjit, si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, prej 1,000 Euro deri 2.000 Euro për personat fizikë dhe prej 3,000 Euro deri në 8,000 Euro për personat juridikë, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet prej 500 Euro deri 1,500 Euro. Në përputhje me ligj, gjobat shqiptohen nga Inspektorati kompetent.”

151. Gjykata rikujton që tri pikat e para (I, II dhe III) të Vendimeve të kontestuara përkitazi me komunat e Dragashit dhe Istogut respektivisht, (i) ndalojnë *“qarkullimin e personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre”* në komunat përkatëse, siç është përcaktuar në pjesën I; (ii) ndalojnë *“qarkullimin e automjeteve”* në komunat përkatëse, siç është përcaktuar në pjesën II; (iii) përcaktojnë *“kushtet që duhet plotësuar për personat fizikë gjatë qarkullimit të lejueshëm”*, siç është përcaktuar në pjesën III. Gjykata po ashtu rikujton që pikat e lartcekura të Vendimeve të kontestuara, përputhen me pikat I, III dhe IV të Vendimit të kontestuar përkitazi me komunën e Prizrenit, dhe i cili, për dallim, në pikën II të tij, gjithashtu përcakton *“ndalimin e hyrjeve-daljeve nga Komuna e Prizrenit”*. Të tri Vendimet e kontestuara, përcaktojnë gjobat që do shqiptohen në rast të mosrespektimit të masave të përcaktuara në Vendimet përkatëse, duke u referuar në nenin 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

152. Gjykata fillimisht thekson se ky nen, i definon si kundërvajtje administrative sanitare, masat e përcaktuara si të tilla përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe për të cilat, shqiptohen dënime me gjobë nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës. Këto gjoba, bazuar në këtë nen, arrijnë shumën prej 1.000 deri 2.000 euro për persona fizikë, kurse prej 3.000 deri 8.000 euro për persona juridikë. Të njejtat mund të shqiptohen në rast të kushteteve të caktuara në po këtë nen, përkatësisht pikave, a), b), c) dhe d) të tij. Më specifikisht, gjoba mund të shqiptohet për kundërvajtje administrative, (i) nëse konstatohet dhe nuk paraqitet sëmundja, vdekja nga sëmundja ngjitëse, epidemia, tajimi i shkaktarëve të sëmundjeve të caktuara ngjitëse, bartja e viruseve të hepatitit B dhe C, bartja e virusit 17 të HIV-it, bartja e parazitëve të malarisë, lëndimi nga kafsha e tërbuar ose nga kafsha për të cilën dyshohet se është e tërbuar, siç është përcaktuar në pikën a) të nenit 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, por në ndërlidhje me nenin 13 të tij. Ky i fundit, paraqet detyrimin e paraqitjes së sëmundjes ngjitëse, të përcaktuar specifikisht në përmbajtjen e tij në pikat a) deri në j); dhe (ii) nëse nuk e bëhet imunizimi, seroprofilaksa dhe kimioprofilaksa, siç është përcaktuar në pikën b) të nenit 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, por gjithashtu në ndërlidhje me nenet 28 deri 32 të tij. Këto të fundit, përcaktojnë kushtet e transportimit të personave të sëmurë apo për të cilët ekziston i njejtë dyshim, në mënyrë që të bëhet e *“pamundshme përhapja e infektimit”*, dhe detyrimin e mbrojtjes me barna për personat të cilët janë të kërcënuar nga rreziku për t'u infektuar nga sëmundjet e përcaktuara në këtë nen.

153. Paragrafët c) dhe d) të neni 53 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, gjithashtu përcaktojnë kundërvajtje administrative sanitare dhe gjobat përkatëse, për rastet në të cilat (i) nuk merren masat e parashikuara për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së mëtejme të infeksionit ose masat e tjera më të domosdoshme kundërepidemike dhe higjienike që kushtëzohen nga natyra e sëmundjes, siç është përcaktuar në pikën c) të këtij neni; dhe (ii) nuk caktohen masat, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse dhe nuk zbatohen masat përkatëse tekniko-sanitare, higjienike dhe të tjera për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse, siç është përcaktuar në pikën d) të të njëjtit nen.
154. Gjykata vëren se paragrafi c) i nenit të lartcekur, i cili është relevant në rrethanat e rastit konkret, dhe përmban diskrecion më të madh në raport me pikat tjera të lartcekura, i referohet “*masave*”, përkatësisht *masave të parashikuara për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së mëtejme të infeksionit ose masat e tjera më të domosdoshme kundërepidemike dhe higjienike që kushtëzohen nga natyra e sëmundjes*.
155. Thënë këtë, këto “*masa*” për parandalimin dhe luftimit e sëmundjeve ngjitëse, janë të përcaktuara në (i) Kapitullin III; dhe (ii) nenet 34 deri me 39 nën titullin “*Masat tjera për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse*” të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Më saktësisht, Kapitulli III, në nenin 8 të tij, përcakton masat e përgjithshme dhe masat e veçanta. Të parat janë të listuara saktësisht në paragrafin 2, ndërsa të dytat në paragrafin 3 të këtij neni. Asnjëra prej këtyre *masave*, nuk ndërlidhet me masat e përcaktuara si “*kundërvajtje administrative*” përmes Vendimeve të kontestuara. Gjykata vëren, pikën i) të paragrafit 3 të nenit 8 të ligjit në fjalë, dhe i cili, i referohet *masave “tjera të përcaktuara me këtë Ligj”*. Megjithatë, këto të fundit, siç u theksua më lart, janë në fakt të përcaktuara në nenet 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe të cilat, gjithashtu saktësisht përcaktojnë masat të cilat kualifikohen si kundërvajtje administrative, dhe të cilat gjithashtu, nuk përmbajnë asnjërën nga masat e përcaktuara si “*kundërvajtje administrative*” përmes Vendimeve të kontestuara.
156. Përpos nenit 53 dhe bazuar në të cilin janë nxjerrë pikat IV dhe V të Vendimeve të kontestuara, Gjykata gjithashtu do të vlerëson nëse nenet e tjera të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përkatësisht ato të përcaktuara në Kapitullin VII përkitazi me Dispozitat Ndëshkimore, parashohin kundërvajtjet administrative të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara. Në këtë aspekt,

Gjykata vëren se neni 54 i ligjit të lartcekur, gjithashtu përcakton dënime me gjobë për personat fizikë, prej 1.000 deri në 2.000 euro dhe për personat juridikë prej 3.000 deri në 8.000 euro, nëse nuk zbatohen ose kryhen masat e parapara në pikat a), b), c), d), dhe e) të paragrafit të parë të tij, dhe të cilat, nuk reflektojnë asnjëherë nga “kundërvajtjet administrative” të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara. E njëjta vlen edhe për nenet 55 dhe 56 të ligjit përkatës, dhe të cilat përcaktojnë dënim me gjobë për kundërvajtje, në rastin e parë, prej 250 deri me 1.000 euro, për personin fizik, nëse aplikohen rrethanat ose situatat e parapara në pikat a), b), c), d), d), f), e), g), ndërsa në rastin e dytë, prej 500 deri në 1000 euro, për personin fizik, nëse aplikohen rrethanat ose situatat e parapara në pikat a) dhe b). Asnjëra nga këto baza ligjore, gjithashtu nuk reflektojnë asnjëherë nga “kundërvajtjet administrative” të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara.

157. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton që Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se bazuar në pikën (m) të nenit 31 të Ligjit për Inspektoratin Sanitar, *“mosrespektimi i pjesshëm ose i plotë i detyrave e vendimeve që merren nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës”*, është kundërvajtje administrative sanitare dhe shqiptohet në bazë të vendimit/eve të nxjerra nga Inspektorati Sanitar. Megjithatë, neni 31 i këtij ligji, gjithashtu përcakton saktësisht shkeljet të cilat përbëjnë kundërvajtje sanitare, dhe asnjëra nga “kundërvajtjet administrative” të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara, nuk janë pjesë e kësaj liste të përshkruar saktësisht në nenin e lartcekur të Ligjit për Inspektoratin Sanitar. Pika m) e nenit 31 e Ligjit për Inspektoratin Sanitar i referohet moszabtimit të vendimeve të marra nga Inspektorati Sanitar i Kosovës, dhe që nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret.
158. Në fakt, “kundërvajtjet administrative” të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara, përkatësisht ato të përcaktuara përmes (i) pikave I, II dhe III të Vendimeve [nr.238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020] *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjithëse COVID-19 në territorin e Komunës”* së Dragashit dhe Istogut, respektivisht, e që ndërliidhen me “*ndalimin e qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre*”; “*qarkullimin e automjeteve*”; dhe “*detyrimet e personave fizikë gjatë qarkullimit të lejueshëm*”; dhe (ii) pikave I, II, III dhe IV të Vendimit [nr. 229/IV/2020] *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjithëse COVID-19 në territorin e Komunës”* së Prizrenit, e që ndërliidhen me “*ndalimin e qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre*”; “*ndalimin e hyrje-daljeve*”, “*qarkullimin e automjeteve*”; dhe “*detyrimet e personave fizikë gjatë qarkullimit të*

lejueshëm”, burojnë nga përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe i cili në pikat a) dhe b) të tij, Ministrisë së Shëndetësisë, ia përcakton kompetencën për (i) të ndaluar udhëtimin në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjëres nga sëmundjet ngjitëse; ose (ii) të ndaluar qarkullimin në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara, masa këto të cilat, bazuar në të njëjtin nen, përcaktohen me aktet nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe zbatohen duke e ndjekur procedurën e përcaktuar përmes nenit 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

159. Gjykata në këtë kontekst, fillimisht vëren se një akt i tillë nënligjor nuk është i publikuar në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, përkundër faktit që bazuar nënin 58 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ministria e Shëndetësisë, ka patur për detyrë të nxjerrë aktet nënligjore lidhur me masat, detyrimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e mbrojtjes dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes së këtij Ligji në fuqi, datë kjo e cila daton në vitin 2008. Për më tepër, *“kundërvajtjet administrative”* të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara, janë përcaktuar përmes procedurës së përcaktuar në nenin 45 të ligjit të lartcekur, përkatësisht përmes një akti të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe nuk janë të definuara si kundërvajtje administrative në vet Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Më saktësisht, *“kundërvajtjet administrative”* të parashikuara përmes Vendimeve të kontestuara, janë përcaktuar përmes një vendimi të Ministrisë së Shëndetësisë.
160. Në kontekst të diskrecionit të Ministrisë së Shëndetësisë, për të përcaktuar kundërvajtje administrative dhe të cilat nuk janë saktësisht *“të përcaktuara në ligj”*, Gjykata fillimisht rikujton që Kuvendi, në vitin 2016 ka nxjerrë Ligjin nr.05/L-087 për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejme: Ligji për Kundërvajtje), dhe sipas (i) nenit 170 (Pushimi i vlefshmërisë së legjislacionit ekzistues në fuqi) të të cilit, është përcaktuar se me hyrjen në fuqi e tij e që bazuar në nenin 171 (Hyrja në fuqi), kjo ka ndodhur në *“janar të vitit 2017”*, *“pushon të vlejë legjislacioni në fuqi për kundërvajtjen.”*; dhe (ii) nenit 167 (Harmonizimi i dispozitave që nuk janë në pajtim me këtë ligj) të tij, është përcaktuar që *“Dispozitat për kundërvajtjen që nuk janë në pajtim me këtë ligj, do të harmonizohen brenda afatit prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji”*. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, nuk është plotësuar/ndryshuar asnjëherë nga Kuvendi.

161. Thënë këtë, janë gjithashtu dy nene të Ligjit për Kundërvajtje, dhe të cilat, janë relevante në vlerësimin e “*përcaktueshmërisë me ligj*” të pikave IV për komunën e Dragashit dhe Istogut, dhe pikës V për komunën e Prizrenit, përkitazi me “*kundërvajtjet administrative*”. Këto janë nenet 3 (Parimi i ligjshmërisë) dhe 7 (Përcaktimi i kundërvajtjes) të Ligjit për Kundërvajtjet. I pari, përkatësisht neni 3, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, përcakton se (i) askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje apo t’i shqiptohet sanksioni kundërvajtës për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës, përmes paragrafit të parë të tij; dhe (ii) përkufizimi i një kundërvajtje duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë, duke theksuar se në rast të paqartësisë, përkufizimi i kundërvajtjes interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura për kundërvajtje, përmes paragrafit të dytë të tij. Ndërsa i dyti, përkatësisht neni 7, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithashtu përcakton se (i) kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës, me këtë të fundit me kompetencë vetëm për shkeljet e akteve të organeve komunale të cilat ata i nxjerrin brenda fushës së kompetencave të tyre, siç është përcaktuar në paragrafin e parë dhe të dytë të tij; dhe (ii) organi i cili është i autorizuar të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje, përkatësisht Kuvendi i Republikës ose Kuvendi Komunal, këtë autorizim nuk mund ta bartë në organe të tjera, siç është përcaktuar në paragrafin e tretë të tij.
162. Në këtë kontekst, Gjykata së pari rikujton se “*kundërvajtjet administrative*” të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara nuk janë të përcaktuara përmes neneve 8, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 53, 54, 55 e 56 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse e as në nenin 31 të Ligjit për Inspektoratin Sanitar. Së dyti gjithashtu vëren se përderisa pikat a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i referohen mundësisë së marrjes së masave përkatëse e të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara, i njëjti nen përcakton se të njëjtat së pari duhet të specifikohen përmes një akti nënligjor dhe më pas të përcaktohen përmes ndjekjes së procedurës të përcaktuar në nenin 45 të të njëjtit ligj. Në këtë kontekst, Gjykata vë theks në tri çështjet në vijim: (i) se bazuar në paragrafin 1 nenit 3 të Ligjit për Kundërvajtjet, kundërvajtjet duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë në një ligj të Kuvendit ose akt të Kuvendit Komunal dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Gjykata rikujton se kundërvajtjet e përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara nuk janë të përcaktuara në mënyrë

të saktë as në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse e as në Ligjin për Inspektoratin Sanitar; (ii) se bazuar në paragrafin 3 të nenit 7 të Ligjit për Kundërvajtjet, organi i autorizuar që të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje, e që bazuar në këtë ligj, siç u theksua më lart, është vetëm Kuvendi i Republikës dhe Kuvendi Komunal, këtë autorizim nuk mund ta bartë në organe të tjera, përfshirë Qeverinë; dhe (iii) se kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje, mund të përcaktohen me ligj të Kuvendit të Republikës dhe me akte të Kuvendit të Komunës, siç është përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 7 të Ligjit për Kundërvajtjet, ndërsa gjithashtu nëse nuk ky nuk është rasti, askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje apo t'i shqiptohet sanksioni kundërvajtës për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte të Kuvendit të Komunës bazuar, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 3 të të njëjtit ligj.

163. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se *“kundërvajtjet administrative”* që ndërlidhen me mosrespektimin e *“ndalimit të qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre”*; *“ndalimin e hyrje-daljeve”*, *“qarkullimin e automjeteve”*; dhe *“detyrimet e personave fizikë gjatë qarkullimit të lejueshëm”*, të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara, nuk janë *“të përcaktuara në ligj”*, përkatësisht në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe për më tepër, të njëjtat janë përcaktuar përmes vendimeve të një ministrie, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë, dhe jo përmes një ligji të Kuvendit të Republikës ose edhe një akti të Kuvendit Komunal.
164. Gjykata thekson, siç ka bërë edhe në Aktgjykimin KO54/20, se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, nuk i ofron autorizimet adekuate Qeverisë për luftimin dhe parandalimin e pandemisë COVID-19. Pikërisht për këtë arsye, përmes Aktgjykimit KO54/20, kishte përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, duke theksuar se deri në këtë datë, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, të bëhen në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO54/20. Një gjë e tillë, siç është sqaruar në pjesën III të këtij Aktgjykimi, nuk ka ndodhur.
165. Thënë këtë, dhe përkundër domosdoshmërisë që në rrethanat e pandemisë aktuale, Qeveria (i) *“duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet”*; dhe (ii) se një gjë e tillë, *“mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta vendimmarrëse, si dhe*

lehtësimin e disa kontrolleve dhe balancave”, siç thekson edhe vet Këshilli i Evropës në Dokumentin Informativ, duke theksuar gjithnjë megjithatë edhe domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së pushtetit legjislativ dhe kontrollit gjyqësor, Kushtetuta, në nenet 92 dhe 93 të saj, saktë përcakton se Qeveria vetëm zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe merr vendime dhe nxjerrë akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve, siç përcakton gjithashtu se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj të Kuvendit, në nenin 55 të saj.

166. Në këtë kontekst, dhe bazuar në vlerësimin e kundërvajtjeve administrative të përcaktuara përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Gjykata duhet të konstatoi se në përcaktimin e mosrespektimit të masave të parashikuara përmes Vendimeve të kontestuara si *“kundërvajtje administrative”*, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara përmes ligjit të lartcekur, sepse të njëjtat, nuk janë *“të përcaktuara me ligj”*.
167. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se: (i) pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* për komunën e Prizrenit; dhe (ii) pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ku përcaktohen *“kundërvajtjet administrative”* dhe sanksionet përkatëse, nuk janë në përputhshmëri me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
168. Siç është sqaruar në Aktgjykimin e Gjykatës KO54/20, dhe në këtë Aktgjykim, në rast të mosplotësimit të kriterit të *“përcaktueshmërisë me ligj”*, nuk vazhdohet më tutje me vlerësimin e kushteve të tjera të testit jokumulativ, përkatësisht *“qëllimin legjitim”* dhe *“domosdoshmërinë në shoqëri demokratike”*. Rrjedhimisht, në vijim Gjykata nuk do të vazhdojë me vlerësimin e këtyre dy kriterëve për sa i përket pikës IV të Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në komunat e Dragashit dhe Istogut; dhe pikës V të Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* për komunën e Prizrenit, ndërsa të njëjtën analizë do e vazhdojë përkitazi me (i) pikat I, II, III, V, VI dhe VII të Vendimeve të

konstestuar për komunën e Dragashit dhe Istogut, dhe (ii) pikat I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII të Vendimit të kontestuar për komunën e Prizrenit, sepse në lidhje me to, Gjykata tashmë ka konstatuar *“përcaktueshmërinë me ligj”*.

(ii) Nëse *“ndërhyrja”* në të drejtën e lirisë së lëvizjes ndjek një *“qëllim legjitim”*

169. Gjykata ka sqaruar strukturën e nenit 35 të Kushtetutës, respektivisht lirisë së lëvizjes, në Aktgjykimin KO54/20, për aq sa është relevante për rrethanat e të dy rasteve përkatëse. Gjykata ka sqaruar se ky nen garanton (i) të drejtën e lëvizjes të lirshme në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhjes së vendbanimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës; (ii) të drejtën e largimit nga vendit të secilit person; dhe (iii) të drejtën e shtetasve të Republikës së Kosovës për t'u mos u ndaluar hyrja në Republikën e Kosovës. Paragrafi 2 i të njëjtin nen, përcakton se të gjitha kufizimet përkitazi me këto të drejta të garantuara, (i) *“rregullohen me ligj”*; (ii) përcaktohen dhe janë të nevojshme për zbatimin e një vendimi të gjykatës; dhe (iii) janë të nevojshme për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit. Paragrafët 4 dhe 5 të nenit 35 të Kushtetutës nuk janë relevante për rrethanat e rastit konkret andaj dhe, si në Aktgjykimin KO54/20, Gjykata nuk do të lëshohet në komentimin e tyre. (Shih paragrafin 201 të Aktgjykimit KO54/20).
170. Këtë nen, bazuar në nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata e lexon dhe e interpreton në lidhje me nenin ekuivalent të KEDNJ-së, respektivisht nenin 2 të Protokollit nr. 4 të tij. Ky i fundit, gjithashtu përcakton të drejtat dhe mundësinë e kufizimeve përkatëse. Në paragrafët 1 dhe 2 të tij, përcakton të drejtën e lëvizjes së lirishme brenda një shtetit dhe të drejtën e zgjedhjes së lirishme të vendbanimit, për të gjithë ata që janë në mënyrë të ligjshme brenda teritorit të shtetit përkatës, dhe të drejtën e çdo personi që të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin. Megjithatë, në paragrafët 3 dhe 4, respektivisht, i njëjti nen përcakton mundësinë e kufizimeve përkatëse, me kushtin që të njëjtat të jenë të *“parashikuara në ligj”* dhe *“të domosdoshme në një shoqëri demokratike”*. Arsyet mbi bazën e të cilave këto kufizime mund të jenë *“të përcaktuara në ligj”* dhe *“të domosdoshme në një shoqëri demokratike”*, përkatësisht *“qëllimet legjitime”* mbi bazën e të cilave mund të bëhen kufizimet përkatëse, janë po ashtu të përcaktuara brenda strukturës së këtij neni, dhe përfshijnë (i) sigurinë kombëtare ose sigurinë publike; (ii) ruajtjen e

rendit publik; (iii) parandalimin e veprave penale; (iv) mbrojtjen e shëndetit apo të moralit; ose (v) mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

171. Kjo strukturë e neneve përkatëse, e që është e ngjashme edhe me nene të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së e të cilat, përcaktojnë të drejtat dhe kufizimet përkatëse (shih, përfshirë por duke mos u kufizuar në nenet 8 deri në 11 të KEDNJ-së, dhe nenet respektive të Kushtetutës), përkon edhe me strukturën e nenit 55 të Kushtetutës, i cili është sqaruar gjërësisht në Aktgjykimin KO54/20 (shih paragrafët 189-198) dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin e kompatibilitetit me KEDNJ-në të kufizimeve të të drejtave dhe lirive përkatëse.
172. Praktika gjyqësore e GJENDJ-së është e konsoliduar përkitazi me vlerësimin nëse një “*ndërhyrje*”, përkatësisht kufizim i të drejtës, ndjek një “*qëllim legjitim*”. Në këtë aspekt, GJEDNJ fokusohet në analizimin e “*qëllimeve legjitime*” përkitazi me të cilat mund të lejohet një “*ndërhyrje*” e të cilat janë specifikisht të përcaktuara në vet paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Për shembull, në një mori rastesh, GJEDNJ e kishte konsideruar si të kalueshëm këtë pikë të testit ngase “*ndërhyrjet*” në fjalë ishin konsideruar që kishin ndjekur një “*qëllim legjitim*” për sa i takon: (i) interesit të sigurisë shtetërore (shih rastet GJEDNJ-së, *Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesat nr. 5871 dhe 9 të tjera, Aktgjykim i 27 marsit 2018; dhe *Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesat nr. 5871 dhe 9 të tjera, Aktgjykim i 27 marsit 2018, paragrafët 84-85); (ii) interesin publik (shih rastin e GJEDNJ-së, *Bessenyei kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 37509/06, Aktgjykim i 21 tetorit 2009, paragrafi 22); (iii) mbrojtjen e interesave të fëmijës, respektivisht mbrojtjes së interesave të të tjerëve (shih rastin GJEDNJ-së rastin *Battista kundër Italisë*, kërkesa nr. 43978/09, Aktgjykim i 2 dhjetorit 2014, paragrafi 40); dhe (iv) mbrojtjen e interesit dhe të drejtave të të tjerëve (shih rastin GJEDNJ-së, *Mursaliyev dhe të tjerët kundër Azerbejxhanit*, kërkesat nr 66650/13 dhe 10 të tjera, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2018).
173. Në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, barrën e të provuarit përkitazi me ekzistencën e një “*qëllimi legjitim*” ia përcakton shtetit përkatës, apo më saktësisht autoritetit publik i cili ndërmerr “*ndërhyrjen*” në mbrojtje të një “*qëllimi legjitim*”. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, barra e të provuarit përkitazi me ekzistencën e një “*qëllimi legjitim*” lidhur me “*ndërhyrjen*” përkatëse bie mbi Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht Qeverinë. Gjykata rikujton që as Kryeministri në emër të Qeverisë dhe as Ministri i Shëndetësisë në emër të Ministrisë së Shëndetësisë, nuk i janë

përgjigjur Gjykatës në kërkesën e saj për komente lidhur me meritat e rastit. Rrjedhimisht, ato nuk kanë argumentuar “*qëllimin legjitim*” të ndjekur përmes “*ndërrhyrjeve*” në të drejtën e lëvizjes përmes Vendimeve të kontestuara.

174. Thënë këtë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së njihet edhe raste në të cilat, ajo, për shkak të rrethanave specifike të një rasti, ka pranuar ekzistencën e një “*qëllimi legjitim*”, përkundër mungesës së argumentimit të qeverisë përkatëse. Në linjën e kësaj praktike gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe duke marrë parasysh edhe mungesën e praktikës gjyqësore përkitazi me kufizimet në lirinë e lëvizjes si rezultat i pandemisë COVID-19, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, është e gatshme të pranojë se në “*ndërrhyrjen*” në të drejtat dhe liritë themelore përkitazi me lirinë e lëvizjes, Ministria e Shëndetësisë, ka ndjekur një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht atë të mbrojtjes së “*shëndetit publik*”, të përcaktuar specifikisht në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
175. Për më tepër, dhe në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata gjithashtu i referohet Dokumentit Informativ SG/Inf(2020)11 të 7 prillit 2020 për Respektimin e Demokracisë, Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut në kuadrin e Krizës Sanitare të COVID-19, të Këshillit të Evropës, i cili, ndër tjerash, thekson se “*mbrojtja e shëndetit*” është njëra nga “*qëllimet legjitime*” e cila u mundëson Qeverive përkatëse që të ndërmarrin masa kufizuese përgjatë parandalimit dhe luftimit të pandemisë përkatëse, po kuptohet, vetëm nëse të njëjtat janë të “*përcaktuara në ligj*” dhe “*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*”. (Shih, pjesën 3.3 të Dokumentit Informativ).
176. Gjithashtu, përkundër faktit që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përkitazi me rastet që mund të rezultojnë si pasojë e kufizimeve të ndërmarra nga shtetet përkatëse me qëllim të parandalimit dhe luftimit të COVID-19 edhe më tej mungon, e edhe faktit që edhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese përkatëse, në këtë fazë, është e paktët dhe në zhvillim e sipër, një numër i gjykatave kushtetuese tashmë kanë nxjerrë vendimet e para përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimeve gjatë pandemisë COVID-19, dhe kanë pranuar ekzistencën e “*qëllimit legjitim*” në kuptim të mbrojtjes së shëndetit publik. Kuptohet, kjo vetëm pasi të njëjtat të kenë konstatuar se masat, përkatësisht kufizimet e ndërmarra, janë “*të përcaktuara në ligj*”. (Shih në këtë kontekst, rastin e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës, Vendim për Pranueshmërinë dhe Meritat, AP-1217/20, paragrafin 51. Përkundër konstatimit të ekzistencës së “*qëllimit legjitim*”, ky Vendim kishte konstatuar shkelje të së drejtave të parashtruesve përkatës përkitazi

me lirinë e lëvizjes, për shkak të mungesës së proporcionalitetit të masave të ndërmarra).

177. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e këtij rasti, “ndërhyrja”, përkatësisht kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 35 të Kushtetutës, përmes Vendimeve kontestuese, ka ndjekur “qëllimin legjitim” të “mbrojtjes së shëndetit publik”, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Ky konstatim afirmativ, pasohet me nevojën e analizës së kriterit të mbetur, përkatësisht vlerësimit nëse “ndërhyrja” në të drejtën e lëvizjes, përmes Vendimeve të kontestuese është e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

(iii) Nëse “ndërhyrja” në të drejtën e lirisë së lëvizjes është e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”

178. Gjykata thekson se në vlerësimin nëse “ndërhyrja” është “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”, GJEDNJ, fillimisht thekson se një “ndërhyrje”, do të konsiderohet si e “domosdoshme në një shoqëri demokratike” nëse i përgjigjet një “nevoje urgjente shoqërore”. Në këtë kontekst, GJEDNJ balancon interesat e shtetit përkatës, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mbrojtjen e shëndetit publik, kundrejt të drejtës së parashtruesit përkatës, dhe, në veçanti, nëse (i) “ndërhyrja” është “proporcionale” me “qëllimin legjitim” që ndjek; dhe (ii) arsyet e prodhuara nga autoritetet shtetërore për të arsyetuar “ndërhyrjet” në fjalë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. (Shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Khyustov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 28975/05, Aktgjykim i 11 korrikut 2013, paragrafi 84 dhe referencat e përdorura aty; *Nikiforenko kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 14613/03, Aktgjykim i 18 shkurtit 2010, paragrafi 56; si dhe, *Kyprianou kundër Qipros*, kërkesa nr. 73797/01, Aktgjykim i vitit 2005, paragrafët 170-171).

179. Në kuptim të vlerësimit të proporcionalitetit, GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, dhe ka konstatuar se “ndërhyrjet” në lirinë e lëvizjes, nuk ishin proporcionale me “qëllimin legjitim” të ndjekur, kur të njëjtat, ndër tjerash, nuk i ishin nënshtruar shqyrtimit të vazhdueshëm nga autoriteti përkatës publik. Për shembull, në rastin *A.E. kundër Polonisë*, duke konstatuar shkelje të së drejtës së parashtruesit përkatës përkitazi me lirinë e lëvizjes të garantuar përmes nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, GJEDNJ, në lidhje me proporcionalitetin e masave të ndërmarra, ndër të tjera, kishte theksuar se autoritetet shtetërore nuk janë të lejuara që të mbajnë masa kufizuese në të drejtën e lirisë së lëvizjes së personave “pa rishqyrtim periodik të arsyeshmërisë së atyre masave.” (Shih,

rastin e GJEDNJ-së, *A.E kundër Polonisë*, kërkesa nr. 14480/04, Aktgjykim i 31 marsit 2009, paragrafët 49 e 50 dhe referencat e përdorura aty). Mungesa e tillë e rishqyrtimit të kohëpaskohshëm të masave kufizuese, u konsiderua nga GJEDNJ, që shkon kundër detyrimit të shteteve që të aplikojnë kujdes të nevojshëm me qëllim të sigurisë që “*ndërhyrjet*” e aplikuara të jenë të arsyeshme përgjatë gjithë kohës së aplikimit të kufizimit përkatës. Ngjashëm, në rastin *Battista kundër Italisë*, GJEDNJ ka theksuar se masat e natyrës automatike, pa kufizime përkitazi me fushëveprimin dhe kohëzgjatjen e tyre, dhe të cilat nuk i nënshtrohen shqyrtimit të kohëpaskohshëm, janë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Battista kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 47; shih gjithashtu edhe disa raste të tjera, në të cilat pas kalimit të testit përkitazi “*përcaktueshmërisë me ligj*” dhe “*qëllimin legjitim*”, është konstatuar se “*ndërhyrjet*” nuk kanë qenë “*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*” për shkak të mungesës së proporcionalitetit të “*ndërhyrjeve*” në fjalë: *Milen Kostov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 40026/07, Aktgjykim i 3 shtatorit 2013; *Mursaliyev dhe të tjerët kundër Azerbejxhanit*, kërkesat nr 66650/13 dhe 10 të tjera, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2018; *Sarkizov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, kërkesat nr. 37981 dhe 3 të tjera, Aktgjykim i 17 prillit 2012; *Stamose kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 19713/05, Aktgjykim i 27 nëntorit 2012; dhe *Vlasov dhe Benyash kundër Rusisë*, kërkesat nr. 51279/09; dhe 32098/13, Aktgjykim i 20 shtatorit 2016).

180. Bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata në vijim duhet të vlerësoj, nëse në rrethanat e rastit konkret (i) “*ndërhyrja*” në të drejtat dhe liritë themelore përkitazi me lirinë e lëvizjes është proporcionale në raport me “*qëllimin legjitim*” të ndjekur, përfshirë nëse të njëjtat janë të natyrës automatike, pa kufizime përkitazi me fushëveprim dhe kohëzgjatjen e tyre, dhe nëse të njëjtat i nënshtrohen shqyrtimit të kohëpaskohshëm; dhe (ii) në “*ndërhyrjen*” në të drejtat dhe liritë themelore përkitazi me lirinë e lëvizjes, autoritetet përkatëse publike, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, kanë paraqitur arsye “*relevante dhe të mjaftueshme*”.
181. Gjykata në këtë kontekst, fillimisht thekson se parandalimi dhe luftimi i pandemisë COVID-19, medoemos përbën një “*nevojë urgjente shoqërore*” në kuptim të vlerësimit të “*nevojës në shoqëri demokratike*”. Të gjitha shtetet janë duke u përballur me sfidën e parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19. Deri më 29 mars 2020, 22 shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë shpallur gjendjen e emergjencës në nivel vendi, bazuar në procedurat përkatëse kushtetuese. Siç është theksuar edhe më lart, më qëllim të adresimit

efektiv të këtyre sfidave por edhe ruajtjes së sistemit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, Këshilli i Evropës ka publikuar Dokumentin Informativ, në mënyrë që t'ju ofrojë qeverive përkatëse një paketë *“për trajtimin e krizës aktuale sanitare të paprecedent dhe masive në mënyrë të tillë që të respektojnë vlerat themelore të demokracisë, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut”*. Ky Dokument Informativ, ndër tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, thekson se nën dritën e kërcënimit nga COVID-19, *“nuk mund të ruhet funksionimi i zakonshëm i shoqërisë, sidomos në kuadrin e masave kryesore mbrojtëse që janë marrë për të luftuar këtë virus, d.m.th. izolimin”*, dhe se këto masa *“do të prekin në mënyrë të pashmangshme të drejtat dhe liritë tona që janë pjesë e pandashme dhe e nevojshme e shoqërive demokratike që qeverisen nga shteti i së drejtës”*.

182. Për më tepër, Dokumenti Informativ i Këshillit të Evropës gjithashtu pohon se *“sfida kryesore sociale, politike dhe ligjore, me të cilën do të përballen shtetet tona anëtare, do të jetë aftësia e tyre për t'ju përgjigjur me efikasitet kësaj krize, duke garantuar në të njëjtën kohë që masat që ato marrin të mos cenojnë interesin tonë të qenësishëm afatgjatë në garantimin e vlerave themeluese të Evropës për demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut”*. Nevoja e veprimit të shpejtë dhe efikas, njihet posaçërisht në kuptim të autoriteteve ekzekutive, duke theksuar, ndër tjerash, se të njëjtat (i) *“duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet; dhe (ii) se një gjë e tillë, “mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta vendimmarrëse, si dhe lehtësimin e disa kontrolleve dhe balancave”*, megjithatë gjithnjë duke e theksuar rëndësinë e kontrollit të pushtetit ekzekutiv nga ai legjislativ. Në këtë kontekst, edhe Komisioni i Venecias, ka theksuar vazhdimisht se edhe në rastet e shpalljes së emergjencave, sundimit i ligjit duhet të mbizotërojë. (Shih Raportin e Komisionit të Venecias për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në raste të Emergjencave, të adoptuar nga Komisioni i Venecias në sesionin plenar të 66, më 17-18 mars 2006; dhe gjithashtu Listën e Kontrollit të Shtetit të së Drejtës të Komisionit të Venecias (CDL-AD(2016)007) (*“Rule of Law Checklist”*), paragrafi 51).
183. Edhe pse jo përkitazi me sfidat që burojnë nga pandemia COVID-19, por në kontekst të përcaktimit dhe sqarimit të mekanizmave përkitazi me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në *“kohë emergjencash”*, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, por edhe Komisioni i Venecias, theksojnë se KEDNJ duhet të interpretohet si një *“instrument i gjallë”*, duke nënkuptuar se kriteret mbi bazën e të cilave vlerësohet bilanci në mes interesit të shtetit dhe të drejtës individuale, dhe pesha që u atribuohet këtyre kriterëve përkatëse të vlerësimit, mund të dallojnë

varësisht nga konteksti. Rrjedhimisht, edhe vlerësimi i proporcionalitetit duhet të bëhet bazuar në rrethanat e rasteve përkatëse dhe vendosja e masave më të ashpra kufizuese në raste të caktuara mund të jetë e pranueshme, megjithatë duke mos e kufizuar esencën e të drejtave të garantuara asnjëherë. (Shih, ndër tjerash, Opinionin e Komisionit të Venecias për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Situata Emergjence, CDL-AD(2006)015), paragrafi 8 dhe referencat e përdorura aty).

184. Në këtë kontekst, dhe në vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimeve të përcaktuara përmes Vendimeve të kontestuara në raport me *“qëllimin e ndjekur legjitim”*, Gjykata rikujton që të njëjtat ndalojnë lëvizjen e personave dhe qarkullimin e automjeteve në komunën e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, me përjashtim të një periudhe prej një ore e gjysmë brenda ditës, me kusht të mosshoqërimit nga askush. Thënë këtë, për qëllime të vlerësimit të proporcionalitetit të masave të ndërmarra, Gjykata duhet të analizojë, përjashtimet e bëra nga rregulli i përgjithshëm i kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe të qarkullimit, përmes tri nga katër Vendimet e kontestuara.
185. Gjykata rikujton se përmes Vendimeve të kontestuara, liria e lëvizjes dhe e qarkullimit është mundësuar me kushtëzimet respektive, lidhur me (i) raste të emergjencave shëndetësore; (ii) rastet e kryerjes së nevojave esenciale përtej distancave të caktuara; (iii) rastet e pjesëmarrjes në varrime; (iv) personat me aftësi të kufizuara; (v) viktimat e dhunës familjare, në përputhshmëri edhe me rekomandimet e Dokumentit Informativ të Këshillit të Evropës; (vi) qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme; (vii) lëvizjen e punëtorëve përkatës; (viii) bujqit dhe fermerët; (ix) qarkullimin për nevoja të institucioneve shtetërore; dhe (x) mediet.
186. Vendimet e kontestuara, gjithashtu kanë trajtuar në mënyrë të veçantë personat mbi moshën 65 vjeç dhe ata nën moshën 16 vjeç. Përmes Vendimeve të kontestuara, në fakt, Ministria e Shëndetësisë, nuk e ka ndaluar lëvizjen e personave mbi moshën 65 vjeç gjatë orarit të lejuar, por ka rekomanduar që një e drejtë e tillë të mos shfrytëzohet përpos nëse është e domosdoshme. Ndërsa, për sa i përket personave nën moshën 16 vjeç, ka kushtëzuar lëvizjen e tyre me kushtin e shoqërimit nga një anëtarë i bashkësisë përkatëse familjare brenda orarit të lejuar të lëvizjes.
187. Në kontekst të përjashtimeve të lartcekura, Gjykata konsideron se (i) janë bërë mjaftueshëm përjashtime në kuptim të kufizimit të lirisë së lëvizjes duke e ruajtur kështu esencën e kësaj të drejte; dhe (ii)

kufizimet dhe përjashtimet përkatëse, reflektojnë balancim të mjaftueshëm në mes interesit të shtetit në njërën anë dhe të drejtave individuale të lirisë së lëvizjes së qytetarëve të afektuar përmes Vendimeve të kontestuara në anën tjetër, nën dritën e rrethanave të paprecedentë të krijuara nga pandemia COVID-19, dhe për pasojë, (iii) “*ndërrhyrja*” përkatësisht, kufizimi i të drejtës së lirisë së lëvizjes së qytetarëve të komunave të afektuara, është proporcional në raport me ndjekjen e “*qëllimit legjitim*” të mbrojtjes së shëndetit publik.

188. Ky konstatim vlen edhe për personat e moshës nën 16 vjeç, liria e lëvizjes të së cilëve përgjatë orarit të lejuar përmes Vendimeve të kontestuara, është kushtëzuar me shoqërimin e një anëtarit të familjes përkatëse. Kjo sepse, neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës] i Kushtetutës, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, përcakton se të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve, në paragrafin e katërt të tij. Marrë parasysh këtë, dhe posaçërisht në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, Gjykata, në parim, nuk e konsideron detyrimin e shoqërimit të personave nën-moshën 16 vjeçare si joproporcional. Një qëndrim i tillë, është në përputhshmëri edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, e cila bazuar në nenin 22 të Kushtetutës zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, dhe e cila, edhe pse nuk përcakton specifikisht të drejtën e lirisë së lëvizjes, megjithatë, përkitazi me kufizimet e mundshme lidhur me të drejtat e fëmijëve, gjithashtu përcakton mbrojtjen e shëndeti publik, si njërën nga “*qëllimet legjitime*” mbi bazën e të cilës mund të “*ndërrhyhet*” në të drejtat e tyre.
189. Në mbështetje të vlerësimit të proporcionalitetit të “*ndërrhyrjeve*” në lirinë e lëvizjes përmes Vendimeve të kontestuara, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se të njëjtat, (i) përcaktojnë afat të specifikuar kohor lidhur me masat e ndërmarra, përkatësisht deri më 4 maj 2020; (ii) përcaktojnë afat brenda të cilit duhet të bëhet rishqyrtimi të tyre, përkatësisht deri më 30 prill 2020; dhe (iii) përcaktojnë mundësinë e rishqyrtimit të vazhdueshëm, në bazë të analizimit të situatës epidemiologjike. Prandaj, Gjykata thekson se Vendimet e kontestuara përmbajnë edhe komponentin e (i) “*rishqyrtimit periodik të arsyeshmërisë së atyre masave*”, prandaj (ii) nuk janë masa të natyrës automatike, pa kufizime përkitazi me fushëveprim dhe kohëzgjatjen e tyre, kritere këto të cilat, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e një “*ndërrhyrje*” në tërësinë e saj, do të mund të rezultojnë në mungesë proporcionaliteti.

190. Gjykata rikujton që në vlerësimin nëse “*ndërrhyrjet*” në të drejtat dhe liritë themelore janë “*të domosdoshme në shoqëri demokratike*”, ajo gjithashtu duhet të vlerësojë nëse arsyet që përmbajnë vendimet përkatëse të autoriteteve shtetërore janë “*relevante dhe të mjaftueshme*”.
191. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që Vendimet e kontestuara, përtej përshkrimit faktik që ndërlidhet me (i) nxjerrjen e Vendimit të Qeverisë nr. 01/07 të datës 11 mars 2020; (ii) nxjerrjen e Vendimit të Qeverisë nr. 01/15 të 23 marsit 2020; dhe (iii) Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO54/20, kufizimet e specifikuar në Vendimet e kontestuara, i arsyeton duke u bazuar në (i) nenin 41.2 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse; dhe (iv) propozimin e IKSHPK-së të datës 12 prill 2020 e cila “*konsideron se infeksioni është përhapur në atë komunë apo e njëjta konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar*”.
192. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton (i) pretendimet e parashtruesve të kërkesës se Ministria e Shëndetësisë ka trajtuar tri komuna me karakteristika të ndryshme në mënyrë të njëjtë, dhe ka vendosur masat e njëjta në Dragash, Istog dhe Prizren, me asnjë rast, një rast, dhe më shumë raste, respektivisht, të infektuara me COVID-19; dhe (ii) faktin që përkundër kërkesës së Gjykatës drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, për komente përkitazi me meritat e kërkesës dhe për të dorëzuar në Gjykatë rekomandimet e IKSHPK-së e të cilat nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të saj, Ministria e Shëndetësisë nuk ka bërë një gjë të tillë.
193. Megjithatë, Gjykata thekson se, bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, nuk është kontestuese që IKSHPK dhe institucionet tjera shëndetësore të përcaktuara me këtë ligj, kanë kompetencën dhe ekspertizën për të vlerësuar situatën përkitazi me sëmundjet ngjitëse, dhe për të rekomanduar ndërmarrjen e masave në “*vendin ku është përhapur epidemia*” dhe “*rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara*” në kuptim të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Për më tepër, dhe përkundër dallimeve në rastet e infektuara në këto komuna, Gjykata nuk mund të vlerësojë vet nëse një rajon edhe pse mund të mos jetë “*infektuar*”, nuk është gjithashtu “*drejtpërsëdrejti i rrezikuar*” për qëllime të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Siç ka theksuar në Aktgjykimin KO54/20, për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese i referohet dhe bindet ekspertëve shëndetësor të fushës në nivel shtetëror dhe botëror (shih paragrafët 177 dhe 310 të Aktgjykimit KO54/20).

194. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron që arsyetimi që përmbajnë Vendimet e kontestuarra, përkatësisht referimi në propozimin e IKSHPK-së të datës 12 prill 2020 e cila *“konsideron se infeksioni është përhapur në atë komunë apo e njëjta konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar”*, është i *“mjaftueshëm dhe relevant”*, në rrethana të parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19. Gjykata në këtë kontekst, gjithashtu vë theks në faktin e njohur përmes Dokumentit Informativ të Këshillit të Evropës, se nevoja e veprimi të shpejtë dhe efikas për parandalimin dhe luftimin e pandemisë, u njihet posaçërisht autoriteteve ekzekutive, duke theksuar se të njëjtat *“duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet”* në këtë kontekst.
195. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se *“ndërhyrja”* në lirinë e lëvizjes përmes Vendimeve të kontestuarra, është e *“domosdoshme në një shoqëri demokratike”*, duke rezultuar kështu edhe në plotësimin e kushtit të fundit të përcaktuar përmes nenit 55 të Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo sepse (i) nuk është kontestuese se në rrethanat të luftimit të pandemisë COVID-19 ekziston një *“nevojë urgjente shoqërore”*; (ii) *“ndërhyrja”* përkatëse është proporcionale në raport me *“qëllimin legjitim”* që ndjek, duke përfshirë balancën në mes interesit të shtetit për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të drejtën e lëvizjes së qytetarëve të afektuar përmes Vendimeve të kontestuarra; dhe (iii) arsyet e prodhuara nga autoritetet shtetërore për të arsyetuar *“ndërhyrjet”* në lirinë e lëvizjes, në rrethanat e luftimit me pandeminë COVID-19, janë *“relevante dhe të mjaftueshme”*.
196. Përfundimisht, Gjykata, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr.238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, konstaton se të njëjtat janë në përputhshmëri me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Ky konstatim, siç është sqaruar më lart, vlen me përjashtim të pikës V të Vendimit [nr. 229/IV/2020] për komunën e Prizrenit dhe pikës IV të Vendimeve [nr.238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] për komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, lidhur me *“kundërvajtjet administrative”*, e të cilat, sipas vlerësimit dhe sqarimeve të dhëna nga Gjykata, nuk janë *“të përcaktuara në ligj”*, dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

197. Thënë këtë, në vijim, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e kushtetueshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, duke filluar nga vlerësimi nëse në nxjerrjen e tij, Ministria e Shëndetësisë është bazuar në autorizimet e përcaktuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përkatësisht “*përcaktueshmërisë me ligj*”.

2. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”

- (i) Nëse “*ndërhyrja*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes është e “*përcaktuar me ligj*”
198. Si në rastin e vlerësimit të Vendimeve [nr.229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ashtu edhe në vlerësimin e Vendimit [nr.214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse i njëjti plotëson kriterin e “*përcaktueshmërisë me ligj*”, përkatësisht, nëse në nxjerrjen e tij, përmes të cilit është “*ndërhyrë*” në lirinë e lëvizjes së qytetarëve të komunës së Prizrenit të garantuar përmes nenit 35 të Kushtetutës, Ministria e Shëndetësisë është bazuar në autorizimet ligjore të përcaktuara përmes një ligji të Kuvendit, përkatësisht Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
199. Gjykata rikujton që Vendimi i kontestuar, përcakton që (i) komuna e Prizrenit shpallet zonë karantinë sepse “*banorët e kësaj komune dyshohen që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejt me personat e infektuar me coronavirus COVID 19*”; (ii) shpall fshatin Skorobisht vatër të përhapjes së Infeksionit; (iii) ndalon hyrjet dhe daljet në këtë komunë; (iv) obligon të gjithë banorët e Prizrenit të respektojnë masat sipas udhëzimeve të IKSHPK-së; dhe (v) përcakton hyrjen në fuqi të tij në po të njëjtën datë.
200. Gjykata gjithashtu rikujton që (i) parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e “*përcaktueshmërisë me ligj*”, janë sqaruar në Aktgjykimin KO54/20 (shih paragrafët 208-216 të tij) dhe në paragrafët 138-139 të këtij

Aktgjykimi; ndërsa (ii) të gjitha dispozitat, përkatësisht bazat ligjore në të cilat është bazuar ky Vendim, tashmë janë analizuar në paragrafët 141-142 të këtij Aktgjykimi.

201. Gjykata, megjithatë vëren se për dallim nga tri Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë që tashmë u vlerësuan nga Gjykata, dhe të cilat ishin të bazuara edhe në nenet 44, 46 dhe 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimi për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, nuk është referuar në to. Ndërsa, siç është sqaruar më lart, e vetmja bazë shtesë e përmendur në këtë Vendim, është neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe për rrjedhojë, Gjykata do të fokusohet pikërisht në këtë nen, për të arritur në përfundimin nëse ka qenë i “*përcaktuar në ligj*”, karantinimi i gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit.
202. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se karantina është e referuar në katër nene të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përkatësisht në (i) nenin 2 të tij, dhe i cili e përkufizon karantinën si “*kufizim i lirisë së lëvizjes së njerëzve të shëndoshë të cilët janë ekspozuar shkaktarëve të rrezikshëm të sëmundjeve ngjitëse*”; (ii) pikën c) të paragrafit 3 të nenit 8 të tij, duke e përcaktuar karantinën si njërën ndër “*masat e veçanta*” për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse; (iii) nenin 33 të tij, në të cilin përcaktohen kushtet për vendosjen e personave fizikë në karantinë; dhe (iv) pikën c) të nenit 49 të tij, dhe i cili përcakton detyrimin e Qeverisë për të siguruar mjetet materiale, për mbulimin e shpenzimeve të karantinës dhe të kontrollit sanitar të personave në karantinë.
203. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese, që ka një “*ndërrhyrje*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Prizrenit, dhe ky konstatim është i bazuar në vet definicionin e karantinës, siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Ndërsa në vlerësimin nëse kjo “*ndërrhyrje*”, përkatësisht kufizim i të drejtës së lëvizjes së qytetarëve të Prizreni përmes Vendimit të kontestuar është “*e përcaktuar me ligj*”, Gjykata duhet të vlerësoj përmbajtjen e nenit 33 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
204. Gjykata, në këtë kontekst, thekson që neni 33 ka gjithsej pesë paragrafë, dhe përcakton se (i) personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga murtaja, variola dhe ethet hemorragjike virale futen në karantinë; (ii) kohëzgjatja e mbajtjes së personave nga paragrafi 1 i këtij neni, në karantinë varet nga periudha maksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse; (iii) personat nga

paragrafi 1 i këtij neni, i nënshtrohen kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së karantinës; (iv) Ministria e Shëndetësisë me propozim të IKSHPK-së merr vendim për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni; dhe (v) zbatimi i aktvendimit për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, sigurohet nga organet kompetente në nivel të vendit.

205. Gjykata thekson se neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i referohet saktësisht vetëm *“personave”*. Ky nen, është pjesë përbërëse e Kapitullit III lidhur me Masat për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe i cili në tërësinë e tij, gjithashtu i referohet vetëm *“personave”*, dhe asnjëherë, *“rajoneve”* apo *“vendeve”*. Kjo për dallim prej Kapitulli IV përkitazi me Masat e Sigurisë për Mbrojtjen e Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse, dhe i cili në nenin 41 të tij, përcakton masën e *“ndalimit të udhëtimit”* dhe *“ndalimit të qarkullimit”* në lidhje me *“vendin ku është përhapur epidemia”*, *“rajonet të infektuara”* ose/edhe *“rajonet drejtpërsëdrejti të rrezikuara”*.
206. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, saktësisht bën dallimin në mes të përdorimit të fjalës *“person”* dhe *“vend”* ose *“rajon”* në kuptim të masave për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, ndërsa ndalimin e *“udhëtimit”* dhe të *“qarkullimit”*, e përdorë saktësisht në kuptim të *“vendit”* ose *“rajonit”* të *“infektuar”* ose *“të rrezikuar”*. Në këtë kuptim, me qëllim të përcaktimit të masave të sigurisë në kontekst të sëmundjeve ngjitëse, për *“vende”* e *“rajone”*, siç është tërësia e komunës së Prizrenit, ka përcaktuar masat e saktësuara në pikat a) dhe b) të paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, masa këto të cilat në komunën e Prizrenit, janë vendosur përmes Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* dhe të cilin tashmë, me përjashtim të pikës V, Gjykata e shpalli në përputhshmëri me Kushtetutën.
207. Gjykata, gjithashtu thekson se, përdorimi i fjalës *“person”* në kontekst të karantimit, reflekton qëllimin e ligjvënësit që të autorizojë kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore për persona fizikë individualisht të përcaktuar, të drejtat e të cilëve rrjedhimisht, mund të kufizohen përmes një akti administrativ individual, dhe jo për *“rajone”* dhe *“vende”* të infektuara e të rrezikuara, të drejtat e qytetarëve të të cilave do të mund të kufizoheshin përmes aktit administrativ të përgjithshëm, sepse kur ligjvënësi ka patur një qëllim të tillë, e ka

përcaktuar saktësisht, siç është rasti me paragrafin 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

208. Prandaj, nuk është kontestuese se neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse u referohet personave fizikë individualisht të përcaktueshëm. Thënë këtë, ky ligj, përcakton edhe kushte tjera mbi bazën e të cilëve të njëjtit mund të karantinohen. Më saktësisht dhe bazuar në paragrafin 1 të nenit 33 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, vetëm dy kategori të personave fizikë mund të i nënshtrohen karantimit: (i) personat për të cilët **vërtetohet** se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje; dhe (ii) personat për të cilët **dyshohet** se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje.
209. Rrjedhimisht, për të karantinuar persona, duhet të (i) *“vërtetohet kontakti”*; ose (ii) duhet të ketë *“dyshime për kontaktin”*, me personat e sëmurë apo të dyshuar për sëmundje ngjitëse, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 33 të ligjit të lartcekur, dhe përkatësisht, duhet të dyshohet se të njëjtit, po ashtu mund të jenë bartës të sëmundjes ngjitëse. Për pasojë, të njëjtit persona i nënshtrohen karantimit për aq kohë sa është periudha maksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të të njëjtit nen. Për më tepër, bazuar në paragrafin 2 të nenit 14 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, jo vetëm *“sëmundja”*, por edhe *“dyshimi se ekziston sëmundja”* konstatohet nga *“mjeku ose punëtori tjetër i shëndetësisë jashtë kryerjes së detyrës në institucionin shëndetësorë, dhe i cili ka për detyrë që lidhur me këtë ta njoftoi menjëherë institucionin më të afërt shëndetësorë”*.
210. Në këtë kontekst, kushtëzimi i *“vërtetimit”* ose *“dyshimit”* të kontakteve me persona të sëmurë ose të dyshuar për sëmundje ngjitëse, për karantinimin e personave e të cilët gjithashtu rrjedhimisht konsiderohen të dyshuar për aq sa zgjat periudha e inkubacionit të sëmundjes përkatëse, reflektojnë qëllimin e ligjvënësit që rastet e karantimit, si një ndër masat e veçanta për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse që aplikohet ndaj *“njerëzve të shëndoshë”* dhe kufizon lirinë e lëvizjes së tyre, të aplikohet përjashtimisht, dhe assesi si masë e përgjithshme e cila vendoset ndaj të gjithë qytetarëve të një *“rajoni”* të tërë. Në fakt, për dallim nga masat e veçanta, masat e përgjithshme edhe ato të sigurisë, janë saktësisht të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 8 dhe kapitullin IV të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i cili përfshinë edhe nenin 41 të ligjit në fjalë, e pjesë përbërëse e të cilave nuk është karantina.

211. Për më tepër, paragrafi 3 i nenit 33 i ligjit të lartcekur, shprehimisht përcakton që personat për të cilët është urdhëruar karantinimi do t'i "*nënshtrohen kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së karantinës.*" Më saktësisht, neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, kushtëzon karantinimin e personave me nënshttrimin e tyre kontrollimeve të vazhdueshme mjekësore gjatë gjithë kohës së karantinës. Ky kushtëzim gjithashtu reflekton qartë qëllimin e ligjvënësit për të përcaktuar masën e veçantë të karantimit vetëm për persona fizikë për të cilët "*vërtetohet*" ose "*dyshohet*" se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë për sëmundje, rrjedhimisht personave individualisht të përcaktuar, dhe jo qytetarëve të një rajoni të tërë. Për më tepër që, kushtëzimi i mjekimit dhe kontrollit të vazhdueshëm mjekësor përgjatë gjithë Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, është përcaktuar vetëm përjashtimisht, dhe atë, vetëm përkitazi me personat për të cilët është "*vërtetuar*" se janë të sëmurë apo është "*vërtetuar se janë të dyshuar*" për sëmundje.
212. Karantimi i të gjithë qytetarëve të Prizrenit nuk i plotëson asnjë nga këto kushte ligjore sepse (i) nuk aplikohet ndaj personave fizikë individualisht të përcaktuar, por ndaj të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit; (ii) të gjithë këta fundit, për qëllime të nenit 33 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, as nuk është "*vërtetuar*" dhe as nuk mund të "*dyshohet*" se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje; (iii) Vendimi përkatës nuk përcakton asnjë afat kohor brenda të cilit do të rishqyrtohet kohëzgjatja e karantinës, në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 33 të ligjit në fjalë, sepse i njëjti qartësisht përcakton afatin brenda të cilit është i lejuar karantimi dhe kjo ndërlikohet me periudhën maksimale të inkubacionit të sëmundjes përkatëse; dhe (iv) qytetarët e karantinuara të komunës së Prizrenit, nuk i janë nënshtruar kontrollit të vazhdueshëm mjekësor që është kusht esencial në rast të karantimit, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur.
213. Për më tepër, dhe pikërisht për qëllime të kontrollit të vazhdueshëm mjekësor, në pikën c) të nenit 49 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse shprehimisht parashihet se në kuadër të mbrojtjes së popullsisë nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin, Qeveria siguron mjete dhe materiale shtesë: "*Për mbulimin e shpenzimeve të karantinës dhe të kontrollit sanitar të personave që kanë qenë në kontakt me personat e sëmurë ose me personat për të cilët dyshohet se vuajnë prej ndonjëres nga këto sëmundje ngjitëse.*" Kjo dispozitë, lexuar së bashku me nenin 33 të ligjit në fjalë, dërgojnë në përfundimin se karantina mund të shqiptohet me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, pas rekomandimit të IKSHPK-së, vetëm

ndaj personave fizikë individualisht të përcaktuar e jo ndaj të gjithë personave të një komune ose rajoni ose ndaj një zone gjeografike, masë kjo gjithnjë e kushtëzuar edhe në zbatimin e paragrafit të dytë dhe të tretë të këtij neni, që ndërlidhen me kohëzgjatjen e karantimit dhe kontrollimit mjekësor të detyrueshëm.

214. Gjykata gjithashtu vëren se Vendimi i kontestuar, përpos që i referohet rekomandimit të IKSHPK-së, nuk përmban asnjë arsyetim të vetëm për vendosjen e qytetarëve të një komune të tërë në karantinë. Nuk përmban asnjë arsyetim, as sa i përket (i) vërtetimit ose dyshimit se këta qytetarë në tërësinë e tyre kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje ngjitëse; (ii) kohëzgjatjes së karantinimit të tyre; (iii) detyrimit të nënshtërimit të kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së karantinës për të njëjtit; e as (iv) mbulimit të shpenzimeve të karantinës këtyre personave të kontrollit sanitar përkatës, siç kërkohet përmes nenit 33 në lidhje me pikën c) të nenit 49 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
215. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në paragrafin 5 të nenit 33 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, procedura e karantimit, përtej rekomandimit të IKSHPK-së, është e kushtëzuar në zbatimin e një aktvendimi. Referenca në këtë të fundit, duhet lexuar së bashku me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe që është i vetmi nen tjetër në këtë ligj që i referohet procedurës përkitazi me nxjerrjen e akteve lidhur me masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Në këtë kontekst, Gjykata vë theks se neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse lexuar së bashku me nenin 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i mundëson Ministrisë së Shëndetësisë nxjerrjen e një akti administrativ individual, që u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar, dhe jo një akti administrativ të përgjithshëm, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu vëren se struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit të shkruar janë të përcaktuara në nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe i cili, gjithashtu përfshinë pjesën arsyetuese të një akti, mungesa e të cilit, bazuar në nenin 52 të të njëjtit ligj, rezulton po ashtu në paligjshmërinë e tij.
216. Në fund, është gjithashtu e rëndësishme, të sqarohet se Vendimi i kontestuar përkitazi me shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantine*”, përtej shpalljes së fshatit Skorobisht vatër të përhapjes së infeksionit, nuk ka asnjë efekt tjetër për qytetarët e Prizrenit. Kjo sepse, i njëjti nuk saktëson asnjë detyrim tjetër për ta, përpos që

ndalon “*hyrjet dhe daljet*” në këtë komunë. Ndalimi i “*hyrjeve dhe daljeve*” në komunën e Prizrenit, ngërthejnë çështje që ndërlidhen me qarkullimin dhe lëvizjen, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, ndërsa për komunën e Prizrenit, të njëjtat masa janë përcaktuar gjithashtu përmes pikës II të Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës*” së Prizrenit, dhe të cilin Gjykata, tashmë, e ka shpallur në përputhje me Kushtetutën, duke e lënë në fuqi.

217. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton se në nxjerrjen e Vendimit për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantine*”, dhe rrjedhimisht, karantinën e të gjithë qytetarëve të një komune, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkaluar autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht, “*ndërrhyrja*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të komunës së Prizrenit, nuk është “*e përcaktuar në ligj*”.
218. Duke e marrë parasysh që “*ndërrhyrjet*” në të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve përkatës, nuk janë të “*përcaktuara me ligj*”, bazuar në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin KO54/20 dhe këtë Aktgjykimin, Gjykata nuk vazhdon më tej me vlerësimin nëse “*ndërrhyrjet*” e përcaktuara përmes këtij Vendimi të kontestuar, gjithashtu kanë ndjekur një “*qëllim legjitim*” apo edhe nëse janë të “*domosdoshme në shoqëri demokratike*”.
219. Për pasojë, Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë nuk plotëson kriterin e “*përcaktueshmërisë në ligj*” dhe, si i tillë, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

(iv) Konkluzë lidhur me përputhshmërinë e Vendimeve të kontestuara me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës

220. Gjykata ka vlerësuar përputhshmërinë e Vendimeve të kontestuara me nenin 35 dhe 55 të Kushtetutës, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me lirinë e lëvizjes së përcaktuar përmes nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, dhe ka konstatuar se:
 - (i) Vendimi [nr.229/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunën e Prizrenit (pikat

I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII); dhe Vendimet [nr.238/IV/2020] dhe [nr.239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunat e Dragashit dhe Istogut (pikat I, II, III, V, VI dhe VII), respektivisht, **janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, të gjitha pikat e saktësuara të Vendimeve të lartcekura, Gjykata i shpalli kushtetuese.

- (ii) Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e Vendimeve të lartcekura, Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në përputhje me autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, përmes pikave të lartcekura, ishin “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata gjithashtu konstatoi se të njëjtat ndjekin një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht atë të mbrojtës së “*shëndetit publik*”, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; janë proporcionale në raport me “*qëllimin legjitim*” të ndjekur; dhe janë “*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.
- (iii) Pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” për komunën e Prizrenit; dhe pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” për komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ku përcaktohen “*kundërvajtjet administrative*” dhe sanksionet përkatëse, **nuk janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata arsyetoi se në përcaktimin e mosrespektimit të masave të parashikuara përmes Vendimeve të lartcekura si “*kundërvajtje administrative*”, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara përmes Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Gjykata theksoi se bazuar në Ligjin për Kundërvajtje, kundërvajtjet dhe sanksionet përkatëse, mund të përcaktohen vetëm me ligj të Kuvendit të Republikës ose me akte të Kuvendit të një Komune, dhe se ky autorizim nuk

mund të bartet në organe të tjera. Rrjedhimisht, kundërvajtjet administrative të përcaktuara përmes këtyre tri Vendimeve të kontestuara, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*” dhe për pasojë, shpallën jokushtetuese.

- (iv) Vendimi [nr.214/IV/2020] i 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, **nuk është në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e këtij Vendimi, Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara përmes Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërrhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes, përmes karantinimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata qartësoi se “*karantina*” sipas Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mund të urdhërohet nga Ministria e Shëndetësisë, pas rekomandimit të IKSHPK-së, vetëm për persona fizikë për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshuar për sëmundje ngjitëse, gjithënjë me kushtin e plotësimit edhe të kushteve tjera të cilat janë të përcaktuara përmes nenit 33 dhe pikës c) të nenit 49 të ligjit në fjalë.

221. Gjykata gjithashtu rithekson konstatimet e Aktgjykimit KO54/20, se Qeveria bazuar në nenet 92 e 93 të Kushtetutës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Ajo zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi, dhe merr vendime në pajtim me Kushtetutën të nevojshme për zbatimin e ligjeve të Kuvendit. Në këtë kontekst, Qeveria, por edhe organet ose autoritetet e tjera ligjzbatuese, mund të ndërmarrin, aplikojnë dhe zbatojnë masa kufizuese vetëm për aq sa ia përcakton dhe ia lejon ligji i Kuvendit. Ky interpretimi është në përputhje të plotë me sistemin e kontroleve dhe balanceve në aspekt të ndarjes së pushteteve ku pushteti legjislativ për të krijuar ligje në vend i takon vetëm Kuvendit; ndërsa ai ekzekutiv për të zbatuar ligjet e Kuvendi, i takon Qeverisë. Gjyqësori në këtë trekëndësh pushtetesh e ka rolin e vet për të kontrolluar, në mes tjerash, edhe kushtetutshmërinë e ligjeve të nxjerra nga Kuvendi por edhe kushtetutshmërinë e vendimeve të Qeverisë përmes së cilave zbatohen ligjet e Kuvendit. (Shih gjithashtu paragrafët 293-295 të Aktgjykimit KO54/20).

222. Gjykata në fund gjithashtu thekson se përkundër faktit që jo vetëm Republika e Kosovës, por e mbarë bota po ballafaqohet me luftimin e

pandemisë COVID-19, dhe e cila medoemos e pamundëson “*funksionimin e zakonshëm të shoqërisë*”, siç thekson edhe Këshilli i Evropës në Dokumentin Informativ, shteti i së drejtës duhet të mbizotërojë, dhe në këtë kontekst, të gjitha institucionet e Republikës janë të detyruara të veprojnë në përputhje të plotë me kompetencat përkatëse Kushtetuese dhe ligjore.

223. Thënë këtë dhe në vijim, Gjykata gjithashtu do të adresojë edhe tri çështje të mbetura. E para ka të bëjë me (i) zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO54/20. E dyta ndërlidhet me (ii) parashtresën e Kryeministrit drejtuar gjyqtarëve të Gjykatës më 23 prill 2020. Ndërsa, e treta, ka të bëjë me (iii) kërkesën e parashtresës të kërkesës për masën e përkohshme lidhur me Vendimet e kontestuar. Në fund, Gjykata do të paraqes përfundimet e saj dhe pjesën operative të këtij Aktgjykimi.

III. Lidhur me zbatimin e Aktgjykimi të Gjykatës në rastin KO54/20

224. Në Aktgjykimin KO54/20, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit [nr. 01/15] të 23 marsit 2020 të Qeverisë, pas kërkesës që kishte dorëzuar Presidenti më 24 mars 2020.
225. Më 31 mars 2020, Gjykata vendosi për rastin KO54/20 dhe konstatoi që Vendimi i lartcekur i Qeverisë nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e lëvizjes], 36 [E drejta e Privatësisë], 43 [Liria e tubimit] të Kushtetutës dhe nenet ekuivalente të KEDNJ-së, respektivisht nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit), dhe 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
226. Gjykata po ashtu konstatoi se bazuar në nenin 55 të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet “*vetëm me ligj*” të Kuvendit; dhe se neni 56 i Kushtetutës nuk ishte i aplikueshëm në rrethanat rastit KO54/20. Aktgjykimi i plotë i Gjykatës u publikua më 6 prill 2020; ndërkaq që më 31 mars 2020, Gjykata veçse kishte publikuar pjesën operative të Aktgjykimit dhe përfundimet e Gjykatës.
227. Gjykata vendosi që Aktgjykimi në rastin KO54/20 do të hynte në fuqi më 13 prill 2020. (Shih pjesën operative të Aktgjykimit në fjalë, cituar më lart, si dhe përfundimet e Gjykatës për atë rast, paragrafët 310-325). Në pjesën ku u elaborua arsyeshmëria e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës në një datë tjetër nga ajo e shpalljes së

Aktgjykimit, Gjykata, në mes tjerash po ashtu shpërfaqin rolin dhe përgjegjësinë institucionale të Kuvendit në dritë të nevojës për ballafaqim me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës, duke theksuar me sa vijon: “[...] Gjykata konstaton se deri në datën e shfuqizimit të Vendimit të kontestuar, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, **në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin veprimet**, në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, që i konsiderojnë si të duhura dhe adekuate për të vazhduar parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 – që në vetvete përbën një interes të lartë të shëndetit publik për të gjithë shtetasit dhe personat që jetojnë në Republikën e Kosovës.”

228. Në mes të datave 12-14 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë, nxori një numër Vendimesh. Më 17 prill 2020, në Gjykatë u dorëzua rasti KO61/20 nga parashtruesit e kërkesës të cilët kontestojnë katër (4) Vendime të Ministrit të Shëndetësisë, të nxjerra në vazhden e luftës me pandeminë COVID-19, vlerësimi i kushtetutshmërisë së të cilave u bë përmes këtij Aktgjykimi. Ndër pretendimet kyçe të parashtruesve të kërkesës ishte edhe fakti se Aktgjykimi i Gjykatës KO54/20, nuk ishte zbatuar dhe respektuar. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Avokati i Popullit.
229. Se çfarë ka ndodhur nga momenti i hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës e deri tani, në nivel të Kuvendit, Gjykata është e painformuar. Kjo për faktin se përkundër kërkesës specifike të Gjykatës drejtuar Kuvendit më 20 prill 2020 që të njoftojë Gjykatën rreth hapave “që janë ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas publikimit të Aktgjykimit KO54/20 të 31 marsit 2020”, Gjykata nuk ka pranuar ndonjë përgjigje, dokument ose informatë. Rrjedhimisht, për Gjykatën, ngelet akoma e paqartë trajtimi që Kuvendi i ka bërë Aktgjykimit KO54/20 që nga momenti i publikimit të tij. Ajo çfarë publikisht dihet bazuar në informatat e përditësuara të Gazetës Zyrtare, është se Kuvendi nuk ka miratuar ndonjë plotësim-ndryshim të ligjeve ekzistuese që adresojnë sëmundjet ngjitëse e as nuk ka miratuar ndonjë ligj të ri në të cilat do të mund të merreshin parasysh gjetjet e Gjykatës në Aktgjykimin KO54/20.
230. Gjykata, përkritazi me mos dorëzimin e përgjegjes të kërkuar nga Kuvendi lidhur me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KO54/20, thekson se, sipas nenit 26 [Bashkëpunimi me organet tjera publike] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, “Të gjitha gjykatat dhe organet publike të Republikës së Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj.” Për më tepër, edhe rregulli 66 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së punës parasheh që “Vendimet e Gjykatës

janë të obligueshme [...] për institucionet e Republikës së Kosovës” dhe se të gjithë personat fizikë dhe juridikë “janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t’u përmbahen atyre.”

231. Për më tepër dhe në fund, përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit KO54/20, Gjykata vë theks të veçantë në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, bazuar në të cilin, *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.”*

IV. Lidhur me parashtresën e Kryeministrit drejtuar gjyqtarëve të Gjykatës

232. Në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit ka informuar publikun se gjatë procedurave të shqyrtimit të rastit KO61/20, ka pranuar një parashtresë nga Kryeministri, në emër të Qeverisë, drejtuar gjyqtarëve të Gjykatës të emërtuar si: *“Parashtresë në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor dhe Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO61/20”*.
233. Për këtë parashtresë dhe me përmbajtjen e saj, si në rastin e të gjitha parashtresave tjera, janë njoftuar të gjithë gjyqtarët e Gjykatës si dhe të gjitha palët e interesuara në këtë rast, respektivisht: parashtguesit e kërkesës; Kryetarja dhe deputetët e Kuvendit; Presidenti; Avokati i Popullit; dhe Ministri i Shëndetësisë. Dërguesin e kësaj parashtrese, respektivisht Kryeministrin, Gjykata e ka njoftuar për pranimin e saj dhe e ka njoftuar që parashtresës në fjalë Gjykata do t’i përgjigjet në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës.
234. Gjykata ka publikuar përmbajtjen e parashtresës së dërguar nga Kryeministri në paragrafin 28 të këtij Aktgjykimi. Ajo gjithashtu tashmë ka dhënë përgjigjen e saj përkitazi me *“shqetësimin”* e Qeverisë për *“shkelje të një rëndësie esenciale në një procedurë gjyqësore kushtetuese”* lidhur me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në paragrafët 108-112 të Aktgjykimi. Në vijim, Gjykata gjithashtu do të adresojë të njëjtat *“shqetësim”* edhe lidhur me nenin 22.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
235. Gjykata në kontekst të nenit 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, fillimisht thekson se është i saktë fakti që dispozita e cekur nga Kryeministri, respektivisht, paragrafi 2 i nenit 22 të Ligjit parasheh që: *“Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Pala kundërshtare ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të*

dorëzuar në Sekretari përgjigjen e saj në kërkesë së bashku me arsyetimin dhe provat e nevojshme.”

236. Megjithatë, Gjykata thekson dhe qartëson se afati i përcaktuar dyzet e pesë (45) ditë nga dispozita e lartcekur është vetëm njëri nga afatet e aplikueshme përmes së cilave Gjykata ushtron funksionin e saj. I njëjti është afat i përgjithshëm i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 22 të pjesës I të Kreut II të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese lidhur me Dispozitat e përgjithshme procedurale. I njëjti Ligj, në Kreun III të tij, gjithashtu përcakton Procedurat e Veçanta. Në këto të fundit, përcakton edhe afate prej njëzet e katër (24) orësh dhe deri në gjashtëdhjetë (60) ditë brenda të cilave, Gjykata është e detyruar të vendos përkritazi me një kërkesën përkatëse. Pikërisht në mënyrë që Gjykata t’ua përshtatë vendimmarrjen e saj natyrës, specifikave dhe urgjencës që ngërthen një rast para saj, përfshirë kërkesat për masa të përkohshme, rregulli 33 i Rregullores së punës, dhe më saktësisht paragrafi 3 i tij, ndër tjera, përcakton kompetencën e Gjykatës, për të urdhëruar një afat më të shkurtër përkritazi me dorëzimin e shkresave përkatëse në një rast të caktuar, nëse në vlerësimin e Gjykatës, një kërkesë *“i nevojitet trajtim i përshpejtuar”*. Ky rregull specifikisht përcakton si në vijim: *“Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër, kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar.”*

237. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se rregulli i përgjithshëm i afatit dyzet e pesë (45) ditë referuar në nenin 22 të Ligjit, i nënshtrohet përjashtimeve të përcaktuara në këtë Ligj dhe Rregulloren e punës, dhe se bazuar në specifikat e rastit para saj, dhe vlerësimit nëse *“një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar”*, Gjykata përcakton afate tjera dhe të përshtatshme për rrethanat e rastit para saj.

238. Gjykata konsideron se kërkesat për vlerësimin e përputhshmërisë së akteve, në rrethanat e rastit konkret, të vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, me të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të saj dhe të garantuara përmes Kapitullit II të Kushtetutës, në rrethanat e pandemisë COVID-19, paraqesin *“një kërkesë që i nevojitet trajtim i përshpejtuar”* dhe se domosdoshmëria për një qasje të tillë nuk është kontestuese. Njëjtë ka vepruar Gjykata edhe në rastin paraprak, përkatësisht vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020, dhe i cili ka rezultuar në Aktgjykimin KO54/20 i publikuar më 6 prill 2020, brenda 13 ditëve nga regjistrimi i tij. Me të njëjtën urgjencë kanë vepruar edhe Gjykatat Kushtetuese të rajonit dhe më gjerë. Një qasje e tillë kërkohet edhe nga Këshilli i Evropës, në Dokumentin Informativ të tij të publikuar më 7 prill 2020, lidhur me respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin

e krizës sanitare të COVID-19, i cili ndër tjerash, thekson rëndësinë e vendimmarrjes së shpejtë nga gjykatat dhe veçanërisht gjykatat kushtetuese, në vlerësimin e përputhshmërisë së kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore më Kushtetutat përkatëse. Në fakt, në parashtrësën e dorëzuar në Gjykatë, Kryeministri, vet thekson se *“pret që Gjykata, ngjashëm sikurse institucionet ekuivalente me të në shtetet perëndimore, të tregojë kujdes të veçantë ndaj jetës dhe shëndetit të qytetarëve”*, përkundër faktit që përcaktueshmëria *“e pritjeve”* nga Gjykata, nuk është në kompetencën e pushtetit ekzekutiv.

239. Gjykata gjithashtu rikujton që tri (3) prej katër (4) Vendimeve të kontestuara para Gjykatës janë në fuqi vetëm deri më 4 maj 2020. Kërkesa para Gjykatës, ngërthen çështje të vlerësimit të kushtetutshmërisë të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë në rrethanat e pandemisë COVID-19. Sipas Kryeministrit, Gjykata do të duhej t'i jepte mundësi këtij të fundit dhe palëve të tjera për të dorëzuar komentet e tyre brenda një afati dyzet e pesë (45) ditore, respektivisht deri më 1 qershor 2020, respektivisht njëzet e tetë (28) ditë pas skadimit të Vendimeve të kontestuara.
240. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se asnjë palë në procedurë, e as Qeveria, nuk ka autorizim që të vet-përcaktojë afatet ligjore brenda të cilave duhet t'i përgjigjet Gjykatës. Është vetëm kjo e fundit ajo që mund të caktojë afate për palët bazuar në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Për më tepër që, siç u sqarua më lart, dhënia e një afati dyzet e pesë (45) ditore palëve për të dorëzuar shkresat e tyre, në rrethanat e rastit para Gjykatës, do të rezultonte në neglizhencë të plotë të Gjykatës, duke mos e trajtuar një rast të rëndësishëm së tillë kushtetuese me *“trajtim i përshpejtuar”*. Kjo do të ishte plotësisht në kundërshtim me mandatin e saj kushtetues për interpretimin e Kushtetutës në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe vlerave të Republikës.
241. Në fund, dhe përkitazi me qasjen që ngërthen parashtrësia e Kryeministrit drejtuar Gjykatës në emër të Qeverisë, dhe e cila, ndër tjerash, shpreh (i) *“shqetësimet e saj shkelje të dispozitave esenciale në lidhje me procedurën dhe afatet që duhet ndjekur”*; (ii) *“shqetësimet e saj në lidhje me shkeljen e dispozitave ligjore në lidhje me afatet e përcaktuara nga ligjdhënësi”*; (iii) *“shqetësim serioz në lidhje me profesionalizmin dhe paanshmërinë e Gjykatës”*; konstaton se (iv) *“Gjykata është shmangur nga procedura që do duhej të ndiqte në rastin Nr. KO61/20”*; (v) *“dy shkelje ligjore të një rëndësie esenciale në një procedurë gjyqësore kushtetuese”*; thekson se (vi) *“vënia nën presion të Qeverisë me njoftime të kundërligjshme, është i*

papranueshëm” dhe në fund, paralajmëron se (vii) “*Qeveria do të shqyrtojë me kujdes shkeljet ligjore të deritanishme dhe varësisht nga kualifikimi juridik i tyre do të ndërmarr veprimet e nevojshme të bazuara në legjislacionin në fuqi*”, Gjykata zgjedh vetëm të thekson fuqishëm se qasja e Qeverisë ndaj Gjykatës që reflekton kjo parashtrësë, është e papranueshme dhe në kundërshtim me vlerat themelore të Kushtetutës së Republikës.

242. Gjykata në këtë kontekst, rithekson se ajo është organ i pavarur në mbrojtje të Kushtetutës dhe është interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës. Gjykata gjithashtu rikujton se Kushtetuta i atribuon asaj pavarësi të plotë në kryerjen e përgjegjësiave të saj. Për më tepër, është detyrim kushtetues i Qeverisë dhe të gjitha institucioneve të Republikës të respektojnë dhe të mos ndërhyjnë në këtë pavarësi. Gjykata gjithashtu i rikujton Qeverisë se Kushtetuta nuk i atribuon asaj asnjë kompetencë përkitazi me vendimmarrjen e pushtetit gjyqësor. Respektimi i vlerave themelore kushtetuese lidhur me ndarjen e pushteteve, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, pavarësinë dhe autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit, është detyrim kushtetues i të gjitha degëve të pushtetit të Republikës së Kosovës.

V. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

243. Gjykata rikujton që përmes kërkesës së dorëzuar më 17 prill 2020, parashtruesit kishin kërkuar që të vendoset masë e përkohshme përmes së cilës do të pezullohej zbatimit i Vendimeve të kontestuara të Ministrit të Shëndetësisë deri në vendosjen e rastit në mënyrë meritore nga Gjykata.
244. Më 20 prill 2020, Gjykata ia kishte dhënë mundësinë Qeverisë, Kuvendit, me kërkesën që e njëjta mundësi t’iu ofrohet të gjithë deputetëve, Presidentit dhe Avokatit të Popullit që, deri në orën 16:00 të datës 21 prill 2020, të komentojnë në kërkesën e parashtruesve për caktim të masës së përkohshme. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata kishte pranuar komente vetëm nga Qeveria. Kjo e fundit e kishte kundërshtuar kërkesën e parashtruesve për caktim të masës nën pretendimin se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet për të caktuar masën e përkohshme të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës. (Shih paragrafët 60-67 të këtij Aktgjykimi ku reflektohen kërkesa e parashtruesve për masë të përkohshme; dhe komentet e dorëzuara në Gjykatë nga Qeveria përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme).

245. Duke qenë se Gjykata, me këtë Aktgjykim, tashmë ka vendosur për meritat e rastit në tërësi, kërkesa për masë të përkohshme ngelet e pa objekt shqyrtimi.

VI. Përfundimet

246. Më 31 mars 2020, Gjykata vendosi për rastin KO54/20 përmes të cilit Aktgjykim, e shpalli të pavlefshëm Vendimin nr. 01/15 të Qeverisë, duke konstatuar se i njëjti ishte në kundërshtim me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta e Privatësisë], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe nenet ekuivalente të KEDNJ-së, respektivisht nenet 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit), dhe 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
247. Në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata kishte theksuar se (i) Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës; dhe se (ii) Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, është e autorizuar që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, vetëm për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Gjykata gjithashtu kishte theksuar se këto dy ligje, nuk e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë, që të kufizojë të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa përjashtim.
248. Pas Aktgjykimit KO54/20, më 14 prill 2020, përmes tridhjetë e tetë (38) vendimeve për *“parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”*, Ministria e Shëndetësisë vendosi kufizime në të gjitha komunat e Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjykata në rastin e tanishëm, KO61/20, nuk është duke e bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë të të gjitha tridhjetë e tetë (38) Vendimeve të lartcekura, sepse parashtuesit e kërkesës nuk i kanë kontestuar të gjitha.
249. Para Gjykatës, janë kontestuar vetëm tri (3) prej tyre, Vendimet [nr. 229/IV/2020]; [nr. 238/IV/2020]; dhe [nr. 239/IV/2020] e datës 14 prill 2020, për Komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht. Para Gjykatës, gjithashtu është kontestuar edhe Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit *“zonë karantinë”*.

250. Si rrjedhojë, çështja kushtetuese që ngërthen Aktgjykimi KO61/20, është përputhshmëria me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës të katër (4) Vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjykata, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre, bazuar në nenin 55 të Kushtetutës, praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë Aktgjykimin KO54/20, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, ka vlerësuar nëse “*ndërhyrjet*”, përkatësisht kufizimet në lirinë e lëvizjes së qytetarëve të komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht: (i) janë të “*përcaktuara në ligj*”, përkatësisht në Ligjin nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse; (ii) ndjekin një “*qëllim legjitim*”; dhe (iii) janë të “*domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.
251. Bazuar në shqyrtimet dhe vlerësimet e shkresave të dorëzuara para Gjykatës dhe praktikës së saj gjyqësore, Gjykata, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën KO61/20 të pranueshme për shqyrtim në merita meqë, ishin plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
252. Gjykata gjithashtu vendosi që Vendimet “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunën e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, respektivisht, janë në përputhshmëri me Kushtetutën, me përjashtim të pikave përkatëse të dispozitivit të cilat përcaktojnë “*kundërvajtjet administrative*”, ndërsa Vendimin për shpalljen “*zonë karantinë*” në komunën e Prizrenit, e shpalli në kundërshtim me Kushtetutën.
253. Më saktësisht, Gjykata, njëzëri, vendosi se: (i) Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunën e Prizrenit (pikat I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII); dhe (ii) Vendimet [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunat e Dragashit dhe Istogut (pikat I, II, III, V, VI dhe VII), respektivisht, **janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, të gjitha pikat e saktësuara të Vendimeve të lartcekura, Gjykata i shpalli kushtetuese.
254. Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e Vendimeve të lartcekura, Ministria e Shëndetësisë, ka vepruar në përputhje me autorizimet e përcaktuara

përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, përmes pikave të lartcekura, ishin “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata gjithashtu konstatoi se të njëjtat ndjekin një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht atë të mbrojtës së “*shëndetit publik*”, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; janë proporcionale në raport me “*qëllimin legjitim*” të ndjekur; dhe janë “*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*”.

255. Megjithatë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi se: (i) pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” për komunën e Prizrenit; dhe (ii) pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19*” në komunat e Dragashit dhe Istogut, respektivisht, ku përcaktohen “*kundërvajtjet administrative*” dhe sanksionet përkatëse, **nuk janë në përputhshmëri** me nenin 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr.4 të KEDNJ-së. Gjykata arsyetoi se në përcaktimin e mosrespektimit të masave të parashikuara përmes Vendimeve të lartcekura si “*kundërvajtje administrative*”, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkalluar autorizimet ligjore të përcaktuara përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse. Gjykata theksoi se bazuar në Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, kundërvajtjet dhe sanksionet përkatëse, mund të përcaktohen vetëm me ligj të Kuvendit të Republikës ose me akte të Kuvendit të një Komune, dhe se ky autorizim nuk mund të bartet në organe të tjera. Rrjedhimisht, kundërvajtjet administrative të përcaktuara përmes këtyre tri Vendimeve të kontestuara, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*” dhe për pasojë, u shpallën jokushtetuese.
256. Gjykata, në anën tjetër, me shumicë votash, vendosi se Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, **nuk është në përputhshmëri** me nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e këtij Vendimi, Ministria e Shëndetësisë, ka tejkalluar kompetencat e përcaktuara përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe rrjedhimisht “*ndërhyrjet*” në të drejtën e lirisë së lëvizjes, përmes karantinimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit, nuk janë “*të përcaktuara në ligj*”. Gjykata qartësoi se “*karantina*” sipas Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin

dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mund të urdhërohet nga Ministria e Shëndetësisë, pas rekomandimit të IKSHPK-së, vetëm për persona fizikë për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshuar për sëmundje ngjitëse. Rrjedhimisht, Vendimi për shpalljen e komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, u shpall jokushtetues.

257. Për sa i takon kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se pas vendimit të gjyqtarëve që të vendosin në tërësi për meritat e rastit dhe të nxjerrin këtë Aktgjykim, e njëjta ngeli e pa objekt shqyrtimi.
258. Gjykata gjithashtu rikujtoi që përmes Aktgjykimit KO54/20, kishte përcaktuar një datë tjetër të hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj, respektivisht datën 13 prill 2020, duke theksuar se deri në këtë datë, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në radhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin masat e duhura për tu siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, të bëhen në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO54/20.
259. Gjykata vë theks në faktin që përkundër kërkesës specifike drejtuar Kuvendit për të njoftuar Gjykatën “*lidhur me të gjithë hapat që janë ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas publikimit të Aktgjykimit KO54/20 të 31 marsit 2020*”, Gjykata nuk ka pranuar një përgjigje nga Kuvendi. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht potencon faktin që është detyrim ligjor i të gjitha organeve publike që “*të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj*”. Për më tepër, Gjykata vë theks në faktin se bazuar në Aktgjykimin KO54/20, Kuvendi është detyruar që, qoftë përmes plotësim-ndryshimit të legjislacionit ekzistues të zbatueshëm ose përmes miratimit të ndonjë ligji të ri, të përcakton mekanizmat dhe autorizimet më të përshtatshme, në mënyrë që autoritetet përkatëse, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht Qeverinë, të ndërmarrin masat e duhura dhe të nevojshme për luftimin dhe parandalimin e pandemisë COVID-19, në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO54/20. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vë theks në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, bazuar në të cilin vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
260. Gjykata, në Aktgjykimin KO61/20, gjithashtu ka adresuar parashtresën e 23 prillit 2020 të Kryeministrit drejtuar Gjykatës në emër të Qeverisë, të titulluar “*parashtresë në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor dhe Rregullores së Punës së Gjykatës*

Kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO61/20”, përmes të cilës janë shprehur “shqetësimet” e Qeverisë për “shkelje të dispozitave esenciale në lidhje me procedurën dhe afatet që duhet ndjekur” nga ana e Gjykatës, duke theksuar gjithashtu që “Qeveria do të shqyrtojë me kujdes shkeljet ligjore të deritanishme dhe varësisht nga kualifikimi juridik i tyre do të ndërmarr veprimet e nevojshme të bazuara në legjislacionin në fuqi.”

261. Gjykata, këtë parashtresë, si dhe të gjitha të tjerat, e ka ndarë me palët e interesuara në këtë rast. E njëjta, është publikuar në tërësinë e saj bashkë me Aktgjykimin KO61/20, e i cili përmban edhe sqarimet e nevojshme përkitazi me këtë parashtresë. Megjithatë, Gjykata thekson fuqishëm se qasja e Qeverisë ndaj Gjykatës që reflekton kjo parashtresë, është e papranueshme dhe në kundërshtim me vlerat themelore të Kushtetutës së Republikës.
262. Gjykata rithekson se ajo është organ i pavarur në mbrojtje të Kushtetutës dhe është interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës. Gjykata gjithashtu rikujton se Kushtetuta i atribuon asaj pavarësi të plotë në kryerjen e përgjegjësisë së saj. Për më tepër, është detyrim kushtetues i Qeverisë dhe të gjitha institucioneve të Republikës të respektojnë dhe të mos ndërhyjnë në këtë pavarësi. Gjykata gjithashtu i rikujton Qeverisë se Kushtetuta nuk i atribuon asaj asnjë kompetencë përkitazi me vendimmarrjen e pushtetit gjyqësor. Respektimi i vlerave themelore kushtetuese, lidhur me ndarjen e pushteteve, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, pavarësinë dhe autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit, është detyrim kushtetues i të gjitha degëve të pushtetit të Republikës së Kosovës.
263. Gjykata në fund, thekson faktin se pavarësisht situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, dhe e cila ka afektuar mbarë botën, sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës duhet të mbizotërojnë. Këtë e ka theksuar edhe Këshilli i Evropës në Dokumentin Informativ SG/Inf(2020)11 të 7 prillit 2020 për Respektimin e Demokracisë, Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut në kuadrin e Krizës Sanitare të COVID-19, por edhe Opinionet e Komisionit të Venecias, përfshirë atë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në raste të Emergjencave dhe Listën e Kontrollit të Shtetit të së Drejtës. Të gjitha institucionet e Republikës janë të detyruara të veprojnë në përputhje të plotë me kompetencat përkatëse kushtetuese dhe ligjore si dhe në përputhje me Aktgjykimet e Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.2 (1) dhe 116 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 1 maj 2020,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË SHPALLË, njëzëri, që Vendimi [nr. 229/IV/2020] i 14 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në territorin e Komunës së Prizrenit (pikat I, II, III, IV, VI, VII dhe VIII), **është në përputhshmëri** me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË, njëzëri, që Vendimet [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] e 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në Komunitet e Dragashit dhe Istogut (pikat I, II, III, V, VI dhe VII), respektivisht, **janë në përputhshmëri** me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së;
- IV. TË SHPALLË, më shumicë votash, që pika V e Vendimit [nr. 229/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në Komunën e Prizrenit, dhe pika IV e Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19”* në Komunitet e Dragashit dhe Istogut, përkitazi me kundërvajtjet administrative, **nuk janë në përputhshmëri** me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së;
- V. TË SHPALLË, më shumicë votash, që Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e Komunës së Prizrenit *“zonë karantinë”*, **nuk është në përputhshmëri** me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës

në lidhje me nenin 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së;

- VI. TË SHPALLË, të pavlefshëm, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, pikën V të Vendimit [nr. 229/IV/2020] dhe pikën IV të Vendimeve [nr. 238/IV/2020] dhe [nr. 239/IV/2020], të cekura në pikën IV të këtij dispozitivi, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VII. TË SHPALLË, të pavlefshëm, në pajtim me nenin 116.3 të Kushtetutës, Vendimin [nr. 214/IV/2020] të cekur në pikën V të këtij dispozitivi, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IX. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- X. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

MENDIM MOSPAJTUES NË AKTGJYKIMIN KO 61/20 TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Bekim Sejdiu, gjyqtar

Duke shprehur fillimisht respektin tim për mendimin e shumicës së gjyqtarëve në këtë rast, më duhet të shprehë mospajtimin tim me konstatimin e Gjykatës Kushtetuese se Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 214/IV/2020, i 12 prillit 2020, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”, **nuk është në përputhshmëri** me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 35 [Liria e Lëvizjes] të Kushtetutës dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

Mospajtimi im me këtë konstatim të Gjykatës Kushtetuese (më tutje: Gjykata) mbështetet në dy argumente themelore: së pari, unë nuk jam pajtuar që Gjykata nuk ka shqyrtuar Vendimin në fjalë të Ministrisë së Shëndetësisë, nga prizmi i detyrimeve pozitive të shtetit, në raport me të drejtën për jetën. Së dyti, nuk pajtohem me qasjen që ka ndjekur Gjykata në interpretimin e atij Vendimi, në dritën e neneve përkatëse të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

1. Lidhur me mos trajtimin nga Gjykata të detyrimeve pozitive të shtetit në raport me të drejtën për jetën, në rrethana të Pandemisë COVID-19

- Gjykata ka shmangur trajtimin e kërkesës KO 61/20, nga prizmi i detyrimeve pozitive të shtetit kundruall të drejtës për jetën (neni 25 i Kushtetutës dhe 2 i KEDNJ). Jam i mendimit se çështja kryesore që është dashur të trajtohet nga Gjykata në këtë rast ka të bëjë me ekuilibrin në mes të detyrimit pozitiv të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetën, të rrezikuar nga pandemia COVID-19, kundruall detyrimit negativ për të mos cenuar lirinë e lëvizjes (nenin 35) dhe, potencialisht, disa të drejta të tjera (siç është liria e tubimit apo e drejta e privatësisë).
- Brenda këtij sfondi normativ, Gjykata është dashur të niset nga premisa themelore se vendimet e kontestuara (gjegjësisht katër vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë), ndërlidhen me detyrimin e shtetit për të ndërmarrë masa për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të rrezikuar në një situatë pandemie të rëndë globale, që ka cenuar edhe jetën edhe shëndetin e popullatës së Republikës së Kosovës.

- Në interpretimin tim, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO 54/20, i 23 marsit 2020 (shpallja si jo kushtetues i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/15), më të drejtë pati vënë në dukje se nuk kontestohet nevoja që të ndërmerren masa për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve nga pandemia. Sidoqoftë, vendimi i Qeverisë që kufizonte të drejtat e njeriut në nivel vendi, nuk kishte asnjë mbështetje ligjore. Megjithatë, gjithnjë sipas interpretimit tim, në atë Aktgjykim (KO54/20) Gjykata iu referua Ligjit për Parandalimi dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, si korniza ligjore kryesore për këtë situatë, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si dikasteri kryesor qeveritarë që Ligji në fjalë e veshte me autorizime për zbatimin e tij (në situatën e pandemisë COVID-19).
- E konsideroj shumë të rëndësishme të nënvizoj se autoritetet më të larta institucionale në fushën e të drejtave të njeriut, në nivel evropian dhe përtej, kanë vënë në pah se situata e pandemisë COVID-19 ka pasur efekte të thella në garantimin e të drejtave të njeriut. Kjo situatë ka shpërfaqur ekuilibrin e brishtë në mes të detyrime pozitive të shteteve për të ndërmarrë veprime proaktive për të mbrojtur të drejtën për jetën, kundruall detyrimit negativ për vetëpërmbytje, gjegjësisht për të mos ndërhyrë në lirinë e lëvizjes dhe një varg të drejtash tjera relative.
- Sjellë në vëmendje se, në lidhje me këtë, Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje: GJEDNJ), Linos-Alexandre Sicilianos, ka theksuar se: “përgjigja efektive e shteteve ndaj rrezikut për jetë dhe integritet personal të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 është pjesë e detyrimeve pozitive të shteteve për të mbrojtur të drejtën në jetë”.¹
- Dihet mirëfilli se jurisprudenca e GJEDNJ, sikundër edhe praktika e vendeve anëtarë të Këshillit të Evropës, i atribuon të drejtës për jetën (neni 2 i KEDNJ), statusin e një prej të drejtave më themelore, në hierarkinë e të drejtave të njeriut. Si e tillë, nga kjo e drejtë nuk mund të ketë shmangie (derogim), asnjëherë në rrethana paqeje, duke përfshirë edhe gjendjet e jashtëzakonshme. Një ndalesë të tillë e bënë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, gjegjësisht neni 56, i cili përcakton se, citoj: “*shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash*”.
- GJEDNJ ka disa vendime lidhur me detyrimet pozitive të shteteve për mbrojtjen e të drejtës për jetën, në rast të fatkeqësive të ndryshme natyrore (shih, për shembull, vendimet e GJEDNJ në rastet: *Budayeva* dhe *të tjerët kundër Rusisë; Oneryidiz kundër Turqisë*). Ky interpretim

¹<https://www.youtube.com/watch?v=HE8IZSgz8Uw>

i GJEDNJ pasqyron besnikërisht qëndrimin e patundur të saj se neni 2 i KEDNJ, i detyron shtetet që të mbrojnë të drejtën për jetën të personave që gjinden nën juridiksionin e tyre (*LCB kundër Mbretërisë së Bashkaur*, paragrafi 38). Kjo nënkupton edhe detyrimet pozitive, të cilat, në terma praktik, përfshijnë sidomos detyrimin për marrje të masave parandaluese (preventive), *vis-a-vis* rreziqeve ndaj jetës dhe të drejtës për jetën.

- Ky fakt thelbësorë përvijohet edhe në komentet dhe deklaratimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe institucioneve ndërkombëtare të cekura në këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Kështu, *Dokumenti Informativ SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020*, i Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, thekson se, citoj: *“Autoritetet ekzekutive duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet. Kjo mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta vendimmarrëse, si dhe lehtësimin e disa kontrolleve dhe balancave. Kjo mund të përfshijë, për aq sa lejon kushtetuta, edhe anashkalimin e ndarjeve standarde të kompetencave mes autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore [...]. Megjithatë, parlamentet duhet të vazhdojnë të kenë pushtetin për të kontrolluar veprimet e ekzekutivit, duke verifikuar në veçanti, në intervale të arsyeshme kohe, nëse kompetencat e ekzekutivit për gjendjen e emergjencës janë ende të justifikuara, ose duke ndërhyrë në mënyrë ad hoc për të modifikuar apo anuluar vendimet e ekzekutivit”.*²
- Siç mund të vërehet nga udhëzimet dhe deklaratimet e bëra nga Këshilli i Evropës dhe institucionet gjegjëse të të drejtave të njeriut, qasja që duhet përqafuar nga gjykatat në këto rrethana është shmangia e interpretimeve të ngurta të dispozitave përkatëse ligjore, për t’ia mundur shteteve/qeverive që të veprojnë me efikasitet për mbrojtjen e shëndetit publik.
- Kjo nuk do të thotë në asnjë rrethanë shmangie nga norma kushtetuese, e cila garantohet me vënien e theksit në rolin mbikëqyrës/kontrollues që duhet ta ushtrojnë, edhe në situatë të tillë emergjence, organet ligjdhënëse dhe gjyqësore.

2. Lidhur me interpretimin e gabuar nga ana e Gjykatës të Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për Shpalljen e Komunes së Prizrenit si “zonë karantinë”

²Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Këshilli i Evropës, Dokument Informativ SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020.

- Në diskursin doktrinar të gjyqësisë kushtetuese, sikundër dhe në jurisprudencën gjyqësore, janë të njohura disa teknika të interpretimit të teksteve kushtetuese dhe teksteve ligjore (origjinalizmi, tekstualizmi, interpretimi qëllimor, interpretimi pragmatik etj).
- Në rastin konkret, Gjykata, në përpjekje për të ndjekur një interpretim tekstual të Vendimit në fjalë të Ministrisë së Shëndetësisë, kundruall dispozitave përkatëse ligjore për shpalljen e “zonave të karantinës”, ka bërë një interpretim të ngurtë dhe kundërthënës.
- Vendimi [nr. 214/IV/2020] i 12 prillit 2020 i Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”, ka këtë përmbajtje:

“I. Komuna e Prizrenit shpallet zonë karantinë, pasi që banorët e kësaj komune dyshohen që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejt me personat e infektuar me corona virus COVID 19; II. Fshati Skorobisht në Komunën e Prizrenit shpallet Vatër e përhapjes së Infeksionit; III. Ndalohen hyrjet dhe daljet në Komunën e Prizrenit; IV. Obligohen të gjithë banorët e Prizrenit [të] respektojnë masat sipas udhëzimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK); V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër”.

- Nenit 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, përcakton se:

“(i) personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga murtaja, variola dhe ethet hemorragjike virale futen në karantinë; (ii) kohëzgjatja e mbajtjes së personave nga paragrafi 1 i këtij neni, në karantinë varet nga periudha maksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse; (iii) personat nga paragrafi 1 i këtij neni, i nënshtrohen kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së karantinës; (iv) Ministri i Shëndetësisë me propozim të IKSHPK merr vendim për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni; dhe (v) zbatimin e aktvendimit për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, e sigurojnë organet kompetente në nivel të vendit”.

- Në dritën e këtyre dispozitave, Gjykata me shumicë votash konstatoi se me nxjerrjen e Vendimit për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”, Ministri i Shëndetësisë ka tejkaluar autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe, rrjedhimisht, “ndërrhyrja” në të drejtën e

lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Komunës së Prizrenit nuk është “e përcaktuar në ligj”. Prandaj, Gjykata erdhi në përfundim se Vendimi në fjalë ka shkelur nenet 35 dhe 55 të Kushtetutës.

- Gjykata më shumicë votash pranoi argumentin se: “karantinimi” i të gjithë qytetarëve të Prizrenit nuk i plotëson kushtet ligjore sepse, citoj: “ (i) nuk aplikohet ndaj personave fizikë individualisht të përcaktuar, por ndaj të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit; (ii) të gjithë këta fundit, për qëllime të nenit 33 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, as nuk është ‘vërtetuar’ dhe as nuk mund të ‘dyshohet’ se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje; (iii) Vendimi përkatës nuk përcakton asnjë afat kohor brenda të cilit do të rishqyrtohet kohëzgjatja e karantinës, në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 33 të ligjit në fjalë, sepse i njëjti qartësisht përcakton afatin brenda të cilit është i lejuar karantimi dhe kjo ndërlidhet me periudhën maksimale të inkubacionit të sëmundjes përkatëse; dhe (iv) qytetarët e karantinuuar të komunës së Prizrenit, nuk i janë nënshtruar kontrollit të vazhdueshëm mjekësor që është kusht esencial në rast të karantimit, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur”.
- Sipas interpretimit të Gjykatës “karantina”, sipas Ligjit nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, mund të urdhërohet nga Ministria/Ministri i Shëndetësisë, pas rekomandimit të IKSHPK-së, vetëm për persona fizikë për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshuar për sëmundje ngjitëse.
- Interpretimi i mësipërm i Gjykatës, duke marrë si pikë referimi ekskluzivisht dhe vetëm termin “karantinë”, që përmendet dy herë në Vendim (në titull dhe në paragrafin I), e jo përmbajtjen dhe efektet e atij Vendimi, ka çuar në përfundimin e gabuar se neni 33 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse është e vetmja kornizë ligjore për të konstatuar se a ka, apo jo, Vendimi në fjalë mbështetje ligjore.
- Konsideroj se një interpretim i tillë është jo-kontekstual, nuk bënë ndërlidhje integrale të të gjitha dispozitave të Vendimit në fjalë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe, mbi të gjitha, nuk merr parasysh përmbajtjen dhe efektin e Vendimit, por emërtimin e tij.
- Kjo për faktin se paragrafët III dhe IV të Vendimit në fjalë përcaktojnë mënyrën e zbatimit të tij, por edhe efektin dhe kuptimin që ka termi

e “karantinimin” i Komunës së Prizrenit për qëllim të këtij Vendimi. Në këtë kontekst, paragrafi III qartëson se efekti i shpalljes së Prizrenit si zonë karantinë është “ndalimi i hyrjeve dhe daljeve nga Komuna e Prizrenit”. Ndërsa paragrafi IV ravigjëzon efektin tjetër të shpalljes së Prizrenit si zonë karantinë, duke përcaktuar detyrimin tjetër të banorëve të Prizrenit që të respektojnë masat sipas udhëzimeve të IKSHPK.

- Pra, sikur Gjykata të bënte një interpretim të integruar të tërë paragrafëve të Vendimit do të arrinte në përfundimin se, pavarësisht emërimit të gabuar (përdorimit të termit “karantinim”), në fakt efekti i vetëm real i tij NUK ka të bëjë fare me “karantinim” të personave, në objekte apo hapësira të caktuara fizike, ashtu si përcaktohet në ligj. Në thelb, efekti i vetëm i Vendimit është kufizimi i lirisë së lëvizjes nga dhe në Komunën e Prizrenit.
- Në këtë kuptim, Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për shpalljen e Komunës së Prizrenit si “zonë karantinë”, është përplotësues ndaj masave të tjera kufizuese që ka ndërmarrë Ministri i Shëndetësisë, përmes Vendimit *“për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunës”* së Prizrenit – Vendim ky të cilin Gjykata nuk e shpalli jo kushtetues. Madje Gjykata e thekson shkarazi edhe vet, në Aktgjykim se, citoj: *“Vendimi i kontestuar përkitazi me shpalljen e Komunës së Prizrenit ‘zonë karantinë’, përtej shpalljes së fshatit Skorobisht vatër të përhapjes së Infeksionit, nuk ka asnjë efekt tjetër për qytetarët e Prizrenit. Kjo sepse, i njejtë nuk saktëson asnjë detyrim tjetër për ta, përpos që ndalon ‘hyrjet dhe daljet’ në këtëkomunë.”*
- Një interpretim i tillë i Gjykatës Kushtetuese shpie në një situatë të palogjikshme, në kuptim juridik, ku Ministria e Shëndetësisë do të mund të mbante ne fuqi të njëjtin vendim që Gjykata Kushtetuese e shpallë si jo kushtetues, me të njëjtën përmbajtje, por vetëm duke ia ndërruar emërtimin përkatësisht vetëm duke ia hequr termin “karantinë” nga teksti i tij.
- Konsideroj se Gjykata Kushtetuese, me vendimet e saj, duhet të shmangë krijimin e situatave të tilla ku improvizimi terminologjik kamuflon përmbajtjen dhe efektin normativ të akteve të institucioneve publike.
- Duke ndjekur një interpretim terminologjik të Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë [nr. 214/IV/2020], Gjykata ka rënë në kundërthënie edhe me vet qasjen e saj tashmë të konsoliduar në interpretimin e

normave kushtetuese dhe ligjore. Gjykata tashmë ka një praktikë konsistente, sidomos për sa i përket interpretimit të akteve të parashikuara në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës (shih vendimet e Gjykatës në rastet KO73/16; KO12/18; dhe KO54/20KO 54/20). Në këto vendime, Gjykata ka theksuar se “aktet nuk cilësohen nga emërtimi por nga efekti i tyre kushtetues”.

- Këtë qasje Gjykata e ka ndjekur edhe për shpalljen të pranueshme të kërkesës së parashtruesëve në këtë rast (KO 61/20), ku ka potencuar se, citoj: *“Gjykata në këtë kontekst rikujton që përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së “dekreteve të Kryeministrit” dhe “rregulloreve të Qeverisë”, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka përcaktuar se përtej terminologjisë të referuar në Kushtetutë, janë ‘aktet’ e Kryeministrit dhe të Qeverisë, respektivisht, që mund të jenë objekt shqyrtimi para Gjykatës, në rast se përputhshmëria e tyre me Kushtetutën ngritet para Gjykatës përmes një pale të autorizuar të përcaktuar me Kushtetutë [...]Për pasojë, vlerësimi i kushtetutshmërisë, së akteve të Kryeministrit e Qeverisë, i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj, dhe bazuar në vlerësimin e Gjykatës, sipas praktikës së saj gjyqësore, përkitazi me ‘efektet’ e tyre dhe nëse të njëjtat ngrisin ‘çështje të rëndësishme kushtetuese’”.*
- Në dritën e interpretimeve të GJEDNJ dhe instancave tjera autoritative në fushën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, gjykatat nuk duhet ndjekur një qasje të ngurtë për sa i përket interpretimeve të normave ligjore. Kjo me qëllim që vendimet e gjykatave të mos bëhen pengesë për realizimin e detyrimeve pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe një varg të drejtash tjera që lidhen situata pandemie.
- Në këtë vazhdë, siç ka potencuar edhe vet Gjykata në Aktgjykimin KO54/20, emëruesi i përbashkët i kritereve të nevojshme për vlerësimin e “përcaktueshmërisë me ligj” të një akti të Qeverisë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, rezulton të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) “ndërhyrja” në një të drejtë dhe liri themelore duhet të këtë bazë ligjore; (ii) ligji përkatës, duhet të ketë cilësinë e duhur, përkatësisht, dhe në parim, duhet të jetë i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’ju mundësuar qytetarëve të rregullojnë sjelljen e tyre; këta të fundit duhet të jenë në gjendje, nëse kanë nevojë me këshilla të përshtatshme, për të parashikuar, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat e caktuara, pasojat të cilat mund t’i sjellë një veprim i caktuar; (iii) saktësia dhe preciziteti i ligjit është

e nevojshme, por gjithashtu mund të rezultojnë në “ngurtësi të tepërt”. Prandaj i njëjti duhet gjithashtu të ketë të mundur t’i përshtatet rrethanave të ndryshueshme, dhe i takon institucioneve përkatëse, gjykatave respektivisht, që të bëjnë interpretimin e tij.

- Një qëndrim të tillë, për sa i përket nevojës që gjykatat të kenë qasje elastike në interpretime të teksteve ligjore, GJEDNJ e ka theksuar në disa raste. Kështu, në rastin *Olivieira kundë Holandës* (ku një personi i ishte kufizuar liria e lëvizjes më një akt të autoriteteve lokale), Gjykata e Strasburgut vuri në dukje se, sipas praktikës së saj konsistente, një masë e pushtetit ekzekutiv që kufizon të drejtat e njeriut duhet të jetë e mbështetur në ligj, të ketë qëllim legjitim, të jetë përpjesëtimore (proporcionale) dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Për sa i përket kushtit të të qenit e “mbështetur në ligj”, GJEDNJ pranoi argumentin se “ligj”, në atë rast, mund të konsiderohej edhe Akti i Komunës (“Municipality Act”). Për më tepër, GJEDNJ theksoi se situatat që imponojnë nevojën që autoriteti lokal të lëshojë urdhra që kanë të bëjnë me sigurinë publike janë aq të ndryshme sa është e pamundur që të parashihihen [saktësisht] me ligj (shih paragrafin 54 të vendimit të GJEDNJ, në rastin *Olivieira kundë Holandës*). Një qëndrim të tillë GJEDNJ e ka përsëritur edhe në rastin *Leyla Sahin kundër Turqisë*. Në vendimin e saj, GJEDNJ ka nënvizuar se, “në lidhje me fjalët ‘në përputhje me ligjin’ dhe ‘të përcaktuara me ligj’, të cilat paraqiten në nenet 8 deri 11 të Konventës, Gjykata vëren se ka kuptuar gjithmonë termin ‘ligj’ në kuptimin e tij ‘thelbësor’, jo ‘formal’ (shih paragrafin 88 të vendimit të GJEDNJ në rastin *Leyla Sahin kundër Turqisë*).

Lidhur me efektin e Aktgjykimit të Gjykatës

- Në fund, dëshiroj të theksoj se unë jam pajtuar me konstatimet e Gjykatës si për pranueshmëri të kërkesës e po ashtu me gjetjen që vendimet “për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19” në Komunën e Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, janë në përputhshmëri me Kushtetutën, me përjashtim të pikave përkatëse të dispozitivit të atyre vendimeve të cilat përcaktojnë kundërvajtje administrative. Por mendoj se në të dyja këto pika, Aktgjykimit të Gjykatës i mungon arsytimi i mjaftueshëm dhe i qartë, për të shmangur çfarëdo amullie lidhur me efektet praktike të këtij Aktgjykimi.
- Si pasojë e paqartësisë së shkaktuar nga vet parashtruesit në kërkesë, Gjykata ka konstatuar se parashtruesit kontestojnë vetëm katër vendime, nga 38 vendime që janë marrë nga Ministria e Shëndetësisë, në të njëjtën kohë dhe, pak a shumë, të njëjtën përmbajtje. Konsideroj se Aktgjykimi i Gjykatës, që përfshinë vetëm 4 nga gjithsej 38 vendime, ka

prodhuar një situatë paradoksale, ne kuptimin juridik. Kjo sepse, edhe pas konstatimit nga Gjykata se një pjesë e masave të Ministrisë së Shëndetësisë janë jo kushtetuese, ato shfuqizohen vetëm në 3 nga 38 komunat e Kosovës (përveç nëse ato shfuqizohen nga vet Ministria/Ministri i Shëndetësisë). Pra, një qytetar i Kosovës që banon në cilindo nga qytetet tjera, përveç Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, mund të vazhdojë t'i nënshtrohet masave të njëjta të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat Gjykata Kushtetuese i ka shpallur jo kushtetuese.

- Për më tepër, jam i mendimit se, duke pasur parasysh sfondin e këtij rasti, Gjykata do duhej të trajtonte më në thellësi konstatimin se dispozitivi i vendimeve në fjalë të Ministrisë së Shëndetësisë që kanë të bëjnë me shqiptimin e kundërvajtjes administrative, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Mendoj se Gjykata është dashur të qartësoj ndërveprimin, në lidhje me këtë çështje, në mes të Ligjit për Kundërvajtje, Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse si dhe Kodit Penal (neni 250 i të cilit e sanksionon “mosveprimin sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë”). Shfuqizimi nga ana e Gjykatës e pikave përkatëse të dispozitivit të vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat përcaktojnë kundërvajtjet administrative, faktikisht ua marrin atyre vendimeve të Ministrisë të Shëndetësisë atributet detyruese, duke iu dhënë natyrë rekomanduese.
- Konsideroj që Gjykatat Kushtetuese, në çdo rast, por sidomos në situata të tilla ku rrezikohet jeta dhe shëndeti i qytetarëve, duhet të analizojnë me kujdes efektet e vendimeve të tyre. Ato vendime, në çdo situatë dhe për sa është e mundur, duhet të jenë të arsyetuara por edhe të arsyeshme.

Bekim Sejdiu

Gjyqtar

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHE

në

rastin nr. KO72/20

parashtrues

**Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës
së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të
Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të 30 prillit
2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Rexhep Selimi, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Arbërie Nagavci, Hekuran Murati, Fitore Pacolli, Hajrullah Çeku, Saranda Bogujevci, Jahja Koka, Mefail Bajçinovci, Valon Ramadani, Mimoza Kusari Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Arbër Rexhaj, Arbëresha Kryeziu Hyseni, Labinotë Demi Murtezi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Arta Bajraliu, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani, Fitim Haziri, Elbert Krasniqi, Eman Rrahmani, Salih Zyba (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të 30 prillit 2020 (në tekstin e mëtejme: Dekreti) me të cilin z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 14 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme *“mbi Dekretin në mënyrë që të parandalohen dëmet e pariparueshme për palën dhe institucionin”*.
5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë mbajtjen e seancës dëgjimore publike.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafi 2, nën-paragrafi 1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 prill 2020, rreth orës 17:00, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Në të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga

gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban (anëtarë).

9. Në të njëjtën ditë, Gjykata, përmes postës elektronike, njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës Presidentin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidenti); Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryetarja e Kuvendit), të cilës iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministrin e Republikës së Kosovës në detyrë (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri); si dhe, Avokatin e Popullit.
11. Gjykata i ka njoftuar të gjitha palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre: (i) lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, nëse kanë, duke pas parasysh urgjencën e rastit, t'i paraqesin në Gjykatë, deri më 1 maj 2020, në orën 12:00; ndërsa (ii) komentet lidhur me meritat e kërkesës, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë jo më vonë se më 8 maj 2020, në orën 16:00.
12. Më 1 maj 2020, para orës 12:00, Gjykata pranoi një shkresë nga Shefi i Grupit Parlamentar të Listës Serbe, deputeti Slavko Simić, përmes së cilës u kërkuar nga Gjykata që të jepet afat shtesë për të paraqitur komente lidhur me masën e përkohshme ngase kërkesën KO72/20 e kanë pranuar vetëm në gjuhën shqipe.
13. Në të njëjtën datë, Gjykata iu përgjigj deputetit Slavko Simić duke e njoftuar se kërkesa KO72/20 është pranuar në Gjykatë vetëm në gjuhën shqipe dhe se Gjykata e ka dërguar për përkthim urgjent menjëherë pas pranimi të saj. Gjykata ia dërgoi kopjen e plotë të kërkesës në gjuhën serbe, deputetëve në fjalë. Gjykata po ashtu miratoi kërkesën e tyre për shtyerje të afatit për dorëzim të komenteve për masë të përkohshme deri në orën 16:00 të datës 1 maj 2020.
14. Më 1 maj 2020, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata ka pranuar komente lidhur me masën e përkohshme nga palët në vijim: Presidenti, Kryetarja e Kuvendit, Kryeministri, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Arban Abrashi dhe deputeti Shkëmb Manaj.
15. Më 1 maj 2020, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 29 maj 2020,

respektivisht të pezullojë zbatimin e mëtejme të Dekretit të kontestuar të Presidentit.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.
17. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend, bazuar në listën vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:
 - a. Lëvizja VETËVENDOSJE!, 29 deputetë;
 - b. Lidhja Demokratike e Kosovës, 28 deputetë;
 - c. Partia Demokratike e Kosovës, 24 deputetë;
 - d. AAK-PSD Koalicioni 100% Kosovë, 13 deputetë;
 - e. Srpska Lista, 10 deputetë;
 - f. Nisma Socialdemokrate – Aleanca Kosova e Re, Partia e Drejtësisë, 6 deputetë;
 - g. Koalicija “Vakat”, 2 deputetë;
 - h. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
 - i. Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputetë;
 - j. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
 - k. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
 - l. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
 - m. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
 - n. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.
18. Më 26 dhjetor 2019, u konstituua Kuvendi.
19. Më 20 janar 2020, Presidenti nxori Dekretin me të cilin z. Albin Kurti, iu propozua Kuvendit si kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë.
20. Më 3 shkurt 2020, Kuvendi zgjodhi Qeverinë me Kryeministër z. Albin Kurti.
21. Më 20 mars 2020, një numër i deputeteve të Kuvendit dorëzuan në Kryesi të Kuvendit mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.
22. Më 25 mars 2020, Kuvendi, miratoi mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.
23. Pas kësaj date, Gjykata vëren se ka pasur komunikime të shkëmbyera rreth caktimit të mandatarit për formimin e Qeverisë. [*Sqarim i Gjykatës*: të gjitha komunikimet dhe shkëmbimet e letrave në fjalë do të reflektohen në vendimin përfundimtar të Gjykatës].

24. Më 30 prill 2020, Presidenti nxori Dekretin e kontestuar i cili përmban tri pika, si në vijim:

“1. Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

2. Kandidati nga pika I e këtij Dekreti, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

3. Dekreti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.”

25. Dekreti i lartcekur i Presidentit theksohet të jetë nxjerrë mbi bazën e:

- (i) paragrafëve (4) dhe (18) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës dhe nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës;
- (ii) nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
- (iii) Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO103/14 të 1 korrikut 2014; dhe
- (iv) në rrjedhë të propozimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të pranuar nga Zyra e Presidentit më 30 prill 2020.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Dekreti i kontestuar i Presidentit nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 14 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës e kundërshtojnë në tërësi Dekretin e kontestuar. [Sqarim i Gjykatës: të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me pranueshmërinë e kërkesës dhe meritat e saj në detaje do të paraqiten në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Në këtë Vendim për masë të përkohshme, Gjykata është fokusuar vetëm në kërkesën për masë të përkohshme].

Lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme

27. Lidhur me masën e përkohshme, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“masa e përkohshme [...] është në interesin publik, sepse një veprim i Kuvendit bazuar në dekretin kundër kushtetues të Presidentit [...] do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm palës, ngase: a) Qeveria që do të votohej bazuar në këtë dekret do të merrte vendime që prekin interesin publik të cilat pastaj do të shpalleshin nule nëse vetë dekreti është jo- kushtetues; b) Qeveria do të duhej të shfrytëzonte resurset publike/buxhetin, shfrytëzim ky që do të ishte i kundërligjshëm; c) Qeveria do të mund të ndërmernte veprime dhe masa që prekin të drejtat kushtetuese të qytetareve, shkaku i pandemisë; d) Nëse me skenarin që votohet qeveria bazuar në këtë dekret nr. 24/2020 dhe pas një-dy apo tre muajsh p.sh shpallet jo kushtetuese zgjedhja e Qeverisë, nga ai moment ajo qeveri duhet të ndërprejë çdo veprimtari. Në atë situatë, asnjë Qeveri nuk do të ishte në detyrë, e Kosova nuk mund të ngelë deri në zgjedhje të reja edhe pa Qeveri kujdestare, prandaj është e domosdoshme që para votimit të Qeverisë, të dihet përputhshmëria me Kushtetutën e asaj procedurë”* duke potencuar më tej, implikimet e mundshme ekonomike, ndërkombëtare si dhe dëmtimin e interesit publik.
28. Për të mbështetur argumentet e tyre ata thirren edhe në rastin e Gjykatës KO119/14 ku Gjykata kishte nxjerrë masë të përkohshme për të pezulluar vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit duke argumentuar se me rastin e zgjedhjes së Qeverisë rreziku për shkaktimin e dëmit dhe interesi publik është edhe më i madh.
29. Prandaj, parashtruesit konsiderojnë se kërkesa ka plotësuar kriterin e përcaktuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilat janë materializuar përmes vendimeve të Gjykatës që kërkesa e tyre të konsiderohet si *prima facie* e pranueshme dhe Gjykata të vendosë masën e përkohshme.
30. Rrjedhimisht, duke i marrë parasysh argumentet e paraqitura në përmbajtjen e kësaj kërkesë si dhe në bazë të nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të marrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme mbi pezullimin e efektin juridik të Dekretit të kontestuar në mënyrë që të parandalohen dëmet e pariparueshme për palën dhe institucionin, si dhe për të mbrojtur interesin publik.

Komentet e pranuar lidhur me masën e përkohshme

31. Brenda afatit të dhënë nga Gjykata, respektivisht deri më 1 maj 2020 në ora 12:00, komente lidhur me kërkesën e parashtruesve për vendosjen masës së përkohshme lidhur me aktin e kontestuar, kanë

paraqitur: Presidenti, Kryetarja e Kuvendit, Kryeministri, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Arban Abrashi dhe deputeti Shkëmb Manaj. Qëndrimet e tyre Gjykata do t'i praqes në mënyrë të përmbledhur në vazhdim.

32. Presidenti, në komentet e tij lidhur me kërkesën arsyeton, mes tjerash, se kërkesa e parashtrueseve lidhur me vendosjen e masës së përkohshme nuk i plotëson kushtet e parapara ligjore për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht parashtruesit nuk kanë treguar se rasti është *prima facie* i pranueshëm, nuk kanë dëshmuar se me zbatimin e aktit të kontestuar do të pësojë dëme të pariparueshme dhe nëse vendosja e masës së përkohshme do të ishte me interes publik. Presidenti, paraqiti qëndrimin e tij se kërkesa e parashtruesve nuk ofron argumente që dëshmojnë se Dekreti i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Po ashtu theksoi se formimi i “*një qeverie që ka legjitimitetin për të marr vendime të rëndësishme për qeverisjen e vendit [...] do të ishte në interesin publik.*” Kjo, sipas tij, duke marrë për bazë masat që duhet ndërmarrë me urgjencë lidhur me pandeminë COVID-19 por edhe duke marrë për bazë faktin që në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare “*vetëm një Qeveri me legjitimitet nga Kuvendi, mund t'i përfaqësoj interesat e Republikës së Kosovë brenda dhe jashtë vendit [...].*” Andaj, Presidenti kërkon që të refuzohet kërkesa për masë të përkohshme.
33. Kryetarja e Kuvendit në komentet e saj lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, arsyeton mes tjerash se masa e përkohshme është e nevojshme duke pasur parasysh kompleksitetin e procedurës kushtetuese për formimin e qeverisë dhe paqartësive mbi këtë procedurë. Ajo më tej arsyeton vendosjen e masës së përkohshme për shkak se vetëm në këtë mënyrë do të garantohet që Kuvendi i Kosovës, si institucioni më i lartë në sistemin tonë politik, nuk do të marrë vendime që mund të rezultojnë kundër kushtetuese, e që për pasojë do të dëmtonin rëndë besimin e publikut dhe vetë integritetin e këtij institucioni.
34. Kryeministri në përgjigjen e tij, lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, thekson se Qeveria vlerëson se Gjykata duhet të aprovojë masën e përkohshme pasi janë plotësuar kriteret ligjore, mes tjerash, pasi parashtruesit kanë dëshmuar se rasti është *prima facie* i pranueshëm, dhe gjithashtu, kanë dëshmuar se vendosja e masës së përkohshme është në interesin publik dhe i shërben administrimit të drejtësisë, respektivisht administrimit të rastit pa presion kohor. Kryeministri shton më tej se masat e përkohshme janë vendosur gjithmonë nga Gjykata në rastet kur para saj janë kontestuar pozitat kryesore të institucioneve shtetërore.

35. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në përgjigjen e tyre theksojnë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vendosjen e masës së përkohshme. Ata veçanërisht potencojnë faktin se nuk është e nevojshme vendosja e masës së përkohshme pasi sipas praktikës së Gjykatës edhe nëse akti i kontestuar do të shpallej jo-kushtetues, atëherë Gjykata do të mund të vendoste se efekti i vendimit do të ishte për të ardhmen dhe nuk do të kishte efekt prapaveprues, dhe rrjedhimisht nuk do të krijohen dëme të pariparueshme.
36. Deputeti Arban Abrashi në përgjigjen e tij lidhur me kërkesën për masë të përkohshme kërkon nga Gjykata që të hedhë poshtë kërkesën për masë të përkohshme dhe t'i hapë rrugë themelimit të një Qeverie të ligjshme dhe me mbështetje nga përfaqësuesit e sovranit, në mënyrë që Qeveria e re të jetë në gjendje të kryej funksionet dhe pritjet që ekonomia e vendit i ka në këto ditë të urgjencës dhe nevojës. Sipas tij, çdo shtyerje e afatit dhe njëkohësisht themelimit të Qeverisë së re me kapacitete të plota Kushtetuese, rrit dëmin ekonomik, shkakton pasoja të rënda ekonomike madje dëme të pariparueshme në ekonominë dhe shoqërinë kosovare.
37. Deputeti Shkëmb Manaj lidhur me kërkesën e parashtruesve për vendosjen e masës së përkohshme thekson se duke marrë parasysh faktin se marrja e masës së përkohshme është e nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave është në interes publik, në rastin konkret, jo që nuk përmbushen këto kritere ligjore për marrjen e masës së përkohshme, por përkundrazi, marrja e masës së përkohshme do bënte dëme të pariparueshme dhe do të ishte në kundërshtim të plotë me interesin publik, sepse, mes tjerash, Qeveria e shkarkuar nuk ka kapacitet për të ndërmarrë nisma ligjore dhe si rrjedhojë e kësaj nuk mundet që të menaxhojë gjendjen emergjente në vend për shkak të pandemisë me COVID-19. Andaj, ai kërkon nga Gjykata që të refuzojë kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

38. Për të bërë vlerësimin e kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret përkatëse, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
39. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se “Gjykata

Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

40. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;”

41. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet edhe neneve 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit që parashohin:

*Neni 29
Saktësimi i kërkesës*

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, [...].

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

*Neni 30
Afatet*

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrihet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

42. Gjykata po ashtu i referohet edhe rregullit 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

43. Gjykata i referohet po ashtu paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

“[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

[...]”

44. Gjithashtu, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.”

45. Në fund, Gjykata rikujton rregullin 57, paragrafët (4) dhe (6), të Rregullores së punës, që specifikojnë:

Rregulli 57 (4) i Rregullores së punës

[...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik
[...]

Rregulli 57 (6) i Rregullores së punës

“[...] Nëse kërkesa për masë të përkohshme ka paraqitur dëshmitë e nevojshme, qoftë tërësisht ose pjesërisht, Gjykata do ta miratojë kërkesën, duke paraqitur faktet dhe arsyet ligjore për të mbështetur vendimin dhe kohën gjatë të cilës masa e përkohshme do të jetë në fuqi. Nuk mund të merret vendim për masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Megjithatë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës [...]”

46. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, për tu shqiptuar një masë e përkohshme kërkohet që pala parashtruese së pari të tregojë rastin *prima facie* për meritat e kërkesës.
47. Lidhur me këtë kriter, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kanë arritur të tregojnë rastin *prima facie* para Gjykatës përmes pretendimeve të ngritura në kërkesë dhe arsyetim të tyre.
48. Përveç kriterit të parë procedural, të elaboruar më sipër, Ligji dhe Rregullorja e punës parashohin edhe dy baza të tjera, mbi të cilat mund të vendoset masa e përkohshme. Baza e parë ka të bëjë me kushtin që pala që kërkon masë të përkohshme të arrijë të dëshmojë se masa e përkohshme është e nevojshme “për tu evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme”. Ndërsa baza e dytë ka të bëjë me argumentimin, përkatësisht konstatimin që masa e përkohshme është me “interes publik.”
49. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesve ngritë një sërë çështjesh të nivelit kushtetues përkitazi me funksionimin

demokratik të institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe ndarjen e pushteteve. Të tilla çështje, pa vendosjen e masës së përkohshme, kanë potencial të shkaktojnë dëme të pariparueshme në aspekt të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe funksionimit të institucioneve kyçe në Republikën e Kosovës - në kuptim të nenit 116, paragrafi 2 të Kushtetutës, nenit 27 paragrafit 1 të Ligjit dhe rregullit 57, paragrafi (4) pika (b) të Rregullores së punës. Gjykata për rrjedhojë konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë dëshmuar se miratimi i kërkesës për masë të përkohshme është i domosdoshëm për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme.

50. Për më tepër, Gjykata konsideron se çështjet kushtetuese të ngritura në këtë kërkesë lidhur me respektimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese që rregullojnë funksionimin demokratik të institucioneve të themeluara me Kushtetutë dhe ndarjen e pushteteve janë të një rëndësie dhe natyre të atillë që pashmangshëm e bëjnë pezullimin e zbatimit të Dekretit të kontestuar, çështje të interesit publik. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ka arsye thelbësore të natyrës së interesit publik në kuptim të nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 57, paragrafi 4, pika (c), të Rregullores së punës, që justifikojnë miratimin e masës së përkohshme përkitazi me Dekretin e kontestuar. Në këtë aspekt, Gjykata konstaton se miratimi i kërkesës për masë të përkohshme është me interes publik për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj dhe i domosdoshëm për mbrojtjen e interesit publik.
51. Prandaj, Gjykata, pa asnjë paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës, përfundon se kërkesa e parashtruesve për masë të përkohshme përkitazi me Dekretin e kontestuar të Presidentit duhet të miratohet si e bazuar në përputhje me arsyetimin e këtij Vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 116.2 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 57 të Rregullores së punës, më 1 maj 2020, me shumicë votash

VENDOS

- I. TË MIRATOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 29 maj 2020, nga data e nxjerrjes së këtij Vendimi;
- II. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të 30 prillit 2020, në kohëzgjatje të përcaktuar në pikën I të këtij dispozitivi;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO72/20, Parashtrues: Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020

KO72/20, Aktgjykim i miratuar më 28 maj 2020

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, mocioni i mosbesimit, caktimi i mandatarit për formimin e Qeverisë, shpërndarja e Kuvendit, ndarja e pushteteve*

Kërkesa ishte parashtruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 113, paragrafi 2 nënparagrafi 1 të Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendonin se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës.

Në titullin **VIII – PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 546-580), Gjykata përmbledhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Në vlerësimin e Dekretit [nr. 24/2020] të 30 prillit 2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit “Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës”, Gjykata, vendosi: (i) njëzëri që kërkesa e parashtrueseve të kërkesës është e pranueshme; (ii) njëzëri që Dekreti i kontestuar i Presidentit është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, duke konstatuar rrjedhimisht, që votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi të Kuvendit ndaj Qeverisë, nuk rezulton në shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit dhe mundëson formimin e një Qeverie të re në pajtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës; (iii) me shumicë që Dekreti i kontestuar është në përputhshmëri me paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës; (iv) njëzëri që të shfuqizohet masa e përkohshme e përcaktuar përmes Vendimit të 1 majit 2020; dhe (v) njëzëri që të refuzohet kërkesa për seancën dëgjimore.

Gjykata rikujton se çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Dekretit të kontestuar të Presidentit të Republikës, përmes të cilit, z. Avdullah Hoti, i është propozuar Kuvendit të Kosovës për kandidat për Kryeministër. Në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të lartcekur, bazuar në pretendimet e

parashtruesve të kërkesës dhe argumentet e kundërshtimet e palëve tjera të interesuara, Gjykata fillimisht vlerësoi nëse pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit të votuar me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit më 25 mars 2020, Presidenti i Republikës, bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, ishte i detyruar të shpërndajë Kuvendin e Republikës dhe të shpall zgjedhjet e parakohshme. Më tej, Gjykata sqaroi procedurën që duhet ndjekur për formimin e një Qeverie të re, pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë në Kuvend dhe, po ashtu dha vlerësimin e saj nëse në rrethanat e rastit konkret, procedura e ndjekur për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë se re, ka rezultuar në një Dekret kushtetues.

Për të interpretuar përfundimisht nenet kushtetuese që ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret përkatësisht nenet 82, 95 dhe 100 të Kushtetutës, Gjykata, gjithashtu mori parasysh: (i) parimet kushtetuese mbi rolin e Kuvendit dhe të Presidentit; (ii) praktikën e saj gjyqësore, përfshirë Aktgjykimin KO103/14 dhe të gjitha rastet e cituara nga palët në procedurë; (iii) Opinione të Komisionit të Venecias; (iv) Analizën krahasimore të Kushtetutave, përfshirë ato të referuara nga parashtruesit e kërkesës; (v) përgjigjet e pranuar nga Gjykatat Kushtetuese/Supreme, pjesë të Forumit të Komisionit të Venecias; dhe (vi) dokumentet përgatitore për hartimin e Kushtetutës.

Gjykata, fillimisht rikujtoi se Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën ngase vetëm në atë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i tyre. Normat kushtetuese nuk mund të nxirren jashtë kontekstit dhe të interpretohen në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera. Struktura e normave kushtetuese që ndërlidhen me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jetësojnë dhe jo të bllokojnë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve përkatëse. Çdo paqartësi e normave duhet të interpretohet në frymën e Kushtetutës dhe vlerave të saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të bllokojë themelimin dhe funksionimin efektiv të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, dhe as mënyrën se si të njëjtat e balancojnë njëra tjetrën në aspekt të ndarjes së pushteteve.

Gjykata gjithashtu theksoi se të gjitha pushtetet dhe bartësit e funksioneve publike, pa përjashtim, kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike në shërbim të jetësimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës. Të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga

Kushtetuta, duhet të ushtrohen në shërbim të themelimit dhe mbarëvajtjes efektive të institucioneve shtetërore.

Sa i përket rregullimit kushtetues për shpërndarje të Kuvendit, Gjykata theksoi se Kushtetuta parasheh detyrimin e shpërndarjes së Kuvendit në rrethanat e paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës dhe mundësinë e shpërndarjes së Kuvendit në rrethanat e paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi. Më saktësisht, Kuvendi shpërndahet detyrimisht vetëm në tri raste: (i) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit për Kryeministër nga Presidenti, nuk mund të formohet Qeveria; (ii) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe (iii) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh prej fillimit të procedurës së zgjedhjes së Presidentit, nuk zgjedhet ky i fundit. Ndërsa, në rast të votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj një Qeverie, Presidenti ka mundësinë, por jo detyrimin të shpërndajë Kuvendin.

Mundësia e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin, nuk mund të ushtrohet në mënyrë të pavarur e as në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit, por duhet të ushtrohet në bashkërendim me vullnetin e shumicës së nevojshme të përfaqësuesve të popullit të përfaqësuar në Kuvend. Përdorimi i foljes “*mund*” në kontekst të paragrafit të 2 të nenit 82 të Kushtetutës reflekton vetëm mundësinë e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin, bazuar në konsultimet me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Një konstatim të tillë lidhur me kompetencat presidenciale që ndërlidhen me foljen “*mund*” [“*može*”/“*may*”] në kontekst të shpërndarjes së Kuvendit, konfirmohet edhe në Opinionet e Komisionit të Venecias të përfshira në këtë Aktgjykim.

Gjykata theksoi se Kuvendi është institucioni i vetëm në Republikën e Kosovës që zgjedhet drejtpërdrejt nga populli për një mandat katër (4) vjeçar. Përveç Kushtetutës, përfaqësuesit e popullit nuk i nënshtrohen asnjë pushteti tjetër dhe asnjë mandati detyrues. As Presidenti që është zgjedhur prej Kuvendit, nuk e ka kompetencën ta shpërndajë atë pa vullnetin e Kuvendit; e as ushtrimi i kompetencës së Kuvendit për shprehjen e mosbesimit ndaj një Qeverie që e ka zgjedhur vet, nuk mund të rezultojë edhe në përfundimin e mandatit të vet Kuvendit. Kuvendi nuk mund të kushtëzohet në shpërndarjen e vetvetes nëse zgjedh të shprehë mosbesimin ndaj një Qeverie të zgjedhur prej tij, pasi që mocioni i mosbesimit si mekanizëm i kontrollit kushtetues të Qeverisë nga Kuvendi si organ përfaqësues i popullit, nuk do të kishte asnjë kuptim. Një qasje e tillë është në kundërshtim me parimin kushtetues të kontrollit parlamentar të Qeverisë të mishëruar në paragrafin 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 8 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 97 [Përgjegjësia] të Kushtetutës dhe parimet themelore demokratike.

Pragu i lartë i votës së nevojshme për shpërndarje të Kuvendit nga vet deputetët reflekton peshën dhe rëndësinë që Kushtetuta ka përcaktuar për këtë qëllim. Krahës pragut më të lartë të paraparë për amendamentimin e Kushtetutës, e për të cilin kërkohet miratimi i dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, për shpërndarjen e Kuvendit, Kushtetuta ka përcaktuar prapun e radhës më të lartë të mundshëm, përkatësisht votën prej dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve të tij, të barabartë, ndër të tjera, me votën e nevojshme për bartje të sovranitetit të shtetit, siç është përcaktuar në nenin 20 të Kushtetutës. Për dallim, Kushtetuta për suksesin e një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë, ka përcaktuar prag më të ulët të votës së nevojshme, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) deputetë.

Po të mund të shpërndante Presidenti njëanshëm Kuvendin pas një mocioni mosbesimi, atëherë Presidenti do të kishte fuqinë e barabartë me dy të tretat (2/3) e votave të përfaqësuesve të popullit si dhe do të reduktonte në mënyrë arbitrare vullnetin e nevojshëm të dy të tretave (2/3) të deputetëve për shpërndarje të Kuvendit në vetëm gjashtëdhjetë e një (61) vota, aq sa janë të nevojshme për një mocion mosbesimi. Një fuqi të tillë, Presidentët, bazuar edhe në Opinionet e Komisionit të Venecias, nuk e kanë madje as në shumicën e shteteve me rregullim presidencial.

Në fakt, analiza e Kushtetutave tjera të reflektuara në këtë Aktgjykim, përfshirë edhe ato Kushtetuta që janë përdorur në argumentet e parashtruesve të kërkesës, Opinionet relevante të Komisionit të Venecias si dhe përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias, saktësojnë që asnjë Kushtetutë nuk përcakton shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit vetëm me faktin që është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi. Përkundrazi, votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi, rezulton në tri situata të mundshme: (i) zgjedhjen e menjëhershme të Kryeministrit të ri, në rastet kur Kushtetutat parashohin "*mocionin konstruktiv*"; (ii) edhe një mundësi shtesë për zgjedhjen e një Kryeministri; ose (iii) kthimin e kompetencës të Presidentit përkatës, për të ndjekur procedurat e përcaktuara për zgjedhjen e Qeverisë, për aq mundësi sa përcakton e njëjta. Në të gjitha këto vende, vetëm atëherë kur të jenë shteruar të gjitha mundësitë kushtetuese për zgjedhjen e një Qeverie të re, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e parakohshme.

Kompetenca e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, zbatohet drejtë, vetëm atëherë kur pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit të votuar nga më së paku gjashtëdhjetë e një (61) deputetë: (i) mungon shumica e nevojshme e deputetëve për të formuar një Qeveri të re dhe në të njëjtën kohë (ii) mungon

edhe shumica prej dy të tretave (2/3) të deputetëve, për t'u vet shpërndarë. Pra kjo mundësi, në njërën anë paraqet një mundësi shtesë për të formuar Qeveri brenda legjislaturës ekzistuese dhe për t'i shmangur zgjedhjet, ndërsa në anën tjetër, paraqet edhe mundësi zhbllokimi në rastet kur nuk ka vullnet dhe as shumicë të nevojshme për formim të një Qeverie të re nga Kuvendi brenda të njëjtës legjislaturë.

Deri më sot, neni 82 i Kushtetutës gjithmonë është zbatuar në këtë mënyrë, më saktësisht: (i) legjislatura e tretë dhe pestë, janë shpërndarë nga Presidenti në vitin e tretë të mandatit të tyre, në vitin 2010 dhe 2017, respektivisht, kur në Kuvend nuk ka pasur vullnet e as shumicë të nevojshme për të formuar një Qeveri të re; ndërkaq, (ii) legjislatura e katërt dhe gjashtë, në vitin 2014 dhe 2019, respektivisht janë vet shpërndarë me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve dhe kjo shpërndarje vetëm është dekretuar nga Presidentët përkatës.

Rrethanat e rastit konkret, dallojnë qartazi nga ato të legjislaturave të kaluara. Në këtë rast, (i) një mocion mosbesimi është votuar me dy të tretat (2/3) e të gjithë përfaqësuesve të popullit dhe të njëjtit nuk kanë nevojë për ndihmën e Presidentit për tu shpërndarë; dhe (ii) shumica e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, respektivisht edhe shumica e të zgjedhurve të popullit, janë deklaruar në favor të krijimit të një Qeverie të re pas shprehjes së mosbesimit ndaj Qeverisë në detyrë/dorëheqje. Shpërndarja e Kuvendit nga Presidenti kundër vullnetit të përfaqësuesve të popullit do të ishte arbitrare e qartazi kundërkushtetuese. Përkundrazi, Presidenti ka qenë i detyruar të fillojë procedurat për t'i dhënë mundësinë formimit të një Qeverie të re bazuar në dispozitat e nenit 95 të Kushtetutës.

Mënyra e zgjedhjes së Qeverisë në Kushtetutën e Kosovës është e përcaktuar përmes nenit 95. Procedura që duhet ndjekur për zgjedhjen e një Qeverie është sqaruar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO103/14. Gjykata u qëndron parimeve të përcaktuara përmes atij Aktgjykimi. Ai ka sqaruar që për formimin e një Qeverie, Kushtetuta përcakton dy mundësi. E drejta e parë për formimin e Qeverisë, i takon *“partisë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht partisë politike ose koalicionit fitues të zgjedhjeve. Presidenti nuk ka diskrecion lidhur me të drejtën e kësaj partie politike ose koalicioni për të propozuar kandidatin për Kryeministër dhe vetëm e mandaton të njëjtin. Në rast të dështimit të zgjedhjes së kësaj Qeverie në Kuvend apo refuzimit të këtij mandati nga partia politike ose koalicioni fitues, e drejta për formimin e Qeverisë, kalon te partia politike ose koalicioni i përfaqësuar në Kuvend, që në diskrecionin e Presidentit, ka gjasat më të mëdha për të formuar Qeverinë në mënyrë që të shmangen zgjedhjet. Ndërsa, dështimi i këtyre dy mundësive, rezulton në detyrimin e Presidentit për të shpallur zgjedhjet, siç është përcaktuar në Kushtetutë.

Neni 95 i Kushtetutës përcakton procedurën për zgjedhjen e një Qeverie përgjatë një cikli zgjedhor. I njëjti, përcakton dy mundësi për zgjedhjen e një Qeverie, sikur pas zgjedhjeve ashtu edhe pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë. Gjykata ka sqaruar se efekti i dorëheqjes së një Kryeministri rezulton në dorëheqjen e një Qeverie, ashtu siç rezulton edhe efekti i votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi për “*Qeverinë në tërësi*”, në dorëheqjen e të njëjtës. Një qëndrim i tillë, është gjithashtu në përputhshmëri me Analizën Krahimore, Opinionet e cituara të Komisionit të Venecias dhe kontributin e dorëzuar në Gjykatë nga anëtarët e Forumit të Komisionit të Venecias, sipas të cilave, pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, Kryeministri/Qeveria janë në dorëheqje, dhe aktivizohet neni kushtetues përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë, me përjashtim të atyre rasteve që e kanë të parashikuar “*mocionin konstruktiv*”, ose kanë paraparë vetëm edhe në mundësi për zgjedhjen Kryeministrit/Qeverisë, pas mocionit përkatës.

Prandaj, në të gjitha rastet kur dorëheqja e Kryeministrit apo mbetja e postit përkatës i lirë për arsye tjera, ka rezultuar në rënien e Qeverisë edhe kur dorëheqja e Qeverisë është rezultat i një mocioni të suksesshëm mosbesimi, me kushtin që pas këtij mocioni nuk ka pasuar shpërndarja e Kuvendit sipas parimeve të sqaruara më lart, aktivizohet paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës, i cili detyron Presidentin për të mandatuar kandidatin e ri për Kryeministër. Partia politike ose koalicioni i cili e ka të drejtën e parë të propozimit të mandatarit për Kryeministër dhe formimit të Qeverisë është sërish partia politike ose koalicioni fitues. Për formimin e kësaj Qeverie duhet të ndiqet procedura e përcaktuar përmes paragrafit 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës, ndërsa, dështimi i marrjes së votave të nevojshme në Kuvend apo refuzimi i këtij mandati, kalon të drejtën e formimit të Qeverisë te një parti politike ose koalicion që mund të ketë shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës dhe sipas parimeve të përcaktuara në Aktgjykimin KO103/14. Gjykata sqaron se përmes Aktgjykimit KO103/14, asnjëherë nuk ka përcaktuar se partia politike ose koalicioni fitues, ka të drejtën ekskluzive dhe të vetme për të propozuar mandatarin për Kryeministër dhe për të formuar Qeverinë.

Gjykata gjithashtu thekson se kompetenca e Kuvendit për të zgjedhë dhe shprehë mosbesimin ndaj Qeverisë është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës dhe zbatohet përmes neneve 95 dhe 100 të Kushtetutës, për Zgjedhjen e Qeverisë dhe Mocionit të Mosbesimit, respektivisht. Ky i fundit, është një ndër mekanizmat më thelbësor të ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë dhe rrjedhimisht edhe balancimit të pushteteve. Legjitimiteti demokratik i një Qeverie të zgjedhur nga një Kuvend, buron nga besimi që përfaqësuesit e popullit i mveshin me rastin e zgjedhjes së saj. Ky

besim pushon në momentin kur shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të kenë votuar kundër tij. Për pasojë, ajo humb besimin e përfaqësuesve të popullit, dhe rrjedhimisht edhe autoritetin kushtetues për të ushtruar kompetencat përkatëse.

Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, më 25 mars 2020, ishte votuar një mocion mosbesimi me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, kundër Qeverisë së udhëhequr nga partia politike fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. E njëjta parti politike, për dallim prej shumicës së Kushtetutave të analizuara e të reflektuara në Aktgjykim, pas votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, sërish ka të drejtën e parë për propozimin e kandidatit për Kryeministër. Një propozim të tillë kjo parti politike nuk e ka bërë edhe pas (4) katër kërkesave të Presidentit, duke filluar prej datës 2 prill 2020 deri në datën 22 prill 2020. Partia politike në fjalë, përkatësisht Lëvizja VETËVENDOSJE!, në thelb, pretendon se: (i) pas mocionit të mosbesimit, Presidenti detyrohet të shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e parakohshme; dhe se (ii) nuk ka afat kushtetues për propozimin e mandatarit për Kryeministër, rrjedhimisht, është në diskrecionin e plotë dhe të paafatizuar të partisë politike fituese, për të propozuar mandatarin për Kryeministër dhe atë *“vetëm atëherë kur të jenë plotësuar kushtet politike, administrative dhe teknike”*. Për pasojë, si çështje vlerësimi të këtij Aktgjykimi është edhe: (i) afati brenda të cilit duhet të propozohet kandidati për Kryeministër; dhe (ii) nëse mos propozimi i këtij kandidati nga partia politike që ka të drejtën e parë të propozimit, reflekton refuzimin e marrjes së mandatit për Kryeministër.

Për sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të bëhet propozimi për kandidatin për Kryeministër, Gjykata ka theksuar i njëjti duhet të analizohet në kuptim të: (i) sistemit të afateve kushtetuese që Kushtetuta ka përcaktuar për qëllime të formimit të Qeverisë; dhe (ii) natyrës së *“konsultimit”* në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit me të drejtën për të propozuar mandatarin për Kryeministër, përfshirë përgjegjësitë dhe detyrimet reciproke në mes tyre, për qëllime të caktimit të të njëjtit.

Së pari, Gjykata theksoi se caktimi i mandatarit nga Presidenti rezulton në rrjedhjen e dy lloj afatesh paralele kushtetuese: (i) atë të shpërndarjes së Kuvendit nëse zgjedhja e Qeverisë nuk bëhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga marrja e mandatit; dhe (ii) atyre të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës, që ndërlidhen me dy mundësitë për formimin e Qeverisë, respektivisht afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor brenda të cilit kandidati për Kryeministër paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit; (iii) afatin dhjetë (10) ditor, brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, në rast se kandidati i parë për Kryeministër dështon t'i sigurojë votat e nevojshme në Kuvend apo edhe e

refuzon mandatin përkatës; dhe (iv) duke iu referuar “*procedurës së njëjtë*”, afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë, brenda të cilit kandidati tjetër për Kryeministër, paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin e saj nga ana e Kuvendit. Këto afate të sakta reflektojnë qëllimin dhe rëndësinë që Kushtetuta i ka dhënë themelimit të shpejtë të Qeverisë, duke përcaktuar afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë, për kandidatin për Kryeministër, për të negociuar dhe arritur marrëveshjet për të siguruar votat e nevojshme të deputetëve të Kuvendit për Qeverinë e propozuar; dhe gjithashtu afatin gjashtëdhjetë (60) ditë për formimin e një Qeverie, dhe pasojën përkatëse të shpërndarjes së Kuvendit nëse ky afat nuk respektohet.

Së dyti, Gjykata rikujtoi që në Aktgjykimin KO103/14, ajo ka bërë dallimin përkitazi me natyrën e “*konsultimit*” në mes Presidentit dhe partisë politike apo koalicionit me të drejtën për të propozuar mandatarin e parë dhe të dytë. Në rastin e parë, Presidenti nuk ka diskrecion dhe është plotësisht e qartë se cila është partia politike ose koalicioni i cili propozon mandatarin për Kryeministër, rrjedhimisht ky “*konsultim*” ngërthen një proces krejtësisht formal dhe teknik ndërmjet Presidentit dhe partisë apo koalicionit fitues, për propozimin e një mandatarit dhe mandatimin e të njëjtit. Për dallim nga kjo, në rastin e dytë, nuk është e qartë se cila është partia politike ose koalicioni me të drejtën e propozimit të mandatarit, gjë që mbetet në diskrecion të Presidentit për t’u konsultuar me të gjitha partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuar në Kuvend për të vlerësuar se cila ka gjasën më të madhe për të formuar Qeverinë, në mënyrë që të shmangen zgjedhet. Rrjedhimisht, ky proces “*konsultimi*” është më kompleks sesa në rastin e parë dhe megjithatë Kushtetuta përcakton detyrimin për Presidentin që ushtrimin e këtij diskrecioni, ta zbatojë në afat dhjetë (10) ditë.

Prandaj, në kontekst të: (i) rëndësisë së pakontestueshme të funksionimit efektiv të një Qeverie si një ndër tri shtyllat themelore të pushtetit shtetëror; (ii) sistemit të afateve të sakta dhe të shkurtër të përcaktuara në Kushtetutë lidhur me formimin e një Qeverie; (iii) natyrën krejtësisht të qartë dhe teknike e formale të “*konsultimit*” në mes të Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit fitues, për qëllim të caktimit të mandatarit të parë; dhe (iv) kufizimin e afatit kushtetues në dhjetë (10) ditë për qëllime të caktimit të mandatarit të dytë përmes një “*konsultimi*” shumë më kompleks, Gjykata thekson që mos saktësimi i afateve në Kushtetutë përkitazi me propozimin e kandidatit të parë për Kryeministër nga partia politike ose koalicioni fitues, nuk nënkupton diskrecionin dhe të drejtën e këtyre të fundit për të mos vepruar në afat të pakufizuar kohor. Përkundrazi, fryma e Kushtetutës reflekton qëllimin e qartë dhe të vetëkuptueshëm të nevojës për veprime të shpejta.

Në këtë kuptim, Gjykata vëren se një afat përkitazi me përcaktimin e mandatarit për Kryeministër nuk është saktësuar në Kushtetutë jo vetëm për

partinë politike ose koalicionin fitues për propozim të mandatarit, por as afatin brenda të cilit Presidenti detyrohet të dekretoj mandatarin e propozuar, apo përcjelljen e të njëjtit në Kuvend. Gjykata thekson që caktimi i mandatarit për Kryeministër, nuk përfshinë vetëm detyrimin e Presidentit për të dekretuar atë dhe as vetëm të drejtën e partisë politike fituese për të propozuar këtë mandatar, por përfshinë edhe detyrimin e kësaj të fundit, për të propozuar ose refuzuar që të propozoj kandidatin për Kryeministër. Më saktësisht, përcaktimi i mandatarit për Kryeministër, ngërthen detyrimin e bashkëpunimit reciprok të Presidentit dhe partisë politike fituese në këtë proces. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën teknike dhe formale të “konsultimit” për qëllime të caktimit të mandatarit të parë, e cila vënë në lëvizje procesin e formimit të Qeverisë dhe afatet e parapara me Kushtetutë, Gjykata thekson se është e vetëkuptueshme, që ky “konsultim” formal, duhet të përmbyllet sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe ngërthen në vetvete kërkesën për dinamikë të shpejtë ndërveprimi.

Në të kundërtën, të gjitha normat e lartcekura kushtetuese lidhur me afatet dhe qëllimet që ngërthejnë ato lidhur me formimin e Qeverisë, do të ishin pa asnjë efekt dhe plotësisht të panevojshme. Zgjedhja e Qeverisë do të mbetej peng i “afateve të pakufizuara” e në diskrecion të plotë të partisë politike ose koalicionit fitues apo edhe të Presidentit. E para, do të mbante peng formimin e Qeverisë, duke u thirrur në diskrecion të plotë dhe të paafatizuar për të bërë propozimin për mandatar për Kryeministër, ndërsa Presidenti po ashtu, do të thirrej në diskrecionin e plotë dhe të paafatizuar për ta dekretuar të njëjtin. Ky “diskrecion i plotë dhe i paafatizuar kohorë”, në ndërkohë ndërlidhet me zgjedhjen e Qeverisë, kompetencë kjo e një pushteti tjetër, përkatësisht Kuvendit. Një qasje dhe interpretim i tillë, do të ishte arbitrar dhe qartazi në kundërshtim me strukturën e normave kushtetuese, qëllimin e frymën e saj por edhe në kundërshtim me parimet themelore të një demokracie parlamentare. Gjykata, në këtë aspekt gjithashtu thekson se përkundër pretendimeve të parashtruesve që ndërlidhen me zgjatjen e procedurave për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, me theks në situatën e vitit 2014 lidhur me zgjatjen e procesit të konstituimit të Kuvendit, Gjykata në Aktgjykimin KO119/14, nuk ka trajtuar çështjen e afateve kohore që ndërlidhen me konstituimin e Kuvendit, pasi të njëjtat nuk ka qenë objekti i shqyrtimit në Gjykatë.

Lidhur me mungesën e propozimit të mandatarit për Kryeministër nga partia politike fituese e zgjedhjeve, Gjykata, në këtë Aktgjykim, ka analizuar shkëmbimin e letrave në Kryetarit të partisë politike fituese, njëherësh Kryeministër në detyrë dhe Presidentit. Këto shkresa reflektojnë dy karakteristika: (i) kërkesën e Presidentit për propozimin e kandidatit për Kryeministër në njërën anë; dhe (ii) mungesën e propozimit dhe kërkesën për shpërndarje të Kuvendit dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, në anën tjetër.

Gjykata, në këtë Aktgjykim ka theksuar se: (i) për qëllime të “konsultimit” për përcaktimin e mandatarit në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit fitues, relevante është vetëm propozimi i kandidatit për Kryeministër dhe mandatimi i tij/saj; dhe (ii) ky “konsultim” nuk mund të përfshijë as çështje që ndërlidhen me shpërndarjen e Kuvendit e as shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme, sepse, asnjëra nga këto çështje nuk është as në kompetencën ekskluzive të Presidentit, as të partisë fituese të zgjedhjeve e as të Qeverisë në detyrë/dorëheqje. Kjo sepse, është e qartë se: (i) rastet e shpërndarjes së detyrueshme e Kuvendit janë të përcaktuara saktë në Kushtetutë; (ii) mundësia e shpërndarjes së Kuvendit nga Presidenti, siç është sqaruar tashmë, nuk është kompetencë që ushtrohet nga Presidenti pa bashkërendim me të gjitha partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend, dhe jo vetëm me atë që ka fituar zgjedhjet; dhe (iii) Qeveria nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese as lidhur me shpërndarjen e Kuvendit e as shpalljen e zgjedhjeve. Përkundrazi, lidhur me këto dy çështje, roli i partive politike ose koalicioneve të përfaqësuara në një Qeveri, është i barasvlershëm vetëm në fuqinë e tyre që e kanë përmes përfaqësimit në Kuvend. Vullneti i shumicës së Kuvendit në rrethanat e rastit aktual, qartazi i ka pamundësuar Presidentit shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme.

Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, partia politike që ka udhëhequr Qeverinë ndaj të cilës është votuar një mocion mosbesimi nga Kuvendi, nuk ka bërë një propozim për mandatar tjetër për Kryeministër për qëllim të formimit të Qeverisë së re. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata asnjëherë nuk e kanë refuzuar shprehimisht marrjen e këtij mandati.

Përkritazi me mundësinë refuzimit të marrjes së mandatit, Gjykata rikujton që në Aktgjykimin KO103/14, ajo kishte konstatuar se “*nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin*”. Përkundër faktit që nuk ishte çështje në rastin para Gjykatës në vitin 2014, ajo e kishte parashikuar mundësinë e refuzimit, pikërisht për të pamundësuar bllokimin e mundshëm të themelimit të Qeverisë në të ardhmen. Ky Aktgjykim, megjithatë nuk kishte saktësuar mënyrën në të cilën mund të bëhet refuzimi i mandatit përkatës. Prandaj, pretendimi i parashtruesve se “*Gjykata ka thënë se Presidenti mund të anashkalojë fituesin e zgjedhjeve, vetëm nëse ky heq dorë shprehimisht nga e drejta e tij por në asnjë rrethanë tjetër*”, nuk është i saktë. Kjo sepse, edhe autorizimi për partinë politike fituese që refuzimin e marrjes së mandatit ta bëjë vetëm shprehimisht, pra mundësia të mos propozoj një emër për mandatar dhe në të njëjtën kohë të mos e refuzoj këtë të drejtë shprehimisht, do ta mveshte partinë politike fituese me të drejtën për të bllokuar procesin e caktimit të mandatarit nga Presidenti.

Një mundësi e tillë do ta pamundësonte zbatimin e kompetencës së Presidentit për caktimin e një mandatarit dhe propozimin e të njëjtit

Kuvendit, duke pamundësuar njëkohësisht dhe ushtrimin e kompetencës së Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë. Përkundrazi, siç është sqaruar tashmë, caktimi i mandatarit për Kryeministër kërkon ndërveprimin e menjëhershëm në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësiwe reciproke në mes Presidentit dhe partisë ose koalicionit fitues. Prandaj, refuzimi në fakt nënkupton mos ndërmarrjen veprimeve me qëllim të përmbushjes së këtij detyrimi, përkatësisht mungesën e veprimeve konkrete dhe propozimit të kandidatit për Kryeministër nga partia ose koalicioni fitues. Kushtetuta dhe fryma e saj përcaktojnë se kjo e drejtë dhe njëkohësisht detyrim, si për partinë e parë ashtu edhe për Presidentin, nuk mund të abuzohet dhe duhet të ushtrohet në mirëbesim dhe në funksion të formimit të Qeverisë.

Nga shkëmbimi i shkresave zyrtare në mes Presidentit dhe partisë politike fituese, në këtë rast, jo vetëm që nuk ka propozim për mandatar, por nuk reflektohet as edhe një indikacion i vetëm lidhur me qëllimin për të propozuar një mandatar për Kryeministër. Përkundrazi, kërkesa e këtyre shkresave është shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme. Këto kërkesa përjashtojnë mundësinë e propozimit të një mandatarit për Kryeministër.

Në rrethana në të cilat është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi me dy të tretat (2/3) e përfaqësuesve të popullit dhe mundësisë për formimin e një Qeverie të re, po të konfirmoheshin pretendimet rreth: (i) afatit të pakufizuar kohor dhe në diskrecion të plotë të partisë politike fituese, dhe (ii) të drejtës që vetëm shprehimisht të refuzohej mandati për Kryeministër, të kombinuara më kërkesën e vetme për shpërndarje të Kuvendit dhe shpallje të zgjedhjeve të parakohshme, formimi i një Qeverie do të bllokohej në pafundësi, duke mbajtur në detyrë Qeverinë që ka humbur besimin e përfaqësuesve të popullit. Kjo nuk është fryma e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Presidenti, duke balancuar detyrimin e tij për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, përfshirë në këtë kontekst edhe të drejtën e Kuvendit për zgjedhur Qeverinë, siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës, në njërën anë, dhe në anën tjetër, duke marrë parasysh që partia politike fituese e zgjedhjeve, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim të vetëm drejt propozimit të mandatarit për Kryeministër përkundër kërkesave të Presidentit, por kishte vazhduar të kërkonte shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, përkundër faktit që shumica e partive politike ose koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend tashmë ishin deklaruar kundër kësaj mundësie, duke i pamundësuar Presidentit ushtrimin e kompetencës së përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, me të drejtë ka konstatuar shterimin e mundësive kushtetuese për të përcaktuar një kandidat për Kryeministër nga partia politike fituese e zgjedhjeve. Si rezultat

kishte filluar procedurat për mandatin e kandidatit të ri për Kryeministër, në konsultim me dhe pas propozimit të partisë politike, e cila bazuar në konsultimet përkatëse, ka rezultuar të ketë gjasën më të madhe për të krijuar Qeverinë dhe në mënyrë që të shmangen zgjedhjet. E kundërta, do të pamundësonte jetësimin e kompetencave esenciale të Kuvendit të Republikës për të zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës.

E drejta për të propozuar mandatarin për Kryeministër është edhe përgjegjësi dhe privilegj. Propozimi i këtij emri, ngërthen në vetvete pikën më të lartë të suksesit të një partie politike ose koalicioni brenda një cikli zgjedhor. E drejta e parë për të propozuar kandidatin për Kryeministër i është garantuar partisë ose koalicionit fitues të zgjedhjeve përmes Kushtetutës. Ushtrimi i kësaj të drejte, nuk është i mveshur edhe me autorizimin për të bllokuar formimin e një Qeverie brenda një cikli zgjedhor. Një qëndrim i tillë, do t'i bënte peng të partisë ose koalicionit fitues, të gjitha institucionet më thelbësore të shtetit.

Gjykata në fund thekson se funksionimi demokratik i institucioneve është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizime publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për Republikën e Kosovës, ashtu që kjo i fundit të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar dhe aspiratave të mishëruara në Preambulën e saj.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO72/20

parashtrues

**Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës
së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të
Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Rexhep Selimi, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Arbërie Nagavci, Hekuran Murati, Fitore Pacolli, Hajrullah Çeku, Saranda Bogujevci, Jahja Koka, Mefail Bajçinovci, Valon Ramadani, Mimoza Kusari Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Arbër Rexhaj, Arbëresha Kryeziu Hyseni, Labinotë Demi Murtezi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Arta Bajraliu, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani, Fitim Haziri, Elbert Krasniqi, Eman Rrahmani, Salih Zyba (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës ose deputetët parashtrues), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020 (në tekstin e mëtejme: Dekreti i kontestuar) me të cilin z. Avdullah Hoti, iu propozua Kuvendit të Republikës së Kosovës si kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme *“mbi Dekretin në mënyrë që të parandalohen dëmet e pariparueshme për palën dhe institucionin”*.
5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan mbajtjen e seancës dëgjimore publike.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafi 2, nën-paragrafi 1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 prill 2020, rreth orës 17:00, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Në të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga

gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban (anëtarë).

9. Në të njëjtën ditë, Gjykata, përmes postës elektronike, njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: Presidentin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidenti); Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryetarja e Kuvendit), të cilës iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministrin në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri); si dhe, Avokatin e Popullit.
11. Gjykata i ka njoftuar të gjitha palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre: (i) lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, deri më 1 maj 2020, në orën 12:00; ndërsa, (ii) komentet lidhur me meritat e kërkesës, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë jo më vonë se më 8 maj 2020, në orën 16:00.
12. Më 1 maj 2020, para orës 12:00, Gjykata pranoi një shkresë nga Shefi i Grupit Parlamentar të Listës Serbe, deputeti Slavko Simić, përmes së cilës u kërkuar nga Gjykata që të jepet afat shtesë për të paraqitur komente lidhur me masën e përkohshme ngase kërkesën KO72/20 e kanë pranuar vetëm në gjuhën shqipe.
13. Më 1 maj 2020, në të njëjtën datë, Gjykata iu përgjigj deputetit Slavko Simić duke e njoftuar se kërkesa KO72/20 është pranuar në Gjykatë vetëm në gjuhën shqipe dhe se Gjykata e ka dërguar për përkthim urgjent menjëherë pas pranimi të saj. Gjykata ia dërgoi kopjen e plotë të kërkesës në gjuhën serbe, deputetit/ëve në fjalë dhe e miratoi kërkesën për shtyerje të afatit për dorëzim të komenteve për masë të përkohshme deri në orën 16:00 të datës 1 maj 2020.
14. Më 1 maj 2020, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi komente lidhur me masën e përkohshme nga palët në vijim: Presidenti, Kryetarja e Kuvendit, Kryeministri, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: LDK), deputeti Arban Abrashi dhe deputeti Shkëmb Manaj.
15. Më 1 maj 2020, Gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 29 maj 2020,

respektivisht të pezullojë zbatimin e mëtejme të Dekretit të kontestuar të Presidentit.

16. Më 6 maj 2020, Gjykata pranoi nga A.M. një kërkesë për ta lejuar atë që të paraqes *Amicus Curiae* lidhur me rastin KO72/20.
17. Më 7 maj 2020, Gjyqtari raportues konform rregullit 55 [*Amicus Curiae*], pas konsultimit me Kolegjin Shqyrtues, vlerësoi se kërkesa e A.M. për të paraqitur *Amicus Curia* duhet të refuzohet. Gjykata e njoftoi A.M.-në për refuzimin e kërkesës së tij.
18. Më 8 maj 2020, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi komente lidhur me meritat e kërkesës nga palët në vijim: Presidenti; Kryetarja e Kuvendit; Kryeministri; Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci; Avokati i Popullit; Grupi Parlamentar i LDK-së; deputetët e Kuvendit, Behxhet Pacolli dhe Mirlindë Sopi–Krasniqi nga Aleanca Kosova e Re (në tekstin e mëtejme: AKR), të mbështetur nga deputetët Endrit Shala, Haxhi Shala dhe Albulena Balaj–Halimaj nga NISMA Socialdemokrate (në tekstin e mëtejme: NISMA); dhe deputeti Arban Abrashi.
19. Më 11 maj 2020, Gjykata parashtroi në Forumin e Komisionit të Venecias pyetjet në vijim:

“1. Pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, a ekziston mundësi kushtetuese/ligjore që lejon formimin e Qeverisë së re brenda së njëjtës legjislaturë?

2. A ekziston obligim kueshtetues/ligjor për të shpërndarë Kuvendin pas mocionit të votëbesimit ndaj Qeverisë?

3. A keni praktikë gjyqësorë lidhur me këtë çështje?”
20. Ndërmjet 11 dhe 21 majit 2020, Gjykata pranoi përgjigje në pyetjet e parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga gjykatat kushtetuese/supreme të shteteve në vijim: Mbretëria e Bashkuar, Brazil, Lihtenshtajn, Austri, Sllovaki, Suedi, Çeki, Kroaci, Gjermani, Bulgari, Maqedoni e Veriut, Moldavi dhe Afrikë e Jugut (shih përmbledhjet e trembëdhjetë (13) përgjigjeve të pranuar në paragrafët 291-306 të këtij Aktgjykimi).
21. Më 12 maj 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës; Presidentin; Kryetaren e Kuvendit; Kryeministrin; si dhe, Avokatin e Popullit lidhur me komentet e pranuar më 8 maj 2020.
22. Gjykata gjithashtu kërkoi nga Kryetarja e Kuvendit që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në kompetencën saj për të informuar

Gjykatën lidhur me *“Travaux Preparatoires”* ose *“Dokumentet Përgatitore”* të Kushtetutës dhe, në rast se të njëjtat ekzistojnë, të dorëzohen në Gjykatë në një afat urgjent kohor dhe jo më vonë se deri më 13 maj 2020.

23. Më 13 maj 2020, Gjykata pranoi nga Kryetarja e Kuvendit shkresën më të cilën kjo e fundit njoftoi Gjykatën se *“Travaux Preparatoires”* të Kushtetutës nuk gjinden në Kuvend por në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Arkivi i Kosovës). Për rrjedhojë, Kryetarja e Kuvendit njoftoi Gjykatën se i është drejtuar me kërkesë zyrtare Arkivit të Kosovës dhe në bazë të përgjigjes së tyre janë njoftuar se për shkak të volumit të madh të dokumenteve, *“është e pamundur që të kryhet fotokopjimi i materialit para datës 15 maj [2020]”* dhe se sapo të pranojnë kopjen e *“Travaux Preparatoires”* nga Arkivi i Kosovës do ta përcjellin menjëherë në Gjykatë.
24. Në po të njëjtën ditë, më 13 maj 2020, Gjykata iu përgjigj shkresës së Kryetares së Kuvendit me ç'rast theksoi: *“Duke marrë parasysh urgjencën e rastit që Gjykata ka në trajtim si dhe volumin e madh të deklaruar të dosjeve të “Travaux Preparatoires”, luteni që të ndërmerrni të gjithë hapat në dispozicionin tuaj që të siguroheni që Gjykata të ketë qasje në kopjet e vërtetuara si dokumente autentike dhe origjinale të “Travaux Preparatoires” sa më shpejtë që është e mundur dhe jo më vonë se brenda afatit të propozuar nga ju, 15 maj 2020.”* Po ashtu, Gjykata theksoi në letër që: *“Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore, luteni që të dorëzohet në Gjykatë e gjithë kopja e materialit arkivor së bashku me dokumentin që vërteton autencitetin e atij materiali arkivor.”*
25. Më 14 maj 2020, Gjykata pranoi përmes Kuvendit kopjen e vërtetuar të Dokumenteve Përgatitore për hartimin e Kushtetutës.
26. Më 18 maj 2020, Gjykata pranoi nga Kryetarja e Kuvendit shkresën më të cilën kjo e fundit paraqiti disa çështje lidhur me Dokumentet Përgatitore për hartimin e Kushtetutës të cilat Gjykata i kishte pranuar më datën 14 maj 2020, dhe të cilat Kuvendi i kishte siguruar nga Arkivi i Kosovës. Në shkresën e saj, Kryetarja e Kuvendit theksoi:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është autor i dokumenteve të dërguara dhe ato nuk janë trajtuar ndonjëherë në procedurë të rregullt në Kuvend;

Kuvendi i Kosovës nuk i ka poseduar ndonjëherë këto dokumente, deri me 14 maj 2020, kur një kopje i është dhënë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave;

Këto dokumente nuk janë publikuar asnjëherë në Gazetën Zyrtare ose ne burime të tjera zyrtare;

Kuvendi nuk mund ta vërtetojë autencitetin e këtyre dokumenteve dhe as nëse ndonjëherë ka pasur ndërhyrje në to;

Kuvendi nuk mund të vërtetojë se kush i ka poseduar këto dokumente para se ato të dërgoheshin në Arkivat e Kosovës, si dhe nëse gjatë këtyre viteve ka pasur ndonjë ndërhyrje në to;

Kuvendi nuk mban asnjë përgjegjësi lidhur me vërtetësinë e dokumenteve të dërguara, pasi që ka vepruar vetëm si lehtësues komunikimi ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.”

27. Në të njëjtën ditë, më 18 maj 2020, lidhur me shkresën e pranuar nga Kryetarja e Kuvendit për Dokumentet Përgatitore për hartimin e Kushtetutës, Gjykata e njoftoi Kryetaren e Kuvendit si në vijim:

“E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj dhe të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për dorëzimin e kopjes së vërtetuar të dokumenteve përgatitore të hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me këtë rast, ju ftojme të gjeni të bashkëngjitur në një CD – version elektronik në PDF kopjen e të gjithë dokumentacionit përgatitor për hartimin e Kushtetutës të dorëzuar në Gjykatë nga Kuvendi më 14 maj 2020. Ju konfirmojmë se ky është materiali i tërësishëm që është përcjellë në Gjykatë në rrugë zyrtare nga ana e Kuvendit dhe si i tillë është regjistruar, protokolluar dhe arkivuar në Gjykatë.

Me respekt rikujtojmë se Gjykata Kushtetuese nuk mund të spekulojë rreth autencitetit të këtij materiali e as të angazhohet në diskutime të tilla. Ky material është dorëzuar si dokument publik në rrugë zyrtare në Gjykatë dhe i njëjti është dorëzuar si kopje e vërtetuar e materialit origjinal që gjendet në Arkivat e Shtetit të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i trajtojë këto dokumente në përputhje me praktikën dhe standardet ndërkombëtare për trajtimin e tyre.”

28. Përmes kësaj shkrese drejtuar Kryetares së Kuvendit, Gjykata gjithashtu sqaroi të gjithë procesin se si është arritur deri tek dorëzimi i kopjes së vërtetuar të Dokumenteve Përgatitore të hartimit të Kushtetutës në Gjykatë dhe e cila është reflektuar më lart, duke përfshirë edhe faktin që më 20 qershor 2014, Gjykata gjatë shqyrtimit të rastit KO103/14 (shih, parashtresë e kërkesës, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 30 qershorit 2014 – në tekstin

vijues: Aktgjykimi KO103/14), kishte kërkuar nga Kuvendi që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të *“Travaux Preparatoires”* por ishte njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit se *“nuk i kishin Travaux Preparatoires”*. Gjithashtu, Gjykata sqaroi se më 8 maj 2020, Avokati i Popullit kishte dorëzuar një shkresë në Gjykatë përmes së cilës kishte theksuar se nuk ka komente lidhur me rastin KO72/20, mirëpo ka informacion që *“dosjet e punëve përgatitore të hartimit të Kushtetutës ndodhen në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.”*

29. Më 28 maj 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
30. Në të njëjtën ditë, më 28 maj 2020, Gjykata vendosi: (i) njëzëri që kërkesa e parashtrueseve të kërkesës është e pranueshme; (ii) njëzëri që Dekreti i kontestuar i Presidentit është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, duke konstatuar rrjedhimisht, që votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi të Kuvendit ndaj Qeverisë, nuk rezulton në shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit dhe mundëson formimin e një Qeverie të re në pajtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës; (iii) me shumicë që Dekreti i kontestuar i Presidentit është në përputhshmëri me paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës; (iv) njëzëri që të shfuqizohet masa e përkohshme e përcaktuar përmes Vendimit të 1 majit 2020; dhe (v) njëzëri që të refuzohet kërkesa për seancën dëgjimore. Përfundimet kryesore të Gjykatës u publikuan po atë ditë.
31. Më 1 qershor 2020, Gjykata publikoi Aktgjykimin e plotë për rastin KO72/20.

Përmbledhja e fakteve

32. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.
33. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend, bazuar në listën vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:
 - a. Lëvizja VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejshëm: LVV), 29 deputetë;
 - b. Lidhja Demokratike e Kosovës, 28 deputetë;
 - c. Partia Demokratike e Kosovës, 24 deputetë;
 - d. AAK-PSD Koalicioni 100% Kosovë, 13 deputetë;

- e. Srpska Lista, 10 deputetë;
- f. Nisma Socialdemokrate – Aleanca Kosova e Re, Partia e Drejtësisë, 6 deputetë;
- g. Koalicija “Vakat”, 2 deputetë;
- h. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
- i. Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet;
- j. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
- k. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
- l. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
- m. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
- n. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

34. Më 26 dhjetor 2019, u konstituua Kuvendi.
35. Më 20 janar 2020, LVV e propozoi kandidatin e saj për Kryeministër të Presidenti.
36. Më 20 janar 2020, në të njëjtën ditë, Presidenti nxori Dekretin me të cilin z. Albin Kurti, iu propozua Kuvendit si kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë.
37. Më 3 shkurt 2020, Kuvendi zgjodhi Qeverinë me Kryeministër z. Albin Kurti.
38. Më 20 mars 2020, një numër i deputeteve të Kuvendit dorëzuan në Kryesinë e Kuvendit Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë.
39. Më 25 mars 2020, Kuvendi [Vendimi nr. 07-V-013] miratoi Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë. Mocioni i votuar, përmbante mes tjerash, arsyetimin si në vijim:
“[...]ju bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që, përmes votës së mosbesimit, ta votojnë këtë mocion. Me këtë veprim, Kuvendi krijon mundësinë e formimit të një qeverie të stabilitetit me kohëzgjatje të kufizuar, e cila do të adresonte sfidat imediate me të cilat po ballafaqohet vendi, si në pozicionin e politikës së jashtme, ashtu edhe në dinamikat e krijuara brenda vendit.”
40. Më 30 mars 2020, Presidenti i dërgoi shkresa të veçanta kryetarëve të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend të cilat kishin përmbajtje vijuese: *“Pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë [...] do të ndërmarra hapat e përcaktuar në Kushtetutë. [...] Në këtë drejtim, Ju ftoj që të merrni pjesë në takimin konsultativ për të diskutuar hapat e mëtejshëm.”*

41. Më 1 prill 2020, Presidenti mbajti takime të ndara konsultative me kryetarët e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend.
42. Më 1 prill 2020, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryeministër, përmes shkresës [Ref: 108/2020], shprehi gatishmërinë për takim me Presidentin, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Në shkresën e tij drejtuar Presidentit, ai gjithashtu theksoi se: *“Kushtetuta si dhe vetë praktika e juaj e mëparshme në vitin 2017, e bëjnë të qartë se, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, e vetmja rrugë përpara është shpërndarja e Kuvendit [...], në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës, dhe shpallja e zgjedhjeve të përkohshme.”* Ai shtoi se: *“çështja e vetme për të cilën do të bisedoj me ju, është se kur do të jetë koha më e përshtatshme për shpërndarjen e Kuvendit duke marrë parasysh në veçanti gjendjen emergjente të shëndetit publik me të cilën po përballlet Republika e Kosovës në këtë kohë.”*
43. Më 1 prill 2020, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryeministër, përmes shkresës [Ref.109/2020] theksoi mes tjerash si në vijim: *“[...] Në lidhje me njoftimin tuaj se jeni duke kryer “konsultime” me liderët e partive të tjera politike [...] dëshiroj të potencoj qëndrimin tim se konsultime të tilla nuk kanë bazë në asnjë dispozitë të Kushtetutës [...]. Po ashtu, dëshiroj të ritheksoj gatishmërinë time që të rrimë në kontakt lidhur me betejën tonë kundër virusit COVID-19, si dhe me detyrën tua për të shpërndarë Kuvendit [...] pas mocionit të mosbesimit. Ndërsa, për çdo çështje tjetër jashtë këtyre dy temave, e ripërsëris qëndrimin tim të shprehur në takimin e sotëm, që komunikimi ndërinstitucional mes Zyrës së Presidentit dhe Zyrës së Kryeministrit, të vazhdojë në formën e shkruar.”*
44. Më 2 prill 2020, Presidenti i dërgoi një shkresë [Nr. Prot.353] z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV me përmbajtjen si në vijim: *“[...] Takimi i djeshëm me ju (01.04.2020), pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë [...], ka qenë takim konsultues me Kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje - liderin e partisë së parë sipas rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 6 tetor 2019. Pra, ka qenë një takim i karakterit formal, juridik e procedural, për konsultim për të vlerësuar nëse është në interesin e partisë politike që përfaqësoni ju formimi i Qeverisë së re apo shpërndarja e Kuvendit. [...]”*
45. Në të njëjtën ditë, më 2 prill 2020, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot.354] njoftoi z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së, se pas mocionit të mosbesimit të Qeverisë, në pajtim me *“nenin 95 të Kushtetutës [...], do të ndërmarr hapat e nevojshëm për*

caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë”. Më tutje, Presidenti theksoi: “Duke marrë parasysh Nenin 95 të Kushtetutës, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese KO103/14, të datës 1 korrik 2014, dhe Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve [...] të mbajtura me 6 tetor 2019 (Protokoll i KQZ-se nr. 1845-2029, 27.11.2019), Lëvizja Vetëvendosje, është subjekti politik që ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe ka të drejtën e propozimit të kandidatit të ri, për të formuar Qeverinë. Ju lutem, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoni kandidatin e ri, të cilin do të mandatoj për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.”

46. Më 10 prill 2020, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot.354/1] iu drejtua z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së:

“I nderuari z. Kurti,

Jam në pritje të përgjigjes suaj në kërkesën që ua kam përcjellë me datë 2 prill 2020 (Ref 354, 02.04.2020), për të propozuar kandidatin për Kryeministër dhe formuar Qeverinë [...] pas mocionit të mosbesimit të Qeverisë [...]

Ju rikujtoj që [LVV] [...] është subjekti politik që ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe ka të drejtën e propozimit të kandidatit/es të ri për të formuar Qeverinë.

Siç e dini, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverise të datës 25.03.2020, kam zhvilluar takime konsultative me të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend për të vlerësuar nëse është në interesin e partive politike formimi i Qeverisë së re apo shpërndarja e Kuvendit. Shumica e partive politike janë deklaruar që janë për formimin e Qeverisë së re.

[...]

Edhe një herë me duhet t'ua rikujtoj se mandati im kushtetues me obligon që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emërimit të kandidatit/es të ri/re për Kryeministër për të formuar Qeverinë [...]. Si President i Republikës së Kosovës unë do ta ndërmarr këtë veprim, duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë sa më shpejt Qeverinë e tyre të re.

Luteni që në emër të [LVV] të propozoni kandidatin/en e ri/re për Kryeministër, të cilin do të mandatoj për formimin e Qeverisë [...].”

47. Më 13 prill 2020, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryeministër përmes shkresës [Ref:120/2020] iu drejtua Presidentit duke theksuar, mes tjerash,

“[...] me lejoni t’ju shpreh keqardhjen time të thellë pas shkresave tuaja të fundit, në të cilat ju e deklaroni haptas qëllimin për të anashkaluar detyrën tuaj kushtetuese që të shpërndani Kuvendin dhe të shpallni zgjedhje të reja, pas përfundimit të betejës kundër COVID-19

Në shkresën tuaj të datës 10.04.2020 theksoni se keni zhvilluar takime konsultative me përfaqësuesit e të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend me qëllim të vlerësimit të interesit të partive politike në raport me zgjedhjet e reja apo formimin e Qeverisë së re. Me lejoni të ju rikujtoj se nuk është në kompetencën e Presidentit të Republikës së Kosovës vlerësimi i interesave të partive politike, por mbrojtja e interesit shtetëror. Për me tepër, Gjykata Kushtetuese në paragrafin 84 të Aktgjyqimit të saj në rastin KO 103/14 shprehimisht ka konstatuar se “Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet vetëm me partinë politike ose me koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicë absolute, qoftë relative.

Prandaj duke zhvilluar takime të tilla konsultative, Ju keni vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse aktgjyqimet e Gjykatës Kushtetuese janë akte juridike përmes të cilave realizohet kushtetutshmëria dhe konsiderohen burim i të Drejtës Kushtetuese. Për të qenë edhe më i qartë, siç e dini, para takimit dhe pas takimit me Ju jeni njoftuar zyrtarisht nga unë se takimet me ju po i zhvilloj në cilësinë e Kryeministrit në detyrë dhe kam qenë i shoqëruar nga dy këshilltarët e mi të jashtëm të cilën nuk janë anëtarë të [LVV-së]. Kam qenë në takim që për temë diskutimi ka pasur gjendjen e emergjencës shëndetësore dhe çështjen e shpalljes së zgjedhjeve pas mocionit të mosbesimit.

Po ashtu më lejoni të ju rikujtojë se pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit [...] presidentit nuk i krijohet hapësirë që të luaj rolin e një akteri politik duke tentuar të imponojë vullnetin e tij në jetën politike. Presidentit të Republikës së Kosovës, si organ kushtetues, një mocion mosbesimi i jep të drejtën që të përmbushë vetëm një veprim të përcaktuar nga kushtetutëdhënësi. Pra, shpërndarjen e Kuvendit në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës [...]”

Se kjo është procedura e vetme të cilën e parasheh Kushtetuta [...] nuk është vënë asnjëherë në dyshim as në praktiken e deritanishme kushtetuese. Se nuk ka pasur asnjëherë takime konsultative me

partinë politike që ka fituar shumicën në Kuvend është fakt notor. Se Presidenca çdo herë e ka konsideruar të domosdoshme shpalljen e menjëhershme të zgjedhjeve, përpos që vërtetohet me faktin e në vitin 2010 dhe 2017 është shpërndarë Kuvendi dhe janë shpallur zgjedhjet në po të njëjtën ditë kur mocioni i mosbesimit është votuar, po ashtu vërtetohen nga intervista e U.D. Presidentit z. Jakup Krasniqi [e 2 shkurtit 2010]. [...].

[...] se zgjedhjet janë opsioni i vetëm pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit është theksuar edhe nga Ju në vitin 2010, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës të datës 02.11.2010, kur keni kërkuar votat pro mocionit të mosbesimit [...]

Prandaj në frymën e kësaj gjendjeje faktike dhe juridike besoj se edhe Ju e keni tani të qartë që nuk është detyrë e Presidentit që të imponohet me shkresa duke kërkuar emra kandidatesh për Kryeministër. Sidomos jo në një periudhë të emergjencës shëndetësore. Por më lejoni të theksoj, se kjo shkresë nuk është refuzim për të ju dhënë një emër të kandidatit për Kryeministër. Është një rikujtim i kornizës së kompetencave tuaja dhe obligimeve kushtetuese që bien mbi institucionin e Presidentit [...], pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, sepse nuk është në diskrecionin tuaj që të impononi skenarë jokushtetues.”

48. Më 15 prill 2020 Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot. 370/1] iu drejtua z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së, duke theksuar:

“Më datë 13.04.2020 (Ref.: 120/2020) kam pranuar një letër nga ju, ku u jeni referuar shkresave që ua kam dërguar juve në cilësinë e Kryetarit të Lëvizjes Vetevendosje. Në këtë shkresë ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por as nuk keni refuzuar një gjë të tillë. Duke marrë parasysh kërkesat që ua kam përcjellë me datë 2 prill 2020 (Ref. 354, 02.04.2020) dhe me datë 10 prill 2020 (Ref. 354/1, 10.04.2020), përsëri ua rikujtoj se jam në pritje të përgjigjes suaj për të propozuar kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë (Vendimi i Kuvendit të Republikës se Kosovës Nr. 07-V- 013, të datës 25.03.2020).

Ju rikujtoj që mandati im kushtetues më obligon që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emërimit të kandidatit/es për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike të

përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të drejte presin funksionalizimin e Qeverisë së re, si dhe presin nga Presidenti të caktojë mandatarin për formimin e Qeverisë.

Duke pasur parasysh edhe Pikën 87 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO103/14, Gjykata Kushtetuese "vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin", atëherë duhet ta kenë në konsideratë se nëse ju nuk e propozoni kandidatin/en për Kryeministër, atëherë veprimet tuaja mund të reflektojnë edhe hezitim në marrjen e mandatit, respektivisht refuzimin e marrjes së mandatit.

Në fund, kërkoj përsëri nga ju që të bëni propozimin për kandidatin/en për Kryeministër pa humbur kohë dhe në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO 103/14. Unë ju siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi [...], do të propozojë kandidatin/en për Kryeministër për të formuar Qeverinë."

49. Më 17 prill 2020, z. Albin Kurti në cilësinë e tij si Kryeministër, përmes shkresës [Ref.122/2020] iu drejtua Presidentit duke theksuar:

"I nderuar President,

Jo, nuk hezitojmë t'ju përgjigjemi.

Jo, nuk e refuzojmë kërkesën tuaj.

Por jam i detyruar të përsëris atë që kam pyetur në letrën time të fundit, e për të cilën nuk kam marrë përgjigje. Shprehimisht kam thënë: E kam të qartë që situata aktuale nuk lejon mbajtjen e zgjedhjeve, dhe kjo është diçka në nuk po kërkojmë të bëhet tani, por sapo të krijohen kushtet pas kalimit të pandemisë. Mirëpo ajo që nuk e kam të qartë është standardi i dyfishtë që Ju dhe partitë politike po tentoni ta impononi në rrugë jokushtetuese, pas këtij mocioni mosbesimi i cili nuk dallon në aspekt formal dhe material nga praktikat e mëhershme. Ndoshta do të mund të na sqaroni këtë?

Unë kam kërkuar sqarim lidhur me këtë, dhe jam akoma në pritje të përgjigjes suaj.

Po ashtu, ju lutem ta specifikoni bazën juridike sipas të cilës po veproni, sepse neni 95 të cilit i referoheni ka gjashtë paragrafë të cilat rregullojnë, çështje të ndryshme nga njëra-tjetra, dhe referimi paushall në nenin 95 nuk është i justifikueshëm në këtë moment.

Do te jem ne pritje te sqarimit tuaj, me shpresën se do të përdorni standardin e njëjtë që po pritni nga unë. Pas përgjigjes suaj mbase mund ta kem më të qartë arsyen pas këtij insistimi për t'u marre me çështje dytësore e tretësore, në një kohë kur të gjithë duhet të bashkohemi në luftën kundër armikut të përbashkët - COVID-19.”

50. Po të njëjtën ditë, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot. 370/3] iu drejtua sërish z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së duke theksuar:

“I nderuar z. Kurti,

Me datë 17.04.2020 (Ref, 122/2020), kam pranuar edhe një letër nga ju, ku u jeni referuar shkresave që ua kam dërguar juve në cilësinë e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Përkundër kërkesave të dërguara me 2 prill 2020 (Ref. 354), me 10 prill 2020 (Ref, 354/1) dhe me 15 prill 2020 (Ref. 370/1), edhe në shkresën tuaj të dërguar më 17 prill 2020 (Ref. 122/2020), ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por keni theksuar se nuk jeni duke refuzuar për të propozuar kandidatin për kryeministër. Më lejoni t'ua theksoj se mosrefuzimi nga ana juaj nënkupton që ta dërgoni emrin e kandidatit/es për Kryeminister. Por, ju nuk e keni bërë ende këtë, përkundër faktit që ua kam dërguar tri kërkesa për këtë qëllim.

Prandaj, edhe një here, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO103/14, kërkoj ta dërgoni emrin e kandidatit/es për Kryeministër pa humbur kohë.”

51. Më 22 prill 2020, z. Albin Kurti në cilësinë e tij si Kryeministër, përmes shkresës [Ref.135/2020] i drejtohet Presidentit duke theksuar:

“I nderuar President,

Përkundër që në asnjë rast nuk kemi refuzuar as kërkesën dhe as propozimin e mandatarit, sot, me 22.04.2020, kam pranuar një letër nga ju, përmes të cilës konstatoni jashtë kompetencave tuaja kushtetuese si President, se unë nuk e paskam shfrytëzuar të drejtën për propozimin e kandidatit të ri për te formuar Qeverinë.

Kushtetuta e Republikës nuk parasheh një kompetence të tillë të Presidentit për të vlerësuar apo konstatuar shfrytëzimin apo mosshfrytëzimin e të drejtës për të propozuar mandatarin. Përveç,

kësaj, Kushtetuta e as Aktgjykimi Nr. 103/14 nuk kanë përcaktuar as afatin për një gjë të tillë. Kushtetuta, çfarë parasheh në këtë rast është caktimi i mandatarit vetëm pas propozimit nga partia ose koalicioni që ka fituar shumicën absolute apo relative, siç përcaktohet edhe në pikën 84 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Andaj, bazuar në rolin dhe funksionin si President, ju nuk keni të drejtë e as autorizim kushtetues për të konstatuar se kemi refuzuar propozimin e kandidatit për kryeministër kur nuk e kemi bërë këtë; ju nuk e keni në mandat e kompetencë që të përcaktoni përtej Kushtetutës së si e çfarë do të jetë Qeveria, siç keni bërë këtyre ditëve në deklaratimet publike; dhe, me keqardhje konstatojmë se ende nuk na jeni përgjigjur se në bazë të cilës pikë të nenit 95 po veproni dhe po na drejtoheni.”

52. Më 22 prill 2020, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot. 380] iu drejtua sërish z. Albin Kurti, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së duke theksuar:

“I nderuar z. Kurti,

Përkundër kërkesave që ua kam dërguar me 2 prill 2020 (Ref. 354), më 10 prill 2020 (Ref. 354/1), me 15 prill 2020 (Ref. 370/1) dhe me 17 prill 2020 (Ref: 370/3), ju nuk e keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër.

Me keqardhje konstatoj se me veprimet tuaja nuk e keni shfrytëzuar të drejtën tuaj të propozimit të kandidatit të ri për ta formuar Qeverinë, në pajtim me Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve [...] për Kuvendin [...].

Më duhet t’ju rikujtoj që në pajtim me mandatin kushtetues të Presidentit të Republikës së Kosovës është përgjegjësi e imja që ta ruaj stabilitetin e vendit dhe ta garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të vendit.

Prandaj, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO 103/14 do të bëj konsultim të përbashkët me të gjithë liderët e subjekteve politike parlamentare për hapat e mëtejme.”

53. Në të njëjtën ditë, më 22 prill 2020, Presidenti u dërgoi shkresa të veçanta kryetarëve të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend duke i ftuar që të marrin pjesë “në takimin e përbashkët

konsultativ me liderët e partive parlamentare për t'i diskutuar hapat e ardhshëm në mënyrë që t'i japim vendit Qeveri me legjitimitet të plotë.”

54. Në të njëjtën ditë, pra më 22 prill 2020, u mbajt takimi me kryetarët e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, duke filluar nga ora 16:30. Presidenti kërkoi mendimin e subjekteve politike nëse ishin në favor të zgjedhjeve të parakohshme apo të formimit të Qeverisë së re. Shumica e partive politike u deklaruan se janë në favor të formimit të Qeverisë së re. Ndërsa, përfaqësuesja e LVV iu referua dhe lexoi shkresën [Ref.135/2020] e 22 prillit 2020, që z. Albin Kurti i kishte dërguar Presidentit, të cituar gjerësisht më lart në paragrafin 51. Presidenti në këtë takim, gjithashtu prezantoi kriteret mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, si kriterin se propozimi për kandidatin për Kryeministër të rrjedh nga partia politike ose koalicioni i cili do të ketë gjasat më të mëdha që të formojë Qeverinë, dhe t'i marrë votat e nevojshme në Kuvend për të ruajtur stabilitetin e vendit, si dhe që Qeveria t'i përmbahet parimeve në vijim: parimin e kushtetutshmërisë; parimin a trajtimit të barabartë; parimin e stabilitetit politik; parimeve lidhur me dialogun dhe politikën e jashtme; parimin e transparencës; parimin e integritetit; parimin e disponueshmërisë, si dhe parimin e meritave (në tekstin e mëtejme: Kriteret Mbizotëruese).
55. Në të njëjtën ditë, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot. 382/1] iu drejtua z. Isa Mustafa, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LDK-së, me këtë përmbajtje:

“I nderuar z. Mustafa,

Në përputhje me mandatin tim kushtetues dhe në respektim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KOI 03/14,

me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme, ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,

pas konsultimit me të gjitha partitë politike parlamentare dhe pajtimit të shumicës absolute të tyre për të formuar Qeveri të re,

pas mos dërgimit të kandidatit për të formuar Qeverinë nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, si subjekt politik që ka fituar shumicën relative në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 06 tetor 2019, përkundër kërkesave të dërguara më 2

prill 2020 (Ref. 354), më 10 prill 2020 (Ref. 354/1), më 15 prill 2020 (Refl 370/1), më 17 prill 2020 (Ref. 370/3), dhe më 22 prill 2020 (Ref. 380),

në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, luteni të propozoni mandatarin potencial për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili duhet të sigurojë se do ta ketë numrin e duhur të votave në Kuvendin e Kosovës dhe të zotohet se do të krijojë Qeveri stabile dhe gjithëpërfshirëse. [...]"

56. Më 29 prill 2020, Presidenti përmes shkresës [Nr. Prot. 382/2] iu drejtua sërish Kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa, duke i kërkuar sërish që, pa humbur kohë, të propozohet mandatarin potencial për formimin e Qeverisë, i cili duhet të sigurojë se do ta ketë numrin e duhur të votave në Kuvend dhe të zotohet se do të krijojë Qeveri stabile dhe gjithëpërfshirëse.

57. Në të njëjtën ditë, më 29 prill 2020, Kryetari i LDK-së, z. Isa Mustafa, përmes shkresës [nr. Prot. 408], iu drejtuar Presidentit duke theksuar se janë:

"në përmbyllje të marrëveshjeve me partnerët e mundshëm të koalicionit qeverisës, në harmoni me kriteret mbizotëruese. Këto ditë kemi kryer shumë takime intensive, që kanë të bëjnë me programin qeverisës dhe ndarjen e përgjegjësisë qeverisëse.

Jemi duke punuar intensivisht dhe shpresojmë që në të ardhmen shumë të afërt të krijojmë shumicën parlamentare dhe të propozojmë kandidatin për Kryeministër të Kosovës."

58. Më 30 prill 2020, Kryetari i LDK-së, z. Isa Mustafa, përmes shkresës [nr. Prot. 409], iu drejtua Presidentit me këtë përmbajtje:

"I nderuari President Thaçi,

Në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re, të prezantuar nga ana e Juaj në takimin e datës 22 prill 2020, pas konsultimit publik me të gjithë liderët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, dhe konsultimeve gjithëpërfshirëse me subjektet AAK, NISMA Socialdemokrate, AKR dhe subjektet tjera që përfaqësojnë komunitetin joshumicë në Kuvendin e Kosovës, me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme, ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe në përputhje me urgjencën për t'i dhënë vendit Qeveri të re me legjitimitet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i propozojmë Presidentit të Republikës së Kosovës z.

Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.”

59. Në të njëjtën ditë, më 30 prill 2020, Presidenti nxori Dekretin e kontestuar i cili përmban tri pika, si në vijim:

*“1. Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës
kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.*

4. Kandidati nga pika I e këtij Dekreti, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

5. Dekreti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.”

60. Dekreti i lartcekur i Presidentit theksohet të jetë nxjerrë mbi bazën e:

- (v) paragrafëve (4) dhe (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës dhe nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës;
- (vi) nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
- (vii) Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO103/14 Parashtrues Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 1 korrikut 2014; dhe
- (viii) në rrjedhë të propozimit të LDK-së, të pranuar nga Zyra e Presidentit më 30 prill 2020.

61. Më 30 prill 2020, një numër i deputeteve të Kuvendit dorëzuan në Kryesinë e Kuvendit Kërkesë për thirrje të seancës së jashtëzakonshme për votimin e përbërjes së Qeverisë.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

62. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Dekreti i kontestuar i Presidentit nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 14 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] si dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës.

63. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës parashtruesit pohojnë se janë plotësuar të gjitha kriteret formalo-kushtetuese, ligjore dhe nënligjore për tu konsideruar kërkesa e pranueshme për shqyrtim në merita.
64. Sa i përket meritave të kërkesës, parashtruesit pretendojnë se përmes Dekretit të kontestuar, Presidenti ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese pasi që: (i) pas mocionit të suksesshëm të votëbesimit, Presidenti ka pasur obligim kushtetuese të shpallë zgjedhjet e parakohshme për Kuvend dhe jo të mandatojë kandidat për Kryeministër; dhe (ii) gjatë procedurës që ka rezultuar në nxjerrjen e Dekretit për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë, Presidenti ka vepruar në kundërshtim me procedurat e parapara në Kushtetutë dhe në Aktgjykimin e Gjykatës KO103/14, si dhe me praktikën e deritanishme lidhur me shpërndarjen e Kuvendit pas mocionit të mosbesimit të Qeverisë.
65. Më konkretisht përkitazi me procedurën, ata theksuan se është bërë: (i) konsultimi pa bazë kushtetuese me të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend dhe është anashkaluar partia fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 me rastin e caktimit të mandatarit për formimin e Qeverisë; (ii) përcaktimi pa bazë kushtetuese i afatit kohor për partinë fituese të zgjedhjeve për të propozuar kandidatin për formimin e Qeverisë dhe pretendimi nga Presidenti që LVV, si parti fitues e zgjedhjeve ka refuzuar propozimin e kandidatit për Kryeministër në mënyrë jo-shprehimore.
 - a. *Pretendimet për shkelje kushtetuese si pasojë e nxjerrjes së Dekretit të kontestuar dhe obligimin e Presidentit për të shpallë zgjedhjet e parakohshme pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë*
66. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se sipas nenin 83 [Statusi i Presidentit] që përcakton se Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës, Presidenti nuk i lejohet të përfaqësojnë interesat grupore ose politike partiake. Presidenti qëndron jashtë ndarjes së pushteteve dhe atij i ndalohej të ushtrojë funksione aktive në drejtimin politik të vendit. Andaj, sipas tyre, ushtrimi i kompetencave të Presidentit “*duhet të jetë në përputhje me funksionin e tij në kuptim të ushtrimit konkret, të saktë dhe të drejtë të kompetencave kushtetuese të cilat i përgjigjen situatës së krijuar kushtetuese.*”
67. Lidhur me rolin e Presidentit pas votimit të mocionit të mosbesimit, parashtruesit e kërkesës mbajnë qëndrimin se në atë rast, “*Qeveria konsiderohet në dorëheqje dhe Presidenti është dashur përmes*

dekretit të shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82 par. 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Pra, Presidenti nuk ka asnjë bazë kushtetuese të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës [...], e atë me pak nenin 95 par. 4 të Kushtetutës, për faktin se në mes nenit 100 par. 6 dhe nenit 95 mungon ura lidhëse e mbuluar me normë kushtetuese në mënyrë të shprehur.”

68. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se në rast të votimit të mosbesimit ndaj Qeverisë, nuk është situata e njëjtë sikur pas zgjedhjeve sa i përket procedurave për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë. Në Kushtetutë nuk ka asnjë normë të shprehur që parashihet se pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, Presidenti fillon procedurën sipas nenit 95.4 të Kushtetutës, përmes nenit 84.4 pas zbatimit të nenit 100.6 të Kushtetutës. Kjo procedurë e ndjekur nga Presidenti e bën kundër kushtetues Dekretin e kontestuar.
69. Për të mbështetur këto argumente, parashtruesit e kërkesës thirren edhe në kushtetuta të vendeve të tjera, konkretisht në dispozitat që rregullojnë çështjen e mocionit të mosbesimit, si Kushtetuta e Kroacisë, Sllovenisë, Gjermanisë, Greqisë, Serbisë, Shqipërisë si dhe Kornizën Kushtetuese për Qeverisje të Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Korniza Kushtetuese) e cila ishte në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ata argumentojnë se nëse në kushtetutat e vendeve të lartcekura, “*në mënyrë shprehimore parashihen hapat e mëtutjeshëm të cilët duhet t’i merr Kuvendi që deputetët të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të parandaluar shpërndarjen e Kuvendit, në Kushtetutën e Kosovës nuk parashihet asnjë procedurë tjetër pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, por vetëm shpërndarja e Kuvendit.*”
70. Andaj, mungesa e këtyre dispozitave konkrete kushtetuese, siç parashihet në kushtetutat e vendeve të tjera, bënë që Dekreti të jetë në kundërshtim me Kushtetutën. Në mungesë të kësaj dispozite lidhëse që pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit të caktohet mandatarit për formimin e Qeverisë nuk lejohet që të aktivizohet neni 95 i Kushtetutës, “*pasi ajo që nuk parashihet në Kushtetutë nuk mund të zbatohet.*”
71. Rrjedhimisht, sipas parashtruesve të kërkesës, pasi nuk parashihet mundësia e zgjedhjes së Qeverisë pas votimit të mocionit të mosbesimit, Kushtetuta parashihet norma të qarta për të zgjidhur situatën aktuale kushtetuese për të mbrojtur legjitimitetin demokratik, pra duke shpërndarë Kuvendin. Andaj Presidenti duke nxjerr Dekretin për të mandatuar kandidat për të formuar Qeverinë, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, ka vepruar në

kundërshtim me nenin 82.2 të Kushtetutës i cili nen është i lidhur natyrshëm me nenin 100.6 të Kushtetutës.

72. Parashtruesit e kërkesës për të mbështetur argumentet e tyre thirren edhe në dekretet e nxjerra në situata të ngjashme të mëhershme lidhur me shpërndarjen e Kuvendit, konkretisht të vitit 2010 dhe 2017 ku pas votimit të mocionit të mosbesimit, ishte shpërndarë Kuvendi përmes nenit 82.2 të Kushtetutës. Ata theksojnë se *“[n]ë lidhje me këtë edhe praktika e nxjerrjes së dekretëve nga Jakup Krasniqi, u.d. i Presidentit të Republikës së Kosovës në vitin 2010, dhe Presidenti Hashim Thaçi në vitin 2017, vërtetojnë qartë se pas mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, rruga e vetme kushtetuese e veprimit është shpërndarja e Kuvendit përmes nenit 82.2 të Kushtetutës.”*
73. Në këtë aspekt, ata tutje theksojnë se *“praktika e nxjerrjes së dekretëve në rrugën e duhur kushtetuese pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, ka të bëjë me respektimin demokracisë vox populi (zëri i popullit), që do të përfaqësohet në organin legjislativ. Pra ky organ zgjedh qeverinë (shih nenin 65.8 të kushtetutës), e cila rrjedh nga fuqia mbizotëruese dhe politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që fiton zgjedhjet.”* Kjo edhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO103/14, mund të jetë një fitore absolute apo relative. Kësisoj ky legjitimitet demokratik nuk mund të bartet te partitë që janë renditur pas vendit të parë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, për të krijuar qeveri pa fituesin e zgjedhjeve.
74. Po ashtu, ata argumentojnë se neni 82.2 nuk përmban dispozitë alternative për shpërndarjen e Kuvendit, kjo dispozitë shpreh rrugën e vetme të mundshme për krijimin e mundësisë për të ruajtur rendin kushtetuese të përcaktuar me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës. *“Folja modale “mund”, e përcaktuar në këtë dispozitë kushtetuese, nuk përbënë alternativë në zbatimin e saj, por ofron zgjidhjen e vetme (më adekuate) të mundshme kushtetuese për të vënë në funksion vullnetin e popullit, përmes zgjedhje parlamentare[...].”* Andaj, për këto arsye ata vlerësojnë se Dekreti i kontestuar është po ashtu në kundërshtim me nenin 84.4 lidhur me nenin 82.2 dhe nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës.
75. Lidhur me përmbajtjen e nenit 95.5 të Kushtetutës, ata më tej argumentojnë se neni 95.5 nuk mund të aktivizohet pasi në këtë rast Kryeministri nuk ka dhënë dorëheqje ashtu si parashihet në nenin 95.5 të Kushtetutës. Andaj, dhënia e dorëheqjes dhe shkarkimi nuk janë sinonime. Dhe pikërisht për shkak të këtij dallimi, sipas tyre *“në këtë mënyrë ndahen edhe rrugët zingjirore të zbatimit të normave kushtetuese”*. Nëse Kryeministri do të kishte dhënë dorëheqje atëherë

Presidenti do të ishte i obliguar që në konsultim me partitë politike apo koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, të mandatojë kandidatin e ri për të formuar Qeverinë.

76. Rast tjetër kur do të mund të aktivizohej paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës sipas parashtruesve të kërkesës, është rasti i vdekjes, ose pamundësisë së përhershme që ta ushtrojë funksionin Kryeministri. Por Kushtetuta nuk parasheh që në rast të votimit të mosbesimit të Qeverisë të zbatohet neni 95.5 i Kushtetutës.

(ii) Pretendimet për shkelje të dispozitave kushtetuese gjatë procedurës për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë përmes Dekretit të kontestuar

77. Në vazhdim të pretendimit të tyre se Presidenti ka qenë i obliguar që të shpallë zgjedhjet për Kuvend, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë identifikuar edhe shkelje të tjera kushtetuese me Dekretin e Presidentit, ku Presidenti, sipas tyre, në mënyrë jokushtetuese ka aktivizuar nenin 95 të Kushtetutës, por pasi e ka bërë këtë, në mënyrë jokushtetuese ka vazhduar me shkelje të tjera brenda nenit 95 të Kushtetutës.

78. Ata theksojnë se paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës përbëhet nga elementet në vijim: (i) nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose; (ii) për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie; dhe, (iii) Presidenti, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri për të formuar Qeverinë.

79. Së pari, lidhur me pikën (iii) të cekur më lart, parashtruesit e ankohen se Presidenti ka ftuar në konsultime të gjitha partitë politike parlamentare si pjesëmarrëse në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, duke shkelur kështu nenin 84 (14) të Kushtetutës, e cila dispozitë sipas interpretimit të Gjykatës në rastin KO103/14 kërkon që Presidenti lidhur me mandatarin për formimin e Qeverisë të konsultohet vetëm me partinë ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend dhe jo me partitë e tjera.

80. Së dyti, parashtruesit e kërkesës ankohen se “pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në tërësi, [...], sipas nenit 84 par. 14 lidhur me nenin 95 par. 4, pa pritur propozimin për mandatar të partisë politike e cila i ka fituar zgjedhjet [e 6 tetorit 2019], ka caktuar për mandatar kandidatin e caktuar për kryeministër nga radhët e partisë politike e cila ishte renditur e dyta në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 6 tetorit 2019. Ky

dekret antikushtetues i ka paraprirë letër këmbimeve të datës 22 prill 2020 dhe 29 prill 2020 (Letrat nuk janë bërë publike) në mes Presidentit dhe LDK-së. Kësisoj nxjerrja e këtij dekreti është në kundërshtim të plotë me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 dhe nenin 84 par.14 të Kushtetutës [...]” që përcakton se Presidenti “cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit.”

81. Në këtë linjë argumentimi, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Dekreti i Presidentit është në kundërshtim me Kushtetutën pasi partia ose koalicioni që ka fituar në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, respektivisht LVV: (i) është e vetmja parti politike që duhet të konsultohet për formimin e Qeverisë së re sipas nenit 95.5 të Kushtetutës; dhe (ii) është e vetmja parti politike që ka të drejtë të propozojë kandidatin për formimin e Qeverisë së re sipas nenit 84 (14) dhe nenit 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO103/14.
82. Parashtruesit e kërkesës ankohen gjithashtu lidhur me çështjen e afatit për të propozuar kandidatin për Kryeministër duke theksuar se, as Kushtetuta, as ndonjë ligj dhe as ndonjë aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese askund nuk parashohin një afat për propozimin e kandidatit nga partia fituese. Rrjedhimisht, Presidenti sipas Kushtetutës nuk ka të drejtë të përcaktojë afate në mënyrë arbitrare nëse ato nuk janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi. Afatet kushtetuese sipas tyre, fillojnë të rrjedhin vetëm në momentin kur Presidentit i propozohet një kandidat për kryeministër. Kjo pasi Presidenti vetëm mandaton kandidatin e propozuar në përputhje me vullnetin politik.
83. Prandaj, sipas parashtruesve të kërkesës, *“ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese, dhe ky diskrecion është i pakufizuar”* dhe i jep mundësinë partisë fituese që të dërgojë *“emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm që ajo e vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike, administrative dhe teknike për dërgimin e emrit të tillë”*. Ata theksojnë se kjo dëshmohet edhe me rastin e krijimit të institucioneve kushtetuese në vitin 2014 kur formimi i qeverisë kishte zgjatur gjashtë (6) muaj, vetëm dhe kryekëput si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese tek Presidenti.
84. Ata më tej theksojnë, duke e cituar Komentarin, Kushtetuta e Republikës së Kosovës *Hasani, Enver dhe Čukalović, Ivan (2013) GIZ, Prishtinë* (në tekstin e mëtejme: Komentari i Kushtetutës) se Presidenti nuk mund të thirret në kompetencën kushtetuese *“sigurimi i funksionimit të institucioneve”* për të përcaktuar arbitrarisht afate

kushtetuese të cilat nuk i ka caktuar vetë Kushtetuta. Prandaj, funksioni i tij si garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë nuk *“mëton të jep ndonjë kompetencë shtesë për Presidentin, por vetëm të vendos detyrimin që Presidenti ka për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të kompetencave të tij specifike”*.

85. Ata gjithashtu theksojnë se mungesa e afatit për të propozuar mandatarin partisë fituese të zgjedhjeve ka për qëllim që t'i jepet hapësirë partisë fituese për negociim për krijimin e Qeverisë duke argumentuar se kur *“kushtetutbërësit”* kanë pasur për qëllim të përcaktojnë afate, ata e kanë bërë këtë në dispozita konkrete të Kushtetutës, duke iu referuar dispozitave konkrete të Kushtetutës ku janë përcaktuar afate si për shembull në nenin 66, paragrafi 1 dhe 2; nenin 70.2; nenin 82, paragrafi 1; nenin 86, paragrafi 2 dhe 6; nenin 95, paragrafi 2 dhe 4; nenin 100, paragrafi 3 dhe 5; nenin 115, paragrafi 5 të Kushtetutës. Andaj, duke lejuar Presidentin për të përcaktuar afat të tillë që nuk parashihet as në Kushtetutë as në legjislacionin tjetër në fuqi, nënkupton që Presidentit t'i jepet e drejta e *“kushtetutbërësit”* e cila kompetencë i takon vetëm Kuvendit.
86. Andaj ata mbajnë qëndrimin që vendosja e afatit përmes shkresave të Presidentit që në këtë rast ka qenë afati njëzet (20) ditësh për LVV-në për të propozuar kandidatin për Kryeministër, apo çfarëdo afati tjetër është arbitrare dhe nuk është e paraparë me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi, dhe kjo e bën Dekretin e Presidentit jokushtetues, po ashtu.
87. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se hartuesit e Kushtetutës duke mos përcaktuar afatin për propozimin e mandatarit nga partia fituese, kanë pasur për qëllim që fituesit të zgjedhjeve t'i japin hapësirë të mjaftueshme për krijimin e Qeverisë përmes procesit politik, pra duke lënë qëllimisht të hapur afatin dhe duke mos i dhënë të drejtën asnjë institucioni që ta kufizojë atë. Lidhur me këtë, ata thirrën në rastin e Gjykatës KO119/14, ku sipas tyre Gjykata kishte konstatuar se edhe pse partia fituese kishte *“vonuar propozimin e emrit për Kryetar të Kuvendit për 6 muaj rresht, gjykata megjithatë nuk kishte kufizuar ndonjë afat por thjeshtë kishte konstatuar se e drejta propozimit të emrit për kryetar kuvendi i takon vetëm partisë së parë të dalë në zgjedhje. Pra edhe pse vonesa në atë rast ishte 6 muaj (për dallim të 20 ditëve në rastin konkret) dhe mosdërgimi i emrit për kryetar kuvendi e kishte bllokuar edhe konstituimin e Kuvendit e edhe krijimin e qeverisë, Gjykata përsëri nuk e afatizoi të drejtën e partisë së parë për të dërguar emrin e kryetarit të kuvendit.”* Ata po ashtu mbajnë qëndrimin se afati nuk konsumohet

me këmbimin e letrave, aq më tepër kur në këto letra LVV është shprehur se nuk refuzon propozimin e mandatarit.

88. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kontestojnë qëndrimin e Presidentit se duke mos propozuar kandidatin për të formuar Qeverinë, LVV ka hequr dorë nga e drejta e tyre për të bërë një propozim të tillë. Ata pretendojnë se refuzimi i propozimit për të propozuar mandatarin për formimin e Qeverisë nga partia fituese e zgjedhjeve, duhet të bëhet në mënyrë shprehimore e jo duke konsideruar se duke mos propozuar kandidatit sipas kërkesave të Presidentit në këmbimin e letrave me z. Albin Kurti, partia fituese e zgjedhjeve ka refuzuar të paraqes një propozim të tillë.
89. Ata konsiderojnë së në raste të caktuara fituesi i zgjedhjeve mund të njoftojë Presidentin se nuk dëshiron të shfrytëzojë të drejtën e tij për të propozuar një kandidat për kryeministër. Sipas tyre, në Kosovë ka një praktikë të tillë duke u thirrur në *“Refuzimin e z. Veseli që në vitin 2019 të propozojë një kandidat të ri për Kryeministër pas dorëheqjes së z. Haradinaj.”* Dhe sipas tyre në këtë rast edhe pse bëhej fjalë për dorëheqje e jo mocion mosbesimi, Presidenti nuk procedoi tutje me formimin e Qeverisë së re me forcat politike por e shpërndau Kuvendin. Sipas tyre, edhe vet Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO103/14, në paragrafin 87 e parasheh mundësinë e partisë për të refuzuar dërgimin e emrit për mandatar.
90. Andaj, ata pretendojnë se Presidenti në rastin konkret, ka shkelur Kushtetutën kur ka konsideruar se LVV ka hequr dorë nga e drejta për të propozuar kandidat për Kryeministër, pasi LVV nuk e ka bërë një refuzim shprehimor për të propozuar kandidatin për Kryeministër asnjëherë. Përkundrazi sipas tyre, në mënyrë shprehimore LVV ishte shprehur në letërkëmbimet me Presidentin se nuk po refuzojnë propozimin për mandatarin për formimin e Qeverisë.
91. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se veprimet e ndërmarra lidhur me propozimin e mandatarit për formimin e Qeverisë, përveç se përbëjnë shkelje procedurale të Kushtetutës, me dhënien e mandatarit për ta formuar Qeverinë partisë së dytë që ka dalë nga zgjedhjet, me këtë veprim *“do të ndryshohet legjitimiteti demokratik; do të shkelej vullneti i qytetareve përmes krijimit të konjunkturave artificiale partiake për të krijuar qeverinë në kundërshtim me legjitimitetin demokratik, respektivisht me zërin e popullit; do të humbte kuptimi i garës demokratike për fitimin e zgjedhjeve parlamentare; do mundësohej që rënia dhe krijimi i qeverisë së re përmes krijimit të konjunkturave parlamentare partiake të ishte shumë e zakonshme (shpeshtë); do të çrregullohej funksionimi i gjithë*

aparatit shtetëror nën menaxhimin dhe kontrollin e pushtetit ekzekutiv si pasojë alternimit të shpeshtë të partive politike në pjesëmarrje të pushtetit ekzekutiv. Në këtë mënyrë do të përmbysesh rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.”

92. Si përmbledhje e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, për arsyet e cekura më lart, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë që Dekreti i Presidentit është kundërkushtetues pasi: (i) Presidenti ka pasur për obligim të shpallë zgjedhjet e parakohshme për Kuvend pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë konform nenit 82, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe jo të caktojë kandidat për formimin e Qeverisë; (ii) Presidenti ka bërë shkelje të dispozitave Kushtetuese gjatë procedurës për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë përmes Dekretit të kontestuar; (iii) Presidenti, ka tejkaluar kompetencat e tij të parapara në nenin 95 të Kushtetutës kur ka ftuar për konsultime të të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend (takimi i parë dhe i dytë konsultativ me partitë politike) edhe pse me Kushtetutë ka qenë i obliguar të konsultohet vetëm me partinë fituese të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, në këtë rast vetëm LVV-në; (iv) Presidenti, ka anashkaluar partinë fituese të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 me rastin e caktimit të mandatarit për formimin e Qeverisë në kundërshtim me nenin 84, paragrafi 14 dhe nenin 95 të Kushtetutës si dhe Aktgjykimin KO103/19 të Gjykatës Kushtetuese, pasi e drejta për të propozuar kandidatin për Kryeministër i takon vetëm partisë fituese të zgjedhjeve, në këtë rast vetëm LVV-së; (v) as Kushtetuta dhe as Aktgjykimi KO103/14 nuk parashohin afat për partinë fituese të zgjedhjeve për të propozuar kandidatin për formimin e Qeverisë, andaj vendosja e çfarëdo afati, në rastin konkret afatit 20 ditë, që në këtë rast LVV për të propozuar kandidatin për mandatar për formimin e Qeverisë, ka qenë arbitrar dhe pa bazë kushtetuese; (vi) as Kushtetuta dhe as Aktgjykimi KO103/14 nuk parashohin mundësinë e refuzimit të propozimit të kandidatit për Kryeministër nga partia fituese e zgjedhjeve në mënyrë jo-shprehimore, andaj partia fituese mund të refuzojë propozimin për mandatarin vetëm në mënyrë shprehimore.

Komentet e dorëzuara nga palët e interesuara lidhur me meritat e kërkesës

Komentet e Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi

93. Presidenti fillimisht theksoi se “*kërkesa në rastin KO72/20 duhet të shpallet e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese, për faktin që ajo është e paqartë si në saktësimin, ashtu edhe në arsyetimin e saj.*”

94. Lidhur me rolin dhe kompetencat e Presidentit, pasi numëron nenet e Kushtetutës që ndërlidhen me kompetencat e tij si nenet: 4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 83, 93, 94, 95, 103, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139 dhe 144 të Kushtetutës, thekson se *“Parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë rolin dhe funksionet e Presidentit [...], bazuar para se gjithash në nenet e mësipërme të Kushtetutës, Ligjin nr. 03/L-094 për Presidentin [...], praktiken e Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht në rastin konkret të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin numër KO103/14.”*
95. Presidenti thekson se mandati i tij ka natyrë edhe politike, pasi që Presidenti merr pjesë në drejtimin e punëve publike. Lidhur me këtë ai thirret në Aktgjykimin KO28/12 dhe KO48/12 duke theksuar se: *“Gjykata Kushtetuese vëren që shprehja “të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike” në nenin 25 (a) të KNDCP-se [Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike] është kryesore për ushtrimin e mandatit të Presidentit të zgjedhur në mënyrë të drejtë e legjitime sipas Kushtetutës si pjesë e detyrave të tij/saj, siç parashihet në nenin 4,[...]”* të Kushtetutës. Ndërsa, *“Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës thotë që “Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit ... [dhe] ... është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”.*
96. Sipas Presidentit: *“Ky formulim sa i përket rolit të Presidentit është kryesor për njërin prej parimeve themelore të Kushtetutës së Kosovës, pra i doktrinës së ndarjes së pushtetit.”* Disa nga kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike të vendit, sikurse kur bën caktimin/propozimin e mandatarit për formimin e Qeverisë. Lidhur me këtë thirret edhe në rastin e Gjykatës KO12/18, duke theksuar se: *“Gjykata konsideron se organet kushtetuese janë të obliguara të përfillin kompetencat e njëri-tjetrit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese.”*
97. Andaj, ai shton se *“Presidenti është faktori kryesor që ka për detyrë të ruajë unitetin e popullit dhe stabilitetin, si dhe të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në rastin konkret edhe të Qeverisë [...]. Presidenti pra kryen funksione të veçanta dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ndalohej në kryerjen e këtyre funksioneve, sepse kjo bie në kundërshtim me përfaqësimin e unitetit të popullit si President. [...] Andaj, detyra e Presidentit për garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve është një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme, të*

cilën e kryen gjithnjë duke pasur parasysh përfaqësimin e popullit dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve.”

98. Lidhur me bazën juridike të Dekretit të kontestuar, Presidenti thekson se është tërësisht në përputhje me fushëveprimin kushtetues dhe kompetencat e Presidentit, *“veçanërisht duke pasur parasysh nënin 4 paragrafët 1 dhe 3, nënin 82, nënin 83, nënin 84 (2), (4) dhe (14) dhe nënin 95 të Kushtetutës.”*
99. Pasi Presidenti citon nenet e lartcekura të Kushtetutës, ai thekson se lidhshmëria mes neneve të lartpërmendura të Kushtetutës është konfirmuar edhe në praktikën e kësaj Gjykate, duke u thirrur specifikisht në paragrafin 61, 66, 67, 68, 73, 80, 8, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, dhe 95 të Aktgjykimit në rastin nr. KO103/14.
100. Lidhur me këtë, ai thekson se dispozitat e nenit 4 paragrafët 1 dhe 3, nenit 82, nenit 83, nenit 84 (2), (4) dhe (14) dhe nenit 95 të Kushtetutës si dhe Aktgjykimi i Gjykatës KO103/14 përbëjnë boshtin kryesor sipas së cilave Presidenti i ka propozuar Kuvendit kandidatin për Kryeministër dhe rrjedhimisht ka ndjekur procedurat për formimin e Qeverisë.
101. Sa i përket mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, Presidenti theksoi mes tjerash se arsyeja e kërkesës së mocionit të mosbesimit ishte: *“[...] krijimi i mundësisë së formimit të Qeverisë së re e cila do të adresonte sfidat imediate me të cilat po ballafaqohet vendi, si në pozicionin e politikës së jashtme, ashtu edhe në dinamikat e krijuara brenda vendit”. Në rrjedhë të kësaj kërkesë, Kuvendi i Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 07-V-013, datë 25.03.2020, ka miratuar Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës me votat e më shumë se dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit (82 deputetë).”*
102. Presidenti gjithashtu potencon faktin se pas mocionit të mosbesimit *“ka ftuar të gjitha partitë politike në takim për të diskutuar për hapat e mëtejme pas Mocionit të Mosbesimit ndaj Qeverisë. Takimet janë mbajtur në Kabinetin e Presidentit të Republikës së Kosovës më datën 01 dhe 02 prill 2020. Në këto takime me liderët e partive politike, shumica absolute prej tyre kanë kërkuar nga Presidenti që të shmangen zgjedhjet e parakohshme dhe të formohet Qeveri e re në përbërjen aktuale të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*
103. Lidhur me mos propozimin e kandidatit nga LVV, Presidenti pohon se i ka dërguar pesë (5) shkresa përmes së cilave i ka kërkuar Kryetarit të LVV-së të propozonte kandidatin e tij për të formuar Qeverinë. Në këtë

drejtim, Presidenti theksoi se LVV nuk i ishte përgjigjur asnjërës nga shkresat e Presidentit për caktimin e mandatarit. Më tej ai theksoi se “përgjigjet në shkresat e dërguara nga Presidenti, kanë ardhur gjithmonë nga Kryeministri në detyrë. Në këto shkresa vërehet tendenca e Kryeministrit në detyrë për të ndërhyrë në kompetencat e Presidentit, duke kërkuar sqarime dhe duke i treguar se si duhet të veprojnë në rastin konkret. Në këtë rast, Kryeministri në detyrë nuk i përfillë kompetencat e Presidentit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, duke e penguar në kryerjen e detyrave kushtetuese. Kjo bie ndesh me Nenin 4, Nenin 83, Nenin 84, Nenin 89 të Kushtetutës dhe me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin në rastin nr. KO12/18 (11 qershor 2018) thekson: “[...] konsideron se organet kushtetuese janë të obliguara të përfillin kompetencat e njëri-tjetrit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese [...].”

104. Presidenti mbi bazën e kësaj që u theksua më lart, po ashtu theksoi se “Vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, të përcaktuara jo vetëm në Nenin 7 të Kushtetutës, bazohen në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe këto kërkojnë që normat kushtetuese të mos abuzohen. Nëse ndodhë një abuzim i tillë, siç ka ndodhur në këtë rast, ku nuk është shfrytëzuar e drejta e propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë nga Lëvizja Vetëvendosje, Presidenti është i autorizuar që të gjejë zgjidhje për ta kaluar këtë situatë, duke përdorur dhe respektuar gjithnjë frymën e Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO103/14.”
105. Andaj, Presidenti mban qëndrimin se “Mosdeklarimi apo mosdërgimi i emrit nga ana e kryetarit të [LVV-së] dhe deklarimet e tij publike të vazhdueshme në shmangien e dërgimit të emrit (duke gjetur lloj-lloj arsytetime në letra dhe deklarime, veçanërisht duke ripërsëritur kërkesën për mbajtjen e zgjedhjeve dhe shpërndarjen e Kuvendit të dërguara në emër të Kryeministrit në detyrë) kanë qenë argumente të mjaftueshme për të treguar që Lëvizja Vetëvendosje ka hequr dorë nga e drejta për të propozuar kandidatin për Kryeministër. Lëvizja Vetëvendosje me çdo kusht është përpjekur të imponojë shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, ku këtë ka tentuar ta bëjë edhe përmes Kryeministrit në detyrë, si dhe në takimin e 22 prillit 2020 me liderët e partive politike parlamentare, në të cilin vetëm përfaqësuesja e Lëvizjes Vetëvendosje ka kërkuar shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme. Këtë situatë të mosshfytëzimit të së drejtës së marrjes së mandatit e ka parashikuar edhe Gjykata Kushtetuese në paragrafin 87 të

Aktgjykimit në rastin nr. KO103/14 (1 korrik 2014): “Sidoqoftë, Gjykata vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin.”

106. Lidhur me afatin për propozimin e kandidatit për Kryeministër, Presidenti po ashtu pohoi se *“duhet vlerësuar faktin se Presidenti në përputhje me rregullat, parimet demokratike, korrektësinë politike, parashikueshmerinë dhe transparencën ka bërë përpjekje të pareshtura që të konsultohet me Lëvizjen Vetëvendosje, e cila ka fituar numrin më të madh të vendeve në Kuvend dhe i ka dhënë mundësinë asaj që ta propozojë mandatarin nga radhët e tyre. Siç u theksua edhe më sipër, në vazhdimësi Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar shpërndarjen e Kuvendit sipas nenit 82 paragrafi 2 të Kushtetutës.”*
107. Presidenti pasi theksoi hapat që ka ndërmarrë pas shkëmbimit të letrave me Kryetarin e LVV-së dhe takimet me partitë politike dhe *“deklarimit të tyre njëzëri, përveç përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje, që janë për një Qeveri të re dhe që vendi të mos shkojë në zgjedhje, ju drejtua Lidhjes Demokratike të Kosovës si parti e dytë e dalë nga Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 6 tetor 2019, që të propozonte mandatarin potencial për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili duhej të siguronte se do ta ketë numrin e duhur të votave në Kuvendin e Kosovës dhe të zotohej se do të krijonte Qeveri stabile dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me Kriteret Mbizotëruese për formimin e Qeverisë së re.”*
108. Duke u thirrur në nenin 95 të Kushtetutës dhe paragrafin 90 të Aktgjykimit KO102/14, Presidenti theksoi se Dekreti i kontestuar *“është nxjerrë duke marrë parasysht faktin që Kushtetuta i jep Presidentit mundësinë e diskrecionit. Këtë dekret, Presidenti e ka nxjerrë në bazë të meritokracisë dhe veprimeve të partive politike dhe duke marrë parasysht që ka mundësi që ta bëjë Qeverinë pa shkuar në zgjedhje të reja [...]. Prandaj kur Presidenti ka nxjerrë Dekretin nr. 24/2020 për propozimin e kandidatit për kryeministër ka vepruar brenda fushëveprimit kushtetues, duke garantuar kështu parimin e ndarjes se pushteteve dhe vlerave demokratike të qeverisjes dhe përfaqësimit të interesit më të mirë të popullit të Kosovës, si përfaqësues i unitetit kushtetues të tyre. Por, duke garantuar edhe mosrrezikimin dhe pakësimin e lirive dhe të drejtave të njeriut që përcaktohen në Kapitullin II dhe Kapitullin III të Kushtetutës.”*

109. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se sipas praktikave të mëhershme pas mocionit të mosbesimit është shpërndarë Kuvendi, Presidenti theksoi se: *“Pretendimet e parashtruesve të kërkesës se Presidenti nuk ka vepruar sipas rasteve të mëhershme të shpërndarjes së legjislativave nuk qëndrojnë fare. Edhe në këtë rast, sikurse herëve të kaluara, Presidenti ka marrë për bazë vullnetin e partive politike, respektivisht vullnetin e të zgjedhurve të popullit. Në tri rastet e mëposhtme të shpërndarjes së legjislativave (Legjislatura e katërt, pestë dhe gjashtë), vullneti i partive politike shprehimisht ka qenë shpërndarja e Kuvendit dhe Presidenti e ka dekretuar këtë vullnet të tyre. Ndërsa, në rastin konkret, vullneti i dy të tretave (2/3) të përfaqësuesve të popullit është që të formohet Qeveria e re dhe vendi të mos shkojë në zgjedhje dhe në rrjedhë të këtij vullneti ka vepruar edhe Presidenti.”*
110. Këtë aspekt Presidenti e sqaroi duke elaboruar rrjedhën e shpërndarjes së Kuvendit që ka ndodhur në vitin 2014, 2017 dhe 2019, duke shtuar se *“Parashtruesit e kërkesës duhet ta kenë të qartë se Presidenti në asnjë mënyrë nuk ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën. Madje, Presidenti me Dekretin nr. 24/2020 (30.04.2020) ka mbrojtur parimin e kushtetutshmërisë, duke pasur parasysh se është përfaqësues i unitetit të popullit. Presidenti, para së gjithash, ka pasur parasysh interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Kushtetutë. Për ta tejkaluar këtë situatë është i nevojshëm funksionimi i plotë dhe bashkëpunimi i institucioneve vitale shtetërore të Republikës së Kosovës, siç janë Kuvendi dhe Qeveria. Në paragrafin 117 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO12/18, ndër të tjera theksohet: “[...] Vendimet themelore të politik-bërjes për qeverisjen e vendit duhet të merren nga organet kushtetuese me legjitimitet demokratik, përkatësisht nga Kuvendi dhe Qeveria [...]”* duke përsëritur arsyet e sipër cekura, sipas së cilave Presidenti ka vendosur të nxjerrë Dekretin e kontestuar.
111. Lidhur me pretendimin se Presidenti pa e pritur propozimin e partisë fituese ka propozuar kandidatin nga partia e dytë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, Presidenti theksoi se: *“pas votimit të Mocionit të Mosbesimit është konsultuar në vazhdimësi vetëm me partinë që ka fituar shumicën, në këtë rast me Lëvizjen Vetëvendosje.”* Duke shtuar se partia fituese ka neglizhuan në vazhdimësi Presidentin dhe se *“Neni 4 paragrafi 3 dhe neni 84(2) i Kushtetutës i japin atij një kompetencë kushtetuese që ka për qëllim të sigurojë garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve. Presidenti thekson që kompetenca kushtetuese e tij për caktimin e kandidatit për Kryeministër, që buron nga Neni 84(14) dhe Neni 95 i Kushtetutës,*

është vetëm njëra ndër kompetencat përmes të cilave Presidenti mund të bëjë garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve.”

112. Lidhur me aplikimin e neneve 82 dhe 95 të Kushtetutës Presidenti theksoi se: *“situata aktuale në të cilën është nxjerrë Dekreti i kontestuar nuk është “pas zgjedhjeve”, ashtu siç e përcakton Neni 95 paragrafi 1 i Kushtetutës, por është pas votimit të Mocionit të Mosbesimit, ku praktikisht posti i Kryeministrit ka mbetur i lirë. Në një situatë të tillë, po të mos nxirrej Dekreti i kontestuar do të rrezikoheshin parimet demokratike dhe tërë sistemi kushtetues, pasi që dy të tretat (2/3) e deputetëve të Kuvendit ishin shprehur duke votuar mosbesimin e Qeverisë.”*
113. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Presidenti nuk ka mundur të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës pas mocionit të votëbesimit, ai thekson se: *“Neni 100 paragrafi 6 dhe Neni 82 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të lexohen në ndërlidhje me Nenin 95 paragrafi 5 të Kushtetutës. Kjo është kështu për shkak të situatave të ndryshme që mund të krijohen, sikur në rastin e situatës aktuale.”*
114. Më tej Presidenti theksoi se: *“Duhet pasur parasysh që Neni 95 paragrafi 5 i Kushtetutës (të cilin Gjykata Kushtetuese nuk e ka interpretuar në rastet e mëhershme) i referohet procedurës së formimit të Qeverisë pas rënies së një Qeverie paraprake, siç e kemi rastin konkret. Në këtë rast nuk mund t'i referohemi procedurës së nominimit të mandatarit të Qeverisë pas zgjedhjeve parlamentare, por i referohemi konsultimeve me partitë politike ose koalicionet për të themeluar Qeverinë, në rastin kur Qeveria bie. Në këtë kuptim, Neni 82 paragrafi 2 i Kushtetutës zbatohet nga Presidenti nëse shihet se nuk ka vullnet nga partitë e përfaqësuara në Kuvend që të formohet Qeveria. Ndërsa, Neni 95 paragrafi 5 i Kushtetutës e rregullon procedurën e mandatimit të kandidatit për krijimin e Qeverisë, pasi që bie Qeveria. Pra, janë dy situata plotësisht të ndryshme dhe nuk kemi të bëjmë me ndonjë kolizion të neneve apo mbizotërim të neneve.”*
115. Në këtë aspekt, Presidenti konsideroi që *“këto elemente janë të lidhura dhe se Neni 95 paragrafi 5 i Kushtetutës duhet të lexohet i ndërlidhur me Nenin 100 paragrafi 6 të Kushtetutës, për faktin se njëra ndër arsyt tjera kur posti i Kryeministrit mbetet i lirë është edhe kur Qeveria e tij/sai shkarkohet përmes Mocionit të Mosbesimit. Këtë e forcon dhe argumenti se në Nenin 95 paragrafi 5 të Kushtetutës përmendet fjala “dorëheqje e kryeministrit” kurse në Nenin 100 paragrafi 6 të Kushtetutës përmendet fjala Qeveria*

konsiderohet në dorëheqje [...]”. Në të dyja këto situata ujen në shprehje efekti juridik i të qenit në dorëheqje. Në analizë të ndërlidhur nënkuptohet se nëse Kryeministri jep dorëheqje dhe Qeveria e tij është në dorëheqje, në secilën rrethanë posti i tij mbetet i lirë për shkak se në rastin e mosbesimit të suksesshëm, Kuvendi përveç Qeverisë ia shkëput legjitimitetin edhe Kryeministrit, duke e lënë edhe Kryeministrin pa mandat kushtetues dhe rrjedhimisht vendin e tij vakant në kuptimin juridiko-kushtetues. Presidenti konsideron që si në rastin e dorëheqjes së Kryeministrit, ashtu edhe në rastin e votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit. Qeveria bie dhe konsiderohet në dorëheqje. Andaj kjo përbën një rrethanë të re që fut në funksion edhe Nenin 95 paragrafi 5 të Kushtetutës, i cili ritheksojmë se nuk është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin në rastin KO103/14, pasi që rënia e Qeverisë dhe Kryeministrit përbën një rrethanë të re nga situata kur Qeveria formohet "pas zgjedhjeve", siç përcakton Neni 95 paragrafi i i Kushtetutës.”

116. *Më tutje, Presidenti theksoi se: “Sipas Nenit 95 paragrafi 5, rrethanat hipotetike kur Qeveria bie mund të jenë: Dorëheqja e Kryeministrit; Vdekja e Kryeministrit; Sëmundja e rëndë e Kryeministrit; Dënimi i Kryeministrit për veprë penale, me vendim përfundimtar dhe votimi i shkarkimit të Qeverisë dhe Kryeministrit (Mocioni i Mosbesimit të Qeverisë) [...] Kryeministri dhe Qeveria janë të lidhur njëri me tjetrin në kuptim të legjitimitetit dhe Kuvendi kur e voton Qeverinë voton edhe Kryeministrin. Anasjelltas, Kuvendi kur ia merr besimin Qeverisë përmes mosbesimit të njëjtin ia merr edhe Kryeministrit, sepse nuk ka logjikë që posti i Kryeministrit të ekzistojë kur një Qeverie të udhëhequr nga ai/ajo i është votuar mosbesimi.”*
117. *Sa i përket referencave të parashtruesve të kërkesës lidhur me kushtetutat e vendeve të tjera, Presidenti thekson se “këto zgjedhje kushtetuese dallojnë nga konteksti i Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet. Parashtruesit e kërkesës duhet theksuar që i referohen vetëm neneve që i konvenojnë për argumentet e tyre” duke dhënë disa shembuj në këtë aspekt. Për shembull, Presidenti theksoi se: “ka Kushtetuta që nuk përcaktojnë saktësisht se çfarë veprimesh mund të ndërmarr Presidenti pas votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë, gjithnjë në kuptim të veprimit për të krijuar një Qeveri të re. Në Republikën e Kosovës, megjithatë rasti është i qartë. Neni 95 është neni që autorizon Presidentin që të veprojë pas votimit të Mocionit të Mosbesimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pasi që konsiderohet se votimi i suksesshëm i mocionit rezulton me efektin juridiko kushtetues që posti i kryeministrit mbetet i lirë (kryeministër në dorëheqje).”*

118. Lidhur me përmbajtjen e nenit 82 të Kushtetutës, Presidenti argumentoi se: *“Neni 82 i Kushtetutës ka dy paragrafë. Paragrafi 1 ka tre nën paragraf. Paragrafi 1 përcakton tri situata kur Kuvendi shpërndahet në mënyrë automatike, nëse këto situata ndodhin. Në rastin e paragrafit 2 të Nenit 82 të Kushtetutës, çështja qëndron krejtësisht ndryshe, sepse përcaktohet se “Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti... shprehia “mund” nuk përbën një detyrim shprehimor për Presidentin, por e obligon Presidentin që të bëjë një vlerësim të rrethanave nëse Kuvendi mund të shpërndahet apo jo, pas votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë. Pra, folja “mund” tregon që shpërndarja ose jo e Kuvendit është në vullnetin e vlerësimit të Presidentit, pas konsultimit edhe me partitë politike të përfaqësuar në Kuvend, të cilën gjë e ka bërë në rastin konkret. Kjo është arsyeja pse Neni 82 i Kushtetutës është i ndarë në dy paragrafë, ku paragrafi i parë përcakton situatat kur Kuvendi shpërndahet domosdoshmërisht, kurse paragrafi tjetër situatën kur Kuvendi mund të shpërndahet.”*
119. Lidhur me pretendimin e parashtresve të kërkesës se Presidenti nuk ka cekur paragrafët e nenit 95 sipas së cilit ka nxjerrë Dekretin, Presidenti theksoi se: *“në preambulën e Dekretit përcaktohet Neni 95 i Kushtetutës, pa specifikuar paragrafët, për faktin se Presidenti ka aktivizuar Nenin 95 të Kushtetutës si tërësi, duke përfshirë edhe paragrafin 5 të këtij neni (Nenin 95 paragrafi 5), pasi që konsideron se posti i Kryeministrit ka mbetur i lirë dhe se Qeveria ka rënë pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit. Arsyeja tjetër pse në preambulën e Dekretit të kontestuar është Neni 95 i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se Presidenti nuk ka mundur të specifikojë paragrafët, për shkak se tani jemi në një situatë tjetër kushtetuese dhe jo “pas zgjedhjeve”. [...]*
120. Lidhur me pretendimin e parashtresve të kërkesës se Presidenti nuk është “kushtetutbërës”, Presidenti theksoi se ai e “ka të qartë funksionin e tij që i cakton Kushtetuta, ligjet dhe disa Aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese, që tanimë janë normë kushtetuese. Andaj, Presidenti i rikujton parashtresve të kërkesës se asnjëherë nuk ka luajtur rolin e kushtetutbërësit, por vetëm i është përmbajtur kompetencave të tij të përcaktuara në nenet 4 paragrafi 3; 83, 84 (2) dhe (14) dhe 95 të Kushtetutës” dhe Aktgjykimit KO103/14.
121. Në fund Presidenti thekson se *“bazuar në këto argumente, kërkesa KO72/20 duhet të shpallet e papranueshme, sepse nuk është në pajtim ratione materiae me Kushtetutën.”*

Komentet e Kryeministrit në detyrë, z. Albin Kurti, të dorëzuara në emër të Qeverisë në detyrë

122. Lidhur me shpërndarjen e Kuvendit sipas nenit 82.2 të Kushtetutës, Kryeministri citoi versionin shqip dhe anglisht të paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, duke theksuar se: *“Një krahasim i versioneve gjuhësore shpërfaqë faktin se gjatë përkthimit të tekstit të Kushtetutës nga angleze në gjuhën shqipe, folja “may” është përkthyer sikurse të ishte përdorur folja “can”. Në këtë mënyrë, norma kushtetuese e cila në versionin burimor (në gjuhën angleze) të aprovuar nga PCN [Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar] ka dispozitiv autorizues/lejues, pra është normë që i njeh Presidentit një kompetencë dhe që në fakt e detyron Presidentin të shpërndajë Kuvendin, [dhe kjo] është duke u keqinterpretuar nga Presidenti dhe disa nga forcat politike si normë alternative, e cila çështjen e shpërndarjes së Kuvendit e lë në diskrecion të Presidentit. Mirëpo, nga praktika e deritanishme kushtetuese dhe dëshmitë e anëtarëve të Komisionit Kushtetues, të cilat do të elaborohen më poshtë, do të shihet se asnjëherë nuk ka pasur dyshime në lidhje me detyrimin e Presidentit që të shpërndajë parlamentin pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi.”*
123. Më tej Kryeministri shtoi se: *“Në teorinë dhe praktikën juridike, karakteri i normës përcaktohet jo vetëm nga një folje në fjali, por nga mënyra si është ndërtuar ajo. Rrjedhimisht, përdorimi i foljes “mund”, nuk përcakton vetvetiu se norma ka karakter alternativ. Që norma të konsiderohet alternative, ajo duhet të përmbajë në formulimin e tekstit të saj edhe të paktën një alternativë që mund të zgjidhet nga organi, të cilit i është njohur diskrecioni në vlerësim dhe zgjedhje mes alternativave.”*
124. Ai shtoi se: *“shembuj të normave alternative kemi edhe në Kushtetutën e Kosovës. Kështu Neni 62 në paragrafin 4 i lë në diskrecion zëvendëskryetarit të komunës që, edhe pas vlerësimit të përputhshmërisë së një akti komunal me liritë dhe të drejtat e garantuara për komunitetet nga ana e kuvendit të komunës, ta referojë atë çështje në Gjykatën Kushtetuese. [...] Në të drejtën kushtetuese krahasuese, norma alternative të cilat lënë në diskrecion të një organi kushtetues zgjedhjen mes alternativave janë ato pas një mocioni votëbesimi apo pas votimit të një qeverie të pakicës. Shembuj të tillë të formulimit të normave janë p.sh.: “Nëse Parlamenti voton një Qeveri të pakicës, Presidenti mund të emërojë Kryeministrin/Kancelarin ose mund të shpallë zgjedhjet”; ose “Nëse Kryeministrit i tërhiqet votëbesimi nga Parlamenti, ai mund të kërkojë një partner tjetër qeverisës, mund të kërkojë shpalljen e*

gjendjes së ligjdhënies së jashtëzakonshme ose mundet t'i kërkojë presidentit të shpallë zgjedhjet.”

125. Andaj, Kryeministri mbajti qëndrimin se: *“Nga formulimi i nenit 82.2 “Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë” vërehet se Kushtetutbërësi nuk ka paraparë asnjë alternativë tjetër për Presidentin. Prandaj kjo normë çdoherë është kuptuar në kuadër të një mocioni destruktiv të mosbesimit i cili, përpos shkarkimit të Qeverisë ka për pasojë edhe shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve.”*
126. Në këtë drejtim Kryeministri theksoi se: *“edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në lidhje me karakterin alternativ të normave kushtetuese, ka konstatuar se sikurse Kushtetutbërësi të kishte pasur për qëllim që të parashikte një alternativë në Kushtetutë, atë do ta bënte shprehimisht. Për këtë arsye, ajo që nuk është paraparë në Kushtetutë nuk mund të konsiderohet si alternativë hipotetike.”* Këtë argument ai e mbështet duke u bazuar në paragrafin 71 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO29/11 ku thuhet se: *“Nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës do të kishte qenë që të paraqisnin një procedurë alternative për zgjedhje, vetëm me një kandidat të nominuar, Kushtetuta, shprehimisht do e kishte parashikuar një procedurë të tillë.”* Andaj sipas tij: *“Në të njëjtën frymë, sikurse Kushtetutbërësit të kishin pasur për qëllim që të paraqisnin një alternativë tjetër, përpos shpërndarjes së Kuvendit, atëherë do ta bënë këtë në Kushtetutë.”*
127. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Gjykata duhet të marrë për bazë dokumentin kushtetues që i ka paraprirë Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht Kornizën Kushtetuese, Kryeministri pohon se *“Gjykata Kushtetuese ka përdorur Kornizën Kushtetuese për të krahasuar ndryshimin në rregullimin kushtetues të organeve shtetërore. Prandaj nga leximi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mund të vërehet qartë krahasimi i Kushtetutës së Kosovës me Kornizën Kushtetuese”. Lidhur me këtë ai u thirr në “paragrafët 69, 70 dhe 71 të rastit nr. KO19/11. me qëllim që të kuptojnë arsyet pse Kushtetutdhënësi ka ndryshuar rregullimin kushtetues përkitazi me një situatë të caktuar, përmes metodës së krahasimit historik të akteve kushtetuese ka arritur të nxjerrë në sipërfaqe qëllimin dhe vullnetin e ligjdhënësit.”*
128. Lidhur me këtë Kryeministri theksoi se: *“Para shpalljes së Pavarësisë në Kosovë ishte i njohur ai që quhet “mocion konstruktiv i mosbesimit” sipas të cilit, një Qeveri mund të shkarkohet vetëm nëse shumica e re parlamentare zgjedh menjëherë pasardhësin e*

kryeministrit të Qeverisë së shkarkuar. Në një situatë të tillë, Kuvendi nuk shpërndahet, por vazhdon të funksionojë deri në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit të paraparë me Kushtetutë.”

129. Në aspekt krahasimor, Kryeministri citoi, mes tjerash, Kushtetutën e Shqipërisë duke theksuar se: *“Neni 104 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon të drejtën e Kryeministrit për të kërkuar mocion besimi në Kuvend. Votimi i mocionit të besimit nga më pak se gjysma e anëtarëve të Kuvendit çon në shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti i Republikës brenda 10 ditësh, pak a shumë si në rastin e nenit 82.2 të Kushtetutës së Kosovës. [...] Neni 105 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton procedurën kushtetuese të mocionit të mosbesimit. Këtu votimi i mocionit të mosbesimit kushtëzohet me zgjedhjen nga më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit të Kryeministrit të ri, njësoj si në rastin e Kornizës Kushtetuese.”*
130. Sa i përket Kushtetutës së Gjermanisë, Kryeministri theksoi se: *“Kushtetuta Gjermane ka parashikuar mocionin e votëbesimit në dy dispozita, nenin 67 dhe nenin 68 të saj. Neni 67 parashikon mundësinë e mocionit të mosbesimit të kërkuar nga parlamenti (Bundestag) vetëm me zgjedhjen gjithashtu të pasardhësit të tij. Presidenti në këtë rast vetëm shkarkon Kryeministrin dhe emëron zgjedhjen e re të Bundestagut për Kanzler. [...] Ndërsa në nenin 68 parashikohet mundësia e kërkesës për votëbesim nga vetë Kryeministri (Bundeskanzler) dhe detyrimi i Presidentit, në rastin e dështimit të kësaj kërkesë, për të shpërndarë parlamentin. [...] Si në rastin e nenit 67, ashtu edhe në nenin 68, Kushtetuta Gjermane nuk lë vend për pushtet diskrecional të Presidentit, por në të dy rastet parashikon qartë detyrimin e tij për të vepruar në mënyrën e përcaktuar nga Kushtetuta.”*
131. Kryeministri, po ashtu theksoi se e drejta krahasuese dërgon *“në përfundim se përpos që në shtetet ku e drejta për të provuar formimin e Qeverisë së re, pas rrëzimit të përbërjes së mëhershme të kabinetit, është e paraparë shprehimisht në Kushtetutë, në ato shtete për dallim nga Kosova”* (i) zgjedhja e deputetit në pozitën e Kryeministrit apo Ministrit nuk rezulton me humbjen e mandatit të tij si anëtar i Kuvendit; (ii) nuk ka vende të garantuara për përfaqësues të pakicave në Kuvend; (iii) nuk ka vende të garantuara për përfaqësues të pakicave në përbërjen e Qeverisë.
132. Sa i përket pikës (i) të cekur më lart, në komentet e Kryeministrit u theksua se *“Fakti se me zgjedhjen e tij në pozitën e Kryeministrit apo Ministrit, deputeti e përfundon mandatin e tij si anëtar i Kuvendit të*

Kosovës, nënkupton shkëputjen e tij me sovranin i cili e legjitimon atë drejtpërdrejtë. Në rast të rrëzimit të Qeverisë, përmes një mocioni mosbesimi, atëherë të gjithë deputetët e zgjedhur në Qeveri do të përjashtoheshin nga jeta institucionale. Në këtë situatë, ata do të vendoseshin në një pozitë të pabarabartë me deputetët tjerë, të cilët do të mund të vazhdonin mandatin deri në fund. Shkëputja e zinxhirit të legjitimitetit kushtetues, i cili paraqet esencën e parimit të demokracisë kushtetuese, nënkupton me zhbërje të rendit demokratik.”

133. Lidhur me procedurat kushtetuese dhe parlamentare në Kosovë pas mocionit të votëbesimit, edhe Kryeministri u thirr në praktikën e vitit 2010 dhe 2017 duke theksuar intervistën e U.D. të Presidentit z. Jakup Krasniqi, “i cili në një intervistë me datën 02.11.2010 pati theksuar se “Ndoshta është mirë të sqaroj se ky mocion ndodh sipas pikës kushtetuese ku flitet për Kuvendin dhe në fund të këtij kapitulli, në Nenin 82 parashihet se nëse mocioni i mosbesimit mbështetet nga 61 deputetë, atëherë nuk ka më procedura të tjera në Kuvend. E vetmja procedurë mbetet shpërndarja e Kuvendit dhe caktimi i datës për zgjedhje.”” Ai shtoi se “Konstatime të njëjta me ato të z. Jakup Krasniqi i cili ishte anëtar i Komisionit Kushtetues i ka paraqitur publikisht edhe anëtari tjetër i këtij komisioni Prof. Dr. Arsim Bajrami, [...]”
134. Kryeministri gjithashtu u thirr edhe në fjalimin e Presidentit të tanishëm i cili në cilësinë e tij të mëparshme të Kryeministrit “Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës të datës 02.11.2010, në cilësinë e Kryeministrit dhe propozuesit të mocionit të mosbesimit, ai ka kërkuar votat pro mocionit të mosbesimit duke theksuar se “Sot besoj se do të votoni drejt duke i vënë fund krizës institucionale e politike e pastaj të dilni para qytetarëve në zgjedhje të reja për të rimarrë besimin e tyre. Duke e bërë një veprim të tillë, i cili është plotësisht në përputhje me kushtetutën tonë, ju i hapni rrugë krijimit të institucioneve të reja më të fuqishme të shtetit tonë me një legjitimitet të ri.”
135. Në lidhje me sa më sipër Kryeministri përfundoi se: “Në vitin 2010 është zhvilluar mocioni i parë i mosbesimit në Kosovë, i cili është votuar me 66 vota për. Në të njëjtën ditë është shpërndarë Kuvendi dhe janë shpallur zgjedhjet. Në vitin 2017, po ashtu është zhvilluar një mocion mosbesimi dhe në të njëjtën ditë është shpërndarë Kuvendi dhe janë shpallur zgjedhjet, pa asnjë konsultim me asnjërin nga partitë politike dhe koalicionet të përfaqësuar në Kuvend.”, duke shtuar se “Argumenti i përdorur se ka dallim midis mocionit të tanishëm të mosbesimit nga ata të mëhershmit, për shkak se në vitin

2010 dhe 2017 forcat politike ishin pajtuar që të shpërndahet Kuvendi dhe të shpallen zgjedhjet, nuk qëndron. Qeveria rithekson se përpos se nuk ka ekzistuar një konsensus i tillë, Kushtetuta nuk mund të anashkalohet me marrëveshje politike.”

136. Lidhur me paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës, Kryeministri theksoi se: *“Presidenti konsultohet vetëm me partinë politike apo grupin parlamentar që ka fituar shumicën në zgjedhje, qoftë absolute apo relative (paragrafi 84 i Aktgjykimit). Sipas Gjykatës, e drejta për të propozuar një kandidat i takon vetëm fituesit të zgjedhjeve, qoftë ai fitues absolut apo relativ. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se Presidenti mundet të anashkalojë fituesin e zgjedhjeve, vetëm nëse ky heq dorë shprehimisht nga e drejta e tij. Por në asnjë rrethanë tjetër.”*
137. Sa i përket paragrafit 2 të nenit 95 të Kushtetutës, ai theksoi se: *“Kushtetuta ka përcaktuar rrjedhjen e afateve vetëm pasi kandidati për Kryeministër të jetë emëruar nga Presidenti. Pra në asnjë moment më herët nuk janë përcaktuar afate. Kjo gjë është në pajtim me shembujt e kushtetutave në të cilat parlamenti e zgjedh Qeverinë, dhe ku po ashtu nuk janë përcaktuar afate brenda të cilave obligohen forcat politike të formojnë një Qeveri”,* pasi kështu edhe në praktikën parlamentare të Kosovës kur zgjedhja e Qeverisë ka zgjatur deri në gjashtë (6) muaj.
138. Pastaj, sipas Kryeministrit, paragrafët 3 dhe 4 të nenit 95 parashohin procedurat që duhet ndjekur në rast se kandidati dështon të fitojë shumicën në Kuvend.
139. Lidhur me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, Kryeministri theksoi se: *“ky paragraf nuk lë dyshime se flet për një situatë tjetër, përpos asaj pas dorëheqjes së Kryeministrit apo mbetjes vakante të pozitës së tij për shkak të vdekjes, pamundësisë për të ushtruar funksionin apo dënimit për vepër penale. Në asnjë rrethanë Kushtetutbërësi nuk e ka barazuar situatën e tillë me situatën pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi. Mirëpo, edhe sikur kjo dispozitë (paragrafi 5) të zbatohet, ose paragrafi 4, theksi i kushtetutdhënësit, ashtu si e ka gjykuar Gjykata Kushtetuese, është te partia politike apo koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend. Sipas Gjykatës Kushtetuese “Kriteri” që përben shumicën në Kuvend”, nga neni 84.14 i Kushtetutës, duhet lexuar në lidhje me dispozitën e nenit 95, paragrafi 1 të Kushtetutës, pra, partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend, pra numrin më të madh të vendeve.”*

140. Më tutje, Kryeministri shtoi se: *“Është e rëndësishme të theksohet se në të njëjtin Aktgjykim Gjykata ka theksuar se nuk i lejohet Presidentit të imponohet në procesin e formimit të Qeverisë, prandaj, edhe sikur të zbatohej neni 95 i Kushtetutës, pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, Presidenti duhet t'i përmbahet rolit të tij kushtetues dhe të presë propozimin nga partia politike. Për më tepër shih paragrafin 68 të Aktgjykimit në rastin KO 103/14 "Sa i përket pikës (b) Pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, Gjykata është e mendimit se propozimi për emërimin duhet të rrjedhë nga partia politike ose nga koalicioni i cili do t'ia paraqesë Presidentit të Republikës emrin e personit për mandatar për Kryeministër.”*
141. Ai po ashtu theksoi se po të ishte i aplikueshëm neni 95, paragrafi 5 i Kushtetutës pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit, atëherë kjo do të thoshte se U.D. Presidenti Jakup Krasniqi dhe Presidenti Hashim Thaçi e paskan shkelur Kushtetutën në vitet 2010 dhe 2017 pa ftuar partinë politike fituese që të propozojë kandidatin e ri për mandatar.
142. Kryeministri theksoi se LVV asnjëherë nuk ka hequr dorë nga e drejta e saj kushtetuese dhe në vazhdimësi i ka kërkuar Presidentit që të qartësojë se cila është baza ligjore e veprimeve të tij sipas nenit 95, pasi ky nen i ka 6 paragrafë por Presidenti nuk i është përgjigjur këtyre kërkesave të fituesit të zgjedhjeve duke e interpretuar këtë si refuzim për të propozuar kandidatin për Kryeministër.
143. Si përfundim lidhur me këtë pjesë Kryeministri theksoi se: *“Qeveria vjen në përfundim se Presidenti i Republikës së Kosovës, edhe sikur të zbatohej neni 95 pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën”* sepse: (i) ka ndërmarrë vetiniciativë në formimin e Qeverisë; (ii) ka konsultuar edhe parti tjera politike, përpos fituesit të zgjedhjeve; (iii) ka imponuar një afat në kundërshtim me Kushtetutën; (iv) ka interpretuar kërkesën e Kryeministrit, z. Albin Kurti, për të specifikuar bazën ligjore të veprimeve të Presidentit, si heqje dorë nga e drejta për të propozuar një kandidat për Kryeministër; (v) ka kërkuar nga partia e dytë që të propozojë një kandidat për Kryeministër të cilin e ka mandataruar përmes Dekretit të kontestuar.
144. Sa i përket strukturës dhe Dekretit të kontestuar, Kryeministri theksoi se: *“përderisa në preambulën e dekretit të Presidentit nuk specifikohet se cila është baza konkrete kushtetuese e veprimeve të tij, dekreti ka të meta në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e tij. Kësisoj, ai është një akt juridikisht i pavlefshëm, sepse institucionet publike, përfshirë edhe Presidentin duhet të arsyetojnë bazën juridike*

të veprimeve të tij. [...] neni 95 i Kushtetutës së Kosovës ka gjashtë (6) paragrafë të cilët rregullojnë çështje të ndryshme nga njëra-tjetra. Për këtë arsye, Presidenti nuk mund të thirret në një dispozitë të përgjithshme që rregullon disa çështje, për të legalizuar një veprim konkret. Por ai duhet të paraqet bazë konkrete kushtetuese për të arsyetuar kushtetutshmërinë e dekretit të tij.”

145. Për me tepër, pasi që ritheksoi disa nga argumentet e cekura më lart lidhur me hapat që duhet të ndërmerren pas votimit të mocionit të mosbesimit, Kryeministri sqaroi se lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës KO103/14 “*ka interpretuar paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, i cili si u theksua disa herë rregullon procedurën e formimit të Qeverisë menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe konstituimit të Kuvendit. Për këtë arsye, ky Aktgjykim nuk mund të përlligjë veprimet dhe Dekretin e Presidentit.*”
146. Gjithashtu, Kryeministri thekoi se Dekreti i kontestuar “*parasheh një afat 15 ditor për kandidatin e propozuar për Kryeministër. Nga e drejta e krahasuar u kuptua se kur pas një mocioni mosbesimi parashihet e drejta për të tentuar një Qeverie të re, atëherë ajo mundëson vetëm një përpjekje. Kësisoj, kur një Qeveri është zgjedhur menjëherë pas zgjedhjeve dhe më në rrugë kushtetuese humb besimin në Parlament, atëherë lejohet vetëm një tentim. Nga akti i kontestuar vërehet se Presidenti e ka konsideruar si të mirëqenë faktin se të gjitha procedurat për legjitimimin dhe zgjedhjen e një Qeverie të re fillojnë nga pika zero, ngjashëm sikurse menjëherë pas zgjedhjeve.*”
147. Po ashtu lidhur me Dekretin e kontestuar, ai thekson se: “*Akti i kontestuar është rezultat i një rruge tërësisht jokushtetuese e cila është manifestuar nga vetiniciativa jokushtetuese e Presidentit për të formuar Qeverinë. Se ai ka tejkaluar kompetencat e tij edhe në këtë drejtim, dëshmohet nga deklaratat e tij në të cilën ai edhe dikton përbërjen e kabinetit qeveritar që ai do ta dekretojë, në të kundërtën nuk do ta bënte një gjë të tillë. Ai ishte shprehur se “Tek çështja e integritetit, dua të jem edhe më i drejtpërdrejtë. Mendoj dhe nuk do të tolerojmë që të ketë anëtarë të qeverisë me njerëz me aktakuza të ngritura e as në dikasteret e tjera ekzekutive.”*”
148. Lidhur me nevojën për një Qeveri me legjitimitet demokratik nga Kuvendi, Kryeministri theksoi se Presidenti ka mbështetur vetë iniciativën e tij kundër kushtetuese për formimin e një Qeverie duke deklaruar se vendit i duhet një Qeveri e cila mund të marrë vendime për luftimin e pandemisë COVID-19. Lidhur me këtë ai thekson se: “*Në lidhje me vendimmarrjen përkitazi me situatën emergjente të shëndetit publik, duhet theksuar se në asnjë fazë, as para dhe as pas*

mocionit të mosbesimit, nuk ka pasur dështim të Qeverisë në marrjen e masave të nevojshme për luftimin e pandemisë COVID-19.”

149. Andaj, Kryeministri pretendoi se *“pretendimi i Presidentit rreth përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë është i paqëndrueshëm, sepse as Kushtetuta dhe asnjë ligj parlamentar nuk kufizon asnjë nga kompetencat e Qeverisë pas mocionit të mosbesimit. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar Qeverinë si funksionale edhe pas dorëheqjes së ish-kryeministrit Ramush Haradinaj.”*
150. Në fund, Kryeministri i propozoi Gjykatës që të nxjerrë Aktgjykim përmes të cilit e deklaroi kërkesën të pranueshme dhe shpallë Dekretin e kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës.

Komentet e Kryetares së Kuvendit, znj. Vjosa Osmani

151. Në komentet lidhur me kërkesën Kryetarja e Kuvendit theksoi fillimisht se përmes Dekretit të kontestuar, Presidenti ka shkelur parimin e ndarjes së pushtetit të garantuar me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit].
152. Ajo më tej theksoi se parimi i ndarjes së pushteteve është elaboruar edhe në Komentarin e Kushtetutës dhe është konfirmuar edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese duke u thirrur në paragrafin 54 të rastit KO103/14 dhe rastin KO98/11 ku ishte potencuar parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe balancimit mes tyre.
153. Në këtë kuptim dhe duke theksuar rolin e Kuvendit lidhur me kushtetutbërjen dhe obligimin që sjell zbatimi i Kushtetues, ajo thekson se: *“Kushtetuta e Republikës së Kosovës buron nga populli dhe është jetësuar me anë të votimit nga shumica e nevojshme e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke u renditur si bazamenti i funksionimit juridiko-politik të vendit. Secili nen dhe paragraf i Kushtetutës është i pacenueshëm dhe i pandryshueshëm, për sa kohë që përfaqësuesit e sovranit nuk vendosin ndryshe, me anë të procedurave të parapara kushtetuese për ndryshimin e aktit më të lartë juridik të Republikës së Kosovës. Si të tilla, të gjitha dispozitat kushtetuese janë drejtpërdrejtë të zbatueshme nga secili institucion dhe organ në Republikën e Kosovës, siç parashihet edhe në paragrafin 4 të nenit 16 të Kushtetutës, i cili thekson që: “Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”* Ajo shtoi se: *“Pra, Kushtetuta i ka dhënë shprehimisht*

të drejtën e kushtetutë-bërjes vetëm Kuvendit të Kosovës, respektivisht deputetëve që kanë fituar mandat në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.”

154. Andaj, Kryetarja e Kuvendit mbajti qëndrimin se: *“Në këtë kuptim, Presidentit të Republikës së Kosovës, me Kushtetutë nuk i njihet në asnjë formë kompetenca e kushtetutë-bërjes. E në rastin konkret, këtë të drejtë nuk e gëzon Presidenti as në kuptim të përcaktimit të afateve kohore lidhur me mandatin e kandidatit për Kryeministër të vendit, përderisa nuk ekziston një normë e tillë kushtetuese.”* Kjo, sipas saj, sepse *“Sipas Kushtetutës, në procesin e formimit të institucioneve, përkatësisht zgjedhjes së qeverisë, Presidenti ka kompetencë të vetme që t’i propozojë Kuvendit emrin e kandidatit të përcaktuar nga subjekti politik i cili ka fituar shumicën relative në zgjedhje. Deri në momentin kur ky emër i dërgohet Presidentit nga ai subjekt politik, Kushtetuta nuk i ka dhënë Presidentit asnjë kompetencë apo rol aktiv.”*
155. Në lidhje me rastin konkret ajo theksoi se: *“bazuar në argumentet e mësipërme, si dhe në shkresat e dërguara nga ana e Presidentit drejt subjektit fitues të zgjedhjeve ku [Presidenti] konstaton se “[...] Me keqardhje konstatoj se me veprimet tua nuk e keni shfrytëzuar të drejtën e propozimit të kandidatit të ri për ta formuar qeverinë, në pajtim me Vendimin e KQZ-së për certifikim të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës”, përkatësisht Dekretin e tij, mund të konkludohet që Presidenti ka tejkaluar autorizimet e tij kushtetuese në raport me pretendimet e tij për të caktuar afate kushtetuese për nominimin nga subjekti i parë, apo edhe të konstatimit të ëimit [sic.] të mandatit, pa një deklaram shprehimor të tillë nga subjekti fitues i zgjedhjeve.”*
156. Sipas saj, *“Presidenti i vendit, duke caktuar afat, ka krijuar normë të re kushtetuese, për një çështje për të cilën kushtetuta qëndron e heshtur. Kushtetuta nuk përcakton afate sa i përket kohës që ka në dispozicion subjekti fitues i zgjedhjeve për të dërguar emrin e kandidatit për Kryeministër. Pra, duhet sqaruar se të vetmet afate kushtetuese të përcaktuara në këtë drejtim fillojnë të konsumohen vetëm pas mandatimit formal të mandatarit nga ana e Presidentit të vendit.”*
157. Lidhur me kuptimin e termit “amendamentin” dhe pretendimit të saj se Dekreti i Presidentit ka efektin e plotësimit apo modifikimit të Kushtetutës, Kryetarja e Kuvendit thekoi se: *“Çfarëdo plotësimi, ndryshimi apo modifikimi i një teksti sipas fjalorit të Kembrixhit (Cambridge Dictionary) nënkupton amendamentim, apo sipas*

gjuhës së Kushtetutës së Kosovës edhe ndryshim. [...]” Në këtë kuptim Kryetarja e Kuvendit kërkoi nga Gjykata që të: “vlerësojë faktin që rreziqet e kuazi-amendamentit janë të natyrës krejtësisht kushtetuese. Katër janë rreziqet substanciale që qartazi ndërlihen me kushtetutën e Kosovës dhe frymën e saj. E para, ato e zbehin vijën e cila ndan kushtetuesen nga jo-kushtetuesja dhe rrezikojnë errësimin e hierarkisë së zakonshme të institucioneve në një demokraci kushtetuese. E dyta, mbështetja e këtyre strategjive jo-kushtetuese për ndryshime të nivelit kushtetues mund të zbulojë, apo edhe të përforcojë një mospërputhje ndërmjet dizajnit kushtetues dhe praktikës politike, që akterët kushtetues mund ta shfrytëzojnë si rrjedhojë për qëllime politike. E treta, shmangia e rregullave të amendamentimit formal dëmton vetë Kushtetutën dhe qëllimin e kodifikimit. Dhe së fundi, kjo qasje eliminon tërësisht sigurinë juridike që është jetike për funksionimin e një demokracie me sundim funksional të së drejtës.”

158. Andaj Kryetarja e Kuvendit mbajti qëndrimin se një formë e tillë e ndryshimit të Kushtetutës cenon parimin e epërsisë së Kushtetutës të garantuar me nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, sipas saj, Dekreti i kontestuar i Presidentit është në kundërshtim me nenin 65 të Kushtetutës [Kompetencat e Kuvendit] që parasheh që Kuvendi vendos të ndryshojë Kushtetutën me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të tij. Për më tepër, sipas saj, Dekreti i kontestuar “*duke ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit, bie ndesh me nenin 4 të Kushtetutës [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] paragrafin 1 të këtij neni*” dhe një “*qëndrim që do të legjitimonte ose legalizonte një dekret të tillë, do të ndryshonte rrënjësisht sistemin tonë kushtetues, duke i dhuruar dekreteve të Presidentit supremaci kushtetuese mbi vet Kushtetutën.*”
159. Andaj, si përfundim lidhur me këtë, ajo theksoi se: “*Ligjvënësi me qëllim nuk ka caktuar afat kushtetues para se të kryhet nominimi formal nga subjekti politik i cili ka fituar zgjedhjet, për të krijuar hapësirën e nevojshme kohore për subjektin politik që të arrijë të krijojë shumicën parlamentare përmes arritjes së marrëveshjeve me subjektet tjera politike. Një konstatim i tillë vërtetohet edhe nga vetë praktika e Gjykatës Kushtetuese, ku në rastin KO29/11, paragrafi 71, specifikohet se “nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës do të kishte qenë që të paraqisnin një procedurë alternative për zgjedhje, vetëm me një kandidat të nominuar, Kushtetuta, shprehimisht do e kishte parashikuar një procedurë të tillë.” Edhe në rastin konkret, mungesa e një norme të tillë dëshmon se nëse ligjvënësit do të donin të caktonin afat, do ta bënë këtë shprehimisht siç kanë bërë në shumë raste të tjera në dispozita kushtetuese.”*

160. Ajo më tej shtoi se: *“Gjykata Kushtetuese, përmes rasteve të trajtuara paraprakisht, ka krijuar hapësirën e nevojshme për subjektet politike që vetvetiu të rregullojnë ndërveprimin politik, pa ju caktuar afat për një gjë të tillë. Kjo dëshmohet përmes paragrafit 127 të rastit KO119/14, ku Gjykata kishte konstatuar se “është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional. Pra, edhe pse parashtruesit e kërkesës në rastin në fjalë argumentonin se partia e parë për muaj të tërë nuk dërgonte emër për Kryetar Kuvendi (duke mbajtur institucionet e pakonstituara), dhe se nuk do të duhej të pritej pafundësisht por ti jepej e drejta të tjerëve për propozime, gjykata vendosi që vetëm partia e parë mund të propozojë atë emër. Kësisoj, Gjykata nuk caktoi afate, por e la një gjë të tillë tek jeta politike, pra që deputetët ta gjejnë një mënyrë për t’u krijuar shumica e nevojshme. Gjykata asnjëherë nuk u caktoi deputetëve afat për ‘ta gjetur këtë mënyrë’.”*
161. Kryetarja e Kuvendit gjithashtu pretendoi se lidhur me nxerrjen e Dekretit të kontestuar *“Presidenti ka vetë-caktuar kompetenca për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”*. Lidhur me këtë ajo theksoi se kompetenca e interpretimit përfundimtar të dispozitave kushtetuese është e përcaktuar me Kushtetutë. *“Një kompetencë e tillë i është dhënë ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese, e cila sipas definicionit kushtetues është “[...] organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës” sipas nenit 112 të Kushtetutës.*
162. Ajo shton se: *“Koncepti që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar i interpretimit të kushtetutës është i lidhur me pozitën hierarkike institucionale që kësaj gjykate i jep ky paragraf. Në këtë kuptim, ky paragraf e vendos Gjykatën Kushtetuese në pikën më të lartë të hierarkisë institucionale sa i përket funksionit të interpretimit të kushtetutës.”* Dhe kjo, sipas saj, në kuptimin institucional ka katër domethënie: (i) që asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t’i marrë apo të ushtrojë në emër të Gjykatës Kushtetuese funksionin e interpretimit përfundimtar kushtetues; (ii) që, edhe nëse cilido institucion tjetër shtetëror ka bërë interpretimin apo është referuar tek Kushtetuta për të ushtruar një kompetencë të tij/saj, kjo mund të konsiderohet përfundimisht e përcaktuar vetëm nëse kalon përmes filtrit të vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese; (iii) asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të shfrytëzojë prerogativat e tij/saj faktike për të vendosur nënkuptime të domethënies së Kushtetutës, dhe se prerogativat e tilla mund të konsiderohen kushtetuese vetëm nëse

kalojnë përmes vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese; dhe, (iv) asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i ikë detyrimit (bishtnoj) që të ndjekë interpretimin e Kushtetutës sipas Gjykatës Kushtetuese, meqë kjo e fundit sipas këtij paragrafi është autoriteti i fundit institucional për interpretimin e saj.

163. Ajo pretendoi po ashtu se: *“Përmes kësaj formë të plotësimit të Kushtetutës më anë të dekretit, Presidenti i ka pamundësuar Gjykatës Kushtetuese edhe një kompetencë tjetër: atë të ushtrimit të juridiksionit të saj në vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve, sic parashihet në nenin 113(9) të kushtetutës. Dekreti është amendament që ka caktuar afat kohor duke zvogëluar një të drejtë të caktuar të një subjekti. Pra, kjo nënkupton që individëve të caktuar u është pamundësuar e drejta për tu zgjedhur, si rezultat i caktimit të një periudhe kohore jo-kushtetuese. Kësisoj, dekreti në fjalë bie ndesh edhe më Nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] paragrafin 1 dhe 2. Sipas Kushtetutës, një e drejtë e tillë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor, dhe jo me dekret të Presidentit si në këtë rast.”*
164. Në këtë aspekt ajo iu referua edhe disa rasteve të Gjykatës Kushtetuese që kanë vlerësuar kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese, si rasti KO29/12 dhe KO48/12, duke theksuar se: *“Gjykata Kushtetuese duke analizuar amendamentin e propozuar sqaronte si në vijim: “Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 45.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. [...] Ky interpretim i gjykatës [...] është edhe një argument shtesë apo një sinjal që përcaktimi i afateve të tilla në kushtetutë, çfarë ka tentuar të bëjë presidenti më anë të dekretit, mund të bëhet vetëm me dispozita kushtetuese. Në këtë pikë, dëshiroj të sqaroj se qëllimi nuk është paragjykim i mbi interpretimin që mund të bëjë gjykata ndaj një amendamenti kushtetutës që përcakton afate kohore, por të sqaroj se praktika e Gjykatës Kushtetuese njeh standardin e kufizimit të kësaj të drejte vetëm me dispozitë kushtetuese dhe assesi me ndonjë akt tjetër, siç është tani rasti me dekretin e presidentit.”*
165. Ajo potencoi edhe rolin e Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit duke u referuar edhe në paragrafin 63 të rastit KO103/14, ku theksoi se Gjykata *“kishte konstatuar se “[...] Gjykata konsideron se është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t'i përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar*

i Republikës ka të drejtë të sigurohet për paanshmerinë, për integritetin dhe për pavarësinë e Presidentit të tyre.””

166. Ajo më tej u thirr edhe në Opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2019)019-e, që trajtonte kompetencat e Presidentit të Shqipërisë që kishte theksuar mes tjerash se: *“Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partizane, me qëllim që të sigurojë, mes të tjerash, një konkurrencë të ndershme midis partive dhe funksionimit të rregullt të formës së qeverisë dhe veprimtarive tjera të shtetit”*. Ajo shton se *“megjë roli i Presidentit edhe në Kosovë është i tillë ku kërkohet përfaqësimi i unitetit të popullit dhe neutraliteti i plotë politik, duke mbrojtur kështu, siç sugjeron edhe vetë Komisioni I Venecias, funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes. Forma e qeverisjes, nuk mund të mbrohet duke shkelur parimin më fundamental të saj, atë të ndarjes së pushteteve.”*
167. Në fund, Kryetarja e Kuvendit kërkoi nga Gjykata *“që të shpallë një Aktgjykim, përmes të cilit konstaton se Dekreti i Presidentit Nr. 24/2020 është në kundërshtim me Kushtetutën sepse nëpërmjet këtij Dekreti, Presidenti i vendit ka tejkaluar kompetencat e veta duke ndërhyrë në kompetencat e institucioneve të tjera dhe rrjedhimisht duke rënë në kundërshtim me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.”*

Komentet e Grupit Parlamentar të LDK-së

168. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Presidenti ka pasur obligim që, në aplikim të nenit 82.2, të shpërndajë Kuvendin pas mocionit të mosbesimit, Grupi Parlamentar i LDK-së theksoi se: *“Presidenti nuk ka të drejtë që me automatizëm ta shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82 pika 2, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, pa e pasur paraprakisht vullnetin e shumicës së subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend. Në rastin konkret, sikur Presidenti do të shpërndante Kuvendin pa vullnetin paraprak të shprehur nga shumica e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, ai në mënyrë arbitrare do të ndërprente mandatin e deputetëve të Kuvendit, rrjedhimisht do të bënte shkelje të rëndë kushtetuese”. Ata shtojnë se shpërndarja e Kuvendit sipas nenit 82.2, nuk ka mundur të bëhet nga Presidenti, “jo vetëm për shkak të ndajfoljes MUND, por edhe për faktin se hartuesit e Kushtetutës, momentin kur ka votim të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë nuk e kanë përcaktuar si moment kur vendi automatikisht shkon në zgjedhje, por kanë lënë mundësi që të evitohen zgjedhjet, të krijohet shumicë parlamentare, rrjedhimisht të themelohet një Qeveri e re.”*

169. Ata theksojnë se folja “mund” e interpretuar nga parashtruesit e kërkesës si mundësia e vetme është gjithashtu kontradiktore dhe e palogjikshme pasi që “lejimi i mundësisë së vetme” nënkupton obligimin që më së miri do të ishte pasqyruar me fjalë “duhet” apo “obligohet” e jo fjalën “mund”.
170. Ata theksojnë se për këtë çështje Gjykata Kushtetuese kishte dhënë vlerësimin e saj edhe në Aktgjykimin KO103/14, ku në pikën 94 thuhet: *“Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruaj stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet”*.
171. Grupi Parlamentar i LDK-së lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se nuk ka ndërlidhje në mes të nenin 100.6 dhe nenit 95 të Kushtetutës theksoi se *“ekziston lidhja substanciale dhe funksionale ndërmjet nenit 100 paragrafi 6, nenit 82 paragrafi 2 dhe nenit 95 paragrafi 4 dhe 5 të Kushtetutës dhe se pretendimi i parashtrues[ve] të kërkesës për t’ia pamundësuar Presidentit të ushtrijë kompetencat e tij në lidhje me nenin 95 është i paqëndrueshëm, sepse, si i tillë, ia kufizon Presidentit mundësinë që të ushtrijë funksionin e tij në pajtim me nenin 84 paragrafi 2 të Kushtetutës, ku si një ndër kompetencat kryesore të tij theksohet se ai: “Garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë” Pretendimet e tilla të parashtrues[ve] të Kërkesës kanë karakter bllokues, sepse tentojnë me çdo kusht të bllokojnë shumicën absolute parlamentare për të themeluar Qeverinë.”*
172. Ata shtojnë se: *“Lidhja kauzale ndërmjet këtyre paragrafëve kushtetues ekziston për faktin se Qeveria ka rënë (si rrjedhojë e mocionit të mosbesimit) dhe se Presidenti i Republikës ka vazhduar konsultimet me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend për të mandatuar kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.”*
173. Lidhur me rolin e Presidentit si *“përfaqësues i unitet të popullit të Republikës së Kosovë”*, Grupi parlamentar i LDK-së mban qëndrimin se *“kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike në vend, ka rol udhëheqës të procedurës kushtetuese në krijimin e Qeverisë, të cilat janë objekt i çështjes së kësaj Kërkese.”*
174. Lidhur me afatin për propozimin e kandidatit për të formuar Qeverinë, Grupi Parlamentar i LDK-së theksoi se: *“Kushtetuta e Republikës nuk e ka përcaktuar shprehimisht një afat të caktuar në këtë fazë, por ka*

përcaktuar afatin prej 15 ditësh pas mandatimit nga Presidenti, Kryeministri është i obliguar të paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit. Hartuesi i Kushtetutës e ka lenë këtë afat të hapur, sepse ka konsideruar se është në interes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, si dhe është interes publik që Qeveria të themelohet në afatin më të shpejtë të mundshëm. Por, tanimë po vërtetohet se mosaktimi i një “afati të arsyeshëm” për dërgimin e emrit të kandidatit për Kryeministër për t’u mandatuar nga Presidenti i Republikës mund të keqpërdoret deri në abuzim nga fituesi relativ i zgjedhjeve.”

175. Andaj, ata theksojnë se *“Sipas frymës së Kushtetutës, mbetet në detyrimin e Presidentit [...] që të shterojë të gjitha mundësitë, brenda një afati optimal, t’ia mundësojë fituesit relativ të zgjedhjeve propozimin e kandidatit për Kryeministër. Në momentin kur vlerëson se fituesi relativ i zgjedhjeve nuk ka vullnet për propozimin e kandidatit për Kryeministër dhe se me çdo kusht po tenton të bllokojë themelimin e Qeverisë së re, Presidenti duhet të konsultojë subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe më pas të konstatojë se fituesi relativ nuk ka mundësi të krijojë shumicë parlamentare. Në rastin kur subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend ia dëshmojnë krijimin e një shumice të re parlamentare, Presidenti është i detyruar që, në pajtim me normën kushtetuese, ta dekretojë mandatarin për Kryeministër nga kjo shumicë e re parlamentare.”*
176. Andaj, ata shprehen se përkundër që Presidenti i ka dërguar disa shkresa LVV-së *“përveç që nuk e ka dërguar tek Presidenti kandidatin e saj për Kryeministër, ajo asnjëherë nuk ka shprehur gatishmëri për ta themeluar Qeverinë e re.”* Rrjedhimisht, sipas tyre, Presidenti, pas konsultimeve me partitë politike, dhe duke pasur parasysh që shumica e partive politike janë shprehur se janë për formimin e Qeverisë së re, ka vepruar konform paragrafëve 90, 92, 92 dhe 94 të Aktgjykimit KO103/14. Ata po ashtu theksuan se: *“pretendimi [i parashtruesve të kërkesës] se Presidenti duhet të presë partinë fituese “që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm, që ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike, administrative dhe teknike”, është krejtësisht i gabuar. Në radhë të parë nuk është e qartë se çka mendohet me “kushte politike, administrative dhe teknike.”*
177. Duke u thirrur në Aktgjykimin KO103/14, Grupi Parlamentar i LDK-së theksoi se: *“Në paragrafin “dh” [të pikës II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi]: “Në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me*

koalicionet (e regjistruara në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun.”

178. Ata më tej theksuan se shembujt nga Kushtetutat e vendeve të tjera që janë marrë nga parashtruesit e kërkesës *“nuk janë referencë objektive që ndihmojnë argumentet e pretenduesit. Për më tepër dispozitat kushtetuese të Kushtetutës sonë janë tejet të qarta dhe nuk ka hapësirë për dilema kushtetuese. Këtë argument e forcon edhe pika 95 e Aktgjykimit 130/14: “Prandaj, Gjykata konkludon se dispozitat kushtetuese janë mjaftueshëm të qarta dhe në përputhshmëri me njëra-tjetrën për të çuar deri te formimi i Qeverisë së re në pajtim me vullnetin e votuesve.””*
179. Grupi parlamentar i LDK-së *“kërkon nga Gjykata që të PËRJASHTOJ shqyrtimin e Kushtetutës së Serbisë nga analiza krahasuese e ofruar nga parashtruesi i kërkesës. Kjo për shkak se shqyrtimi i një dokumenti ku SHPREHIMISHT mohohet shtetësia e Kosovës, mund të prodhojë pasoja të paparashikueshme kushtetuese dhe politike për vendin.”*
180. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se legjitimiteti demokratik nuk mund të bartet te partitë që janë renditur pas vendit të parë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, Grupi Parlamentar i LDK-së theksoi se: *“pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme dhe madje absurde. Në një republikë parlamentare, madje me një sistem elektoral proporcional, siç e kemi ne, asnjë fitues relativ i zgjedhjeve nuk e ka monopolin e legjitimitetit demokratik, e aq më pak në rastet kur abstenon/refuzon për të shfrytëzuar të drejtat kushtetuese. Gjykata Kushtetuese kësaj çështjeje ka provuar t'i jep përgjigje edhe me Aktgjykimin 130/14, përkatësisht me pikën 87 ku thotë se: “Sidoqoftë, Gjykata vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë (bëhet fjalë për partinë fituese v.j.) do të refuzojë të marrë mandatin. Prandaj, duke u bazuar në këto vlerësime, Gjykata Kushtetuese ka ofruar edhe mundësitë se si të dilet nga një situatë e tillë.”*
181. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Presidenti ka bërë veprim antikushtetues kur, pas votimit të mocionit të mosbesimit në Kuvend, ka ftuar të gjitha partitë politike në konsultim për formimin e Qeverisë së Kosovës, Grupi Parlamentar i LDK-së theksoi se: *“konsultimet me subjektet politike parlamentare, pas votimit të*

suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, bien tërësisht në mandatin kushtetues të Presidenti të vendit që të ndërmarrë të gjitha veprimet në përputhje me vullnetin e shprehur të shumicës së subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend.”

182. Ata shtuan se: *“Refuzimi i Kryeministrit në detyrë për të propozuar kandidatin për Kryeministër nga subjekti politik që vetë e udhëheq, duhet interpretuar si tentim i Kryeministrit në detyrë për të imponuar shpërndarjen e Kuvendit, në kundërshtim me vullnetin e shprehur të Kuvendit me mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë. Për më tepër, refuzimi për të propozuar kandidatin për themelim të Qeverisë nga Kryeministri në detyrë, i cili udhëheqë partinë fituese relative të zgjedhjeve mund të konsiderohet si tentim për të uzurpuar pushtetin ekzekutiv në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit të Republikës, të shprehur në mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.”*
183. Në fund Grupi parlamentar i LDK-së theksoi se disa nga pasojat, të mungesës së Qeverisë me kompetenca të plota kushtetuese, mund të jenë: (i) pamundësia e respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit parlamentar ndaj organeve ekzekutive; (ii) pamundësia për të proceduar projektligje; pamundësia për të pasur nisma të ndryshme për adresim në Kuvend; (iii) pamundësia për të propozuar dhe miratuar pako sociale e fiskale; (iv) pamundësia e marrjes së vendimeve për t'i mbështetur bizneset dhe kategoritë e caktuara shoqërore; pamundësia për të plotësuar dhe ndryshuar Ligjin për Buxhetit. Andaj, ata kërkuan nga Gjykata që ta deklarojë kërkesë si qartazi të pabazuar dhe të konstatojë se Dekreti i kontestuar është në përputhshmëri me Kushtetutën.

Komentet e deputetëve të Kuvendit, Behxhet Pacolli dhe Mirlindë Sopi–Krasniqi nga AKR, të mbështetur nga deputetët Endrit Shala, Haxhi Shala dhe Albulena Balaj–Halimaj nga NISMA

184. Deputetët e lart cekur pohojnë se *“për të vlerësuar dekretin e kontestuar Gjykata Kushtetuese duhet të ketë parasysh rolin e tërësishëm të Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe kompetencat që përcaktohen me kushtetutë, qofshin ato kompetenca të Presidentit që hyjnë në kuadër të nenit 84 por edhe kompetencat e tjera të cilat i janë përcaktuar Presidentit të Republikës së Kosovës jashtë nenit 84. Mbi të gjitha janë dy kompetenca të cilat i janë atribuuar Presidenti me kushtetutë dhe që përcaktojnë rolin e tij në sistemin kushtetues të Kosovës, përmes të cilave Presidenti mund të materializojë edhe kompetencat e tjera kushtetuese. Në nenin 83 të Kushtetuese përcaktohet se Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, kurse në nenin 4.3 dhe nenin 82.2 [të Kushtetutës]*

përcaktohet se Presidenti garanton funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve.”

185. Ata më tej kontestojnë interpretimin e bërë nga parashtruesit e kërkesës lidhur me nenin 82.2 të Kushtetutës ku parashtruesit e kërkesës theksojnë se në rast të mocionit të suksesshëm të votëbesimit, Presidenti duhet të shpallë zgjedhjet. Në këtë kuptim ata e konsiderojnë këtë interpretim *“krejtësisht gabim për dy arsye: e para kjo është në kundërshtim me praktikën e deritanishme parlamentare dhe e dyta kjo është edhe në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, respektivisht nenin 95.5. Parashtruesit e kërkesës duhet ta kenë të qartë se në vitin 2010 (praktikë që ata e citojnë në kërkesën e tyre) kuvendi është shpërndarë nga Presidenti në rrethana krejtësisht tjera, ku një partner i koalicionit kishte dalë nga koalicioni dhe se ishte krijuar një krizë kushtetuese, për shkak se atë botë ish Presidenti i Kosovës z.Sejdiu ishte gjetur në shkelje të rëndë të kushtetutës. Po ashtu, shpërndarja e Kuvendit ishte bërë pas një mocioni të mosbesimit të një qeverie që kishte qenë në vitin e tretë të mandatit. Ky mocion mosbesimi madje në vitin 2010 madje ishte kërkuar nga vetë Kryeministri i atëhershëm. Po ashtu vullneti i partive politike në vitin 2010 kishte qenë që të shpërndahej kuvendi dhe jo të krijohet një qeveri e re, pasi që edhe objektivisht ishte e pamundur krijimi i kësaj qeverie, e cila nuk kishte mandat më shumë se një vjeçar. [...] Edhe në vitin 2017 kishte qenë e njëjta situatë, kur Kuvendi ishte shpërndarë pas një mocioni të mosbesimit, por legjislatura në atë kohë vetëm ishte futur në vitin e katërt të mandatit dhe se partitë politike nuk kishin pasur vullnet që të krijonin një qeveri të re.”*
186. Andaj, ata mbajnë qëndrimin se rrethanat e tanishme janë krejt të ndryshme duke potencuar faktin që Kuvendi është në fillim të mandatit dhe faktin se shumica absolute e partive politike janë deklaruar për krijimin e Qeverisë së re.
187. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se neni 95 i Kushtetutës nuk përcakton se si duhet të veprojë Presidenti pas mocionit të votëbesimit, ata theksojnë se *“parashtruesit e kërkesës duhet ta kenë të qartë se ka edhe raste tjera në botë, ku kushtetuat nuk përcaktojnë se si të veprojë Presidenti pas mocionit të mosbesimit”* duke shtuar se *“ura lidhëse që përcakton se si Presidenti duhet të veprojë pasi të votohet mosbesimi i qeverisë është neni 95.5 i kushtetutës”*. Ata pretendojnë se shprehja *“ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë”* nënkupton rastet kur posti i Kryeministrit mbetet i lirë, përpos dorëheqjes së tij/saj. E që kjo përfshinë edhe

rastet kur kemi që Qeverisë i merret besimi përmes mocionit, si në rastin konkret.

188. Për me tepër, sipas deputetëve të lartcekur, folja “mund” e përdorur në nenin 82.2, që Presidenti mund të shpërndajë Kuvendit nënkupton se *“bie në të drejtën e Presidentit që t’i vlerësojë rrethanat faktike dhe kushtetuese, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve, nëse duhet të shpërndajë ose jo Kuvendin. Në rastin konkret Presidenti kur ka vlerësuar shpërndarjen ose jo të kuvendit sipas nenit 82.2 ka vlerësuar vullnetin e shumicës absolute të partive politike parlamentare si dhe rrethanat e reja të rastit, sidomos mandatin e Kuvendit dhe nevojën për një qeveri të re, efikase dhe jo në dorëheqje, siç është qeveria aktuale. Presidenti në kuadër të funksionit të tij si përfaqësues i unitetit të popullit duhet të marrë parasysh edhe vullnetin e partive politike parlamentare, sidomos kur është fjala për shpërndarjen e Kuvendit në këtë rast. Siç u theksua edhe më sipër Presidenti duke vlerësuar rrethanat politike dhe funksionimin demokratik të institucioneve ka vepruar edhe në vitin 2010 dhe 2017.”*
189. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Presidenti është dashur të presë propozimin e LVV-së për kandidat për Kryeministër, deputetët e lartcekur pohuan se *“ndonëse e drejta e propozimit të kandidatit për kryeministër, i jepet partisë fituese në nenin 84.14 të kushtetutës, kjo nuk nënkupton në asnjë mënyrë që partia fitues mund të abuzojë me të drejtën e saj për propozimin e mandatarit, në kuptimin që e njëjta të mund ta vonojë propozimin e kandidatit për kryeministër në pafundësi. [...] E drejta për të propozuar kandidatin për kryeministër e partisë fituese nuk është një e drejtë absolute, e njëjta relativizohet edhe më shumë kur situata dhe rrethanat kushtetuese, sikur në rastin konkret nuk janë “pas zgjedhjeve” por pas votimit të suksesshëm të një mocioni të votëbesimit të qeverisë, ku qartazi shumica parlamentare, apo qëndrimi i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka ndryshuar në raport me qëndrimin i cili ishte pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Në këtë rast ka qenë rol i Presidentit që të vlerësojë situatën dhe të veprojë në drejtim të garantimit të funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve.”*
190. Duke u thirrur në paragrafin 94 të Aktgjykimit KO113/14, që përcakton se *“Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruaje stabilitetin e vendit dhe të gjeje kritere mbizotëruese pre formimin e qeverise se re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet”,* deputetët e lartcekur pohuan se: *“Në këtë rast*

shihet qartë se barra e ruajtjes së stabilitetit të vendit dhe përfaqësimit të unitetit të popullit, në kuptim të krijimit të një qeverie të re i bie Presidentit. Sipas këtij paragrafi Gjykata Kushtetuese i kërkon Presidentit që të gjejë kritere mbizotëruese për të mundësuar krijimin e qeverisë dhe në këtë mënyrë t'i shmang zgjedhjet. Kërkesa e Gjykatës Kushtetuese që Presidenti t'i shmang zgjedhjet përbën një kriter të rëndësishëm që mbi Presidentin bie barra që duke luajtur rolin e përfaqësuesit të unitetit të popullit të krijojë një qeveri funksionale dhe jo të krijojë rrethana që t'i shpall zgjedhjet.”

191. Në fund, duke konsideruar Dekretin e Presidentit në pajtueshmëri me Kushtetutën, deputetët e lartcekur theksuan se *“duke vlerësuar rrethanat e rastit konkret Gjykata Kushtetuese duhet të ketë parasysh vullnetin e deputetëve, sjelljen e partisë fituese të shumicës relative gjatë procesit të konsultimeve me Presidentin si dhe diskrecionin dhe rolin e Presidentit në krijimin e kritereve mbizotëruese, me qëllim që të shmangen zgjedhjet e reja, ashtu siç përcakton Gjykata Kushtetuese në rastin KO 103/14.”*

Komentet e Nënkryetares së Kuvendit dhe deputetes së LVV-së Arbërie Nagavci

192. Lidhur me pretendimin se Presidenti e ka pasur për obligim të shpërndajë Kuvendit pas mocionit të votëbesimit, Nënkryetarja Arbërie Nagavci pretendon se Dekreti i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën sepse Presidenti pas mocionit të votëbesimit ndaj Qeverisë, ka pasur për obligim të shpërndajë Kuvendin sipas paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës.
193. Lidhur me këtë ajo theksoi se: *“në sistemin tonë kushtetues, arrijmë para së gjithash të vëmë në dukje se Presidenti i Republikës së Kosovës si pushtet neutral apo si përfaqësues i pushtetit asnjans, pra, që qëndron mbi palët, nuk hyn në ndarjen e pushteteve dhe nuk kryen asnjë funksion ekzekutiv në drejtimin politik të vendit. Koncepti i kreut të shtetit, prandaj, është më shumë një kategori kushtetuese formale që i takon presidentit të republikës, por që nuk nënkupton që Presidenti i Republikës vishet me karakteristika qeverisëse. I vënë në këtë kontekst, neni 83 ilustron pozitën formale të presidentit të republikës si kreu i shtetit dhe jo kompetencat/autoritetin e tij substancial. Pikërisht në këtë drejtim përcaktohet statusi i Presidentit të Republikës së Kosovës në kuptim të asaj se “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”. Nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet se Presidenti i Kosovës nuk lejohet t'i përfaqësojë interesat grupore ose politike partiake por i përfaqëson të gjithë së bashku, që*

i jep kuptim substancial përfaqësimit të unitetit të popullit të një shteti.”

194. Në këtë aspekt ajo shtoi se: *“në kryerjen e funksionit të kreut të shtetit, sipas këtij neni, Presidenti i Republikës duhet përmbajtur këtyre katër parimeve: a) shprehjes së neutralitetit: [...]; b) kredibilitetit shtetëror: [...]; c) objektivitetit [...]; dhe, d) kufizimi i këtij funksioni në aspekte formale: përcaktimi i vënë në nenin 83 për presidentin e republikës si kreu i shtetit duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke përjashtuar çdo hapësirë që kjo të nënkuptojë një autoritet substancial të qeverisjes në dobi të presidentit të republikës.”*

195. Andaj, ajo pretendoi se: *“Presidenti i Republikës më 30 prill 2020, ka nxjerrë dekretin Nr. 24/2020 në kundërshtim të plotë me nenin 84 par. 4 lidhur me nenin 82 par. 2 dhe nenin 84 par. 14 lidhur me nenin 95 të Kushtetutës së Kosovës, duke dekretuar një kandidat të ri për kryeministër, i cili nuk është propozuar nga partia politike apo koalicioni që ka fituar zgjedhjet.”*

196. Gjithashtu, ajo theksoi se: *“Kushtetuta e Republikës nuk parasheh asnjë hap apo përgjegjësi aktive të Presidentit për të vlerësuar apo konsideruar paraprakisht vullnetin politik të subjekteve politike, siç është konsultimi me partitë politike apo grupet parlamentare për shpërndarjen ose jo të Kuvendit. Megjithëkëtë, brenda logjikës së Presidentit për të marrë për bazë vullnetin e subjekteve politike për shpalljen ose jo të zgjedhjeve, dy subjektet politike që përbejnë rreth 50% të votuesve nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, janë deklaruar për zgjedhje. Përveç Lëvizjes VETËVENDOSJE!, edhe PDK kërkon zgjedhje pas pandemisë”. Dhe në këtë rast, i vetmi kriter kushtetues, për shpërndarjen e Kuvendit është votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë.*

197. Ajo shtoi se: *“në ushtrimin e kësaj kompetence [të shpërndarjes së Kuvendit], presidenti i republikës nuk gëzon diskrecion vendosjeje, meqë vendimi për të shpërndarë Kuvendin është i paralidhur me një kusht tjetër, siç është votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit, si dhe nga mospasja e alternativës të përcaktuar me Kushtetutë për një veprim tjetër.”*

198. Nënkyetarja Arbërie Nagavci po ashtu pretendoi se: *“Nëse interpretimi i Presidentit do të ishte i drejtë se Kuvendi nuk shpërndahet pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, por vetëm pas dështimit për të zgjedhur Qeverinë dhe Presidentin, atëherë dispozita në nenin 82 para 2 është krejtësisht e panevojshme dhe pa kurrfarë funksioni. Sepse, Kuvendi në rast të dështimit për të*

zgjedhur qeverinë apo presidentin në afatin e përcaktuar me Kushtetutë, shpërndalet automatikisht dhe vetvetiu sipas nenit 82, par. 1.1, dhe neni 82 para 1.3 por edhe sipas nenit 95 para 4. Madje edhe pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, po të ndërlihej votimi i mocionit me zgjedhjen e Qeverisë së re, Kuvendi do të shpërndahej pa u aktivizuar neni 82 para 2.”

199. Ajo më tej shtoi se: *“shtete të ndryshme përmes rregullimit kushtetues kanë kufizuar efektet kushtetuese të mocionit të mosbesimit për të shmangur shpërndarjen e Kuvendit, dhe këtë e kanë bërë zakonisht përmes dy modeleve të përgjithshme: së pari, një kryeministër apo qeveri mund të shkarkohet përmes votës së mosbesimit vetëm duke e zgjedhur një kryeministër apo qeveri tjetër në të njëjtën kohë. Së dyti, pas votimit të mosbesimit ekziston mundësia dhe afat i përcaktuar shprehimisht se Kuvendi mund të zgjedh një Qeveri të re. Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh as mundësinë e parë dhe as mundësinë e dytë, përveç veprimin për shpërndarjen e Kuvendit.”*
200. Ajo e mbështeti këtë argument duke u bazuar edhe në praktikën parlamentare të vitit 2010 dhe 2017 kur pas mocionit të votëbesimit, ishin shpallur zgjedhjet e parakohshme dhe nuk ishte formuar Qeveria e re.
201. Për më tepër, lidhur me të drejtën e Presidentit për konsultimin e partive politike, për të vendosur për shpërndarjen e Kuvendit ajo thekson se Kushtetuta përcakton saktë rastet kur Presidenti mund të konsultojë palët e ndryshme lidhur me kompetencat e tij, duke iu referuar rasteve konkrete siç është *“caktimi i mandatarit për kryeministër pas konsultimit me partinë apo koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme, apo kur shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në konsultim me Kryeministrin, vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin, si dhe emërimet të ndryshme, si Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.”*
202. Rrjedhimisht ajo konsideroi se Presidenti ka pasur për obligim që pas mocionit të votëbesimit, të shpërndajë Kuvendin dhe jo të nxjerrë Dekretin për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë.
203. Lidhur me nenin 95 të Kushtetutës, Nënkryetarja e Kuvendit theksoi se Presidenti në Dekretin e kontestuar *“nuk e përcakton se në cilin paragraf të nenit 95 të Kushtetutës e bazon dekretin e tij për të caktuar z. Avdullah Hoti si kandidat për kryeministër.”* Lidhur me

këtë ajo shtoi se “Siç dihet, neni 95 “Zgjedhja e Qeverisë” përmban gjashtë paragrafë të cilët rregullojnë situata të ndryshme. Neni 95, përcakton së paku tri situata të ndryshme nga njëra-tjetra të zgjedhjes së Qeverisë. Respektivisht, paragrafi 1 i nenit 95, përcakton procedurën dhe kriteret e propozimit pas zgjedhjeve të mandatarit nga Presidenti, në konsultim me partinë ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, [...] Ndërsa, paragrafi 4 i nenit 95, përcakton autorizimin e Presidentit për të emëruar kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë, në rast se përbërja e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme sipas nenit 95 para 2 dhe nenit 95 para 3. Dhe së fundi, paragrafi 5 i nenit 95 përcakton se nëse Kryeministri jep dorëheqje ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partinë ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.”

204. Andaj, sipas saj: “Duke mos precizuar se në cilin paragrafë të nenit 95 është bazuar, Presidenti manifeston se ka qenë i vetëdijshëm për antikushtetutshmërinë e dekretit, por është përpjekur ta pamundësojë identifikimin e mospërputhshmërisë së dekretit me Kushtetutën, duke mos përcaktuar bazën e qartë kushtetuese. Në mënyrë krejtësisht të kundërt kishte vepruar, kur kishte dekretuar z. Albin Kurti si kandidat për Kryeministër, ku ishte bazuar me saktësi, paragrafëve, 1 dhe 2 të nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në dekretin Nr 05-2020, të datës 20.01.2020. [...] Sidoqoftë, në mënyrën se si ka vepruar Presidenti, dekreti nr 24/2020 do të ishte në kundërshtim si me paragrafin 1 të nenit 95, paragrafin 2 të nenit 95, paragrafin 4 të nenit 95, si dhe paragrafin 5 të nenit 95.”
205. Në linjë të njëjtë me parashtruesit e kërkesës, Nënkryetarja e Kuvendit po ashtu theksoi se: “Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka autorizime kushtetuese për të caktuar në mënyrë arbitrare afate të cilat nuk i parasheh Kushtetuta se deri kur duhet të dërgojë propozimin partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme.” Ajo shtoi se: “Me këtë, Presidenti ka marrë rolin e interpretuesit, e për më shumë, plotësuesit të Kushtetutës.” Gjithashtu ajo theksoi se Presidenti nuk mund të konsiderojë se LVV e ka refuzuar që të paraqes kandidatin për Kryeministër, në mungesë të një afati kushtetues dhe në mungesë të një refuzimi në mënyrë shprehimore. Ajo u thirr edhe në praktikën e mëhershme kur në vitin 2014 formimi i qeverisë kishte zgjatur gjashtë (6) muaj si pasojë e mos dërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese. Si përfundim, Nënkryetarja e Kuvendit konsideroi se Dekreti i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën.

Komentet e deputetit Arban Abrashi

206. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se Presidenti ka pasur për obligim që të shpërndajë Kuvendin, deputeti Arban Abrashi theksoi se në paragrafin 2 të nenit 82, shpërndarja e Kuvendit lihet vetëm si mundësi e Presidentit, e cila merret në shqyrtim eventuale nga ana e Presidentit pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë. Lidhur me këtë argument, ai mbështetet edhe në Komentarin e Kushtetutës.
207. Sipas tij: *“asgjë nuk e ndal, madje Presidenti duhet të krijojë mundësi për zgjedhjen e Qeverisë së re, kur për këtë ka vullnet politik të shprehur nga ana e shumicës së subjekteve politike parlamentare, meqë, dhe sidomos kur Kuvendi i Kosovës ka mandat edhe më tutje, dhe veçanërisht duke marrë parasysh edhe praktikën e njohura në botë (në shtetet me sistem parlamentar) ku, krijimi i qeverisë së re, pas një mocioni mosbesimi ndaj qeverisë, merret në konsideratë pas mocionit të mosbesimit (mocioni destruktiv i mosbesimit) apo edhe krahas tij (mocioni konstruktiv i mosbesimit).”*
208. Ai me tej theksoi se sikur qëllimi i hartuesve të Kushtetutës të ishte që shpërndarja e Kuvendit të ishte e detyrueshme në rast të votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë atëherë kjo do të përfshihej në paragrafin 1 të nenit 82 dhe të vazhdonte si nën-paragraf 4 i paragrafit 1 që parasheh rastet kur shpërndarja e Kuvendit është e detyrueshme.
209. Për të mbështetur argumentin e tij lidhur me atë se shpërndarja e Kuvendit pas mocionit të mosbesimit nuk është e detyrueshme, ai thirret në *Travaux Préparatoires* të Kushtetutës, ku sipas tij, drafti i mëhershëm ka theksuar në mënyrë shprehimore se Kuvendi “duhet” të shpërndahet. Andaj, sipas tij, hartuesit e Kushtetutës, duke mos aprovuar propozime të tilla me vetëdije dhe qëllim të plotë kishin formuluar këtë dispozitë me përmbajtje alternative, ku shpërndarja e Kuvendit do të vinte në shprehje vetëm nëse Kuvendi do të kishte të pamundur të formonte qeverinë e re.
210. Ai i referohet edhe praktikës së Suedisë, Kanadasë e Gjermanisë duke potencuar se kur paraqitet mocioni i votëbesimit ndaj Qeverisë, kjo shihet si rast për ndërrimin e Qeverisë dhe jo detyrimisht, që të shkohet në zgjedhje të reja. Deputeti Arban Abrashi po ashtu theksoi se ndryshe nga viti 2019, kur Kuvendi me 89 vota “për” ka vendosur shpërndarjen e Kuvendit, në rrethanat e tanishme shumica e subjekteve politike janë deklaruar në favor të krijimit të Qeverisë së re. Lidhur me vonesat në krijimin e Qeverisë prej gjashtë (6) muajve në

vitin 2014, deputeti në fjalë theksoi se vonesat atëkohë kanë ndodhur si rezultat i mos konstituimit të Kuvendit e jo për shkak të mos caktimit të mandatarit, siç pretendojnë parashtuesit e kërkesës.

211. Lidhur me pretendimin e parashtuesve të kërkesës se Dekreti është kundërkushtetues ngase vetëm partia e parë ka të drejtë të propozojë mandatarin, deputeti Arban Abrashi theksoi se: *“Dekreti i Presidentit [...] është në përputhje të plotë me Kushtetutën, saktësisht me nenin 84, par. 4 dhe 14, me nenin 95 dhe në mbështetje e duke marrë parasysh Aktgjykimin [...] KO103/14. Kjo sepse, Presidentit, sipas Kushtetutës i lejohet të nxjerrë Dekrete, sikur që i njëjti autorizohet nga Kushtetuta (84.14) që të caktojë mandatarin për formimin e qeverisë, meqë në nenin 82.2 të Kushtetutës përcaktohet se ai mund (jodomosdoshmerisht) të shpërndaj kuvendin sikur që edhe nënkuptohet se, nëse nuk e bënë këtë (shpërndarjen) Presidenti mund të vazhdojë me procedurë e përcaktimit të kandidatit të ri për Kryeministër.”*
212. Ai theksoi se sipas interpretimit të parashtuesve të kërkesës, shumica parlamentare *“është fare e panevojshme në sistemin tonë pluralist, sepse i pari, gjithnjë sipas interpretimeve [të parashtuesve të kërkesës] përveç përparësive të cilat ja njeh Kushtetua, ka të drejtë absolute të vendosë dhe vendimin t’ia imponojë shumicës parlamentare por edhe organeve të tjera , siç në këtë rast mund të jetë Presidenti”*. Në rastin konkret, sipas deputetit Arban Abrashi, pavarësisht takimeve dhe letërkëmbimeve të shumta, LVV nuk kishte propozuar kandidatin për Kryeministër. Andaj, nuk bëhet fjalë për veprime të Presidentit të cilat bien ndesh me nenin 84 (14) të Kushtetutës por me mosveprim të qëllimshëm të subjektit të parë politik (fituesit relativ) në zgjedhje.
213. Deputeti Arban Abrashi, theksoi se pavarësisht përparësisë që subjekti i parë politik e ka në procedurën e ndërtuar qartë nga Kushtetuta, kjo e drejtë nuk është absolute dhe e pakufizuar në kohë dhe se nuk mund të qëndrojë pretendimi se kjo çështje është lënë qëllimisht e pa afatizuar me qëllim që subjektit të parë politik t’i lihet kohë e mjaftueshme për të ndërtuar koalicione pasi sipas tij, konsultimet eventuale për formimin e Qeverisë behën pasi të caktohet mandatarin përmes Dekretit nga Presidenti dhe jo para saj siç pretendojnë parashtuesit e kërkesës.
214. Andaj, ai konsideron se: *“Presidenti ka vepruar drejtë kur pas pese (5) letrave dhe dy (2) takimeve që kishte në një periudhë prej rreth njëzetë (20) ditësh me subjektin e parë politik të dalur nga zgjedhjet, e të cilat nuk kishin rezultuar të suksesshme në kuptimin e*

propozimit të emrit të kandidatit për Kryeministër me arsyetimin publik se "jemi për zgjedhje", përmes Dekretit Nr. 24 / 2020 , i ka propozuar Kuvendit të Kosovës kandidatin për Kryeministër nga rradhët e subjektit tjetër (të dytë) politik i cili ka dëshmuar se ka shumicën e mjaftueshme në Kuvendin e Kosovës për të formuar Qeverinë."

215. Rrjedhimisht, Presidenti, në përputhje me Aktgjykimin KO103/14, i ka propozuar Kuvendit kandidatin për Kryeministër nga një subjekt i cili ka gjasat më të mëdha për formimin e Qeverisë. Ai shtoi se Presidenti përmes caktimit të kandidatit për kryeministër "merr pjesë" ose involvohet duke vepruar konkretisht në formimin e Qeverisë. Në secilin rast që Presidenti nuk do të vepronte në përputhje me autorizimet e tij kushtetuese, duke "lejuar" kështu çrregullimin të funksionimit të institucioneve të caktuara jo në përputhje me Kushtetutën në këtë rast duke lejuar që për një kohë të gjatë të mos formohet Qeveria e re por që vendi të qeveriset nga një Qeveri e cila është shkarkuar përmes mocionit të mosbesimit.
216. Duke marrë për bazë të lartcekurat, deputeti Arban Abrashi kërkoi nga Gjykata që të konstatojë se Dekreti i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën.

Komentet e Avokatit të Popullit

217. Avokati i Popullit në komentet e tij lidhur me kërkesën thekson se ai nuk gjen bazë për të paraqitur *Amicus Curiae* në këtë kërkesë duke pasur parasysh se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u lë hapësirë të vlerësimit shteteve, dhe kjo është e pranueshme në rastet kur çështjet trajtohen brenda rendit kushtetues të shtetit. Ai thekson se teksti i Kushtetutës që nga miratimi i saj ka një kuptim "*objektivisht të identifikueshëm*" dhe nuk ka ndryshuar me kalimin e kohës. Andaj, ai shton se kërkesa KO72/20 është ekskluzivisht e koncentruar në dispozitat kushtetuese për analizimin dhe interpretimin e të cilave Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar.
218. Në këtë kuptim, sipas Avokatit të Popullit, Kushtetuta "*duhet të shihet në qëllimin autentik të Komisionit për Hartimin e Kushtetutës për të përcaktuar se cila është fryma kushtetuese që ky Komision e ka pasqyruar në tekstin e saj.*" Në këtë aspekt, ai theksoi se "*duke e konsideruar të rëndësishë së veçantë për rendin kushtetues në vend interpretimin që Gjykata Kushtetuese do ta jap lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit thekson vlerën që ka autenticiteti i frymës që përcjell Kushtetuta e vendit, i shfaqur nëpërmjet Punëve përgatitore*

[Travaux preparatoires] të Komisionit Kushtetues i cili ka punuar në hartimin e saj.”

219. Për më tepër, në letrën e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës u theksua: *“Avokati i Popullit dëshiron të rikujtojë se dosjet e punëve përgatitore të hartimit të Kushtetutës ndodhen në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.”*

Lidhur me pretendimet për kërkesën për caktim të masës së përkohshme

220. Gjykata sqaron se të gjitha pretendimet dhe kundër pretendimet lidhur me kërkesën për caktim të masës së përkohshme tashmë janë elaboruar në Vendimin për Masë të Përkohshme në rastin KO72/20, të datës 1 maj 2020. Rrjedhimisht, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të përsërit të njëjtat në këtë Aktgjykim.

Praktikat e deritanishme lidhur me shpërndarjen e Kuvendit

221. Në vijim, Gjykata do të elaborojë të gjitha praktikat e deritanishme lidhur me shpërndarjen e Kuvendit që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës më 15 qershor 2008, duke përfshirë procedurën e ndjekur dhe bazën juridike për shpërndarjen e Kuvendit.

Legjislatura e tretë e Kuvendit të Republikës së Kosovës – Mocion i mosbesimit ndaj Qeverisë

222. Më 17 nëntor 2007, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.
223. Më 4 dhe 9 janar 2008, u mbajt seanca konstituive e Kuvendit në të cilën z. Jakup Krasniqi u zgjodh Kryetar i Kuvendit.
224. Më 9 janar 2008, Kuvendi votoi Qeverinë me Kryeministër z. Hashim Thaçi.
225. Më 2 nëntor 2010, Kryesia e Kuvendit shqyrtoi dhe vendosi në rend të ditës për Seancë plenare mocionin e mosbesimi ndaj Qeverisë të propozuar nga 40 deputetë të Kuvendit.
226. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, në mbledhjen plenare shqyrtoi mocionin e votëbesimit ndaj Qeverisë. Propozuesit arsyetuan Mocionin si në vijim:

“Kriza institucionale, e shkaktuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ku ka konstatuar shkelje

serioze të Kushtetutës nga ana e Presidentit, që ka rezultuar me dorëheqje të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe pas tërheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës nga koalicioni qeveritar, rrezikon të derivojë me krizë të përgjithshme institucionale në vend. Për dalje nga kjo krizë, Grupi Parlamentar i AKR-së, i mbështetur nga 40 deputetë, ngrit Mocion për mosbesim ndaj Qeverisë dhe kërkon nga Kuvendi ndërmarrjen e veprimeve të tjera në pajtim me Kushtetutën. [...]

Qytetari i Kosovës sot i ka drejtuar sytë nga ky tempull, i cili e ka në dorën e vet nëse do të ndalojë keqqeverisjen dhe degradimin e mëtejme të institucioneve të vendit ose do të lejojë që edhe më tej të thellohet kjo krizë.

[...]

Ju ftoj që ta mbështesni këtë mocion, si e vetmja mënyrë për të dalë nga kjo krizë institucionale që ka përfshirë vendin dhe për ta dënuar këtë qeverisje të keqe. [...].”

227. Në të njëjtën ditë, Kuvendi konform nenit 100 të Kushtetutës nxorri Vendimin për miratimin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Kosovës.
228. Në të njëjtën ditë, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit z. Jakup Krasniqi, konform nenit 82.2, nenit 84.4 dhe nenit 90 të Kushtetutës nxorri Dekretin për shpërndarjen e legjislaturës së tretë të Kuvendit.

Legjislatura e katërt e Kuvendit të Republikës së Kosovës – Shpërndarja e Kuvendit nga 2/3 e deputetëve

229. Më 12 dhjetor 2010, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.
230. Më 21 shkurt 2011, u mbajt seanca konstituive e Kuvendit në të cilën z. Jakup Krasniqi u rizgjodh Kryetar i Kuvendit.
231. Më 22 shkurt 2011, Kuvendi votoi Qeverinë me Kryeministër z. Hashim Thaçi.
232. Më 7 maj 2014, Kuvendi në seancë të jashtëzakonshme, pas propozimit të grupit prej 57 deputetëve të Kuvendit, konform nenit 69, paragrafi 4, nenit 82, paragrafi 1, pika (2) të Kushtetutës nxorri Vendimin [nr.04-V-841] për shpërndarjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit.
233. Po atë ditë, Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi përmes shkresës [nr. Prot.415] njoftoi Presidenten, znj. Atifete Jahjaga për Vendimin e lartcekur duke theksuar: “*Luteni që, në pajtim me [nenin 82,*

paragrafi 1, pika 2] të Kushtetutës [...] të ndërmerrni veprimet e nevojshme për Dekretimin Vendimit të Kuvendit [...] për shpërndarjen e Legjislaturës së katërt të Kuvendit [...].”

234. Në të njëjtën ditë, Presidentja, znj. Atifete Jahjaga, konform nenit 82, paragrafi 1, pika (2), dhe nenin 84, pika 4 të Kushtetutës nxorri Dekretin [DV-001-2014] për shpërndarjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit.

Legjislatura e pestë e Kuvendit të Republikës së Kosovës – Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë

235. Më 8 qershor 2014, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.
236. Më 8 dhjetor 2014 u mbajt seanca kontituive e Kuvendit në të cilën z. Kadri Veseli u zgjodh Kryetar i Kuvendit.
237. Më 9 janar 2015, Kuvendi votoi Qeverinë me Kryeministër z. Isa Mustafa.
238. Më 5 maj 2017, një grup prej 42 deputetëve të Kuvendit paraqitën mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë, me arsyetimin si në vijim: *“Kabineti qeveritar, ka krijuar mosbesim të thellë publik si dhe reflekton shenja të një mosfunksionimi total brenda vetes. Në këtë kuptim, një pjesë e rëndësishme e institucioneve të vendit janë tërësisht jo-funksionale. [...] Parlamenti jo pak herë nuk ka arritur që të ketë kuorum as për votimin e ligjeve të sponsorizuara nga vetë qeveria. Ka po ashtu edhe shumë deputetë nga radhët e këtij koalicioni që tashmë janë deklaruar kundër vazhdimit të këtij koalicioni qeverisës. [...]*
Konsiderojmë që e vetmja zgjidhje për të dalë vendi unë nga kjo situatë, e në të cilën edhe praktikisht të gjitha institucionet janë jo funksionale, janë zgjedhjet e lira dhe demokratike.”
239. Më 10 maj 2017, Kuvendi në seancë plenare, konform nenit 100, paragrafi 6 të Kushtetutës nxorri Vendimin [nr.05-V-465] për Miratimin e Mocionit të Mosbesimit ndaj Qeverisë së Kosovës.
240. Po atë ditë, Kryetari i Kuvendit z. Kadri Veseli përmes shkresës [nr.Prot.544] njoftoi Presidentin z. Hashim Thaçi për Vendimin e lartcekur me të cilin u votua mocioni për mosbesim ndaj Qeverisë.

241. Në të njëjtën ditë, Presidenti z. Hashim Thaçi, konform nenit 82, paragrafi 2, dhe nenin 84, pika 4 të Kushtetutës nxorri Dekretin [DV-001-2017] për shpërndarjen e legjislaturës së pestë të Kuvendit.

Legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Republikës së Kosovës - Shpërndarja e Kuvendit nga 2/3 e deputetëve

242. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.
243. Më 7 shtator 2017, u mbajt seanca konstituive e Kuvendit në të cilën z. Kadri Veseli u zgjodh Kryetar i Kuvendit.
244. Më 9 shtator 2017, Kuvendi votoi Qeverinë me Kryeministër z. Ramush Haradinaj.
245. Më 19 korrik 2019, Kryeministri, z. Ramush Haradinaj, dha dorëheqje.
246. Më 2 gusht 2019, Presidenti z. Hashim Thaçi përmes shkresës [Nr.Prot.1246] i kërkoi z. Kadri Veseli nga koalicioni Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës, në cilësi të fituesit sipas rezultateve të zgjedhjeve të 11 qershorit 2017, që të propozojë kandidatin e ri për formimin e Qeverisë.
247. Në të njëjtën ditë, z. Kadri Veseli përmes shkresës [Nr.Prot.1246/1] e njoftoi Presidentin z. Hashim Thaçi që: *“duke u bazuar në rrethanat aktuale politike, vullnetin politik të shprehur publikisht nga partitë e koalicionit fitues, si dhe në gjykimin tim se çfarë është më e mira tani për qytetarët dhe Republikën e Kosovës, se nuk do të propozoj një kandidat të ri si mandatar për të formuar një qeveri të re.”* Ai po ashtu e njoftoi Presidentin se ka ftuar mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për datën 5 gusht 2019 që bashkë me grupet parlamentare të diskutojnë për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për shpërndarjen e legjislaturës aktuale të Kuvendit.
248. Më 22 gusht 2019, Kuvendi në seancë plenare, pas propozimit të grupit prej 98 deputetëve të Kuvendit, konform nenit 82, paragrafi 1, pika 2 të Kushtetutës, nxorri Vendimin [nr.06-V-378] për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë të Kuvendit.
249. Po atë ditë, Kryetari i Kuvendit z. Kadri Veseli përmes shkresës [nr.Prot.06/35531] e njoftoi Presidentin z. Hashim Thaçi për

Vendimin e lartcekur të Kuvendit duke theksuar: *“Luteni që, në pajtim me [nenin 82, paragrafi 1, pika (2)] të Kushtetutës [...] të ndërmerrni veprimet e nevojshme për Dekretimin Vendimit të Kuvendit [...] për shpërndarjen e Legjislaturës së gjashtë të Kuvendit [...]”*

250. Më 26 gusht 2019, Presidenti z. Hashim Thaçi, konform nenit 82, paragrafi 1, pika (2), dhe nenin 84, pika 4 të Kushtetutës nxorri Dekretin [193/2019] për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë të Kuvendit.

Dispozitat relevante të Kushtetutës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Neni 7

[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. *Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- [...]
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;
- [...]

Neni 82
[Shpërndarja e Kuvendit]

1. *Kuvendi shpërndahet në këto raste:*
 - (1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;
 - (2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. *Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.*

Neni 83
[Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;

(3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;

(4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;

[...]

(14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;

[...]

(30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Neni 95
[Zgjedhja e Qeverisë]

1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.

Neni 100 **[Mocioni i Vetëbesimit]**

1. Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Vetëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë Kryeministri.

3. Mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditë të Kuvendit, jo më vonë se pesë (5) ditë e as më herët se dy (2) ditë nga data e parashtrimit të tij.

4. Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

5. Nëse mocioni i mosbesimit dështon, mocioni tjetër i mosbesimit nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme.

6. Nëse mocioni i mosbesimit votohet për Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

251. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

252. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

253. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2 (1), të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

“2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; [...].”

254. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet edhe neneve 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit që parashohin:

*Neni 29
Saktësimi i kërkesës*

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, [...].

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

*Neni 30
Afatet*

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrihet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

255. Gjykata po ashtu i referohet edhe rregullit 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrihet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në

papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

256. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e aktit të kontestuar; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe paragrafëve (2) dhe (3) të Rregullit 67 të Rregullores së Punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit dhe paragrafin (4) të Rregullit 67 të Rregullores së punës.

(vi) Lidhur me Palën e Autorizuar

257. Kuvendi, bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës është i autorizuar që para Gjykatës të ngrejë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën, të: (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit; (iii) dekreteve të Kryeministrit; dhe (iv) rregulloreve të Qeverisë. Neni 29 i Ligjit, saktëson që Kuvendi është palë e autorizuar para Gjykatës, nëse kërkesa përkatëse është parashtruar nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit. E njëjta kërkesë është e specifikuar në paragrafin 1 të rregullit 67 të Rregullores së punës.

258. Në rrethanat e rastit konkret Gjykata vëren se kërkesa ishte nënshkruar nga tridhjetë (30) deputetë të Kuvendit. Andaj, Gjykata vlerëson se kërkesa u paraqit nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, në pajtim me nenin 113, paragrafi 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29, paragrafi 1 të Ligjit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

(vii) Lidhur me aktin e kontestuar

259. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës, Kuvendi, përkatësisht një e katërta (1/4) e deputetëve të tij, siç është sqaruar më lart, mund të kontestojnë përputhshmërinë e “ligjeve”, “dekreteve të Presidentit”, “dekreteve të Kryeministrit”, dhe “rregulloreve të Qeverisë” me Kushtetutën.

260. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, specifikuan aktin, kushtetutshmërinë e të cilit e kontestojnë para Gjykatës, përkatësisht, Dekretin e Presidentit, nr. 24/2020, të 30 prillit 2020. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Dekreti i kontestuar i plotëson kushtet për të qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata në bazë të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës.

(viii) Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe specifikimin e kundërshtimeve

261. Gjykata rikujton që neni 29 i Ligjit dhe rregulli 67 i Rregullores së punës, përcaktojnë që (i) kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të specifikojë nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
262. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës, (i) aktin e kontestuar - Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, e kundërshtojnë në tërësi, dhe (ii) paraqitën kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar në pajtim me nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës, nenin 29, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit, dhe rregullin 67, paragrafët (2) dhe (3) të Rregullores së punës.

(ix) Lidhur me afatin

263. Gjykata rikujton që neni 30 i Ligjit dhe rregulli 67 i Rregullores së punës, përcaktojnë që kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të dorëzohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.
264. Gjykata thekson se Dekreti i kontestuar është nxjerrë më 30 prill 2020, ndërsa është kontestuar para Gjykatës po atë ditë. Rrjedhimisht, kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 30 të Ligjit dhe rregullit 67, paragrafit (4) të Rregullores së punës.

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

265. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës: (i) janë palë e autorizuar para Gjykatës; (ii) kontestojnë një akt të cilin kanë të drejtë ta kontestojnë; (iii) kanë specifikuar se aktin e kontestojnë në tërësi; (iv) kanë paraqitur kundërshtimet kushtetuese kundrejt aktit të

kontestuar; dhe, (v) kanë kontestuar aktin përkatës brenda afatit të përcaktuar.

266. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

MERITAT E KËRKESËS

I. Hyrje

267. Gjykata fillimisht rikujton që parashtuesit e kërkesës, respektivisht një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, përkatësisht tridhjetë (30) deputetë, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit nr. 24/2020 të 30 prillit 2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, duke pretenduar se i njëjti është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 84; paragrafin 2 të nenit 82; paragrafin 1 të nenit 4; paragrafin 14 të nenit 84; dhe nenin 95 të Kushtetutës. Këto pretendime janë mbështetur nga Kryeministri në detyrë dhe nga Kryetarja e Nënkryetarja e Kuvendit. Të njëjtat pretendime janë kundërshtuar nga Presidenti, Grupi Parlamentar i LDK-së dhe deputeti i saj, Arban Abrashi, si dhe deputetët e subjekteve politike parlamentare AKR dhe NISMA. Këta të fundit, pretendojnë se Dekreti i kontestuar i Presidentit është në përputhje me nenet e lartcekura të Kushtetutës.
268. Gjykata thekson se çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Dekretit të kontestuar të Presidentit, përmes të cilit z. Avdullah Hoti, i është propozuar Kuvendit si kandidat për Kryeministër. Në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të lartcekur, dhe bazuar në pretendimet e parashtuesve të kërkesës dhe kundërshtimet e palëve përkatëse, Gjykata do të vlerësojë fillimisht nëse pas votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, siç është përcaktuar në nenin 100 të Kushtetutës, Presidenti, bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, është i detyruar të shpërndajë Kuvendin, përkatësisht nëse votimi i suksesshëm i mosbesimit pamundëson zgjedhjen e një Qeverie të re. Në ndërlidhje dhe varësisht nga kjo analizë, Gjykata më tej do të vlerësojë se cila është procedura që duhet ndjekur për formimin e një Qeverie të re, pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit në Kuvend, dhe më saktësisht ndërlidhjen e nenit 100 të Kushtetutës përkthimi me Mocionin e Mosbesimit me nenin 95 të Kushtetutës përkthimi me Zgjedhjen e Qeverisë. Dhe në fund, Gjykata do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht pas mocionit të mosbesimit të votuar me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit më 25 mars 2020, procedura e ndjekur për

formimin e Qeverisë se re dhe mandatin e kandidatit për Kryeministër, ka rezultuar në një Dekret kushtetues apo jo.

269. Gjykata thekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij Dekreti, ajo do të fokusohet në analizën e dispozitave të zbatueshme të Kushtetutës, por edhe Aktgjykimin e saj në rastin KO103/14, përmes të cilit janë interpretuar paragrafi 14 i nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 dhe 4 të nenit 95 të Kushtetutës. Po ashtu, Gjykata bazuar në praktikën e deritanishme, gjatë këtij vlerësimi, do të merr parasysh edhe: (i) analizën krahasimore të dispozitave relevante për rrethanat e rastit konkret të një numri Kushtetutash, përfshirë ato në të cilat janë referuar para Gjykatës nga parashtuesit e kërkesës dhe palët tjera të interesuara; (ii) kontributet e Forumit të Komisionit të Venecias përkitazi me rrethanat e rastit konkret; dhe (iii) Opinione të Komisionit të Venecias. Në fund, Gjykata gjithashtu do të merr parasysh edhe dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës së Kosovës të cilat, siç është sqaruar në procedurën para Gjykatës, janë vënë në dispozicion të Gjykatës për herë të parë nga Arkiva Shtetërore e Republikës së Kosovës, përmes Kuvendit. Gjykata do t'i paraqes të gjeturat nga analiza krahasimore, kontributin e Forumit të Komisionit të Venecias dhe dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës, në pjesën e mëposhtme të titulluar Çështje Preliminare dhe të njëjtave do t'iu referohet për aq sa është e nevojshme dhe relevante, përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar.
270. Analiza për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar do të ndahet në tri pjesë, sipas strukturës vijuese: (i) nenin 82 të Kushtetutës përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit; (ii) nenin 100 të Kushtetutës përkitazi me Mocionin e Votëbesimit dhe nenin 95 të Kushtetutës përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë dhe ndërlidhjen përkatëse në mes tyre; dhe (iii) zbatimin e procedurës kushtetuese të përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës që ka rezultuar në Dekretin e kontestuar; dhe në fund (iv) do të paraqes Përfundimet përkitazi me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar.
271. Përgjatë vlerësimeve të nevojshme përkitazi me pikat (i), (ii) dhe (iii) të sqaruara më lart, dhe për secilën prej tyre, Gjykata do të paraqes: (i) thelbin e pretendimeve të parashtuesve të kërkesës dhe palëve në mbështetje të këtyre pretendimeve; (ii) thelbin e argumenteve të palës kundërshtare dhe palëve mbështetëse; dhe (iii) Përgjigjen e Gjykatës, e cila do të përfshijë parimet e përgjithshme lidhur me çështjen në shqyrtim dhe aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret.
272. Në fund, Gjykata gjithashtu do të adresojë: (i) masën e përkohshme; (iii) kërkesën për seancë dëgjimore të parashtuesve të kërkesës; dhe

në fund, do të paraqes (iv) Përfundimet e Gjykatës dhe Dispozitivin përkatës.

II. Çështje Preliminare

273. Siç u theksua më lart, Gjykata, më qëllim të lehtësimit dhe mbështetjes së analizës së nevojshme për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar, në vijim do të paraqes: (i) gjetjet e analizës krahasimore të Kushtetutave të ndryshme përkitazi me shpërndarjen e Kuvendeve në rastet e votimit të suksesshëm të mosbesimit dhe/ose zgjedhjes së Qeverive të reja; (ii) kontributin e Forumit të Komisionit të Venecias përkitazi me të njëjtat çështje; dhe (iii) pasqyrën e evoluimit të neneve relevante për rrethanat e rastit konkret, përkatësisht neneve 82, 95 dhe 100 të Kushtetutës, siç reflektohet nga dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës.

(i) *Analiza Krahasimore*

274. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, si dhe të palëve të tjera të interesuara, kanë përfshirë referenca në një numër Kushtetutash në mbështetje të argumenteve dhe kundër argumenteve të tyre. Parashtruesit e kërkesës, përmes komenteve të tyre përkatëse të dorëzuara në Gjykatë, u janë referuar Kushtetutave të Kroacisë, Sllovenisë, Gjermanisë, Greqisë, Serbisë, Shqipërisë dhe Kornizës Kushtetuese, ndërsa në anën tjetër, Presidenti i është referuar Kushtetutave të Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Austrisë. Përkundër pretendimeve dhe kundër pretendimeve specifike të parashtruesve dhe palëve të interesuara përkitazi me dispozitat relevante të këtyre Kushtetutave, Gjykata është angazhuar në një analizë krahasimore të dispozitave kushtetuese që rregullojnë mocionin e votëbesimit e mosbesimit në këto Kushtetuta si dhe të tjera në rajon dhe më gjerë, në mënyrë që të përcaktojë nëse ekziston një emërues i përbashkët përgjatë gjithë këtyre Kushtetutave e që ka të bëjë me procedurat që duhet të ndiqen pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit në Kuvendet përkatëse. Në vijim, Gjykata do të paraqesë këtë analizë krahasimore, duke u përqendruar vetëm në dispozitat e Kushtetutave përkatëse që kanë të bëjnë me formimin e Qeverisë, mocionin e mosbesimit si dhe shpërndarjen e Kuvendit në rast të votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit dhe vetëm deri në masën sa është e rëndësishme për rrethanat e këtij rasti.
275. Kushtetuta e Shqipërisë, sa i përket zgjedhjes së Kryeministrit/Qeverisë, në nenin 96, parasheh që: (i) Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose

koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend. Ky nen nuk saktëson afatin kohor brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin për Kryeministër për herë të parë, megjithatë përcakton një periudhë prej dhjetë (10) ditësh për secilin emërim pasues; (ii) parashikon tri përpjekje për zgjedhjen e Kryeministrit, sipas procedurës së parashikuar në këtë nen, para se të shpërndahet Kuvendi. Në nenet 104 dhe 105 të tij, parasheh procedurën e mocionit të besimit dhe të mosbesimit. Në rast të votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Nëse ky proces dështon, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.

276. Kushtetuta e Malit të Zi, në nenin 103 parasheh që Presidenti propozon mandatarin për Kryeministër brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit. Nenet 106 dhe 107, parashikojnë çështjet e besimit dhe mosbesimit, respektivisht. Sipas nenit 110 të kësaj Kushtetute, mandati i Qeverisë do të pushojë kur të japë dorëheqjen Kryeministri ose me rastin e humbjes së besimit nga Kuvendi. I njëjti nen parashikon në mënyrë specifike që Qeveria të cilës i ka pushuar mandati nuk mund të shkaktojë shpërndarjen e Kuvendit. Neni 105 specifikon që dorëheqja e Kryeministrit konsiderohet edhe dorëheqje e Qeverisë.
277. Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 90 të saj, parasheh që Presidenti e ka për detyrë që në afat prej dhjetë (10) ditëve, nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë ose partive që kanë shumicën në Kuvend. Ky nen nuk specifikon pasojat e mos zgjedhjes së Kryeministrit. Në nenin 92 të saj, nga ana tjetër, ajo përcakton procedurën që ka të bëjë me një votim mosbesimi. Neni i njëjtë parasheh që nëse ky votim është i suksesshëm, Qeveria është e detyruar të paraqesë dorëheqjen. Neni 93, më pas, përcakton që dorëheqja e Kryeministrit, vdekja e tij ose pamundësia e përhershme për të kryer detyrat e tij/saj, rezulton me dorëheqjen e Qeverisë, dhe se e njëjta, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re. Përkundër faktit që Kushtetuta nuk parasheh shprehimisht që pas mocionit të mosbesimit duhet të zgjidhet një Qeveri tjetër, bazuar në përgjigjen e Maqedonisë së Veriut të dorëzuar në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias (shih paragrafin 302 të këtij Aktgjykimi), një praktikë e tillë është e aplikueshme në sistemin kushtetues të Maqedonisë së Veriut.
278. Sipas nenit 98 të Kushtetutës së Kroacisë, Presidenti ia beson mandatin për formimin e Qeverisë një personi i cili, bazuar në shpërndarjen e vendeve në Kuvendin kroat dhe konsultimeve të përfunduara, gëzon besimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të

Kuvendit. Kushtetuta nuk saktëson afatin kohor brenda të cilit jepet ky mandat. Bazuar në nenet 109 dhe 109a, nëse procesi i parë i formimit të Qeverisë, sipas procedurës së paraparë në këto nene, dështon, Presidenti ia jep mandatin një kandidati tjetër. Nëse edhe përpjekja e dytë dështon, sipas nenit 109b, Presidenti emëron një Qeveri të përkohshme jopartiake dhe njëkohësisht thërret zgjedhje të parakohshme për Kuvendin kroat. Neni 113 i kësaj Kushtetute, përcakton procedurën e votimit të besimit. Ndër të tjera, saktëson, se nëse bëhet një votim mosbesimi ndaj Kryeministrit ose gjithë Qeverisë, Kryeministri dhe Qeveria do të japin dorëheqje. Nëse një votë besimi në Kryeministrin e ri të caktuar dhe anëtarët e paraqitur si anëtarë të Qeverisë nuk mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve, Kryetari i Parlamentit kroat do të njoftojë Presidentin dhe ky i fundit, shpërndan menjëherë Kuvendin dhe njëkohësisht thërret zgjedhje parlamentare. Në fund, sipas nenit 104, Presidenti mundet, me propozimin e Qeverisë, me nënshkrimin e Kryeministrit dhe pas konsultimeve me përfaqësuesit e partive parlamentare, të shpërndajë Kuvendin kroat nëse ky i fundit, kalon një votë mosbesimi në Qeveri ose nuk arrin të miratojë buxhetin e shtetit brenda 120 ditëve nga data në të cilën është propozuar.

279. Sipas nenit 111 të Kushtetutës së Sllovenisë, pas konsultimit me liderët e grupeve parlamentare, Presidenti i propozon Kuvendit Kombëtar një kandidat për Kryetar të Qeverisë. Nëse procesi i zgjedhjes dështon, sipas procesit dhe afateve të përcaktuara në këtë nen, Presidenti por edhe grupe të deputetëve mund të propozojnë kandidatët për Kryeministër. Prandaj, mund të propozohen disa kandidatë për Kryeministër. Nëse të gjithë ata nuk arrijnë të marrin votën e nevojshme, Presidenti shpërndan Kuvendin dhe thërret zgjedhje, përveç nëse Kuvendi dëshmon me një numër të mjaftueshëm votash se do të jetë në gjendje të zgjedh një kandidat tjetër. Vota e mosbesimit dhe vota e besimit janë paraparë në nenet 116 dhe 117. Në lidhje me të parën, ajo parashikon në mënyrë specifike që Kuvendi Kombëtar mund të kalojë një votë mosbesimi në Qeveri vetëm duke zgjedhur një Kryeministër të ri me propozimin e të paktën dhjetë (10) deputetëve dhe me shumicë votash të të gjithë deputetëve. Ndërsa sa i përket të dytës, parashikon që nëse Qeveria nuk merr mbështetjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve brenda tridhjetë (30) ditësh, Kuvendi Kombëtar duhet të zgjedh një Kryeministër të ri ose me një votim të ri të shprehë besimin në Kryeministrin në detyrë të Qeverisë, dhe nëse kjo dështon, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe thërret zgjedhje të reja.
280. Kushtetuta e Greqisë në nenin 37 të saj parasheh që Presidenti emëron kandidatin për Kryeministër nga partia që ka shumicën absolute të

vendeve në Parlament. Ajo nuk saktëson afatin brenda të cilit bëhet ky mandatim, megjithatë, ajo përcakton afate tri (3) ditore për secilin kandidat pasues për Kryeministër nëse i pari dështon, duke bërë edhe tri përpjekje shtesë, para se të shpërndahet Kuvendi. Nga ana tjetër, neni 38 i të njëjtës Kushtetutë parasheh që Presidenti heq Kabinetin nga detyrat e tij nëse Kabineti jep dorëheqje, ose nëse Kuvendi tërheq besimin e tij, siç përcaktohet në nenin 84, dhe se në rrethana të tilla, paragrafët përkatës të nenit 37, për zgjedhjen e Kryeministrit, aplikohen në mënyrë analoge. Kjo Kushtetutë nuk parasheh shpërndarjen e Kuvendit pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit, por bazuar në nenin 41 të saj dhe për aq sa është e rëndësishme për rrethanat e rastit në fjalë, përcakton shpërndarjen e Kuvendit vetëm me kushtin që dy qeveri radhazi të kenë dhënë dorëheqje ose janë votuar kundër nga Kuvendi dhe nëse përbërja e kësaj Qeverie nuk garanton stabilitetin e saj.

281. Kushtetuta e Gjermanisë, nga ana tjetër, parasheh votimin e ashtuquajtur konstruktiv të mosbesimit në nenin 67 të saj. Ajo parasheh që Bundestagu mund të shprehë mungesën e besimit ndaj Kancelarit Federal vetëm duke zgjedhur një pasues me shumicën e anëtarëve të tij dhe duke i kërkuar Presidentit Federal ta shkarkojë atë aktual. Ajo parasheh që Presidenti Federal duhet ta respektojë kërkesën dhe të emërojë personin e zgjedhur. Ndërsa në nenin 68 të saj, Kushtetuta përcakton votën e besimit dhe shpërndarjen e Bundestagut, përmes së cilit përcakton se kur një mocion i Kancelarit Federal për një votë besimi nuk miratohet nga shumica e anëtarëve të Bundestagut, Presidenti Federal mundet, me propozimin e Kancelarit Federal, të shpërndajë Bundestagun brenda njëzet e një (21) ditësh. Sapo Bundestagu të zgjedh një Kancelar tjetër Federal me shumicën e anëtarëve të tij, ai nuk mund të shpërndahet më.
282. Përndryshe, Kushtetuta e Austrisë, në nenin 74 të saj vetëm parasheh që nëse Këshilli Kombëtar tërheq besimin e tij nga Qeveria ose nga anëtarët e saj individualë, përmes një mocioni, Qeveria Federale ose Ministri përkatës Federal, do të largohet nga detyra. Megjithatë, përmes përgjigjes së dhënë në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, Austria kishte theksuar se nëse Presidenti Federal emëron një Qeveri të re në të cilën shumica e nevojshme e Parlamentit ka besim, mandati i Kuvendit mund të vazhdojë pavarësisht nga ndryshimet në Qeveri.
283. Përtej referencave të paraqitura nga parashtruesit e kërkesës, Kryeministri dhe Presidenti, Gjykata gjithashtu ka analizuar edhe dispozitat relevante në një numër të Kushtetutave të tjera dhe të cilat reflektojnë zgjidhje të ndryshme përkitazi me procedurat e ndjekura

për zgjedhjen e Qeverive të reja, pas votimit të një mocioni të suksesshëm mosbesimi ndaj Qeverisë në Kuvend.

284. Kushtetuta e Bullgarisë rregullon procedurën e formimit të Qeverisë në nenin 99 të saj, ku përcaktohet se pas konsultimeve me grupet parlamentare, Presidenti nominon Kryeministrin e caktuar nga partia që ka numrin më të madh të vendeve në Asamblenë Kombëtare për të formuar Qeverinë. Ajo nuk saktëson afatin brenda të cilit Presidenti mandaton Kryeministrin. Nëse ky proces dështon, ajo parashikon edhe tri përpjekje shtesë për të krijuar një Qeveri, brenda afateve dhe sipas procedurës siç parashikohet në këtë nen, para se të fillojë procesi i shpërndarjes së Asamblesë Kombëtare. Në nenin 89 të kësaj Kushtetute parashikohet procesi i një mocioni mosbesimi ndaj Kryeministrit ose Këshillit të Ministrave, kalimi i suksesshëm i të cilit, rezulton në dorëheqjen e Qeverisë. Neni 111 i të njëjtës Kushtetutë, saktëson gjithashtu se kompetencat e Këshillit të Ministrave përfundojnë, ndër të tjera, me kalimin e një mocioni të mosbesimit, dhe se dorëheqja përkatëse rezulton në një proces të zgjedhjes së një Këshilli të ri të Ministrave.
285. Në Republikën Çeke, neni 68 i Kushtetutës parasheh që Presidenti i Republikës emëron kandidatin për Kryeministër dhe se nëse i njëjti nuk arrin të marrë votat e nevojshme, procesi përsëritet duke rezultuar në një tjetër kandidat për Kryeministër. Nëse ky proces dështon, i njëjti nen parasheh edhe dy përpjekje shtesë për të zgjedhur një Kryeministër, sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në të njëjtin nen. Sipas nenit 35 të së njëjtës Kushtetutë, vetëm nëse të gjitha tentativat për të zgjedhur një Kryeministër dështojnë, Presidenti e shpërndan Kuvendin. Nenet 71 dhe 72 të Kushtetutës parashohin votimin e besimit dhe votimin e mosbesimit, respektivisht. Kalimi i suksesshëm i të dytit rezulton në dorëheqjen e Qeverisë, sipas nenit 73 të Kushtetutës. Kushtetuta nuk parashikon një procedurë specifike se si Kuvendi vepron për zgjedhjen e Qeverisë së re pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, por vetëm përcakton që Kuvendi shpërndahet vetëm pas dështimit të përpjekjes së tretë për të zgjedhur një Kryeministër, siç parashikohet në nenin 35 në lidhje me nenin 68 të Kushtetutës.
286. Kushtetuta Hungareze, në nenin 16 të saj, përcakton procedurën e formimit të Qeverisë. Ajo parashikon që Kryeministri zgjidhet nga Kuvendi me rekomandimin e Presidentit të Republikës. Nëse ky proces dështon, parashihet edhe një përpjekje shtesë për të zgjedhur një Kryeministër, sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen. Në nenin 21 të saj, Kushtetuta rregullon procesin e mocionit të mosbesimit, përmes të cilit kërkohet që të propozohet një person tjetër

që të shërbejë si Kryeministër. Prandaj, Kuvendi hungarez shpreh njëkohësisht mungesën e besimit të Kryeministri dhe zgjedh si Kryeministër personin e propozuar përmes mocionit të mosbesimit. Neni 3 i të njëjtës Kushtetutë, parasheh që Presidenti mund të shpërndajë Kuvendin dhe njëkohësisht të shpallë zgjedhje nëse dhe kur, ndër të tjera, Kuvendi nuk arrin të zgjedhë personin e propozuar nga Presidenti për të shërbyer si Kryeministër brenda dyzet (40) ditëve nga paraqitja e nominimit të parë, por gjithashtu kërkon që ai/ajo të kërkojë nga Kryeministri, Kryetari i Dhomës dhe krerët e grupeve parlamentare mendimet e tyre, para se ta bëjë një gjë të tillë.

287. Kushtetuta e Estonisë, në nenin 89 të saj, parasheh që Presidenti i Republikës, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pas dorëheqjes së Qeverisë, cakton një kandidat për Kryeministër. Nëse ky proces dështon, i njëjti nen parashikon edhe dy përpjekje shtesë për të zgjedhur një Kryeministër, përmes procedurës dhe afateve të parashikuara në këtë nen, para se të thirren zgjedhjet e parakohshme. Neni 92 i Kushtetutës përcakton që Qeveria jep dorëheqje, ndër të tjera, edhe në rast të shprehjes së mosbesimit ndaj Qeverisë ose Kryeministrit nga Riigikogu (ekuivalenti i Kuvendit). Mocioni i mosbesimit është paraparë në nenin 94 të kësaj Kushtetute dhe parashikon që nëse mosbesimi shprehet ndaj Qeverisë ose Kryeministrit, Presidenti i Republikës mundet, me propozimin e Qeverisë dhe brenda tri ditëve, të shpallë zgjedhje të jashtëzakonshme për Riigikogu.
288. Kushtetuta e Lituanisë në nenin 92 të saj parasheh që Kryeministri, me pëlqimin e Seimas (ekuivalenti i Kuvendit), emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës. Neni 101, nga ana tjetër, parashikon që Qeveria duhet të japë dorëheqje kur Seimas, me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të Seimas, shpreh mosbesim ndaj Qeverisë ose Kryeministrit. Thënë këtë, neni 84 i Kushtetutës së Lituanisë gjithashtu i jep Presidentit kompetencë të paraqesë pranë Seimas kandidaturën e një Kryeministri të ri për shqyrtim, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëheqja e Qeverisë. Megjithatë, Kushtetuta e Lituanisë, në nenin 58, parasheh që zgjedhjet e parakohshme për Seimas gjithashtu mund të shpallen nga Presidenti, ndër të tjera, pas propozimit të Qeverisë, në rastet kur është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi.
289. Kushtetuta e Gjeorgjisë parasheh si votën e besimit edhe votën e mosbesimit në nenet e saj 56 dhe 57 të saj, respektivisht. E para rregullon procesin e formimit të Qeverisë pas dorëheqjes së Kryeministrit dhe parashikon që Kuvendi do të mbajë një votëbesim ndaj Qeverisë së propozuar nga një kandidat për zyrën e Kryeministrit

të nominuar nga partia politike, e cila ka siguruar rezultatet më të mira në zgjedhjet parlamentare. Dështimi në zgjedhjen e Qeverisë, i mundëson Kuvendit shpërndarjen e Kuvendit, megjithatë shpërndarja nuk do të jetë e mundur nëse Kuvendi kalon me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij votën e besimit ndaj Qeverisë së propozuar nga një kandidat për zyrën e Kryeministrit të emëruar nga më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve, sipas afateve dhe procesit të parashikuar në këtë nen. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 57 të Kushtetutës, kërkohet që pas një votimi të mosbesimit, iniciatorët të propozojnë një kandidat për zyrën e Kryeministrit, dhe kandidati për zyrën e Kryeministrit të propozojë një përbërje të re të Qeverisë në Kuvend.

290. Kushtetuta e Armenisë, në nenin 149 parasheh që menjëherë pas fillimit të punës së Asamblesë Kombëtare të sapo zgjedhur, Presidenti emëron si Kryeministër kandidatin e propozuar nga shumica parlamentare e formuar sipas procedurës së paraparë me nenin 89 të Kushtetutës. Në rast se kjo zgjedhje dështon, organizohet një zgjedhje e re e Kryeministrit, sipas procesit të paraparë në këtë nen, ku kandidatët për Kryeministër, të emëruar nga të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve, kanë të drejtë të marrin pjesë. Nëse edhe ky proces me më shumë se një kandidat dështon, Asambleja Kombëtare shpërndahet në bazë të ligjit. Përndryshe, i njëjti nen gjithashtu parasheh që në rast se Kryeministri paraqet dorëheqje ose në raste të tjera ku zyra e Kryeministrit mbetet e lirë, grupet e Asamblesë Kombëtare kanë të drejtë të propozojnë kandidatët për Kryeministër brenda një periudhe prej shtatë (7) ditëve pasi të kenë pranuar dorëheqjen e Qeverisë. Neni 115 i Kushtetutës, parasheh mosbesim ndaj Kryeministrit. Ai specifikon që procesi lejohet vetëm nëse njëkohësisht emërohet një kandidat për Kryeministër të ri. Nëse kalohet me sukses, Kryeministri konsiderohet se ka paraqitur dorëheqjen. Nëse zgjedhja e Kryeministrit dështon, atëherë bazuar në nenin 92 të kësaj Kushtetute, thirren zgjedhje të jashtëzakonshme.

(ii) Kontributet e Forumit të Komisionit të Venecias

291. Gjykata në vijim do të paraqes përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias. Siç është sqaruar në pjesën e procedurës para Gjykatës (shih paragrafët 19 dhe 20 të këtij Aktgjykimi), Gjykata u kishte drejtuar pyetje anëtarëve të Forumit të Komisionit të Venecias, që kishin të bëjnë me mocionin e mosbesimit dhe shpërndarjen e Kuvendeve përkatëse. Përgjigje janë pranuar nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria, Suedia, Lihtenshtajni, Çekia, Sllovakia, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Afrika e Jugut, Moldavia dhe Brazili.

292. Përgjigja e Mbretërisë së Bashkuar specifikon që: (i) kur dy të tretat (2/3) e Dhomës kalojnë një mocion që kërkon që të mbahen zgjedhje të përgjithshme në bazë të asaj që nuk ka besim në Qeveri, zgjedhjet e përgjithshme duhet të mbahen para se cilado parti të mund të përpiket të formojë një Qeveri; dhe (ii) nëse një mocion mosbesimi kalon ndryshe nga sa më sipër dhe pas katërmbëdhjetë (14) ditëve asnjë Qeveri e re nuk është në gjendje të marrë besimin e Dhomës, Qeveria aktuale mund të kërkojë të formojë një Qeveri të re p.sh., nëse ata do të ishin nën një udhëheqës të ri, dhe opozita zyrtare të përpiket të formojë një Qeveri gjithashtu. Nëse një Qeveri e re e merr besimin e Dhomës, nuk do të ketë zgjedhje të përgjithshme deri në kohën e paracaktuar (ose një mocion tjetër të mosbesimit). Nëse nuk e bënë këtë, duhet të ketë zgjedhje të përgjithshme të parakohshme.
293. Përgjigja nga Gjermania specifikon që: (i) në pajtim me nenin 62 të Ligjit Themelor, Qeveria Federale përbëhet nga Kancelari Federal dhe Ministrat Federalë. Në pajtim me nenin 67 të Ligjit Themelor, *Bundestag-u* mund të shprehë mungesën e besimit të tij në Kancelarin Federal vetëm duke zgjedhur një pasardhës me votën e një shumice të anëtarëve të tij dhe duke i kërkuar Presidentit Federal të shkarkojë Kancelarin Federal. Presidenti Federal duhet ta respektojë kërkesën dhe të emërojë personin e zgjedhur. Kjo dispozitë ka për qëllim sigurimin e legjitimitetit demokratik dhe funksionimin e Qeverisë Federale. *Bundestagu* nuk shpërndahet vetë duke pasur parasysh që qytetarët zgjedhin anëtarët e tij për një periudhë katër (4) vjeçare dhe zgjedhjet e reja duhen shmangur; (ii) në pajtim me nenin 68 të Ligjit Themelor, Presidenti Federal mund të shpërndajë *Bundestagun* me propozimin e Kancelarit Federal brenda njëzet e një (21) ditëve, nëse një mocion i Kancelarit Federal për një votë besimi nuk mbështetet nga shumica e anëtarëve të *Bundestagut*. Kjo e drejtë e shpërndarjes përfundon sapo *Bundestagu* të zgjedh një Kancelar Federal me votën e një shumice të Anëtarëve të tij; dhe (iii) Gjykata Kushtetuese Federale ka vendosur për shpërndarjen e *Bundestagut* në kontekstin e një mocioni të besimit në pajtim me nenin 68 të Ligjit Themelor në vitin 2005 dhe 1983. Në këto dy vendimet, Gjykata Kushtetuese Federale theksoi se vota e besimit që synon shpërndarjen justifikohet vetëm nëse është humbur qëndrueshmëria e një Qeverie Federale e cila është e ankoruar në Kuvend. Qëndrueshmëria do të thotë që Kancelari Federal përcakton udhëzimet e përgjithshme të politikës dhe mbështetet nga një shumicë e anëtarëve të *Bundestagut*. Për më tepër, “tri organe kushtetuese - Kancelari Federal, *Bundestagu* dhe Presidenti Federal - secili mund të parandalojë shpërndarjen e *Bundestagut* sipas vlerësimit të tyre të lirë politik. Kjo ndihmon për të siguruar besueshmërinë e supozimit që Qeveria Federale ka humbur qëndrueshmërinë e saj parlamentare”.

294. Përgjigja nga Austria, specifikon që: (i) nëse një votë mosbesimi në Qeveri (ose në një ministër) është miratuar nga Parlamenti, Presidenti Federal është i detyruar ta largojë Qeverinë (ose ministrin në fjalë) nga detyra (neni 74 paragrafi 1 i Ligjit Federal Kushtetues); dhe (ii) që në një sistem parlamentar, *“kjo është një ngjarje mjaft e jashtëzakonshme që çon normalisht në zgjedhje të parakohshme, të cilat, nga ana tjetër, i japin fund mandatit të Kuvendit para kohe”*. Megjithatë, nga pikëpamja juridike, kjo pasojë nuk është e detyrueshme - nëse Presidenti Federal emëron një Qeveri të re (ose një ministër të ri) në të cilën Kuvendi (ose, më saktësisht, shumica e anëtarëve të Kuvendit) ka besim të plotë, mandati legjislativ i Kuvendit mund të vazhdojë pavarësisht nga ndryshimet në Qeveri.
295. Përgjigja nga Suedia sqaron që: (i) Kushtetuta suedeze përcakton se nëse Kuvendit i mungon besimi te Kryeministri, Qeveria ose ndonjë ministër tjetër, ai mund të detyrojë Qeverinë ose Ministrin përkatës të japë dorëheqje, duke vendosur për një mocion të mosbesimit. Të paktën tridhjetë e pesë (35) deputetë të Kuvendit duhet të propozojnë që të zhvillohet votimi për një mocion të tillë, ndërsa një shumicë e anëtarëve (175) të Kuvendit duhet të votojë për propozim në mënyrë që Parlamenti të deklarojë mosbesimin e tij ndaj Qeverisë ose një ministri. Nëse Parlamenti konstaton se nuk ka besim te Kryeministri, e gjithë Qeveria duhet të japë dorëheqje ose të thërrasë zgjedhje të jashtëzakonshme për Kuvend brenda një jave; (ii) nëse nuk thirren zgjedhje të jashtëzakonshme, Qeveria do të mbajë pozitat e tyre të mëparshme derisa Qeveria e re të marrë detyrën. Në teori, një Qeveri e re do të merrte detyrën brenda të njëjtës legjislaturë dhe do të qeveriste deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta. Por nëse Qeveria ka dhënë dorëheqje pas një mocioni të mosbesimit, Kuvendi me siguri nuk do të ishte në gjendje të gjente një Qeveri të re të mbështetur nga shumica e nevojshme e Kuvendit, dhe për këtë arsye do të mbaheshin zgjedhje të reja të jashtëzakonshme. Kuvendi dhe Qeveria e re do të qeverisin vetëm deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta, që është një vit i caktuar, çdo i katërti vit. Një Qeveri asnjëherë nuk ka dhënë dorëheqje në Suedi në kohën moderne, për shkak të një mocioni të mosbesimit; dhe (iii) sipas Kushtetutës suedeze shpërndarja e Kuvendit mund të ndodhë vetëm nëse Qeveria thërret zgjedhje të jashtëzakonshme. Zgjedhjet e tilla mund të jenë rezultat i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë siç u përmend më lart.
296. Përgjigja nga Lihtenshtajni sqaron që: (i) sipas nenit 80 të Kushtetutës, nëse Qeveria e humb besimin e Princit qeverisës ose të Kuvendit, autoriteti i saj për të ushtruar funksionet do të përfundojë. Derisa një qeveri e re të vijë në detyrë, Princi qeverisës emëron një

Qeveri kalimtare për të menaxhuar tërë Administratën Kombëtare në ndërkohë (neni 78 paragrafi 1), në zbatim të dispozitave të nenit 79 paragrafët 1 dhe 4; (ii) procedura e formimit të një Qeverie të re nuk është adresuar në mënyrë të qartë në nenin 80. Kjo është arsyeja pse neni 79 (2) mbi procedurën e përgjithshme për formimin e një qeverie të re është i zbatueshëm; (iii) prandaj dhe brenda të njëjtës legjislaturë, Princi qeverisës duhet të formojë një Qeveri pasi Qeveria ta humb besimin e Kuvendit ose të Princit qeverisës. Më pas, Princi qeverisës dhe Kuvendi mund të pajtohen për formimin e një Qeverie të re, sipas nenit 79 (2) të Kushtetutës; dhe (iv) nuk ka asnjë detyrim për shpërndarjen e Kuvendit pas një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë.

297. Përgjigja nga Republika Çeke specifikon që: (i) pasi Kuvendi të miratojë rezolutën e mosbesimit ose të refuzojë kërkesën e Qeverisë për një votë besimi, Qeveria kërkohet të paraqesë dorëheqjen e saj; (ii) pas dorëheqjes së Qeverisë, Kushtetuta nuk kërkon automatikisht shpërndarjen e Kuvendit, por mbështetet në formimin e një Qeverie të re brenda të njëjtit Kuvend; (iii) nëse Qeveria merr një votë mosbesimi nga Kuvendi, Presidenti emëron Kryeministrin e ri dhe, në bazë të propozimit të tij, anëtarët e tjerë të Qeverisë. Nëse Qeveria e emëruar në përpjekjen e dytë nuk merr një votë besimi nga Kuvendi, Presidenti emëron Kryeministrin bazuar në një propozim të Kryetarit të Kuvendit (neni 68 paragrafi 4 i Kushtetutës). Kushtetuta përcakton në mënyrë të qartë këto tri përpjekje për të caktuar Qeverinë dhe për të marrë një votë besimi nga Kuvendi në rast se Kuvendi nuk miraton një rezolutë besimi në një Qeveri të sapo emëruar (në përpjekjen e tretë) nga Kryeministri (emëruar nga Presidenti në bazë të një propozimi të Kryetarit të Kuvendit të Deputetëve), Presidenti mundet, por nuk është i obliguar, të shpërndajë Kuvendin (neni 35 paragrafi 1 shkronja a) i Kushtetutës). Ky kusht është përcaktuar në mënyrë rigorozë në mënyrë që shpërndarja e Kuvendit të pasojë shterimin e mundësive politike për të emëruar një Qeveri të re nga Kuvendi.
298. Përgjigja nga Republika Slloake specifikon që: (i) Kushtetuta lejon formimin e një Qeverie të re brenda të njëjtës legjislaturë pas votimit të mosbesimit në Qeverinë e mëparshme (shih nenin 115); dhe (ii) Presidenti mund të shpërndajë Këshillin Kombëtar, nëse nuk e miraton programin e Qeverisë së re të sapo formuar brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas formimit të Qeverisë së re. Çdo Qeveri e formuar rishtazi paraqet programin e saj në Këshillin Kombëtar, dhe sipas Kushtetutës, kjo është gjithashtu një çështje besimi në Qeverinë përkatëse (shih nenin 102.1 dhe nenin 113 të Kushtetutës); dhe në fund (iii) Presidenti mund të shpërndajë edhe Këshillin Kombëtar nëse Këshilli Kombëtar nuk arrin të votojë brenda

një periudhe tremujore një projekt-ligj të propozuar dhe shpallur nga Qeveria si çështje besimi (neni 102.1 dhe neni 114.3 të Kushtetutës).

299. Përgjigja nga Bullgaria specifikon që: (i) korniza ligjore është e përfshirë në Kushtetutë (neni 89) dhe në Rregulloren e Organizimit dhe të Punës së Kuvendit Kombëtar. Mocioni i mosbesimit mund të paraqitet ndaj Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Megjithatë, nuk parashihet mocioni i mosbesimit ndaj një ministri individual. Një e pesta (1/5) e Përfaqësuesve Kombëtarë mund të iniciojnë në Kuvendin Kombëtar një mocion mosbesimi ndaj Këshillit të Ministrave ose Kryeministrit. Propozimi mund të jetë për një rast specifik, si dhe për programin e përgjithshëm ose për politikën e përgjithshme të Qeverisë. Në çdo rast, propozimi për një mocion mosbesimi duhet të arsyetohet. Nëse mocioni i mosbesimit është drejtuar ndaj politikës së përgjithshme të Qeverisë dhe është refuzuar, një mocion pasues i mosbesimit për çfarëdo rasti të veçantë brenda një periudhe 6-mujore, nuk lejohet pasi që është *“absorbuar nga mocioni i refuzuar ndaj politikës së përgjithshme, me përjashtim të shkëljes së Kushtetutës të kryer gjatë asaj periudhe”*. Propozimi miratohet kur më shumë se gjysma e të gjithë Përfaqësuesve Kombëtarë kanë votuar për atë, d.m.th., shumica e kualifikuar. Votimi është i hapur. Vendi i strukturuar i kornizës kushtetuese (neni 89) është në Kapitullin e tretë “Kuvendi Kombëtar”, i cili e konfirmon këtë institucion si arma më e fortë që Kuvendi Kombëtar ka kundër Qeverisë; (ii) pasojat juridike të një mocioni të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë ose Kryeministrit janë dorëheqja e detyrueshme e Qeverisë dhe përfundimi i kompetencave të saj (në përputhje me nenin 111, paragrafi 1, pika 1.). Në këtë rast, Kushtetuta aktuale Bullgare nuk parashikon shpërndarjen e Kuvendit Kombëtar me propozimin e Kryeministrit, por një përpjekje për të formuar një Qeveri të re gjatë mandatit të të njëjtit Kuvend. Kur Kuvendi Kombëtar miraton një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit ose Këshillit të Ministrave, Kryeministri ofron dorëheqjen e Qeverisë. Për shkak të mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, kompetencat e saj si një qeveri e rregullt përfundojnë; e njëjta bëhet një *“qeveri në dorëheqje”* dhe vazhdon të kryejë funksionet e saj deri në formimin e një qeverie të rregullt në përputhje me nenin 99, paragrafin 6 të Kushtetutës si në vijim: (i) pas konsultimeve me grupet parlamentare, Presidenti mandaton kandidatin për kryeministër të emëruar nga grupi parlamentar numerikisht më i madh, për të formuar një Qeveri; (ii) kur kandidati për Kryeministër nuk propozon Këshillin e Ministrave brenda shtatë ditëve, Presidenti ia beson këtë detyrë një kandidati për Kryeministër të emëruar nga grupi parlamentar numerikisht i dyti më i madh; (iii) nëse as në këtë rast nuk propozohet Këshilli i Ministrave, Presidenti mandaton disa nga grupet tjera më të mëdha parlamentare

për të emëruar një kandidat për Kryeministër brenda afatit të përmendur në paragrafin e mësipërm; (iv) kur mandati i kërkuar plotësohet me sukses, Presidenti i propozon Kuvendit Kombëtar që të zgjedhë kandidatin për Kryeministër. Kushtetuta nuk saktëson se kur fillon formimi i Qeverisë së re, por përgjigja qëndron në specifikën e situatës – sa më shpejt që të jetë e mundur; (iii) vetëm kur nuk është arritur asnjë marrëveshje për formimin e Qeverisë gjatë procedurës së përshkruar më sipër, Presidenti emëron një kabinet të përkohshëm, shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe cakton zgjedhje të reja brenda dy (2) muajve pas përfundimit të kredencialeve të Kuvendit Kombëtar paraprak (neni 64, paragrafi 3). Akti me të cilin Presidenti shpërndan Kuvendin Kombëtar cakton edhe datën për zgjedhjet për Kuvendin Kombëtar të ri. Në këtë rast, Presidenti nuk mund të shpërndajë Kuvendin Kombëtar gjatë tre muajve të fundit të mandatit të Presidentit. Nëse Parlamenti nuk është në gjendje të formojë një Qeveri brenda asaj periudhe, Presidenti emëron një kabinet të përkohshëm; dhe (iv) siç është theksuar në rastin (“Rezultati i kërimit CODICES: BUL-1994-3-002”), me Vendimin Nr. 4 të vitit 1994 për rastin kushtetues nr. 8/1994, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë e interpretoi nenin 111, paragrafin 1 të Kushtetutës dhe vendosi që dorëheqja përbën një shprehje të lirë të vullnetit të Qeverisë ose udhëheqësit të saj, dhe jo përmbushjen e një detyrimi kushtetues. Këshilli i Ministrave dhe Kryeministri nuk janë të detyruar të theksojnë arsyet e dorëheqjes. Megjithatë, sipas përgjigjes së Bullgarisë, në rastet kur Kryeministri detyrohet me Kushtetutë të japë dorëheqjen e Qeverisë, përfundimi i kompetencave ndodh në bazë të vendimit të Kuvendit Kombëtar, i cili e voton mocionin e mosbesimit ose kur Qeveria nuk merr besimin e kërkuar. Përveç këtyre dy situatave të rregulluara në mënyrë të qartë me Kushtetutë, Kryeministri nuk ka asnjë detyrim kushtetues të dorëhiqet nga Qeveria. Një detyrim i tillë nuk lind kur Kuvendi Kombëtar refuzon propozimet e bëra nga Këshilli i Ministrave ose Kryeministri, përfshirë nismat legislative. Me Vendimin nr. 13 të vitit 1992 për rastin kushtetues nr. 27/1992, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë interpretoi nenin 89, paragrafin 3 të Kushtetutës duke theksuar se: “*Kur Kuvendi Kombëtar refuzon një mocion mosbesimi ndaj Këshillit të Ministrave, mocioni i ri i mosbesimit për të njëjtat arsye nuk lejohet brenda gjashtë muajve në vijim.*” Kur Kuvendi Kombëtar ka refuzuar një mocion mosbesimi ndaj Këshillit të Ministrave për politikën e tij të përgjithshme, asnjë mocion i ri i mosbesimit nuk mund të miratohet brenda periudhës gjashtë (6) mujore sipas nenit 89.3 të Kushtetutës mbi asnjë bazë përveç për shkelje të Kushtetutës të kryer brenda këtij afati. Me Vendimin nr. 20 të vitit 1992 për rastin kushtetues nr. 30/1992, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë interpretoi Kushtetutën dhe rregullat për formimin e Qeverie së re, për kompetencat dhe afatin

e qeverisë së përkohshme dhe në lidhje me statusin e Kuvendit Kombëtar të shpërndarë sipas kushteve të nenit 99.5 të Kushtetutës, dhe të Përfaqësuesve Kombëtarë nga Kuvendi Kombëtar i shpërndarë.

300. Përgjigja e Bullgarisë theksoi gjithashtu se: (i) pasi Presidenti t'i ketë dhënë mandatin grupit parlamentar të parë dhe të dytë më të madh për të formuar një Qeveri, Presidenti më nuk është i kufizuar nga numri i grupeve parlamentare dhe nuk është i detyruar t'i japë mandatin asnjërit prej kandidatëve për Kryeministër të emëruar nga cilido prej tyre (nuk është i detyruar t'i japë mandatin grupit të tretë parlamentar më të madh). Në këtë rast, Presidenti është i autorizuar të vendosë se cili grup parlamentar të emërojë një kandidat për Kryeministër. Kur ekzistojnë tre grupe parlamentare, Presidenti është i detyruar të udhëzojë grupin e tretë parlamentar që të emërojë një kandidat për Kryeministër. Mandati përfundon me sukses në kuptimin e nenit 99.4 të Kushtetutës, kur kandidati për mandatar, duke përmbushur kërkesat për pranueshmëri, i paraqet Presidentit një përbërje të Këshillit të Ministrave. Kjo nuk përjashton ndryshimet në përbërjen e propozuar përpara votimit nga Kuvendi Kombëtar. Kur Kuvendi Kombëtar zgjedh një Kryeministër por refuzon të zgjedhë Këshillin e Ministrave të propozuar në strukturë dhe përbërje, konsiderohet se mandati i këtij kandidati ka dështuar dhe procedura për zgjedhjen e një qeverie vazhdon duke i dhënë mandatin një kandidati nga grupi tjetër parlamentar, ose në mënyrën e specifikuar në nenin 99.5 të Kushtetutës. Pas dorëheqjes së Qeverisë së zgjedhur, formimi i një Qeverie të re kryhet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 99 të Kushtetutës, pavarësisht nga kohëzgjatja që kjo Qeveri ka ekzistuar; dhe (ii) Qeveria e përkohshme emërohet përkohësisht nga Presidenti kur janë shteruar mundësitë kushtetuese për formimin e një Qeverie me besimin e Kuvendit Kombëtar. Afati i kompetencave të saj do të vazhdojë deri në formimin e një Qeverie në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 99 të Kushtetutës. Me emërimin e një Qeverie të përkohshme, Qeveria e dorëhequr pushon së funksionuari. Qeveria e përkohshme ushtron kompetencat e Këshillit të Ministrave të përcaktuara në Kapitullin e Pestë të Kushtetutës. Disa kufizime të funksioneve të saj burojnë nga fakti se ajo nuk e merr mandatin e saj nga Kuvendi. Nuk është subjekt i përcaktimit ose legjislacionit, por është pasojë e kufizimeve në kohë gjatë së cilës Qeveria e përkohshme vepron, si pasojë e qëllimit të saj për të menaxhuar çështjet aktuale të politikës së brendshme dhe të jashtme, drejt mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe formimit të një Qeverie nga Kuvendi Kombëtar i sapo zgjedhur, natyra e saj është pasojë e kontrollit të kufizuar parlamentar të ushtruar mbi të dhe mungesës së parlamentit kur Kuvendi Kombëtar shpërndahet dhe nuk zgjidhet një Kuvend Kombëtar i ri, si dhe nga burimi jo parlamentar i

kompetencave të saj. Qeveria e përkohshme nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes parlamentare e cila synon të ushtrojë përgjegjësi politike; dhe (iii) Kuvendit Kombëtar të shpërndarë nën kushtet e nenit 99.5 të Kushtetutës i kanë përfunduar kompetencat. Kompetencat e tij mund të ripërtërihen vetëm në rrethanat në nenin 64.2, dhe për këtë qëllim ai do të mblidhet me urdhrin e nenit 78 të Kushtetutës. Pas shpërbërjes së Kuvendit Kombëtar, ndërpriten gjithashtu edhe kompetencat e përfaqësuesve të popullit. Kjo do të thotë që, ndër tjerash, ata humbasin imunitetin e tyre parlamentar, pushojnë së pranuari kompensim si deputetë, nuk mund të ushtrojnë kontrollin parlamentar dhe komitetet parlamentare do të përfundojnë veprimin e tyre.

301. Përgjigja nga Kroacia specifikon që: (i) Kushtetuta rregullon dy lloje të procedurave në lidhje me një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë (qoftë Kryeministrit ose tërë Qeverisë). E para është menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare (nenet 109, 109a dhe 109b); dhe e dyta (e quajtur gjithashtu mosbesim i Qeverisë dhe shpërndarje *reale* e Parlamentit kroat) nuk është menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare (neni 113). Ajo sqaroi gjithashtu se në rastin e parë, sipas nenit 109a.1 të Kushtetutës, afati i formimit të Qeverisë është 60 ditë (30 ditë + 30 ditë shtesë) ndërsa në rastin e dytë, sipas nenit 113.7, afati është vetëm 30 ditë, megjithatë, nëse sërish përpjekja për formimin e Qeverisë dështon, Presidenti i Republikës duhet të thërrasë zgjedhje të parakohshme për Kuvendin Kroat, sipas nenit 109b në rastin e parë dhe sipas nenit 113.7 në rastin e dytë; (ii) Kuvendi Kroat mund të shpërndahet vetë në bazë të nenit 77.1 ose mund të shpërndahet në bazë të nenit 104 dhe nenit 113.7 nga Presidenti i Republikës; (iii) nëse mocioni i mosbesimit kalohet në Kuvend, nuk ka asnjë obligim (automatik) të detyrueshëm kushtetues për shpërndarjen e Kuvendit. Vetëm nëse përpjekja e riorganizimit të Qeverisë dështon, Presidenti i Republikës duhet të kërkojë zgjedhje të parakohshme për Kuvendin Kroat (neni 113.7 i Kushtetutës) dhe Kuvendi duhet të shpërndahet ose vetë ose nga Presidenti i Republikës; dhe në fund (iv) sipas përgjigjes kroate, *“Faktet e çështjes tuaj janë si në vijim: zgjedhjet parlamentare ishin më 6 tetor 2019; Qeveria mori detyrën në 3 shkurt 2020; votimi i mocionit të mosbesimit u kalua në Parlament më 25 mars 2020. Nëse këto fakte janë të sakta, neni 113.7 i KKK do të zbatohet në Kroaci”*. Në fund, afati 30 ditor (sipas nenit 113.7 të KKK) për të provuar formimin e një qeverie të re u përdor me sukses në vitin 2003 dhe 2009 në Kroaci, por jo në vitin 2016 kur u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe më pas Qeveria e re mori detyrën më 19 tetor 2016. Qeveria e Trembëdhjetë e Republikës së Kroacisë u udhëhoq nga Kryeministri Tihomir Orešković nga 22 janari deri më 19 tetor 2016. Ajo ishte formuar pas zgjedhjeve parlamentare të vitit

2015. Procesi negociator që çoi në formimin e saj ishte më i gjati në historinë e Kroacisë. Më 16 qershor 2016, Qeveria e Oreškovićit humbi mocionin e mosbesimit në Kuvend. Një përpjekje e mëpasshme nga Koalicioni Patriotik për të formuar shumicë të re parlamentare, me ministrin e Financave Zdravko Marić si Kryeministër, dështoi dhe Kuvendi votoi për shpërndarjen e vet më 20 qershor 2016. Shpërndarja hyri në fuqi më 15 korrik 2016, gjë që i mundësoi Presidentit të Republikës së Kroacisë që zyrtarisht të thërrasë zgjedhjet për 11 shtator 2016. Kabineti i Oreškovićit shërbeu në kapacitet të ushtrimit të detyrës (si qeveri teknike) deri në kohën kur Qeveria e re mori detyrën pas zgjedhjeve të vitit 2016.

302. Përgjigja nga Maqedonia e Veriut sqaroi që: (i) nuk ka ndonjë dispozitë specifike kushtetuese që lejon formimin e një Qeverie të re brenda të njëjtës legjislaturë pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj një Qeverie të zgjedhur. Megjithatë, ekziston një praktikë në punën e Kuvendit për këtë çështje kur pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale, mandati për të formuar një Qeveri të re i jepet partisë ose koalicionit tjetër; (ii) nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese për shpërndarjen e Kuvendit pas një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë. Sipas nenit 63.6 të Kushtetutës, Kuvendi shpërndahet kur shumica e numrit të përgjithshëm të përfaqësuesve votojnë për shpërndarje. Kjo shpërndarje varet vetëm nga vendimi i anëtarëve të Kuvendit.
303. Përgjigja nga Afrika e Jugut sqaron që: (i) një mocion mosbesimi është konsideruar të jetë një mekanizëm me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë kushtetuese të Afrikës së Jugut. Qëllimi i tij kryesor është *“të sigurojë që Presidenti dhe ekzekutivi kombëtar të jenë përgjegjës para Kuvendit [Kombëtar] të përbërë nga përfaqësues të zgjedhur”*. Kësisoj një mocion mosbesimi luan një rol të rëndësishëm në *“dhënien e efektit elementit të doktrinës së kontrollit dhe balancimit të ndarjes së pushteteve”* dhe avancimin e *“higjienës sonë demokratike”*. Siç ka vërejtur Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut në rastin e *Lëvizjes Demokratike të Bashkuar*: *“Një mocion mosbesimi përbën një kërcënim të sanksionit përfundimtar që Kuvendi Kombëtar mund t’ia imponojë Presidentit dhe Kabinetit, nëse ata dështojnë ose perceptohen se nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese. Është një nga mjetet më të efektshme të përgjegjësisë ose të zbatimit të pasojave, të dizajnuara për të përkujtuar në mënyrë të vazhdueshme Presidentin dhe Kabinetin se çfarë mund të ndodhë nëse mekanizmat e rregullt dëshmojnë se janë ose duken joefektivë. Kjo masë zakonisht do të përdoret kur përfaqësuesit e popullit thënë praktikisht kanë hequr dorë nga Presidenti ose Kabineti. Ai përbën një nga pasojat më të ashpra*

politike të imagjinueshme - një shpatë që varet mbi kokën e Presidentit për ta detyruar atë të bëjë gjithmonë gjërat e duhura”; (ii) e drejta për të pasur një votim mosbesimi të debatuar në Kuvendin Kombëtar njihet si e drejtë që gëzohet edhe nga anëtarët e partive shumicë edhe nga ato pakicë. Anëtarët e partisë shumicë nuk mund të pengojnë mundësinë e një anëtari të një partie pakicë që të propozoj një mocion mosbesimi për debat përpara Kuvendit Kombëtar, pavarësisht nga gjasat e suksesit të një mocioni të tillë. Një mocion i mosbesimit paraqet një mocion, nga publiku i Afrikës së Jugut, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në Kuvendin Kombëtar që veprojnë si kolektiv, për t'i dhënë fund mandatit të dhënë një Presidenti apo Kabineti në detyrë. Efekti i një votimi të suksesshëm të mosbesimit ndaj Presidentit është se Presidenti dhe i gjithë Kabineti aktual, si dhe të gjithë Zëvendësministrat, duhet të japin dorëheqjen; (iii) Rregullat e Kuvendit Kombëtar rregullojnë ushtrimin e së drejtës që rrjedh nga neni 102 (2) i Kushtetutës. Sidoqoftë, siç ka menduar Gjykata Kushtetuese në rastin *Mazibuko*, Rregullat nuk mund të *“mohojnë, pengojnë, vonojnë në mënyrë të paarsyeshme ose të shtyjnë ushtrimin e së drejtës.”*; (iv) kapitulli 5 i Kushtetutës (nenet 83 deri 102) rregullon autoritetin ekzekutiv të Afrikës së Jugut, i cili, siç u përmend më lart, i është dhënë Presidentit, të cilin ai e ushtron atë së bashku me anëtarët e kabinetit të tij. Neni 102 i Kushtetutës parashikon dy lloje të mocioneve të mosbesimit: një në lidhje me Kabinetin, duke përjashtuar Presidentin dhe një në lidhje me Presidentin si një individ; (v) mekanizmi i themeluar në nenin 102 (1) të Kushtetutës nuk është përdorur ende në Afrikën e Jugut. Nga gjuha e këtij nën-neni është e qartë se një mocion i suksesshëm i mosbesimit do të rezultojë në ri-konstituimin e Kabinetit nga Presidenti, ndërsa vetë Presidenti do të mbetet në detyrë. Për më tepër, nuk ka asnjë indikacion se sukseksi i një mocioni të mosbesimit në kabinet do të ketë ndonjë efekt në Parlamentin (d.m.th., Kuvendi Kombëtar dhe Këshilli Kombëtar i Provincave). Në të vërtetë, mënyra me të cilën një mocion mosbesimi arrin të përbëjë faktorë të fuqishëm kundër kësaj: është vetë Kuvendi Kombëtar që është përgjegjës për kalimin e një mocioni të mosbesimit - nëse sukseksi i mocionit rezulton në shpërndarjen e Kuvendit Kombëtar, kjo do të kërkonte që Kuvendi të votonte kundër interesave të veta. Prandaj, nëse një mocion i mosbesimit i bërë në lidhje me nenin 102 (1) është i suksesshëm, atëherë nuk ka asnjë kërkesë që Kuvendi të shpërndahet. Presidenti duhet thjesht të përsërisë procesin e emërimit të anëtarëve të kabinetit të tij. Nuk ka juridiksion të Afrikës së Jugut që në mënyrë specifike merr në konsideratë zbatimin e këtij nën-seksioni. Adoptimi i një interpretimi të qëllimshëm të nën-seksionit, është e qartë se ai nuk parashikon që Presidenti thjesht të ri-emërojë të njëjtin Kabinet: kjo do të mposhte qëllimin e qartë të nenit dhe do ta bënte atë të pa efekt; (vi) Kushtetuta

parasheh dy mënyra me të cilat mandati i Presidentit mund të përfundojë para skadimit të tij. E para nga këto është përmes rezolutës së mbështetur nga të paktën dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, për shkak të shkeljeve serioze të Kushtetutës, sjelljes së rëndë ose paaftësisë për të kryer funksionet e tij zyrtare. E dyta është përmes një mocioni të mosbesimit, të miratuar nga një shumica e Kuvendit Kombëtar, i cili do të detyronte Presidentin, anëtarët e kabinetit dhe zëvendësministrat të japin dorëheqje. Ky mekanizëm i fundit është parashikuar në nenin 102 (2) të Kushtetutës, i cili thotë: *“Nëse Kuvendi Kombëtar, me një votim të mbështetur nga një shumicë e anëtarëve të saj, kalon një mocion mosbesimi në Presidentin, Presidenti dhe anëtarët e tjerë të kabinetit dhe secili zëvendësministër duhet të japin dorëheqjen.”* Ashtu si seksioni 102 (1), seksioni 102 (2) nuk parashikon shpërbërjen e Kuvendit, ose parandalon formimin e një ekzekutivi të ri, në mungesë të shpërbërjes së Kuvendit. Sidoqoftë, shpërbërja e Kuvendit për shkak të një boshllëku në zyrën e Presidentit adresohet në mënyrë të shprehur në nenin 50 (2) të Kushtetutës, i cili parashikon që: *“Presidenti në detyrë duhet të shpërndaqë Kuvendin Kombëtar nëse (a) ekziston një vend bosh në zyrën e Presidentit; dhe b) Kuvendi nuk arrin të zgjedhë një President të ri brenda 30 ditëve pasi të jetë krijuar vendi bosh.”* Prandaj, në masën që Presidenti dhe Kabineti largohen si rezultat i një mocioni të suksesshëm të mosbesimit, Kuvendi Kombëtar ka 30 ditë gjatë të cilës periudhë duhet të zgjedhë një President të ri, i cili, nga ana tjetër, duhet të zgjedhë një Kabinet të ri. Rregulla 15 e Rregullave të Kuvendit Kombëtare parasheh që: *“Në seancën e parë, pas zgjedhjes së një Kryetari dhe Zëvendëskryetari të Kuvendit, Dhoma duhet, në përputhje me seksionin 86 (1) dhe (2), të lexuar me Shtojcën 3 të Kushtetutës, të zgjedh një nga anëtarët e saj si President të Republikës.”*; (vii) Neni 86 i Kushtetutës parasheh që: *“(1) Në seancën e parë të zgjedhjes së tij, dhe sa herë që është e nevojshme për të plotësuar një vend vakant, Kuvendi Kombëtar duhet të zgjedhë një grua ose një burrë nga anëtarët e saj që të jetë President; [...] (3) Zgjedhja për të plotësuar një vend vakant në zyrën e Presidentit duhet të mbahet [...] jo më shumë se 30 ditë pasi të jetë krijuar vendi i lirë.”* Prandaj, bazuar në më sipër, nuk duket se ka ndonjë ligj që pengon zgjedhjen e anëtarëve të rinj të ekzekutivit nga brenda Kuvendit Kombëtar, i cili nuk do të shpërndahet si rezultat i largimit nga detyra e Kabinetit, ose Presidentit dhe Kabinetit. Sidoqoftë, interpretuar me qëllim, supozohet se të njëjtit persona thjesht nuk mund të rizgjidhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Për më tepër, kjo alternative do të dëmtonte parimin e ligjshmërisë, i cili është një komponent i sundimit të ligjit në Afrikën e Jugut. Ligjshmëria kërkon që personat që e ushtrojnë pushtetin publik, përveç të tjerash, ta bëjnë këtë në mënyrë racionale, domethënë, në

atë mënyrë që demonstroi një lidhje racionale midis qëllimit për të cilin iu dha pushteti dhe provave përpara se personi (at) që e ushtronte pushtetin dhe ndjek një proces racional; (viii) nuk ekziston asnjë detyrim për shpërndarjen e Kuvendit, megjithatë, siç u theksua më lart, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit kërkohet, në kuptim të nenit 50 (2) të Kushtetutës, të shpërndajë Kuvendin Kombëtar nëse ka një vend të lirë në zyrën e Presidentit dhe Kuvendi Kombëtar nuk arrin të zgjedh një President të ri brenda 30 ditëve nga momenti i postit të lirë; dhe (ix) Në Afrikën e Jugut ende nuk ka pasur një mocion të suksesshëm të mosbesimit. Prandaj, jurisprudenca e Afrikës së Jugut nuk është angazhuar drejtpërdrejt në pyetjet e shtruar. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut ka adresuar çështjet e përafërta që janë ngritur në lidhje me zbatimin e nenit 102 (2) të Kushtetutës. Së pari, në rastin *Mazibuko*, parashtruesi bëri njoftimin për një mocion mosbesimi të Presidentit. Për shkak të mungesës së konsensusit midis komiteteve të brendshme të Kuvendit Kombëtar, mocioni nuk u nxor para Kuvendit. Parashtruesja ishte e pasuksesshme në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës së Lartë për një urdhër që urdhëronte Kryetarin e Kuvendit të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të paraqitur mocionin e mosbesimit. Parashtruesja e çoi aktgjykimin e Gjykatës së Lartë me ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila konsideroi se neni 102 (2) i Kushtetutës i jep një anëtarit të Kuvendit të drejtën të njoftojë dhe të ketë një mocion mosbesimi ndaj Presidentit të paraqitur dhe votuar në Kuvend brenda një kohe të arsyeshme. Gjykata konsideroi që qëllimi kryesor i një mocioni të mosbesimit është të sigurojë që Presidenti dhe ekzekutivi kombëtar të jenë të përgjegjshëm para Kuvendit, i cili përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit. Në masën që Rregullat e Kuvendit Kombëtar nuk i japin të drejtë deputetëve për të pasur një mocion mosbesimi të formuluar, diskutuar dhe votuar në Kuvend brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata konstatoi se ato nuk ishin në pajtueshmëri me nenin 102 (2) të Kushtetutës dhe ishin të pavlefshme. Së dyti, çështja ligjore e ngritur në *Lëvizjen Demokratike të Bashkuar* ishte nëse Kushtetuta kërkon, lejon apo ndalon votimin me vota të fshehta në mocione të mosbesimit në Presidentin. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se një mocion i mosbesimit i shërben, në thelb, qëllimit të përmirësimit të efektivitetit të mekanizmave të rregullt të përgjegjësisë dhe ruajtjes së interesave më të mirë të popullit të Afrikës së Jugut. Ajo gjithashtu vlerësoi se Kryetari i Kuvendit ka kompetencën të përshkruajë që një mocion mosbesimi ndaj Presidentit të kryhet me votim të fshehtë nën rrethana të përshtatshme. Vendimi për të përcaktuar procedurën e votimit në zhvillimin e një mocioni të mosbesimit, për sa i përket kompetencave të tij kushtetuese sipas nenit 57 të Kushtetutës, u vlerësua se mbetej tek Kuvendi Kombëtar. Përfundimisht, përgjigja e Afrikës së Jugut

pohon se në masën që termi “Qeveri” interpretohet ngushtë, për t’iu referuar kabinetit dhe/ose presidentit, atëherë pozicioni paraqitet të jetë se një Kabineti i ri, ose një Presidenti *dhe* Kabineti i ri (siç mund të jetë rasti), duhet të emërohet pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit. Siç u shpjegua më lart, nëse shumica e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar e kalojnë një mocion mosbesimi në kabinet, atëherë Presidenti kërkohet të emërojë një Kabinet të ri. Nëse ajo shumicë kalon një mocion mosbesimi ndaj Presidentit, atëherë Presidenti, kabineti i tij ose i saj dhe të gjithë zëvendësministrat kërkohet që të japin dorëheqjen. Nuk ka kërkesë që Kuvendi të shpërndahet në cilëndo ngjarje - përveç një situate në të cilën Presidenti ka dhënë dorëheqjen në bazë të një mocioni të suksesshëm të mosbesimit dhe një President i ri nuk emërohet brenda tridhjetë (30) ditëve. Jashtë këtij eventualiteti, nuk ka asnjë detyrim ligjor për shpërndarjen e Kuvendit pas një mocioni të mosbesimit.

304. Përgjigja e Moldavisë specifikon që: (i) është e mundur të formohet një Qeveri e re brenda legjislaturës së njëjtë, pas një mocioni të mosbesimit. Sipas nenit 103 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Moldavisë, në rastet kur Parlamenti ka kaluar një votë mosbesimi në Qeverinë aktuale, apo Kryeministri është larguar nga detyra, ose siç parashikohet nga paragrafi (1) më lart [Qeveria ushtron mandatin e saj deri në datën e kur zgjedhja e Kuvendit të ri bëhet valide], Qeveria do të ushtroj vetëm administrimin e punëve publike deri në betimin e Qeverisë së re. Për më tepër, neni 85 paragrafi 1 parasheh kompetencën e Presidentit për shpërndarjen e Kuvendit në rast të pamundësisë për të formuar Qeverinë për një periudhë tre (3) mujore; (ii) neni 85 i Kushtetutës së Republikës së Moldavisë, i cili parasheh shpërndarjen e Parlamentit, parasheh si më poshtë: (1) Në rast të pamundësisë për të formuar Qeverinë ose në rast të bllokimit të procedurës së miratimit të ligjeve për një periudhë prej tre muajsh, Presidenti i Republikës, pas konsultimeve me fraksionet parlamentare, mund të shpërndajë Kuvendin; (2) Kuvendi mund të shpërndahet, nëse nuk ka pranuar votën e besimit për krijimin e Qeverisë së re brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga kërkesa e parë dhe vetëm pas refuzimit të së paku të dy kërkesave të emërimit; (3) Kuvendi mund të shpërndahet vetëm një herë gjatë një viti; dhe (4) Kuvendi nuk mund të shpërndahet brenda gjashtë (6) muajve të fundit të mandatit të Presidentit të Republikës, as gjatë një gjendjeje të jashtëzakonshme, Qeverie ushtarake ose gjendjeje lufte.
305. Gjykata Kushtetuese e Moldavisë ka interpretuar nëse paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni themelojnë një fuqi diskrecionale ose një obligim të detyrueshëm në Aktgjykimin e saj nr. 30 të datës 1 tetor 2013 për interpretimin e nenit 85 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Kushtetutës

gjetjet përkatëse nga Aktgjykimi i para cekur i Gjykatës Kushtetuese përfshijnë konstatimin se neni 85, në tërësi ka statusin e një mekanizmi balancues, një mekanizëm që zbatohet për të shmangur ose kapërcyer një krizë institucionale ose një konflikt midis legjislaturës dhe ekzekutivit; se kompetenca diskrecionale e Presidentit për shpërndarjen ose jo të Kuvendit në rast të votimit të mosbesimit për të formuar Qeverinë ndodh pas skadimit të dyzet e pesë (45) ditëve nga kërkesa e parë dhe refuzimi i të paktën dy kërkesave të emërimit deri në skadimin e afatit prej 3 muajsh; nëse Kuvendi nuk ka arritur të emërojë Qeverinë brenda tre (3) muajve, Presidenti është i detyruar të shpërndajë Kuvendin, kështu që kompetenca e tij diskrecionale për shpërndarjen e Kuvendit bëhet një detyrim i imponuar nga vullneti i ligjvënësit. Gjithashtu, nga rrjedha e bashkëpunimit dhe kontrollit të ndërsjellë midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, detyra e Kreut të Shtetit është që të pajtohet për të kapërcyer krizën politike dhe konfliktin midis pushteteve, dhe jo për të mbajtur situatën e krizës për një periudhë të papërcaktuar, fakt që nuk korrespondon me interesat e përgjithshme të qytetarëve, mbajtësve të sovranitetit kombëtar; dhe pavarësisht nga rrethanat që çuan në mungesën e votimit të besimit, dështimi për të formuar Qeverinë e re brenda tre (3) muajsh do të çojë në mënyrë të pashmangshme në shpërbërjen e Kuvendit. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese gjeti se Presidenti i Republikës së Moldavisë është i detyruar të shpërndajë Parlamentin pas tre (3) muajsh, nëse ai nuk arrinte ta formojë Qeverinë, gjithëpërfshirëse dhe nëse vota e besimit për të formuar një Qeveri nuk pranohej.

306. Në fund, përgjigja nga Brazili specifikon që sistemi presidencial i Brazilit nuk parashikon mocione të mosbesimit dhe as shpërndarje të Parlamentit, siç përcaktohet me Kushtetutën e shpallur në vitin 1988.

(iii) Dokumentet Përgatitore të Hartimit të Kushtetutës

307. Siç është reflektuar në procedurën para Gjykatës, Gjykata ka pranuar dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Këto dokumente, në të cilat Gjykata ka qasje për herë të parë, janë analizuar vetëm me synimin e përcaktimit të qëllimit të hartuesve të Kushtetutës përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, Zgjedhjen e Qeverisë, dhe Mocionin e Mosbesimit/Votëbesimit, të reflektuara në Kushtetutë si nenet 82, 95 dhe 100, të cilat reflektojnë esencën e rastit në shqyrtim para Gjykatës. Të njëjtat nuk janë përcaktuese për vendimin e Gjykatës.
308. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që këtë dokumentacion e ka pranuar nga Arkiva Shtetërore e Republikës së Kosovës si kopje të

certifikuar të dokumentacionit origjinal që gjendet në Arkivin e Kosovës, pas propozimit të bërë nga Avokati i Popullit dhe pas kërkesës që Gjykata ia ka drejtuar Kuvendit. Bazuar në këtë dokumentacion, dhe posaçërisht në të gjitha draftet përgatitore të Kushtetutës që janë pjesë e këtij materiali, Gjykata, në vijim, do të pasqyroj evoluimin e neneve të lartcekura, përgjatë hartimit të Kushtetutës, duke filluar me nenin 82, 95 dhe 100, respektivisht. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që gjuha e përdorur përgjatë përgatitjes së drafteve të Kushtetutës nuk reflekton gjithherë terminologji të harmonizuar edhe përmban edhe gabime eventuale teknike. Gjykata do ta paraqes këtë gjuhë saktësisht, ashtu siç është e reflektuar në këto drafte përgatitore.

Lidhur me nenin për Shpërndarjen e Kuvendit

309. Drafti më i hershëm i Kushtetutës që është pjesë e këtij dokumentacioni është ai i 21 majit 2007. Në këtë fazë të hartimit, përpos numrave të neneve, draftet e Kushtetutës nuk përmbajnë tituj të neneve dhe as numërim të paragrafëve përkatës. Shpërndarja e Kuvendit, në nenin 80 të këtij drafti, kishte pesë paragrafë, të cilët përcaktonin se Kuvendi shpërndahet në rastet në vijim: (i) kur në afat prej 60 ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti, nuk mund formohet Qeveria; (ii) kur për shpërndarje votojnë 2/3 e deputetëve; (iii) kur në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës, nuk zgjidhet Kryetari i Kosovës; (iv) me vendim të Presidentit pas konsultimeve me grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend; dhe (v) shpërndarja e Parlamentit bëhet me dekret të Presidentit.
310. Një dokument, i titulluar “*Pyetësor për Çështjet Kushtetuese: Pika për Udhëzime Politike*”, i datës 1 qershor 2007, i cili bazuar në procesverbalet që janë pjesë përbërëse e dokumenteve përgatitore, rezulton të jetë përgatitur nga Komisioni Kushtetues për Grupin Politik dhe Strategjik dhe Ekipin e Unitetit, përfshinë, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit edhe pyetjet në vijim: (i) në pyetjen 11, përkatësisht “*Kush duhet të jetë në gjendje të shpërbëjë Kuvendin dhe të thërret zgjedhje të hershme*”, kishte listuar alternativat vijuese: a) vet-shpërbërje me 2/3 të votave; b) Kryetari i Kosovës; c) me propozim të Qeverisë; d) cila do nga këto më sipër; dhe e) asnjë mundësi për shpërbërjen e Kuvendit; dhe (ii) në pyetjen 26, përkatësisht “*Dorëheqja – nëse Kryeministri jep dorëheqje a do të bie e tërë qeveria?*”. Në një dokument të njëjtë, të titulluar “*Pyetësor për Çështjet Kushtetuese*” por tri javë më të vjetër, përkatësisht të datës 20 qershor 2007, përtej dy pyetjeve të lartcekura, figuron edhe pyetja 30, përkatësisht “*A duhet të vazhdojë sistemi aktual i mocionit për votim*”.

të mosbesimit (vota pozitive e mosbesimit)". Të njëjtat pyetje janë reflektuar edhe në një tjetër "*Pyetësor për Çështjet Kushtetuese*" të pa datuar.

311. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 16 tetor 2007, i titulluar "*Drafti Final i Grupit Punes (GR-III) 'Institucionet e Kosovës'*". Neni 80, përkatësisht, Shpërndarja e Kuvendit, reflekton përmbajtjen e njëjtë, me përjashtim të: (i) kombinimit të pikës ii me pikën v, siç është sqaruar më lart; dhe (ii) pikës iv, me saktësisht, fjalisë "*me vendim të Presidentit pas konsultimit me grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend*", e cila, për dallim nga drafti paraprak, nuk reflektohet në këtë draft.
312. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 21 nëntor 2007. Neni 80 lidhur me Shpërndarjen e Kuvendit, tashmë i titulluar, ka katër pika të një paragrafi i vetëm, të shënuara si a), b), c) dhe d). Për dallim prej draftit pararendës, pika d) e tij, përmban "*Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti pas votimit të sukseshëm të mosbesimit për Qeverinë*". Pikat a), b) dhe c) mbeten të njëjta, me pikat (i), (ii), dhe (iii) të draftit pararendës.
313. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 14 dhjetor 2007. Neni 80, përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, nuk reflekton ndryshime, por në draft reflektohen një numër komentesh për konsiderim.
314. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 22 dhjetor 2007. Neni 80, përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, ka katër pika në të njëjtin paragraf, përfshirë shpërndarjen e Kuvendit, "*kur Kuvendi voton për mosbesimin ndaj Qeverisë*", në pikën e tij të fundit. Dokumenti reflekton komente, përfshirë një koment i cili rekomandon që kjo pikë të fshihet, dhe të shtohet një paragraf i ri përkitazi me këtë pikë.
315. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 2 shkurt 2008. Neni 82, përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, tashmë është i ndarë në dy paragrafë. Paragrafi i parë është strukturuar në tre nën-paragrafë, ku parashihen tri rrethana në të cilat shpërndahet Kuvendi: (1) kur brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria; (2) kur për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës; (3) kur brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet Presidenti i Republikës së Kosovës. Ndërsa,

paragrafi dy i të njëjtin nen, ka vetëm një pikë dhe përcakton që *“Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë”*.

316. Në vijim, në dokumentet përgatitore përfshihet edhe një draft, i pa datuar, që titullohet *“Komentet e Publikut në Draftin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës”*, dhe i cili bazuar në procesverbalet e Komisionit Kushtetutes të përfshira në dokumentet përgatitore, rezulton të jetë draft i Kushtetutës i fundit të muajit shkurt të vitit 2008. Ky dokument nuk reflekton të ketë pasur komente përkitazi me nenin 82 lidhur me Shpërndarjen e Kuvendit.
317. Drafti i radhës dhe i fundit i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 13 mars 2008. Neni 82, përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, reflekton përmbajtjen e tanishme të nenit 82 të Kushtetutës.

Lidhur me Zgjedhjen e Qeverisë

318. Drafti i Kushtetutës i 21 majit 2007, në nenin 104 përcakton mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë. Siç është sqaruar më lart, në këtë fazë të hartimit, përpos numrave të neneve, draft Kushtetuta nuk përmban tituj të neneve dhe as numërim të paragrafëve përkatës. Ky nen saktëson si në vijim: (i) pas zgjedhjeve ose kur Kryeministri jep dorëheqjen apo për arsye tjera, posti i tij mbetet i lirë, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër; (ii) Kryeministri, jo më vonë se 15 ditë pas emërimit paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon votimin e Qeverisë nga Kuvendi i Kosovës; (iii) Qeveria apo anëtar i saj konsiderohen të zgjedhur kur marrin shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës; (iv) Kur përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Kryetari i Kosovës, në afatin prej 10 ditësh emëron kandidatin tjetër, sipas procedurës së njëjtë. Kur edhe herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Kryetari i Kosovës shpall zgjedhjet e parakohshme të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 45 ditë nga e shpalljes së tyre; dhe (v) detyrën e Qeverisë e ushtron Qeveria ekzistuese deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.
319. Drafti i radhës, përkatësisht ai i datës 16 tetor 2007, në nenin 104, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, reflekton ndryshimet si në vijim: pika e parë lartcekur është riformuluar si në vijim: (i) Presidenti i Kosovës, pas zgjedhjeve dhe konsultimeve me partitë politike ose koalicionin që e ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër; shtohet pika dy si në vijim (ii) Me rënien e Kryeministrit bie Qeveria; shtohet

pika e ri-formuluar nga drafti paraprak (iii) Kur Kryeministri jep dorëheqjen apo për arsye tjera, posti i tij mbetet i lirë, Presidenti i Kosovës mandaton kandidatin e ri; pika (ii) e lartcekur shndërrohet në pikën e radhës dhe përmban si në vijim (iv) Kryeministri jo më vonë se 15 ditë pas emërimit paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon votën e Kuvendit; pika (iii) e lartcekur e draftit pararendës, shndërrohet në pikën e radhës dhe përmban si në vijim (v) Qeveria konsiderohet e zgjedhur kur merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës; pika (iv) e lartcekur e draftit pararendës shndërrohet në pikën e radhës me përmbajtjen si në vijim (vi) Kur përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Kryetari i Kosovës, në afatin prej 10 ditësh emëron kandidatin tjetër, sipas procedurës së njëjte. Kur edhe herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Kryetari i Kosovës shpall zgjedhjet e parakohshme të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga e shpalljes së tyre; ndërsa pika e fundit, mbetet e njëjtë, (vii) detyrën e saj, Qeveria ekzistuese e ushtron deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

320. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 21 nëntorit 2007, lidhur me Zgjedhjen e Qeverisë, tashmë të listuar si neni 96 dhe i titulluar, përmban shtatë paragrafë. Të njëjtit përmbajnë saktësisht si një vijim: 1) Presidenti i Kosovës, pas zgjedhjeve dhe konsultimeve me partitë politike ose koalicionin që e ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër; 2) Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se 15 ditë pas emërimit paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon votën e Kuvendit; 3) Qeveria konsiderohet e zgjedhur kur merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës; 4) Kur përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Kosovës, në afatin prej 10 ditësh emëron kandidatin tjetër, sipas procedurës së njëjte. Kur edhe herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës shpall zgjedhjet e parakohshme të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga e shpalljes së tyre; 5) Kur Kryeministri jep dorëheqjen apo për arsye tjera posti i tij mbetet i lirë, Presidenti i Kosovës, mandaton kandidatin e ri; 6) Detyrën e saj Qeveria ekzistuese e ushtron deri në zgjedhjen e Qeverisë së re; dhe 7) Me rënien e Kryeministrit bie Qeveria.
321. Drafti i radhës përkatësisht ai i 14 dhjetorit 2007, neni 96, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, nuk reflekton ndryshime, por në draft reflektohen një numër komentesh për konsiderim.
322. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 22 dhjetorit 2007, në nenin 93 të tij përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, reflekton ndryshime. Tashmë reflekton pesë paragrafët si në vijim: 1) Pas zgjedhjeve, në konsultim

me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, Presidenti i Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, për të formuar Qeverinë; 2) Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se 15 ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit; 3) Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës; 4) Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Kosovës, në afatin prej 10 ditësh emëron kandidatin tjetër, sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre; 5) Kur Kryeministri jep dorëheqjen apo, për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

323. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 2 shkurtit 2008, në nenin 95 të tij përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, reflekton nenin aktual 95 të Kushtetutës, me tri përjashtime (i) në paragrafin e parë të tij, për dallim prej draftit paraprak i referohet "*partisë*" në njëjës; (ii) në paragrafin e tretë kërkon votën e "*të gjithë deputetëve*" për dallim prej drafti pararendës në të cilin i referohet "*votave të deputetëve*" për miratimin e Qeverisë; dhe (iii) nuk përmban paragrafin e gjashtë të nenit aktual të Kushtetutës, respektivisht "*Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj*".
324. Drafti i titulluar "*Komentet e Publikut në Draftin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës*", nuk reflekton të ketë pasur komente me ndikim në përmbajtjen përfundimtare të nenit 95.
325. Drafti i radhës dhe i fundit i përfshirë në dokumentet përgatitore, përkatësisht ai i 13 marsit 2008, në nenin 95 përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, reflekton përmbajtjen e nenit 95 të Kushtetutës, me përjashtim të paragrafit të gjashtë lidhur me betimin e anëtarëve të Qeverisë.

Lidhur me Mocionin e Votëbesimit

326. Drafti i Kushtetutës i 21 majit 2007, në nenin 105 përcakton Mocionin e Votëbesimit. Siç është sqaruar më lart, në këtë fazë të hartimit, përpos numrave të neneve, draft Kushtetuta nuk përmban tituj të neneve dhe as numërim të paragrafëve përkatës. Ky nen saktëson si në vijim: (i) me propozimin e një të tretës (1/3) të deputetëve të Kuvendit

mund të ngritet mocioni i mosbesimit të Kryeministrit apo ndonjërit nga anëtarët e Qeverisë; (ii) Votëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë edhe Kryeministri; (iii) Mocioni i mosbesimit nuk votohet para tri ditëve nga dita e dorëzimit të tij. Mocioni i shtruar i votëbesimit vihet në rend dite në Kuvend brenda pesë ditëve nga dita e parashtrimit të tij në Kuvend; (iv) Mocioni i mosbesimit konsiderohet i pranuar nëse për atë kanë votuar më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit të Kosovës; (v) Kur mocioni i mosbesimit refuzohet nga shumica e deputetëve, parashtruesit e mocionit mund të parashtrojnë prapë mocion të mosbesimit, pas afatit prej tre muajve; (vi) Kur mocioni i mosbesimit është votuar për Kryeministrin e Qeverisë apo Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje dhe Kryetari i Kosovës emëron mandatarin e ri në afat prej 10 ditësh; (vii) kur mocioni i mosbesimit ka të bëjë me një anëtarë të Qeverisë, Kryeministri bën zëvendësimin e tij në afat prej 15 ditësh; dhe (viii) pas dorëheqjes së Kryeministrit konsiderohet se i ka pushuar mandati Qeverisë.

327. Drafti i radhës, përkatësisht ai i datës 16 tetor 2007, në nenin 105 të tij përkritazi me Mocionin e Votëbesimit, reflekton ndryshimet si në vijim: pikat (i) dhe (ii) mbesin të njëjta; pika e radhës ndryshohet si në vijim (iii) mocioni i votëbesimit vihet në rend dite në Kuvend brenda pesë ditëve nga dita e parashtrimit; pikat (iv) dhe (v) mbeten esencialisht të njëjta; pika e radhës ndryshohet si në vijim (vi) Kur mocioni i mosbesimit është votuar për Kryeministrin apo Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje; pika (vii) mbetet e njëjte; ndërsa (viii) e lartcekur e draftit pararendës nuk është e përfshirë në këtë draft, e cila saktësisht lexon si në vijim *“pas dorëheqjes së Kryeministrit konsiderohet se i ka pushuar mandati Qeverisë”*.
328. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 21 nëntorit 2007, lidhur me Mocionin e Votëbesimit, tashmë të listuar si neni 97 dhe i titulluar, përmban gjashtë paragrafë. Të njëjtit përmbajnë saktësisht si një vijim: 1) Me propozimin e një të tretës (1/3) të deputetëve të Kuvendit mund të ngritet mocioni i mosbesimit ndaj Kryeministrit apo ndonjërit nga anëtarët e Qeverisë; 2) Votëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë edhe Kryeministri; 3) Mocioni i votëbesimit vihet në rend dite në Kuvend brenda pesë ditëve nga dita e parashtrimit; 4) Konsiderohet se është votuar mocioni i mosbesimit nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit të Kosovës; 5) Kur mocioni i mosbesimit nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave të deputetëve, parashtruesit e mocionit mund të parashtrojnë prapë mocion të mosbesimit, vetëm pas afatit prej tre muajve; 6) Kur mocioni i mosbesimit është votuar për Kryeministrin apo Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje.

329. Drafti i radhës përkatësisht ai i 14 dhjetorit 2007, në nenin 97 përkitazi me Mocionin e Votëbesimit, nuk reflekton ndryshme, por në draft reflektohen një numër komentesh për konsiderim.
330. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 22 dhjetorit 2007, në neni 98 përkitazi me Mocionin e Mosbesimit, mbetet esencialisht i njëjtë, por në draft reflektohen një numër komentesh për konsiderim. Drafti i radhës, përkatësisht ai i 2 shkurtit 2008, neni 100, përkitazi me Mocionin e Votëbesimit, nuk reflekton ndryshime përmbajtësore.
331. Drafti i titulluar “*Komentet e Publikut në Draftin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës*”, i muajit shkurt 2008, reflekton të ketë pasur komente specifike, nga një komentues i identifikuar si PAI, përkitazi me Mocionin e Votëbesimit, duke rekomanduar, ndër tjerash, por specifikisht, që ky nen të ndryshohet për të përfshirë “*mocionin konstruktiv*”, përkatësisht kushtëzimin e paraqitjes dhe votimit të mocionit të mosbesimit me propozimin e kandidatit të ri për Kryeministër.
332. Drafti i radhës dhe i fundit i përfshirë në dokumentet përgatitore, përkatësisht ai i 13 marsit 2008, në nenin 100 përkitazi me Mocionin e Votëbesimit, reflekton përmbajtën e nenit 100 të Kushtetutës, me përjashtim të paragrafit të gjashtë të tij, përkatësisht “*Nëse mocioni i mosbesimit votohet për Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje*”, dhe i cili nuk është përfshirë në këtë draft dhe është shtuar në draftin përfundimtarë të Kushtetutës.

III. Lidhur me nenin 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës

333. Gjykata rikujton se çështja kushtetuese përkitazi me nenin 82.2 të Kushtetutës ka të bëjë me interpretimin përfundimtar kushtetues nëse Kushtetuta e detyron Presidentin që ta shpërndajë Kuvendin pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë apo vetëm ia mundëson shpërndarjen e Kuvendit.
334. Deputetët parashtrues pretendojnë se Presidenti është i detyruar të shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82.2 të Kushtetutës; ndërkaq, Presidenti si palë kundërshtare pretendon se kjo normë nuk e detyron atë për të shpërndarë Kuvendin, por ia jep mundësinë e shpërndarjes së Kuvendit, varësisht nga vullneti i shumicës së partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend për formimin e një Qeverie të re.

335. Për qëllime të trajtimit të këtij pretendimi specifik, në vijim, dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata do të paraqesë: (1) Thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të dorëzuara nga palët e interesuara (shih paragrafët 62-92, 122-167 dhe 192-205 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të këtyre pretendimeve dhe komenteve mbështetëse); (2) Thelbin e argumenteve të palës kundërshtare dhe palëve të tjera të interesuara që kanë mbështetur palën kundërshtare (shih paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të kundërshtimeve dhe të komenteve në favor të kundërshtimit të tillë); dhe (3) Përgjigjen e Gjykatës lidhur me këtë pretendim specifik.

Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës

336. Parashtruesit e kërkesës, përkatësisht tridhjetë (30) deputetët parashtrues, në thelb, pretendojnë se neni 82.2 i Kushtetutës e detyron Presidentin që të shpërndajë Kuvendin pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë. Pretendimet e parashtruesve për jokushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar të Presidentit janë mbështetur nga Kryeministri, Kryetarja e Kuvendit dhe Nënkryetarja e Kuvendit – gjithnjë sipas arsyeve specifike të cekura nga secila palë e interesuar në parashtrësit e tyre të dorëzuara në Gjykatë dhe të pasqyruara në hollësi në paragrafët 62-92, 122-167 dhe 191-205 të këtij Aktgjykimi.
337. Sipas parashtruesve të kërkesës: (i) Presidenti është dashur përmes Dekretit të shpërndajë Kuvendin mbi bazën e nenit 82.2 të Kushtetutës; (ii) Kushtetuta, përveç shpërndarjes së Kuvendit, nuk parasheh asnjë procedurë tjetër pas mocionit të mosbesimit; (iii) neni 82.2 i Kushtetutës dërgon në rrugë njëdrejtimëshe dhe nuk lejon zbatimin e nenit 95 të Kushtetutës për shkak të mungesës së dispozitës kushtetuese që mund të cilësohet si urë lidhëse kushtetuese në mes të nenit 100 dhe nenit 95 të Kushtetutës; (iv) praktika e dekreteve të nxjerra në vitet 2010 dhe 2017 vërtetojnë qartë se pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, rruga e vetme kushtetuese e veprimtimit është shpërndarja e Kuvendit përmes nenit 82.2 të Kushtetutës; (v) Kushtetuta ka përcaktuar qartë nenin 82.2 si portën e vetme kushtetuese për të zhblllokuar institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës; (vi) kalimi nga një mocion konstruktiv mosbesimi në llojin e mocionit destruktiv të mosbesimit, është bërë në mënyrë që të kuptohet qartë se shkarkimi i Qeverisë ka për pasojë shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja; (vii) praktika tregon se pas çdo mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë dispozitat kushtetuese janë jetësuar natyrshëm duke u përcjellë me shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti në të njëjtën ditë; (viii) neni 100.6 i Kushtetutës është

natyrshëm i lidhur me nenin 82.2 të Kushtetutës; (ix) neni 82.2 i Kushtetutës nuk përbën dispozitë kushtetuese alternative (të mundësisë) për shpërndarjen e Kuvendit por përbën rrugën e vetme të mundshme; dhe (x) folja modale “*mund*” e përdorur në nenin 82.2 të Kushtetutës nuk përbën alternativë në zbatimin e saj, por ofron zgjidhjen e vetme (më adekuate) të mundshme kushtetuese për të vënë në funksion vullnetin e popullit, përmes zgjedhjeve parlamentare në zgjedhjen e përfaqësuesve të ri në institucionet kushtetuese.

338. Sipas Kryeministrit: (i) Përmbajtja tekstuale e nenit 82.2 përbën normën e vetme kushtetuese të aplikueshme për rastet pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë; (ii) Kushtetutbërësi nuk ka lënë asnjë alternativë tjetër, përpos shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti përmes nenit 82.2 të Kushtetutës; (ii) folja “*mund*” [“*may*” në gjuhën angleze] e përdorur në nenin 82.2 të Kushtetutës ka dispozitiv autorizues/lejues, pra është normë që i njeh Presidentit një kompetencë dhe që në fakt e detyron Presidentin të shpërndajë Kuvendin; (iii) përdorimi i foljes “*mund*” në nenin 82.2 të Kushtetutës nuk përcakton vetvetiu se norma ka karakter alternativ, ngase që një normë të konsiderohet alternative ajo duhet të përmbajë në formulimin e tekstit të saj të paktën një alternativë që mund të zgjidhet nga organi, të cilit i është njohur diskrecioni në vlerësim dhe zgjedhje mes alternativave; (iv) neni 82.2 i Kushtetutës vetëm parasheh se Presidenti autorizohet/fuqizohet të shpërndajë Kuvendin pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, por nuk e lë në diskrecion të tij ndonjë alternativë tjetër; dhe, (v) interpretimi i nenit 82.2 të Kushtetutës duhet të bëhet duke iu referuar metodave të tjera të interpretimit kushtetues, ashtu që kuptimi i vërtetë i normës të mund të nxjerrët nga burime tjera, përpos formulimit gjuhësor.
339. Sipas Kryetares së Kuvendit janë tri arsye kryesore përse Dekreti i kontestuar i Presidentit është kundërkushtetues, si në vijim: (i) Presidenti nuk ka respektuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve; (ii) Presidenti, përmes Dekretit të tij ka synuar të amandamentoj Kushtetutën e vendit, kompetencë e cila i takon ekskluzivisht Kuvendit; dhe, (iii) Presidenti ka ngërthyer mbi vete kompetenca për interpretimin e Kushtetutës e që sipas të drejtës pozitive i takon Gjykatës Kushtetuese. Kryetarja e Kuvendit, në komentet e saj nuk ka paraqitur ndonjë koment specifik lidhur me nenin 82.2 të Kushtetutës.
340. Sipas argumenteve të Nënkryetares së Kuvendit: (i) Dekreti i Presidentit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 82.2 të Kushtetutës ngase ai është dashur që të dekretojë shpërndarjen e Kuvendit; (ii) pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, Kushtetuta

autorizon Presidentin vetëm që në përputhje me rolin e tij kushtetues të shpërndajë Kuvendin dhe të caktojë datën e zgjedhjeve; (iii) neni 82.2 i Kushtetutës që parasheh shpërbërjen e Kuvendit ka ndërlidhje vetëm me nenin 100.6 të Kushtetutës që flet për mocionin e mosbesimit dhe me nenin 84.3 që flet për kompetencën e Presidentit për shpallje të zgjedhjeve; (iv) nëse interpretimi i Presidentit do të ishte i drejtë se nuk shpërndahet Kuvendi pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë atëherë norma e nenit 82.2 është krejtësisht e panevojshme dhe pa kurrfarë funksioni; (v) neni 82.2 i Kushtetutës ekziston për faktin se nuk ekziston alternativë për të krijuar Qeveri të re pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, andaj si rrugëdalje kushtetuese është paraparë shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve; (vi) është qartazi përcaktim i kushtetutbërësit, që përmes nenit 82.2 të mundësohet qeverisje legjitime, duke synuar rikthimin e legjitimitetit për Kuvendin përmes zgjedhjeve; (vii) dallimi në mes të Kushtetutës dhe Kornizës Kushtetuese qartazi vërteton se kushtetutbërësi kapërcen nga modeli i mocionit konstruktiv; dhe, (viii) veprimi i Presidentit në rrethanat e këtij rasti është në kundërshtim me praktikën e deritanishme parlamentare në Republikën e Kosovës në rastet e ngjashme, në vitin 2010 dhe në vitin 2017, kur Qeveria e vendit është shkarkuar përmes një mocioni të mosbesimit.

Thelbi i argumenteve të palës kundërshtare

341. Pala kundërshtare, respektivisht Presidenti, në thelb, pretendon se Kushtetuta nuk e detyron Presidentin që të shpërndajë Kuvendin pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë. Në mbështetje të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar të Presidentit janë dorëzuar parashtresa nga Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetët e AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s, dhe nga deputeti i LDK-së, Arban Abrashi – për arsyet specifike të cekura nga secila palë e interesuar në parashtresat e tyre të dorëzuara në Gjykatë dhe të pasqyruara në paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi.
342. Sipas Presidentit: (i) neni 82 i Kushtetutës është i ndarë në dy paragrafë, ku paragrafi i parë përcakton situatat kur Kuvendi shpërndahet detyrimisht, kurse paragrafi tjetër situatën kur Kuvendi “mund” të shpërndahet; (ii) me nxjerrjen e Dekretit, Presidenti ka pasur parasysh shmangien e zgjedhjeve dhe vullnetin e të zgjedhurve të popullit; (iii) LVV ka kërkuar shpërndarjen e Kuvendit sipas nenit 82.2 të Kushtetutës, mirëpo Presidenti duke pasur parasysh kompetencat kushtetuese, frymën e Kushtetutës dhe standardet e Aktgjykimit KO103/14, është dashur të gjejë rrugë për formimin e

Qeverisë, me qëllim që vullnetin e partive politike ta materializojë përmes procedurave kushtetuese për formimin e Qeverisë, sipas nenit 95 të Kushtetutës; (iv) në të tri rastet e legjislaturave të kaluara, respektivisht atyre të: katërt (2014), pestë (2017) dhe gjashtë (2019), vullneti i partive politike shprehimisht ka qenë shpërndarja e Kuvendit dhe Presidenti e ka dekretuar këtë vullnet të tyre, ndërkaq që në rastin konkret, vullneti i dy të tretave (2/3) të përfaqësuesve të popullit është që të formohet Qeveri e re dhe vendi të mos shkojë në zgjedhje të parakohshme; (v) duke marrë për bazë vullnetin e partive politike, respektivisht 2/3 e deputetëve për të mos e shpërndarë Kuvendin, Presidenti ka përfaqësuar vullnetin e të zgjedhurve të popullit, të cilët e kanë vlerësuar të nevojshme krijimin e një Qeverie të re; (vi) shkuarja në zgjedhje të reja, përkundër vullnetit të të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend për të mos shkuar në zgjedhje të parakohshme, (përveç LVV), do të përbënte shkelje kushtetuese; (viii) qytetarët në një vend me demokraci parlamentare nuk e zgjedhin Qeverinë, por e zgjedhin Kuvendin dhe qytetarët kur votojnë presin që Kuvendi të ketë mandat katër (4) vjeçar; (ix) Presidenti me nxjerrjen e Dekretit të kontestuar ka pasur parasysh rrethanat e reja kushtetuese, përkatësisht kalimin e mocionit të mosbesimit me 2/3 e votave të deputetëve, vullnetin e shprehur të deputetëve për Qeveri të re, dhe mandatin e Kuvendit deri në fund të vitit 2023; (x) nenet 100.6 dhe 82.2 të Kushtetutës duhet të lexohen në ndërlidhje me nenin 95.5 të Kushtetutës për shkak të situatave të ndryshme që mund të krijohen, sikur në rastin e situatës aktuale; (xi) për herë të parë në praktikën kushtetuese, shumica e partive politike të përfaqësuara në Kuvend janë deklaruar dhe kanë kërkuar nga Presidenti që të mos e shpërndajë Kuvendin, por të ndjek procedurat kushtetuese për krijimin e një Qeverie të re; (xii) neni 82.2 i Kushtetutës zbatohet nga Presidenti nëse shihet se nuk ka vullnet nga partitë e përfaqësuara në Kuvend që të formohet Qeveria; (xiii) shprehja “*mund*” e përdorur në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës nuk përbën një detyrim shprehimor për Presidentin, por e obligon Presidentin që të bëjë një vlerësim të rrethanave nëse Kuvendi mund të shpërndahet apo jo, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë; dhe, (xiv) folja “*mund*” e përdorur në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës tregon se shpërndarja e Kuvendit është në vullnetin e vlerësimit të Presidentit, pas konsultimit me partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend.

343. Sipas Grupit Parlamentar të LDK-së: (i) Presidenti nuk ka të drejtë me automatizëm të shpërndajë Kuvendin sipas nenit 82.2 të Kushtetutës pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit, pa e pasur paraprakisht vullnetin e shumicës së subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend; (ii) neni 82.2 nuk mund të përdoret me automatizëm nga Presidenti jo

vetëm për shkak të ndajfoljes “*mund*” por edhe për faktin se hartuesit e Kushtetutës, momentin kur ka votim të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë nuk e kanë përcaktuar si moment kur vendi automatikisht shkon në zgjedhje, por kanë lënë mundësi që të evitohen zgjedhjet, të krijohet shumicë parlamentare, rrjedhimisht të themelohet një Qeveri e re; (iii) pretendimi më kontradiktor i parashtruesve të kërkesës ka të bëjë pikërisht me interpretimin e fjalës “*mund*” të përdorur në paragrafin 2 të nenit 82 meqë ata theksojnë se dispozita e tillë nuk ka karakter alternativ, por ka karakter të lejitimit të mundësisë së vetme sepse shprehja “*lejimi i mundësisë së vetme*” nënkupton obligim (që më së miri do të ishte pasqyruar me fjalën “*duhet*” apo “*obligohet*” e jo me fjalën “*mund*”); (iv) neni 82.1 qëllimshëm është anashkaluar nga parashtruesit e kërkesës, ani pse ai paragraf në mënyrë taksative ka përcaktuar tri momente kur vendi shkon automatikisht në zgjedhje, përkatësisht tri momente kur domosdoshmërisht shpërndahet Kuvendi; dhe, (v) asnjë nga kushtet e parapara për shpërndarje të domosdoshme të Kuvendit të parapara me nenin 82.1 të Kushtetutës nuk janë plotësuar në rrethanat e rastit konkret.

344. Sipas deputetëve të AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s: (i) Gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat e reja politike dhe kushtetuese dhe faktin se për herë të parë në Kosovë kemi një situatë kur në fillim të mandatit të Kuvendit kemi një ndryshim të shumicës parlamentare në disfavor të Qeverisë; (ii) interpretimi i parashtruesve të kërkesës se neni 82.2 e detyron Presidentin që të shpërndajë Kuvendin është krejtësisht gabim, ngase shpërndarja e Kuvendit do të ishte në kundërshtim me praktikën parlamentare dhe në kundërshtim me nenin 95.5; (iii) në vitin 2010 Kuvendi është shpërndarë nga Presidenti në rrethana krejtësisht tjera dhe kjo shpërndarje ishte bërë në vitin e tretë të mandatit të Kuvendit; ndërkaq, në vitin 2017, Kuvendi ishte shpërndarë pas një mocioni të mosbesimit, por legjislatura në atë kohë vetëm ishte futur në vitin e katërt të mandatit dhe partitë politike nuk kishin pasur vullnet të krijonin Qeveri të re; (iv) rrethanat e tanishme janë krejtësisht tjera për shkakun se Kuvendi është në fillim të mandatit dhe të gjitha partitë politike parlamentare, shumica absolute e tyre, janë deklaruar për krijimin e një Qeverie të re; (v) Presidenti në rastin e veprimit për shpërndarjen e Kuvendit apo për ndërmarrjen e hapave kushtetues për krijimin e një Qeverie të re, ka pasur parasysh vullnetin e shumicës së kualifikuar parlamentare të cilët janë deklaruar për një Qeveri të re dhe jo për shpërndarje të Kuvendit sipas nenit 82.2; dhe, (vi) Presidenti në kuadër të funksionit të tij si përfaqësues i unitetit të popullit duhet të marrë parasysh edhe vullnetin e partive politike parlamentare, sidomos kur është fjala për shpërndarjen e Kuvendit në këtë rast.

345. Sipas deputetit Arban Abrashi nga LDK: (i) mandati i Kuvendit zgjatë katër (4) vite, përveç kur ky organ, pas krijimit të rrethanave dhe plotësimit të kushteve kushtetuese, shpërndahet para përfundimit të rregullt e të plotë të mandatit të tij; (ii) Kuvendi shpërndahet detyrimisht dhe para përfundimit të mandatit të plotë sipas situatave të parapara në paragrafin 1 të nenit 82, në rastet kur Kuvendi shndërrohet në organ i cili nuk mund të përmbushë përgjegjësitë e veta kushtetuese ligjore, siç janë zgjedhja e organeve të tjera të rëndësishme si për shembull mos zgjedhja e Qeverisë apo e Presidentit; (iii) sipas paragrafit 2 të nenit 82 Kuvendi mund të shpërndahet (opsionale) edhe pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë dhe këtu shpërndarja e Kuvendit lihet vetëm si mundësi e Presidentit; (iv) sikur shpërndarja e Kuvendit pas mocionit të mosbesimit të ishte e detyrueshme, atëherë hartuesit e Kushtetutës, do të vazhdonin me rregullimin e kësaj sate në nenin 82, paragrafi 1, saktësisht duke vazhduar me nënparagrafin 4 të vetëm një paragrafi, dhe jo të kalohet në një paragraf të ri siç është rasti me paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës; (v) në praktika tjera parlamentare mocioni i mosbesimit shihet si rast për ndërrimin e Qeverisë dhe jo detyrimisht të shkohet në zgjedhje të reja; (vi) në vitin 2019, legjislatura e Kuvendit ishte shpërndarë meqë subjektet politike, të gjitha pa dallim, ishin deklaruar kundër formimit të Qeverisë dhe për zgjedhje të reja; dhe, (vii) nga pretendimet e parashtruesve të kërkesës, rrjedh që sikur përmes Dekretit të Presidentit të ishte propozuar një kandidat nga LVV për Kryeministër, atëherë ky dekret nuk do të ishte në kundërshtim me nenin 82.2 të Kushtetutës.

PËRGJIGJA E GJYKATËS – përkitazi me nenin 82 të Kushtetutës

Parimet e përgjithshme lidhur me shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti

346. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë shteti i Republikës së Kosovës. Këto parime dhe vlera mishërojnë dhe pasqyrojnë frymën e Kushtetutës, e cila është e transpozuar në secilën normë të saj. Si e tillë, Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërrarësi me njëra tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra tjetra, dhe gjithnjë duke pasur parasysh parimet dhe vlerat e saj. Asnjë normë e Kushtetutës nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndarë dhe të izoluar nga parimet dhe vlerat e proklamuar në Kushtetutë, përfshirë Preambulën e saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të

interpretohet në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj. Kjo qasje rekomandohet edhe nga Opinionet e Komisionit të Venecias e të cilat do të sqarohen në vijim.

347. Për qëllime të interpretimit të paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës i cili parasheh se *“Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë”*, është e nevojshme që fillimisht të analizohen dy çështje themelore vijuese: (i) roli i Kuvendit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës; dhe, (ii) roli i Presidentit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Përkitazi me këtë analizë thelbësore, Gjykata do iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në Kushtetutë dhe të reflektuara në praktikën e saj gjyqësore të deritanishme, duke marrë parasysh edhe rrethanat relevante të rastit konkret. Më pas, në pjesën e “Përgjigjes së Gjykatës” do të interpretohet neni 82 në tërësi, kurse paragrafi 2 i nenit 82 të Kushtetutës, në veçanti.

Kuvendi në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

348. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të popullit, në pajtim me Kushtetutën. Mënyrë tjetër e ushtrimit të sovranitetit nga populli janë referendumet ose format e tjera të pajtueshme me Kushtetutën. (Shih, neni 2 i Kushtetutës).
349. Në veçanti, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit janë deputetët e Kuvendit të zgjedhur në zgjedhje të lira dhe demokratike. Ushtrimi i sovranitetit përmes të zgjedhurve të popullit është modaliteti kryesor dhe më i përhapur për të shprehur atë se çfarë *“buron nga populli”* dhe për ta reflektuar atë në veprime dhe vendime konkrete përmes sistemit të demokracisë përfaqësuese.
350. Kuvendi si institucion ligjvënës zgjidhet me mandat katër (4) vjeçar. Pas përfundimit të rregullt të mandatit të Kuvendit, vendi shkon automatikisht në zgjedhje. Pra qëllimi i një legjislature bazuar në Kushtetutë, është përfundimi i mandatit katër (4) vjeçar të saj. Në zgjedhje të reja, populli voton dhe zgjedh legjislaturën e re, me bindjen që ajo legjislaturë do t'i përfaqësojë për katër (4) vitet e tjera të radhës. Kjo paraqet ciklin e rregullt të zgjedhjes së përfaqësuesve të popullit në Kuvend. Përkundër këtij cikli të rregullt të demokracisë përfaqësuese, mandati i Kuvendit mund të mbarojë para përfundimit të mandatit të rregullt katër (4) vjeçar, vetëm sipas rregullimit të

përcaktuar përmes nenit 82 të Kushtetutës, ku specifikisht përcaktohen tri (3) situata të shpërndarjes të detyrueshme të Kuvendit dhe, një (1) situatë të mundshme të shpërndarjes së Kuvendit. Përfundimisht, mandati i Kuvendit mund të vazhdohet edhe përtej mandatit të rregullt kushtetues katër (4) vjeçar, në rrethana të Gjendjes së Jashtëzakonshme. (Shih nenin 66 të Kushtetutës).

351. Ndër vlerat themelore mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës të mishëruara në Kushtetutë, ndër të tjera, janë edhe “demokracia” dhe “sundimi i ligjit” dhe “ndarja e pushteteve. (Shih, neni 7 i Kushtetutës). Demokracia në Republikën e Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre. (Shih, neni 4 i Kushtetutës). Për më tepër, bazuar në nenin 4 të Kushtetutës përkritazi me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve: (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; dhe (iii) Gjyqësori është unik dhe i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Vend të veçantë në ndarjen e pushteteve kanë edhe Gjykata Kushtetuese dhe Presidenti. E para mbron kushtetutshmërinë në vend dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës; ndërkaq i dyti përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës.
352. Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues. Si njëra nga degët kryesore të pushtetit, Kuvendi ka obligim që të respektojë pavarësinë e pushteteve të tjera po aq sa edhe degët e tjera kanë për obligim që të respektojnë pavarësinë e Kuvendit. Ky ndërveprim paraqet thelbin e vlerës që ngërthen në vetvete ndarja e pushteteve si parim themelor në një sistem demokratik. Respektimi i kësaj vlere është parakusht për jetësimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.
353. Të gjitha pushtetet pa përjashtim, qofshin ato pjesë të trekëndëshit klasik të ndarjes së pushteteve, qofshin ato pjesë tjetër e rëndësishme e strukturës së shtetit, kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto pushtete kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike me qëllim të jetësimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës. Në këtë aspekt, bashkëpunimi besnik në mes të institucioneve kushtetuese/publike paraqet detyrim kushtetues dhe besnikëri ndaj betimit formal e publik me rastin e

marrjes së përgjegjësive kushtetuese nga secili bartës i funksionit përkatës publik.

354. Si institucion ligjvënës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, Kuvendi ka një mori të kompetencave të cilat janë të përcaktuara specifikisht në Kushtetutë. Ndër kompetencat kryesore të Kuvendit, në aspekt të rrethanave të rastit konkret, është kompetenca për të “zgjedhur Qeverinë” dhe për të shprehur “mosbesimin” ndaj saj.
355. Në këtë aspekt, në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate është theksuar se: *“Demokracia, “vox populi” (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky [Kuvendi] është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Një nga përgjegjësitë kryesore të parlamentit është që të vendosë duke votuar se kë të fuqizojë me funksione ekzekutive. Qeveria rrjedh nga fuqia mbizotëruese politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që fiton zgjedhjet. Kjo mund të jetë një fitore absolute apo relative.”* (Shih Aktgjykimi KO103/14, paragrafi 49).
356. Kushtetuta ka paraparë mënyra të ndryshme të dhënies së pëlqimit nga ana e Kuvendit, për çështje të caktuara, varësisht nga lloji i veprimit ose vendimit që kërkohet të (ndër)merret nga të zgjedhurit e popullit. Për vendime të rëndësishme të lartë, siç është për shembull, shpërndarja e Kuvendit nga vet deputetët, është paraparë votimi me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Për amendamentimin e Kushtetutës është paraparë votimi përmes dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës. Për disa veprime ose vendime të tjera, mjafton shumica e thjeshtë e të gjithë deputetëve të Kuvendit, siç është për shembull, vendimi për t’ia dhënë ose për t’ia marrë besimin një Qeverie.
357. Lidhur me deputetët dhe mandatin e tyre, Gjykata veçse ka theksuar se sipas nenit 74 të Kushtetutës, *“deputetët janë të obliguar të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës”*. (Shih rastin KO98/11, parashtrues Qeveria e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, paragrafët 58 dhe 59). Se çka konsiderojnë deputetët se është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në aspekt politik dhe në aspekt të politikave publike, është tërësisht në dorën e deputetëve të Kuvendit. Përderisa respektohet Kushtetuta, çdo zgjidhje e të zgjedhurve dhe njëkohësisht

përfaqësuesve të popullit, duhet respektuar. Deputetët nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues. Mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm vetëm në situatat e përcaktuara në nenin 70.3 të Kushtetutës. Ndër to, si arsye për mbarimin e mandatit të deputetit parashihet edhe përfundimi i mandatit të Kuvendit. Përfundimi i mandatit të deputetit për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, si mënyrë e përfundimit të mandatit të Kuvendit, mund të bëhet vetëm në zbatim të drejtë të nenit 82 të Kushtetutës.

Presidenti në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

358. Presidenti, si kreu i shtetit, *inter alia*, përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. (Shih nenet 4 dhe 83 të Kushtetutës).
359. Presidenti ka një mori të kompetencave të cilat janë të përcaktuara specifikisht në Kushtetutë. Gjykata veçse ka theksuar se, përveç kompetencave të Presidentit të përcaktuara me nenin 84 të Kushtetutës, “*ekziston edhe një numër i madh referencash për Presidentin në Kushtetutë*” dhe se “*pushteti, funksionet, detyrat dhe kompetencat*” e Presidentit janë të përcaktuara edhe në nene të tjera të Kushtetutës, “*4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 93, 94, 95, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139, 144, 150 dhe 158.*” (Shih, rastin KO47/10, parashtrues Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i datës 28 shtator 2010, paragrafi 52).
360. Ndër kompetencat kryesore të Presidentit, që ndërliiden me rrethanat e rastit konkret, është kompetenca për t’i propozuar Kuvendit kandidatin për Kryeministër sipas procedurës së përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës dhe mundësia për të shpërndarë Kuvendin në rast të një mocioni të mosbesimit ndaj një Qeverie sipas nenit 82.2 të Kushtetutës (shih, nenet 82, 84, 95 të Kushtetutës). Në kuadër të ndërveprimit të institucioneve kushtetuese për qëllim të zbatimit të përgjegjësisë të tyre, gjithnjë duhet pasur parasysh edhe parimin themelor të ushtrimit të ndërvarur të kompetencave kushtetuese. Andaj, nga kjo pikënisje, jo të gjitha kompetencat e Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë janë kompetenca që ai mund t’i ushtrojë si aktor i vetëm vendimmarrës. Për ushtrimin e disa kompetencave ose autorizimeve kushtetuese, Presidenti varet edhe nga institucionet e tjera kushtetuese, në mënyrën e përcaktuar përmes Kushtetutës.
361. Për të tilla autorizime të ndërvarura kushtetuese, sikurse kompetenca e nenit 82.2 të Kushtetutës, nga Presidenti kërkohet që të veproj në bashkërendim me Kuvendin. Kësisoj, Presidenti ushtron në praktikë detyrimin e tij kushtetues për të përfaqësuar unitetin e popullit dhe

për të ndihmuar në sigurimin e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës.

362. Sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate: *“disa nga kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike të vendit.”* (Shih Aktgjykimin e Gjykatës KO103/14, paragrafi 62). Shembull konkret është paragrafi 2 i nenit 82 të Kushtetutës. Kompetencën që Kushtetuta ia jep Presidentit me këtë dispozitë specifike është kompetencë të cilën Presidenti nuk mund ta ushtrojë kundër vullnetit të Kuvendit. Bashkëpunimin ndërinstitucional në mes të Presidentit dhe Kuvendit për qëllime të përfundimit ose jo të mandatit të Kuvendit, Kushtetuta e ka paraparë si mekanizëm zhblllokues në kompetencë të Presidentit.
363. Duke pasur parasysh nenin 83 të Kushtetutës, sipas të cilit, Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit dhe kompetencat e konsiderueshme të dhëna Presidentit të Republikës në bazë të Kushtetutës, Gjykata edhe më parë ka theksuar se *“është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe “jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t’i përfaqësojë të gjithë.”* (Shih paragrafët 63 dhe 94 të Aktgjykimi KO103/14 dhe referencën e cituar aty). Respektimi i vullnetit të të zgjedhurve të popullit, në rrethanat e një situatë pas mocionit të mosbesimit, bëhet gjithashtu duke vepruar sipas vullnetit të shprehur të të zgjedhurve të popullit lidhur me përfundimin ose mospërfundimin e mandatit të Kuvendit.
364. Në këtë aspekt, Gjykata veçse e ka theksuar që çdo qytetar i Republikës *“ka të drejtë të sigurohet për paanshmërinë, për integritetin dhe për pavarësinë e Presidentit të tyre.”* Një gjë e tillë bëhet edhe më e rëndësishme në situatat kur *“Presidenti i Republikës ushtron kompetenca politike sikurse kur bën zgjedhjen ndërmjet kandidatëve konkurrentë nga koalicionet të mundshme për t’u bërë Kryeministër.”* Po aq e rëndësishme bëhet ushtrimi i kompetencës së Presidentit sipas së cilës ai mund të shpërndajë Kuvendin, i cili përbëhet nga të zgjedhurit e popullit me mandat kushtetues katër (4) vjeçar. Në lidhje me formimin Qeverisë, Gjykata po ashtu ka theksuar se detyra e Presidentit për të përfaqësuar shtetin dhe unitetin e popullit, nënkupton edhe *“përgjegjësi e Presidentit të ruaj stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet.”* (Shih paragrafët 63 dhe 94 të KO103/14 dhe referencën e cituar aty).

Parimet e përgjithshme sipas Komisionit të Venecias

365. Në vijim, Gjykata do të paraqesë përmbajtjen e gjashtë (6) Opinioneve të Komisionit të Venecias në të cilat janë analizuar në mënyrë specifike çështje që ndërlidhen me kompetencat e një Presidenti për të shpërndarë Kuvendin në një sistem demokratik parlamentar, presidencial ose semi-presidencial. Opinionet e tilla, Komisioni i Venecias i ka dhënë mbi bazën e kërkesave specifike të Azerbajxhanit (1 opinion), Rumanisë (1 opinion), Moldavisë (3 opinione), Gjeorgjisë (1 opinion) dhe Turqisë (1 opinion). Gjykata do të paraqesë në vijim pikat kryesore të këtyre Opinioneve, duke u fokusuar po ashtu edhe në rekomandimet përfundimtare të Komisionit të Venecias lidhur me çështjen në fjalë.

(a) *Opinionit i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2016)029*

366. Në këtë Opinion, Komisioni i Venecias analizoi draft-amandamentet e Kushtetutës së Azerbajxhanit. Në pjesën relevante ku diskutohej *“Fuqia e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin”*, Komisioni i Venecias, kishte konstatuar me sa vijon:

“59. Megjithatë, kjo fuqi [e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin] duhet të vlerësohet jo në abstrakt por në dritë të fuqive të tjera që Presidenti ka brenda një sistemi. Nëse një President shumë i fortë, në një regjim super-presidencial, ka një diskrecion të gjerë për të shpërndarë Kuvendin, një gjë e tillë mund të prishë balancën e pushteteve në mes të dy degëve. Për shembull, në periudhën kur Republika e Koresë ishte nën regjimin autoritar, Presidenti kishte fuqinë që të shpërndajë Kuvendin. Megjithatë, ajo fuqi e Presidentit ishte hequr pas tranzicionit në demokraci. Në kontekst të Azerbajxhanit, fuqia e jashtëzakonshme për shpërndarje të Kuvendit shton në kompetencat e tjera të grumbulluara në dorën e Presidentit, i cili veçse është shumë i fortë. Kjo dobëson edhe më tutje Kuvendin.” (Shih Opinioni CDL-AD(2016)029 e Komisionit të Venecias, të 18 tetorit 2016, për Azerbajxhanin lidhur me Draft-Amendamentimet e Kushtetutës të vendosura në Referendum më 26 shtator 2016, të miratuar në Seancën Plenare të 14-15 tetorit 2016, Pjesa C. Fuqia e Presidentit për të shpërbë Kuvendin, paragrafët 56-69, veçanërisht paragrafi 59).

367. Si rrjedhojë, në konkluzat e këtij Opinioni, *inter alia*, Komisioni i Venecias kishte arritur në përfundimin se: *“Fuqia e re e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin e bën kundërshtimin politik të Kuvendit skajshmërisht joefektiv.”* Në atë drejtim, *“Komisioni i Venecias ftoi autoritetet për të ndërmarrë një reformë kushtetuese e cila do të forconte dhe jo që do të dobësonte Kuvendin [...]”* (Shih Opinioni CDL-AD(2016)029, të cituar më lart, paragrafët 87-88).

(b) *Amicus Curiae Brief e Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2011)014*

368. Në këtë Opinion të karakterit “*Amicus Curiae Brief*”, Komisioni i Venecias vlerësoi dhe dha përgjigje për tri pyetje rreth nenit 78 të Kushtetutës së Republikës së Moldavisë, që kishin të bëjnë me shpërndarjet e përsëritura të Kuvendit si pasojë e mos-arritjes së zgjedhjes së Presidentit. Në pjesën relevante të këtij Opinioni, Komisioni i Venecias kishte konstatuar me sa vijon:

“Kushtetutat përgjithësisht parashohin disa ndalesa përkitazi me shpërndarjen e Kuvendit. Qëllimi i ndalesave të tilla është që të parandalojnë jostabilitetin politik dhe të luftojnë abuzime të ndërlidhura me shpërndarje të përsëritura. Kushtetuta e Moldavisë nuk përbën përjashtim nga ky rregull.” (Shih Opinioni CDL-AD(2011)014 për Republikën e Moldavisë lidhur me tri pyetje të ndërlidhura me nenin 78 të Kushtetutës, të Komisionit të Venecias të 4 korrikut 2011, miratuar në Venecia, në Seancën Plenare të 87-të, të mbajtur më 17-18 qershor 2011, paragrafi 23 dhe referenca në atë paragraf; shih po ashtu edhe dokumentin tjetër të cituar këtu nga Komisioni i Venecias, CDL-AD(2007)037add4 të përgatitur nga Sekretariati i Komisionit të Venecias, respektivisht dokumentin e ashtuquajtur “Shënim për Çështjen e Shpërndarjes së Kuvendit”, në të cilin, në mes tjerash, parashihi rastet specifike në të cilat Kuvendi nuk mund të shpërndahet.)

(c) *Opinionit i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2017)005*

369. Në këtë Opinion të Komisionit të Venecias vlerësoheshin disa amendamente të Kushtetutës së Republikës së Turqisë. Në këtë rast, Komisioni i Venecias kishte theksuar se edhe në republika presidenciale, *“fuqia për të shpërndarë një legjislaturë është shumë e rrallë, për arsye se një gjë e tillë do të minonte parimin e ndarjes së pushteteve në kuptimin klasik.”* Në shpjegimet rreth këtij konstatimi, Komisioni i Venecias kishte qartësuar se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si vend me sistem presidencial klasik, Presidenti nuk e ka fuqinë që të shpërndajë legjislaturën [Kongresin].
370. Komisioni i Venecias theksoi më tutje se me amendamentet kushtetuese në Turqi, Presidentit i ishte dhënë *“fuqia që të shpërndajë Kuvendin, mbi çfarëdo baze, që është fuqi simetrike me fuqinë e Kuvendit për të shpërnda vetveten mbi çfarëdo baze me 3/5 e votave”*; si dhe se me këto amendamente kushtetuese *“Presidenti është i lirë të vendosë se*

nëse dhe kur të shpërndajë Kuvendin, gjë që pa asnjë dyshim përbën mënyrë për t'i bërë presion Kuvendit.”

371. Për rrjedhojë, në konkluzë, Komisioni i Venecias potencoi se amendamentimet e Kushtetutës përmes së cilave Presidentit i lejohej të shpërndajë Kuvendin ngritin shqetësim të veçantë në aspekt të ndarjes së pushteteve për arsye se *“Presidentit do ti jepej fuqia për të shpërndarë Kuvendin mbi çfarëdo baze, gjë e cila është krejtësisht e huaj/panjohur në sistemet demokratike parlamentare [...]”* (Shih Opinionin CDL-AD(2017)005 e Komisionit të Venecias për Turqinë lidhur me amendamentimet e Kushtetutës të miratuara nga Kuvendi më 21 janar 2017 dhe të vendosura në Referendum Kombëtar më 16 prill 2017, të 13 marsit 2017, miratuar në Venedik në Seancën Plenare të 110-të, të mbajtur më 10-11 Mars 2017, Pjesa e. Fuqia për të Shpërbë Kuvendin, paragrafët 84-88 dhe paragrafi 127 i Konkluzave të këtij Opinionit, dhe referencat e cituara në këtë Opinion; shih në këtë aspekt edhe Opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2019)022 për Perunë rreth lidhjes së amendamenteve kushtetuese me pyetjen e besimit, të 14 tetorit 2019, miratuar në Venedik në Seancën Plenare të 120-të, më 11-12 tetor 2019, paragrafi 42).

(d) Opinioni i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2012)026

372. Në këtë Opinion, Komisioni i Venecias, në pjesën ku theksohej nevoja për bashkëpunim ndër-institucional në mes të institucioneve publike shtetërore në Rumani, specifikisht kishte theksuar me sa vijon:

“Komisioni [i Venecias] është i opinionit se respekti për Kushtetutën nuk mund të kufizohet vetëm në zbatimin literal të dispozitave operative. Vet natyra e Kushtetutës është që, përveç garantimit të të drejtave të njeriut, të sigurojë një kornizë për institucionet shtetërore ku përcaktohen fuqitë dhe obligimet e tyre. Qëllimi i këtyre dispozitave është që të mundësojnë një funksionim të lehtë të institucioneve të bazuar në bashkëpunim besnik në mes tyre. Presidenti, Kuvendi, Qeveria, Gjyqësori, të gjithë i shërbejnë qëllimit të përbashkët për përparim të interesave të shtetit si tërësi, dhe jo interesave të ngushta të secilit institucion ose të partisë politike e cila ka nominuar mbajtësin e zyrës në fjalë. Edhe nëse një institucion gjendet në situatë të pushtetit, që ia mundëson të influencojë institucionet e tjera shtetërore, duhet ta bëjë një gjë të tillë duke pasur në mendje interesat e Shtetit në tërësi, dhe si rrjedhojë, edhe interesat e institucioneve të tjera përfshi ato të pakicave parlamentare.”

373. Në fund, Komisioni i Venecias po ashtu theksoi se *“institucionet shtetërore të Rumanisë do të duhej të përfshiheshin në bashkëpunim*

besnik në mes vete dhe se është i kënaqur për deklaratat nga të dyja palët që shprehin synimin për të respektuar obligimet e tyre.” (Shih Opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2012)026 për Rumaninë në lidhje me përputhshmërinë e parimeve kushtetuese dhe sundimin e ligjit të veprimeve të ndërmarra nga Qeveria dhe Kuvendi përkitazi me institucionet e tjera, të 17 dhjetorit 2012, paragrafët 87-88).

(e) Opinioni i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2012)026 – Moldavia 2017

374. Në këtë Opinion, Komisioni i Venecias u përgjigj pas kërkesës së Presidentit të Republikës së Moldavisë për një opinion lidhur me propozimin për të shtuar disa kompetenca shtesë të Presidentit për shpërndarje të Kuvendit. Komisioni i Venecias e kishte vlerësuar si jo të këshillueshme shtimin e kompetencave shtesë për Presidentin për shpërndarje jo-diskrecionale të Kuvendit. Në vijim, Gjykata do t'i citojë saktësisht të gjitha pjesët relevante të këtij Opinioni ku reflektohet mospajtimi i Komisionit të Venecias për shtim të kompetencave shtesë për Presidentin sa i përket shpërndarjes së Kuvendit:

“20. Në pjesën më të madhe të regjimeve parlamentare, Kreu i Shtetit luan një rol të arbitrit, ose pouvoir neutre, të shkëputur nga politika partiake. Këto nuk janë fjalë boshe: përderisa askush nuk mund të pengojë që kreu i Shtetit të ketë pikëpamjet dhe simpatitë e tij politike, mandati i tij ose saj është i kufizuar. Funksionet kryesore të Shefit të Shtetit brenda këtij modeli janë të përfaqësojë marrëdhëniet e jashtme të Shtetit, të marrë pjesë në emërimin e disa zyrtarëve kryesorë shtetërorë, të garantojë funksionimin e institucioneve shtetërore, por jo të përcaktojë drejtimin aktual politik të vendit - ky është roli i Kuvendit dhe i ekzekutivit. Presidenti është një element i rëndësishëm i sistemit politik, por nuk është partizan. Kompetencat e Presidentit për shpërndarje [të Kuvendit] gjatë një periudhe parlamentare përcaktohen nga qëndrimi neutral i Presidentit: në kohëra të krizës institucionale Kryeministri merr përsipër funksionin e rëndësishëm të shpërndarjes së Parlamentit me qëllim që të kapërcehet ngërçi duke u bërë thirrje njerëzve dhe që të rikthehet funksionimi i qetë i makinerisë kushtetuese.

21. Shpërndarja e Kuvendit mund të gjendet pothuajse në të gjitha kushtetutat parlamentare Evropiane. Modelet konkrete kushtetuese, megjithëse, ndryshojnë në varësi se kush është bartësi i kompetencës për shpërndarje (Kreu i Shtetit [Presidenti], kreu i Qeverisë, vetë Kuvendi, populli, etj.) dhe sa diskrecion i është dhënë këtij bartësi. Nga pikëpamja e teknikës legjislativë, ekzistojnë dy mundësi:

Kushtetuta mund të përmbajë ose një klauzolë të përgjithshme shpërndarjeje (për shembull, neni 88 i Kushtetutës së Italisë) ose një listë të rasteve specifike (që arrijnë masën e një krize në funksionimin e institucioneve demokratike) në të cilat shpërndarja është e mundur me qëllim të parandalimit të ngërçit politik: mungesën e zgjatur të një Qeverie, mosmiratimin e një buxheti, mungesën e zgjatur të kuorumit në Kuvend, etj. [...]

23. Për dallim, në bazë të paragrafit të ri 2 (2) pika (a) e nenit 85, Presidenti i Republikës së Moldavisë do të ishte i autorizuar ta shpërndajë Parlamentin “pas konsultimeve të fraksioneve parlamentare”. Kjo dispozitë kësisoj do t'i jepte Presidentit, përveç kompetencave specifike ekzistuese të shpërndarjes, një kompetencë të përgjithshme shpërndarjeje, të kufizuar vetëm nga detyrimi procedural për t'u konsultuar me fraksionet parlamentare.

24. Propozimi i Presidentit kësisoj kombinon dy teknika legislative të cilat përndryshe nuk përdoren kurrë në mënyrë kumulative, ato të kompetencës diskrecionale të shpërndarjes (paragrafi i ri 2-1 pika (a)) dhe e drejta për shpërndarje në raste specifike (neni ekzistues 85 i Kushtetutës dhe pikat pasuese të propozuara të paragrafit të ri 2-1, plus neni i ri 85-1). Dispozita që i jep Presidentit një kompetencë diskrecionale të shpërndarjes i bën arsyet e tjera të listuara në propozim plotësisht të panevojshme. Madje, mund të nënkuptohet se kompetenca e përgjithshme e shpërbërjes nuk është e lidhur me kohën e krizës institucionale (të cilat përfshihen në rastet specifike të shpërbërjes), por shton mundësinë e Presidentit që të shpërndajë Parlamentin për arsye thjesht politike, për shembull nëse ai/ajo nuk pajtohet me një zgjedhje politike të bërë nga Parlamenti dhe dëshiron zgjedhje të reja. Një interpretim i tillë i kompetencës së Presidentit për shpërndarjen e Parlamentit e ndryshon rolin neutral të Presidentit dhe e shndërron atë në një lojtar politik. Kjo nuk është në përputhje me logjikën e një regjimi parlamentar.

25. Edhe jashtë rastit të kombinimit të klauzolës së përgjithshme dhe rasteve specifike të shpërndarjes, Komisioni i Venecias është i mendimit që kompetencat diskrecionale të shpërndarjes në duart e Kreut të Shtetit mund të jenë të rrezikshme në vendet të cilave u mungon një traditë e vendosur demokratike dhe nuk kanë qenë pjesë e rendit juridik tradicional (siç është rasti në disa monarki kushtetuese si Lihtenshtajni, Luksemburgu, Monako ose Holanda) dhe ku nuk u nënshtrohet kufizimeve të caktuara (siç është rasti në Danimarkë ose Irlandë), saktësisht sepse rrezikon të interpretohet si një mjet i politikës së partisë. Komisioni i Venecias ka shprehur kritikë për kompetencat e gjera diskrecionale të shpërndarjes, madje

edhe në lidhje me një regjim gjysmë-presidencial: “pasi që deputetët e Rada Verkhovna [Kuvendi në Rumani] marrin mandatin e tyre drejtpërdrejtë nga votuesit për një periudhë të caktuar kohe, dhe duhet të ketë arsye bindëse për një përfundim para afatit. Neni i sugjeruar 95 (1) [i cili ishte i ngjashëm me projekt-nenin 85 paragrafi 2 (a)] do të çonte në shpërndarje gjithashtu edhe në situatat kur shpërndarja mund të shmangej.

26. Në lidhje me argumentin që mandati popullor kërkon domosdoshmërisht kompetenca më të gjera për shpërndarje, Komisioni i Venecias vëren se zgjedhja e Presidentit me votim popullor nuk kërkon shndërrimin e Presidentit në një kundërshtar politik të Parlamentit. Është e vërtetë që zgjedhja me votim popullor ka tendencë të përmirësojë pozicionin e Presidentit, por ka shembuj të shumtë të regjimeve kushtetuese ku një President i zgjedhur me votim popullor ende e luan rolin e një *pouvoir neutre* dhe nuk gëzon kompetenca të gjera, dhe, ku kontrolli dhe balancimet e nevojshme sigurohen nga parlamentarizmi. Këto përfshijnë për shembull Austrinë, Irlandën apo Finlandën. (Referenca për shembullin francez në shënimin e informacionit 15 është udhëzim i gabuar: presidenti Francez me të vërtetë gëzon kompetenca diskrecionale të shpërndarjes, por sistemi Francez është gjysmë-presidencial dhe jo parlamentar.)

27. Edhe më relevante në kontekstin e Republikës së Moldavisë janë ato demokraci të reja parlamentare të cilat kohët e fundit janë anëtarësuar në BE dhe kanë një President të zgjedhur drejtpërdrejt me prerogativa të kufizuara ekzekutive dhe disa shtesë në momentet e një krize parlamentare, përkatësisht Bullgaria, Republika e Çekisë, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia. Në të gjitha vendet e mësipërme, kompetencat e shpërndarjes [të Kuvendit] të Presidentit janë të kufizuara në një numër situatash specifike dhe kështu nuk janë diskrecionale, por gjysmë-automatike. Të gjitha kushtetutat e mësipërme kanë një listë të mbyllur të situatave specifike për shpërndarjen; këto situata kanë të bëjnë me pamundësinë e Parlamentit për të formuar një qeveri, me një votë mosbesimi në Qeveri (ose me mos zbatimin e një ligji të cilit Qeveria i bashkëngjiti besimin ose një programi të Qeverisë), ose me pamundësinë e Parlamentit për të ushtruar funksionet ligj-bërëse (mungesa e kuorumit, shtyrjet e gjata, dështimi për të miratuar buxhetin). Shihni, në veçanti Kushtetutën e Bullgarisë, neni 99; Kushtetutën e Republikës Çeke, neni 35, par. 1; Kushtetutën e Lituaniës, neni 58; Kushtetutën e Polonisë, neni 98, par. 4, neni 155, par. 2; Kushtetutën e Rumanisë, neni 89; Kushtetutën e Sllovakisë, neni 102 dhe neni 106 (kjo e fundit ka të bëjë me dështimin për

tërheqjen e Presidentit në plebishit - mbi këtë shih më poshtë); Kushtetutën e Sllovenisë, neni 111 dhe 117. Ky është një model kushtetues që është miratuar gjithnjë e më shumë (nga katër të parat, dhe tani nga shtatë në total) të vendeve që në çerekun e kaluar të një shekulli kishin [ri]-vendosur qeveritë demokratike, e cila jep baza shtesë për ta konsideruar atë një praktikë të rekomandueshme. Si përmbledhje, vetëm mandati popullor nuk e shndërron një Udhëheqës të Shtetit në drejtues të ekzekutivit dhe nuk kërkon që atij t'i akordohen kompetenca diskrecionale të shpërndarjes.

28. Si përmbledhje, Komisioni i Venecias është i mendimit se shtimi i një kompetence të gjerë diskrecionale të Presidentit për shpërndajen e Parlamentit (neni 85, paragrafi i ri 2-1 pika (a)) është jo e arsyeshme dhe duhet të rishqyrtohet. Kompetenca e propozuar diskrecionale e shpërndarjes kërcënon të vendos Parlamentin dhe Presidentin kundër njëri-tjetrit dhe të provokojë konflikte të panevojshme kushtetuese dhe politike.”

(f) Opinioni i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2019)012 - Moldavia 2019

375. Në Opinionin tjetër të vitit 2019 për Republikën e Moldavisë, Komisioni i Venecias kishte analizuar nenin 85.1 të Kushtetutës së Moldavisë rreth mundësisë së Presidentit për të shpërndarë Kuvendin dhe konsultimet para shpërndarjes. Dispozita në fjalë përmbante foljen “**mund**” apo në gjuhën angleze “**may**” dhe lidhur me këtë aspekt Komisioni i Venecias kishte theksuar me sa vijon:

“Kjo dispozitë parasheh shprehimisht që Presidenti “mund” [“may” në gjuhën angleze] të shpërndajë Kuvendin, dhe jo që do ta bëjë atë [and not that it “shall” do so]. [...] Në çdo rast, gjuha e përdorur në nenin 85.1 nënkupton një prag të lartë për shpërndarjen e Kuvendit. Për më tepër, neni 85.1 gjithashtu kërkon që fraksionet parlamentare duhet të konsultohen para shpërndarjes, gjë e cila qartazi nënkupton se shpërndarja është një fuqi diskrecionale për Presidentin. (Shih Opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2019)012 për Republikën e Moldavisë lidhur me Situatën Kushtetuese me Referencë të Veçantë në Mundësinë e Presidentit për të Shpërbë Kuvendin, të 24 qershorit 2019, miratuar në Venedik në Seancën Plenare të 119-të, Pjesa B. Konsultimet para shpërbërjes së Kuvendit nga ana e Presidentit, paragrafët 37-43).

376. Më tutje, në po të njëjtin Opinion, Komisioni i Venecias theksoi me sa vijon:

“40. Megjithatë, ai rast, që ndryshon nga situata e tanishme, kishte të bënte me formimin e një qeverie të re pas një votimi të mosbesimit. Duhet të theksohet gjithashtu se Gjykata [Kushtetuese] e lidhi të drejtën e shpërndarjes me detyrën e Presidentit “të ndihmojë në kapërcimin e krizës politike dhe konfliktit midis pushteteve dhe të mos përjetësojë krizën për një periudhë të pacaktuar, që nuk do të ishte në interes të përgjithshëm të qytetarëve, bartësve të sovranitetit kombëtar”. Për më tepër, Gjykata e lidhi të drejtën për të siguruar funksionimin e organeve kushtetuese dhe shmangien e pengimit të veprimtarisë së njërit prej pushteteve shtetërore. Nga vendimi i vitit 2013, është e qartë se shpërbërja e Parlamentit është zgjidhja e fundit në rast se përpjekjet e përsëritura për të formuar një qeveri kanë dështuar. Gjykata Kushtetuese kufizoi detyrimin e Presidentit për shpërndarjen e parlamentit në dështimin e përsëritur të formimit të qeverisë në fazën e veshjes me pushtet të formimit të qeverisë, dhe jo në fazën paraprirëse të negociatave, si në rastin aktual. Kjo qasje është logjike: nëse nuk është bërë më shumë se një votim zyrtar i besimit në Parlament, nuk ka asnjë mënyrë të vendoset në mënyrë objektive nëse është apo jo e pamundur të formosh një qeveri. Sa i përket fazës së negociatave që i paraprijnë veshjes me pushtet, Gjykata Kushtetuese në par. 73 theksoi se neni 85 ka funksionin e një mekanizmi balancues për të shmangur ose kapërcyer një krizë institucionale. Ky qëllim i nenit 85 shpjegon se pse kompetencat e Presidentit për shpërndarjen e Parlamentit janë diskrecionale pasi që ky diskrecion ka për qëllim të parandalojë bllokimin dhe të parandalojë krizën institucionale me anë të negociatave politike.

377. Gjithashtu, Komisioni i Venecias theksoi edhe me sa vijon:

“41. Nga ana tjetër, për sa i përket formulimit të nenit 85 § që Presidenti “mund” dhe “do të” shpërndajë parlamentin, Komisioni thekson se dallimi midis “mund” dhe “do të” është i mirë-themeluar në ligj dhe pa dyshim synon t’i sigurojë Presidentit një liri veprimi për të ushtruar gjykimin dhe diskrecionin e tij, duke marrë parasysh rrethanat e një situatë të veçantë në interes të vendit në tërësi. Është e qartë që shpërndarja e Parlamentit, të zgjedhur në zgjedhje të drejta dhe të lira në shprehje të vullnetit të popullit, nuk është diçka që duhet të trajtohet në një mënyrë aritmetike, por në përputhje me frymën dhe formulimin e Kushtetutës që i siguron Kreut të Shtetit diskrecionin e nevojshëm për të ushtruar gjykim të mirë dhe të mençur. Prandaj, në dritën e qëllimit të nenit 85 të Kushtetutës, detyra e Presidentit që të ketë konsultime me fraksionet parlamentare duhet të shihet si një mjet për të shteruar të gjitha mundësitë për të formuar Qeverinë ose për të zhblokuar procedurën

e miratimit të ligjeve pas skadimit të afatit prej 3 muajsh, para se të vendosë mbi shpërndarjen e Parlamentit.”

378. Në fund të analizës së këtij Opinioni, Komisioni i Venecias theksoi me sa vijon:

“42. E drejta e shpërndarjes është një mjet ratio ultima për të zgjidhur një krizë kushtetuese, të shkaktuar nga pamundësia e formimit të një qeverie ose bllokimi i legjislacionit. Nëse nuk ekziston asnjë mjet tjetër, shpërndarja e Parlamentit madje mund të konsiderohet një detyrim kushtetues i Presidentit. Nga ana tjetër, nëse ekzistojnë mënyra të tjera, nëse, për shembull, partitë që përfaqësojnë një shumicë parlamentare janë pajtuar për formimin e qeverisë, asnjë detyrim i tillë nuk mund të ekzistojë. Shpërndarja e Parlamentit në një situatë të tillë dhe thellimi i krizës kushtetuese apo edhe krijimi i një krize të re, madje mund të konsiderohet shkelje e detyrave kushtetuese të Presidentit si një pouvoir neutre. Siç kanë treguar ngjarjet pasuese, në rastin konkret, shpërndarja e Parlamentit nga Presidenti do të kishte kundërshtuar arsyen e nenit 85 (1), siç ishte përmbledhur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2013.”

379. Në përfundimet përmbyllëse të këtij Opinioni, Komisioni i Venecias përfundoi, *inter alia*, se:

“51. Komisioni i Venecias thekson se një rol thelbësor i Gjykatës Kushtetuese është të ruajë distancën e barabartë nga të gjitha degët e pushtetit dhe të veprojë si një arbitër i paanshëm në rast të përplasjes midis tyre. Një nga qëllimet e çdo Kushtetute është të ruajë rendin kushtetues dhe një nga funksionet kryesore të çdo Gjykate Kushtetuese është, që duke i mbështetur parimet e Ligjit, të ruaj funksionimin e sistemit kushtetues. Ky funksion i arbitrimit sipas definicionit presupozon paanshmërinë dhe ekonomicitetin dhe kërkon respektimin e zgjidhjeve të arritura nga institucionet legjitime demokratike.

54. Shpërndarja e parlamentit të zgjedhur në zgjedhje të drejta dhe të lira në shprehje të vullnetit të popullit është një masë e fundit e zgjidhjes e cila mund të mos jetë e lehtë për t'u trajtuar por bëhet vetëm në përputhje me frymën dhe formulimin e Kushtetutës. Kushtetuta e Republikës së Moldavisë i siguron Kreut të Shtetit, ashtu si çdo kushtetutë, diskrecionin e nevojshëm për të ushtruar gjykimin e tij të mirë dhe të mençur për shpërndarjen e parlamentit pas konsultimit me fraksionet parlamentare. Kushtet për shpërbërjen e parlamentit qartazi nuk ekzistonin më 7 ose 8 qershor.”

Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

380. Fillimisht, Gjykata rikujton nenin 82 të Kushtetutës, kuptimin e të cilit, përkritazi me kompetencën e Presidentit për shpërndarje të Kuvendit, do ta interpretojë në vijim:

Neni 82

[Shpërndarja e Kuvendit]

1. *Kuvendi shpërndahet në këto raste:*
 - a. *nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;*
 - b. *nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;*
 - c. *nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.*
 2. *Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.*
381. Paragrafi 1 i nenit 82 të Kushtetutës paraqet tri situata specifike, të parapara në pikat (1), (2) dhe (3), kur Kuvendi shpërndahet detyrimisht. Situata e parë është kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Qeverinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e caktimit të mandatarit nga ana e Presidentit. Nëse një situatë e tillë ndodhë, Kuvendi detyrimisht shpërndahet.
382. Situata e dytë është kur të zgjedhurit e popullit vendosin vet, duke votuar me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve, që Kuvendi të shpërndahet. Gjykata rikujton që votimi me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, përpos kërkesës për amendamentim të Kushtetutës që kërkon edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, është pragu më i lartë i nevojshëm për një votim të suksesshëm në Kuvend i përcaktuar me Kushtetutë, vetëm për vendime të rëndësishme të madhe, ndër të tjera, i barabartë edhe me numrin e deputetëve të nevojshëm për dhënien e pëlqimit për bartje të sovranitetit (shih nenin 20.2 të Kushtetutës). Numri i votave të kërkuara për shpërndarje të Kuvendit, nga vet të zgjedhurit e popullit, reflekton peshën e vendimit përkatës. Pas një votimi të tillë, Kuvendi detyrimisht shpërndahet. Dekreti i Presidentit vetëm vulos, në aspekt

formal, vullnetin e dy të tretave (2/3) të Kuvendit. (Shih neni 82.1 (2) i Kushtetutës).

383. Situata e tretë është kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes. Nëse një situatë e tillë ndodhë, Kuvendi detyrimisht shpërndahet. (Shih neni 82.1 (3) i Kushtetutës).

384. E përbashkëta e situatës së parë dhe të tretë, të qartësuara më lart, është pamundësia e Kuvendit që të kryej detyrimet kushtetuese për formim të Qeverisë ose për zgjedhjen e Presidentit. Në këtë aspekt, Kushtetuta parasheh që nëse Kuvendi nuk arrin të kryej detyrimet e rëndësishme kushtetuese për të formuar Qeverinë dhe për të zgjedhur Presidentin e Republikës – atëherë Kuvendi duhet të shpërndahet me qëllim të krijimit të një Kuvendi të ri që do të mund t'i kryej këto detyra të rëndësishme kushtetuese, pas zgjedhjeve të reja dhe të parakohshme.

385. Situata e dytë e theksuar më sipër, për dallim nga situata e parë dhe e tretë, paraqet autorizimin që Kushtetuta ua jep vet të zgjedhurve të popullit që me vullnetin e tyre të deklaruar përmes votës të shpërndajnë Kuvendin. Arsyeja apo arsyet për shpërndarje të Kuvendit mbi këtë bazë janë tërësisht në vullnetin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, të cilët vendosin se *kur* dhe *përse* do të shpërndajnë Kuvendin me votën e tyre dhe rrjedhimisht *kur* dhe *përse* duan ta shkurtojnë vet mandatin e tyre.

386. E përbashkëta përfundimtare e të tri situatave të lartcekura është se që të tri situatat çojnë në shpërndarje të detyrueshme të Kuvendit dhe në zgjedhje të reja, që do të rezultonte në një Kuvendi të ri dhe me të zgjedhur të rinj të popullit të Republikës.

387. Në anën tjetër, dhe për dallim, paragrafi 2 i nenit 82 të Kushtetutës, qartazi dhe qëllimshëm i ndarë nga paragrafi 1 i nenit 82 të Kushtetutës, paraqet situatën kur Kuvendi mund të shpërndahet nga ana e Presidentit të Republikës, por jo detyrimisht. Ky nen parasheh mundësinë që Presidenti të shpërndajë Kuvendin, por në asnjë mënyrë detyrimin për Presidentin që një veprim të tillë ta ndërmarrë një vullnetshëm dhe duke shpërfillur vullnetin e deklaruar të deputetëve të Kuvendit. Në fakt, kjo kompetencë e Presidentit është ngushtësisht e lidhur me faktin se a ka vullnet të legjislaturës e cila ka rrëzuar një Qeveri me mocion mosbesimi që të vazhdojë tutje me zgjedhjen e një Qeverie të re. Nëse ka vullnet dhe nëse një vullnet i tillë është shprehur, Presidenti nuk mund ta shpërndaj Kuvendin. Një shpërndarje e tillë e Kuvendit, në kundërshtim me vullnetin e

shprehur deklarativisht të përfaqësuesve të popullit, do të ishte ndërhyrje arbitrare e Presidentit në pushtetin legjislativ.

388. Një Qeveri e votuar dhe legjitimuar me besim qeverisës nga Kuvendi e humb besimin e këtij të fundit, si rezultat i shprehjes së mosbesimit përmes votës në Kuvend, sipas nenit 100 të Kushtetutës. Për miratimin e mosbesimit ndaj një Qeverie, mjaftojnë gjashtëdhjetë e një (61) vota të përfaqësuesve të popullit, aq sa mjaftojnë edhe për t'i dhënë besimin e Kuvendit një Qeverie për tu konsideruar e zgjedhur. Sikurse edhe në sistemet e tjera me karakteristika parlamentare, edhe në Republikën e Kosovës, siç është reflektuar në Analizën Krahimore, përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias dhe në raportet e Komisionit të Venecias që kanë shqyrtuar këtë çështje në shtete të ndryshme (shih paragrafët 274-306 dhe 365-379 të këtij Aktgjykimi), është Kuvendi ai që ia jep besimin një Qeverie dhe po ai që ia merr. Kuvendi është po ashtu i autorizuar që, edhe brenda një legjislature të njëjtë, të ndryshojë mendje përmes mekanizmit të mocionit të mosbesimit dhe të zgjedh një Qeveri tjetër duke ia përfunduar mandatin një Qeverie ekzistuese, bazuar në mandatin e lirë të të zgjedhurve të popullit. Një gjë e tillë, pavarësisht se nuk ndodh shpesh as në sistemet tjera parlamentare e as në atë të Republikës së Kosovës, është krejtësisht brenda normës kushtetuese që një situatë e tillë të ndodhë në një demokraci parlamentare, ku votat e të zgjedhurve të popullit në Kuvend determinojnë rrugëtimin dhe kohëzgjatjen e një Qeverie dhe besimin që të zgjedhurit e popullit kanë në atë Qeveri.
389. Gjykata vlerëson se pikëpamja dhe pretendimi që ushtrimi i të drejtës së Kuvendit për votimin e mocionit të mosbesimit ndaj një Qeverie, si vullnet për të krijuar një shumicë të re qeverisëse, rezulton në shkurtimin automatik të mandatit kushtetues të vetë Kuvendit, bie në kundërshtim me parimet dhe frymën e sistemit parlamentar të qeverisjes. Kjo do të nënkuptonte që Kuvendi, me rastin e votimit të mocionit të mosbesimit ndaj një Qeverie, efektivisht shpërndanë edhe vetë Kuvendin. Sikur të ishte kështu dhe sikur kjo të ishte zgjedhja që parasheh Kushtetuta, paragrafi 2 i nenit 82 do të ishte i pakuptimtë dhe pa asnjë efekt kushtetues. Në këtë rast, sikur kjo të ishte zgjedhja që parasheh Kushtetuta, pika (2) e paragrafit 1 të nenit 82 sipas të cilit deputetët mund të shpërndajnë Kuvendin nuk do të kishte kuptim, ngase përkundër vullnetit të tyre, Presidenti do të mund ta shpërndante Kuvendin pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit. Efektivisht, Presidenti, pas çdo mocioni të mosbesimit, do të kishte fuqinë e barabartë me dy të tretat (2/3) e votave të përfaqësuesve të popullit. Për më tepër, shpërndarja e detyrueshme e Kuvendit nga Presidenti pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit për të cilin

mjaftojnë gjashtëdhjetë e një (61) vota bazuar në paragrafin 4 të nenit 100 të Kushtetutës, do të zbriste numrin e votave të nevojshme të deputetëve nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve për të shpërndarë Kuvendin, në vetëm gjysmën e deputetëve të Kuvendit, në kundërshtim me pikën (2) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës. Një pretendim e interpretim i tillë është i paqëndrueshëm.

390. Gjykata thekson se në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, Presidenti nuk ka ingerenca kushtetuese që të shpërndajë organin më të lartë legjislativ në vend dhe, rrjedhimisht, pushtetin nga i cili buron vullneti i popullit. Presidenti, as pas një mocioni mosbesimi, nuk është i pajisur me autoritetin apo fuqinë që të shkurtojë mandatin e Kuvendit, pa pajtimin e shumicës së nevojshme të partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend dhe shterimit të mundësisë për të zgjedhur një qeveri të re. Përkundrazi, Presidenti duhet të respektojë vullnetin e tyre për vazhdimin e mandatit kushtetues të Kuvendit edhe pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi në rast se zgjedhja e një Qeverie të re është e mundshme, ku dështimi i votimit të suksesshëm të së cilës bazuar në nenin 95 të Kushtetutës, rezulton në shpërndarje të detyrueshme të Kuvendit sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 95 dhe pikës 1 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës.
391. Siç tregojnë edhe Opinionet e Komisionit të Venecias, por edhe përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias (shih paragrafët 291-306 dhe 365-379 të këtij Aktgjykimi), Presidentët në sistemet parlamentare, por as në ato presidenciale ose semi-presidenciale, nuk janë të pajisur me fuqinë automatike që t'ia shkurtojnë mandatin një Kuvendi legjitim dhe të zgjedhur nga populli, në asnjë rast, e as pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit, pa konsultimin dhe pajtueshmërinë e partive e koalicioneve të përfaqësuara në Kuvendet përkatëse. Madje, një fuqi e tillë për Presidentin konsiderohet si fuqi që dobëson, kushtëzon dhe e vendos në presion të padëshirueshëm Kuvendin. Në të gjitha rastet kur të tilla kompetenca për shpërndarje të Kuvendit është tentuar tu jepen Presidentëve të vendeve të ndryshme përmes amendamenteve kushtetuese, Komisioni i Venecias i ka konsideruar zgjedhjet e tilla *“jo të këshillueshme.”*
392. Gjykata rikujton se ajo çfarë parashtruesit e kërkesës pretendojnë është se Kushtetuta e ka mveshur Presidentin me kompetencë, respektivisht detyrim për të shpërndarë Kuvendin pas çdo mocioni të suksesshëm të mosbesimit ndaj një Qeverie. Një obligim të tillë, sipas parashtruesve të kërkesës, Presidenti duhet ta kryej përkundër faktit që shumica e deputetëve të Kuvendit kanë shprehur vullnetin e tyre

për të vazhduar legjislaturën ekzistuese dhe për të zgjedhur një Qeveri të re. Një obligim të tillë, sipas parashtresve të kërkesës, Presidenti duhet ta kryej përkundër faktit që legjislatura e tanishme është në vitin e saj të parë dhe përkundër faktit se mandati i rregullt i Kuvendit përfundon në vitin 2023.

393. Pretendimi i parashtresve të kërkesës se në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, Presidenti ka rol *“ceremonial”* dhe rol të një *“noteri publik”*, shkon në kundërshtim me pretendimin e tyre kyç se Presidenti në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës ka të drejtë ta shpërndajë Kuvendin, përkundër vullnetit të shprehur të deputetëve të Kuvendit. Një President i cili ka fuqi kushtetuese të shpërbëjë Kuvendin, përkundër vullnetit të Kuvendit, është një President shumë i fortë. Siç shihet nga Analiza Krahimore, kontributi i Forumit të Komisionit të Venecias dhe Opinionet e lartcituarra të Komisionit të Venecias, në shtetet demokratike me sisteme parlamentare, Presidenti nuk është i mveshur me këtë pushtet. Karakteristika të tilla të fuqisë presidenciale gjenden rrallë edhe në sistemet më klasike presidenciale të shteteve demokratike. Siç vë theks vet Komisioni i Venecias në Opinionin e lartcituar, edhe Republika e Koresë e kishte hequr nga Kushtetuta këtë kompetencë të Presidentit, pasi e njëjta kishte kaluar nga regjimi autoritar në demokraci.
394. Republika e Kosovës, si një shtet me demokraci kushtetuese dhe parlamentare nuk e ka fuqizuar Presidentin me të tilla kompetenca për shpërndarje automatike të Kuvendit në rast të mocionit të mosbesimit ndaj një Qeverie. Përkundrazi, Republika e Kosovës e ka fuqizuar Kuvendin si ushtrues i sovranitetit që buron nga populli, i cili thotë fjalën e fundit për çështje që ndërlidhen me shpërndarjen e Kuvendit pas një mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë. Presidenti, rrjedhimisht, mund ta ushtrojë të drejtën e shpërndarjes së Kuvendit pas një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë, vetëm bazuar në vullnetin e partive apo koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend dhe pasi të ketë vepruar në bashkërendim me vullnetin e shprehur të tyre lidhur me qëllimin për formimin e një Qeverie të re apo shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve.
395. Sipas kësaj Gjykate, do të ishte në kundërshtim të plotë me Kushtetutën sikurse Presidenti të vendoste vetë që, bazuar në nenin 82.2 të Kushtetutës, të shpërndajë Kuvendin përkundër vullnetit të Kuvendit. Kushtetuta qartazi nuk e parasheh një kompetencë të tillë për Presidentin. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret janë dy të tretat (2/3) e deputetëve të Kuvendit që kanë votuar mocionin e mosbesimit. Të njëjtit nuk kanë nevojë për ndihmën e Presidenti për

të shpërndarë Kuvendin. Bazuar në pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, ata mund të shpërndajnë vet Kuvendin.

396. Për më tepër, Gjykata konsideron se neni 82.2 ka një logjikë të qartë kushtetuese. Si lloj i kompetencës me karakter zhbllokues parashihet edhe në vende të tjera demokratike me sistem parlamentar. Ky nen është i nevojshëm për të zhbllokuar ngërçet dhe krizat e mundshme politike, në rastet kur pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit të votuar nga së paku gjashtëdhjetë e një (61) vota, aq sa janë të nevojshme për kalimin e suksesshëm të mocionit të mosbesimit bazuar në paragrafin 4 të nenit 100 të Kushtetutës Kuvendi nuk ka shumicë të mjaftueshme për të votuar një Qeveri të re, por po ashtu nuk ka as tetëdhjetë (80) vota, përkatësisht dy të tretat (2/3), aq sa janë të nevojshme që Kuvendi të shpërndajë vetveten bazuar në pikën (2) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës. Pra, ky nen mbulon rrethanat kur Kuvendi nuk mund të zbatojë nenin 82.1 (2) për tu vet-shpërndarë ngase nuk i ka dy të tretat (2/3) e votave të nevojshme për këtë qëllim; por as nuk i ka gjashtëdhjetë e një (61) vota, të nevojshme për të krijuar një Qeveri të re. Ky nen, në njërin anë paraqet një shans shtesë për të formuar Qeveri brenda legjislaturës ekzistuese dhe një shans për t'i shmangur zgjedhjet. Në anën tjetër, ky nen paraqet edhe një mundësi zhbllokimi për rastet kur nuk ka vullnet dhe as shumicë të nevojshme për formim të një Qeverie të re nga Kuvendi, pas një mocioni mosbesimi.
397. Një dallimi tjetër i rëndësishëm në mes të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 82 të Kushtetutës qëndron tek zgjedhja e fjalëve që hartuesit e Kushtetutës kanë përdorur për të treguar mënyrat dhe situatat e shpërndarjes së Kuvendit. Përderisa paragrafi 1 i nenit 82 fillon me fjalët *“Kuvendi shpërndahet”*; paragrafi 2 i nenit 82 fillon me fjalët: *“Kuvendi mund të shpërndahet”*. Dallimi i vetëm në këtë aspekt është përdorimi i foljes *“mund”* në paragrafin 2 të nenit 82. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që përdorimi i foljes *“mund”* e detyron Presidentin të shpërndajë Kuvendin. Kjo zgjedhje e fjalëve dhe strukturës së fjalisë nuk është e rastësishme e as e parëndësishme, por për të kundërtat arsye të cilat reflektojnë pretendimet e parashtruesve të kërkesës. Folja modale *“mund”*, edhe në rastin konkret, shpreh pikërisht alternativat, rrugët e mundshme dhe jo rrugën e vetme. Rruga e vetme bëhet e tillë, pra mundësia e shpërndarjes së Kuvendit dhe shpalljes së zgjedhjeve, vetëm kur nuk ka alternativë tjetër. Kuptimi i fjalës *“mund”* në aspektin e diskrecionit të një Presidenti, është sqaruar qartësisht edhe nga Raportet e Komisionit të Venecias të cituara më lart. Në këtë kontekst, nuk ka asnjë dilemë.

398. Folja “*mund*” e përdorur në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës ka kuptim të “*ofrimit*” të mundësisë për Presidentin që të shpërndajë Kuvendin dhe jo të “*detyrimit*” të Presidentit që të shpërndajë Kuvendin pas çdo mocioni të mosbesimit. Presidenti e ka të drejtën për të ushtruar këtë “mundësi”, por që e njëjta është e kushtëzuar edhe për vet Presidentin. Kjo nënkupton se as Presidenti nuk ka diskrecion të plotë dhe të pakufizuar në atë se si e ushtron këtë kompetencë të kushtëzuar kushtetuese. Kompetenca e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin është drejtpërdrejt e varur nga vullneti i Kuvendit.
399. Për më tepër, dhe me rëndësi, Komisioni i Venecias, tashmë ka zgjidhur këtë dilemë. Në Raportin e Komisionit të Venecias, të cituar më lart (Shih Opinioni i Komisionit të Venecias nr. CDL-AD(2019)012 Moldavia 2019), Komisioni i Venecias pikërisht kishte analizuar përdorimin e fjalës “*mund*” në kontekst të kompetencës për shpërndarjen e Kuvendit. Përkitazi me përdorimin e kësaj fjale, në kontekst të shpërndarjes së Kuvendit nga Presidenti, kishte theksuar se (i) dallimi midis “*mund*” dhe “*do të*” është i mirë-themeluar në ligj dhe pa dyshim synon t'i sigurojë Presidentit një liri veprimi për të ushtruar gjykimin dhe diskrecionin e tij, duke marrë parasysh rrethanat e një situatë të veçantë në interes të vendit në tërësi; (ii) shpërndarja e Kuvendit, të zgjedhur në zgjedhje të drejta dhe të lira në shprehje të vullnetit të popullit, nuk është diçka që duhet të trajtohet në një mënyrë aritmetike, por në përputhje me frymën dhe formulimin e Kushtetutës që i siguron Kreut të Shtetit diskrecionin e nevojshëm për të ushtruar gjykim të mirë dhe të mençur; (iii) detyra e Presidentit që të ketë konsultime me fraksionet parlamentare duhet të shihet si një mjet për të shteruar të gjitha mundësitë për të formuar Qeverinë, para se të vendosë mbi shpërndarjen e Parlamentit; dhe (iv) nëse ekzistojnë mënyra të tjera, nëse, për shembull, partitë që përfaqësojnë një shumicë parlamentare janë pajtuar për formimin e Qeverisë, asnjë detyrim i tillë nuk mund të ekzistojë. Shpërndarja e Parlamentit në një situatë të tillë dhe thellimi i krizës kushtetuese apo edhe krijimi i një krize të re, madje mund të konsiderohet shkelje e detyrave kushtetuese të Presidentit.
400. Në mbështetje të këtij konstatimi dhe vetëm për të reflektuar qëllimin e hartuesve të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë re faktin se dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës reflektojnë qëllimin e hartuesve të saj, që mocioni i suksesshëm i mosbesimit të mos rezultojë në shpërndarje të detyrueshme të Kuvendit. Siç është paraqitur në paragrafët 309-317 të këtij Aktgjykimi, shpërndarja e Kuvendit në rast të votimit të suksesshëm të mosbesimit ka qenë pjesë e një paragrafi të vetëm të nenit 80 të draft Kushtetutës, bashkë me tri rastet tjera në të cilat, përcaktohet shpërndarja e detyrueshme e

Kuvendit. “*Pyetësori për Çështjet Kushtetuese*”, gjithashtu reflekton që alternativat përkritazi me shpërndarjen e Kuvendit, janë diskutuar veçanërisht në Komisionin Kushtetutes, dhe bazuar në procesverbalet që janë pjesë e dokumenteve përgatitore edhe në Ekipin e atëhershëm të Unitetit, në cilin ishin të përfaqësuara institucionet kryesore, forcat politike kryesore dhe shoqëria civile. Draftet e Kushtetutave të përfshira në dokumentet përgatitore gjithashtu reflektojnë që në mes 22 dhjetorit 2007 dhe 2 shkurtit 2008, është ndarë neni, tashmë 82 i Kushtetutës në dy paragrafë. I pari që përcakton rastet në të cilat Kuvendi shpërndahet detyrimisht, dhe i dyti, rastin kur shpërndarja e Kuvendit nga ana e Presidentit është e mundshme në rast të votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit, siç është interpretuar më lart, bazuar në konsultimet e Presidentit me partitë dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend nuk është e mundshme zgjedhja e një Qeverie të re.

401. Një zgjidhje e tillë kushtetuese është plotësisht në harmoni me zgjidhjet kushtetuese të shteteve tjera, përfshirë edhe ato të referuara nga vet parashtruesit e kërkesës dhe Kryeministri. Siç reflektohet në analizën krahasimore të Kushtetutave tjera dhe përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias, të reflektuara në paragrafët 274-290 dhe 291-306 të këtij Aktgjykimi: (i) asnjë Kushtetutë nuk përcakton shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit në rast të votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj një Qeverie; (ii) Kushtetutat që përcaktojnë mocionin konstruktiv, përcaktojnë që i njëjti mund të paraqitet dhe votohet vetëm në rast se njëkohësisht propozohet një kandidat tjetër për Kryeministër, dështimi i zgjedhjes të së cilit, më pas rezulton në shpërndarje të Kuvendit; ndërsa (iii) në rastet, përkatësisht shumicën e rasteve të analizuara, kur nuk është përcaktuar ky kushtëzim, votimi i suksesshëm i mosbesimit rezulton në shkarkimin/dorëheqjen e Kryeministrit përkatës dhe rënies së Qeverisë në tërësi, dhe në fillimin e procedurave për zgjedhjen e Qeverisë së re, duke i ndjekur procedurat përkatëse kushtetuese. Vetëm atëherë kur të jenë shteruar të gjitha mundësitë kushtetuese për zgjedhjen e një Qeverie të re, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e parakohshme.
402. Për më tepër, Kuvendi nuk mund të kufizohet që besimin e dhënë ndaj një Qeverie ta mbajë deri në fund të legjislaturës, sepse në të kundërtën, nuk i lejohet të krijojë Qeveri të re brenda të njëjtës legjislaturë, duke rezultuar edhe në ndërprerjen e mandatit të deputetëve. Mandati i deputetit nuk është i kushtëzuar dhe as nuk i nënshtrohet mandatit të Qeverisë, të cilin ai vet e zgjedh apo ia merr besimin. Një detyrim i tillë për Kuvendin do të ishte qartazi në kundërshtim me Kushtetutën dhe me parimin e mosnënshtimit të

mandatit të deputeti ndaj asnjë mandati detyrues. Deputetët, si përfaqësues të popullit, kanë të drejtë të ndryshojnë qëndrimet e tyre ashtu që t'ia marrin besimin një Qeverie dhe t'ia japin atë një Qeverie tjetër. Një gjë e tillë është krejtësisht e normale në një demokraci parlamentare. E kundërta do të nënkuptonte kushtëzim të mandatit të deputetit që ose do të mbahet detyruesisht një Qeveri që nuk gëzon besimin e Kuvendit ose do të shkurohet edhe mandati i Kuvendit. Kjo qartazi nuk është rregullimi kushtetues që parasheh Kushtetuta për raportin institucional ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë ngase vetëm kjo e dyta i përgjigjet të parës dhe jo anasjelltas. Rrjedhimisht, një praktikë e tillë, e cila do ta kushtëzonte mandatin e Kuvendit me mandatin e një Qeverie, do të ishte në kundërshtim të hapur me nenet 2 (1), 4 (4), 65 (8 dhe 9), 70 (1) dhe 74.

403. Në fund, Gjykata po ashtu vëren se, në njërën anë, parashtresit e kërkesës pretendojnë se pas çdo mocioni të mosbesimit, Presidenti ka shpërndarë Kuvendin në mënyrë automatike dhe vendi ka shkuar në zgjedhje të parakohshme, ndërkaq, në anën tjetër, pala kundërshtare pretendon se rrethanat e shpërndarjeve të kaluara kanë qenë të ndryshme nga rrethanat e rastit konkret meqë, në thelb, asnjëherë më parë nuk ka ekzistuar vullneti i shprehur i të zgjedhurve të popullit për të krijuar një Qeveri të re pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit.
404. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton faktet e shpërndarjes së të gjitha legjislativave të mëhershme që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës. (Shih paragrafët 221-250 të këtij Aktgjykimi, ku në mënyrë të hollësishme reflektohet historia parlamentare e Kuvendit e viteve 2007-2020). Janë tri lloje të ndryshme të situatave dhe rrethanave të shpërndarjes së Kuvendit që kanë ndodhur deri më tani, respektivisht: (i) situata kur Kuvendi është vet-shpërndarë me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (shih legjislativën e katërt dhe të gjashtë) dhe Presidenti vetëm ka dekretuar formalisht këtë vet-shpërndarje të Kuvendit bazuar në nenin 82.1.2 të Kushtetutës; (ii) situatat kur Kuvendi ka kërkuar të shpërndahet nga Presidenti pas një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë të votuar në vitin e tretë të legjislativës përkatëse, për faktin se të gjitha partitë politike kanë qenë të interesuara për zgjedhje të parakohshme (shih legjislativën e tretë dhe të pestë); dhe (iii) situata e tanishme e legjislativës së shtatë, kur Kuvendi ka kërkuar nga Presidenti që të vazhdojë procedurat për krijimin e një Qeverie të re pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, me arsyetimin dhe me kërkesën eksplicite që ekziston vullneti i qartë politik për të mos shkurtuar mandatin e kësaj legjislativë dhe për të shmangur zgjedhjet e parakohshme. Në fakt, vet mocioni i mosbesimit i votuar në Kuvend me datë 25 mars 2020,

me dy të tretat (2/3) të gjithë deputetëve të Kuvendit, në përmbajtjen e tij, ndër tjerash, shprehimisht tregon qëllimin e Kuvendit për krijimin të një Qeverie të re.

405. Më konkretisht, Gjykata vëren se legjislatura paraprake e Kuvendit, ajo e gjashta e viteve 2017-2019, nuk është shpërndarë nga Presidenti sipas nenit 82.2 të Kushtetutës; mirëpo është shpërndarë nga vet Kuvendi me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, sipas nenit 82.1 (2) të Kushtetutës. Dekreti i Presidentit vetëm kishte konfirmuar vet-shpërndarjen e Kuvendit dhe në atë aspekt Presidenti nuk kishte asnjë diskrecion përveç se të vuloste vullnetin e të zgjedhurve të popullit dhe të shpallte zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se legjislatura e gjashtë dhe rrethanat që kanë dërguar në shpërndarjen e saj nuk kanë asgjë të përbashkët me rrethanat e rastit konkret. I njëjtë është rasti me legjislaturën e katërt, që ishte vet-shpërndarë bazuar në pikën (2) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve dhe Presidentja vetëm kishte dekretuar këtë shpërndarje të Kuvendit bazuar në po të njëjtën dispozitë.
406. Më tutje, Gjykata vëren se e përbashkëta e dy legjislaturave të tjera, respektivisht legjislaturës së tretë (2008 - 2010) dhe të pestë (2015 - 2017), është se Kuvendi kishte votuar mocionet përkatëse të mosbesimit rreth tri vite pas zgjedhjeve parlamentare përkatëse, dhe specifikisht kishte kërkuar nga Presidenti që të shpërndante këto legjislatura dhe të shpallte zgjedhjet e parakohshme. Këto legjislatura kishin përfunduar pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë dhe në asnjërën nga këto dy raste, nuk kishte pasur vullnet për krijim të një Qeverie të re e as edhe ndonjë mospajtim rreth asaj se çfarë duhet të bëjë Presidenti në ato rrethana. Bazuar në vullnetin e partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, Presidentët kishin shpërndarë legjislaturat në fjalë duke përdorur mundësinë e dhënë me nenin 82.2 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se faktet dhe rrethanat e shpërbërjes së legjislaturave të tretë, katërt dhe pestë nuk janë të njëjta me rrethanat e rastit konkret.
407. Rrethanat e legjislaturës së tanishme, të shtatës me radhë e cila ka filluar më 2019, janë të ndryshme nga të gjitha situatat e lartcekura. E ndryshmja e rrethanave të tanishme është që, për herë të parë, një mocion mosbesimi: (i) është votuar më pak se dy muaj pas votimit të Qeverisë përkatëse; (ii) është votuar me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve; dhe (iii) shumica e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, respektivisht edhe shumica e të zgjedhurve të popullit, janë deklaruar për krijimin e një Qeverie të

re pas shprehjes së mosbesimit ndaj Qeverisë në Kuvend. Siç është sqaruar më lart, legjislatura e tanishme, bazuar në pikën (2) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës mund të vet-shpërndahej me dy të tretat (2/3) e votave që kanë votuar mocionin e mosbesimit. Një vullnet i tillë qartazi nuk ekziston. Prandaj, Presidenti në rrethana të tilla nuk mund ta shpërndajë Kuvendin, kundër vullnetit të përfaqësuesve të popullit. Kjo siç u sqarua më lart, do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën.

408. Gjykata rikujton që Qeveria e fundit ndaj të cilës Kuvendi shprehi mosbesimin e tij u krijua më 3 shkurt 2020. Besimi i Kuvendit ndaj Qeverisë zgjati deri më 25 mars 2020, ndërkohë që vet Kuvendi vazhdon të ketë mandat kushtetues deri në fund të vitit 2023. Nga praktika e deritanishme, asnjë Qeveri nuk ishte rrëzuar me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe, asnjëherë deri më tani nuk ishte kërkuar shprehimisht nga institucioni i Presidentit që të niste procedurat për krijimin e një Qeverie të re. Fakti që një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më sot, nuk e bën këtë kërkesë të Kuvendit jokushtetuese. Përkundrazi, një kërkesë e tillë, përderisa është në vullnetin e Kuvendit dhe në vullnetin e shumicës së të zgjedhurve të popullit është kërkesë legjitime e bazuar në Kushtetutë, të cilën Presidenti është i detyruar ta respektojë në kuptim të zbatimit të diskrecionit të tij të sipas nenit 82.2 të Kushtetutës.
409. Gjykata konstaton se paragrafi 1 i nenit 82 të Kushtetutës paraqet kushtet dhe rrethanat kur detyrimisht shpërndahet Kuvendi. Gjykata gjithashtu konstaton se paragrafi 2 i nenit 82 të Kushtetutës paraqet kushtin dhe rrethanën kur Presidenti ka mundësinë, por nuk është i detyruar të shpërndajë Kuvendin. Kjo mundësi nuk mund të ushtrohet në mënyrë të pavarur dhe në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit. Praktikisht, një situatë tipike e ushtrimit të mundshëm të këtij autorizimi diskrecional nga Presidenti, do të gjente shprehjen e vet në një situatë të kushtëzuar nga dy faktorë: (i) kur nuk mund të bëhet një shumicë e re e nevojshme për të formuar një qeveri pas votimit të një mocioni mosbesimi; dhe, (ii) kur nuk mund të arrihet konsensus politik brenda partive të përfaqësuara në Kuvend për të shpërndarë Kuvendin mbi bazë të nenit 82.1 (2). Në këto rrethana, shpërndarja e Kuvendit mbetet e vetmja mundësi për kapërcimin e krizave kushtetuese, ndaj Presidenti, në funksion të zhbllokimit të një krize parlamentare, ku Kuvendi nuk do të ishte në gjendje të ushtrojë funksionet e tij kushtetuese, mund të ushtrojë diskrecionin e tij të përcaktuar në nenin 82.2 të Kushtetutës, gjithnjë në konsultim dhe bazuar në pajtimin e shumicës së nevojshme të partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend.

410. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Dekreti i kontestuar i Presidentit [nr. 24/2020 i 30 prillit 2020] është në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës.

IV. LIDHUR ME NENET 95 [ZGJEDHJA E QEVERISË] DHE 100 [MOCIONI I MOSBESIMIT] TË KUSHTETUTËS

411. Gjykata rikujton se çështja kushtetuese përkitazi me nenet 95 dhe 100 të Kushtetutës ka të bëjë me interpretimin përfundimtar nëse pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, siç është përcaktuar në nenin 100 të Kushtetutës dhe në mungesë të vullnetit të shumicës së mjaftueshme të partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend për shpërndarjen e Kuvendit pas këtij mocioni, duke i pamundësuar Presidentit shpërndarjen e Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, mund të aktivizohet neni 95 i Kushtetutës përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë së re.
412. Për qëllime të trajtimit të kësaj çështjeje, dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata do të paraqes: në vijim (1) Thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të pranuar nga palët e interesuara (shih paragrafët 62-92, 122-167 dhe 192-205 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të këtyre pretendimeve dhe komenteve mbështetëse); (2) Thelbin e argumenteve të palës kundërshtare dhe palëve të tjera të interesuara që kanë mbështetur palën kundërshtare (shih paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të kundërshtimeve dhe të komenteve në favor të kundërshtimit të tillë); dhe (3) Përgjigjen e Gjykatës lidhur me çështjet që ngërthejnë këto pretendime.

Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës

413. Parashtruesit e kërkesës, respektivisht tridhjetë (30) deputetët parashtrues, në thelb, pretendojnë se Kushtetuta e detyron Presidentin që të shpërndajë Kuvendin pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, dhe se i njëjti, nuk ka kompetencë që të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, sepse në mes nenit 100 dhe atij 95 të Kushtetutës, mungon “ura lidhëse”, përkatësisht Kushtetuta nuk përcakton shprehimisht që pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, mund të zgjidhet Qeveri e re përmes procedurave të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës, duke lënë kështu si të vetmen mundësi shpërndarjen e Kuvendit sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës.

414. Sipas parashtresve të kërkesës: (i) aktivizimi i nenit 95 të Kushtetutës, sidomos paragrafit 4 të tij, përmes dekretit të Presidentit, është kundërkushtetues për faktin se, procedura që duhet ndjekur pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, nuk është e përcaktuar me normë kushtetuese në formë të shprehur, dhe se rrjedhimisht, “*mungesa e kësaj ure lidhëse*” në mes nenit 95 dhe më pas nenit 95.4 përmes paragrafit 4 të nenit 84 të Kushtetutës, pas zbatimit të nenit 100, e bën kundërkushtetues dekretin e Presidentit. Në mbështetje të argumentit se Kushtetuta karakterizohet nga një “*vakum*” në këtë aspekt, parashtresit e kërkesës i referohen një numri Kushtetutash, përfshirë Kornizës Kushtetuese, dhe pohojnë se në mungesë të një dispozite specifike në Kushtetutë përkritazi me procedurën që duhet ndjekur pas mocionit të mosbesimit, e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet pas shpërndarjes së Kuvendit bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës; (ii) paragrafi 6 i nenit 100 nuk mund të aktivizojë paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, sepse “*Kryeministri nuk ka dhënë dorëheqje*”, dhe se këto dy dispozita prodhojnë situata të ndryshme kushtetuese, përkatësisht e para përcakton situatën në të cilën një Qeveri shkarkohet përmes një mocioni mosbesimi, ndërsa e dyta, përpos dorëheqjes, duke iu referuar “*arsyeve tjera*” për të cilat “*post i tij/saj mbetet i lirë*” nënkupton “*vdekjen, ose pamundësinë e përhershme që të ushtrojë funksionin e Kryeministrit*” dhe jo “*mocionin e mosbesimit*”; dhe (iii) se Presidenti nuk ka pasur të drejtë të përcaktoj mandatarin për formimin e Qeverisë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, sepse nuk është respektuar paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtin nen, përkatësisht mandati nuk i është dhënë “*partisë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, përkundër faktit që e njëjta nuk e ka refuzuar këtë mandat. (Pretendimet specifike të parashtresve të kërkesës përkritazi me “*mungesën e afatit kushtetues*” për marrjen e mandatit për Kryeministër dhe “*mungesën e refuzimit*” të të njëjtit në rrethanat e rastit konkret, do të shtjellohen në hollësi në seksionin e radhës të këtij Aktgjykimi).
415. Të njëjtat pretendime i mban edhe Kryeministri, i cili përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, gjithashtu vë theks në faktin se: (i) Kushtetuta në mënyrë të qëllimshme ka ndërruar sistemin e mocionit të votëbesimit të paraparë përmes Kornizës Kushtetuese, dhe i cili kishte përcaktuar se “*Kuvendi mund të mos ia jep votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo*”, duke mos përcaktuar asnjë procedurë tjetër pas votimit të suksesshëm të mocionit të votëbesimit,

rrjedhimisht duke paraparë vetëm *“mocionin deskruktiv të mosbesimit”*, për dallim prej *“mocionit konstruktiv të mosbesimit”*, dhe në rast të të cilit, sipas pretendimit, Kuvendi nuk shpërndahet, por vazhdon të funksionojë deri në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit të paraparë me Kushtetutë. Në këtë kontekst, Kryeministri i referohet një numër Kushtetutash, të cilat janë përfshirë në Analizën Krahimore të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 274-290 të Aktgjykimit) dhe janë aplikuar përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar; dhe (ii) Presidenti, duke u bazuar në Kushtetutë dhe në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO103/14, i takon që të konsultojë *“vetëm partinë politike apo koalicionin që është fitues relativ apo absolut i zgjedhjeve, e jo edhe partitë politike apo koalicionet tjera”*, dhe se i njëjti, duhet të pres *“derisa ti dërgohet emri i kandidatit”* nga partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe se *“nuk ka afat të caktuar për të propozuar emrin e kandidatit”*. Deputetja e LVV dhe Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci, gjithashtu mbështet këtë qëndrim, duke theksuar ndër tjerash se Kushtetuta nuk ofron shprehimisht veprim alternativ për Presidentin e Republikës pas votimit të suksesshëm të mosbesimit përpos shpërndarjes së Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës. Kryetarja e Kuvendit, përkundër faktit që ka dorëzuar komente në Gjykatë në mbështetje të pretendimeve për kundërkushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar, në përmbajtjen e të njëjtave, nuk ka paraqitur argumente që ndërlidhen me çështjen që është duke u shqyrtuar në këtë pjesë të Aktgjykimit.

Thelbi i argumenteve të palës kundërshtare

416. Pala kundërshtare, respektivisht Presidenti, në thelb, pretendon se Kushtetuta nuk e detyron Presidentin që të shpërndajë Kuvendin pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë, dhe se një kompetencë e tillë është diskrecionale dhe ushtrohet në konsultim me partitë politike apo koalicionet e përfaqësuara në Kuvend. Në rast se këto të fundit, në shumicën e nevojshme të tyre, nuk pajtohen me shpërndarjen e Kuvendit, Presidenti detyrohet të aktivizojë nenin 95 të Kushtetutës përkritazi me iniciimin e procedurës për zgjedhjen e Qeverisë së re. Argumente në favor të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar të Presidentit janë dorëzuar edhe nga Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetët e AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s, dhe deputeti i LDK-së, z. Arban Abrashi, për arsyt specifike të cekura nga secila palë e interesuara në parashtrësit e tyre të dorëzuara në Gjykatë dhe të cilat janë pasqyruar në hollësi në paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi.

417. Sipas Presidentit: (i) paragrafi 6 i nenit 100, paragrafi 2 i nenit 82 dhe paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës, duhet të lexohen së bashku; (ii) neni 95 i Kushtetutës përcakton mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë si pas “zgjedhjeve” ashtu edhe “pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit të Qeverisë”; (iii) referenca përkitazi me “dorëheqjen e Kryeministrit” në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës dhe ajo përkitazi me të konsideruarit të “Qeverisë në dorëheqje” në paragrafin 6 të nenit 100 të Kushtetutës, janë të ndërlidhura sepse në të dy rastet “Qeveria bie”. Në këtë kontekst, Presidenti argumenton se Kryeministri dhe Qeveria janë të ndërlidhura dhe se bazuar në Kushtetutë, posti i Kryeministrit nuk mund të konsiderohet i ndarë nga Qeveria, sepse bazuar në nenin 92 të Kushtetutës “Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, Zëvendëskryeministrat dhe ministrat”. Presidenti gjithashtu konteston referencat e parashtruesve të kërkesës në dispozitat e Kushtetutave tjera, duke u referuar në një numër Kushtetutash tjera dhe në të cilat, ngjashëm si në Republikën e Kosovës, Kushtetutat përkatëse nuk përcaktojnë shprehimisht hapat që duhet ndërmarrë pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, duke përfshirë Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Austrisë.
418. Në të njëjtën linjë argumentimi janë edhe Grupi Parlamentar i LDK-së edhe Deputeti i saj, z. Arban Abrashi. Të parët, në kundërshtim të argumenteve të parashtruesve të kërkesës dhe të Kryeministrit në detyrë, pretendojnë se: (i) ekziston lidhja “*substanciale dhe funksionale*” në mes paragrafit 6 të nenit 100, paragrafit 2 të nenit 82 dhe paragrafit 4 e 5 të nenit 95 të Kushtetutës; (ii) situatat e përcaktuara në paragrafin 6 të nenit 100 dhe në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, në të cilat “Qeveria bie”, si rezultat i dorëheqjes së Kryeministrit apo edhe votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, kanë të njëjtin efekt, përkatësisht rënien e Qeverisë, dhe se duke marrë parasysh paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, bazuar në të cilin Presidenti “mund”, por nuk është i detyruar të shpërndaj Kuvendin, i mundëson të njëjtit, përkatësisht Presidentit të aktivizoj nenin 95 të Kushtetutës, duke filluar procedurat për zgjedhjen e Qeverisë së re. Ndërsa, i dyti, përkatësisht deputeti Abrashi, përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës lidhur me “*mungesën e dispozitave lidhëse*”, gjithashtu i referohet paragrafit 5 të nenit 95 të Kushtetutës duke theksuar se “*dorëheqja e Kryeministrit dhe dorëheqja e Qeverisë janë kompatible*”, dhe se situata e përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 100 të Kushtetutës është e përfshirë në paragrafin 5 të nenit 95 të saj, dhe se në të dy rastet “*Presidenti menjëherë zhvillon procedurat për zgjedhjen e Qeverisë së re*”. Deputetët e AKR-së e të mbështetur nga NISMA Socialdemokrate,

gjithashtu vënë theks në ndërlidhjen në mes paragrafit 6 të nenit 100 me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës.

PËRGJIGJA E GJYKATËS – përkitazi me nenet 95 dhe 100 të Kushtetutës

Parimet e përgjithshme kushtetuese përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë dhe Mocionin e Mosbesimit/Votëbesimit

419. Në kontekst të thelbit të pretendimeve dhe kundërshtimeve përkitazi me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar e të përmbledhura më lart, dhe duke rikujtuar që Gjykata tashmë konstatoi se votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit sipas procedurës të përcaktuar në nenin 100 të Kushtetutës, nuk e detyron por i mundëson Presidentit të Republikës të shpërndajë Kuvendin bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, mundësi kjo e kushtëzuar nga vullneti i përfaqësuesve të popullit, përkatësisht mundësia/pamundësia e shumicës së nevojshme të partive ose koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend për të formuar një Qeveri të re.
420. Më saktësisht, Gjykata tashmë ka sqaruar se edhe pas votimit të suksesshëm të një mocioni të mosbesimit në Kuvend, në rast se shumica e nevojshme e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend kanë vullnetin dhe shumicën e nevojshme për të tentuar formimin e një Qeverie të re, Presidenti nuk mund të shpërndajë Kuvendin bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, dhe është i detyruar të filloj procedurat për formimin një Qeverie të re bazuar në dispozitat e nenit 95 të Kushtetutës. Një qëndrim i tillë është plotësisht kompatibil me Analizën Krahasimore, Opinionet e cituara të Komisionit të Venecias dhe kontributin e dorëzuar në Gjykatë nga anëtarët e Forumit të Komisionit të Venecias.
421. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se (i) bazuar në nenin 66 të Kushtetutës, Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar, mandat ky që fillon nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve; dhe se (ii) ky mandat mund të shkurtohet vetëm në rast të shpërndarjes së detyrueshme të Kuvendit në rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 82 të Kushtetutës dhe mundësinë e shpërndarjes së Kuvendit nga Presidenti, në rast se bazuar në vullnetin e partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, formimi i një Qeverie të re nuk është i mundur, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, kompetenca e Presidentit, e përcaktuar përmes paragrafit 3 të nenit 84 të Kushtetutës, përkitazi me shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, mund të ushtrohet vetëm nëse

janë plotësuar kushtet e lartcekura, përkatësisht përfundimi i rregullt i mandatit të Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të rregullta, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 66 të Kushtetutës apo edhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme, vetëm në zbatim të drejtë të dispozitave të nenit 82 të Kushtetutës përkitazi me shpërndarjen e Kuvendit. Për pasojë, nuk është kontestuese se në rast të votimit të suksesshëm të mosbesimit dhe pasojës respektive të dorëheqjes së Qeverisë, siç është përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 100 të Kushtetutës dhe pamundësisë së shpërndarjes së Kuvendit bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, fillojnë procedurat për formimin e Qeverisë së re, siç është përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës.

422. Në dritën e këtij konstatimi, Gjykata në vijim do të sqarojë më tej: (i) ndërlidhjen e nenit 100 me nenin 95 të Kushtetutës; dhe më pas, (ii) procedurën që duhet ndjekur për formimin e një Qeverie të re pas një votimi të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj një Qeverie në Kuvendin e Republikës.
423. Gjykata fillimisht thekson se këto dy nene, neni 95 dhe 100 i Kushtetutës, jetësojnë një ndër detyrat më thelbësore të Kuvendit të Republikës, përkatësisht atë të ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 4 të Kushtetutës, përmes ushtrimit të kompetencës së përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës, bazuar në të cilin, Kuvendi zgjedh por edhe shpreh mosbesimin ndaj Qeverisë.
424. Zgjedhja e edhe shprehja e mosbesimit të pushtetit legjislativ ndaj bartësit të pushtetit ekzekutiv është një ndër premiset esenciale të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, siç është përcaktuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe ndër vlerat themelore të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 7 të Kushtetutës. Për pasojë, bazuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës, nenet 95 dhe 100 të Kushtetutës duhet të lexohen së bashku, posaçërisht duke marrë parasysh faktin që tashmë është konstatuar se paragrafi 2 i nenit 82 të Kushtetutës nuk rezulton detyrimisht në shpërndarje të Kuvendit, dhe se votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit para se të rezultojë në shpërndarjen e Kuvendit, mundëson zgjedhjen e një Qeverie të re.
425. Në mënyrë që edhe vet Qeveria të ketë mundësinë të sigurohet që përtej zgjedhjes së saj, siç është përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës, të mbajë dhe të konfirmoj besimin e Kuvendit në të, Kushtetuta i ka mundësuar një Kryeministri që të kërkojë votëbesimin e Qeverisë në Kuvend, bazuar në paragrafin 2 të nenit 100 të Kushtetutës. Në anën tjetër, gjithashtu ka autorizuar një të tretën (1/3) e deputetëve të Kuvendit që të sfidojnë këtë besim, duke proceduar në Kuvend një

mocion mosbesimi ndaj Qeverisë, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 100 të Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, ka përcaktuar edhe garancitë e nevojshme për Qeverinë, duke përcaktuar se një mocion mosbesimi konsiderohet të jetë pranuar vetëm nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa në të kundërtën një mocioni tjetër i mosbesimit, nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme.

426. Gjykata rikujton që Kuvendi, si institucion i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, siç është përcaktuar në nenin 62 të Kushtetutës, ushtron sovranitetin e Republikës së Kosovës, i cili buron nga populli, siç është përcaktuar në nenin 2 të Kushtetutës. Legjitimiteti demokratik i një Qeverie të zgjedhur nga një Kuvend i cili është i vetmi institucion i Republikës që zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, buron nga besimi që përfaqësuesit e popullit i mveshin me rastin e zgjedhjes së saj. Një Qeveri e zgjedhur nga Kuvendi, nuk vazhdon të ketë të njëjtin legjitimitet, nga momenti kur përfaqësuesit e popullit ia marrin besimin përmes votimit të një mocioni të suksesshëm të mosbesimit. Qeveria duhet gjithnjë të ketë të paktën besimin e shumicës së nevojshme në Kuvend. Ky besim pushon në momentin kur kundër tij të kenë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht dhe bazuar në paragrafin 4 të nenit 100 të Kushtetutës, të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë. Me kalimin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, kjo e fundit, humb besimin e përfaqësuesve të popullit, dhe rrjedhimisht edhe autoritetin kushtetues për të ushtruar kompetencat përkatëse. Prandaj, Kushtetuta përcakton që e njëjta është Qeveri në dorëheqje, sepse e humb mandatin qeverisës, ashtu siç, pa asnjë përjashtim të njëjtin parim e përcaktojnë edhe të gjitha Kushtetutat e analizuara në Analizën Krahasimore dhe në të gjitha shtetet që kanë dhënë kontributin e tyre përmes Forumit të Komisionit të Venecias.
427. Pasoja e një Qeverie në dorëheqje si rezultat i votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit bazuar në paragrafin 6 të nenit 100 të Kushtetutës dhe në pamundësi të shpërndarjes së Kuvendit bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, aktivizon nenin 95 të Kushtetutës përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë.
428. Neni 95 i Kushtetutës është i organizuar në 6 paragrafë, të cilët përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë në kuadër të një cikli zgjedhor, duke marrë parasysh që i njëjti përcakton edhe mënyrën e zgjedhjes së një Qeverie pas zgjedhjeve por edhe pas rënies së një Qeverie. Më saktësisht, paragrafi i parë i tij, përcakton që Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në

Kuvend për të formuar Qeverinë. Paragrafi i dytë dhe i tretë i tij, përcaktojnë që ky kandidat, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit dhe se Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht votën e gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve. Paragrafi i katërt i tij, përcakton dy elemente shtesë, (i) afatin prej dhjetë (10) ditësh, brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, sipas së njëjtës procedurë, nëse përbërja e propozuar e Qeverisë sipas paragrafit 1 të nenit 95 të Kushtetutës, nuk merr shumicën e votave të nevojshme; dhe (ii) detyrimin e Presidentit për të shpallur zgjedhjet, nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre. Paragrafi i pestë, përcakton procedurën e mandatimit të kandidatit të ri për Kryeministër, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, nëse Qeveria bie, si rezultat i dorëheqjes së Kryeministrit ose nëse *“për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë”*. Dhe në fund, paragrafi 6 i tij, përcakton se anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit, teksti i të cilit rregullohet me ligj.

429. Gjykata ka interpretuar paragrafin 14 të nenit 84 të Kushtetutës lidhur me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 95 të Kushtetutës në Aktgjykimin KO103/14. Në këtë Aktgjykim, Gjykata kishte trajtuar tri aspekte që ndërlidhen me nenet e lartcekura (i) funksionin dhe rolin e Presidentit të Republikës (shih paragrafët 59 deri më 65 të këtij Aktgjykimi); (ii) interpretimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës (shih paragrafët 66 deri në 88 të këtij Aktgjykimi); dhe (iii) interpretimin e paragrafit 4 të nenit 95 të Kushtetutës (shih paragrafët 89 deri në 95 të këtij Aktgjykimi).
430. Në këtë rast, Gjykata kishte vendosur se: (i) nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë në përputhshmëri me njëri-tjetrin; (ii) përdorimi i termave *“parti politike ose koalicion”*, kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafët 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkupton partinë politike ose koalicionin që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend; (iii) partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, siç përcaktohet në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, nënkupton partinë ose koalicionin që ka shumicën e vendeve në Kuvend, qoftë absolute, qoftë relative; (iv) Presidenti i Republikës, në bazë të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër të nominuar nga partia politike ose nga koalicioni që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend; (v)

Presidenti i Republikës nuk ka diskrecion të refuzojë caktimin e kandidatit të propozuar për Kryeministër; (vi) në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti i Republikës, në diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me koalicionet (të regjistruara në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun; dhe (vii) nuk përjashtohet që Presidenti i Republikës të vendosë t'i japë partisë ose koalicionit të parë, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, mundësinë të propozojë kandidatin tjetër për Kryeministër (shih Dispozitivin e Aktgjykimit KO103/14).

431. Më saktësisht, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit të tanishëm, ky Aktgjykim në interpretimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës, kishte përcaktuar se: (i) Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, përkatësisht shumicën relative bazuar në rezultatin zgjedhor dhe numrin më të madh të vendeve në Kuvend, dhe se nëse e njëjta i ka votat “*e nevojshme*” ose jo për formimin e Qeverisë, përcaktohet nga vota në Kuvend (shih paragrafët 81 deri më 86 të këtij Aktgjykimi); (ii) Presidenti i Republikës nuk ka diskrecion që të aprovoj ose mos aprovoj nominimin e mandatarit nga partia ose nga koalicioni, por duhet të sigurojë caktimin e tij/saj (shih paragrafin 88 të këtij Aktgjykimi); dhe (iii) që nuk përjashtohet mundësia që partia ose koalicioni në fjalë të refuzojë të marrë mandatin (shih paragrafin 87 të këtij Aktgjykimi).
432. Ndërsa, në interpretimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, kishte përcaktuar se: (i) është në diskrecionin e Presidentit të Republikës, që pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion, do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër, dhe se i njëjti, duhet të vlerësojë se cila është gjasa më e madhe që një parti politike ose koalicion të propozojë kandidatin për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë së re (shih paragrafët 90 dhe 92 të këtij Aktgjykimi); dhe (ii) se është përgjegjësi e Presidentit të ruajë stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e

qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet (shih paragrafin 94 të këtij Aktgjykimi).

433. Gjykata rithekson se parimet e përcaktuara përmes Aktgjykimit KO103/14, janë të aplikueshme dhe nuk do të angazhohet në diskutim të mëtejshëm të paragrafëve të nenit 95 të Kushtetutës, të cilët tashmë janë interpretuar përmes Aktgjykimit të lartcekur. Thënë këtë, ky Aktgjykim nuk ka interpretuar mënyrën e zgjedhjes së një Qeverie: (i) bazuar në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës; dhe (ii) bazuar në paragrafin 6 të nenit 100 të Kushtetutës, në rast të dhe pas votimit të suksesshëm të një mocioni të mosbesimit. Megjithatë, parimet e përcaktuara përmes Aktgjykimit KO103/14, janë gjithashtu të aplikueshme edhe në mënyrën e zbatimit të këtyre paragrafëve dhe procedurave që duhet ndjekur për krijimin e një Qeverie të re.
434. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vëren se për tu aktivizuar paragrafi 5 i nenit 95, Kryeministri: (i) duhet të ketë dhënë dorëheqjen; ose, (ii) *“për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë”*. Ky nen i referohet Kryeministrit si individ dhe postit të tij/ose të saj, dhe cilave do arsye të tjera, mbi bazën e të cilave, ky post, mbetet i lirë. Këto arsye, mund të përfshijnë sëmundjen, vdekjen, pamundësinë e ushtrimit të detyrës, apo arsye tjera të cilat, nuk janë të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë. Thënë këtë, bazuar në këtë paragraf, efekti i dorëheqjes së Kryeministrit apo mbetjes së postit të tij/saj të lirë, ngërthen edhe efektin *“rënies së Qeverisë”*. I njëjti efekt pason edhe nëse mocioni i mosbesimit votohet suksesshëm për *“Qeverinë në tërësi”*, pas të cilit *“Qeveria konsiderohet në dorëheqje”*, siç është përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 100 të Kushtetutës.
435. Më saktësisht, efekti juridik i dorëheqjes së Kryeministrit është rënia e Qeverisë, rrjedhimisht, Qeveria në dorëheqje. Efekti juridik i votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj *“Qeverisë në tërësi”* në Kuvend, është po ashtu, Qeveria në dorëheqje. Ky konstatim, është për më tepër i bazuar edhe në (i) nenin 92 të Kushtetutës, sipas të cilit, Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat, ndërsa e njejtja, përkatësisht Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin; dhe në (ii) nenin 94 të Kushtetutës, sipas të cilit Kryeministri përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë. Rrjedhimisht, pasojat juridike për *“Qeverinë në tërësi”* janë të njëjtat si në rrethanat e paragrafit 5 të nenit 95 të Kushtetutës, kur Kryeministri të ketë dhënë dorëheqjen apo kur për arsye tjetër posti i tij/saj të ketë mbetur i lirë, po ashtu edhe në rrethanat e paragrafit 6 të nenit 100 të Kushtetutës kur është votuar *“mocionit i mosbesimit për Qeverinë në tërësi”*. Gjykata vëren që referimi në *“mocionin e mosbesimit për Qeverinë në tërësi”*, nënkupton që Kushtetuta

mundëson edhe votimin e mosbesimit për vetëm një anëtarë individual të kabinetit Qeverisë, megjithatë, duke marrë parasysh që një çështje e tillë nuk është para Gjykatës, kjo e fundit, nuk do të analizojë mundësitë kushtetuese dhe efektet juridike të një votimi të suksesshëm të mosbesimit i cili nuk përfshinë “*Qeverinë në tërësi*”.

436. Konstatimi që efektet juridike të dorëheqjes së Kryeministri dhe votimit të suksesshëm të mosbesimit për “*Qeverinë në tërësi*”, janë të njëjta, përkatësisht Qeveria në dorëheqje, mbështetet edhe nga Analiza Krahasimore e pasqyruar në paragrafët 274-290 të këtij Aktgjykimi e edhe nga përgjigjet e të gjithë anëtarëve të Forumit të Komisionit të Venecias. Në të gjitha këto raste, vihet theks në faktin që: (i) nëse bëhet një votim mosbesimi ndaj Kryeministrit ose gjithë Qeverisë, Kryeministri dhe Qeveria do të japin dorëheqje; (ii) mandati i Qeverisë pushon kur të japë dorëheqjen Kryeministri ose me rastin e humbjes së besimit nga Kuvendi; dhe (iii) që me përjashtim të rasteve të cilat kanë paraparë specifikisht “*mocionin konstruktiv*” në Kushtetutat e tyre, e bazuar në të cilin votimi i suksesshëm i mosbesimit rezulton automatikisht në zgjedhjen e një Kryeministri të ri, në të gjitha rastet tjera, si pasojë e dorëheqjes së Kryeministrit apo edhe votimit të suksesshëm të mosbesimit, aktivizohet neni respektiv përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë së re, në mënyrën e përcaktuar në Kushtetutat përkatëse.
437. Njëjtë, Kushtetuta e Kosovës, në rast të dorëheqjes së një Qeverie si pasojë e: (i) dorëheqjes së Kryeministrit; (ii) mbetjes së këtij posti të lirë “*për arsye tjera*”, apo (iii) votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj saj, aktivizon paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, dhe e cila, brenda të njëjtit cikël zgjedhor, mundëson zgjedhjen e një Qeverie të re. Bazuar në këtë nen, kandidati i ri, për të formuar Qeverinë, mandatohet nga Presidenti, “*në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend*”.
438. Zbatimi i kësaj dispozite është drejtpërdrejtë e ndërlidhur me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës sepse: (i) Presidenti në zbatim të paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës ashtu si edhe në zbatim të paragrafit 1 të nenit 95 të Kushtetutës, është i detyruar të caktoj mandatarin për Kryeministër vetëm në konsultim me “*partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend*”, rrjedhimisht partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, ka të drejtën e parë të propozimit të kandidatit për Kryeministër si pas zgjedhjeve ashtu edhe pas dorëheqjes së Qeverisë [Shënim: Gjykata vëren dallimin në mes njëjësit dhe shumësit të fjalës parti politike në paragrafin 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës. Thënë këtë përderisa paragrafi 5 i nenit 95, i

referohet partisë në shumës, i njëjti i referohet koalicionit në njëjës, për më tepër që gjithashtu referenca në *“ka fituar”*, është në njëjës. Paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës në gjuhën serbe është po ashtu në njëjës. Prandaj, Gjykata vlerëson se paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës kanë kuptimin e njëjtë në kuptim të *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*]; dhe (ii) zbatimi i procedurës pas mandatimit të kandidatit për Kryeministër si rezultat i situatës së përcaktuar në paragrafin 5 apo 1 të nenit 95 të Kushtetutës, është i kushtëzuar, përkatësisht zbatohet vetëm në ndërlidhje me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës, sipas të cilëve ky kandidat është i detyruar që, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, të paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe të kërkon miratimin nga ana e Kuvendit dhe se Qeveria e propozuar konsiderohet e zgjedhur, nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) deputetë, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 95 të Kushtetutës.

439. Gjykata gjithashtu thekson se në zbatimin e kësaj procedure, dhe siç është interpretuar edhe në Aktgjykimin e Gjykatës KO103/14, Presidenti nuk ka diskrecion në përzgjedhjen e emrit të kandidatit për Kryeministër, por është i detyruar që të mandat kandidatit për Kryeministër i cili është propozuar nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”* (shih paragrafin 68 të Aktgjykimit në rastin KO103/14).
440. Në rast se, Qeveria e propozuar nuk merr shumicën e nevojshme të votave në Kuvend, apo edhe nëse, *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend”* nuk e propozon mandatarin për Kryeministër dhe rrjedhimisht, refuzon marrjen e mandatit përkatës, siç është përcaktuar në Aktgjykimin KO103/14 (shih paragrafin 87 të këtij Aktgjykimi), ndiqet procedura e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës. Për dallim nga procedura e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, në zbatimin e paragrafit 4 të nenit 95 të Kushtetutës, siç është saktësuar në Aktgjykimin e Gjykatës KO103/14, caktimi i mandatarit për Kryeministër është në diskrecionin e Presidentit. Ky diskrecion megjithatë është i kushtëzuar, siç është sqaruar në Aktgjykimin KO103/14, nga detyrimi i Presidentit për të vlerësuar se cila parti politike ose koalicion ka *“gjasën më të madhe”* që të propozojë kandidatit për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë së re, *“në mënyrë që të shmangen zgjedhjet”*. Rrjedhimisht kandidati për Kryeministër në rastin e zbatimit të paragrafit 4 të nenit 95 të Kushtetutës, mund të jetë nga cilado parti apo koalicion i përfaqësuar

në Kuvend, duke përfshirë edhe “*partinë politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, me kushtin që të ketë gjasën më të madhe për të siguruar votat e nevojshme për votimin e suksesshëm të Qeverisë, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e parakohshme.

441. Megjithatë, zgjedhjet do të jenë të paevitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, qoftë pas zgjedhjeve ose pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, me ç'rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti i shpallë zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
442. Gjykata thekson se “*partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend*”, përkatësisht partia ose koalicioni që ka fituar shumicën relative në zgjedhje parlamentare, ka të drejtën e parë por jo të drejtën ekskluzive për të propozuar mandatarin për Kryeministër. Kushtetuta por as Aktgjykimi në rastin KO103/14, nuk përcaktojnë që Qeveria mund të bëhet vetëm bazuar në propozimin e partisë ose koalicionit që ka fituar shumicën në Kuvend. Kjo parti ose koalicion gëzon të drejtën e parë për: (i) propozimin e kandidatit për Kryeministër pas zgjedhjeve bazuar në paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës; (ii) propozimin e kandidatit për Kryeministër edhe në rast të dështimit të parë, me kushtin që në vlerësimin e Presidentit kjo parti ka gjasat më të mëdha për të formuar Qeverinë dhe për të shmangur zgjedhjet bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës dhe siç është interpretuar nga Gjykata në rastin KO103/14; dhe (iii) të drejtën e propozimit të parë të kandidatit për Kryeministër edhe pas dorëheqjes së Qeverisë, si pasojë e dorëheqjes së Kryeministrit apo edhe dorëheqjes së Qeverisë si pasojë e votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit. Thënë këtë, në rast të dështimit të marrjes së votave të mjaftueshme në Kuvend apo edhe refuzimit të marrjes së mandatit, Kushtetuta i mundëson edhe një partie apo koalicioni tjetër që të propozoj mandatarin për Kryeministër, me kushtin që e njëjta ka gjasën më të madhe për të formuar Qeverinë dhe të për shmangur zgjedhjet e parakohshme, siç është interpretuar në Aktgjykimin KO103/14.
443. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se leximi i përbashkët i: (i) paragrafit 8 të nenit 65 të Kushtetutës lidhur me kompetencën e Kuvendit për zgjedhjen dhe shprehjen e mosbesimit ndaj Qeverisë; (ii) paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, i cili përjashton mundësinë e shpërndarjes së Kuvendit, në rast se ekziston vullneti dhe shumica e mjaftueshme e partive politike apo koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend për qëllimin e formimit të një Qeverie të re; (iii) paragrafit 6 të nenit 100

dhe paragrafit 5 të nenit 95 të Kushtetutës, të cilët, rezultojnë në një Qeveri në dorëheqje, ka për pasojë aktivizimin e nenit 95 të Kushtetutës përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë, i cili mundëson dy tentativa për zgjedhjen e një Qeverie para se të shpallen zgjedhjet e parakohshme, në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe sipas sqarimeve të Aktgjykimit KO103/14 dhe këtij Aktgjykimi.

444. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vë re faktin se dokumentet përgatitore të hartimit të Kushtetutës reflektojnë qëllimin e hartuesve të Kushtetutës lidhur me nenet respektive përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë (shih paragrafët 318-325 të Aktgjykimit për përshkrim të detajuar përkitazi me evoluimin e këtij neni). Evoluimi i nenit 104, 96, 93 dhe në fund, 95 në draftet e Kushtetutës të përfshira në dokumentet përgatitore lidhur me Zgjedhjen e Qeverisë, reflekton që i njëjti: (i) duke përcaktuar situatat e formimit të Qeverisë, pas zgjedhjeve, pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, dhe pas mbetjes së lirë së postit të Kryeministrit, gjithnjë ka përfshirë një cikël zgjedhor në tërësinë e tij; (ii) gjithnjë ka përcaktuar dy tentativa për formimin e Qeverisë, të parën brenda periudhës pesëmbëdhjetë (15) ditore, ndërsa të dytën, pas emërimit të kandidatit tjetër nga Presidenti brenda afatit dhjetë (10) ditor, sipas procedurës së njëjtë; (iii) vazhdimisht ka përcaktuar se kur edhe herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë shpallen zgjedhjet e parakohshme; dhe (iv) ka theksuar se me rënien e Kryeministrit bie edhe Qeveria. Gjykata gjithashtu vëren që gjuha aktuale e Kushtetutës e reflektuar në paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, përkitazi me partinë ose koalicionin që duhet të konsultohet nga Presidenti për caktimin e mandatarit të parë, pas zgjedhjeve apo pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përkatësisht *“në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend”* është bërë pjesë e drafteve Kushtetuese në versionet e 22 dhjetorit 2007 dhe 2 shkurtit 2008. Deri në këto ndryshime, për qëllim të caktimit të mandatarit për formimin e Qeverisë, draft Kushtetuta i është referuar *“konsultimeve me partitë politike ose koalicionin që e ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*.
445. Në anën tjetër, evoluimi i nenit 105, 97, 98 dhe në fund, 100 nëpër draftet e Kushtetutës të përfshira në dokumentet përgatitore lidhur me Mocionin e Mosbesimit/Votëbesimit, reflekton që i njëjti, nuk u është nënshtruar ndryshimeve të mëdha përgjatë hartimit, por që, dhe me rëndësi, është konsideruar nëse duhet të mbahet ose jo sistemi i mocionit të mosbesimit i përcaktuar përmes Kornizës së atëhershme Kushtetuese, dhe ka përjashtuar qëllimisht një zgjidhje të tillë (shih paragrafët 307-332 të Aktgjykimit për përshkrim të detajuar përkitazi me evoluimin e këtij neni). Gjykata rikujton që Korniza Kushtetuese

në pikën 9 të saj përkitazi me Mocionin e Vetëbesimit kishte përcaktuar se Kuvendi *“mund të mos ia jep votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo”*.

446. Se kjo çështje ishte trajtuar specifikisht reflektohet në dokumentin e titulluar *“Pyetësor për Çështjet Kushtetuese”* të 20 qershorit 2007 që është pjesë përbërëse e dokumenteve përgatitore. E njëjta çështje ishte ngritur dhe reflektohet në draftin e titulluar *“Komentet e Publikut në Draftin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës”*, ku specifikisht ishte rekomanduar ndryshimi i mocionit të votëbesimit në atë të quajtur *“konstruktiv”*. Draftet e Kushtetutës nuk kishin pësuar këto ndryshime të rekomanduara duke zgjedhur Mocionin e Mosbesimit siç është reflektuar në nenin 100 të Kushtetutës dhe jo zgjidhjen e përcaktuar përmes Kornizës Kushtetuese. Një qëndrim i tillë i hartuesve të Kushtetutës, i lexuar së bashku me ndryshimet që janë bërë në nenin aktual 82 të Kushtetutës në fund të vitit 2007, duke e mundësuar por jo detyruar shpërndarjen e Kuvendit në rast të votimit të suksesshëm të mosbesimit, reflektojnë qëllimin e hartuesve të Kushtetutës, për të mundësuar formimin e një Qeverie të re sipas procedurave të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës, zgjidhje kjo e cila, është e reflektuar edhe në shumë Kushtetuta të vendeve tjera, siç është pasqyruar në Analizën Krahësimore e edhe në përgjigjet e anëtarëve të Forumit të Komisionit të Venecias në paragrafët 274-306, respektivisht, të këtij Aktgjykimi.
447. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që bazuar në Analizën Krahësimore të Kushtetutave përkatëse (shih paragrafët 274-290 të këtij Aktgjykimi), rezulton si në vijim: (i) të gjitha përcaktojnë kompetencën e Presidentit për të nominuar kandidatin për Kryeministër, sipas procedurave të përcaktuara në to, duke përfshirë edhe ato raste në të cilat në faza të mëvonshme të procedurës, dhe pas dështimit të numrit të caktuar të kandidatëve, e drejta e kandidimit të Kryeministrit kalon në Kuvendet përkatëse; (ii) të gjitha, me përjashtim të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk specifikojnë procedurën në rast të dështimit të zgjedhjes së Kryeministrit herën e parë, përcaktojnë prej dy deri në katër tentime përmes nominimit të kandidatëve të ndryshëm për Kryeministër, duke përfshirë edhe rastet në të cilat mund të kandidohen njëkohësisht më shumë se një kandidat për Kryeministër për votim në Kuvend, para se të fillohen procedurat për shpërndarjen e Kuvendeve përkatëse dhe shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme. Gjykata rikujton faktin se bazuar në përgjigjen e Maqedonisë së Veriut përmes Komisionit të Venecias, e njëjta ka theksuar se përkundër faktit që Kushtetuta e saj

nuk e përcakton shprehimisht se pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale mund të zgjidhet një Qeveri e re, mandati për të formuar një Qeveri të re i jepet partisë ose koalicionit tjetër; (iii) të gjitha kanë të parapara procedurat për mocionin e mosbesimit kundër Qeverisë, votimi i suksesshëm i të cilit, në asnjërin nga rastet, nuk rezulton në shpërndarje të menjëhershme dhe të detyrueshme të Kuvendit, por në shterimin e të gjitha mundësive kushtetuese për formimin e një Qeverie të re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e parakohshme; dhe (iv) në të gjitha këto Kushtetuta, është paraparë që votimi i suksesshëm i mosbesimit rezulton në dorëheqjen e Kryeministrit përkatës dhe Qeverisë së tij/saj.

448. Gjykata më tej thekson se Analiza Krahasmë e këtyre Kushtetutave dhe përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias, rezultojnë në katër lloje sistemesh të mocionit të mosbesimit, gjithnjë bazuar në karakteristikat specifike të tyre siç janë sqaruar në Analizën Krahasmë dhe kontributin e Forumit të Komisionit të Venecias të pasqyruara në paragrafët 274-306 të këtij Aktgjykimi. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se: (i) mocioni konstruktiv i mosbesimit, përkatësisht kushtëzimi i propozimit dhe votimit të një mocioni mosbesimi me propozimin e një kandidati të ri për Kryeministër, është paraparë në Kushtetutat e Gjermanisë, Sllovenisë, Hungarisë, Gjeorgjisë dhe Armenisë. Në këto raste, Kuvendi përkatës shpërndahet nëse nuk zgjidhet kandidati i propozuar për Kryeministër përmes mocionit përkatës; (ii) mocioni i mosbesimit pas të cilit, në mënyrë shprehimore është e përcaktuar vetëm edhe një tentativë për zgjedhjen e një Kryeministri të ri, para shpërndarjes së Kuvendit përkatës, e që është paraparë në Kushtetutat e Kroacisë, Shqipërisë, Lituanisë dhe Austrisë; (iii) përjashtimisht, mocion mosbesimi, pas votimit të suksesshëm të së cilit, vazhdon të ketë rol Qeveria e shkarkuar, në lidhje me shpërndarjen e Kuvendit. Ky i fundit, nuk shpërndahet detyrimisht, por mund të ndodh me rekomandim të Qeverisë. Ky është rasti në Estoni, Lituani por edhe në Suedi, bazuar në Kushtetutën e të cilës, por edhe në përgjigjen e dërguar përmes Forumit të Komisionit të Venecias, nuk është i detyrueshëm shpërndarja e Kuvendit, por megjithatë Qeveria luan rol, në shpërndarjen ose jo të të njëjtit. Thënë këtë, përgjigja e Suedisë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, specifikisht thekson se nëse Kuvendi ka shumicë të mjaftueshme për zgjedhjen e një Qeverie të re, shpërndarja e Kuvendit nuk është e detyrueshme; dhe në fund, (iv) shumica e shteteve, përcaktojnë sistem mocioni mosbesimi, kalimi i suksesshëm i të cilit rezulton në dorëheqjen e Qeverisë dhe kthimin e procedurës të kompetenca e Presidentit, thënë shprehimisht ose jo, për iniciimin e procedurës për zgjedhjen e Qeverisë së re përmes caktimit të mandatarit për

Kryeministër, sipas dispozitave kushtetuese përkatëse, duke përshtirë detyrimin për shterjen e të gjitha mundësive, për zgjedhjen e Kryeministrit, para se të shpërndalet Kuvendi. Kjo zgjidhje reflektohet në Kushtetutat e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Bullgarisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, e Lihtenshtajnit. E njëjta zgjidhje reflektohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

449. Për pasojë, Kushtetuta e Kosovës, përkundër pretendimeve të parashtruesve të kërkesës: (i) nuk ka asnjë ka asnjë “*vakum*” apo “*munxesë të urës lidhëse*” në mes dispozitave të saj përkitazi me mundësinë e zgjedhjes së një Qeverie të re pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, siç është përcaktuar në nenin 100 të Kushtetutës; (ii) mocioni konstruktiv është zgjidhje e disa Kushtetutave siç është sqaruar më lart dhe nuk është zgjidhje e shumë tjerave; (iii) votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi nuk rezulton në asnjë mënyrë në shpërndarje të detyrueshme të Kuvendit, por përkundrazi mundëson zgjedhjen e një Qeverie të re, bazuar në dispozitat përkatëse kushtetuese, në rastin e Kushtetutës së Kosovës, atyre të përcaktuara me nenin 95 të saj.
450. Gjykata, siç është sqaruar edhe më lart, gjithashtu vë theks në faktin se: (i) pretendimi i parashtruesve të kërkesës se formimi i një Qeverie që “*përjashton fituesin e zgjedhjeve*” është në kundërshtim me Aktgjykimin KO103/14, nuk qëndron, sepse ky Aktgjykim asnjëherë nuk ka konstatuar një gjë të tillë, por vetëm ka vënë theks në të drejtën e “*fituesit të zgjedhjeve*” që i pari të bëjë propozimin e emrit për mandatar për Kryeministër, respektivisht të drejtën e tentimit të parë për formimin e Qeverisë; (ii) pretendimi i parashtruesve të kërkesës që pas votimit të suksesshëm të mosbesimit në Kuvend, lejohet vetëm edhe një tentim për formimin e Qeverisë, gjithashtu nuk qëndron. Siç është sqaruar më lart, përpos në raste kur parashihet “*mocioni konstruktiv*” apo edhe ato raste kur pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, Kushtetuta shprehimisht përcakton vetëm edhe një mundësi për formimin e Qeverisë, siç është për shembull rasti i Shqipërisë, të gjitha rastet tjera, lejojnë shterimin e të gjitha mundësive kushtetuese, e në raste të caktuara edhe deri në katër tentativa apo edhe mundësinë e votimit të më shumë se një kandidati për Kryeministër në të njëjtën kohë, për të formuar Qeverinë dhe evituar zgjedhjet e parakohshme. Një konstatim i tillë është i qartë nga Analiza Krahimore dhe përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias, edhe në vet rastet e Kushtetutave të referuara nga parashtruesit e kërkesës; dhe (iii) pretendimi i Kryeministrit në detyrë përkitazi me epërsinë e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Final të Kosovës në raport me Kushtetutën e Kosovës dhe

epërsinë e gjuhës angleze si burimin autentik i Kushtetutës në raport me “*versionet e përkthyerat*”, gjithashtu nuk qëndron. Gjykata rikujton që bazuar në nenin 5 të Kushtetutës gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe; dhe se me amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës në vitin 2012, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës nuk ka asnjë efekt juridik në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

451. Gjykata, përfundimisht, thekson se përmes këtij Aktgjykimi tashmë është konstatuar se: (i) Dekreti i kontestuar është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës; (ii) votimi i suksesshëm i mocionit të mosbesimit bazuar në paragrafin 6 të nenit 100 rezulton në efektin e dorëheqjes së Qeverisë; (iii) në rast të ekzistimit të shumicës së nevojshme në Kuvend për zgjedhjen e Qeverisë së re pas dorëheqjes së Qeverisë paraprake, përfshirë rrethanat e paragrafit 6 të nenit 100 të Kushtetutës, aktivizohet paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës, përmes të cilit Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë; (iv) në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë së propozuar, qoftë shkaku i mungesës së shumicës së votave të nevojshme të të gjithë deputetëve të Kuvendit apo edhe qoftë shkaku i refuzimit të propozimit të kandidatit për Kryeministër nga “*partia politike ose koalicioni që e ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, siç është sqaruar në Aktgjykimin KO103/14, aktivizohet paragrafi 4 i nenit 95 të Kushtetutës, mbi bazën e të cilit është nxjerrë Dekreti i kontestuar.
452. Mbi këtë bazë, për të vlerësuar përputhshmërinë e Dekretit të kontestuar me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, dhe marrë parasysh që kandidati për Kryeministër nuk është votuar dhe as nuk ka dështuar në Kuvend, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 95 të Kushtetutës, por nuk është propozuar nga partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë, Gjykata fillimisht duhet të vlerësoj nëse në rrethanat e rastit konkret, “*partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, përkatësisht LVV, ka refuzuar marrjen e mandatit për Kryeministër, apo më saktësisht, ka refuzuar të propozojë mandatarin për formimin e Qeverisë, siç është përcaktuar në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, konstatimi i kushtetutshmërisë së këtij Dekreti me nenin 95 të Kushtetutës, do të trajtohen në analizën vijuese.

V. LIDHUR ME ZBATIMIN E PROCEDURËS KUSHTETUESE QË KA REZULTUAR NË DEKRETIN E KONTESTUAR

453. Gjykata rikujton se çështja e mbetur kushtetuese që ndërlidhet me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar e të nxjerrë bazuar në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, ndërlidhet me vlerësimin e procedurës së ndjekur përkitazi me zbatimin e paragrafit 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës. Më saktësisht, Gjykata duhet të vlerësojë nëse nxjerrja e Dekretit të kontestuar bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, ka pasuar shterimin e të drejtës të *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, në rrethanat e rastit konkret LVV, për: (i) të propozuar mandatarin për Kryeministër bazuar në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës; dhe (ii) për të paraqitur përbërjen e Qeverisë së tij/saj para Kuvendit dhe për të kërkuar miratimin nga ana e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, siç është përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës.
454. Në rrethanat e rastit konkret, *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht LVV, nuk ka propozuar mandatarin për Kryeministër për formimin e Qeverisë, siç përcaktohet në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht nuk është ndjekur procedura e përcaktuar përmes paragrafi 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse, siç është përcaktuar në Aktgjykimin KO103/14, *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, ka refuzuar të marrë mandatin për Kryeministër (shih paragrafin 87 të Aktgjykimit KO103/14).
455. Në këtë aspekt, janë dy çështje që duhet të interpretohen nga Gjykata. Çështja e parë ka të bëjë me afatin brenda të cilit *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”* duhet të bëjë propozimin e kandidatit për Kryeministër tek Presidenti, i cili mandatohet nga ky i fundit, siç është përcaktuar në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës. Ndërsa, çështja e dytë ka të bëjë me vlerësimin nëse, në rrethanat e rastit konkret, marrja e mandatit është refuzuar, si rezultat i mos propozimit të emrit, përkatësisht kandidatit për Kryeministër nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht LVV.

456. Për qëllime të trajtimit të këtyre çështjeve, në vijim, Gjykata do të paraqes: (1) Thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komentet mbështetëse të pranuar nga palët e interesuara (shih paragrafët 62-92, 122-167 dhe 192-205 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të këtyre pretendimeve dhe komenteve mbështetëse); (2) Thelbin e argumenteve të palës kundërshtare dhe palëve të tjera të interesuara që kanë mbështetur palën kundërshtare (shih paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi për një pasqyrim të hollësishëm të kundërshtimeve dhe të komenteve në favor të kundërshtimit të tillë); (3) Përgjigjen e Gjykatës përkitazi me çështjet që ngërthejnë këto pretendime.

Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës

457. Parashtruesit e kërkesës, respektivisht tridhjetë (30) deputetët parashtrues, në thelb, pretendojnë se: (i) Kushtetuta nuk parasheh afat brenda të cilit duhet të propozohet mandatarin nga partia politike ose koalicioni që ka fituar zgjedhjet; dhe se (ii) heqja dorë nga e drejta për të deklaruar propozimin e mandatarit tek Presidenti mund të bëhet vetëm shprehimisht. Pretendimet e parashtruesve për jokushtetutshmëri të Dekretit të kontestuar të Presidentit janë mbështetur nga Kryeministri, Kryetarja e Kuvendit dhe Nënkryetarja e Kuvendit, gjithnjë sipas arsyeve specifike të cekura nga secila palë e interesuar në parashtruesat e tyre të dorëzuara në Gjykatë dhe të reflektuara detajisht në paragrafët 62-92, 122-167 dhe 192-205 të këtij Aktgjykimi. Në vijim, Gjykata do të paraqes, thelbin e pretendimeve përkitazi me çështjen e afatit dhe (mos) refuzimit për propozimin e mandatarit për Kryeministër.

Thelbi i pretendimeve përkitazi me (mungesën e) afatin[t]

458. Sipas parashtruesve të kërkesës: (i) Presidenti e ka interpretuar nenin 95 në mënyrë arbitrare, duke supozuar (konkluduar) se, partia fituese ka refuzuar të propozojë mandatarin brenda një afati njëzet (20) ditësh të përcaktuar nga vet Presidenti; (ii) Kushtetuta e as ndonjë vendim i Gjykatës nuk parashohin afat se kur duhet ta propozojë mandatarin partia fituese; (iii) qëllimi i mos përcaktimit të afatit nga partia fituese është që, sipas Kushtetutës, partia fituese ka të drejtën ekskluzive që të dërgojë emrin e kandidatit në momentin më të përshtatshëm kur ajo vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet politike, administrative dhe teknike për dërgimin e një emri tek Presidenti; (iv) afati njëzet (20) ditë i përdorur nga Presidenti ose çfarëdo afati tjetër është arbitrar dhe kundërkushtetues; (v) parimisht nuk mund të kërkojë afat nga tjetri përderisa ai afat nuk është i paraparë me Kushtetutë ose legjislacion në fuqi; (vi) afati nuk mund

të konsumohet me këmbim të letrave por afatin e konsumon periudha e përcaktuar me Kushtetutë, e nuk mund të respektohet afati i cili nuk është i paraparë me Kushtetutë; (vii) ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese, e ky diskrecion është i paafatizuar; (viii) historia e krijimit të institucioneve kushtetuese të vitit 2014 dëshmon qartë se formimi i Qeverisë ka zgjatur mbi gjashtë (6) muaj, vetëm dhe kryekëput si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese te Presidenti; (ix) mungesa e afateve është në të njëjtën logjikë sikurse me kushtetutat e shteteve evropiane; (x) mos-përcaktimi i afateve me kushtetuta është i qëllimshëm sepse forcat politike nuk mund të detyrohen të lidhin koalicione paszgjedhore lehtësisht, sidomos kur ekzistojnë shpërputhje të mëdha në programet e tyre; (xi) afatet kushtetuese në raport me formimin e Qeverisë fillojnë të rrjedhin vetëm në momentin kur Presidentit i propozohet një kandidat për Kryeministër; (xii) duke caktuar afate në mënyrë arbitrare, Presidenti po rrezikon funksionimin kushtetues të institucioneve; (xiii) mungesa e afatit implikon qëllimin që ti lihet partisë fituese hapësirë për negociata për krijimin e Qeverisë; (xiv) në rastin KO119/14, edhe pse partia fituese kishte vonuar emrin e Kryetarit të Kuvendit për gjashtë (6) muaj, Gjykata megjithatë nuk kishte kufizuar ndonjë afat; (xv) në rastet kur kufizimi i afatit ishte qëllimi i hartuesve të Kushtetutës, ata e kanë bërë një gjë të tillë në mënyrë shprehimore dhe kjo vërehet p.sh. afati pesëmbëdhjetë (15) ditë i përcaktuar pas dhënies së emrit për mandatar herën e parë dhe 10 ditë herën e dytë; dhe (xvi) se Kushtetuta ka përcaktuar afate shprehimore në nene të tjera të Kushtetutës, respektivisht nenet 66.1; 66.2; 70.2; 82.1 (1) dhe (3); 86.2; 86.6; 95.2; 95.4; 100.3; 100.5; 113.5; 131.5; 131.6; 145.1; 145.2; 161.

459. Sipas Kryeministrit: (i) Kushtetuta nuk parasheh afate për partinë politike apo koalicionin fitues që të propozojë një emër për kandidat për Kryeministër; (ii) Kushtetuta me nenin 95 ka përcaktuar rrjedhjen e afateve vetëm pasi kandidati për Kryeministër të jetë emëruar, duke mos përcaktuar afate në asnjë moment më herët; (iii) praktikat e vitit 2014 dhe 2017 tregojnë se ka pasur disa raste kur zgjedhja e Qeverisë ka zgjatur më tepër se gjashtë (6) muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe konstituimit të Kuvendit mirëpo Presidentët në ato raste nuk kanë ndërhyrë duke iu bërë presion forcave politike për të dërguar emrin; (iv) Presidenti nuk duhet të imponohet por duhet të pres propozimin nga partia fituese; (v) Kushtetuta ia ndalon vetiniciativën Presidentit dhe e obligon atë që të pres propozimin nga partia politike ose koalicioni parazgjedhor që është fitues.

460. Sipas Kryetares së Kuvendit: (i) Presidentit me Kushtetutë nuk i njihet në asnjë formë kompetenca e kushtetutbërjes, as në kuptim të

përcaktimit të afateve kohore lidhur me mandatin e kandidatit për Kryeministër, përderisa një normë e tillë kushtetuese nuk ekziston; (ii) duke caktuar afat, Presidenti ka krijuar normë të re kushtetuese, për çështje për të cilën Kushtetuta qëndron e heshtur; (iii) Kushtetuta nuk përcakton afate sa i përket kohës që ka në dispozicion subjekti fitues i zgjedhjeve për të dërguar emrin e kandidatit për Kryeministër; (iv) të vetmet afate kushtetuese që fillojnë të konsumohen janë ato pas mandatin formel të mandatarit nga ana e Presidentit; (v) përmes përcaktimit të afateve kohore, Presidenti ka ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit si i vetmi institucion që ka kompetencë të amendamenteve Kushtetutën; (vi) Presidenti ka tejkaluar kompetencat në momentin kur vet ka caktuar afate dhe kjo është bërë në shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve; (vii) nëse qëllimi i hartuesve do të ishte që të caktonin afat, hartuesit do të mund ta caktonin atë shprehimisht; dhe (viii) në rastin KO119/14, Gjykata nuk përcaktoi afate por një gjë të tillë ia la jetës politike përkundër faktit që partia e parë për muaj të tërë nuk dërgonte emër për Kryetar Kuvendi.

461. Sipas Nënkryetares së Kuvendit: (i) Presidenti nuk ka autorizime kushtetuese për të caktuar në mënyrë arbitrare afate të cilat nuk i parasheh Kushtetuta se deri kur duhet të dërgojë propozimin për mandatar; (ii) kur është fjala për procedurën e zgjedhjes së Qeverisë, Kushtetuta ka përcaktuar vetëm dy afate, respektivisht afatin 15 ditë pas emërimit të kandidatit dhe afatin 10 ditë për emërimin e kandidatit tjetër për Kryeministër nëse përbërja e Qeverisë së propozuar nuk merr besimin e Kuvendit; (iii) ekskluziviteti i dërgimit të emrit mbetet në diskrecionin e partisë fituese dhe ky diskrecion është i paafatizuar; (iv) nenit 95.1 dhe 95.5 i mungon afati kohor sikurse edhe mungon afati kohor në mes të procedurës së nenit 95.1 dhe 95.4, ngase e njëjta pyetje ishte edhe pas zgjedhjeve, se sa duhet të pritët mandatarin nga partia që ka fituar zgjedhjet për të siguruar numrat në Kuvend; dhe (v) neni 95 nuk përmban asnjë fjalë për afatin e caktimit të kandidatit nga partia fituese.

Thelbi i pretendimeve përkitazi me (mos) refuzimin

462. Sipas parashtresve të kërkesës: (i) LVV asnjëherë, në asnjë formë, nuk e ka refuzuar propozimin për të paraqitur kandidatin e ri për kryeministër; (ii) Presidenti e ka kërkuar me shkresë mandatarin dhe e ka refuzuar pa asnjë bazë kushtetuese propozimin i cili në bazë të Kushtetutës ishte dashur ta bënte LVV; (iii) të drejtën kushtetuese për pranim ose refuzim shprehimor e ka vetëm partia fituese e zgjedhjeve; (iv) Presidenti ka usurpuar kompetencat e Kryetarit të LVV për të refuzuar shprehimisht, në formë të shkruar, propozimin për mandatarin; (v) sipas Aktgjykimit KO103/14, paragrafi 87, të drejtën

ekskluzive për të refuzuar mandatin e ka vetëm partia që i ka fituar zgjedhjet; (vi) Presidenti ka vepruar në mënyrë kundërkushtetuese me konstatimin se partia fituese me veprimet e saj nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë; (vii) Presidenti ka rol pasiv në formimin e Qeverisë dhe nuk i njihet rol aktiv në jetësimin e vullnetit të tij politik; (viii) refuzimi i shfrytëzimit të një të drejte bëhet në mënyrë shprehimore andaj dhe duhet që bartësi i të drejtës shprehimisht të heq dorë nga shfrytëzimi i saj; (ix) edhe Aktgjykimi KO103/14 flet për mundësinë e partisë për të refuzuar dërgimin e emrit për mandatar; dhe (x) në rastin konkret refuzimi nuk është bërë as në mënyrë eksplicite e as implicite, përkundrazi, partia fituese e ka njoftuar Presidentin se nuk e refuzon këtë të drejtë dhe se do e shfrytëzojë këtë të drejtë sa më parë që të jetë e mundur.

463. Sipas Kryeministrit: (i) Kryetari i LVV asnjëherë nuk refuzoi dhe nuk hoqi dorë nga e drejta e partisë së tij për të propozuar mandatarin; (ii) Gjykata ka thënë se Presidenti mund të anashkalojë fituesin e zgjedhjeve, vetëm nëse ky heq dorë shprehimisht nga e drejta e tij por në asnjë rrethanë tjetër; (iii) fituesi i zgjedhjeve asnjëherë nuk ka hequr dorë nga e drejta e saj kushtetuese për propozim të mandatarit; (iv) Presidenti e ka interpretuar në mënyrë arbitrare pyetjet për qartësim të dispozitës mbi të cilën thirret dhe kështu këto pyetje i ka interpretuar si refuzim për të propozuar kandidat për Kryeministër; (v) Kushtetuta nuk ia njeh Presidentit të drejtën që mos dërgimin e emrit të kandidatit ta konsiderojë si refuzim; (vi) mos refuzimi i Kryetarit të LVV për të propozuar kandidat për Kryeministër ka qenë i qartë për të dyja palët; dhe (vii) mos refuzimi është komunikuar me shkresë zyrtare nga Zyra e Kryeministrit dhe nuk ka krijuar asnjë paqartësi apo pasiguri juridike.
464. Sipas Kryetares së Kuvendit: (i) deri në momentin kur Presidentit i dërgohet emri nga subjekti politik, Kushtetuta nuk i ka dhënë Presidentit asnjë kompetencë apo rol aktiv; (ii) Presidenti ka tejkaluar autorizimet e tij kushtetuese kur ka konstatuar se nuk është shfrytëzuar e drejta për propozim të mandatarit, pa një deklaram shprehimor nga subjekti fitues i zgjedhjeve; dhe (iii) Kushtetuta nuk parasheh rol aktiv të Presidentit në rastet kur Kushtetuta qëndron e heshtur, respektivisht situatave juridike pa shprehje formale të vullnetit të partisë politike të cilës i është njohur kjo e drejtë dhe detyrim me Kushtetutë.
465. Sipas Nënkryetares së Kuvendit: (i) Presidenti nuk ka diskrecion për të caktuar apo refuzuar kandidatin për Kryeministër, sikurse as nuk ka diskrecion për vetiniciativë për të caktuar mandatarin; (ii) Presidenti nuk ka të drejtë të konstatoj ose interpretoj arbitrisht se meqenëse

brenda një afati të paqenë në kuptim kushtetues, partia politike nuk e ka dorëzuar emrin e kandidatit dhe kësisoj ka hequr dorë nga e drejta për të propozuar kandidatin për Kryeministër; (iii) duke qenë se Kushtetuta nuk parasheh ndonjë afat njëzet (20) ditor, si dhe duke qenë se Kryeministri e as Kryetari i LVV në asnjë rast nuk kanë refuzuar të dërgojë emrin nuk mund të konsiderohet se është hequr dorë nga propozimi i kandidatit për Kryeministër; (iv) Presidenti nuk ka autorizim që të konstatojë se një subjekt ka abdikuar nga një e drejtë për sa kohë nuk e ka refuzuar shprehimisht e as nuk ka hequr dorë formalisht nga propozimi i kandidatit për Kryeministër; dhe (v) Presidenti ka konstatuar jashtë autorizimeve të tij se LVV nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të propozuar kandidatin e ri për formim të Qeverisë.

Thelbi i argumenteve të palës kundërshtare

466. Pala kundërshtare, respektivisht Presidenti, në thelb, pretendon se për qëllim të sigurimit të funksionimit demokratik të institucioneve, Presidenti nuk mund të pres në pafundësi propozimin e partisë fituese për caktimin e emrit të mandatit dhe se partia fituese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të dërguar emrin. Argumentet në favor të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar të Presidentit janë dorëzuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetët e AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s, dhe deputeti i LDK-së, z. Arban Abrashi, për arsyt specifike të cekura nga secila palë e interesuara në parashtrësit e tyre të dorëzuara në Gjykatë dhe të paraqitura në hollësi në paragrafët 93-121, 168-191 dhe 206-216 të këtij Aktgjykimi.

Thelbi i kundërshtimeve përkitazi me (mungesën e) afatin[t]

467. Sipas Presidentit: (i) mungesa e afateve të sakta në Kushtetutë nuk e justifikon sjelljen e partisë që ka fituar shumicën relative që ta vonojë në pafundësi propozimin e mandatarit ngase vonesa në pafundësi do të rrezikonte funksionimin e institucioneve; (ii) mungesa e afatit nuk implikon që t'i lihet partisë fituese hapësirë për negociim për krijimin e Qeverisë por krejtësisht e kundërta, respektivisht mungesa e afatit kupton mundësinë që partia fituese të refuzojë mandatin në rastet kur kjo parti vëren që pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit me dy të tretat (2/3) nuk e ka një shumicë të tillë; (iii) situata hipotetike sipas së cilës partia fituese në pafundësi do të abuzonte me të drejtën e propozimit të kandidatit do të pamundësonte funksionimin normal të Qeverisë dhe të shumicës parlamentare; (iv) i takon Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit që të parandalojë situatën kur një parti politike do të rrezikonte në pafundësi

funksionimin e institucioneve; (v) vonimi do të dërgonte në bllokim të Kuvendit, ku në njërën anë partia fituese e shumicës relative nuk do të dërgonte propozimin e kandidatit për Kryeministër kurse në anën tjetër do të vazhdohej me një Qeveri në dorëheqje dhe një shumicë parlamentare që nuk pajtohet me të; (vi) situata e tillë do të rrezikonte funksionimin e Kuvendit që do të rrezikonte bllokimin e të gjitha institucioneve kushtetuese apo krizë të thellë të sistemit kushtetues; (vii) duke qenë se Presidentit i takon të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve, nuk ka mundur të pres në pafundësi partinë që ka fituar shumicën relative të bëjë propozimin shprehimor të mandatarit; (viii) Presidenti i gjendur në mes të vullnetit të partisë fituese relative që insistonte për shpërndarjen e Kuvendit dhe vullnetit të shprehur të të gjitha partive tjera të përfaqësuara në Kuvend që kërkonin themelimin e një Qeverie të re, është dashur të veprojë pa vonesë për të mos e rrezikuar funksionimin demokratik të institucioneve.

468. Sipas Grupit Parlamentar të LDK-së: (i) Kushtetuta nuk ka përcaktuar shprehimisht afat të caktuar për propozim të mandatarit por ka përcaktuar afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas mandatit të Presidentit për tu paraqitur përbërja e Qeverisë; (ii) hartuesit e Kushtetutës e kanë lënë këtë afat të hapur sepse kanë konsideruar se është në interes të subjekteve politike dhe të publikut që Qeveria të themelohet në afatin më të shpejtë të mundshëm; (iii) tani po vërtetohet se mos përcaktimi i një afati të arsyeshëm për dërgimin e emrit të mandatarit mund të keqpërdoret deri në abuzim nga fituesi relativ i zgjedhjeve; (iv) sipas frymës së Kushtetutës mbetet në detyrimin e Presidentit që të shterojë të gjitha mundësitë brenda një afati optimal; (v) në momentin kur Presidenti vlerëson se fituesi relativ i zgjedhjeve nuk ka vullnet për propozimin e kandidatit dhe se me çdo kusht po tenton të bllokojë themelimin e Qeverisë së re, Presidenti duhet të konsultojë subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe më pas të konstatojë se fituesi relativ nuk ka mundësi të krijojë shumicën parlamentare; (vi) në rastin kur Presidentit i dëshmohej krijimi i një shumice të re parlamentare, ajo/ai është i detyruar të dekretojë mandatarin për Kryeministër nga shumica e re parlamentare; (vii) interpretimi i parashtruesve të kërkesës lidhur me afatin se partia fituese mund ta dërgojë emrin e mandatarit në momentin më të përshtatshëm dhe kur janë plotësuar “*kushtet politike, administrative dhe teknike*” për dërgimin e emrit, është krejtësisht i gabuar sepse nuk është e qartë se çka mendohet me kushte politike, administrative dhe teknike si dhe kush do të vlerësojë se a janë përmbushur kushtet e tilla apo jo; dhe (viii) interpretimi i tillë i afatit do të sillte deri te ngërçet politike dhe deri te pengimi i funksionimit demokratik të institucioneve.

469. Sipas deputetëve të AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s: (i) ndonëse e drejta e propozimit të kandidatit për Kryeministër i takon partisë fituese kjo nuk nënkupton që partia fituese mund të abuzojë me të drejtën e saj për propozimin e mandatarit, në kuptimin që ta vonojë propozimin në pafundësi; dhe (ii) Gjykata duhet të ketë parasysh situatën kur partia fituese mund të abuzojë në vazhdimësi me të drejtën për të propozuar kandidatin dhe këtë ta balancojë me obligimin e Presidentit për të krijuar rrethana që mundësojnë funksionimin demokratik të institucioneve.
470. Sipas deputetit Arban Abrashi nga LDK: (i) sipas pretendimeve të parashtrueseve se ata mund të mos përgjigjen dhe të mos e dërgojnë emrin tek Presidenti deri në pjekje të kushteve politike, administrative, teknike, i bie që ata mund ta mbajnë pafundësisht peng procesin e formimit të Qeverisë; (ii) pavarësisht përparësisë që ka subjekti i parë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe e pakufizuar në kohë; (iii) çështja e propozimit të kandidatit nga subjekti i parë edhe mund të qëndroj se është e pa afatizuar, mirëpo nëse merren parasysh afatet e dhëna pas caktimit të kandidatit atëherë vërehen se këto afate janë tejet të shkurtra dhe qëllimisht të lëna ashtu nga hartuesit duke pas parasysh nevojën imanente që vendi të ketë Qeveri sa më parë; (iv) mos-afatizimi i kohës për propozim të mandatarit nuk mund të kuptohet si qëllim për ti lënë kohë subjektit të parë për të ndërtuar koalicione eventuale sepse bisedimet eventuale për formimin e Qeverisë duhet ti fillojë dhe zhvillojë mandatarin i caktuar zyrtarisht përmes Dekretit nga ana e Presidentit; (v) pas mos-propozimit të kandidatit për Kryeministër nga subjekti i parë brenda një kohe të arsyeshme dhe kur kemi parasysh se kjo çështje është e thjeshtë dhe krejt teknike, Presidenti ka propozuar kandidatin i cili ka gjasat më të mëdha për formimin e Qeverisë; (vi) sikur Presidenti të mos vepronte por të lejonte që për një kohë të gjatë të mos formohet Qeveria, Presidenti do të bënte shkelje kushtetuese duke mos vepruar në përputhje me kërkesën eksplicite që të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve; dhe (vii) Presidenti është i obliguar që të gjejë zgjidhje brenda autorizimeve të tij kushtetuese për shmangie të zgjedhjeve përmes formimit të Qeverisë së re.

Thelbi i kundërshtimeve përkitazi me (mos) refuzimin

471. Sipas Presidentit: (i) Presidenti i ka dërguar pesë (5) shkresa Kryetarit të LVV (më 2, 10, 15, 17 dhe 22 prill 2020), si subjekt politik me të drejtën për të propozuar kandidatin për Kryeministër; (ii) LVV nuk u është përgjigjur asnjërës prej shkresave për caktim të mandatarit ngase të gjitha përgjigjet kanë arritur nga Kryeministri në detyrë; (iii)

Presidenti me shkresën e datës 22 prill 2020 e ka njoftuar Kryetarin e LVV se duke pasur parasysh që nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e propozimit të kandidatit të ri, Presidenti, në përputhje me nenin 95 dhe Aktgjykimin KO103/14, do të procedojë tutje me konsultimet e përbashkëta me të gjithë liderët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend; (iv) kur nuk shfrytëzohet ose abuzohet me të drejtën e propozimit të kandidatit të ri, Presidenti është i autorizuar që të gjejë zgjidhje për të kaluar situatën; (v) mos-deklarimi apo mos-dërgimi i emrit nga ana e Kryetarit të LVV dhe deklarimet e tij publike për shmangien e dërgimit të emrit dhe duke përsëritur kërkesën për shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve, kanë qenë argumente të mjaftueshme për të treguar që LVV ka hequr dorë nga e drejta për të propozuar kandidatin për Kryeministër; (vi) LVV me çdo kusht është përpjekur të imponojë shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme; (vii) situatën e mosshfrytëzimit të së drejtës së marrjes së mandatisë e ka parashikuar edhe Gjykata në Aktgjykimin KO103/14; (viii) mundësia që partia e parë fituese të refuzojë mandatin lidhet me argumentin që nëse e njëjta, pas konsultimeve me partitë e tjera, vlerëson se nuk e ka shumicën për të formuar një Qeveri atëherë ajo duhet ta refuzojë propozimin e mandatarit; (ix) votimi i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së kaluar me tetëdhjetë e dy (82) vota të deputetëve të Kuvendit tregoi për ndryshimin e shumicës parlamentare në raport me partinë që ka fituar; (x) Presidenti ka bërë përpjekje që të konsultohet me LVV dhe i ka dhënë mundësinë që të propozojë mandatarin nga radhët e tyre; (xi) Presidenti pas konsultimit të vazhdueshëm është dashur që të gjejë rrugë për formimin e Qeverisë me qëllim të materializimit të vullnetit të partive politike dhe përfaqësuesve të popullit; (xii) të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, njëzëri, përveç LVV janë deklaruar për Qeveri të re dhe që vendi të mos shkojë në zgjedhje; (xiii) Presidenti në takimin konsultativ të 22 prillit 2020 i kishte njoftuar të pranishmit se meqenëse vullneti i shprehur i partive politike (që përfaqësojnë 91 deputetë) është që vendi të ketë Qeveri të re pa shkuar në zgjedhje atëherë mandati do ti jepet secilës parti apo koalicion që dëshmon që ka shumicën në Kuvend për të krijuar Qeverinë e re; (xiv) Presidenti e ka nxjerrë Dekretin me qëllim të shmangie së zgjedhjeve të parakohshme, pas pajtimit të shumicës absolute të partive politike të përfaqësuara në Kuvend për të formuar Qeveri të re; dhe (xv) nenet 4.3 dhe 84.2 të Kushtetutës i japin presidentit rol aktiv që të garantojë funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve.

472. Sipas Grupit Parlamentar të LDK-së: (i) vetëm pas pesë (5) letrave dërguar LVV-së, Presidenti ka konstatuar se ajo refuzon të dërgojë mandatarin dhe atëherë janë ftuar partitë politike të përfaqësuara në

Kuvend për tu pyetur nëse janë të gatshme për zgjedhje ose për formim të Qeverisë së re; (ii) të gjitha partitë janë deklaruar për evitim të zgjedhjeve dhe LDK, me dakordim të disa partive tjera, ka marrë përsipër krijimin e shumicës parlamentare; (iii) Presidenti, deri më 22 prill 2020, ia përcolli LVV-së katër kërkesa radhazi por asnjëherë nuk u dërgua propozimi i kandidatit për Kryeministër dhe kjo tregon qartazi se LVV nuk dëshironte ose refuzonte të propozonte kandidatin e saj; (iv) LVV asnjëherë nuk ka shprehur gatishmëri për të krijuar Qeveri të re dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim brenda forumeve partiake dhe nuk ka zhvilluar ndonjë takim me subjektet e tjera për të tentuar që të krijojë shumicë të re parlamentare; (v) këto rrethana qartazi tregojnë se LVV ka refuzuar të caktojë mandatarin dhe ka tentuar të bllokojë themelimin e Qeverisë së re; dhe (vi) asnjë fitues relativ i zgjedhjeve nuk e ka monopolin e legjitimitetit demokratik, e aq më pak në rastet kur abstenon/refuzon për të shfrytëzuar të drejtat kushtetuese.

473. Sipas deputetëve të AKR-së të mbështetur nga deputetët e NISMA-s: (i) e drejta e propozimit të kandidatit nga partia fituese nuk është e drejtë absolute dhe e njëjta relativizohet edhe më shumë në situatën post-mocion mosbesimi ku qartazi shumica parlamentare ose qëndrimi i deputetëve ka ndryshuar; (ii) nëse partia fituese e shumicës relative insiston në të drejtën e propozimit të mandatarit atëherë nuk do të duhej në vazhdimësi në komunikimet me Presidentin të theksonte se dëshiron të shkoj në zgjedhje dhe të shpërndahet Kuvendi; dhe (iii) Presidenti ka vepruar drejtë kur ka vepruar në drejtim të krijimit të Qeverisë së re ngase Presidentit i kërkohet që të gjejë kriteret mbizotëruese për të mundësuar krijimin e Qeverisë dhe të shmangen zgjedhjet.
474. Sipas deputetit Arban Abrashi nga LDK: (i) Presidenti ka ndërmarrë një varg veprimesh me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë të tij kushtetuese që caktimin e mandatarit ta bëjë pas konsultimit me partinë apo koalicionin që përbëjnë shumicën në Kuvend; (ii) fituesi relativ i zgjedhjeve ka vepruar në mënyrë të papërgjegjshme në raport me përgjegjësinë për formimin e Qeverisë të cilën ia njeh Kushtetuta; (iii) në rastin konkret, nuk kemi të bëjë me veprime kundërkushtetuese të Presidentit por me mosveprim, mos-propozim të kandidatit qëllimshëm nga LVV; (iv) përparësia që Kushtetuta ja jep subjektit të parë duhet të përveç si privilegj duhet të shihet edhe si përgjegjësi e fituesit përballë vendit dhe qytetarëve; dhe (v) Presidenti ka vepruar drejtë kur pas pesë (5) letrave dhe dy (2) takimeve që kishte në një periudhë prej rreth njëzet (20) ditësh kishte propozuar kandidatin nga rradhët e subjektit të dytë, pasi që fituesi relativ nuk kishte dorëzuar emër por kishte thënë publikisht se jemi për zgjedhje.

PËRGJIGJA E GJYKATËS – përkitazi me zbatimin e procedurës kushtetuese që ka rezultuar në Dekretin e kontestuar

475. Gjykata rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë shteti i Republikës së Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën dhe jo të izoluara nga njëra tjetra. Vetëm në këtë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i normave të caktuara kushtetuese dhe i mundësohet Gjykatës interpretimi i paqartësive lidhur me zbatimin e kompetencave kushtetuese në përputhshmëri me qëllimin dhe frymën e Kushtetutës.
476. Gjykata gjithashtu thekson që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo bllokojë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre, sepse vetëm në atë mënyrë mund të zbatohet drejt parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
477. Gjykata rithekson se interpretimi i Kushtetutës në mbështetje të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, është posaçërisht i rëndësishëm përkitazi me themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, rezultatet e të cilave i përcaktojnë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit për një mandat katër (4) vjeçar në Kuvendin e Republikës, dhe më pas, Qeverinë e tyre, të zgjedhur përmes Kuvendit, sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë, për një mandat me të njëjtën kohëzgjatje, apo për aq sa një Qeveri, ka besimin e përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të përfaqësuar në Kuvend.
478. Për më tepër, Gjykata thekson se funksionimi demokratik i institucioneve është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin e Republikës së Kosovës, ashtu që kjo e fundit të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar. Çdo pengesë ose mungesë bashkëpunimi në përmbushjen e detyrimeve dhe autorizimeve kushtetuese, është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës.

Lidhur me afatin kohor brenda të cilit propozohet kandidati për Kryeministër

479. Gjykata rikujton që thelbi i kontestit përkitazi me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar ndërlidhet me mungesën e saktësimit të një afati kohor në Kushtetutë, lidhur me caktimin e mandatarit për Kryeministër. Gjykata rikujton që: (i) paragrafi 14 i nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, përcaktojnë detyrën e Presidentit për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë nga radhët e *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, *“pas propozimit”* të kësaj të fundit dhe *“në konsultim”* me të.
480. Gjykata në këtë aspekt, thekson se mungesa e një saktësimi të tillë në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, duhet të analizohet në kuptim të: (i) afateve kushtetuese që Kushtetuta ka përcaktuar për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, me theks të veçantë në ato që janë përcaktuar për qëllime të themelimit të Qeverisë; dhe, (ii) përmbajtjes së shprehjeve *“propozim”* dhe *“konsultim”* për qëllime të caktimit të mandatarit për Kryeministër.
481. Fillimisht, në kuptim të afateve të përcaktuara në Kushtetutë, përkitazi me themelimin e Qeverisë, Gjykata thekson, se Kushtetuta, përcakton një strukturë afatesh të sakta që tregojnë qëllimin: (i) për themelimin e shpejtë të Qeverisë; dhe (ii) pasojën e shpërndarjes së Kuvendit, nëse të njëjtat afate nuk respektohen.
482. Më saktësisht, formimin e institucioneve pas zgjedhjeve, Kushtetuta bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, e ndërlidhë me shpalljen zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve. Bazuar në po të njëjtin nen, përcaktohet që mandati i Kuvendit të zgjedhur fillon nga dita e seancës konstitutive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të zgjedhjeve. Gjykata rikujton që ajo përmes Aktgjykimit KO119/14, ka vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit Nr. 05-V-001 të 17 korrikut 2014 për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, përmes të cilit, ka interpretuar kuptimin e *“grupit më të madh parlamentar”*, siç është referuar në paragrafin 2 të nenit 67 të Kushtetutës (shih paragrafin 116 të Aktgjykimit KO119/14) dhe kishte konstatuar në pikat a) dhe b) të Dispozitivit si në vijim: (i) mbledhja dhe procedura e ndjekur pas pezullimit të seancës konstitutive, më 17 korrik 2014, nga Kryesuesja, për shkak të mungesës së kuorumit, kanë shkelur nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1), të Kushtetutës dhe Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene; dhe (ii) Vendimi Nr.05-V-001, i 17 korrikut, është jokushtetues, si për nga procedura e ndjekur, ashtu edhe nga përmbajtja, pasi nuk ishte grupi më i madh

parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit, dhe rrjedhimisht, i pavlefshëm (shih Dispozitivin e Aktgjykimit KO119/14).

483. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se pretendimi i parashtresve të kërkesës se historia e krijimit të institucioneve kushtetuese në vitin 2014 dëshmon qartë se formimi i Qeverisë ka zgjatur mbi gjashtë (6) muaj, *“si pasojë e mosdërgimit të emrit të mandatarit nga partia fituese te Presidenti”*, nuk është i saktë. Vonesat e referuara janë të ndërlidhura me mos konstituimin e Kuvendit, dhe Gjykata, asnjëherë nuk ka vlerësuar çështje që ndërlidhen me afatet përkitazi me konstituimin e Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës.
484. Menjëherë pas konstituimit të Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, pason detyrimi i Presidentit, për të filluar procedurën për formimin e Qeverisë, duke zbatuar paragrafin 4 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës. Ky detyrim po ashtu pason menjëherë pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë rastet e votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, bazuar paragrafin 4 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës. Fillimi i procedurës për formimin e Qeverisë, nënkupton detyrimin e Presidentit për të caktuar mandatarin për Kryeministër, *“pas propozimit”* të dhe *“në konsultim”* me *“partinë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht fituesin e zgjedhjeve.
485. Caktimi i mandatarit rezulton në rrjedhjen e dy lloj afatesh paralele: (i) atë të përcaktuar në pikën 1 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës; dhe (ii) ato të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës. Afati i parë, përkatësisht ai i nenit 82 të Kushtetutës, përcakton gjashtëdhjetë (60) ditë kohë për formimin e një Qeverie, dështimi i formimit të së cilës, rezulton në pasojën e shpërndarjes së Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme. Një dispozitë e tillë, reflekton rëndësinë që Kushtetuta ka vënë në themelimin e shpejtë të Qeverisë, dhe në të kundërtën, pasojën përkatëse të shpërndarjes së Kuvendit. Për më tepër, brenda kësaj periudhe gjashtëdhjetë (60) ditore, përmes nenit 95 të Kushtetutës, janë përcaktuar gjithashtu afate të sakta, përkitazi me dy mundësi për formimin e Qeverisë, pas zgjedhjeve ose pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë në rast të votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit nga Kuvendi. Neni 95 i Kushtetutës përcakton: (i) afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor brenda të cilit kandidati për Kryeministër nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit dhe

kërkon miratimin nga ana e Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 95 të Kushtetutës; (ii) afatin dhjetë (10) ditore brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, në rast se kandidati i parë për Kryeministër dështon të i sigurojë votat e nevojshme në Kuvend apo edhe refuzon mandatin përkatës; dhe (iii) duke iu referuar “*procedurës së njejtë*”, në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, afatin pesëmbëdhjetë (15) ditore, brenda të cilit kandidati tjetër për Kryeministër, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit dhe kërkon miratimin nga ana e tij.

486. Gjykata rithekson se afatet e lartcekura reflektojnë rëndësinë që Kushtetuta ka dhënë themelimit të shpejtë të Qeverisë, duke përcaktuar afatet pesëmbëdhjetë (15) ditore, për kandidatin për Kryeministër, për të negociuar dhe arritur marrëveshjet e nevojshme për të siguruar votat e nevojshme të deputetëve të Kuvendit për votimin e Qeverisë së propozuar. Ky afat vlen për propozimin e Qeverisë përkatëse në Kuvend. Përderisa i njëjti nuk përcakton edhe afatin brenda të cilit Kuvendi miraton Qeverinë ose jo, veprimi i Kuvendit duhet të jetë i shpejtë dhe brenda afatit të tërësishëm (60) gjashtëdhjetë ditore brenda të cilit janë të parapara të dy mundësitë për formimin e Qeverisë. Në të kundërtën, dhe siç është sqaruar edhe më lart, Kushtetuta ka përcaktuar pasojën e shpërndarjes së Kuvendit dhe zgjedhjeve të parakohshme, siç është përcaktuar në pikën (1) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës.
487. Gjykata verën se një afat përkritazi me caktimin e mandatarit për Kryeministër nuk është saktësuar në Kushtetutë vetëm përkritazi me: (i) mandatarin e parë për Kryeministër, përkatësisht mandatarin e propozuar nga “*partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, pas zgjedhjeve bazuar në paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës; dhe (ii) mandatarin e parë për Kryeministër, përkatësisht mandatarin e propozuar nga “*partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë edhe situatën pas votimit të suksesshëm të një mocioni të mosbesimit, bazuar në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës.
488. Por, Gjykata gjithashtu vëren se ky afat nuk është i saktësuar jo vetëm lidhur me propozimin e mandatarit nga ana e “*partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”; por edhe lidhur me mandatin e të njëjtit nga Presidenti dhe përcjelljen e mandatarit të propozuar Kuvendit. E njëjta nuk vlen për mandatarin e dytë për Kryeministër, në rast të dështimit të të parit, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 95

të Kushtetutës, rast ky në të cilin, Kushtetuta ka përcaktuar saktësisht dhjetë (10) ditë në dispozicion të Presidentit për caktimin e tij bazuar në propozimin e partisë ose koalicionit, i cili, siç është sqaruar në Aktgjykimin KO103/14, në vlerësimin e Presidentit se ka gjasën më të madhe për të formuar Qeverinë dhe rrjedhimisht për të shmangur zgjedhjet.

489. Ky dallim në mënyrën e saktësisht të afateve në rast të zbatimit të: (i) paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, si pas zgjedhjeve ashtu edhe pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përkitazi me mandatarin e parë për Kryeministër; dhe (ii) paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, si pas zgjedhjeve ashtu edhe pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përkitazi me mandatarin e dytë për Kryeministër, në rast të dështimit të të parit, është i rëndësishëm në dritën e kuptimit dhe dallimeve që ngërthejnë shprehjet *“pas propozimit”* dhe në *“konsultim me”* partinë politike ose koalicionin përkatës, kur aplikohen në rast të përcaktimit të mandatarit të parë dhe të dytë, respektivisht.
490. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në Aktgjykimin KO103/14, ka vënë theks në dallimin në mes mënyrës së caktimit të këtyre dy mandatarëve dhe kuptimit të shprehjeve në *“në konsultim me”* dhe *“pas propozimit”* në zbatimin e procedurave përkatëse. Më saktësisht, këto shprehje në rastin e përcaktimit të mandatarit të parë, dhe në mungesë të plotë të diskrecionit të Presidentit përkitazi me partinë politike ose koalicionin që duhet konsultuar, nënkuptojnë një proces *“konsultimi”* krejtësisht formal dhe teknik. Më saktësisht, në çdo rast, si pas zgjedhjeve apo pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë është plotësisht e qartë: (i) cila është *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*; (ii) që kjo është partia politike ose koalicioni i vetëm me të cilin Presidenti mund të konsultohet për qëllime të përcaktimit të mandatarit për Kryeministër; dhe (iii) që Presidenti vetëm duhet të mandatoj emrin e propozuar nga kjo parti politike ose koalicion. Prandaj, *“konsultimi”* për qëllime të zbatimit të paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 e 5 të nenit 95 të Kushtetutës, nënkupton vetëm detyrimin reciprok, pra detyrimin e *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”* për të propozuar emrin e kandidatit për mandatar dhe, detyrimin e Presidentit për të mandatuar këtë emër.
491. Për dallim, në zbatimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, në dritën e

Aktgjykimit KO103/14, shprehja “*në konsultim me*” partinë politike ose koalicionin përkatës, ka kuptim më të gjerë. Në kontekst të paragrafit 4 të nenit 95 të Kushtetutës: (i) Presidenti nuk është i detyruar të “*konsultohet*” vetëm me “*partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, por me të gjitha partitë politike ose koalicionet e përfaqësuar në Kuvend; (ii) bazuar në këto konsultime, Presidenti duhet të vlerësojë se cila parti politike ose koalicion ka gjasën më të madhe për të formuar Qeverinë në mënyrë që të shmangen zgjedhjet; dhe (iii) Presidenti bazuar në këtë kushtëzim, përcakton partinë politike ose koalicionin, mandatarin e propozuar të të cilit do e mandatoj për Kryeministër, sigurisht duke mos pasur asnjë diskrecion në përcaktimin e emrit të kandidatit të propozuar. Në ushtrimin e këtij diskrecioni dhe përfundimit të të gjithë procesit të “*konsultimit*” në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit përkatës, Kushtetuta ka përcaktuar vetëm dhjetë (10) ditë.

492. Prandaj, duke vënë theks në dallimin që ngërthen “*konsultimi*” i Presidentit me partinë ose koalicionin përkatës në zbatimin e paragrafit 14 të nenit 84 në lidhje me: (i) paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, pa asnjë diskrecion; dhe (ii) paragrafin 4 të nenit të 95, me diskrecion, Gjykata thekson se nuk është saktësuar afati në përcaktimin e mandatarit të parë, në të cilin “*konsultimi*” ngërthen në vetvete një proces plotësisht formal dhe teknik, ndërsa është përcaktuar afat dhjetë (10) ditë, në përcaktimin e mandatarit të dytë, në të cilin “*konsultimi*” ngërthen një proces shumë më kompleks.
493. Në këtë kontekst, neni 95 i Kushtetutës lexuar në tërësinë e tij nuk mund të interpretohet të nënkuptojë që ky nen mundëson afat të pakufizuar në caktimin e mandatarit të parë bazuar në paragrafët 1 dhe 5 të nenit 95 të Kushtetutës, si për partinë politike ose koalicionin me të drejtën e propozimit ashtu edhe për Presidentin, në dritën e një procesi “*konsultimi*” krejtësisht formal e teknik, pa asnjë diskrecion apo paqartësi; përderisa, i njëjti nen ka kufizuar saktësisht afatin në dhjetë (10) ditë brenda të cilave propozohet dhe përcaktohet mandatarin e dytë, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, e që ngërthen në vetvete një proces shumë më të ndërlikuar “*konsultimi*” përkthyer me përcaktimin e mandatarit për Kryeministër. Përcaktimi i këtij afati dhjetë (10) ditë në Kushtetutë përkthyer me mandatarin e dytë, gjithashtu reflekton qëllimin e saj për përmbylljen e procesit të “*konsultimit*” për qëllime të caktimit të një mandatarin në afate të shkurtra kohore.
494. Për më tepër, pretendimi se partia politike ose koalicioni fitues mund të propozoj mandatarin për Kryeministër “*vetëm atëherë kur të jenë*

plotësuar kushtet politike, administrative dhe teknike” në vlerësimin e saj, do të ishte në kundërshtim me (i) qëllimin e Kushtetutës për themelimin e shpejtë të institucioneve, dhe posaçërisht Qeverisë, si bartëse e pushtetit ekzekutiv, të reflektuar përmes afateve të sakta kushtetuese të sqaruara më lart; (ii) nevojën e menjëhershme të formimit të Qeverisë, në rast të dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë edhe rastet e votimit të suksesshëm të mosbesimit, proces ky përmes të cilit Qeveria ekzistuese e humbet besimin e përfaqësuesve të popullit dhe legjitimitetin demokratik për të drejtuar pushtetin ekzekutiv; (iii) paragrafët 2 dhe 4 të nenit 95 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë afatet pesëmbëdhjetë (15) ditore, në dispozicion të kandidatit për Kryeministër për të arritur marrëveshjet e nevojshme dhe për të i propozuar Kuvendit Qeverinë; dhe (iv) qëllimin e pikës (1) të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës bazuar në të cilën parashihet pasoja e shpërndarjes së Kuvendit në rast të pamundësisë së formimit të Qeverisë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga caktimi i mandatarit të parë. Nëse afati për propozimin e mandatarit nga partia politike ose koalicioni fitues është në diskrecion të plotë të kësaj të fundit, por edhe Presidentit, për një afat të pakufizuar, atëherë afatet e lartcekura e pasojat përkatëse, nuk do të kishin asnjë kuptim e as vlerë.

495. Për më tepër, dhe posaçërisht duke marrë parasysh faktin që Kushtetuta i njeh *“partisë politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht fituesit të zgjedhjeve, të drejtën që e para të fillojë procesin e formimit të Qeverisë, e njëjta, duke u referuar në afatin e pakufizuar kohor në dispozicion për të propozuar emrin e mandatarit për Kryeministër, do të mund të bllokonte dinamikën e nevojshme për themelimin e shpejtë të Qeverisë për kohë të pakufizuar. Njëjtë, dhe edhe më me rëndësi, duke marrë parasysh faktin që Kushtetuta i njeh të drejtën e parë për të propozuar mandatarin për Kryeministër, edhe partisë politike ose koalicionit që, në rrethana të caktuara mund të ketë udhëhequr apo mund të ketë qenë i përfaqësuar në Qeverinë të cilës i është marrë besimi nga përfaqësuesit e popullit në Kuvend përmes votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, referimi në afatin e pakufizuar kohor në dispozicion për të propozuar emrin e mandatarit të ri për Kryeministër, do t'i mundësonte partisë politike ose koalicionit fitues të zgjedhjeve, bllokimin e krijimit të Qeverisë së re, përkundër faktit që e njëjta parti politike ose koalicion ka humbur besimin në Kuvend të Republikës për të udhëhequr me pushtetin ekzekutiv. Për më tepër, një qasje e tillë interpretimi do t'i mundësonte po ashtu Presidentit, që propozimin për mandatarin e parë për Kryeministër të mos e dekretoj për një afat të pakufizuar kohor dhe kështu të mbaj peng të gjithë procesin e formimit të Qeverisë. Një

interpretim i tillë, jo vetëm që është në kundërshtim me Kushtetutën, por bie ndesh edhe me vlerat themelore të një shoqërie demokratike.

496. Për pasojë, Gjykata thekson se mos saktësimi i një afati kohor në nenin 95 të Kushtetutës përkitazi me një proces “konsultimi” krejtësisht teknik dhe formal të propozimit të mandatarit të parë nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”* dhe detyrimit të Presidenti për emërimin dhe propozimin e të njëjtit Kuvendit, për dallim nga përcaktimi i afateve jo vetëm të sakta por edhe të shkurtra, përkitazi me çdo hap tjetër që ndërldhet me procedurën e formimit të Qeverisë, nënkupton që ky afat në fakt ngërthen në vetvete kërkesën për dinamikë të shpejtë ndërveprimi në mes partisë politike përkatëse dhe Presidentit. Bazuar në të gjitha sqarimet e mësipërme, ky qëllim kushtetues është i qartë dhe vetëkuptueshëm.
497. Në fakt, Kushtetuta nuk e ka saktësuar këtë afat duke u nisur nga premisa e qartë dhe e nënkuptueshme se: (i) Presidenti si garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit duhet të filloj procesin e formimit të Qeverisë përmes caktimit të mandatarit për Kryeministër, në mënyrë që Kuvendi të mund të ushtrojë përgjegjësinë themelore kushtetuese të zgjedhjes së Qeverisë; dhe (ii) qëllimi parësor i fituesit të zgjedhjeve është që të nisë menjëherë procesin e krijimit të Qeverisë së re dhe të marrë besimin e Kuvendit. Mbajtësi i të drejtës së propozimit përveç të drejtës të dhënë nga Kushtetuta për formimin e Qeverisë, njëkohësisht ka edhe detyrimin që këtë të drejtë ta ushtrojë në mirëbesim dhe të tregojë qëllimin e qartë se është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për krijimin sa më të shpejtë të organit ekzekutiv, dhe fillimit të zbatimit të planit qeverisës.
498. Gjykata gjithashtu vëren se një numër i Kushtetutave të përfshira në Analizën Krahimore të këtij Aktgjykimi, nuk e kanë gjithashtu të saktësuar këtë afat, përkundër faktit që të shumica kanë të përcaktuara afate të sakta dhe të shkurtra kohore, për të gjithë hapat që duhet ndjekur për formimin e një Qeverie nga momentin kur caktohet mandatarin i parë për Kryeministër, duke përfshirë edhe afatet kohore brenda të cilave, mandatohet secili kandidat pasues për Kryeministër. Mos-saktësimi i afatit kohor vetëm përkitazi me hapin e parë, atë për mandatimit të kandidatit të parë për Kryeministër, partia politike ose koalicioni prej të cilit i njëjti propozohet është gjithashtu saktë e identifikueshme në shumicën e Kushtetutave, nënkupton që mandatimi i kandidatit të parë për Kryeministër, duhet të bëhet sa më shpejt. Një intencë e tillë specifikohet për shembull edhe nga përgjigja e Bullgarisë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, e cila thekson

se përkundër faktit që Kushtetuta Bullgare nuk saktëson afatin për mandatin e kandidatit të parë për Kryeministër, ky afat është “*sa më shpejt që të jetë e mundur*”. Dinamika e shpejtë e fillimit të procesit për formimin e Qeverive, reflektohet edhe nga ato Kushtetuta, që në fakt, kanë të përcaktuar këtë afat. Kushtetutat e Malit të zi dhe të Maqedonisë së Veriut, për shembull, përcaktojnë mandatin e kandidatit për Kryeministër brenda tridhjetë (30) dhe dhjetë (10) ditësh respektivisht, nga momenti i konstituimit të Kuvendit. Ndërsa, në raste të formimit të Qeverive, pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, janë të përcaktuara afate edhe më të shkurta kohore, si për shembull në rastin e Kushtetutës së Estonisë e Lituaniës, në të cilat Qeveria e re i propozohet Kuvendit, brenda katërmëdhjetë (14) dhe pesëmbëdhjetë (15) ditëve, respektivisht.

499. Nëse Gjykata do të pranonte propozimin e deputetëve parashtrues, efektivisht Gjykata do të duhej të konstatonte se meqë Kushtetuta nuk ka saktësuar shprehimisht një afat për dërgimin e emrit të mandatarit tek Presidenti, partia politike ose koalicioni fitues, ka diskrecion që emrin ta dërgojë brenda 1 muaji, 1 viti, 2 vitesh, 3 vitesh, varësisht kur partia ose koalicioni fitues konsideron se janë pjekur kushtet e nevojshme, të cilësuar si kushte “*politike, administrative dhe teknike*” për të propozuar emrin e mandatarit për Kryeministër. E njëjta do të vlente edhe për Presidentin. Ky fundit do të mund të mbante dhe të mos e dekretonte propozimin e mandatarit derisa në vlerësimin e tij/saj të plotësoheshin kushtet e nevojshme, krejt kjo në mungesë të saktësisht të afatit për të dekretuar/dërguar emrin në Kuvend. Sikur ky interpretim të miratohej, asgjë nuk do të mund ta kufizonte diskrecionin e partisë politike ose koalicionit fitues dhe të Presidentit, tani ose në të ardhmen, që të përdorin këto të drejta dhe detyrime, në mënyrë dhe kohë të pakufizuar, duke përfshirë edhe bllokimin e zgjedhjes së Qeverisë pas zgjedhjeve, por edhe duke mbajtur në detyrë Qeverinë e cila ka humbur besimin e përfaqësuesve të popullit, përmes mospropozimit/mosdekretimit/mosdërgimit të emrit të kandidatit për Kryeministër, duke i pamundësuar kandidatit tjetër për Kryeministër që vjen nga radhët e një partie politike ose koalicioni dhe që mund të ketë shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë e re, dhe më me rëndësi, duke i pamundësuar Kuvendit ushtrimin e funksioneve të tij për të zgjedhur një Qeveri. Një interpretim i tillë, do të ishte qartazi në kundërshtim me Kushtetutën.
500. Për pasojë, Gjykata thekson se duke marrë parasysh që procesi i “*konsultimit*” në rastin e përcaktimit të mandatarit të parë, në mungesë të diskrecionit të Presidentit dhe me qartësi të plotë se cila është partia politike ose koalicioni me të drejtën e këtij propozimi, është krejtësisht formal dhe teknik. I njëjti ngërthen në vetvete, vetëm

detyrimin reciprok në mes Presidentit dhe partisë politike apo koalicionit fitues të zgjedhjeve, për caktimin e mandatarit për Kryeministër nga Presidenti pas propozimit të partisë politike ose koalicionit fitues. Ky “konsultim” duhet përmbyllet sa më shpejt që është e mundur përmes një dinamike të shpejtë ndërveprimi, duke marrë parasysh: (i) natyrën krejtësisht formale dhe teknike të këtij “konsultimi”; (ii) sistemin dhe strukturën e afateve kushtetuese përkitazi me formimin e Qeverisë; (iii) kufizimin prej dhjetë (10) ditësh që përcakton Kushtetuta në rast të caktimi të mandatarit të dytë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, dhe në të cilin për dallim, “konsultimi” është shumë më kompleks; dhe (iv) faktin që Kushtetuta ka përcaktuar afate të sakta pesëmbëdhjetë (15) ditore në dispozicion të kandidatëve për Kryeministër për të arritur marrëveshjet e nevojshme politike dhe për t’i propozuar Qeverinë Kuvendit.

Lidhur me mungesën e propozimit për kandidatin për Kryeministër

501. Në vazhdim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në rrethanat e rastit konkret, “*partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, përkatësisht LVV, ka propozuar apo refuzuar të propozojë, kandidatin për Kryeministër. Në këtë aspekt, Gjykata në vijim, fillimisht do të rikujtoj procedurën e ndjekur nga Presidenti i Republikës dhe partia politike fitues, përkatësisht LVV, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit kundër Qeverisë së udhëhequr nga e njëjta, në Kuvendin e Kosovës.
502. Gjykata rikujton që Mocioni i Mosbesimit ndaj Qeverisë është votuar me 25 mars 2020, me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Teksti i votuar nga kjo shumicë parlamentare gjithashtu reflekton vullnetin e tyre për të provuar mundësinë “*për formimin e një qeverie të stabilitetit*”.
503. Bazuar në shkresat e lëndës, më 1 prill 2020, Presidenti kishte takuar të gjithë përfaqësuesit e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuar në Kuvend, lidhur me “*hapat e mëtejshëm*” pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit. Në pajtueshmëri me vullnetin e shprehur përmes mocionit të mosbesimit të 25 marsit 2020, shumica e partive dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend janë deklaruar kundër shpërndarjes së Kuvendit dhe në mbështetje të mundësisë për formimin e një Qeverie të re.
504. Në të njëjtën ditë, Presidenti ishte takuar edhe me Kryeministrin në detyrë, njëherazi edhe Kryetarin e “*partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”,

përkatësisht LVV. Pas këtij takimi, ky i fundit, i ishte drejtuar Presidentit përmes dy shkresave, që mbajnë të njëjtën datë, përkatësisht atë të 1 prillit 2020, përmes të cilave kishte theksuar, ndër të tjera: (i) *“detyrën tuaj [të Presidentit] për të shpërndarë Kuvendin e Republikës së Kosovës pas mocionit të mosbesimit”*; dhe (ii) se *“Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe vet praktika juaj e mëparshme në vitin 2017, e bëjnë të qartë se, pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, e vetmja rrugë përpara është shpërndarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme”*, duke theksuar gjithashtu se *“për sa i përket interpretimeve të gabuara të nenit 95.5 të Kushtetutës, këtë temë të rëndësishme detyësore apo tretësore, mund të lëmë për ndonjë ditë tjetër”*.

505. Të nesërmen, përkatësisht me 2 prill 2020, Presidenti i kishte drejtuar dy shkresa, Kryetarit të LVV. Në të parën, kishte theksuar se takimi i një dite më parë, përkatësisht ai i 1 prillit 2020, ka qenë takim konsultues me Kryetarin e LVV, përkatësisht, *“liderin e partisë së parë sipas rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 6 tetor 2019”*, dhe rrjedhimisht takim i *“karakterit formal, juridik e procedural, për konsultim për të vlerësuar nëse është në interesin e partisë politike që përfaqësoni ju formimi i Qeverisë së re apo shpërndarja e Kuvendit”*. Ndërsa në të dytën, Presidenti kishte theksuar se: (i) LVV, është subjekti politik që *“ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, dhe bazuar në nenin 95 të Kushtetutës ka drejtën e propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë; dhe (ii) kishte kërkuar që LVV, të propozoj kandidatin e ri, i cili do të mandatohet për formimin e Qeverisë.
506. Shkresës së 2 prillit 2020, përmes të cilit Presidenti kishte kërkuar propozimin e mandatarit për Kryeministër nga Kryetari i LVV, ky i fundit nuk iu kishte përgjigjur. Rrjedhimisht, bazuar në shkresat e lëndës, më 10 prill 2020, Presidenti i kishte drejtuar një shkresë tjetër Kryetarit të LVV. Përmes kësaj shkrese, dhe duke rikujtuar shkresën e 2 prillit 2020, Presidenti ndër tjerash, kishte: (i) rikujtuar se është në pritje të propozimit të kandidatit për Kryeministër nga LVV, si subjekti politik që ka fituar shumicën në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe ka të drejtën e propozimit të kandidatit të ri për Kryeministër për të formuar Qeverinë; dhe (ii) kërkuar edhe një herë nga Kryetari i LVV që të propozonte kandidatin për Kryeministër, e të cili do të mandatohej nga Presidenti për formimin e Qeverisë.
507. Kësaj shkrese të Presidentit, Kryetari i LVV, i ishte përgjigjur më 13 prill 2020, duke mos e propozuar kandidatin për Kryeministër nga

radhët e saj, por duke theksuar, ndër të tjerash, se: (i) Presidenti ka për të detyrë vetëm të shpërndajë Kuvendin pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit; (ii) nuk është në kompetencën e Presidentit vlerësimi i *“interesave të partive politike”*; (iii) se takimi i 1 prillit 2020 me Presidentin e ka zhvilluar në cilësinë e Kryeministrit në detyrë, dhe jo Kryetarit të LVV; (iv) pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit, Presidenti ka të drejtën *“që të përmbush vetëm një veprim të caktuar nga kushtetutëdhënësi. Pra shpërndarjes e Kuvendit në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*; (v) se zgjedhjet janë opsioni i vetëm pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, duke u thirrur në praktikën e ndjekur në vitin 2010 dhe 2017, respektivisht; (vi) se Presidenti po e pengon punën e Qeverisë *“në mes të një gjendje emergjente të shëndetit publik”*, përmes kërkesave për propozimin e mandatarit për Kryeministër; dhe në fund, (vi) gjithashtu kishte theksuar se *“kjo shkresë nuk është refuzim për të ju dhënë një emër të kandidatit për Kryeministër”*.

508. Më 15 prill 2020, Presidenti i ishte përgjigjur shkresës së 13 prillit 2020 të Kryetarit të LVV, dhe i cili i kishte rikujtuar të njëjtit shkresat e 2 dhe 10 prillit 2020, respektivisht, dhe kishte theksuar: (i) se është edhe më tej në pritje të *“propozimit të kandidatit për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë”*; (ii) se ai është i detyruar me Kushtetutë që të garantoj funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe sigurimin e emrit të kandidatit për Kryeministër për të formuar Qeverinë dhe se *“qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të drejtë presin funksionalizmin e Qeverisë së re, si dhe presin nga Presidenti të caktojnë mandatarin e ri për formimin e Qeverisë”*; (iii) askush nuk ka të drejtë t'i privojë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në Kuvendin e Republikës për të pasur kandidatit për Kryeministër dhe për të ushtruar kompetencën për të zgjedhur Qeverinë, siç përcaktohet në nenin 65 (8) të Kushtetutës; (iv) vonesa juaj për propozimin e kandidatit/es për Kryeministër i pamundëson Kuvendit për të zgjedhur Qeverinë, dhe rrjedhimisht pamundëson edhe funksionimin demokratik të institucioneve, që sipas Kushtetutës, duhet të garantojë Presidenti; (v) bazuar në Aktgjykimin KO103/14, *“nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë të refuzojë të marrë mandatin”*; dhe (vi) i kërkoj edhe një herë propozimin për mandatarin për Kryeministër për formimin e Qeverisë.

509. Kryetari i LVV ishte përgjigjur në shkresën e lartcekur të Presidentit, më 17 prill 2020, duke theksuar se: (i) *“nuk e refuzojmë kërkesën tuaj”*

për propozim të mandatarit; por (ii) duke e cilësuar si “*çështje dytësore e tretësore*” kërkesën për propozimin e mandatarit për Kryeministër, kishte kërkuar sqarime nga Presidenti përkitazi me detyrimin e tij për të shpërndarë Kuvendin dhe bazën juridike të nenit 95 të Kushtetutës përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë, të cilit i referohet Presidenti.

510. Presidenti i ishte përgjigjur kësaj shkresë në të njëjtën ditë, përkatësisht më 17 prill 2020, duke i rikujtuar Kryetarit të LVV shkresat e tij të dërguara më 2 prill, 10 prill dhe 15 prill 2020, respektivisht, dhe duke kërkuar edhe një herë propozimin përkatës të mandatarit për Kryeministër nga radhët e partisë politike që ai përfaqëson. Përmes kësaj shkrese, Presidenti kishte theksuar se: (i) “*ju nuk keni propozuar kandidatin/en për Kryeministër, por keni theksuar se nuk jeni duke refuzuar për të propozuar kandidatin për Kryeministër*”; dhe (ii) “*se mosrefuzimi nga ana juaj nënkupton që ta dërgoni emrin e kandidatit për Kryeministër*”. Kësaj shkrese, Kryetari i LVV nuk iu ishte përgjigjur.
511. Më 22 prill 2020, Presidenti i kishte drejtuar edhe një shkresë Kryetarit të LVV, përmes të cilës: (i) kishte theksuar se përkundër shkresave të 2, 10, 15, e 17 prillit 2020, respektivisht, Presidentit nuk i ishte propozuar kandidati për Kryeministër; dhe (ii) kishte theksuar se Kryetari i LVV nuk kishte “*shfrytëzuar të drejtën e propozimit të kandidatit të ri për të formuar Qeverinë*”; dhe (iii) se bazuar në nenin 95 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin KO103/14, do të “*bëj konsultim të përbashkët me të gjithë liderët e subjekteve politike parlamentare për hapat e mëtejme*”. Në të njëjtën datë, Kryetari i LVV, i ishte përgjigjur shkresës së Presidentit duke theksuar se: (i) Presidenti kishte konstatuar “*jashtë kompetencave kushtetuese si President, se unë nuk paskam shfrytëzuar të drejtën për propozimin e kandidatit të ri për të formuar Qeverinë*”; (ii) Kushtetuta nuk parasheh një kompetencë të tillë të Presidentit për të “*vlerësuar apo konstatuar shfrytëzimin ose mosshfrytëzimin e të drejtës për të propozuar mandatarin*”; (iii) Kushtetuta dhe Aktgjykimi KO103/14, “*nuk kanë përcaktuar afatin për një gjë të tillë*”; dhe (iv) Kushtetuta parasheh “*caktimin e mandatarit vetëm pas propozimit nga partia ose koalicioni që e ka fituar shumicën absolute apo relative, siç përcaktohet edhe në pikën 84 të Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese*”.
512. Më 22 prill 2020, Presidenti kishte ftuar në një takim të përbashkët konsultativ liderët e partive parlamentare, duke përfshirë edhe Kryetarin e LVV. Pas këtij takimi dhe në të njëjtën datë, iu drejtua përmes shkresës Kryetarit të LDK-së, përkatësisht partisë politike të renditur pas LVV me më së shumti deputetë sipas zgjedhjeve të 6

tetorit 2019, e të cilit i kërkoi propozimin për mandatarin për Kryeministër për formimin e Qeverisë. Të njëjtën kërkesë Presidenti e përsëriti në adresë të Kryetarit të LDK-së edhe me 29 prill 2020. Në po të njëjtën datë, Kryetari i LDK-së iu përgjigj Presidentit, duke theksuar se mandatarin për Kryeministër do të propozohet së shpejti. Pas kësaj, z. Avdullah Hoti, u propozua kandidat për Kryeministër, të nesërmen më 30 prill 2020. Në të njëjtën datë, Presidenti dekretoi mandatin e tij për Kryeministër.

513. Në dritën e sqarimeve të mësipërme përkritazi me shkëmbimin e shkresave në mes të Presidentit dhe *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, përkatësisht LVV, Gjykata, siç është sqaruar më lart, në vijim duhet të vlerësojë nëse është shterur mundësia e përcaktuar përmes paragrafëve 5, 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës, përkritazi me caktimin e mandatarit të parë për Kryeministër për të formuar Qeverinë pas dorëheqjes së kësaj të fundit si rezultat i votimit të suksesshëm të mosbesimit në Kuvend, në mënyrë që të ketë qenë e mundur që Presidenti të caktoj kandidatin tjetër për Kryeministër, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës. Në rrethanat e rastit konkret, tashmë është e qartë, që tentativa e parë për formimin e Qeverisë, nuk ka dështuar në Kuvend si rezultat i dështimit të marrjes së shumicës së nevojshme të votave, por e njëjta pretendohet të ketë dështuar si pasojë e mungesës së propozimit të emrit të kandidatit për Kryeministër nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, dhe rrjedhimisht, sipas pretendimit të Presidentit, është refuzuar marrja e mandatit përkatës, siç është përcaktuar në Aktgjykimin KO103/14. Një pretendim të tillë të Presidentit e kundërshtojnë parashtruesit e kërkesës dhe Kryeministri në detyrë, përkatësisht, dhe për qëllime të këtij shqyrtimi, Kryetari i LVV. Prandaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse, bazuar në rrethanat e këtij rasti, *“partia politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, ka refuzuar marrjen e mandatit përkatës.
514. Ky vlerësim varet nga: (i) roli i Presidentit në përcaktimin e mandatarit për Kryeministër, siç është përcaktuar në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me nenin 95 të Kushtetutës; (ii) ndërvlerësia dhe detyrimet reciproke të Presidentit dhe *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, siç është përcaktuar në paragrafin 14 të nenit 84 të lidhje me nenin 95 të Kushtetutës; dhe (iii) rrethanat e formimit të një Qeverie të re, pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi në Kuvend.

515. Së pari, dhe sa i përket rolit të Presidentit në caktimin e mandatarit për Kryeministër, Gjykata vëren se: (i) Presidenti ushtron çdo kompetencë të tij duke u bazuar në nenin 83 të Kushtetutës, sipas të cilës, ai/ajo është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, kompetenca e tij/saj e përcaktuar përmes paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës, përkritazi me caktimin e mandatarin për formimin e Qeverisë në lidhje me paragrafët përkatës të nenit 95 të Kushtetutës, duhet të ushtrohet gjithnjë së bashku me kompetencën e Presidentit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë. Kjo sepse, përcaktimi i mandatarit ngërthen në vetvete jo vetëm raportin në mes të Presidentit dhe *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, por edhe raportin në mes të Presidentit dhe Kuvendit të Republikës, përkritazi me realizimin e kompetencës së këtij të fundit për zgjedhjen dhe shprehjen e mosbesimit ndaj Qeverisë, siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës.
516. Më saktësisht, ushtrimi i kompetencës së Kuvendit përkritazi me zgjedhjen e Qeverisë, është i varur nga ushtrimi i kompetencës së Presidentit të përcaktuar përmes paragrafi 14 të nenit 84 të Kushtetutës për caktimin e mandatarit për Kryeministër. Presidenti është i detyruar që këtë kompetencë të ushtroj në dritën e detyrimit të tij për garantimin e funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, duke filluar procedurat e *“konsultimit”* me partinë politike ose koalicionin përkatës për formimin e Qeverisë, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve apo menjëherë pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë edhe rastet e votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë në Kuvend. Në të kundërtën, Presidenti do të pengonte Kuvendin për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tij për zgjedhjen e Qeverisë. Prandaj, Presidenti në ushtrimin e kompetencës së përcaktuar përmes paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës, është edhe në rolin e ndërmjetësit në mes partisë politike ose koalicionit që ka shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë dhe Kuvendit. Caktimi i mandatarit, fillon procedurat kushtetuese për formimin e një Qeverie të re e cila i paraqitet Kuvendit për votim duke i mundësuar këtij ushtrimin e një prej kompetencave më esenciale të tij, atë të zgjedhjes së Qeverisë.
517. Së dyti, në lidhje me ndërvarësinë dhe detyrimet reciproke të Presidentit dhe të *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, Gjykata rikujton se kompetenca e Presidentit e përcaktuar në paragrafin 14 të

nenit 84 të Kushtetutës, ushtrohet “*në konsultim*” me partinë politike ose koalicionin që ka shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë. Pra, ky paragraf, i lexuar së bashku me nenin 95 të Kushtetutës, nuk ngërthen në vetvete vetëm detyrimin e Presidentit për të caktuar mandatarin, por edhe detyrimin e “*partisë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*” për të propozuar mandatarin. Në mungesë të një detyrimi të tillë reciprok, norma kushtetuese nuk do të mund të realizohej, dhe do të mbetej në diskrecion të plotë të “*partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, e cila duke mos e propozuar mandatarin për Kryeministër, do të pamundësonte jo vetëm ushtrimin e kompetencave të Presidentit, por edhe të drejtën e Kuvendit për të zgjedhur Qeverinë.

518. E drejta për të propozuar mandatarin për Kryeministër është edhe përgjegjësi dhe privilegj. Propozimi i këtij emri, ngërthen në vetvete pikën më të lartë të suksesit të një partie politike ose koalicioni drejt dhe brenda një cikli zgjedhor. E drejta e parë për të propozuar kandidatin për Kryeministër i është garantuar partisë ose koalicionit fitues të zgjedhjeve përmes Kushtetutës së Kosovës. Ushtrimi i kësaj të drejte, nuk është i mveshur edhe me autorizimin për të bllokuar formimin e një Qeverie brenda një cikli zgjedhor. Një qëndrim i tillë, do të i bënte peng të partisë politike ose koalicionit fitues, të gjitha institucionet më thelbësore të shtetit. Përkundrazi dhe për këtë arsye, Kushtetuta ka paraparë mekanizmin zhbollukes, përmes të cilit kalohet te një kandidat tjetër për Kryeministër, dështimi eventual i të cilit, do të rezultonte në shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme.
519. Në fund, nevoja për formimin e një Qeverie të re pas një votimi të suksesshëm të një mocioni të mosbesimit, është e menjëhershme. Kjo sepse, siç është sqaruar më lart, një Qeveri e zgjedhur nga Kuvendi, nuk vazhdon të ketë të njëjtin legjitimitet, në momentin kur, përfaqësuesit e popullit ia marrin besimin përmes votimit të një mocioni të suksesshëm të mosbesimit.
520. Për më tepër, bazuar në Analizën Krahimore dhe kontributin e Forumit të Venecias, në shumicën absolute të rasteve, pas votimit të suksesshëm të një mocioni të mosbesimit, Qeveria në dorëheqje nuk ka asnjë rol përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë së re. Presidentët përkatës, fillojnë procedurat kushtetuese për zgjedhjen e një Kryeministri tjetër që ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë dhe marr besimin e saj. Kjo me përjashtim të rasteve, kur Qeveria e shkarkuar është e mveshur me rol të caktuar përkitazi me shpërndarjen e Kuvendit pas votimit të një mocioni të suksesshëm të mosbesimit. Ky është rasti me: (i) nenin 104 të

Kushtetutës së Kroacisë, i cili përcakton se Presidenti mundet me propozimin e Qeverisë, me nënshkrimin e Kryeministrit dhe pas konsultimeve me përfaqësuesit e partive parlamentare, të shpërndajë Parlamentin kroat nëse ky i fundit, ndër të tjerash, kalon një votë mosbesimi në Qeveri; (ii) nenin 94 të Kushtetutës së Estonisë e cila parashikon që nëse mosbesimi shprehet ndaj Qeverisë ose Kryeministrit, Presidenti i Republikës mundet, me propozimin e Qeverisë dhe brenda tri ditëve, të shpallë zgjedhje të jashtëzakonshme për Riigikogu; (iii) nenin 58 të Kushtetutës së Lituanisë, i cili parasheh që zgjedhjet e parakohshme për Seimas gjithashtu mund të shpallen nga Presidenti, ndër të tjera, me propozimin e Qeverisë, nëse Seimas shpreh një mosbesimin në Qeveri; dhe (iv) sipas Kushtetutës Suedeze, dhe bazuar në përgjigjen e Suedisë në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, shpërndarja e Parlamentit mund të ndodhë vetëm nëse Qeveria thërret zgjedhje të jashtëzakonshme. Zgjedhjet e tilla mund të jenë rezultat i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, siç u përmend më lart.

521. Për dallim, Kushtetuta e Kosovës, si edhe shumica e Kushtetutave tjera, nuk përcakton asnjë kompetencë për Qeverinë e shkarkuar përmes votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi, përkitazi me shpërndarjen ose jo të Kuvendit. Partitë politike ose koalicionet që e kanë udhëhequr/përbërë të njëjtën, për qëllime të shpërndarjes së Kuvendit, reduktohen në fuqinë politike që e kanë përmes përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Republikës. Thënë këtë, Kushtetuta e Kosovës, i njeh *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht fituesit të zgjedhjeve të drejtën e parë të propozimit të kandidatit për Kryeministër edhe atëherë, kur Qeveria që e njëjta ka udhëhequr, ka humbur besimin në Kuvend përmes një votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi.
522. Kjo e drejtë kushtetuese, në asnjë mënyrë nuk mund të shndërrohet në mekanizëm përmes të cilit partia politike ose koalicioni fitues, të pengoj formimin e Qeverisë së re, duke mos propozuar emrin e kandidatit të ri për Kryeministër e as duke mos refuzuar mandatin shprehimisht, dhe duke mbajtur në detyrë një Qeveri të udhëhequr prej të njëjtës parti politike ose koalicioni fitues, e cila tashmë ka humbur besimin e Kuvendit. Përkundrazi, detyra e një partie politike apo koalicioni fitues, Qeveria e të cilit ka humbur besimin në Kuvend përmes një votimi të suksesshëm të mosbesimit, është që të drejtën për propozimin e kandidatit për Kryeministër të ushtrojë në funksion të mundësisë për formimin e një Qeverie të re, duke marrë sërish besimin e Kuvendit, ose në funksion të lejimit të hapësirës së formimit

të një Qeverie nga partitë politike ose koalicione tjera, që kanë numrat e nevojshëm në Kuvend për të formuar Qeverinë.

523. Në rrethanat e rastit konkret, *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht LVV, Qeveria e së cilës është shkarkuar përmes mocionit të mosbesimit të 25 marsit 2020, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë përfaqësuesve të popullit, dhe të cilit, i është dhënë sërish mundësia e parë për formimin e Qeverisë së re bazuar në paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, nuk ka propozuar një mandatar për Kryeministër, përkundër katër (4) kërkesave të Presidentit të Republikës, për formimin e Qeverisë re.
524. Më saktësisht, kërkesave të Presidentit të datave 2, 10, 15 e 17 prill 2020, respektivisht, për propozimin e kandidatit për Kryeministër, Kryetari i LVV i është përgjigjur duke (i) theksuar se çështja e propozimit të mandatarit për Kryeministër është *“çështje dytësore apo tretësore”*; (ii) duke kërkuar nga Presidenti të shpërndajë Kuvendin e Republikës bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës; (iii) duke kërkuar shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme; dhe në të njëjtën kohë duke theksuar se (iv) nuk është duke e refuzuar mandatin, por në fakt, gjithashtu (v) duke mos propozuar asnjë emër për të njëjtin qëllim.
525. Gjykata tashmë ka sqaruar se përcaktimi i mandatarit për Kryeministër, si pasojë e *“konsultimit”* në mes të Presidentit dhe *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, ngërthen një *“konsultim”* krejtësisht teknik e formal, përkatësisht kërkesën e Presidentit për propozimin e një emri për mandatar për Kryeministër dhe propozimin e një emri nga ana e *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*. Ky *“konsultim”* për qëllime të zbatimit të paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, nuk mund të përfshijë një diskutim përkitazi me shpërndarjen e Kuvendit apo edhe shpalljen e zgjedhjeve. Kjo sepse, këto dy çështje, nuk janë as në kompetencën ekskluzive të Presidentit e as të *“partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*.
526. Përkundrazi, shpallja e zgjedhjeve të parakohshme, si rezultat i shpërndarjes së Kuvendit është e përcaktuar saktësisht me Kushtetutë, përkatësisht në nenin 82 të saj, dhe siç është sqaruar përgjatë këtij Aktgjykimi, realizohet bazuar në Kushtetutë dhe është e detyrueshme në rastet e paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, ndërsa

është në diskrecion të Presidentit në rast të një votimi të suksesshëm të mosbesimit në Kuvend, diskrecion ky që nuk mund të ushtrohet në konsultim vetëm me *“partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht partinë politike ose koalicionin fitues të zgjedhjeve, por me të gjitha partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend. Për më tepër, në momentin kur është aktivizuar neni 95 i Kushtetutës për zgjedhjen e Qeverisë së re, nënkuptohet që: (i) konsultimet me partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend përkitazi me shpërndarjen e Kuvendit pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit, tashmë janë përmbyllur, duke e pamundësuar shpërndarjen e Kuvendit bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës; dhe (ii) se ekziston një shumicë e mjaftueshme e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend për të formuar një Qeveri të re.

527. Rrjedhimisht, dhe siç është sqaruar më lart, për qëllime të *“konsultimit”* bazuar në paragrafin 14 të nenit 84 në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, është e nevojshme vetëm propozimi i emrit për mandatar për Kryeministër dhe mandatimi i të njëjtit. Në rrethanat e rastit konkret, partia politike me të drejtën e propozimit, as nuk ka propozuar mandatarin për Kryeministër po as nuk ka refuzuar shprehimisht marrjen e mandatit për Kryeministër.
528. Përkitazi me mundësinë refuzimit të marrjes së mandatit, Gjykata rikujton që në Aktgjykimin KO103/14, ajo kishte konstatuar se *“nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin”*. Ky Aktgjykim nuk kishte saktësuar mënyrën në të cilin mund të bëhet refuzimi i mandatit përkatës.
529. Gjykata rikujton së në vlerësimin e çështjes kushtetuese në Aktgjykimin KO103/14, çështja para Gjykatës nuk ndërlidhej me asnjë aspekt të refuzimit të mundshëm të marrjes së mandatit për Kryeministër nga *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*. Megjithatë, Gjykata, kishte paraparë mundësinë e refuzimit, gjithnjë duke pasur parasysh që rrethanat në të ardhmen mund të ngërthejnë mundësinë që partia politike ose koalicioni fitues mund të mos e sigurojë shumicën e nevojshme në Kuvend për votimin e Qeverisë së propozuar apo edhe arsye tjera, dhe rrjedhimisht refuzon marrjen e mandatit për Kryeministër, duke mundësuar vazhdimin e procedurave për zgjedhjen e një Qeverie, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës.

530. Gjykata, në atë Aktgjykim [KO103/14], nuk ka përcaktuar si bëhet ky refuzim. Prandaj, pretendimi i parashtruesve të kërkesës se “*Gjykata ka thënë se Presidenti mund të anashkalojë fituesin e zgjedhjeve, vetëm nëse ky heq dorë shprehimisht nga e drejta e tij por në asnjë rrethanë tjetër*”, nuk është i saktë. Gjykata, në fakt, nuk është deklaruar asnjëherë më parë lidhur me modalitetin e mos ushtrimit të së drejtës që mund ta bëjë partia politike ose koalicioni fitues. Në të gjitha praktikat parlamentare të deritanishme në Republikën e Kosovës, nuk ka pasur rast kur partia politike ose koalicioni fitues që ka pasur të drejtën e propozimit, ka refuzuar të propozojë një kandidat për Kryeministër. Rasti i tanishëm, rrjedhimisht, është rasti i parë që e trajton aspektin e mos ushtrimit të së drejtës për propozimin e mandatarit, respektivisht *de facto* refuzimit për të propozuar një emër.
531. Gjykata në këtë aspekt thekson se interpretimi se e drejta për propozimin e mandatarit për Kryeministër duhet të refuzohet vetëm shprehimisht, nuk është i pranueshëm. Kjo sepse, mundësia e një refuzimi me kushtin që i njëjti të bëhet vetëm shprehimisht, i kombinuar me rrethanat që ndërlidhen me pretendime për paqartësi rreth afatit brenda të cilit duhet të bëhet propozimi për mandatarin për Kryeministër nga “*partia politike ose koalicion që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, si në zbatimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 95 të Kushtetutës, pas zgjedhjeve; po ashtu edhe në zbatimin e paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë, përfshirë rastin e votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit, do të rezultonte në diskrecion të plotë të “*partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, lidhur me formimin e Qeverisë, qoftë duke mos propozuar një emër për mandatar, qoftë duke mos e refuzuar këtë të drejtë shprehimisht.
532. Prandaj, refuzimi jo detyrimisht nënkupton të jetë bërë shprehimisht. Gjykata vëren se sipas fjalorit të gjuhës shqipe: “*REFUZIM m. sh. [nënkupton] Veprimi sipas kuptimeve të foljeve REFUZOJ.*” Folja REFUZOJ në kallëzore: “*Nuk pranoj të bëj një punë a një veprim që më kërkohet, kundërshtoj.*”
533. E drejta për të propozuar kandidatin për mandatarin për Kryeministër është e drejtë e “*partisë politike ose koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë*”, përkatësisht partisë ose koalicionit fitues, dhe gjithashtu ngërthen në vetvete përgjegjësinë dhe detyrimin për të vepruar, përkatësisht për të propozuar këtë kandidat dhe për të propozuar Qeverinë në Kuvend.

Kjo e drejtë, gjithashtu ngërthen detyrimin dhe përgjegjësinë për të refuzuar propozimin dhe për të zhbllokuar procedurën kushtetuese për zgjedhjen e Qeverisë, nëse, partia politike ose koalicioni fitues konsideron se nuk i ka votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë. Thënë këtë, (i) mos ndërmarrja e veprimeve konkrete drejt propozimit dhe mungesa e propozimit të emrit të kandidatit për Kryeministër; e (ii) as refuzimi i marrjes së këtij mandatit, duke kërkuar në të njëjtën kohë, (iii) shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, nuk mund të kushtëzohet vetëm me deklarimin shprehimor të partisë politike ose koalicionit fitues për refuzimin e mandatit për Kryeministër, për tu konsideruar refuzim. Në të kundërtën, në rrethana të tilla, kushtëzimi i refuzimit në deklarimin shprehimor përkitazi me refuzimin e partisë politike ose koalicionit përkatës, do të bënte themelimin e institucioneve shtetërore peng vetëm të mungesës së refuzimit të shprehur formalisht nga ana e partisë politike ose koalicionit fitues.

534. Nga shkëmbimi i shkresave zyrtare në mes Presidentit dhe Kryetarit të LVV, në cilësi të *“partisë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, nuk reflektohet as edhe një veprim apo qëllim i vetëm, që i njëjti planifikon të propozojë një mandatar për Kryeministër. Përkundrazi, kërkesa e këtyre shkresave është shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme. Këto kërkesa janë në kundërshtim të plotë dhe përjashtojnë mundësinë e propozimit të një mandatarit për Kryeministër. Gjykata tashmë ka sqaruar që *“konsultimi”* për qëllime të propozimit të mandatarit të parë, përfshin propozimin e mandatarit dhe dekretimin e të njëjtit. As shpërndarja e Kuvendit e as shpallja e zgjedhjeve të parakohshme nuk janë në vendimmarrjen ekskluzive as të Presidentit as të partisë politike ose koalicionit fitues.
535. Mungesa e propozimit të mandatarit për Kryeministër, përkatësisht mosveprimi përkitazi me detyrimin e vetëm të nevojshëm dhe ndërmarrjen e çfarëdo hapi konkret në këtë drejtim, posaçërisht në rrethanat kur kundër Qeverisë që ka udhëhequr *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, mjafton për të konstatuar këtë refuzim. Vet mungesa e kryerjes së veprimit i cili kërkohet të kryhet, përkundër të drejtës, mundësisë dhe ftesave ndërmjetësuese, konsiston *de facto* në kundërshtim ose refuzim për të kryer veprimin e caktuar.
536. Në këto rrethana, dhe pas një votimi të suksesshëm të një mocioni mosbesimi me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit,

Presidenti, duke (i) balancuar detyrimin e tij për të garantuar funksionimin demokratik të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, përfshirë në këtë kontekst edhe të drejtën e Kuvendit për zgjedhur Qeverinë, siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës, në njërën anë; dhe, në anën tjetër, duke (ii) marrë parasysh që *“partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht LVV, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim të vetëm drejt propozimit të mandatarit për Kryeministër përkundër të drejtës, mundësisë dhe kërkesave të Presidentit, por kishte vazhduar të kërkonte shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, përkundër faktit që shumica e partive politike ose koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend tashmë ishin deklaruar kundër kësaj mundësie, duke i pamundësuar Presidentit ushtrimin e kompetencës së përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, me të drejtë ka konstatuar shterimin e mundësive kushtetuese për propozimin e mandatarit të përcaktuara përmes paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 5 të nenit 95 të Kushtetutës, dhe ka filluar procedurën vijuese të përcaktuara përmes paragrafit 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës. E kundërta, do të pamundësonte jetësimin e kompetencave esenciale të Kuvendit për të zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës.

537. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Dekreti i kontestuar i Presidentit, është nxjerrë në përputhje me paragrafin 14 të nenit 84 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës.

VI. Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore

538. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore duke theksuar se *“është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se përmbajtja e këtij dekreti shkel rendin kushtetues, si dhe disa dispozita kushtetuese thelbësore që hapin rrugën kushtetuese të krijimit të legjitimitetit të ri përmes zgjedhjeve parlamentare të parakohshme.”*
539. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit 1 të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës: *“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsytimi të mirë”*; ndërsa, në bazë të paragrafi 2 të po të njëjtit rregull: *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në*

rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit.”

540. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritior lidhur me rastin që është në shqyrtim. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO43/19, parashtruese: *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 116; shih gjithashtu rastin, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
541. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti sepse Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth “provave apo ligjit” dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet dhe shkresat të cilat janë pjesë e dosjes së rastit KO72/20 janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast.
542. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

VII. Kërkesa për masë të përkohshme

543. Më 30 prill 2020, parashtruesit e kërkesës kishin dorëzuar kërkesën në Gjykatë ku, në mes tjerash, kishin kërkuar vendosjen e masës së përkohshme *“mbi Dekretin në mënyrë që të parandalohen dëmet e pariparueshme për palën dhe institucionin.”*
544. Më 1 maj 2020, Gjykata e kishte miratuar si të bazuar kërkesën për masë të përkohshme dhe kishte e pezulluar zbatimin e Dekretit të kontestuar të Presidentit duke theksuar se i njëjti po pezullohet *“pa asnjë paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës.”* Masa e përkohshme ishte vendosur deri më 29 maj 2020. (Shih Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO72/20, 1 maj 2020, paragrafi 51 dhe dispozitivi).
545. Duke qenë se sot, më 28 maj 2020, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi për meritat e saj duke e konfirmuar kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar të Presidentit, nuk është më tutje e nevojshme mbajtja në fuqi e masës së përkohshme.

VIII. PËRFUNDIME

546. Në vlerësimin e Dekretit [nr. 24/2020] të 30 prillit 2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit “Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës”, Gjykata, vendosi: (i) njëzëri që kërkesa e parashtrueseve të kërkesës është e pranueshme; (ii) njëzëri që Dekreti i kontestuar i Presidentit është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, duke konstatuar rrjedhimisht, që votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi të Kuvendit ndaj Qeverisë, nuk rezulton në shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit dhe mundëson formimin e një Qeverie të re në pajtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës; (iii) me shumicë që Dekreti i kontestuar është në përputhshmëri me paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës; (iv) njëzëri që të shfuqizohet masa e përkohshme e përcaktuar përmes Vendimit të 1 majit 2020; dhe (v) njëzëri që të refuzohet kërkesa për seancën dëgjimore.
547. Gjykata rikujton se çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e Dekretit të kontestuar të Presidentit të Republikës, përmes të cilit, z. Avdullah Hoti, i është propozuar Kuvendit të Kosovës për kandidat për Kryeministër. Në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të lartcekur, bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe argumentet e kundërshtimet e palëve tjera të interesuara, Gjykata fillimisht vlerësoi nëse pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit të votuar me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit më 25 mars 2020, Presidenti i Republikës, bazuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, ishte i detyruar të shpërndajë Kuvendin e Republikës dhe të shpall zgjedhjet e parakohshme. Më tej, Gjykata sqaroi procedurën që duhet ndjekur për formimin e një Qeverie të re, pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë në Kuvend dhe, po ashtu dha vlerësimin e saj nëse në rrethanat e rastit konkret, procedura e ndjekur për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë se re, ka rezultuar në një Dekret kushtetues.
548. Për të interpretuar përfundimisht nenet kushtetuese që ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret përkatësisht nenet 82, 95 dhe 100 të Kushtetutës, Gjykata, gjithashtu mori parasysh: (i) parimet kushtetuese mbi rolin e Kuvendit dhe të Presidentit; (ii) praktikën e saj gjyqësore, përfshirë Aktgjykimin KO103/14 dhe të gjitha rastet e cituara nga palët në procedurë; (iii) Opinionet relevante të Komisionit

të Venecias; (iv) Analizën krahasimore të Kushtetutave, përfshirë ato të referuara nga parashtruesit e kërkesës; (v) përgjigjet e pranuar nga Gjykatat Kushtetuese/Supreme, pjesë të Forumit të Komisionit të Venecias; dhe (vi) dokumentet përgatitore për hartimin e Kushtetutës.

549. Gjykata, fillimisht rikujtoi se Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën ngase vetëm në atë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i tyre. Normat kushtetuese nuk mund të nxirren jashtë kontekstit dhe të interpretohen në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera. Struktura e normave kushtetuese që ndërlidhen me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jetësojnë dhe jo të bllokojnë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve përkatëse. Çdo paqartësi e normave duhet të interpretohet në frymën e Kushtetutës dhe vlerave të saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të bllokojë themelimin dhe funksionimin efektiv të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, dhe as mënyrën se si të njëjtat e balancojnë njëra tjetrën në aspekt të ndarjes së pushteteve.
550. Gjykata gjithashtu theksoi se të gjitha pushtetet dhe bartësit e funksioneve publike, pa përjashtim, kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike në shërbim të jetësimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës. Të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Kushtetuta, duhet të ushtrohen në shërbim të themelimit dhe mbarëvajtjes efektive të institucioneve shtetërore.
551. Sa i përket rregullimit kushtetues për shpërndarje të Kuvendit, Gjykata theksoi se Kushtetuta parashihet detyrimin e shpërndarjes së Kuvendit në rrethanat e paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës dhe mundësinë e shpërndarjes së Kuvendit në rrethanat e paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, pas votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi. Më saktësisht, Kuvendi shpërndahet detyrimisht vetëm në tri raste: (i) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit për Kryeministër nga Presidenti, nuk mund të formohet Qeveria; (ii) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe (iii) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh prej fillimit të procedurës së zgjedhjes së Presidentit, nuk zgjidhet ky i fundit. Ndërsa, në rast të

votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj një Qeverie, Presidenti ka mundësinë, por jo detyrimin të shpërndajë Kuvendin.

552. Mundësia e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin, nuk mund të ushtrohet në mënyrë të pavarur e as në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit, por duhet të ushtrohet në bashkërendim me vullnetin e shumicës së nevojshme të përfaqësuesve të popullit të përfaqësuar në Kuvend. Përdorimi i foljes “*mund*” në kontekst të paragrafit të 2 të nenit 82 të Kushtetutës reflekton vetëm mundësinë e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin, bazuar në konsultimet me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Një konstatim të tillë lidhur me kompetencat presidenciale që ndërlidhen me foljen “*mund*” [“*može*”/“*may*”] në kontekst të shpërndarjes së Kuvendit, konfirmohet edhe në Opinionet e Komisionit të Venecias të përfshira në këtë Aktgjykim.
553. Gjykata theksoi se Kuvendi është institucioni i vetëm në Republikën e Kosovës që zgjidhet drejtpërdrejt nga populli për një mandat katër (4) vjeçar. Përveç Kushtetutës, përfaqësuesit e popullit nuk i nënshtrohen asnjë pushteti tjetër dhe asnjë mandati detyrues. As Presidenti që është zgjedhur prej Kuvendit, nuk e ka kompetencën ta shpërndajë atë pa vullnetin e Kuvendit; e as ushtrimi i kompetencës së Kuvendit për shprehjen e mosbesimit ndaj një Qeverie që e ka zgjedhur vet, nuk mund të rezultojë edhe në përfundimin e mandatit të vet Kuvendit. Kuvendi nuk mund të kushtëzohet në shpërndarjen e vetvetes nëse zgjedh të shprehë mosbesimin ndaj një Qeverie të zgjedhur prej tij, pasi që mocioni i mosbesimit si mekanizëm i kontrollit kushtetues të Qeverisë nga Kuvendi si organ përfaqësues i popullit, nuk do të kishte asnjë kuptim. Një qasje e tillë është në kundërshtim me parimin kushtetues të kontrollit parlamentar të Qeverisë të mishëruar në paragrafin 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 8 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 97 [Përgjegjësia] të Kushtetutës dhe parimet themelore demokratike.
554. Pragu i lartë i votës së nevojshme për shpërndarje të Kuvendit nga vet deputetët reflekton peshën dhe rëndësinë që Kushtetuta ka përcaktuar për këtë qëllim. Krahës pragut më të lartë të paraparë për amendamentimin e Kushtetutës, e për të cilin kërkohet miratimi i dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, për shpërndarjen e Kuvendit, Kushtetuta ka përcaktuar praguin e radhës më të lartë të mundshëm, përkatësisht votën prej dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve të tij, të barabartë, ndër të tjera, me votën e nevojshme për bartje të sovranitetit të shtetit, siç është përcaktuar në nenin 20 të Kushtetutës. Për dallim,

Kushtetuta për suksesin e një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë, ka përcaktuar prag më të ulët të votës së nevojshme, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) deputetë.

555. Po të mund të shpërndante Presidenti njëanshëm Kuvendin pas një mocioni mosbesimi, atëherë Presidenti do të kishte fuqinë e barabartë me dy të tretat (2/3) e votave të përfaqësuesve të popullit si dhe do të reduktonte në mënyrë arbitrare vullnetin e nevojshëm të dy të tretave (2/3) të deputetëve për shpërndarje të Kuvendit në vetëm gjashtëdhjetë e një (61) vota, aq sa janë të nevojshme për një mocion mosbesimi. Një fuqi të tillë, Presidentët, bazuar edhe në Opinionet e Komisionit të Venecias, nuk e kanë madje as në shumicën e shteteve me rregullim presidencial.
556. Në fakt, analiza e Kushtetutave tjera të reflektuara në këtë Aktgjykim, përfshirë edhe ato Kushtetuta që janë përdorur në argumentet e parashtruesve të kërkesës, Opinionet relevante të Komisionit të Venecias si dhe përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias, saktësojnë që asnjë Kushtetutë nuk përcakton shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit vetëm me faktin që është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi. Përkundrazi, votimi i suksesshëm i një mocioni mosbesimi, rezulton në tri situata të mundshme: (i) zgjedhjen e menjëhershme të Kryeministrit të ri, në rastet kur Kushtetutat parashohin "*mocionin konstruktiv*"; (ii) edhe një mundësi shtesë për zgjedhjen e një Kryeministri; ose (iii) kthimin e kompetencës të Presidenti përkatës, për të ndjekur procedurat e përcaktuara për zgjedhjen e Qeverisë, për aq mundësi sa përcakton e njëjta. Në të gjitha këto vende, vetëm atëherë kur të jenë shteruar të gjitha mundësitë kushtetuese për zgjedhjen e një Qeverie të re, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e parakohshme.
557. Kompetenca e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës, zbatohet drejtë, vetëm atëherë kur pas një mocioni të suksesshëm të mosbesimit të votuar nga më së paku gjashtëdhjetë e një (61) deputetë: (i) mungon shumica e nevojshme e deputetëve për të formuar një Qeveri të re dhe në të njëjtën kohë (ii) mungon edhe shumica prej dy të tretave (2/3) të deputetëve, për t'u vet shpërndarë. Pra kjo mundësi, në njërën anë paraqet një mundësi shtesë për të formuar Qeveri brenda legjislaturës ekzistuese dhe për t'i shmangur zgjedhjet, ndërsa në anën tjetër, paraqet edhe mundësi zhbllokimi në rastet kur nuk ka vullnet dhe as shumicë të nevojshme për formim të një Qeverie të re nga Kuvendi brenda të njëjtës legjislaturë.

558. Deri më sot, neni 82 i Kushtetutës gjithmonë është zbatuar në këtë mënyrë, më saktësisht: (i) legjislatura e tretë dhe pestë, janë shpërndarë nga Presidenti në vitin e tretë të mandatit të tyre, në vitin 2010 dhe 2017, respektivisht, kur në Kuvend nuk ka pasur vullnet e as shumicë të nevojshme për të formuar një Qeveri të re; ndërkaq, (ii) legjislatura e katërt dhe gjashtë, në vitin 2014 dhe 2019, respektivisht janë vet shpërndarë me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve dhe kjo shpërndarje vetëm është dekretuar nga Presidentët përkatës.
559. Rrethanat e rastit konkret, dallojnë qartazi nga ato të legjislatrave të kaluara. Në këtë rast, (i) një mocion mosbesimi është votuar me dy të tretat (2/3) e të gjithë përfaqësuesve të popullit dhe të njëjtit nuk kanë nevojë për ndihmën e Presidentit për tu shpërndarë; dhe (ii) shumica e partive politike dhe koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend, respektivisht edhe shumica e të zgjedhurve të popullit, janë deklaruar në favor të krijimit të një Qeverie të re pas shprehjes së mosbesimit ndaj Qeverisë në detyrë/dorëheqje. Shpërndarja e Kuvendit nga Presidenti kundër vullnetit të përfaqësuesve të popullit do të ishte arbitrare e qartazi kundërkushtetuese. Përkundrazi, Presidenti ka qenë i detyruar të fillojë procedurat për t'i dhënë mundësinë formimit të një Qeverie të re bazuar në dispozitat e nenit 95 të Kushtetutës.
560. Mënyra e zgjedhjes së Qeverisë në Kushtetutën e Kosovës është e përcaktuar përmes nenit 95. Procedura që duhet ndjekur për zgjedhjen e një Qeverie është sqaruar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO103/14. Gjykata u qëndron parimeve të përcaktuara përmes atij Aktgjykimi. Ai ka sqaruar që për formimin e një Qeverie, Kushtetuta përcakton dy mundësi. E drejta e parë për formimin e Qeverisë, i takon *“partisë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë”*, përkatësisht partisë politike ose koalicionit fitues të zgjedhjeve. Presidenti nuk ka diskrecion lidhur me të drejtën e kësaj partie politike ose koalicioni për të propozuar kandidatin për Kryeministër dhe vetëm e mandaton të njëjtin. Në rast të dështimit të zgjedhjes së kësaj Qeverie në Kuvend apo refuzimit të këtij mandati nga partia politike ose koalicioni fitues, e drejta për formimin e Qeverisë, kalon te partia politike ose koalicioni i përfaqësuar në Kuvend, që në diskrecionin e Presidentit, ka gjasat më të mëdha për të formuar Qeverinë në mënyrë që të shmangen zgjedhjet. Ndërsa, dështimi i këtyre dy mundësive, rezulton në detyrimin e Presidentit për të shpallur zgjedhjet, siç është përcaktuar në Kushtetutë.
561. Neni 95 i Kushtetutës përcakton procedurën për zgjedhjen e një Qeverie përgjatë një cikli zgjedhor. I njëjti, përcakton dy mundësi për

zgjedhjen e një Qeverie, sikur pas zgjedhjeve ashtu edhe pas dorëheqjes së Kryeministrit/Qeverisë. Gjykata ka sqaruar se efekti i dorëheqjes së një Kryeministri rezulton në dorëheqjen e një Qeverie, ashtu siç rezulton edhe efekti i votimit të suksesshëm të një mocioni mosbesimi për “*Qeverinë në tërësi*”, në dorëheqjen e të njëjtës. Një qëndrim i tillë, është gjithashtu në përputhshmëri me Analizën Krahasimore, Opinionet e cituara të Komisionit të Venecias dhe kontributin e dorëzuar në Gjykatë nga anëtarët e Forumit të Komisionit të Venecias, sipas të cilave, pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi, Kryeministri/Qeveria janë në dorëheqje, dhe aktivizohet neni kushtetues përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë, me përjashtim të atyre rasteve që e kanë të parashikuar “*mocionin konstruktiv*”, ose kanë paraparë vetëm edhe në mundësi për zgjedhjen Kryeministrit/Qeverisë, pas mocionit përkatës.

562. Prandaj, në të gjitha rastet kur dorëheqja e Kryeministrit apo mbetja e postit përkatës i lirë për arsye tjera, ka rezultuar në rënien e Qeverisë edhe kur dorëheqja e Qeverisë është rezultat i një mocioni të suksesshëm mosbesimi, me kushtin që pas këtij mocioni nuk ka pasuar shpërndarja e Kuvendit sipas parimeve të sqaruara më lart, aktivizohet paragrafi 5 i nenit 95 të Kushtetutës, i cili detyron Presidentin për të mandatuar kandidatin e ri për Kryeministër. Partia politike ose koalicioni i cili e ka të drejtën e parë të propozimit të mandatarit për Kryeministër dhe formimit të Qeverisë është sërish partia politike ose koalicioni fitues. Për formimin e kësaj Qeverie duhet të ndiqet procedura e përcaktuar përmes paragrafit 2 dhe 3 të nenit 95 të Kushtetutës, ndërsa, dështimi i marrjes së votave të nevojshme në Kuvend apo refuzimi i këtij mandati, kalon të drejtën e formimit të Qeverisë te një parti politike ose koalicion që mund të ketë shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës dhe sipas parimeve të përcaktuara në Aktgjykimin KO103/14. Gjykata sqaron se përmes Aktgjykimit KO103/14, asnjëherë nuk ka përcaktuar se partia politike ose koalicioni fitues, ka të drejtën ekskluzive dhe të vetme për të propozuar mandatarin për Kryeministër dhe për të formuar Qeverinë.
563. Gjykata gjithashtu thekson se kompetenca e Kuvendit për të zgjedhë dhe shprehë mosbesimin ndaj Qeverisë është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës dhe zbatohet përmes neneve 95 dhe 100 të Kushtetutës, për Zgjedhjen e Qeverisë dhe Mocionit të Mosbesimit, respektivisht. Ky i fundit, është një ndër mekanizmat më thelbësor të ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë dhe rrjedhimisht edhe balancimit të pushteteve. Legjitimiteti demokratik i një Qeverie të zgjedhur nga një Kuvend, buron nga besimi që përfaqësuesit e popullit i mveshin me rastin e zgjedhjes së saj. Ky besim pushon në

momentin kur shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të kenë votuar kundër tij. Për pasojë, ajo humb besimin e përfaqësuesve të popullit, dhe rrjedhimisht edhe autoritetin kushtetues për të ushtruar kompetencat përkatëse.

564. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, më 25 mars 2020, ishte votuar një mocion mosbesimi me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, kundër Qeverisë së udhëhequr nga partia politike fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. E njëjta parti politike, për dallim prej shumicës së Kushtetutave të analizuara e të reflektuara në Aktgjykim, pas votimit të mocionit të suksesshëm të mosbesimit, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, sërish ka të drejtën e parë për propozimin e kandidatit për Kryeministër. Një propozim të tillë kjo parti politike nuk e ka bërë edhe pas (4) katër kërkesave të Presidentit, duke filluar prej datës 2 prill 2020 deri në datën 22 prill 2020. Partia politike në fjalë, përkatësisht LVV, në thelb, pretendon se: (i) pas mocionit të mosbesimit, Presidenti detyrohet të shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e parakohshme; dhe se (ii) nuk ka afat kushtetues për propozimin e mandatarit për Kryeministër, rrjedhimisht, është në diskrecionin e plotë dhe të paafatizuar të partisë politike fituese, për të propozuar mandatarin për Kryeministër dhe atë *“vetëm atëherë kur të jenë plotësuar kushtet politike, administrative dhe teknike”*. Për pasojë, si çështje vlerësimi të këtij Aktgjykimi është edhe: (i) afati brenda të cilit duhet të propozohet kandidati për Kryeministër; dhe (ii) nëse mos propozimi i këtij kandidati nga partia politike që ka të drejtën e parë të propozimit, reflekton refuzimin e marrjes së mandatit për Kryeministër.
565. Për sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të bëhet propozimi për kandidatin për Kryeministër, Gjykata ka theksuar i njëjti duhet të analizohet në kuptim të: (i) sistemit të afateve kushtetuese që Kushtetuta ka përcaktuar për qëllime të formimit të Qeverisë; dhe (ii) natyrës së *“konsultimit”* në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit me të drejtën për të propozuar mandatarin për Kryeministër, përfshirë përgjegjësitë dhe detyrimet reciproke në mes tyre, për qëllime të caktimit të të njëjtit.
566. Së pari, Gjykata theksoi se caktimi i mandatarit nga Presidenti rezulton në rrjedhjen e dy lloj afatesh paralele kushtetuese: (i) atë të shpërndarjes së Kuvendit nëse zgjedhja e Qeverisë nuk bëhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga marrja e mandatit; dhe (ii) atyre të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës, që ndërlidhen me dy mundësitë për formimin e Qeverisë, respektivisht afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor brenda të cilit kandidati për Kryeministër paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin nga ana e

Kuvendit; (iii) afatin dhjetë (10) ditor, brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, në rast se kandidati i parë për Kryeministër dështon t'i sigurojë votat e nevojshme në Kuvend apo edhe e refuzon mandatin përkatës; dhe (iv) duke iu referuar “*procedurës së njëjte*”, afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor, brenda të cilit kandidati tjetër për Kryeministër, paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin e saj nga ana e Kuvendit. Këto afate të sakta reflektojnë qëllimin dhe rëndësinë që Kushtetuta i ka dhënë themelimit të shpejtë të Qeverisë, duke përcaktuar afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor, për kandidatin për Kryeministër, për të negociuar dhe arritur marrëveshjet për të siguruar votat e nevojshme të deputetëve të Kuvendit për Qeverinë e propozuar; dhe gjithashtu afatin gjashtëdhjetë (60) ditor për formimin e një Qeverie, dhe pasojën përkatëse të shpërndarjes së Kuvendit nëse ky afat nuk respektohet.

567. Së dyti, Gjykata rikujtoi që në Aktgjykimin KO103/14, ajo ka bërë dallimin përkitazi me natyrën e “*konsultimit*” në mes Presidentit dhe partisë politike apo koalicionit me të drejtën për të propozuar mandatarin e parë dhe të dytë. Në rastin e parë, Presidenti nuk ka diskrecion dhe është plotësisht e qartë se cila është partia politike ose koalicioni i cili propozon mandatarin për Kryeministër, rrjedhimisht ky “*konsultim*” ngërthen një proces krejtësisht formal dhe teknik ndërmjet Presidentit dhe partisë apo koalicionit fitues, për propozimin e një mandatarit dhe mandatimin e të njëjtit. Për dallim nga kjo, në rastin e dytë, nuk është e qartë se cila është partia politike ose koalicioni me të drejtën e propozimit të mandatarit, gjë që mbetet në diskrecion të Presidentit për t’u konsultuar me të gjitha partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend për të vlerësuar se cila ka gjasën më të madhe për të formuar Qeverinë, në mënyrë që të shmangen zgjedhet. Rrjedhimisht, ky proces “*konsultimi*” është më kompleks sesa në rastin e parë dhe megjithatë Kushtetuta përcakton detyrimin për Presidentin që ushtrimin e këtij diskrecioni, ta zbatojë në afat dhjetë (10) ditor.
568. Prandaj, në kontekst të: (i) rëndësisë së pakontestueshme të funksionimit efektiv të një Qeverie si një ndër tri shtyllat themelore të pushtetit shtetëror; (ii) sistemit të afateve të sakta dhe të shkurtra të përcaktuara në Kushtetutë lidhur me formimin e një Qeverie; (iii) natyrën krejtësisht të qartë dhe teknike e formale të “*konsultimit*” në mes të Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit fitues, për qëllim të caktimit të mandatarit të parë; dhe (iv) kufizimin e afatit kushtetues në dhjetë (10) ditë për qëllime të caktimit të mandatarit të dytë përmes një “*konsultimi*” shumë më kompleks, Gjykata thekson që mos saktësimi i afateve në Kushtetutë përkitazi me propozimin e kandidatit të parë për Kryeministër nga partia politike ose koalicioni fitues, nuk

nënkupton diskrecionin dhe të drejtën e këtyre të fundit për të mos vepruar në afat të pakufizuar kohor. Përkundrazi, fryma e Kushtetutës reflekton qëllimin e qartë dhe të vetëkuptueshëm të nevojës për veprime të shpejta.

569. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se një afat përkitazi me përcaktimin e mandatarit për Kryeministër nuk është saktësuar në Kushtetutë jo vetëm për partinë politike ose koalicionin fitues për propozim të mandatarit, por as afatin brenda të cilit Presidenti detyrohet të dekretoj mandatarin e propozuar, apo përcjelljen e të njëjtit në Kuvend. Gjykata thekson që caktimi i mandatarit për Kryeministër, nuk përfshinë vetëm detyrimin e Presidentit për të dekretuar atë dhe as vetëm të drejtën e partisë politike fituese për të propozuar këtë mandatar, por përfshinë edhe detyrimin e kësaj të fundit, për të propozuar ose refuzuar që të propozoj kandidatin për Kryeministër. Më saktësisht, përcaktimi i mandatarit për Kryeministër, ngërthen detyrimin e bashkëpunimit reciprok të Presidentit dhe partisë politike fituese në këtë proces. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën teknike dhe formale të “*konsultimit*” për qëllime të caktimit të mandatarit të parë, e cila vënë në lëvizje procesin e formimit të Qeverisë dhe afatet e parapara me Kushtetutë, Gjykata thekson se është e vetëkuptueshme, që ky “*konsultim*” formal, duhet të përmbyllet sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe ngërthen në vetvete kërkesën për dinamikë të shpejtë ndërveprimi.
570. Në të kundërtën, të gjitha normat e lartcekura kushtetuese lidhur me afatet dhe qëllimet që ngërthejnë ato lidhur me formimin e Qeverisë, do të ishin pa asnjë efekt dhe plotësisht të panevojshme. Zgjedhja e Qeverisë do të mbetej peng i “*afateve të pakufizuara*” e në diskrecion të plotë të partisë politike ose koalicionit fitues apo edhe të Presidentit. E para, do të mbante peng formimin e Qeverisë, duke u thirrur në diskrecion të plotë dhe të paafatizuar për të bërë propozimin për mandatar për Kryeministër, ndërsa Presidenti po ashtu, do të thirrej në diskrecionin e plotë dhe të paafatizuar për ta dekretuar të njëjtin. Ky “*diskrecion i plotë dhe i paafatizuar kohorë*”, në ndërkohë ndërlidhet me zgjedhjen e Qeverisë, kompetencë kjo e një pushteti tjetër, përkatësisht Kuvendit. Një qasje dhe interpretim i tillë, do të ishte arbitrar dhe qartazi në kundërshtim me strukturën e normave kushtetuese, qëllimin e frymën e saj por edhe në kundërshtim me parimet themelore të një demokracie parlamentare. Gjykata, në këtë aspekt gjithashtu thekson se përkundër pretendimeve të parashtruesve që ndërlidhen me zgjatjen e procedurave për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve, me theks në situatën e vitit 2014 lidhur me zgjatjen e procesit të konstituimit të Kuvendit, Gjykata në Aktgjykimin KO119/14, nuk ka trajtuar çështjen e afateve

kohore që ndërlidhen me konstituimin e Kuvendit, pasi të njëjtat nuk ka qenë objekti i shqyrtimit në Gjykatë.

571. Lidhur me mungesën e propozimit të mandatarit për Kryeministër nga partia politike fituese e zgjedhjeve, Gjykata, në këtë Aktgjykim, ka analizuar shkëmbimin e letrave ndërmjet Kryetarit të partisë politike fituese, njëherësh Kryeministër në detyrë dhe Presidentit. Këto shkresa reflektojnë dy karakteristika: (i) kërkesën e Presidentit për propozimin e kandidatit për Kryeministër në njërën anë; dhe (ii) mungesën e propozimit dhe kërkesën për shpërndarje të Kuvendit dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme nga LVV, në anën tjetër.
572. Gjykata, në këtë Aktgjykim ka theksuar se: (i) për qëllime të “konsultimit” për përcaktimin e mandatarit në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit fitues, relevante është vetëm propozimi i kandidatit për Kryeministër dhe mandati i tij/saj; dhe (ii) ky “konsultim” nuk mund të përfshijë as çështje që ndërlidhen me shpërndarjen e Kuvendit e as shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme, sepse, asnjëra nga këto çështje nuk është as në kompetencën ekskluzive të Presidentit, as të partisë fituese të zgjedhjeve e as të Qeverisë në detyrë/dorëheqje. Kjo sepse, është e qartë se: (i) rastet e shpërndarjes së detyrueshme e Kuvendit janë të përcaktuara saktë në Kushtetutë; (ii) mundësia e shpërndarjes së Kuvendit nga Presidenti, siç është sqaruar tashmë, nuk është kompetencë që ushtrohet nga Presidenti pa bashkërendim me të gjitha partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvend, dhe jo vetëm me atë që ka fituar zgjedhjet; dhe (iii) Qeveria nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese as lidhur me shpërndarjen e Kuvendit e as shpalljen e zgjedhjeve. Përkundrazi, lidhur me këto dy çështje, roli i partive politike ose koalicioneve të përfaqësuara në një Qeveri, është i barasvlershëm vetëm në fuqinë e tyre që e kanë përmes përfaqësimit në Kuvend. Vullneti i shumicës së Kuvendit në rrethanat e rastit aktual, qartazi i ka pamundësuar Presidentit shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme.
573. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, partia politike që ka udhëhequr Qeverinë ndaj të cilës është votuar një mocion mosbesimi nga Kuvendi, nuk ka bërë një propozim për mandatar tjetër për Kryeministër për qëllim të formimit të Qeverisë së re. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata asnjëherë nuk e kanë refuzuar shprehimisht marrjen e këtij mandati.
574. Përkritazi me mundësinë refuzimit të marrjes së mandatis, Gjykata rikujton që në Aktgjykimin KO103/14, ajo kishte konstatuar se “nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë

mandatin”. Përkundër faktit që nuk ishte çështje në rastin para Gjykatës në vitin 2014, ajo e kishte parashikuar mundësinë e refuzimit, pikërisht për të pamundësuar bllokimin e mundshëm të themelimit të Qeverisë në të ardhmen. Ky Aktgjykim, megjithatë nuk kishte saktësuar mënyrën në të cilën mund të bëhet refuzimi i mandatit përkatës. Prandaj, pretendimi i parashtruesve se “*Gjykata ka thënë se Presidenti mund të anashkalojë fituesin e zgjedhjeve, vetëm nëse ky heq dorë shprehimisht nga e drejta e tij por në asnjë rrethanë tjetër*”, nuk është i saktë. Kjo sepse, edhe autorizimi për partinë politike fituese që refuzimin e marrjes së mandatit ta bëjë vetëm shprehimisht, pra mundësia të mos propozoj një emër për mandatar dhe në të njëjtën kohë të mos e refuzoj këtë të drejtë shprehimisht, do ta mveshte partinë politike fituese me të drejtën për të bllokuar procesin e caktimit të mandatarit nga Presidenti.

575. Një mundësi e tillë do ta pamundësonte zbatimin e kompetencës së Presidentit për caktimin e një mandatarit dhe propozimin e të njëjtit Kuvendit, duke pamundësuar njëkohësisht dhe ushtrimin e kompetencës së Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë. Përkundrazi, siç është sqaruar tashmë, caktimi i mandatarit për Kryeministër kërkon ndërveprimin e menjëhershëm në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësiwe reciproke në mes Presidentit dhe partisë ose koalicionit fitues. Prandaj, refuzimi në fakt nënkupton mos ndërmarrjen veprimeve me qëllim të përmbushjes së këtij detyrimi, përkatësisht mungesën e veprimeve konkrete dhe propozimit të kandidatit për Kryeministër nga partia ose koalicioni fitues. Kushtetuta dhe fryma e saj përcaktojnë se kjo e drejtë dhe njëkohësisht detyrim, si për partinë e parë ashtu edhe për Presidentin, nuk mund të abuzohet dhe duhet të ushtrohet në mirëbesim dhe në funksion të formimit të Qeverisë.
576. Nga shkëmbimi i shkresave zyrtare në mes Presidentit dhe partisë politike fituese, në këtë rast, jo vetëm që nuk ka propozim për mandatar, por nuk reflektohet as edhe një indikacion i vetëm lidhur me qëllimin për të propozuar një mandatar për Kryeministër. Përkundrazi, kërkesa e këtyre shkresave është shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme. Këto kërkesa përjashtojnë mundësinë e propozimit të një mandatarit për Kryeministër.
577. Në rrethana në të cilat është votuar suksesshëm një mocion mosbesimi me dy të tretat (2/3) e përfaqësuesve të popullit dhe mundësisë për formimin e një Qeverie të re, po të konfirmoheshin pretendimet rreth: (i) afatit të pakufizuar kohor dhe në diskrecion të plotë të partisë politike fituese, dhe (ii) të drejtës që vetëm shprehimisht të refuzohej mandati për Kryeministër, të kombinuara më kërkesën e vetme për shpërndarje të Kuvendit dhe shpallje të zgjedhjeve të parakohshme,

formimi i një Qeverie do të bllokohej në pafundësi, duke mbajtur në detyrë Qeverinë që ka humbur besimin e përfaqësuesve të popullit. Kjo nuk është fryma e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

578. Presidenti, duke balancuar detyrimin e tij për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 84 të Kushtetutës, përfshirë në këtë kontekst edhe të drejtën e Kuvendit për zgjedhur Qeverinë, siç është përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 65 të Kushtetutës, në njërën anë, dhe në anën tjetër, duke marrë parasysh që partia politike fituese e zgjedhjeve, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim të vetëm drejt propozimit të mandatarit për Kryeministër përkundër kërkesave të Presidentit, por kishte vazhduar të kërkonte shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, përkundër faktit që shumica e partive politike ose koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend tashmë ishin deklaruar kundër kësaj mundësie, duke i pamundësuar Presidentit ushtrimin e kompetencës së përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 82 të Kushtetutës, me të drejtë ka konstatuar shterimin e mundësive kushtetuese për të përcaktuar një kandidat për Kryeministër nga partia politike fituese e zgjedhjeve. Si rezultat kishte filluar procedurat për mandatin e kandidatit të ri për Kryeministër, në konsultim me dhe pas propozimit të partisë politike, e cila bazuar në konsultimet përkatëse, ka rezultuar të ketë gjasën më të madhe për të krijuar Qeverinë dhe në mënyrë që të shmangen zgjedhjet. E kundërta, do të pamundësonte jetësimin e kompetencave esenciale të Kuvendit të Republikës për të zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës.
579. E drejta për të propozuar mandatarin për Kryeministër është edhe përgjegjësi dhe privilegj. Propozimi i këtij emri, ngërthen në vetvete pikën më të lartë të suksesit të një partie politike ose koalicioni brenda një cikli zgjedhor. E drejta e parë për të propozuar kandidatin për Kryeministër i është garantuar partisë ose koalicionit fitues të zgjedhjeve përmes Kushtetutës. Ushtrimi i kësaj të drejte, nuk është i mveshur edhe me autorizimin për të bllokuar formimin e një Qeverie brenda një cikli zgjedhor. Një qëndrim i tillë, do t'i bënte peng të partisë ose koalicionit fitues, të gjitha institucionet më thelbësore të shtetit.
580. Gjykata në fund thekson se funksionimi demokratik i institucioneve është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizime publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për Republikën e

Kosovës, ashtu që kjo e fundit të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar dhe aspiratave të mishëruara në Preambulën e saj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 113 (2) (1) dhe 116.2 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullit 59 (1) të Rregullores së punës, më 28 maj 2020,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË SHPALLË, njëzëri, që Dekreti [nr. 24/2020] i 30 prillit 2020 i Presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit *“Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës”, është në përputhshmëri* me paragrafin 2 të nenin 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË SHPALLË, me shumicë votash, që Dekreti [nr. 24/2020] i 30 prillit 2020 i Presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit *“Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës”, është në përputhshmëri* me paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] në lidhje me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË SHFUQIZOJË, njëzëri, masën e përkohshme të vendosur më 1 maj 2020;
- V. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore;
- VI. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VIII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajri

KO116/19, Parashtrues: Ismet Kryeziu si përfaqësues i pretenduar i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës, Kërkesë për interpretim ligjor të Vendimit AC-I-13-0125-0001 dhe 0002 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 22 korrikut 2015

KO 116/19, Vendim për refuzim të kërkesës i 13 majit 2020, i publikuar më 9 qershor 2020

Fjalë kyç: Kërkesa është paraqitur në përputhje me paragrafin 10 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe në lidhje me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kërkesë për interpretimin ligjor të vendimeve të gjykatave të rregullta, kërkesa nuk i përmbush kërkesat procedurale për shqyrtim, kërkesë e refuzuar.

Kërkesa bazohet në paragrafin 10 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe në lidhje me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Parashtruesi i pretenduar i drejtohet gjykatës me një kërkesë për interpretimin ligjor se a duhet të zbatohet aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të konfirmuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, dhe vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që refuzoi padinë e AKP-së, apo të pezullohet procedura sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 158/15 të datës 05.04.2016, në mënyrë që të vendoset për kërkesën e palës për regjistrimin e të drejtave pronësore në emër të saj sipas akteve ligjore të mësipërme.

Gjykata në disa raste ka kontaktuar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës në lidhje me plotësimin e kërkesës, që ishte e nevojshme për vendosur më tutje në lidhje me këtë kërkesë. Sidoqoftë, Gjykata nuk ka marrë sqarimet e kërkuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës në lidhje me kërkesën.

Rjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa në fjalë është e jo e plotë, sepse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës nuk ka dorëzuar dokumentet përcjellëse të kërkuara nga Gjykata me të cilat dëshmohet bazueshmëria e kërkesës.

Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kushtet procedurale për shqyrtim të mëtutjeshëm të parashikuara me rregullin 32 dhe 35 të Rregullores së punës.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KO116/19

Parashtrues

**Ismet Kryeziu si përfaqësues i pretenduar i Ministrisë së
Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës**

**Kërkesë për interpretim ligjor të Aktvendimit AC-I-13-0125-0001
dhe 0002 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit të 22 korrikut 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ismet Kryeziu i cili pretendon të jetë përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretim ligjor të Aktvendimit AC-I-13-0125-0001 dhe 0002 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) të 22 korrikut 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 158/15 të 5 prillit 2015.

3. Përfaqësuesi i pretenduar parashtroi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), pyetjen si në vijim:

“kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës të na jepni një interpretim ligjor a duhet të zbatojmë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të cilin e vërteton Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe vendimet e Dhomës së Posaçëm e Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilat refuzohet padija e AKP-s apo të pezullohet procedura sipas aktgjykimit të e Gjykatës së Apelit nr. PAKR.1581/5 i datës 5.04.2016, për të vendosur lidhur me kërkesën e palës për regjistrim të drejtës së pronës në emër të tij sipas akteve juridike të cekura më lartë.”

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 10 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], në lidhje me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 korrik 2019, përfaqësuesi i pretenduar e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 10 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 31 korrik 2019, Gjykata e njoftoi Agjencinë Kadastrale të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 30 shtator 2019, Gjykata e njoftoi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 3 tetor 2019, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës kërkoi nga Gjykata që t'i dorëzohet kërkesa e plotë KO116/19, e dorëzuar nga përfaqësuesi i pretenduar.

10. Më 9 tetor 2019, Gjykata ia përcolli Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës kërkesën e plotë KO116/19, të dorëzuar nga përfaqësuesi i pretenduar.
11. Më 30 dhjetor 2019, përfaqësuesi i pretenduar kërkoi nga Gjykata që rasti i tij të trajtohet me urgjencë.
12. Më 18 shkurt 2020, Gjykata përsëri i dërgoi letër informuese Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ajo të sqarojë kërkesën e saj, përkatësisht të përgjigjet në pyetjet konkrete.

1. A e ka dorëzuar Z. Ismet Kryeziu, Drejtor i Departamentit Ligjor të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, një kërkesë KO 116/19, të quajtur kërkesë për “interpretim ligjor” para Gjykatës Kushtetuese në emër të tij si drejtor i zyrës që ai përfaqëson ose në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)? Ju lutemi që të konfirmoni me saktësi, me përgjigje të drejtpërdrejt të përgjigjeni, kush e paraqiti kërkesën KO116 / 19.

2. Nëse kërkesa është bërë në emër të MMPH, ju lutemi sqaroni nëse kërkesa është bërë në emër të MMPH si një nga ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, apo në emër të gjithë Qeverisë së Republikës së Kosovës? Në këtë drejtim, ju lutemi konfirmoni qartë procesin e vendimmarrjes për paraqitjen e kësaj kërkesë në mënyrë që të dihet saktësisht kush e bëri kërkesën KO116 / 19.

13. Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës nuk u përgjigj në kërkesën e Gjykatës, e as nuk dorëzoi kurrfarë dokumentesh shtesë.
14. Më 13 maj 2020, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës refuzim të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut në Prishtinë në bazë të padisë për anulimin e kontratave të shitblerjes

15. Në një ditë të pacaktuar të vitit 2005, M.B., Đ.V., Đ.LJ., Đ.S. dhe Đ.T. në cilësi të trashëgimtarëve ligjorë parashtruan kërkesëpadi për anulim të kontratave të shitblerjes të lidhura nga paraardhësi i tyre ligjor M.R. me KBI „Kosova-Export“ nga Fushë Kosova.
16. Më 15 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C. nr. 2333/2005, me të cilin aprovoi kërkesat e M.B., Đ.V., Đ.LJ., Đ.S. dhe Đ.T. dhe i anuloi kontratat e shitblerjes të lidhura nga paraardhësi i tyre ligjor M.R. me KBI „Kosova-Export“, dhe obligoi KBI „Kosova-Export“ t’ua kthejë në pronësi dhe posedim paluajtshmëritë të cilat ishin objekt i kontratave të anuluar të trashëgimtarëve të M.R.
17. Në një ditë të pacaktuar, KBI „Kosova-Export“ parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër Aktgjykimit (C. nr. 2333/2005) të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 15 majit 2007, duke pretenduar se ky aktgjykim nuk është në përputhje me legjislacionin pozitiv.
18. Më 2 tetor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin GZH. nr. 664/2007, me të cilin refuzoi ankesën e KBI „Kosova-Eksport“ si të pabazuar dhe e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Procedura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

19. Më 11 mars 2008, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) duke përfaqësuar KBI „Kosova-Export“ parashtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për rishqyrtim të Aktgjykimit C. nr. 2333/2005 të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 15 majit 2007 dhe të Aktgjykimit GZH. nr. 664/2007 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 2 tetorit 2007, duke pretenduar se Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut nuk kishin juridiksion të vendosin për këto çështje.
20. Më 28 qershor 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar),

me Aktvendimin SCA-08-0035, hodhi poshtë kërkesën e AKM-së sepse ishte parashtruar jashtë afatit të paraparë kohor.

21. Më 19 korrik 2013, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshme: AKP), si pasardhëse ligjore e AKM-së, parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër aktvendimit (SCA-08-0035) të Kolegjit të Specializuar të 28 qershorit 2013, duke kërkuar që ky aktvendim të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.
22. Më 23 korrik 2015, Kolegji i Apelit, me Aktvendimin AC-I-13-125-A0001 dhe A0002, e refuzoi ankesën e AKP-së dhe e vërtetoi në tërësi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar (SCA-08-0035) të 28 qershorit 2013.

Procedura në Zyrën e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Komunën e Graçanicës

23. Më 20 janar 2011, trashëgimtarët e M.R. parashtruan kërkesë pranë Zyrës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Komunën e Graçanicës për regjistrimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme të cilat u ishin kthyer me aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut.
24. Më 24 qershor 2017, Zyra e Agjencisë Kadastrale të Kosovës të Komunës së Graçanicës, me Konkluzionin 60/2011, pezulloi/ndërpreu zgjidhjen e mëtejshme sipas kërkesës së trashëgimtarëve të M.R., duke arsyetuar *„Pas shikimit të detajuar në shkresa të lëndës dhe shikimit të aktgjykimet të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2333/05 të dt. 15.05.2007 është vërejtur se i njëjti është marrë nga ana e gjyqtarës Sh. Sh.. Pasi Gjykata e Apelit e ka marrë aktgjykimin PAKR 158/15 të dt. 05.04.2016 me të cilën disa ish gjyqtarë, në mes të cilëve edhe gjyqtarja Sh. Sh. janë shpallur fajtorë për veprën penale Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, me qëllim të shkaktimit të dëmit personit tjetër, [...]. Në aktgjykimin e lartpërmendur, si vendim i kundërligjshëm që është marrë nga ana e të pandehurës Sh. Sh. përmendet edhe aktvendimi C. nr. 2333/05 të dt. 15.05.2007. Duke marrë parasysh faktin se procedura në këtë çështje juridike nuk është përfundimtare dhe nuk është kryer në mënyrë të plotfuqishme, ZKK në Graçanicë e ka pezulluar vendimmarrjen në lidhje me kërkesën tuaj deri në njoftim të mëtejshëm, gjegjësisht deri në marrje të aktgjykimet përfundimtar, të plotfuqishëm dhe ekzekutues nga ana e organit gjyqësor”*.

Procedura në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit në çështjen e përcaktimit të përgjegjësisë penale të gjyqtarës SH.SH.

25. Më 9 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 272/13 e shpalli fajtores gjyqtarën SH.SH për veprën penale të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore dhe e dënoi me kusht, si dhe me një dënim shtesë të ndalimit të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, për një periudhë prej dy vjetësh.
26. Më 24 dhjetor 2014, SH.SH. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, *“për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit për dënimin.”*
27. Më 5 prill 2016, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR nr. 158/15 aprovoi pjesërisht ankesën e SH.SH. në masën që qëllimi i të pandehurës për të përfituar përfitim material të kundërligjshëm nuk mund të provohej përtej dyshimit të bazuar dhe se dënimi shtesë i shqiptuar ishte tepër i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës u refuzua si e papabazuar, si dhe u vërtetua aktgjykimi i shkallës së parë.
28. Në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, thuhet,

“Në aspektin e aktgjykimi dënues për personat e pandehur: (...) S.S. dhe(...)

Të pandehurit(...) S~S. (...)kanë kryer veprën penale Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore me qëllim të shkaktimit të dëmit ndaj personit tjetër.

Në aspektin e dënimeve shtesë për personat e pandehur: (...)S.S., (...)

Konform nenit 57 paragraf. 1 dhe 2 të KPPK, personave të pandehur (...)S.S., (...) iu ndalohej kryerja e profesionit, veprimtarisë apo detyrës së gjyqtarit për një periudhë prej 2 (dy) vjetëve, duke filluar prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pjesa tjetër e aktgjykimi të kontestuar vërtetohet.”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Përfaqësuesi i pretenduar i drejtohet Gjykatës, *“kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës të na jepni interpretim ligjor a duhet të zbatojmë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të cilin e vërteton Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe vendimet e Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilat refuzohet padija e AKP-s apo të pezullohet procedura sipas aktgjykimit të e Gjykatës së Apelit nr. PAKR. Nr. 1581/5 i datës 5.04.2016, për të vendosur lidhur me kërkesën e palës për regjistrim të drejtës së pronës në emër të tij sipas akteve juridike të cekura më lartë”*.
30. Më tej përfaqësuesi i pretenduar gjithashtu pretendon, *“ne si kadastër nuk dim se a ka mbetur në fuqi apo është shfuqizuar ky aktgjykim, pasi që në aktgjykim nuk sqarohet se çka duhet të bëhet me këto aktgjykime të ish gjyqtarëve, kemi edhe raste tjera të njëjta si ky rast”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata fillimisht vlerëson nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, siç që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në Rregulloren e punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
32. Neni 113, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton që *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
33. Gjykata i referohet gjithashtu edhe neneve 22.4 dhe 48 të Ligjit, që parashohin:

Neni 22 [Procedimi i kërkesës]

4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë(15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

34. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
[...]
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”*

35. Gjykata, merr parasysh gjithashtu rregullin 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...] Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën [...]

36. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata vëren se përfaqësuesi i pretenduar kërkon një interpretim ligjor përkatësisht një rekomandim për veprim të mëtejshëm në lidhje me zbatimin e gjykimit të plotfuqishëm të gjykatave të rregullta.
37. Përfaqësuesi i pretenduar, më konkretisht para Gjykatës e shtron pyetjen në vijim:

“a duhet të zbatohet aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të cilin e vërteton Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe vendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilat refuzohet padia e AKP-s apo të pezullohet procedura sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nr. PAKR. Nr. 1581/5 i datës 5.04.2016.”

38. Gjykata së pari rikujton se, në rastin konkret, në pajtim me nenin 22 të Ligjit, Gjykata në dy raste e njoftoi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të sqarimit përfundimtar kërkoi që të përgjigjet në pyetjet specifike dhe të sqarojë kërkesën.

39. Më tej, Gjykata mbi bazën e fletëkthesave konstaton që, më 30 shtator 2019, përfaqësuesit të pretenduar iu dërgua njoftimi, pas kësaj, më 9 tetor 2019, me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës, atij iu dërgua kërkesa e plotë, ndërsa më 18 shkurt 2020, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës është kërkuar përsëri që të plotësojë dhe saktësojë kërkesën e saj, por për këtë Gjykata nuk mori asnjë përgjigje.
40. Gjykata konstaton se përfaqësuesi i pretenduar nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës për sqarimin e kërkesës dhe dorëzimin e dokumentacionit mbështetës pa të cilin asnjë organ publik i Republikës së Kosovës nuk mund të ndërmarrë ndonjë veprim.
41. Gjykata rikujton se barra, për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën, bie mbi parashtruesin e kërkesës i cili ka një interes të drejtpërdrejtë që deklaratimet dhe pretendimet e tij të trajtohen në mënyrë efikase nga Gjykata. Prandaj, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e përfaqësuesit të pretenduar pasi që kërkesa është e paplotë pasi që ai nuk i sqaroi ankesat sipas Kushtetutës (shiko, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese, KIO3/15, Parashtrues i kërkesës: *Hasan Beqiri*, i 13 majit 2015, paragrafi 19, si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese, KIO7/16, Parashtrues *Rifat Abdullahi*, i 14 korrikut 2016, paragrafi 22).
42. Prandaj, Gjykata vëren se, përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, përfaqësuesi i pretenduar nuk i dorëzoi Gjykatës sqarimet e kërkuara ose dokumentet mbështetëse, edhe pse Gjykata kërkoi që ai ta bënte këtë.
43. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa në fjalë është e paplotë sepse përfaqësuesit të pretenduar nuk kanë dorëzuar sqarimet e kërkuara e as ndonjë dokument mbështetës të kërkuar nga Gjykata për të dëshmuar pretendimet e tyre.
44. Gjykata, gjithashtu, vëren se edhe nëse kërkesa do të plotësonte kriteret e parapara me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa për *“një interpretim ligjor përkatësisht një rekomandim për veprim të mëtejshëm në lidhje me zbatimin e gjykimit të plotfuqishëm të gjykatave të rregullta”*, të cilën e ka ngritur përfaqësuesi i pretenduar, thjesht nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë Gjykata nuk merret me kërkesat e tilla.
45. Në përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kërkesat procedurale për shqyrtim të mëtejshëm të parashikuara me rregullin 35 të Rregullores së punës. Meqenëse përfaqësuesi i

pretenduar nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1, të Kushtetutës, nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 29, 35 (5) të Rregullores së punës, më 13 maj 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO203/19

parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr.
06/L-114 për Zyrtarët Publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare), më 11 mars 2019, dhe që hyri në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetë Zyrtare, gjegjësisht, nenet 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6),

37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit të kontestuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me dispozitat tjera kushtetuese që rregullojnë statusin e institucioneve të pavarura kushtetuese.
4. Parashtruesi i kërkesës për më tepër, lidhur me statusin e nëpunësve të Agjencisë së Kosovës për Forensikë (në tekstin e mëtejme: AKF), personelit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe Policisë së Kosovës, megjithëse nuk specifikon nenet konkrete të Kushtetutës, ngrit çështjen e përputhshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar me parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe parimin e ndarjes së pushteteve shtetërore.
5. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për *“pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht të neneve 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68, (paragrafi 8); 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe neni 85 të [Ligjit të kontestuar], ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatit e Popullit.”*

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116

[Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); si dhe në rregullat 32, 56, dhe 57 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë pas miratimit të masës së përkohshme

7. Më 19 nëntor 2019, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 28 shkurt 2020.
8. Më 25 nëntor 2019, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin përkitazi me procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të Ligjit të kontestuar në Kuvend.
9. Më 27 nëntor 2019, KPK dhe AKF dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
10. Më 29 nëntor 2019, Ministria e Administratës Publike (në tekstin e mëtejshëm: MAP), dhe Policia e Kosovës dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
11. Më 6 dhjetor 2019, Gjykata iu komunikoi dokumentet e dorëzuara nga Sekretariati i Kuvendit si dhe komentet e pranuar nga KPK, AFK, Policia e Kosovës dhe MAP, palëve të përfshira në rast me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet e tyre, nëse kanë, brenda shtatë (7) dite.
12. Më 12 dhjetor 2019, MAP njoftoi Gjykatën se *“pas shqyrtimit dhe analizimit të komenteve të paraqitura nga [AKF, KPK] dhe Policia e Kosovës, konsiderojmë se të gjitha komentet tona lidhur me këto institucione i kemi paraqitur në përgjigjen e dërguar te ju me date 29.11.2019.”* duke dorëzuar edhe një herë komentet e 29 nëntorit 2019.
13. Më 26 shkurt 2020, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin KO203/19, të miratuar nga Gjykata më 19 nëntor 2019. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë vazhdimin e masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata më 19 nëntor 2019, deri më 28 prill 2020.

Përkitazi me vazhdimin e masës së përkohshme

14. Gjykata i referohet Vendimit të saj për masat e përkohshme të 19 nëntorit 2019 në këtë rast.
37. Gjykata vëren se palë të interesuara për pranueshmërinë dhe meritat e kësaj kërkesë kanë dorëzuar vëllim të konsiderueshëm të dokumenteve dhe të komenteve dhe se Gjykata konsideron se duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha argumenteve të paraqitura nga palët.
38. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kësaj kërkesë, Gjykata vendos të vazhdojë masën e përkohshme deri më 28 prill 2020.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116.2 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 57 të Rregullores së punës, më 26 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA VAZHDOJË masën e përkohshme të vendosur me Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO203/19 të datës 19 nëntor 2019, deri më 28 prill 2020;
- II. TA VAZHDOJË PEZULLIMIN e zbatimit në tërësi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në kohëzgjatje të përcaktuar në pikën I;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve;
- IV. Ky vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO203/19

parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr.
06/L-114 për Zyrtarët Publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare), më 11 mars 2019, dhe që hyri në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetë Zyrtare, gjegjësisht, nenet 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12),

41(paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit të kontestuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me dispozitat tjera kushtetuese që rregullojnë statusin e institucioneve të pavarura kushtetuese
4. Parashtruesi i kërkesës për më tepër, lidhur me statusin e nëpunësve të Agjencisë së Kosovës për Forensikë (në tekstin e mëtejme: AKF), personelit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe Policisë së Kosovës, megjithëse nuk specifikon nenet konkrete të Kushtetutës, ngrit çështjen e përputhshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar me parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe parimin e ndarjes së pushteteve shtetërore.
5. Parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për *“pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht të neneve 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68, (paragrafi 8); 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe neni 85 të [Ligjit të kontestuar], ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatit e Popullit.”*

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22, 27, 29 dhe

30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); si dhe në rregullat 32, 56, dhe 57 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 12 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të Gjyqtarëve: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 15 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.
10. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, Ministrit në detyrë të Ministrisë për Administratë Publike (në tekstin e mëtejshëm: MAP), Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Shefit Ekzekutiv të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë dhe Drejtorit të Policisë së Kosovës, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 29 nëntor 2019. Kërkesa gjithashtu iu komunikua Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkuar që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për Ligjin e kontestuar.
11. Më 19 nëntor 2019, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 28 shkurt 2020.
12. Më 25 nëntor 2019, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin përkitazi me procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të Ligjit të kontestuar në Kuvend.
13. Më 27 nëntor 2019, KPK dhe AKF dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
14. Më 29 nëntor 2019, MAP dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
15. Më 6 dhjetor 2019, Gjykata iu komunikoi dokumentet e dorëzuara nga Sekretariati i Kuvendit si dhe komentet e pranuar nga KPK, AFK, Policia e Kosovës dhe MAP, palëve të përfshira në rast me udhëzimin

që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet e tyre, nëse kanë, brenda shtatë (7) dite.

16. Më 12 dhjetor 2019, MAP njoftoi Gjykatën se *“pas shqyrtimit dhe analizimit të komenteve të paraqitura nga [AKF, KPK] dhe Policia e Kosovës, konsiderojmë se të gjitha komentet tona lidhur me këto institucione i kemi paraqitur në përgjigjen e dërguar te ju me date 29.11.2019.”* duke dorëzuar edhe një herë komentet e 29 nëntorit 2019.
17. Më 26 shkurt 2020, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin KO203/19, të miratuar nga Gjykata më 19 nëntor 2019. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë vazhdimin e masën e përkohshme të vendosur nga Gjykata më 19 nëntor 2019, deri më 28 prill 2020.
18. Më 22 prill 2020, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin KO203/19, të miratuar nga Gjykata më 19 nëntor 2019 dhe të vazhduar më 26 shkurt 2020. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë vazhdimin e masën e përkohshme të vendosur nga Gjykata më 19 nëntor 2019, deri më 30 qershor 2020.

Përkitazi me vazhdimin e masës së përkohshme

19. Gjykata i referohet Vendimit të saj për masë të përkohshme të 19 nëntorit 2019 në këtë rast dhe Vendimit për vazhdimin e masës së përkohshme të 26 shkurtit 2020. Të gjitha arsyet e cekura kushtetuese dhe ligjore për vendosjen e masës së përkohshme dhe vazhdimin e masës së përkohshme vazhdojnë të jenë të aplikueshme edhe tani dhe, rrjedhimisht Gjykata thirret në arsyetimin e paraqitur në Vendimin e saj fillestar për caktim të masës së përkohshme dhe Vendimin për vazhdimin e masës së përkohshme (shih, Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO203/19 dhe Vendimin për vazhdimin e masës së përkohshme në rastin KO203/19, cituar me lart).
39. Gjykata vëren se palët e interesuara për pranueshmërinë dhe meritat e kësaj kërkeje kanë dorëzuar vëllim të konsiderueshëm të dokumenteve dhe të komenteve dhe se Gjykata konsideron se duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha argumenteve të paraqitura nga palët.
40. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kësaj kërkeje, Gjykata vendos të vazhdojë masën e përkohshme për rastin KO203/19 deri më 30 qershor 2020.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116.2 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 57 të Rregullores së punës, më 22 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA VAZHDOJË masën e përkohshme të vendosur me Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO203/19 të datës 19 nëntor 2019, të vazhduar me Vendimin e 26 shkurtit 2020, deri më 30 qershor 2020;
- II. TA VAZHDOJË PEZULLIMIN e zbatimin në tërësi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në kohëzgjatje të përcaktuar në pikën I;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve;
- IV. Ky vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO203/19, parashtrues Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë

KO203/19, Aktgjykim i miratuar më 30 qershor 2020, publikuar më 9 korrik 2020

Fjalët kyçe: Kërkesë institucionale, ndarja e pushteteve, pavarësia e institucioneve të pavarura, barazia para ligjit, zyrtarët publikë

Kërkesa bazohej në paragrafin 2, nënparagrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2, të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, si dhe në rregullat 32, 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2, dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe nenit 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 11 mars 2019, dhe që hyri në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se nenet e kontestuara nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 132 [Roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me dispozitat e tjera kushtetuese që rregullojnë statusin e institucioneve të pavarura kushtetuese. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi që Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, të cilën kërkesë Gjykata e miratoi pas shqyrtimit të parë më 19 nëntor 2019, në kohëzgjatje deri më 28 shkurt 2020, dhe që e vazhdoi edhe për dy herë të tjera, deri më 28 prill respektivisht deri më 30 qershor 2020.

Në titullin – **PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi, Gjykata përmbledhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë Gjykata, vendosi njëzëri: (i) që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5),

33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139, 140 dhe 141 të Kushtetutës; (iii) Ligji i kontestuar nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Medieve, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë; (iv) Ligji i kontestuar nuk cenon dispozitat e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës; (v) Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën (iii); dhe (vi) që të shfuqizohet masa e përkohshme.

Çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht vlerësimi nëse i njëjti është në pajtueshmëri me parimin e “ndarjes së pushteteve”, “pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese” dhe parimin e “barazisë para ligjit”, të garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës. Gjykata shqyrtoi kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar vetëm në raport me institucionet e lartcekura shtetërore, pasi parashtuesi i kërkesës nuk kontestoi kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në tërësi dhe në raport me të gjithë zyrtarët publikë të rregulluar me Ligjin e kontestuar.

Në lidhje me institucionet e sistemit të drejtësisë, të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se Ligji i kontestuar i jep kompetenca të gjera Qeverisë që të menaxhojë dhe mbikëqyrë nëpunësit civilë të administratës publike, duke përfshirë, edhe nëpunësit civilë të institucioneve të pushtetit të Gjyqësorit, siç janë nëpunësit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Për më tepër, Ligji i kontestuar i jep Qeverisë kompetenca për të nxjerrë një varg të akteve nënligjore për të rregulluar me tej çështje të rëndësishme lidhur me nëpunësit civilë siç janë, çështjet e rekrutimit, emërimit, ngritjes në detyrë, orarit të punës, klasifikimit të pozitave, shkeljeve disiplinore, e që në thelb ndikojnë edhe në funksionimin, klasifikimin e pozitave por edhe sistematizimin dhe strukturën organizative të institucioneve përkatëse të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Kuvendi, megjithëse përmes Ligjit të kontestuar i ka dhënë kompetencë Qeverisë që të menaxhojë me sistemin e shërbimit civil në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe

Sistemin e Drejtësisë, ka përcaktuar që Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore lidhur me nëpunësit e Kuvendit.

Me këtë zgjidhje legjislative është siguruar që Qeveria, respektivisht Ekzekutivi nuk do të ketë kompetenca “ndërhyrëse” në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, respektivisht Legjislativit; ndërkaq që për pushtetin e Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura nuk është paraparë asnjë garanci për të parandaluar “ndërhyrjet” në menaxhimin e nëpunësve të tyre. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se Kuvendi ka dështuar që të njëjtin përjashtim ta përcaktojë edhe për nëpunësit e Gjyqësorit dhe të Sistemit të Drejtësisë, ashtu që të siguronte ndarjen e pushteteve jo vetëm në aspekt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe lidhur me stafin mbështetës të tyre, njësoj sikurse kishte bërë për nëpunësit e Kuvendit dhe të Qeverisë.

Andaj, Gjykata vlerësoi se, duke mos përfshirë nëpunësit civil të institucioneve të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë], në përjashtimet e nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, Ligji i kontestuar cenon parimin e ndarjes së pushtetit të garantuar me nenin 4 dhe 7 të Kushtetutës, si dhe pavarësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës, konkretisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me këto institucione dhe nuk zbatohet ndaj këtyre institucioneve përderisa cenon pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, të përcaktuara me Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, Gjykata iu referohet Institucioneve të Pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medie], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizmin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet të cilat krijojnë “ndërhyrje” të drejtpërdrejtë në pavarësinë

funkionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuar aty.

Në këtë aspekt, Gjykata vlerësoi se Kuvendi, duke autorizuar Qeverinë që përmes Ligjit të kontestuar të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit, duke përfshirë, klasifikimin e pozitive, kriterëve për rekrutim dhe çështje të tjera edhe në Institucionet e Pavarura kushtetuese, pa marrë për bazë pavarësinë e tyre - cenon thelbin e pavarësisë së Institucioneve të Pavarura kushtetuese të garantuar me nenin 115 të Kapitullit VIII të Kushtetutës dhe nenet 132, 136, 139, 140, 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës, si autoritete shtetërore publike të ndara nga Legjislativi, Ekzekutivi dhe nga Gjyqësori i rregullt. Andaj, Gjykata konstatoi se shkeljet e lartpërmendura bëjnë që Ligji i kontestuar të mos jetë në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me Gjyqësorin dhe me Institucionet e Pavarura, dhe se ndaj tyre nuk mund të zbatohet përderisa nuk respekton pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative.

Sa i përket institucioneve të tjera lidhur me të cilat parashtuesi paraqiti kërkesën në Gjykatë, konkretisht nëpunësve të AKF-së dhe nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, Gjykata theksoi se Agjencitë e Pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të Institucioneve të Pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo pasi që, për dallim nga institucionet e tjera të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës *“janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”*. Pra, për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuajë *“me ligj”* Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuajë *“me ligj”* ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.

Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se as nëpunësit e Agjencisë Kosovare të Forenzikës dhe as nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës nuk janë në pozitë ekuivalente me zyrtarët e AKI-së; zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor; dhe zyrtarët doganorë të Kosovës, dhe si pasojë nuk është e nevojshme që të trajtohen në mënyrën e njëjtë. Kjo për faktin se parimi i trajtimit të pabarabartë vjen në shprehje vetëm në rastet kur një trajtim i tillë bëhet për situata të njëjta apo analoge. Në rastin konkret nuk mund të flitet për një trajtim të pabarabartë sepse zyrtarët e AKF-së dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës nuk janë në pozitë të njëjtë apo të ngjashme, apo analoge me zyrtarët në raport me të cilët ata (vetë) krahasohen. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar duke përfshirë nëpunësit e AKF-së dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit të

kontestuar, nuk cenon parimin e barazisë të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ.

Gjykata, në fund konstatoi që nuk është e nevojshme që Ligji i kontestuar të shfuqizohet në tërësinë e tij. Në rrethanat e rastit konkret, analiza dërgoi në përfundimin se, mos zbatimi i Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e cekura më lart nuk e bën Ligjin të pazbatueshëm në praktikë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Kuvendi është i obliguar që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara specifikisht në Dispozitiv të Aktgjykimit. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO203/19

parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr.
06/L-114 për Zyrtarët Publikë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, Kryetare
Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare), më 11 mars 2019, dhe që hyri në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, gjegjësisht, nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafi 3 dhe 4) 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41(paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi

13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit të kontestuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me dispozitat e tjera kushtetuese që rregullojnë statusin e institucioneve të pavarura kushtetuese.
4. Parashtruesi i kërkesës, lidhur me statusin e nëpunësve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë (në tekstin e mëtejme: AKF), personelit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe Policisë së Kosovës, megjithëse nuk specifikon nenet konkrete të Kushtetutës, ngrit çështjen e përputhshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar me parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe parimin e ndarjes së pushteteve shtetërore.
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për *“pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht të neneve 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68, (paragrafi 8); 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe nenit 85 të [Ligjit të kontestuar], ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatin e Popullit.”*

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së

Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); si dhe në rregullat 32, 56, dhe 57 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 12 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të Gjyqtarëve: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 15 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.
10. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, Ministrit në detyrë të Ministrisë për Administratën Publike (në tekstin e mëtejshëm: MAP), Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Shefit Ekzekutiv të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë dhe Drejtorit të Policisë së Kosovës, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 29 nëntor 2019. Kërkesa gjithashtu iu komunikua Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkuar që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për Ligjin e kontestuar. [Sqarim i Gjykatës: Në kohën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, MAP ishte dikaster i veçantë i Qeverisë, ndërsa me strukturën aktuale të Qeverisë, MAP dhe përgjegjësitë e saj janë inkorporuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme].
11. Më 19 nëntor 2019, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 28 shkurt 2020.
12. Më 25 nëntor 2019, Sekretariati i Kuvendit ia dorëzoi Gjykatës dokumentacionin përkitazi me procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të Ligjit të kontestuar në Kuvend, si në vijim:
 1. Projektligjin nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 7 shtator 2018;
 2. Procesverbalin e Komisionit funksional për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, shqyrtimi në parim i Projektligjit për Zyrtarët Publikë, datë 8 tetor 2018;

3. Raportin e Komisionit funksional për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, shqyrtimi në parim i Projektligjit për Zyrtarët Publikë, datë 8 tetor 2018;
4. Ftesën dhe rendin e ditës për Seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtimi i pare i Projektligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, datë 25 tetor 2018;
5. Transkriptin e Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zyrtarët Publikë, datë 18, 19, 28 tetor dhe 2 nëntor 2018;
6. Procesverbalin e Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zyrtarët Publikë, datë 8, 19, 25 tetor, 2, 7 nëntor, 21 dhjetor 2018;
7. Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin në parim të Projektligjit për Zyrtarët Publikë, nr. 06-V -250, datë 25 tetor 2018;
8. Procesverbalin e Komisionit funksional për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, shqyrtimi në parim i Projektligjit për Zyrtarët Publikë, datë 29 janar 2019;
9. Raportin me amendamente në Projektligjin për Zyrtarët Publikë i Komisionit funksional për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, proceduar për shqyrtim në komisionet e përhershme;
10. Raportin e Komisionit për Integritet Evropian, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional;
11. Procesverbalin e Komisionit për Integritet Evropian, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional, datë 30-31 janar 2019;
12. Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional;
13. Procesverbalin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional datë 30 janar 2019;
14. Raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional;
15. Procesverbalin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional, datë 30 janar 2019;
16. Raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandatë, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional;
17. Procesverbalin e Komisionit për Legjislacion, Mandatë, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë

kundër Korrupsionit, shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë me amendamentet e Komisionit funksional, datë 30 janar 2019;

18. Raportin final me amendamentet e propozuara në Projektligjin për Zyrtarët Publikë i Komisionit funksional për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, i proceduar për shqyrtim në seance plenare;

19. Ftesën dhe rendin e ditës për Seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtimi i dyte i Projektligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë;

20. Transkriptin e Seancës së plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shqyrtimi i dyte i Projektligjit për Zyrtarët Publikë;

21. Procesverbalin e Seancës Plenare, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Zyrtarët Publikë;

22. Vendimin e Kuvendit për miratimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nr. 06-V-312, datë 2 shkurt 2019;

23. Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe

24. Shkresën nr. 06/2842/L-114 datë 12 shkurt 2019, dërguar Presidentit të Republikës së Kosovës, për shpalljen e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

13. Më 27 nëntor 2019, KPK dhe AKF dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
14. Më 29 nëntor 2019, MAP dhe Policia e Kosovës dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
15. Më 6 dhjetor 2019, Gjykata iu komunikoi dokumentet e dorëzuara nga Sekretariati i Kuvendit si dhe komentet e pranuar nga KPK, AFK, Policia e Kosovës dhe MAP, palëve të përfshira në rast me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet e tyre, nëse kanë, brenda shtatë (7) ditësh.
16. Më 12 dhjetor 2019, MAP njoftoi Gjykatën se *“pas shqyrtimit dhe analizimit të komenteve të paraqitura nga [AKF, KPK] dhe Policia e Kosovës, konsiderojmë se të gjitha komentet tona lidhur me këto institucione i kemi paraqitur në përgjigjen e dërguar te ju me datë 29.11.2019.”* duke dorëzuar edhe një herë komentet e 29 nëntorit 2019.
17. Më 26 shkurt 2020, Gjyqtari Raportues i rekomandoi Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin KO203/19, të miratuar nga Gjykata më 19 nëntor 2019. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë vazhdimin e masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata më 19 nëntor 2019, deri më 28 prill 2020.

18. Më 22 prill 2020, Gjykata miratoi rekomandimin e Gjyqtarit raportues për vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin nr. KO203/19 deri më 30 qershor 2020.
19. Më 30 qershor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
20. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi: (i) që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139, 140 dhe 141 të Kushtetutës; (iii) Ligji i kontestuar nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Medieeve, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë; (iv) Ligji i kontestuar nuk cenon dispozitat e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civil të Policisë së Kosovës; (v) Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën (iii); dhe (vi) që të shfuqizohet masa e përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 2 shkurt 2019, Kuvendi i Kosovës [Vendimi Nr.06-V-312] miratoi Ligjin e kontestuar.
22. Më 11 mars 2019, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
23. Me nenin 86 [Hyrja në fuqi] të Ligjit të kontestuar parashihet që *“Ky ligji hyn në fuqi (6) muaj pas publikimit në “Gazetën Zyrtare”.*”

Pretendimet e parashtruesit

24. Parashtruesi i kërkesës konteston dispozitat e caktuara të Ligjit të kontestuar (Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë), përkatësisht, nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafi 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe nenin 85.
25. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas nenit 1 [Qëllimi], Ligji i kontestuar ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë, ai pretendon se Ligji i kontestuar e “veshë” Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) dhe ministrinë përgjegjëse për administratë publike me kompetenca për administrimin e çështjes së punësimit për të gjitha institucionet shtetërore duke përfshirë institucionet e pavarura. Kjo sipas tij, cenon, pavarësinë kushtetuese të Institucionit të Avokatit të Popullit të garantuar me nenin 132 të Kushtetutës që përcakton se: *“Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.”* Këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e ndërton duke shtjelluar shkeljet e pretenduara, dhe rolin e Qeverisë në administrimin e nëpunësve të parashtruesit të kërkesës duke u referuar në dispozitat specifike të Ligjit të kontestuar.
26. Lidhur me këtë, ai fillimisht i referohet paragrafit 3 të nenit 2 [Fusha e zbatimit] të Ligjit të kontestuar që definojnë “nëpunësit civil” si zyrtarë publikë në kuadër të shërbimit civil që përfshinë në mënyrë shprehimore edhe zyrtarët publikë të punësuar në institucione të pavarura. Sipas parashtruesit të kërkesës, shkelja e pavarësisë së parashtruesit të kërkesës e garantuar me nenin 132 të Kushtetutës konsiston në faktin se Ligji i kontestuar nuk përmban ndonjë dispozitë specifike, lidhur me personelin e saj, për të siguruar pavarësinë e parashtruesit të kërkesës, për dallim prej Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i shfuqizuar me Ligjin e kontestuar, i cili në nenin 3, paragrafi 7 që kishte përcaktuar shprehimisht se *“Gjatë zbatimit të këtij Ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi”* dhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 32 [Personeli],

që përcakton se: [...] *Ndaj të punësuarve në [Institucionin e Avokatit të Popullit], zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit.*"

27. Ai gjithashtu i referohet edhe paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2 të Nenit 5 [Përkufizime] të Ligjit të kontestuar, që definon kuptimin e "institucionet tjetër shtetëror" duke përfshirë në këtë definicion, institucionet e pavarura. Sipas tij, Ligji i kontestuar dhe Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (në tekstin e mëtejme: LOFASHAP) *"synim kanë marginalizimin e institucioneve të pavarura dhe futjen e tyre nën mbikëqyrjen e Qeverisë, gjë që paraqet ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë kushtetuese, duke pësuar kështu kthim prapa në kuptimin e ndarjes së pushteteve dhe të institucioneve të pavarura si dhe funksionimit demokratik të shtetit."*
28. Parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 10 [Qeveria] të Ligjit të kontestuar duke theksuar se ky nen e autorizon Qeverinë që të miratojë politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarit publik si dhe për t'i miratuar aktet nënligjore lidhur me Ligjin e kontestuar, por nuk përcakton se në çfarë mase Qeveria mund të ushtrojë pushtetin karshi institucioneve të pavarura. Ai thekson se, duke marrë parasysh se Ligji i kontestuar nuk bënë përjashtim për zyrtarët publikë në institucionet e pavarura, atëherë kuptohet se Qeveria ka të drejtë që të nxjerrë akte nënligjore ku përfshihen edhe çështjet që kanë të bëjnë me punësimin e zyrtarëve publikë në institucionet e pavarura. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Ligji i kontestuar, në nenet e veçanta, i konkretizon autorizimet e Qeverisë dhe të ministrisë përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore për një varg të gjatë çështjesh që kanë të bëjnë me punësimin"*. Ai këtë pretendim e ndërlidh edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO73/16 që mes tjerash kishte konstatuar se *"nuk mund të pritet që stafi i institucioneve të pavarura me Kushtetutë të jetë konform, në mënyrë identike, me sistemin e rekrutimit, klasifikimit të vendeve të punës, kategorizimit dhe pagave të përcaktuara me një akt juridik të natyrës së përgjithshme të nxjerrë nga Qeveria, apo me çfarëdo akti të degës së ekzekutivit, pa marrë parasysh paraprakisht, në mënyrë të duhur, specifikat dhe veçantitë e institucioneve në fjalë."*
29. Gjithashtu parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 11 [Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë] të Ligjit të kontestuar që përcakton përgjegjësitë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (në tekstin e mëtejme: DMZP), ku parashihen që DMZP-ja ka

kompetenca që të kërkojë dhe të marrë nga institucionet e Kosovës çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësi të tij. Parashtruesi i kërkesës thekson gjithashtu se *“ky nen parasheh që secili institucion publik që merr në punë zyrtarë publikë, si dhe çdo funksionar publik dhe zyrtar publik, që ka kompetenca menaxheriale vendimmarrëse, ose që ka informacione në këtë fushë, është i detyruar të bashkëpunoj me DMZP-në. Sipas tij, kjo bien ndesh me nenin 32, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatit e Popullit që përcakton se ndaj nëpunësve të Avokatit të Popullit zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit”*.

30. Parashtruesi i kërkesës i referohet edhe paragrafit 5 të nenit 14 [Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)], të Ligjit të kontestuar që përcakton se Njësiti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë të obliguara të mbajnë raport vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe një kopje të tij ta dërgojnë në DMZP. Parashtruesi i kërkesës konsideron se kjo dispozitë mund të ndikojë në pavarësinë e tij për faktin që *“kërkohej që t’i raportohet DMZP-së, pa përcaktuar mënyrën e raportimit të institucioneve të pavarura. Mungesa e një dispozite në ligj që përcakton zbatimin e këtij ligji apo të kësaj dispozite ndaj institucioneve të pavarura, e vë në dyshim kushtetutshmërinë e kësaj dispozite [...]”*.
31. Lidhur me nenet e tjera të Ligjit të kontestuar për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se janë në kundërshtim me Kushtetutën, si nenet 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85, parashtruesi i kërkesës thekson se këto nene kanë të bëjnë me planet e personelit dhe me sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore; me marrëdhënien e punës në shërbimin civil dhe me klasifikimin e vendeve të punës; me pranimin në shërbimin civil; me lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë; me emërimin në pozita të kategorisë së lartë drejtuese; me vlerësimin e rezultateve në punë; me disiplinën në shërbimin civil; me transferimin në shërbimin civil dhe me çështje të ngjashme që kanë të bëjnë me punësimin dhe çështje pune të zyrtarëve publikë. Duke pasur parasysh rolin e Avokatit të Popullit si institucion i pavarur si dhe faktin që nenet e lartcekura të Ligjit të kontestuar autorizojnë Qeverinë të miratojë akte nënligjore dhe në anën tjetër neni 85 i Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo normë në kundërshtim me

Ligjin e kontestuar, duke përfshirë dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe akteve të brendshme të tij që kanë të bëjnë me organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës që janë nxjerrë në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit, me këtë rast cenohet pavarësia e parashtruesit të kërkesës.

32. Lidhur me sa më sipër, ai u referohet dhe i citon pjesët e Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, si Aktgjykimin në rastin KO73/16 të 8 dhjetorit 2016 si dhe Aktgjykimin në rastin KO171/18 të 25 prillit 2019 përmes të cilëve ishte vendosur lidhur me çështjen e pavarësisë së institucioneve të pavarura Kushtetuese duke theksuar se edhe përkundër faktit që Avokati i Popullit ka kërkuar nga Qeveria dhe Kuvendi që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të Ligjit të kontestuar dhe ligjeve të tjera të ndërlidhura, të merren parasysh Aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Kushtetuese, me miratimin e Ligjit të kontestuar, pavarësia e institucioneve të pavarura, përkatësisht pavarësia e Institucionit të Avokatit të Popullit, vihet përsëri në pikëpyetje, duke shpërfillur kështu në tërësi Kushtetutën si dhe Aktgjykimin KO73/16, të 8 dhjetorit 2016, të Gjykatës Kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës i referohet edhe statusit dhe rregullimit juridik të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kroaci, parimeve të Komisionit të Venedikut lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe të ashtuquajturave “Parime të Parisit”.
33. Parashtruesi i kërkesës po ashtu paraqet ankesa lidhur me ndërhyrjen përmes Ligjit të kontestuar në statusin e nëpunësve të institucioneve të tjera shtetërore si nëpunësve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, personelit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Policisë së Kosovës, duke iu referuar ankesave të tyre para Avokatit të Popullit. Ai thekson se Ligji i kontestuar ndërhyr në marrëdhëniet e punës së personelit të këtyre institucioneve në kundërshtim me ligjet specifike që rregullojnë çështjen e personelit të këtyre institucioneve. Në lidhje me këtë, ai thirret në parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e ndarjes së pushteteve. Ai pretendon, mes tjerash, se për disa nga këto institucione është dashur të parashihihen dispozita me të cilat bëhen përjashtime për personelin e këtyre institucioneve nga fushëveprimtaria e Ligjit të kontestuar, sikurse është rasti me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Doganën e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjyqtarët, dhe prokurorët.
34. Në fund, parashtruesi i kërkesës lidhur me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera shtetërore të cekura më lart, thekson se *“[t]lek ligji i kontestuar vërehet qartë tendenca për të centralizuar autoritetin për punësim, por edhe për largim nga puna*

të shumicës së zyrtarëve publikë, tek Qeveria. Përjashtimet nga zbatimi i ligjit nuk janë krejtësisht adekuate dhe logjike, madje në raste të caktuara përbëjnë edhe trajtim të pabarabartë. Për shembull, Ligji i kontestuar përjashton nga zbatimi i tij nëpunësit civilë të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (shih nenin 4, paragrafi 3), ndërsa nuk i përjashton nëpunësit civilë në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe në institucion të pavarur (shih nenin 2, paragrafi 3). Përcaktimet e tilla të Ligjit të kontestuar shkelin parimin e ndarjes së pushteteve, meqenëse dihet qartë se sikur Kuvendi ashtu dhe gjyqësori janë pushtete të ndara nga Qeveria, sikurse edhe institucionet e pavarura.”

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

35. Lidhur me masën e përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkon që në bazë të argumenteve të lartcekura, Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht, nenet 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2, paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85, “ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatit e Popullit.” Parashtruesi i kërkesës i referohet Rregullit 55 të Rregullores së punës së Gjykatës që përcakton kushtet që duhet të plotësohen për vendosjen e masës së përkohshme, duke theksuar se të tri kushtet e parapara janë plotësuar në këtë rast.
36. Se pari, parashtruesi i kërkesës konsideron se argumentet e parashtruara më lart japin bazë *prima facie* për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara në raport me Institucionin e Avokatit të Popullit.
37. Së dyti, në mungesën e miratimit të masës së përkohshme, funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit do të pengohet rëndë prej ndërhyrjeve të vazhdueshme të institucioneve të tjera (Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës) në këtë institucion. Avokati i Popullit konsideron, me respekt, se është e domosdoshme që kjo Gjykate t'i pezullojë menjëherë dispozitat e kontestuara, në bazë të të cilave institucionet e tjera mund ta pengojnë

punën efikase të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të punonjësve të tij.

38. Së treti, Institucioni i Avokati të Popullit shërben shpeshherë si shpresa e fundit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut që t'i adresojnë këto shkelje si dhe t'u japin zgjidhje. Pamundësia e funksionimit normal dhe ushtrimit të mandatit të Avokatit të Popullit, si institucion i vetëm kombëtar për të drejtat e njeriut, pashmangshmërisht do ta pamundësonte mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për këto arsye, Avokati i Popullit konsideron se miratimi i masës së përkohshme është i domosdoshëm, me qëllim që të sigurohet funksioni i mirëfilltë dhe i papenguar i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke respektuar pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare të tij në raport me institucionet e tjera të Republikës së Kosovës.

Komentet e KPK-së

39. Në komentet e tyre lidhur me kërkesën, KPK thekson se *“në bazë të nenit 110 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar që [KPK] është institucion tërësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës”*. KPK shton se *“Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës është përcaktuar se: [KPK] vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit (paragrafi 1.1); [...] bënë mbikëqyrjen dhe administrimin e prokurorive dhe personelit të saj (paragrafi 1.20) dhe [...] nxjerr rregullore për organizimin e brendshëm të prokurorit të shtetit (paragrafi 1.28). [...] [andaj KPK] ka kompetencë për organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e administratës së Prokurorit të Shtetit.”*
40. Për më tepër, duke u thirrur gjithashtu edhe në nenin 31, paragrafi 1, pika 1.5 të Ligjit për KPK-në, KPK thekson se Sekretariatit të Këshillit i është dhënë kompetencë që të *“menaxhoje me gjithë personelin administrativ dhe mbështetës të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, përfshirë vlerësimin e performancës, sigurimin e disiplinimit të duhur si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit.”*
41. Andaj, KPK konsideron se Ligji i kontestuar *“bie ndesh me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës në dispozitat si ne vijim: planit të zhvillimit të personelit (neni 15); klasifikimin e pozitave (neni 33);*

lëvizjet brenda kategorisë (neni 38); ngritja në detyrë (neni 39); pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese (neni 40); përbërja e komisionit për pozita të larta drejtuese (neni 41); vlerësimi i rezultateve në punë (neni 43); vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese (neni 44); kompetenca dhe procedura disiplinore (neni 48); transferimi i përkohshëm (neni 52); transferimi në rast mbylljes apo ristrukturimit (neni 54); lirimi nga Shërbimi Civil (neni 61); procedura e rekrutimit (68); vlerësimi i rezultateve në punë (neni 71).” Kjo, pasi Ligji i kontestuar i jep Qeverisë të drejtën që të përcaktojë procedurat e lart përmendura me akt nënligjor.

42. KPK, po ashtu, konsideron se dispozitat e lartcekura të Ligjit për Zyrtarët Publikë janë në kundërshtim me nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] paragrafi 1 i Kushtetutës ku përcaktohet se *“1. Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin”*. Sipas KPK-së, dispozitat e Ligjit të kontestuar janë në kolizion me dispozitat e Ligjit për KPK-në i cili, mbështetur në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, i ka dhënë mandat KPK-së të përcaktojë, menaxhojë dhe administrojë me strukturën e brendshme organizative.”
43. KPK, po ashtu, thekson se parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton edhe garantimin e ushtrimit të pushtetit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje, dhe se kufizimi duhet të jetë i bazuar në balancimin e pushteteve vetëm në masën që e lejon Kushtetuta dhe kompetencat e secilit pushtet. KPK shtonë se *“mundësia që Qeveria me akt nënligjor të përcaktojë pozitat e administratës së sistemit prokurorial nënkupton ndërhyrje të drejtpërdrejtë në funksionimin e institucioneve kushtetuese të [KPK-së] dhe të Prokurorit të Shtetit pasi që në këto dy institucione janë të angazhuar zyrtarë me detyra mjaft specifike”*.
44. KPK më tej pretendon se Ligji i kontestuar ndërhyt edhe në procedura për përzgjedhjen dhe kualifikimet për zgjedhjen e zyrtarëve të lartë administrativë të sistemit prokurorial duke potencuar se neni 40, paragrafi 12 i Ligjit të kontestuar që përcakton procedurën për pranimin në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, është në kundërshtim me nenin 32, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit për KPK-në ku është përcaktuar mënyra e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit, respektivisht nenin 33, paragrafi 1 për Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.
45. KPK në fund thekson së gjatë procesit të draftimit të Ligjit të kontestuar kanë kërkuar që nëse ndonjë kategori të administratës i

jepet statusi i veçantë, ai status t'i takojë edhe administratës së sistemit prokurorial, por këto vërejtje nuk janë marrë parasysh nga institucionet relevante, përkundër faktit që Ligji i kontestuar i ka dhënë status të veçantë administratës së Kuvendit dhe një pjesë të administratës së Qeverisë, duke mos e trajtuar në mënyrë të barabartë administratën e sistemit prokurorial edhe pse është pjesë e shtyllës së tretë të pushtetit.

46. KPK, rrjedhimisht, kërkon nga Gjykata që të konstatojë se nenet e kontestuarra cenojnë barazinë në ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë funksionale të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit si dy institucione kushtetuese.

Komentet e AFK-së

47. AKF sqaron se është agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për AKF). Ligji për AKF-në dhe udhëzimet administrative rregullojnë, mes tjerash, çështjen e gradave, rekrutimin, transferimin, procedurat disiplinore etj, për nëpunësit e AKF-së. Ato po ashtu sqarojnë se personeli i AKF-së është specifik për sa i përket kualifikimeve profesionale, përvojës së punës, trajnimeve dhe specializimeve si dhe kohës së nevojshme për avancim. Po ashtu, për shkak të natyrës dhe llojit të punës që ka AKF, punonjësit e saj i nënshtrohen vazhdimisht rreziqeve që rrjedhin gjatë kryerjes së ekspertizave forenzike nëpër laboratorët e saj, rreziqe që shkaktohen nga përdorimi i armëve të ndryshme si, ekspozimit të rrezeve të ndryshme gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, infeksioneve, rrezikut nga palët e ndryshme ndërgjyqësore si rezultat i ekspertizave të tyre. Sipas AKF-së, *“nëse bëjmë krahasim vërehet qartë lidhshmëria dhe karakteristikat të përbashkëta ndërmjet Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor, Agjencinë e Inteligjencës, Doganën etj.”*
48. AKF ankohet se Ligji i kontestuar, nuk ka *“marrë për bazë specifikat e këtij institucioni por ka vendosur që marrëdhënien e punës së zyrtarëve të saj me shtetin, ta trajtoj dhe rregulloj njëjtë sikurse të ishte administratë e zakonshme e një Ministrie, Komune etj.[...]”*. Sipas AKF-së, ligjvënësi nuk ka marrë për bazë rolin e AKF-së sipas Kodit të Procedurës Penale në kryerjen e ekspertizave ku shumica e tyre kryhen *“nëpër laboratorët e AKF-së”*. Ata shtojnë se përkundër faktit që AKF është institucion që i shërben drejtësisë dhe sigurisë sikurse Policia, Dogana e Inspektoriari policor, ata nuk janë përfshirë

në nenin 3, paragrafi 3 të Ligjit të kontestuar si institucion me status të veçantë.

49. AKF më tej thekson se “*Është fakt se në kuptim të [LOFASHAP], AKF-ja, është administratë shtetërore, mirëpo nuk mund të rregullohet marrëdhënia e punës se punonjësve-zyrtarëve të saj njëjtë me administratën e Kuvendit, Kryeministrit, Ministrive apo Komunave, për arsye të dallimeve thelbësore dhe specifike që kanë njëra me tjetrën, të theksuara në paragrafët 1, 2, 3 të kësaj shkrese*”.
50. AKF po ashtu potencon se “[...] në situatën e krijuar me Ligjin nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pothuajse të gjitha çështjet që lidhen me punonjësit-zyrtarët e AKF-së, do të pësojnë ndryshime, përshtirë pagat të cilat do të ulën deri në 30%, nga muaji dhjetor 2019, për shkak se ky ligj ka lidhshmëri me Ligjin nr. 06/l-111 për Pagat në Sektorin Publik , dhe kjo është kthim prapa dhe rrezikim i të ardhmes së këtij institucioni”.

Komentet e Policisë së Kosovës

51. Policia e Kosovës ankohet se Ligji i kontestuar në nenin 3 të paragrafit 3, nënparagrafin 3.3 ka paraparë përjashtimin nga fushë-veprimtaria e zbatimit të këtij Ligji stafin civil, marrëdhënia e punë e të cilëve është e rregulluar me Ligjin për Policinë, ndërsa çështjet lidhur me kategorinë e kadetëve, nuk i ka rregulluar fare. Përfshirja e stafit administrativ të Policisë së Kosovës në Ligjin e kontestuar bie në kundërshtim me Ligjin për Policinë që ka paraparë rregullimin ndryshe të marrëdhënies së punë së stafit administrativ, në raport me pjesën tjetër të administratës. Gjithashtu, Ligji për Policinë ka paraparë mundësinë e nxjerrjes së akteve nënligjore për të rregulluar marrëdhënien e punës si dhe çështjet disiplinore. Ngjashëm është paraparë edhe me Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.
52. Policia e Kosovës thekson se “*me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës i ka përcaktuar kriteret bazë për marrëdhënien e punës për personelin policor përfshirë edhe stafin civil. Për shkak të specifikave që ka Policia e Kosovës, numrit të madh të personelit policor dhe çështjeve komplekse që përfshinë marrëdhënia e punës më në detaje kjo çështje është paraparë me dispozitat e nenit 24 paragrafi 2 të këtij UA të rregullohet me hollësisht nga Departamenti për Burime Njerëzore me (PSO) Procedura Standarde të Operimit gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Policinë, Ligjin për IPK-në dhe aktet tjera ligjore*”.

53. Andaj, Policia e Kosovës konsideron se Ligji i kontestuar është në kundërshtim me Ligjin për Policinë dhe Ligjin për Inspektoratin Policor. Ata konsiderojnë se pasi Ligji i kontestuar nuk zhvleftëson në mënyrë specifike ligjet e lartcekura, kërkesa e tyre për përjashtimin nga Ligji i kontestuar është e argumentuar. Pasi kemi ligje që rregullojnë ndryshe çështjen e njëjtë, atëherë përparësi duhet t'i jepet ligjeve të veçanta, duke u thirrur edhe në parimit "*lex specialis derogat legi generali*".
54. Lidhur me këtë, ata thirrën edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës duke theksuar se "*në Aktgjykimin Nr.04-L-093 i Gjykatës Kushtetuese me rastin KO97/12 i 12 Prill 2012 që ka të bëjë me kushtetutshmërinë e Ligjit për Bankat, Institucionet Financiare dhe Institucionet financiare jo bankare, ku gjykata shprehë një qëndrim domethënës sa i përket zbatimit uniformë të ligjeve. Sipas Gjykatës Kushtetuese: "Një ligj i ri nuk mund të anulojë dispozitat e një ligji ekzistues pa ndryshuar dispozitat relevante, të cilat përbëjnë parimet e përgjithshme ... , sepse kjo do të vinte në rrezik parimet e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit" (shih paragrafin 128 të Aktgjykimit KO97/12). Gjykata Kushtetuese në të njëjtin aktvendim thotë: "Gjykata rikujton se autoritetet kanë një detyrim kushtetues për të siguruar zbatimin uniform të ligjeve, prandaj ky detyrim mund të pengohet duke futur dispozitat të cilat kundërshtojnë plotësisht dispozitat ekzistuese përkatësisht të ligjit... pa i ndryshuar ato dispozita në të njëjtën kohë (shih paragrafin 130 të aktgjykimit KO 97/12)".*
55. Policia shprehet se për shkak të specifikave të punës së zyrtarëve administrativë të Policisë së Kosovës, është e papranueshme që MAP të përzgjedhë stafin administrativ të Policisë së Kosovës ashtu si parashihet me Ligjin e kontestuar.

Komentet e MAP-it

56. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për cenimin e pavarësisë kushtetuese nga Ligji i kontestuar, MAP sqaron se "*për dallim nga Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil në Republikën e Kosovës (LSHCK) i cili në nenin 3 paragrafi 7 në mënyrë deklarative parashikonte se "Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi" [...] Ligji [i kontestuar] bën shumë më tepër*". Në këtë aspekt ata potencojnë dallimin e qartë, sipas tyre që ekziston "*në nenin 5 [të Ligjit të kontestuar] ndërmjet "institucioneve të administratës shtetërore" (qeveria dhe administrata e saj) dhe "institucionet e tjera shtetërore" [ku përfshihen institucionet e pavarura kushtetuese] me një objektiv*

specifik për të rregulluar ndryshe këto dy grupe të organeve publike me një set të rregullave pothuajse për të gjitha dispozitat e marrëdhënies së shërbimit civil [...]”.

57. Lidhur me sa më sipër, MAP potencon dallimet në trajtim sipas Ligjit të kontestuar, si në vijim:
- procedurën e pranimit të nëpunësve për institucionet jashtë administratës shtetërore (ku përfshihen institucionet e pavarura) e bënë Njësia për Burime Njerëzore e vet institucioneve, e që kjo reflektohet në nenin 34, paragrafin 13 të Ligjit të kontestuar. Gjithashtu, emërimi përfundimtar bëhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit tjetër shtetëror në pajtim me nenin 35, paragrafi 2;
 - konkursi për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese organizohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore e “institucionit tjetër shtetëror” duke përfshirë Avokatin e Popullit që dallon nga procedura që ndiqet për institucionet e tjera. Kjo reflektohet edhe në komisionet e pranimit që themelohen nga “institucionet e tjera shtetërore” duke përfshirë edhe emërimin; dhe,
 - vlerësimi i rezultateve në punë për pozitat e larta drejtuese bëhet nga titullari i institucionit si dhe komisioni disiplinor themelohet nga vet “institucioni tjetër shtetëror”.
58. Sa i përket organizimit të brendshëm të një institucioni të pavarur në këtë rast parashtuesit të kërkesës, MAP thekson se, institucionet e pavarura kushtetuese nuk janë të përfshira në LOFASHAP pasi LOFASHAP rregullon organizimin dhe funksionimin vetëm të institucioneve të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura të themeluara sipas nenin 142 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Ligji i kontestuar nuk i ndalon institucionet e pavarura kushtetuese që të përcaktojnë organizimin e vet të brendshëm. Gjithashtu, MAP mban qëndrimin se Ligji i kontestuar nuk e shfuqizon nenin 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit që thotë se legjislacioni i shërbimit civil zbatohet ndaj parashtuesit të kërkesës deri sa nuk cenon pavarësinë e tij.
59. MAP, për më tepër, pohon se Ligji i kontestuar megjithëse i lejon Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (në tekstin e mëtejshëm: DMZP) që të kërkojnë informacion të nevojshëm lidhur me përgjegjësitë e tyre, nuk cenon pavarësinë e ndonjë institucioni, dhe mund të interpretohet, nëse është e nevojshme, në lidhje me nenin 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit ku parashtuesi i kërkesës mund të thirret në nenin 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit për të mbrojtur pavarësinë e tij. Ngjashëm është edhe me planet e stafit të çdo institucioni dhe me planifikimin e buxhetit. Duke u thirrur në parimin

- e shtetit demokratik dhe të sundimit të ligjit, MAP thekson se *“bashkëpunimi midis institucioneve të ndryshme të shtetit, e bën shtetin më të fortë dhe e lejon atë të arrijë objektivat e tij dhe t'i shërbejë në mënyrë efektive qytetarëve dhe bizneseve të tij”*.
60. Lidhur me Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejshëm: SIMBNJ), konkretisht neni 17 i Ligjit të kontestuar, MAP sqaron se *“Megjithatë Kuvendi u pajtua me Qeverinë se kush është përgjegjës për ekzekutimin e buxhetit të shtetit, të përdorë SIMBNJ për ekzekutimin e pagave dhe shpërblimeve, nuk përmendet se çdo institucion duhet të përdorë SIMBNJ për të gjithë përfituesit e buxhetit të shtetit. Njëjtë si buxheti i shtetit dhe ekzekutimi i tij i duhur, është e vështirë të imagjinohet në një institucion që nuk zbaton mjetet (në këtë rast një zgjidhje të TI) të vëna në dispozicion të tyre nga institucioni përgjegjës”*.
61. MAP potencon se gjatë draftimit të Ligjit të kontestuar, kanë qenë të angazhuar ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë dhe janë ndihmuar nga SIGMA/OECD të cilët janë konsultuar edhe me kërkesën e parashtruesit lidhur me konceptin e “pavarësisë kushtetuese” të institucioneve të pavarura. MAP në komentet e saj citon një pjesë të opinionit të SIGMA/OECD lidhur me këtë çështje.
62. Sa i përket kompetencës sipas Ligjit të kontestuar që Qeveria të nxjerrë akte nënligjore, MAP thekson se sipas Kushtetutës, përkatësisht nenit 93, paragrafi 4, parashihet shprehimisht se Qeveria ka kompetencë të nxjerrë akte juridike apo rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Kjo kompetencë e Qeverisë është zbërthyer në nenin 10, paragrafi 1.2 si dhe në nenet e veçanta të Ligjit të kontestuar. Kushtetuta nuk autorizon institucionet e pavarura kushtetuese për nxjerrjen e akteve nënligjore.
63. Sa i përket AKF-së, MAP sqaron se *“Ligji i kontestuar nuk ka për objekt rregullimi organizimin dhe funksionimin dhe statusin e institucioneve të administratës shtetërore (në rastin konkret AKF) që rrjedhimisht i njëjti nuk ka/mundet të ndryshoj statusin e një agjencie në rastin konkret të AKF. LOFASHAP ka përcaktuar tipologjinë se çfarë lloje të organeve mund të ekzistojnë në kuadër të administratës shtetërore, por edhe vet Ligji për AKF përcakton se kjo agjenci themelohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në lidhje me statusin e nëpunësve të AKF nuk ka asnjë dilemë se ata janë zyrtar publikë përderisa definimi konkret i nëpunësve të AKF (cilit lloj të zyrtarit publik ju takojnë) duhet të bëhet sipas funksioneve që ushtrojnë ata. Për këtë qëllim [Ligji i kontestuar] në nenin 83 parasheh dispozita konkrete për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë”*.

64. Sa i përket KPK-së, MAP pohon se Ligji për KPK-në dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit nuk rregullojnë marrëdhënien e punës së stafit administrativ. MAP pohon se vet Ligji për KPK-në i referohet shqiptimit të masave për stafin administrativ në pajtim me Ligjin përkatës për Shërbimin Civil.
65. Sa i përket Policisë së Kosovës, MAP sqaron se Ligji "Nr. 04/L-076 për policinë në nenin 44 paragrafi 2 "përcakton se marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor" ku hyjnë edhe nëpunësit civilë dhe sipas nenit 55 të këtij Ligji të drejtën e nxjerrjes së akteve nënligjore për marrëdhënien e punës e ka drejtori i përgjithshëm i Policisë. [...] E drejta e nxjerrjes së akteve nënligjore nga drejtori përgjithshëm e paraparë me nenit 55 të Ligjit Nr. 04/L-076 për policinë, është në kundërshtim me nenin 93, par. 4, të Kushtetutës së Kosovës, ku shprehimisht përcakton se: "Qeveria ka këto kompetenca: ... (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve [...]".

Dispozitat relevante të Ligjit të kontestuar:

Neni 2

Fusha e zbatimit

[...]

3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.

[...]

Neni 3

Përjashtime e nga fusha e zbatimit të Ligjit

1. Ky ligj nuk zbatohet për:

1.1. funksionarët publikë;

1.2. funksionarët publikë me status të veçantë.

2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë:

2.1. të zgjedhurit;

2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre;

2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura.

3. Funksionarë publikë me status të veçantë, në kuptimin e nënparagrafit 1.2 të këtij neni janë:

3.1. gjyqtarët dhe prokurorët;

3.2. personeli komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse;

3.3. zyrtarët policor të Kosovës dhe inspektorati policor i Kosovës;

3.4. zyrtarët doganor të Kosovës;

3.5. personeli drejtues dhe punonjësit e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

3.6. drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatore.

4. Marrëdhënia ndërmjet shtetit dhe funksionarit publik me status të veçantë, të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, rregullohet tërësisht me ligj të veçantë sektorial.

5. Ky ligj, gjithashtu, nuk zbatohet për personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të një komune, për të cilat marrëdhënia e punës rregullohet me legjislacionin e punës.

Neni 4

Nëpunësit civilë me status të veçantë

1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civil me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë.

2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës:

2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim;

2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj;

2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave;

2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime;

2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.

3. Nëpunësi i Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës është nëpunës civil me status të veçantë, statusi i të cilit rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Rregullimi me akt të veçantë, sipas paragrafit 4 të këtij neni, bëhet për:

4.1. *Strukturën organizative të funksionimit, klasifikimin e pozitive;*

4.2. *Kushtet e veçanta për rekrutim;*

4.3. *Orarin e punës, i cili mund të tejkalojë kufirin e orarit të punës të përcaktuar me këtë ligj, pushimin vjetor; dhe*

4.4. *Të drejtat dhe detyrimet specifike tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj.*

Neni 5

Përkufizime

1. *Fjalët apo shprehjet e tjera, të përdorura në këtë ligj, kanë këtë kuptim:*

[...]

1.2. *Institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune;*

[...]

2. *Terminologjia e përdorur në këtë ligj, si: Zyra e Kryeministrit, ministri, agjenci ekzekutive, agjenci rregullatore, degë lokale, administratat e shërbimeve publike, institucion i pavarur, agjenci e pavarur, kabinet, kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar apo të rregulluar në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura.*

[...]

Neni 10

Qeveria

1. *Qeveria:*

1.1. *miraton politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarit publik;*

1.2. *miraton aktet nënligjore në bazë të këtij ligji;*

1.3. *publikon raportin vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore të zyrtarëve publikë.*

2. *Qeveria përcakton një nga anëtarët e saj për administrimin e përgjithshëm të politikave për zyrtarët publikë (në vijim: ministri përgjegjës për administratën publike).*

[...]

Neni 11

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë

1. *Në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike krijohet dhe funksionon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (më tej: DMZP), i cili ka këto përgjegjësi:*

- 1.1. përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për zyrtarët publikë;
- 1.2. mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për zyrtarët publikë në institucionet e administratës shtetërore;
- 1.3. përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për paga për zyrtarët publikë dhe funksionarët publikë;
- 1.4. përgatit opinion për çdo projektakt të propozuar nga institucionet e tjera, që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publikë;
- 1.5. miraton dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të trajnimit për nëpunësit civilë;
- 1.6. së bashku me Ministrinë e Financave përfaqëson Qeverinë në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës të zyrtarëve publikë me sindikatat dhe me përfaqësuesit e zyrtarëve publikë;
- 1.7. të kërkojë dhe të marrë nga institucionet e Republikës së Kosovës çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre;
- 1.8. të inspektojë çdo dosje apo dokument lidhur me një vendimmarrje mbi marrëdhëniet e punës të zyrtarëve publikë në institucionet e administratës shtetërore;
- 1.9. administron dhe mirëmban Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ);
- 1.10. mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji;
- 1.11. përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtarët publikë;
- 1.12. harton politikat e angazhimit të praktikantëve në administratën publike;
- 1.13. harton planin e përgjithshëm të personelit;
- 1.14. organizon procedurat e pranimit në pajtim me këtë ligj;
- 1.15. harton raportin ujetor për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- 1.16. ushtron çdo kompetencë të dhënë me këtë ligj.

2. Përgjegjësitë e përcaktuara në nënparagrafët 1.1 dhe 1.6 të këtij neni, për aq sa kanë të bëjnë me nëpunësit administrativ dhe mbështetës, kryhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës.

3. Përgjegjësitë e përcaktuara në nënparagrafët 1.1 dhe 1.7 të këtij neni, për aq sa kanë të bëjnë me nëpunësin e Shërbimeve Publike, kryhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për politikat shtetërore për shërbimin përkatës publik.

4. Çdo institucion që merr në punë zyrtarë publikë, si dhe çdo funksionar publik dhe zyrtar publik, që ka kompetenca menaxheriale vendimmarrëse, ose që ka informacione në këtë fushë, është i detyruar të bashkëpunojnë me DMZP.

[...]

Neni 14

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)

[...]

5. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është e obliguar të mbajë raport vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore për institucionin e saj dhe deri më 31 dhjetor të vitit aktual ta dërgojë atë për aprovim te udhëheqësi më i lartë administrativ institucionit. Një kopje të këtij raporti, pas aprovimit të udhëheqësi më i lartë administrativ, deri më 15 janar të vitit vijues, duhet ta dërgojë në DMZP në ministrinë përgjegjëse për administratë publike.

[...]

Neni 15

Planet e zhvillimit të personelit

[...]

4. Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bazë të planeve të personelit të institucioneve, harton dhe miraton Planin e përgjithshëm.

[...]

6. Procedurat e hollësishme për planifikimin e personelit, miratimin e planeve, përmbajtja e planeve dhe publikimi i tyre, miratohen me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për administratën publike.

[...]

Neni 17

Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ)

[...]

7. Ministri përgjegjës për administratën publike, me akt nënligjor miraton rregullat për përmbajtjen, administrimin dhe përdorimin e SIMBNJ-së.

[...]

Neni 31

Detyrimi për zhvillimin profesional

[...]

3. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton modulet e

detyrueshme të trajnimit për çdo kategori, klasë dhe grup të pozitive të Shërbimit Civil.

[...]

Neni 32

Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil

[...]

4. Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

5. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për zbatimin e paragrafit 4 të këtij neni.

[...]

Neni 33

Klasifikimi i pozitive në Shërbimin Civil

[...]

5. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse të administratës publike, me akt nënligjor, miraton:

5.1. klasat e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtimet në çdo klasë;

5.2. grupet e administrimit të veçantë;

5.3. përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, duke përfshirë këtu kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grup;

5.4. rregullat e hollësishme, procedurat, standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e një pozite të caktuar në një klasë apo grup të caktuar, sipas këtij neni.

[...]

Neni 34

Procedura e pranimit në Shërbimin Civil

[...]

16. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e Komisionit dhe për pagesën e ekspertit të jashtëm, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

[...]

Neni 35

Përzgjedhja e pozitës dhe emërimi

[...]

6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton procedurat e hollësishme për emërimin në kategorinë profesionale.

[...]

Neni 37

Periudha e provës

[...]

5. Qeveria, me propozimin e ministrisë së administratës publike, me akt nënligjor, miraton te drejtat dhe detyrimet e nëpunësit në periudhë prove sipas këtij neni.

[...]

Neni 38

Lëvizja brenda kategorisë

[...]

7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton kushtet që duhet t'i plotësojnë nëpunësit për lëvizjen brenda kategorisë dhe procedurat e detajuara për lëvizjen brenda kategorisë, si dhe rregullat për krijimin dhe përbërjen e komisionit, të parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni.

[...]

Neni 39

Ngritja në detyrë

[...]

11. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton kushtet që duhet t'i plotësojnë nëpunësit për ngritjen në detyrë dhe procedurat e detajuara të saj, si dhe modulet e trajnimit të obligueshëm.

[...]

Neni 40

Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese

[...]

12. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton, me akt nënligjor, rregullat e hollësishme për procedurën e konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

[...]

Neni 41

Komisioni i pranimit për kategorinë e lartë drejtuese

[...]

6. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton, me akt nënligjor:

6.1. rregullat për funksionimin dhe vendimmarrjen e komisioneve;

6.2. kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve;

6.3. pagesën e anëtarëve të komisioneve, që nuk janë nëpunës civilë.

[...]

Neni 42

Përzgjedhja përfundimtare dhe emërimi në pozitë e nivelit të lartë drejtues

[...]

10. Çdo emërim në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në kundërshtim me këtë nen dhe nenin 40 është i pavlefshëm.

11. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton, me akt nënligjor, rregullat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

[...]

Neni 43

Vlerësimi i rezultateve në punë

[...]

13. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton metodologjinë dhe procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve në punë.

[...]

Neni 44

Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese

[...]

4. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton metodologjinë dhe procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve të punës për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe procedurën e zgjidhjes të mosmarrëveshjeve sipas paragrafit 3 të këtij neni.

[...]

Neni 48

Kompetenca dhe procedura disiplinore

[...]

9. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedurën e hollësishme disiplinore, ne përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

[...]

Neni 49

Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor

[...]

6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor dhe në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative.

[...]

Neni 52

Transferimi i përkohshëm

[...]

7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm sipas këtij neni.

[...]

Neni 54

Transferimi në rast mbylljes apo ristrukturimit

[...]

6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për risistemimin e nëpunësve civilë, për shkak të shuarjes apo ristrukturimit, si dhe përbërjes së hollësishme të komisionit.

[...]

Neni 67

Organizimi i konkursit

[...]

11. Klasifikimi i personelit drejtues dhe personelit profesional për administratat e Shërbimit Publik miratohet, me akt nënligjor, nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për atë fushë.

[...]

Neni 68

Procedura e konkurrimit

[...]

8. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme mbi krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komisioneve të përhershme të pranimit, rregullat e hollësishme për organizimin dhe zhvillimin e procedurës së konkurrimit dhe për vlerësimin e kandidatëve.

[...]

Neni 70

Puna provuese

[...]

8. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për punën provuese.

[...]

Neni 71

Vlerësimi i rezultateve të punës

[...]

7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve të punës.

[...]

Neni 75

Aktet nënligjore

Aktet nënligjore, të parashikuara në këtë pjesë të këtij ligji, miratohen nga Qeveria, me propozim të ministrit përgjegjës, që mbulon Shërbimin Publik përkatës dhe pas pëlqimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike.

[...]

Neni 80

Konkurrimi

4. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe të ministrisë përgjegjëse për çështjet e punës, me akt nënligjor, miraton procedurat e hollësishme të konkurrimit.

Neni 83
Dispozitat transitorë

[...]

18. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat dhe procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

[...]

Neni 85

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

66. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
67. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se, “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
68. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2, nënparagrafit 1 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;”
69. Gjykata, gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], i cili parasheh që: “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.”
70. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar që ngrit çështjen e përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar në Gjykatë, në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës.

71. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 30 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 67, paragrafin (4) të Rregullores së punës që përcaktojnë se kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 12 shtator 2019, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 8 nëntor 2019, rrjedhimisht, brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.
72. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton që:

“1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.”

73. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 67 të Rregullores së punës, i cili specifikon:

Rregulli 67

Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

74. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar dispozitat përkatëse kushtetuese që pretendon se janë shkelur, gjithashtu ka specifikuar dispozitat e Ligjit të kontestuar që konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën dhe ka paraqitur prova që mbështesin pretendimet e tij.
75. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka identifikuar dispozitat e kontestuar të Ligjit të kontestuar, ka specifikuar pretendimet e tij kushtetuese, ka paraqitur dëshmi mbështetëse dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar.
76. Rrjedhimisht, Gjykata deklaron që kërkesa është e pranueshme.

Meritat e kërkesës

77. Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, përkatësisht, neneve 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafi 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 8), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit të kontestuar.
78. Sa i përket nenit 71, paragrafi 8 të Ligjit të kontestuar, të cilin e konteston parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se ky nen i ka vetëm 7 paragrafë. Në bazë të rrethanave të rastit dhe në ndërlidhje me pretendimet e tjera të parashtruesit, Gjykata vlerëson se në fakt parashtruesi, lidhur me neni 71 të Ligjit të kontestuar, konteston paragrafin 7 të nenit 71 të Ligjit të kontestuar.
79. Në lidhje me nenet e kontestuar, parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se Ligji i kontestuar:
 - (i) Ndërhyn në marrëdhëniet e punës së personelit të KPK-së si pjesë e sistemit të drejtësisë të përcaktuar me Kapitullin VII

[Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës duke cenuar parimin e ndarjes së pushteteve, pavarësinë e KPK-së dhe parimin barazisë para ligjit;

- (ii) I jep Qeverisë dhe ministrisë përgjegjëse për administratën publike kompetenca për administrimin e çështjes së punësimit dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për të gjithë zyrtarët publikë të institucioneve shtetërore, duke përfshirë institucionet e pavarura kushtetuese siç është parashtruesi i kërkesës, duke cenuar pavarësinë kushtetuese të tyre;
- (iii) Ndërhyn në marrëdhëniet e punës së personelit të nëpunësve të AKF-së dhe nëpunësve të Policisë së Kosovës, duke cenuar ligjet specifike që rregullojnë çështjen e personelit të këtyre institucioneve dhe parimin e barazisë para ligjit.

80. Andaj, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës nuk konteston kushtetutshmërinë e neneve të kontestuara të Ligjit të kontestuar në tërësinë e tyre dhe në raport me të gjithë zyrtarët publikë të rregulluar me Ligjin e kontestuar. Por konteston vetëm kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e lartcekura shtetërore duke ngritur çështje të rëndësishme të ndarjes së pushteteve shtetërore, pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe barazisë para ligjit.

81. Rrjedhimisht, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë, kushtetutshmërinë e normave të kontestuara të Ligjit të kontestuar në raport me këto institucione, konkretisht pretendimet për:

- A) Shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë e sistemit të drejtësisë të përcaktuar me Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës;
- B) Shkelje të pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese të pacaktuara specifikisht në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura]; dhe
- C) Shkeljet e parimit të barazisë para ligjit në raport me nëpunësit e administratës së AKF-së dhe Policisë së Kosovës.

A) LIDHUR ME KUSHTETUSHMËRINË E LIGJIT TË KONTESTUAR NË RAPORT ME SISTEMIN E DREJTËSISË TË PËRCAKTUAR NË KAPITULLIN VII [SISTEMI I DREJTËSISË] TË KUSHTETUTËS

82. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe KPK ankohen se me Ligjin e kontestuar i është pamundësuar KPK-së që të rregullojë marrëdhënien e punës së personelit administrativ përmes rregullave të brendshme bazuar në Ligjin për KPK-në që autorizon KPK-në që të rregullojë mes tjerash, klasifikimin e pozitive; lëvizjen brenda kategorisë; ngritjen në detyrë; pranimin në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese; komisionet për pozita drejtuese, etj. Lidhur me këtë, KPK pretendon se është cenuar parimi i ndarjes së pushteteve i përcaktuar me Kushtetutë, si dhe pavarësia e KPK-së e garantuar me nenin 110 të Kushtetutës duke kontestuar mundësinë që Qeveria me akt nënligjor të përcaktojë pozitën e sistemit prokurorial. Lidhur me këtë, KPK po ashtu ngrit çështjen e statusit të veçantë të administratës së Kuvendit, duke theksuar se është cenuar parimi i ndarjes së pushtetit, pavarësia institucionale dhe parimi i trajtimit të barabartë të administratës së KPK-së në raport me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.
83. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe KPK, në thelb, kontestojnë kushtetutshmërinë e nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3, të Ligjit të kontestuar që ka paraparë që nëpunësit e administratës së Kuvendit janë nëpunës civil me status të veçantë, ku i lejon Kryesisë së Kuvendit që të nxjerrë akt të veçantë për të rregulluar çështjen e strukturës organizative të funksionimit; klasifikimin e pozitive; kushtet e veçanta për rekrutim; orarin e punës; si dhe të drejtat dhe detyrimet specifike të tjera nga ato të përcaktuara me Ligjin e kontestuar.
84. Andaj, parashtruesi i kërkesës dhe KPK pretendojnë se si rezultat i mos përfshirjes së administratës së KPK-së në nenin 4, paragrafi 3, ka rezultuar në shkeljen e parimit të ndarjes së pushtetit, cenimin e pavarësisë së KPK-së dhe trajtim të pabarabartë në mes të pushteteve shtetërore, pretendime që ndërlidhen jo vetëm me sistemin prokurorial por me sistemin e drejtësisë në përgjithësi, që përfshin sistemin gjyqësor dhe prokurorial, dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë.
85. Përkitazi me këto pretendime të parashtruesve, Gjykata rikujton nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës që përcakton se:

*“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, [...] e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
[...].”*

86. Gjykata po ashtu rikujton se në bazë të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre e ku Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ, Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore ndërsa, në mënyrë specifike përcaktohet se Pushteti Gjyqësor ushtrohet nga gjykatat.

87. Gjykata po ashtu i referohet nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës që përcakton *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e [...] respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, [...], ndarjes së pushtetit shtetëror [...].”*

88. Gjykata për më tepër rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte konstatuar se *“Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit”* (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KO98/11, Parashtrues, Qeveria e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, paragrafi 44).

89. Më tej, Gjykata rikujton se Komisioni i Venedikut ka theksuar se *“gjyqësori duhet të jetë i pavarur. Pavarësia do të thotë që gjyqësori nuk ka presion nga jashtë, dhe nuk është subjekt i influencës apo manipulimit, veçanërisht nga ekzekutivi. Kjo kërkesë është pjesë integrale e parimi themelor të demokracisë atë të sundimit të ndarjes së pushteteve”* (Lista e Kontrollit për Sundimin e Ligjit, të miratuar nga Komisioni i Venecias në Takimin e 106 Plenar të 11-12 marsit 2016, faqe 20).

90. Për sa i përket ndarjes së pushteteve dhe raporteve në mes të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, Gjykata i referohet Aktgjykimit Nr. U-I-4039/2009, U-I-25427/2009, U-I-195/2010, të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, të 18 korrikut 2014, që kishte konstatuar si në vijim: *“Ti jepet [...] Qeverisë kompetenca direkte që të influencojë vendosjen e pagave të gjyqësorit, do të thotë a priori që raportet në mes të dy pushteteve shtetërore, pushtetit ekzekutiv, kjo është ekzekutivi politik, dhe pushtetit gjyqësor bazohet në postulate të cilat janë të papranueshme në një shoqëri demokratike të bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit dhe sundimit të ligjit, të gjitha nën dritën e nevojës që gjyqësori të jetë i pavarur. Rrjedhimisht, është kërkesë që buron nga Kushtetuta që të gjitha elementet e pagave të gjyqësorit duhet të rregullohen nga ligjvënësi*

përmes ligjit të nxjerrë në një procedurë parlamentare demokratike në mënyrë që të respektohet esenca e garantimit të stabilitetit të pushtetit gjyqësor, që është i duhur, i kualifikuar dhe administruese e pavarur e drejtësisë, dhe ku të gjitha elementet e pagave të gjyqësorit duhet të jenë në konformitet me dinjitetin e profesionit të gjyqtarit dhe barrën e tij/saj të përgjegjësisë”.

91. Lidhur me sistemin e drejtësisë në Kosovë, Gjykata i referohet Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës që rregullon sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Sipas nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafi 1, të Kushtetutës *“Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.”*
92. Po ashtu, Gjykata i referohet edhe nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] që përcakton se:

*“1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. [...]”*

93. Lidhur me sistemin prokurorial të Kosovës, Gjykata i referohet nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës që përcakton se:

*“1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.
[...].”*

94. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], paragrafi 1, të Kushtetutës që përcakton se:

“Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin.”

95. Lidhur me sa më sipër, Gjykata thekson që Kushtetuta e Kosovës përcakton se Kosova është shoqëri demokratike e bazuar në parimin e sundimit të ligjit që garanton ndarjen e pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ku sigurohet pavarësia në mes tri pushteteve dhe kontrolli reciprok sipas parimeve të përcaktuara me Kushtetutë.
96. Gjykata thekson se Kushtetuta në mënyrë specifike përcakton se pushteti legjislativ ushtrohet nga Kuvendi, pushteti ekzekutiv nga Qeveria ndërsa pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat. Kushtetuta

ka paraparë po ashtu themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) për të siguruar pavarësinë e sistemit gjyqësor.

97. Gjykata rikujton se Kushtetuta e Kosovës nuk e përfshin në mënyrë specifike sistemin prokurorial në ndarjen klasike të pushtetit, pra brenda sistemit gjyqësor, si pushtet i tretë, pasi në mënyrë specifike Kushtetuta ka paraparë që pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat.
98. Në lidhje me këtë, sipas Raportit të Komisionit të Venecias ekzistojnë sisteme juridike ku sistemi prokurorial nuk është i pavarur nga ekzekutivi, dhe në këtë sistem nevoja për garancitë e nevojshme koncentrohet në nivel të rasteve individuale që do të ketë transparencë sa i përket instruksioneve të dhëna (shih Raportin për *Standardet Evropiane lidhur me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, Pjesa II- të shërbimeve Prokuroriale*, të miratuar nga Komisioni i Venecias në Takimin e 85 Plenar të 17-18 dhjetor 2010, paragrafi 23; shih gjithashtu, *Përmbledhjen e Komisionit të Venedikut të Opinioneve dhe Raporteve lidhur me Prokurorinë*, CDL-PI(2018)001, Strasburg, 11 Nëntor 2017, faqe 27).
99. Megjithatë, Komisioni i Venecias thekson se vetëm një numër i vendeve të Këshillit të Evropës ka zyrë prokuroriale që bënë pjesë nën autoritetin e ekzekutiv dhe nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë (p.sh. Austria, Danimarka, Gjermania dhe Holanda). Sipas Komisionit të Venecias, tendenca e shteteve është që të lejohet për pavarësi më të madhe të zyrës së prokurorit, në krahasim me varësinë ndaj ekzekutivit (shih Raportin për *Standarde Evropiane lidhur me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, Pjesa II- të shërbimeve Prokuroriale*, të miratuar nga Komisioni i Venecias në Takimin e 85 Plenar të 17-18 dhjetor 2010, paragrafi 23).
100. Sipas Komisionit të Venecias, pasi prokurorët veprojnë në emër të shoqërisë në përgjithësi dhe për shkak të pasojave serioze të dënimeve penale, prokurorët duhet të veprojnë fer, në mënyrë të paanshme dhe me standarde të larta. Edhe në sistemet ku prokuroria nuk është pjesë e gjyqësorit, prokuroria pritet të veprojë në mënyrë gjyqësore. Përderisa, Kushtetuta duhet t'i jep pavarësi sistemit prokurorial si dhe prokurorit të përgjithshëm, kujdes duhet t'i kushtohet në njërën anë mbajtjes së balancës në mes mbrojtjes nga varësia e prokurorëve nga ndërhyrjet e Qeverisë, Parlamentit, policisë apo publikut dhe, në anën tjetër, autoritetin dhe përgjegjësinë e prokurorit të përgjithshëm për tu siguruar që ata kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të duhur (shih gjithashtu, *Përmbledhjen e Komisionit të Venedikut të Opinioneve*

dhe Raporteve lidhur me Prokurorinë, CDL-PI(2018)001, Strasbourg, 11 Nëntor 2017, faqe 28).

101. Megjithatë, sa i përket Kushtetutës së Kosovës, megjithëse Kushtetuta në mënyrë specifike parasheh që pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, sistemi prokurorial i Kosovës është përfshirë në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës së bashku me sistemin gjyqësor, ku në mënyrë specifike është përcaktuar se Prokuroria e Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale ndërsa KPK, sipas nenin 110 të Kushtetutës, është mandatar që të sigurojë, mes tjerash, pavarësinë e Prokurorit të Shtetit, ngjashëm sikurse është mandatar Këshilli Gjyqësor për të siguruar pavarësinë e gjykatave.
102. Andaj, Gjykata vlerëson se Kushtetuta e Kosovës ka pasur për qëllim që sistemit prokurorial ti sigurojë pavarësinë e njëjtë për të ushtruar funksionet e saj po aq sa edhe sistemit gjyqësor. Andaj, Gjykata, për qëllime të pavarësisë së tyre institucionale që ndërlidhet me Ligjin e kontestuar, do të trajtojë sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial së bashku, në raport me pushtetin legjislativ që ushtrohet nga Kuvendi dhe pushtetin ekzekutiv që ushtrohet nga Qeveria.
103. Gjykata thekson edhe një herë se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë referencë konkrete në lidhje me pavarësinë e gjykatave apo të KGJK-së, por në mënyrë specifike ka kontestuar Ligjin e kontestuar, sidomos, përjashtimet që janë bërë nga nëpunësit civilë me status të veçantë të përcaktuar në nenin 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë] të Ligjit të kontestuar, duke pretenduar shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve si rezultat i mos përfshirjes së KPK-së në këto përjashtime duke i pamundësuar që të rregullojë vet specifikat e punës së nëpunësve të saj.
104. Andaj, Gjykata rithekson edhe një herë se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-à-vis* normave kushtetuese dhe se nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesi i kërkesës (shih rastin KO171/18, cituar më lart, paragrafi 148; shih po ashtu, ndër autoritete të tjera, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).
105. Lidhur me këtë Gjykata thekson se Ligji i kontestuar i jep kompetenca të gjerë Qeverisë që të menaxhojë dhe mbikëqyrë nëpunësit civil të administratës publike, duke përfshirë, me disa përjashtime, edhe nëpunësit civil të institucioneve siç janë nëpunësit e KGJK-së dhe KPK-së. Për më tepër, Ligji i kontestuar i jep Qeverisë kompetenca për të nxjerrë një varg të akteve nënligjore për të rregulluar me tej çështje

të rëndësishme lidhur me nëpunësit civil siç janë, çështjet e rekrutimit, emërimit, ngritjes në detyre, orarit të punës, klasifikimit të pozitive, shkeljet disiplinore, e që në thelb ndikojnë edhe në funksionimin, klasifikimin e pozitive por edhe sistematizimin dhe strukturën organizative të institucioneve, duke përfshirë edhe administratën e KGJK-së dhe KPK-së.

106. Kjo i pamundëson KGJK-së dhe KPK-së, si pjesë të sistemit të drejtësisë që në mënyrë autonome, të përcaktojnë rregulla specifike për të rregulluar çështjet e punësimit të nëpunësve të tyre, duke ndikuar edhe në përcaktimin e strukturës së tyre organizative dhe çështjet e tjera lidhur me nëpunësit civil të këtyre institucioneve, megjithëse një kufizim të tillë nuk e parasheh LOFASHAP, që përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës (shih nenin 1 [Qëllimi dhe fushëveprimi] i LOFASHAP).
107. Në këtë kontekst, Kuvendi i Kosovës, si organ legjislativ, me aprovimin e Ligjit të kontestuar, ka përcaktuar kriteret e përgjithshme për menaxhimin e zyrtarëve publikë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë nëpunësit civilë të punësuar në institucione publike, duke autorizuar Qeverinë për të menaxhuar dhe mbikëqyrë sistemin e nëpunësve civilë dhe duke nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara.
108. Megjithatë, për dallim prej sistemit të drejtësisë, lidhur me nëpunësit e të cilëve nuk ka paraparë ndonjë përjashtim, sa i përket nëpunësve civilë të vet Kuvendit të Kosovës, ligjvënësi ka vendosur disa përjashtime duke i dhënë kompetencë Kryesisë së Kuvendit që sipas nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 i Ligjit të kontestuar që të nxjerrë akt të veçantë për të rregulluar çështjen e strukturës organizative të funksionimit; klasifikimin e pozitive; kushtet e veçanta për rekrutim; orarin e punës; si dhe të drejta dhe detyrime specifike të tjera nga ato të përcaktuara me Ligjin e kontestuar.
109. Rrjedhimisht, Kuvendi i Kosovës i ka dhënë kompetencë Qeverisë që të menaxhojë me sistemin e shërbimit civil në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe sistemin e drejtësisë, por duke përcaktuar që Kryesia e Kuvendit të nxjerrë akte nënligjore lidhur me nëpunësit civil të Kuvendit, me çka ka siguruar që Qeveria nuk do të ndërhyjë në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, si pushtet legjislativ.

110. Megjithatë, Kuvendi ka dështuar që të njëjtin përjashtim ta përcaktojë edhe për nëpunësit civilë të sistemit të drejtësisë më qëllim që të sigurojë ndarjen e pushteteve jo vetëm në aspekt të gjyqtarëve dhe prokurorëve por edhe lidhur me stafin mbështetës të tyre, njësoj sikurse kishte bërë për nëpunësit civilë të Kuvendit të Kosovës.
111. Kjo për faktin se duke aplikuar të njëjtat rregulla lidhur me çështjen e punësimit, klasifikimit të pozitive, kriterëve për rekrutim dhe çështje të tjera lidhur me punësimin e nëpunësve civilë, dhe më e rëndësishme, duke lejuar Qeverinë që të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit edhe në institucionet jashtë ekzekutivit, pa marrë për bazë ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve si KGJK e KPK, ndërhyjnë edhe në përcaktimin e strukturës së tyre organizative dhe çështjet e tjera lidhur me nëpunësit civilë të këtyre institucioneve të garantuara me nenet 102, 108, 109 dhe 110 të Kushtetutës.
112. Andaj, Gjykata vlerëson se duke mos përfshirë nëpunësit civilë të KGJK-së dhe KPK-së në përjashtimet e nenin 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, Ligji i kontestuar cenon parimin e ndarjes së pushtetit të garantuar me nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës si dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor të garantuar me nenet 102 dhe 108 të Kushtetutës si dhe pavarësinë e sistemit prokurorial të garantuar me nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës.
113. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me nëpunësit e KGJK-së dhe KPK-së dhe nuk zbatohet përderisa dispozitat e këtij Ligji bien ndesh me pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.
114. Megjithatë, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të anulojë nenin 4 të Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, apo dispozitat e tjera të Ligjit të kontestuar, pasi në raport me nëpunësit e institucioneve të tjera, kushtetutshmëria e tyre nuk është kontestuar para Gjykatës, ose për ato që është kontestuar, Gjykata nuk ka gjetur shkelje (shih pjesën e Aktgjykimit për AKF-në dhe nëpunësit e Policisë së Kosovës).
115. Megjithatë, duke pasur parasysh që Gjykata sapo ka konstatuar shkelje të Ligjit të kontestuar në raport me nëpunësit e KGJK-së dhe KPK-së por nuk ka anuluar zbatimin e Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e tjera lidhur me të cilat nuk është kontestuar kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar, Kuvendi i Kosovës duhet, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të kontestuar në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, në

mënyrë që të njeh të drejtën e KGJK-së dhe KPK-së për nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme, sa i përket, *inter alia*, çështjeve të strukturës organizative të funksionimit; klasifikimit të pozitive; kushteve të veçanta për rekrutim; orarit të punës; si dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike të përcaktuara me Ligjin e kontestuar, ashtu si parashihet për nëpunësit e Kuvendit sipas nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4, ku Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara të nëpunësve të saj civilë.

B) PËRKITAZI ME PRETENDIMIN PËR SHKELJEN E PAVARËSISË KUSHTETUESE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE TË PARAPARA NË KAPITULLIN XII [INSTITUCIONET E PAVARURA] DHE KAPITULLIN VIII [GJYKATA KUSHTETUESE] TË KUSHTETUTËS

116. Përkitazi me institucionet e pavarura kushtetuese, Gjykata i referohet institucioneve të pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.
117. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se agjencitë e pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, megjithëse themelohen bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, që përfshihet në Kapitullin XII të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar në mënyrë shprehimore me Kapitullin XII të Kushtetutës. Ndërsa “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës *“janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilët rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”*. Pra, për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuajë *“me ligj”* Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuajë *“me ligj”* ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.
118. Andaj, referencat që bëhen në këtë Aktgjykim lidhur me institucionet e pavarura kushtetuese, i referohen institucioneve të pavarura

kushtetuese të cekura specifiku në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës dhe jo agjencive të pavarura të themeluara në bazë të nenit 142 të Kushtetutës dhe institucioneve të tjera të ngjashme, dhe nuk krijojnë të drejta për ato agjenci.

119. Lidhur me rastin konkret, Gjykata rikujton se në lidhje me pavarësinë kushtetuese të institucioneve të pavarura kushtetuese, konkretisht pavarësinë e Avokatin e Popullit, parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se: Ligji i kontestuar, përfshinë në fushëveprimtarinë e tij nëpunësit civilë të institucioneve të pavarura kushtetuese, konkretisht Avokatin e Popullit por duke mos përcaktuar ndonjë dispozitë specifike me të cilën respekton pavarësinë e Avokatit të Popullit; duke autorizuar Qeverinë dhe/ose ministrinë përkatëse për administratën publike me kompetenca edhe lidhur me nëpunësit e institucioneve të pavarura; si dhe, duke autorizuar Qeverinë/ministrinë përgjegjëse për administratën publike për nxjerrjen e akteve nënligjore për një varg të gjatë çështjesh që kanë të bëjnë me punësimin duke përfshirë edhe Avokatin e Popullit, rezulton në cenimin e pavarësisë e tij të përcaktuar me Kushtetutë. Ai këtë pretendim e ndërlidh edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO73/16 që mes tjerash kishte konstatuar se *“nuk mund të pritët që stafi i institucioneve të pavarura me Kushtetutë të jetë konform, në mënyrë identike, me sistemin e rekrutimit, klasifikimit të vendeve të punës, kategorizimit dhe pagave të përcaktuara me një akt juridik të natyrës së përgjithshme të nxjerrë nga Qeveria, apo me çfarëdo akti të degës së ekzekutivit, pa marrë parasysh paraprakisht, në mënyrë të duhur, specifikat dhe veçantitë e institucioneve në fjalë.”*
120. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës në thelb konteston aplikueshmërinë e Ligjit të kontestuar ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, si Avokati i Popullit si dhe kompetencat e Qeverisë të parapara me Ligjin e kontestuar për mbikëqyrjen, kërkesat për raportim, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore të mishëruara në nenet e kontestuar të Ligjit të kontestuar, të cilët janë të detyrueshëm edhe ndaj institucioneve të pavarura, pa i marrë parasysh rregullat e tyre të brendshme të nxjerra sipas autorizimeve të Kushtetutës dhe ligjeve të veçanta. Parashtruesi pretendon se, legjislacioni lidhur me zyrtarët publikë nuk mund të zbatohet ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, konkretisht në këtë rast, Avokatit të Popullit, njësoj si ndaj zyrtarëve publikë të institucioneve të tjera, pasi kjo cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të garantuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta.
121. Gjykata vëren, në anën tjetër, se MAP mban qëndrimin se Ligji i kontestuar nuk cenon pavarësinë e parashtruesit të kërkesës pasi Ligji

i kontestuar nuk e shfuqizon nenin 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit që përcakton se legjislacioni i shërbimit civil zbatohet ndaj parashtruesit të kërkesës deri sa nuk cenon pavarësinë e tij.

122. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata fillimisht e sheh të nevojshme të përcaktojë fushëveprimtarinë e Ligjit të kontestuar në raport me zyrtarët publikë të institucioneve publike të Kosovës dhe në raport me ligjet e tjera që rregullojnë çështjet e punësimit të zyrtarëve publikë në Kosovë.
123. Në lidhje më këtë, ashtu si do të sqarohet në vazhdim, nëpunësit e institucioneve të pavarura kushtetuese po ashtu janë subjekt i Ligjit të kontestuar. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet nenit 2 [Fusha e zbatimit] paragrafin 3, të Ligjit të kontestuar që përcakton se nëpunës civil është çdo *“zyrtar publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratë e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive dhe në një degë lokale të tyre, në administratë e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.”* Gjykata gjithashtu i referohet nenin 5 [Përkufizimet] të Ligjit të kontestuar që përcakton se *“Institucion tjetër shtetëror - është administrata [...] e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune.”*
124. Gjykata i referohet edhe nenit 3 [Përjashtime nga fusha e zbatimit të Ligjit] të Ligjit të kontestuar që përcakton se Ligji i kontestuar nuk zbatohet ndaj:
 - i) funksionarëve publikë (të zgjedhurit, anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre, funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës dhe titullarët e anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe agjencive të pavarura);
 - ii) funksionarëve publikë me status të veçantë (gjyqtarët dhe prokurorët, personeli komandues i Forcës së Sigurisë; zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor të Kosovës; zyrtarët doganorë; personelit drejtues dhe punonjësit e AKI-së; si dhe, drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive të pavarura rregullatore).
125. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit 1 dhe 2 të nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë] të Ligjit të kontestuar, që parasheh se nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe

shërbimit korrektues rregullohen me këtë Ligj dhe ligj të veçantë. Një përjashtim të tillë neni 4, paragrafi 3 dhe 4, i Ligjit të kontestuar e parash edhe për nëpunësit e Administratës së Kuvendit që e autorizon Kryesinë e Kuvendit të miratojë akt të veçantë për të rregulluar strukturën organizative të funksionimit dhe klasifikimin e pozitave; kushtet e veçanta të rekrutimit; orarin e punës; si dhe të drejtat dhe detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me Ligjin e kontestuar.

126. Gjykata vëren se sipas dispozitave të lartcekura, nëpunësit e administratës së institucioneve të pavarura kushtetuese janë të përfshirë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, pasi ato janë të cekura specifikisht në nenin 2 të Ligjit të kontestuar.
127. Gjithashtu, Gjykata vëren se institucionet e pavarura kushtetuese nuk janë të përfshira në nenet 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar që parasheh përjashtimet në zbatimin e Ligjit të kontestuar. Andaj, Ligji i kontestuar, përfshin dhe rregullon çështjen e punësimit të nëpunësve të institucioneve të pavarura kushtetuese, konkretisht parashtruesin e kërkesës.
128. Lidhur me raportin në mes të Ligjit të kontestuar dhe ligjeve të tjera të veçanta që rregullojnë çështjen e punësimeve, Gjykata i referohet edhe nenit 85 të Ligjit të kontestuar që përcakton se:

“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.”

129. Gjykata vëren rrjedhimisht, se Ligji i kontestuar sipas nenit 85 të tij në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil si dhe çdo dispozitë tjetër juridike, që është në kundërshtim me të, duke përfshirë këtu edhe ligjet e veçanta të institucioneve të pavarura siç është Avokati i Popullit përderisa ato ligje apo rregullore, rregullojnë ndryshe çështjen e nëpunësve të këtyre institucioneve.
130. Andaj, si përfundim lidhur me fushëveprimtarinë e Ligjit të kontestuar dhe raportin e këtij ligji me ligjet e tjera, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar aplikohet ndaj të gjitha institucioneve të Kosovës që punësojnë shërbyes civilë me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, të sqaruar më lart, e ku institucionet e pavarura kushtetuese nuk përfshihen në listën e përjashtimeve në zbatimin e Ligjit të kontestuar.

131. Rrjedhimisht, në vijim Gjykata do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Ligji i kontestuar, specifikisht nenet e kontestuarra, duke paraparë rregulla të njëjta për të gjitha institucionet shtetërore, duke përfshirë institucionet e pavarura kushtetuese, duke paraparë si kompetencë të Qeverisë mbikëqyrjen dhe raportimin lidhur me çështjen e punësimit për këto institucione, veçanërisht duke iu pamundësuar institucioneve të pavarura kushtetuese nxjerrjen e akteve të brendshme, cenojnë pavarësinë e institucioneve të pavarura, të garantuar me Kushtetutë, duke përfshirë Avokatin e Popullit. Gjykata, fillimisht, do të: a) elaborojë parimet e përgjithshme lidhur me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese siç është Avokati i Popullit; dhe b) vlerësojë nëse dispozitat e kontestuarra të Ligjit të kontestuar shkelin këto parime.

a) Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës si dhe të përcaktuara në praktiken e Gjykatës

132. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës Ligjin e kontestuar e konteston kryesisht në raport me Avokatin e Popullit dhe pavarësinë e tij të garantuar me nenin 132 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata rritheksion se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-à-vis* normave kushtetuese dhe se nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesi i kërkesës (shih rastin KO171/18, cituar më lart, paragrafi 148; shih gjithashtu, ndër autoritete të tjera, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).
133. Andaj, Gjykata duke pasur parasysh statusin, rolin dhe funksionin kushtetues që kanë institucionet e pavarura kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë, do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në raport me të gjitha institucionet e pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë specifike në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës.
134. Gjykata rikujton se pavarësia e institucioneve të pavarura kushtetuese, ka qenë objekt shqyrtimi në rastin KO171/18, parashtrues, *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimi i 25 prillit 2019 (në tekstin e mëtejme:

Aktgjykimi KO171/18) dhe rastin KO73/16, parashtues, *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016, Aktgjykimi i 16 nëntorit 2016 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO73/16).

135. Në aktgjykimet e lartcekura, Gjykata kishte theksuar se *“Kushtetuta është e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Përveç tri degëve të pushtetit, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësorit të rregullt, Kushtetuta i garanton status special Zyrës së Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kushtetuta, gjithashtu, ia garanton statusin special Gjykatës Kushtetuese, si garantues dhe interpretues përfundimtar i Kushtetutës. Parashtuesi i kërkesës dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë pjesë e legjislativit, e ekzekutivit dhe e gjyqësorit të rregullt. E njëjta vlen për institucionet e tjera të pavarura të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës”* (shih, Aktgjykimin KO171/18, para. 119; dhe Aktgjykimin KO73/16, para.63, 64, 65. Shih gjithashtu, Aktgjykimin në rastin KO98/11, të 20 shtatorit 2011, parashtues *Qeveria e Kosovës*, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paragrafi 44).
136. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton edhe njëherë nenin 132. 2 të Kushtetutës që përcakton se *“Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës”* si dhe nenin 133 [Zyra e Avokatit të Popullit], që përcakton se *“Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj”* (shih Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 120).
137. Gjykata i referohet edhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht nenin 3 [Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit], paragrafi 2 që përcakton se *“Institucioni i Avokatit të Popullit gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj”*, si dhe nenin 32 [Personeli], paragrafi 2, që përcakton se: *“ndaj të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa*

nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit” (shih Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 121).

138. Gjithashtu, gjykata rikujton se sipas nenit 37 [Rregulloret e Institucionit] të Ligjit për Avokatin e Popullit, *“Avokati i Popullit nxjerr Rregulloren e punës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin”.*
139. Gjkata në Aktgjykimin KO73/16 dhe Aktgjykimin KO171/18, kishte theksuar se *“Zyra e Avokatit të Popullit është institucion i pavarur që është krijuar për të siguruar llogaridhënie nga autoritetet publike vis-à-vis të drejtave dhe lirive të individëve. Në përmbushjen e kësaj detyre, ky institucion ushtron në mënyrë të pavarur mandatin e tij duke mos pranuar asnjë instruksion apo ndërhyrje nga ndonjë autoritet tjetër shtetëror. Gjithashtu, Kushtetuta, u vë obligim organeve të shtetit, nëpërmjet mjeteve legjislative dhe mjeteve të tjera, që të sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë, dinjitetin dhe efektshmërinë e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura”* (shih Aktgjykimin KO73/16, para. 68 dhe 69; dhe Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 123).
140. Për më tepër, Gjkata kishte theksuar se të gjitha institucionet janë të obliguara me Kushtetutë të respektojnë pavarësinë e Zyrës së Avokatit të Popullit. Po ashtu, Gjkata kishte theksuar se Avokati i Popullit është i obliguar të sigurojë pavarësinë e tij duke nxjerrë rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike në atë mënyrë që ato të mos kufizojnë pavarësinë e tij funksionale, organizative dhe financiare (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin KO73/16, para. 69 dhe Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 124).
141. Në këtë aspekt, Gjkata gjithashtu rikujton edhe rolin dhe statusin që Kushtetuta i garanton edhe institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese të përfshira në mënyrë specifike në Kapitullin XII të saj. Sa i përket Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, rolin dhe statusin kushtetues të tij, Gjkata rikujton se sipas nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], paragrafit 1 që përcakton se *“Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar”* dhe paragrafit 2 që përcakton se *“Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.”*
142. Sa i përket Komisionit Qendror Zgjedhor dhe rolit dhe statusit të tij si institucion i pavarur kushtetues, Gjkata i referohet nenit 139,

paragrafit 1 të Kushtetutës, i cili përcakton që: *“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe shpall rezultatet e tyre.”* Andaj, ashtu si ka sqaruar Gjykata në rastin e saj KO58/19, KQZ është organ i përhershëm i mandatuar për administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve në Kosovë, që kryen funksionet e saj në mënyrë profesionale dhe të paanshme, e pavarur nga çdo interes politik. Rrjedhimisht, Kushtetuta i atribuon KQZ-së natyrën e organit të përhershëm shtetëror, si dhe ia njeh asaj autoritetin e vetëm dhe të pavarur për të kontrolluar dhe certifikuar mandatin e institucioneve përfaqësuese (shih rastin e Gjykatës KO58/19, Aktgjykimi i 29 korrikut 2019, paragrafët 99 dhe 100).

143. Gjykata po ashtu rikujton edhe nenin 140 [Banka Qendrore e Kosovës] që në mënyrë shprehimore rregullon statusin e këtij institucioni të pavarur kushtetues, konkretisht paragrafin 1 të nenit 140 që përcakton se *“Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës”*, dhe paragrafin 2 që përcakton se *“Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ushtron kompetencat dhe pushtetin e vet vetëm në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme”*.
144. Gjithashtu, Gjykata i referohet edhe statusit specifik të Komisionit të Pavarur të Medieve, që sipas nenit 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] *“është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj”*.
145. Ngjashëm si për parashtruesin e kërkesës, sa i përket Gjykatës Kushtetuese, në Aktgjykimin e saj KO73/16, dhe Aktgjykimin KO171/18, Gjykata kishte konstatuar se mandati për të nxjerrë rregulloren e vet të punës është vendosur brenda kompetencës ekskluzive të Gjykatës, duke arsyetuar edhe qëllimin e këtij përcaktimi si në vijim: *“[qartazi, autorët e Kushtetutës kishin për qëllim sigurimin e pavarësisë dhe të efikasitetit të Gjykatës Kushtetuese, duke ia mundur Gjykatës që vetë të krijojë Rregulloren e punës ashtu që të parandalojë çfarëdo ndërhyrje në ushtrimin e përgjegjësiave që i janë caktuar asaj. Kjo, po ashtu, tregon dhe konfirmon që Gjykata ka pozicion dhe autoritet të veçantë sipas Kushtetutës dhe brenda sistemit të institucioneve shtetërore. Rrjedhimisht, pavarësia e Gjykatës e kërkon që ajo të udhëhiqet nga rregulla specifike, për më tepër të vlerave kushtetuese, dhe e obligon Qeverinë dhe degët e saj t’i respektojnë ato”* (shih Aktgjykimin

KO73/16, paragrafi 79 dhe 80; dhe Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 128).

146. Gjykata po ashtu ka theksuar se ajo duhet të jetë në gjendje të vendosë vetë për organizimin e saj të brendshëm dhe të arrijë funksionim efikas. I takon Kuvendit të përcaktojë dhe të miratojë buxhetin e institucioneve të Republikës së Kosovës, por në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kushtetuta e obligon ligjvënësin dhe ekzekutivin të mos cenojnë pavarësinë e Gjykatës (shih, për shembull, *Vendim përkitazi me pranueshmërinë dhe meritat i Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës* në rastin nr. U. 6/06, të 29 marsit 2008; shih po ashtu Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 129).
147. Ky status i veçantë, i parashtresit të kërkesës dhe i institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës, ishte reflektuar për më tepër, edhe në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të cilin Ligji i kontestuar parasheh ta shfuqizojë, përkatësisht, paragrafin 4, të nenit 1 [Qëllimi dhe fushëveprimi] që përcakton se “*institucionet e administratës qendrore, të cilat rregullohen me akte të posaçme, iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji [Ligjit për Shërbimin Civil], përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme*” dhe nenin 3 [Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës] që përcakton se “*gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi*” (shih Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 130).
148. Gjykata vëren gjithashtu se në Aktgjykimin e saj KO73/16, ku kishte vlerësuar Qarkoren e Qeverisë për klasifikimin e pozitive në shërbimin civil, kishte deklaruar se “*implementimi i ligjeve dhe i politikave shtetërore është njëra nga detyrat kushtetuese të Qeverisë. Megjithatë, Qeveria duhet të marrë parasysh statusin e veçantë të Avokatit të Popullit, dhe të institucioneve të tjera të pavarura në pajtim me garancinë kushtetuese të pavarësisë së tyre siç është theksuar më lart. Rrjedhimisht, përgatitja, përmbajtja dhe aplikueshmëria e çfarëdo norme lidhur me funksionimin e tyre dhe me përshkrimet e brendshme të vendeve të punës dhe të pagave duhet të zhvillohet dhe të përcaktohet në mënyrë të duhur. Qeveria nuk mund të mjaftohet duke aplikuar kritere identike me ato që aplikohen për agjencitë qeveritare, t'i aplikojë në mënyrë të njëjtë edhe për institucionet e pavarura të definuara në Kushtetutë*” (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin KO73/16, paragrafi 69).
149. Gjykata ne rastet e saj KO73/16 dhe KO171/18 në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura, iu kishte referuar edhe Vendimit (V-19-07) të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, që arsyetoi:

“Nocioni i pavarësisë nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën përmbajtje apo kuptim referuar në tërësi të gjithë organeve apo institucioneve kushtetuese. Ai ndryshon në varësi të natyrës së organit, detyrave dhe funksioneve të tij kushtetuese. Megjithatë, marrë në tërësi, duhet vënë në dukje se pavarësia e tyre e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet organike përkatëse, ka si përbërës apo elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare. Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, ndër të tjera, pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese [...]. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese[...]. Nga ana tjetër, dispozitat kushtetuese dhe ligjet organike përkatëse përcaktojnë qartazi se menaxhimi i këtij buxheti në përputhje me ligjin duhet t’u lihet në dorë vetë këtyre organeve. Sigurisht, ato i dinë dhe i vlerësojnë më mirë se kushdo tjetër kërkesat dhe problemet e tyre, nevojat për investime, objektivat që synojnë të arrijnë etj” (shih Vendimin (V-19-07) në rastin nr. 43/13, të 3 majit 2007, të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

150. Andaj, sa i përket statusit të personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese, ashtu si derivon nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, dhe parimeve të sqaruara më lart, Gjykata në Aktgjykimin KO171/18, ripërsërit se:
 - a) dispozitat e legjislacionit relevant, duke e përfshirë legjislacionin e shërbimit civil që ishte në fuqi para miratimit të Ligjit të kontestuar, nuk i referohen në mënyrë specifike personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese si

shërbyes civilë, por parashohin që ndaj tyre aplikohet legjislacioni i shërbimit civil;

- b) legjislacioni i shërbimit civil, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, aplikohen ndaj personelit të këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese vetëm për atë që ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre;
 - c) Kushtetuta dhe ligjet e veçanta i autorizojnë dhe obligojnë institucionet e pavarura, veçanërisht, parashtruesin dhe Gjykatën, që të nxjerrin rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative, por vetëm për atë që është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e tyre të paraparë me Kushtetutë dhe ligje të veçanta.
 - d) rregulloret dhe aktet e tjera juridike të institucioneve të pavarura kushtetuese, që rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të institucioneve të pavarura që derivojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, duhet të respektohen nga të gjitha institucionet, përfshirë ekzekutivin dhe institucionet e tjera, siç është Këshilli, dhe kanë përparësi ndaj ligjeve të tjera (shih Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 133).
151. Në anën tjetër, Gjykata ka theksuar se institucionet e pavarura, përfshirë parashtruesin e kërkesës, nuk mund të veprojnë në vakum në raport me kornizën ligjore. Gjykata konsideron se pavarësia e parashtruesit të kërkesës dhe e Gjykatës, gjithashtu i nënshtrohet disa kufizimeve dhe kontrollit. Këto i përmban neni 14.3 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese që parashihet: *“Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës”*. Ngjashëm, neni 35.4 i Ligjit për Avokatin e Popullit parashihet: *“Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës”* (shih Aktgjykimin KO73/16, paragrafi 90; dhe Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 134).
152. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se sipas nenit 137 të Kushtetutës [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës], Auditori i

Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është i vetmi autoritet i themeluar me Kushtetutë që mund të auditojë aktivitetin ekonomik të parashtruesit të kërkesës dhe të Gjykatës, si dhe të të gjitha institucioneve të tjera publike në Republikën e Kosovës (shih Aktgjykimin KO73/16, paragrafi 91; dhe Aktgjykimin KO171/18, paragrafi 135).

b) Zbatimi i këtyre parimeve lidhur me Ligjin e kontestuar

153. Gjykata rikujton se sipas nenit 2 [Fusha e zbatimit] të Ligjit të kontestuar, parashihet që Ligji i kontestuar aplikohet ndaj të gjitha institucioneve publike, duke përfshirë institucionet e pavarura kushtetuese, siç është parashtruesi i kërkesës, por jo edhe ndaj atyre të përcaktuara nenin 3 [Përfshirje nga fusha e zbatimit të Ligjit] dhe 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë] të Ligjit të kontestuar që përfshijnë funksionarët publik, funksionarët publik me status të veçantë (ndaj të cilëve Ligji i kontestuar nuk aplikohet) dhe nëpunësve publik me status të veçantë (nëpunësit e shërbimit diplomatik dhe nëpunësit e Kuvendit të Kosovës, ndaj të cilëve aplikohet ky Ligj dhe aktet e tyre të veçanta).
154. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar nuk parasheh përjashtim në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar në nenin 2 [Fusha e zbatimit] apo në përjashtimet e përcaktuara në nenin 3 [Përfshirje nga fusha e zbatimit të Ligjit] dhe nenin 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë] sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese të përfshira në Kapitullin VIII dhe XII të Kushtetutës, siç bënë Kushtetua, ligjet e veçanta dhe Ligji për Shërbimin Civil i paraparë të shfuqizohet me Ligjin e kontestuar. Respektivisht, Ligji i kontestuar nuk parasheh mundësinë që gjatë zbatimit të Ligjit, do të merren në konsideratë ligjet e veçanta të institucioneve të pavarura dhe rregullat e tyre të brendshme për të siguruar pavarësinë e tyre, pasi, ashtu si është sqaruar, më lart: në nenin 85 të tij shfuqizon çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë Ligj duke përfshirë edhe ligjet e veçanta që rregullojnë këto institucione.
155. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 10 të Ligjit të kontestuar që përcakton se *“Qeveria, mes tjerash, miraton politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarit publik dhe miraton aktet nënligjore në bazë të këtij ligji.”* Gjithashtu, dispozitat e tjera të kontestuar të Ligjit të kontestuar i japin kompetenca Qeverisë që, mes tjerash, të nxjerrë rregulla lidhur me planet e personelit dhe sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore; marrëdhënien e punës në shërbimin civil dhe klasifikimin e vendeve

të punës; pranimin në shërbimin civil; lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritja në detyrë; emërimin në pozita të kategorisë së lartë drejtuese; vlerësimin e rezultateve në punë; disiplinën në shërbimin civil; transferimin në shërbimin civil dhe çështje të ngjashme që kanë të bëjnë me punësimin dhe çështje pune të zyrtarëve publikë.

156. Andaj, Gjykata vlerëson se, Ligji i kontestuar, parasheh një qasje të njëjtë ndaj të gjitha institucioneve publike duke përfshirë edhe institucionet e pavarura kushtetuese, me disa përjashtime të përcaktuara në dispozita specifike të Ligjit të konstatuar e të cilat i thekson në përgjigjen e saj edhe MAP, e të cilat përjashtime reflektohen në faktin se procedurën e konkursit të nëpunësve për institucionet jashtë administratës shtetërore (ku përfshihen institucionet e pavarura) e bënë Njësia e Burimeve Njerëzore e vet institucioneve (shih paragrafin 3 të nenit 34 [Procedura e pranimin në Shërbimin Civil] të Ligjit të kontestuar). Gjithashtu, Komisioni i Pranimin caktohet nga titullari i institucionit (paragrafi 13 i nenit 34); konkursi për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese organizohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore e “institucionit tjetër shtetëror” (shih paragrafin 5 të nenit 41 [Komisioni i pranimin për kategorinë e lartë drejtuese] të Ligjit të kontestuar; emërimi i këtij të fundit bëhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit tjetër shtetëror (shih paragrafin 4 të nenit 42 [Përzgjedhja përfundimtare dhe emërimi në pozitat e nivelit të lartë drejtues] që dallon nga procedura që ndiqet për institucionet e Qeverisë.
157. Megjithatë, Gjykata vëren se të gjitha këto veprime dhe përjashtime parashihen të kryhen ose bazuar në dispozitat e Ligjit të kontestuar, ose në aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria dhe në thelb, Ligji i kontestuar nuk merr për bazë pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, ligjet e tyre specifike dhe rregullat e tyre të brendshme që derivojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta.
158. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton edhe njëherë se sipas Kushtetutës dhe ligjeve të veçanta si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në këtë Aktgjykim: ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Lidhur me këtë, Gjykata është e vetëdijshme se jo të gjitha nenet e kontestuar dhe kompetencat që i janë përcaktuar Qeverisë lidhur me Ligjin e kontestuar ndikojnë drejtpërdrejtë në pavarësinë e institucioneve të pavarura.
159. Megjithatë, ashtu si buron nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, institucionet e pavarura, parashtruesi i kërkesës, janë të autorizuar që të nxjerrin akte të brendshme, për të rregulluar specifikat në lidhje

me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet e tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative dhe vetëm për atë që kjo është e nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre dhe lidhur me ato çështje për të cilat është e nevojshme një gjë e tillë.

160. Këto norma të veçanta, duhet të respektohen nga të gjitha institucionet përfshirë edhe Qeverinë dhe institucionet që mbikëqyrin zbatimin e këtyre dispozitave.
161. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se duke autorizuar Qeverinë që të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit, duke përfshirë, klasifikimin e pozitave, kriterëve për rekrutim dhe çështje të tjera edhe në institucionet e pavarura kushtetuese, pa marrë për bazë pavarësinë e institucioneve të pavarura, Ligji i kontestuar marrë në tërësinë e tij, cenon thelbin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese të garantuar me Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, si autoritete shtetërore të ndara nga legjislativi, ekzekutivi, nga gjyqësori i rregullt dhe institucionet e tjera.
162. Megjithatë, ashtu si u theksua dhe më lart, lidhur me institucionet e sistemit të drejtësisë, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të anulojë këto dispozita në tërësinë e tyre pasi këto dispozita aplikohen edhe ndaj nëpunësve të institucioneve të pavarura kushtetuese përderisa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre dhe gjithashtu aplikohen në raport me nëpunësit e institucioneve të tjera, kushtetutshmëria e të cilave nuk është kontestuar para Gjykatës në mënyrë specifike.
163. Gjykata konstaton se nenet 2 (paragrafi 3), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit të kontestuar cenojnë pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, të përcaktuara në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura]. Rrjedhimisht Ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me këto institucione, dhe nuk zbatohet ndaj këtyre institucioneve,

përderisa ky Ligj nuk respekton pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.

164. Duke pasur parasysh që Gjykata ka konstatuar shkelje të Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e pavarura Kushtetuese por nuk ka anuluar zbatimin e Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e tjera lidhur me të cilat nuk është kontestuar kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar, si dhe faktin që Ligji i kontestuar zbatohet edhe ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese përderisa nuk cenon pavarësinë e këtyre institucioneve, Kuvendi i Kosovës duhet, në afatin sa më të shkurtër, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të kontestuar në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, në mënyrë që të njihen funksionet dhe autoriteti specifik i institucioneve të pavarura kushtetuese që reflektohet në nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, sa i përket, *inter alia*, çështjes së strukturës organizative të funksionimit; klasifikimit të pozitive; kushteve të veçanta për rekrutim; si dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike të tjera nga ato të përcaktuara me Ligjin e kontestuar, sipas specifikave të punës të personelit të tyre.

C) LIDHUR ME PRETENDIMET PËR SHKELJET KUSHTETUESE NË RAPORT ME AKF-NË DHE NËPUNËSIT E POLICISË SË KOSOVËS

165. Gjykata i referohet pretendimeve të parashtruesit të kërkesës por edhe komenteve të vet AKF-së dhe Policisë së Kosovës të dorëzuara në Gjykatë. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i AKF-së para Gjykatës është se Ligji i kontestuar nuk merr parasysh specifikat e AKF-së të përcaktuara më Ligjin nr.04/L-64 për AKF-në, Ligjin nr 05/L-022 për Armët, Ligjin 05/L-017 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Sigurti (me amendamentet e saj) si dhe Kodin e Procedurës Penale përkundër faktit *“që AKF është institucion që i shërben drejtësisë dhe sigurisë sikurse Policia, Dogana e Inspektorati policor”*. Andaj, ata pretendojnë se përkundër këtyre specifikave dhe natyrës së punës së tyre, për dallim nga zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor; si dhe zyrtarëve doganorë, AKF nuk është përfshirë në nenin 3 [Përjashtime nga fusha e zbatimit të Ligjit], paragrafin 3 të Ligjit të kontestuar që përcakton funksionarët me status të veçantë, ndaj të cilëve aplikohet ligji i veçantë dhe jo Ligji i kontestuar.
166. Andaj, parashtruesi i kërkesës dhe AKF kontestojnë faktin që AKF është trajtuar me Ligjin e kontestuar, si agjenci ekzekutive marrëdhënia juridike e nëpunësve të së cilës rregullohet me Ligjin e

kontestuar sipas përkufizimit të nenit 2 [Fusha e zbatimit], paragrafit 3, të Ligjit të kontestuar, që përmban definicionin e nëpunësit civil.

167. Andaj, AKF në thelb pretendon se Ligji i kontestuar, i diskriminon nëpunësit e AKF-së në raport me zyrtarët policorë dhe inspektoratit policor të Kosovës dhe zyrtarët doganorë.
168. Sa i përket nëpunësve të Policisë së Kosovës, Policia e Kosovës po ashtu konteston mospërfshirjen në përjashtimet e nenit 3 [Përjashtime nga fusha e zbatimit të Ligjit], paragrafi 3 të Ligjit të kontestuar të nëpunësve civilë të Policisë së Kosovës njësoj sikurse bënë përjashtim edhe për zyrtarët policorë dhe kjo bie në kundërshtim me Ligjin për Policinë dhe aktet nënligjore të Policisë së Kosovës. Lidhur me këtë, ata ankohen se Ligji i kontestuar nuk merrë për bazë specifikat e marrëdhënies së punës së nëpunësve të Policisë së Kosovës.
169. Gjykata para se të trajtojë çështjen e barazisë para ligjit lidhur me nëpunësit e AKF-së dhe Policisë së Kosovës, dëshiron të rikujtojë edhe një herë atë që ka përcaktuar në rastin KO171/18, të cekur më lart se, se agjencitë e pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo, pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar në mënyrë shprehimore me Kapitullin XII të Kushtetutës, ndërsa “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës “janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”. Pra, për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuajë “me ligj” Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuajë “me ligj” ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.
170. Në këtë aspekt, edhe lidhur me pretendimet e lartcekura të AKF-së dhe Policisë së Kosovës që ndërliiden me statusin e tyre, fillimisht të Policisë së Kosovës si institucion i përcaktuar me nenin 128 të Kushtetutës që përfshihet në Kapitullin XI [Sektori i Sigurisë] të Kushtetutës si dhe AKF-në si Agjenci ekzekutive, Gjykata rithekson se këto institucione nuk e gëzojnë statusin e njëjtë të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara shprehimisht në Kapitullin XII të Kushtetutës.

171. Andaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse me nenin 2 [Fusha e zbatimit], paragrafin 3 që definon nëpunësit civilë në atë mënyrë që përfshin edhe stafin e AKF-së si agjenci ekzekutive, edhe nëpunësve të Policisë së Kosovës ndaj të cilëve aplikohet Ligji i kontestuar, dhe duke mos përjashtuar ata nga zbatimi i Ligjit të kontestuar sikurse zyrtarët policorë, të inspektoratit policor, nëpunësit e AKI-së dhe zyrtarët doganorë, është shkelur e drejta për barazi para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ.

Parimet e përgjithshme në lidhje me barazinë para ligjit

172. Gjykata përsërit që neni 24 i Kushtetutës si dhe neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (të tekstin e mëtejme: KEDNJ) përcaktojnë se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore.
173. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Lidhur me këtë Gjykata vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, *ose status*, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrehet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, rastin KO157/18, parashtues: *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 13 marsit 2019 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO157/18), paragrafi 77; shih po ashtu, *mutatis mutandis Kjeldsen, BuskMadsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72 të 7 dhjetorit 1976, para. 56; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05 e 16 marsit 2010, para. 61).
174. Gjykata konsideron se, për qëllimet e interpretimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim ndryshe, në rrethana të njëjta apo analoge, është i pabarabartë dhe arbitrar nëse: 1) nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim, dhe 2) kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatesisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që

synohet të realizohet (shih, Aktgjykimin KI157/18, cituar më lart, paragrafi 78; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesat nr. 9214/80; 9473/81 dhe 9474/81 të 24 prillit 1985, paragrafi 72).

175. Gjykata thekson se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë, përkatësisht një hapësirë diskrecionale, kur vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase mund të arsyetohet trajtimi i pabarabartë në rrethana të njëjta. Fushëveprimi i kësaj margjine ndryshon sipas rrethanave, sipas objektit të çështjes dhe sipas historisë së rastit. Një margjinë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih, Aktgjykimin KI157/18, cituar më lart, paragrafi 78; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13378/05 e 29 prillit 2008, paragrafi 60; *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 64).

Nëse ka pasur trajtim të pabarabartë në situatë analoge apo të ngjashme

176. Gjykata së pari përcakton nëse ekziston një dallim në trajtimin në situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme. Në rast se një kusht i tillë plotësohet, atëherë Gjykata do të vlerësojë nëse trajtimi i tillë: 1) ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se ndjek një qëllim legjitim, ose 2) ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatësisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.
177. Sa i përket AKF-së Gjykata vëren se, sipas paragrafit 2, pika 2.3 dhe 3 të Nenit 2 [Fusha e zbatimit] të Ligjit të kontestuar nëpunësit e agjencive ekzekutive janë zyrtarë publikë marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet me Ligjin e kontestuar. Gjykata gjithashtu vëren se edhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës hyjnë në kategorinë e nëpunësve civilë ndaj të cilëve aplikohet Ligji i kontestuar.
178. Gjykata përsërit edhe njëherë se sipas nenit 3 [Përfshirje nga fusha e zbatimit të Ligjit] paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, 3.4 dhe 3.5 respektivisht, zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor; zyrtarët doganorë; dhe zyrtarët e AKI-së përfshihen nga aplikimi i Ligjit të kontestuar dhe lidhur me marrëdhënien e punës së të cilëve aplikohet ligji i veçantë. Andaj, Gjykata thekson se nëpunësit e Policisë së Kosovës dhe Doganës së Kosovës nuk përfshihen në përfshirjet e nenit 3 të Ligjit të kontestuar.

179. Andaj, duke pasur parasysh që nëpunësit e AKF-së dhe nëpunësit e Policisë së Kosovës trajtohen me Ligjin e kontestuar në mënyrë të ndryshme në raport me zyrtarët policorë e të inspektoratit policor, zyrtarët doganorë dhe nëpunësit e AKI-së, Gjykata fillimisht duhet të trajtojë nëse nëpunësit e AKF-së dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës janë në pozitë të njëjtë apo analoge në raport me zyrtarët më të cilët bëjnë krahasimin.

180. Në këtë aspekt, lidhur me AKF-në Gjykata i referohet nenit 4 [Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë] të Ligjit nr.04/L-064 për AKF-në që përcakton se: AFK *“themelohet si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme”*. Sipas nenit 2 [Fushëveprimi], AKF është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike. Megjithatë, AKF lidhur me administrimin dhe menaxhimin i përgjigjet ministrit përgjegjës për punë të brendshme pasi neni 11 [Ministri] i Ligjit të AKF-së parash se *“Kryeshefi i AKF-së i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së”*.

181. Lidhur me Policinë e Kosovë, Gjykata i referohet Ligjit nr.-4/L-076 për Policinë i cili në nenin 3 [Përkufizimet], paragrafi 1.2 specifikon se *“Stafi Civil - personeli i policisë të cilët janë të punësuar për të kryer shërbime administrative apo mbështetëse por të cilët nuk kanë autorizime policore”*.

182. Në anën tjetër, Gjykata rikujton nenin 128 [Policia e Kosovës] të Kushtetutës që përcakton se Policia e Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike në tërë territorin e Kosovës.

183. Ndërsa, lidhur me AKI-në Gjykata rikujton se neni 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] parasheh se AKI zbulon, heton dhe mbikëqyrë kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës.

184. Sa i përket zyrtarëve doganorë, Gjykata vëren se sipas, nenit 4, paragrafit 3 të Kodit nr.03/L-109, Doganor dhe i Akcizave në Kosovë *“Doganë nënkupton, Doganat e Republikës së Kosovës përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor.”*

185. Lidhur me sa më sipër, Gjykata vëren se zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor dhe ata të AKI-së kanë përgjegjësi specifike sipas Kushtetutës për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike, respektivisht për zbulimin, hetimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë në Kosovë, si dhe përderisa, zyrtarët doganorë kanë përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit doganor.

186. Ndërsa, nëpunësit e AKF-së ofrojnë analiza objektive shkencore dhe asistencë për disa institucione në mbështetje të këtyre institucioneve. Gjithashtu, zyrtarët e AKF-së janë pjesë e ekzekutivit të cilët i përgjigjen drejtpërdrejtë ministrit përgjegjës për punë të brendshme. Andaj, natyra e punës, specifikat e punës dhe statusi juridik i nëpunësve të AKF-së, dallon nga natyra e punës së institucioneve tjera me të cilat ato krahasohen.

187. Gjykata gjithashtu, konsideron se specifikat e nëpunësve civilë të Policisë së Kosovës nuk janë të ngjashme me specifikat e punës së zyrtarëve policorë, zyrtarëve doganorë dhe zyrtarëve të AKI-së, pasi ata nuk janë përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, sikurse zyrtarët policorë, apo për zbatimin e legjislacionit doganor sikurse zyrtarët doganorë, por vetëm ofrojnë mbështetje administrative për Policinë e Kosovës. Në fakt, duke pasur parasysh specifikat e punës së tyre, Gjykata vlerëson se ato më tepër kanë ngjashmëri me funksionet e shërbyesve civilë të punësuar në institucione të tjera, si për shembull në ministri dhe agjenci ekzekutive se sa me zyrtarët policorë, zyrtarët doganorë e ata të AKI-së.

188. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se as nëpunësit e AKF-së dhe as ata nëpunës civilë të Policisë së Kosovës nuk janë në pozitë ekuivalente me zyrtarët e AKI-së; zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor; dhe zyrtarët doganorë të Kosovës, dhe si pasojë nuk është e nevojshme që të trajtohen në mënyrën e njëjtë sikurse zyrtarët policorë, zyrtarët e inspektoratit, zyrtarët doganorë dhe nëpunësit e AKI-së.

189. Andaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lart, parimi i trajtimit të pabarabartë vjen në shprehje vetëm në rastet kur një trajtim i tillë bëhet për situata të njëjta apo analoge, në rastin konkret nuk mund të flitet për një trajtim të pabarabartë sepse zyrtarët e AKF-së nuk janë në pozitë të njëjtë apo të ngjashme apo analoge me zyrtarët në raport me të cilët ata krahasohen.

190. Gjykata vjen në përfundim se nëpunësit e AKF-së nuk janë në pozitë të ngjashme apo analoge me zyrtarët policorë, doganorë dhe të inspektoratit, që e bënë të panevojshme analizën nëse trajtimi i ndryshëm ka qëllim objektiv dhe nëse ka një raport proporcionaliteti në mes të masës së ndërmarrë dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet.

191. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar duke përfshirë nëpunësi e AKF-së dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit të kontestuar, nuk cenon parimin e barazisë të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ.

192. Parashtruesi i kërkesës dhe Policia e Kosovës po ashtu ankohen se në kundërshtim me Aktgjykim e Gjykatës KO97/12 *“paragrafin 128 dhe 130 të Aktgjykimit KO97/12 të Gjykatës Kushtetuese, Ligji i kontestuar nuk shfuqizon në mënyrë specifike Ligjin e Policisë dhe rrjedhimisht shkel parimin e sigurisë juridike.”*
193. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar më lart se Ligji i kontestuar sipas nenit 85 të tij në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil si dhe çdo dispozitë tjetër juridike, që është në kundërshtim me të, duke përfshirë edhe ligjet e veçanta si dispozitat e Ligjit për Policinë lidhur me nëpunësit e Policisë së Kosovës me përjashtim të zyrtarëve policorë dhe të Inspektoratit Policor që përjashtohen nga aplikimi i Ligjit të kontestuar sipas nenin 3 [Përjashtime nga fusha e zbatimit të Ligjit], paragrafi 4.
194. Lidhur me pretendimin e Policisë së Kosovës se Ligji i kontestuar cenon parimin e sigurisë juridike pasi nuk shfuqizon në mënyrë specifike Ligjin për Policinë e Kosovës lidhur me dispozitat që rregullojnë marrëdhënien e punës së stafit administrativ, Gjykata i referohet rastit të Gjykatës KO97/12, Parashtrues: *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 13 marsit 2013, ku kishte konstatuar se parimi i sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit kërkon që një ligj i ri nuk mund të anulohet dispozitat e një ligji ekzistues pa ndryshuar dispozitat relevante (shih rastin KO97/12, paragrafi 128).
195. Gjykata në këtë rast kishte ardhur në përfundim se Ligji Nr.04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, kishte dispozita që nuk ishin në pajtueshmëri me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ por ky Ligj në nenin 117 [Efekti në dispozitat e mëparshme statutore] përcaktonte se ky Ligj shfuqizon vetëm Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/21.
196. Gjykata vlerëson se rrethanat e këtij rasti dallojnë nga rrethanat e Ligjit të kontestuar pasi, Ligji i kontestuar në nenin 85 në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të duke rregulluar marrëdhënien e punës për të gjithë zyrtarët publikë me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar.
197. Andaj, Gjykata vlerëson se pretendimi i Policisë së Kosovës lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO97/12, nuk është i bazuar.

198. Si përfundim, pretendimet për shkelje kushtetuese sa i përket nëpunësve të AKF-së dhe nëpunësve të Policisë së Kosovës, nuk janë të bazuara.

Kërkesa për masë të përkohshme

199. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë ku, në mes tjerash, kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme lidhur me Ligjin e kontestuar.
200. Më 19 nëntor 2019, Gjykata përmes Vendimit për masë të përkohshme në rastin KO203/19, e kishte miratuar si të bazuar kërkesën për masë të përkohshme dhe e kishte pezulluar zbatimin e Ligjit të kontestuar deri më 28 shkurt 2020. Më 26 shkurt 2020, Gjykata vendosi të miratojë vazhdimin e masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata më 19 nëntor 2019, deri më 28 prill 2020. Ndërsa më 22 prill 2020, Gjykata vendosi vazhdimin e masës së përkohshme lidhur me rastin nr. KO203/19 deri më 30 qershor 2020.
201. Duke qenë se Gjykata tanimë e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi për meritat e saj, nuk është më tutje e nevojshme mbajtja në fuqi e masës së përkohshme.

Përfundime

202. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë Gjykata, vendosi njëzëri: (i) që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139, 140 dhe 141 të Kushtetutës; (iii) Ligji i kontestuar nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Medie, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë; (iv) Ligji i kontestuar nuk cenon dispozitat

e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës; (v) Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën (iii); dhe (vi) që të shfuqizohet masa e përkohshme.

203. Çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht vlerësimi nëse i njëjti është në pajtueshmëri me parimin e “ndarjes së pushteteve”, “pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese” dhe parimin e “barazisë para ligjit”, të garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës. Gjykata shqyrtoi kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar vetëm në raport me institucionet e lartcekura shtetërore, pasi parashtruesi i kërkesës nuk kontestoi kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në tërësi dhe në raport me të gjithë zyrtarët publikë të rregulluar me Ligjin e kontestuar.
204. Në lidhje me institucionet e sistemit të drejtësisë, të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se Ligji i kontestuar i jep kompetenca të gjera Qeverisë që të menaxhojë dhe mbikëqyrë nëpunësit civilë të administratës publike, duke përfshirë, edhe nëpunësit civilë të institucioneve të pushtetit të Gjyqësorit, siç janë nëpunësit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Për më tepër, Ligji i kontestuar i jep Qeverisë kompetenca për të nxjerrë një varg të akteve nënligjore për të rregulluar me tej çështje të rëndësishme lidhur me nëpunësit civilë siç janë: çështjet e rekrutimit, emërimit, ngritjes në detyrë, orarit të punës, klasifikimit të pozitave, shkeljeve disiplinore, e që në thelb ndikojnë edhe në funksionimin, klasifikimin e pozitave por edhe sistematizimin dhe strukturën organizative të institucioneve përkatëse të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Kuvendi, megjithëse përmes Ligjit të kontestuar i ka dhënë kompetencë Qeverisë që të menaxhojë me sistemin e shërbimit civil në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Sistemin e Drejtësisë, ka përcaktuar që Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore lidhur me nëpunësit e Kuvendit.
205. Me këtë zgjidhje legislative është siguruar që Qeveria, respektivisht Ekzekutivi nuk do të ketë kompetenca “ndërhyrëse” në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, respektivisht Legjislativit; ndërsa që për pushtetin e Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura nuk është paraparë asnjë garanci për të parandaluar “ndërhyrjet” në

menaxhimin e nëpunësve të tyre. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se Kuvendi ka dështuar që të njëjtin përjashtim ta përcaktojë edhe për nëpunësit e Gjyqësorit dhe të Sistemit të Drejtësisë, ashtu që të siguronte ndarjen e pushteteve jo vetëm në aspekt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe lidhur me stafin mbështetës të tyre, njësoj sikurse kishte bërë për nëpunësit e Kuvendit dhe të Qeverisë.

206. Andaj, Gjykata vlerësoi se, duke mos përfshirë nëpunësit civil të institucioneve të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë], në përjashtimet e nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, Ligji i kontestuar cenon parimin e ndarjes së pushtetit të garantuar me nenin 4 dhe 7 të Kushtetutës, si dhe pavarësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës, konkretisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me këto institucione dhe nuk zbatohet ndaj këtyre institucioneve përderisa cenon pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.
207. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, të përcaktuara me Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, Gjykata iu referohet Institucioneve të Pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medie], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet të cilat krijojnë “ndërhyrje” të drejtpërdrejtë në pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuar aty.

208. Në këtë aspekt, Gjykata vlerësoi se Kuvendi, duke autorizuar Qeverinë që përmes Ligjit të kontestuar të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit, duke përfshirë, klasifikimin e pozitave, kriterëve për rekrutim dhe çështje të tjera edhe në Institucionet e Pavarura kushtetuese, pa marrë për bazë pavarësinë e tyre - cenon thelbin e pavarësisë së Institucioneve të Pavarura kushtetuese të garantuar me nenin 115 të Kapitullit VIII të Kushtetutës dhe nenet 132, 136, 139, 140, 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës, si autoritete shtetërore publike të ndara nga Legjislativi, Ekzekutivi dhe nga Gjyqësori i rregullt. Andaj, Gjykata konstatoi se shkeljet e lartpërmendura bëjnë që Ligji i kontestuar të mos jetë në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me Gjyqësorin dhe me Institucionet e Pavarura, dhe se ndaj tyre nuk mund të zbatohet përderisa nuk respekton pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative.
209. Sa i përket institucioneve të tjera lidhur me të cilat parashtuesi paraqiti kërkesën në Gjykatë, konkretisht nëpunësve të AKF-së dhe nëpunësve civilë të Policisë së Kosovës, Gjykata theksoi se Agjencitë e Pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të Institucioneve të Pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo, pasi që, për dallim nga institucionet e tjera të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës *“janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”*. Pra, për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuajë *“me ligj”* Agjenci të Pavarura, Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuajë *“me ligj”* ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.
210. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se as nëpunësit e Agjencisë Kosovare të Forenzikës dhe as nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës nuk janë në pozitë ekuivalente me zyrtarët e AKI-së; zyrtarët policorë dhe të inspektoratit policor; dhe zyrtarët doganorë të Kosovës, dhe si pasojë nuk është e nevojshme që të trajtohen në mënyrën e njëjtë. Kjo, për faktin se parimi i trajtimit të pabarabartë vjen në shprehje vetëm në rastet kur një trajtim i tillë bëhet për situata të njëjta apo analoge. Në rastin konkret nuk mund të flitet për një trajtim të pabarabartë sepse zyrtarët e AKF-së dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës nuk janë në pozitë të njëjtë apo të ngjashme, apo analoge me zyrtarët në raport me të cilët ata (vetë) krahasohen. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar duke përfshirë nëpunësit e AKF-së dhe nëpunësit

civilë të Policisë së Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit të kontestuar, nuk cenon parimin e barazisë të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ.

211. Gjykata, në fund konstatoi që nuk është e nevojshme që Ligji i kontestuar të shfuqizohet në tërësinë e tij. Në rrethanat e rastit konkret, analiza dërgoi në përfundimin se, moszbatimi i Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e cekura më lart nuk e bën Ligjin të pazbatueshëm në praktikë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Kuvendi është i obliguar që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara specifikisht në Dispozitiv të Aktgjykimit. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe me rregullat 56, 57 dhe 59 të Rregullores së punës, më 30 qershor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41(paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me: nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; 109 [Prokurori i Shtetit]; 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]; 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; dhe me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës;
- III. TË KONSTATOJË që Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Medieve, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë;
- IV. TË KONSTATOJË që Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk cenon dispozitat e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës;

- V. TË KONSTATOJË që Kuvendi i Republikë së Kosovës, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën III të këtij Dispozitivi;
- VI. TË KËRKOJË nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi;
- VII. TË SHFUQIZOJË vendimin për caktim të masës së përkohshme të 19 nëntorit 2019, dhe vendimet për vazhdimin e masës së përkohshme të 26 shkurtit 2020 dhe të 22 prillit 2020;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IX. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- X. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

VENDIM

PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO219/19

parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare), më 1 mars 2019, dhe që hyri në fuqi nëntë (9) muaj pas publikimit në Gazetë Zyrtare, respektivisht më 1 dhjetor 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon të mos jetë në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafët 3 dhe 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafin 1 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura], nenin 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe paragrafin 2 të nenit 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për *“pezullimin e menjëhershëm”* të Ligjit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nën-paragrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme], 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], 56 [Kërkesa për masë të përkohshme], dhe 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë pas miratimit të masës së përkohshme

6. Më 12 dhjetor 2019, Gjyqtarja Raportuese i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Të njëjtën datë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi që të pezullojë zbatimin në tërësi të Ligjit të kontestuar, deri më 30 mars 2020. (Shih pjesën operative të Vendimit

të Gjykatës Kushtetuese për caktim të masës së përkohshme, KO219/19, të 12 dhjetorit 2019).

7. Më 23 dhjetor 2019, Ministria e Administratës Publike, lidhur me kërkesën KO219/19 dorëzoi komentet e saj, si përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe pretendimeve specifike të ngritura në kërkesën në fjalë.
8. Më 14 janar 2020, Gjykata i dërgoi një kërkesë Komisionit të Venecias për paraqitjen e një Opinion në cilësi të *Amicus Curiae* lidhur me rastin KO219/19.
9. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e informoi Gjykatën se pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë dorëzuar disa kërkesa për “*revokim të Vendimit për masën e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese KO219/19, i datës 12 dhjetor 2019, për pezullimin e Ligjit të Pagave.*” Me atë rast, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se lidhur me këtë çështje: “*Avokati i Popullit, ka pranuar kërkesa nga 17 komuna, me 266 institucione arsimore dhe 7.047 nënshkrime.*” Të gjitha këto kërkesa parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë duke theksuar se të njëjtat po i përcjellë për vëmendjen e Gjykatës mirëpo pa shpjeguar ose qartësuar se çfarë është kërkesa konkrete ndaj Gjykatës në raport me dokumentet e përcjella.
10. Më 30 janar 2020, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në tekstin e mëtejme: SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë, Sindikata e Policisë, Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës dhe Sindikata e Zjarrfikësve, dorëzuan në Gjykatën një “*Kërkesë për revokim të masës së përkohshme (pezullimit) të Ligjit të Pagave.*” Kërkesën në fjalë, sindikatat në fjalë theksuan se e kanë dorëzuar bazuar në nenin 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës dhe paragrafin 11 të rregullit 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës. Sindikatat në fjalë e njoftuan Gjykatën edhe për komunikimet që kishin pasur me Institucionin e Avokatit të Popullit.
11. Më 3 shkurt 2020, Komisioni i Venecias i dërgoi Gjykatës disa dokumente dhe opinione të Komisionit të Venecias që kishin të bëjë me pagat e gjyqtarëve dhe të Avokatit të Popullit, duke e njoftuar Gjykatën se ky rast është më i përshtatshëm për Forum të Komisionit të Venecias se sa për një Opinion *Amicus Curiae*. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias i rekomandoi Gjykatës që t’i drejtohet Forumit të Komisionit të Venecias, ku pjesëmarrëse janë gjykatat kushtetuese dhe supreme, për të marrë informata më të hollësishme krahasuese rreth çështjes që trajton rasti KO219/19.

12. Më 6 shkurt 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë shkresat e dorëzuara nga Avokati i Popullit më 23 janar 2020 dhe se çfarë konkretisht kërkohet që të ndërmarrë Gjykata në lidhje me dokumentet e përcjella. Në kërkesën e Gjykatës drejtuar parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, Gjykata sqaroi dhe theksoi se:

“[...] palë e vetme në rastin KO219/19 është Institucioni i Avokatit të Popullit, si palë e cila e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin e tërësishëm të kushtetutshmërisë së Ligjit në fjalë dhe pezullimin e tërësishëm të tij. Të gjithë të tjerët, përfshirë sindikatat e lartcekura, mund të kenë vetëm statusin e palës së interesuar por jo edhe të “palës” në kuptim të dispozitave të lartcekura të Rregullores së punës [Rregulli 57 i Rregullore së punës].

“[...] Ne vërejmë që dokumentet që ju i keni përcjellë tek Gjykata Kushtetuese, në fakt iu janë drejtuar juve dhe është pikërisht Institucioni i Avokatit të Popullit, organi që duhet t'i shqyrtojë dokumentet e drejtura Avokatit të Popullit dhe të merr vendim se çfarë hapi dëshiron të ndërmerr në lidhje me ato kërkesa. Nëse Institucioni i Avokatit të Popullit konsideron se duhet të bëhet kërkesë për “revokim të masës së përkohshme”, atëherë Institucioni të cilin ju e drejtoni duhet të bëjë një kërkesë specifike dhe të arsyetuar, sipas dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore, dhe me sqarimet e nevojshme se çfarë veprimi kërkohet të merret nga Gjykata Kushtetuese. Nga kjo rrjedh që, për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nuk mjafton vetëm përcjellja e kërkesave të palëve të tjera të interesuara, pa sqarimet e domosdoshme përkritazi me dokumentet dhe dosjet e dorëzuara në Gjykatë.”

13. Më 13 shkurt 2020, Gjyqtarja raportuese, pas konsultimit me gjyqtarët e Gjykatës dhe pas rekomandimit të Komisionit të Venecias për t'ju drejtuar Forumit të Komisionit të Venecias, iu drejtua këtij të fundit me pyetjet vijuese lidhur me rastin KO219/19:

“(1) Si është rregulluar çështja e pagave në sektorin publik në vendet tuaja përkatëse, në lidhje me parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe “kontrollat dhe balancet” midis degëve të ndryshme të qeverisjes? A ka trajtuar Gjykata juaj ndonjë rast në të cilën janë diskutuar këto dy parime në lidhje me pagat në sektorin publik?

(2) A ka trajtuar Gjykata juaj ndonjë rast në të cilën janë diskutuar dhe vendosur çështje në lidhje me “pavarësinë

organizative, funksionale dhe financiare” të institucioneve publike?

(3) Sipas Kushtetutës, ligjeve dhe praktikës tuaj gjyqësore (nëse është e zbatueshme), a është Kuvendi i autorizuar me kompetencë të mohojë pavarësinë buxhetore dhe kategorizimin e brendshëm të vendeve të punës në institucionet publike që më parë gëzonin një pavarësi të tillë me ligjet ekzistuese të mëparshme?

(4) A keni njohuri për ndonjë rast në vendin tuaj në të cilin pagat e gjyqësorit ose institucioneve të tjera publike janë ulur dhe nëse kjo ka ndodhur, cilat ishin rrethanat dhe arsyetimi për një ulje të tillë? Në këtë aspekt:

a) a keni ndonjë praktikë përkatëse që tregon se si ulja e tillë e pagave ndikon në pavarësinë e gjyqësorit dhe institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese;

b) a keni ndonjë praktikë përkatëse në të cilën keni analizuar zbatueshmërinë e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (mbrojtja e pronës) në lidhje me të drejtat e fituara tashmë dhe mënyrën se si këto të drejta mund të modifikohen nga Kuvendi?

c) a keni ndonjë praktikë përkatëse që tregon se rregullimi i pagave dhe kompensimeve duhet të ndjekë specifikat kushtetuese të institucioneve të caktuara publike në kuptimin e pavarësisë institucionale?”

14. Ndërmjet 14 shkurtit 2020 dhe 12 marsit 2020, Gjykata ka pranuar përgjigje nga zyrtarët ndërlidhës të Komisionit të Venecias me ç’rast është rekomanduar që, për rrethanat e rastit konkret, të analizohen dhe të përdoren dokumentet dhe opinionet vijuese të Komisionit të Venecias si dhe rastet vijuese të gjykatave të ndryshme ndërkombëtare dhe kushtetuese:

- (i) Amicus curiae për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut lidhur me plotësimin-ndryshimin e disa ligjeve që kishin të bënin me sistemin e pagave dhe kompensimeve për zyrtarët e zgjedhur dhe të caktuar CDL-AD(2010)038 – pjesën relevante ku flitet për uljen e pagave të gjyqtarëve;*
- (ii) Opinionin CDL-AD(2002)008 për Bosnje dhe Hercegovinën lidhur me statusin e Ombudspersonit– pjesën relevante ku flitet për pagën e Ombudspersonit dhe gjyqtarëve;*
- (iii) Opinionin CDL-AD(2004)006 për Bosnje dhe Hercegovinën lidhur me statusin e Ombudspersonit– pjesën relevante ku flitet për çështjen e pavarësisë së Ombudspersonit dhe pagën e tij;*

- (iv) Opinionin CDL-AD(2019)005, të njohur si “Parimet e Venecias” për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucionit të Ombudspersonit – pjesën relevante për stafin e Ombudspersonit dhe çështjet lidhur me punësimin e stafit të Ombudspersonit;
 - (v) Check-lista për parimin e Sundimit të Ligjit CDL-AD(2016)007;
 - (vi) Rasti i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, me nr. të referencës ECJ-2018-1-003;
 - (vii) Rasti i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me nr. të referencës ECH-2017-3-006;
 - (viii) Rastet e Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, me nr. të referencave POR-2015-3-018, POR-2013-3-018; POR-2013-1-006; POR-2012-2-011;
 - (ix) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Qipros, me nr. të referencës CYP-2014-2-001;
 - (x) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Andorrës, me nr. të referencës AND-2014-2-001;
 - (xi) Rastet e Gjykatës Kushtetuese të Çekisë, me nr. të referencës CZE-2011-2-007; CZE-2010-1-003;
 - (xii) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, me nr. të referencës SLO-2009-3-006;
 - (xiii) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë, me nr. të referencës POL-2001-H-001;
 - (xiv) Rasti i Gjykatës Supreme të Kanadës, me nr. të referencës CAN-1997-3-005.
15. Brenda periudhës së datave të lartpërmendura, përveç dokumenteve, opinioneve dhe rasteve të lartcekura të propozuara nga zyrtarët ndërlidhës të Komisionit të Venecias, Gjykata po ashtu ka pranuar nëntë (9) përgjigje direkte nga nëntë (9) gjykata kushtetuese/supreme pjesë anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, respektivisht nga: Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore, Gjykata Kushtetuese e Moldavisë, Gjykata Supreme e Suedisë, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Gjykata Supreme e Meksikës, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë, Tribunali Kushtetues i Polonisë, Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut. Të gjitha këto gjykata kanë sqaruar legjislacionin e tyre kushtetues si dhe praktikën e tyre gjyqësore lidhur me çështje që ndërlidhen me caktimin e pagave në sektorin publik lidhur me zyrtarët, punonjësit dhe nëpunësit e ndryshëm të sektorit publik.
16. Më 14 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës, u përgjigj ndaj kërkesës së Gjykatës për sqarime të datës 6 shkurt 2020 lidhur me shkresat që Avokati i Popullit kishte përcjellë në Gjykatë më 23 janar 2020 si dhe

në lidhje me shkresat e dorëzuara nga disa sindikata më 30 janar 2020. Parashtruesi i kërkesës sqaroi me sa vijon: *“Në këtë rast, SBASHK-u, si palë e tretë e interesuar ka kërkuar nga ne që këto kërkesa ti procedojmë në Gjykatën Kushtetuese, dhe si rezultat i këtyre kërkesave me 23 janar 2020, ne kemi përcjellë kërkesat e tilla për njoftim në Gjykatën Kushtetuese.”* Parashtruesi i kërkesës nuk theksoi e as nuk ka kërkoj revokim të masës së përkohshme por la në fuqi kërkesën e tij të parë për vendosje të masës së përkohshme dhe për pezullim të tërësishëm të zbatueshmërisë së Ligjit të kontestuar.

17. Më 29 mars 2020, Gjykata njoftoi sindikatat e lartcekura se Gjykata ka pranuar shkresat e tyre dhe të njëjtat do të shqyrtohen në kuadër të kërkesën që e ka dorëzuar Avokati i Popullit si palë e cila e ka parashtruar kërkesën KO219_19.
18. Më 30 mars 2020, Gjyqtarja raportuese i rekomandoi Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme për vazhdimin e pezullimit të zbatimit të Ligjit të kontestuar mbi bazën e dy arsyeje që reflektohen në pjesën vijuese të këtij Vendimi (shih paragrafët 20-21).
19. Të njëjtën datë, Gjykata, njëzëri, vendosi të miratojë vazhdimin e masën e përkohshme të vendosur nga Gjykata më 12 dhjetor 2019, deri më 30 qershor 2020 dhe rrjedhimisht të mbajë të pezulluar aplikueshmërinë e Ligjit të kontestuar deri në atë datë, ose deri në momentin kur Gjykata të vendosë për rastin konkret.

Përkritazi me vazhdimin e masës së përkohshme

20. Gjykata i referohet Vendimit të saj për caktim të masës të përkohshme të 12 dhjetorit 2019. Të gjitha arsyet e cekura kushtetuese dhe ligjore për vendosjen e masës së përkohshme vazhdojnë të jenë të aplikueshme edhe tani dhe rrjedhimisht Gjykata thirret në arsyetimin e paraqitur në Vendimin e saj fillestar për caktim të masës së përkohshme. (Shih, Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO219/19, cituar më lart).
41. Më tutje, Gjykata vëren se pas caktimit të masës së përkohshme, palë të ndryshme të interesuara për pranueshmërinë dhe meritat e kësaj kërkesë kanë dorëzuar një vëllim të konsiderueshëm të dokumenteve dhe të komenteve, të cilave Gjykata duhet tu kushtojë vëmendje dhe t'i trajtojë në raport me pretendimet e ngritura. Kjo përbën arsyen e parë përse vazhdimi i masës së përkohshme edhe për një periudhë shtesë kohore është i domosdoshëm.

42. Arsyeja e dytë për vazhdimin e masës së përkohshme është volumi jashtëzakonisht i madh i materialeve të pranuar nga Komisioni i Venecias dhe gjykatat kushtetuese/supreme pjesë përbërëse të Forumit të Komisionit të Venecias. Të gjitha këto materiale, përfshi praktikën legislative dhe gjyqësore të dorëzuar nga gjykatat anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, duhet të analizohen ashtu që Gjykata të mund t'i aplikojë ato në rrethanat e rastit konkret, për aq sa do të jenë të aplikueshme.
43. Në dritë të arsyeve të lartcekura, Gjyqtarja raportuese i propozoi Gjykatës që të miratojë propozimin e saj për vazhdimin e masës së përkohshme, propozim ky që u miratua njëzëri nga gjyqtarët e Gjykatës.
44. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kësaj kërke, Gjykata vendos të vazhdojë masën e përkohshme deri më 30 qershor 2020.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116.2 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 57 të Rregullores së punës, më 30 mars 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA VAZHDOJË masën e përkohshme të vendosur me Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO219/19 të datës të 12 dhjetor 2019, deri më 30 qershor 2020;
- II. TA VAZHDOJË PEZULLIMIN e zbatimin në tërësi të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik në kohëzgjatje të përcaktuar në pikën I;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve;
- IV. Ky vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO219/19, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik

KO219/19, Aktgjykim i miratuar më 30 qershor 2020, publikuar më 9 korrik 2020

Fjalët kyç: Kërkesë nga Avokati i Popullit, ligjbërja, ndarja e pushteteve, sundimi i ligjit, siguria juridike, parashikueshmëria e ligjit, vlerat kushtetuese, sektori publik, pagat, barazia para ligjit, Gjyqësori, Institucionet e Pavarura Kushtetuese

Kërkesa ishte parashtruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 113 paragrafi 2 nënparagrafi (1) të Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, i cili, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafët 3 dhe 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafin 1 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura], nenin 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta); nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ); si dhe me paragrafin 2 të nenit 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).

Në titullin **V – PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi (shih paragrafët 308-332), Gjykata përmbledhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, Gjykata, vendosi: (i) njëzëri që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) me shumicë që Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, nuk është në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 103, 108, 109, 110 të Kapitullit VII, nenin 115 të Kapitullit VIII Kushtetutës; si dhe me nenet 132, 136, 139 dhe 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës; (iii) të konstatojë që, nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës pas shpalljes së Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij si

kundërkushtetues në aspekt të cenimit të parimeve të “ndarjes së pushteteve” dhe “sigurisë juridike”; (iv) që të shfuqizohet masa e përkohshme.

Çështja kushtetuese që ngërthente Aktgjykimi në fjalë ishte përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht vlerësimi nëse i njëjti është në pajtueshmëri me parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe atë të “sigurisë juridike” të garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës.

Gjykata arriti në përfundimin se Ligji i kontestuar përmbante një mori problemesh serioze të nivelit kushtetues e që do të mund të përmblihdeshin me sa vijon: (i) Ligji i kontestuar kundërshton vet qëllimin e tij për “*harmonizim*” të pagave në nivel të të gjithë sektorit publik - duke bërë përjashtime arbitrare dhe të paarsyetuara për disa institucione, ndër të tjera Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bankën Qendrore të Kosovës, dhe vet Kuvendin; (ii) Ligji i kontestuar përjashton në tërësi pavarësinë e pushtetit Gjyqësor duke mos i lënë asnjë kompetencë vetërregulluese për çështje që ndërlidhen me jetësimin e pavarësisë “funksionale, organizative dhe buxhetore”; (iii) Ligji i kontestuar, ndonëse thekson se pagat rregullohen me këtë Ligj, e ka zbritur rregullimin ligjor për shumë çështje në nivel të akteve nënligjore, duke i dhënë mundësi rregullimi nënligjor vetëm Ekzekutivit dhe Legjislativit; (iv) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore, gjashtëmbëdhjetë (16) janë për Qeverinë dhe dy (2) për Kuvendin, ndërkaq asnjë kompetencë vetërregulluese për Gjyqësorin ose Institucionet e Pavarura; (v) pushtetit Gjyqësor dhe Institucioneve të Pavarura nuk iu është mundësuar asnjë kompetencë vetërregulluese përmes së cilës ato do të mund të gëzonin pavarësinë e tyre “institucionale, organizative, strukturore dhe buxhetore” në raport me organizimin e brendshëm dhe stafin e tyre; (vi) është miratuar vetëm një (1) nga tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që është dashur të miratohen brenda periudhës së nëntë (9) mujore të *vacatio legis*, respektivisht deri më 1 dhjetor 2019; (vii) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, për rreth 42% të pozitave nuk është e mundur të deshifrohet paga ngase e njëjta përfundimisht do të përcaktohet përmes klasifikimeve përkatëse me akte nënligjore të Qeverisë; (viii) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve “*kostoja buxhetore shtesë*” e Ligjit të kontestuar “*nuk është pjesë e projeksioneve buxhetore 2019-2021*”; (ix) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, edhe po të hynte sot në fuqi Ligji i kontestuar, i njëjti nuk do të mund të zbatohet në tërësi në mungesë të akteve nënligjore.

Lidhur me nenin 1 të Ligjit të kontestuar, ku parashihej qëllimi për harmonizim gjithëpërfshirës të pagave të të gjithë sektorit publik, Gjykata vërejtë se ligjvënësi, pa ndonjë arsyetim dhe në mënyrë arbitrare kishte

përrjashtuar nga ky Ligj, ndër të tjera, AKI-në, FSK-në, BQK-në dhe AKP-në. Në pjesë të tjera të Ligjit, ligjvënësi kishte akorduar edhe përrjashtime të tjera, të drejtpërdrejta ose të patheksuara fare, për nëpunësit e Kuvendit, stafin politik të Kuvendit, deputetët e Kuvendit. Gjykata arriti në përrfundimin se, përrjashtimet e akorduara me Ligjin e kontestuar kundërshtojnë haptazi vet qëllimin e *“harmonizimit”* gjithëpërrfshirës për të cilin thuhet të jetë nxjerrë. Rrjedhimisht, përrjashtimet e bëra u konsideruan se shkojnë kundër vet qëllimit të Ligjit dhe krijojnë diferencime të paarsyetuara, të padëshmuara dhe arbitrare.

Lidhur me nenin 3 (në lidhje me nenin 24) të Ligjit të kontestuar, Gjykata konstatoi se, nuk janë ndjekur e respektuar të paktën dy (2) nga gjashtë (6) parimet themelore mbi të cilat thuhet të jetë udhëhequr Ligji i kontestuar, respektivisht ai i *“parashikueshmërisë”* dhe *“transparencës”*. I pari parashihte që paga *“nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit”*; ndërkaq i dyti parashihte që *“procedura për përrcaktimin e pagës, [do] të jetë transparente për publikun”*. Më konkretisht, lidhur me parimin e parashikueshmërisë, Gjykata theksoi se qasja e ligjvënësit për ta konsideruar si të rëndësishëm parimin e *“parashikueshmërisë”* vetëm për të ardhmen, jo edhe për të tashmen ka rezultuar në neglizhim të të drejtave të personave që janë prekur negativisht me Ligjin për Paga. Kjo meqë, sipas rregullimit të ri ligjor të Kuvendit, rezulton që për të ardhmen, ligjvënësi konsideron se pagat mund të ulen **vetëm** në situata të jashtëzakonshme dhe të vështirësisë financiare; ndërkohë që asnjë nga pagat e shkurtuara në sektorin publik përrmes Ligjit të kontestuar nuk janë arsyetuar mbi bazën e ndonjë *“situatë të jashtëzakonshme”* ose të *“vështirësisë financiare”*. Qeveria, në Projektligj kishte paraparë një garanci të tillë për mos shkurtim të pagave (neni 27 i Projektligjit fillestar) por që Kuvendi me amendamentim e kishte eliminuar atë garanci. Tutje, Gjykata nuk konsideron se është aplikuar parimi i *“transparencës”*, kur rreth 42% të pozitave që aktualisht marrin pagë nga buxheti i shtetit ende nuk mund të deshifrojnë se ku pozicionohen dhe se sa do ta kishin pagën me Ligjin e ri për Paga.

Lidhur me nenet 4, 5 dhe 12 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vërejti se Kuvendi, si njëri nga tri pushtetet klasike të qeverisjes me Republikën e Kosovës, ka paraparë që të gjitha çështjet që ndërlidhen me shtesat dhe kompensimet e nëpunësve të vet, staf të rregullt dhe politik, dhe të vet deputetëve të rregullohen me *“akte të veçanta”* të miratuara nga Kryesia e Kuvendit dhe se një përrjashtim i tillë, sipas ligjvënësit *“bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.”* Gjykata konsideroi se, përrjashtimet e tilla të parapara vetëm për njërin pushtet – paraqesin një nga problemet më serioze kushtetuese të Ligjit në fjalë. Vet përrjashtimi selektiv i vetëm njërit pushtet dhe mos respektimi i garancive kushtetuese të pushteteve tjera, duke injoruar tërësisht Gjyqësorin

dhe Institucionet e Pavarura, është zgjidhje legjislative që nuk përkon me vlerat dhe parimet e Kushtetutës, veçanërisht me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Gjykata po ashtu shënoi faktin se, Ligji i kontestuar i jep gjashtëmbëdhjetë (16) kompetenca të veçanta Qeverisë që përmes akteve nënligjore dhe pas konsultimit me ministrinë përkatëse të rregullojë çështje të caktuara, përfshi çështje që prekin Gjyqësorin dhe Institucionet e Pavarura në aspekt të pavarësisë së tyre funksionale, organizative, strukturore dhe buxhetore. (*Shih nenet 5.4; 5.5; 6.3; 6.4; 7.5; 8.3; 9.5; 14.4; 15.4; 17.4; 18.2; 19.4; 20.5; 21.6; 21.8; 22.5; 25.3; 26.2; 27.2 të Ligjit të kontestuar*). Në këtë aspekt, Gjykata vërejtë që përveç Kuvendit, respektivisht Legjislativit, i vetmi pushtet tjetër i autorizuar që të rregullojë çështje të caktuara me akte nënligjore është Qeveria, respektivisht Ekzekutivi. I vetmi pushtet të cilin i është injoruar pavarësia për çdo lloj rregullimi specifik që do të kishte parasysh *“natyrën dhe kushtet specifike”* të punës dhe të pavarësisë së tij – është pushteti i Gjyqësorit. E njëjta mund të thuhet edhe për Institucionet e Pavarura të referuara në Kapitujt VIII dhe XII të Kushtetutës. Kjo nënkuptonte se, të gjitha kompetencat rregulluese përmes akteve nënligjore janë lënë në duart e Ekzekutivit dhe Legjislativit – si dy nga pushtetet që në fakt e kanë hartuar, respektivisht miratuar këtë iniciativë ligjore përmes votës në Kuvend.

Gjykata theksoi se rregullimi ligjor, me përjashtim të tërësishëm të kompetencave vetërregulluese të Gjyqësorit, padyshim që ka krijuar një disbalancim në ndarjen e pushteteve të cilin nuk e aspiron fryma dhe germa e Kushtetutës. Rregullimi i tillë ligjor, nëse do të konfirmohej si kushtetues, do të kishte potencialin që të krijonte “ndërrhyrje” të pushtetit Ekzekutiv ndaj pushtetit Gjyqësor dhe “varësi” e “vartësi” të pushtetit Gjyqësor ndaj pushtetit Ekzekutiv, ngase i pari do të duhej të varej nga vullneti i të dytës në aspekt të rregullimeve të brendshme për staf dhe aspekt funksional, organizativ, buxhetor e strukturor të punës. Një rregullim i tillë ligjor është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën.

Lidhur me nenin 31 (në lidhje me nenin 34) të Ligjit të kontestuar ku parashihej që të gjitha aktet nënligjore të parapara me këtë Ligj duhet të *“miratohen brenda 9 muajve pas publikimit në Gazetën Zyrtare”* dhe se Ligji i kontestuar *“hyn në fuqi 9 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare”*, Gjykata vërejtë se është miratuar vetëm një (1) nga tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që do duhej të miratoheshin deri më 1 dhjetor 2019, respektivisht brenda periudhës që ligjvënësi kishte lënë si *vacatio legis* për t’u përgatitur për zbatim të Ligjit të kontestuar. Në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, Ministria e Financave dhe Transfereve ka pranuar se Ligji i kontestuar edhe po të hynte sot në fuqi nuk do të mund të zbatohet në tërësi në mungesë të akteve nënligjore. Mungesa e këtyre të fundit, sipas sqarimit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, e ka pamundësuar atë që të japë përgjigje për

rreth 42% të pozitive që paguhen nga buxheti i shtetit, ngase pa miratim të akteve nënligjore nuk dihet se sa do ta kenë pagën një mori pozicionesh që aktualisht paguhen nga buxheti i shtetit. I gjithë ky proces i shkujdesur ligjbërës, pa asnjë dyshim dërgon në një situatë të papranueshme të pasigurisë juridike që kurrsesi nuk mund të jetë e pajtueshme me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e saj të parashikueshmërisë, sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit.

Lidhur me nenin 32 të Ligjit të kontestuar, ku parashihet që me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave, Gjykata vërejtí disa probleme serioze konceptuale dhe praktike në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. Kjo për faktin se, nëse kjo dispozitë do të deklarohej si kushtetuese, do të nënkuptonte që sa herë që Gjyqësori dhe Institucionet e tjera të Pavarura e kanë të nevojshme të krijojnë një pozicion të ri brenda organogramit të tyre ose të ndryshojnë strukturën e brendshme organizative, varësisht nga nevoja që mund të lind në të ardhmen – ato duhet t'i drejtohen Qeverisë për të kërkuar leje dhe miratim për krijim të një pozite të re dhe për të kërkuar leje dhe miratim për ndryshim të strukturës së brendshme organizative. Ligji i kontestuar, në zinxhirin përfundimtar vendimmarrës e ka lënë Qeverinë si pushtet që duhet të “*aprovojë*” çdo propozim të Gjyqësorit. Gjykata konstatoi se, ky rregullim ligjor pa as edhe një dyshim shkon, në mënyrë flagrante, në kundërshtim me nocionin e pavarësisë “institucionale, funksionale dhe organizative” të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Si i tillë është i papranueshëm dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe parimin kyç të ndarjes së pushteteve, si model i përzgjedhur kushtetues për qeverisjen e Republikës së vendit.

Lidhur me nenin 33 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vërejtí se *inter alia*, janë shfuqizuar shprehimisht disa nga nenet specifike të ligjeve organike të Gjyqësorit që më parë rregullonin çështjen e pagave të pushtetit të Gjyqësorit në përgjithësi, të Gjykatës Kushtetuese dhe të kryesuesve të të dy Këshillave, atij Gjyqësor dhe Prokurorial. Megjithatë, përmes nenit 28 të Ligjit të kontestuar është paraparë që ky i fundit nuk do të zbatohet për funksionarët e lartpërmendur deri më 31 dhjetor 2022. Gjykata vërejtí dy probleme evidente dhe bazike në këtë aspekt.

E para kishte të bëjë me vakumin dhe kontradiktën ligjore të krijuar me Ligjin e kontestuar. Kjo për faktin se, në momentin juridik që do të hynte në fuqi Ligji i kontestuar, neni 33 i këtij Ligji do të shfuqizonte të gjitha normat respektive të cilat rregullojnë aktualisht pagat e Gjyqësorit, të Gjykatës Kushtetuese, kryesuesve të Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial (*shih pikat 1.4; 1.6; 1.7; 1.8 të nenit 33 të Ligjit të kontestuar*), e për pagat e të cilëve në të njëjtën kohë Ligji thekson se do të ruhen për periudhën përkatëse. Shtrohet pyetja, nëse do të shfuqizoheshin me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit

të kontestuar nenet e ligjeve organike që rregullojnë pagat aktuale – në bazë të cilit Ligj i bie që do të pranonin pagë këta funksionarë të veçantë. Cila pagë do t'u ruhej atyre kur dispozitat që rregullojnë pagën e tyre “të vjetër” – e që supozohej “të ruhej” - do të shfuqizoheshin. Me këtë rregullim të shkujdesur ligjor rezulton se ligjvënësi do t'i kishte lënë funksionarët në fjalë pa asnjë rregullim ligjor. E dyta kishte të bëjë me konceptin e ruajtjes së pagave të Gjyqësorit vetëm deri në fund të vitit 2022 dhe më pas uljen drastike të pagave pas asaj date. Një skenar i tillë nuk u konsiderua se mund të kontribuojë në garantimin e një Gjyqësori të pavarur. Përkundrazi, zgjidhja e tillë legjislative do të vendoste në një presion të pakëshillueshëm Gjyqësorin kundrejt pushtetit Legjislativ dhe Ekzekutiv.

Për të arritur në këto përfundime, Gjykata kishte parasysh aspektet vijuese.

Përkitazi me Kuvendin, Gjykata potencoi se pushteti ligjvënës e ka ingerencën kryesore kushtetuese për ligjvënien në nivel vendi. Në aspekt të rrethanave të rastit konkret, ishte rrjedhimisht i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrim të kompetencës së tij për “miratim të ligjeve” të rregullojë pagat në sektorin publik sipas një politike të caktuar publike të votuar nga vet Kuvendi. Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të pagave për Republikën e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënien është që të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty.

Gjatë analizës së Ligjit të kontestuar, Gjykata është fokusuar qëllimisht tek “uljet” arbitrarë të pagës dhe jo te “rritja” e pagave për faktin se, Kuvendi gjatë ligjbërjes është dashur të përkujdeset për të drejtat e personave të cilëve iu shkurtohet paga. Arsytet për ulje pagash duhet të jenë shumëfish më të qëndrueshme se sa arsyet për rritje pagash, ngase të parat pakësojnë një të drejtë ekzistuese ndërkaq të dytat shtojnë mbi një të drejtë ekzistuese. Thënë këtë, Gjykata potencon që Ligjvënësi është në të drejtën e tij që pas këtij Aktgjykimi të ndërmerr çfarëdo lloj hapi për të rritur pagat në sektorin publik ashtu që të përmbush çdo synim të politikës publike për rritje pagash në sektorë të caktuar. Nuk është detyrë e Gjykatës që të shprehet se ku dhe si duhet të bëhen rritjet e pagave. Modalitetet e mundshme për këtë çështje ngelen plotësisht në diskrecion të Kuvendit dhe të Qeverisë.

Përkitazi me rolin e Gjykatës Kushtetuese në vlerësim abstrakt të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, u sqarua se në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të

caktuar. Kompetenca e Gjykatës në rastin konkret ishte që të vlerësojë, *in abstracto*, nëse Ligji i kontestuar është kushtetues apo jo dhe varësisht nga përgjigja - të vulosë kushtetutshmërinë e tij ose ta shfuqizojë të njëjtin si kundërkushtetues. E dyta ishte e domosdoshme në këtë rast.

Në nivel parimesh që Kushtetuta përcakton, Gjykata potencoi se ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, janë edhe “ndarja e pushteteve” dhe “sundimi i ligjit”. Funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre. Bazuar në nenin 4 të Kushtetutës përkritazi me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve: (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore; dhe (iii) Gjyqësori është unik dhe i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Këto tri pushtete, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve. Raporti në mes të “tri pushteteve” mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve si parim thelbësor i nivelit më të lartë kushtetues është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë është i panegociueshëm.

Secilit nga tri degët klasike të ndarjes së pushteteve, Kushtetuta i ka dedikuar një kapitull të veçantë. Në të tre këta kapitujt [për pushtetin Legjislativ; Ekzekutiv dhe Gjyqësor] parashihen parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet. Përveç kësaj, aty parashihen edhe mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra tjetrën pa krijuar ndonjë “ndërhyrje”, “varësi” apo “vartësi” kundërkushtetuese në mes tyre që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo pushtetit tjetër. Logjika e parimit të ndarjes së pushteteve është që ndikimi i njërit pushtet në tjetrin gjatë procesit të ndërveprimit institucional të tyre, kurrësi nuk duhet të krijojë një raport ndërhyrës apo të varësisë ose vartësisë që do të mund të rezultonte në humbje të pavarësisë për të vepruar si pushtet i lirë dhe i pandikuar. Kjo përbën esencën e ekuilibrit kushtetues që Kushtetuta ka përcaktuar e që kërkohet të mbahet në çdo instancë ndërvepruese në mes të pushteteve të pavarura.

Përveç kësaj, Gjykata theksoi se Kushtetuta i ka njohur një status dhe rol të veçantë e të rëndësishëm në mbarëvajtjen e detyrave publike shtetërore edhe Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, të cilat janë veçuar si të tilla jo pa arsye. Në këtë kapitull bëjnë pjesë: (i) Avokati i Popullit; (ii) Auditori i Përgjithshëm i Kosovës; (iii) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; (iv) Banka Qendrore e Kosovës; (v) Komisioni i Pavarur i Medieve; dhe (vi) Agjencitë e Pavarura.

Për dallim nga institucionet e tjera të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës *“janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”*. Ky dallim është i nevojshëm të evidentohet si i tillë çfarë është, për një arsye se pesë Institucionet e Pavarura të referuara në pikat (i), (ii), (iii), (iv) dhe (v) janë krijuar si të tilla me rastin e votimit dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës ekzistuese nga ligjvënësi, respektivisht Kuvendi; ndërkaq, Agjencitë e Pavarura nuk janë krijuar si të tilla me rastin e votimit të Kushtetutës ekzistuese – por janë agjenci për krijimin e të cilave Kushtetuta ia jep Kuvendit të drejtën që përmes ligjit t’i krijojë dhe t’i shuaj, varësisht nga nevojat që mund të paraqiten në jetën publike dhe shoqërore. Për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuaj *“me ligj”* Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuaj *“me ligj”* ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës – e cila duhet të merret parasysh si e tillë sa herë që ndërmerren veprime që prekin Agjencitë e Pavarura – të cilat dallojnë nga Institucionet e tjera të Pavarura.

Konkluzionet kyçe që Gjykata nxori dhe aplikoi pas analizimit të përgjigjeve të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias dhe praktikës gjyqësore të gjykatave të ndryshme kushtetuese dhe supreme, ishin me sa vijon: (i) nuk ekziston një sistem i vetëm i mundshëm i rregullimit të pagave në sektorin publik dhe se nuk ekziston një parim i njohur ndërkombëtar që përcakton rregullimin “pagë e njëjtë për punë të njëjtë”; (ii) shumica e vendeve i rregullojnë pagat përmes ligjeve të ndryshme dhe njëkohësisht aplikojnë metoda të ndryshme duke e rregulluar këtë çështje qoftë përmes ligjeve të veçanta për sektorë të veçantë ose përmes ndonjë rregullimi më të koncentruar ligjor; (iii) Kuvendi, si organ ligjvënës, ka kompetencë dhe të drejtë organike që të nxjerrë çfarëdo lloj legjislacioni për rregullim të pagave në sektorin publik, me kushtin që i njëjti të jetë në përputhje me Kushtetutën; (iv) parimi i ndarjes së pushtetit dhe balancës ndërmjet pushtetit Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor nuk nënkupton izolimin e pushteteve dhe mungesën e varësisë së ndërsjellë; mirëpo, i njëjti nënkupton evitimin e situatave sipas së cilave mund të krijohet “ndërhyrje”, “varësi” ose “vartësi” kundërkushtetuese në mes të pushteteve të pavarura; (v) pavarësia e gjyqësorit, si njëra nga degët e pushtetit, nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm dhe nuk i nënshtrohet ndikimi nga dega ekzekutive; (vi) burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet e tjera shtetërore dhe nga palët private - ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet; (vii) zvogëlimi i buxhetit nga pushteti ekzekutiv është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar dhe

të padëshiruar; (viii) nuk ekziston një rregull që krijon garanci absolute se pagat në sektorin publik nuk mund të zvogëlohen *per se* – por që ulja e pagave duhet të jetë e arsyetuar dhe asnjëherë arbitrare; (ix) ulja e pagave të gjyqësorit mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize të theksuar ekonomike dhe financiare dhe e cila për më tepër duhet të jetë e njohur zyrtarisht si të tillë; (x) sakrificat në kohë krize [meqë theksi tek ulja është gjithmonë kur ka kriza] që rezultojnë me ulje të pagave e të cilat nuk janë universale dhe nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë midis të gjithë qytetarëve, në proporcion me aftësinë e tyre financiare individuale – nuk konsiderohet të jenë të pajtueshme me konceptet e shpërndarjes së barrës midis përfituesve të pagave në një shtet.

Krejt në fund, Gjykata theksoi edhe disa çështje të rëndësishme.

Në rast të ligjbërjes së re në këtë fushë, Qeveria në cilësi të propozueses së ligjeve dhe Kuvendi në cilësi të votuesit të ligjeve, janë të obliguara që të marrin parasysh parimet e theksuara në këtë Aktgjykim dhe Aktgjykimet e tjera nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në interpretim të neneve respektive të Kushtetutës. Pavarësia “institucionale, funksionale, organizative dhe buxhetore” e Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura duhet të njihet dhe çdo iniciativë ligjore duhet të respektojë këtë pavarësi. (*Shih Aktgjykimet KO73/16 dhe KO171/18*).

Gjetja e shkeljeve të lartcituara e bëri Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij kundërkushtetues. Gjykata me shumë kujdes analizoi mundësinë e shfuqizimit të pjesshëm të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret një zgjidhje e tillë, për dallim nga rrethanat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik që u shfuqizua pjesërisht, nuk ishte e mundur për dy arsye kryesore. E para sepse shkeljet kushtetuese të evidentuara në Ligjin e kontestuar janë të një peshe aq serioze sa që të njëjtat ndikojnë në bazën e funksionimit të qeverisjes në Republikën e Kosovës – duke shkaktuar disekuilibrim të ndarjes së pushteteve në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. E dyta, sepse Ligji i kontestuar nuk ofron një mundësi të shfuqizimit të vetëm disa dispozitave dhe të vetëm disa pikave të Shtojcave nr. 1 dhe 2, ngase çdo lloj shfuqizimi do ta bënte Ligjin të pazbatueshëm në praktikë. Dhe, në rastet kur analiza dërgon në përfundimin se Ligji me shfuqizim të pjesshëm bëhet i pazbatueshëm me nenet e ngelura në fuqi si kushtetuese, Gjykata është e obliguar të shfuqizojë Ligjin në tërësinë e tij.

Gjykata, po ashtu theksoi se të gjitha pushtetet pa përjashtim kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të kryejnë detyrat publike për të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Në këto detyra publike përfshihet edhe obligimi i secilit pushtet që përgjatë kryerjes së detyrave kushtetuese të

përkujdeset për respektim të pavarësisë së pushtetit tek i cili po krijon një “ndërhyrje”. Për shembull, Qeveria dhe Kuvendi, megjithëse e kanë kompetencën për të propozuar dhe votuar ligje, respektivisht, e të cilat do të mund të ndikonin edhe në sferën e Gjyqësorit, si pushtet i tretë; ato [Qeveria dhe Kuvendi] duhet të sigurohen që gjatë hartimit të propozimeve të tyre e deri në finalizimin e tyre me votë të Kuvendit të ruhet pavarësia kushtetuese e pushtetit simotër, respektivisht Gjyqësorit. Kujdes dhe ndjeshmëri të njëjtë, Qeveria dhe Kuvendi, duhet të tregojnë edhe për akterët e tjerë shtetërorë të cilët Kushtetuta i ka pajisur me garanci kushtetuese të pavarësisë funksionale, organizative, strukturore dhe buxhetore. Garantimin dhe sigurimi paraprak i kushtetutshmërisë së iniciativave të Qeverisë dhe Kuvendit duhet të jetë aspekt i përhershëm dhe i pandashëm i krijimtarisë ligjore të këtyre dy pushteteve.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO219/19

parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës ose Avokati i Popullit).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: Ligji për Pagat ose Ligji i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, i cili, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e

Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafët 3 dhe 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafin 1 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura], nenin 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); si dhe me paragrafin 2 të nenit 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

4. Përveç kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit për Pagat në tërësinë e tij, parashtruesi i kërkesës, respektivisht Avokati i Popullit, konteston edhe kushtetutshmërinë e neneve vijuese të Ligjit për Pagat: 4.4; 4.5; 5.5; 6.4; 7.5; 8; 8.3; 9.5; 14.4; 15.4; 17.4; 18.2; 19.4; 20.5; 21.8; 22.5; 23.5; 25.3; 26.2; 29; 33, duke pretenduar se dispozitat e Ligjit në fjalë nuk janë në pajtueshmëri, në veçanti me parimin e ndarjes së pushteteve.
5. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme për *“pezullimin e menjëhershëm”* të Ligjit të kontestuar.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme], 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], 56 [Kërkesa për masë të përkohshme], dhe 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 5 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 6 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të Gjyqtarëve: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
9. Më 10 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, me ftesën që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet eventuale deri më 24 dhjetor 2019. Kërkesa gjithashtu iu komunikua Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkuar që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për Ligjin e kontestuar. [Sqarim i Gjykatës: në kohën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, Qeveria e Kosovës kishte Kryeministër në detyrë].
10. Më 12 dhjetor 2019, Gjyqtarja Raportuese i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Të njëjtën datë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi që të pezullojë zbatimin në tërësi të Ligjit të kontestuar, deri më 30 mars 2020. (Shih pjesën operative të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, KO219/19, të 12 dhjetorit 2019).
11. Më 23 dhjetor 2019, Ministria e Administratës Publike (në tekstin e mëtejshëm: MAP), lidhur me kërkesën KO219/19 dorëzoi komentet e saj, si përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. [Sqarim i Gjykatës: në kohën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, MAP ishte Ministri e veçantë e Qeverisë, ndërsa me strukturën aktuale të Qeverisë, MAP dhe përgjegjësitë e saj janë inkorporuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme].
12. Më 14 janar 2020, Gjykata i dërgoi një kërkesë Komisionit të Venecias për paraqitjen e një Opinioni në cilësi të *Amicus Curiae* lidhur me rastin KO219/19.
13. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e informoi Gjykatën se pranë Avokatit të Popullit janë dorëzuar disa kërkesa për “revokim të Vendimit për masën e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese KO219/19, i datës 12 dhjetor 2019, për pezullimin e Ligjit të Pagave.” Me atë rast, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se lidhur me këtë çështje: “Avokati i Popullit, ka pranuar kërkesa nga 17 komuna, me 266 institucione arsimore dhe 7.047 mijë nënshkrime”. Të gjitha

këto kërkesa ai i dorëzoi në Gjykatë, pa shpjeguar ose qartësuar se çfarë është kërkesa konkrete ndaj Gjykatës në raport me dokumentet e dorëzuara.

14. Më 30 janar 2020, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në tekstin e mëtejme: SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë, Sindikata e Policisë, Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës dhe Sindikata e Zjarrfikësve, dorëzuan në Gjykatë një *“Kërkesë për revokim të masës së përkohshme (pezullimit) të Ligjit të Pagave”*. Kërkesën në fjalë, sindikatat në fjalë theksuan se e kanë dorëzuar bazuar në nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe paragrafin (11) të rregullit 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës.
15. Më 3 shkurt 2020, Komisioni i Venecias i dërgoi Gjykatës disa dokumente që kishin të bëjnë me pagat e gjyqtarëve dhe të Avokatit të Popullit, si dhe duke e njoftuar Gjykatën se për shkak të mungesës së standardeve ndërkombëtare në lidhje me parimin *“pagesë e njëjtë për punë të njëjtë”*, ky rast është më i përshtatshëm për Forum të Komisionit të Venecias se sa për një Opinion *Amicus Curiae*. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias i rekomandoi Gjykatës që t’i drejtohet Forumit të Komisionit të Venecias për të marrë informata më të hollësishme krahasuese rreth çështjes që trajton rasti KO219/19.
16. Më 6 shkurt 2020, Gjykata kërkoj nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë shkresat e dorëzuara më 23 janar 2020. Në kërkesën e Gjykatës drejtuar parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, Gjykata theksoi:

*“[...] palë e vetme në rastin KO219/19 është Institucioni i Avokatit të Popullit, si palë e cila e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin e tërësishëm të kushtetutshmërisë së Ligjit në fjalë dhe pezullimin e tërësishëm të tij. Të gjithë të tjerët, përfshirë sindikatat e lartcekura, mund të kenë vetëm statusin e palës së interesuar por jo edhe të “palës” në kuptim të dispozitave të lartcekura të Rregullores së punës.
[...] Ne vërejmë që dokumentet që ju i keni përcjellë tek Gjykata Kushtetuese, në fakt iu janë drejtuar juve dhe është pikërisht Institucioni i Avokatit të Popullit, organi që duhet t’i shqyrtojë dokumentet e drejtura Avokatit të Popullit dhe të merr vendim se çfarë hapi dëshiron të ndërmerr në lidhje me ato kërkesa. Nëse Institucioni i Avokatit të Popullit konsideron se duhet të bëhet kërkesë për “revokim të masës së përkohshme”, atëherë Institucioni të cilin ju e drejtoni duhet të bëjë një kërkesë specifike dhe të arsyetuar, sipas dispozitave përkatëse kushtetuese dhe*

ligjore, dhe me sqarimet e nevojshme se çfarë veprimi kërkohet të merret nga Gjykata Kushtetuese. Nga kjo rrjedh që, për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nuk mjafton vetëm përcjellja e kërkesave të palëve të tjera të interesuara, pa sqarimet e domosdoshme përkitazi me dokumentet dhe dosjet e dorëzuara në Gjykatë.

17. Më 13 shkurt 2020, Gjyqtarja raportuese, pas konsultimit me gjyqtarët e tjerë të Gjykatës dhe pas rekomandimit të Komisionit të Venecias për t'ju drejtuar Forumit të Komisionit të Venecias, iu drejtua këtij të fundit me pyetjet vijuese lidhur me rastin KO219/19:

“(1) Si është rregulluar çështja e pagave në sektorin publik në vendet tuaja përkatëse, në lidhje me parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe “kontrollet dhe balancet” midis degëve të ndryshme të qeverisë? A ka trajtuar Gjykata juaj ndonjë rast në të cilën u diskutuan këto dy parime në lidhje me pagat në sektorin publik?

(2) A ka trajtuar Gjykata juaj ndonjë rast në të cilën janë diskutuar dhe vendosur çështjet në lidhje me “pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare” të institucioneve publike?

(3) Sipas Kushtetutës, ligjeve dhe praktikës tuaj gjyqësore (nëse është e zbatueshme), a është Kuvendi i autorizuar me kompetencë të mohojë pavarësinë buxhetore dhe kategorizimin e brendshëm të vendeve të punës në institucionet publike që më parë gëzonin një pavarësi të tillë me ligjet ekzistuese të mëparshme?

(4) A keni njohuri për ndonjë rast në vendin tuaj në të cilin pagat e gjyqësorit ose institucioneve të tjera publike janë ulur dhe nëse kjo ka ndodhur, cilat ishin rrethanat dhe arsyetimi për një ulje të tillë? Në këtë aspekt:

a) A keni ndonjë praktikë përkatëse që tregon se si ulja e tillë e pagave ndikon në pavarësinë e gjyqësorit dhe institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese?

b) A keni ndonjë praktikë përkatëse në të cilën keni analizuar zbatueshmerinë e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (mbrojtja e pronës) në lidhje me të drejtat e fituara tashmë dhe mënyrën se si këto të drejta mund të modifikohen nga Kuvendi?

c) A keni ndonjë praktikë përkatëse që tregon se rregullimi i pagave dhe kompensimeve duhet të ndjekë specifikat kushtetuese të institucioneve të caktuara publike në kuptimin e pavarësisë institucionale?”

18. Ndërmjet 14 shkurtit 2020 dhe 12 marsit 2020, Gjykata ka pranuar përgjigje nga zyrtarët ndërlidhës të Komisionit të Venecias me ç'rast është rekomanduar që, për rrethanat e rastit konkret, të analizohen dhe të përdoren dokumentet vijuese të Komisionit të Venecias si dhe rastet vijuese të gjykatave të ndryshme ndërkombëtare dhe kushtetuese:

- (xv) *Amicus curiae* për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut lidhur me plotësimin-ndryshimin e disa ligjeve që kishin të bënin me sistemin e pagave dhe kompensimeve për zyrtarët e zgjedhur dhe të caktuar CDL-AD(2010)038 – pjesën relevante ku flitet për uljen e pagave të gjyqtarëve;
- (xvi) Opinionin CDL-AD(2002)008 për Bosnje dhe Hercegovinën lidhur me statusin e Ombudspersonit– pjesën relevante ku flitet për pagën e Ombudspersonit dhe gjyqtarëve;
- (xvii) Opinionin CDL-AD(2004)006 për Bosnje dhe Hercegovinën lidhur me statusin e Ombudspersonit– pjesën relevante ku flitet për çështjen e pavarësisë së Ombudspersonit dhe pagën e tij;
- (xviii) Opinionin CDL-AD(2019)005, të njohur si “Parimet e Venecias” për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucionit të Ombudspersonit – pjesën relevante për stafin e Ombudspersonit dhe çështjet lidhur me punësimin e stafit të Ombudspersonit;
- (xix) Check-lista për parimin e Sundimit të Ligjit CDL-AD(2016)007 – pjesën relevante ku flitet për gjyqtarë;
- (xx) Rasti i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: GJEDB), me nr. të referencës ECJ-2018-1-003;
- (xxi) Rasti i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), me nr. të referencës ECH-2017-3-006;
- (xxii) Rastet e Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, me nr. të referencave POR-2015-3-018, POR-2013-3-018; POR-2013-1-006; POR-2012-2-011;
- (xxiii) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Qipros, me nr. të referencës CYP-2014-2-001;
- (xxiv) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Andorrës, me nr. të referencës AND-2014-2-001;
- (xxv) Rastet e Gjykatës Kushtetuese të Çekisë, me nr. të referencës CZE-2011-2-007; CZE-2010-1-003;

- (xxvi) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, me nr. të referencës SLO-2009-3-006;
- (xxvii) Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë, me nr. të referencës POL-2001-H-001;
- (xxviii) Rasti i Gjykatës Supreme të Kanadasë, me nr. të referencës CAN-1997-3-005.
19. Brenda periudhës së datave të lartpërmendura, përveç dokumenteve, opinioneve dhe rasteve të lartcekura të propozuara nga zyrtarët ndërlidhës të Komisionit të Venecias, Gjykata po ashtu ka pranuar nëntë (9) përgjigje të drejtpërdrejta nga nëntë (9) gjykata kushtetuese/supreme pjesë anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, respektivisht nga: Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, Gjykata Kushtetuese e Moldavisë, Gjykata Supreme e Suedisë, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Gjykata Supreme e Meksikës, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë, Tribunali Kushtetues i Polonisë, Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut.
 20. Më 14 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës, u përgjigj ndaj kërkesës së Gjykatës, të datës 6 shkurt 2020, për sqarime lidhur me shkresat që kishte përcjellë në Gjykatë më 23 janar 2020 si dhe në lidhje me shkresat e dorëzuara nga disa sindikata më 30 janar 2020. Parashtruesi i kërkesës sqaroi me sa vijon: *“Në këtë rast, SBASHK-u, si palë e tretë e interesuar ka kërkuar nga ne që këto kërkesa t’i procedojmë në Gjykatën Kushtetuese, dhe si rezultat i këtyre kërkesave me 23 janar 2020, ne kemi përcjellë kërkesat e tilla për njoftim në Gjykatën Kushtetuese.”* Parashtruesi i kërkesës nuk theksoi e as nuk kërkoi revokim të masës së përkohshme por la në fuqi kërkesën e tij të parë për vendosje të masës së përkohshme dhe për pezullim të tërësishëm të zbatueshmërisë së Ligjit të kontestuar.
 21. Më 29 mars 2020, Gjykata njoftoi sindikatat e lartcekura se Gjykata ka pranuar shkresat e tyre dhe të njëjtat do të shqyrtohen në kuadër të kërkesës që e ka dorëzuar Avokati i Popullit si palë e cila e ka parashtruar kërkesën KO219/19.
 22. Më 30 mars 2020, Gjykata vazhdoi masën e përkohshme deri më 30 qershor 2020 duke shtyrë kështu pezullimin e zbatimit të Ligjit të kontestuar deri në atë datë.
 23. Më 10 prill 2020, Gjykata kërkoi nga Ministri në detyrë i Ministrisë së Financave dhe Transfereve, z. Besnik Bislimi (në tekstin e mëtejme: Ministria e Financave dhe Transfereve), që të përgjigjet në disa pyetje të Gjykatës dhe të dorëzojë disa dokumente shtesë. Specifikisht,

Gjykata kërkoi nga Ministria e Financave dhe Transfereve që të përgjigjen në pyetjet vijuese:

1. *Për cilat pozicione saktësisht dhe sa do të ulet paga? Luteni të na tregoni saktësisht, duke theksuar se për pozicionin X, të institucionit X, paga ka qenë X euro me ligjet e mëhershme, ndërkaq me Ligjin e kontestuar paga do të jetë X euro, që rrjedhimisht i bie diferencë në pagë prej minus X euro?*
2. *Për cilat pozicione saktësisht dhe sa do të rritet paga? Luteni të na tregoni saktësisht, duke theksuar se për pozicionin X, të institucionit X, paga ka qenë X euro me ligjet e mëhershme, ndërkaq me Ligjin e kontestuar, paga do të jete X euro, që rrjedhimisht i bie difference në page prej plus X euro?*
3. *A ka ndonjë pozicion ekzistues në Republikën e Kosovës i cili vazhdon të marrë pagë sipas ligjeve në fuqi – e për të cilin paga e re nuk është e përcaktuar në Ligjin e kontestuar? Nëse po, saktësisht cilat janë ato pozicione, në cilat institucione janë dhe sa e kanë pagën aktuale? Çfarë do të ndodhë me pagën e tyre të ardhshme? Sa do ta kenë pagën po që se Ligji i kontestuar zbatohet?*
4. *Cilat pozicione saktësisht do të paguhen nga buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës? Cilat pozicione dhe cilat institucione janë saktësisht të përjashtuara nga Ligji i kontestuar?*
5. *Për ndërmarrjet publike dhe ato të cilat nuk financohen nga buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës ose që nuk financohen krejtësisht nga buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës, si është rregulluar çështja e pagave të tyre me Ligjin e kontestuar. Saktësisht si do të paguhen dhe nga cilat mjete do të gjenerohet paga e tyre?*
6. *Ligji i kontestuar parasheh rreth 18 kompetenca të veçanta për Qeverinë që përmes akteve nënligjore të rregullojë çështje të caktuara. Në këtë drejtim, luteni që të shpjegoni se a janë të gjitha pagat e sektorit publik të rregulluara vetëm dhe ekskluzivisht me Ligjin e kontestuar dhe Shtojcën nr. 1 të tij, apo ka paga të cilat do të caktohen me akte nënligjore të Qeverisë? Nëse po, cilat pozicione janë ato dhe për cilat institucione? Nëse jo, na tregoni se si shpjegohet pretendimi i mungesës së përcaktimit direkt për disa pozicione ekzistuese që janë në marrëdhënie pune dhe se si do të vendosen pagat për të tilla pozicione?*

7. *A i ka miratuar Qeveria të gjitha aktet nënligjore që përmenden në Ligjin e kontestuar duke pas parasysh që afati për miratimin e tyre ka qenë 9 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar? Nëse po, ju lutem na dërgoni nga një kopje të akteve të tilla nënligjore.*

24. Gjykata po ashtu kërkoi nga Ministria e Financave dhe Transfereve që të dorëzojë në Gjykatë dy dokumente shitesë, respektivisht:

“[L]istën e fundit të pagave të disbursuara nga Ministria e Financave dhe Transfereve për muajin mars 2020 për të gjithë të punësuarit në nivel të Republikës së Kosovës. Kjo listë do të ndihmojë që të qartësohet saktësisht se me ligjin e aplikueshëm, cilat pozicione paguhen dhe sa saktësisht është paga për secilin pozicion.

[L]istën e pagave që do të disbursoheshin nga Ministria e Financave dhe Transfereve po që se do të zbatohej Ligji i kontestuar. Kjo listë do të ndihmojë që të qartësohet saktësisht se me Ligjin e kontestuar, cilat pozicione janë të përfshira dhe sa saktësisht do të jetë paga për secilin pozicion. Kjo po ashtu do të qartësojë: (i) ku është bërë zbritje e pagave; (ii) ku është bërë ngritje e pagave; (iii) paga e cilave pozicione akoma nuk është e përcaktuar (nëse një pretendim i tillë është i saktë).”

25. Më 17 prill 2020, Ministria e Financave dhe Transfereve, kërkoi shtyrje të afatit, me arsyetimin se: *“Në shqyrtimin fillestar të shkresës tuaj, kemi venë re që pyetjet janë shumë komplekse dhe duhet trajtim shumë serioz nga ana jonë. Në anën tjetër, marrë parasysh gjendjen e pandemisë Ministria e Financave dhe Transfereve është duke punuar me kapacitet të reduktuara dhe fokusi kryesor i punës në këtë kohë është mbi zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale dhe ne proceset tjera buxhetore. Andaj, me mirëkuptim kërkoj që afati i përcaktuar nga ana juaj për përgjigje të zgjatet deri me 20 maj 2020.”*
26. Më 21 prill 2020, Gjykata miratoi kërkesën e Ministrisë për Financa dhe Transfere për shtyrje të afatit.
27. Më 21 maj 2020, Gjykata pranoi përgjigjet e kërkuara nga Ministria e Financave dhe Transfereve ku theksohet me sa vijon: *“Më datë 10 prill 2020, kam pranuar nga ju shkresën me Nr. Protokolli 330 në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, ku keni kërkuar përgjigje në disa pyetje lidhur me Ligjin Nr. 06-L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Pas pranimit të shkresës, unë kam formuar një komision profesional të përberë nga zyrtarë të lartë nga Ministria e Financave*

dhe Transfereve dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, të cilët me kanë ndihmuar me këshilla profesionale në hartimin e përgjigjeve lidhur me pyetjet e juaja.”

28. Më 22 maj 2020, Ministria e Financave dhe Transfereve, ka dorëzuar një shkresë sqaruese e cila thekson: *“Ju njoftojmë se për shkak të një problemi teknik që patëm me datë 20.05.2020, nuk arritëm të dërgojmë përgjigjen e kompletuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në fakt, dosja ka qenë e gatshme dhe është protokolluar me atë datë në Ministrinë tonë, por kemi pasur një problem në ngarkimin e dokumentacionit në CD. Kjo ka shkaktuar vonesën. Shpresoj që kjo të mirëkuptohet nga ana Juaj, dhe komentet të merren parasysht nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.”*
29. Më 1 qershor 2020, Gjykata iu dërgoi një kopje të përgjigjeve të pranuara nga Ministria e Financave të gjitha palëve të interesuara për informatën e tyre.
30. Më 30 qershor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
31. Në të njëjtën ditë, më 30 qershor 2020, Gjykata vendosi: (i) të deklarojë, njëzëri kërkesën të pranueshme; (ii) të shpallë, me shumicë që Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, në tërësinë e tij, nuk është në përputhshmëri me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave] paragrafi 1; 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; 109 [Prokurori i Shtetit]; 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; dhe me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve] të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës; (iii) të shpallë të pavlefshëm në tërësinë e tij, Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik; (iv) të shfuqizojë vendimin për caktim të masës së përkohshme të 12 dhjetorit 2019 si dhe vendimin për vazhdim të masës së përkohshme të 30 marsit 2020. Përfundimet kryesore të Gjykatës dhe Pjesa Operative e Aktgjykimit KO219/19 u publikuan po atë ditë.
32. Më 9 korrik 2020, Gjykata publikoi Aktgjykimin e plotë për rastin KO219/19.

Përmbledhja e fakteve

33. Në vitin 2018, MAP filloi me hartimin e Projektligjit për Pagat.
34. Më 8 qershor 2018, Projektligji për Pagat në sektorin publik është publikuar në platformën elektronike për konsultime publike dhe ka qenë i hapur për komente deri me 28 qershor 2018.
35. Më 23 qershor 2018, MAP përcolli për miratim në zyrën e Kryeministrit Projektligjin për Paga. Në shkresën përcjellëse theksohej që Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor i cili përpilohet nga Ministria e Financave mungonte në këtë dosje, ndërsa i njëjti do i dërgohej në momentin e përfundimit.
36. Më 3 shator 2018, Ministria e Financave e përcolli vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Pagat. Në këtë vlerësim u konkludua që Projektligji për Pagat do të ketë kosto shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe se kjo kosto nuk është pjesë e projeksioneve buxhetore 2019-2021.
37. Më 3 shtator 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), përmes vendimit Nr.08/63, aprovoi Projektligjin për Pagat.
38. Më 14 gusht 2018, Ministria e Integrimit Evropian (në tekstin e mëtejme: MIE) përpiloi Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me “*acquis*” të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: BE) për Projektligjin për Pagat.
39. Më 24 gusht 2018, MAP i dërgoi Zyrës së Kryeministrit versionin përfundimtar të Projektligjit për Pagat, me kërkesën që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet në mbledhje të Qeverisë. Së bashku me (i) Projektligjin për Pagat, u dërguan edhe: (ii) Memorandumi Shpjegues; (iii) Deklarata e pajtueshmërisë; dhe, (iv) Opinioni i Ligjor i MIE. Vlerësimi i ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave u theksua se do të dërgohej posa të pranohej nga MAP.
40. Më 27 gusht 2018, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit lëshoi një Certifikatë përmes së cilës konfirmoi se Projektligji i Ligjit të kontestuar “*ka kaluar në të gjitha fazat procedurale të parashikuara nga Rregullorja e punës.*”
41. Më 3 shtator 2018, Ministria e Financave dorëzoi në MAP Opinionin lidhur me vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Pagat. Në përfundime të këtij Opinioni u theksua: “*Ministria e Financave -*

Departamenti i Buxhetit vlerëson se nga aspekti i ndikimit buxhetor kostoja e vlerësuar e Projektligjit për Paga për vitin 2019 në krahasim me ndarjet buxhetore të vitit 2018 do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës në shumën prej 90,669,920 €. Kurse, krahasuar me dokumentin c KASH 2019-2021, kostoja shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës do të jetë në shumën prej 205,768,891 € për periudhën 2019-2021, për kategorinë paga dhe mëditje, dhe atë për vitin 2019 shuma prej 69,747,219 €, për vitin 2020 shuma prej 67,776,873 € dhe për vitin 2021 shuma prej 68,244,799 €.

Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit vlerëson se kostoja buxhetore shtesë e paraqitur si me lartë nuk është pjesë e projekioneve buxhetore 2019-2021.”

42. Më 3 shtator 2018, Qeveria përmes Vendimit Nr.08/63 aprovoi Ligjin e kontestuar dhe vendosi që të njëjtin t’ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) për shqyrtim dhe miratim.
43. Më 7 shtator 2018, Qeveria, në përputhje me Vendimin e lartcekur të saj, e procedoi Ligjin e kontestuar në Kuvend “*me qëllim që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet në procedurën e përcaktuar.*”
44. Më 12 shtator 2018, Kryetari i Kuvendit ua dërgoi deputetëve të Kuvendit draftin e Ligjit të kontestuar dhe e ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funksional (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Funksional), që ta shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe t’ia paraqesë Kuvendit një Raport me rekomandime.
45. Më 8 tetor 2018, Komisioni Funksional i lartcekur, rekomandoi miratimin në parim të Projektligjit për Pagat.
46. Më 25 tetor 2018, Kuvendi procedoi me leximin e parë të Projektligjit për Pagat. Të njëjtën ditë Kuvendi me Vendimin nr. 06-V-248 e miratoi Projektligjin në parim dhe i ngarkoi pesë komisione parlamentare që të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe t’i paraqesin raportet e tyre me rekomandime. Kuvendi ngarkoi me këtë rast, Komisionin Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsion; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Integritet Evropian; dhe Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

47. Më 29 janar 2019, Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e procedoi Projektligjin në fjalë për shqyrtim të komisionet e përhershme.
48. Më 30 janar 2019, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'i rekomandojë që Projektligji për Pagat dhe amandamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, ky komision paraqiti disa amandamente.
49. Më 30 janar 2019, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'i rekomandojë që Projektligji për Pagat nuk cenon dhe nuk prek të drejtat e komuniteteve.
50. Më 31 janar 2019, Komisioni për Integritet Evropian i shpjegoi Komisionit FunkSIONAL që fushëveprimi i Projektligjit për Pagat nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.
51. Më 31 janar 2019, Komisioni për Buxhet dhe Financa, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë rekomandimin që Projektligji për Pagat përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
52. Më 1 shkurt 2019, Komisioni FunkSIONAL, ia dorëzoi deputetëve të Kuvendit një "Raport me Rekomandime" për Projektligjin në fjalë. Në këtë Raport u shpjegua që në Projektligjin fillestar prej 32 neneve në tërësi, u propozuan gjithsej 58 amandamente të cilat kishin marrë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL ndërkaq, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, u propozuan edhe 19 amandamente të tjera. Gjithsej, Kuvendit iu proceduan për shqyrtim në seancë plenare 77 amandamente.
53. Më 2 shkurt 2019, Kuvendi e procedoi për leximin të dytë Projektligjin për Pagat. Të njëjtën ditë Kuvendi me Vendimi Nr.06-V-310, e miratoi Ligjin e kontestuar.
54. Më 12 shkurt 2019, Ligji i kontestuar iu dërgua Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim dhe shpallje në Gazetën Zyrtare.
55. Më 1 mars 2019, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare. Neni 34 [Hyrja në fuqi] i Ligjit të kontestuar përcakton që "*Ky ligji hyn në fuqi 9 (nëntë) muaj pas publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës*".

56. Më 1 dhjetor 2019, Ligji i kontestuar hyri në fuqi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

57. Parashtruesi i kërkesës konteston në tërësi Ligjin e kontestuar (Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik). Parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar dhe Shtojca një (1) e tij nuk ka arritur që të bartë frymën kushtetuese në kuptim të: (i) ndarjes së pushteteve; (ii) barazisë para ligjit; (iii) garantimit të së drejtës pronësore; dhe (iv) sundimit të ligjit.

Pretendimet në lidhje me “ndarjen e pushteteve”

58. Përkitazi me “ndarjen e pushteteve”, Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës pretendon që Ligji i kontestuar nuk siguron në mënyrë të duhur ndarjen e pushteteve siç përcaktohet në nenin 4 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, sipas tij, është e domosdoshme që të sigurohet parimi i ndarjes së pushteteve si në aspektin hierarkik ashtu edhe në atë operues në çështjen e pagave në sektorin publik.

59. Parashtruesi i kërkesës thekson që Ligji i kontestuar duke i dhënë të drejtën e nxjerrjes së akteve nënligjore vetëm Qeverisë dhe në raste të caktuara edhe Kuvendit, nuk merr parasysh kërkesën kushtetuese për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve të përcaktuara në nenin 4 të Kushtetutës. Ky përcaktim si i tillë ka ndikim në (i) pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare; dhe ndërhyr në (ii) mekanizmin e kontrollit dhe balancimit, që është garantues i funksionimit demokratik të shtetit. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, pretendon se specifikat e statusit kushtetues të institucioneve duhet të respektohen në tërësinë e tyre duke përfshirë edhe nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktuara në këtë Ligj, si dhe duhet të ruhet dhe të sigurohet pavarësia e tyre. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës konteston në mënyrë specifike dispozitat vijuese të Ligjit të Kontestuar: nenin 4 paragrafi 4, neni 5 paragrafi 5, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 5, neni 8 paragrafi 3, neni 9 paragrafi 5, neni 14 paragrafi 4, neni 15 paragrafi 4, neni 17 paragrafi 4, neni 18 paragrafi 2, neni 19 paragrafi 4, neni 20 paragrafi 5, neni 21 paragrafi 8, neni 22 paragrafi 5, neni 23 paragrafi 5, neni 25 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 2.

60. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Ligji i kontestuar aplikon kritere të njëjta për autoritetet, institucionet dhe organet në Republikën e Kosovës, pa marrë parasysh rendin dhe ndarjen e pushteteve në

pajtim me Kushtetutën dhe specifikën e statusit kushtetues të subjekteve të ndryshme të sektorit publik.

61. Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës thekson se Ligji i kontestuar e cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve duke mos marrë parasysh se shumë prej këtyre institucioneve, i kanë ligjet specifike, të cilat i rregullojnë në mënyrë të veçantë të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të këtyre institucioneve. Sipas parashtruesit, Ligji i kontestuar vepron në kundërshtim me parimin e drejtësisë *lex specialis derogat legi generalis*, i cili përcakton se kur një situatë e caktuar faktike hyn në fushëveprimin e dy akteve normative, përparësi i jepet aktit të posaçëm kundrejt aktit të përgjithshëm (Ligji i kontestuar është akt i përgjithshëm).
62. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se për sa u përket institucioneve të pavarura të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar me Kapitullin VIII të Kushtetutës, nuk janë marrë parasysh qëndrimet dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, të shprehura në Aktgjykimin KO73/16 (shih, parashtrues Avokati i Popullit, “*Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016*”, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016 - në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO73/16), në veçanti paragrafët 88, 97, 98 dhe 100 të atij Aktgjykimi). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se ka kërkuar vazhdimisht nga Qeveria e po ashtu edhe nga Kuvendi që gjatë kohës së shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve që përbëjnë pakon e ligjeve për reformën e administratës, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar të merret parasysh Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KO73/16, gjë që nuk ishte marrë parasysh.

Pretendimet në lidhje me “sundimin e ligjit”

63. Përkitazi me parimin e “sundimit të ligjit”, parashtruesi i kërkesës thekson që Kushtetuta, në nenin 7 [Vlerat], e përcakton sundimin e ligjit si një ndër vlerat e rendit kushtetues në vend. Lidhur me këtë çështje, parashtruesi i kërkesës u referohet parimeve të sundimit të ligjit, sipas Raportit të Komisionit të Venedikut mbi sundimin e së drejtës (shih Raportin mbi Sundimin e Ligjit CDL-AD(2011)003rev të miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e 86 plenar, 25-26 mars 2011).
64. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i thekson disa nga parimet që i konsideron relevante për rrethanat e rastit konkret, respektivisht: (i) parimin e sigurisë juridike - përmes së cilit kërkohet që rregullat

ligjore të jenë të qarta dhe të sakta, qëllimi i të cilave është që të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet ligjore të jenë të parashikueshme. Sipas parashtruesit të kërkesës, Kuvendit, si ligjvënës, nuk i lejohet që t'i anashkalojë të drejtat themelore me ligje të dykuptimta por që përmes këtij parimi t'i ofrohet mbrojtje ligjore individëve vis-a-vis shtetit, organeve dhe agjentëve të tij; (ii) respektimi i të drejtave të njeriut - respektimi i sundimit të ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut jo domosdoshmërisht janë sinonime. Sidoqoftë, këto dy koncepte në masë të madhe e mbulojnë njëra-tjetrën dhe shumë të drejta të përfshira në KEDNJ, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i referohen sundimit të ligjit; (iii) ndalimi i diskriminimit dhe barazia para ligjit - përveç që paraqesin të drejta themelore të njeriut, ato gjithashtu paraqesin edhe koncepte të sundimit të ligjit.

65. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar përmban dispozita të cilat nuk janë mjaftueshëm të qarta dhe precize dhe se Kuvendi me miratimin e tij e ka anashkaluar të drejtën për të mos diskriminuar dhe të drejtën e pronës, që bashkë me shkeljet e tjera kushtetuese ka nxitur parashtruesin e kërkesës që Ligjin e kontestuar ta referojë për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

Pretendimet në lidhje me “barazinë para ligjit”

66. Përkitazi me “barazinë para ligjit”, Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës thekson se Ligji i kontestuar nuk ka arritur të sigurojë *“pagë të barabartë për punë të barabartë”*, në të gjithë sektorin publik. Ligji i kontestuar pretendohet të ketë krijuar një situatë divergjente për pozita të barasvlershme, sepse në institucionet e ndryshme pozitat e njëjta apo të krahasueshme janë vlerësuar me nivele të ndryshme të pagave. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se Ligji i kontestuar nuk është në pajtim me nenet 3 paragrafi (2), 7 (1); 21, 22 dhe 24 paragrafi (1) të Kushtetutës – nene këto që përcaktojnë barazinë para ligjit dhe parimet e përgjithshme të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon që Ligji i kontestuar nuk është në pajtim me nenin 23 paragrafi (2) të DUDNJ-së, në të cilin përcaktohet që: *“Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.”* Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës i referohet paragrafit (1) të nenit 22 të Kushtetutës, ku përcaktohet që DUDNJ zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me këtë Deklaratë, kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.

67. Parashtruesi i kërkesës thekson që duke pasur parasysh që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe si të tilla janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësojë ose të cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe të lirive themelore të përcaktuara nga Kushtetuta dhe nga ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, paraqesin diskriminim.

Pretendimet në lidhje me “mbrojtjen e pronës”

68. Përkitazi me të “drejtën e pronës”, Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar cenon të drejtat pronësore të individëve apo grupeve të sektorit publik. Parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës për të vlerësuar proporcionalitetin e uljes së pagave në sektorin publik me ç’rast pohon se: *“Në rastin konkret, i mbetet Gjykatës Kushtetuese ta vlerësojë nëse ulja e pagave të një numri subjektesh në sektorin publik është bërë në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës, i cili parasheh kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore, esencës të së drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe mundësisë së realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël”*.
69. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se paga është një e “mirë” nga këndvështrimi i nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sepse punonjësit kanë pritje legjitime në “materializimin” e pagave të tyre. Parashtruesi i kërkesës shton se ulja e pagave është ankesa kryesore që i është adresuar Institucionit të Avokatit të Popullit dhe se, sipas tij, Ligji i kontestuar në shumë sektorë “ka bërë uljen e pagave”. Duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës vlerëson se Ligji i kontestuar nuk ka gjetur një balancë të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore të individit.
70. Në këtë drejtim, duke cituar rastin e GJEDNJ-së *Hasani kundër Kroacisë* (shih rastin e GJEDNJ-së *Hasani kundër Kroacisë*, kërkesa nr. 20844/09, Vendim mbi Pranueshmëri i 30 shtatorit 2010), parashtruesi i kërkesës thekson se: *“GJEDNJ-ja thekson obligimin e autoriteteve publike për të mbajtur një balancë të drejtë të domosdoshëm për interesin publik dhe për mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve. Kjo balancë nuk arrihet kur qytetarëve u duhet ta bartin një barrë të madhe dhe jo proporcionale, me ndikim*

të drejtpërdrejtë në reduktimin e të drejtave ekonomike. Në këto rrethanat, ka shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për shkak të shkeljes së arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit në reduktimin e të drejtave pronësore [...] Është e qartë se çështjet buxhetore imponojnë barra të mëdha dhe jo proporcionale në të punësuarit që paguhen nga buxheti, pa ruajtur balancën e drejtë në mes të interesit publik dhe të mbrojtjes së domosdoshme të të drejtave themelore të njeriut. Për më shumë, në rastin Kjartan Asmundsson v. Iceland, nëse shumica e benefiteve është ulur apo është ndaluar, kjo paraqet kufizim të të drejtave pronësore dhe se kjo duhet të arsyetohet me interesin e përgjithshëm. Në esencë, GJEDNJ-ja konsideron se një kufizim është i arsyetuar (edhe në rastet kur aplikuesit do të duhej të jenë në posedim të aseteve) në rrethanat kur është ndjekur qëllimi legjitim (balancimi i buxhetit të shtetit në kriza ekonomike) kur është proporcional, duke marrë parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit të shtetit në politikat ekonomike dhe sociale dhe balancën e arritur me aplikim të masave të tilla”.

Ankesat individuale të institucioneve dhe subjekteve të tjera të interesuara në kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar – të dorëzuara pranë Avokatit të Popullit dhe të përcjellura nga ky i fundit në Gjykatën Kushtetuese si pjesë e dosjes së rastit KO219/19

71. Përveç pretendimeve të lartcekura të Avokatit të Popullit përmes së cilave kontestohet kushtetutshmëria e tërësishme e Ligjit për Paga, Avokati i Popullit ka përcjellur në Gjykatë edhe tridhjetë e pesë (35) ankesa individuale që janë dorëzuar pranë Avokatit të Popullit nga institucione dhe subjekte të ndryshme të interesuara. [Sqarim: këto ankesa Gjykata i ka pranuar nga Avokati i Popullit si pjesë e dosjes së rastit KO219_19 dhe të njëjtat iu janë dërguar Avokatit të Popullit nga të gjitha këto 35 palë të interesuara që kanë konsideruar se Ligji i kontestuar shkelë norma të caktuara kushtetuese ose të drejta dhe liri të caktuara].
72. Lidhur me kërkesat individuale të lartpërmendura të cilat janë paraqitur tek Avokati i Popullit, parashtruesi i kërkesës konsideron që është në interes të ankuesve, por edhe të publikut, që Gjykata të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar prek interesat legjitime të këtyre ankuesve. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës, lidhur me 35 ankesat e pranuar nga Avokati i Popullit konsideron se Gjykata duhet të japë një vlerësim lidhur me çështjet si në vijim: (i) “Nëse parimi i ndarjes së pushteteve dhe garancia kushtetuese, që ka të bëjë me barazinë para ligjit, është arritur me Ligjin e kontestuar dhe me

Shtojcën 1 të tij"; (ii) "Nëse Ligji i kontestuar duhet t'i përfshijë ndërmarrjet publike, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës dhe nëse përfshirja e tyre në Ligjin e kontestuar e cenon Kushtetutën, përkatësisht parimin e ekonomisë së tregut të lirë, i shprehur në nenin 10 dhe në nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të reflektuar në Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike"; (iii) "Nëse Ligji i kontestuar duhet t'i trajtojë me kujdes punonjësit e institucioneve, të organeve dhe të autoriteteve të një rëndësie të veçantë dhe punonjësit në sektorin publik për specializimin e të cilëve është investuar."

73. Në vijim, Gjykata do të paraqesë esencën e të gjitha 35 ankesave në fjalë. Në pjesën e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata do të përgjigjet specifikisht për statusin e këtyre ankesave në shqyrtimin e këtij rasti (shih paragrafët 188-191 të këtij Aktgjykimi).

Ankesa nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

74. KQZ pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar ka bërë kategorizim joadekuat të KQZ-së karshi përgjegjësisë kushtetuese të këtij institucioni. Ankuesja thekson se sipas Kapitullit XII të Kushtetutës janë formuar institucionet e pavarura si: Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Banka Qendrore e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioni i Pavarur i Mediave. Më tej, ankuesja pretendon se KQZ-ja asnjëherë nuk është trajtuar njësoj me institucionet e tjera të cilat e kanë bazën e njëjtë kushtetuese, ndonëse natyra e përgjegjësisë të tyre nuk është e njëjtë me KQZ-në. KQZ-ja, në bazë të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës KO73/16 si dhe në bazë të nenit 17 të Rregullores së Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka nxjerrë rregullativën e vet të brendshme. Si rezultat i kësaj, KQZ-ja ua ka caktuar gradat dhe koeficientet nëpunësve të vet, mbi bazën e specifikave të vendeve të punës. Lidhur me këtë, KQZ-ja kërkon që me Ligjin për Pagat të respektohet pavarësia kushtetuese e KQZ-së, si institucion i pavarur dhe të ruhen pagat dhe gradat aktuale sipas rregullores së brendshme të KQZ-së (Rregullore nr. 02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve).

Ankesa nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

75. KGJK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se miratimi i Ligjit të kontestuar, në mënyrë të pashmangshme, i bën të pazbatueshme në praktikë parimet kushtetuese të Kushtetutës dhe si rrjedhojë e kësaj

edhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat Republika e Kosovës i ka lidhur me BE-në, më konkretisht, Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila është lidhur në frymën e respektimit të kriterëve për ndarjen e pushteteve. KGJK thekson se Ligji për Pagat është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse shkel parimin e barazisë së pushteteve e rrjedhimisht shkel edhe të drejtat e punonjësve të KGJK-së. Tutje, sipas nenit 4 të Kushtetutës, theksohet se pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat, gjë që rezulton se pushteti gjyqësor është i barabartë me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Sipas këtij rregulli të barabarsisë, do të duhej që të punësuarit të trajtoheshin krejtësisht të barabartë, veçanërisht pagat e nëpunësve civilë në të tre nivelet (pushtetet). Po ashtu, KGJK thekson se, duke pasur parasysh faktin se gjyqësori është i pavarur, do të duhej të përcaktoheshin edhe pagat në përputhje me rolin dhe peshën që ka sistemi gjyqësor e rrjedhimisht edhe administrata e tij në kuadër të sistemit të aplikueshëm kushtetues. Më tej, KGJK po ashtu pretendon se Ligji i kontestuar nuk i ka përfshirë disa pozita ekzistuese të pushtetit gjyqësor, gjë që paraqet faktin se Qeveria dhe Kuvendi nuk i kanë marrë parasysh komentet dhe propozimet e paraqitura nga KGJK. Kjo e fundit i referohet dhe e konsideron si pjesë të kësaj kërkesë edhe kërkesën nga Sindikata e Pavarur e Judikaturës së Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e theksuara më sipër, KGJK kërkoi nga parashtruesi i kërkesës, respektivisht Avokati i Popullit që të referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit të kontestuar.

Ankesa nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)

76. KPK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe shkel parimin e barazisë së pushteteve e rrjedhimisht shkel edhe të drejtat e të punësuarve në sistemin prokurorial të Kosovës. Ankuesi ka kërkuar kompensimin e pagave në pajtim me parimin e ndarjes dhe barazisë së pushteteve, siç është përcaktuar me Kushtetutë, përkatësisht gjyqësori të jetë i barabartë me legjislativin dhe me ekzekutivin edhe në pikëpamjen e pagave. Lidhur me këtë çështje, ankuesi ka kërkuar që në Ligjin e kontestuar të bëhet harmonizimi në Shtojcën 1 ashtu që pozita e Kryesuesit të Këshillit dhe Kryeprokurorit të Shtetit të kalojnë në nëngrupin e pozitave A2, me koeficient 10. Ankuesi kërkon që zëvendeskryeprokurori i shtetit të pranojë 95% të pagës së Kryeprokurorit të Shtetit. Më tej ankuesi pretendon se sipas ndryshimeve të bëra me Ligjin nr. 05/L-032 për Gjykatat, prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit marrin 90% të pagës së

kryetarit të Gjykatës Supreme. Prokurorët e Prokurorisë së Apelit pranojnë 90% të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit. Po ashtu, 90% të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit pranojnë edhe kryeprokurorët e prokurorive themelore. Prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda pranojnë 90% të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, përderisa prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm pranojnë 85% të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Skemën e pagave të shpjeguar më lart Këshilli Prokurorial e konsideron në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht në harmoni me nenin 21, paragrafi 1, pika 10, të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit. Ankuesi njoftoi se nuk do të pranojë që paga e Kryesuesit të Këshillit dhe e Kryeprokurorit të Shtetit të jetë e barabartë me pushtetin ekzekutiv dhe që paga e prokuroreve të nivelit themelor të jetë në grupin e pozitave A9, me koeficientin 5.5, sepse kjo shkel nenin 4 të Kushtetutës dhe bie ndesh me ligjet themelore që i rregullojnë gjykatat dhe sistemin prokurorial.

Ankesa nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës

77. Shoqata e Prokurorëve të Kosovës pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën. Ata theksojnë se neni 4, paragrafi 1, i Kushtetutës parasheh se Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve, kontrollit dhe balancimit mes tyre. Sipas tyre, kjo nënkupton balancimin e detyrimeve, por edhe të të drejtave të tre pushteteve, që duhet të jenë të balancuara edhe sa i përket pagave. Sipas nenit 4 të Kushtetutës, ata kanë theksuar se janë pesë kategori kushtetuese që duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe ato janë: Presidenti, Kuvendi, Qeveria, pushteti gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese. Sipas tyre, në shtojcën e Ligjit të kontestuar, kryetari i Gjykatës Supreme, Kryeprokurori i Shtetit, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, dhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial janë renditur në Klasën A4, me koeficient 8, që është dy kategori me poshtë sesa kryetari i Kuvendit, sesa kryeministri dhe sesa kryetari i Gjykatës Kushtetuese, të cilët janë renditur në Klasën A2, me koeficient 9. Sipas tyre, ky dallim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-054 për Gjykatat (neni 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1); të Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit (neni 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) dhe të Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitimin e Ish-Zyrtarëve të Lartë (neni 3, siç është ndryshuar me Ligjin nr.04/L-038, neni 3, paragrafi 2), sepse, sipas këtyre ligjeve, kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit janë të barabartë me kryetarin e Kuvendit dhe me Kryeministrin. Çështja tjetër e ngritur nga Shoqata e Prokurorëve të

Kosovës është dispozita e nenit 13, paragrafi 3, të Ligjit të kontestuar, e cila nuk parasheh shtesa të tjera mbi pagën bazë për funksionarë me status të veçantë, një kategori që përfshin edhe gjyqtarët e prokurorët. Ndërsa, sipas nenit 12 të të njëjtit ligj, shtesat e posaçme u takojnë disa kategorive të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës konsideron se me Ligjin e kontestuar jo vetëm që është shkelur parimi i balancimit të tre pushteteve, por është bërë edhe diskriminimi mes pozitave të ndryshme brenda sistemit gjyqësor. Diskriminimi, sipas tyre, qëndron në faktin se në Shtojcën 1 të Ligjit të kontestuar, në Klasën A5, me koeficient 7.75, janë renditur gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa një kategori me poshtë, në Klasën A6, janë renditur prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me koeficient 7.5. Me këtë dispozitë, theksohet të jenë diskriminuar vetëm prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, sepse gjyqtarët dhe prokurorët në instanca të tjera të sistemit gjyqësor dhe prokurorial janë të barabartë sa i përket pagave. Po ashtu theksohet se Gjykata Kushtetuese duhet ta trajtojë dispozitën e nenit 28, paragrafi 1, të Ligjit të kontestuar meqë kjo dispozitë parasheh që për sistemin e pagave, të shtesave, të shpërblimeve dhe Shtojca nr. 1 nuk zbatohen për funksionarin publik me status të veçantë: gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial, deri me 31 dhjetor 2022. Sipas Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, kjo dispozitë lejon hapësirë që gjyqtarëve dhe prokurorëve t'u ulet paga nga 1 janari 2021, përafërsisht për gjysmë, që bie në kundërshtim me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor të paraparë me nenin 4, paragrafi 5, me nenin 102, paragrafi 2, dhe me nenin 109, paragrafi 1, të Kushtetutës.

Ankesa nga ekspertet për antikorupsion nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

78. Ankuesit pretenduan, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar cenon dispozitat kushtetuese në vijim: vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës (neni 7), dinjiteti i njeriut (neni 23), barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit (neni 24) dhe e drejta e pronës (neni 46). Ekspertët për antikorupsion nga Prokuroria Speciale kanë cekur që titulli i tyre sipas akt emërimit është ekspert, ndërsa paga e tanishme sipas të njëjtit akt është 1,450.00 euro, duke përfshirë shtesat e lejuara. Ndërsa, sipas Shtojcës 1 të Ligjit të kontestuar, pozita e ekspertit për antikorupsion, që i përket kategorisë të ekspertit në gjykatë dhe në prokurori, është paraparë në Klasën L6, me pagë bazë 836.50 euro. Më tutje, ekspertët për antikorupsion kanë theksuar se Ligji i kontestuar bën ndarjen në

Shtojcën 1 në renditjen e pozicioneve, në mënyrë që për ekspertë në Prokurori të Shtetit është paraparë pozicioni numër 92, me koeficient 2.9, gjithashtu edhe pozicioni numër 93, me koeficient 2.65, por edhe pozicioni 194, i cili përfshin edhe ekspertët në prokurori, me koeficient 3.5. Kjo ndarje reflektohet në pagat përkatëse. Ekspertët për antikorrupsion nga Prokuroria Speciale e konsiderojnë këtë ndarje si diskriminuese, por edhe si një gjë që krijon huti, sepse nuk dihet saktë se në cilin pozicion ata duhet të kategorizohen. Kjo për faktin se 5 pozita të ekspertëve ekzistojnë në tërë administratën e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në Prokurorinë e Shtetit dhe faktikisht punojnë në Prokurorinë Speciale ndërsa i raportojnë direkt Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale. Në këtë drejtim, ankuesit e kanë theksuar çështjen e ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjit dhe theksojnë se rasti i tyre ka të bëjë me të drejtat e pronësisë, të parapara në nenin 46 të Kushtetutës ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Po ashtu, ekspertët për antikorrupsion e kontestojnë joproporcionalitetin e Ligjit të kontestuar, duke cekur se disa institucione janë përjashtuar nga kategorizimi i bërë dhe kanë të drejtë që vetë ta caktojnë nivelin e pagave të tyre. Në Ligjin e kontestuar këto institucione janë renditur para Prokurorisë Speciale, që sipas ekspertëve për antikorrupsion, paraqet diskriminim. Për më shumë, Prokuroria Speciale, sipas eksperteve për antikorrupsion, është privuar nga e drejta e përfitimit të shtesave të rrezikshmërisë dhe nga shtesat e tjera. Më tutje, ekspertet për antikorrupsion theksojnë se çdo ligjënie e Kuvendit duhet ta ketë parasysh Kushtetutën dhe Gjykatën Kushtetuese. Në kërkesën e ekspertëve për antikorrupsion nga Prokuroria Speciale theksohet më tutje se Prokuroria Speciale është institucion kushtetues me specifika të veçanta dhe kjo duhet të reflektohet edhe në rikategorizimin e vendeve të punës. Sipas Shtojcës 1, e cila paraqet katalogun e vendeve të punës, parimi i pagës së barabartë për punën e njëjtë është shkelur, sepse ekspertët për antikorrupsion janë renditur së bashku me bashkëpunëtorët profesionalë dhe nuk dihet me çfarë baze ligjore është bërë rikategorizimi i këtyre ekspertëve. Sipas tyre, diskriminimi qëndron në faktin se puna e pozitës Ekspert në Departamentin Special për antikorrupsion të jetë e barasvlershme me pozitën e tjera në institucione të tjera, sepse puna e tyre kërkon njohuri më të gjëra dhe specifike ligjore dhe nuk mund të krahasohet me punën e ekspertëve në institucione të tjera, as me punën e bashkëpunëtorëve profesionalë. Ekspertet për antikorrupsion kërkojnë që pozita e tyre të kategorizohet ngjashëm me këshilltarët juridikë në Gjykatën Kushtetuese, në kategorinë L4, me koeficient 5.5. Gjithashtu kërkojnë që të merret parasysh fakti se të gjithë ekspertët kanë përvojë tanimë tetëvjeçare me kontribut të veçantë në luftimin e korrupsionit, të krimit të organizuar, të pastrimit të parave dhe të veprave të tjera që

hetohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ekspertët për antikorrupsion thirren në rastin KO73/16 të Gjykatës Kushtetuese.

Ankesa nga Policia e Kosovës (PK)

79. PK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar nuk është paraparë që zyrtarët policorë të kenë të drejtë për shtesën për kushtet e tregut (neni 6, paragrafi 1). PK pretendon se Ligji i kontestuar, përkatësisht neni 6 [Shtesa për kushte tregu], neni 13 [Paga e funksionarit publik me status të veçantë], neni 14 [Shtesa të posaçme për funksionarin publik me status të veçantë], nuk janë në harmoni me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, përkatësisht me nenin 47. Lidhur me këto paqartësi, PK-ja ka dhënë komentet edhe më herët duke kërkuar që edhe zyrtarët policorë të përfshihen dhe ta gëzojnë të drejtën në shtesën për kushtet e tregut dhe të mos kufizohet marrja e dy (2) shtesave. Komentet e Policisë së Kosovës nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Administratës Publike.

Ankesa nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)

80. IPK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se punonjësit e tij janë kategorizuar si punonjës me status të veçantë sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë, ndërsa në Ligjin e kontestuar, në Shtojcën (1) është përfshirë vetëm pozita e inspektorit policor, por jo edhe pozitat e tjera udhëheqëse sipas hierarkisë së IPK-së. IPK-ja propozon përfshirjen e pozitave të tjera udhëheqëse në Shtojcën (1), si në vijim: Kryeshefi ekzekutiv i IPK-së, udhëheqës departamenti në IPK, udhëheqës divizioni operativ në IPK, dhe renditjen e tyre në ekuivalencë me pozitat në Policinë e Kosovës, duke kërkuar që niveli i pagave për pozitat udhëheqëse në IPK të përfshihet në Shtojcën 1. Sipas pretendimeve, IPK gëzon të drejtën në rrezikshmëri, për shkak të natyrës së punës dhe propozon që neni 14 i Ligjit të kontestuar, i cili rregullon shtesat e posaçme për funksionaret publike me status të veçantë, t'i përfshijë edhe punonjësit operativë të IPK-së, në mënyrë që ata të përfitojnë një shtesë të posaçme për detyra që kryejnë në sektor apo në operacione të posaçme me rrezikshmëri për jetën, për të trajtuar punonjësit operative të IPK-së krahas zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës.

Ankesa nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë (AKF)

81. AKF pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar, punonjësve të AKF-së u ulen pagat rreth 20%. AKF më tej pretendon se me këtë ligj është cenuar parimi “pagë e njëjtë për punë të njëjtë”,

sepse kjo agjenci ka të njëjtin sistem të gradave sikurse Policia e Kosovës. Ky sistem i gradave sipas AKF-së është i përcaktuar në neni 17 të Ligjit 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe me aktet nënligjore. Duke pasur parasysh rreziqet e punës që kryejnë punonjësit e kësaj agjencie, e po ashtu duke pasur parasysh faktin se kualifikimi dhe ngritja e gradave në agjenci bëhet duke u bazuar në përvojën e punës e po ashtu në kryerjen e trajnimeve të ndryshme që kryhen për një kohe relativisht të gjatë dhe në vende, si ShBA, Zvicër, Turqi etj., ankuesja pretendon se punonjësit e agjencisë janë bartës të testeve profesionale dhe të testeve të kompetencës që nga AKI-ja (Agjencia e Kosovës për Inteligjencë) janë verifikuar në nivelin sekret. Ankuesja pretendon se aktivitetet e tyre shoqërohen me rreziqe të mëdha, sepse ekspertizat bëhen në fushën e balistikës, të gjurmëve, të gishtave, në fushën e narkotikëve, Serologjisë dhe ADN-së, pastaj ballafaqimi i punonjësve të agjencisë përmes dhënies së dëshmimeve në gjykata dhe në prokurori për testet e trajtuara nga ta. Bazuar në këto që u theksuan më sipër, agjencia pretendon se ata ballafaqohen me rreziqe dhe me vështirësi të njëjta të punës sikurse Policia e Kosovës, sikurse Inspektorati Policor dhe sikurse Agjencia për Inteligjencë, sepse me Ligjin nr. 05/L- 022 për Armë (neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1), me Ligjin nr. 05/L-0 17 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri (neni 1), përcaktojnë se Agjencia e Kosovës për Forenzikë bën pjesë në institucionet shtetërore të sigurisë njëjte sikurse Policia e Kosovës, sikurse Inspektorati Policor dhe sikurse Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.

Ankesa nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)

82. AKK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se është diskriminuar si në nivel të renditjes së institucionit, në përcaktimin e koeficienteve, e po ashtu edhe në aspektin e përqindjes së përfitimit të shtesave të veçanta. Shqetësimet e AKK-së kryesisht kanë të bëjnë me përfitimin e shtesave të posaçme të nëpunësve civilë, të cilët në AKK si përfitim në emër të shtesave të posaçme gëzojnë deri në 20% mbi pagën bazë, sipas nenit 8 të Ligjit nr.06/L-111. AKK thekson se është renditur në numrin 32 për nga niveli i rëndësisë dhe e konsideron këtë si dëmtrim të rolit dhe të rëndësisë që ka. Më tutje, AKK thekson se niveli i pagës apo përcaktimi i koeficienteve për stafin e saj nuk është bërë fare sipas detyrave, as sipas përgjegjësive dhe as sipas funksioneve që ushtrojnë zyrtarët e AKK-së. Drejtorit të AKK-së i është zvogëluar paga në krahasim me pagën aktuale, që sipas tyre nënvlerëson rolin dhe nivelin e përgjegjësisë së kësaj pozite. Uljen e nivelit të pagave të nëpunësve të AKK-së, kjo agjenci e konsideron si diskriminim. Për

këto arsye, AKK i ka adresuar shqetësimet e saj tek Avokati i Popullit, duke kërkuar që të shqyrtohet ankesa e saj dhe të merren për bazë të gjitha faktet dhe rrethanat e parashtruara, në mënyrë që AKK, bazuar në rolin dhe rëndësinë e saj që e ka, të renditet ashtu siç ka qenë, paralel me institucione të tjera të zbatimit të ligjit (policinë, prokurorinë, doganën, Zyrën Kombëtare të Auditimit etj) dhe t'i gëzojë shtesat e veçanta, njëjtë sikurse institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Ankesa nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)

83. ZRRë pretendoi, para Avokatit të Popullit, se përfshirja e ZRRë-së në Ligjin e kontestuar dhe në Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore është në kundërshtim me Kushtetutën, në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Direktivave Evropiane (Pakos së III-të, të legjislacionit për energjinë e Bashkimit Evropian) dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, në veçanti me dispozitat që ndërlidhen me pavarësinë financiare të Rregullatorit të Energjisë. ZRRë-ja thekson se financohet nga të hyrat vetanake, përkatësisht nga taksat që mblidhen nga ndërmarrjet dhe operatorët e licencuar në sektorin e energjisë dhe jo nga buxheti i Republikës së Kosovës. ZRRë pretendon se e ka statusin e agjencisë së pavarur sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 142, paragrafi 1, dhe ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, sipas nenit 142, paragrafi 2, të Kushtetutës. Përveç kësaj, Ligj nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë e ka themeluar ZRRë-në si agjenci të pavarur, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Me tutje, ZRRë thekson se financohet nga të hyrat vetanake, ndërsa nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë potencojnë të drejtën e ZRRë-së për përdorimin e të ardhurave të saj, pra për të përcaktuar buxhetin e saj vetanak sipas nevojave specifike. Po ashtu, ZRRë thekson se është palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe e obliguar t'i miratojë dhe t'i zbatojë direktivat e Komunitetit të Energjisë, përfshirë Paketën të Tretë të Energjisë, e cila përcakton kërkesa strikte të pavarësisë vendimmarrëse dhe financiare të rregullatorit të energjisë. Më tej, ZRRë njofton se Kapitulli IX i Direktivës për Tregun e Brendshëm (Direktiva 2009/72/EC) e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, në nenin 35.5, kërkon ndër të tjera që shtetet anëtare të sigurojnë që autoriteti rregullator të këtë alokim të ndarë nga buxheti dhe autonomi në zbatimin e buxheti të vet. Po ashtu, ZRRë tërheq vëmendje në raportet e progresit për Kosovën, ku financohet domosdoshmëria për pavarësinë e buxhetit të ZRRë-së. ZRRë e konsideron personelin e saj si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vlerëson se pagat e anëtareve të stafit duhet të jenë të pajtueshme me nivelin e pagave të industrisë së rregulluar, me qëllim

që të shmanget ikja e stafit drejt industrisë dhe t'i mundësohet ZRrE-së që të mbajë dhe tërheqë burime njerëzore të kualifikuara dhe të mjaftueshme. Ndërsa sipas ZRrE-së, Ligji i kontestuar potencialisht rrezikon ikjen e stafit të ZRrE-së. ZRrE-ja njofton se këto kërkesa i kanë përcjellë gjatë periudhës së hartimit të këtyre ligjeve, mirëpo nuk janë marrë parasysh.

Ankesa nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)

84. ARC pretendoi, para Avokatit të Popullit, se stafi në pozita menaxhuese dhe pozita nën-menaxhuese në qendrat për regjistrimin e automjeteve e as në qendrat për pajisje me dokumente në ARC nuk është i kënaqur me koeficientet e përcaktuara me Ligjin e kontestuar, të cilët, sipas ARC-së, janë në kundërshtim me Ligjin nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. ARC-ja theksoi se koeficientet e ri nuk janë përcaktuar në pajtim me punën dhe as me përgjegjësitë në qendrat për regjistrimin e automjeteve e as në qendrat për pajisje me dokumente në ARC, sepse këto punë dhe përgjegjësi janë shumë më të larta sesa që janë përcaktuar me koeficientet dhe lidhur me këtë kërkon që pagat të rregullohen duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe në Ligjin nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (dispozitat për nivelin drejtues) dhe të behët plotësimi në Shtojcën nr.1 të Ligjit të kontestuar, për pozitat drejtuese në ARC. Kjo e fundit pretendon që stafi i saj duhet të paguhet me pagë të njëjtë për punë të njëjtë, në bazë të nenit 3, paragrafi 1, pika l.3, të Ligjit të kontestuar, sepse konsideron se janë diskriminuar, për shkak se kanë pozita të barabarta, detyra dhe përgjegjësi të njëjta me zyrtarët në ministri dhe në institucione të tjera të përcaktuara sipas Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Ankesa nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AAC)

85. AAC pretendoi, para Avokatit të Popullit, se është kategori e veçantë kushtetuese, e paraparë me nenin 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas Kushtetutës, AAC rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror. Po ashtu, ankuesi thekson se, sipas Ligjit nr.03/L-051 për Aviacionin Civil, AAC është agjenci e pavarur rregullatore që rregullon të gjitha aspektet e sigurisë së aviacionit civil dhe është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe të ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Më tej, AAC pretendon se pagat e personelit të tij janë të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 2, të Ligjit nr.03/L-051 për Aviacionin Civil. Sipas këtij ligji, Ministri i Financave

e ka miratuar një skemë pagash, e cila është kompetitive dhe që ka mundësuar tërheqjen e personelit profesional në fushën e aviacionit. Për më tepër, AAC thekson se gjeneron të hyra vetanake për funksionimin e vet, nga tarifa e sigurisë, nga tarifat e licencimit, të certifikimit dhe të mbikëqyrjes së operatorëve të aviacionit civil. Ankuesi tërheq vëmendjen se në Aneksin 19 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar theksohet se shtetet duhet t'i marrin masat e nevojshme, si: caktimi i shpërblimit dhe sigurimi i kushteve të shërbimit, për të siguruar rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për kryerjen e funksioneve të mbikëqyrjes së sigurisë së aviacionit civil. Veç kësaj, AAC thekson se Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ONAC), në manualin e mbikëqyrjes së sigurisë përcakton se stafi i aviacionit civil duhet të gëzojë kushte të punësimit, të cilat janë konkurruese me ato të ofruara nga industria e aviacionit civil. Po ashtu, AAC thekson se në industrinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës pagat në sektorin privat janë dukshëm më të larta sesa niveli i pagave sipas Ligjit të kontestuar. Për më tepër, sipas AAC-së, ekziston mundësia që profesionistët e AAC-së të gjejnë punë në tregun ndërkombëtar të punës. AAC, vë në pah shqetësimet e personelit për shkak të uljes së madhe të pagave për stafin profesional në aviacion dhe tërheq vëmendjen në dallimin në paga të shkaktuar nga gradat e ndryshme të pagave brenda AAC-së.

Ankesa nga Agjencia për Shërbimin e Navigacionit Ajror (AshNA)

86. ASHNA pretendoi, para Avokatit të Popullit, se përfshirja e saj në Ligjin e kontestuar cenon autonominë e saj në zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare që janë të detyrueshme për Republikën e Kosovës. ASHNA thekson se Marrëveshja për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (marrëveshja për HPEA), në nenin 13, dhe Aneksin 1, pika B, parasheh, financimin dhe vendosjen e tarifave të shfrytëzimit të shërbimeve të navigimit ajror. Ky financim bazohet në parimin “shfrytëzuesi paguan”, i cili, sipas ASHNA-së është shkelur me përfshirjen e saj në Ligjin e kontestuar. Për më tej, ASHNA cek se edhe Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim, të cilën Republika e Kosovës e ka nënshkruar me BE-në, në nenin 53, përcakton se baza e funksionimit të veprimtarisë së aviacionit civil është në marrëveshjen për HPEA-në. Po ashtu, ASHNA thekson rolin e saj që ka të bëjë me kontrollin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, rëndësinë e saj si agjenci për alarmin e shkeljes së paautorizuar të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës dhe përpjekjet në marrjen e plotë të kompetencave për menaxhimin e hapësirës ajrore. Sipas ankueses, resursi kryesor i saj është personeli që përbëhet nga profesionistë të veçantë të fushës së navigacionit ajror. Me përfshirjen e personelit të

AShNA-së në Ligjin për Pagat rrezikohet që këta profesionistë ta braktisin Kosovën për ta vazhduar karrierën në vende të tjera. Po ashtu, ankuesja cek se caktimi i pagave dhe i shpenzimeve të tjera të ASHNA-së, si rrjedhojë e nënshkrimit të marrëveshjes HPEA, bëhet duke u bazuar në Rregulloren e Bashkimit Evropian nr. 1794/2006 të transponuar përmes Rregullores 3/2016 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, e cila cakton tarifën për shfrytëzues të shërbimeve aeronautike. Ankuesja, në fund konsideron se trajtimi që i bëhet me Ligjin për Pagat do të këtë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në besimin e ndërtuar me palë të interesit, me theks të veçantë në NATO, KFOR dhe në kompanitë ajrore.

Ankesa nga Sindikata e Pavarur e Judikatures e Republikës së Kosovës (SPJRK)

87. SPJRK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se përmes Ligjit të kontestuar është bërë trajtim jo i drejtë, diskriminues, degradues, i cili bie ndesh me parimet bazë të Kushtetutës, bie ndesh me marrëdhëniet kontraktuese dhe të vetë Ligjit të kontestuar, për shkak të pabarazisë së kompensimit “*page e njëjte për punë të njëjtë*”. SPJRK këtë pretendim e mbështet në nenin 4 të Kushtetutës, që trajton ndarjen e pushteteve dhe theksohet qartë se pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i barabartë me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Më tej, Sindikata pretendon se me këtë ligj është ruajtur paga e prokurorëve dhe e gjyqtarëve në raport me pagat e tyre aktuale, mirëpo kjo gjë nuk ka ndodhur edhe me pjesën tjetër të personelit udhëheqës dhe atij mbështetës të sistemit gjyqësor dhe të sistemit prokurorial në raport me pagat dhe koeficientet e personelit udhëheqës dhe të atij mbështetës të pushtetit legjislativ, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e pagave bazë gati të të gjitha pozitave udhëheqëse dhe mbështetëse, e po ashtu me këtë ligj është krijuar ndryshim shumë i lartë ndërmjet pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve me pagat e stafit mbështetës të të dy organizatave buxhetore.

Ankesa nga Sindikata e Shërbimit Civil të Kosovës dhe nga Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës

88. Sindikata në fjalë pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar është diskriminues, joreal, joobjektiv dhe mbi të gjitha është antikushtetues. Sipas ankuesve, me Ligjin e kontestuar janë shkelur dispozitat e nenit 3, të nenit 21, paragrafi 1, të nenit 24 dhe të nenit 58, paragrafi 3 dhe paragrafi 7, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Më tej, ankuesit pretendojnë se ky ligj ka cenuar rëndë parimin e “*pagës së barabartë për punët e njëjta ose të përafërta*”,

parimin e mosdiskriminimit të punëtoreve dhe parimin e ligjshmërisë. Ankuesit njoftojnë se ky ligj cenon realizimin e të drejtës në shtesa të posaçme për pozita menaxhuese dhe për nëpunësit administrativo-teknik të të dy niveleve të administratës publike të Kosovës. Sipas ankuesve, kjo cenohet me dispozitën e nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit të kontestuar. Sipas pohimeve të ankuesve, ky ligj nuk ngërthen në vete zgjidhje të drejta, jodiskriminuese, gjithëpërfshirëse, parimore, reale, objektive dhe korrekte, as sa i përket nivelimit të pagave, as në pikëpamje të trajtimit të drejtë dhe të barabartë të kategorive të njëjta sipas parimit për punë të njëjtë apo të ngjashme, pagë të njëjtë apo të përafërt. Për këtë arsye, sipas ankuesve, ky ligj krijon pabarazi dhe pakënaqësi, thellon dallimet dhe problemet në shërbimin civil dhe në administratën shtetërore të Kosovës.

Ankesa nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK)

89. AShAK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se përfshirja e saj në Ligjin e kontestuar dëmton statusin e anëtarit të akademisë. AShAK thekson se është institucion i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ka ligj të veçantë: Ligjin nr. 05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (neni 2). AShAK pohon se është institucion i pavarur në fushën e shkencës dhe të artit, ndërsa veprimtaria e akademisë është veprimtari e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës, Po ashtu, çështja e shpërblimit të anëtarit të AShAK është e rregulluar me Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (neni 25). Sipas njoftimit të AShAK kuptohet se anëtarët e saj nuk marrin pagë, mirëpo marrin shpërblim, që është karakteristike e të gjitha akademive të shkencave, dhe përcaktimet aktuale të Ligjit të kontestuar bien në kundërshtim me këtë rregull. AShAK-u pretendon se përgjithësisht Ligji i kontestuar e cenon Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i cili nuk është marrë parasysh në kohen e miratimit të Ligjit të kontestuar.

Ankesa nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)

90. IML, para Avokatit të Popullit, kërkon pezullimin e zbatimit të nenit 33, paragrafi 1.8, të Ligjit të kontestuar, për nëpunësit e IML-së, dhe lënien në fuqi të shtesës mbi pagën bazë prej 30%, për çdo orë pune si rrezikshmëri, e paraparë me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësi Ligjore, deri në miratimin e akteve nënligjore të parapara me nenin 31 të Ligjit të kontestuar dhe caktimin meritator të shtesës së rrezikshmërisë në punë për stafin e IML-së. IML-ja thekson se gjatë periudhës së hartimit të Ligjit të kontestuar, nuk është marrë parasysh fakti se IML-ja është organ i vetëm dhe specifik në Republikën e Kosovës, për nga natyra dhe specifikat e punës që kryhet

në këtë institut. Për këtë arsye IML kërkon që caktimi i gradës së nëpunësve të tij të bëhet në mënyrën meritore duke pasur parasysh faktin se IML është organ i vetëm dhe specifik në Republikën e Kosovës dhe rolin që e ka ai në kuadër të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në fund, IML kërkon që stafi i tij mbështetës të këtë statusin e njëjtë në QKUK dhe të instituteve të tjera shëndetësore.

Ankesa nga Administrata e Qendrës Klinike Universitare

91. Administrata e Qendrës Klinike Universitare pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar ulën pozitën administrative aktuale të punonjësve administrativ të QKUK-ShSKUK. Ankuesit pretendojnë se në bazë të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.28, është përcaktuar organizimi administrativ brenda institucioneve publike shëndetësore duke e përcaktuar administratën si shërbim profesional. Po ashtu, neni 62, paragrafi 6, i këtij ligji përcakton se të gjithë të punësuarit e ShSKUK nuk i takojnë shërbimit civil, por janë shërbyes publikë. Ankuesit pretendojnë se Ligji për Pagat në Sektorin Publik, e ka cenuar parimin “pagë e njëjtë për punë të njëjtë”, që ka rezultuar me cenimin e dispozitës Kushtetuese “Barazia para ligjit”. Përfundimisht, ankuesit kërkojnë trajtim të barabartë në mënyrë që të mos diskriminohen në raport me përgjegjësinë dhe punën që kryejnë në Institucionin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në ShSKUK.

Ankesa nga Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë (Oda)

92. Oda pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar thellon hendekun social në Republikën e Kosovës. Më tej, Oda thekson se me Ligjin e kontestuar, infermieret, mamitë dhe profesionistet e tjerë shëndetësorë janë kategorizuar me koeficientin 2.2, pa kurrfarë analize dhe pa marrë parasysh asnjë kriter bazik për këtë kategorizim. Sipas Odes, në këtë rast nuk është marrë parasysh kriteri bazik, ai i shkollimit, kur dihet se në mesin e këtyre të punësuarve ka të punësuar me gradën doktor, me gradën master, baçelor etj. Oda, më tej, thekson se të gjithë punonjësit janë kategorizuar me të njëjtin koeficient. Sipas Odës, me këtë ligj janë cenuar vlerat universale të cilat mbrohet me Kushtetutë, e cila në nenin 7 thekson se rendi kushtetues bazohet në parimin e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë (theks i shtuar), respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të sundimit të ligjit, mosdiskriminimit; të drejtës së pronës, të drejtësisë sociale. Mbi këtë bazë, Ligji i kontestuar konsiderohet se cenon rendë parimin e barazisë, është diskriminues dhe nuk promovon parimet e drejtësisë sociale, por thellon hendekun social në vendin tonë.

Ankesa nga Sindikata e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë

93. Sindikata në fjalë pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar infermieret janë ndarë në tri grupe: grupi i parë me koeficient 2.2 për shërbimin parësor; grupi i dytë me koeficient 2.25 për shërbimin dytësor dhe tretësor; dhe grupi i tretë i fizioterapeutëve me koeficient 3.2, megjithëse e kanë punën, funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë sikurse infermieret, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë. Sindikata konsideron se kjo ndarje është në kundërshtim me parimin e pagës së barabartë të përcaktuar me nenin 3, pika 1.3, të Ligjit të kontestuar, i cili nënkupton që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme. Po ashtu, Sindikata konsideron se ngritja e koeficientit në 3.2. për të gjithë është me rëndësi për të evituar largimin e infermierëve nga Kosova, duke pasur parasysh numrin e madh të tyre që kanë aplikuar për viza pune në shtetet e BE.

Ankesa nga Këshilli Iniciues i Mësimdhënësve nga klasa 1-5

94. Këshilli në fjalë pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar është cenuar parimi “*pagë e njëjtë për punë të njëjtë*”, sepse mësimdhënësit e klasave 1-5 nuk janë trajtuar njëjtë sikurse mësimdhënësit e klasave 6-9. Këshilli pretendon se, sipas shtojcës së Ligjit të kontestuar, mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta 6-9 janë kategorizuar me koeficient 2.45, ndërsa mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta 1-5, janë kategorizuar me koeficient 2.3. Këshilli pretendon se në këtë rast nuk janë marrë parasysh kriteret e njëjta dhe janë trajtuar ndryshe nga mësimdhënësit e klasave 6-9. Këshilli, në fund shpreh pakënaqësinë rreth këtij trajtimi, e po ashtu nuk e di se cilin kriter e kanë marrë për bazë Qeveria dhe Kuvendi në kohen kur e kanë bërë këtë dallim në rregullimin në Ligjin e kontestuar.

Ankesa nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK)

95. RTK pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me përfshirjen në Ligjin e kontestuar është cenuar pavarësia e saj institucionale, editoriale dhe statusi i transmetuesit publik i RTK-së. RTK thekson se, në bazë të Ligjit nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, RTK, në cilësi të transmetuesit publik të Kosovës, ka statusin e institucionit të pavarur publik, i cili ofron shërbime në fushën e veprimtarisë mediale. RTK pohon se ka pasur reagime nga Unioni Evropian për Transmetim (European Broadcasting Union), ku ceket se përfshirja e RTK-se në

Ligjin e kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Ligjin nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, me ç'rast inkurajohen autoritetet e Kosovës ta miratojnë ligjin e ri për RTK-në, për ta siguruar autonominë institucionale dhe editoriale, duke përfshirë autonominë e resurseve njerëzore. RTK përmend epërsinë e Kushtetutës ndaj ligjeve dhe faktin se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës behën pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Në këtë drejtim, RTK i referohet rekomandimit të Këshillit të Evropës No.R(96)10 lidhur me garantimin e pavarësisë së transmetuesit publik. Për më shumë, RTK u referohet edhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë pavarësinë institucionale të Transmetuesve Publik në Evropë, siç janë: Protokolli i Amsterdamit nga 1997, Dokumenti i Këshillit të Evropës CoE 2012/1, Vlerat e Standardet të EBU-së lidhur me pavarësinë institucionale dhe editoriale të Transmetuesit Publik.

Ankesa nga Sindikata e Re e Korporatës Energjetike të Kosovës

96. Sindikata në fjalë pretendoi, para Avokatit të Popullit, se puna e punëtoreve të KEK-ut dallon nga puna e shërbyesve civilë sepse punëtorët e KEK-ut punojnë në kushte shumë të vështira, gjë që reflektohet në gjendjen e tyre shëndetësore dhe në faktin se një numër i konsiderueshëm i punëtorëve vdesin pa arritur moshën e pensionimit. Sipas Sindikatës në fjalë, Ligji i kontestuar cenon ekonominë e tregut të lirë dhe nuk përputhet me Ligjin e Punës. Sindikata, përfundimisht kërkon që të merret parasysh rrezikshmëria e veprimtarisë së KEK-ut, dhe pasi që KEK-u është kompania më fitimprurëse në vend, të hiqet nga fushëveprimi i Ligjit të kontestuar dhe të veprojë si e pavarur.

Ankesa nga Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT sh.a.

97. KOSTT pretendoi, para Avokatit të Popullit, se neni 27 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën, duke kërkuar përjashtimin e ndërmarrjes publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu -KOSTT sh.a., nga fushëveprimi i këtij ligji. Po ashtu, KOSTT rikujton parimin e ekonomisë së tregut të lirë të shprehur në nenin 10 dhe në nenin 119 të Kushtetutës, të reflektuar në Ligjin nr.03/L-048, për Ndërmarrjet Publike. Po ashtu, KOSTT rikujton parimet e mëvetësisë dhe të autonomisë së ndërmarrjeve publike, në aspektin e organizimit ligjor, të vendimmarrjes, të zbatimit të parimit të ligjshmërisë dhe funksionit mbikëqyrës të veprimtarisë së ndërmarrjeve publike nga autoritetet përkatëse rregullatore, siç, është shprehur në nenin 119 të Kushtetutës. KOSTT thekson se nocionet e pavarësisë së ndërmarrjeve publike, në pajtim me Kushtetutën, janë

shprehur në Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, ku behet dallimi ndërmjet ndërmarrjeve publike autonome, siç është KOSTT-i dhe ndërmarrjeve e agjencive të tjera. KOSTT konsideron se kufizimi i pagës (faktorëve të koeficientit) për ndërmarrjet publike, sipas nenit 27 të Ligjit të kontestuar, kufizon dhe pamundëson ofrimin e stimulimit ekonomik dhe motivues për punonjësit e ndërmarrjeve publike në Kosovë, dhe si i tillë është në kundërshtim me Kushtetutën. Për me tepër, KOSTT mëton se neni 27 i Ligjit të kontestuar drejtpërdrejt cenon pavarësinë financiare të KOSTT-it në përcaktimin e pagave për punonjësit e vet. Në këtë mënyrë, KOSTT konsideron se kufizohet pasja në dispozicion e resurseve njerëzore të saj për t'i përmbushur detyrat dhe obligimet ligjore të dhëna me Ligjin nr.05/L-081 për Energji Elektrike dhe për t'i zbatuar obligimet e Republikës së Kosovës sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. KOSTT shpreh brengën se me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar do të përballë me ikjen e stafit të saj, sepse pagat e punonjësve të KOSTT-it do të zvogëlohen për 47 %, dhe KOSTT nuk do të jetë në gjendje të ofrojë kompensime motivuese për stafin. KOSTT thekson se duhet të ketë personel të veçantë për t'i përmbushur kërkesat specifike teknike dhe operative, dhe personeli i kësaj kompanie duhet të jetë me i kualifikuar sesa ne kompanitë e tjera në sektorin e energjisë. Kjo për arsye se duhet vazhdimisht ndërveprim me operatorët e sistemeve të transmissioinit të vendeve të tjera, si dhe me rregullatorët.

Ankesa nga Sindikata e Pavarur e KOSTT-it

98. Sindikata e Pavarur e KOSTT-it pretendoi, para Avokatit të Popullit, se është kompania e vetme në Kosovë, e cila merret me menaxhimin e linjave të tensionit të lartë, prandaj puna e saj është shumë specifike dhe me përgjegjësi të madhe. Për të kryer punën në tregun e energjisë, KOSTT ka nevojë për staf të trajnuar dhe me përvojë. Sipas Sindikatës së Pavarur të KOSTT-it, përfshirja e KOSTT-it në Ligjin e kontestuar cenon pavarësinë financiare të KOSTT-it dhe paraqet rrezik për largimin e stafit profesional nga KOSTT. Sindikata e Pavarur e KOSTT-it konsideron se punëtorët e KOSTT-it nuk janë shërbyes civilë, pasi që KOSTT ka pavarësi financiare.

Ankesa nga Federata Sindikale e Pavarur e Postes dhe Telekomunikacionit të Kosovës

99. Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës pretendoi, para Avokatit të Popullit, se neni 27 i Ligjit të kontestuar do të godasë me së shumti Telekomin e Kosovës, që përbëhet nga inxhinierë, juristë, ekonomistë dhe teknikë specialistë.

Po ashtu, ankuesja pretendon se Telekom i Kosovës nuk financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, por përmes biznes-planit që planifikon në baza vjetore bazuar në të hyrat vetanake dhe rritjes në tregun e telekomunikacionit.

Ankesa nga Agjencia e Shqipërisë së Informacionit në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike (TIK)

100. Ankuesja pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Qeveria deri më tani ka trajtuar ndaras pozitat në fushën e TIK-ut, mirëpo me Ligjin e kontestuar nuk është bërë kategorizimi për fushën e TIK-ut. Më tej, ankuesja thekson se kjo agjenci në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike është institucion përgjegjës në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit TIK, e cila përben bazë të zhvillimit për të gjitha sferat e tjera, p.sh. arsimi, shëndetësia, ekonomia, bujqësia.

Ankesa nga Veton Çoçaj – certifikues

101. Z. Çoçaj pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar nuk është hartuar mbi parimin “*punë e njëjte, pagë e njëjtë*”. Në këtë drejtim ai thekson se në Kuvendin e Republikës së Kosovës pozita certifikues është trajtuar si pozite e veçantë dhe është klasifikuar me koeficientin 4.2, ndërsa në institucionet e tjera, ministri dhe agjenci, pozita e certifikuesit nuk figuron fare, por është e kategorizuar si kuadër ekzekutiv profesional dhe është klasifikuar me koeficientin 2.35. Më tej, z. Çoçaj pretendon se ngarkesat e punës janë më të mëdha në ministri sesa në Kuvend dhe, sipas këtij arsyetimi, kërkon që të ketë trajtim të barabartë për të gjithë certifikuesit në Republikën e Kosovës.

Ankesa nga Pajtim Zogaj, inspektor në Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore

102. Z. Zogaj pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar është cenuar parimi “*pagë e njëjtë për punë të njëjte*”, e po ashtu është cenuar neni 23 i DUDNJ. Me konkretisht, ankuesi specifikon se me Ligjin e kontestuar është rregulluar edhe çështja e shtesave mbi pagën bazë, e cila u takon zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës, inspektorëve hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit, mirëpo e njëjta shtesë nuk është paraparë edhe për inspektorët e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, edhe pse natyra e punës është e njëjtë me subjektet e theksuar me sipër. Ankuesi, më tej, pretendon se në baze të këtij përcaktimi inspektorët e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore janë

diskriminuar dhe janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga dispozitat e Ligjit të kontestuar.

Ankesa e psikologëve dhe e pedagogëve të shkollave

103. Ankuesit pretenduan, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar i trajton ata në mënyrë të pabarabartë, në krahasim me pedagogët dhe me psikologët e shkollave speciale. Ankuesit theksojnë se me këtë ligj nuk është respektuar parimi i *"pagës së njëjtë për punë të njëjta"*. Ata pretendojnë se pozicionimi i tyre do duhej të ishte i ngjashëm me mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, me koeficient 2.6, ose me mësimdhënësit e shkollave speciale, me koeficient 2.5. Më tej, ankuesit theksojnë se psikologët klinikë në klinikën e QKUK-së kanë të njëjtin kualifikim dhe janë kategorizuar me koeficient 3.5. Ata theksojnë se, edhe në këtë rast, ligji ka diskriminuar ankuesit, sepse edhe ata ofrojnë shërbime të njëjta psikosociale ndaj njerëzve në nevojë. Ankuesit po ashtu pohojnë se mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta janë kategorizuar me koeficient 2.6 (grada master), pedagogët specialë dhe mësimdhënësit e shkollave speciale janë kualifikuar me koeficient 2.5 (grada master), mësimdhënësit në nivelin klasor 6 - 9 janë kualifikuar me koeficient 2.45 (grada baçelor deri në 240 kredi), mësimdhënësit e nivelit klasor 1 - 5 janë kualifikuar me koeficient 2.3 (grada baçelor deri në 180 kredi), ndërsa psikologu i shkollës është kualifikuar me koeficient 2.3 (grada master). Ky përcaktim, sipas ankuesve, paraqet qartë trajtimin e pabarabartë të psikologëve dhe të pedagogëve në shkolla. Prandaj, bazuar në argumentet e paraqitura më sipër, ankuesit (psikologët dhe pedagogët) kërkojnë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminues me Ligjin e kontestuar, si dhe të respektohet parimi *"pagë e njëjtë për punë të njëjtë"*, parim ky i cili aktualisht nuk është marrë parasysh me këtë ligj.

Ankesa nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Auditorët e Brendshëm nga niveli qendror dhe lokal

104. Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Auditorët e Brendshëm nga niveli qendror dhe lokal pretenduan, para Avokatit të Popullit, se nuk janë të përfshirë në Ligjin e kontestuar, mirëpo përcaktimi i statusit dhe i pagave të tyre pritet të bëhet me një akt nënligjor, i cili do miratohet nga Qeveria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ankuesit shfaqin shqetësimin e tyre se një veprim i tillë ka rrezik ta cenojë sigurinë e tyre juridike si dhe qëndrueshmërinë financiare të auditorëve të brendshëm. Ankuesit theksojnë se fakti se me ligjin e

kontestuar nuk është rregulluar pozicioni dhe paga e auditorëve të brendshëm, dëshmon se ky ligj nuk ka respektuar barazinë para ligjit, sepse e ka lenë mundësinë që për disa pozita, siç është pozita e auditorëve të brendshëm, të rregullohet me akt nënligjor, përkatësisht me udhëzim administrativ i cili ka mundësi të ndryshohet me një procedurë të shkurtër dhe të shpejtë tregon se siguria juridike e auditorëve të brendshëm nuk është e njëjtë sikurse siguria juridike e pozitave që janë përcaktuar me Ligjin e kontestuar. Po ashtu, ankuesit pretendojnë se pozicionimi i tyre në Ligjin e kontestuar do të këtë ndikim në përcaktimin e statusit të tyre dhe të pagës së tyre në nivel ligji. Lidhur me këtë, ankuesit theksojnë se Ligji i kontestuar nuk ka marrë parasysh fare dispozitat e Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, i cili në nenin 23, paragrafi 2, përcakton qartë: *“Paga e stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe e Njësive të Auditimit të Brendshëm trajtohen në mënyrë të veçantë dhe duhet të jenë të harmonizuara me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.”* Prandaj, duke pasur parasysh gjithë këtë, ankuesit pretendojnë se është esenciale për funksionimin e tyre që pozicioni i tyre të jetë i përcaktuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, dhe pozicionimi i tyre të bëhet duke pasur parasysh në tërësi nenin 23, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, sipas të cilit, pagat e stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe e njësive të Auditimit të brendshëm trajtohen në mënyrë të veçantë dhe duhet të jenë të harmonizuara me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ankesa nga profesionistët shëndetësorë/mjekët e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH)

105. Ankuesit theksuan, para Avokatit të Popullit, se në kuadër të profesionistëve shëndetësorë janë mjekë, stomatologë të punësuar në MSH. Sipas pretendimeve të tyre përcaktimet aktuale me Ligjin e kontestuar i vë ata në kategorizim të njëjtë me shërbyesit civilë dhe nuk u njihet shkollimi universitar dhe specialistik gjatë llogaritjes së pagës. Ankuesit konsiderojnë se janë të diskriminuar nga e drejta për pagë të dinjitetshme, sipas arritjeve profesionale dhe shërbimeve të cilat i ofrojnë. Më tej, ankuesit theksojnë se për t'u punësuar në MSH është dashur të plotësohen disa kriterë, si shkollimi nga lëmi i mjekësisë, si dhe licencimi si punëtorë shëndetësorë dhe si rrjedhojë e kësaj, të njëjtët në pozitat që i mbajnë në MSH nuk i përkasin shërbyesve civilë sipas Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (neni 4. paragrafi 1), por kategorizohen si staf mjekësor të sistemit shëndetësor. Ankuesit pohojnë se kjo fryme nuk është bartur në Ligjin e kontestuar sepse ata janë kategorizuar si shërbyes civilë. Në vazhdim, ankuesit theksojnë se sipas Ligjit nr. 04/L-125 për

Shëndetësi, neni 69, profesionist shëndetësor konsiderohet doktori i mjekësisë, doktori i stomatologjisë dhe farmacist i diplomuar. Pretendimet e tyre ankuesit i bazojnë në mendimet e organizatës botërore të shëndetësisë, sipas të cilave, sistemi shëndetësor përbehet nga organizatat, nga njerëzit dhe nga veprimet qëllimi primar i të cilëve është promovimi, rikthimi dhe ruajtja e shëndetit, e sipas Bankës Botërore, konstatohet se sistemi shëndetësor nuk përbëhet vetëm nga institucionet shëndetësore, por edhe nga MSH, nga financuesit shëndetësorë dhe nga organizata të tjera. Ankuesit, përfundimisht pretendojnë se përcaktimi aktual në Ligjin e kontestuar i diskriminon ata nga e drejta e pagës si mjekë specialistë, me koeficient 5, sepse i rendit si shërbyes civilë me një koeficient shumë më të ulët, duke mos ua llogaritur shkollimin universitar dhe specialistik.

Ankesa nga stafi i inxhinierëve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP-it)

106. Ankuesit pretenduan, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar, stafi i ARKEP-it nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë sikurse institucionet e tjera. Lidhur me këtë, ata theksojnë se inxhinierët në disa institucione të tjera, si Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA), janë kategorizuar me koeficient shumë më të lartë sesa inxhinierët e ARKEP-it. Sipas tyre, kjo formë e kategorizimit është e pabarabartë, sepse inxhinierët e këtyre institucioneve i sjellë në pozicione jo të barabarta, e kur kësaj i shtohet fakti se inxhinierët e AAC-së dhe të AShNA-s autorizohen nga ARKEP-i për shfrytëzimin e resurseve për komunikimet elektronike, që është shumë vitale për fushën e aviacionit civil dhe navigimit ajror, e po ashtu realizon matje radio-monitoruese për identifikimin e interferencave, shfaqja e të cilave mund ta rrezikojë sigurinë e komunikimit. Për këtë arsye ata pretendojnë se duhet të pozicionohen tek pozicioni “Ekspert 2”, me koeficient 5.5 dhe “Ekspert 3”, me koeficient 4.

Ankesa nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARrU)

107. ARrU, pretendoi, para Avokatit të Popullit, se me Ligjin e kontestuar, kadri profesional dhe nëpunësit e ARrU-së janë kategorizuar në nivel të njëjtë me nivelin e shërbyesve civilë. Ata theksojnë se, duke pasur parasysh natyrën specifike të punës dhe përshkrimin e detyrave të punës të njëjtit nuk mund të harmonizohet me pozita të njëjta në sektorin e shërbimit publik. Ankuesi shpreh shqetësimin e tij se me përcaktimin aktual të Ligjit të kontestuar, ka rrezik që të largohet kadri profesional nga ARrU dhe të reflektojë dëmshëm për

institucionin. ARrU, më tej, thekson se aktualisht pagat e kuadrit të ARrU-së janë në nivel me të ulët se pagat e pozitive ekuivalente të ofruesve të shërbimeve të cilat rregullohen dhe mbikëqyren nga ARrU. Prandaj, kategorizimi i punonjësve të ARrU-së, sipas ankuesit në nivel me shërbyesit civile do ta thellonte akoma më shumë këtë dallim, gjë që ndikon në zhvlerësimin e punës dhe të autoritetit të stafit të ARrU-së, ndaj ofruesve të shërbimeve. Në fund, ankuesi pretendon se në të gjitha vendet punonjësit e rregullatorëve në aspektin e pagave qëndrojnë me lart se institucionet që i rregullojnë, gjë që nuk është në Kosovë dhe ky dallim me këtë ligj do të jetë shumë më i madh.

Ankesa nga Sindikata e Universitetit të Prishtinës (UP)

108. Sindikata e UP-së, pretendoi, para Avokatit të Popullit, se Ligji i kontestuar është diskriminues dhe nuk e ka përfshirë premtimin publik për rritje lineare në vlerën prej 70 eurosh për të gjithë punëtorët e administratës së UP-së. Sipas Sindikatës së UP-së me Ligjin e kontestuar, disa pozitive kryesore në UP, iu ulen pagat, për çfarë sindikata konsideron se kjo është kundër kushtetuese e po ashtu diskriminuese, sepse një e drejtë e fituar nuk mund të mohohet në këtë formë. Sindikata e UP-së për këtë çështje i referohen Ligjit nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 28, ku thuhet: *“Nëpunësit civilë, paga bazë e të cilëve pas zbatimit të këtij ligji është me e vogël se paga bazë e tyre ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ruajnë pagën e tyre ekzistuese bazë deri në kohen kur paga e tyre bazë të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat që kanë të bëjnë me klasifikimin e përgjithshëm të pozicioneve të punës në Shërbimin Civil, si dhe me standardet dhe procedurat për klasifikimin e secilës pozitë në gradën përkatëse.”* Më tej, kjo sindikatë pretendon se me Ligjin e kontestuar nuk janë caktuar titujt dhe koeficientet për administratën e UP-së dhe kjo mund të sjellë diskriminim në rast të gradimit të këtyre koeficienteve dhe pozitive nga Komisionet *ad-hoc* nga Qeveria. Po ashtu, sindikata thekson se me këtë ligj nuk është përcaktuar përqindja e pagesës për honorar (mbinormë), e që është specifike në rastet e universiteteve. Sindikata e UP-së, më tej, pretendon se parimet kryesore për miratimit të këtij ligji kane qenë: parimi i *“barazisë”*, parimi i *“pagës së njëjte për punë të njëjta”* dhe parimi i *“mosdiskriminimit”*. Lidhur me këtë çështje, Sindikata e UP-së thekson se asnjëri nga këto parime në rastin e UP-së nuk është respektuar dhe nuk është marrë parasysh. Për më tepër, sindikata e UP-së pretendon se ky ligj ka krijuar pabarazi ndërmjet punonjësve të UP-së dhe institucioneve të tjera. Për këtë e njëjta ka marrë shembull rastin e certifikuesit në Kuvendit, i cili është përcaktuar me koeficient 4.2, ndërsa në institucionet e tjera kjo pozitë është certifikuar dukshëm me ulët, pavarësisht faktit se kanë buxhet

shumë më të lartë. Më tej, Sindikata e UP-së pretendon se pabarazia është shfaqur edhe në rastet, si p.sh. vozitësi në kabinete politike është përcaktuar me koeficient 2.2, ndërsa zyrtarët administrativë në UP (që mund të kenë gradën master apo doktor), mund ta kenë koeficientin më së shumti 2.35. Më tej, pozita e asistentit administrativ dhe e asistentit teknik në Kuvend ka koeficient 2.8, ndërsa ekuivalent me këtë pozitë apo koeficient në administratën e shërbimeve publike është pozita e udhëheqësit të divizionit (Drejtnes i ulët 2). Kjo sindikatë, duke u bazuar në argumentet e paraqitura me sipër, nga Avokati i Popullit ka kërkuar që ta iniciojë në Gjykatën Kushtetuese vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit të kontestuar, sepse ky ligj sipas saj është i pabarabartë, nuk e ka arritur qëllimin e pagës së njëjtë për punën e njëjtë dhe ka rezultuar me diskriminim ndërmjet punonjësve në institucionet e Republikës së Kosovës.

Kërkesat përfundimtare të parashtruesit të kërkesës drejtuar Gjykatës

109. Së pari, Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës kërkoj nga Gjykata që të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, duke konstatuar që i njëjti, ndër të tjera: (i) nuk pasqyron parimin e ndarjes së pushteteve, kontrollit e balancimit mes tyre, sikurse që është përcaktuar me Kushtetutë; (ii) nuk mundëson pagë të barabartë për punë të barabartë për të gjithë të punësuarit në sektorin publik, sipas hierarkisë kushtetuese, përgjegjësisë institucionale dhe ndërlikueshmërisë në punë; (iii) cenon të drejtën e pronës; (iv) nuk reflekton parimet e përcaktuara të vet Ligjit të kontestuar në të gjitha dispozitat dhe Shtojcën 1 të tij.
110. Së dyti, Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës kërkoj që, për sa i takon 35 ankesave individuale të institucioneve dhe subjekteve të ndryshme të dorëzuara tek ai e ku janë ngritur pretendime për jo-kushtetutshmëri të Ligjit për Pagat, Gjykata “të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar prek interesat legjitime të këtyre ankuesve.”

Komentet e dorëzuara nga MAP si përgjigje ndaj pretendimeve të Avokatit të Popullit

111. MAP, në cilësi të Ministrisë që kishte propozuar Ligjin e kontestuar i cili më pas ishte miratuar nga Qeveria dhe votuar nga Kuvendi, ka dorëzuar komente përkitazi me çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit në kërkesën e tij, respektivisht për ndarjen e pushteteve; sundimin e ligjit, barazinë para ligjit; të drejtën e pronës dhe ndërmarrjet publike. MAP gjithashtu ka paraqitur edhe komente

specifike në lidhje me disa nga 35 ankesat individuale të cilat ishin dorëzuara pranë Avokatit të Popullit nga institucione dhe subjekte të ndryshme të interesuara për statusin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar. Të gjitha komentet e MAP, përfshi edhe ato për ankesat individuale, Gjykata do t'i paraqesë në vijim.

Komentet përkitazi me “ndarjen e pushteteve”

112. Sa i përket cenimit të ndarjes së pushteteve, kontrollit e balancimit mes tyre, MAP argumenton se pretendimi kryesor i Avokatit të Popullit është se Ligji i kontestuar duhet të kishte parasysh këtë parim edhe sa i përket pagave si për nga aspekti hierarkik ashtu edhe operues. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk e ka bërë të ditur se si duhej të rregullohej çështja e pagave duke u bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe nuk ka dhënë asnjë indikacion të vetëm se ku është bërë shkelja e Kushtetutës me Ligjin e kontestuar për cilin është cenuar parimi i ndarjes së pushteteve. Në përgjithësi si shkelje paraqiten rregullimi i njëjtë për të gjitha degët e pushtetit dhe veshja e Qeverisë me autorizime për të rregulluar me akte nënligjore disa procedura sa i përket pagës dhe shtesave në page. Në lidhje me këtë çështje kemi dhënë përgjigje edhe në shkresën nr. 3664 të 29 nëntorit 2019 për Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.
113. Pretendimi se cenimi i parimit të ndarjes së pushtetit, kontrollit dhe balancimit të tyre është bërë me Ligjin për Paga për shkak se i njëjti nuk ka marrë parasysh rregullimet e veçanta sa i përket të drejtave dhe detyrave që bëjnë ligjet e veçanta të shumë institucioneve, sidomos të ligjeve që rregullojnë Institucionet e Pavarura - është shumë i gjerë dhe nuk kufizohet vetëm në të drejtën e pagës dhe si i tillë nuk është i vërtetë. Kjo vërehet më së miri tek vet ligjet e veçanta për Institucionet e pavarura, për shembull: Ligji nr. 05/L-O 19 për Avokatin e Popullit, në nenin 34 në mënyrë precize përcakton *“Pagat në Institucionin e Avokatit të Popullit rregullohen sipas ligjit përkatës për Pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës”*; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në nenin 13 për pagat e Këshilltarëve juridike përcakton *“[...] Pagat e këshilltareve juridik caktohen në pajtim me legjislacionin në fuqi”*, ndërsa nenin 15 për pagat e Gjyqtareve përcakton *“Paga e gjyqtareve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtareve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”*; Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave në paragrafin 4 të nenit 45 përcakton *“Niveli i kompensimit të kryetarit dhe anëtareve të KPM-së dhe anëtareve të Bordit për Ankesa, caktohet në pajtim me Ligjin për pagat e zyrtareve të lartë”*, ndërsa që nuk ka asnjë dispozite tjetër për pagat e personelit tjetër në KPM; Ligji Nr.05/L-055 për Auditorin e

Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në paragrafin 7 të nenit 4 përcakton *“Niveli i pagës së Auditorit të Përgjithshëm, caktohet me Ligjin përkatës që rregullon pagat e funksionareve të lartë publike”* dhe nuk ka asnjë dispozite tjetër që rregullon pagat për personelin tjetër në këtë institucion. Pra të gjitha këto ligje, sipas MAP, jo që nuk kanë ndonjë dispozite specifike siç pretendohet, por përkundrazi referojnë se çështja e pagave duhet të rregullohet me një ligj për pagat e në këtë rast është Ligji i kontestuar i cili është miratuar nga Kuvendi. Ligji i veçantë siç pretendojnë ankuesit nuk janë ligjet e tyre sepse ato rregullojnë themelimin, organizimin dhe funksionimin e institucioneve të tyre si institucione të pavarura. Ligj për paga deri më tani si ligj i veçantë që i rregullon pagat e të punësuarve në institucionet e Republikës së Kosovës përveç Ligjit nr.03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë - nuk ka pasur në sistemin ligjor të Kosovës. Pra, Ligji i kontestuar është i vetmi ligj i veçantë që i rregullon pagat e të gjithë të punësuarve në institucionet e Republikës së Kosovës.

114. Në anën tjetër Ligji i kontestuar njëjtë sikurse ligjet e tjera horizontale kanë për qëllim rregullimin e menaxhimit të parasë publike (Ligji për prokurimin publik, Ligji për menaxhimin e financave publike që asnjëherë nuk janë kontestuar deri me tash) ka për qëllim të rregullojë sistemin e pagave dhe shpërblimeve për funksionarët dhe zyrtarët publikë të cilët paguhet nga buxheti i Kosovës. Sa i përket referencës dhe ngjashmërisë me rastin KO73/16, MAP thekson se ky rast nuk mund të merret si rast i njëjtë me kërkesën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar. Kjo për faktin se objekt shqyrtimi në rastin KO73/16 ka qenë vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga MAP e jo një ligj i miratuar nga Kuvendi i cili *“në mënyrë homogjene ka për qëllim të vendos rregulla për menaxhimin e parasë publike sa i përket pagave të funksionareve dhe zyrtareve publik”*.
115. Sa i përket ndarjes së pushteteve, rikujtojmë se thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës nga parashtuesi i kërkesës është nëse Ligji i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën. Neni 4 i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes, ndarjen e pushtetit, në mes tri pushteteve të qeverisjes dhe kontrollin e balancimit përkatës në mes tyre. Në këtë aspekt, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Kushtetuta përcakton që Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ (neni 4.2), dhe rrjedhimisht nxjerr ligje, e në çështjen e ngritur ka ushtruar mandatin e vet kushtetues duke nxjerrë Ligjin e kontestuar. Përndryshe ligji, si akt i përgjithshëm juridik që rregullon marrëdhëniet e caktuara shoqërore është i kufizuar në hapësirë dhe kohë. Në sistemin juridik të vendit ka nevojë për nxjerrjen e ligjeve të

reja, për ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese. Prandaj, nuk ka pengesa kushtetuese dhe ligjore, për qëllim të interesit publik parësor që me legjislacionin e ri të rregullohet mjedisi ligjor për pagat në sektorin publik. Në pajtim edhe me praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është brenda fushëveprimit të Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga ligjvënësi. Parimi i ndarjes së pushteteve e obligon Gjykatën që të respektojë përcaktimin e politikave nga ligjvënësi. Ligjvënësi, respektivisht Kuvendi, për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik është në pozitë me të mirë se sa Gjykata për të përcaktuar dhe avancuar politikat ekonomike dhe sociale të vendit (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Duboka dhe Krejzova kundër Republikës Çeke* kërkesat nr. 28859/11 dhe 28473/12, Aktgjykim i 15 nëntorit 2016, paragrafi 175 dhe referencat e përmendura aty).

116. Në nenin 4 të Kushtetutës është sanksionuar një prej elementeve më të qenësishëm të parimit të shtetit të së drejtës, për të cilin bëhet fjalë që në preambulën e Kushtetutës. Në demokraci, si formë e qeverisjes, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një seri ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta i krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Vendimi nr. 19, i 3 majit 2007, V-19/07).
117. MAP me tej thekson se parashtruesi *inter alia* pretendon se Ligji i kontestuar aplikon kritere të njëjta për autoritetet, për institucionet dhe për organet në Republikën e Kosovës, pa marrë parasysh rendin dhe ndarjen e pushteteve në pajtim me Kushtetutën dhe specifikën e statusit kushtetues të subjekteve të sektorit publik. Në këtë aspekt të kontestimit, vlerësojmë se parashtruesi nuk ka paraqitur se cilat kritere janë të njëjta në Ligjin e kontestuar dhe rrjedhimisht po të “*aplikoheshin kriteret jo të njëjta*” konsiderojmë se do të bëhej fjalë për diskriminim apo trajtim jo të barabartë. Në këtë pikë konsiderojmë se Avokati i Popullit ka dështuar të dëshmojë para Gjykatës së për cilat kritere e ka fjalën, duke anashkaluar autoritetin që i është dhënë me Kushtetutë për nxjerrë edhe ligje të veçanta që i rregullojnë pagat e punonjësve në dy degët tjera të pushtetit dhe të

institucioneve të pavarura kushtetuese (Shih, Opinioni i Komisionit të Venecias nr. 598/2010 - Amicus curiae brief për Gjykatën Kushtetuese të “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” për ndryshimet në disa ligje në lidhje me sistemin e pagave dhe shpërblimet e zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar (Miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e 85-të plenar, Venecia, 17-18 dhjetor 2010). Rekomandimi (94) 12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës thotë se pagat e shtesat gjyqësore duhet të garantohen me ligj (parimi 1.2b.ii). Për me shumë në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, pika 9.1, thuhet: Gjykata Kushtetuese thekson se realizimi i parimit të shtetit të së drejtës, si një nga vlerat më të larta të rendit kushtetues të Republikës së Kroacisë dhe bazës për interpretimin e Kushtetutës është e paimagjinueshme pa një gjyqësor të pavarur. Kushtetuta i ka kushtuar rendësi organizimit të pushtetit shtetëror, në përputhje me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve (në legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv) të përshkruar me nenin 4 të Kushtetutës, dhe garanton autonominë dhe pavarësinë e gjyqësorit (neni 115, paragrafi 2 i Kushtetutës).

118. Sidoqoftë, sipas MAP-it Kushtetuta nuk parashikon se si do të përcaktohen pagat për gjyqtarët (ose për ndonjë institucion tjetër), as elementet që e përbejnë pagën. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë në vendimin për papranueshmëri të kërkesës, lidhur me Ligjin për Pagat në shërbimet Publike nr. U-I-1489/2001, U-I-1490/2001, U-I-1570/2001, U-I-1571/2001 të 20 shkurtit 2002, kishte nënvizuar në pikën 13 se ligji për pagat është një *lex specialis* dhe ligjvënësi është i autorizuar që të përcaktojë rrethin e zyrtarëve ndaj të cilëve zbatohet ligji. Gjykata kishte konsideruar të domosdoshme të theksojë në mënyrë të veçantë që Parlamenti Kroat është i autorizuar të vendosë në mënyrë të pavarur rregullimin e marrëdhënieve ekonomike, juridike dhe politike në Republikën e Kroacisë, përfshirë ato që lidhen me rregullimin e pagave. Sidoqoftë, në rregullimin e këtyre marrëdhënieve, ligjvënësi është i detyruar të respektojë kërkesat e përcaktuara me Kushtetutë, veçanërisht ato që rrjedhin nga parimet e sundimit të ligjit dhe ato që mbrojnë vlerat kushtetuese. Kur bëhet fjalë për garancitë e pavarësisë materiale të gjyqtareve, legjislativi është veçanërisht i detyruar të respektojë parimin themelor kushtetues të ndarjes së pushteteve si një nga elementet e shtetit të së drejtës. Këtë e parasheh edhe vendosja e gjyqtareve në nivelin më të lartë në Shtojcën nr. 1 të Ligjit të kontestuar, edhe sa i përket vet parashtruesit të kërkesës, ku pozitën e tij ligjvënësi e ka pasur parasysh (dhe të Auditorit të Përgjithshëm) dhe e ka vendosur në nivelin më të lartë të hierarkisë shtetërore, duke u bazuar në Opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me pozitën e Avokatit të Popullit në hierarkinë shtetërore. (Shih: Opinioni në Draft-ligjin për

Amandamente në Ligjin e Ombudspersonit për të Drejtat e Njeriut në Bosnie dhe Hercegovinë, miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 60-të, Venecia 8-9 tetor 2004).

119. Përfundimisht, MAP lidhur me pretendimin e parashtruesit për ndarjen e pushteteve thekson se, përderisa parimi i ndarjes së pushtetit përcakton pavarësinë e tri pushteteve të qeverisjes, parimi i kontroleve dhe balancimeve përcakton ndërvlerësinë e tyre. Të tri pushtetet e qeverisjes nuk mund të veprojnë në izolim prej njëra-tjetrës. Ndërvlerësia e tyre, përpos dispozitave kushtetuese, gjithashtu definohet nëpërmjet parimeve të bashkëpunimit, bashkërendimit, kontrollimit dhe balancimit. Të tri pushtetet e qeverisjes mbështetën në njëra tjetrën për të siguruar totalin e shërbimeve publike të nevojshme në një shoqëri demokratike. Këtë e potencojnë edhe komentet kryesore të pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias (paragrafët 62 deri 73 të Aktgjykimit KO12/18, shih, parashtrues Albulena haxhiu dhe 30 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, *“Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.04/20, të 20 dhjetorit 2017”*, Aktgjykim i 29 majit 2018-në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KO12/18), shkojnë në drejtim të theksimit që *“çështja e pagave në sektorin publik rregullohet me ligje”* (paragrafi 99 i Aktgjykimit KO12/18). Ligjet përkatëse nënkupton të miratuara nga Kuvendet jo nga Qeveritë. Më tutje, kompensimi financiar për pushtetin e gjyqësorit, si një aspekt esencial i pavarësisë së gjyqësorit, duhet të rregullohet nga ana e pushtetit legjislativ përmes një procedure demokratike parlamentare.
120. Në këtë aspekt, MAP thekson se Gjykata Kushtetuese e Kroacisë në praktikën e saj nuk ka kontestuar nxjerrjen e ligjit për paga për gjyqësorin, duke shqyrtuar kushtetutshmërinë e Ligjit për Pagat e Gjyqtarëve dhe punonjësve gjyqësorë. Ndërmjet tjerash ka konstatuar se: *“Rrjedhimisht, një kusht rrjedh nga Kushtetuta që të gjitha elementet e pagave të gjyqësorit duhet të rregullohen nga ligjvënësi në ligjin e saj të miratuar në një procedurë parlamentare demokratike [...]”*. Edhe pagat në institucionet e pavarura janë të rregulluara me ligje të miratuara nga organi ligjvënës, si për shembull në Shqipëri, Ligji për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve tjera të krijuara me ligje (Shih, vendimin nr. 19/07 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, datë 03 majit 2007). Vlen të nënvizohet, sipas MAP, se në rastin *Centro Europa 7 S.R.L. dhe Di Stefano vs Italia* (shih rastin e GJEDNJ-së *Centro Europa 7 S.R.L. and Di Stefano kundër Italisë*, kërkesë nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012), GJEDNJ mori qëndrim se niveli i saktësisë së ligjit në çdo rast nuk mund të mbulojë të gjitha mundësitë dhe varet nga përmbajtja e atij ligji, materies që

mbulon dhe statusit të cilit i referohet. Nga kjo rezulton se ligji duhet në mënyrë të mjaftueshme të rregulloje ato raporte – e që, sipas MAP, Ligji i kontestuar i ka këto elemente në mënyrë të pakontestueshme.

Komentet përkitazi me “sundimin e ligjit”

121. Ne lidhje me sundimin e ligjit MAP argumenton se nevoja e ndryshimit të Ligjit të kontestuar është përmendur në shumë ankesa të parashtruara të parashtruesi i kërkesës. Në lidhje me parimet e sundimit të ligjit sipas Komisionit të Venecias (shih pikën 78, fq. 19 – Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit CDL-AD (2016)007, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën plenare të 106-të, Venecia, 11-12 mars 2016, në tekstin e mëtejshëm: Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit), sundimi i ligjit kërkon nënshkrimin universal të të gjithëve ndaj ligjit. Ai nënkupton që ligji duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë dhe të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme. Barazia nuk është thjesht një kriter zyrtar, por duhet të rezultojë në një trajtim thelbësisht të barabartë. Për të arritur këtë qëllim, diferencimet mund të duhet të tolerohen dhe madje mund të kërkojnë. Për shembull, veprimi pohues mund të jetë një mënyrë për të siguruar barazi thelbësore në rrethana të kufizuara në mënyrë që të korrigjojë disavantazhin ose përjashtimin e së kaluarës. Në këtë pikë, MAP konsideron se Avokati i Popullit në kërkesën para Gjykatës Kushtetuese nuk ka dëshmuar se Ligji i kontestuar nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit, gjë që dëshmon se ka dështuar të specifikojë kërkesën e tij sipas nenit 29.3 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Komentet përkitazi me “barazinë para ligjit”

122. Sa i përket çështjes së dytë, e cila më së shumti ka të bëjë me barazinë para ligjit, MAP argumenton se, parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar nuk ka siguruar pagë të njëjtë për punën e njëjtë duke krijuar situata divergjente sepse në institucione të ndryshme pozita të njëjta ose të krahasueshme janë vlerësuar me nivele të ndryshme të pagës. Është e vërtetë që njeri ndër parimet e Ligjit të kontestuar është edhe parimi “pagë e njëjtë për punën e njëjtë”, i cili është mishëruar gjatë gjetjes së ekuivalencës së pagës për funksionet dhe pozitat që janë paraqitur në Shtojcën nr. 1 të Ligjit të kontestuar. Dallimet dhe diskriminimi i ligjshëm është vendosur vetëm në kuptim të sigurimit sa më efektiv të pagave bazuar në ndarjen e pushtetit.
123. Sa i përket diskriminimit MAP thekson se ai ka ekzistuar deri në miratimin e Ligjit të kontestuar, duke argumentuar se pozita të njëjta në institucione të ndryshme, si zyrtarë certifikues për financa dhe prokurim kanë realizuar pagë të ndryshme, me arsyetim se të njëjtit

punojnë në institucione të pavarura ose “në zhargonin e tyre në institucione specifike”. MAP, pretendon se dallime në paga mund të ketë dhe kjo nuk është diskriminuese, këtë e vërteton edhe Aktgjykimi KO12/18 për vlerësimin kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017, në pikën 116 që përcakton: “Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron së dallimi në paga në vetvete nuk krijon trajtim të pabarabartë për qëllime të nenit 3 dhe 7 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, parashtresit nuk kanë paraqitur fakte bindëse se pagat e para në vendimin e kontestuar trajtojnë ndryshe pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” për derisa tek pika 118 “Gjykata konsideron se organet Kushtetuese janë të obliguara të përfillin kompetencat e njeri-tjetrit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese. Situatat e paqarta për sa i përket ushtrimit të kompetencave, sikurse rasti nën shqyrtim, në të ardhmen mund të shmangen me nxjerrje të ligjeve përkatëse për Qeverinë dhe për pagat e funksionareve shtetëror” ka inkurajuar Qeverinë dhe Kuvendin për të rregulluar pagat me ligj për të shmangur paqartësitë në ushtrimin e kompetencave, gjë e cila ka ndodhur me miratimit e Ligjit të kontestuar nga Kuvendi. Gjykata kishte ripërsëritur se trajtimi ndryshe duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih rastin e GJEDNJ-se *Marckx kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 33). Në lidhje me këtë, sa i përket barazisë para ligjit, respektivisht trajtimit të pafavorshëm vlen të përmendet se në doktrinën juridike përcaktohet qartë se çka nënkuptohet si “diskriminim”. Ai paraqitet në rastet kur personi trajtohet pafavorshëm si rezultat i krahasimit të një personi në një situatë të ngjashme. Një ankesë për një pagë “të ulët” nuk është pretendim për diskriminim po të mos demonstron se paga është më e ulët sesa paga e dikujt të punësuar për kryerjen e një detyre të ngjashme nga i njëjti punëdhënës. Për rrjedhojë, nevojitet një “krahasues”: d.m.th, një person në rrethana materialisht të ngjashme, me ekzistencën e ndryshimit kryesor ndërmjet dy personave që është “shkaku i mbrojtur”.

124. Sipas MAP, parashtresit i kërkesës, nuk ka paraqitur fakte bindëse se pagat e parapara me Ligjin e kontestuar trajtojnë ndryshe pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Në dritën e kësaj, shihet se pretendimet e ankuesve të dorëzuara tek Avokati i Popullit kanë të bëjnë me barazimin me punonjës të profileve tjera, si bie fjala mësuesit e klasave 1-5 pretendojnë të barazohen me mësuesit e klasave 6-9,

inspektoret policorë kërkojnë të barazohen me zyrtarët policorë etj. Rrjedhimisht, sipas MAP, në rrethana të këtij rasti nuk bëhet fjalë për trajtim të pabarabartë apo diskriminim. Në fakt, sipas MAP, sindikatat nuk kërkojnë shfuqizimin e Ligjit për Paga por kërkojnë nga Gjykata të “amendamentojë” Ligjin e kontestuar dhe të përmbushen kërkesat e tyre për barazim me profesione tjera.

Komentet përkitazi me të “drejtën e pronës”

125. Lidhur me cenimin e të drejtave pronësore, MAP argumenton se pretendimet e Avokatit të Popullit fokusohen kryekëput në uljen e pagave që i bëhet individëve dhe grupeve të individëve përmes Ligjit të kontestuar. Argumentimi i MAP në këtë pikë është se duhet vlerësuar nëse pagat e atyre individëve ose grupeve të individëve janë në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe në proporcion të drejtë e të arsyeshëm me pozitat e njëjta apo të krahasueshme deri më tani. Precedentët në rastet e GJEDNJ-së *Kjartan Asmudsson kundër Islandës*, kërkesë nr. 60669/00, Aktgjykim i 12 tetorit 2004 (*Musk v. Ploland*) dhe *Hasani kundër Kroacisë*, cituar më lart që janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk mund të merren parasysh tek rasti i vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, për shkak se objekti i gjykimit në to ka qenë kryesisht në të drejtën e pensionimit jo edhe pagat të cilat janë raste esencialisht të dallueshme për të cilat është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin KO12/18, respektivisht paragrafin 114 ku thihet se: “[...] për me tepër, Gjykata konsideron se nuk qëndron analogja e këtij vendimi me rastin Nr. KO 119/10 [Aktgjykim i datës 8 dhjetor 2011, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010]. Kjo për faktin se në rastin KO119/10, Gjykata nuk ka vlerësuar pagat e deputeteve por pensionet shtesë të tyre, për të cilat Gjykata ka konsideruar se krijon diskriminim ndaj pjesëtareve të tjerë të shoqërisë dhe pensionisteve në Kosovë, pasi deputetet do të përfitonin pensione substanciale, nga buxheti i shtetit pa kontributin e tyre, që nuk ishte rasti me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë”.
126. Për më tepër, MAP shton se neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së zbatohet vetëm ndaj pronës ekzistuese të personit. Prandaj, fitimi i ardhshëm nuk mund të konsiderohet pronë përveç nëse tashme është fituar ose është pa asnjë “mëdyshje i pagueshëm”. Veç kësaj, shpresa për “rigjallërim” (revive) të së drejtës ndaj pronës së humbur, kohë me parë, (long-extinguished property) nuk mund të konsiderohet pronë; e njëjta vlen dhe për pretendimin e

kushtëzuar (shih rastin e GJEDNJ: *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 39794/98, Vendim për Pranueshmëri, paragrafi 69). Megjithatë, në disa rrethana, "pritjet legjitime" për të fituar një "vlere" (asset) po ashtu mund të gëzojnë mbrojtje. Prandaj, kur një interes pronësor shprehet në formë të pretendimit, personit që i është veshur ai interes mund të konsiderohet se ka "pritje legjitime" nëse për atë interes ka bazë të mjaftueshme në të drejtën vendore, për shembull kur ka jurisprudencë të konsoliduar të gjykatave vendore që konfirmojnë ekzistencën e tij (shih rastin e GJEDNJ-së *Kopecky kundër Sllovakisë*, kërkesë nr. 44912/98, paragrafi 52). Mirëpo, asnjë pritje legjitime nuk mund të thuhet se është ngritur në rastet ku ka mosmarrëveshjes lidhur me zbatimin dhe interpretimin e drejte të së drejtës vendore dhe ku më pas pretendimet e parashtresit jenë refuzuar nga gjykatat vendore. Bazuar në sa me sipër, rrjedh se doktrina e pritjes legjitime vjen në shprehje vetëm kur, nga rrethanat e rastit është e qartë se parashtresi nuk ka "pronë ekzistuese" dhe me pas shqyrtohet nëse personi ka ndonjë "të mirë" ("asset") në lidhje me të cilën mund të thuhet se ka pritje legjitime që ai do të jetë në gjendje ta gëzojë atë. (Shih, aktgjykimin e GJEDNJ-së *Kopecky kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafët 40-42).

127. Pikërisht, kjo pritje legjitime nga Ligji i kontestuar ka të bëjë për kategoritë e zyrtarëve publikë të cilët pritet të kenë rritje pagash. Edhe në këtë aspekt, rikujtojmë se nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mund të konkludohet se doktrina e pritjeve legjitime vlerësohet brenda një konteksti nëse pritjet legjitime mbështeten në një akt juridik të pushtetit (baza e pritjeve legjitime) i justifikuar në kuptimin që ai mund të supozojë se ligji ose norma nuk do të ndryshohet më pas (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ *Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët kundër Irlandës*). Vetvetiu, sipas praktikës së GJEDNJ nuk garantohet që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ *X kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8410/78, Vendim për Pranueshmëri, i 13 dhjetorit 1979).

Komentet përkitazi me "ndërmarrjet publike"

128. Në lidhje me këtë çështje MAP thekson se pretendimi i Avokatit të Popullit është nëse ndërmarrjet publike duhet përjashtuar nga Ligji i kontestuar. Sipas MAP vlen të rikujtohet praktika e shteteve tjera, ku parimet lidhur me pagat dhe përfitimet në këto subjekte janë përcaktuar me ligje, si për shembull rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës (shih *Ligji për Pagat dhe të drejtat e tjera materiale të anëtarëve të organeve menaxhuese të institucioneve të Federatës së Bosnjës dhe*

Hercegovinës dhe ndërmarrjeve publike me shumicë në pronësi të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, “Gazeta Zyrtare e Federatës së B&H”, nr. 12/09); rasti i Malit të Zi me Ligjin për Fitimet e të Punësuarave në Sektorin Publik; rasti i Kroacisë me Ligjin për Pagat në Shërbimet Publike, Ligji mbi bazat e pagave në shërbimet Publike.

Komentet e MAP në lidhje me ankesat individuale të pranuar nga Avokati i Popullit nga ana e institucioneve dhe subjekteve të tjera të interesuara

129. MAP, në cilësi të Ministrisë që kishte propozuar Ligjin e kontestuar i cili më pas ishte miratuar nga Qeveria dhe votuar nga Kuvendi, përveç komenteve mbi pretendimet e Avokatit të Popullit, ka dorëzuar edhe komente të veçanta në lidhje me ankesat specifike të cilat janë dorëzuara pranë Avokatit të Popullit nga institucione dhe subjekte të ndryshme të interesuara për statusin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar.
130. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që MAP nuk ka dorëzuar ndonjë koment përkitazi me ankesat e parashtruara pranë Avokatit të Popullit nga ana e: Veton Çoçaj - Certifikues; Pajtim Zogaj, inspektor në Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore; Sindikata e re Korporatës Energjetike të Kosovës, Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe tregut të Kosovës-KOSTT, Sindikata e pavarur e KOSTT-it, Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës; Sindikata e Pavarur Judikatures së Republikës së Kosovës; Këshilli iniciues i mësimdhënësve nga klasa 1-5; Radiotelevizioni i Kosovës.
131. Ndërkaq, në vijim, Gjykata do të paraqesë të gjitha komentet specifike që MAP ka dorëzuar përkitazi me ankesat individuale të institucioneve dhe subjekteve të tjera të dorëzuara pranë Avokatit të Popullit.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ)

132. MAP konsideron se nuk ka asnjë kuptim të ruhet gjendja ekzistuese e krijuar me akte nënligjore pa bazë ligjore dhe pa autorizimin kushtetues ose ligjor që i jep KQZ-së të drejtën e rregullimit me akt nënligjor të pagave dhe komponentëve të saj.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Shoqata e Prokuroreve të Kosovës (KGJK), (KPK) dhe (SHP)

133. Në lidhje me pretendimet e KGJK, KPK dhe SHP, MAP theksoi se kërkesat e tyre gjithëherë kanë qenë abstrakte dhe pa ndonjë propozim konkret. MAP konsideron se, çelës kryesor në përcaktimin e pagës

janë përgjegjësitë dhe detyrat për punën/funksionin e kryer brenda parimit të ndarjes së pushteteve. MAP, pohon se nuk është i saktë pretendimi i KGJK-së, se në këtë institucion nuk janë përfshirë disa pozita, sepse i njëjti asnjëherë, sikurse edhe në këtë kërkesë nuk ka treguar se cilat janë ato pozita të cilat nuk janë të përfshira në Ligjin e kontestuar. Sa i përket rangimit dhe përcaktimit të klasave në KPK por edhe në KGJK, MAP theksoi se nuk ka ndonjë koment. Sa i përket mundësisë së një shtese për personelin në KPK-së nuk është dhënë asnjë arsye e vetme se pse duhet të jepet kjo shtesë. Nuk është i qartë pretendimi i SHP me të cilin thuhet se pagat e prokuroreve do të ulen nga 1 janari i vitit 2021, kur sipas paragrafit 1 të nenit 28 të Ligjit të kontestuar kjo do të jetë e njëjtë, deri më 31 dhjetor 2022. MAP theksoi se të gjitha elementet janë përfshirë në pagën bazë bazuar në përgjegjësitë që kanë këto pozita dhe nuk ka pas nevojë që të rregullohen këto pozita me shtesë.

Ekspertet Antikorrupsion nga Prokuroria Speciale e Kosovës (EAPSK)

134. MAP pohon se të njëjtit nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme pse këto pozita duhet të paguhen ndryshe me kategoritë tjera të nëpunësve në Prokurorinë Speciale. Megjithatë MAP thekson se Ligji i kontestuar, ka bërë një dallim tek kjo kategori, duke i vendosur në kategorinë e eksperteve sepse në kundërtën të njëjtit është dashur të klasifikohen tek pozitat e njëjta ose të ngjashme në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Policia e Kosovës (PK)

135. Sipas MAP, shtesa për kushtet e tregut ju dedikohet pozitave apo grupeve të pozitave për të cilat tregu privat ofron kushte me të mira me së paku 50 % pagë më shumë dhe e cila reflektohet në rekrutimin dhe mbajtjen e stafit. Tek zyrtarët policorë nuk mund të jepet kjo shtesë sepse ata nuk janë nëpunës civilë dhe se nuk ka zyrtar policor që mund të kalojë në tregun privat, e që do e rrezikonte Policinë e Kosovës me mbajtjen dhe rekrutimin e zyrtarëve policorë.

Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK)

136. MAP argumenton se, edhe pse disa pozita të IPK-së nuk janë përfshirë shprehimisht në Ligjin e kontestuar, të njëjtat gjenden Brenda Shtojcës së Ligjit të kontestuar si klasa të përgjithshme bazuar në statusin e IPK-së si agjenci ekzekutive dhe strukturën e saj. IPK gëzon shtesën sipas paragrafit 1 të nenit 14 të Ligjit të kontestuar, ndërsa detajet se kush janë përfituesit dhe masa e shtesës do të përcaktohen me akt nënligjor sipas paragrafit 4 të nenit 14 të Ligjit të kontestuar.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë (AKF)

137. MAP thekson se AKF është agjenci ekzekutive tipike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prandaj edhe stafi saj është i njëjtë si për nga statusi i marrëdhënies së punës po ashtu edhe për nga pagat. Sistemi i gradave në AKF është i pasaktë dhe nuk është i njëjtë me sistemin e gradave në Policinë e Kosovës. Elementi i rrezikshmërisë që përmendet është hipotetik sepse sipas MAP nuk është dhënë ndonjë argument se pse kësaj kategorie i kanoset rreziku për jetën dhe shëndetin.

Agjencia Kundër Korrupsion (AKK)

138. Klasifikimi i pagës së Drejtorit të AKK sipas MAP është bërë duke marrë parasysh funksionet dhe përgjegjësitë e kësaj pozite dhe duke krahasuar atë me udhëheqësit e tjerë siç: është rasti me Komisionarin për mbrojtjen e të dhënave Personale meqë kjo agjenci ka të njëjtin status si AKK. Ndërsa për zyrtarët profesional në AKK-së janë rezervuar dy klasa të veçanta në nivelin profesional njëjtë si për agjencitë e tjera të pavarura e që janë të favorizuara me kategoritë e tjera të nëpunësve civilë. Për nëpunësit e AKK-së gjithashtu është rregulluar një shtesë e cila ka vlerën deri 20 % të pagës bazë.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë)

139. Sipas MAP, ZRRë ka statusin e agjencisë rregullatore sipas Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, rrjedhimisht edhe stafi tyre ka statusin e nëpunësit civil. Nuk ka asnjë arsye dhe argument se pse kjo agjenci duhet të përjashtohet nga Ligji i kontestuar. Nuk është i saktë pretendimi se ZRRë nuk financohet nga buxheti i shtetit dhe se kjo vërtetohet me vet Ligjin për ndarjet buxhetore të vitit 2019, ku kjo agjenci ka kod buxhetor ku specifikohen pagat dhe mëditjet.

Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)

140. MAP pohon se pagat në ARC janë të njëjta si në çdo agjenci tjetër ekzekutive, sepse sipas MAP nuk është e mundur që të këtë dallime mes nëpunësve të agjencive me status të njëjtë.

Autoriteti Aviacionit Civil (AAC)

141. MAP argumenton se për AAC-në është bërë një diferencim në raport me pagat e nëpunësve tjerë, e cila pak a shumë është e ngjashme me

pagat aktuale. Zbritja është bërë kryesisht për pozitat menaxheriale për të cilat nuk ishte e mundur të gjendej një zgjidhje, sepse pagat e tyre kanë qenë shumë me të mëdha se koeficienti maksimal 10, që është caktuar më Ligjin e kontestuar, p.sh. Kryeshefi në AAC e ka pagën 2860 Euro, ndërsa sipas Ligjit të kontestuar paga me e lartë në sektorin publik është 2390 Euro.

Agjencia për Shërbimet e Navigimit Ajror (ASHNA)

142. Në lidhje me këtë agjenci, MAP argumenton se njëjtë si në AAC është bërë një diferencimi i profesionisteve në ASHNA. Sipas MAP, nuk ka asnjë kuptim lidhja që bëhet me krijimin e të hyrave me lartësinë e pagave dhe se nuk është paraqitur asnjë argument se përse me Ligjin e kontestuar cenohet autonomia e ASHNA-s. Pretendimi për largimin e stafit është një supozim i pabazuar në ndonjë provë (p.sh. numri i dorëheqjeve në 5 vitet e fundit).

Sindikata e Shërbimit Civil të Kosovës dhe Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës (SShCK) (SPAC)

143. Në lidhje me këtë sindikatë, MAP thekson se nuk ka ndonjë koment specifik, sepse pretendimet që ngritën janë supozime pa ndonjë provë konkrete në aspekt të jo-kushtetutshmërisë së supozuar të Ligjit të kontestuar.

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK)

144. Lidhur me ASHAK, MAP argumenton se Ligji i kontestuar ka trajtuar vetëm lartësinë e pagës jo edhe natyrën dhe qëllimin, sepse këtë e rregullon vet ligji i ASHAK-ut.

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)

145. MAP konsideron se IML nuk e ka kuptuar drejtë dhe saktë Ligjin e kontestuar. Kjo për faktin se, sipas MAP, pozitat funksionale në IML (kryesisht mjekët) do të paguheshin sipas klasave të pagave të mjekëve, ndërsa stafi mbështetës njëjtë sikurse stafi i QKUK-së.

Administrata e Qendrës Klinike Universitare (AQKU)

146. Nëpunësit në administratën e QKU, sipas MAP, kanë statusin e nëpunësve të shërbimeve publike, ndërsa pagat e tyre janë vendosur duke krahasuar natyrën e punës e cila është plotësisht e njëjtë me nëpunësit civilë, p.sh. zyrtari financiar në QKU për nga puna është i njëjtë si në një komunë ose ministri.

Oda dhe Sindikata e infermiereve, mamive dhe profesionisteve tjera shëndetësor

147. MAP shton se pretendimi i Odës në fjalë se rangimi do duhej bërë në bazë të shkollimit nuk është i saktë, kjo për faktin se Ligji i kontestuar ka përcaktuar vlerën e punës në një pozitë konkrete e jo gradën shkencore që kanë përfituar këto kategori. Sindikata kryesisht ka dhënë propozime të cilat pas miratimit Ligjit të kontestuar nuk janë relevante më.

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)

148. Kategorizimi i pozitive të TIK-ut në Ligjin e kontestuar, sipas MAP, është bërë ashtu që për secilën klasë është vendosur edhe koeficienti përkatës.

Psikologët dhe Pedagogët e shkollave

149. Sipas MAP, kategorizimi i tyre është bërë duke marrë parasysh natyrën e punës së tyre, e jo nivelin ose shkallën e shkollimit, siç pretendohet.

Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimit e Brendshëm në Ministrinë e Financave (NJQH) dhe Auditorët e Brendshëm

150. MAP argumenton se pozitat e NJQH dhe Auditorëve të Brendshëm janë të përfshirë në Ligjin e kontestuar përmes sistemit të rregullt të klasave të cilat do të klasifikohen sipas një procesi të rregullt të klasifikimit të vendeve të punës. Nuk është i saktë konstatimi se rregullimi i klasifikimit me akt nënligjor nga Qeveria, cenon të drejtat e kësaj kategorie sepse Ligji i kontestuar ka autorizuar Qeverinë që të bëjë rregullimin e klasifikimit për të gjithë nëpunësit civilë në Republikën e Kosovës.

Profesionistët shëndetësorë/mjeket e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH)

151. Pagat për këtë kategori, sipas MAP, janë kategorizuar në bazë të natyrës dhe rëndësisë së punës që kryejnë nëpunësit në MSH, e jo siç pretendohet sipas llojit të profesionit dhe vështirësisë së shkollimit të përfunduar. Nëpunësit në MSH janë të ngarkuar kryesisht me detyra të politikëbërjes dhe detyra administrative, e jo me dhënie të shërbimit ashtu siç ndodh p.sh. me mjekët e kirurgjisë të cilët ofrojnë shërbime

kirurgjike për qytetarët, prandaj edhe krahasimi është i pasaktë dhe i pamundshëm.

Stafi i inxhinierëve në ARKEP

152. MAP pohon se pretendimet e stafit të ARKEP më shumë janë propozime të cilat do të merren parasysh në klasifikimin e vendeve të punës.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARShU)

153. MAP thekson se nuk ka asnjë dyshim që nëpunësit e ARShU nuk janë nëpunës civilë, prandaj edhe pagat e tyre përcaktohen sipas klasave të njëjta si të gjithë nëpunësve civilë. Është vetëm supozim fakti për ikjen e stafit dhe i njëjti është i pa faktuar me ndonjë provë.

Administrata e Universitetit të Prishtinës (UP)

154. Përkitazi me administratën e UP-së, MAP thekson se Ligji i kontestuar nuk ka për qëllim jetësimet e premtimeve publike, por ka për qëllim të rregullojë sistemin e pagave. Pretendimet për ulje të pagave më shumë janë supozime se sa fakte të bazuara me prova. Thirrja në nenin 28 të Ligjit nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë sipas MAP nuk është e saktë, pasi që ky nen asnjëherë nuk është zbatuar në praktikë. Pagesa e honorarëve mund të bëhet në pajtim me paragrafin 4 të nenit 16 të Ligji të kontestuar.

Përgjigjet e pranuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, pas kërkesës specifike të Gjykatës drejtuar kësaj Ministrie

155. Gjykata rikujton faktin që kishte kërkuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve që të përgjigjet në disa pyetje të Gjykatës (shih paragrafët 23 dhe 24 të këtij Aktgjykimi ku reflektohen saktësisht të gjitha pyetjet e Gjykatës drejtuar Ministrisë së Financave dhe Transfereve). Lidhur me këtë çështje, Gjykata kishte pranuar përgjigje të cilat do të reflektohen në vijim.
156. Lidhur me pyetjen (1) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: *“Në pyetjen e parë keni shtruar çështjet se për cilat pozicione dhe sa saktësisht do të ulët paga, në cilat institucione, sa ka qenë paga e mëhershme dhe sa do të bëhej me Ligjin Nr. 06/L-111 për Paga në Sektorin Publik (këtu e tutje: Ligji), si dhe diferenca në mes pagës që marrin aktualisht dhe pagës që do të merrnin me Ligjin. Lidhur me këtë pyetje, kemi paraqitur tabelën A në formatin Excel në CD. Kjo tabelë tregon të gjitha pozitat që aktualisht paguhen*

nga Buxheti i Republikës së Kosovës, institucionet, paga aktuale, paga sipas Ligjit dhe diferenca. Për sqarim, paga aktuale është paga bazë bazuar në koeficient, si dhe shtesa mbi pagën bazë (në rastet kur aplikohet), dhe nuk përfshin asnjë nga shtesat tjera aktuale. Prandaj, krahasimi nuk është bërë për pagën bruto (paga bazë dhe të gjitha shtesat), por vetëm për pagën bazë.”

157. Lidhur me pyetjen (2) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: *“Në pyetjen e dytë keni shtruar çështjet se për cilat pozicione dhe sa saktësisht do të rritet paga, në cilat institucione, sa ka qenë paga e mëhershme dhe sa do të bëhej me Ligjin si dhe diferenca në mes pagës që marrin aktualisht dhe pagës që do të merrnin me Ligjin. Lidhur me këtë pyetje, kemi paraqitur tabelën B në formatin Excel në CD. Kjo tabelë tregon të gjitha pozitat që aktualisht paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, institucionet, paga aktuale, paga sipas Ligjit dhe diferenca. Për sqarim, paga aktuale është paga bazë bazuar në koeficient si dhe shtesa mbi pagën bazë (në rastet kur aplikohet), dhe nuk përfshin asnjë nga shtesat tjera aktuale. Prandaj, krahasimi nuk është bërë për pagën bruto (paga bazë dhe të gjitha shtesat), por vetëm për pagën bazë.”*

158. Lidhur me pyetjen (3) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: *“Në pyetjen e tretë keni shtruar çështjen lidhur me pozicionet që marrin pagë sipas sistemit aktual por që me Ligjin pagave nuk është përcaktuar, etj. Lidhur me këtë pyetje, japim sqarimin se pagat e gjyqtareve të Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarit, Prokurorit, Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor dhe Kryesuesit të Këshillit Prokurorial, të cilët janë caktuar me vendim qeverie, do të mbeten të paprekura deri me 31 dhjetor 2022 (Neni 28 i Ligjit), pra nuk i nënshtrohen rregullonit të ri ligjor edhe se paku 2.5 vite (varësisht nga koha e zbatimit të ligjit). Shih Tabelën 1.” [Sqarim i Gjykatës: tabelat në fjalë, disa prej tyre në Excel, janë të qasshme për Gjykatën por që është e pamundur të reflektohen në këtë Aktgjykim për shkak të volumit të tyre. Megjithatë, esenca relevante e tyre do të shpjegohet përgjatë këtij Aktgjykimi].*

159. Më tutje, vijon përgjigja e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për pyetjen (3) të Gjykatës, ku theksohet se as për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dispozitat e ligjit për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe Shtojca nr. 1 e këtij Ligji nuk i nënshtrohen rregullimit të ri ligjor deri në dhjetor 2022. Pagat aktuale të AKP janë përcaktuar me akte të brendshme dhe janë paraqitur në Tabelën 2. Ndërkaq, pagat e reja në AKP do të përcaktohen përmes procesit të klasifikimit sipas kufizimeve të dhëna në Shtojcën 1 të Ligjit.

Meqenëse nuk dihet statusi përfundimtar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit pagat e tyre të ardhshme do të caktohen varësisht statusit të tyre të ardhshëm. Po ashtu, keni parasysh që pagat e Bordit të AKP-së nuk janë të përfshirë në sistemin e pagave, por paguhen nga kategoria e pagave dhe shtesave, prandaj edhe nuk janë pjese e Tabelës 2. [Sqarim i Gjykatës: tabelat në fjalë, disa prej tyre në Excel, janë të qasshme për Gjykatën por që është e pamundur të reflektohen në këtë Aktgjykim për shkak të volumit të tyre. Megjithatë, esenca relevante e tyre do të shpjegohet përgjatë këtij Aktgjykimi].

160. Në këtë kontekst, thekson Ministria e Financave dhe Transfereve në përgjigjen e saj për pyetjen e (3) të Gjykatës se duhet sqaruar se *“pavarësisht se pozitat/kategoritë e përcaktuara në kuptim të gjerë në Ligj, është evidente vështirësia e përcaktimit të pagës për pozitat të cilat nuk janë në mënyrë të drejtpërdrejtë për pacaktuara. Te tilla janë rreth 23% e pozitave (prej 206 pozita unike, për 47 pozita nevojitet klasifikimi, prej të cilave 27 pozita kërkojnë klasifikim dhe riorganizim, kurse të tjerat 20 pozita mund të definohen me procesin e riorganizimit), apo rreth 42% e të punësuarve nga lista e pagave aktuale për të cilat kërkohet klasifikim për përcaktim të pagës. Si rrjedhojë, dokumenti i dytë shtesë i kërkuar në shkresën tuaj (pas pyetjeve 1-7) nuk mund të ofrohet në këtë fazë, meqë një dokument i tillë me listën e të gjithë të punësuarve sipas pozitave nuk ka pasur mundësi të përpilohet për arsyet e lartcekura, por i njëjti do të mund të ofrohet vetëm pas realizimit të procesit të klasifikimit dhe riorganizimit të institucioneve.”*
161. Lidhur me pyetjen e (4) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: *“Në pyetjen e katërt keni shtruar çështjet se cilat pozicione saktësisht do të paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, cilat pozicione dhe cilat institucione janë saktësisht të përjashtuara nga Ligji. Lidhur me këtë pyetje, sqarojmë se me fillimin e zbatimit të Ligjit nga buxheti i shtetit do të paguhen të gjitha pozicionet që janë në tabelën nr. 1 të këtij Ligji, përveç pozitës nr. 29 (Drejtor i Përgjithshëm i Transmetuesit Publik -RTK).”* Më tutje, vijon përgjigja: *“dispozitat e nenit 28 të këtij Ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe Shtojca nr. 1 e Ligjit nuk zbatohen për funksionarin publik me status të veçantë: Gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe Kryesuesin e Këshillit Prokurorial deri me 31 dhjetor 2022 (shih Tabelën 1), dhe dispozitat e nenit 29 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe shtojca numër 1 e këtij ligji nuk zbatohet deri me 31 dhjetor 2022 (shih Tabelën 2). Sa i përket se cilat pozicione dhe institucione janë të përjashtuara nga Ligji, sqarojmë se dispozitat e përgjithshme të këtij*

ligji, në nenin 1 nen paragraf 1.1 përcakton: sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht Forcës së sigurisë së Kosovës -FSK (shih pagat në FSK në Tabelën 3) dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës -AKI (shih pagat në AKI në Tabelën 4).” [Sqarim i Gjykatës: tabelat në fjalë, disa prej tyre në Excel, janë të qasshme për Gjykatën por që është e pamundur të reflektohen në këtë Aktgjykim për shkak të volumit të tyre. Megjithatë, esenca relevante e tyre do të shpjegohet përgjatë këtij Aktgjykimi].

162. Ministria e Financave dhe Transfereve, në përgjigjet e saj lidhur me pyetjen (4) të Gjykatës, po ashtu thekoi se *“duhet të kihet parasysht që shpërblimet sipas Nenit 25 të Ligjit Nr. 05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, anëtarët e Akademisë, anëtarët e rregullt dhe me korrespondencë, në kuadër të shtojcës Nr.1 të Ligjit (numër rendor 43 dhe 51), nuk janë paga (kompensim për punën), dhe të njëjtat janë caktuar në mënyrë direkte si paga, dhe jo si shpërblime përmes ekuivalencës. Megjithatë, këto shpërblime paguhen përmes sistemit të pagave të Thesarit, dhe ky rregullim praktik/Operacional ka qenë ndër vite.”*
163. Lidhur me pyetjen pesë (5) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: *“Në pyetjen pestë keni shtruar çështjen lidhur me pagat për të punësuarit e ndërmarrjeve publike. Lidhur me këtë pyetje sqarojmë se Ligji, në nenin 27 - Kompetenca për caktimin e pagave në ndërmarrjet publike, rregullon çështjen e kompetencës së caktimit të nivelit të pagave për punonjësit e ndërmarrjeve publike (NP), qofshin ato NP qendrore apo NP lokale, gjithmonë kur ato NP janë mbi 50% në zotërim të shtetit apo komunës/komunave. Në rastet kur NP-të janë qendrore, pra në zotërim të shtetit, atëherë sipas nenit 27, paragrafi 1 i Ligjit, organet kolegjiale drejtuese të NP-ve, qe d.m.th. bordet e drejtoreve të NP-ve, kanë kompetencën të miratojnë nivelet e pagave të punonjësve të tyre brenda koeficientit minimal dhe koeficientit maksimal 7, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit. Gjithashtu, sipas po këtij neni dhe paragrafi, janë bordet e drejtoreve të NP-ve qe janë të autorizuar të miratojnë masën e shtesës për performancë, por jo më shumë se një page mujore në vit, pas daljes së rezultatit pozitiv financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Komisioni ndërministror për ndërmarrje publike. Në rastet kur NP-të e caktuara operojnë me humbje ose nëse subvencionohen nga shteti, atëherë sipas nenit 27, paragrafi 2 i Ligjit, është Qeveria e Kosovës ajo qe me propozim te Komisionit ndërministror për ndërmarrje publike, me akte të veçanta, miraton nivelin e pagave të punonjësve të këtyre NP-ve, brenda kornizave të përcaktuara me këtë Ligj, pra brenda koeficientit minimal dhe*

koeficientit maksimal 7. Në rastin e ndërmarrjeve publike lokale, sipas nenit 27 paragrafi 3 i Ligjit, është Komisioni Komunal i Aksionareve për ndërmarrjet publike, që cakton nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda koeficientit minimal dhe koeficientit maksimal 5, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit. Pagat e punonjësve të të gjitha ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale paguhen nga të hyrat e krijuara nga afarizmi i këtyre NP. Për më tepër nënvizojmë se ndërmarrjet publike nuk janë organizata buxhetore që marrin ndarje direkte buxhetore nga Ligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës, dhe pagesa e pagave të tyre nuk behet nga sistemi i pagave të Thesarit.”

164. Lidhur me pyetjen gjashtë (6) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: “Në pyetjen e gjashtë keni shtruar çështjet se a janë të gjitha pagat e sektorit publik të rregulluara vetëm dhe ekskluzivisht me Ligjin dhe Shtojcën Nr. 1 të këtij Ligji, apo ka paga të cilat do të caktohen me akte nënligjore të Qeverisë, etj. Lidhur me këtë pyetje sqarojmë si vijon: Me Ligjin rregullohen pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht kategorive që janë cekur në piken 4 të kërkesës së juaj. Se kush është zyrtar publik dhe funksionar publik përcaktohet me Ligjin Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin në vijim LZP). Pra, pagat për zyrtarët dhe funksionarët publikë janë caktuar me Ligj (në mënyrën të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) dhe nuk mundet të caktohen me akt nënligjor. Por, aktet nënligjore kanë marginë të gjerë që të caktojnë specifika dhe kriteret për këtë përcaktim të tërthortë. Pra, për të gjitha pozitat (rreth 42%) që nuk janë pozita direkte, në Ligj autorizon Qeverinë me akt nënligjor të miratojë klasat e zbatueshme, grupet e administrimit të veçantë dhe të tjera siç përshkruhet me poshtë, që i nënshtrohen procesit të klasifikimit dhe riorganizimit, i cili në fund do të rezultojë me një pagë përkatëse për secilin të punësuar, bazuar në tabelën 1 të këtij ligji. Ligji rregullon edhe pagat e nëpunësve në ndërmarrjet publike me kapital mbi 50% shtetëror (neni 27 i Ligjin Nr. 06/L-111) në kuptimin e përcaktimit të kompetencës (organet kolegjiale) dhe kufijve se deri sa mund të jenë pagat e tyre por jo edhe klasat konkrete për secilën pozitë. Sqarimet me konkrete janë dhënë në përgjigjen nr. 5.
165. Më tutje, në lidhje me pretendimin e mungesës së përcaktimit direkt për disa pozicione ekzistuese që janë në marrëdhënie pune dhe se si do të vendosen pagat për pozicionet e tilla, japim shpjegimet e mëposhtme, Ligji për Pagat në Shtojcën nr. 1 përcakton dy sisteme të përcaktimit të pagës.

166. Sistemi i parë, është përcaktimi direkt i pagave për pozitat të cilat për nga natyra janë pozita të përveçshme, p.sh president, ministër, deputet, mjek, etj. Meqenëse këto pozita janë unike dhe të pakta për nga vëllimi është vlerësuar që ato të përcaktohen drejtpërdrejt me Ligj pa pasur nevojë për një proces klasifikimi. Sidoqoftë, ky rregull ka pasur përjashtime, kur pozita të shërbimit civil janë përcaktuar si pozita direkte, edhe pse nuk janë unike (për shembull disa nga pozitat nr. 79, 92, 93 në Shërbim Civil). E njëjta ndodh në Kuvendin e Kosovës ku pozitat nga 109-132 rregullohen direkt nga Ligji. Se cilat janë pozitat e përcaktuara në mënyrë direkte e kemi sqaruar në tabelat A dhe B në formatin Excel në CD. (Sqarim: këto tabela janë të qasshme për Gjykatën).
167. Sistemi i dytë, është përcaktimi indirekt i pagave që do të thotë se me Ligjin janë caktuar vetëm klasat kryesore prandaj nevojitet edhe një proces klasifikimi. Ky sistem zbatohet kryesisht tek pagat e nëpunësve civilë ku nëni 5 paragrafi 3 i Ligjit përcakton *“Klasifikimi i një pozite të caktuar të Shërbimit Civil, sipas paragrafit 2 të këtij neni, krijohet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të Shërbimit Civil, në pajtim me legjislacionin për zyrtarin publik. Klasa që i përket një pozite të caktuar përcaktohet shprehimisht në rregulloren e organizimit të brendshëm të institucionit, të miratuar sipas Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura”*. Nga ky paragraf mund të kuptojmë se për tu klasifikuar një pozitë e caktuar e cila është përcaktuar sipas Shtojcës nr. 1 (paragrafi 2 i nenit 5) duhet të plotësohen disa kushte ligjore:
1. Klasifikimi dhe vlerësimi i një pozite të caktuar bëhet sipas vlerësimit dhe klasifikimit të rregullave të përcaktuara në legjislacionin për zyrtarin publik; dhe
 2. Klasa që i përket një pozite të caktuar duhet të përcaktohet shprehimisht në rregulloren për organizimin e brendshëm të institucionit sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.
168. Kur jemi tek kushti i parë, LZP në nenin 33 rregullon klasifikimin e vendeve të punës ndërsa paragrafi 2 përcakton kategoritë kryesore në shërbimin civil e që janë:
1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme;

2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të;
 3. Kategoria e ulet drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe
 4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë.
169. Paragrafi 3 i nenit 33 të LZP-së, përcakton se secila nga kategoritë mund të këtë një e me shumë klasa në bazë të nivelit të ndryshëm të kompleksit të punës dhe kërkesave të përgjithshme (njohurive, aftësive dhe cilësive) të nevojshme për kryerjen e punës. Kompleksiteti i punëve nënkupton kombinim i rëndësisë, lirisë së vendimmarrjes, vështirësisë dhe rrezikshmërisë të kryerjes së punës të një pozite të caktuar. Sipas po të njëjtit paragraf çdo pozitë e Shërbimit Civil klasifikohet si pjesë e një klase të caktuar në bazë të procesit të vlerësimit të punës.
170. Paragrafi 5 i nenit 33 të Ligjit autorizon Qeverinë që me propozim të ministritë përgjegjëse të administratës publike, me akt nënligjor të miratojë:
1. klasat e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtimet në çdo klasë;
 2. grupet e administrimit të veçantë;
 3. përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, duke përfshirë këtu kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grup; dhe
 4. rregullat e hollësishme, procedurat, standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e një pozite të caktuar në një klasë apo grup të caktuar, sipas këtij neni.
171. Ky akt nënligjor është përgatitur nga Ministria përgjegjëse për Administratën Publike dhe përmban të gjitha elementet e përcaktuar në këtë paragraf duke përfshirë edhe metodologjinë e vlerësimit të një pozite të caktuar, por i njëjti nuk ka mund të miratohet nga Qeveria për shkak të masës pezulluese të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese ndaj LZP.
172. Sa i përket kushtit të dytë, klasa (që përcaktohet sipas rregullave të LZP të sqaruara me lartë) që i përket një pozite të përcaktuar duhet shprehimisht të përcaktohet me rregulloren për organizimin e brendshëm të institucionit në të njëjtën kohë kjo është kërkesë edhe e vet Ligjit m. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në nenin paragrafin 1.2 i nenit 18 i cili përcakton se *Organogrami i detajuar i institucionit, që përfshin edhe klasën e secilës pozite të punës dhe*

grepin e çdo pozite të kategorisë profesionale në pajtim me dispozitat për klasifikimin në Shërbimin Civil sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë.

173. Rreth procedurave dhe standardeve të detajuara se si behet rregullorja për organizim të brendshëm të një institucioni, Qeveria me propozim të Ministrisë së Administratës Publike ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura e cila edhe me shembull konkret e pasqyron në Shtojcën nr.1, se si duhet vendosur klasa e një pozite të caktuar.
174. Siç mund të kuptohet, Ligji ka lidhje organike me LZP dhe Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, prandaj edhe klasifikimi i vendeve të punës duhet të behet me këtë logjike. Ligji mund të zbatohet në tërësi vetëm pasi të plotësohen kushtet e lartshënuara.
175. Lidhur me pyetjen shtatë (7) të Gjykatës, Ministria e Financave dhe Transfereve u përgjigj: “Në pyetjen e shtatë keni shtruar çështjen se a i ka miratuar Qeveria të gjitha aktet nënligjore që përmenden në Ligjin e kontestuar, etj. Lidhur me këtë pyetje japim sqarimin si vijon:

7.1. Akti nënligjor lidhur me shtesat dhe kompensimin e nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës - Neni 4 paragrafi 4 i Ligjit thekson si vijon: Shtesa dhe Kompensimi i nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Kuvendi.

7.2. Akti nënligjor lidhur me ekuivalencën e pozitës me gradën - Neni 5 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Në rastin e nëpunësve civilë me status të veçantë për të cilët sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë zbatohet sistemi i gradave personale, paga bazë përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket grada, sipas Shtojës nr.1, bashkëngjitur dhe pjesë përcjellëse të këtij ligji, Neni 5 paragrafi 5 i Ligjit thekson: Në rastin e nëpunësve civilë me status të veçantë sipas paragrafit 4, të nenit 5, Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për kategoritë e nëpunësve ku zbatohet sistemi i gradave personale miraton, me akt nënligjor, ekuivalencën e pozitës me gradën, Për këtë akt nënligjor është përgjegjës ministri përgjegjës për administratën publike dhe ministri përgjegjës për kategoritë e nëpunësve ku zbatohet sistemi i gradave personale, Drafti nuk është përgatitur ende.

7.3, Akti nënligjor lidhur me shtesën për kushte tregu -Neni 6 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Llojet e pozitive dhe profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohet me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrisë' përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut rishikohet në baza vjetore nga Qeveria, Neni 6 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Pas miratimit të aktit nënligjor nga Qeveria, sipas paragrafit 3, të këtij neni, përfitimi i shtesës për kushte tregu miratohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa, me propozim të arsyetuar të institucionit përkatës. Për këtë akt nënligjor është përgjegjëse ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa, Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Kabineteve dhe Kompensimet e Zyrtarëve dhe Funkionarëve Publikë) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.5, Akti nënligjor lidhur me shtesën e posaçme të nëpunësve civilë -Neni 8 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Shtese të posaçme mbi pagën bazë të nëpunësve civilë përfitojnë zyrtarët e Administratës Tatimore dhe inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, gardianët në shërbimin korrektues dhe zjarrfikësit në operacione të rrezikshme, Neni 8 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Lista e pozitive apo grup i pozitive, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për përfitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Neni 8 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Nëpunësit civilë në Agjencinë e Kundër Korrupsionit, të cilët ushtrojnë funksione të Agjencisë, përfitojnë shtesë deri në njëzet për qind (20%) mbi pagën bazë. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa, Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr., XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Kabineteve dhe Kompensimet e Zyrtarëve dhe Funkionarëve Publikë) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.6 Akti nënligjor lidhur me shtesën apo kompensimin për punë jashtë orarit të punës –Neni 9 paragrafi 5 i Ligjit thekson: Qeveria miraton, me akt nënligjor, kushtet e detajuara për shtesa dhe kompensime për punë jashtë orarit të punës sipas këtij neni. Për

këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX / 2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Kabineteve dhe Kompensimet e Zyrtarëve dhe Funkionarëve Publikë) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.7. Akti nënligjor për shtesën e posaçme për funksionaret publikë - Neni 12 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Deputetet mund të përfitojnë shtesë të posaçme mbi pagën bazë. Shtesa e posaçme, nga paragrafi 1, i nenit 12 i takon deputetit për funksion parlamentar: Kryetar i Kuvendit, nënkryetar i Kuvendit, kryetar i komisionit parlamentar, zëvendëskryetar i komisioni parlamentar dhe kryetarit të grupit parlamentar. Neni 12 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Kriteret dhe procedurat për shtesa dhe kompensim nga paragrafit 1. dhe 2. të nenit 12, me propozim të Komisionit përkatës parlamentar për buxhet dhe financa, përcaktohen me rregullore nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Neni 12 paragrafi 6 i Ligjit thekson: Shtesa dhe kompensimi për stafin politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me akte të veçantë' të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Kuvendi.

7.8. Akti nënligjor për shtesën e posaçme për funksionarin publik me status të veçante - Neni 14 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Zyrtarët policorë përfitojnë një shtesë të posaçme për ato detyra që kryejnë në sektorë apo operacione të posaçme në rrezikshmëri për jetën, Neni 14 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Inspektorati policor, zyrtarët doganorë dhe zyrtarët e Administratës Tatimore përfitojnë shtesë deri në njëzet për qind (20%) të pagës bazë, Neni 14 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Lista e pozitive të zyrtarëve policorë, inspektoratit policor, zyrtarëve doganorë dhe zyrtarëve të Administratës Tatimore, që përfitojnë: shtesën e posaçme, rregullat për fitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë *me propozim të ministrisë* përgjegjëse për punë të brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrisë përgjegjëse për punë të brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/115 të datës 17.12.2019, ka aprovuar Rregulloren për Shtesën e Posaçme në Pagë për Rrezikshmëri të Zyrtarëve Policorë dhe për Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës, Në vendim thuhet se kjo rregullore zbatohet me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-111 për pagat në Sektorin Publik. Ky akt nënligjor është aprovuar pa Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Transferove, siç kërkohet me

legjislacionin në fuqi të financave publike, Gjithashtu, Ministria e Financave nuk ka qenë anëtare e grupit punues. Kësaj shkrese i është bashkëlidhur vendimi i Qeverise dhe Rregulloja në fjalë.

7.9. Akt nënligjor për shtesën e posaçme për nëpunësit e Kabinetit - Neni 15 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Nëpunësi i Kabinetit, me përjashtim të këshilltarit politik, mund të përfitojë një shtesë të posaçme, e cila nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë, Neni 15 paragrafi 4 ë Ligjit thekson: Kriteret dhe procedura për p fitimin e shtesës, sipas paragrafit 3, të nenit 15 rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Kabineteve dhe Kompensimet e Zyrtarëve dhe Funksionarëve Publikë) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.10. Akti nënligjor për shtesën për kushte të vështira/të dëmshme te punës -Neni 17 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Shtesa për kushte të vështira/të dëmshme shpërblen punën në kushte të dëmshme për shëndetin, Neni 17 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitat të cilat përfitojnë shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e saj. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Drafti i aktit nënligjor qe rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë për Kushte të Vështira e të Dëmshme të Punës, Shtesat për Punë Jashtë Orarit të Punës dhe Shtesat e Posaçme për Nëpunësit e Sistemit Shëndetësor) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.11. Akti nënligjor për shtesën e performancës për nëpunësin e sistemit të arsimit parauniversitar-Neni 18 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Nëpunësit profesionalë të sistemit të arsimit parauniversitar, të cila tregojnë rezultate të veçanta në punë, kanë të drejtë të marrin shtesën e performancës, Neni 18 paragrafi 2 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, një akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafit 1,

të nenit 18, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr.XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Publike dhe Nëpunësve Administrative dhe Mbështetës në Sistemin e Arsimit Parauniversitar dhe Universitar) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.12. Akti nënligjor për shtesën e posaçme për nëpunësin e arsimit universitar -Neni 19 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Profesorët universitare që kryejnë funksionet, si: rektori, prorektori, dekani dhe prodekani dhe shefi i departamentit, përfitojnë një shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës, Neni 19 paragrafi 2 i Ligjit thekson: Profesorët universitare gjithashtu për kryerjen e punës si mentor të temave të diplomës për të gjitha nivelet e studimeve (baçelor, mastër dhe doktoratë), mund të përfitojnë një shtesë të posaçme, dhjetë për qind (10%) të pagës bazë, Neni 19 paragrafi 4 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa miraton, një akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafëve 1, dhe 2, të nenit 19, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e shtesave. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa, Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX/2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Publikë dhe Nëpunësve Administrative dhe Mbështetës në Sistemin e Arsimit Parauniversitar dhe Universitar) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.13 Akti nënligjor për shtesën e posaçme për nëpunësin e sistemit shëndetësor-Neni 20 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Profesionistët shëndetësor në SHSKUK dhe QKMF, që ushtrojnë funksione udhëheqëse dhe të cilat nuk janë pjesë e Shtojcës 1 të këtij ligji përfitojnë një shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës Neni 20 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Nëpunësit profesionalë të sistemit shëndetësorë të cilët ushtrojnë detyrën në profesione të veçanta, të rralla apo në lokacione të largëta, përfitojnë një shtesë të posaçme Neni 20 paragrafi 5 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë

përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitivat, rregullat për shtesën sipas këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj. Për këtë akt nënligjor është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX /2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë për Kushte të Vështira e të Dëmshme të Punës, Shtesat për Punë Jashtë Orarit të Punës dhe Shtesat e Posaçme për Nëpunësit e Sistemit Shëndetësor) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.14 Akti nënligjor për pagesën si page deri në njëzet për qind (20%) në rastet kur funksionari publik, funksionari publik me status të veçantë, zyrtari publik dhe stafi akademik universitar, që marrin pagën bazë sipas Shtojcës 1 të Ligjit të Pagave, angazhohen edhe me punë në një institucion tjetër publik. Neni 21 paragrafi 5 i Ligjit thekson: Funksionari publik, funksionari publik me status të veçantë, zyrtari publik dhe stafi akademik universitar, që marrin pagën bazë sipas Shtojcës 1 të Ligjit të Pagave, nëse angazhohen me punë në një institucion tjetër publik, kur këtë e lejon ligji i veçantë, marrin një pagesë, si pagë deri në njëzet për qind (20%) për angazhimin në atë institucion. Neni 21 paragrafi 6 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, kushtet, masën dhe procedurën e pagesës për angazhimin shtesë sipas paragrafit 50 të nenit 21. Për aktin nënligjor lidhur me kushtet, masën dhe procedurën e pagesës për angazhimin shtesë sipas paragrafit 50 të nenit 21, është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullorja Nr.XX/2019 për Angazhime Shtesë dhe Përlllogaritjen e Pagës dhe Përvojës së Punës) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.15 Akti nënligjor për llogaritjen e përvojës së punës -Neni 21 paragrafi 8 i Ligjit thekson: *Qeveria e Republikës së Kosovës*, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton me akt nënligjor, rregullat për llogaritjen e përvojës së punës, sipas paragrafit 70 të nenit 21 për aktin nënligjor lidhur me llogaritjen e përvojës së punës, është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse

për financa Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullorja Nr. XX /2019 për Angazhime Shtesë dhe Përllogaritjen e Pagës dhe Përvojës së Punës) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.16. Akti nënligjor për llogaritjen e pagës dhe pagesën e pagave - Neni 22 paragrafi 5 i Ligjit thekson: Qeveria e Republikës së Kosovës, me akt nënligjor, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë' përgjegjëse për financa, miraton rregullat e detajuara për zbatimin e nenit 22 lidhur me llogaritjen e pagës dhe pagesën e pagave, Për rregullat lidhur me llogaritjen e pagës dhe pagesën e pagave është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Drafti i këtyre rregullave konfirmo kërkesave të këtij neni ende nuk është përgatitur, por ekzistojnë rregullat aktuale të cilat janë në zbatim e sipër.

7.17. Akti nënligjor lidhur me kompensimin për udhëtime dhe shpenzimet e reprezentacionit. Neni 25 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Zyrtarët dhe funksionarët publikë kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e kryera për udhëtime dhe qëndrim zyrtar jashtë vendit. Neni 25 paragrafi 2 i Ligjit thekson: Zyrtarët dhe funksionarët publikë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, kanë të drejtë për shpenzimet e kryera për reprezentacion. Neni 25 paragrafi 3 i Ligjit thekson: Kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitim të kompensimit, sipas paragrafëve 1. dhe 2, të këtij neni, miratohen me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë' përgjegjëse për financa, Për aktin nënligjor lidhur me kompensimin për udhëtime dhe shpenzimet e reprezentacionit është përgjegjës Qeveria me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Drafti i aktit nënligjor që rregullon këtë çështje (Projekt Rregullore Nr. XX / 2019 për Shtesat mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Kabineteve dhe Kompensimet e Zyrtarëve dhe Funksionarëve Publikë) është përgatitur nga grupi punues dhe ka kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk ka arritur të procedohet për aprovim nga Qeveria.

7.18. Akti nënligjor lidhur me kompensimet për punonjësit e shërbimit diplomatik të cilët ushtrojnë detyrën jashtë vendit-Neni 26 paragrafi 1 i Ligjit thekson: Punonjësit e shërbimit diplomatik, që ushtrojnë detyrën jashtë' vendit, përftojnë këto kompensime: kompensim për koston e jetesës sipas vendit ku ushtrohet veprimtaria, kompensim për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, kompensim për zhvendosje të sendeve familjare dhe kompensim

për udhëtime në atdhe. Neni 26 paragrafi 2 i Ligjit thekson: Kushtet, mënyra dhe procedura për përfitim të kompensimit sipas paragrafit 1, të këtij neni dhe vlera përkatëse miratohet me akt nënligjor të Qeverisë me propozim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe Ministrisë së Financave. Për aktin nënligjor lidhur me kompensimin për punonjësit e shërbimit diplomatik të cilët ushtrojnë detyrën jashtë vendit, Ministria e Punëve të Jashtme ka përgatitur një draft.

Siç, mund të shihet në sqarimet e dhëna në piken 7, shumica e akteve nënligjore që janë përmendur në Ligjin janë hartuar dhe kanë kaluar në të gjitha fazat e konsultimit publik, por nuk kanë mundur të procedohen për aprovim në Qeveri për shkak se në atë kohë Qeveria ka qenë në dorëheqje dhe për shkak të masës pezulluese të Gjykatës Kushtetuese ndaj Ligjit.

Te pika 1 (pas 7 pyetjeve), kërkohet lista e fundit e pagave të distribuuara nga Ministria e Financave dhe Transferove për muajin mars 2020 për të gjithë të punësuarit në nivel të Republikës së Kosovës. Meqë kjo liste është voluminoze, me të gjitha detajet dhe për të gjithë të punësuarit (muaji mars) është dorëzuar në formatin Excel përmes CD-së.

Te pika 2 (pas 7 pyetjeve), kërkohet që të dorëzohet lista e pagave që do të disbursoheshin nga Ministria e Financave dhe Transferove po që se do të zbatohet Ligji. Përgjigja është si vijon: Në situatën aktuale siç u shpjegua në përgjigjet në pyetjet (1-7), rezulton se pa pasur rregulloren për klasifikim si dhe pa u kryer ri-organizimi i institucioneve është e pamundur të përcaktohet paga për secilin të punësuar, pra nuk është e mundur të përpilohet lista e pagave që do të disbursoheshin me Ligjin për mbi 80 mijë përfitues. Rrjedhimisht, edhe sikur Ligji të jetë në fuqi, i njëjti nuk do të mund të zbatohet në tërësi dhe menjëherë. Shënim: Tabelat dhe listat që janë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese, janë dërguar në formatin Excel përmes CO-së.

8. Në bazë të paragrafit të fundit të shkresës tuaj, keni kërkuar që Ministria e Financave dhe Transferove të ua jap edhe informata tjera të rëndësishme. Ne vlerësojmë që informatat dhe vlerësimet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë në vendimmarrjen tuaj, si në vijim:

8.1. Në bazë të një vlerësimi preliminar të kostos së Ligjit (vlerësim që ka ndryshuar që nga drafti i parë i Ligjit deri në aprovim në Kuvend), me nivelin e koeficienteve dhe vlerën e koeficientit të përcaktuar me këtë ligj (239), fatura e pagave sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar do të tejkalojë kufirin e lejuar (rregullën fiskale të pagave), Neni 22/C Kufizimi i rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje), që do të përbënte thyerje të

rregullës fiskale, me refleksione në deficit (si shpenzime rrjedhëse që vazhdojnë) si dhe në nevojën për financim të vazhdueshëm të deficitit. Janë edhe një serë shtesash që Ligji i parasheh, dhe që do ta rendonin edhe me tej situatën sa i përket financimit të këtij Ligji. Në këtë kontekst, duhet të kihet parasysh se neni 81 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ka paraparë një dispozitë të epërsisë ligjore të saj, karshi ligjeve tjera, në çështjet që ndërlidhen me menaxhimin e parashë publike dhe kjo vlerësojmë se duhet të vlerësohet nëse është në përputhje me parimet e përcaktuara për parashë publike në nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

8.2. Në vështrim të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, vërejmë dispozita horizontale dhe kritere të njëjta në organizimin e administratës shtetërore, konkretisht të Zyrës së Kryeministrit, sistemeve ministrore (ministri, agjenci ekzekutive dhe administrata e shërbimeve publike) dhe agjencive rregullatore. Konkretisht, ky Ligj për sistemet ministrore paracakton në mënyrë të njëjtë kriteret për të themeluar agjenci ekzekutive, departamente apo divizion. Në anën tjetër, hartimi i ndryshëm i pagave për udhëheqësit apo stafin e këtyre strukturave në disa raste sipas dispozitave të Ligjit, ndër tjerash, mendojmë se duhet vlerësuar nëse është në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me parashë publike. Po ashtu, mendojmë se një vlerësim i njëjtë duhet të bëhet edhe për disa kategori të zyrtarëve financiarë të rëndësishëm për procesin e menaxhimit dhe kontrollit financiar (shembull auditorët e brendshëm) të cilët nuk kanë trajtim të veçantë dhe nuk janë përcaktuar si pozita të veçanta.”

DISPOZITAT RELEVANTE TË KUSHTETUTËS, KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE, LIGJEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE AKTEVE NËNLIGJORE

Lidhur me pretendimet për shkelje të referuara nga parashtruesi i kërkesës

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

[...]

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektim të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të

pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7

[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

[...]

Neni 10

[Ekonomia]

Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të

- | | |
|---|--------|
| Diskriminimit | Racor; |
| (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj | Gruas; |
| (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; | |
| (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. | |

Neni 23 **[Dinjiteti]**

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 46 **[Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohej.
- [...]

Neni 55**[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.

Neni 58**[Përgjegjësitë e Shtetit]**

1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.
2. Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.
3. Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.
4. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuata për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.

5. Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet.

6. Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikrat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t'i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.

7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë.

Neni 102

[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

Neni 109

[Prokurori i Shtetit]

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.
2. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.
3. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj.
4. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.

5. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.
6. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

Neni 119

[Parimet e Përgjithshme]

1. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.
2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.
3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.
4. Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
5. Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.
6. Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.
7. Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.
8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.
9. Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.
10. Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.

Neni 142

[Agjencitë e Pavarura]

1. Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat

rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.

2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.

3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.

Neni 130

[Autoriteti Civil i Aviacionit]

1. Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës së Kosovës rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj.

2. Autoriteti Civil i Aviacionit bashkëpunon plotësisht me autoritetet relevante ndërkombëtare dhe vendore, të përcaktuara me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 1

[Mbrojtja e pronës] i Protokolli nr.1 të KEDNJ-së

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[...]

Neni 14

[Ndalimi i diskriminimit]

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”

Protokolli Nr. 12 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Romë, 4.XI.2000

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij protokolli,

Duke pasur parasysh parimin themelor sipas të cilit të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë ë drejtë për një mbrojtje të njëjtë nga ligji,

Të vendosur për të ndërmarrë hapa të mëtëjshëm për të nxitur barazinë e të gjithë personave nëpërmjet zbatimit kolektiv të një ndalimi të përgjithshëm të diskriminimit në kuadrin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim referuar si “Konventa”);

Duke ripohuar që parimi i mosdiskriminimit nuk i ndalon Shtetet Palë të marrin masa me qëllim që të nxisin një barazi të plotë dhe efektive, me kusht që këto masa të kenë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

[Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit]

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t’u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 23

1. Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.
2. Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.
3. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.
4. Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

LIDHUR ME KOMPETENCAT KUSHTETUESE TË QEVERISË DHE KUVENDIT PËR LIGJBËRJE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme; [...]

Neni 76

[Rregullorja e Punës]

Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.

Neni 79

[Nisma Legjislative]

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 93

[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

[...]

(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;

[...]

DISPOZITAT SPECIFIKE TË KONTESTUARA TË LIGJIT PËR PAGAT

Neni 4

[Paga e nëpunësit civil]

4. Shtesa dhe Kompensimi i nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Rregullimi me akt të veçantë sipas paragrafit 4. të këtij neni, bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 5**[Paga bazë e nëpunësit civil]**

5. Në rastin e nëpunësve civilë me status të veçantë, sipas paragrafit 4. të këtij neni, Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për kategoritë e nëpunësve ku zbatohet sistemi i gradave personale miraton, me akt nënligjor, ekuivalencën e pozitës me gradën.

Neni 6**[Shtesa për kushte tregu]**

4. Pas miratimit të aktit nënligjor nga Qeveria, sipas paragrafit 3. të këtij neni, përfitimi i shtesës për kushte tregu miratohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa, me propozim të arsyetuar të institucionit përkatës

Neni 7**[Shtesa e performancës]**

5. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, masën dhe procedurën për fitimin e shtesës për performancë.

Neni 8**[Shtesa të posaçme të nëpunësve civilë]**

3. Lista e pozitive apo grup pozitive, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për përfitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

Neni 9**[Shtesa apo kompensimi për punë jashtë orarit të punës]**

5. Qeveria miraton, me akt nënligjor, kushtet e detajuara për shtesa dhe kompensime për punë jashtë orarit të punës sipas këtij neni.

Neni 14**[Shtesa të posaçme për Funksonarin publik me status të veçantë]**

1. Zyrtarët policor përfitojnë një shtesë të posaçme për ato detyra që kryejnë në sektorë apo operacione të posaçme me rrezikshmëri për jetën.

2. Shtesa e posaçme, sipas paragrafit 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se dyzet për qind (40%) e pagës bazë, sipas Shtojcës 1 të këtij ligji.

3. Inspektorati policor, zyrtarët doganor dhe zyrtarët e Administratës Tatimore përfitojnë shtesë deri në njëzet për qind (20%) të pagës bazë.

4. Lista e pozitive të zyrtarëve policor, Inspektoratit policor, zyrtarëve doganor dhe zyrtarëve të Administratës Tatimore, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për fitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punë të brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

Neni 15

[Paga e nëpunësit të Kabinetit]

4. Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës, sipas paragrafit 3. të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.

Neni 17

[Shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës]

4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitat të cilat përfitojnë shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e saj.

Neni 18

[Shtesa e performancës për nëpunësin e sistemit të arsimit parauniversitar]

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafit 1. të këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj.

Neni 19

[Shtesa e posaçme për nëpunësin e arsimit universitar]

4. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa miraton, me akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e shtesave.

Neni 20**[Shtesa e posaçme për nëpunësin e sistemit shëndetësor]**

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitat, rregullat për shtesën sipas këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj.

Neni 21**[Llogaritja e pagës bazë]**

8. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton me akt nënligjor, rregullat për llogaritjen e përvojës në punë, sipas paragrafit 7. të këtij neni.

Neni 22**[Llogaritja dhe pagesa]**

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, me akt nënligjor, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton rregullat e detajuara për zbatimin e këtij neni.

Neni 23**[Përcaktimi i vlerës së koeficientit dhe fondi për shtesa]**

5. Fondi sipas paragrafit 4. të këtij neni alokohet nga ministria përgjegjëse e financave për organizatat buxhetore vetëm në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 25**[Kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e reprezentacionit]**

3. Kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitimin e kompensimit, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, miratohen me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

Neni 26**[Kompensimi për punonjësit e shërbimit diplomatik, të cilët ushtrojnë detyrën jashtë vendit]**

2. Kushtet, mënyra dhe procedura për përfitimin e kompensimit sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe vlera përkatëse miratohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe Ministrisë së Financave.

Neni 29 **[Pa titull]**

Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dispozitat e këtij ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe shtojca numër 1 e këtij ligji nuk zbatohet deri me 31 dhjetor 2022.

Neni 33 **[Shfuqizimi]**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen:
 - 1.1. Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil;
 - 1.2. Ligji nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-038;
 - 1.3. Neni 11, paragrafi 2. i ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
 - 1.6. Neni 35, paragrafët 1. dhe 2. të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat;
 - 1.7. Neni 21, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1. deri në 1.10., i Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
 - 1.8. Neni 18, paragrafi 1., i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe çdo dispozitë e ligjit dhe e aktit nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave dhe shpërblimeve.

DISPOZITAT SPECIFIKE TË LIGJEVE TË TJERA TË SHFUQIZUARA ME NENIN 33 [SHFUQIZIMI] TË LIGJIT TË KONTESTUAR

Neni 11, paragrafi 2. i Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;

Neni 11 **Paga e Presidentit të Republikës**

1. Paga e Presidentit të Republikës së Kosovës është paga më e lartë në kuadër të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Paga e Presidentit të Republikës gjithmonë duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e lartë se të ardhurat e përgjithshme të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe udhëheqësve të tjerë institucional.

Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

Neni 15

Paga e Gjyqtarëve

Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;

Neni 9

Paga e drejtorit

Drejtori i Agjencisë ka një pagë në lartësinë e pagës së Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës.

Neni 35, paragrafët 1. dhe 2. të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat;

Neni 35

Paga dhe kompensimi gjyqësor

1. Gjatë mandatit të tyre në detyrë gjyqtarët do të pranojnë pagat si në vijim:

1.1. kryetari i Gjykatës Supreme do të pranoj një pagë jo më pak se ajo e Kryeministrit të Republikës së Kosovës;

1.2. gjyqtari i Gjykatës Supreme do të pranoj pagën në shkallë prej nëntëdhjetë përqind (90%) të pagës së Kryetarit të Gjykatës Supreme;

1.3. kryetari i Gjykatës së Apelit do të pranoj një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës;

1.4. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të pranojnë një pagë ekuivalente prej nëntëdhjetë përqind (90%) të Kryetarit të Gjykatës së Apelit;

1.5. kryetari i Gjykatës Themelore do të pranoj një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit;

1.6. gjyqtari mbikëqyrës i një dege të Gjykatës themelore do të pranoj një pagë ekuivalente me nëntëdhjetepesë përqind (95%) të Kryetarit të Gjykatës Themelore;

1.7. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore do të pranojnë një pagë ekuivalente prej tetëdhjetë përqind (80%) të Kryetarit të Gjykatës Themelore

2. Paga e një gjyqtari nuk do të zvogëlohet gjatë mandatit në të cilin gjyqtari është emëruar, përveç sanksionimit disiplinor të vendosur nën autoritetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

3. Gjyqtarët gëzojnë të drejtën e pushimit vjetor në pajtim me Ligjin e Punës.

Neni 21, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. deri në 1.10., i Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;

Neni 21

Kompensimi i prokurorëve të shtetit

1. Gjatë periudhës së shërbimit, prokurorët e shtetit gëzojnë pagat bazë si në vijim:

1.1. kryeprokurori i Shtetit pranon pagë ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme.

1.2. prokurorët me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.

1.3. kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pranon pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë e pesë (95) % me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.

1.4. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë Speciale marrin pagë ekuivalente me pagën e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;

1.5. kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit merr pagë ekuivalente me pagën e kryetarit të Gjykatës së Apelit;

1.6. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë e Apelit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.

1.7. kryeprokurorët e prokurorive themelore marrin pagë ekuivalente me kryetarët e gjykatave themelore.

1.8. secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rast shuma e pagës bazë dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.

1.9. përpos pagës së tyre bazë, secili prokuror gëzon të drejtën për kompensim shtesë për shërbime tjera siç ceket me ligj apo rregulla të nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

1.10. pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, paga e prokurorëve të shtetit nuk do të zvogëlohet gjatë periudhës së shërbimit të tyre përpos nëse kjo caktohet si sanksion nga Këshilli Prokurorial apo Komisioni Disiplinor i Këshillit bazuar në përcaktimin se prokurori i shtetit ka kryer sjellje të pahijshme apo ndonjë vepër penale.

1.11. prokurorët e shtetit kanë të drejtë në pushim vjetor në masë të barabartë me shërbyesit civilë, por në asnjë rast më pak se njëzet (20) ditë pushimi vjetor me pagesë.

Neni 18, paragrafi 1. i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Neni 18

Paga e Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit

1. Gjatë mandatit të tyre, Kryesuesi, dhe anëtarët me orar të plotë të Këshillit pranojnë pagën si në vijim:

1.1. Kryesuesi pranon pagë ekuivalente me pagën e Kryetarit të Gjykatës Supreme;

1.2. Zëvendëskryesuesi dhe anëtarët me orar të plotë pranojnë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme.

2. Anëtarët jogjyqtarë të Këshillit që nuk janë me orar të plotë, kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit.

3. Gjatë mandatit të tyre, kryesuesi si dhe anëtarët gjyqtarë me orar të plotë, pranojnë vetëm pagën e përcaktuar me ligj, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlihet me ushtrimin e detyrave të tyre, siç përcaktohet në paragrafin 5. të këtij neni.

4. Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi, me skadimin e mandatit të tyre do të pranojnë kompensimin që lidhet me pozitën fillestare gjyqësore në të cilën këta do të kthehen.

5. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

6. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.

Pranueshmëria e kërkesës

176. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtguesve të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur

kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

177. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, sipas të cilave Avokati i Popullit, mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...]

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

- (3) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.

[...]

Neni 135

[Raportimi i Avokatit të Popullit]

[...]

4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

KREU III

Procedurat e Veçanta

Neni 29

[Saktësimi i kërkesës]

“1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar”.

Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese

VII. Dispozita të veçanta për procedura sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 67

[Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

178. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e aktit të kontestuar, (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe pikave (2) dhe (3) të Rregullit 67 të Rregullores së Punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit dhe pikës (4) të Rregullit 67 të Rregullores së punës.

(x) Lidhur me Palën e Autorizuar dhe aktin e kontestuar

179. Avokati i Popullit, bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës është i autorizuar që para Gjykatës të ngrejë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit; (iii) dekreteve të Kryeministrit; dhe (iv) rregulloreve të Qeverisë. Neni 29 i Ligjit saktëson që Avokati i Popullit është palë e autorizuar para Gjykatës dhe rregulli 67 i Rregullores së punës thirret në nenet respektive, të lartcituara, të Kushtetutës dhe Ligjit.

180. Në aspekt të rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se, Avokati i Popullit, në cilësi të parashtruesit të kërkesës, para Gjykatës konteston kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, respektivisht një “ligj” të miratuar nga Kuvendi.
181. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se para Gjykatës është një kërkesë e ngritur nga Avokati i Popullit, i cili bazuar në nenet e lartcituara të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, është palë e autorizuar që të ngre para Gjykatës, në mes të tjerash, çështjen e përputhshmërisë së “ligjeve” me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit është palë e autorizuar dhe konteston një akt të cilin ka autorizim kushtetues që ta kontestojë.

(xi) Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe specifikimin e kundërshtimeve

182. Gjykata rikujton që neni 29 i Ligjit dhe rregulli 67 i Rregullores së punës, përcaktojnë që kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të specifikojë (i) nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.
183. Sa i përket kriterit të parë të saktësimin të kërkesës, Gjykata verën se Avokati i Popullit konteston kushtetutshmërinë e Ligjit për Paga në tërësinë e tij, duke pretenduar se i njëjtë nuk është në përputhshmeri me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafët 3 dhe 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafin 1 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura], nenin 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit] të Kushtetutës; nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së si dhe paragrafin 2 të nenit 23 të DUDNJ-së. Përveç kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, Avokati i Popullit konteston në veçanti edhe kushtetutshmërinë e neneve vijuese të këtij Ligji për Pagat: nenet 4.4; 4.5; 5.5; 6.4; 7.5; 8; 8.3; 9.5; 14; 14.4; 15.4; 17.4; 18.2; 19.4; 20.5; 21.8; 22.5; 23.5; 25.3;

26.2; 29; 33, duke pretenduar se të njëjtit janë të papajtueshëm me parimet kushtetuese të “*ndarjes së pushteteve*”.

184. Andaj, Gjykata konstaton se Avokati i Popullit ka specifikuar se e konteston aktin në tërësinë e tij dhe se ka paraqitur kundërshtimet e tij lidhur me jo-kushtetushmërinë e tërësishme të aktit të kontestuar.
185. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se, përveç pretendimeve për kushtetutshmërinë e Ligjit për Paga në tërësinë e tij dhe në aspekte të veçanta për sa i përket parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve, Avokati i Popullit ka përcjellë në Gjykatë edhe: (i) tridhjetë e pesë (35) ankesa të institucioneve dhe subjekteve të ndryshme të interesuara në kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar; dhe, (ii) disa dosje dhe kërkesa të pranuar nga Avokati i Popullit nga disa sindikata, komuna dhe institucione arsimore (shih paragrafin 197 të këtij Aktgjykimi ku reflektohen komunikimet me Avokatin e Popullit lidhur me këto shkresa; si dhe paragrafët 71-108 dhe 110 të këtij Aktgjykimit ku reflektohet esenca e 35 ankesave në fjalë).
186. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se më 23 janar 2020, Avokati i Popullit kishte përcjellë në Gjykatë disa kërkesa që iu ishin drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit – e që kishin të bëjnë me kërkesë të disa sindikatave për revokim të masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata lidhur me Ligjin për Pagat. Avokati i Popullit kishte përcjellë ato shkresa në Gjykatë, për njoftimin e Gjykatës, pa specifikuar dhe qartësuar se çfarë kërkon nga Gjykata. Rrjedhimisht, përmes një shkrese zyrtare (shih paragrafin 16 të këtij Aktgjykimi), Gjykata veçse e ka njoftuar Avokatin e Popullit se “*palë e vetme në rastin KO219/19 është Institucioni i Avokatit të Popullit, si palë e cila e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin e tërësishëm të kushtetutshmërisë së Ligjit në fjalë dhe pezullimin e tërësishëm të tij*” dhe se të gjitha palët e tjera “*përfshirë sindikatat [...] mund të kenë vetëm statusin e palës së interesuar por jo edhe të “palës” në kuptim të dispozitave të lartcekura të Rregullores së punës [që flasin për palët e autorizuara].*”
187. Më tutje, Gjykata kishte sqaruar për Avokatin e Popullit se bazueshmëria e të gjitha dokumenteve, kërkesave ose ankesave që dorëzohen tek Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të shqyrtohet fillimisht nga vet Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ky i fundit duhet “*të merr vendim se çfarë hapi dëshiron të ndërmerret në lidhje me ato kërkesa*”, gjithnjë duke pasur parasysh kompetencat kushtetuese të këtij Institucioni për kontestim të akteve para kësaj Gjykate. Nëse Institucioni i Avokatit të Popullit konsideron se duhet të ndërmerret ndonjë veprim aktiv në lidhje me kërkesat/ankesat që

ai pranon, atëherë Avokati i Popullit *“duhet të bëjë një kërkesë specifike dhe të arsyetuar, sipas dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore, dhe me sqarimet e nevojshme se çfarë veprimi kërkohet të merret nga Gjykata Kushtetuese.”* Krejt në fund, në shkresën drejtuar Avokatit të Popullit, Gjykata kishte potencuar se: *“për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nuk mjafton vetëm përcjellja e kërkesave të palëve të tjera të interesuara, pa sqarimet e domosdoshme përkitazi me dokumentet dhe dosjet e dorëzuara në Gjykatë.”*

188. Të njëjtën logjikë dhe linjë të arsyetimit Gjykata e aplikon edhe për 35 ankesat individuale të dorëzuara pranë Avokatit të Popullit (për vlerësimin e tij) - e të përcjella më pas në Gjykatë nga Avokati i Popullit si pjesë e dosjes së rastit KO219/19. Lidhur me këto ankesa individuale të institucioneve dhe subjekte të ndryshme, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që vet *“të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar prek interesat legjitime të këtyre ankuesve”*, pa specifikuar saktë kundërshtimet dhe qëndrimin e tij lidhur me këto ankesa.
189. Në këtë aspekt, Gjykata sqaron se kompetenca kushtetuese e Avokatit të Popullit për të kontestuar, në mes të tjerash, “ligje” të Kuvendit përmes nenit 113.2 (1) të Kushtetutës – nuk nënkupton që Avokati i Popullit mund thjeshtë të përcjellë në Gjykatën Kushtetuese ankesa që dorëzohen për vlerësim tek Avokati i Popullit, me kërkesën që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë se a ka apo jo shkelje të Kushtetutës. Përkundrazi, çdo ankesë ose kërkesë që Avokati i Popullit vendosë ta përkrahë me qëllim të kontestimit të një ligji ose akti tjetër para Gjykatës Kushtetuese – duhet ta arsyetojë ashtu që të kuptohet qartë kundërshtimi, qëndrimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese. E kundërta, respektivisht vetëm përcjellja e ankesave ose kërkesave nga Avokati i Popullit tek Gjykata pa arsyetim relevant përkatës, do të mund të nënkuptonte se Avokati i Popullit thjesht mund të shërbejë si ndërmjetës i cili përcjellë në Gjykatë për vlerësim kërkesa të palëve të treta pa obligimin që kundërshtimet e nivelit kushtetues për të njëjtat t’i arsyetojë dhe argumentojë. Një skenar i tillë qartazi që nuk është qëllimi i kompetencës kushtetuese të paraparë me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës për Avokatin e Popullit. Në fakt, qëllimi i kësaj kompetence është që t’i jepet mundësia Avokatit të Popullit që të ushtrojë rolin e tij kushtetues për të *“mbikëqyr dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”* (shih neni 132.1 i Kushtetutës) – duke kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit ose akti tjetër sipas juridiksionit të paraparë me nenin 113 të Kushtetutës.

190. Rrjedhimisht, në vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata do të fokusohet vetëm në pretendimet dhe kundërshtimet e saktësuara dhe të arsyetuara të Avokatit të Popullit rreth jo-kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, duke mos u lëshuar në vlerësim individual të 35 ankesave të dorëzuara pranë Avokatit të Popullit e të përcjella në Gjykatë pa ndonjë argumentim mbështetës rreth qëndrimit të Avokatit të Popullit për ato ankesa.
191. Thënë këtë, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës para Gjykatës konteston Ligjin për Paga në tërësinë e tij, dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtuesit të kërkesës (i) specifikon aktin e kontestuar që konsideron të jetë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) specifikon kundërshtimet e ngritura rreth kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar në aspekt të ndarjes së pushteteve, sigurisë juridike, barazisë para ligjit dhe mbrojtjes së pronës - siç është përcaktuar në nenin 29 të Ligjit dhe rregullin 76 të Rregullores së punës.

(xii) Lidhur me afatin

192. Gjykata, rikujton që neni 30 [Afatet] i Ligjit dhe rregulli 67 (4) i Rregullores së punës përcaktojnë se kërkesa e referuar në bazë të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës duhet të parashtrohet brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.
193. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2019, ndërsa është kontestuar në Gjykatë më 5 dhjetor 2019, dhe rrjedhimisht, është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar përmes dispozitave të lartcituara.

(xiii) Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

194. Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar para Gjykatës; (ii) konteston akt të cilin ka të drejtë ta kontestojë; (iii) ka specifikuar se konteston Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij; (iv) ka paraqitur kundërshtimet kushtetuese kundër aktit të kontestuar; dhe, (v) ka kontestuar aktin brenda afatit të përcaktuar.
195. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

MERITAT E KËRKESËS

I. Hyrje

196. Gjykata fillimisht rikujton se parashtuesi i kërkesës, respektivisht Avokati i Popullit, konteston kushtetutshmërinë e Ligjit për Paga, duke pretenduar se i njëjti nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], 10 [Ekonomia], 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafët 3 dhe 7 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafin 1 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit], 119 [Parimet e Përgjithshme] paragrafët 1 dhe 2 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura], 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit] të Kushtetutës; me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; si dhe, me paragrafin 2 të nenit 23 të DUDNJ-së.
197. Gjykata po ashtu rikujton se parashtuesi i kërkesës, respektivisht Avokati i Popullit, përveç pretendimeve të tij që ndërlidhen me: (i) ndarjen e pushteteve; (ii) sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike; (iii) barazinë para ligjit; dhe, (iv) mbrojtjen e pronës, ka dorëzuar si pjesë të dosjes së rastit KO219/19 edhe tridhjetë e pesë (35) ankesa individuale të dorëzuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit nga institucione dhe subjekte të ndryshme të interesuara në kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka përcjellë në Gjykatë, për informatën e kësaj të fundit, edhe disa kërkesa/dosje që i ka pranuar nga sindikata të ndryshme. Lidhur me të gjitha këto, në pjesën e vlerësimit të pranueshmërisë, Gjykata veçse ka konstatuar që Avokati i Popullit nuk ka qartësuar qëndrimin e tij dhe se çdo kërkesë e dorëzuar në Gjykatë duhet të arsyetohet dhe mbi bazën e kundërshtimeve kushtetuese dhe të specifikohet se çfarë konkretisht kërkohet nga Gjykata. Rrjedhimisht, Gjykata veçse ka konkluduar që ankesat në fjalë ndonëse i konsideron si pjesë e dosjes, në mungesë të një arsytimi dhe qëndrimi lidhur me to nga ana e Avokatit të Popullit, nuk mund të lëshohet në vlerësimin e tyre, një e nga një. Ankuesit në fjalë nuk janë palë të autorizuar para kësaj Gjykate; ndërkaq që, Avokati i Popullit nuk e ka arsytuar e as shprehur qëndrimin e tij përkitazi me ato ankesa të përcjella në Gjykatë. Kjo e fundit, për pjesën tjetër dhe parësore të kërkesës së Avokatit të Popullit – e që ndërlidhet kryesisht me pretendime për shkelje të parimit të “ndarjes së pushteteve”, veçse ka konfirmuar që kërkesa e dorëzuar nga Avokati i Popullit përmbush të gjitha kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim në merita.
198. Thënë këtë, Gjykata vë në pah se fushëveprimi i kësaj kërkesë dhe respektivisht çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është

përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar, përkatësisht vlerësimi nëse ky i fundit shkelë parimin e ndarjes së pushteteve të garantuar me nenet 4 dhe 7 në ndërlidhje me nenet 102, 108.1, 109, 115 të Kushtetutës, duke mos respektuar garancitë kushtetuese të njëjës degë të pushtetit, respektivisht gjyqësorit; dhe, duke mos respektuar garancitë kushtetuese të Institucioneve të Pavarura të reflektuara në nenet përkatëse të Kapitullin XII të Kushtetutës.

199. Për qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar në dritë të pretendimeve dhe kundërshtimeve për shkelje të parimit të “ndarjes së pushteteve”, Gjykata fillimisht do të paraqesë: (i) thelbin e pretendimeve të Avokatit të Popullit; (ii) thelbin e kundërshtimeve të MAP; (iii) thelbin e përgjigjeve dhe komenteve të Ministrisë së Financave dhe Transfereve; (iv) parimet e përgjithshme të aplikueshme për rrethanat e rastit konkret të nxjerra nga nenet respektive të Kushtetutës dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në Aktgjykimet KO73/16 dhe KO171/18; përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias; Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias së bashku me praktikën tjetër gjyqësore të sugjeruar nga zyra ndërlidhëse e Komisionit të Venecias; dhe (v) zbatimin e parimeve në fjalë në rrethanat e rastit konkret ku edhe do të paraqitet “Përgjigjja e Gjykatës” përkitazi me kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar.
200. Gjykata gjithashtu do të adresojë çështjen e (i) pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës për kundërkushtetutshmëri të Ligjit të kontestuar; (ii) masës së përkohshme; dhe, krejt në fund do të paraqesë (iv) “Përfundimet e Gjykatës” dhe (iii) “Dispozitivin” përkatës.
201. Para adresimit të çështjeve të lartpërmendura, Gjykata e shoh të nevojshme të theksojë edhe një fakt të rëndësishëm lidhur me kërkesën në shqyrtim. Kjo ka të bëjë me faktin se akti i kontestuar nga Avokati i Popullit, përveç që ka efekt në rreth 80.000 (tetëdhjetë mijë) punonjës që marrin pagë nga buxheti i shtetit, i njejtë ka efekt edhe për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, e vetëdijshme për efektin e aktit të kontestuar, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme ndërkombëtare që në rastet kur e gjithë trupa e Gjykatës Kushtetuese preket në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga akti i cili duhet patjetër ta vlerësojë, është e pamundur që të bëhet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve ngase nuk do të ngelej asnjë autoritet tjetër alternativ i cili do të mund të vlerësonte kushtetutshmërinë e një akti të caktuar. Në këtë aspekt, duhet të theksohet se mundësia e përjashtimit të gjyqtarëve nuk duhet të rezultojë në pamundësinë e Gjykatës që të merr një vendim. Duhet të sigurohet që Gjykata

Kushtetuese, si garantuese e Kushtetutës, vazhdon të funksionojë si një institucion demokratik. Komisioni i Venecias veçse ka theksuar se: *“Autorizimi i Gjykatës buron nga domosdoshmëria e sigurimit se asnjë ligj nuk i shmanget kontrollit kushtetues, përfshirë ligjet që ndërlidhën me pozitën e gjyqtarëve”*. Rrjedhimisht, Gjykata njeh faktin që preket nga Ligji i kontestuar por që nuk ka asnjë autoritet tjetër në Republikën e Kosovës që mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar (shih Opinion nr. 524/2009 i Komisionit i Venecias lidhur me *Ligjin për Pastërtinë e Figurës së Zyrtarit të Lartë të Administratës Publike dhe Personave të Zgjedhur në Shqipëri*, miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 80-të, paragrafi 142 (Venecia 9-10 tetor 2009); shih *mutatis mutandis*, rastin nr. KI108/16 Parashtrues, Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 2016-COS-0488, të nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së Shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, të 22 korrikut 2016*, Aktvendim për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 nëntorit 2016, paragrafi 34).

II. Përputhshmëria e Ligjit të kontestuar me parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe të “sigurisë juridike”, respektivisht nenet 4, 7, 102, 108.1, 109, 115 të Kushtetutës dhe nenet respektive të Kapitullit XII të Kushtetutës

Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës

202. Gjykata rikujton se në thelb përkitazi me aspektin e ndarjes së pushteteve, parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji për Pagat është kundërkushtetues për arsyet vijuese: (i) *“nuk siguron në mënyrë të duhur ndarjen e pushtetit”*, ashtu siç përcaktohet me nenin 4 të Kushtetutës ngase edhe në çështjet e pagave duhet të ruhet parimi i ndarjes së pushteteve; (ii) nuk bën dallim të qartë në mes të tri pushteteve cilat janë të ndara dhe balancohen në mes vete si dhe në mes të institucioneve të pavarura të cilat janë shprehimisht të themeluara si të tilla me Kushtetutë; (iii) bën ndërhyrja kundërkushtetuese në parimin e ndarjes së pushteteve me faktin se Ligji i kontestuar i ka dhënë *“të drejtën e nxjerrjes së akteve nënligjore vetëm Qeverisë dhe në raste të caktuara Kuvendit”*, duke mos përfillur kështu kërkesën kushtetuese për respektim të parimit të ndarjes së pushteteve; (iv) është kundërkushtetues ngase rregullimi ligjor sipas të cilit vetëm Qeveria, e në raste të caktuara edhe Kuvendi, mund të nxjerrin akte nënligjore për të gjithë institucionet e tjera publike, gjë që *“përveç që ka ndikim në pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare, po ashtu ndërhyr në mekanizmin e*

kontrollit dhe balancimit, që është garantues i funksionimit demokratik të shtetit"; (v) *"aplikon kritere të njëjta"* për të gjitha autoritetet publike, institucionet dhe organet e tjera në Republikën e Kosovës *"pa marrë parasysh rendin dhe ndarjen e pushteteve në pajtim me Kushtetutën dhe specifikën e statusit kushtetues të subjekteve të sektorit publik"*; (vi) cenon parimin e ndarjes së pushteteve meqë *"nuk merr parasysh faktin se shumë institucione, në veçanti institucionet e pavarura, i kanë ligjet e veta që përmbajnë dispozita specifike, të cilat i rregullojnë në mënyrë të veçantë të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të këtyre institucioneve"*; (vii) sipas kapitullit XII të Kushtetutës *"Kushtetuta dhe ligjet përkatëse kërkojnë garanci për trajtim adekuat të degëve të pavarura të pushtetit, dhe, për më tepër, kërkojnë garanci për pavarësi institucionale, organizative dhe financiare për institucionet e pavarura të përcaktuara me Kapitullin XII të Kushtetutës, sikurse edhe për vet Gjykatën Kushtetuese"* – parime këto që, sipas Avokatit të Popullit, nuk janë respektuar.

203. Rrjedhimisht, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që Ligjin e kontestuar ta shpallë si kundërkushtetues në tërësinë e tij.

Thelbi i kundërshtimeve të MAP

204. Gjykata rikujton se thelbi i kundërshtimeve të MAP përkthet me aspektin e ndarjes së pushteteve konsiston në argumentet se Ligji për Pagat nuk është kundërkushtetues për arsyet vijuese: (i) Avokati i Popullit nuk e ka bërë të ditur se si duhej të rregullohej çështja e pagave dhe nuk ka dhënë asnjë indikacion të vetëm se ku është bërë shkelja e Kushtetutës me Ligjin e kontestuar; (ii) se ky rast nuk mund të merret si rast i njëjtë me rastin KO73/16, sepse në këtë të fundit Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e një Qarkoreje Administrative e jo një ligj i miratuar nga Kuvendi i cili *"në mënyrë homogjene ka për qëllim të vendos rregulla për menaxhimin e parasë publike sa i përket pagave të funksionarëve dhe zyrtarëve publikë"*; (iii) Kushtetuta përcakton që Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ ashtu që me nxjerrjen e Ligjit të kontestuar, Kuvendi ka ushtruar mandatin e vet kushtetues; (iv) nuk ka pengesa kushtetuese dhe ligjore që për qëllim të interesit publik me legjislacionin e ri të rregullohet mjedisi ligjor për pagat në sektorin publik; (v) në pajtim edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është brenda fushëveprimit të Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga ligjvënësi dhe se parimi i ndarjes së pushteteve e obligon Gjykatën që të respektojë përcaktimin e politikave nga ligjvënësi; (vi) ligjvënësi, respektivisht Kuvendi, për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik është në pozitë me të mirë se sa

Gjykata për të përcaktuar dhe avancuar politikat ekonomike dhe sociale të vendit; (vii) tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar dhe se kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit; (viii) Kushtetuta nuk parashikon se si do të përcaktohen pagat për gjyqtarët (ose për ndonjë institucion tjetër) e as elementet që e përbejnë pagën por që Kuvendi në rregullimin e këtyre marrëdhënieve është i detyruar të respektojë kërkesat e përcaktuara me Kushtetutë, veçanërisht ato që rrjedhin nga parimet e sundimit të ligjit dhe ato që mbrojnë vlerat kushtetuese; (ix) kur bëhet fjalë për garancitë e pavarësisë materiale të gjyqtareve, legjislativi është veçanërisht i detyruar të respektojë parimin themelor kushtetues të ndarjes së pushteteve si një nga elementet e shtetit të së drejtës; (x) përderisa parimi i ndarjes së pushtetit përcakton pavarësinë e tri pushteteve të qeverisjes, parimi i kontroleve dhe balancimeve përcakton ndërvarësinë e tyre ashtu që të tri pushtetet e qeverisjes nuk mund të veprojnë në izolim prej njëra-tjetrës; (xi) ndërvarësia e tyre, përpos dispozitave kushtetuese, gjithashtu definohet nëpërmjet parimeve të bashkëpunimit, bashkërendimit, kontrollimit dhe balancimit.

205. Rrjedhimisht, MAP kërkon nga Gjykata që Ligjin e kontestuar ta shpallë si kushtetues në tërësinë e tij.

Thelbi i përgjigjeve dhe komenteve të Ministrisë së Financave dhe Transfereve

206. Gjykata rikujton se Ministria e Financave dhe Transfereve ishte përgjigjur në 7 pyetjet e Gjykatës duke dorëzuar kështu edhe disa nga dokumentet dhe krahasimet e kërkuara nga Gjykata (shih paragrafët 23 dhe 24 të këtij Aktgjykimi për pyetjet e Gjykatës; paragrafët 155-175 të këtij Aktgjykimi për përgjigjet e pranuara). Në thelb, në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, Ministria e Financave dhe Transfereve theksoi me sa vijon: (i) pavarësisht se pozitat/kategoritë e përcaktuara në kuptim të gjerë në Ligjin e kontestuar, *“është evidente vështirësia e përcaktimit të pagës për pozitat të cilat nuk janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të pacaktuara”*; (ii) për rreth **42%** të të punësuarve nga lista e pagave aktuale kërkohet klasifikim paraprak për përcaktim të pagës dhe duke qenë se **jo për të gjitha pozitat dihet paga**, dokumenti i dytë shtesë i kërkuar nga Gjykata nuk mund të ofrohet në këtë fazë, meqë një dokument i tillë me listën e të gjithë të punësuarve sipas pozitave nuk ka pasur mundësi të përpilohet për arsyet e lartcekura, por i njëjti do të mund të ofrohet vetëm pas realizimit të procesit të klasifikimit dhe riorganizimit të institucioneve; (iii) në

përgjigje ndaj pyetjes së Gjykatës se cilat pozicionet saktësisht janë përjashtuar nga Ligji i kontestuar, Ministria e Financave kishte theksuar se me fillimin e zbatimit të Ligjit nga buxheti i shtetit do të paguhen të gjitha pozicionet që Shtojcën nr. 1 të Ligjit të kontestuar, përveç përjashtimeve për gjyqësorin dhe AKP-në (deri në vitin 2022) dhe dispozitës së përgjithshme të nenit 1, nënparagrafit 1.1 ku përcaktohet se: *“sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht”* Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI); (iv) pagat për zyrtarët dhe funksionarët publikë janë caktuar me Ligj (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) dhe nuk mundet të caktohen me akt nënligjor – mirëpo *“aktet nënligjore kanë marginë të gjerë që të caktojnë specifika dhe kritere për këtë përcaktim të tërthortë”*; (v) për të gjitha pozitat (rreth 42%) që nuk janë pozita direkte, Ligji i kontestuar *“autorizon Qeverinë me akt nënligjor të miratoj klasat e zbatueshme, grupet e administrimit të veçantë dhe te tjera siç përshkruhet me poshtë, që i nënshtrohen procesit të klasifikimit dhe riorganizimit, i cili në fund do të rezultojë me një pagë përkatëse për secilin të punësuar”*, bazuar në Shtojcën 1 të Ligjit të kontestuar; (vi) Ligji i kontestuar në Shtojcën nr. 1 përcakton dy sisteme të përcaktimit të pagës; (vii) Sistemi i parë, është **përcaktimi direkt i pagave** për pozitat të cilat për nga natyra janë pozita të përveçme, p.sh president, ministër, deputet, mjek etj. dhe meqenëse këto pozita janë unike dhe të pakta për nga vëllimi është vlerësuar që ato të përcaktohen drejtpërdrejt me Ligj pa pasur nevojë për një proces klasifikimi. Sidoqoftë, ky rregull ka pasur përjashtime, kur pozita të shërbimit civil janë përcaktuar si pozita direkte, edhe pse nuk janë unike (për shembull disa nga pozitat nr. 79, 92, 93 në Shërbim Civil). E njëjta ndodh në Kuvendin e Kosovës ku pozitat nga 109-132 rregullohen direkt nga Ligji. Se cilat janë pozitat e përcaktuara në mënyrë direkte e kemi sqaruar në tabelat A dhe B në formatin Excel në CD. (Sqarim: këto tabela janë të qasshme për Gjykatën); (viii) Sistemi i dytë, është **përcaktimi indirekt i pagave** që do të thotë se me Ligjin e kontestuar *“janë caktuar vetëm klasat kryesore prandaj nevojitet edhe një proces klasifikimi”*. Ky sistem zbatohet kryesisht tek pagat e nëpunësve civilë ku neni 5.3 i Ligjit të kontestuar përcakton se *“Klasifikimi i një pozite të caktuar të Shërbimit Civil, sipas paragrafit 2 të këtij neni, krijohet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të Shërbimit Civil, në pajtim me legjislacionin për zyrtarin publik. Klasa që i përket një pozite të caktuar përcaktohet shprehimisht në rregulloren e organizimit të brendshëm të institucionit, të miratuar sipas Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të*

Pavarura". Nga ky paragraf mund të kuptojmë se për tu klasifikuar një pozitë e caktuar e cila është përcaktuar sipas Shtojcës nr. 1 (paragrafi 2 i nenit 5) të Ligjit të kontestuar duhet të plotësohen disa kushte ligjore: (1) Klasifikimi dhe vlerësimi i një pozite të caktuar bëhet sipas vlerësimit dhe klasifikimit të rregullave të përcaktuara në legjislacionin për zyrtarin publik; dhe (2) Klasa që i përket një pozite të caktuar duhet të përcaktohet shprehimisht në rregulloren për organizimin e brendshëm të institucionit sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura; (ix) neni 33.5 i Ligjit për Paga e autorizon Qeverinë që me propozim të MAP, me akt nënligjor të miratojë: (1) klasat e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtimet në çdo klase; (2) grupet e administrimit të veçantë; (3) përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, duke përfshirë këtu kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grup; dhe (4) rregullat e hollësishme, procedurat, standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e një pozite të caktuar në një klasë apo grup të caktuar, sipas këtij neni; (x) akti nënligjor i cekur në pikën më lart u theksua të jetë përgatitur nga MAP dhe përmban të gjitha elementet e përcaktuar në këtë paragraf duke përfshirë edhe metodologjinë e vlerësimit të një pozite të caktuar, por i njëjti nuk ka mund të miratohet nga Qeveria për shkak të masës pezulluese të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese ndaj Ligjit për Zyrtarët Publikë; (xi) Ligji i kontestuar ka lidhje organike me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, prandaj edhe klasifikimi i vendeve të punës duhet të behet me këtë logjikë; ligji mund të zbatohet në tërësi vetëm pasi të plotësohen kushtet e lartshënuara; (xii) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që do të duhej të aprovoreshin nga Kuvendi dhe Qeveria deri më tani është miratuar vetëm një (1) akt nënligjor; (xiii) edhe ky akt i vetëm nënligjor që është miratuar, në fakt është aprovuar pa vlerësimin e ndikimit buxhetor të departamentit të buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Transferove, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi të financave publike dhe Ministria e Financave nuk ka qenë anëtare e grupit punues; (xiv) për përgatitjen e dy akteve nënligjore të Ligjit të kontestuar përgjegjës është Kuvendi; ndërsa njëmbëdhjetë (11) aktet tjera nënligjore janë përgatitur nga grupet punuese dhe kanë kaluar nëpër fazat e konsultimit publik, por nuk kanë arritur/nuk kanë mundur të procedohen për aprovim në Qeveri për shkak se në atë kohë Qeveria ka qenë në dorëheqje dhe për shkak të masës pezulluese të Gjykatës Kushtetuese ndaj Ligjit të kontestuar; (xv) Ministria e Financave dhe Transfereve potencoi se në situatën aktuale rezulton se *“pa pasur rregulloren për klasifikim si dhe pa u kryer ri-organizimi i institucioneve është e pamundur të përcaktohet paga për*

secilin të punësuar, pra nuk është e mundur të përpilohet lista e pagave që do të disbursoheshin me Ligjin për mbi 80 mijë përfitues” [Sqarim: Gjykata kishte kërkuar specifikisht nga Ministria e Financave dhe Transfereve që të dorëzojnë dy dokumente në Gjykatë – një dokument që tregon pagat aktuale dhe një dokument tjetër që tregon se si do të ishin pagat sikurse Ligji i kontestuar të zbatohet].

207. Rrjedhimisht, në fund Ministria e Financave dhe Transfereve theksoi se Gjykata duhet të ketë parasysh katër aspekte vijuese: (i) edhe sikur Ligji i kontestuar **“të jetë në fuqi, i njëjti nuk do të mund të zbatohet në tërësi dhe menjëherë”**; (ii) **“në bazë të një vlerësimi preliminar të kostos së Ligjit (vlerësim që ka ndryshuar që nga drafti i parë i Ligjit deri në aprovim në Kuvend), me nivelin e koeficienteve dhe vlerën e koeficientit të përcaktuar me këtë ligj (239), fatura e pagave sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar do të tejkalojë kufirin e lejuar (rregullën fiskale të pagave), Neni 22/C Kufizimi i rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje, që do të përbënte thyerje të rregullës fiskale, me refleksione në deficit (si shpenzime rrjedhëse që vazhdojnë) si dhe në nevojën për financim të vazhdueshëm të deficitit. Janë edhe një serë shtesash që Ligji i parasheh, dhe që do ta rendonin edhe me tej situatën sa i përket financimit të këtij Ligji. Në këtë kontekst, duhet të kihet parasysh se neni 81 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ka paraparë një dispozitë të epërsisë ligjore të saj, karshi ligjeve tjera, në çështjet që ndërlidhen me menaxhimin e parasë publike dhe kjo vlerësojmë se duhet të vlerësohet nëse është në përputhje me parimet e përcaktuara për paranë publike në nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”; (iii) në “vështrim të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, vërejmë dispozita horizontale dhe kritere të njëjta në organizimin e administratës shtetërore, konkretisht të Zyrës së Kryeministrit, sistemeve ministrore (ministri, agjenci ekzekutive dhe administrata e shërbimeve publike) dhe agjencive rregullatorë. Konkretisht, ky Ligj për sistemet ministrore paracakton në mënyrë të njëjtë kriteret për të themeluar agjenci ekzekutive, departamente apo divizion. Në anën tjetër, hartimi i ndryshëm i pagave për udhëheqësit apo stafin e këtyre strukturave në disa raste sipas dispozitave të Ligjit, ndër tjerash, mendojmë se duhet vlerësuar nëse është në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me paranë publike; (iv) po ashtu Ministria e Financave dhe Transfereve theksoi se “një vlerësim të njëjtë duhet të bëhet edhe për disa kategori të zyrtarëve financiarë të rëndësishme për procesin e menaxhimit dhe kontrollit financiar (shembull**

auditorët e brendshëm) nuk kanë trajtim të veçantë dhe nuk janë përcaktuar si pozita të veçanta.”

Parimet e përgjithshme

208. Për të elaboruar në mënyrë të gjerësishme parimet e përgjithshme relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të paraqesë: (1) parimet e përgjithshme sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në çështje të krahasueshme kushtetuese me çështjen kushtetuese të rrethanave të rastit konkret; (2) përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias; (3) Opinione relevante të Komisionit të Venecias dhe vendime të tjera të gjykatave të ndryshme – sipas propozimit të Komisionit të Venecias.

Parimet e përgjithshme sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktika gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

Parimet relevante sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

209. Ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, janë edhe “ndarja e pushteteve” dhe “sundimi i ligjit” (shih, neni 7 i Kushtetutës). Funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre (shih, neni 4 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 4 të Kushtetutës përkitazi me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve: (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; dhe (iii) Gjyqësori është unik dhe i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Këto tri pushtete, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve. Raporti në mes të “tri pushteteve” mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve si parim themelor i nivelit më të lartë kushtetues është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë është i panegociueshëm (shih rastet e Gjykatës: KO72/20, me parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, paragrafi 351; KO43/19, parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 27 qershorit 2019, paragrafi 72;

KO98/11, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, paragrafi 44).

210. Secilit nga tri degët klasike të ndarjes së pushteteve, Kushtetuta i ka dedikuar një kapitull të veçantë. Pushteti ligjvënës rregullohet përmes Kapitullit IV të Kushtetutës, të titulluar: “*Kuvendi i Republikës së Kosovës*”. Pushteti ekzekutiv rregullohet përmes Kapitullit V të Kushtetutës, të titulluar: “*Qeveria e Republikës së Kosovës*”. Pushtetit gjyqësor rregullohet përmes Kapitullit VII të Kushtetutës, të titulluar: “*Sistemi i Drejtësisë*”. Në të tre kapitujt e lartcituara të Kushtetutës parashihihen parimet e përgjithshme si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet. Përveç kësaj, aty parashihihen edhe mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra tjetrën pa krijuar ndonjë “ndërhyrje”, “varësi” apo “vartësi” kundërkushtetuese në mes tyre që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo pushtetit tjetër. Për shembull, Kuvendi kontrollon dhe balancon Qeverinë përmes votës së besimit/mosbesimit; sistemi i drejtësisë mban “nën përgjegjësi” Qeverinë por edhe Kuvendin përmes kontrollimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së vendimmarrjes së tyre, etj. Theksi këtu është pikërisht në termin “*kundërkushtetues*” kur flitet për ndërhyrje, varësi dhe vartësi në mes të tri pushteteve. Kjo për faktin se dihet mirëfilli se për kryerjen e detyrave të tyre publike, pushtetet në fjalë nuk veprojnë në vakum dhe pa asnjë ndërveprim në mes tyre. Pa dyshim që veprimet e tyre ndikojnë në pushtetet e tjera dhe kjo është krejtësisht normale. Megjithatë, logjika e parimit të ndarjes së pushteteve është që ndikimi i tillë kurrësi nuk duhet të krijoj një raport ndërhyrës apo të varësisë ose vartësisë që do të mund të rezultonte në humbje të pavarësisë për të vepruar si pushtet i lirë dhe i pandikuar. Kjo përbën esencën e ekuilibrit kushtetues që Kushtetuta ka përcaktuar e që kërkohet të mbahet në çdo instancë ndërvepruese në mes të pushteteve të pavarura.
211. Përveç tri pushteteve klasike, vend të veçantë në sistemin e ndarjes së pushteteve ka edhe Gjykata Kushtetuese, si institucion përgjegjës për garantimin përfundimtar të kushtetutshmërinë në nivel vendi; dhe Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik të institucionit (shih Aktgjykimin KO72/20, paragrafi 351). Të dyja këtyre institucioneve publike, Gjykatës Kushtetuese dhe Presidentit, Kushtetuta i ka dedikuar nga një kapitull të veçantë, respektivisht kapitujt V dhe VIII – ku përshkruhen statusi dhe kompetencat e tyre të veçanta sipas Kushtetutës. Asnjëri nga këto dy institucione nuk bëjnë pjesë në kapitujt e ndarjes klasike të pushteteve por që të dyja figurojnë specifikisht në nenin 4 të

Kushtetutës ku dhe përshkruhet “Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit” në nivel të Republikës së Kosovës. Kjo zgjidhje kushtetuese meriton të shënohet si një e veçantë e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.

212. Më tutje, Kushtetuta i ka njohur një status dhe rol të veçantë e të rëndësishëm në mbarëvajtjen e detyrave publike shtetërore edhe Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, të cilat janë veçuar si të tilla jo pa arsye. Në këtë kapitull bëjnë pjesë: (i) Avokati i Popullit (nenet 132, 133, 134 dhe 135 të Kushtetutës); (ii) Auditori i Përgjithshëm i Kosovës (nenet 136, 137 dhe 138 të Kushtetutës); (iii) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (neni 139 i Kushtetutës); (iv) Banka Qendrore e Kosovës (neni 140 i Kushtetutës); (v) Komisioni i Pavarur i Medieve (neni 141 i Kushtetutës); dhe (vi) Agjencitë e Pavarura (neni 142 i Kushtetutës).
213. Si premisë thelbësore, duhet të theksohet dhe qartësohet se asnjë nga këto institucione të pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës nuk janë pjesë e pushteteve klasike të definuara sipas nenit 4 të Kushtetutës. Thënë këtë, nuk ka asnjë dyshim se këto institucione kanë një status të veçantë sipas Kushtetutës meqenëse hartuesit e kësaj të fundit kanë konsideruar se duhet t’iu dedikohet një Kapitull i veçantë me rregullim të veçantë kushtetues. Leximi i dispozitave të lartcekura për secilin institucion të pavarur të referuara në Kapitullin XII dërgon në përfundimin që as ato nuk janë identike me njëra tjetrën për nga aspekti i përgjegjësisë dhe detyrave publike që u janë besuar. Secili nga ato institucione ka specifikat e veta, varësisht nga detyra publike që iu është besuar. Gjithsesi, një emërues i përbashkët i të gjitha institucioneve të referuara në Kapitullin XII është që ato janë institucione të pavarura “në ushtrimin” e detyrave të tyre publike dhe se një rregullim i tillë kushtetues duhet të merret parasysh nga të gjithë akterët publik në nivel të Republikës së Kosovës – në rastet kur krijohen iniciativa legjislative që mund të krijojnë “ndërhyrje” në pavarësinë e tyre të nivelit kushtetues.
214. Për dallim nga institucionet e referuara në pikat (i), (ii), (iii), (iv) dhe (v) që janë institucione të themeluara me Kushtetutë specifikisht; Agjencitë e Pavarura të referuara në pikën (vi) “*janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre*” (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi KO171/18, paragrafi 156). Ky dallim është i nevojshëm të evidentohet si i tillë çfarë është, për një arsye të rëndësishme. Kjo sepse të pesë Institucionet e Pavarura të referuara në pikat (i), (ii), (iii), (iv) and (v) janë krijuar si të tilla me rastin e votimit dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës ekzistuese nga ligjvënësi,

respektivisht Kuvendi; ndërkaq, Agjencitë e Pavarura nuk janë krijuar si të tilla me rastin e votimit të Kushtetutës ekzistuese nga ligjvënësi, respektivisht Kuvendit – por janë agjenci për krijimin e të cilave Kushtetuta ia jep Kuvendit të drejtën t’i krijojë dhe t’i shuaj, me ligj, varësisht nga nevojat që mund të paraqiten në jetën publike dhe shoqërore. Për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuaj “me ligj” Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuaj “me ligj” ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Ato pesë institucione të pavarura janë krijuar me Kushtetutë dhe mund të amendamentohen, ndryshohen, plotësohen, vetëm me Kushtetutë, përmes amendamentimit të kësaj të fundit. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës – e cila duhet të merret parasysh si e tillë sa herë që ndërmerren veprime që i prekin ato.

215. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të potencohet që fjala “Pavarura” që i referohet këtyre institucioneve nuk duhet të nënkuptohet si ingerencë kushtetuese për të vepruar në izolim dhe vakum nga pushtetet e tjera të përcaktuara me Kushtetutë. Fjala “Pavarura” duhet kuptuar si garanci kushtetuese për ushtrim dhe kryerje të detyrave publike në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar, në aspekt të vendimmarrjes, nga pushtetet e tjera. Kjo kurrësi nuk do të thotë se Qeveria dhe Kuvendi nuk mund të plotësojnë dhe ndryshojnë rregullativën e aplikueshme ligjore për veprimtarinë e këtyre institucioneve – përderisa e njëjta amendamentohet në përputhje me garancitë e tyre të nivelit kushtetues.
216. Gjykata, në fund, rikujton se të gjitha pushtetet “[...] pa përjashtim, qofshin ato pjesë të trekëndëshit klasik të ndarjes së pushteteve, qofshin ato pjesë tjetër e rëndësishme e strukturës së shtetit, kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto pushtete kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike me qëllim të jetësisimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës” (shih Aktgjykimi KO72/20, paragrafi 353).
217. Në këto detyra publike përfshihet edhe obligimi i secilit pushtet që përgjatë kryerjes së detyrave kushtetuese të përkujdeset për respektim të pavarësisë së pushtetit tek i cili po krijon një “ndërhyrje”. Kjo e fundit duhet të matet, kontrollohet, balancohet dhe konfirmohet paraprakisht, në aspekt *bona fide*, si “ndërhyrje kushtetuese” para se të ndërmerret ndonjë veprim për ekzekutim të ndërhyrjes së synuar – e cila potencialisht mund të jetë e lejueshme. Për shembull, Qeveria dhe Kuvendi, megjithëse e kanë kompetencën për të propozuar dhe

votuar ligje, respektivisht, e të cilat do të mund të ndikojnë edhe në sferën e gjyqësorit, si pushtet i tretë; ato [Qeveria dhe Kuvendi] duhet të sigurohen që gjatë hartimit të nismave të tyre ligjore e deri në finalizimin e tyre me votë të Kuvendit të ruhet pavarësia kushtetuese e pushtetit simotër, respektivisht gjyqësorit. Kujdes dhe ndjeshmëri të njëjtë, Qeveria dhe Kuvendi, duhet të tregojnë edhe për akterët e tjerë shtetërorë të cilët Kushtetuta i ka pajisur me garanci kushtetuese të pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore. Garantimi dhe sigurimi paraprak i kushtetutshmërisë së iniciativave të Qeverisë dhe Kuvendit duhet të jetë pjesë thelbësore e veprimtarisë së këtyre dy pushteteve.

218. Parimi i sigurisë juridike dhe ai i parashikueshmërisë janë tipare të qenësishme të një ligji dhe pjesë përbërëse të parimit kushtetues të sundimit të ligjit. Siguria juridike është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit dhe kërkon, në mes tjerash, që rregullat të jenë të qarta dhe të sakta, dhe të synojnë të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme. Parashikueshmëria para se gjithash kërkon që norma ligjore të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme, ashtu që t’iu mundësohet individëve dhe subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljet e tyre në përputhje me të. Individët dhe subjektet tjera juridike duhet të të dinë saktësisht se si dhe sa ndikohen nga një normë e caktuar ligjore dhe se si një normë e re ligjore e ndryshon statusin ose gjendjen e tyre të mëparshme të paraparë me një normë tjetër ligjore. Autoritetet publike, gjatë hartimit të ligjeve duhet të marrin parasysh edhe këto parime bazë të sundimit të ligjit – si pjesë të rëndësishme të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.
219. Në dritën të kësaj që u tha më sipër, Gjykata në vijim do të rikujtojë praktikën e saj gjyqësore në të cilën, në fakt, për të disatën herë, veçse janë theksuar këto parime të përgjithshme për ndarje të pushtetit. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese përmes së cilës interpretohen nene të caktuara të Kushtetutës është e detyrueshme për të gjitha institucionet publike dhe individët në Republikën e Kosovës. Si e tillë, përveç Kushtetutës, edhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, e cituar në këtë Aktgjykim dhe në vendime të tjera të Gjykatës, duhet të mishërohet në çdo iniciativë ligjore që mund të shndërrohet në ligj vendi.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese - Aktgjykimet KO73/16 dhe KO171/18

220. Arsyetimi i Gjykatës në rastin KO73/16 (shih gjerësisht paragrafët 61-96; ndërsa më poshtë të cituar vetëm disa nga ata paragrafë), e që

është drejtpërsëdrejti relevant, në nivel parimesh, për rrethanat e rastit konkret – në aspekt të ndarjes së pushteteve dhe respektimit të garancive kushtetuese të pavarësisë institucionale, thekson:

“61. Siç parashihet me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Rrjedhimisht, Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ, Qeveria pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësori pushtetin gjyqësor. Jashtë tyre janë institucionet e tjera shtetërore, ndër të tjera, Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese.

62. Gjykata vëren se Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Kushtetuese u janë ofruar rregullime të detajuara dhe ekstensive kushtetuese, në krahasim me institucionet e tjera të pavarura sipas Kapitullit XII. Për këtë arsye, Gjykata do të merret në mënyrë më ekstensive me këto dy institucione, por nënvizon se pavarësia kushtetuese është gjithashtu po aq e aplikueshme ndaj institucioneve të tjera të pavarura. Gjykata gjithashtu vëren se institucionet e tjera të pavarura kanë mandat dhe autoritet tjetër, siç përcaktohet me Kushtetutë, dhe specifikiteti i statusit të tyre kushtetues duhet të respektohet. Është detyrë e Qeverisë që në tërësi të marrë parasysh këtë arsye. [...]

65. Siç vëren Gjykata, parashtruesi i kërkesës [Avokati i Popullit] dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë pjesë e legjislativit, e ekzekutivit dhe e gjyqësorit të rregullt. E njëjta vlen për institucionet e tjera të pavarura të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës. [...]

87. Gjykata konsideron që qasja e MAP-it se duhet të vendoset klasifikimi dhe kategorizimi i vendeve të punës dhe i pagave sipas parimit “Pagesë të barabartë për punë të barabartë” duhet të interpretohet ndryshe dhe të aplikohet në mënyrë të diferencuar në raport me parashtruesin e kërkesës dhe me Gjykatën, në veçanti. Një qasje teknike dhe unifikuese shpërfill rolin dhe autoritetin e tyre të definuar me Kushtetutë dhe, si e tillë, prek në pavarësinë që u është akorduar atyre me Kushtetutë dhe që është elaboruar më tej me ligjet e tyre organike dhe me rregulloret e tyre të punës.

88. Personeli që punon në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe në Gjykatë ka përgjegjësi të ndryshme të punës krahasuar me pozita të ngjashme në institucionet e tjera dhe ky diferencim eksplícit reflektohet në përshkrimet e tyre të punës dhe në pagë dhe kjo duhet të ruhet.

89. *Për më tepër, pavarësia funksionale dhe organizative e parashtruesit [Avokatit të Popullit] dhe e Gjykatës pashmangshëm është e ndërlidhur dhe e nënkupton pavarësinë e tyre financiare dhe buxhetore sipas Kushtetutës dhe ligjeve organike përkatëse. Qarkorja Administrative e kontestuar nuk respekton, në mënyrë të duhur ose deri në masën e nevojshme, pavarësinë e tyre të trefishtë: organizative, funksionale dhe financiare, dhe specifikat e punës së stafit të tyre.*

[...]

97. *Gjykata konsideron se institucionet e pavarura, të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe, në veçanti, parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata gjenden jashtë tri degëve të pushtetit dhe, si të tilla, ato nuk janë dhe nuk mund të përfshihen në ndërveprimin e ndarjes së pushtetit dhe të kontrollit dhe balancimit që karakterizon të tri degët e pushtetit. Rrjedhimisht, ato kanë status kushtetues specifik që duhet të respektohet nga autoritetet qeverisëse.*

98. *Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata, në veçanti, u asistojnë tri degëve të pushtetit në sigurimin e sundimit të ligjit, në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe në epërsinë e Kushtetutës, gjë që i bën ato institucione të specializuara dhe në mënyrë unike të pavarura.*

100. *Gjykata pajtohet se Qeveria ka detyrë dhe prerogativë kushtetuese të jetë politikëbërës i Shtetit, përfshirë klasifikimin dhe kategorizimin e vendeve të punës. Por Gjykata vlerëson se nuk mund të pritet që stafi i institucioneve të pavarura me Kushtetutë të jetë konform, në mënyrë identike, me sistemin e rekrutimit, klasifikimit të vendeve të punës, kategorizimit dhe pagave të përcaktuara me një akt juridik të natyrës së përgjithshme të nxjerrë nga Qeveria, apo me qfarëdo akti të degës së ekzekutivit, pa marrë parasysh paraprakisht, në mënyrë të duhur, specifikat dhe veçantinë institucioneve në fjalë. Prandaj, Gjykata gjen se Qarkorja Administrative në tërësi cenon dispozitat e Kushtetutës të përcaktuara në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura].”*

221. Arsyetimi i Gjykatës në rastin KO171/18 (shih gjerësisht paragrafët 117-137; ndërkaq më poshtë të cituar vetëm disa nga ato paragrafe), e që është drejtpërsëdrejti relevant, në nivel parimesh, për rrethanat e rastit konkret – në aspekt të ndarjes së pushteteve dhe respektimit të garancive kushtetuese të pavarësisë institucionale, thekson:

“144. Gjykata rikujton edhe njëherë se sipas Kushtetutës dhe ligjeve të veçanta ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil, për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Kjo nënkupton edhe ligjet që rregullojnë mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve, si dhe të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, ashtu siç buron nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, institucionet e pavarura, veçanërisht parashtruesi [Avokati i Popullit] dhe Gjykata, janë të autorizuar që të nxjerrin rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Këto norma të veçanta duhet të respektohen nga të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Këshillin.

145. Andaj, Gjykata konsideron se gjatë zbatimit të Ligjit të kontestuar duhet të njihen funksionet dhe autoriteti specifik i institucioneve të pavarura kushtetuese që reflektohet, inter alia, në nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre organizative, funksionale dhe buxhetore, ashtu siç kërkohet me parimet e elaboruara më lart, duke përfshirë rregullat e brendshme të këtyre institucioneve dhe specifikat e punës së personelit të tyre.

146. Gjykata, rrjedhimisht, konkludon se kompetencat e Këshillit të parapara me Ligjin e kontestuar zbatohen edhe ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese, përderisa kjo nuk cenon pavarësinë e tyre të garantuar me Kushtetutë, e që kjo pavarësi reflektohet në nxjerrjen e akteve të brendshme të këtyre institucioneve, në bazë të kompetencave të tyre të parapara me Kushtetutë dhe ligje të veçanta, për të mbrojtur pavarësinë e tyre. [...]

157. Gjykata vëren se agjencitë e pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar në mënyrë shprehimore me Kapitullin XII të Kushtetutës, për shkak të rëndësisë dhe specifikave të autorizimeve kushtetuese që ato ushtrojnë. Ndërsa roli, statusi dhe kompetencat e agjencive të pavarura rregullohen me ligjin e miratuar nga Kuvendi në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 142 të Kushtetutës.

158. Kapitulli XII i Kushtetutës nuk e autorizon Kuvendin e Kosovës që përmes ligjit të themelojë institucione të tjera të pavarura kushtetuese me statusin e njëjtë të institucioneve të pavarura të përfshira në kapitullin XII, por vetëm agjenci të pavarura duke i dhënë autorizimet e përcaktuara sipas nenit 142 të Kushtetutës.

159. Andaj, Gjykata vlerëson se Këshilli nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës.”

Përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias

222. Siç është reflektuar në procedurën para Gjykatës, kjo e fundit iu ishte drejtuar me disa pyetje specifike Forumit të Komisionit të Venecias. Gjykata pranoi gjithsej dhjetë (10) përgjigje, përmbajta e të cilave do të pasqyrohet në vijim.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë

223. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë theksoi se sistemi i rregullimit të pagave në Kroaci është i tillë që pagat e zyrtarëve publikë janë të rregulluara me disa ligje. Në këtë aspekt, ata theksuan se: (i) Ligji për të Drejtat dhe Detyrimet e Zyrtarëve Shtetërorë rregullon pagat e zyrtarëve shtetërorë si në vijim: Presidenti i Republikës së Kroacisë, Kryetari dhe Nënkyetari i Parlamentit Kroat; Anëtarët e Parlamentit Kroat; Kryeministri dhe Anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kroacisë (Ministrat); Kryetari, Nënkyetari dhe Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë; Kryetari, Nënkyetari dhe Anëtarët e Komisionit Shtetëror për Zgjedhje të Republikës së Kroacisë; sekretarët shtetërorë; Drejtori i Përgjithshëm i Policisë; Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore; Drejtori i Përgjithshëm i Doganave; Auditori i Përgjithshëm i Shtetit dhe zëvendësit e tij apo të saj; Sekretari i Parlamentit Kroat; Sekretari i Përgjithshëm i Republikës së Kroacisë; Drejtori i Institutit Kroat për Sigurime Pensionale; Drejtori i Institutit Kroat për Sigurime Shëndetësore; Drejtori i Institutit Kroat për Punësim; Kryetari i Këshillit Kombëtar për Minoritete; zyrtarët shtetërorë në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kroacisë etj. Më tutje, (ii) Ligji për Pagat e Gjyqtarëve dhe Zyrtarëve të tjerë Gjyqësorë rregullon pagat e gjyqtarëve (përfshirë dhe kryetarët e gjykatave), si dhe prokurorët dhe zëvendës prokurorët. Në fund, përmes (iii) Ligjit për Shërbyesit Civilë rregullohet pagat e shërbyesve civilë të punësuar në organet qendrore dhe lokale të pushtetit shtetëror; shërbyesit lokal që shërbejnë në organet lokale dhe qarqe; shërbyesit publik të punësuar në shërbimet publike të financuara nga organet qendrore; dhe shërbyesit publik që

shërbejnë në institucionet e financuara organet lokale të pushtetit shtetërorë (shkollat e infermierisë, bibliotekat, muzetë etj.).

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë

224. Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë theksoi se çështja e pagës është e një rëndësie të madhe dhe si e tillë i takon legjislaturës së zgjedhur në mënyrë demokratike për të vendosur për mënyrën e rregullimit. Prandaj, paga e shërbyesve civilë dhe pjesëtarëve të gjyqësorit është rregulluar me ligj. Deri më tani, theksohet në përgjigje, parimi i ndarjes së pushteteve nuk ka qenë çështje në kontekst të ligjeve për paga. Gjykata Federale Kushtetuese zbaton standard të rreptë të shqyrtimit lidhur me ligjet për pagat e shërbyesve civilë dhe pjesëtarëve të gjyqësorit. Gjykata Federale Kushtetuese i vë rëndësi të madhe pavarësisë financiare dhe personale të pjesëtarit individual të gjyqësorit apo shërbyesit civil individual. Në një vendim të vitit 2015, Gjykata Federale Kushtetuese konstatoi se pavarësia e gjyqësorit duhet gjithashtu të sigurohet me pagat e gjyqtarëve. Kohëve të fundit, nuk duket të ketë ndonjë rast ku janë ulur pagat për shërbyesit civil apo pjesëtarët e gjyqësorit që veç ishin në shërbim. Në vitin 2018, Gjykata Federale Kushtetuese nxori vendim lidhur me pagën fillestare të shërbyesve civilë dhe pjesëtarëve të gjyqësorit. Në mënyrë që të konsolidohet buxheti shtetëror, Landi i Baden-Württemberg kishte ulur pagën fillestare të disa grupeve të shërbyesve civilë dhe pjesëtarëve të gjyqësorit. Gjykata Federale Kushtetuese konstatoi që kjo ishte kundër-kushtetuese pasi që cenonte parimin e alimentacionit. Përveç pagës, po ashtu pagesat speciale apo pezullimi i pagës i nënshtrohen shqyrtimit nga Gjykata Federale Kushtetuese në rast se kontestohen.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Meksikës

225. Gjykata Supreme e Meksikës shpjegoi se “ligji federal i punëtorëve të shtetit” përcakton që Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjyqësori (Pushtetet e Federatës) do të përcaktojnë nivelet e pagave për punëtorët e tyre. Kjo nënkupton se secili pushtet, veç e veç, mund të përcaktojë se sa duhet paguar shërbyesit publik të tyre. Megjithatë, duhet vënë re se ka disa kufizime kushtetuese ndaj pushtetit për të caktuar pagat e shërbyesve publik. Bazuar në Kushtetutën e Meksikës, asnjë shërbyes publik nuk mund të marrë pagë më të lartë se sa ajo që është caktuar për Presidentin e Meksikës dhe as të barabartë ose më të lartë se sa eprori i tij në hierarki. Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në Meksikë ka përcaktuar se parimi i ndarjes së pushteteve ka vënë tri ndalesa: nuk ka ndërhyrje, nuk ka varësi, dhe nuk ka vartësi (*subordination*). Në atë mënyrë, asnjë prej pushteteve të Shtetit nuk

mund të ndërmerr veprime që nënkuptojnë ndërhyrje në sferën e kompetencave të pushtetit tjetër, që do të shkaktonte varësinë e njëjës degë apo që do të pretendonte vartësinë (*subordination*) e një organi autonom. Gjykata Supreme po ashtu ka shpjeguar se autonomia e pushtetit publik nuk nënkupton përjashtim nga sistemi ligjor. Thënë ndryshe, Gjykata Supreme ka njohur të drejtën e Legjislativit për t'i rregulluar disa aspekte të organeve autonome dhe të degëve tjera nëse ligjet në fjalë nuk përbëjnë ndërhyrje, varësi dhe vartësi.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Moldavisë

226. Gjykata Kushtetuese e Moldavisë lidhur me sistemin e pagave të shërbyesve civil, shpjegoi, mes tjerash, se përcaktimi i niveleve të diferencuara të pagës për seksionin “Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese”, në lidhje me seksionet e pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv, ndikon në parimet e ndarjes dhe bashkëpunimit të pushtetit shtetëror dhe të barazisë të përcaktuar me Kushtetutë. Po ashtu në lidhje me pagat e shërbyesve civilë të punësuar në gjykata si dhe për gjyqtarët, Gjykata Kushtetuese shpjegoi se si, çështje parimi, gjyqësori gjatë ushtrimit të detyrave të tyre përfitojnë nga përkrahja e punëtorëve të specializuar, të cilët i garantojnë gjyqësorit një veprimtari institucionale efektive në interes të palës ndërgjyqëse. Përkitazi me pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Moldavisë shpjegoi se Gjykata Kushtetuese është shtyllë e demokracisë dhe sundimit të ligjit, çka i kontribuon funksionit të mirëfilltë të pushtetit publik përbrenda marrëdhënies kushtetuese të ndarjes, balancës, bashkëpunimit dhe kontrollit të pushteteve shtetërore. Për të siguruar epërsinë e Kushtetutës dhe ndarjen e pushteteve, është e domosdoshme që Gjykata Kushtetuese ta ushtroj funksionin e saj pavarësisht nga ndonjë autoritet publik tjetër. Një nga garancitë e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese është sigurimi i pavarësisë funksionale dhe financiare të fushëveprimit të juridiksionit kushtetues. Përkitazi me uljen e pagave në sektorin publik, u shpjegua se ulja e pagave mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize objektivisht ekzistuese ekonomike dhe financiare, të njohur zyrtarisht, në rast të uljes korrekte të të gjitha ose pjesës dërmuese të kategorive të pagave të punonjësve buxhetor, në pajtim me parimin e solidaritetit. Veç kësaj, edhe në këto kushte, ligjvënësi është i obliguar të merr parasysh veçoritë dhe rëndësinë e sistemit gjyqësor, ashtu që të mos ndikojë në parimin e pavarësisë së gjyqtarëve.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë

227. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë shpjegoi se tri kushte duhen plotësuar njëkohësisht në mënyrë që ulja e pagave të jetë kushtetuese:

(i) ulja është mjaftueshëm e justifikuar nga situata e vështirë ekonomike e vendit, është proporcionale në raport me situatën ekonomike dhe nuk rrezikon standardin e të jetuarit të gjyqtarëve; (ii) ulja është e përkohshme dhe zgjat vetëm aq sa është e nevojshme; (ii) ligjvënësi nuk ka vepruar në mënyrë arbitrare në zbatim të uljes. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë më tej shpjegoi se paga e gjyqtarëve nuk është e rregulluar shprehimisht me Kushtetutë por që parimi se pagat e gjyqtarëve mund të ulen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm në masën e nevojshme dhe kohën e nevojshme mund të konkludohet nga parimet kushtetuese të ndryshme siç janë ndarja e pushteteve, barazia e degëve të pushtetit shtetëror, pavarësia gjyqësore dhe proporcionaliteti.

Kontributi i dorëzuar nga Tribunali Kushtetues i Polonisë

228. Tribunali Kushtetues i Polonisë shpjegoi se në praktikën gjyqësore të tij është theksuar se parimi i ndarjes dhe balancës ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor nuk nënkupton izolimin e pushteteve dhe mungesën e varësisë së ndërsjellë. Kjo rrjedhë nga parimi i ndalimit të ndërhyrjes në sferën e pushteteve që bien në kompetencë të veçantë të secilit prej degëve të pushtetit shtetëror. Për atë arsye, formësimi i sistemit të pagave të gjyqtarëve nga dega e legjislativit cenon parimin kushtetues të tri degëve dhe balancës së pushteteve, për aq sa sistemi në fjalë do të themelonte korrelacion ndërmjet pagës në fjalë dhe ushtrimit të pushtetit ekskluziv të gjykatave. Më tutje, Tribunali në fjalë shpjegoi se ka përvijuar kufijtë që degët legjislative dhe ekzekutive nuk mund t'i tejkalojnë gjatë përcaktimit të mënyrës së pagës së gjyqtarëve e që janë: (i) paga e gjyqtarëve duhet të përcaktohet në atë mënyrë që përjashton çfarëdo diskrecioni – sa i përket këtij grupi profesional në tërësi, nga ana e degës së ekzekutivit, por edhe sa i përket gjyqtarëve individual, lartësia e pagës të cilëve nuk mund të bazohet mbi vlerësimin individual të punës së tyre; (ii) shumta e pagës së gjyqtarit – përfshirë dhe gjyqtarin që sapo ka filluar shërbimin e tij apo të saj si gjyqtar i gjykatës së qarkut – duhet që në mënyrë të konsiderueshme ta tejkalojë shumën e pagës mesatare në sektorin publik; (iii) në aspektin afatgjatë, paga e gjyqtarëve duhet të ketë tendencë të rritjes, jo në një nivel më të vogël se sa paga mesatare në sektorin publik; (iv) në rast të situatës financiare të vështirë të shtetit, paga e gjyqtarëve duhet të mbrohet ndaj ndryshimeve me dëm të tepruar në një shkallë më të lartë sesa paga e të gjithë funksionarëve dhe punonjësve tjerë të sektorit publik; (v) është e papranueshme, nga aspekti normativ, ulja e shumës së pagës së gjyqtarit, përveç në situatat e tejkalimit të limitit të borxhit kombëtar.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Suedisë

229. Gjykata Supreme e Suedisë shpjegoi se sikurse gjykatat e tjera në Suedi, Gjykata Supreme pranon fond vjetor nga Administrata Suedeze e Gjykatave Shtetërore (ASGJSH). ASGJSH është autoriteti i pavarur shtetëror që i raporton Qeverisë dhe është përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm të çështjeve që ndërlidhen me gjykatat suedeze. Thënë ndryshe, ASGJSH prezanton projekt-buxhetin tek Qeveria për çdo vit, e cila më pas e dorëzon një propozim tek Parlamenti. Ky i fundit merr vendim përfundimtar përkitazi me buxhetin. ASGJSH i shpërndan fondet e ndara pas dialogut me gjykatat. Fjala e fundit për pagat individuale të gjyqtarëve mbetet tek kryetari i gjykatës përkatëse. Pagat e gjyqtarëve të rangut të lartë, siç janë gjyqtarët e Gjykatës Supreme, vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm i ASGJSH.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Maltës

230. Gjykata Kushtetuese shpjegoi se në Maltë pagat e gjyqtarëve janë të mbrojtura nga Kushtetuta dhe asnjë mënyrë nuk mund të zvogëlohen.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut

231. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut shpjegoi se nuk ka një dispozitë kushtetuese që shprehimisht autorizon Kuvendin për t'i rregulluar pagat në sektorin publik. Megjithatë, Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut ia akordon Kuvendit autorizimin e përgjithshëm për të miratuar ligje me qëllim të rregullimit të marrëdhënieve në të gjitha sferat e jetës sociale. Veç kësaj, paragrafi 5 i nenit 32 të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut përcakton se ushtrimi i të drejtave të punonjësve dhe statusi i tyre rregullohen me ligj dhe marrëveshje kolektive. Në shkurt 2014, Kuvendi miratoi Ligjin për punonjësit e sektorit publik, i cili hyri në fuqi në shkurt 2015 ku në nenin 1 të tij thuhet: "Ky ligj rregullon parimet e përgjithshme, klasifikimin e vendeve të punës, regjistrimet, llojet e punësimit, etj. të drejtat e përgjithshme, detyrat dhe detyrimet, lëvizshmërinë, si dhe çështje të tjera të përgjithshme në lidhje me punonjësit e sektorit publik. Neni 2 përcakton fushën e këtij ligji: (i) punëdhënësit e sektorit publik (në tekstin e mëtejshëm: institucionet), në përputhje me këtë ligj, janë: organet e autoriteteve shtetërore dhe vendore dhe organet e tjera shtetërore të krijuara në përputhje me Kushtetutën dhe ligji; dhe institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e arsimit, shkencës, shëndetit, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes

së fëmijëve, sportit, si dhe aktivitete të tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, dhe të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike, dhe ndërmarrjet publike të krijuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose komunat, Qyteti i Shkupit, si dhe komunat në qytetin e Shkupit; (ii) punonjësit e sektorit publik janë personat që janë të punësuar në ndonjë prej punëdhënësve nga paragrafi 1 i këtij neni; dhe (iii) funksionarët, respektivisht, personat që kanë marrë mandat për të kryer një detyrë në zgjedhjet presidenciale, parlamentare ose lokale, personat të cilëve u është dhënë mandati që ta mbajnë një zyrë në autoritetin ekzekutiv ose gjyqësor, me anë të zgjedhjes ose emërimit të bërë nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ose nga organet e pushtetit vendor, si dhe personat e tjerë që, në përputhje me ligjin, zgjidhen ose emërohen për të kryer një detyrë nga mbajtësit e autoriteti legjislativ, ekzekutiv ose gjyqësor, në kuptim të këtij ligji, nuk konsiderohen si punonjës i sektorit publik”.

Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut

232. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut shpjegoi se në rastin “*Van Rooyen*” kishte vlerësuar ndikimin e pagave në pavarësinë gjyqësore dhe ndarjen e pushteteve. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut shqyrtoi nenin 12 të Ligjit nr. 90 të Magjistratëve të vitit 1993, i cili merret me përcaktimin e pagave të magjistratëve, dhe i cili kërkon që Ministri i Drejtësisë të përcaktojë pagat e magjistratëve në konsultim me Komisionin e Magjistraturës dhe me pajtimin e Ministrit të Financave. Gjykata e Lartë kishte konstatuar që kjo dispozitë lejonte që pagat e magjistratëve të përcaktoheshin nga ekzekutivi. Kjo, së bashku me faktin se nuk ka garanci kundër zvogëlimit të pagave, nënkuptonte se magjistratët mund të jenë të hapur ndaj për manipulim. Prandaj, Gjykata e Lartë vlerësoi se neni 12 ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese rrëzoi këtë vendim. Ajo konsideroi se Komisioni i Magjistraturës është një organ i larmishëm, i përbërë nga anëtarët e legjislaturës, ekzekutivit, magjistratët dhe persona nga profesioni juridik, dhe kryesohet nga një gjyqtar. Për më tepër, megjithëse magjistratët nuk kanë të njëjtën mbrojtje kushtetuese nga ulja e pagave siç kanë gjyqtarët, në atë që pagat e tyre mund të ulen nga Parlamenti, Ministri i Drejtësisë kërkoi të konsultohet me Komisionin e Magjistraturës dhe Ministrin e Financave përpara se të përcaktojë pagat e tyre. Kjo do të thotë që, me ligj, pagat e magjistratit duhet të rishikohen në intervale të rregullta. Prandaj, Gjykata vendosi që, nëse i kushtohet kujdes mbrojtjes nga abuzimi i mundshëm i pushtetit, neni 12 nuk është në kundërshtim me pavarësinë gjyqësore. Për më tepër, në rastin “*De Lange*”, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se pavarësia gjyqësore kërkon sigurinë e mandatit dhe një shkallë themelore të sigurisë financiare nga

ndërhyrjet arbitrare nga ekzekutivi. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se “nuk ishte e bindur” se kriteri i “sigurisë financiare nga ndërhyrja arbitrare nga ekzekutivi” është i vlefshëm në mënyrë të njëjtë për zyrtarët në shërbimin publik. Pavarësia e institucioneve të caktuara përcaktohet nga vetë Kushtetuta. Këto përfshijnë gjyqësorin, autoritetin e ndjekjes dhe institucionet shtetërore që “forcojnë demokracinë kushtetuese në Republikë”, të tilla si Mbrojtësi Publik, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Afrikën e Jugut dhe Auditori i Përgjithshëm. Pavarësia e institucioneve të tjera, siç janë Drejtoria e Pavarur e Hetimit të Policisë, Inspektorati Gjyqësor për Shërbime Korrektuese dhe Drejtoria për Hetimin Prioritet të Krimeve, është e garantuar me legjislacion, ose konsiderohet se nënkuptohet me Kushtetutë. Prandaj, çdo ndërhyrje në pavarësinë e këtyre institucioneve (buxhetore ose tjetër) do të ishte jokushtetuese. Sidoqoftë, shpërblimi dhe kategorizimi i pozicionit të punës në institucione të tjera publike, pavarësia e të cilëve nuk është e garantuar në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar nga Kushtetuta, mund të kontrollohet dhe kufizohet nga Parlamenti. Në fund të fundit, Parlamenti ka të drejtë të nxjerrë çdo legjislacion që është në përputhje me Kushtetutën, dhe në përputhje me rrethanat është i autorizuar të rregullojë pagat, buxhetet dhe kategorizimin e vendeve të punës në masën e lejuar nga Kushtetuta.

Konkluzion përkitazi me përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias

233. Në dritë të përgjigjeve të pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias, Gjykata arrin në përfundimin se emëruesi i përbashkët i praktikës së elaboruar më lart konsiston në atë se: (i) nuk ka një sistem të vetëm të mundshëm të rregullimit të pagave në sektorin publik; (ii) shumica e vendeve i rregullojnë pagat përmes ligjeve të ndryshme dhe njëkohësisht aplikojnë metoda të ndryshme duke e rregulluar këtë çështje qoftë përmes ligjeve të veçanta për sektorë të veçantë ose përmes ndonjë rregullimi më të koncentruar ligjor; (iii) Kuvendi, si organ ligjvënës, ka kompetencë dhe të drejtë organike që të nxjerrë çfarëdo lloj legjislacioni për rregullim të pagave në sektorin publik me kushtin që i njëjti të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet kushtetuese të vendit përkatës; (iv) Kuvendi, si organ ligjvënës dhe si përfaqësues i të zgjedhurve të popullit, është në pozicionin më të mirë për të miratuar ligje me qëllim të rregullimit të marrëdhënieve në të gjitha sferat e jetës sociale, përfshi në sektorin e pagave; (v) pavarësia gjyqësore kërkon një shkallë themelore të sigurisë financiare nga ndërhyrjet arbitrare nga ekzekutivi ose degët e tjera të pushtetit; (vi) parimi i ndarjes së pushtetit dhe balancës ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor nuk nënkupton

izolim e pushteteve dhe mungesën e varësisë së ndërsjellë; mirëpo, i njëjti nënkupton evitimin e situatave sipas së cilave mund të krijohet “ndërhyrje”, “varësi” ose “vartësi” jokushtetuese në mes të pushteteve të pavarura; (viii) krijimi i një korrelacioni të kushtëzuar ndërmjet pagës dhe ushtrimit të pushtetit të gjykatave paraqet cenim të parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve; (ix) ulja e pagave të gjyqësorit mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize të theksuar ekonomike dhe financiare dhe e cila për më tepër duhet të jetë e njohur zyrtarisht si të tillë; (x) sigurimi i pavarësisë funksionale dhe financiare hyn në garancitë e nevojshme kushtetuese; (xi) parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton se nuk duhet të ketë ndërhyrje, varësi ose vartësi në mes të pushteteve dhe se asnjëri nga pushtetet nuk mund të ndërmerr veprime që nënkuptojnë ndërhyrje në sferën e kompetencave të pushtetit tjetër, që potencialisht do të shkaktonte varësi kundërkushtetuese të njëres degë në tjetrën.

Opinionet relevante të Komisionit të Venecias dhe vendimet e tjera të gjykatave të ndryshme të rekomanduara për tu hulumtuar nga Gjykata

234. Gjykata rikujton që të gjitha Opinionet e Komisionit të Venecias dhe vendimet e gjykatave të ndryshme evropiane, regjionale dhe më gjerë, që do të elaborohen në vijim janë dokumente të rekomanduara nga zyrtarët ndërlidhës së Komisionit të Venecias pas kërkesës së Gjykatës drejtuar kësaj të fundit. (Shih “Procedurën para Gjykatës” ku reflektohet komunikimi i Gjykatës me Komisionin e Venecias dhe rekomandimet e këtij të fundit drejtuar Gjykatës, paragrafët 12 dhe 15-19 të këtij Aktgjykimi). Gjykata i ka analizuar të gjithë dokumentacionin e sugjeruar dhe në vijim do të paraqesë të gjitha Opinionet dhe vendimet relevante për rastin konkret.

Opinion i CDL-AD(2010)038, “Amicus curiae brief” për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut lidhur me plotësimin-ndryshimin e disa ligjeve që kishin të bënin me sistemin e pagave dhe kompensimeve për zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin plenar të 85 të, 17-18 dhjetor 2010

235. Opinioni i lartcekur ishte lëshuar nga Komisioni i Venecias për çështje që ndërlidheshin me sistemin e pagave dhe shpërblimeve të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar në Maqedoni si dhe zyrtarët e gjyqësorit (gjyqtarët e gjykatave të zakonshme, prokurorët publik, anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve). Komisionit të Venecias iu ishte kërkuar që të përgjigjej në dy pyetje, respektivisht: (i) nëse rregulli ose ndalesa për zvogëlim të pagave të gjyqtarëve është

i vlefshëm në kohë krize, dhe (ii) nëse po, a është e vlefshme kjo ndalesë edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

236. Ndaj pyetjes së parë, Komisionit i Venecias ishte përgjigjur: “11. *Rekomandimi (94) 12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës thotë se shpërblimi i gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj (Parimi I. 2b. ii) dhe të jetë “në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë” (Parimi II. 1. b). Ngjashëm, sipas Komisionit të Venecias, ‘shpërblimi i gjyqtarëve duhet të korrespondoj me dinjitetin e profesionit dhe se shpërblimi adekuat është i domosdoshëm për mbrojtjen e gjyqtarëve nga ndërhyrjet e padrejta të jashtme. [...] Niveli i shpërblimit duhet të përcaktohet në dritën e kushteve sociale në vend dhe të krahasohet me nivelin e shpërblimit të nëpunësve më të lartë civilë. Shpërblimi duhet të bazohet në një standard të përgjithshëm dhe të mbështetet në kritere objektive dhe transparente. [...] 14. Po kështu, Komiteti i KB-së për të Drejtat e Njeriut ka treguar se vendet anëtare duhet të marrin masa specifike për të garantuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe mbrojtjen e gjyqtarëve nga çfarëdo forme e ndikimit politik në vendimmarrjen e tyre, ndër të tjera, duke vendosur shpërblimin e gjyqtarit (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14, Komenti i Përgjithshëm Nr. 32, paragrafi 19). 15. Sidoqoftë, si për çdo garanci të pavarësisë gjyqësore, garancia e përmendur nuk është një qëllim në vetvete: ajo ndjek qëllimin për të siguruar administrimin e duhur, të kualifikuar dhe të paanshëm të drejtësisë, dhe zbatimin e të drejtës për një gjykim të drejtë”.*
237. Ndaj pyetjes së dytë, Komisioni i Venecias ishte përgjigjur: “24. *Sipas Komisionit të Venecias është e qartë se parimi i pavarësisë së gjyqësorit po ashtu vlen dhe ndaj Gjykatës Kushtetuese [...] neni 108 i Kushtetutës përcakton “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë është një organ i Republikës që mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë”. [...] Sikurse ka deklaruar Gjykata Kushtetuese e Lituanisë: fakti që “Gjykata Kushtetuese ka pushtet kushtetues të interpretojë Kushtetutën dhe të merr vendime që janë të detyrueshme ndaj të gjitha institucioneve ligjvënëse dhe ligj-zbatuese, nuk lë asnjë dyshim se Gjykata Kushtetuese është një institucion që ushtron pushtet shtetëror. [...] Nga sa më sipër: pavarësia gjyqësore është element i qenësishëm i gjykatave kushtetuese [...] 27. Prandaj, nuk është në përputhje me pozitën e Gjykatës Kushtetuese që të konsiderohet si diçka tjetër në vend të gjykatës ndaj së cilës parimi i pavarësisë gjyqësore është i vlefshëm. Prandaj, konkluzioni duhet të jetë që ligjvënësi është prirë nga parimi i pavarësisë gjyqësore çka nënkupton që madje edhe në situatë krize*

pagat e gjyqtarëve nuk mund të zvogëlohen, atëherë duhet gjithashtu të zbatohet ndaj anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese”.

Opinion i CDL-AD (2002)008, lidhur me statusin dhe rangun e Avokatit të Popullit në Bosnjë dhe Hercegovinë, 17 maj 2002

238. Komisioni i Venecias kishte pranuar një kërkesë nga Avokati i Popullit të Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës për një opinion, duke pyetur mes tjerash: *“Nëse Rangu dhe Statusi i Avokatit të Popullit të Federatës së Bosnjë Hercegovinës duhet barazuar me rangun dhe statusin e shërbyesve civilë të lartë apo gjyqtarëve të pavarur të gjykatave të zakonshme?”*
239. Pas shqyrtimit të kuadrit ligjor të shteteve si Norvegjia, Suedia, Malta, Kroacia, Holanda, Franca, Estonia, Belgjika dhe të tjera lidhur me statusin dhe rangun e Avokatit të Popullit, Komisioni i Venecias në pjesën relevante të përgjigjes përcaktoi: *“16. Përgjigjet demonstrojnë se ka një mori mënyrash për përcaktim të statusit të Avokatit të Popullit. Vende të ndryshme ose subjekte regjionale barazojnë statusin e Avokatit të Popullit me atë të shërbyesve civilë, gjyqtarëve, ministrave ose deputetëve të parlamentit. 17. Megjithatë, pavarësisht nga statusi në të cilin asimilohet Avokati i Popullit, në vendet dhe subjektet regjionale që janë përgjigjur, Avokatit të Popullit me të drejtë i është dhënë rang i lartë, çka është reflektuar me lartësi të pagës. [...] 18. Rangu dhe lartësia e pagës janë të një rëndësie vendimtare në mënyrë që të garantohet pavarësia e Avokatit të Popullit dhe t'i mundësohet atij ose asaj që t'i kryej siç duhet funksionet që atij ose asaj i janë besuar. [...] 28. Nga sa më sipër, duke pasur parasysh analizën e Kushtetutës së Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe legjislacionit relevant, është e qartë se, në Federatën e Bosnjë Hercegovinës, është bërë një zgjedhje në favor të barazimit të statusit të Avokatit të Popullit me atë të gjyqtarëve të zakonshëm, të rangut dhe pagës me Kryetarin e Gjykatës Supreme. 29. Kjo zgjedhje është në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe, siç është treguar nga përgjigjet e Avokatit të Popullit të vendeve të ndryshme dhe subjekteve regjionale, ky është qëndrimi në një numër vendesh tjera evropiane. Në të vërtetë, është një zgjedhje që qartësisht garanton pavarësinë e Avokatit të Popullit. 30. Prandaj, Komisioni i Venecias është i mendimit se në kontekstin ligjor të tanishëm të Bosnjë Hercegovinës, Avokati i Popullit të Federatës së Bosnjë Hercegovinës duhet barazuar me gjyqtarët e gjykatave të zakonshme”.*

Parimet e Venecias për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, CDL-AD(2019)005-e, të miratuara nga Komisioni i Venecias në sesionin plenar të 118-të, Venecia, 15-16 mars 2019

240. Të ashtuquajturat “Parimet e Venecias” për mbrojtjen dhe promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit u miratuan nga Komisioni i Venecias në vitin 2019. Pjesa relevante, për rrethanat e rastit konkret, e këtyre Parimeve parasheh me sa vijon:

“21. Burime buxhetore të mjaftueshme dhe të pavarura duhet të sigurohen për Institucionin e Avokatit të Popullit. Ligji duhet të parashikojë që ndarja buxhetore e fondeve për Institucionin e Avokatit të Popullit duhet të jetë e mjaftueshme karshi nevojës për të siguruar, kryerje të plotë, të pavarur dhe efektive të përgjegjësiave dhe funksioneve të tij. Avokati i Popullit duhet konsultuar dhe t’i kërkohet të prezantojë një draft-buxhet për vitin financiar të ardhshëm. Buxheti i miratuar për këtë institucion nuk duhet të zvogëlohet gjatë vitit financiar, përveç nëse zvogëlimi në përgjithësi vlen edhe për institucionet tjera shtetërore. Kontrolli i pavarur financiar i buxhetit të Avokatit të Popullit do të merr parasysh vetëm ligjshmërinë e procedurave financiare dhe jo zgjedhjen e prioriteteve në ushtrim të mandatit.

22. Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ketë staf të mjaftueshëm dhe fleksibilitet strukturor të duhur. Ky institucion mund të ketë një apo më shumë zëvendës, të emëruar nga Avokati i Popullit. Avokati i Popullit duhet të jetë në gjendje ta rekrutojë stafin e tij apo të saj”.

Lista e Sundimit të Ligjit (“Rule of Law Checklist”), CDL-AD (2016)007-e, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën plenare të 106-të, Venecia, 11-12 mars 2016

241. Lista e Sundimit të Ligjit e miratuar nga Komisioni i Venecias në vitin 2016, në pjesën relevante të saj në aspekt të rrethanave të rastit konkret parasheh me sa vijon:

“74. Gjyqësori duhet të jetë i pavarur. Pavarësia e gjyqësorit nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm, dhe nuk i nënshtrohet ndikimit apo manipulimit politik, posaçërisht nga dega ekzekutive. Ky kriter është pjesë përbërëse e parimit themelor demokratik për ndarjen e pushteteve. Gjyqtarët nuk duhet t’i nënshtrohen ndikimit apo manipulimit politik.

75. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përmbledhur katër elemente të pavarësisë gjyqësore: mënyra e emërimit, kohëzgjatja e mandatit, ekzistenca e garancive kundër presionit të

jashtëm – përfshirë çështjet buxhetore – dhe nëse gjyqësori duket si i pavarur dhe i paanshëm.

[...]

83. Burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet Shtetërore, dhe palët private, ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet, duke u kujdesur kështu për besimin e publikut në drejtësi dhe Sundimin e Ligjit. Pushteti ekzekutiv për ta zvogëluar buxhetin e gjyqësorit është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar.

85. Përfundimisht, pagat e drejta dhe të mjaftueshme janë një aspekt konkret i autonomisë financiare të gjyqësorit. Ato janë mjete për ta parandaluar korrupsionin, që mund të rrezikojë pavarësinë e gjyqësorit jo vetëm nga degët e pushteti shtetëror, por edhe nga individët.”

Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED) në rastin me numër të referencës ECJ-2018-1-003

242. Në këtë rast të GJED-së, ligjvënësi portugez kishte nxjerrë ligj për “menaxhim të pagave” në sektorin publik me ç’rast paga e gjyqtarëve të Gjykatës për Kontroll Financiar (*Tribunal de Contas/Court of Auditors*) ishte zvogëluar. Duke pasur parasysh këto rrethana, gjykata referuese kishte ngritur çështjen pranë GJED-së nëse legjislacioni vendor i Portugalisë është në përputhje me parimin e pavarësisë gjyqësore, që, sipas saj, buron nga nën-paragrafi i dytë i nenit 19.1 të Traktatit të Bashkimit Evropian (në tekstin në vijim: TBE) dhe neni 47 i Kartës për të Drejtat Themelore të BE-së dhe praktikës gjyqësore të GJED-së. Kjo e fundit ishte përgjigjur duke arsyetuar se: “Gjykata Evropiane e Drejtësisë vërejtë se garancia e pavarësisë, që është e qenësishme në detyrën e gjyqësorit është kriter jo vetëm në nivel të BE-së lidhur me Gjyqtarët në BE dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë [...] por edhe në nivel të Shteteve Anëtare lidhur me gjykatat vendore. [...] Koncepti i pavarësisë prezumon, në veçanti, që organi në fjalë ushtron funksionet e tij gjyqësore krejtësisht në mënyrë autonome, pa iu nënshtruar ndonjë kufizimi hierarkik apo në vartësi të ndonjë organi tjetër dhe pa pranuar urdhra apo instruksione nga çfarëdo burimi, dhe që është i pavarur nga ndërhyrjet e jashtme ose presionet që mund të dëmtojnë gjykimin e pavarur të anëtarëve të tij dhe të ndikojë vendimet e tyre”.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë në rastin me numër të referencës POR-2015-3-018

243. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Portugalisë trajtoi kushtetutshmërinë e normave të një ligji që përcaktonte orarin normal të punës të punëtorëve në sektorin publik në tetë (8) orë në ditë dhe katërdhjetë (40) orë në javë, me ç'rast ndryshohej norma që ishte në fuqi, sipas së cilës një ditë pune nuk mund t'i tejkalojë shtatë (7) orë kurse një javë pune tridhjetepesë (35) orë. Parashtruesit kërkuan vlerësim kushtetues duke pretenduar se kjo ngritje e orëve normale të punës ishte kundërkushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Portugalisë kishte arsyetuar: *"[...] Kushtetuta nuk përmban ndonjë rregull që krijon garanci se pagat nuk mund të zvogëlohen per se. Gjykata u shpreh se është e vetëdijshme se rritja e numrit normal të orëve të punës mund të krijojë shpenzime shtesë për punëtorët (transporti, kujdesi për të moshuarit dhe të miturit, etj.), por dëmi më i madh që e pësojnë si rezultat i normave në fjalë ka të bëjë me kohën që ata kanë dispozicion për vetveten, familjet e tyre si dhe ushtrimi i një game të të drejtave tjera themelore [...]. Gjykata konsideroi se humbja e vërtetë e pagës ishte kufizuar me pagën e fituar duke punuar jashtë orarit të punës. Gjykata e çmoi këtë fakt, duke pasur parasysh shkurtimet efektive të pagave që sektori i punëtorëve në sektorin publik kishte pësuar viteve të fundit. Megjithatë, Gjykata u shpreh se pagesa e punës jashtë orarit të punës nuk është përfshirë në konceptin cilësor të pagës, dhe kështu garancia kushtetuese se pagat nuk mund të zvogëlohen nuk është e vlefshme. Nga sa më sipër, Gjykata konstatoi se zvogëlimi në shumat e parave që në mënyrë efektive pranohen si pagesë për punë jashtë orarit të punës nuk ishte element vendimtar që do ta bënte një normë kundërkushtetuese".* Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Portugalisë nuk kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyeve të lartcekura.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë në rastin me numër të referencës POR- 2013-1-006

244. Në këtë rast, Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë trajtoi kushtetutshmërinë e normave të ndryshme të përfshira në Ligjin për Buxhetin e Shtetit për vitin 2013. Pretendimi ishte se një trajtim i ndryshëm për stafin e sektorit publik nuk mund të vazhdojë të justifikohet me idenë se masat e uljes së pagave janë më efektive sesa alternativat e tjera të mundshme të përmbajtjes së kostos së shpenzimeve. Gjykata Kushtetuese e Portugalisë kishte arsyetuar: *"Ky është viti i tretë radhazi në të cilin kjo ulje e shpërblimeve të paguara në fushën e marrëdhënies juridike të punës publik ka qenë në fuqi, dhe në këtë drejtim Ligji për Buxhetin e vitit 2013 thjesht ruajti normat dhe uljet e përcaktuara në paraardhësit e tij. Gjykata rikujtoi juridiksionin e saj të mëparshëm, në të cilin tha se rregulli nën të cilin*

nuk mund të ulen pagat nuk është një rregull absolut, por më tepër një rregull infra-kushtetues. Ndalimi i vetëm absolut është që as një punëdhënës publik dhe as një punëdhënës privat nuk mund të ulin në mënyrë arbitrare pagën, përveç nëse një normë ligjore e lejon atë. Më tutje, në arsyetim ishte theksuar se: “Gjykata [Kushtetuese e Portugalisë] mbështeti qëndrimin e saj të mëparshëm (Vendimi nr. 396/2011) për argumentin se uljet në pagën e punonjësve të sektorit publik janë në kundërshtim me parimin e barazisë, sepse ato synojnë vetëm njerëzit që punojnë për shtetin dhe publikun tjetër- personat juridikë dhe nuk zbatohen për punëtorët që paguhen për sigurimin e punës vartëse në sektorin privat ose bashkëpunues, punëtorë të pavarur ose këdo tjetër që fiton të ardhura nga burime të tjera. Ajo konkludoi se ekzistojnë baza legjitime për këtë diferencim, si për shkak se nuk u paraqitën prova për të hedhur poshtë pozicionin që vetëm uljet e pagave janë në gjendje të garantojnë një ulje të sigurt dhe të menjëhershme të peshës së shpenzimeve publike, dhe sepse aty ku bëhet fjalë për këtë objektiv, njerëzit të cilët janë paguar nga fondet publike nuk janë në të njëjtin pozicion me qytetarët e tjerë. Për këto arsye Gjykata mendoi se sakrifica shitesë e kërkuar nga kjo kategori personash për një periudhë kalimtare nuk përbën një trajtim të pajustifikueshëm të pabarabartë”. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Portugalisë nuk kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyeve të lartcekura.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë në rastin me numër të referencës POR-2012-2-011

245. Në këtë rast, ligjvënësi portugez kishte parashikuar një masë për pezullimin e pagesave për muajin e Krishtlindjes (paga e 13-të) dhe muajin e festave (paga e 14-të) në vitet 2012-2014, si për personat që marrin pagë nga subjektet publike, ashtu edhe për ata që marrin pensionin përmes sistemit publik të sigurimeve shoqërore. Pretendimi kundër kësaj mase bazohej në çështjen se duhej të kishte kufij në ndryshimin midis masës së sakrificës së bërë nga personat që u prekën nga kjo masë dhe sakrificës së atyre që nuk ishin prekur nga kjo masë dhe se pabarazia e shkaktuar nga ndryshimi në situata duhej të ishte objekt i një shkalle proporcionaliteti. Situata shumë e rëndë ekonomike dhe nevoja për miratimin e masave për t'u marrë me të nuk do të thoshte që ligjvënësi nuk i nënshtrohej më obligimit për të respektuar të drejtat themelore dhe parimet kryesore strukturore të shtetit të së drejtës, apo parimit të barazisë proporcionale.

246. Gjykata Kushtetuese e Portugalisë kishte arsyetuar se: “[...] natyra e këtyre dhe çdo pagese ekuivalente tjetër të muajit 13-të dhe 14-të nuk

ishite ndryshe nga ajo e formave të pagave që kishin qenë objekt i zvogëlimit në [vitin] 2011 - ulje të cilat Gjykata kishte refuzuar t'i deklaronte jokushtetuese (Vendimi nr. 396/11 i 21 shtatorit 2011). Ligji thotë që natyra e Krishtlindjes dhe e shpërblimeve të festave është ajo e pagesës për punën e bërë dhe se ato bëjnë pjesë në shpërblimin vjetor të punëtorit, pavarësisht nëse ato paguhen nën ligjin privat ose regjimin e ligjit publik.” Më tutje, ishte theksuar se: “Gjykata kujtoi që parimi i barazisë në lidhje me shpërndarjen e drejtë të kostove publike, si një manifestim specifik i parimit të barazisë, është një parametër legjislativ i nevojshëm të cilin ligjvënësi duhet ta marrë parasysh kur vendos për të ulur deficitin publik në mënyrë që të mbrohet aftësia paguese e shtetit. Qëndrueshmëria e financave publike është me interes për të gjithë; gjithkush duhet, në masën që është në gjendje ta bëjë këtë, të kontribuojë në barrën e rregullimeve që duhet të bëhen për të ruajtur atë qëndrueshmëri. Fakti që masat e përfshira në normat përpara Gjykatës nuk ishin universale nënkupton që sakrificat nuk u shpërndanë në mënyrë të barabartë midis të gjithë qytetarëve, në proporcion me aftësinë e tyre financiare individuale. Përpjekje shtesë kërkohej ekskluzivisht nga kategori të caktuara të qytetarëve. Barazia juridike është gjithmonë një barazi proporcionale; çdo pabarazi që justifikohet nga një ndryshim në situata nuk mund të jetë imun nga gjykimi i proporcionalitetit. Gjykata deklaroi se ndryshimi në trajtim në këtë rast ishte aq thelbësor dhe domethënës sa arsyet që lidhen me efikasitetin e avancuar për masën nuk ishin të vlefshme sa duhet për ta justifikuar atë, veçanërisht sepse zgjidhjet alternative mund të ishin vendosur”. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Portugalisë kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyeve të lartcekura.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Qipros në rastin me numër të referencës CYP-2014-2-001

247. Zanafilla e rastit të lartpërmendur ishte Ligji që vendosi ulje të pagave për gjyqtarët, si pjesë e masave shtrënguese të vendit. Ankuesit, gjyqtarë në Republikën e Qipros, kërkuan nga Gjykata Supreme e Qipros që të rishikojë dispozitat e ligjeve përkatëse ngase veprimet administrative që ulin pagat e gjyqtarëve ishin të pavlefshme. Ankuesit pretendonin se kompensimi për gjyqtarët mund të zvogëlohet vetëm me një ligj të përgjithshëm të taksave që prek të gjithë tatimpaguesit në vend pa diskriminim. Gjykata Supreme e Qipros kishte arsyetuar: “[...] fuqia legjislativë që miratoi Ligjin e kontestuar nuk iu referua një domosdoshmërie të tillë për të justifikuar shpalljen e tij. Sidoqoftë, për të referuar me sukses Doktrinën e Domosdoshmërisë, në përputhje me praktikën ligjore të vendosur mirë, duhet të ketë një

domosdoshmëri absolute për të mbrojtur vazhdimin e funksionimit efektiv të Shtetit. Gjykata Supreme nuk u pajtua me argumentin e prokurorit të përgjithshëm se ekzistonte një nevojë e tillë, që do të thotë të përfshijë një numër relativisht të vogël të personave (gjyqtarët) për të ndarë barrën e shkaktuar nga situata e pafavorshme financiare e vendit. Kjo nevojë nuk është më e rëndësishme sesa nevoja për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, që është qëllimi i qartë i dispozitave të Nenit 158.3 të Kushtetutës, dhe një çështje me rëndësi të madhe për sa i përket interesit publik. [...] Prandaj, ai [Ligji i kontestuar] arrin në një ulje të palejueshme, të pafavorshme të kompensimit të gjyqtarëve (pagës), dhe në kundërshtim me dispozitat e qarta të Nenit 158.3 të Kushtetutës”. Në këtë rast, Gjykata Supreme e Qipros kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyeve të lartcekura.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë në rastin me numër të referencës SLO-2009-3-006

248. Objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë ishin disa rregullore që rregullonin pozicionin e pagës së gjyqtarëve. Pyetja thelbësore në këtë rast ishte ajo e pozitës kushtetuese të gjyqësorit dhe gjyqtarëve, dhe brenda këtyre kornizave çështja e përcaktimit të garancive të cilat janë siguruar nga Kushtetuta në lidhje me dy degët e tjera të pushtetit. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë kishte arsyetuar se: “Mbrojtja nga ulja e pagës së gjyqtarit individual, si e tillë ka për qëllim të sigurojë stabilitetin e saj dhe rrjedhimisht pavarësinë e gjykatës, duhet të kuptohet si mbrojtje ndaj çdo ndërhyrje që mund të shkaktojë ulje të pagës së gjyqtarit, të cilin gjyqtari e pret në mënyrë të arsyeshme me marrjen e detyrës. Kështu që, jo vetëm pagat themelore të gjyqtarëve janë ato që mbrohen nga ulja, por edhe të gjitha pagesat për të cilat gjyqtarët kanë të drejtë për shkak të kryerjes së detyrës gjyqësore. Shqyrtimi i konsistencës së rregulloreve që parashikon pagesa shtesë të gjyqtarëve për performancën në punë, me parimin e pavarësisë së gjyqtarëve të përcaktuar në Neni 125 i Kushtetutës nuk mund të kryhet për shkak se dispozitat e kontestuara janë të përcaktuara në mënyrë të pamjaftueshme dhe të paqartë ligjore” Prandaj, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë kishte gjetur shkelje duke konstatuar që rregullimi ligjor i kontestuar ishte në kundërshtim me neni 2 të Kushtetutës Sllovene.

Aktgjykimi i Tribunalit Kushtetues të Polonisë në rastin me numër të referencës POL-2001-H-001

249. Një ligj i caktuar kishte përcaktuar kufizime në pagat e menaxherëve të disa njësive shtetërore si dhe të subjekteve të vetëqeverisjes lokale. Ligji në fjalë po ashtu kishte kufizuar numrin e bordeve mbikëqyrëse të kompanive në pronësi të Shtetit ose të vetëqeverisjes lokale. Konfederata e punëdhënësve Polakë kundërshtoi kushtetutshmërinë e kufizimeve të lartpërmendura para Tribunalit Kushtetues. Ky i fundit, në arsyetim të vendimit të tij theksoi: *“Parimi i shpërblimit minimal për punë [...] është i një karakteri më të përgjithshëm. [...] Neni 65.4 i Kushtetutës, përcakton se është detyrë e ligjvënësit që të përcaktojë në statut shpërblimin minimal për plotësimin e nevojave parësore të jetës. Jo vetëm që ligjvënësi ka të drejtë të përmbushë detyrat e vendosura në të me dispozitat kushtetuese, por ligjvënësi gjithashtu mund të miratojë, me respektimin e duhur të ligjit, rregulla që rregullojnë sferat e tjera të jetës shoqërore, përfshirë nivelin e shpërblimit për punë. Sidoqoftë, diskrecioni i ligjvënësit është i kufizuar nga Neni 2 i Kushtetutës që përcakton parimin e drejtësisë shoqërore, i cili kërkon që paga të jetë e duhur dhe të plotësojë nevojat e arsyeshme të një individi. Sipas nenit 2 të Kushtetutës, dispozitat e reja nuk mund të befasojnë personat të cilët i prekin. Dispozitat në fjalë hynë në fuqi “ditën e parë të muajit pas një muaji nga data e botimit”. Për më tepër, tre muaj shtesë u siguruan për përshtatjen e atyre që iu zvogëlua paga. Si pasojë, persona të tillë nuk u befasuan nga ndryshimet dhe nuk u cenua parimi i besimit të qytetarëve në shtet dhe ligjet e tij”. Në këtë rast, Tribunali Kushtetues i Polonisë nuk kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyeve të cekura më lart.*

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kanadasë në rastin me numër të referencës - CAN-1997-3-005

250. Disa provinca në Kanada miratuan legjislacion për uljen e pagave të gjyqtarëve të gjykatave të tyre dhe punonjësve të sektorit publik – ulje kjo që u kundërshtuar bazuar në nenin 11.d të Kartës Kanadeze të Drejtave dhe Lirive.
251. Gjykata Supreme e Kanadasë kishte theksuar se: *“[...] uljet e pagave ishin jokushtetuese. Siguria financiare, një nga karakteristikat thelbësore të pavarësisë gjyqësore, ka një dimension individual dhe institucional. Dimensionin institucional i sigurisë financiare ka tre përbërës. Së pari, si një parim i përgjithshëm, neni 11.d i Kartës lejon që rrogat e gjyqtarëve të gjykatave provinciale të zvogëlohen, rriten ose ngrihen, ose si pjesë e një mase të përgjithshme ekonomike që prek pagat e të gjithë ose disa personave që janë shpërblyer nga fondet publike, ose si pjesë e një mase e cila drejtohet te gjykatësit e*

gjykatave provinciale si një klasë. Sidoqoftë, për të shmangur mundësinë ose shfaqjen e ndërhyrjes politike përmes manipulimit ekonomik, një organ, siç është një komision, duhet të përfshihet në gjyqësor dhe degët e tjera të qeverisë. Funkzioni kushtetues i këtij organi do të ishte që të depolitizojë procesin e përcaktimit të ndryshimeve ose ngrirjet në shpërblimin gjyqësor. Ky objektiv do të arrihet duke i caktuar këtij organi detyrën specifike të lëshimit të një raporti mbi pagat dhe përfitimet e gjyqtarëve për ekzekutivin dhe legjislaturën. Prandaj, provincat janë nën një detyrim kushtetues për të krijuar organe që janë të pavarura, efektive dhe objektive. [...] Masat gjithëpërfshirëse që prekin në mënyrë thelbësore çdo person që paguhet nga qesja publike janë prima facie racionale, ndërsa një masë e drejtuar vetëm për gjyqtarët mund të kërkojë një shpjegim më të plotë. Së dyti, në asnjë rrethanë nuk lejohet që gjyqësori - jo vetëm kolektivisht përmes organizatave përfaqësuese, por edhe si individë - të angazhohet në negociata mbi pagat me ekzekutivin ose përfaqësuesit e legjislaturës. Negocimi i tillë do të ishte në kundërshtim thelbësor me pavarësinë gjyqësore. Së treti, çdo ulje e shpërblimit gjyqësor nuk mund t'i marrë ato paga nën nivelin bazë minimal të shpërblimit që kërkohet për zyrën e gjykatësit. Besimi i publikut në pavarësinë e gjyqësorit do të dëmtohej nëse gjyqtarët paguheshin me një shkallë kaq të ulët, sa që ata mund të vlerësoheshin si të ndjeshëm ndaj presionit politik përmes manipulimit ekonomik. Për tu mbrojtur nga mundësia që mosveprimi i qeverisë të përdoret si një mjet për manipulim ekonomik, duke lejuar që rrogat e gjyqtarëve të bien për shkak të inflacionit, dhe në mënyrë që të mbrohen nga mundësia që pagat gjyqësore të bien nën minimumin e duhur të kërkuar nga pavarësia gjyqësore, organi duhet të mblidhet nëse ka kaluar një periudhë e caktuar kohe që nga raporti i fundit i tij, në mënyrë që të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e gjyqtarëve në dritën e kostos së jetesës dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm. Përbërësit e dimensionit institucional të sigurisë financiare nuk duhet të respektohen në rastet e urgjencës financiare të jashtëzakonshme dhe të shtyrë nga rrethanat të pazakonta. Këtu, uljet e pagave ishin jokushtetuese, sepse ato ishin bërë nga qeveritë e [Provincave] pa mbështetje në një proces të pavarur, objektiv dhe efektiv për përcaktimin e shpërblimit gjyqësor dhe për shkak se qeveria e [një Province tjetër] nuk arriti të respektojë procesin e pavarur, efektiv dhe objektiv për caktimin e shpërblimit gjyqësor i cili tashmë ishte duke vepruar në atë provincë.” Në këtë rast, Gjykata Supreme e Kanadasë kishte gjetur shkelje mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme.

Konkluzion përkitazi me Opinionet e Komisionit të Venecias dhe vendimet e gjykatave të tjera

252. Në dritë të Opinioneve dhe vendimeve të sugjeruara nga zyra ndërlidhëse e Komisionit të Venecias, Gjykata arrin në përfundimin se emëruesi i përbashkët i dokumentacionit të propozuar për hulumtim konsiston në atë se: (i) pavarësia e gjyqësorit, si njëra nga degët e pushtetit shtetëror, nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm, dhe nuk i nënshtrohet ndikimit apo manipulimit politik, posaçërisht nga dega ekzekutive - ky kriter konsiderohet të jetë pjesë përbërëse e parimit themelor demokratik për ndarjen e pushteteve; (ii) burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet e tjera shtetërore dhe nga palët private - ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet, duke u kujdesur kështu për besimin e publikut në drejtësi dhe sundim të ligjit; (iii) zvogëlimi i buxhetit nga pushteti ekzekutiv është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar dhe të padëshiruar; (iv) koncepti i pavarësisë prezumon, në veçanti, që organi në fjalë ushtron funksionet e tij gjyqësore krejtësisht në mënyrë autonome, pa iu nënshtrohet ndonjë kufizimi hierarkik apo në vartësi të ndonjë organi tjetër dhe pa pranuar urdhra apo instruksione nga çfarëdo burimi; (v) shpërblimi i gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj dhe të jetë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë dhe se paga e gjyqtarit nuk mund të ulet përgjatë mandatit (përveç situatave të jashtëzakonshme të vështirësive ekonomike); (vi) niveli i shpërblimit me pagë duhet të përcaktohet në dritën e kushteve sociale në vend dhe të krahasohet me nivelin e shpërblimit të nëpunësve më të lartë civilë; (vii) Avokatit të Popullit me të drejtë duhet t'i jepet një rang i lartë që reflektohet edhe me shpërblimin përkatës; (viii) shteti duhet të sigurojë burime buxhetore të mjaftueshme dhe të pavarura për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të njëjtat duhet të jetë e mjaftueshme karshi nevojës për të siguruar, kryerjen e plotë, të pavarur dhe efektive të përgjegjësisë dhe funksioneve të tij; (ix) Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ketë staf të mjaftueshëm dhe fleksibilitet strukturor të duhur si dhe duhet të jetë në gjendje ta rekrutojë stafin e tij apo të saj; (x) nuk ekziston një rregull që krijon garanci absolute se pagat në sektorin publik nuk mund të zvogëlohen *per se* – por që ulja e pagave duhet të jetë e arsyetuar; (xi) ekziston një ndalim i vetëm absolut në aspekt të uljes së pagave sipas të cilit as një punëdhënës publik dhe as një punëdhënës privat nuk mund të ulin në mënyrë arbitrare pagën, përveç nëse një normë ligjore e lejon atë; (xii) uljet në pagën e punonjësve të sektorit publik janë në kundërshtim me parimin e barazisë kur ato synojnë vetëm persona të caktuar; (xiii) parimi i barazisë në lidhje me shpërndarjen e drejtë të kostove publike, si një manifestim specifik i parimit të barazisë, është një parametër legjislativ i nevojshëm të cilin ligjvënësi duhet ta marrë parasysh kur vendos për të ulur deficitin publik në mënyrë që të mbrohet aftësia

paguese e shtetit; (xiv) qëndrueshmëria e financave publike është me interes për të gjithë dhe rrjedhimisht gjithkush duhet, në masën që është në gjendje ta bëjë këtë, të kontribuojë në barrën e rregullimeve që duhet të bëhen për të ruajtur atë qëndrueshmëri në kohë krize; (xv) sakrificat në kohë krize që rezultojnë me ulje të pagave e të cilat nuk janë universale dhe nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë midis të gjithë qytetarëve, në proporcion me aftësinë e tyre financiare individuale – nuk konsiderohet të jenë të pajtueshme me konceptet e shpërndarjes së barrës midis përfituesve të pagave në një shtet; (xvi) mbrojtja nga ulja e pagës së gjyqtarit, si e tillë ka për qëllim të sigurojë stabilitet dhe rrjedhimisht pavarësi të gjykatësit e që duhet të kuptohet si mbrojtje ndaj çdo ndërhyrje që mund të shkaktojë ulje të pagës së gjyqtarit, të cilin gjyqtari e pret në mënyrë të arsyeshme me marrjen e detyrës; (xiii) Kuvendi si ligjvënës është i thirrur të rregullojë sferat të ndryshme shoqërore, përfshirë nivelin e shpërblimit për punë; megjithatë diskrecioni i ligjvënësit është i kufizuar në atë që paga të jetë e duhur dhe të plotësojë nevojat e arsyeshme të një individi; (xvii) dispozitat e reja të nxjerra nga ligjvënësi nuk mund të befasojnë personat të cilët i prekin dhe në rastet kur ata e dinë saktësisht se çfarë i pret me legjislacionin e ri – gjykatat e caktuara nuk kanë gjetur shkelje; (xviii) siguria financiare është një nga karakteristikat thelbësore të pavarësisë gjyqësore; (xix) masat gjithëpërfshirëse që prekin në mënyrë thelbësore çdo person që paguhet nga buxheti publik janë *prima facie* racionale, ndërsa një masë e drejtuar vetëm për gjyqtarët [ose vetëm për një grup të caktuar] mund të kërkojë një shpjegim më të plotë.

PËRGJIGJA E GJYKATËS – *përkitazi me përputhshmërinë e Ligjit të kontestuar me parimin e ndarjes së pushteteve, respektivisht nenet 4 dhe 7 në lidhje me nenet 102, 108.1, 109, 110, 115 të Kushtetutës dhe nenet respektive të Kapitullit XII të Kushtetutës*

253. Gjykata rikujton faktin që Avokati i Popullit kontestoi kushtetutshmërinë e Ligjit për Pagat, në tërësinë e tij, nën pretendimet thelbësore se i njëjti shkelë parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe parimin e “sigurisë juridike”, pjesë e parimit të sundimit të ligjit. MAP, në cilësi të Ministrisë propozuese në kuadër të Qeverisë kundërshtoi pretendimet e Avokatit të Popullit; ndërkaq që Ministria e Financave dhe Transfereve si Ministri që do të ekzekutonte Ligjin e kontestuar është përgjigjur gjerësisht në pyetjet e Gjykatës duke theksuar disa të meta potenciale që duhet të vlerësohen nga Gjykata dhe disa aspekte të rëndësishme për vështirësinë dhe pamundësinë e zbatimit të menjëhershëm të Ligjit në fjalë në praktikë (shih, thelbin e pretendimeve të parashtresit të kërkesës; komentet e MAP dhe të Ministrisë së Financave dhe Transfereve).

254. Siç është definuar dhe më lart, çështja kushtetuese në të cilën Gjykata duhet të përgjigjet është nëse Ligji i kontestuar (i) shkelë parimin e ndarjes së pushteteve të garantuar me Kushtetutë në raport me pushtetin Gjyqësor; dhe nëse Ligji i kontestuar (ii) cenon pavarësinë “institucionale, organizative dhe funksionale” të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitujt VIII dhe XII të Kushtetutës.
255. Parimet themelore që rrjedhin nga Kushtetuta, praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare, si dhe nga Opinionet e Komisionit të Venecias lidhur me “ndarjen e pushteteve” dhe domethënien e këtij parimi për pushtetin e gjyqësorit, veçse janë elaboruar gjerësisht më lart. Gjykata thirret në të gjitha ato parime në frymën e së cilave do ta vlerësojë Ligjin e kontestuar në aspekt kushtetutshmërie.
256. Andaj dhe, në zbatim të parimeve të sipërelaboruara dhe me qëllim të vlerësimit të pretendimeve për shkelje e parimit të ndarjes së pushteteve në disfavor të pushtetit Gjyqësor dhe Institucioneve të Pavarura, Gjykata në vijim do të: (i) analizojë dispozitat specifike dhe relevante të Ligjit të kontestuar; (ii) specifikojë përjashtimet e bëra për dy degët e tjera të pushtetit, respektivisht Legjislativin dhe Ekzekutivin – duke analizuar kështu kompetencat specifike që iu janë dhënë vetëm Qeverisë dhe Kuvendit; (iii) vë në pah përjashtimet e tjera të bëra me Ligjin e kontestuar, përfshi mos-përfshirjen e disa institucioneve në rregullimin ligjor të Ligjit të kontestuar; dhe (iv) shqyrtojë se a janë respektuar parimet mbi të cilat supozohet të jetë hartuar Ligji i kontestuar. Krejt në fund, Gjykata do të paraqesë konkluzionin e saj.
257. Para këtij vlerësimi, dy paranteza të rëndësishme preliminare. Njëra për Kuvendin; tjera për Gjykatën Kushtetuese.
258. Së pari, Gjykata potencon ingjencën kryesore kushtetuese të Kuvendit për ligjvënien në nivel vendi. Kuvendi, si pushtet legjislativ, *“përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, [...] nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër”* (shih Aktgjykimi i Gjykatës KO72/20, paragrafi 352). Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, është rrjedhimisht i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrim të kompetencës së tij për “miratim të ligjeve” (shih nenin 65.1 të Kushtetutës) të rregullojë pagat në sektorin publik sipas një politike të caktuar të zgjedhur nga vet Kuvendi. Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të pagave për Republikën e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënien

është që të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty.

259. Së dyti, Gjykata potencon faktin se në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të caktuar. Gjykata veçse ka theksuar në praktikën e saj gjyqësore që në shqyrtim të kushtetutshmërisë së një Ligji, ajo asnjëherë nuk vlerëson se a është një ligj i bazuar në politika të mira publike apo jo (shih rastet e Gjykatës: Aktgjykimi KO73/16, paragrafi 52; Aktgjykimi KO72/20, cituar më lartë, paragrafi 357; KO12/18, me parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 11 qershorit 2018, paragrafi 117). Vlerësimi i tillë nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese dhe rrjedhimisht analiza e kushtetutshmërisë së një Ligji gjithmonë fokusohet vetëm në aspektin kushtetues të Ligjit të caktuar. Kompetenca e Gjykatës në rastin konkret është që të vlerësojë, *in abstracto*, nëse Ligji i kontestuar është kushtetues apo jo dhe varësisht nga përgjigja - të vulosë kushtetutshmërinë e tij ose ta shfuqizojë të njëjtin, ose një pjesë të tij, si kundërkushtetues. Është e qartë se Gjykata Kushtetuese nuk vepron *ex officio* në kontrollim të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kushtetutshmëria e të gjitha ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës prezumohet si e tillë përderisa e njëjta nuk kontestohet pranë Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar. Kuvendi konsiderohet të ketë nxjerrë një ligj kushtetues deri në momentin që një ligj i tillë ose një pjesë e ligjit të mos vlerësohet si kundërkushtetues nga Gjykata.
260. Thënë këtë, Gjykata i kthehet vlerësimit të dispozitave specifike të Ligjit të kontestuar.
261. Ligji i kontestuar përmban gjithsej 10 kapituj, me gjithsej 34 nene dhe dy shtojca të emërtuara si “Shtojca nr. 1” dhe “Shtojca nr. 2”. Në vijim, Gjykata do të elaborojë disa nga nenet që kanë rëndësi për vlerësimin e tërësishëm të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar – duke mos u lëshuar në nenet që nuk ndërlidhen me analizën kyçe të Gjykatës. Për secilin nga këto nene, Gjykata do të paraqesë argumentet dhe vërejtjet e saj të aspektit kushtetues.
262. Neni 1 i Ligjit për Paga përcakton qëllimin dhe fushëveprimin e Ligjit të kontestuar. Sipas këtij neni, Ligji për Paga ka tri qëllime. Qëllimi i parë është që të përcaktojë: *“sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë, që paguhën nga buxheti i shtetit,*

përrjashtimisht AKI [Agjencia Kosovare e Inteligjencës] dhe FSK [Forca e Sigurisë së Kosovës]”. Qëllimi i dytë i Ligjit të kontestuar është që të caktojë “rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë”. Qëllimi i tretë është që të përcaktojë “kriteret për pagën kalimtare dhe përfitimet tjera pas përfundimit të funksionit për funksionarin publik dhe funksionarin publik me status të veçantë, si dhe për ish zyrtarin e lartë që është duke i realizuar të drejtat sipas ligjit përkatës”.

263. Lidhur me këtë, Gjykata vëren që në po të njëjtin nen ku ligjvënësi si qëllim primar të Ligjit ka paraparë harmonizimin e sistemit të pagave dhe shpërblimeve për të gjithë ata që paguhen nga buxheti i shtetit – është bërë përjashtimi për AKI-në dhe FSK-në. Rikujtojmë që këto përjashtime nuk ishin propozuar nga Qeveria si propozuese e Ligjit por ishin shtuar si amandamente në Kuvend. Në fakt, Qeveria edhe në dokumentet përgatitore të Ligjit të kontestuar vazhdimisht kishte potencuar qëllimin e një “homogjenizimi” gjithëpërfshirës të të gjitha pagave që paguhen nga buxheti i shtetit. Ndërkaq, me këtë amendamentim të Projektligjit të propozuar, ligjvënësi ka përcaktuar që ndonëse AKI dhe FSK paguhen nga buxheti i shtetit, pagat e tyre nuk do të përcaktohen me Ligjin për Pagat por përmes legjislacionit tjetër të aplikueshëm për to. Arsyetim për këtë përjashtim – nuk rezulton të jetë dhënë. Amendamenti në fjalë është propozuar nga Komisioni Funkcional i Kuvendit mirëpo Gjykata nuk ka arritur të vërejë asnjë arsyeje legjitime mbi bazën e së cilës është shpjeguar ky lloj diferencimi ose ky përjashtim i tërësishëm për këto dy institucione që financohen drejtpërsëdrejti nga buxheti i shtetit. Për disa përjashtime të tjera ligjvënësi e ka konsideruar se duhet të ceket arsyeshmëria në mënyrë specifike në Ligj – siç është p.sh. arsyeshmëria e theksuar për përjashtimet e bëra për nëpunës të Kuvendit dhe për deputetë.
264. Madje, këto dy institucione nuk janë të vetmet përjashtime që Ligji i kontestuar ka bërë në kundërshtim me vet qëllimin e Ligjit. Avokati i Popullit thekson, për shembull, se Banka Qëndrore e Kosovës si një nga Institucionet e Pavarura të listuara në Kapitullin XII të Kushtetutës nuk figuron askund në Ligjin e kontestuar. Arsyet për këtë nuk janë të ditura. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe të tjerë të përjashtuar, qoftë në aspekt institucional ose në aspekt të pozitave specifike. Për Gjykatën është e paqartë se si këto përjashtime të akorduar me këtë Ligj, në mënyrë shprehimore ose të heshtur, kanë kontribuar në qëllimin parësor të Ligjit për të rregulluar sistemin e pagave dhe shpërblimeve për të gjithë zyrtarët dhe funksionarët publikë, që paguhen nga buxheti i shtetit. Kjo nuk është për të thënë që Kuvendit nuk i lejohet të bëjë përjashtime – mirëpo Kuvendi nuk

mund të bëjë përjashtime arbitrare dhe të paarsyetuara e që mund të ngjallin konfuzion, pakënaqësi dhe pabarazi në trajtim në mesin e atyre që paguhën nga buxheti i shtetit.

265. Për më tepër, Gjykata po ashtu ka vënë re theksin se qëllimi i Ligjit është që të harmonizojë pagat në nivel të sektorit publik mbi bazën e parimit të ashtuquajtur **“pagë e njëjtë për punë të njëjtë”**. Lidhur me këtë “parim”, Gjykata fillimisht i referohet përgjigjes së pranuar nga Komisioni i Venecias ndaj kërkesës së Gjykatës, ku është theksuar se *“për shkak të mungesës së standardeve të aplikueshme ndërkombëtare”* në lidhje me parimin *“pagesë e njëjtë për punë të njëjtë”*, në fushën që mbulon Ligjin në fjalë, nuk ka mundësi të ofrohet një *Amicus Curiae* brief (shih paragrafin 15 të këtij Aktgjykimi).

266. Gjykata thekson se në nivel të përgjithshëm, mungesa e një përkufizimi të qartë të parimit të “pagës së njëjtë për punë të njëjtë” dhe “punës me vlerë të barabartë”, duke përfshirë një tregues të qartë të kriterëve të vlerësimit për krahasimin e punëve të ndryshme në institucione të ndryshme, është një mangësi evidente që ka prodhuar shumë pakënaqësi, konfuzion dhe ankesa. Për të vlerësuar nëse një nëpunës i caktuar i një institucioni të caktuar publik po kryen punë me vlerë të barabartë, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh përfshirë natyrën e punës, institucionin në të cilin ushtrohet detyra, edukimi dhe trajnimi përkatës që kërkohet, si dhe kushtet e tjera të punës. Rrjedhimisht, në përcaktimin dhe zbatimin e parimit “pagë e njëjtë për punë të njëjtë” dhe “punë me vlerë të njëjtë” në kontekstin vendor, ligjvënësi duhet të merr parasysh tiparet e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të përkujdeset që të sigurojë dhe garantojë inkorporimin e tyre në kontekst të pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të pushteteve klasike si dhe Institucioneve të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë.

267. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Ligji i kontestuar kundërshton haptazi vet qëllimin për të cilin thuhet të jetë nxjerrë. Prandaj, përjashtimet e bëra shkojnë kundër vet qëllimit të Ligjit dhe krijojnë diferencime të paarsyetuara, të padëshmuara dhe arbitrare.

268. Neni 3 i Ligjit për Pagat citon gjithsej gjashtë parime sipas të cilëve theksohet se bazohen pagat e përcaktuara me Ligjin e kontestuar. Parimi i parë është ai i *“ligjshmërisë”* ku theksohet se: *“pagat e përfituesve përcaktohen vetëm në pajtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore, të autorizuara dhe të nxjerra në zbatim të tij”*. Parimi i dytë është ai i *“drejtësisë”* ku theksohet se: *“niveli i pagës duhet të shpërblejë në mënyrë të drejtë kompleksin e punës dhe kontributin e individit në punën e organizatës”*. Parimi i tretë është ai i *“pagës së*

barabartë”, ku theksohet se: “secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme”. Parimi i katërt është ai i “transparencës”, ku theksohet se: “procedura për përcaktimin e pagës, niveli i saj dhe administrimi i sistemit të pagave të jetë transparente për publikun, pa rënë në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi”. Parimi i pestë është ai i “mosdiskriminimit”, ku theksohet se “asnjë përfitues i pagës nuk diskriminohet në pagë, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Parimi i gjashtë është ai i “parashikueshmërisë”, ku theksohet se “niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit.”

269. Gjykata në veçanti vëren se ligjvënësi e ka konsideruar si të rëndësishëm parimin e **“parashikueshmërisë”** duke rregulluar që niveli i pagës i përcaktuar me Ligjin për Paga *“nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit.”* Më specifikisht në zbatim të këtij parimi, në nenin 24 [Ulja e nivelit të pagës] të Ligjit për Paga, ligjvënësi ka paraparë që niveli i pagës i përcaktuar sipas Ligjit të kontestuar *“mund të ulet”* vetëm *“me ligj”* dhe atë *“në situata të jashtëzakonshme të vështirësive financiare.”* Megjithatë, ligjvënësi duket të mos e ketë konsideruar si të rëndësishëm këtë parim për ata persona që tashmë pranojnë paga nga buxheti i shtetit, sipas “ligjit” ekzistues. Në fakt, Gjykata vëren se Projektligji i propozuar nga Qeveria e ka pasur një nen të veçantë në dispozitatë tranzitore që ka pasur për qëllim pikërisht mbrojtjen e të drejtave të personave që tashmë e kanë fituar një të drejtë për të përfituar një pagë ose kompensim të caktuar nga buxheti i shtetit. Neni 27 i Dispozitave tranzitore i Projektligjit të kontestuar të propozuar nga Qeveria parashihte: *“1. Nëse një individ, zyrtar apo funksionar publik, përfitonte përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, një pagë të plotë (paga bazë me të gjitha llojet e shtesave të rregullta), që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe një shtesë tranzitore të posaçme të barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vjetër dhe pagës së re.”*
270. Megjithatë, Kuvendi ka konsideruar që propozim-neni i tillë nuk është i nevojshëm dhe e ka larguar atë nga drafti final i Ligjit për Paga gjatë procesit të ligjbërjes në Kuvend. Nga dokumentet përgatitore, Gjykata nuk ka vënë re asnjë diskutim ose arsyetim se përse është bërë një gjë e tillë. Mos respektimi i të drejtave ekzistuese të individëve që pranojnë pagë ose kompensim të caktuar nga buxheti i shtetit ka ngjallur një numër të konsiderueshëm ankesash të cilat janë adresuar

edhe tek Avokati i Popullit. Ajo çfarë duhet të potencohet në këtë aspekt është se Kuvendi ka konsideruar që parimi i “parashikueshmërisë” është parim shumë i rëndësishëm – por vetëm për të ardhmen, jo edhe për të tashmen dhe për personat tashmë të prekur negativisht nga Ligji për Paga. Sipas rregullimit të ri ligjor të Kuvendit rezultojnë që për të ardhmen, ligjvënësi konsideron se pagat mund të ulen **vetëm** në situata të jashtëzakonshme dhe të vështirësisë financiare; ndërkohë që asnjë nga pagat e shkurtuara në sektorin publik përmes Ligjit të kontestuar nuk janë arsyetuar mbi bazën e ndonjë “situatë të jashtëzakonshme” ose të “vështirësisë financiare”. Ato thjeshtë janë ulur në emër të tendencës për “homogjenizim” dhe “harmonizim” gjithëpërfshirës i cili rezultojnë të mos jetë arritur. Në fakt, rezultojnë që ulja e pagave për një mori të konsiderueshme të pagëmarrësve nga buxheti i shtetit, siç dëshmojnë të dhënat e pranuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, është bërë në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë arsyetim. Për disa, madje as nuk dihet sa dhe si do iu ulen paga, siç konfirmon përgjigja e Ministrisë së Financave dhe Transfereve. Qasja e tillë selektive ndaj parimit të parashikueshmërisë i cili është pjesë përbërëse e parimit të sundimit të ligjit dhe të sigurisë juridike – është e papranueshme dhe duhet të evitohet në çdo ligjëbërje të ardhshme të Kuvendit.

271. Arsyetja përse fokusi i analizës në aspekt të parashikueshmërisë është më shumë tek “ulja” e pagave se sa te “rritja” e pagave që është bërë me Ligjin e kontestuar është pikërisht për faktin se ligjvënësi gjatë ushtrimit të kompetencës kushtetuese për ligjëbërje është dashur të përkujdeset për të drejtat e personave të cilëve iu shkurohet paga. Ligjvënësi është në të drejtën e tij që menjëherë pas këtij Aktgjykimi të ndërmerr çfarëdo lloj hapi për të rritur pagat në sektorin publik ashtu që të përmbush çdo synim të politikës publike për rritje pagash në sektorë të caktuar. Ekzistojnë modalitete të shumta se si një gjë e tillë mund të bëhet por që kjo ngelet plotësisht në diskrecion të Kuvendit dhe të Qeverisë, pas analizave respektive që ata bëjnë. Menjëherë pas këtij Aktgjykimi, ligjvënësi është po ashtu në të drejtën e tij që të ndërmerr çfarëdo lloj hapi për të ulur pagat në sektorin publik ngase nuk ekziston një ndalesë absolute për të mos ulur pagat në sektor publik. Megjithatë, ndonëse në diskrecion të Qeverisë dhe Kuvendit, duhet pasur parasysh që çdo ulje e pagave, për secilin pozicion ekzistues, duhet të arsyetohet fuqishëm dhe të mos jetë arbitrare. Po ashtu, çdo ulje e pagave duhet të jetë e tillë që të mos e vëjë barrën e shkurtimit të pagës vetëm në disa persona ose sektorë të caktuar të sektorit publik. Arsyet për ulje pagash duhet të jenë shumëfish më të qëndrueshme se sa arsyet për rritje pagash. Për pagat e Gjyqësorit, veçse është elaboruar më lart. Ato kurrësi nuk mund të shkurohen gjatë mandatit të një gjyqtari përveç nëse shkurtimi në

pagë arsyetohet nga një situatë e jashtëzakonshme e vështirësisë së dëshmuar financiare (shih rastet e Gjykatëve të ndryshme evropiane dhe botërore si dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias që flasin për pagat e Gjyqësorit, cituar më lart).

272. Më tutje, përkitazi me parimin e “transparencës” si një nga parimet më të cilat thuhet të jetë udhëhequr rregullimi i Ligjit të kontestuar, do të duhej që *“procedura për përcaktimin e pagës, niveli i saj dhe administrimi i sistemit të pagave të jetë transparente për publikun”*. Për Gjykatën nuk është e qartë se si është aplikuar ky parim kur rreth 42% të pozitive që aktualisht marrin pagë nga buxheti i shtetit ende nuk mund të deshifrojnë se sa do ta kenë pagën me Ligjin e ri për Paga. Madje, për shumicën prej tyre fjalën e fundit se ku ata do të klasifikohen dhe çfarë page do të kenë - do ta ketë Qeveria, respektivisht MAP-i dhe atë vetëm pasi që të jenë miratuar aktet nënligjore që do duhej të miratoheshin deri më 1 dhjetor 2019. Edhe për Gjyqësorin si pushtet i tretë e edhe për Institucionet e Pavarura – është Qeveria, respektivisht MAP-i ai që do të vendoste për pagën përfundimtare të një nëpunësi të tyre. Kjo dërgon në përfundimin që parimi i transparencës – ndonëse i duhur dhe i qëlluar si parim, përmes Ligjit të kontestuar nuk ka gjetur aplikim.
273. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Ligji i kontestuar nuk ka ndjekur e respektuar të paktën dy nga parimet themelore mbi të cilat thuhet të jetë udhëhequr Ligji i kontestuar, atë të parashikueshmërisë dhe transparencës. Në vlerësim të parimeve të tjera, Gjykata nuk do të lëshohet.
274. Neni 4 i Ligjit për Pagat flet për pagën e “nëpunësit civil” ku theksohet se e njëjta përbëhet nga *“paga bazë dhe shtesat, sipas rastit”*. Po në të njëjtin nen, në paragrafin 4 parashihet një përjashtim për nëpunësit e Administratës së Kuvendit për sa i përket shtesave dhe kompensimeve. Përderisa në paragrafin 3 thuhet se: *“Pagat e nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj, sipas Shtojcës 1 të këtij ligji”*, menjëherë në paragrafin pasues vijon përjashtimi sipas të cilit: *“Shtesa dhe Kompensimi i nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*. Tutje, në paragrafin 5 të nenit 4 të Ligjit për Pagat thuhet se: *“Rregullimi me akt të veçantë sipas paragrafit 4. të këtij neni, bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

275. Përveç kësaj, neni 12 [Shtesa të posaçme për funksionarët publik] flet për shtesat e posaçme të deputetëve mbi pagën bazë; shtesat e posaçme për funksion parlamentar të Kryetarit të Kuvendit, nënkryetarit të Kuvendit, kryetarit të komisionit parlamentar, zëvendëskryetarit të komisionit parlamentar dhe kryetarit të grupit parlamentar; të drejtën e kompensimit për pjesëmarrje në seancë parlamentare, në mbledhje të komisionit parlamentar dhe për shpenzimet mujore. Sipas paragrafit 4 të këtij neni, të gjitha kompetencat për të përcaktuar kriteret dhe procedurat për shtesa dhe kompensime për deputetë iu janë lënë Kryesisë së Kuvendit që t'i vetpërcaktojë me rregullore të brendshme. Më tutje, neni 12 i Ligjit për Pagat përcakton që shtesat dhe kompensimi për stafin politik të Kuvendit *“rregullohet me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit”*.
276. Përjashtimet e parapara në nenin 4 të Ligjit të kontestuar, vetëm për Administratën e Kuvendit; dhe përjashtimet e parapara në nenin 12 të Ligjit të kontestuar, vetëm për deputetët dhe stafin politik të Kuvendit – paraqesin një nga problemet më serioze kushtetuese të Ligjit në fjalë. Përmes këtij neni, ligjvënësi, respektivisht Kuvendi si njëri nga tri pushtetet klasike të qeverisjes së Republikës së Kosovës ka paraparë që të gjitha çështjet që ndërlidhen me shtesat dhe kompensimet e nëpunësve të vet, staf civil dhe politik, dhe të vet deputetëve të rregullohen me “akte të veçanta” të miratuar nga Kryesia e Kuvendit dhe se një përjashtim i tillë, sipas ligjvënësit *“bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*
277. Përjashtimet e tilla e edhe arsyetimi i dhënë në Ligjin e kontestuar mbase dhe do të mund të ishte në rregull nëse ligjvënësi do të kushtonte vëmendje të njëjtë edhe për pushtetet e tjera e edhe për Institucionet e Pavarura kushtetuese. Po t'i trajtonte të gjitha pushtetet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me specifikat e tyre kushtetuese - edhe do të mund të rezultonte në rregullim në përputhje me Kushtetutën. Mirëpo, përjashtimi i vetëm njërit pushtet dhe mos respektimi i garancive kushtetuese të pushteteve tjera, duke injoruar tërësisht Gjyqësorin dhe Institucionet e Pavarura është zgjidhje legjislative që nuk përkon me vlerat dhe parimet e Kushtetutës, veçanërisht me parimin e ndarjes së pushteteve. Shto kësaj faktin që, përveç Kuvendit, respektivisht legjislativit, i vetmi pushtet tjetër i autorizuar që të rregullojë çështje të caktuara me akte nënligjore është Qeveria, respektivisht ekzekutivi. I vetmi pushtet që është injoruar tërësisht nga çdo lloj rregullimi specifik dhe i përshtatur që do të kishte parasysh *“natyrën dhe kushtet specifike”* të punës dhe të pavarësisë së tij – është pushteti i Gjyqësorit. E njejta mund të thuhet edhe për

Institucionet e Pavarura të referuara në Kapitujt VIII dhe XII të Kushtetutës.

278. Për më tepër, Gjykata po ashtu vëren se nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit të kontestuar rregullojnë çështje që kanë të bëjë me pagën bazë, shtesa për kushte tregu, shtesa vjetore bazuar në rezultatet e vlerësimit të punës, shtesa të posaçme mbi pagën bazë dhe shtesa për punë jashtë orari. Për të gjitha këto çështje, ligjvënësi e ka mveshur Qeverinë me autorizim për të nxjerrë akte nënligjore për të gjitha institucionet (me përjashtim të rasteve specifike ku janë paraparë përjashtime – si për Kuvendin e edhe për FSK-në, AKI-në dhe të tjerët që janë përjashtuar tërësisht nga Ligji në mënyrë të heshtur).
279. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar i jep gjashtëmbëdhjetë (16) kompetenca të veçanta Qeverisë që përmes akteve nënligjore dhe pas konsultimit me ministri përkatëse të rregullojë çështje të caktuara (shih nenet 5.4; 5.5; 6.3; 6.4; 7.5; 8.3; 9.5; 14.4; 15.4; 17.4; 18.2; 19.4; 20.5; 21.6; 21.8; 22.5; 25.3; 26.2; 27.2 të Ligjit të kontestuar – ku në të gjitha këto nene Qeveria autorizohet të nxjerrë akt nënligjor; shih po ashtu edhe dy (2) kompetencat specifike të Kuvendit për akte nënligjore, të elaboruara më lart).
280. Kjo nënkupton se të gjitha kompetencat rregulluese përmes akteve nënligjore janë lënë në duart e Ekzekutivit dhe Legjislativit – si dy nga pushtetet që në fakt e kanë hartuar, respektivisht miratuar këtë iniciativë ligjore përmes votës në Kuvend. Gjyqësori si pushteti i tretë nuk ka kompetenca kushtetuese as për të propozuar ligje e as për t'i miratuar ato. Por, kjo nuk do të thotë që dy pushtetet tjera simotra duhet ta injorojnë atë tërësisht vetëm për faktin se nuk ka qenë pjesëmarrës aktiv në ligjbërje. Përkundrazi, pikërisht për faktin se pushteti i tretë nuk ka qenë pjesëmarrës aktiv në ligjbërje është dashur që t'i kushtohet vëmendje e veçantë çdo rregullimi ligjor që potencialisht do të mund të krijonte “ndëhyrje” kundërkushtetuese në pavarësinë institucionale, funksionale, organizative. Kjo do arrihej duke marrë parasysh “*natyrën dhe kushtet specifike*” të punës dhe të pavarësisë së pushtetit Gjyqësor.
281. Është e qartë se Ligji i kontestuar, përveç kompetencave që i ka dhënë Qeverisë dhe Kuvendit, nuk i jep asnjë kompetencë Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura kushtetuese që të rregullojnë çështje të caktuara. Për të gjitha çështjet, ligjvënësi ka lënë Qeverinë dhe Ministrinë përkatëse të saj si organe vendimtare vendimmarrëse. Rregullimi i tillë ligjor, me përjashtim të tërësishëm të kompetencave vetrregulluese të Gjyqësorit, padyshim që ka krijuar një disbalancim në ndarjen e pushteteve të cilin fryma dhe germa e Kushtetutës

kurrsesi nuk e aspiron. Rregullimi i tillë ligjor, nëse do të konfirmohej si kushtetues, do të kishte potencialin që të krijonte “ndërhyrje” të pushtetit Ekzekutiv ndaj pushtetit Gjyqësor dhe “varësi” e “vartësi” të pushtetit Gjyqësor ndaj pushtetit Ekzekutiv ngase i pari do të duhej të varej nga vullneti i të dytit në aspekt të rregullimeve të brendshme për staf dhe aspekt funksional, organizativ, buxhetor e strukturor të punës. Një rregullim i tillë ligjor është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën.

282. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Ligji i kontestuar përmes përjashtimeve të bërë vetëm për Kuvend dhe Qeveri ka cenuar garancitë kushtetuese të pavarësisë së Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura – duke krijuar një disbalancë në ndarjen e pushteteve.
283. Neni 31 [Aktet nënligjore] parasheh që të gjitha aktet nënligjore të parapara me këtë ligj duhet të *“miratohen **brenda 9 muajve** pas publikimit në Gazetën Zyrtare”*, ndërkaq që neni 34 [Hyrja në fuqi] përcakton që Ligji i kontestuar *“hyn në fuqi 9 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare.”*
284. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar u miratua nga Kuvendi më 2 shkurt 2019; u publikua në Gazetën Zyrtare më 1 mars 2019 dhe hyri në fuqi nëntë (9) muaj pas publikimit, respektivisht më 1 dhjetor 2019. Në mënyrë shumë të qartë, neni 31 i Ligjit të kontestuar ka paraparë masën përgatitore për zbatim të Ligjit në fjalë duke kërkuar që të gjitha aktet nënligjore të parapara me Ligj të miratohen **“brenda”** 9 muajve pas publikimit në Gazetën Zyrtare, respektivisht deri më 1 dhjetor 2019. Gjykata vëren se përgjigja e Ministrisë së Financave dhe Transfereve në mënyrë shumë të qartë ka sqaruar se vetëm një (1) nga gjithsejt tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që do duhej të miratoheshin – është miratuar. Në mes tjerash edhe për këtë arsye, Ministria e Financave dhe Transfereve theksoi se Ligji për Pagat, edhe sikur të hynte në fuqi sot, nuk do të mund të zbatohej në tërësi në praktikë derisa të miratoheshin të gjitha aktet e parapara nënligjore (edhe shtatëmbëdhjetë (17) të mbetura). Fakti që Ligji i kontestuar është pezulluar me vendim për masë të përkohshme nga Gjykata dhe se kjo është një nga arsyet përse nuk janë miratuar aktet nënligjore nuk qëndron. Kjo për faktin se aktet nënligjore është dashur të miratohen pikërisht brenda periudhës 9 mujore të *vacatio legis* që ka lënë Ligji i kontestuar. Mos miratimi i akteve nënligjore e ka bërë të pamundur që Gjykata të kuptojë saktë se për cilat pozicione sa rritet paga dhe për cilat pozicione saktë sa ulet paga. Në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, Ministria e Financave dhe Transfereve ka pranuar dhe sqaruar se nuk mund ta japë atë përgjigje për rreth 42% të pozitive që paguhen nga buxheti i shtetit ngase pa miratim të akteve

nënligjore nuk dihet se sa do ta kenë pagën një mori pozicionesh që aktualisht paguhen nga buxheti i shtetit. I gjithë ky proces i shkujdesur ligjbërës, pa asnjë dyshim dërgon në një situatë të papranueshme të pasigurisë juridike që asesi nuk mund të jetë e pajtueshme me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e saj.

285. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se fakti se Ligji i kontestuar, edhe po të hynte në fuqi nuk do të mund të zbatohet menjëherë në tërësinë e tij, shkon kundër parimit të parashikueshmërisë dhe të sigurisë juridike.
286. Neni 32 [Ndalimi dhe përcaktimi i ekuivalencës] parasheh që me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave. Paragrafi 2 i këtij Neni parasheh që me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave apo emërtesave të reja, Institucioni në të cilin krijohet pozita **“duhet të kërkojë”** nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave përcaktimin e klasës së pagës që zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë, në bazë të ekuivalencës. Paragrafi 3 i këtij Neni parasheh që ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financat, në momentin që marrin një kërkesë nga Institucioni i caktuar, **“do të vlerësojnë funksionin, pozitën apo emërtesën”** me ekuivalencën bazë të parimet e Ligjit të kontestuar dhe do të bëjnë propozimin **“për aprovim në Qeveri”** për klasën e pagës që do të zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë.
287. Ky nen po ashtu paraqet një problem serioz konceptual dhe praktik, sidomos për Gjyqësorin dhe Institucionet e Pavarura. Nëse kjo dispozitë do të deklarohej si kushtetuese, kjo do të nënkuptonte që sa herë që Gjyqësori, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit dhe Institucionet e tjera të Pavarura e kanë të nevojshme të krijojnë një pozicion të ri brenda organogramit të tyre ose të ndryshojnë strukturën e brendshme organizative, varësisht nga nevoja që mund të lind në të ardhmen – ato duhet t’i drejtohen Qeverisë për të kërkuar leje dhe miratim për krijim të një pozite të re dhe për të kërkuar leje dhe miratim për ndryshim të strukturës së brendshme organizative. Ligji i kontestuar në këtë aspekt thotë që është MAP ai i cili **“do të vlerësojnë funksionin, pozitën apo emërtesën”** dhe do të bëjë **“propozimin për aprovim në Qeveri për klasën e pagës që do të zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë”**. Ndërkaq, në zingjirin vendimtar dhe përfundimtar vendimmarrës është Qeveria ajo e cila duhet të **“aprovojë”** çdo propozim të Gjyqësorit. Në terma të tjerë praktik kjo nënkupton që çdo pozicion i ri, çdo emërtim i ri, çdo

funksion i ri i konsideruar i nevojshme nga Gjyqësori – duhet të miratohet nga ekzekutivi, respektivisht Qeveria.

288. Gjykata konstaton se ky rregullim ligjor shkon, në mënyrë flagrante, në kundërshtim me nocionin e pavarësisë “institucionale, funksionale dhe organizative” të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Si i tillë është i papranueshëm dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe parimin kyç të ndarjes së pushteteve si model kushtetues i qeverisjes në Republikën e Kosovës.
289. Neni 33 [Shfuqizimi] përcakton shprehimisht që Ligji i kontestuar shfuqizon ligjet ose dispozitat vijuese:

*“1.1. Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë;
1.2. Ligji nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-038;
1.3. Neni 11, paragrafi 2. i ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
1.4. Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
1.5. Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
1.6. Neni 35, paragrafët 1. dhe 2. të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat;
1.7. Neni 21, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1. deri në 1.10., i Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
1.8. Neni 18, paragrafi 1., i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe çdo dispozitë e ligjit dhe e aktit nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave dhe shpërblimeve.”*

290. Përmes nenit 33 të Ligjit të kontestuar, *inter alia*, janë shfuqizuar shprehimisht disa nga nenet specifike të ligjeve organike të Gjyqësorit që më parë rregullonin çështjen e pagave të pushtetit të Gjyqësorit në përgjithësi, të Gjykatës Kushtetuese dhe të kryesuesve të të dy Këshilleve, atij Gjyqësor dhe Prokurorial. Megjithatë, përmes nenit 28 [Dispozita transitore] të Ligjit të kontestuar është paraparë që sistemi i pagave, shtesave dhe shpërblimeve të parapara në Shtojcën nr. 1 të Ligjit të kontestuar nuk zbatohen për funksionarët publik me status të veçantë, respektivisht, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, kryesuesin e Këshillit gjyqësor dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial deri më 31 dhjetor 2022. Ndërkaq, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ligjvënësi ka paraparë të njëjtin përjashtim deri më 31 dhjetor 2022 në nenin 29 të Ligjit – por nuk ka shfuqizuar

ligjet ekziesutese përmes së cilave rregullohej paga e Agjencisë Kosovare për Privatizim. Ky dallim ka rëndësi.

291. Gjykata vëren dy probleme evidente dhe bazike në këtë aspekt. E para ka të bëjë me vakumin dhe kontradiktën ligjore të krijuar me Ligjin e kontestuar. Kjo për faktin se në momentin juridik që do të hynte në fuqi Ligji i kontestuar, neni 33 i Ligjit të kontestuar do të shfuqizonte të gjitha normat respektive të cilat rregullojnë aktualisht pagat e Gjyqësorit, të Gjykatës Kushtetuese, kryesuesve të Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial (shih pikat 1.4; 1.6; 1.7; 1.8 të nenit 33 të cituar më lart). Kjo do të thotë që me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar dhe nëse i njëjti do të ishte në fuqi e të mos pezullohej, këto dispozita ligjore i bie të mos ishin më tutje në fuqi ngase do të ishin shfuqizuar me Ligjin e kontestuar.
292. Në anën tjetër, Gjykata vëren që në ditën e votimit në Kuvend është shtuar një nen i ri, sipas të cilit theksohet se: *“Dispozitat e këtij ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe Shtojca nr. 1 e këtij ligji nuk zbatohen për funksionarin publik me status të veçantë: gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial deri më 31 dhjetor 2022”* (shih neni 28 i Ligjit të kontestuar). Shtrohet pyetja, nëse janë shfuqizuar me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar nene të caktuara të ligjeve organike të cekura në pikat 1.4; 1.6; 1.7; 1.8 të nenit 33 të cituar më lart – në bazë të cilit Ligji i bie që do të pranonin pagë këta funksionarë të veçantë. Cila pagë do tu ruhej atyre kur dispozitat që rregullojnë pagën e tyre do të shfuqizoheshin. Me këtë rregullim të shkujdesur ligjor, në fakt, po të hynte në fuqi Ligji i kontestuar, rezulton se ligjvënësi do t'i kishte lënë pa asnjë rregullim ligjor funksionarët e veçantë të lartcekur duke shfuqizuar pikërisht normat mbi të cilat është rregulluar paga e tyre. Është e paqartë se si do të mund të zbatohet paga e tyre e vjetër kur vet nenet specifike mbi të cilat është bazuar paga e tyre e vjetër do të ishin shfuqizuar.
293. Një tjetër problem madhor me mënyrën e rregullimit të pagave të Gjyqësorit është qasja e shtyerjes së zbritjes të pagave për pushtetin e Gjyqësorit për rreth 2 vite e disa muaj, respektivisht deri në fund të vitit 2022. Pas vitit 2022, respektivisht më 1 janar 2023, të gjithë gjyqtarët në detyrë do të pësonin ulje drastike të pagave të tyre. Siç shprehimisht theksohet në të gjitha Opinionet e Komisionit të Venecias e edhe në shumë praktika gjyqësore të nivelit evropian dhe botëror, paga e gjyqtarit individual mund të ulet vetëm si pasojë e një krize të evidentuar ekonomike që do të përbënte rrethanë të jashtëzakonshme për shtetin e që patjetër do të duhej të ndërmerrej masa e tillë. Gjithashtu, barra e uljes së pagave, nëse veç konsiderohet

si e domosdoshme për shkak të krizës ekonomike, duhet të jetë proporcionale dhe të përfshijë të gjithë në mënyrë të barabartë ashtu që asnjë sektor i veçantë të mos e marrë përsipër barrën kryesore. Ligji i kontestuar nuk ka marrë parasysh asnjë nga këto parime.

294. Rrjedhimisht, koncepti i ruajtjes së pagave të Gjyqësorit vetëm deri në vitin 2022, dhe më pas përgjysmimi i pagave pas asaj date nuk mund të kontribuojë në garantimin e një Gjyqësori të pavarur. Një gjë e tillë në fakt do të vinte në një presion të pakëshillueshëm Gjyqësorin kundrejt pushtetit Legjislativ dhe Ekzekutiv. Ndërkaq, përmes rregullimit të paharmonizuar ligjor përkitazi me efektet ligjore të nenit 28 të Ligjit të kontestuar në raport me nenin 33 të Ligjit të kontestuar – Ligji i kontestuar, po të lejohej zbatimi i tij, do të shkaktonte një vakum ligjor sipas të cilit Gjyqësori dhe të gjithë funksionarët publik me status të veçantë të referuar në nenin 28 do të ngelin pa një “ligj” të aplikueshëm që përcakton pagat e tyre (të vjetra apo të reja) deri më 31 dhejtor 2022.

KONKLUZION - *përkitazi me përputhshmërinë e Ligjit të kontestuar me parimin e ndarjes së pushteteve, respektivisht nenet 4 dhe 7 në lidhje me nenet 102, 103.1, 108, 109, 110, 115 të Kushtetutës dhe nenet 132, 136, 139, 141 të Kapitullit XII të Kushtetutë*

295. Në dritë të këtyre që u thanë më sipër, Gjykata konstaton se Ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 4 dhe 7 në lidhje me nenet 102, 103.1, 108, 109, 110, 115 të Kushtetutës dhe nenet 132, 136, 139, 141 të Kapitullit XII të Kushtetutë.
296. Në rast të ligjbërjes së re në këtë fushë, Qeveria në cilësi të propozueses së ligjeve dhe Kuvendi në cilësi të miratuesit të ligjeve, janë të obliguar që të marrin parasysh parimet e theksuara në këtë Aktgjykim dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në interpretim të neneve respektive të Kushtetutës. Pavarësia “institucionale, funksionale, organizative dhe buxhetore” e Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura duhet të njihet dhe çdo iniciativë ligjore duhet të respektojë këtë pavarësi.
297. Gjetja e shkeljeve të lartcituara e bën Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij kundërkushtetues.
298. Gjykata me shumë kujdes ka analizuar mundësinë e shfuqizimit të pjesërisht të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret një zgjidhje e tillë, për dallim nga rrethanat e Ligjit për Zyrtarët Publik që u shfuqizua pjesërisht, nuk ishte e mundur për dy arsye. E para sepse shkeljet kushtetuese të evidentuara në Ligjin e

kontestuar janë të një peshe aq serioze sa që të njëjtat ndikojnë në bazën e funksionimit të qeverisjes në Republikën e Kosovës – duke shkaktuar disekuilibrim të ndarjes së pushteteve në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. E dyta, sepse Ligji i kontestuar nuk ofron një mundësi të shfuqizimit të vetëm disa dispozitave dhe të vetëm disa pikave të Shtojcave nr. 1 dhe 2, ngase çdo lloj shfuqizimi do ta bënte Ligjin të pazbatueshëm në praktikë. Dhe, në rastet kur analiza dërgon në përfundimin se Ligji me shfuqizim të pjesshëm bëhet i pazbatueshëm me nenet e ngelura në fuqi si kushtetuese, Gjykata është e obliguar të shfuqizojë Ligjin në tërësinë e tij.

III. Pretendimet e tjera për shkelje të Kushtetutës të ngritura nga Avokati i Popullit

299. Gjykata rikujton që përveç pretendimit për shkelje të parimit të “ndarjes së pushteteve” dhe “sundimit të ligjit/sigurisë juridike”, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata që të konstatojë se Ligji i kontestuar është po ashtu në kundërshtim me “barazinë para ligjit”; “mbrojtjen e pronës” dhe disa nene të tjera të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe DUDNJ-së.
300. Duke qenë se Gjykata tashmë gjeti shkelje të neneve 4, 7, 102, 103.1; 108; 109; 110, 115; kapitullin VIII dhe kapitullin XII të Kushtetutës, në aspekt të “ndarjes së pushteteve” dhe gjetja e këtyre shkeljeve mjafton për deklarimin e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij si kundërkushtetues, nuk e shih të nevojshme të vijojë tutje me trajtimin e pretendimeve tjera të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës, respektivisht neneve 3.2, 10, 21, 22.1, 23, 24, 46, 55, 58.3, 58.7, 119.1, 119.2, 130 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenin 23.2 të DUDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës në të cilat me rastin e gjetjes e një shkeljeje të caktuar është konstatuar se nuk është e nevojshme trajtimi i pretendimeve të tjera: KO01/17, parashtrues Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, “*Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*”, Aktgjykim i 27 marsit 2017, paragrafët 101-103; KI65/15, parashtrues *Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković Zlatoj Jevtić*, Aktgjykim i 14 shtatorit 2016, paragrafi 137; KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 145).
301. Thënë këtë, Gjykata gjithsesi e shih të nevojshme të theksojë dy aspekte të rëndësishme përkitazi me pretendimet shtesë të parashtruesit të kërkesës.

302. E para ka të bëjë me obligimin e Qeverisë, si propozuese e ligjeve, dhe Kuvendit, si ligjvënës që përfundimisht miraton ligjet e propozuara nga Qeveria, që gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, të kenë parasysh parimet e barazisë para ligjit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë personave të drejtat e të cilëve preken nga çfarëdo lloj plotësimi ose ndryshimi ligjor. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurohen që vlerat kushtetuese për barazi para ligjit dhe mos diskriminim të respektohen në gjithsecilën rrethanë dhe që çdo rregullim ligjor të jetë në përputhje me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së si dhe në përputhje me praktikë gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Njeriut.
303. E dyta ka të bëjë me obligimin e Qeverisë, si propozuese e ligjeve, dhe Kuvendit, si ligjvënës që përfundimisht miraton ligjet e propozuara nga Qeveria, që gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, të kenë parasysh aspektet relevante të drejtat e pronës dhe pritjeve të të gjithë personave të drejtat e të cilëve preken nga çfarëdo lloj amendamenti, plotësimi ose ndryshimi ligjor. Çdo ulje e mundshme e pagave ekzistuese, ndonëse e mundshme dhe në diskrecion përfundimtar të ekzekutivit dhe legjislativit, duhet të jetë e arsyetuar dhe të respektojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të jetë në pajtim me parimin e parashikueshmërisë, sigurisë juridike dhe atë të sundimit të ligjit. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurohen që e drejta e pronës të respektohet në gjithsecilën rrethanë dhe që çdo rregullim ligjor të jetë në përputhje me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe në përputhje me praktikë gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Njeriut.

IV. Kërkesa për masë të përkohshme

304. Më 5 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë ku, në mes tjerash, kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për pezullimin e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij.
305. Më 12 dhjetor 2019, Gjykata e kishte miratuar si të bazuar kërkesën për masë të përkohshme dhe e kishte pezulluar zbatimin e Ligjit të kontestuar, *“pa paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës.”* Masa e përkohshme ishte vendosur deri më 30 mars 2020.

(Shih Vendimin për masë të përkohshme në rastin KO219/19, të 12 dhjetorit 2019, në piken I të dispozitivit).

306. Më 30 mars 2020, Gjykata, vendosi për vazhdimin e masës së përkohshme, respektivisht pezullimin e zbatimit të Ligjit të kontestuar deri me 30 qershor 2020. (Shih Vendimin për vazhdimin e masës së përkohshme në rastin KO219/19, të 30 marsit 2020, në piken I të dispozitivit).
307. Më 30 qershor 2020, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi për meritat e saj. Në po të njejtën datë, Gjykata vendosi gjithashtu që të shfuqizojë masën e përkohshme.

V. PËRFUNDIME

308. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, Gjykata, vendosi: (i) njëzëri që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) me shumicë që Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, nuk është në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 103, 108, 109, 110 të Kapitullit VII, nenin 115 të Kapitullit VIII Kushtetutës; si dhe me nenet 132, 136, 139 dhe 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës; (iii) të konstatojë që, nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës pas shpalljes së Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij si kundërkushtetues në aspekt të cenimit të parimeve të “ndarjes së pushteteve” dhe “sigurisë juridike”; (iv) që të shfuqizohet masa e përkohshme.
309. Çështja kushtetuese që ngërthente Aktgjykimi në fjalë ishte përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht vlerësimi nëse i njëjti është në pajtueshmëri me parimin e “ndarjes së pushteteve” dhe atë të “sigurisë juridike” të garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës.
310. Gjykata arriti në përfundimin se Ligji i kontestuar përmbante një mori problemesh serioze të nivelit kushtetues e që do të mund të përmbilidheshin me sa vijon: (i) Ligji i kontestuar kundërshton vet qëllimin e tij për “*harmonizim*” të pagave në nivel të të gjithë sektorit publik - duke bërë përjashtime arbitrare dhe të paarsyetuara për disa institucione, ndër të tjera Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bankën Qendrore të Kosovës, dhe vet Kuvendin; (ii) Ligji i kontestuar përjashton në tërësi pavarësinë e pushtetit Gjyqësor duke mos i lënë asnjë kompetencë vetërregulluese për çështje që ndërlidhen me jetësimin e pavarësisë “funktionale, organizative dhe buxhetore”; (iii) Ligji i kontestuar, ndonëse thekson se pagat rregullohen me këtë Ligj,

e ka zbritur rregullimin ligjor për shumë çështje në nivel të akteve nënligjore, duke i dhënë mundësi rregullimi nënligjor vetëm Ekzekutivit dhe Legjislativit; (iv) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore, gjashtëmbëdhjetë (16) janë për Qeverinë dhe dy (2) për Kuvendin, ndërkaq asnjë kompetencë vetërregulluese për Gjyqësorin ose Institucionet e Pavarura; (v) pushtetit Gjyqësor dhe Institucioneve të Pavarura nuk iu është mundësuar asnjë kompetencë vetërregulluese përmes së cilës ato do të mund të gëzonin pavarësinë e tyre “institucionale, organizative, strukturore dhe buxhetore” në raport me organizimin e brendshëm dhe stafin e tyre; (vi) është miratuar vetëm një (1) nga tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që është dashur të miratohen brenda periudhës së nëntë (9) mujore të *vacatio legis*, respektivisht deri më 1 dhjetor 2019; (vii) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, për rreth 42% të pozitave nuk është e mundur të deshifrohet paga ngase e njëjta përfundimisht do të përcaktohet përmes klasifikimeve përkatëse me akte nënligjore të Qeverisë; (viii) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve “*kostoja buxhetore shtesë*” e Ligjit të kontestuar “*nuk është pjesë e projeksioneve buxhetore 2019-2021*”; (ix) siç konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, edhe po të hynte sot në fuqi Ligji i kontestuar, i njëjti nuk do të mund të zbatohet në tërësi në mungesë të akteve nënligjore.

311. Lidhur me nenin 1 të Ligjit të kontestuar, ku parashihej qëllimi për harmonizim gjithëpërfshirës të pagave të të gjithë sektorit publik, Gjykata vërejti se ligjvënësi, pa ndonjë arsytim dhe në mënyrë arbitrare kishte përjashtuar nga ky Ligj, ndër të tjera, AKI-në, FSK-në, BQK-në dhe AKP-në. Në pjesë të tjera të Ligjit, ligjvënësi kishte akorduar edhe përjashtime të tjera, të drejtpërdrejta ose të patheksuara fare, për nëpunësit e Kuvendit, stafin politik të Kuvendit, deputetët e Kuvendit. Gjykata arriti në përfundimin se, përjashtimet e akorduara me Ligjin e kontestuar kundërshtojnë haptazi vet qëllimin e “*harmonizimit*” gjithëpërfshirës për të cilin thuhet të jetë nxjerrë. Rrjedhimisht, përjashtimet e bëra u konsideruan se shkojnë kundër vet qëllimit të Ligjit dhe krijojnë diferencime të paarsyetuara, të padëshmuara dhe arbitrare.
312. Lidhur me nenin 3 (në lidhje me nenin 24) të Ligjit të kontestuar, Gjykata konstatoi se, nuk janë ndjekur e respektuar të paktën dy (2) nga gjashtë (6) parimet themelore mbi të cilat thuhet të jetë udhëhequr Ligji i kontestuar, respektivisht ai i “*parashikueshmërisë*” dhe “*transparencës*”. I pari parashihte që paga “*nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit*”; ndërkaq i dyti parashihte që “*procedura*

për përcaktimin e pagës, [do] të jetë transparente për publikun". Më konkretisht, lidhur me parimin e parashikueshmërisë, Gjykata theksoi se qasja e ligjvënësit për ta konsideruar si të rëndësishëm parimin e "parashikueshmërisë" vetëm për të ardhmen, jo edhe për të tashmen ka rezultuar në neglizhim të të drejtave të personave që janë prekur negativisht me Ligjin për Paga. Kjo meqë, sipas rregullimit të ri ligjor të Kuvendit, rezulton që për të ardhmen, ligjvënësi konsideron se pagat mund të ulen **vetëm** në situata të jashtëzakonshme dhe të vështirësisë financiare; ndërkohë që asnjë nga pagat e shkurtuara në sektorin publik përmes Ligjit të kontestuar nuk janë arsyetuar mbi bazën e ndonjë "situatë të jashtëzakonshme" ose të "vështirësisë financiare". Qeveria, në Projektligj kishte paraparë një garanci të tillë për mos shkurtrim të pagave (neni 27 i Projektligjit fillestar) por që Kuvendi me amendamentim e kishte eliminuar atë garanci. Tutje, Gjykata nuk konsideron se është aplikuar parimi i "transparencës", kur rreth 42% të pozitave që aktualisht marrin pagë nga buxheti i shtetit ende nuk mund të deshifrojnë se ku pozicionohen dhe se sa do ta kishin pagën me Ligjin e ri për Paga.

313. Lidhur me nenet 4, 5 dhe 12 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vërejtë se Kuvendi, si njëri nga tri pushtetet klasike të qeverisjes me Republikën e Kosovës, ka paraparë që të gjitha çështjet që ndërlidhen me shtesat dhe kompensimet e nëpunësve të vet, staf të rregullt dhe politik, dhe të vet deputetëve të rregullohen me "akte të veçanta" të miratuara nga Kryesia e Kuvendit dhe se një përjashtim i tillë, sipas ligjvënësit "*bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.*" Gjykata konsideroi se, përjashtimet e tilla të parapara vetëm për njërin pushtet – paraqesin një nga problemet më serioze kushtetuese të Ligjit në fjalë. Vet përjashtimi selektiv i vetëm njërit pushtet dhe mos respektimi i garancive kushtetuese të pushteteve tjera, duke injoruar tërësisht Gjyqësorin dhe Institucionet e Pavarura, është zgjidhje legjislative që nuk përkon me vlerat dhe parimet e Kushtetutës, veçanërisht me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.
314. Gjykata po ashtu shënoi faktin se, Ligji i kontestuar i jep gjashtëmbëdhjetë (16) kompetenca të veçanta Qeverisë që përmes akteve nënligjore dhe pas konsultimit me ministritë përkatëse të rregullojë çështje të caktuara, përfshi çështje që prekin Gjyqësorin dhe Institucionet e Pavarura në aspekt të pavarësisë së tyre funksionale, organizative, strukturore dhe buxhetore. (*Shih nenet 5.4; 5.5; 6.3; 6.4; 7.5; 8.3; 9.5; 14.4; 15.4; 17.4; 18.2; 19.4; 20.5; 21.6; 21.8; 22.5; 25.3; 26.2; 27.2 të Ligjit të kontestuar*). Në këtë aspekt, Gjykata vërejtë që përveç Kuvendit, respektivisht Legjislativit, i vetmi pushtet tjetër i autorizuar që të rregullojë çështje të caktuara me akte nënligjore është

Qeveria, respektivisht Ekzekutivi. I vetmi pushtet të të cilit i është injoruar pavarësia për çdo lloj rregullimi specifik që do të kishte parasysh *“natyrën dhe kushtet specifike”* të punës dhe të pavarësisë së tij – është pushteti i Gjyqësorit. E njëjta mund të thuhet edhe për Institucionet e Pavarura të referuara në Kapitujt VIII dhe XII të Kushtetutës. Kjo nënkuptonte se, të gjitha kompetencat rregulluese përmes akteve nënligjore janë lënë në duart e Ekzekutivit dhe Legjislativit – si dy nga pushtetet që në fakt e kanë hartuar, respektivisht miratuar këtë iniciativë ligjore përmes votës në Kuvend.

315. Gjykata theksoi se rregullimi ligjor, me përjashtim të tërësishëm të kompetencave vetërregulluese të Gjyqësorit, padyshim që ka krijuar një disbalancim në ndarjen e pushteteve të cilin nuk e aspirojnë fryma dhe germa e Kushtetutës. Rregullimi i tillë ligjor, nëse do të konfirmohej si kushtetues, do të kishte potencialin që të krijonte “ndërrhyrje” të pushtetit Ekzekutiv ndaj pushtetit Gjyqësor dhe “varësi” e “vartësi” të pushtetit Gjyqësor ndaj pushtetit Ekzekutiv, ngase i pari do të duhej të varej nga vullneti i të dytit në aspekt të rregullimeve të brendshme për staf dhe aspekt funksional, organizativ, buxhetor e strukturor të punës. Një rregullim i tillë ligjor është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën.
316. Lidhur me nenin 31 (në lidhje me nenin 34) të Ligjit të kontestuar ku parashihej që të gjitha aktet nënligjore të parapara me këtë Ligj duhet të *“miratohen brenda 9 muajve pas publikimit në Gazetën Zyrtare”* dhe se Ligji i kontestuar *“hyn në fuqi 9 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare”*, Gjykata vërejti se është miratuar vetëm një (1) nga tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që do duhej të miratoheshin deri më 1 dhjetor 2019, respektivisht brenda periudhës që ligjvënësi kishte lënë si *vacatio legis* për t’u përgatitur për zbatim të Ligjit të kontestuar. Në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, Ministria e Financave dhe Transfereve ka pranuar se Ligji i kontestuar edhe po të hynte sot në fuqi nuk do të mund të zbatohet në tërësi në mungesë të akteve nënligjore. Mungesa e këtyre të fundit, sipas sqarimit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, e ka pamundësuar atë që të japë përgjigje për rreth 42% të pozitave që paguhën nga buxheti i shtetit, ngase pa miratim të akteve nënligjore nuk dihet se sa do ta kenë pagën një mori pozicionesh që aktualisht paguhën nga buxheti i shtetit. I gjithë ky proces i shkujdesur ligjbërës, pa asnjë dyshim dërgon në një situatë të papranueshme të pasigurisë juridike që kurrësi nuk mund të jetë e pajtueshme me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e saj të parashikueshmërisë, sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit.

317. Lidhur me nenin 32 të Ligjit të kontestuar, ku parashihet që me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar ndalohej çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave, Gjykata vërejti disa probleme serioze konceptuale dhe praktike në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. Kjo për faktin se, nëse kjo dispozitë do të deklarohet si kushtetuese, do të nënkuptonte që sa herë që Gjyqësori dhe Institucionet e tjera të Pavarura e kanë të nevojshme të krijojnë një pozicion të ri brenda organogramit të tyre ose të ndryshojnë strukturën e brendshme organizative, varësisht nga nevoja që mund të lind në të ardhmen – ato duhet t'i drejtohen Qeverisë për të kërkuar leje dhe miratim për krijim të një pozite të re dhe për të kërkuar leje dhe miratim për ndryshim të strukturës së brendshme organizative. Ligji i kontestuar, në zinxhirin përfundimtar vendimmarrës e ka lënë Qeverinë si pushtet që duhet të “*aprovojë*” çdo propozim të Gjyqësorit. Gjykata konstatoi se, ky rregullim ligjor pa as edhe një dyshim shkon, në mënyrë flagrante, në kundërshtim me nocionin e pavarësisë “institucionale, funksionale dhe organizative” të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Si i tillë është i papranueshëm dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe parimin kyç të ndarjes së pushteteve, si model i përzgjedhur kushtetues për qeverisjen e Republikës së vendit.
318. Lidhur me nenin 33 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vërejti se *inter alia*, janë shfuqizuar shprehimisht disa nga nenet specifike të ligjeve organike të Gjyqësorit që më parë rregullonin çështjen e pagave të pushtetit të Gjyqësorit në përgjithësi, të Gjykatës Kushtetuese dhe të kryesuesve të të dy Këshillave, atij Gjyqësor dhe Prokurorial. Megjithatë, përmes nenit 28 të Ligjit të kontestuar është paraparë që ky i fundit nuk do të zbatohet për funksionarët e lartpërmendur deri më 31 dhjetor 2022. Gjykata vërejti dy probleme evidente dhe bazike në këtë aspekt.
319. E para kishte të bëjë me vakumin dhe kontradiktën ligjore të krijuar me Ligjin e kontestuar. Kjo për faktin se, në momentin juridik që do të hynte në fuqi Ligji i kontestuar, neni 33 i këtij Ligji do të shfuqizonte të gjitha normat respektive të cilat rregullojnë aktualisht pagat e Gjyqësorit, të Gjykatës Kushtetuese, kryesuesve të Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial (*shih pikat 1.4; 1.6; 1.7; 1.8 të nenit 33 të Ligjit të kontestuar*), e për pagat e të cilëve në të njëjtën kohë Ligji thekson se do të ruhen për periudhën përkatëse. Shtrohet pyetja, nëse do të shfuqizoheshin me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar nenet e ligjeve organike që rregullojnë pagat aktuale – në bazë të cilit Ligj i bie që do të pranonin pagë këta funksionarë të veçantë. Cila pagë do t'u ruhej atyre kur dispozitat që rregullojnë pagën e tyre “të vjetër” – e që supozohej “të ruhej” - do të shfuqizoheshin. Me këtë rregullim të

shkujdesur ligjor rezulton se ligjvënësi do t'i kishte lënë funksionarët në fjalë pa asnjë rregullim ligjor. E dyta kishte të bëjë me konceptin e ruajtjes së pagave të Gjyqësorit vetëm deri në fund të vitit 2022 dhe më pas uljen drastike të pagave pas asaj date. Një skenar i tillë nuk u konsiderua se mund të kontribuojë në garantimin e një Gjyqësori të pavarur. Përkundrazi, zgjidhja e tillë legislative do të vendoste në një presion të pakëshillueshëm Gjyqësorin kundrejt pushtetit Legjislativ dhe Ekzekutiv.

320. Për të arritur në këto përfundime, Gjykata kishte parasysh aspektet vijuese.
321. Përkitazi me Kuvendin, Gjykata potencoi se pushteti ligjvënës e ka ingerencën kryesore kushtetuese për ligjvënie në nivel vendi. Në aspekt të rrethanave të rastit konkret, ishte rrjedhimisht i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrim të kompetencës së tij për “miratim të ligjeve” të rregullojë pagat në sektorin publik sipas një politike të caktuar publike të votuar nga vet Kuvendi. Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të pagave për Republikën e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënie është që të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty.
322. Gjatë analizës së Ligjit të kontestuar, Gjykata është fokusuar qëllimisht tek “uljet” arbitrare të pagës dhe jo te “rritja” e pagave për faktin se, Kuvendi gjatë ligjbërjes është dashur të përkujdeset për të drejtat e personave të cilëve iu shkurtohet paga. Arsyet për ulje pagash duhet të jenë shumëfish më të qëndrueshme se sa arsyet për rritje pagash, ngase të parat pakësojnë një të drejtë ekzistuese ndërkaq të dytat shtojnë mbi një të drejtë ekzistuese. Thënë këtë, Gjykata potencon që Ligjvënësi është në të drejtën e tij që pas këtij Aktgjykimi të ndërmerr çfarëdo lloj hapi për të rritur pagat në sektorin publik ashtu që të përmbush çdo synim të politikës publike për rritje pagash në sektorë të caktuar. Nuk është detyrë e Gjykatës që të shprehet se ku dhe si duhet të bëhen rritjet e pagave. Modalitetet e mundshme për këtë çështje ngelen plotësisht në diskrecion të Kuvendit dhe të Qeverisë.
323. Përkitazi me rolin e Gjykatës Kushtetuese në vlerësim abstrakt të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, u sqarua se në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e

asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të caktuar. Kompetenca e Gjykatës në rastin konkret ishte që të vlerësojë, *in abstracto*, nëse Ligji i kontestuar është kushtetues apo jo dhe varësisht nga përgjigja - të vulosë kushtetutshmërinë e tij ose ta shfuqizojë të njëjtin si kundërkushtetues. E dyta ishte e domosdoshme në këtë rast.

324. Në nivel parimesh që Kushtetuta përcakton, Gjykata potencoi se ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, janë edhe “ndarja e pushteteve” dhe “sundimi i ligjit”. Funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre. Bazuar në nenin 4 të Kushtetutës përkitazi me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve: (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore; dhe (iii) Gjyqësori është unik dhe i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Këto tri pushtete, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve. Raporti në mes të “tri pushteteve” mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve si parim thelbësor i nivelit më të lartë kushtetues është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë është i panegociueshëm.
325. Secilit nga tri degët klasike të ndarjes së pushteteve, Kushtetuta i ka dedikuar një kapitull të veçantë. Në të tre këta kapitujt [për pushtetin Legjislativ; Ekzekutiv dhe Gjyqësor] parashihen parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet. Përveç kësaj, aty parashihen edhe mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra tjetrën pa krijuar ndonjë “ndërhyrje”, “varësi” apo “vartësi” kundërkushtetuese në mes tyre që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo pushtetit tjetër. Logjika e parimit të ndarjes së pushteteve është që ndikimi i njërit pushtet në tjetrin gjatë procesit të ndërveprimit institucional të tyre, kurrësi nuk duhet të krijoj një raport ndërhyrës apo të varësisë ose vartësisë që do të mund të rezultonte në humbje të pavarësisë për të vepruar si pushtet i lirë dhe i pandikuar. Kjo përbën esencën e ekuilibrit kushtetues që Kushtetuta ka përcaktuar e që kërkohet të mbahet në çdo instancë ndërvepruese në mes të pushteteve të pavarura.
326. Përveç kësaj, Gjykata theksoi se Kushtetuta i ka njohur një status dhe rol të veçantë e të rëndësishëm në mbarëvajtjen e detyrave publike shtetërore edhe Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin

XII të Kushtetutës, të cilat janë veçuar si të tilla jo pa arsye. Në këtë kapitull bëjnë pjesë: (i) Avokati i Popullit; (ii) Auditori i Përgjithshëm i Kosovës; (iii) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; (iv) Banka Qendrore e Kosovës; (v) Komisioni i Pavarur i Medieve; dhe (vi) Agjencitë e Pavarura.

327. Për dallim nga institucionet e tjera të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës, “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës *“janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”*. Ky dallim është i nevojshëm të evidentohet si i tillë çfarë është, për një arsye se pesë Institucionet e Pavarura të referuara në pikat (i), (ii), (iii), (iv) dhe (v) janë krijuar si të tilla me rastin e votimit dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës ekzistuese nga ligjvënësi, respektivisht Kuvendi; ndërkaq, Agjencitë e Pavarura nuk janë krijuar si të tilla me rastin e votimit të Kushtetutës ekzistuese – por janë agjenci për krijimin e të cilave Kushtetuta ia jep Kuvendit të drejtën që përmes ligjit t’i krijojë dhe t’i shuaj, varësisht nga nevojat që mund të paraqiten në jetën publike dhe shoqërore. Për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuaj *“me ligj”* Agjenci të Pavarura; Kuvendi nuk mund asnjëherë të shuaj *“me ligj”* ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura. Kjo përbën diferencën kryesore në mes të Institucioneve të Pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës – e cila duhet të merret parasysh si e tillë sa herë që ndërmerren veprime që prekin Agjencitë e Pavarura – të cilat dallojnë nga Institucionet e tjera të Pavarura.
328. Konkluzionet kyçe që Gjykata nxori dhe aplikoi pas analizimit të përgjigjeve të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias dhe praktikës gjyqësore të gjykatave të ndryshme kushtetuese dhe supreme, ishin me sa vijon: (i) nuk ekziston një sistem i vetëm i mundshëm i rregullimit të pagave në sektorin publik dhe se nuk ekziston një parim i njohur ndërkombëtar që përcakton rregullimin “pagë e njëjtë për punë të njëjtë”; (ii) shumica e vendeve i rregullojnë pagat përmes ligjeve të ndryshme dhe njëkohësisht aplikojnë metoda të ndryshme duke e rregulluar këtë çështje qoftë përmes ligjeve të veçanta për sektorë të veçantë ose përmes ndonjë rregullimi më të koncentruar ligjor; (iii) Kuvendi, si organ ligjvënës, ka kompetencë dhe të drejtë organike që të nxjerrë çfarëdo lloj legjislacioni për rregullim të pagave në sektorin publik, me kushtin që i njëjti të jetë në përputhje me Kushtetutën; (iv) parimi i ndarjes së pushtetit dhe balancës ndërmjet pushtetit Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor nuk nënkupton izolimin e pushteteve dhe mungesën e varësisë së ndërsjellë; mirëpo, i njëjti nënkupton evitimin e situatave sipas së cilave mund të krijohet “ndërhyrje”, “varësi” ose

“vartësi” kundërkushtetuese në mes të pushteteve të pavarura; (v) pavarësia e gjyqësorit, si njëra nga degët e pushtetit, nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm dhe nuk i nënshtrohet ndikimi nga dega ekzekutive; (vi) burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet e tjera shtetërore dhe nga palët private - ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet; (vii) zvogëlimi i buxhetit nga pushteti ekzekutiv është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar dhe të padëshiruar; (viii) nuk ekziston një rregull që krijon garanci absolute se pagat në sektorin publik nuk mund të zvogëlohen *per se* – por që ulja e pagave duhet të jetë e arsyetuar dhe asnjëherë arbitrare; (ix) ulja e pagave të gjyqësorit mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize të theksuar ekonomike dhe financiare dhe e cila për më tepër duhet të jetë e njohur zyrtarisht si të tillë; (x) sakrificat në kohë krize [meqë theksi tek ulja është gjithmonë kur ka kriza] që rezultojnë me ulje të pagave e të cilat nuk janë universale dhe nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë midis të gjithë qytetarëve, në proporcion me aftësinë e tyre financiare individuale – nuk konsiderohet të jenë të pajtueshme me konceptet e shpërndarjes së barrës midis përfituesve të pagave në një shtet.

329. Krejt në fund, Gjykata theksoi edhe disa çështje të rëndësishme.
330. Në rast të ligjbërjes së re në këtë fushë, Qeveria në cilësi të propozueses së ligjeve dhe Kuvendi në cilësi të votuesit të ligjeve, janë të obliguar që të marrin parasysh parimet e theksuara në këtë Aktgjykim dhe Aktgjykimet e tjera nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në interpretim të neneve respektive të Kushtetutës. Pavarësia “institucionale, funksionale, organizative dhe buxhetore” e Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura duhet të njihet dhe çdo iniciativë ligjore duhet të respektojë këtë pavarësi (*shih Aktgjykimet KO73/16 dhe KO171/18*).
331. Gjetja e shkeljeve të lartcituara e bëri Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij kundërkushtetues. Gjykata me shumë kujdes analizoi mundësinë e shfuqizimit të pjesshëm të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret një zgjidhje e tillë, për dallim nga rrethanat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që u shfuqizua pjesërisht, nuk ishte e mundur për dy arsye. E para sepse shkeljet kushtetuese të evidentuara në Ligjin e kontestuar janë të një peshe aq serioze sa që të njëjtat ndikojnë në bërthamën e funksionimit të qeverisjes në Republikën e Kosovës – duke shkaktuar disekuilibrim të ndarjes së pushteteve në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. E

dyta, sepse Ligji i kontestuar nuk ofron një mundësi të shfuqizimit të vetëm disa dispozitave dhe të vetëm disa pikave të Shtojcave nr. 1 dhe 2, ngase çdo lloj shfuqizimi do ta bënte Ligjin të pazbatueshëm në praktikë. Dhe, në rastet kur analiza dërgon në përfundimin se Ligji me shfuqizim të pjesshëm bëhet i pazbatueshëm me nenet e ngelura në fuqi si kushtetuese, Gjykata është e obliguar të shfuqizojë Ligjin në tërësinë e tij.

332. Gjykata, po ashtu theksoi se të gjitha pushtetet pa përjashtim kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të kryejnë detyrat publike për të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Në këto detyra publike përfshihet edhe obligimi i secilit pushtet që përgjatë kryerjes së detyrave kushtetuese të përkujdeset për respektim të pavarësisë së pushtetit tek i cili po krijon një “ndërhyrje”. Për shembull, Qeveria dhe Kuvendi, megjithëse e kanë kompetencën për të propozuar dhe votuar ligje, respektivisht, e të cilat do të mund të ndikojnë edhe në sferën e Gjyqësorit, si pushtet i tretë; ato [Qeveria dhe Kuvendi] duhet të sigurohen që gjatë hartimit të propozimeve të tyre e deri në finalizimin e tyre me votë të Kuvendit të ruhet pavarësia kushtetuese e pushtetit simotër, respektivisht Gjyqësorit. Kujdes dhe ndjeshmëri të njëjtë, Qeveria dhe Kuvendi, duhet të tregojnë edhe për karakteret e tjerë shtetërorë të cilët Kushtetuta i ka pajisur me garanci kushtetuese të pavarësisë funksionale, organizative, strukturore dhe buxhetore. Garantimin dhe sigurimi paraparak i kushtetutshmërisë së iniciativave të Qeverisë dhe Kuvendit duhet të jetë aspekt i përhershëm dhe i pandashëm i krijimtarisë ligjore të këtyre dy pushteteve.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 2 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2020,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË SHPALLË, me shumicë, se Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, në tërësinë e tij, **nuk është në përputhshmëri** me: nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave] paragrafi 1; 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; 109 [Prokurori i Shtetit]; 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]; 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; dhe me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Medie] të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik;
- IV. TË SHFUQIZOJË vendimin për caktim të masës së përkohshme të 12 dhjetorit 2019, si dhe vendimin për vazhdim të masës së përkohshme të 30 marsit 2020;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KO139/18, Parashtrues: Komuna e Skënderajt, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, Nr. 05-3815, të 12 qershorit 2018

KO139/18, Aktvendim i miratuar më 30 shtator 2020, i publikuar më 12 nëntor 2020

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, buxheti komunal, pagat jubilarë, kontratë kolektive, kërkesë e papranueshme.

Në rrethanat e rastit konkret, Komuna e Skënderajt konteston Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS) të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë më 12 qershor 2018. Kjo Kontratë, në nenin 17 të saj, kishte përcaktuar pagesën e shpërblimeve jubilarë për punëtorët shëndetësorë, duke përcaktuar gjithashtu se shumat përkatëse paguhen nga punëdhënësi i fundit. Këtë dispozitë, parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar se e njëjta është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës dhe paragrafin 3 të nenit 18 (Kompetencat e deleguara) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Parashtruesi i kërkesës pretendon se detyrimi i komunës për të paguar shpërblimet jubilarë përbën barrë financiare shtesë për komunën, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore, bazuar në të cilat, ndër tjerash, autoriteti i cili delegon kompetencën bartë edhe detyrimin e mbulimit të koston financiare.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu shqyrtoi edhe këndvështrimet e (i) Ministrisë së Shëndetësisë; (ii) Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë; dhe (iii) Ministrisë së Financave. E para, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, kryesisht argumentoi se (i) KKS buron nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e 18 marsit 2014; (ii) detyrimet për pagesën e shpërblimeve jubilarë burojnë nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe jo nga KKS e kontestuar; dhe (iii) bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, rrethanat e rastit konkret nuk ndërlidhen me kompetenca të deleguara në nivel komunal, por me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht theksoi se kërkesat e dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, duhet t'i plotësojnë kriteret kushtetuese si në vijim: (i) Komuna duhet të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit ose të një akti të Qeverisë; dhe (ii) Komuna duhet të argumentojë se ligji ose akti i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e saj. Prandaj, Gjykata theksoi

se në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës përkatëse, çështja më esenciale është vlerësimi nëse në rrethanat e rastit konkret para Gjykatës kontestohet një “akt i Qeverisë”.

Gjykata në këtë kontekst theksoi se (i) në rrethanat e rastit konkret, kontestohet një marrëveshje e nënshkruar në mes të dy palëve, në njërën anë Ministrisë së Shëndetësisë dhe në anën tjetër Federatës së Sindikatave së Shëndetësisë, përkatësisht Kontratë Kolektive e nënshkruar në nivel dege, siç është përcaktuar përmes Ligjit të Punës; (ii) Ministria e Shëndetësisë është vetëm njëra palë e Marrëveshjes, përkatësisht aktit të kontestuar, dhe rrjedhimisht, ky i fundit nuk buron nga vendimmarrja e Qeverisë, por është rezultat i një marrëveshje dypalëshe bazuar në Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës; dhe (iii) bazuar në analizën krahasimore të Kushtetutave të rajonit dhe praktikën gjyqësore të Gjykatave Kushtetuese përkatëse, marrëveshjet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese para se të jenë shterur mjetet juridike në procedurë të rregullt, përpos nëse Kushtetutat përkatëse specifikisht e përcaktojnë kompetencën e Gjykatave Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Marrëveshjeve Kolektive ose të njëjtat i mundësojnë Gjykatave Kushtetuese përkatëse të bëjnë vlerësimin e “akteve tjera” e të cilat jodetyrimisht kualifikohen si akte të Qeverisë. Duke u bazuar në vështirimet e mësipërme, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk konteston një “akt Qeverie” siç kërkohet përmes paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe për pasojë, nuk është i nevojshëm edhe vlerësimi nëse Marrëveshja Kolektive mund të ketë cenuar përgjegjësitë komunale ose zvogëluar të hyrat e saj, sepse kriteri i parë i një testi kumulativ të përcaktuar përmes nenit të lartcekur nuk është plotësuar.

Në fund, duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore lidhur me rastet e parashtruara bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu theksoi se edhe po të parashtronte Komuna e Skenderajt kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së KKS-së, në cilësinë e saj si person juridik dhe bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, kërkesa do të ishte e papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve juridike, sepse (i) bazuar në paragrafin 9 të nenit 90 të Ligjit të Punës, për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme nga përfaqësuesit e punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë në cilësi të partnerëve socialë, është kompetent Këshilli Ekonomiko-Social; dhe (ii) bazuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 32 të KKS-së, kontestet në mes palëve zgjidhen fillimisht përmes “konsultimeve dhe dialogut të ndërsjellë” dhe në të kundërtën, përmes “Gjykatës kompetente në Prishtinë”.

Rrjedhimisht dhe në përfundim, bazuar në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 40 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe paragrafin 1 të rregullit 73 (Kërkesa në

pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës u shpall e papranueshme për shqyrtim në merita.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KO139/18

Parashtrues

Komuna Skënderaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale,
Nr. 05-3815, të 12 qershorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Skënderajt, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Enver Çerkini (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Kontratën Kolektive Sektoriale [Nr. 05-3815] (në tekstin e mëtejme: KKS) të 12 qershorit 2018, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Shëndetësisë) dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata e Sindikatave).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 17 (Pagat) të KKS-së, i cili pretendohet të jetë në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe me nenin 18 (Kompetencat e deleguara) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (në tekstin e mëtejshëm: LVL).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon (i) caktimin e masës së përkohshme për *“faktin se kemi të bëjmë me interesa publike”*; dhe (ii) mbajtjen e një seance dëgjimore duke arsyetuar se *“për të ardhur deri te e vërteta objektive, konsiderojmë se është e nevojshme të mbahet seancë publike”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 14 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 18 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 21 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe Federatën e Sindikatave për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të paraqesin komentet e tyre, nëse kanë, lidhur me kërkesën në shqyrtim, deri më 11 tetor 2018.

9. Më 11 tetor 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave dorëzuan komentet e tyre përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 15 tetor 2018, Gjykata njoftoi (i) parashtruesin e kërkesës për pranimin e komenteve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave, duke i dhënë mundësinë të dorëzojë përgjigje ndaj komenteve të tyre; dhe (ii) Ministrinë e Financave dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të paraqesin komentet e tyre, nëse kanë. Në të dy rastet, afati i dorëzimit të komenteve u përcaktua më 1 nëntor 2018.
11. Më 1 dhe 5 nëntor 2018, respektivisht, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave dorëzuan komentet e tyre në Gjykatë.
12. Më 8 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi edhe një shkresë në Gjykatë, përmes të cilës, kërkoi nga Gjykata mbajtjen e një seance dëgjimore.
13. Më 12 nëntor 2018, Gjykata njoftoi Ministrinë e Shëndetësisë për pranimin e komenteve nga Ministria e Financave dhe kërkoi nga të njëjtit që të dorëzojnë përgjigje ndaj komenteve, nëse kanë, deri më 20 nëntor 2018.
14. Më 12 nëntor 2018, Gjykata gjithashtu njoftoi parashtruesin e kërkesës për komentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave dhe kërkoi nga të njëjtit që të dorëzojnë përgjigje ndaj komenteve, nëse kanë, deri më 20 nëntor 2018.
15. Më 16 nëntor 2018, Gjykata njoftoi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) për regjistrimin e kërkesës dhe po ashtu i adresoi Ministrisë në fjalë pyetje përkitazi me (i) plotfuqishmërinë e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (në tekstin e mëtejme: MPKK); (ii) statusin juridik të KKS-së; si dhe (iii) buxhetin e përcaktuar për implementimin e MPKK-së. MPMS nuk dorëzoi komente për kërkesën nën shqyrtim dhe as nuk u përgjigj lidhur me pyetjet e lartcekura.
16. Më 20 nëntor 2018, në Gjykatë u dorëzuan komentet e parashtruesit të kërkesës dhe ato të Ministrisë së Shëndetësisë përkitazi me komentet e Ministrisë së Financave.
17. Më 25 mars 2019, 30 prill 2019 dhe 10 janar 2020, respektivisht, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë edhe tre dokumente shtesë.

Përmes të parit kërkoi caktimin e masës së përkohshme për *“faktin se kemi të bëjmë me interesa publike”*, gjithashtu duke bashkangjitur në mbështetje të kësaj kërkesë një Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Mitrovicë përmes së cilit është detyruar Komuna e Skenderajt të bartë shpenzimet lidhur me shpërblimet jubilarë që burojnë nga KKS. Përmes të dytit, parashtoi një kërkesë për urgjencë, duke vënë theks gjithashtu në rëndësinë e masës së përkohshme. Ndërsa përmes të tretit, kërkoi përmirësimin e një gabimi në kërkesën e tyre fillestare, duke theksuar se *“kemi vërejtur se është bërë një lëshim teknik nga ana e jonë edhe pse në përmbajtje është në rregull, por në vend se të shkruhej neni 124 i kushtetutës ju kemi referuar nenit 123, pra paragrafi 3 i nenit 124 është ngatërruar me nenin 123 të saj”*.

18. Më 18 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese me propozimin që kërkesa të shpallet e pranueshme dhe për shqyrtimin e çështjes në merita. Procesverbali i kësaj date reflekton deklarin individual të anëtarëve të Kolegjit shqyrtues, të cilët me shumicë u deklaruan kundër pranueshmërisë së kërkesës. Gjithashtu, procesverbali reflekton edhe deklarin e gjyqtarëve të tjerë për këtë, si dhe i njëjti procesverbal reflekton që Gjykata në përbërje të plotë përfundimisht vendosi që vendimmarrja përkitazi me rastin të shtyhet për një nga seancat e radhës.
19. Më 9 korrik 2020, Gjyqtarja raportuese paraqiti para Kolegjit shqyrtues propozimin e njëjtë me plotësime. Kolegji shqyrtues, me shumicë, votoi në mbështetje të propozimit për ta shpallur kërkesën të pranueshme dhe për shqyrtimin e çështjes në merita. Megjithatë, në të njëjtën datë, Gjykata në përbërje të plotë, me shumicë, vendosi kundër propozimit të Gjyqtarës raportuese dhe rrjedhimisht, vendosi që ta shpallë kërkesën të papranueshme. Gjyqtarja raportuese në bazë të paragrafit (4) të rregullit 58 (Këshillimet dhe Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktvendimin për papranueshmëri. Kryetarja e Gjykatës, në këtë detyrë, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani.
20. Më 30 shtator 2020, në emër të shumicës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani prezantoi Aktvendimin për papranueshmëri para Gjykatës. Gjatë diskutimit të gjyqtarëve u ngrit çështja e gabimeve teknike në lidhje me procesverbalin e datës 18 dhjetor 2019.
21. Më 30 tetor 2020, duke marrë parasysh që Gjykata gjatë diskutimit më 30 shtator 2020, kishte vërejtur se procesverbali i datës 18 dhjetor 2019 reflektonte kundërthënie si rezultat i gabimeve teknike, në kuadër të Seancës Administrative, gjyqtarët diskutuan përmbajtjen e

këtij procesverbali dhe konstatuan që i vetmi konstatim nga ajo seancë është vendimi i gjyqtarëve në përbërje të plotë që të shtyjnë vendimmarrjen për një nga seancat e radhës.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 18 mars 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe përfaqësuesit e punëdhënësve, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit, respektivisht, lidhën MPKK-në. Kjo e fundit, ndër të tjera, përcaktoi (i) në nenin 2 (Fushëveprimi) të saj se dispozitat e MPKK-së, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror, në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje; (ii) në nenin 4 [pa titull] të saj se Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes; (iii) në nenin 6 [pa titull] të saj se dispozitat dhe kualifikimet nga MPKK janë standarde, unike dhe obliguese edhe në nivel të degës dhe të ndërmarrjes; (iv) në nenet 52 (Shpërblime jubilarë) dhe 53 (Kompensimi në rast të pensionimit) të saj se punëtorët shëndetësorë përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë të një (1), dy (2) ose tri (3) pagash për dhjetë (10), njëzet (20) e tridhjetë (30) vite përvojë punë, respektivisht, dhe gjithashtu në rast të pensionimit, shpërblimin jubilar në vlerë prej tri (3) pagash, shuma këto të cilat paguhen nga punëdhënësi i fundit; (v) në nenin 81 [pa titull] të saj se nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit; dhe në fund (vi) në nenin 82 [pa titull] të saj se MPKK hyn në fuqi më 1 janar 2015.
23. Më 12 qershor 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave, lidhën KKS-në. Kjo e fundit, ndër të tjera, përcaktoi (i) në nenin 4 (Fusha e Zbatimit) të saj se Kontrata përkatëse zbatohet në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit në institucione shëndetësore; (ii) në nenin 32 (Zgjidhja e kontestit) të saj se zgjidhjet e kontesteve në mes palëve nënshkruese bëhen përmes konsultimeve dhe dialogut të ndërsjellë, dhe në rast të dështimit, përmes gjykatës kompetente në Prishtinë; dhe (iii) në nenin 17 të saj se punëtorët shëndetësorë përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë të një (1), dy (2) ose tri (3) pagash për dhjetë (10), njëzet (20) e tridhjetë (30) vite përvojë punë, respektivisht, dhe gjithashtu në rast të pensionimit shpërblimin jubilar në vlerë prej tri (3) pagash, shuma këto të cilat paguhen nga punëdhënësi i fundit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 17 i KKS-së është në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 124 të Kushtetutës dhe nenin 18 të LVL-së.
25. Parashtruesi i kërkesës më saktësisht pretendon se në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 3 të nenit 124 të Kushtetutës dhe paragrafit 3 të nenit 18 të LVL-së, përkatësisht detyrimit të autoritetit shtetëror që të përballojë shpenzimet me rastin e delegimit të kompetencave në nivelin komunal, Ministria e Shëndetësisë, në bazë të nenit 17 të KKS-së, ka obliguar vet komunën që të përballojë shpenzimet përkitazi me pagat jubilarë të punëtorëve shëndetësorë.
26. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson se: *“Komuna e Skenderajt kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të vlerësojë kushtetutshmërinë e kësaj kontrate kolektive në përgjithësi, e në veçanti të nenit 17 paragrafi 3, e nën paragrafi 3.1,3.2, dhe 3.3. e paragrafin 4 dhe 5 të po këtij neni të Kontratës Kolektive Sektoriale të dt.12.06.2018, me të cilat dispozita ligjore i kane ven një barrë shtesë komunës edhe pse kemi një buxhet te vogël e të varfër ne raport me kërkesat e qytetareve, dhe një mbingarkesë e tillë është e padrejtë e paligjshme dhe në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin, për faktin se Ministria e Shëndetësisë para se ta nënshkruaj këtë kontratë është dashur ta parasheh buxhetin dhe mjetet financiare, pra ta krijoj linjën buxhetore sepse i ka listat për të gjithë të punësuarit në sektorin e shëndetësisë që dalin në pension dhe ato paga përcjellëse dhe jubilarë ti parasheh me buxhet e jo ta ngarkoj komunën në mënyrë të padrejtë për këtë”.*
27. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që të (i) shpallë të pranueshme kërkesën; dhe (ii) shfuqizojë nenin 17 të KKS-së të 12 qershorit 2018.

Komentet e subjekteve të interesuara

28. Gjykata në vijim do të paraqes komentet e (i) Ministrisë së Shëndetësisë ndaj kërkesës së parashtruesit të kërkesës; (ii) Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë ndaj kërkesës së parashtruesit të kërkesës; (iii) Ministrisë së Financave; (iv) parashtruesit të kërkesës ndaj përgjigjeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave; dhe (v) Ministrisë së Shëndetësisë ndaj shkresës së Ministrisë së Financave.

(i) *Komentet e Ministrisë së Shëndetësisë*

29. Duke u përgjigjur në mundësinë e dhënë nga Gjykata më 21 shtator 2018 për komentet e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Ministria e Shëndetësisë, dorëzoi komentet duke u referuar në nenin 124 të Kushtetutës; nenin 4 (Hierarkia në mes të Ligjit, Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës) e nenin 90 (Marrëveshja Kolektive) të Ligjit nr. 03-L/212 të Punës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Punës); dhe nenet 2, 3 (Aplikimi dhe përfshirja), 4, 5, 6, 52 dhe 53 të MPKK-së të 18 marsit 2014.
30. Ministria e Shëndetësisë, ndër të tjera, theksoi se (i) bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës, një Marrëveshje Kolektive zbatohet drejtëpërdrejtë në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe se një e tillë mund të lidhet në nivel vendi, siç është KPKK e 18 marsit 2014 ose në nivel dege, siç është KKS e 12 qershorit 2018; (ii) KPKK në nenin 2 të saj përcakton se dispozitat e saj janë të detyrueshme për sektorin privat, publik e shtetëror, në nivel të përgjithshëm, të degëve dhe të ndërmarrjeve, dhe se rrjedhimisht, shpërblimet jubilarë për vite përvojë pune dhe në rast të pensionimit, janë të përcaktuara përmes KPKK-së dhe kanë qenë të detyrueshme në nivel të Kosovës edhe para nënshkrimit të KKS-së; (iii) për pasojë, Ministria e Shëndetësisë, përmes nënshkrimit të KKS-së, nuk ka përcaktuar asnjë detyrim shtesë por vetëm ka zbatuar Ligjin e Punës dhe nenet 52 dhe 53 të KPKK-së, duke i përfshirë këto dy të fundit në nenin 17 të saj; dhe (iv) Ministria e Shëndetësisë nuk ka “*deleguar*” kompetenca në nivel të komunave, sepse nuk ka bartur asnjë përgjegjësi që i ka takuar Ministrisë së Shëndetësisë në nivel të komunës përkatëse, për më tepër që, LVL në nenin 3 (Përkufizimet) dhe 18 të saj, përcakton saktësisht mënyrën e delegimit të kompetencave nga niveli qendror në atë komunal, dhe se një delegim i tillë bëhet vetëm përmes ligjit, e që nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret.

(ii) *Komentet e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë*

31. Duke u përgjigjur në mundësinë e dhënë nga Gjykata më 21 shtator 2018 për komentet e Federatës së Sindikatave lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Federata e Sindikatave, dorëzoi komentet e tyre duke theksuar, ndër të tjera, se (i) parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur mjetet juridike sepse bazuar në nenin 32 të KKS-së, i njëjti është detyruar që fillimisht të tentojë t'i adresojë pretendimet e tij përmes dialogut social dhe “*Gjykatës kompetente në Prishtinë*”; (ii) neni 17 i KKS-së derivon nga nenet 52 dhe 53 të KPKK-së të 18 marsit 2014, dhe rrjedhimisht nuk përbën asnjë lloj detyrimi shtesë; dhe (iii)

analiza financiare e KKS-së është *“kalkuluar nga ana e palës tjetër nënshkruese në këtë rast Ministrisë së Shëndetësisë”*.

(iii) *Komentet e Ministrisë së Financave*

32. Duke u përgjigjur në mundësinë e dhënë nga Gjykata më 15 tetor 2018 për komente në kërkesën e parashtruesit të kërkesës si dhe në shkresat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave, Ministria e Financave dorëzoi komentet përkatëse në Gjykatë, duke theksuar se KKS-ja *“nuk i është nënshtruar procedurave të kostimit dhe Ministria e Financave nuk ka dhënë ndonjë opinion lidhur me koston eventuale që mund të ketë ky dokument. Andaj, zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet brenda ndarjeve buxhetore ekzistuese”*.

(iv) *Komentet e parashtruesit të kërkesës në përgjigjen e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë*

33. Duke u përgjigjur në mundësinë e dhënë nga Gjykata më 12 nëntor 2018 për komentet e parashtruesit të kërkesës në komentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Financave, parashtruesi i kërkesës përkitazi me të parën theksoi se komentet e tyre janë *“të pa baza e të pa argumentueshme”*, duke shtuar gjithashtu se KKS është edhe në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë), ndërsa përkitazi me të dytën, theksoi se shkresa e Ministrisë së Financave konfirmon pretendimet e tyre se nuk janë respektuar procedurat e parashikuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë.

(v) *Komentet e Ministrisë së Shëndetësisë në shkresën e Ministrisë së Financave*

34. Duke u përgjigjur në mundësinë e dhënë nga Gjykata më 12 nëntor 2018 për komentet e Ministrisë së Shëndetësisë në shkresën e Ministrisë së Financave, Ministria e Shëndetësisë theksoi se (i) MPKK e 18 marsit 2014 vazhdon të jetë në fuqi sepse bazuar në nenin 81 të saj, nëse pasi të skadon afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra palë nënshkruese, zbatimi i saj vazhdon edhe një vit, përkatësisht deri në janar të vitit 2019; dhe (ii) duke marrë parasysh faktin që MPKK është në fuqi, *“si e tillë nuk paraqet kosto shtesë ndaj dhe lidhur me të nuk ka pasur nevojë që të konsultohet Ministria e Financave”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 113

[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

[...]

Neni 124

[Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitatet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

[...]

3. Komunitatet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.

[...]

5. Komunitatet kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS

Neni 4

Hierarkia në mes të Ligjit, Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës

1. Dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

[...]

Neni 90 **Marrëveshja Kolektive**

1. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:*
 - 1.1. *organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe*
 - 1.2. *organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve;*
2. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:*
 - 2.1. *nivel të vendit,*
 - 2.2. *nivel të degës,*
 - 2.3. *nivel të ndërmarrjes.*
- [...]
3. *Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.*
4. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.*
- [...]
9. *Për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme në mënyrë paqësore dhe zhvillimin e konsultave nga fusha e punësimit, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike të punës nga përfaqësuesit punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë në cilësi të partnerëve social me akt të veçantë ligjor-nënligjor themelohet Këshilli Ekonomiko Social.*
- [...]

LIGJI Nr. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Neni 3 **Përkufizimet**

-“Kompetencat e deleguara”- do të thotë kompetencat e qeverisë qendrore dhe të institucioneve të tjera qendrore ekzekutimi i të cilave përkohësisht i caktohet me ligj komunave;

Neni 18 **Kompetencat e deleguara**

- 18.1 *Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:*
 - a) *shënimet kadastrale;*
 - b) *regjistrimin civil;*
 - c) *regjistrimin e votuesëve;*
 - d) *regjistrimin e biznesit dhe licencimin;*

e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);

f) mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

18.2 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.

18.3 Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

MARRËVESHJA E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE E KOSOVËS

(e nënshkruar me 18.03.2014 dhe hyrë në fuqi me 01.01.2015)

Neni 1 Qëllimi

1.Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje të Përgjithshme Kollective të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm MPKK), është përcaktimi dhe rregullimi më i qartë dhe më i detajuar i të drejtave, përgjegjësi dhe detyrimeve të palëve në këtë Marrëveshje.

2.Palë në këtë MPKK janë: përfaqësuesit e punëdhënësve, përfaqësuesit e të punësuarave dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

3.Qeveria e Kosovës është garantues për implementimin e kësaj MPKK, të arritur me vullnetin e palëve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 2 Fushëveprimi

1.Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje).

[...]

Neni 3 **Aplikimi dhe përfshirja**

Dispozitat e MPKK aplikohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4 **[Pa titull]**

1.Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes.
[...]

Neni 5 **[Pa titull]**

MPKK, vlen për të gjithë të punësuarit të cilët punojnë tek punëdhënësit, që kanë selinë në territorin e Kosovës

Neni 6 **[Pa titull]**

Dispozitat dhe kuantifikimet nga MPKK janë standarde, unike dhe obliguese edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes.

Neni 52 **Shpërblime jubilarë**

- 1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:*
 - 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;*
 - 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;*
 - 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij;*
- 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë;*
- 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Neni 53 **Kompensimi në rast të pensionimit**

I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, qe i ka marr për tre (3) muajt te fundit.

KONTRATA KOLEKTIVE SEKTORIALE **(e nënshkruar me 12.06.2018)**

Neni 1 **Qëllimi**

1. *Kontrata Kolektive Sektoriale (ne vijim: KKS) lidhet nga palët në këtë kontratë për avancimin e te drejtave nga marrëdhënia e punës dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese.*
2. *Përmes KKS-së zgjerohen të drejtat nga marrëdhënia e punës sipas legjislacionit në fuqi.*
3. *KKS-së rregullon:*
[...]
- 3.12. *Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.*

Neni 17 **Paga**

1. *Paga e te punësuarit rriten për çdo vit të plotë të stazhit të punës në lartësi prej 0.5% mbi pagën bazë në pajtim me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës*
2. *Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjete) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.*
3. *Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë:*
 - 3.1 *Për 10 vjet te përvojës ne pune ne institucione shëndetësore, në vlere të një page mujore te tij;*
 - 3.2 *Për 20 vjet të përvojës në punë ne institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij ;*
 - 3.3 *Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij.*

4. *Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*
5. *Kompensimi në rast pensionimit, i punësuarit me rast të pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej (3) pagave mujore, që i ka marrë për (3) muaj të fundit.*

Neni 32 **Zgjidhja e kontestit**

1. *Palët në këtë kontratë, të gjitha kontestet ndërmjet tyre do ti zgjidhin përmes konsultimeve dhe dialogut të ndërsjellët.*
2. *Në rast se kontesti në' mes palëve nuk mund të zgjidhet sipas paragrafit 1 të këtij neni, për zgjedhjen e kontestit palët drejtohen në gjykatën kompetente në Prishtinë.*
3. *Punëtorët shëndetësor të cilët janë anëtar të sindikatës gëzojnë mbrojtje ligjore nga sindikata.*

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjkata, së pari, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
36. Gjkata, në këtë aspekt, fillimisht i referohet paragrafit 1 dhe 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”
[...]

“4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose akteve të qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.”

37. Gjkata gjithashtu i referohet neneve 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afatet) të Ligjit, e të cilët përcaktojnë:

Neni 40
(Saktësimi i kërkesës)

“Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.”

Neni 41
(Afatet)

“Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës.”

38. Ndërsa, në fund, Gjykata i referohet edhe rregullit 73 (Kërkesa në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit), i cili specifikon:

“(1) Kërkesa, e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit.

(2) Në kërkesën e parashtruar sipas këtij rregulli, komuna duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) informatat relevante në lidhje me ligjin ose aktin e kontestuar të Qeverisë;

(b) dispozitën specifike të Kushtetutës e cila pretendohet se është shkelur; dhe

(c) përgjegjësitë ose të ardhurat e komunës që janë të prekura nga ky ligj ose akt.

(3) Kërkesa, sipas këtij rregulli duhet të paraqitet brenda një (1) viti në fuqi të dispozitës së ligjit apo aktit të kontestuar të Qeverisë.”

39. Bazuar në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet t'i plotësojnë kriteret kushtetuese si në vijim: (i) Komuna duhet të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit ose të një akti të Qeverisë; dhe (ii) Komuna duhet të argumentojë se ligji ose akti i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e saj. Këto dy kushte janë kumulative. Rrjedhimisht, Komuna përkatëse duhet të kontestojë ligjin e Kuvendit ose aktin e Qeverisë dhe të argumentojë se të njëjtat kanë cenuar ose zvogëluar përgjegjësitë komunale ose të hyrat e saj, respektivisht. Bazuar në Ligj dhe Rregulloren e punës, ky ligj ose akt duhet të konstestohet në Gjykatë brenda një (1) viti nga hyrja e tij në fuqi.

40. Për pasojë dhe vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse para saj kontestohet një ligj i Kuvendit ose një akt i Qeverisë, dhe nëse përgjigja është afirmative atëherë, duhet të vlerësojë nëse ligji/akti përkatës zvogëlon përgjegjësitë komunale ose cenon të hyrat e saj.
41. Në rrethanat e rastit konkret, është e qartë që Marrëveshja e kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht KKS, nuk është ligji i Kuvendit. Prandaj, duhet të vlerësohet nëse e njëjta mund të kualifikohet si “akt i Qeverisë”.
42. Gjykata në këtë kontekst thekson se në fushëveprimin e “akteve” të Qeverisë, përkatësisht Kryeministrit, Zëvendëskryeministrave dhe Ministrave, hyn vendimmarrja e tyre, siç është përcaktuar në nenin 92 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës. Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se pa marrë parasysh emërtimin formal të këtyre vendimeve të nxjerra, të njëjtat i nënshtrohen kontrollit kushtetues, nëse ngrenë “*çështje të rëndësishme kushtetuese*” dhe duke marrë parasysh efektet juridike që ato prodhojnë, gjithnjë për aq sa janë ngritur para Gjykatës në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj (shih rastin e Gjykatës KO61/20, me parashtrues, *Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “*zonë karantinë*”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, *për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut*, Aktgjykim i 5 majit 2020, paragrafët 92 deri 98 dhe referencat e tjera të përdorura aty).
43. Në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës kontestohet një marrëveshje e nënshkruar në mes të dy palëve, në njërën anë Ministrisë së Shëndetësisë dhe në anën tjetër Federatës së Sindikatave, përkatësisht Kontratë Kolektive e nënshkruar në nivel dege, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2.2 të nenit 90 të Ligjit të Punës. Gjykata thekson se bazuar në këtë të fundit, përkatësisht paragrafin 1.8 të nenit 3 (Përkufizimet) të tij, Kontrata Kolektive definohet si marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur. Për më tepër, bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës, Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe organizatës së të

punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve.

44. Rrjedhimisht, Ministria e Shëndetësisë është vetëm njëra palë e Marrëveshjes, përkatësisht aktit të kontestuar. Ky i fundit nuk buron nga vendimmarrja e Qeverisë, por është rezultat i një marrëveshje dypalëshe bazuar në Ligjin e Punës dhe MPKK e 18 marsit 2014. Për pasojë, e njëjta nuk mund të kualifikohet si “*akt qeverie*” për qëllime të paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës. Kjo Marrëveshje në fakt reflekton vullnetin reciprok në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë, si palë nënshkruese dhe të cilat për më tepër, përmes të njëjtës janë dakorduar që kontestet e mundshme t’i adresojnë përmes dialogut social apo edhe përmes “*gjykatës kompetente në Prishtinë*”. Zgjidhja e kontesteve në këtë aspekt, u takon gjykatave të rregullta.
45. Rrjedhimisht, dhe marrë parasysh që para Gjykatës, nuk kontestohet një “*akt Qeverie*”, ajo më tej nuk vlerëson nëse Marrëveshja Kolektive mund të ketë cenuar përgjegjësitë komunale ose zvogëluar të hyrat e saj, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, sepse nuk është përmbushur kriteri i parë i pranueshmërisë, përkatësisht kontestimi i një ligji të Kuvendit apo “*akti të Qeverisë*”, siç është përcaktuar përmes po të njëjtit paragraf të nenit 113 të Kushtetutës.
46. Gjykata thekson se qasje të njëjtë në këtë aspekt kanë pasur edhe Gjykatat Kushtetuese të rajonit. Më saktësisht, për dallim nga Kushtetuta e Kosovës, një pjesë e kushtetutave të shteteve në rajon, përcaktojnë shprehimisht kompetencën e Gjykatave Kushtetuese përkatëse për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Kontratave Kolektive. Në këtë kategori hyjnë Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ajo e Serbisë. E para, në nenin 110 të Kushtetutës përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe bazuar në të cilin, kjo e fundit, ndër të tjera, vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe të rregullave të tjera e të Marrëveshjeve Kolektive me Kushtetutën dhe me ligjet. Ndërsa e dyta, në nenin 167 të Kushtetutës, përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe bazuar në të cilin, kjo e fundit, ndër të tjera, vendos për përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve të përgjithshme me Kushtetutën; e akteve të përgjithshme me ligjin dhe të akteve të përgjithshme të organizatave që u janë besuar autorizime publike, partive politike, sindikatave, shoqatave të qytetarëve dhe Marrëveshjeve të Përgjithshme Kolektive me Kushtetutën dhe ligjin.

47. Kushtetutat tjera, njëjtë sikur ajo e Republikës së Kosovës, nuk i referohen kompetencës së Gjykatave Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një Marrëveshje Kolektive. Të njëjtat, ndër tjerash, i referohen përtej vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve, edhe vlerësimit të kushtetutshmërisë së “akteve” të organeve qendrore dhe vendore apo atyre të nxjerra për ushtrimin e autoritetit publik. Më saktësisht, (i) Shqipëria, në nenin 131 të Kushtetutës së saj, përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në të cilin, ndër të tjera, saktëson se kjo e fundit vlerëson përputhshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare; (ii) Sllovenia, në nenin 160 të Kushtetutës së saj, përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në të cilin, ndër të tjera, saktëson se kjo e fundit vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, e rregulloreve me Kushtetutën dhe me ligjet; dhe të akteve të përgjithshme të nxjerra në ushtrimin e autoritetit publik me Kushtetutën, ligjet dhe rregulloret; (iii) Kroacia, në nenin 129 të Kushtetutës së saj, përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në të cilin, ndër të tjera, saktëson se kjo e fundit vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe të rregulloreve të tjera me Kushtetutën dhe ligjet; ndërsa (iv) Mali i Zi, në nenin 149 të Kushtetutës së tij, përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në të cilin, ndër të tjera, saktëson se kjo e fundit vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe të rregulloreve dhe të akteve të tjera të përgjithshme me Kushtetutën dhe ligjin. Në kuadër të kompetencës për të vlerësuar edhe „akte të tjera të përgjithshme“, Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi kishte vlerësuar edhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive. (Shih, Vendimin U-II br. 3/15, e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, të 21 prillit 2017).
48. Për dallim, Gjykatat Kushtetuese të Sllovenisë dhe të Kroacisë kishin refuzuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Marrëveshjeve Kolektive. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë me rastin e shqyrtimit të rasteve r. UI-220/94 të 6 shkurtit 1997 dhe UI-75/97 të 14 majit 1997, ka mbajtur qëndrimin se nuk ka kompetencë të shqyrtojë dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke theksuar se kjo është kompetencë e gjykatave të rregullta. Njëjtë, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, gjatë shqyrtimit të rasteve, Aktvendim Nr. U-II-75/2018 i 30 janarit 2018 dhe Aktvendimet U-II-363/2015 të 4 shkurtit 2015, U-II-318/2003 të 9 prillit 2003 dhe U-II-4380/2004 të 14 qershorit 2006, gjithashtu ka theksuar se nuk ka kompetencë për të vlerësuar dispozitat e Marrëveshjeve të Përgjithshme Kolektive, sepse kjo është kompetencë e gjykatave të rregullta.

49. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, ndër të tjera, ishte shprehur si në vijim: *“Në këto raste u konstatua se për (mos) përputhjen e marrëveshjes kolektive me Kushtetutë, rregulloret e detyrueshme dhe moralin e shoqërisë vendosin gjykatat duke zbatuar rregullat e së drejtës së detyrueshme për pavlefshmërinë e kontratës. Gjykata Kushtetuese vetëm me rastin e padisë eventuale kushtetuese vendos nëse me një vendim gjyqësor, të nxjerrë në një kontest të tillë, janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Nga sa u tha më lart rrjedh se Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për të vendosur për vlefshmërinë ligjore të marrëveshjeve kolektive në procesin e vlerësimit të përputhjes së ligjeve me Kushtetutë dhe rregulloreve tjera me Kushtetutë dhe ligj”*. (Shih Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Aktvendim Nr. U-II-75/2018 i 30 janarit 2018 dhe, *mutatis mutandis*, Aktvendimet numër: U-II-363/2015 të 4 shkurtit 2015, U-II-318/2003 të 9 prillit 2003 dhe U-II-4380/2004 të 14 qershorit 2006).
50. Gjykata thekson se ajo ka ndjekur të njëjtën qasje edhe në rastet paraprake të shqyrtuara nga ajo e të dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës. Njërin rast, përkatësisht rastin KO 89/16 (shih, rastin e Gjykatës, KO89/16, me parashtrues, *Komuna e Prishtinës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2016), Gjykata e kishte shpallur të papranueshëm si të pasafatshëm. Ndërsa tri tjera, përkatësisht rastet KO 08/13, KI 07/10 dhe KO 123/10, i kishte shpallur të papranueshme sepse nuk ishte kontestuar një *“akt i Qeverisë”*, siç kërkohet përmes paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës.
51. Më saktësisht, në rastin KO 08/13 (shih rastin e Gjykatës KO08/13, me parashtrues *Komuna e Klinës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 nëntorit 2013), duke u referuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Komuna e Klinës kishte kontestuar Vendimin [A.nr.811/2006] e 14 marsit 2007 dhe pesëmbëdhjetë (15) vendime të tjera të Kolegjit Administrativ të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se të njëjtat, ndër tjerash, ishin në kundërshtim me nenet 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe 124 të Kushtetutës. Gjykata kishte shpallur kërkesën të papranueshme, duke theksuar se nuk ishin përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, sepse aktet e kontestuar nga parashtruesi i kërkesës nuk ishin *“akte të Qeverisë”* për qëllimet e këtij neni. Për më tepër, Gjykata kishte theksuar se edhe po të parashtrohej kërkesa bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në cilësinë e komunës përkatëse si person juridik, kërkesa do të ishte e papranueshme si e pasafatshme.

52. Në rastin KI 07/10 (shih rastin e Gjykatës KI 07/10, me parashtrues *Komuna e Klinës*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2010), duke u referuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Komuna e Klinës kishte kontestuar Vendimin [Nr.112/08] e 5 qershorit 2009 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Gjykata kishte shpallur kërkesën të papranueshme, duke theksuar se nuk ishin përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, sepse aktet e kontestuara nga parashtruesi i kërkesës nuk ishin “*akte të Qeverisë*” për qëllimet e këtij neni, por të një organi të pavarur bazuar në legjislacionin në fuqi. Për më tepër, Gjykata kishte theksuar se edhe po të parashtrohej kërkesa bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në cilësinë e komunës përkatëse si person juridik, kërkesa do të ishte e papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike.
53. Në rastin KO 123/10 (shih rastin e Gjykatës, KO 123/10, me parashtrues *Komuna e Gjakovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 majit 2011), duke u referuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Komuna e Gjakovës kishte kontestuar Aktgjykimin [Nr.c.nr.183/2009] e 17 qershorit 2009 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Gjykata kishte shpallur kërkesën të papranueshme duke theksuar se nuk ishin përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, sepse aktet e kontestuara nga parashtruesi i kërkesës nuk ishin “*akte të Qeverisë*” për qëllimet e këtij neni. Për më tepër, Gjykata kishte theksuar se edhe po të parashtrohej kërkesa bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në cilësinë e komunës përkatëse si person juridik, kërkesa do të ishte e papranueshme si e pasaftshme.
54. Prandaj, bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore përkitazi me rastet e parashtruara bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu thekson se edhe po të parashtronte Komuna e Skenderajt kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së KKS-së, në cilësinë e saj si person juridik dhe bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, njëjtë sikur në rastin e Gjykatës KI07/10, kërkesa do të ishte e papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve juridike. Kjo sepse (i) bazuar në paragrafin 9 të nenit 90 të Ligjit të Punës, për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme nga përfaqësuesit e punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë në cilësi të partnerëve social është kompetent Këshilli Ekonomiko-Social; dhe (ii) bazuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 32 të KKS-së, kontestet në mes palëve zgjidhen fillimisht përmes “*konsultimeve dhe dialogut të ndërsjellë*” dhe në të kundërtën, përmes “*Gjykatës kompetentë në Prishtinë*”.

55. Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se qëllimi dhe arsyeimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit i përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: *Selmouni kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 74; *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 52; dhe, ndër të tjera, shih edhe rastet e Gjykatës: KIO7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST Sh.P.K.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
56. Rrjedhimisht dhe në përfundim, bazuar në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenin 40 të Ligjit dhe paragrafin 1 të rregullit 73 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, duhet të shpallet e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

57. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vënien e masës së përkohshme për "*faktin se kemi të bëjmë me interesa publike*".
58. Gjykata tanimë konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.
59. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (a) të paragrafit (4) të rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 majit 2019, paragrafët 89-91; dhe KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed*

Thaqi dhe Egzon Keka, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafët 53-55).

Kërkesa për seancë dëgjimore

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të caktojë seancë dëgjimore me arsyetimin: *“për të ardhur deri te e vërteta objektive, konsiderojmë se është e nevojshme të mbahet seancë publike”*.
61. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (2) të rregullit 42 (E drejta në dëgjim dhe heqja dorë) të Rregullores së punës, *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit.”*
62. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritohet lidhur me rastin që është në shqyrtim. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI48/18, *parashtrues Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 272 dhe referencat e përmendura aty).
63. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *“provave apo ligjit”* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për papranueshmërinë e këtij rasti.
64. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit për caktim të seancës dëgjimore duhet të refuzohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 4 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 40 të Ligjit, me rregullat 57 (4), 59 (2) dhe 73 (1) të Rregullores së punës, më 30 shtator 2020, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;
- III. TË REFUZOJË kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Rasti KO 98/20 Parashtruesi Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr.52/2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës, të 14 marsit 2020

Fjalët kyçe: *kërkesë institucionale, shpallja e zgjedhjeve, shtyrja e zgjedhjeve, kërkesë pa objekt shqyrtimi*

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës [nr.52/20], të 14 marsit 2020, për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës. Parashtruesit e kërkesës pretendonin se, vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me: paragrafin 4 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], nenin 7 [Vlerat], nenin 123 [Parimet e Përgjithshme], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe paragrafin 1 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 21 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkesa bazohej në nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Përfundime

#

1. Në lidhje me rrethanat e rastit konkret, Gjykata merr parasysh paragrafin (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës, si dhe nenin 37 të KEDNJ-së, me ç' rast, për çështjen e rasteve para saj, ajo i përgjigjet dy pyetjeve me radhë: (i) *së pari*, se a qëndrojnë ende rrethanat për të cilat ishin ankuar drejtpërdrejtë parashtruesit e kërkesës; dhe, (ii) *së dyti*, nëse efekti i shkeljes eventuale të Konventës për shkak të atyre rrethanave gjithashtu është korrigjuar. Gjykata poashtu vlerësoi nëse edhe më tej është i nevojshëm vazhdimi i shqyrtimit të rastit konkret, në kontekst të respektimit të të drejtave të njeriut të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa.
2. Në kontekst të kësaj analize, Gjykata në vijim konkludoi se në rastin konkret, (i) përderisa arsyeja për të cilën është kontestuar Vendimi i Presidentit, d.m.th. *Shtyrja e zgjedhjeve në afat të pacaktuar*, më nuk qëndron; dhe (ii) përderisa efekti i shkeljes eventuale të nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për shkak të atyre rrethanave është adresuar me përcaktimin e datës së re të

zgjedhjeve (përkatësisht më 29 nëntor 2020), Gjykata konsideron se rasti konkret nuk përfshin ndonjë rrethanë të veçantë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë.

3. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se përmes Vendimit të Presidentit [Nr.157/2020], objekti i kërkesës së parashtruesve të kërkesës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Pozita e tanishme, përkatësisht *caktimi i datës së zgjedhjeve* është rrethanë e tillë e cila konsiston në atë që kërkesa në fjalë, tashmë nuk ka arsyetim dhe se qëllimi që është kërkuar të arrihet, tashmë është arritur plotësisht. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka më merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje dhe një arsyetim të tillë, Gjykata tashmë e ka shprehur qartë edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih rastet e Gjykatës: KO63/12, me parashtrues *Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82*, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 10 dhjetorit 2012, paragrafi 19; Rasti KO107/10, me parashtrues *Gani Geci dhe deputetët tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit, 14 tetorit 2010, në lidhje me Strategjinë dhe Projekt-Vendimin e Qeverisë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës, Vendim për heqje nga lista të kërkesës, i 17 gushtit 2011, paragrafët 24-26; Rastet KI58, KI66 dhe KI94/12, me parashtrues *Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunalë të KK të Vitisë, Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Komunës së Mitrovicës, Gjilanit dhe Vitisë për kushtëzimet e qytetarëve në qasje në shërbimet komunale me pagesën e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike*, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 5 korrikut 2013, paragrafi 45).
4. Pra, si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekziston më dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbajtjes gjyqësore (shih rastin KO63/12, cituar më lartë, paragrafi 23; KI11/09, *Tomë Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/12, dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-47*, Vendim për heqjen nga lista të kërkesës, i 30 majit 2011, paragrafi 46).

5. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës nr.52/20, të 14 marsit 2020, Gjykata vendosi me shumicë votash që, çështja ka mbetur pa objekt shqyrtimi dhe rrjedhimisht vendosi:
- (i) TË HEQË NGA LISTA kërkesën, në përputhje me rregullin 35 (4) të Rregullores së punës;
 - (ii) T'UA KUMTOJE këtë Vendim palëve;

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

rastin nr. KO98/20

parashtrues

Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr.52/2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 14 mars 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), përkatësisht: Hajrulla Çeko, Rexhep Selimi, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Arbërie Nagavci, Hekuran Murati, Fitore Pacolli, Saranda Bogujevci, Jahja Koka, Mefail Bajçinovci, Valon Ramadani, Mimoza Kusari Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Arbër Rexhaj, Arbëresha Kryeziu Hyseni, Labinotë Demi Murtezi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Arta Bajraliu, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani, Fitim Haziri, Elbert Krasniqi, Eman Rrahmani dhe Salih Zyba (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës ose deputetët parashtrues).
2. Parashtruesit e kërkesës u përfaqësuan në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), nga deputeti Hajrulla Çeko.

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.52/20, të 14 marsit 2020 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar) për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 4 të Nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], nenin 7 [Vlerat], nenin 123 [Parimet e Përgjithshme], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], paragrafin 1 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) me nenin 21 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ), me nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 67 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 qershor 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë duke kontestuar vendimin e Presidentit për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.
7. Më 22 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu- Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 23 qershor 2020, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: Presidentin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti); Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetarja e Kuvendit), të cilës iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); Avokatin e Popullit dhe Kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ).
9. Gjykata i ka njoftuar të gjitha palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, brenda afatit 15 ditësh, përkatësisht deri më 8 korrik 2020, në adresën elektronike të Gjykatës ose me dorëzim personal.
10. Më 8 korrik 2020, Presidenti dorëzoi komentet në rastin KO98/20 të Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 10 Korrik 2020, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës lidhur me komentet e pranuar më 8 korrik 2020. Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që deri me 17 korrik 2020, të qartësojnë që *përveç "faktit që kontestoni Vendimin për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës (Vendimi Nr. 52/20, datë 14 mars 2020), kërkojmë që të sqaroni se a e kontestoni edhe Vendimin për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut (Nr. 63/20, date 11 qershor 2020)".*
12. Në të njëjtën datë, Gjykata njoftoi Kryetaren e Kuvendit të cilës iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministrin; Avokatin e Popullit; dhe Kryetaren e KQZ-së; lidhur me komentet e Presidentit të pranuar më 8 maj 2020.
13. Më 28 korrik 2020, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës se brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht deri me 17 korrik 2020, nuk është pranuar ndonjë përgjigje nga ana e tyre. Rrjedhimisht, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës se *"procedurat për shqyrtimin e rastit KO98/20 do të vazhdojnë bazuar në dokumentacionin ekzistues".*
14. Me 29 korrik 2020, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të kërkesës, përmes emailit të drejtuar Sekretarit të Gjykatës, theksoi se e ka pranuar shkresën e datës 28 korrik 2020, mirëpo ai nuk e ka pranuar shkresën e 10 korrikut 2020, për të cilën thekson se *"Nëse ka pasur një kërkesë më herët, dua t'ju informoj që unë nuk kam*

pranuar asgjë nga ana e Gjykatës. Për këtë arsye, ju lus të më informoni konkretisht se për çfarë kërkesë bëhet fjalë, duke më ofruar edhe afatin e arsyeshëm për përgjigje”.

15. Më 5 gusht 2020, Gjykata i drejtohet përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës – deputetit Çeko, ku konfirmon se shkresa e Gjykatës [Nr.ref.:1230/20/rl] e 10 korrikut 2020, është dërguar nga Gjykata në Kuvendin e Kosovës dhe e njëjta është pranuar nga Administrata e Kuvendit (Lidhur me këtë, Gjykata ka bashkëlidhur konfirmimin e pranimit të shkresës). Gjithashtu, Gjykata i drejtohet si në vijim: *“Gjykata konfirmon trajtim të barabartë të të gjitha palëve në procedurë para saj. Rrjedhimisht, në rast se konsideroni se ju nuk e keni pranuar shkresën e Gjykatës [Nr.ref.:1230/20/rl] të 10 korrikut 2020, kërkojmë nga ju që të sillni një konfirmim nga ana e Administratës së Kuvendit në të cilën sqarohet që shkresa në fjalë nuk është pranuar nga ana juaj”.*
16. Në të njëjtën datë, Gjykata i drejtohet Sekretarit të Kuvendit lidhur me kërkesën për informatat vijuese: (i) konfirmimi i pranimit të shkresës së Gjykatës [Nr.ref.:1230/20/rl] nga Administrata e Kuvendit; dhe njëkohësisht (ii) konfirmimi se a është dorëzuar shkresa e Gjykatës tek i adresuari, përkatësisht deputeti Hajrulla Çeko.
17. Më 6 gusht 2020, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, deputeti Çeko përmes emailit drejtuar Sekretarit të Gjykatës thekson se: (i) nuk ka pranuar shkresën e Gjykatës dhe se nuk e ka idenë se për çfarë shkrese bëhet fjalë, pavarësisht se shkresa mund të jetë dorëzuar në Kuvend dhe për të cilën ka dëshmi; dhe (ii) kërkon të njoftohet se për çfarë kërkesë bëhet fjalë dhe t’i jepet afati për përgjigje.
18. Më 7 gusht 2020, Sekretari i Kuvendit njofton Gjykatën se (i) shkresa e Gjykatës (Nr.ref. 1230/20/rl) e 10 korrikut 2020, është pranuar nga Administrata e Kuvendit të Kosovës dhe (ii) e njëjta më 10 korrik 2020, nga Shërbimi për Mbështetjen e Deputetëve, i është dërguar deputetit, z. Hajrulla Çeko, në kutinë e tij postare të dedikuar për deputetët.
19. Më 13 gusht 2020, Gjykata i drejtohet përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës – deputetit Çeko, duke e informuar që kërkesa për shtyrje të afatit refuzohet lidhur me shkresën e Gjykatës (Nr.ref. 1230/20/rl) të 10 korrikut 2020.
20. Më 3 shtator 2020, Gjykata i drejtohet KQZ-së me kërkesë për informata shtesë, si në vijim:

- (1) a. A ka pasur raste të mëhershme të shtyrjes së zgjedhjeve në Kosovë – qoftë zgjedhje të Përgjithshme apo lokale?
b. Nëse përgjigja është Po, cilat zgjedhje janë shtyrë (të rregullta apo të parakohshme/jashtëzakonshme)?
 - (2) a. Cilat janë autoritetet vendimmarrëse në rastet e shtyrjes të zgjedhjeve?
b. Cila ishte baza ligjore e përdorur për shtyrje zgjedhesh?
 - (3) Bazuar në mandatin e KQZ-së për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, si dhe bazuar në paragrafin 4 të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, cilat veprime mund ti ndërmerr KQZ sa i përket zgjedhjeve të parakohshme, në kontekst të ndryshimit të afateve kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave?
 - (4) Cila ishte baza e kërkesës suaj të 14 marsit 2020, drejtuar Presidentit për shtyrje të zgjedhjeve?
 - (5) Cilat janë veprimet e ndërmarra nga KQZ, nga përcjellja e aktiviteteve zgjedhore të shteteve tjera?
21. Më 10 shtator 2020, KQZ-ja kthen përgjigje në Gjykatë lidhur me pyetjet e lartcekura.
 22. Më 15 shtator 2020, Gjykata lidhur me çështjen e pranimi të informatave shitesë nga KQZ-ja, e njoftoi Kryetaren e Kuvendit, të cilës iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Presidentin; Kryeministrin; dhe Avokatin e Popullit.
 23. Më 5 nëntor 2020, Presidenti i Kosovës, jep dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës.
 24. Më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit Znj. Vjosa Osmani- Sadriu filloi ushtrimin e postit të ushtrueses së detyrës të Presidentes së Republikës së Kosovës.
 25. Më 18 nëntor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 6 shkurt 2020, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejshëm: MAPL) përmes shkresës [Nr. Prot.158] i paraqiti Presidentit njoftimin ku theksohej që Agim Veliu ka dhënë dorëheqje nga posti i Kryetarit të Komunës së Podujevës.

27. Më 7 shkurt 2020, Presidenti përmes Vendimit 15/2020, për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, përcaktoi që (i) zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës do të mbahen më 15 mars 2020; (ii) Udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Podujevës, në përputhje me këtë vendim dhe ligjin në fuqi [...].
28. Në intervalin kohor ndërmjet 11 marsit dhe 18 marsit 2020, Qeveria e Kosovës nxori disa vendime që ndërlidhen me parandalimin e pandemisë COVID-19 (shih vendimet e Qeverisë: nr. 01/07 të 11 marsit 2020; nr. 01/08 të 12 marsit 2020; nr. 01/09 të 13 marsit 2020; nr. 02/09 të 13 marsit 2020; nr. 01/10 të 14 marsit 2020; nr. 01/11 të 15 marsit 2020; nr. 01/12 të 17 marsit 2020; nr. 01/13 të 18 marsit 2020).
29. Më 11 mars 2020, KQZ i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë për të marrë këshilla nëse duhet të ndërmerr ndonjë masë urgjente mbrojtëse specifike shëndetësore për ditën e zgjedhjeve.
30. Më 12 mars 2020, Ministria e Shëndetësisë i përgjigjet KQZ-së duke i dërguar rekomandimet për vendvotimet gjatë zgjedhjeve, lidhur me masat higjienike parandaluese të dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: IKSHPK).
31. Më 14 mars 2020, IKSHPK i drejtohet Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) me rekomandimin *për pezullim të përkohshëm të zgjedhjeve të 15 marsit 2020 në Podujevë për të parandaluar përhapjen e COVID-19 në Republikën e Kosovës*.
32. Në shkresën e lartpërmendur të IKSHPK-së theksohet që marrë parasysh situatën epidemiologjike me COVID-19 ditët e fundit, vlerësimin e OBSH-së (1 mars 2020) që e konsideron situatën epidemiologjike me risk shumë të lartë në tërë botën dhe ECDC (2 mars 2020) që e vlerëson si risk i lartë, si dhe shpalljen e pandemisë nga ana e OBSH-së më 11 mars 2020, masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 11 marsit 2020, IKSHPK dhe Komiteti për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse të Ministrisë së Shëndetësisë, ju kanë dërguar paraprakisht Udhëzuesin për Zgjedhje më 12 mars 2020. Pasi që situata epidemiologjike është përkeqësuar dje më 13 mars 2020, me detektimin e dy rasteve pozitive me SARS CoV-2 dhe sot më 14 mars 2020 rezultoi pozitiv edhe rasti i tretë, IKSHPK dhe Komiteti për

Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse rekomandon të pezullohen përkohësisht zgjedhjet e 15 marsit 2020 në Podujevë, për të parandaluar përhapjen e COVID-19 në Republikën e Kosovës.

33. Më 14 mars 2020, Kryetarja e KQZ-së, i drejtohet Presidentit të Republikës së Kosovës me shkresë ku kërkohet shtyrja e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, deri në një kohë tjetër të përshtatshme konform rekomandimit të IKSHKP-së dhe Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
34. Më 14 mars 2020, Presidenti nxori Vendimin nr.52/2020, për shtyrjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, në një afat të pacaktuar për shkak të parandalimit të përhapjes së Coronavirusit-COVID-19 dhe parandalimit të rritjes së numrit të personave të infektuar në Republikën e Kosovës dhe ruajtjes së shëndetit publik.
35. Më 14 gusht 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësiave gjatë pandemisë COVID-19. I njëjti hyri në fuqi me 25 gusht 2020.
36. Më 20 tetor 2020, Presidenti përmes Vendimit 157/2020, për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, përcaktoi që (i) zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës do të mbahen më 29 nëntor 2020; (ii) Udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Podujevës, në përputhje me këtë vendim dhe ligjin në fuqi; (iii) Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Podujevës të bëhet në koordinim dhe bashkërendim me institucionet përkatëse në pajtim me Ligjin Nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 3, 25 gusht 2020), [...].

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar, respektivisht Vendimit nr. 52/2020 të Presidentit, të 14 marsit 2020. Sipas parashtruesve të

kërkesës, Vendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me paragrafin 4 të Nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], nenin 7 [Vlerat], nenin 123 [Parimet e përgjithshme], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], paragrafin 1 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) me nenin 21 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ), me nenin 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, me paragrafin 2 të nenit 3 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me paragrafin 3 të nenit 56 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 të Ligjit për Zgjedhje Lokale.

38. Përkitazi me *pranueshmërinë e kërkesës dhe saktësimin e saj*, parashtruesit e kërkesës theksojnë që si Grup Parlamentar i përberë nga 30 deputetë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ata janë palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit Nr. 52/2020, në përputhje me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës. Për më tepër, çështja e ngritur nga deputetët në fjalë është çështje kushtetuese, sepse konteston kushtetutshmërinë e një Vendimi të një autoriteti publik brenda afatit të caktuar ligjor, i cili pretendohet se cenon nenet e lartë theksuara kushtetuese.
39. Gjithashtu parashtruesit e kërkesës pretendojnë që edhe përkundër emërtimit të aktit të Presidentit si vendim, i njëjti është identik për nga forma dhe përmbajtja me emërtimin *dekret* të përcaktuar me nenin e lartcekur në Kushtetutë. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës vënë theksin në praktikën e Gjykatës në rastet KO54/20, KO12/18 dhe KO73/16, ku Gjykata kishte vlerësuar se "[...] në praktikën e saj gjyqësore, në thelb, veçse është vendosur që nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti por në përmbajtjen dhe efektet e tij. Vendimi i kontestuar rrjedhimisht hyn në fushëveprim të fjalës *dekret*[...]" i Presidentit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës konkludojnë se i kanë plotësuar të gjitha kriteret ligjore për të qenë palë e autorizuar në Gjykatë.
40. Përkitazi me përmbajtjen/substancën e Vendimit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Vendimi i kontestuar nuk është në përputhje me nenet 123, 124 lidhur me nenin 45 të Kushtetutës, si dhe me paragrafin 2 të nenit 3 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
41. Sipas parashtruesve të kërkesës paragrafi 1 i nenit 123 të Kushtetutës përcakton qartë se vetëqeverisja lokale garantohet me ligj. Ndërsa, në paragrafin e dytë të këtij neni theksohet se "*Vetëqeverisja lokale*

ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë". Po ashtu në paragrafin 3 theksohet se "Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues". Në paragrafin 2 të nenin 3 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcaktohet se "Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asamblatë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre [...]".

42. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se praktika gjyqësore e Gjykatës në Aktgjykimin e rastit KO80/10, përcakton qartë se koncepti i vetëqeverisjes lokale është i ndërlidhur me paragrafin 1 të nenit 45 të Kushtetutës i cili përcakton se *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjete vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor"*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se *"Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë"* prandaj, Vendimi i Presidentit për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në afat të pacaktuar, privon qytetarët e Komunës së Podujevës, në kundërshtim me nenet e lartcekura, që pas dorëheqjes së Kryetarit të Komunës të Podujevës të votojnë për kryetarin e ri në përputhje me legjislacionin në fuqi.
43. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë që Presidenti nuk ka autoritet kushtetues që të marrë vendime të llojit të tillë për shtyrjen e zgjedhjeve komunale në afat të pacaktuar për shkak të parandalimit të rritjes së numrit të personave të infektuar me COVID-19. Gjithashtu, Presidenti nuk ka kompetencë kushtetuese të krijojë politika dhe njëkohësisht të marrë masa adekuate për mbrojtjen e shëndetit publik. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata në rastin KO54/20, ka përcaktuar se *"me këtë Aktgjykim nuk do të vlerësojë se a janë adekuate dhe të nevojshme, apo jo, masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Ky nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese. Politikat dhe vendimmarrja për shëndetin publik nuk hyjnë dhe nuk janë pjesë e kompetencave dhe autorizimeve të kësaj Gjykate [...]"*. Prandaj, vendimi i mbështetur në këto masa pa asnjë bazë kushtetuese dhe ligjore përbën shkelje të Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare. Kësisoj, vendimmarrja në lidhje me shëndetin publik dhe

parandalimin e përhapjes së korona virusit nuk janë kompetencë e Presidentit.

44. Sipas parashtresve të kërkesës Presidenti shtyn mbajtjen e zgjedhjeve në afat të pacaktuar për Kryetar në Komunën e Podujevës, duke u bazuar vetëm në situatën aktuale të pambuluar me ligj të veçantë dhe Kushtetutë, siç është ajo për parandalimin e përhapjes së korona virusit dhe ruajtjes së shëndetit publik. Ky vendim privon në mënyrë kundër kushtetuese qytetarët e Komunës së Podujevës të ushtrojnë të drejtën e tyre politike për të zgjedhur njërin nga kandidatët për kryetar komune tashmë të certifikuar nga KQZ-ja.
45. Më tutje, parashtresit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar ka prodhuar efekte juridike të cilat bien ndesh me parimin e demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në kuadër të nenit 7 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Vendimi i tillë ndalon që demokracia të materializojë funksionin e vetë përmes pjesëmarrjes së qytetarëve të komunës së caktuar në drejtim të zgjedhjes përmes votimit të përfaqësuesit të tyre si kryetar i komunës përkatëse.
46. Prandaj, sipas parashtresve të kërkesës koncepti i demokracisë i përcaktuar në nenin 7 duhet parë në lidhje me paragrafin 1 të nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës, e cila paraqet normën kushtetuese të përgjithshme që vlen për zgjedhjet lokale dhe për ato qendrore. Si rrjedhojë, në rastin konkret demokracia e përcaktuar në nenin 7 jetësohet përmes nenit 45 të Kushtetutës i cili ia mundëson qytetarëve të caktuar të komunës përkatëse të zgjedhin kryetarin e komunës së tyre pas dorëheqjes së z. Agim Veliu si Kryetar i Komunës së Podujevës.
47. Po ashtu, parimi i sundimit të ligjit nënkupton në rastin konkret që veprimet e Presidentit të materializuara përmes vendimit duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën e vendit. Mbi këtë bazë, komponentë thelbësore e parimit të sundimit të ligjit është edhe siguria juridike, ku sipas të cilës vendimet e autoriteteve publike duhet të jenë të bazuara në Kushtetutë dhe ligj. Çdo akt duhet të ketë parashikueshmërinë e vetë të cilin ia mundëson norma kushtetuese dhe ligjore. Ndërsa në këtë rast, vendimi i presidentit ka cenuar sigurinë juridike për faktin se norma kushtetuese dhe ligjore janë të sakta, koncize, të qarta dhe të parashikueshme në rastin kur një kryetar i komunës përkatëse jep dorëheqje. Pra në këtë rast, Presidenti i vendit duhet të vë në jetë normën kushtetuese dhe ligjore siç është përcaktuar në Kushtetutë dhe legjislacionin zgjedhor.

48. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se e drejta e Zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes e përcaktuar në nenin 45 paragrafi 1 të Kushtetutës është e drejtë politike e njeriut i cili përmes vullnetit të tij përmes normave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën kushtetuese të zgjedh (të drejtën aktive të votës) kryetarin e Komunës së Podujevës si qytetar me vendbanim brenda atij territori.
49. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Vendimi për të shtyrë mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujeve në një afat të pacaktuar është diskriminues në kuptim të mohimit të një të drejte politike të qytetarëve të cilët i përkasin asaj komune, në raport me komunat e tjera.
50. Parashtruesit e kërkesës në vijim theksojnë se sipas tyre Kryeministri i Kosovës z. Avdullah Hoti ka lejuar mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Rrjedhimisht, në njërën anë ndalohen qytetarët e komunës përkatëse pa asnjë bazë kushtetuese dhe ligjore të ushtrojnë të drejtën politike që të zgjedhin kryetarin e komunës së tyre, ndërsa në anën tjetër lejohen qytetarët serbë të votojnë në Kosovë për zgjedhjet parlamentare në Serbi. Përderisa nuk ka të dhëna shkencore deri më tani që disa qytetarë mund të jenë më imunë ndaj COVID-19 në ushtrimin e të drejtës politike për të zgjedhë e disa qytetarë të tjerë për shkak të kësaj pandemie privohen në mënyrë kundër kushtetuese nga ushtrimi i kësaj të drejte themelore politike. Në lidhje me këtë, sipas parashtruesve të kërkesës Presidenti me *11 qershor 2020*, ka nxjerrë Vendimin, *nr.63/2020*, për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Edhe ky vendim është i një natyre të njëjtë me vendimin nr. *52/2020*, dhe i njëjti është në kundërshtim me të gjitha dispozitat kushtetuese, ligjore dhe me konventat ndërkombëtare të përmendura në këtë kërkesë.
51. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë që mos mbajtja dhe shtyrja e zgjedhjeve në një afat të pacaktuar pa mbështetje kushtetuese dhe ligjore, shkel të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas parashtruesve të kërkesës, fokusi i këtij neni është detyrimi që ka shteti kontraktues dhe jo tek të drejtat dhe liritë e personave fizikë apo juridikë, ndonëse ato nuk përjashtohen, siç edhe tregon jurisprudenca e GJEDNJ-së. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se janë të vetëdijshëm që në rastin e Gjykatës KI48/18 është theksuar që neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk mbulon të gjitha kategoritë e zgjedhjeve dhe në parim, garancitë e saj nuk aplikohen për zgjedhjet lokale. Mirëpo, të njëjtit i referohen këtij neni në dritën e definicioneve dhe të garancive që i posedon shteti dhe

që ndërlidhen me të drejtat zgjedhore të mbrojtura përtej KEDNJ-së edhe me nenin 45 të Kushtetutës.

52. Përveç të lartë theksuarave, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se DUDNJ, e cila është pjesë integrale e Kushtetutës së Kosovës përmes nenit 22 të saj, e cila në nenin 21 të kësaj Deklarate përcakton se shprehja e vullnetit të popullit bëhet përmes zgjedhjeve periodike dhe të lira. Sipas parashtruesve të kërkesës kjo dispozitë e DUDNJ-së në formë të parimit ose vlerës juridike mbulon të gjitha zgjedhjet në nivel të pushtetit shtetëror varësisht prej niveleve të pushtetit shtetëror të rregulluar dhe përcaktuar me legjislacionet përkatëse të shteteve përkatëse.
53. Në vijim, parashtruesit e kërkesës theksojnë që Vendimi për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut privon të drejtën politike qytetare për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur të përcaktuar në nenin 45 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, sipas parashtruesve të kërkesës edhe Parimet e Trashëgimisë Elektorale Evropiane të hartuar nga Komisioni i Venecias përcaktojnë pesë parimet bazë të trashëgimisë elektorale Evropiane si në vijim: votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë.
54. Prandaj, parashtruesit e kësaj kërkeje konsiderojnë se shtyrja e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, në afat të pacaktuar është cenim edhe i konventave ndërkombëtare si dhe vetë Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Andaj, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se ndonëse baza ligjore në preambulën e këtij vendimi është jo e saktë dhe për më shumë është keqpërdorim i legjislacionit në fuqi, ky Vendim ka prodhuar efekte juridike në kundërshtim të plotë me të gjitha dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës, konventave ndërkombëtare dhe Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.
55. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të *“nxjerrë Aktgjykim me të cilin vendos: I. Të shpallë të Pranueshme këtë kërkesë; II. Të shpallë Vendimin e Presidentit nr. 52/2020, të datës 14 mars 2020, në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare; III. Të Urdhërojë Presidentin që në afatin sa më të shkurtë të caktojë shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës; IV. Të Urdhërojë që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të shpallet në Gazetën Zyrtare; V. Ky aktgjykim të hyjë në fuqi menjëherë”*.

Komentet e Presidentit

56. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Presidenti thekson se kërkesa KO98/20 duhet të shpallet e papranueshme nga Gjykata, për faktin se është e paqartë si në saktësimin, ashtu edhe në arsyetimin e saj. Fillimisht Presidenti thekson se kompetencat e tij janë të shtrira në një gamë të gjerë të neneve kushtetuese dhe ligjore, të cilat paraqesin tërësinë e rolit që ka Presidenti në sistemin kushtetues dhe juridik të Kosovës, i bazuar para së gjithash në Kushtetutë, por edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese.
57. Në vijim Presidenti argumenton se mandati i tij ka natyrë edhe politike, pasi që Presidenti merr pjesë në drejtimin e punëve publike. Në mbështetje të kësaj, Presidenti përdorë edhe referenca të Gjykatës Kushtetuese (rasti i Gjykatës KO29/12 dhe KO48/12) ku theksohet *"të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike" në nenin 25 (a) të KNDCP-së është kryesore për ushtrimin e mandatit të Presidentit të zgjedhur në mënyrë të drejtë e legjitime sipas Kushtetutës si pjesë e detyrave të tij/saj, siç parashihet me nenin 4 [...]" të Kushtetutës. Ndërsa, Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës përcakton që "Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit ... [dhe] ... është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë". Ky formulim sa i përket rolit të Presidentit është kryesor për njërin prej parimeve themelore të Kushtetutës së Kosovës, pra i doktrinës së ndarjes së pushtetit".*
58. Pra, sipas Presidentit, disa nga kompetencat e tij prekin shumë qartë jetën politike të vendit, sikurse kur bën shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës apo shpalljen e zgjedhjeve për organet vetëqeverisëse lokale. Në rrjedhë të kësaj, Presidenti është faktori kryesor që ka për detyrë të ruajë unitetin e popullit dhe stabilitetin, si dhe të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në vijim, Presidenti thekson se në rastin konkret është përfillur kërkesa e KQZ-së, që është përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve dhe si rrjedhojë është marrë parasysh rekomandimi i IKPSHK-së. Kështu, detyra e Presidentit për garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve është një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme, të cilën e kryen gjithnjë duke pasur parasysh përfaqësimin e popullit dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Rrjedhimisht, në rast të mos shtyrjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Komunën e Podujevës, do të rrezikohej shëndeti i qytetarëve dhe punonjësve të institucioneve që do të merrnin pjesë në procesin zgjedhor.

59. Në vijim të përgjigjes së Presidentit theksohet se Vendimi i Presidentit nr. 52/2020 është tërësisht në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Pra, Vendimi është bazuar në Ligjin nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
60. Presidenti gjithashtu thekson se me rëndësi janë edhe veprimet dhe ngjarjet paraprake, para nxjerrjes së Vendimit nr. 52/2020 të 14 marsit 2020. Këtu duhet pasur parasysh rrjedhën e veprimeve dhe ngjarjeve si tërësi dhe jo vetëm Vendimin e kontestuar, pasi që të gjitha veprimet janë marrë në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore dhe nën dritën e rrethanave të paraqitura në Republikën e Kosovës, që i kanë paraprirë nxjerrjes së Vendimit nr. 52/2020.
61. Ndër këto veprime Presidenti përmend: (i) Dorëheqjen e Kryetarit të Komunës së Podujevës të 6 shkurtit 2020; (ii) përmes Vendimit Nr.15/2020 të 7 shkurtit 2020, u bë shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës për datën 15 mars 2020; (iii) Me qëllim të luftimit të pandemisë COVID-19, Qeveria më 12 mars 2020, përmes Vendimit të Qeverisë nr. 01/08, vendos themelimin e Komisionit të posaçëm për parandalimin e infeksionit Coronavirus COVID-19; dhe më 13 mars 2020, Qeveria përmes Vendimit të Qeverisë Nr.01/09 vendos masa shtesë, ku ndër të tjera përfshiheshin: mbyllja e kafiterive, bareve, pabeve dhe restoranteve, qendrave tregtare me përjashtim të farmaceve dhe marketeve ushqimore; pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive; reduktohen në veprime esenciale dhe staf esencial për çdo institucion publik përveç stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë; urdhërohen kompanitë private që ta organizojnë punën në atë mënyrë që shumicën e aktiviteteve punëtoret t'i kryejnë nga shtëpia; rekomandohet: u bëhet thirrje të gjithë qytetarëve që t'u shmangen ambienteve të frekuentuara me njerëz dhe t'u përmbahen të gjitha masave të ndërmarra nga Qeveria dhe rekomandimeve të dhëna nga IKSHPK.
62. Prandaj, sipas Presidentit nxjerrja e Vendimit të kontestuar është bërë me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19. Ky Vendim është reflektim i kërkesës së KQZ-së së 14 marsit 2020, lidhur me pezullimin e përkohshëm të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, për të parandaluar përhapjen e COVID-19 në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, Presidenti thekson se kërkesës së KQZ-së për shtyrje të zgjedhjeve i ka paraprirë rekomandimi parandalues nga IKSHPK dhe Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse, për pezullimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Podujevë, i 14 marsit 2020, i cili

rridhte pas vlerësimit të situatës epidemiologjike të COVID-19, që ka rezultuar e përkeqësuar.

63. Rrjedhimisht, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, Presidenti pretendon se gjithnjë ka pasur parasysh rrethanat që kanë shtyrë ndryshimin e afateve kohore të mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, interesat e qytetarëve dhe ruajtjen e shëndetit publik, duke vepruar në pajtim me rekomandimin parandalues nga IKSHPK dhe Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse, me kërkesën e KQZ-së së 14 marsit 2020 dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
64. Gjithashtu sipas Presidentit, gjatë marrjes së Vendimit të kontestuar, janë marrë parasysh edhe Vendimi i Qeverisë Nr. 01/09, i 13 marsit 2020, ku çdo institucioni publik i kërkohet të reduktohet në veprime esenciale dhe staf esencial, përveç stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë.
65. Presidenti gjithashtu thekson se pretendimet e parashtrueseve të kërkesës nuk qëndrojnë, ngase neni 4.4 i Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, ndër të tjera përcakton: "... Zgjedhjet e parakohshme qeverisen përmes ligjeve të njëjta dhe rregullat e KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave". Prandaj, KQZ-ja në bazë të rekomandimit parandalues të IKSHPK-së ka vlerësuar se për shkak të rrethanave të shkaktuara nga rreziku i lartë i përhapjes së COVID-19 duhet të ndryshojnë afatet kohore për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, respektivisht duhet të pezullohen dhe një kërkesë të tillë e ka adresuar tek Presidenti, i cili e ka marrë parasysh dhe ka nxjerrë Vendimin nr. 52/2020.
66. Përfundimisht, Presidenti thekson se kërkesa KO98/20 duhet të shpallet e papranueshme, sepse nuk është në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën.

Komentet e KQZ-së

67. Lidhur me pyetjet e Gjykatës të 3 shtatorit 2020, KQZ-ja përgjigjet si në vijim:

Duke ju referuar kërkesës suaj me pese (5) pyetje të dorëzuar ne KQZ me datën 03.09.2020, Nr.767/2020, për informata lidhur me shtyrjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën

e Podujevës, po ju dërgojmë përgjigjet e radhitura sipas pyetjeve tuaja dhe atë si në vijim:

I. Nga pavarësimi i Kosovës e deri te Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, nuk ka pasur raste tjera të shtyrjes së mbajtjes së zgjedhjeve.

II. Autoritet vendimmarrës për shpalljen e zgjedhjeve në Kosovë qofshin ato zgjedhje të përgjithshme apo lokale në Kosovë është Presidenti i Republikës së Kosovës. Presidenti, pas konsultimit me partitë politike: a) bazuar në nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës; dhe b) bazuar në nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve lokale.

III. Veprimet e ndërmarra nga KQZ-ja bazuar në mandatin e KQZ-së, për përgatitjen mbikëqyrjen drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, sipas nenit 4 paragrafi 4, KQZ-ja mund t'i ndryshoj afatet kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave. Për të rregulluar këto veprime, KQZ ka nxjerr Rregullën e KQZ-së nr.15/2013 për Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme. Rregulla Nr.15/20 sipas nenit 3 përcakton mundësinë e shkurtimit të 12 afateve dhe atë si më poshtë:

1) afatet për krijimin e Listës së Votuesve dhe i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit; 2) afatet për procedurën e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve; 3) afati i shortit të fletëvotimit, dhe afati i fundit për tërheqje nga shorti i fletëvotimit; 4) afati për zëvendësimin e kandidatëve; 5) afatet për publikimin e listave të kandidatëve të certifikuar dhe me çfarëdo ndryshime; 6) afati i fundit për të përcaktuar kufizimin e shpenzimeve për fushatë; 7) kohëzgjatja e fushatës zgjedhore si dhe afatet për tubimet e fushatës zgjedhore; 8) afatet për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhguesve 9) afatet për emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV); 10) afati i fundit për publikimin e Qendrave të Vendvotimit; 11) afatet për aplikim për regjistrim si votues jashtë Kosovës, si dhe afatet e procesit të konfirmimit; 12) afatet për aplikim për regjistrim si votues me nevoja të veçanta.

IV. Baza konkrete e kërkesës së KQZ-së drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve ishte përgjigjja dhe rekomandimi i IKSHPKS-së, të datës 14 mars 2020, të cilët 21 kanë rekomanduar KQZ-së pezullimin e përkohshëm të zgjedhjeve të datës 15 mars 2020, me qëllim të parandalimit të përhapjes së COVID 19 në Republikën e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik të qytetarëve.

V. KQZ, edhe pse fillimisht ka planifikuar dhe ka kryer të gjitha përgatitjet për vëzhgim të zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut të mbajtura këtë vit, për shkak të shfaqjes së rasteve me COVID-19 në mesin e delegacionit që është planifikuar të vëzhgoj ato zgjedhje, ka dështuar ai aktivitet.

Dispozita të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;

Kapitulli X Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

- 1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.*
- 2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.*
- 3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.*
- 4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve*

publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitatet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 21

Gjithkush ka të drejtë të marre pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Neni 56 Zgjedhja e kryetarit të komunës

[...]

56.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

- a) kur ta kryejë mandatin e tij;
- b) nëse vdes;
- c) nëse jep dorëheqje;
- d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;
- g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike; dhe
- h) në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**Neni 4****Data dhe shpallja e zgjedhjeve**

4.1 Pas konsultimit me partitë politike, Kryetari i Kosovës cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve lokale.

4.2 Zgjedhjet për organet vetëqeverisëse lokale mbahen ditën e diele për çdo katër (4) vite. Zgjedhjet nuk mund të mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit.

4.3 Sipas kompetencave të Presidentit të Kosovës të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Kryetarit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më vonë se katër (4) muaj dhe jo më herët se gjashtë (6) muaj, para datës së zgjedhjeve.

4.4 Pas shpërbërjes së Kuvendit të Komunës ose shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit, nëse nuk parashtrohet ankesë në afat prej pesë (5) ditësh tek Gjykata Kushtetuese, zgjedhjet e parakohshme lokale shpallen nga Presidenti i Kosovës. Pas shpërbërjes së Kuvendit të Komunës zgjedhjet e parakohshme shpallen jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërbërjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas shpërbërjes. Zgjedhjet e parakohshme qeverisen përmes ligjeve të njëjta dhe rregullat e KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave.

4.5 Vendimi për caktimin e zgjedhjeve bëhet publik në 'Gazetën Zyrtare të Kosovës'.

LIGJI Nr. 03/L-094 PËR PRESIDENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**Neni 6 Kompetencat e Presidentit**

Presidenti i Republikës së Kosovës ushtron kompetencat që i janë akorduar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi.

Pranueshmëria e kërkesës

68. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

69. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore sipas të cilave Kuvendi, mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...] 2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën. [...]

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

KREU III

Procedurat e Veçanta

Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 29 [Saktësimi i kërkesës]

- 1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.*
- 2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
- 3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.*

Neni 30 [Afatet]

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese

VII. Dispozita të veçanta për procedura sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 67

[Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe me nenet 29 dhe 30 të Ligjit.

(2) Kur një kërkesë parashtrohet në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, inter alia, nëse përmbajtja e plotë e aktit të kontestuar ose pjesë të caktuara dhe cilat pjesë të aktit të përmendur konsiderohen të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

(3) Kërkesa specifikon kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

70. Në lidhje me rrethanat e rastit konkret, Gjykata merr parasysh edhe paragrafin (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës, ku është përcaktuar si në vijim:

Rregulli 35

(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur Gjykata përcakton se pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm, nuk paraqet një çështje të drejtë gjyqësore dhe nuk ka çështje të veçanta të të drejtave të njeriut të pranishme në rast.

71. Fillimisht, Gjykata nënvizon që detyrim i ngjashëm me rregullin 35 paragrafi 4 të Rregullore së punës, ekziston edhe në nenin 37 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas pikës 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, parasheh zbatim të drejtpërdrejtë të Konventës në Republikën e Kosovës, e njëjta në pjesën relevante përcakton si në vijim:

Neni 37
Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:

- a. kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose
- b. çështja është zgjidhur; ose
- c. për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.

Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollet e saj.

72. Prandaj, në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
73. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së *Vendimit nr. 52/2020 të 14 marsit 2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës*, i cili kishte të bënte me shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës në afat të pacaktuar, duke pretenduar se i njëjti është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], nenin 7 [Vlerat], nenin 123 [Parimet e përgjithshme], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], paragrafin 1 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, me nenin 21 të DUDNJ-së dhe me nenin 3 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.
74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së, kur vlerëson se a aplikohet nënparagrafi b i paragrafit 1 të nenit 37 të Konventës, për çështjen e rasteve para saj, ajo duhet t'u përgjigjet dy pyetjeve me radhë: (i) *së pari*, se a qëndrojnë ende rrethanat për të cilat ishin ankuar drejtpërdrejtë parashtruesit e kërkesës; dhe, (ii) *së dyti*, nëse efekti i shkeljes eventuale të Konventës për shkak të atyre rrethanave gjithashtu është korrigjuar (shih rastet e GJEDNJ-së *El Majjaoui & Stichting Toubia Moskee kundër Holandës*, kërkesa nr. 25525/03, Vendim për çregjistrim të kërkesës, paragrafi 30; *Pisano kundër*

Italisë, kërkesa nr. 36732/97, Vendim për çregjistrim të kërkesës, paragrafi 42; Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë, kërkesa nr. 60654/00, Vendim për çregjistrim të kërkesës, paragrafi 97).

75. Në rastin konkret, në kontekst të aplikimit të pikës së parë të testit të lartcekur, përkatësisht të vlerësuarit *(i) nëse ende qëndrojnë rrethanat për të cilat ishin ankuar drejtpërdrejtë parashtruesit e kërkesës*, Gjykata nënvizon se kjo përfshin para së gjithash vërtetimin e situatës nëse shtyrja e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, ende ekziston.
76. Në ndërlidhje me këtë pikë, Gjykata rikujton që më 20 tetor 2020, Presidenti përmes Vendimit nr. 157/2020, ka caktuar datën 29 nëntor 2020, si datë të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës. Prandaj për sa i përket pikës së parë të vlerësimit, nuk është më kontestues fakti i mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se me faktin e caktimit të datës së zgjedhjeve, është shuar çështja e mos mbajtjes së zgjedhjeve, përkatësisht shtyrjes së zgjedhjeve në afat të pacaktuar.
77. Në anën tjetër, në kontekst të aplikimit të pikës së dytë të testit të lartcekur, përkatësisht të vlerësuarit *(ii) nëse efekti i shkeljes eventuale të Konventës për shkak të atyre rrethanave gjithashtu është korrigjuar*, Gjykata thekson se kjo pikë përfshin vlerësimin kushtetues, nëse shkelja eventuale e Kushtetutës dhe Konventës përmes Vendimit të kontestuar, është sanuar me marrjen e Vendimit të Presidentit [Nr. 157/2020] të 20 tetorit 2020, për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.
78. Gjykata vëren se Vendimi i Presidentit [Nr.157/2020], përveç caktimit të datës së zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Podujevës, ka precizuar që “organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve të bëhet në koordinim dhe bashkërendim me institucionet përkatëse në pajtim me Ligjin nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 3, 25 gusht 2020)”. I njëjti vendim në bazën ligjore të tij thirret edhe në vendimin e kontestuar, përkatësisht Vendimin e Presidentit Nr. 52/2020 [për shtyrjen e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, për afat të pacaktuar] për të cilin thekson që është nxjerrë për shkak të pandemisë COVID-19.
79. Gjykata në bazë të analizimit të situatës aktuale, që ndikohet nga marrja e Vendimit të Presidentit [Nr.157/2020], duke përfshirë edhe

aspektin e organizimit të zgjedhjeve në përputhje me Ligjin nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, vlerëson që i njëjti ka zëvendësuar Vendimin e kontestuar dhe se efekti juridik i shkeljes eventuale të Kushtetutës dhe Konventës nga Vendimi i kontestuar, tashmë është sanuar me rastin e caktimit të 29 nëntorit 2020 si datë e mbajtjes së zgjedhjeve.

80. Megjithatë, Gjykata poashtu do të vlerësojë nëse edhe më tej është i nevojshëm vazhdimi i shqyrtimit të rastit konkret, në kontekst të respektimit të të drejtave të njeriut të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa.
81. Fillimisht, Gjykata vëren se standardi i GJEDNJ-së, në rastet kur është i nevojshëm vazhdimi i shqyrtimit të çështjes [në kontekst të respektimit të të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa] konsiston në ato rrethana në të cilat pozita e parashtruesit të kërkesës është e paqartë lidhur me epilogun e rastit të tij dhe kur i njëjti në mënyrë të pashmangshme do të mbetet në një situatë të pasigurt për sa i përket çështjeve të ngritura në parashtrësë bazuar në nene të caktuara të Konventës (shih rastin e GJEDNJ-së *F.G kundër Suedisë*, kërkesa nr. 43611/11, Aktgjykim i 23 marsit 2016, paragrafët 79-84).
82. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim konkludon se në rastin konkret, (i) përderisa arsyeja për të cilën është kontestuar Vendimi i Presidentit, d.m.th. *Shtyrja e zgjedhjeve në afat të pacaktuar*, më nuk qëndron; dhe (ii) përderisa efekti i shkeljes eventuale të nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për shkak të atyre rrethanave është adresuar me përcaktimin e datës së re të zgjedhjeve (përkatesisht më 29 nëntor 2020), Gjykata konsideron se rasti konkret nuk përfshin ndonjë rrethanë të veçantë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë.
83. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se përmes Vendimit të Presidentit [Nr.157/2020], objekti i kërkesës së parashtruesve të kërkesës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Pozita e tanishme, përkatesisht *caktimi i datës së zgjedhjeve* është rrethanë e tillë e cila konsiston në atë që kërkesa në fjalë, tashmë nuk ka arsyetim dhe se qëllimi që është kërkuar të arrihet, tashmë është arritur plotësisht. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka më merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje dhe një arsyetim të tillë, Gjykata tashmë e ka shprehur qartë edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih rastet e Gjykatës: KO63/12, me parashtrues *Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, Nr. 04/L-82, Vendim për heqje të kërkesës

nga lista i 10 dhjetorit 2012, paragrafi 19; Rasti KO107/10, me parashtrues *Gani Geci dhe deputetët e tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit, i 14 tetorit 2010, në lidhje me Strategjinë dhe Projekt-Vendimin e Qeverisë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës, Vendim për heqje nga lista të kërkesës, i 17 gushtit 2011, paragrafët 24-26; Rastet KI58, KI66 dhe KI94/12, me parashtrues *Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunalë të KK të Vitisë, Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Komunës së Mitrovicës, Gjilanit dhe Vitisë për kushtëzimet e qytetarëve në qasje në shërbimet komunale me pagesën e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike*, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 5 korrikut 2013, paragrafi 45).

84. Pra, si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekziston më dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbytjes gjyqësore (shih rastin KO63/12, cituar më lartë, paragrafi 23; KI11/09, *Tomë Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/12, dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji nr. 02/L-47*, Vendim për heqjen nga lista të kërkesës, i 30 majit 2011, paragrafi 46).
85. Prandaj, duke i konsideruar vlerësimet e lartcekura, Gjykata tashmë konstatoi se 2 kushtet e aplikimit të nenit 37 paragrafi 1 nënparagrafi b, të Konventës janë përmbytur. Gjithashtu pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm dhe se Gjykata vlerëson që nuk ka arsye të veçanta lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë për të cilat është e nevojshme që të vazhdohet me vlerësimin e mëtejshëm të kësaj kërkesë, përderisa nuk ka rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar dhe se çështja faktikisht ka mbetur pa objekt shqyrtimi.
86. Përfundimisht, duke marrë parasysh Vendimin e Presidentit Nr.157/2020 për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani më nuk kanë rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar dhe çështja faktikisht është pa objekt shqyrtimi, andaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 35 (4) dhe 59 (3) të Rregullores së punës, më 18 nëntor 2020,

VENDOS

- I. TË HEQË NGA LISTA, kërkesën në përputhje me rregullin 35 (4) të Rregullores së punës;
- II. T'UA KUMTOJE këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJE këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. TE SHPALLË që ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Rasti nr. KO50/19, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale dhe nenit 19 paragraf 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale (Ligji i kontestuar 1) dhe nenit 19 paragraf 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (Ligji i kontestuar 2), kërkesë qartazi e pabazuar

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafi 2, nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar 1 dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar 2, për të cilët pretendohet se janë në kundërshtim me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon që sipas dispozitave të nenit 7.3, 7.4 dhe 7.5 të Ligjit të kontestuar 1, ndaj personit të vdekur mund të ngritët aktakuzë, të caktohet mbrojtësi dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor, që është në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së.

Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se në kontekst të vlerësimit të kriterit nëse *Ligjet e kontestuar duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj*, erdhi në përfundim që ky kriter nuk plotësohet.

Gjykata konstatoi se nga faktet e rastit rezulton që më 14 tetor 2020 Gjykata referuese kishte zgjidhur rastin që kishte para saj. Këtë zgjidhje ose përfundim të rastit Gjykata Supreme e kishte bërë përmes nxjerrjes së Aktvendimit Pml.nr.3/2019, ku kishte hedhur poshtë kërkesën e palës së interesuar për mbrojtje të ligjshmërisë – nën arsyetimin se pas tërheqjes së PSRK-së nga aktakuza nuk kishte më kompetencë të vazhdonte procedurën penale.

Gjykata rikujton qëndrimin e saj që Gjykata mund të vendosë për kërkesat që ndërlidhen me nenin 113.8 të Kushtetutës vetëm nëse para Gjykatës referuese ka një rast aktiv në pritje të zgjidhjes dhe ku “*vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit*” të kontestuar. Siç u shpjegua më lart, para Gjykatës referuese nuk ka më rast aktiv ngase kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë për vendosjen e së cilës ishte pezulluar procedura gjyqësore deri në një vendim të Gjykatës Kushtetuese – tashmë është zgjidhur si çështje nga Gjykata Supreme.

Gjykata Supreme nuk ka mund të vendosë për rastin që veçse e ka referuar në Gjykatën Kushtetuese para se të bënte kërkesë për tërheqje të rastit nga procedurat shqyrtuese në Gjykatën Kushtetuese. Kjo për faktin se neni 52 i Ligjit thotë qartë që: “*Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.*” Kjo nënkupton që neni 52 i Ligjit parasheh suspendim *ex lege* të procedurës në momentin që ngritët një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës. Nga kjo rrjedhë që Gjykata Supreme nuk e ka pasur të mundshme të ndërmerr asnjë veprim procedural lidhur me rastin pa e njoftuar paraprakisht Gjykatën Kushtetuese tek e cila është referuar rasti për shqyrtim.

Si përfundim, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenet 20, 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe rregullin 77 të Rregullores së punës, Gjykata e deklaroi kërkesën KO50/19 si të papranueshme për shqyrtim të mëtejshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO50/19

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale dhe nenit 19 paragrafit 1 nënparagrafit 1, paragrafit 2 nënparagrafit 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata referuese) e nënshkruar nga kryetari Enver Peci.

Ligjet e kontestuar

2. Gjykata referuese ngre dyshime për kushtetutshmërinë e: (i) nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 5 / 8 mars 2013, Prishtinë, në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar 1); dhe (ii)

nenit 19 paragrafit 1 nënparagrafit 1, paragrafit 2 nënparagrafit 1, paragrafit 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 23/26 dhjetor 2018, Prishtinë, në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar 2) [tani e tutje kur referohen bashkërisht: Ligjet e kontestuar].

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar 1 dhe nenit 19 paragrafit 1 nënparagrafit 1, paragrafi 2 nënparagrafit 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar 2, për të cilët pretendohet se janë në kundërshtim me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 51 [Saktësimi i kërkesës], 52 [Procedura para Gjykatës] dhe 53 [Vendimi] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 mars 2019, Gjykata referuese dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 27 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 2 prill 2019, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën referuese, Presidentin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti), Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit), Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri), Avokatin e Popullit dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: PSRK), duke iu ofruar mundësinë e paraqitjes së komenteve, nëse

kanë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të shkresës së Gjykatës.

8. Në të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi avokatin Visar Haxhibeqiri për regjistrimin e kërkesës KO50/19, si avokat i palëve të interesuara në procedurat gjyqësore pranë gjykatave të rregullta, respektivisht personave L.H. V.H dhe V.H. [*Sqarim i Gjykatës*: të gjitha palët e interesuara janë pasardhësit e të ndjerit H.H. ndaj të cilit PSRK kishte propozuar vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale (në tekstin e mëtejme Gjykata do iu referohet bashkërisht si “pala e interesuar”)]. Edhe palëve të interesuara Gjykata u ofroi mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të shkresës së Gjykatës.
9. Më 18 prill 2019, pala e interesuar paraqiti komente lidhur me kërkesën e Gjykatës referuese parashtruar kësaj Gjykate.
10. Më 10 maj 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën referuese, Presidentin, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Avokatin e Popullit dhe PSRK-në në lidhje me komentet e palës së interesuar. Gjykata referuese u njoftua se komentet e saj në lidhje me komentet e palës së interesuar, nëse ka, mund t’i paraqes deri më 22 maj 2019.
11. Më 15 maj 2019, Gjykata referuese kërkoi që t’i kthehet origjinali i lëndës.
12. Më 3 qershor 2019, Gjykata Kushtetuese ia ktheu origjinalin e lëndës Gjykatës referuese.
13. Gjykata referuese nuk paraqiti komente në lidhje me komentet e palës së interesuar.
14. Më 27 dhjetor 2019, pala e interesuar paraqiti plotësim të kërkesës ku theksonte që pas përfundimit të 30 (tridhjetë) ditëve të vlefshmërisë së Aktvendimit [GJPP 181/2009] të 4 majit 2011, as prokuroria e as gjykata nuk ka lëshuar ndonjë urdhër apo vendim gjyqësor për ngrirje, sekuestrim apo çfarëdo mase tjetër që do të pengonte administrimin e lirshëm të pronës që ishte objekt kontesti në këtë rast.
15. Më 24 shkurt 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën referuese, Presidentin, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Avokatin e Popullit dhe PSRK-në në lidhje me plotësimin e kërkesës nga ana e palës së interesuar.

16. Më 4 mars 2020, pala e interesuar paraqiti plotësimin e dytë të kërkesës, ku vendosi theksin tek shkresa e PSRK-së drejtuar Gjykatës Themelore –Departamentit për Krime të Rënda ku theksohej se PSRK ka hequr dorë nga propozimi për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale ndaj të pandehurit të vdekur H.H. *ex relation* [H.H. ishte bashkëshorti, respektivisht babai i palëve të interesuara të theksuara më lartë].
17. Më 14 shtator 2020, pala e interesuar paraqiti kërkesë për vendosje të rastit KO50/19 ose që i njëjti të hidhet poshtë në bazë të rregullit 35.4 të Rregullores së Punës.
18. Më 14 shtator 2020, Gjykata iu drejtua PSRK-së për informata shtesë lidhur me rastin në fjalë, duke kërkuar specifikisht vërtetim se *“a është hequr dorë nga propozimi [PPS.nr.22/09] i 16 janarit 2018, për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale ndaj të pandehurit të vdekur H. H. ex relation? Një informatë të tillë Gjykata e ka pranuar nga palët e interesuara në rastin KO50/19”*.
19. Më 5 tetor 2020, në mungesë të një përgjigje brenda afatit të përcaktuar, Gjykata e përsëriti kërkesën e njëjtë për informata shtesë nga ana e PSRK-së.
20. Më 7 tetor 2020, PSRK iu përgjigj Gjykatës duke theksuar se janë përgjigjur dhe më herët por që shkresa e tyre nuk kishte arritur në emailin zyrtar të Gjykatës. Më tutje, në përgjigjen e tyre theksohej më sa vijon: *“ju njoftojmë se kjo prokurori [PSRK] me dt. 27.02.2020, ju ka drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, me njoftim se ka hequr dorë nga Propozimin PPS.nr. 22/2019, dt. 16.01.2018, për vazhdimin e procedurës penale së konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale, kundër të vdekurit H.H., për arsyet të cilat janë cekur në shkresën të cilën po ua bashkëngjisim”*.
21. Më 13 tetor 2020, Gjykata fillimisht e njoftoi Gjykatën Supreme që bazuar në informatat e marra nga pala e interesuar, e të cilat janë konfirmuar në komunikim me PSRK-në, rezulton që PSRK-ja më 27 shkurt 2020, e ka njoftuar Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë që *“heqin dorë nga propozimi PPS.nr. 22/09 i datës 16.01.2018 për vazhdimin e procedurës penale së konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale, kundër të vdekurit H.H.”*. Pas theksimit të këtyre fakteve, Gjykata kërkoi sqarimet vijuese nga Gjykata Supreme:

“a) Bazuar në legjislacionin në fuqi, cila është praktika e Gjykatës Supreme në rastet kur PSRK heq dorë nga propozimi për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfituara me vepër penale?”

b) A pushon procedura në rast të tërheqjes së Prokurorit nga Propozimi për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfituar me vepër penale?

c) A ka ndryshuar diçka në statusin e rastit KO50/19 nga momenti që keni dorëzuar kërkesën në Gjykatë, duke marrë për bazë veprimet procedurale të ndërmarra pasi që ju keni dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese?”

22. Më 14 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml. nr. 3/2019] vendosi që të hudhet si jolëndore kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga avokati i palës së interesuar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.1/17 të datës 26 nëntorit 2018 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [PN. nr.1240/18] të 17 dhjetorit 2018.

23. Më 27 tetor 2020, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës me informatat vijuese:

*“Gjykata Supreme e Kosovës duke analizuar këtë situatë procedurale me vendimin Pml.nr.3/2019 me datë 14 tetor 2020, konstatoj se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit Visar Haxhibeqiri përfaqësues i palëve të interesuara trashëgimtarëve ligjor të tani të ndjerit H.H., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.1/17 të datës 26.11.2018, dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1240/18 të datës 17.12.2018, **hudhet si jo lëndore.***

Sipas kësaj që u përshkrua më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës me heqjen dorë nga propozimi i prokurorisë kompetente nga rasti nuk ka kompetencë të mëtutjeshëm për vazhdimin e procedurës penale sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe rrjedhimisht vendimi i kësaj gjykate për rastin konkret nuk varet nga përputhshmëria e Ligjit nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë të Përfituar me Vepër Penale.

Andaj, propozoj që Gjykata Kushtetuese sipas rregullit 35 të Rregullores së punës, të vlerësoj nevojën e procedimit të mëtutjeshme të këtij rasti.”

24. Më 18 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.
25. Më 9 dhjetor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 30 qershor 2009, PSRK nxori një Aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj 25 personave, për disa vepra penale të natyrës së krimeve financiare. Që në fazën e parë të hetimeve ishte vërejtur se në këtë çështje penalo juridike, sipas PSRK ka qenë i përfshirë edhe i ndjeri H.H. i cili kishte ndërruar jetë më 21 mars 2008.
27. Më 15 mars 2010, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në bazë të kërkesës së Prokurorit të PSRK, lëshoi urdhër për masa të fshehta – “Zbulimin e të dhënave financiare” kundër të ndjerit H.H., si i dyshuar për përfshirje në vepra të caktuara penale. Në bazë të raporteve të marra nga autoritetet bankare, H.H. edhe pas vdekjes, vazhdonte të kishte llogari aktive në bankat komerciale në Kosovë me një bilanc të të hollave prej 235,990.12 euro (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntë qind e nëntëdhjetë euro e dymbëdhjetë cent).
28. Më 28 prill 2010, Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përmes Aktvendimit [GJPP 181/2009] urdhëroi bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të H.H. në institucionet financiare në Kosovë në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve. Ky Aktvendim theksonte se: *“Duke pasur parasysh faktin se H.H. ishte i dyshuar në këtë rast së bashku me të dyshuarit tjerë, prandaj ekziston dyshimi i arsyeshëm se paratë në llogaritë bankare burojnë nga kryerja e veprës penale [...]”*.
29. Më 28 maj 2010, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përmes Aktvendimit [GJPP 181/2009] urdhëroi vendosjen e masës së përkohshme për sigurim të pasurisë, konform paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 247 dhe paragrafit 1 të nenit 489 [Procedura për Konfiskim] të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin në vijim: KPPPK) dhe paragrafit 1 të nenit 60 [Marrja e sendit] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin në vijim: KPPK).

30. Më 4 maj 2011, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përmes Aktvendimit [GJPP 181/2009] urdhëroi konfiskimin e përkohshëm të pronës së paluajtshme të H.H.-së.
31. Më 28 qershor 2017, Gjykata Themelore – Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [PKR.nr.642/15], ndër tjerash dhe për atë që është relevante për këtë rast, shpalli fajtor K.P. për kryerjen e disa veprave penale. Në kuadër të këtij aktgjykimi, Prokuroria Speciale më 31 mars 2016, kishte propozuar edhe konfiskimin e aseteve të cilat udhëhiqen në emrin e të ndjerit H.H. Megjithatë, Gjykata Themelore me rastin e vendosjes sa i përket konfiskimit të këtyre aseteve/pasurisë, ka konsideruar se kjo pasuri nuk ishte objekt i akuzës, i ndjeri H.H. nuk është pjesë e këtij procesi penal dhe se prokurori nuk ka kërkuar e as zhvilluar veprime procedurale për konfiskimin e këtyre aseteve ashtu siç e kërkojnë kompetencat e zgjeruara për konfiskim të përcaktuara me ligj.
32. Më 2 tetor 2017, PSRK, paraqiti propozim për lejimin e procedurës së konfiskimit të aseteve të përfituara me aktivitet kriminal [PPS.nr.22/2009], kundër të vdekurit H.H., sa i përket konfiskimit të pronës së paluajtshme në emër të tij dhe shumën e parave që gjendeshin në llogaritë e tij bankare.
33. Me 16 janar 2018, PSRK, pas pranimit të Aktgjykimit [PSKR.nr.486/2017] të 20 nëntorit 2017, të Gjykatës së Apelit, përsëri paraqiti propozim për lejimin e procedurës së konfiskimit të aseteve të përfituara me aktivitet kriminal [PPS.nr.22/2009], kundër të vdekurit H.H., sa i përket konfiskimit të paluajtshme në emër të tij dhe shumën e parave që gjendeshin në llogaritë e tij bankare. Propozimin për lejimin e procedurës së konfiskimit të aseteve të përfituara me aktivitet kriminal PSRK e paraqiti duke u bazuar në Ligjin e kontestuar 1.
34. Me 26 nëntor 2018, Gjykata Themelore me Aktvendimin [PKR.nr.1/17], aprovoi propozimin e PSRK për lejimin e vazhdimin të procedurës së konfiskimit kundër të vdekurit H.H. Gjithashtu u vazhdua procedura penale kundër të vdekurit H.H. *ex relatione* për asetet që janë objekt i konfiskimit.
35. Më 30 nëntor 2018, pala e interesuar paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal.

36. Me 17 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PN.nr.1240/2018], refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së interesuar të paraqitur kundër aktvendimit të shkallës së parë me arsyetimin se “[Gjykata e shkallës së parë, drejt ka vepruar kur ka aprovuar kërkesën e PPSRK-se, PPS.nr.22/2009, të dt.16.01.2018, për lejimin e vazhdimit të procedurës së konfiskimit kundër tani të vdekurit H.H, ex relation, për asetet që janë objekt i konfiskimit, [...]”.
37. Më 24 dhjetor 2018, pala e interesuar paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.
38. Më 26 mars 2019, Gjykata referuese, përkatësisht Gjykata Supreme, pezulloi rastin para saj dhe, bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, dorëzoi në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të nenit 5 paragrafi 2, Nenit 7 paragrafëve 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar 1, dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafëve 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar 2.
39. Më 14 tetor 2020, Gjykata referuese, pavarësisht faktit se rasti ishte dërguar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, nxorri Aktvendimin Pml.nr.3/2019 përmes së cilit e hodhi poshtë si jo lëndore kërkesën e palës së interesuar për mbrojtje të ligjshmërisë. Specifikisht, Gjykata Supreme konstatoi se: *“kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit Visar Haxhibeqiri përfaqësues i palëve të interesuara trashëgimtarëve ligjor të tani të ndjerit H.H., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Renda PKR.nr.1/17 të datës 26.11.2018, dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1240/18 të datës 17.12.2018, **hudhet si jo lëndore.**”*
40. Më 27 tetor 2020, e njëjta Gjykatë referuese, pak kohë pasi që kishte hedhur poshtë si jolëndore kërkesën e palës së interesuar për mbrojtje të ligjshmërisë, kërkoi nga Gjykata që *“sipas rregullit 35 të Rregullores së punës, të vlerësoj nevojën e procedimit të mëtutjeshme të këtij rasti.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Gjykata referuese pretendon se neni 5 paragrafi 2, neni 7 paragrafët 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar 1, dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 1, si dhe paragrafët 7 dhe 8 të Ligjit të

kontestuar 2, nuk janë në pajtueshmëri me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës.

42. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht shpreh dyshimet sa i përket paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga pala e interesuar, pasi që *"[...sipas nenit 432. paragrafi 1. të KPPK, kjo kërkesë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka parapri marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë]"*.
43. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, çështja e parë nga e cila varet vendimi është se a është paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit i cili është marrë në procedurën penale në formë të prerë.
44. Gjykata referuese thekson që në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK) bëhet fjalë për personin e gjallë, përkatësisht në nenet 19.3 deri në 19.6 jepen përkufizimet për personin e dyshuar, të pandehur, të akuzuar dhe të dënuar, por edhe në të gjitha dispozitat e tjera, gjithnjë flitet për personin e gjallë. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës thekson që konform dispozitës së nenit 160 të KPPK kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, prokurori i shtetit merr aktvendim për pushimin e procedurës penale. Prandaj, parashtruesi i kërkesës shpreh dilemat në të kuptuarit e dispozitave të nenit 5.2 të Ligjit të kontestuar 1 sipas së cilave *"pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e cila është fituar nga i pandehuri i cili ka vdekur mund ti nënshtrohet konfiskimit nga neni 7 i këtij ligji"*.
45. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon që sipas dispozitave të nenit 7.3, 7.4 dhe 7.5 të Ligjit të kontestuar 1, ndaj personit të vdekur mund të ngritët aktakuzë, të caktohet mbrojtësi dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor, që është në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së.
46. Çështja e dytë, që njëkohësisht paraqet edhe dilemën e dytë të Gjykatës referuese dhe nga e cila varet vendimi i saj, konsiston në atë se a është paraqitur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga personi i autorizuar.
47. Sipas Gjykatës referuese, kjo kërkesë nuk është paraqitur nga personat e autorizuar të përcaktuar me nenin 433 paragrafi 1 të KPPK-së, ku përfshihen Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Gjithashtu, Gjykata referuese vë theksim të veçantë tek kjo dispozitë ku përcaktohet që 'pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë në emër të tij

mund të paraqesin personat e paraparë me nenin 424 paragrafi 1 fjalë e fundit e këtij Kodi, ku përfshihen: prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit’.

48. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës referuese, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ka paraqitur mbrojtësi që i është caktuar personit të vdekur, ndaj të cilit nuk ka procedurë penale dhe nuk ka pas procedurë penale as derisa ka qenë i gjallë.
49. Përfundimisht, si pretendim kryesor Gjykata referuese e paraqet dyshimin e saj përkitazi me çështjen si në vijim: se pasi që personi i vdekur sipas dispozitave të kontestuara e merr statusin e të akuzuarit, Gjykata referuese shpreh dyshim për përputhshmërinë e këtyre dispozitave me nenin 30 të Kushtetutës, sepse është e qartë se një person i vdekur nuk mund të ketë mbrojtës e as ti gëzojë këto të drejta, ndërsa në anën tjetër, akuzimi dhe gjykimi do të kenë pasojë për trashëgimtarët e tij, edhe pse ata janë persona ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuzë e as zhvilluar procedurë penale.
50. Gjykata referuese gjithashtu arsyeton që në kohën e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, ka qenë në fuqi Ligji i kontestuar 1, ndërsa nga 10 janari 2019 në fuqi është Ligji i kontestuar 2. Megjithatë, sipas Gjykatës referuese dispozitat me interes për rastin në fjalë nuk janë ndryshuar, kështu që nenet 5.2, 7.3, 7.4 dhe 7.5 të Ligjit të kontestuar 1 janë identike me dispozitat e neneve 19.1.1, 19.2.1, 19.7 dhe 19.8 të Ligjit të ri (Ligjit të kontestuar 2).
51. Në fund, Gjykata referuese thekson që pasi që vendimi meritohet i saj është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me normat ligjore të Ligjeve të kontestuara, rrjedhimisht ata nuk mund të vendosin për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, deri sa Gjykata të marrë vendim meritohet i lidhur me këtë kërkesë.

Komentet e palës së interesuar

52. Pala e interesuar, fillimisht shpreh habinë e saj për qëllimin e kërkesës së paraqitur në Gjykatë, pasi që sipas saj kjo kërkesë nuk trajton problematikën e ngritur përmes mjeteve juridike në këtë procedurë.
53. Sa i përket pretendimit të parë të Gjykatës referuese lidhur me çështjen nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur kundër vendimit i cili është marrë në procedurë penale, si vendim i formës së prerë, pala e interesuar thekson që vendimet gjyqësore të

kontestuarra prej saj paraqesin vendimmarrje meritore (edhe pse të gabuar) dhe jo aktvendime procedurale. Sipas tyre, ky vendim i pritur i Gjykatës referuese për aprovimin ose jo të propozimit të Prokurorit të Shtetit, është me pasoja të drejtpërdrejta nëse do të ketë procedurë penale me objekt konfiskimin e pasurisë ose jo.

54. Prandaj, sipas palës së interesuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [PN.nr.1240/2018] i 17 dhjetorit 2018, është i formës së prerë dhe se i njëjti sipas nenit 432, paragrafi 1 të KKPPK-së mund të goditet me mjetin e jashtëzakonshëm juridik.
55. Sa i përket pretendimit të Gjykatës referuese lidhur me atë se *‘sipas dispozitave të nenit 7.3, 7.4 dhe 7.5 të Ligjit të kontestuar 1, ndaj personit të vdekur mund të ngritët aktakuzë, të caktohet mbrojtësi dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor, që është në kundërshtim me dispozitat e KPPKJ’* pala e interesuar thekson që neni 5 paragrafi 2 i Ligjit të kontestuar 1 qartazi shpreh se pasuria mund t’i nënshtrohet konfiskimit nga neni 7 dhe se ky nënshttrim nuk është automatik dhe i pakushtëzuar, por vjen si rezultat i plotësimit të disa kushteve ligjore të përcaktuara. Pala e interesuar pretendon se për të ngritur aktakuzë sipas kësaj dispozite ligjore, aktakuza nuk ngritët ndaj të pandehurit që ka vdekur, por ndaj të pandehurit që ka vdekur *ex relatione* për pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit. Pra, objekt i akuzës në këtë rast, nuk është i pandehuri që ka vdekur, por pasuria e tij.
56. Më tej pala e interesuar e shpreh shqetësimin për sa i përket shkeljeve procedurale të bëra nga dy instancat e gjykatave të rregullta të cilat kanë vendosur për *‘vazhdimin e procedurës’*, që sipas palës së interesuar *‘nuk ka filluar asnjëherë’*, pasi që tanimë i ndjeri H.H. nuk e ka pasur asnjëherë statusin e të dyshuarit, pandehurit, të akuzuarit apo të dënuarit në procedurë penale.
57. Sa i përket çështjes së dytë të ngritur nga Gjykata referuese, lidhur me atë se a është paraqitur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga personi i autorizuar, pasi që e njëjta është *“[...paraqitur nga mbrojtësi që i është caktuar personit të vdekur...]”*, pala e interesuar thekson që *“[Fillimisht, kërkesa nuk është paraqitur nga mbrojtësi që i është caktuar personit të vdekur. Personi i vdekur nuk mund të ketë mbrojtës për shkak të shuarjes së subjektivitetit të tij dhe këto të drejta nuk u përkasin personave të vdekur]”*.
58. Për më tepër, pala e interesuar thekson se kontestimi i legjitimitetit të tyre si parashtrues të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ka pasoja fatale me efekt të drejtpërdrejtë në shkelje të të drejtave kushtetuese, si në vijim: *“[Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] - ku janë shkelur*

parimet themelore të drejtave të njeriut ne futje në procedurë penale, në kundërshtim me KPPK; 2. Neni 23 [Dinjteti i Njeriut] - prishja e imazhit, humbja e dinjtetit, poshtërimi përmes zhvillimit të procedurave gjyqësore në kundërshtim me ligjet e aplikueshme, vendimeve arbitrare në shkelje të vazhdueshme të ligjit penal e procedural; 3. Neni 24 [Barazia para Ligjit] - ku diskriminimi është shprehur nga institucionet e vendit si Prokuroria e Shtetit dhe Gjykatat, duke tentuar në marrjen e pronës së ligjshme nën tendencën e krijimit të procedurave fiktive gjyqësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore ne fuqi; 4. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] - ku në rastin në fjalë nuk është siguruar as minimalisht mbrojtje e të drejtave në procedurë para gjykatave dhe Prokurorisë së shtetit, në mohim të njohjes me shkresat e lëndës në këtë çështje penale pavarësisht kërkesës së paraqitur me shkrim gjykatës, nën marrjen e veprimeve arbitrare dhe të njëanshme me qëllime të panjohura në dëm të integritetit të personave, dinjtetit e në tentim të marrjes së pronës private; 5. Neni 36 [E Drejta e Privatësisë] - me publikimin e vazhdueshëm të të dhënave personale financiare dhe shpërndarjes së informacioneve private në publik, lidhur me pasuritë e paluajtshme të cilat asnjëherë nuk kanë qenë ligjërisht objekt i ndonjë çështjeje penale; 6. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] - privimi nga e drejta e pronës, cenimi arbitrar i disponimit të lirshëm të pronës private]”.

59. Bazuar në elaborimet e mësipërme, pala e interesuar, përfundimisht kërkon nga Gjykata që ta shpallë kërkesën si qartazi të pabazuar sepse dispozitat e Ligjit të kontestuar 1 dhe Ligjit të kontestuar 2 nuk cenojnë në asnjë masë asnjë të drejtë kushtetuese të përcaktuar me nenin 30 të Kushtetutës.
60. Në fund, pala e interesuar kërkon nga Gjykata që të bëjë vlerësimin e ekzistimit të vetë çështjes penale të rastit në fjalë, nën rrethanat e mosplotësisht të kushteve ligjore për ekzistimin e të njëjtës, si procedurë e "vazhduar" pa filluar kurrë, për shkak të mungesës së aktvendimit për fillim të hetimeve, mungesës së statusit të palës në procedurë të të ndjerit H.H. si i pandehur, apo çfarëdo statusi tjetër, mungesën e urdhrave ndalues të lëshuar nga gjykata, mos përfshirja në aktin fillestar akuzues [PPS. nr. 22/2009] të pasurisë, që janë me pasojë të shkeljes së disa ligjeve të aplikueshme e me pasoja direkte për palët e interesuara në këtë procedurë.
61. Pala e interesuar ka paraqitur edhe 2 plotësime të komenteve të dhëna në Gjykatë. Më 27 dhjetor 2019, avokati i palës së interesuar theksonte se pas përfundimit të vlefshmërisë 30-ditore të Aktvendimit [GJPP 181/2009] të 4 majit 2011, as prokuroria e as gjykata nuk ka lëshuar

ndonjë urdhër apo vendim gjyqësor për ngrirje, sekuestrim apo çfarëdo mase tjetër që do të pengonte administrimin e lirshëm të kësaj prone nga ana e tyre. Pala e interesuar i ofroi Gjykatës komunikime të Drejtorisë së Kadastrit të Komunës së Prishtinës dhe Prokurorisë Speciale, ku kjo e fundit përmes zëdhënësit të saj kishte deklaruar se *“Ndërsa Prokuroria Speciale ka vlerësuar se nuk ka bazë ligjore për të ushtruar aktakuzë kundër të ndjerit, H.H., ex relation, ngase i njëjti nuk e ka pas asnjë herë cilësinë e të pandehurit deri sa ka qenë gjallë. Andaj, në mungesë të aktakuzës gjykata do të duhet të lëshoj ndonjë vendim lidhur me këtë çështje”*.

62. Plotësimi i dytë i komenteve të palës së interesuar u parashtrua më 4 mars 2020, ku theksi vendosej tek shkresa e Prokurorisë [PPS.nr.22/09] e 27 shkurtit 2020, drejtuar Gjykatës Themelore – Departamentit për Krime të Rënda ku theksohej se Prokuroria heqte dorë nga propozimi për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfutur me vepër penale ndaj të pandehurit të vdekur H.H. ex relation. Përmes kësaj shkrese Prokuroria Speciale theksonte që *“Duke vlerësuar faktin, se nga shkresat e lëndës rezulton se H.H, derisa ka qenë në jetë nuk ka pasur cilësinë e të pandehurit, ndërsa bazuar në Ligjin nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfutur me Vepër Penale, aktakuza mund të paraqitet ndaj të pandehurit të vdekur ex relation, kjo prokurori nuk ka paraqitur Aktakuzë në afatin prej 180, andaj konsiderojmë se nuk ka bazë ligjore as për vazhdimin e procedurës së konfiskimit tutje, për këtë arsye heqim dorë nga propozimi [PPS.nr. 22/09] i datës 16.01.2018 për vazhdimin e procedurës penale të konfiskimit të aseteve të përfutur me vepër penale, kundër të vdekurit H.H”*.

Pranueshmëria e kërkesës

63. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 8, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

2. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

(...)

8. *Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse*

ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.”

65. Më tutje, Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, që përcaktojnë:

*Neni 51
Saktësimi i kërkesës*

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë se cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

*Neni 52
Procedura para Gjykatës*

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

*Neni 53
Vendimi*

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

66. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 77 të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit]

(1) Kërkesa e ngritur sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit.

(2) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë një kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

(c) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata në lidhje me çështjen në pritje; dhe

(d) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin lidhur me rastin në pritje të gjykatës.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën. Dokumenti i shqyrtuar nga Gjykata i bashkëngjitet kërkesës.

(4) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në rast dhe pavarësisht nëse një palë në rast ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

(5) Pas parashtrimi të kërkesës, Gjykata urdhëron gjykatën referuese që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë derisa të merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

67. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar sipas nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:

- (1) Kërkesa të jetë dorëzuar nga një "gjykatë";*
- (2) Ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj;*
- (3) Gjykata referuese duhet të mos jetë e sigurtë për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën;*
- (4) Gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën;*
- (5) Ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim.*

68. Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore e cila konfirmon kriteret e lartpërmendura, përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave të paraqitura në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO157/18, parashtrues:

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafët 41-46; KO126/16, parashtrues: *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, të 27 marsit 2017, paragrafi 62, si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KO142/16, parashtrues: *Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, të 9 majit 2017, paragrafi 58).

69. Kriteret e lartcekura duhet të përmbushen, të gjitha në mënyrë kumulative, në mënyrë që një kërkesë e dorëzuar, bazuar në nenin 113.8, të shqyrtohet në merita. Në rast se ndonjëri prej këtyre kriterëve nuk plotësohet, atëherë kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shqyrtim në merita për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të vlerësojë plotësimin e kriterëve të lartcekura.

(1) Nëse kërkesa është dorëzuar nga një “gjykatë”

70. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesa është dorëzuar nga Gjykata Supreme dhe është nënshkruar nga kryetari i saj, në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij. Kërkesa, në momentin e dorëzimit, theksonte qartë se ajo paraqitet nga Gjykata Supreme e cila duhet të vendosë për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar nga pala e interesuar.
71. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme është dorëzuar nga “gjykata” në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës dhe në kuptim të praktikës së lartcekur gjyqësore të kësaj Gjykate.

(2) Nëse Ligjet e kontestuar duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj

72. Gjykata rikujton se ky kriter kërkon që Ligji ose Ligjet e kontestuar duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastin që ajo ka në shqyrtim; dhe se Gjykata referuese duhet të ketë një rast aktiv që po pret shqyrtim. Pra, para Gjykatës referuese duhet të ekzistojë një rast i pazgjidhur i cili është pezulluar deri në vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me kushtetutshmërinë e Ligjit që dyshohet të mos jetë në përputhje me Kushtetutën.
73. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se ky kriter nuk plotësohet, siç do të sqarohet në vijim.

74. Gjykata rikujton që Gjykata Supreme në cilësi të Gjykatë referuese, ka dorëzuar kërkesën e tanishme pranë kësaj Gjykate, duke kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë së dy Ligjeve të kontestuara nën dyshimin se dispozitat e caktuara të tyre mund të mos jenë në pajtim me Kushtetutën.
75. Megjithatë, gjatë kohës kur Gjykata Kushtetuese ishte duke e shqyrtuar rastin, ajo është njoftuar nga pala e interesuar se PSRK ka hequr dorë nga aktakuza që ka të bëjë me thelbin e rastit pranë Gjykatës referuese. Me atë rast, ishte kërkuar nga Gjykata që kërkesa të refuzohet dhe të mos shqyrtohet tutje meqë nuk ka më rast aktiv para Gjykatës Supreme.
76. Duke qenë se Gjykata nuk kishte një informacion të tillë zyrtar nga Gjykata Supreme si Gjykatë referuese, ajo iu drejtua PSRK-së fillimisht për të konfirmuar se a është hequr dorë nga aktakuza në fjalë. PSRK përmes shkresës e konfirmoi një gjë të tillë. Më pas, Gjykata kërkoi nga Gjykata referuese të njoftojë Gjykatën rreth statusit të rastit para saj (shih pjesën e procedurës para Gjykatës ku reflektohet komunikimi i Gjykatës me palën e interesuar, PSRK-në dhe Gjykatën Supreme).
77. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton sqarimin që ka pranuar nga Gjykata referuese përkitazi me ndryshimet në statusin e rastit para saj. Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën se veçse ka vendosur për rastin dhe në këtë aspekt gjithashtu theksoi se: *“Gjykata Supreme e Kosovës me heqjen dorë nga propozimi i prokurorisë kompetente [PSRK] nga rasti nuk ka kompetencë të mëtutjeshëm për vazhdimin e procedurës penale sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe rrjedhimisht vendimi i kësaj gjykate për rastin konkret nuk varet nga përputhshmëria Ligjit nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë të Përfitur me Vepër Penale. Andaj, propozoj që Gjykata Kushtetuese sipas rregullit 35 të Rregullores së Punës, të vlerësoj nevojën e procedimit të mëtutjeshme të këtij rasti”*.
78. Nga faktet e rastit rezulton se më 14 tetor 2020 Gjykata referuese kishte zgjidhur rastin që kishte para saj. Këtë zgjidhje ose përfundim të rastit Gjykata Supreme e kishte bërë përmes nxjerrjes së Aktvendimit Pml.nr.3/2019, ku kishte hedhur poshtë kërkesën e palës së interesuar për mbrojtje të ligjshmërisë – nën arsyetimin se pas tërheqjes së PSRK-së nga aktakuza nuk kishte më kompetencë të vazhdonte procedurën penale.
79. Gjykata rikujton qëndrimin e saj që Gjykata mund të vendosë për kërkesat që ndërlidhen me nenin 113.8 të Kushtetutës vetëm nëse para

Gjykatës referuese ka një rast aktiv në pritje të zgjidhjes dhe ku *“vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit”* të kontestuar. Siç u shpjegua më lart, para Gjykatës referuese nuk ka më rast aktiv ngase kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë për vendosjen e së cilës ishte pezulluar procedura gjyqësore deri në një vendim të Gjykatës Kushtetuese – tashmë është zgjidhur si çështje nga Gjykata Supreme.

80. Gjykata Kushtetuese është vënë në dijeni të ekzistencës së Aktvendimit [Pml.nr.3/2019] të 14 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme vetëm pasi që kishte pyetur Gjykatën Supreme specifikisht për statusin e rastit, pas informatave për zhvillime procedurale që kishte pranuar nga pala e interesuar.
81. Gjykata vë theks në faktin se Gjykata Supreme si Gjykatë referuese e ka pasur për obligim që ta njoftoj Gjykatën me kohë për të gjitha zhvillimet procedurale që kanë ndodhur në këtë rast dhe ta përditësojë kërkesën e dorëzuar në Gjykatë me këto informata relevante, pa vonesë.
82. Gjykata Supreme nuk ka mund të vendosë për rastin që veçse e ka referuar në Gjykatën Kushtetuese para se të bënte kërkesë për tërheqje të rastit nga procedurat shqyrtuese në Gjykatën Kushtetuese. Kjo për faktin se neni 52 i Ligjit thotë qartë që: *“Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.”* Kjo nënkupton që neni 52 i Ligjit parasheh suspendim *ex lege* të procedurës në momentin që ngritët një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës.
83. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se kriteri i pranueshmërisë sipas së cilit Ligjet e kontestuar duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj, nuk plotësohet në rrethanat e rastit konkret meqë pranë Gjykatës referuese nuk ka rast aktiv dhe të pazgjidhur.
84. Duke qenë se ky kriter nuk plotësohet, Gjykata nuk e sheh të nevojshëm shqyrtimin e mëtejme të kriterëve të tjera të pranueshmërisë.
85. Si përfundim, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenet 20, 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe rregullin 77 të Rregullores së punës, Gjykata e deklaroi kërkesën KO50/19 si të papranueshme për shqyrtim të mëtejme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës, neneve 20, 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe rregullin 77 të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

**KI35/18 Parashtrues: “Bayerische Versicherungsverband”,
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
të Kosovës E.Rev.nr.18/2017, të 4 dhjetorit 2017**

KI35/18, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, publikuar më 10 janar 2020

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, person juridik, shkelje e të drejtave kushtetuese, neni 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm*

Si pasojë e një aksidenti të shkaktuar nga i siguruari i INSIG në vitin 2007, i siguruari i parashtruesit të kërkesës, H.H., kishte pësuar dëme materiale. Më 12 maj 2009 parashtruesi i kërkesës ushtroi padi pranë Gjykatës Themelore. Shuma e kompensimit prej 10.500 euro në emër të borxhit kryesor, u miratua nga të gjitha gjykatat e rregullta. Kontestuese përgjatë procedurave para gjykatave të rregullta ishte lartësia e kamatëvonesës dhe mënyra e llogaritjes së saj.

Gjykata Themelore fillimisht kishte përcaktuar kamatëvonesën në lartësinë prej 20% në vit duke filluar nga 12 maji 2009 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar këtë Aktgjykim duke e përcaktuar kamatën *“që e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar”* me një dënim shtesë (i) prej 20% duke filluar nga data 12 maj 2009 (data e paraqitjes së padisë), deri më 29 korrik 2011 (hyrja në fuqi e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia) ndërsa (ii) duke filluar nga data 30 korrik 2011 e deri në pagesën definitive, vetëm kamatëvonesën prej 12% të normës së kamatës vjetore, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Në fund, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [E.Rev.Nr.18/2017] të 4 dhjetorit 2017, kishte ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta përkitazi me kamatëvonesën dhe kishte përcaktuar si detyrim për INSIG kamatëvonesën *“në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit”* nga data 3 gusht 2015 (data në të cilën ishte bërë ekspertiza), e deri në pagesën definitive.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor, dhe në cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse sipas tij, Gjykata Supreme në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi kishte vepruar edhe në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore në të paktën shtatë (7) raste të cilat ai i kishte dorëzuar në Gjykatë në mbështetje të argumenteve të tij.

Në shqyrtimin e meritave të rastit, Gjykata elaboroi (i) praktikën gjyqësore lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, si dhe kriteret përkatëse bazuar në të cilat, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vlerëson nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjenca në praktikën gjyqësore përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshirë nëse: (a) divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (b) ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla dhe (c) ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti.

Gjykata, duke i aplikuar parimet dhe kriteret e lartpërmendura, konstatoi se Aktgjykimi [E.Rev.nr. 18/2017] i 4 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(i) *sa i përket mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor:*

Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit [E.Rev.nr. 18/2017] të 4 dhjetorit 2017, ka dështuar të arsyetoj pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e saj përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës së caktuar dhe momentin prej të cilit rrjedh llogaritja e kamatëvonesës; dhe

(ii) *sa i përket parimit të sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme:*

Gjykata përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës së aplikueshme në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, duke aplikuar tri kriteret e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstatoi se në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme ka “*dallime të thella dhe afatgjata*”, sepse në në të paktën nëntë (9) raste, brenda një periudhe pesë (5) vjeçare, Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat ligjore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës në mënyrë divergjente. Për më tepër, Gjykata theksoi se përkundër faktit që mekanizmat për sigurimin e konsistencës në praktikë gjyqësore janë të përcaktuar në ligjet përkatëse, ky mekanizëm nuk ishte përdorur nga Gjykata Supreme.

Ndërsa, sa i përket aplikimit të dispozitave ligjore që ndërlidhen me momentin prej të cilit fillon llogaritja e kamatëvonesës, Gjykata vlerësoi se devijimi i Gjykatës Supreme nga praktika gjyqësore në këtë aspekt, është rast

i izoluar dhe i cili nuk mund të kalojë testin e përcaktuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të konstatuar “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën përkatëse gjyqësore.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI35/18

Parashtrues

“Bayerische Versicherungsverband”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës E.Rev.nr.18/2017, të 4 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimeve “*Bayerische Versicherungsverband*” me seli në Munih të Gjermanisë, e përfaqësuar nga ICS Assistance LLC, përmes Visar Morinës dhe Besnik Z. Nikqit, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr.18/2017] të 4 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ae.nr.12/2016] e 6 qershorit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [III.C.nr.626/2013] e 30 tetorit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 26 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 21 mars 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës edhe Gjykatës Supreme.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 12 tetor 2018, Gjykata dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai bashkëngjitjen e kopjes së padisë, përgjigjes në ankesë dhe përgjigjes në revizion nga ana e tyre në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Në po të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Kompaninë e Sigurimeve “INSIG” (në tekstin e mëtejme: INSIG) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi bashkëngjitjen e revizionit të parashtruar në procedurat pranë gjykatave të rregullta.
12. Më 16 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
13. Më 2 nëntor 2018, Kompania e Sigurimeve “INSIG”, bashkëngjiti dokumentin e kërkuar si dhe dorëzoi në Gjykatë komentet përkatëse.
14. Më 30 nëntor 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin Nr.GJR.35/18 për përcaktimin e Kolegjit të ri shqyrtues dhe ky i fundit u përcaktua në përbërje të: Arta Rama-Hajrizit (kryesuese), Bajram Ljatifit dhe Remzije Istrefi-Pecit.
15. Më 19 prill 2019, parashtruesi i kërkesës përmes një shkrese njoftoi Gjykatën për pranimin e Aktgjykimit të Gjykatës të 15 prillit 2019 në rastin KI87/18 të cilin para Gjykatës e kishin parashtruar përfaqësuesit e njejtë si të parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar nga Gjykata trajtimin e rastit KI35/18 me prioritet me arsyetimin se: “[...] kemi të bejmë me të njejtën çështje, për më tepër Kërkesë Individuale të mëhershme dhe me interes që të evitohet mundësia që aktgjykimet e atakuara të Gjykatës Supreme të shërbejnë si precedent[...].”
16. Më 6 nëntor 2019, Gjyqtarja Raportuese prezentoj raportin paraprak para Kolegjit shqyrtues dhe njëzëri u vendos që vendimarrja përkitazi me rastin të shtyhet për një seancë të radhës.
17. Më 8 nëntor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.

18. Më 11 nëntor 2019, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.
19. Më 11 dhjetor 2019, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
20. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë konstatoi se (ii) Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme, nuk është në përpuethshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Gjyqtari Nexhmi Rexhepi votoi kundër këtij konstatimi.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 4 qershor 2007, personi H.H i cili ishte i siguruar tek parashtruesi i kërkesës, kishte pësuar aksident komunikacioni të shkaktuar nga një i siguruar i INSIG në Prishtinë. Personi H.H, përkatësisht i siguruari i parashtruesit të kërkesës, ishte kompensuar nga ky i fundit në shumën prej 10.500 euro.
22. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se më 12 maj 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi pranë Gjykatës Themelore.
23. Sipas shkresave të lëndës gjithashtu rezulton se më 10 mars 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktgjykimit [IV.C.nr503/2010] e kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar. Kundër këtij Aktgjykimi, e padituara, përkatësisht INSIG, kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.233/2012] të 24 tetorit 2013, duke e aprovuar ankesën, e kishte kthyer çështjen në rivendosje.
24. Më 30 tetor 2015, në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.C.nr.626/2013], (i) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi INSIG t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën e kompensimit prej 10.500 Euro, së bashku me kamatën ndëshkuese prej 20% në vit, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, përkatësisht 12 maji 2009 e deri në pagesën definitive; dhe (iii) e detyroi INSIG të paguante dhe shpenzimet e procedurës. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj, arsyetoi përcaktimin e kamatës ndëshkuese prej 20% duke u bazuar në nenin 277 (Kamatëvonesa) të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejme: LMD) dhe nenin 5 (Regullimi i

dëmeve) të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (në tekstin e mëtejme: Rregulli 3).

25. Në një datë të paspecifikuar, INSIG parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë dhe propozoi që ankesa e INSIG të shpallet e pabazuar.
26. Më 6 qershor 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.12/2016], refuzoi si të pabazuar ankesën e INSIG dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (i) përkitazi me borxhin kryesorë mbi bazën e subrogimit në shumën prej 10,500 euro, ndërsa ndryshoi Aktgjykimin përkatës (ii) përkitazi me kamatën ndëshkuese, duke detyruar INSIG që të paguajë kamatën *“që e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar”* me një dënim shtesë prej 20% prej datës 12 maj 2009 deri më 29 korrik 2011, ndërsa duke filluar nga data 30 korrik 2011 e deri në pagesën definitive, vetëm kamatëvonesën prej 12% të normës së kamatës vjetore. Gjykata e Apelit sqaroi se zbritja e kamatëvonesës prej 20% në 12% pas 30 korrikut 2011, është rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/Lo-18 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (në tekstin e mëtejme: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm).
27. Më 14 korrik 2017, INSIG parashtroi revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe Aktgjykimet e gjykatave më të ulta të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje. INSIG më specifikisht, kontestoi shumën e kamatëvonesës, përkatësisht momentin prej të cilit e njëjta ishte llogaritur, duke theksuar se Gjykata e Apelit gabimisht ka aplikuar dispozitën ligjore, përkatësisht nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, me rastin e zbritjes së kamatës prej 20% dhe 12% nga data e paraqitjes së padisë sepse sipas pretendimit, *“kjo vlen vetëm atëherë kur të dëmtuarit nuk i kthehet përgjigja në afat prej 60 ditësh”*. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në revizion duke propozuar që (i) revizioni përkatës të shpallet i palejuar mbi bazën e paragrafit 2 të nenit 214 të Ligjit 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së);

dhe (ii) të shpallen të pabazuara pretendimet e INSIG përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatës së Apelit, sepse, sipas pretendimit, kjo e fundit kishte vepruar drejt kur kishte arsyetuar vendimin e saj bazuar në nenin 5 të Rregullit 3 dhe nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

28. Më 4 dhjetor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.Nr.18/2017] e (i) refuzoi si të pabazuar revizionin e INSIG përkitazi me borxhin kryesor mbi bazën e subrogimit; ndërsa (ii) pranoi si të bazuar revizionin përkitazi me kamatëvonesën, duke e detyruar INSIG që të paguaj kamatëvonesën *“në lartësi të depozitimeve kursimore të paqfatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit”* nga data 3 gusht 2015, përkatësisht data në të cilën ishte bërë ekspertiza, e deri në pagesën definitive. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi:

“...[Parashtruesit të kërkesës] borxhi duhet t'i paguhet me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 3.8.2015, (dita e ekspertizës) e deri në pagesën definitive sepse dispozita e nenit 26. 6 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (Ligji nr. 04L-018) ku parashihet kamata prej 12%, e as dispozita e nenit 5.5 të Rregullës 3 të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) Rregulla mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto-përgjegjësisë datë 1.10.2008, nuk gjejnë zbatim në rastin konkret sepse nga shkresat e lëndës nuk ka prova se [parashtruesi i kërkesës] i është drejtuar [INSIG] me kërkesë për dëmshpërblim jashtë-gjyqësor për të cilën [INSIG] të mos e ketë trajtuar dhe në kë mënyrë të bie në vonesë. Për më tepër ky ligj nuk ka efekt prapaveprues sepse rasti ka ndodhur në vitin 2007 ndërsa ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendon shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme.

30. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme kur ka ndryshuar Aktgjykimin [Ae.nr.12/2016] e 6 qershorit 2017 të Gjykatës së Apelit, nuk ka saktësuar bazën juridike mbi të cilën e ka mbështetur vendimin e saj në lidhje me kamatëvonesën. Për më tepër që, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme kishte vepruar edhe në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore përkitazi me kamatëvonesën, në lidhje me të cilën, për dallim prej rastit konkret, ajo ka zbatuar Rregullin 3 dhe Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet shtatë (7) Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, si në vijim: (i) Aktgjykimit [E.Rev.nr.20/2014] të 14 prillit 2014; (ii) Aktgjykimit [E.Rev.nr.48/2014] të 27 tetorit 2014; (iii) Aktgjykimit [E.Rev.55/2014] të 3 nëntorit 2014; (iv) Aktgjykimit [E.Rev.62/2014] të 21 janarit 2015; (v) Aktgjykimit [E.Rev.nr.6/2015] të 19 marsit 2015; (vi) Aktgjykimit [E.rev.nr. 14/2016] të 24 marsit 2016; dhe (vii) Aktgjykimit [E.Rev.23/2017] të 14 dhjetorit 2017.
31. Parashtruesi i kërkesës specifikisht thekson se përmes Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme kishte përcaktuar kamatëvonesën “*në lartësi të depozitimeve të paqfatuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit*”, duke mos arsyetuar (i) as bazën ligjore mbi të cilën është përcaktuar kjo kamatëvonesë; dhe as (ii) devijimin nga praktika e saj gjyqësore përkitazi me kamatëvonesat.
32. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme gjithashtu ka dështuar të arsyetoj (i) përcaktimin e momentin prej të cilit INSIG kishte rënë në vonesë, përkatësisht datën e ekspertizës mekanike pa mbështetje ligjore, për dallim prej datës së parashtrimit të kërkesës për kompenzim, në lidhje me të cilën Gjykata Supreme kishte konstatuar se nuk ka prova që e njëjta është paraqitur, në kundërshtim me provat e administruara në shqyrtimin kryesor të 20 tetorit 2015; dhe (ii) nuk kishte arsyetuar efektin prapaveprues të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, përkundër nenit 43 (Shfuqizimi) të këtij ligji.
33. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës ka elaboruar parimet themelore të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor siç është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe rasteve të Gjykatës KI55/09, parashtrues *NTSH Meteorit*, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2010; KI 135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2015; KI138/15 parashtrues *Sharr Beteiligungs GmbH SHPK*, Aktgjykim i 4 shtatorit

2017; dhe KI97/16 parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017; si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) *Boldea kundër Rumanisë* (Aktgjykim i 15 shkurtit 2007); *Hiro Balani kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Ruiz Torija kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); dhe *Helle kundër Holandës* (Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997).

34. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij të shpallë të pranueshme, dhe të konstatoj që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të njëjtin shpall të pavlefshëm, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar “INSIG”

35. Më 2 nëntor 2018, INSIG dërgoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Sipas INSIG, Gjykata Supreme ka vendosur drejt lidhur me kamatëvonesën për faktin se parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur INSIG-ut kërkesë për kompensim dëmi ashtu siç parashihet me ligj. Më tutje, sipas INSIG Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore gabimisht kanë aplikuar dispozitat ligjore me rastin e caktimit të kamatës prej 20% dhe 12% sepse “*kjo vlen vetëm atëherë kur kërkuesit nuk i kthehet përgjigja për kërkesën për dëmin material në afat prej 60 dite*”. Në fund, INSIG i propozon Gjykatës që kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta refuzojë si të pabazuar.

Dispozitat përkatëse juridike

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

III. KAMATËVONESA

Kur ka debitim

Neni 277

(1) *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjës, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë.*

(2) *Për detyrimin në të holla të rezultuar nga kontrata në ekonomi kamatëvonesën e cakton Këshilli Ekzekutiv Federativ.*

(3) *Në qoftë se shkalla e kamatës kontraktuese është më e lartë nga sa shkalla e kamatësvonesës së parashikuar në paragrafin paraprak të këtij neni, ajo rrjedh edhe pas vonesës së debitorit.*

RREGULLI 3 MBI NDRYSHIMIN E RREGULLIT PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTO-PËRGJEGJËSIA

“Neni 5 Rregullimi i dëmeve

5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësise në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo nga fondi garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.

Fondi Garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk e rregullon dëmin valid brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabarte me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar”.

LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

Neni 26

Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:

1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë

kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar

kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

38. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

39. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridik. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtguesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
41. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E.Rev.nr.18/2017] e 4 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
42. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtguesit të kërkesës gjithashtu plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafi 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
43. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj. (Shih gjithashtu, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjyrimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat

44. Gjykata fillimisht rikujton që aksidenti kishte ndodhur në vitin 2007. Ai ishte shkaktuar nga i siguruari i INSIG, ndërsa i siguruari i parashtguesit të kërkesës, H.H., kishte pësuar dëme materiale. Gjykata gjithashtu thekson se sipas parashtguesit të kërkesës, me 12 maj 2009, është kërkuar riimbursimi përkatës nga INSIG, dhe duke marrë parasysh që nuk është arritur marrëveshje, i njëjti ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore më 19 mars 2010. Megjithatë, sipas të

gjitha gjykatave të rregulla, data 12 maj 2009, figuron sikur datë e ushtrimit të padisë në gjykatën përkatëse, dhe datë prej të cilës, gjykatat e rregullta, me përjashtim të Gjykatës Supreme, kanë llogaritur se INSIG ka rënë në vonesë, dhe rrjedhimisht ka filluar llogaritja e kamatëvonesës.

45. Më tej Gjykata rikujton, që çështja e parashtruesit të kërkesës, fillimisht ishte kthyer në rivendosje përmes Aktgjykimit [Ae.nr.233/2012] të 24 tetorit 2013 të Gjykatës së Apelit. Në rivendosje, të tri nivelet e gjykatave të rregullta kishin miratuar përmes Aktgjykimeve përkatëse shumën e kompensimit prej 10.500 euro në emër të borxhit kryesorë. Kjo shumë, sipas shkresave të lëndës, ishte konfirmuar edhe përmes ekspertizës së 3 gushtit 2015, dhe e cila ishte plotësuar edhe më 10 shtator 2015. E para përkatësisht, data 3 gusht 2015, është relevante, sepse përdoret nga Gjykata Supreme si datë prej të cilës duhet të llogaritet kamatëvonesa. Është kjo e fundit, përkatësisht llogaritja e kamatëvonesës, që është kontestuese përgjatë gjykatave të rregullta dhe pretendimi kryesorë i parashtruesit të kërkesës para Gjykatës.
46. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.C.nr.626/2013] të 30 tetorit 2015, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së dhe nenin 5 të Rregullit 3 përcaktoi kamatën ndëshkuese prej 20% në vit duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, përkatësisht 12 maji 2009 e deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.12/2016] të 6 qeshorit 2017, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, nenin 5 të Rregullit 3 dhe nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, përcaktoi kamatën *“që e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar”* me një dënim shtesë (i) prej 20% duke filluar nga data 12 maj 2009, si datë e paraqitjes së padisë, deri më 29 korrik 2011, datë kjo në të cilin kishte hyrë në fuqi Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm dhe bazuar në nenin 43 të tij, ishte shfuqizuar Rregulli 3; ndërsa (ii) duke filluar nga data 30 korrik 2011 e deri në pagesën definitive, vetëm kamatëvonesën prej 12% të normës së kamatës vjetore, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm. Ndërsa, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [E.Rev.Nr.18/2017] të 4 dhjetorit 2017, pranoi si të bazuar revizionin e INSIG-ut përkitazi me kamatëvonesën, dhe përcaktoi si detyrim për INSIG vetëm kamatëvonesën *“në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit”* nga data 3 gusht 2015, përkatësisht data në të cilën ishte bërë ekspertiza, e deri në pagesën definitive. Gjykata theksoi se (i) Rregulli 3 dhe Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nuk janë të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, sepse të njëjtat nuk ishin në

fuqi në vitin 2007 kur kishte ndodhur aksidenti dhe nuk kanë “efekt prapaveprues”, dhe (ii) “nga shkresat e lëndës nuk ka prova se [parashtruesi i kërkesës] i është drejtuar [INSIG] me kërkesë për dëmshpërblim jashtë-gjyqësor për të cilën [INSIG] të mos e ketë trajtuar dhe në këtë mënyrë të bie në vonesë”.

47. Megjithatë, Gjykata Supreme, nuk specifikoi dhe arsyetoi bazën ligjore mbi të cilën (i) kishte përcaktuar kamatëvonesën “në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit”; dhe (ii) datën e ekspertizës, përkatësisht 3 gushtin 2015, si datë prej të cilës llogaritej kamatëvonesa, përkundër Gjykatës Themelore dhe të Apelit e të cilat kishin përcaktuar datën e ushtrimit të padisë, përkatësisht 12 majin 2009, si datë prej të cilës INSIG kishte rënë në vonesë, dhe rrjedhimisht datë prej të cilës llogaritet kamatëvonesa.
48. Të lartcekurat, janë në esencë pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës, mbi bazën e të cilave pretendon se Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor, dhe për më tepër, në cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi kishte vepruar edhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të saj.
49. Këto dy kategori pretendimesh, mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe mungesën e konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me dispozitat ligjore mbi kamatëvonesat në kontekst të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, respektivisht, Gjykata do t’i shqyrtoj duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, dhe në vijim, Gjykata fillimisht do të i shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me (i) mungesën e vendimit të arsytimit gjyqësor, për të vazhduar me shqyrtimin e pretendimeve lidhur me (ii) mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme. Përkitazi me këtë të fundit, Gjykata fillimisht do të i shtjelloj parimet e përgjithshme, dhe me pas, do të i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

I. Për sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor

50. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, me parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019).
51. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
52. Gjykata gjithashtu rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, cituar më lart, paragrafi 61; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 58; KI 96/16 parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart,

paragrafi 52; dhe KI87/18 parashtues “IF Skadeforsikring”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 49).

53. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtuesit të kërkesës për mungesën e arsytimit përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme konsistojnë në (i) ndryshimin e kamatëvonesës së përcaktuar nga gjykatat më të ulta pa arsyetuar dhe pa përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën është përcaktuar kamatëvonesa e re; dhe (ii) përcaktimin e datës së ekspertizës dhe jo atë të ngritjes së padisë si datë prej të cilës llogaritet kamatëvonesa. Gjykata konsideron se këto dy çështje përbëjnë pretendime thelbësore të parashtuesit të kërkesës dhe të cilat rrjedhimisht duhet të kenë qenë të arsyetuara nga Gjykata Supreme.
54. Për të konstatuar nëse arsytimi i dhënë nga Gjykata Supreme përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata rikujton arsytimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin [E. Rev. nr.18/2017], ku theksohet si në vijim:

„[...] paditësit [parashtuesit të kërkesës] borxhi duhej t'i paguhet me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paqafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 03.08.2015(nga dita e ekspertizës), e deri në pagesën definitive sepse dispozita e nenit 26.6 e Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia (Ligji nr. 04/L-018), ku parashihet kamata prej 12% e as dispozita e nenit 5.5 të Rregullës 3 të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) Rregulla mbi Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto-përgjegjësisë datë 1.10.2008 nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, ngase nga shkresat e lëndës nuk ka prova se pala paditëse i është drejtuar të paditurës me kërkesë për dëmshpërblim jashtë-gjyqësor të cilin e paditura të mos e ketë trajtuar dhe në këtë mënyrë të bie në vonesë. Për më tepër ky ligj nuk ka efekt prapaveprues, sepse rasti ka ndodhur në vitin 2007 ndërsa ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2011.“

55. Në këtë kontekst, dhe siç është theksuar më lart, Gjykata vëren që Gjykata Supreme ka përjashtuar aplikueshmërinë e Rregullit 3 dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm në rrethanat e rastit konkret, duke arsyetuar se (i) të njëjtat nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti në vitin 2007; dhe (ii) nuk ka prova që parashtuesi i kërkesës i ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim të paditurit, përkatësisht INSIG. Mbi bazën e këtij arsytimi, Gjykata Supreme prishi Aktgjykimet e gjykatave më të ulta përkitazi me kamatëvonesën prej 20% dhe 12% respektivisht.

56. Gjykata në këtë kontekst vëren se Gjykata kishte konstatuar se lartësia e kamatëvonesës prej 12% siç është përcaktuar përmes nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe prej 20% siç është përcaktuar përmes nenit 5 të Rregullit 3, nuk janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret, sepse rregullativa përkatëse nuk ishte në fuqi në kohën e aksidentit në vitin 2007. Megjithatë, duke theksuar se nuk kishte prova që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për kompensim dëmi, Gjykata ishte bazuar në po rregullativën ligjore për të cilin kishte theksuar se nuk është e aplikueshme në kuptim të përcaktimit të lartësisë së kamatëvonesës. Gjykata rikujton që kërkesat për zhdëmtim, përkatësisht dëmshpërblim dhe afatet përkatëse janë të përcaktuara përmes nenit 5 të Rregullit 3 dhe nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.
57. Për më tepër, Gjykata vëren se në përcaktimin e kamatëvonesës “*në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit*”, Gjykata Supreme, (i) nuk specifikoj dhe arsyetoj bazën ligjore; dhe (ii) nuk arsyetoi përcaktimin e datës së ekspertizës, përkatësisht 3 gushtin 2015, si datë prej të cilës llogaritet kamatëvonesa, përkundër Gjykatës Themelore dhe të Apelit e të cilat kishin përcaktuar datën e ushtrimit të padisë, përkatësisht 12 majin 2009, si datë prej të cilës INSIG kishte rënë në vonesë, dhe rrjedhimisht datë prej të cilës llogaritet kamatëvonesa. Në aspekt të kësaj të fundit, Gjykata vëren dallimin prej gjashtë (6) vitesh kamatëvonesë varësisht se cila llogaritet data e rënies në vonesë së të paditurit.
58. Përkitazi me qëndrimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, Gjykata përsërit se GJEDNJ, ndër të tjera, në Aktgjykimin *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, cituar më lart, mori qëndrimin se gjykatat vendore duhet “*të shpjegojë në mënyrë mjaft të qartë mbi cilat baza juridike e bazon vendimin e saj*”. (Shih, në këtë kontekst, gjithashtu rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 61).
59. Për më tepër, dhe bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata thekson se arsyetimi përkatës i Gjykatës Supreme nuk ka arritur të shpjegojë pikërisht raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit të cilin ajo e ka përdorur dhe të cilin ajo nuk e ka cituar fare, respektivisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra-tjetrën dhe se si kanë ndikuar në vendimin që Gjykata Supreme t’i ndryshojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me mënyrën e caktimit të kamatëvonesës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafët 60 dhe

- 87). Gjykata ka theksuar disa herë përmes praktikës së saj gjyqësore se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimet e dhëna nuk i përmbajnë faktet e vërtetuara dhe dispozitat ligjore, si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre.
60. Gjykata rikujton se ajo kishte konstatuar shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, në një rast të ngjashëm, përkatësisht rastin KI87/18, përmes të cilit vlerësoj kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr.27/2017] të 24 janarit 2018 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: rasti KI87/18). Në këtë rast, kjo e fundit, poashtu kishte pranuar revizionin e të paditurës dhe kishte ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët përkitazi me mënyrën e caktimit të kamatëvonesës. Edhe në këtë rast, Gjykata Supreme kishte përcaktuar *“kamatën në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 19.11.2010, e deri në pagesën definitive.”* Gjykata vëren se edhe në këtë rast, Gjykata Supreme, kishte theksuar se Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm kishte hyrë në fuqi pasi kishte ndodhur aksidenti, dhe rrjedhimisht nuk ishte i aplikueshëm në rrethanat e rastit përkatës. (Shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtues *“IF Skadeforsikring”*, cituar më lart, paragrafi 21). Gjykata kishte konstatuar se arsyetimi i vendimit të Gjykatës Supreme nuk plotësonte standardet e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndër të tjera sepse (i) Gjykata Supreme nuk kishte specifikuar ligjin e aplikueshëm në rrethanat përkatëse (shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtues *“IF Skadeforsikring”*, cituar më lart, paragrafi 58); dhe (ii) nuk kishte shpjeguar raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit në të cilin ajo është thirrur. (Shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtues *“IF Skadeforsikring”*, cituar më lart, paragrafi 60).
61. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017, nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtuesit të kërkesës për (i) përcaktimin e kamatëvonesës *“në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit”*; dhe (ii) përcaktimin e datës së ekspertizës dhe jo atë të ngritjes së padisë, siç kishin konstatuar gjykatat më të ulta, si datë prej të cilës llogaritet kamatëvonesa, duke rezultuar kështu në shkelje të së drejtës së parashtuesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të

Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, paragrafi 115).

62. Pas konstatimit se Aktgjykimi [E.Rev.nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata në vijim do të shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me cenimin e parimit të sigurisë juridike nga ana e Gjykatës Supreme në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi, përkatësisht mungesën e konsistencës në praktikën përkatëse gjyqësore.
63. Rrjedhimisht dhe në vijim, Gjykata do të shtjellojë (i) parimet themelore që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së që kanë të bëjnë me konsistencën e praktikës gjyqësore; dhe (ii) kriteret përkatëse bazuar në të cilat, GJEDNJ vlerëson nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjenca në praktikën gjyqësore përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për më shumë lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 Dhjetorit 2018, lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Civil); E drejta për një proces të rregullt gjyqësor; Pjesa IV. Kërkesat procedurale; A. Procesi i rregullt; 2. Fushëveprimi, c. Konsistenca e ligjit vendor).

II. Për sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me divergjencën e praktikës gjyqësore

(i) Parimet e përgjithshme

64. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, si vijon: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNJ-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.
65. Lidhur me parimin e parë, GJEDNJ është përqendruar në parimin e sigurisë juridike e që në këtë kontekst është e mishëruar në të gjitha nenet e KEDNJ-së dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56). Ky parim garanton një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon në besimin e publikut në gjykata. Vazhdimësia e divergjencës në praktikë

gjyqësore mund të krijojë situata të pasigurisë juridike duke rezultuar në ulje të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, ndërsa ky besim është qartazi njëri nga komponentët thelbësor të shtetit që bazohet në sundim të ligjit. (Shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Hayati Çelebi dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; dhe *Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 30 korrikut 2015, paragrafi 42; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/2017, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33).

66. Lidhur me parimin e dytë, GJEDNJ-ja ka konstatuar se kërkesat e sigurisë juridike dhe të mbrojtjes së besimit legjitim të publikut, megjithatë nuk garantojnë një të drejtë të fituar në konsistencë të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e drejtë të drejtësisë pasi që mos-ruajtja e një qasje dinamike dhe evolutive, do të rrezikonte të pengojë reformën ose përmirësimin e vazhdueshëm. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafin 58; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/2017, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 34).
67. Lidhur me parimin e tretë, GJEDNJ-ja ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNJ-në. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51; *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë* dhe gjashtëdhjetë e tri (63) kërkesa tjera, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; *Santo Pinto kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 122; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/2017, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 35).
68. E fundit dhe në lidhje me parimin e katërt, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë

vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, GJEDNJ-ja ka theksuar se nuk mund të konsiderohet të ketë divergjencë në praktikën gjyqësore kur gjendjet faktike të çështjes janë objektivisht të ndryshme. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Uçar kundër Turqisë*, Vendim i 29 shtatorit 2009). Njëlloj, trajtimi i dy kontesteve në mënyrë të ndryshme nuk mund të konsiderohet se krijon praktikë gjyqësore divergjente kur kjo arsyetohet nga një ndryshim në gjendjet faktike në fjalë. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Hayati Çelebi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; si dhe *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 116).

69. Gjithashtu, Gjykata vëren se qasja e GJEDNJ-së në analizimin e divergjencave në praktikën gjyqësore, ndryshon në varësi të faktit nëse (i) divergjencat ekzistojnë brenda të njëjtës degë të gjykatave; ose (ii) ndërmjet dy degëve të ndryshme të gjykatave të cilat janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Situata e dytë ka të bëjë me sistemet gjyqësore që përbëhen nga më shumë se një degë e sistemit gjyqësor, secila me gjykatën përkatëse e të pavarur supreme e që nuk i nënshtrohet ndonjë hierarkie të përbashkët gjyqësore. Rasti kryesorë i GJEDNJ-së lidhur me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën e praktikës gjyqësore, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, bie brenda kësaj kategorie. Sidoqoftë, parimet themelore të vendosura përmes këtij rasti, përdoren gjithashtu në vlerësimin e divergjencave që kanë të bëjnë me praktikën gjyqësore edhe në rastet që i përkasin kategorisë së parë, përkatësisht, atyre me një sistem unik gjyqësor, që do të ishte rasti në kontekst të sistemit juridik të Republikës së Kosovës.
70. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GJEDNJ-ja përdor tri kritere themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim: (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti. (Në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe *Hayati Çelebi dhe të tjerët*, cituar më

lart, paragrafi 52; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/2017, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 39).

71. Gjykata më tej thekson se koncepti i “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” është shtjelluar nga GJEDNJ, ndër të tjera në rastin *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, rasti ky në të cilin GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 135). Prandaj, Gjykata, dhe për aq sa është relevante, do të shtjelloj sipërfaqësisht rrethanat e këtij rasti. Ky i fundit, kishte të bëjë me “*me dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të një gjykate të vetme, përkatësisht Gjykatës Supreme dhe me mospërdorimin e mekanizmit për të siguruar harmonizimin dhe konsistencën e praktikës gjyqësore. Më konkretisht, rrethanat e këtij rasti pasqyrojnë ekzistencën e praktikës gjyqësore kundërthënëse brenda gjykatës më të lartë vendore, duke rezultuar në praktikë gjyqësore divergjente edhe në kuadër të gjykatave më të ulëta si pasojë. Çështja në fjalë kishte të bënte me interpretimin e një dekreti legjislativ, siç ishte formuluar para amandamentimeve përkatëse dhe ndërlidhej me juridiksionin e gjykatave për të vendosur përkitazi me veprimet e Famullisë Katolike Greke. Ky dekret interpretohej vazhdimisht në mënyrë jokonsistente, në disa raste duke refuzuar, dhe në raste të tjera duke miratuar, juridiksionin për të vendosur për kontestet e paraqitura para tyre nga famullitë katolike greke, duke afektuar kështu edhe të drejtat për qasje në gjykatë siç garantohen me nenin 6 të KEDNJ-së për parashtruesit përkatës. Legjislatura rumune si rezultat amandamentoit tekstin e dekretit përkatës. Megjithatë, ky amandamentim rezultoj edhe një grup tjetër të vendimeve gjyqësore kundërthënëse. Si pasojë, e drejta e qasjes në gjykatë u bë kontestuese për një numër të madh të famullive katolike greke. Për më tepër, kjo praktikë gjyqësore kundërthënëse kishte prekur një numër të madh personash e që për pasojë do të paraqisnin një numër të madh rastesh gjyqësore, dhe gjykatat vendore prisnin që të përballeshin me një numër të madh padish.
72. Në ilustrimin e rastit të mësipërm, Gjykata vëren se në konstatimin e shkeljes së nenit 6 të KEDNJ-së në kuptim të divergjencës në praktikën gjyqësore, dhe në përcaktimin nëse ekzistojnë “*dallime të thella dhe afatgjata*”, GJEDNJ-ja gjithashtu morri parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 38).

73. Gjykata në këtë drejtim gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42 - 43).
74. Kjo e fundit ndërlidhet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe me çfarë efekti. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 4 marsit 2009, paragrafët 30-32; dhe *Ştefăniţă dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2010, paragrafët 37-38; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 54). Në këtë drejtim, GJEDNJ ka përsëritur në shumë raste rëndësinë e përcaktimit të mekanizmave për të siguruar konsistencë dhe uniformitet të praktikës gjyqësore të gjykatave. Gjithashtu, ajo ka deklaruar se është përgjegjësi e shteteve për të organizuar sistemet e tyre juridike në mënyrë të tillë që të shmangin divergjencat në praktikë gjyqësore. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 24 marsit 2009, paragrafi 58; *Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 23 marsit 2010, paragrafi 86; *Brezovec kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 29 mars 2011, paragrafi 66; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 55). GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se roli i një gjykate supreme është pikërisht për të zgjidhur kundërthënie të tilla. (Në këtë kontekst, shih rastin e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë (nr. 1)*, cituar më lart, paragrafi 37; *Zielinski dhe Pradal & Gonslaez dhe të tjerët kundër Francisë*, Aktgjykim i 28 tetorit 1999; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 123). Kjo sepse, nëse praktika kundërthënëse zhvillohet brenda një prej autoriteteve më të larta gjyqësore në një vend, vetë ajo gjykatë bëhet burim i pasigurisë juridike, duke minuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe duke e dobësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Beian (nr. 1)*, cituar më lart, paragrafi 39; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 123).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

75. Në vijim, Gjykata do të aplikoj parimet e shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret. Gjykata do të i aplikoj këto kriterë duke pasur parasysh parimet themelore përkitazi me konsistencën e praktikës gjyqësore e të elaboruara më lart, rrjedhimisht (i) rëndësinë e sigurisë juridike; (ii) faktin që parimi i sigurisë juridike dhe rëndësia e konsistencës së praktikës gjyqësore nuk garantojnë një të drejtë në këtë konsistencë në praktikë gjyqësore; (iii) që në fakt, divergjencat në praktikën gjyqësore nuk rezultojnë domosdoshmërisht në shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe me rëndësi (iv) që GJEDNJ-së konstaton shkelje të tilla, në rast të arbitraritetit të dukshëm.
76. Në këtë kontekst, Gjykata duhet gjithashtu të rithekson se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtuesit e kërkesave duhet të i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
77. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij, Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe përkitazi me kamatëvonesën, duke vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore. Në mbështetje të argumenteve të tij, ai iu referohen shtatë (7) rasteve tjera të Gjykatës Supreme si në vijim: (i) Aktgjykimit [E.Rev.nr.20/2014] të 14 prillit 2014; (ii) Aktgjykimit [E.Rev.nr.48/2014] të 27 tetorit 2014; (iii) Aktgjykimit [E.Rev.55/2014] të 3 nëntorit 2014; (iv) Aktgjykimit [E.Rev.62/2014] të 21 janarit 2015; (v) Aktgjykimit [E.Rev.nr.6/2015] të 19 marsit 2015; (vi) Aktgjykimit [E.Rev.nr. 14/2016] të 24 marsit 2016; dhe (vii) Aktgjykimit [E.Rev.23/2017] të 14 dhjetorit 2017. Për më tepër, në

rastin KI87/18, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.27/2017] të 24 janarit 2018 të Gjykatës Supreme, dhe të cilin, Gjykata gjithashtu do të e përfshijë në analizën e saj.

78. Para analizës dhe konstatimit nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përtej mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, është nxjerr gjithashtu në cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore, Gjykata në vijim dhe fillimisht, do të i paraqes pjesët relevante të Aktgjykimeve të lartcekura, përkatësisht ato që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës dhe momentin e llogaritjes së saj, për aq sa këto të fundit janë shtjelluar.

a) Aktgjykimi [E.Rev.nr.20/2014] i 14 prillit 2014

79. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.20/2014] të 14 prillit 2014 refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.3/2013] të 16 janarit 2014, konfirmoi kamatën vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009, dhe gjithashtu konfirmoi se llogaritja e kamatëvonesës në rrethanat e këtij rasti fillon nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Edhe thëniet e të paditurës në revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur paditësës i kanë pranuar të drejtën me kamatë në lartësinë e shumës së aprovuar në lartësi prej 12% vjetore janë të pabazuara, ngase gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale dhe atë dispozitën e nenit 277 të LMD-së lidhur me nenin 26 pika 6 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr.04/L-018 me të cilën dispozitë është e paraparë se në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në parag.1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruksi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

b) Aktgjykimi [E.Rev.nr.48/2014] i 27 tetorit 2014

80. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 48/2014] të 27 tetorit 2014, refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër

Aktgjykimit [Ac.nr. 460/2012] të 13 majit 2014, dhe konfirmoi aplikimin e kamatës vjetore prej 20% deri 29 korrik 2019, duke u bazuar në nenin 5 të Rregullit 3 dhe pas kësaj date kamatën prej 12%, duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Gjykata Supreme gjithashtu konfirmoi datën 19 nëntor 2010, përkatësisht paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim, si datë prej të cilës fillon llogaritja e kamatëvonesës në rrethanat e këtij rasti. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar edhe të drejtën materiale kur paditëses i kanë pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 20% vjetore duke filluar nga data 19.11.2010 e deri më datën 28.7.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga data 29.7.2011 e deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD si dhe nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018 me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4 i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë me vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë, ky interes paguhet në lartësinë prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

c) Aktgjykimi [E.Rev.55/2014] i 3 nëntorit 2014

81. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.55/2014] e 3 nëntorit 2014, refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.46/2013] të 10 majit 2014, dhe konfirmoi kamatën vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.46/2013 të datës 10.5.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut [...] me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që të paguaj në emër të borxhit regresiv shumën prej 14.041,58 €, me kamatë vjetore prej 12% duke llogaritur nga data 19.12.2010 gjerë në pagesë definitive si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej [...]”.

82. Sa i përket momentit të llogaritjes së kamatëvonesës, nga ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme rezulton se është llogaritur data 19 dhjetor 2010, datë kjo që ndërlidhen me atë të ngritjes së padisë. Ky Aktgjykim në këtë aspekt, kishte theksuar si në vijim:

“Pretendimi i të paditurës se nuk është marrë parasysht oferta e të paditurës, nuk qëndron nga arsyja se palët meqenëse nuk kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore çështja ka mbetur të zgjidhet në kontest civil”.

d) Aktgjykimi [E.Rev.62/2014] i 21 janarit 2015

83. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 62/2014] të 21 janarit 2015, refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.57/2013] të 10 qershorit 2014, dhe konfirmoi kamatën vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009 dhe duke e llogaritur kamatëvonesën nga momenti i paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur të paditurës ia ka pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 12% duke ia llogaritur nga data 14.6.2010 deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD e lidhur me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018, parashihet kamata në lartësi prej 12% në vit e cila llogaritet për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi, duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Nga shkresat e lëndës del se paditësja të paditurës ia ka paraqitur kërkesën për rimbursim të dëmit nga data 14.06.2010[...].”

e) Aktgjykimi [E.Rev.nr.6/2015] i 19 marsit 2015;

84. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.6/2015] të 19 marsit 2015, refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.162/2013] të 10 qershorit 2014, dhe konfirmoi kamatën vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.162/2013 datë 10.06.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [...] me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkespacia e paditësit, dhe është detyruar e paditura që paditësit t'i paguajë shumën prej 17.924,35 €, në emër të kompensimit të dëmit-kasko regres lidhur me riparimin e automjetit të dëmtuar [...] në aksidentin e datës 25.08.2009,[...] me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke filluar nga data 22.07.2010 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë pre 1.134,29 €.

f) Aktgjykimi [E. Rev. nr. 14/2016] i 24 marsit 2016

85. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 14/2016] të 24 marsit 2016, refuzoi si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.40/2015] të 12 nëntorit 2015, dhe konfirmoi kamatën vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.40/2015 datë 12.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [...] me të cilin me pjesën I të dispozitivit është miratuar si e bazuar kërkespacia e paditësi që të detyrohet kompania e sigurimeve [...] që paditësit t'i paguajë shumën prej 42,243.41 €, në emër të regresit nga sigurimi i autopërgjegjësisë, me kamatë prej 12% në vit, duke llogaritur nga data 14.1.2010, e deri në pagesën definitive [...]

g) Aktgjykimi [E. Rev. 23/2017] i 14 dhjetorit 2017

86. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. 23/2017] të 14 dhjetorit 2017, ndryshoi Aktgjykimin [Ae.nr. 53/2016] të 21 shtatorit 2017, duke përcaktuar aplikimin e kamatës vjetore prej 20% deri 29 korrik 2019, duke u bazuar në nenin 5 të Rregullit 3 dhe pas kësaj date kamatën prej 12%, duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Gjykata Supreme gjithashtu konfirmoi datën 22 prill 2010, përkatësisht paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim, si datë prej të cilës fillon llogaritja e kamatëvonesës në rrethanat e këtij rasti. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

“[...] sa i përket lartësisë së kamatës, ndryshohet aktgjykimi i goditur i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 53/2016 të datës 21.09.2017 dhe detyrohet e paditura që në shumën e aprovuar të kërkesëpadisë t’ia paguaj paditësit kamatën në lartësi prej 20% duke filluar nga data 22.04.2010 si ditë e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të dëmit e deri më 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive kamatës në lartësi prej 12% në shumën e gjykuar”.

h) Aktgjykimi [E.Rev.27/2017] i 24 janarit 2018

87. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr.27/2017] të 24 janar 2018, Aktgjykim ky i cili u shpall në kundërshtim me Kushtetutën përmes rastit KI87/18, ndryshoi Aktgjykimin [Ae.nr. 191/2015] të 31 tetorit 2017, përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata Supreme ndryshoi konstatimin e gjykatave më të ulta të cilat kishin përcaktuar aplikimin e kamatës vjetore prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, përkitazi me një aksident të shkaktuar në vitin 2009. Gjykata Supreme Supreme përcaktoi së në rrethanat e këtij rasti, duhet të aplikohet *“kamata në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit”*. Në këtë aspekt dhe ndër tjerash, ky Aktgjykim thekson si në vijim:

„Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shumën prej 23.609,24 €, e paditura duhet t’ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 19.11.2010, e deri në pagesën definitive, kjo ngase Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011 ndërsa rasti ka ndodhur në vitin 2009 dhe si i tillë nuk gjen zbatim për rastin konkret“.

88. Për më tepër, para analizës nëse (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. nr.18/2017] i 4 dhjetorit 2017, është nxjerrë nga Gjykata Supreme në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore; dhe (ii) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë *“të thella dhe afatgjata”*, Gjykata fillimisht rikujton arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata rikujton edhe një herë, që Gjykata Supreme në rrethanat e rastit konkret përcaktoi (i) *“kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat*

afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit"; (ii) datën e ekspertizës, përkatësisht datën 3 gusht 2015 si datë prej të cilës fillon llogaritja e kamatëvonesës; dhe (iii) që Rregulli 3 dhe Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nuk ishin të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.

89. Në këtë kontekst, dhe përkitazi me ligjin e aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht vëren se bazuar në nenin 9 (Hyrja në fuqi) të Rregullit 3, ky i fundit ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2008. Ndërsa, Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm është mirtuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 qershor 2011, është Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 5 korrik 2011, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 korrik 2011, dhe bazuar në nenin 44 të tij (Hyrja në fuqi), ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, rrjedhimisht më 29 korrik 2011. Për më tepër, ky ligj, përmes nenit 43 të tij, ka përcaktuar shfuqizimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 që rregullon sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë si dhe aktet respektive nënligjore të Bankës Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: BQK), e të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.
90. Kjo rregullativë, duke përfshirë LMD-në, e e cila ishte aplikuar në të gjitha rastet e referuara nga parashtuesi i kërkesës dhe të sqaruara më lart, përcakton edhe lartësinë e kamatëvonesës, por edhe momentin prej të cilës ajo llogaritet. Përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, Gjykata vëren se ajo (i) nuk është shprehimisht e përcaktuar përmes nenit 277 të LMD-së; (ii) është 20% bazuar në nenin 5 të Rregullit 3; dhe (iii) është 12% bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm. Ndërsa, përkitazi me momentin e llogaritjes, Gjykata vëren se kamatëvonesa aplikohet nga momenti i vonesës për përmbushjen e detyrimit. Llogaritja e këtij momenti (i) nuk është specifikisht e përcaktuar në nenin 277 të LMD-së; (ii) fillon nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar bazuar në nenin 5 të Rregullit 3; ndërsa (iii) në rast të dëmeve të shkaktuara në pasuri, fillon në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtimit të kërkesës të kompletuar për dëmshpërblim bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.
91. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.12/2016] të 6 qershorit 2017, kishte përcaktuar datën 29 korrik 2011, përkatësisht datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, si datën prej të cilës kamatëvonesa do të zbritet prej 20% në 12%, duke aplikuar kështu nenin 26 të Ligjit të Sigurimin e Detyrueshëm përkitazi me

kamatëvonesën. Megjithatë, Gjykata rikujton, se Gjykata Supreme, në prishjen e Aktgjykimeve të gjykatave më të ulta, përkitazi me kamatëvonesën, kishte theksuar se as (i) Rregulli 3 dhe as (ii) Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm, nuk ishin në fuqi në kohën e aksidentit të ndodhur në vitin 2007, dhe rrjedhimisht, nuk ishin të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret. Megjithatë, dhe siç është theksuar tashmë nga Gjykata duke konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor, në prishjen e Aktgjykimeve të gjykatave më të ulta përkitazi me kamatëvonesën, Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar dy çështje: (i) bazën ligjore mbi të cilën kishte përcaktuar kamatëvonesën e re; dhe (ii) bazën ligjore mbi të cilën kishte përcaktuar datën e ekspertizës si datë mbi të cilën ISNIG kishte rënë në vonesë, dhe detyruar të paguajë kamatëvonesën respektivisht.

92. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen cenimin e parimit të sigurisë juridike, përkatësisht, në rrethanat e rastit konkret, mungesën e konsistencës në praktikë gjyqësore, Gjykata vëren se Aktgjykimet e referuara nga parashtruesi i kërkesës, mund të ndahen në dy kategori. Në të parën hyn Aktgjykimi [E.Rev.nr.27/2017] i 24 janarit 2018 dhe i cili, njejtë si në rrethanat e rastit konkret, kishte përcaktuar *“kamatën në lartësi të depozitimeve kursimore të paqfaturuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit”*, ndërsa për dallim, këtë kamatë e kishte aplikuar nga data e paraqitjes së se padisë, përkatësisht nga 19 nëntori 2010. Ky rast ishte shqyrtuar edhe nga Gjykata në rastin KI87/18, dhe në të cilin ajo kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, edhe si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor e edhe si rezultat i mungesës së konsistencës në praktikën përkatëse gjyqësore, duke rezultuar kështu në shkelje të parimit të sigurisë juridike. (Shih më specifikisht paragrafët 82-88 të rastit KI87/18, parashtrues *“IF Skadeforsikring”*, cituar më lart).
93. Ndërsa, në kategorinë e dytë, hyjnë Aktgjykimet tjera, dhe në të cilat, Gjykata Supreme kishte aplikuar kamatëvonesën prej 12% të përcaktuar përmes nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, me përjashtim të Aktgjykimeve [E.Rev.nr.48/2014] të 27 tetorit 2017 dhe [E.Rev.nr.23/2017] të 14 dhjetorit 2017, në të cilat Gjykata Supreme kishte aplikuar kamatëvonesën prej 20% deri më 29 korrik 2011, ndërsa nga kjo datë, përkatësisht data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, kamatëvonesën prej 12%. Gjykata vëren se interpretimi i ligjit të aplikueshëm nga Gjykata Supreme në këto dy raste, përkon me interpretimin e e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin [Ae.nr.12/2016] të 6 qershorit 2017, në rrethanat e parashtruesit të kërkesës.

94. Në të gjitha rastet tjera brenda kësaj kategorie, përkatësisht Aktgjykimet [E.Rev.55/2014] të 3 nëntorit 2013; [E.Rev.nr.20/2014] të 14 prillit 2014; [E.Rev.62/2014] të 21 janarit 2015; [E.Rev.nr.6/2015] të 19 marsit 2015; dhe [E.rev.nr. 14/2016] të 24 marsit 2016 të Gjykatës Supreme (i) ishte aplikuar kamatëvonesa prej 12% bazuar në neni 26 i Ligjit për Sigurime të Detyrueshme; dhe (ii) kjo kamatëvonesë në të gjitha rastet ishte aplikuar duke filluar nga data të caktuara të vitit 2010, duke marrë parasysh si datë fillestare, datën e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim ose të padisë.
95. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta vetëm në raport me shkeljet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikë gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i “*dallimeve të thella dhe të afatgjata*” në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të përkojnë më ato të rasteve kundërthënia me të cilat pretendohet.
96. Në këtë aspekt, Gjykata vënë re se për dallim nga të gjitha rastet të cilat iu referohet parashtruesi i kërkesës, duke përfshirë Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI87/18, aksidenti ka ndodhur në vitin 2007. Nuk është kontestuese se Rregulli 3 dhe Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nuk kanë qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit. Megjithatë, Gjykata thekson se Ligji për Sigurimet e Detyrueshme në të paktën pesë (5) raste të lartcekura, ishte aplikuar retrokativisht, dhe rrjedhimisht, para hyrjes në fuqi të tij. Kjo për dallim nga rrethanat e rastit konkret, në të cilin Gjykata Supreme, kishte ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave më të ulta, me arsyetimin se Rregulli 3 dhe Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nuk ishin të aplikueshëm, sepse të njejtat nuk kishin qenë në fuqi në kohën e aksidentit.
97. Gjykata në këtë aspekt rithekson qëndrimin që ajo vazhdimisht ka mbajtur përkitazi me faktin se aplikimi dhe interpretimi i ligjit është në jurisdiksionin e gjykatave të rregullta; dhe që roli i saj është vetëm të sigurohet se aplikimi dhe interpretimi i ligjit nga gjykatat e rregullta janë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastet e GJENDJ-së, *Brualla Gomes de la Torre kundër Francës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 31; *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 54;; *Kuchoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; *Işyar kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 20 nëntorit 2008 paragrafi 48; dhe

Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 49). Thënë këtë, Gjykata gjithashtu ka theksuar se përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, janë rastet e arbitraritetit të dukshëm. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

98. Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata rikujton që GJENDJ ka theksuar se kundërthëniet në praktikën gjyqësore janë pjesë përbërëse e secilit sistem gjyqësor dhe që divergjenca në praktikë gjyqësore mund të ketë edhe brenda të së njejtës gjykatë. Një e gjë e tillë, nuk është detyruesisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Santo Pinto kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51). Për më tepër, dhe siç është cekur më lart, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtje legjitime të besimit të publikut në gjykata nuk ofrojnë/garantojnë një të drejtë në praktikë gjyqësore konsistente. Për më tepër që, zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administratimit të drejtësisë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Atanasovski kundër "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë"*, Aktgjykim i 14 janarit 2010, paragrafi 38; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 58). Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përjashtim edhe nga këto parime të përgjithshme, është arbitrariteti i dukshëm, dhe në kuptim të vlerësimit të mungesës së konsistencës gjyqësore, vlerësimi nëse ka “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën përkatëse gjyqësore dhe nëse ka një mekanizëm efektiv për të adresuar të njejtat.
99. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, në të paktën nëntë (9) raste, duke e përfshirë edhe rastin e parashtruesit të kërkesës, dhe brenda një periudhe pesë (5) vjeçare, Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat ligjore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës në mënyrë të ndryshme përkitazi me aksidente, të cilat me përjashtim të rastit të parashtruesit të kërkesës, kishin ndodhur në vitin 2009, dhe rrjedhimisht para hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm. Interpretimet përfshijnë (i) përcaktimin e kamatëvonesës në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit, në dy raste, përfshirë rastin e parashtruesit të kërkesës; (ii) aplikimin e kamatës prej 12 % të përcaktuar përmes Rregullit 3 deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, datë kjo prej të cilës ishte aplikuar kamatëvonesa prej 20%, në dy raste; dhe (iii) aplikimin e kamatës prej 20%, lidhur me aksidente të shkaktuara në vitin 2009

dhe duke filluar nga data të caktuara të vitit 2010, periudhë kjo në të cilën ishte në fuqi Rregulli 3 dhe jo Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm, dhe i cili, siç është cekur më lart, në të paktën pesë (5) raste, ishte aplikuar retroktivisht. Për më tepër, Gjykata vëren që e njëjta divergjencë është e dukshme edhe në të gjitha vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të cilat ishin shqyrtuar përmes revizionit nga Gjykata Supreme.

100. Gjykata gjithashtu vëren, se për dallim nga rasti në shqyrtim, Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuara kërkesat për revizion në rastet [E.Rev.nr. 48/2014] të 27 tetorit 2014; [E.Rev.nr.62/2014] të 21 janarit 2015; [E.Rev.55/2014] të 3 nëntorit 2014; [E.Rev.nr.20/2014] të 14 prillit 2014; [E.Rev.nr.14/2016] të 24 marsit 2016; dhe [E.Rev.nr.6/2015] të 19 marsit 2015, raste këto të cilat herë përfshijnë aplikimin e kamatës 12% dhe 20% bazuar në datën e hyrjes në fuqi në Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, e herë aplikojnë në mënyrë retroaktive nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke aplikuar kështu kamatëvonesën prej 12% duke filluar nga viti 2010.
101. Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vënë theks në faktin se divergjenca në praktikë gjyqësore jodetyrimisht është në kundërshtim me KEDNJ-së, sepse qasja dinamike dhe evolutive e gjykatave në interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe për për më tepër, zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administratimit të drejtësisë. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, kundërthëniet e lartcekura në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme, nuk paraqesin një trend të përmirësimit dhe konsolidimit të praktikës gjyqësore përkitazi me kamatëvonesën në raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Për më tepër, kundërthëniet e lartcekura nuk paraqesin një rast të izoluar.
102. Përkundrazi, duke marrë parasysh natyrën e rasteve që ndërlidhen me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, kjo praktikë kundërthënëse gjyqësore ka afektuar në mënyrë të vazhdueshme një numër personash brenda një periudhe pesë (5) vjeçare, dhe ngërthen potencial për të afektuar një numër edhe më të madh personash, duke rezultuar në rritje të numrit të padive dhe kontestimit të vendimeve gjyqësore si rezultat i kundërthënieve të vazhdueshme në praktikë gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
103. Në këtë kontekst dhe për pasojë, Gjykata duhet të konstatoj, ashtu siç ka bërë në rastin KI87/18, se në rrethanat e rastit konkret, dhe përkitazi me përcaktimin e lartësisë së kamatëvonesave që ndërlidhen

me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ekzistojnë “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta. (Shih gjithashtu rastin KI87/18, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 79).

104. Ky konstatim megjithatë nuk vlen përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me momentin prej të cilit aplikohet kjo kamatëvonesë. Gjykata rikujton që për dallim nga të gjitha rastet e referuara në Gjykatë, dhe siç është konstatuar tashmë, pa e sqaruar dhe arsyetuar bazën përkatëse ligjore, në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, kishte përcaktuar datën e ekspertizës, si datë prej të cilës kishte filluar llogaritja e kamatëvonesës. Megjithatë, Gjykata thekson dhe marrë parasysh që ky është rasti i vetëm nga të gjitha rastet e shqyrtuara në të cilin Gjykata Supreme kishte devijuar nga praktika gjyqësore e saj në këtë aspekt, ajo nuk mund të konstatoj “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore përkatëse për sa i përket interpretimit të dispozitave ligjore që ndërlidhen me rënien në vonesë, përkatësisht momentin e llogaritjes së kamatëvonesës. Gjykata konsideron se në këtë kontekst rasti i parashtruesit të kërkesës është rasti izoluar, dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të kaloj prapën për të konstatuar “*dallime të thella dhe afatgjata*” dhe cenim të parimit të sigurisë juridike. Gjykata mjaftohet me konstatimin e shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor në këtë aspekt.
105. Në anën tjetër, konstatimi se ka “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesave, nuk rezulton detyruesisht në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për të konstatuar një gjë të tillë, Gjykata duhet të shqyrtoj edhe dy kriteret tjera të GJEDNJ-së që ndërlidhen me vlerësimin e mungesës së konsistencës në praktikë gjyqësore, përkatësisht nëse ligji i aplikueshëm përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjencë të tilla; dhe nëse një mekanizëm i tillë është zbatuar në rrethanat e një rasti dhe me çfarë efekti.
106. Gjykata thekson se Gjykata Supreme ka një mekanizëm që mundëson zgjidhjen e kundërtënieve të tilla, mekanizëm ky i cili nuk është aplikuar në rrethanat e rastit konkret, duke rezultuar kështu në përmbushjen e dy kriterëve të lartcekura.
107. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në rastin KI87/18, Gjykata kishte theksuar se bazuar në pikën 10 të paragrafit 2 të nenit 14 (Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të

Gjykatës) të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Gjykatat), Kryetarët e gjykatave përmes takimeve vjetore të të gjithë gjyqëtarëve kanë detyrimin, ndër të tjera, për të për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika. (Shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 80). Përmes këtij rasti, Gjykata gjithashtu theksoi se funksionimi i vetë mekanizmit të harmonizimit të praktikës nuk është i pamundësuar, apo i kufizuar me asgjë, gjë që do të zvogëlonte drejtpërdrejt zbatimin dhe efikasitetin e tij në vetë praktikën gjyqësore. (Shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 81)

108. Megjithatë dhe për më tepër, Gjykata përmes këtij rasti gjithashtu thekson se pika 4 e paragrafit 1 të nenit 26 (Kompetencat e Gjykatës Supreme) të Ligjit për Gjykatat, përcakton kompetencën ekskluzive të vet Gjykatës Supreme për të përcaktuar qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës. Në çështjen që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, përkatësisht aplikimin e lartësisë së kamatëvonesës përkitazi me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Gjykata Supreme, jo vetëm që nuk kishte bërë një gjë të tillë, por në fakt, kishte shërbyer vet si burim i divergjencave në praktikë gjyqësore, duke cenur kështu parimin e sigurisë juridike.
109. Gjykata thekson se GJEDNJ vazhdimisht ka theksuar se roli i një gjykate supreme është pikërisht për të zgjidhur kundërthënie të tilla. Për më tepër, ajo gjithashtu ka mbajtur se, nëse praktika kundërthënëse zhvillohet brenda një prej autoriteteve më të larta gjyqësore në një vend, vetë ajo gjykatë bëhet burim i pasigurisë juridike, duke minuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe duke e dobësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor.
110. Rrjedhimisht, Gjykata marrë parasysh të lartcekurat, konstaton se në rrethanat e rastit konkret, plotësohen të tri kriteret e GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjencat në praktikë gjyqësore, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, ka konstatuar “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me aplikimin e dispozitave që rregullojnë lartësinë e kamatëvonesës në kontekst të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, dhe për më tepër, gjithashtu ka konstatuar se mekanizmat ekzistues të Gjykatës Supreme për harmonizimin e kësaj praktikë, nuk janë përdorur.

111. Si rezultat, Gjykata duhet të konstatoj se në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, “*dallimet e thella dhe afatagjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të ndërlidhura me mospërdorimin e mekanizmave të përcaktuar me ligj e të dizajnuar për të siguruar konsistencën e duhur brenda të praktikës gjyqësore të Gjykatës më të lartë në vend, kanë rezultuar në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundime

112. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike në aspektin e konsistencës së praktikës gjyqësore, garanci këto, që me përjashtime të caktuara, janë të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
113. Sa i përket mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata ka konstatuar se në nxjerren e Aktgjykimit [E.Rev.nr. 18/2017] të 4 dhjetorit 2017, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetoj pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk arsyetuar vendimin e saj përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës së caktuar dhe momentin prej të cilit rrjedh llogaritja e kamatëvonesës përkatëse.
114. Sa i përket parimit të sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës, përkatësisht divergjencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, Gjykata pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të GJEDNJ-së në këtë kontekst, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, dhe konstatoi se në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme ka “*dallime të thella dhe afatgjata*” përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës së aplikueshme në rastet të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për më tepër që, përkundër faktit që mekanizmat për sigurimin e konsistencës në praktikë gjyqësore janë të përcaktuar në ligjet respektive, ky mekanizëm nuk ishte përdorur nga Gjykata Supreme. Për pasojë, Gjykata konstatoi se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, dhe se Aktgjykimin [E.Rev.nr. 18/2017] e 4 dhjetorit 2017 është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata nuk konstatoi të njëjtën shkelje përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me momentin e rënies në vonesë, përkatësisht momentin prej të cilit fillon llogaritja e kamatëvonesës, duke e

vlerësuar devijimin e Gjykatës Supreme nga praktika gjyqësore në këtë aspekt, si rast të izoluar dhe i cili nuk mund të kalojë testin e përcaktuar nga GJEDNJ për të konstatuar “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 dhjetor 2019,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 18/2017, të 4 dhjetor 2017;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 18/2017, të 4 dhjetor 2017 për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KIO7/18 Parashtrues: “Çeliku Rollers” sh.p.k. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 14/2017, të 14 shtatorit 2017

KIO7/18, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2019, i publikuar më 20 janar 2020.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, person juridik, shkelje e të drejtave kushtetuese, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Shkaku kryesor i kontestit në mes të parashtruesit të kërkesës dhe N.P. "Vali AL-PVC", dhe të cilët në mes vete kishin nënshkruar një Kontratë fillestare dhe më pas ishin dakorduar edhe për punë shtesë, ishte kualiteti i profileve të aluminit për mbajtjen e xhamave në objektin banesor “Plisi” në Gjilan dhe i cili po ndërtohej nga parashtruesi i kërkesës. Ky i fundit kishte konstatuar se profilet përkatëse nuk ishin të kualitetit të duhur dhe rrjedhimisht, kishte urdhëruar heqjen dhe zëvendësimin e tyre nga një kompani tjetër. N.P. "Vali AL-PVC" fillimisht paraqiti propozim për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Komunale në Gjilan duke kërkuar që parashtruesit të kërkesës t'i ndalohet montimi i profileve të reja, dhe më pas kishte paraqitur edhe padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, duke kërkuar përmbushjen e tërësishme të Kontratës dhe kompensimin për punët e kryera. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kundërpadi. Gjykatat e rregullta kishin vendosur në favor të N.P. "Vali AL-PVC". Çështje kontestuese përgjatë gjithë procedurave në gjykatat e rregullta rezultoi të jetë ekspertiza e ekspertit gjyqësor, ekspertizë kjo të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar përgjatë gjithë procesit në gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se Aktgjykimi [E.Rev.nr.14/2017] i 14 shtatorit 2017 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse sipas tij është cenuar (i) parimi i barazisë së armëve si rezultat i anshmërisë së ekspertit; (ii) e drejta e parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar si rezultat i mosshqyrtimit të duhur të provave; dhe (iii) e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

Në shqyrtimin e meritave të rastit, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkritazi me (i) raportet e ekspertizës, anshmërinë e ekspertit dhe efektet përkatëse në parimin e barazisë së armëve; (ii) detyrimin e gjykatave të rregullta për vlerësimin e dëshmive dhe provave ;dhe (iii) të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata përtej shtjellimit të parimeve të përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë aspekt, gjithashtu detajisht shqyrtoi praktikën relevante gjyqësore ,përfshirë rastet *Letinčić kundër Kroacisë*; *Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës*; *Mantovanelli kundër Francës*; *Devinar kundër Sllovenisë*; dhe *Van Kück kundër Gjermanisë*, për të sqaruar rrethanat në të cilat Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me mungesën e neutralitetit të ekspertit apo edhe mundësisë efektive të pjesëmarrjes dhe kontestimit të gjetjeve të raporteve përkatëse. Gjykata në kontekst konstatoi se sa i përket (i) paanshmërisë së ekspertit, parashtruesi i kërkesës nuk argumenton dyshimet legjitime për paanshmërinë e ekspertit dhe as pse të njëjtat mund të jenë objektivist të justifikueshme në rrethanat e rastit konkret, për më tepër që, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk mund të konkludohet se eksperti përkatës nuk ka qenë neutral apo i paanshëm; (ii) procedurës së ndjekur për përpilimin e raportit të ekspertizës, parashtruesi i kërkesës ka patur mundësi efektive pjesëmarrjeje dhe kontestimi të gjetjeve të tij dhe (iii) përcaktimit të ekspertizës së re, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar mjaftueshëm mangësitë dhe paqartësitë e raportit të kontestuar përgjatë seancave shqyrtuese dhe nuk ka argumentuar mjaftueshëm kërkesën e tij për të përcaktuar një ekspertizë të re.

Sa i përket çështjes së dytë, Gjykata përtej shtjellimit të parimeve të përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë aspekt, gjithashtu detajisht shqyrtoi praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë rastet *Kraska kundër Zvicrës* dhe *Perez kundër Francës*, për të sqaruar rrethanat në të cilat Gjykata Evropiane ka konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me mospërmbushjen e detyrimit të gjykatave për të bërë një shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët. Gjykata në këtë kontekst konstatoi se parashtrësat, argumentet dhe dëshmitë e parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e procedurës, ishin shqyrtuar në mënyrë të duhur nga e ana e gjykatave të rregullta. Gjykata theksoi se një konstatim në të kundërtën nuk gjen mbështetje në ligjin e aplikueshëm dhe as në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sa i përket çështjes së tretë, Gjykata u referua në praktikën e saj tashmë të konsoliduar gjyqësore përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor dhe konstatoi se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës ishin arsyetuar mjaftueshëm përgjatë procesit në gjykatat e rregullta.

Përfundimisht, duke i aplikuar parimet dhe kriteret e lartpërmendura, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi [E.Rev.nr. 14/2017] i 14 shtatorit 2017 i

Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KIo7/18

Parashtrues

“Çeliku Rollers” sh.p.k.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 14/2017, të 14 shtatorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është “Çeliku Rollers” sh.p.k. me seli në Komunën e Gjilanit, i përfaqësuar nga Rudi Metaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E. Rev. nr 14/2017] të 14 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ae. nr. 133/2016] e 14 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [IC. nr. 660/2013] e 31 marsit 2016 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara përmes nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshmë: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Gjykata) caktimin e masës së përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura para Gjykatës

7. Më 12 janar 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 16 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Cakanimani Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Alltay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 29 janar 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

10. Më 7 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti një dokument shtesë në Gjykatë përmes të cilit saktësoi kërkesën e parashtruar, kërkoi zëvendësimin e kërkesës së parashtruar fillimisht dhe paraqiti edhe kërkesën për masë të përkohshme.
11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
13. Më 1 prill 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH. KIO7/18, për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci.
14. Më 18 dhjetor 2019, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
15. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe se (ii) Aktgjykimi [E. Rev. nr 14/2017] i 14 shtatorit 2017 i Gjykatës Supreme është në përpuethshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

16. Në prill 2012, parashtruesi i kërkesës, i cili ushtron aktivitetin tregëtar kryesisht në ndërtimin e objekteve banesore dhe jobanesore, kishte arritur një marrëveshje verbale me N. P. "Vali AL-PVC", një biznes individual, i cili veprimtari kryesore ka prodhimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve prej metalit, lidhur me pajisjen me dyer dhe dritare të objektit banesor në ndërtim e sipër të parashtruesit të kërkesës, "Plisi".
17. Më 2 tetor 2012, të lartcekurit kanë lidhur një kontratë për furnizimin dhe punimin e montimin e dyerve dhe dritareve prej profileve të plastikës dhe aluminit në vlerë të përgjithshme të punëve të kontraktuara prej 37. 000.00 euro (në tekstin e mëtejme: Kontrata). Kjo e fundit, përcaktoi se gjysma e kësaj vlere, përkatësisht 18.560.00

euro do të kompenzohej në të holla, ndërsa gjysma tjetër përmes një banese me sipërfaqe prej 58 m² në shumën prej 320 euro për m².

18. Më 7 qershor 2013, palët u dakorduan për punë shtesë në lartësinë prej 42,127.40 euro. Kjo punë u dakordua përmes një dokumenti të titulluar "Ofertë", e cila përmban punët shtesë që duhen të kryhen dhe çmimet përkatëse për secilën. Përmes kësaj "Oferte", detyrimi total në mes palëve arriti vlerën prej 79,247.40 euro. Parashtruesi i kërkesës fillimisht ia kishte paguar N.P. "Vali AL-PVC" shumën prej 38,000 euro, në mënyrë që të filloj realizimi i punëve, ndërsa, gjithashtu, sipas shkresave të lëndës, ia kishte transferuar posedimin faktik të një banese, pronësia e të cilës do të bartej pas përfundimit të punimeve shtesë dhe regjistrimit të saj në zyrën përkatëse katastrale.
19. Më 10 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës i propozoi N.P. "Vali AL-PVC", që kompensimi me banesë të shndërrohet në kompensim me të holla dhe që vlera totale e borxhit prej 79,247 euro e përcaktuar në "Ofertë", të shndërrohej në detyrim në vlerë totale prej 42,247,00 euro, pasi të jetë zbritur pagesa prej 38,000 euro tashmë e realizuar. Bazuar në shkresat e lëndës, një marrëveshje e tillë nuk ishte nënshkruar.
20. Sipas parashtruesit të kërkesës, në realizimin e punëve nga N.P. "Vali AL-PVC", u paraqitën vonesa si rezultat i mungesës së cilësisë së profileve të aluminit/mbajtësve të xhamave, dhe të cilët, sipas pretendimit, nuk mund të mbanin në mënyrë të sigurtë llojin e xhamit për të cilin ishin dakorduar palët. Pas një vonese, sipas pretendimit, prej 9 (nëntë) muajsh dhe pas disa paralajmërimeve të parashtruesit të kërkesës, ky i fundit angazhoi një kompani tjetër për kryerjen e punëve dhe e cila, çmontoi profilet/mbajtëset e xhamave dhe filloi vendosjen e të rejave sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës.
21. Më 3 shtator 2013, N.P. "Vali AL-PVC" paraqiti propozim për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Themelore në Gjilan duke kërkuar që parashtruesit të kërkesës t'i ndalohet montimi i profileve të reja, duke kthyer situatën në gjendjen e mëparshme.
22. Më 24 dhjetor 2013, N.P. "Vali AL-PVC" paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, duke kërkuar përmbushjen e tërësishme të Kontratës dhe kompensimin për punët e kryera. Më 16 tetor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan përmes Aktvendimit [C. nr. 548/13] e shpalli vetveten jokompetente, duke e përcjellur çështjen në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
23. Bazuar në shkresat e lëndës, padi kanë ngritur edhe N.P. "Vali AL-PVC" dhe "Çeliku Rolls" sh.p.k. Nga po të njëjtat rezulton se padia e

parashtruesit të kërkesës është tërhequr. Por, i njëjti më 9 korrik 2015, ka paraqitur kundërpadi, përmes të cilës, ndër të tjera theksoi se (i) "Oferta" nuk e kishte zëvendësuar Kontratën dhe rrjedhimisht, marrëveshja për kompensim prej 50% të vlerës së detyrimit me të holla dhe 50% të kompensimit përmes banesës, mbetej në fuqi; (ii) me rritjen e vlerës së detyrimit, parashtruesi i kërkesës ka zëvendësuar banesën fillestare me një tjetër prej 152 m², përkatësisht 95,000 euro; (iii) si rezultat, vlera e kompensimit të paditësit kishte arritur shumën prej 133,000 euro; dhe (iv) duke marrë parasysh vonesën në përfundimin e punëve dhe cilësinë e profileve/mbajtësve të xhamave, ishte detyruar të bëjë zëvendësimin e tyre.

24. Më 31 mars 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [IC. nr. 660/2013] vendosi të: (i) miratoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, përkatësisht N.P. "Vali AL-PVC", duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që në emër të borxhit për punët ndërtimore të kompensoi paditësin në shumën prej 81.279.50 euro, me kamatë ligjore në lartësinë të cilën e aplikojnë bankat komerciale, përfshirë edhe shpenzimet e procedurës; dhe (ii) refuzoj si të pabazuar kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës.
25. Vendimi i Gjykatës Themelore u bazua në raportin e ekspertizës së ekspertit gjyqësor, dhe i cili kishte konstatuar se vlera e detyrimit të të paditurit ndaj paditësit ishte 120,975.00 euro, të cilës do t' i zbritesh shumën prej 38,000 euro e cila tashmë i ishte paguar paditësit. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar këtë ekspertizë dhe kishte propozuar nxjerrjen e një ekspertize tjetër të ndërtimtarisë, por Gjykata Themelore kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për të caktuar një ekspertizë të dytë.
26. Më 27 prill 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të ndryshohet duke e miratuar kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës ose që i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash dhe specifikisht kishte kontestuar (i) raportin e ekspertizës me pretendimin se i njëjti kishte dështuar të vlerësojë cilësinë e profileve/mbajtësve të xhamave; dhe (ii) refuzimin e Gjykatës Themelore për të miratuar ekspertizën shtesë, me qëllim të vërtetimit të cilësisë së profileve/mbajtësve të xhamave. Në kontestim të raportit të ekspertizës, parashtruesi i kërkesës i ishte referuar shkresës së përfaqësuesit gjeneral të "Alumilit" të Greqisë në Shqipëri, të 26 qershorit 2016 dhe mendimit të ekspertit I.M. të 27 prillit 2016.

27. Më 14 prill 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae. nr. 133/2016] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e vërtetuar rrjedhimisht Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
28. Më 8 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me propozimin që revizioni të miratohet si i bazuar dhe pas anulimit të dy aktgjykimeve të gjykatave më të ulëta, çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës specifikisht kishte kontestuar raportin e ekspertizës, duke u fokusuar në cilësinë e profileve/mbajtëseve të xhamave dhe vlerën e detyrimit. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës kishte ritheksuar se raporti i ekspertizës dështon të bëjë një vlerësim të saktë të cilësisë së profileve/mbajtëseve të xhamave dhe se një gjë e tillë, vërtetohet nga shkresat e “*Alumil-Albania*”, mendimi i ekspertit I.M. dhe raportit të kompanisë “*ENI Design*”, dëshmi këto të cilat parashtruesi i kërkesës, sipas pretendimit, ishte detyruar t’i sigurojë pasi që Gjykata Themelore kishte refuzuar propozimin e tij për një ekspertizë shtesë nga ana e tre ekspertëve të lëmive përkatëse, përfshirë mundësinë që të angazhohet Fakulteti Teknik i Universitetit të Prishtinës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore nuk e kishte arsyetuar refuzimin e këtij propozimi. Ndërsa, përkitazi me të dytën, përkatësisht vlerën e detyrimit, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kishte kontestuar faktin se vlera e detyrimit të përcaktuar përmes raportit të ekspertizës tejkalonte edhe vlerën e përgjithshme të detyrimeve të ndërmarra nga paditësi përmes Kontratës dhe “Ofertës” në mes palëve.
29. Më 14 shtator 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 14/2017] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. nr. 14/2017] i 14 shtatorit 2017 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara përmes nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
31. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon shkelje të (i) parimit të barazisë së armëve, për shkak të anshmërisë së

ekspertit; (ii) të drejtës së tij për t'u dëgjuar; dhe (iii) të së drejtës së tij për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

32. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës fokuson argumentimin e tij në anshmërinë e ekspertit gjyqësor. Sipas pretendimit, dhe ndër të tjera, ky i fundit (i) ka tejkaluar objektin e ekspertizës; (ii) nuk ka bërë vlerësimin e cilësisë së profileve/mbajtëseve të xhamave në raport me kriteret e përcaktuara në Kontratë, përkatësisht nuk ka sqaruar nëse profilet e aluminit/mbajtëset e xhamave të vendosur janë në gjendje të mbajnë xhamat e kontraktuar, por ka vlerësuar nëse të njëjtit janë në përputhje me *“standardet e aplikueshme në Republikën e Kosovës”* dhe *“përgjithësisht në përputhje me standardet bashkëkohore të ndërtimit”*; (iii) gabimisht ka konstatuar se *“me dakordim të dy palëve banesa nuk është marrë në kompensim”*; dhe (iv) nuk ka bazuar konstatimet e tij në fakte. Në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të parimit të barazisë së armëve si rezultat i anshëmrisë së ekspertit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës* (Aktgjykim i 27 tetorit 1993) dhe *Sara Lind Eggersdottir kundër Islandës* (Aktgjykim i 5 korrikut 2007).
33. Përkitazi me të dytën, parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta e tij për t'u dëgjuar është shkelur sepse Gjykata e Apelit, ka dështuar t' i shqyrtojë provat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht deklaratën e përfaqësuesit gjeneral të *“Alumil”*. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo provë dëshmonte pasaktësitë e raportit të ekspertizës dhe vërtetonte se profilet/mbajtëset e xhamave nuk e kishin cilësinë e duhur. Për më tepër, përmes kërkesës për revizion, një eksperitizë shtesë e bërë privatisht i ishte dorëzuar Gjykatës Supreme, dhe kjo e fundit, sipas pretendimit, nuk e ka shqyrtuar dhe as nuk i është referuar të njëjtës në arsyetimin e saj. Në këtë kontekst të detyrimit të gjykatave për të shqyrtuar provat e parashtruesit të kërkesës i referohet vendimeve të GJEDNJ-së, *Kraska kundër Zvicrrës* (Aktgjykim i 19 prillit 1993) dhe *Perez kundër Francës* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2004).
34. Përkitazi me të tretën, përkatësisht pretendimet për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore nuk e kishte arsyetuar refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për të caktuar një ekspertizë të dytë, dhe se përkundër arsyetimit të Gjykatës Themelore, paragrafi 2 i nenit 366 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) nuk e ndalon gjykatën përkatëse që të caktoj një ekspertizë të dytë.

35. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat kanë dështuar t'i arsyetojnë (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes kundërpadisë përkitazi me vonesën e paditësit, shkaktimit të fitimit të munguar dhe kërkesës për caktimin e ekspertit ekonomik për llogaritjen e dëmit në fjalë; (ii) vlerësimin e provave të dorëzuara në Gjykatën e Apelit, përkatësisht mendimin e 'Alumil' dhe atë të ekspertit I.M. të dorëzuar në Gjykatën e Apelit dhe ekspertizës private të dorëzuar në Gjykatën Supreme; (iii) lartësinë e detyrimit të përcaktuar nga raporti i ekspertizës, i cili në vlerën prej 120,975.00 euro tejkalon edhe detyrimin e përcaktuar përmes Kontratës dhe "Ofertës" në vlerën prej 79,247.40 euro; dhe (iv) konstatimin se kompensimi me banesë për gjysmën e vlerës së punëve të kontraktuara është shndërruar në kompensim në të holla, përkundër faktit se ky konstatim është në kundërshtim me Kontratën e dakorduar në mes palëve. Në mbështetje të pretendimeve të tij për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet vendimeve të GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës* (Aktgjykim i 25 shtatorit 2001) dhe *Donadze kundër Gjorgjisë* (Aktgjykim i 7 marsit 2006);
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij shpallet e pranueshme dhe që të shpallen të pavlefshme tri Aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe çështja e tij të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore në përbërje të re kolegji; ose të shpall të pavlefshme Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe atë të Gjykatës së Apelit, duke e kthyer çështjen në rivendosje në nivel apeli; ose të shpall të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen në rivendosje në Gjykatën Supreme në përbërje të re kolegji. Parashtruesi i kërkesës specifikisht thekson se rivendosja e të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës mund të arrihet vetëm përmes një rigjykimi në shkallë të parë ose të dytë.
37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon vendosjen e masës së përkohshme duke pretenduar, ndër tjerash, se vendosja e të njëjtës është në interes publik. Këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës e arsyeton me prodhimin e efekteve juridike të Aktgjykimeve e të cilat, sipas tij, nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
41. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

42. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastin e Gjykatës nr. KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev. nr. 14/2017] e 14 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
43. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
44. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kriterëve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
45. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

[...]

Dispozitat Relevante të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore

Neni 356

Gjykata, me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes.

Neni 357

357.1 Pala e cila e propozon ekspertizën ka për detyrë që në propozimin e saj ta tregojë objektin dhe vëllimin e ekspertizës dhe ta propozojë personin që do ta bëjë ekspertizën.

357.2 Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar.

357.3 Po që se palët nuk merren vesh për personin që do të bëjë ekspertizën si dhe për objektin dhe vëllimin e tij, vendimin për këtë do ta jep gjykata.

Neni 361

Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me vendim i cili duhet të përmbajë:

- a) emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit;*
- b) objektin e kontestit;*
- c) vëllimin dhe lëndën e ekspertimit;*
- d) afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit.*

Neni 366

366.1 Kur shihet se ekspertimi është i mangët ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjëres nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese. Në rast të këtillë ekspertit i caktohet një afat brenda të cilit duhet të dorëzohet konstatimi dhe mendimi me shkrim.

366.2 Po që se eksperti as pas thirrjes së gjykatës nuk e paraqet konstatimin dhe mendimin e plotë dhe të qartë, gjykata, pas deklaramentit të bërë nga palët, cakton ekspertin tjetër për ekspertim.

Neni 367

Gjykata ua dërgon palëve konstatimin dhe mendimin e shkruar së paku tetë (8) ditë para se të filloj seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Meritat

46. Gjykata rikujton që në vitin 2012, palët në kontest kishin nënshkruar një Kontratë dhe të cilës një vit më vonë, ia kishin bashkëngjitur edhe një dokument shtesë të quajtur "Ofertë", duke përcaktuar listën dhe çmimet përkatëse të dyerve dhe dritareve të cilat N.P. "Vali AL-PVC" ishte i detyruar t' i furnizoj dhe montoj për parashtruesin e kërkesës në objektin përkatës banesor "Plisi". Kontrata fillestare përcaktonte se gjysma e kompensimit bëhet nëpërmes të hollave, ndërsa gjysma tjetër përmes një banese në objektin përkatës në ndërtim. Gjatë implementimit të kësaj Kontrate, kontestuese u bë cilësia e profileve/mbajtëseve të xhamave të kontraktuara dhe të vendosura nga

- N.P. "Vali AL-PVC". Parashtruesi i kërkesës, sipas pretendimit, pas vonesave në realizimin e punëve, angazhoi një tjetër kompani dhe e cila e bëri heqjen e këtyre profileve/mbajtëseve të xhamave të vendosura nga N.P. "Vali AL-PVC". Ky veprim i parashtruesit të kërkesës rezultoi në iniciimin e procedurave gjyqësore, dhe të cilat, përmes tri Aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, përfunduan në favor të paditësit, përkatësisht N.P. "Vali AL-PVC".
47. Çështja më kontestuese përgjatë procedurave të gjykatave të rregullta dhe pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës para Gjykatës është raporti i ekspertizës i bërë në nivel të Gjykatës Themelore. Ekspertiza e bërë në nivel të kësaj gjykate ishte ngarkuar me (i) vlerësimin nëse profilet e aluminit të montuara nga paditësi ishin në përputhje me standardet ndërtimore; dhe (ii) llogaritjen e vlerës së punëve të kryera nga paditësi. Përkitazi me të parën, ekspertiza profesionale kishte konstatuar se *“dritaret dhe dyert plastike të vendosura në banesat e këtij objekti janë në përputhje me normat dhe standardet ndërtimore të aplikueshme në Republikën e Kosovës”* dhe se *“profilet e aluminit të montuara dhe ato të demoluara nga objekti ishin në përputhje me standardet ndërtimore”*; ndërsa përkitazi me të dytën, fillimisht kishte konstatuar se me dakordim të palëve, banesa nuk ishte marrë në kompensim, ndërsa vlera e punëve të kryera në objekt ishte 120,975.00 euro, dhe rrjedhimisht borxhi i mbetur 81,279.50 euro, sepse një shumë prej 38,000 ishte paguar tashmë.
48. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar konstatimet e kësaj ekspertize në nivel të Gjykatës Themelore, duke propozuar nxjerrjen e një ekspertize shtesë. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Gjykata Themelore. Në Gjykatë të Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar sërish konstatimet e ekspertizës, duke i dorëzuar edhe dy prova shtesë, shkresën e përfaqësuesit gjeneral të *“Alumilit”* të Greqisë në Shqipëri dhe mendimin e ekspertit I.M., dhe të cilat sipas parashtruesit të kërkesës vërtetojnë pasaktësinë e raportit të ekspertizës, mbi të cilin ishte bazuar vendimi i Gjykatës Themelore, në tërësinë e tij. Gjykata e Apelit kishte konfirmuar qëndrimin e Gjykatës Themelore që një ekspertizë shtesë nuk ishte e nevojshme. Në Gjykatë Supreme, parashtruesi i kërkesës sërish kontestoi konstatimet e raportit të ekspertizës, duke dorëzuar në favor të argumenteve të tij edhe një ekspertizë private. Gjykata Supreme kishte konfirmuar qëndrimin e gjykatave më të ulëta.
49. Parashtruesi i kërkesës vazhdon të kontestojë konstatimet e raportit të ekspertizës edhe në Gjykatë, duke pretenduar se eksperti përkatës ka qenë i anshëm dhe për më tepër, që gjykatat e rregullta nuk kanë shqyrtuar provat dhe dëshmitë e tij, në kundërshtim me parimin e

barazisë së armëve dhe të drejtës së tij për t'u dëgjuar, garanci këto të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, dhe siç është cekur më lart, parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e tij thelbësore.

50. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata fillimisht thekson se (i) bazuar në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, të drejtat e garantuara përmes marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare përmes saj, përfshirë KEDNJ-në, janë të drejta të garantuara edhe me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Në këtë kontekst, garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat parashtuesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të kontestuar, janë të zbatueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rendin juridik të Republikës së Kosovës, dhe për më tepër, në tërësinë e tyre janë të garantuara edhe përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës; dhe (ii) bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata detyrohet t' i interpretojë të drejtat dhe liritë themelore në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe rrjedhimisht, në vlerësimin e pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Gjykata do të aplikoj parimet relevante që ngërthen praktika gjyqësore e GJENDJ-së.
51. Më tej, Gjykata gjithashtu thekson se në trajtimin e pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, çështja esenciale ndërlidhet me raportin e kontestuar të ekspertizës dhe se, pretendimet tjera, detyrimi i gjykatave për të shqyrtuar dëshmitë dhe e drejta në një vendim të arsyetuar gjyqësor, respektivisht, ndërlidhen ngushtësisht me pretendimin esencial, përkatësisht, raportin e kontestuar të ekspertizës dhe refuzimin e Gjykatës Themelore, për të miratuar kërkesën e parashtuesit të kërkesës për një ekspertizë të dytë.
52. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim, do të shtjellojë fillimisht (i) parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me raportet e ekspertizës, anshmërinë e ekspertit dhe efektet përkatëse në parimin e barazisë së armëve, duke i aplikuar ato njëkohësisht në rrethanat e rastit konkret, për të vazhduar me trajtimin e pretendimeve tjera të parashtuesit të kërkesës, përkatësisht (ii) detyrimin e gjykatave të rregullta për vlerësimin e dëshmive dhe provave; dhe (iii) të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

I. **Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me raportin e ekspertizës dhe anshmërinë e ekspertit gjyqësor**

- (i) *Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së përkitazi me raportet e ekspertëve*
53. GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore, thekson se pranueshmëria dhe/ose refuzimi i opinioneve të ekspertëve është, në parim, çështje e gjykatave vendore. (Për më shumë detaje lidhur me raportet e ekspertëve, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të rregullt (Aspekti civil) i 31 dhjetorit 2018, IV. Kërkesat procedurale; A. Drejtësia; 6. Administrimi i provave; b. Opinionet e ekspertëve). Përveç kësaj dhe në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se refuzimi për të urdhëruar një opinion të ekspertit nuk është, në vetvete, i padrejtë. Sidoqoftë, arsyet e dhëna për refuzim përkatës duhet të jenë të arsyeshme. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Francës*, Aktgjykim i 24 tetorit 1989, paragrafët 61 dhe 70). Megjithatë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, ka zhvilluar gjithashtu një numër parimesh që kanë të bëjnë me opinionet e ekspertëve, zbatimi i të cilave është i rëndësishëm për pajtueshmërinë e procesit, në tërësinë etij, me KEDNJ-në. Në parim, GJEDNJ pohon se (i) palëve ndërgjyqëse duhet t'u jepet mundësi për të kontestuar në mënyrë efektive opinionet/dëshmitë e ekspertëve (shih rastin e GJEDNJ-së, *Letinčić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 3 majit 2016, paragrafi 50); dhe (ii) kur një ekspert është caktuar nga një gjykatë, palëve duhet t'u ofrohet mundësia të marrin pjesë në intervistat e mbajtura prej tij/saj dhe t'u tregohen dokumentet që ai/ajo ka marrë parasysh përgjatë këtij procesi. Ajo që është thelbësore është që palët të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedurë. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Letinčić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 50; dhe *Devinar kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 22 majit 2018, paragrafi 46).
54. Për më tepër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është e zhvilluar gjithashtu në lidhje me aspektet në vijim (i) neutralitetin/paanshmërinë e ekspertit; dhe (ii) ndikimin dominues të opinionit të ekspertit. Në lidhje me të parin, ajo pohon se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, nuk kërkon shprehimisht që një ekspert i dëgjuar nga një “gjykatë” të përmbush të njëjtat kritere të pavarësisë dhe paanshmërisë si vetë gjykata. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Sara Lind Eggertsdóttir kundër Islandës*, cituar më lart, paragrafi 47; dhe *Letinčić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 51). Megjithatë, ajo gjithashtu thekson se mungesa e neutralitetit nga ana e një eksperti, së bashku me pozicionin dhe rolin e tij/saj në procedurë, mund të ndikojnë në ekuilibrin e procedurave në favor të njëres palë në dëm të

tjetrës, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Sara Lind Eggertsdóttir kundër Islandës*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe *Letinčić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 51). Ndërsa, në lidhje me të dytin, ajo thekson se kur opinioni i ekspertit zë një pozitë dominuese në procedurë dhe ushtron ndikim të konsiderueshëm në vlerësimin e gjykatës, pozicioni që zë eksperti përkatës gjatë procedurës, mënyra në të cilën janë kryer detyrat e tij/saj si dhe mënyra se si gjyqtarët vlerësojnë këtë opinion, janë faktorë relevant që duhet të merren parasysh në vlerësimin nëse është respektuar parimi i barazisë së armëve. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Devinar kundër Sllovenisë*, cituar më lart, paragrafi 47; *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 37; *Letinčić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe *Mantovanelli kundër Francës*, Aktgjykim i 18 marsit 1997, paragrafi 36).

55. Gjykata vëren se çështjet që janë ngritur më shpesh në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me opinionet e ekspertëve në procedurat administrative dhe gjyqësore, ndërlidhen me neutralitetin e tyre dhe procesin përmes të cilit janë nxjerrë këto opinione/raporte. Duke marrë parasysh që këto çështje janë gjithashtu më të rëndësishmet për çështjet që ngrit rasti në fjalë, Gjykata, në vijim do të shtjellojë detajisht praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, me qëllim që të përcaktoj një emërues të përbashkët, të rëndësishëm dhe të aplikueshëm, përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë rastet (i) *Letinčić kundër Kroacisë*, që pasqyron çështje të neutralitetit dhe procesit, duke konstatuar shkelje në të dytën, por jo të parën; (ii) *Sara Lind Eggertsdóttir kundër Islandës*, që reflekton çështje të neutralitetit të një eksperti, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë drejtim; (iii) *Mantovanelli kundër Francës*, i cili pasqyron çështje të procesit, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë aspekt; dhe për krahasim, (iv) *Devinar kundër Sllovenisë*, i cili gjithashtu pasqyron çështje të procesit, por duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë drejtim.
56. Në rastin *Letinčić kundër Kroacisë*, përfshihet një parashtrues, babai i të cilit, veteran i luftës, vrau nënën e tij dhe prindërit e saj dhe më pas, bëri vetëvrasje. Familja kërkoi kompensimin përkatës në lidhje me vetëvrasjen e babait të tij, duke pretenduar se vetëvrasja ishte pasojë e çrregullimit mendor të shkaktuar nga pjesëmarrja e tij në luftë. Gjatë procedurave, ishte hartuar një raport i ekspertëve nga një institucion publik i kujdesit shëndetësor i autorizuar të japë opinione të ekspertëve përkitazi me çrregullimet psikiatrike të veteranëve të luftës. Raporti konkludoi se vetëvrasja përkatëse nuk mund t'i atribuohet shërbimit në luftë. Ky raport i ekspertëve nuk iu dërgua parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës kontestoi gjetjet e raportit përkatës përgjatë tërë procedurës administrative dhe gjyqësore, ku të gjitha pretendimet e tij u refuzuan, me Gjykatën Kushtetuese Kroate në fund, e cila deklaroi rastin si qartazi të pabazuar. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 5 deri 22 të rastit *Letinčić kundër Kroacisë*). GJEDNJ shqyrtoi rastin dhe konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ shqyrtoi dy çështje specifike në këtë rast (i) faktin që parashtruesi i kërkesës nuk i ishte dhënë mundësia të marrë pjesë në mënyrë efektive gjatë procesit të përgatitjes së raportit të ekspertit; dhe (ii) neutralitetin e ekspertit, përkatësisht nëse fakti që raporti i ekspertit ishte përgatitur nga një autoritet publik, ndikoi në neutralitetin e tij.

57. Në zhvillimin e parimeve të përgjithshme në këtë rast konkret, GJEDNJ, si zakonisht, nënvizoi se përderisa neni 6 i KEDNJ-së garanton të drejtën për gjykim të drejtë, ai nuk përcakton ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën e vlerësimit të tyre, çështje këto të cilat janë, në parim, çështje që rregullohen nga gjykata vendore. (Shih paragrafin 47 në rastin *Letinčić kundër Kroacisë* dhe referencat në të). Ajo shtoi megjithatë se parimi i barazisë së armëve, në parim, nëkupton që në një çështje gjyqësore e që përfshijnë interesa të kundërta palëve, secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj – duke përfshirë dëshmitë përkatëse - në kushte që nuk e vendosin atë në një pozitë esencialisht më të pafavorshme kundrejt kundërshtarit të tij. (Shih paragrafin 48 të rastit të GJEDNJ-së *Letinčić kundër Kroacisë* dhe referencat në të). Në veçanti, ajo vuri në dukje se kur një ekspert është caktuar nga një gjykatë, palët duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë efektivisht në intervistat e mbajtura prej tij/saj ose të kenë qasje në dokumentet që ai/ajo ka marrë parasysh gjatë përgatitjes së opinionit përkatës. (Shih paragrafin 50 të rastit të GJEDNJ-së *Letinčić kundër Kroacisë* dhe referencat në të). Për më tepër, GJEDNJ theksoi se mungesa e neutralitetit nga ana e një eksperti të caktuar nga gjykata mund të rezultoj shkelje të parimit të barazisë së armëve, parim ky i qenësishëm përkitazi me konceptin e një gjykimi të drejtë. (Shih paragrafin 51 të rastit *Letinčić kundër Kroacisë* dhe referencat në të).
58. Specifikisht për sa i përket rastit, GJEDNJ pranoi se gjetjet e ekspertëve kishin ndikim dominues në vlerësimin e fakteve nga ajo gjykatë, kryesisht sepse ndërli dhej me një fushë mjekësore që nuk ishte në dijeninë e gjyqtarëve. Ajo gjithashtu pranoi se është e kuptueshme që dyshime mund të kishin lindur në mendjen e parashtruesit të kërkesës për sa i përket paanshmërisë së raportit të ekspertëve, duke pasur parasysh që ekspertët ishin caktuar nga shteti, përkatësisht kundërshtari i tij në procedurën administrative e gjyqësore në fjalë. Megjithatë, GJEDNJ theksoi se vetë fakti që një ekspert është i

punësuar në një institucion publik, nuk e justifikon në vetvete frikën se ekspertët e punësuar në institucione të tilla nuk janë në gjendje të veprojnë në mënyrë neutrale dhe të paanshme në dhënien e mendimeve të tyre. Prandaj, GJEDNJ nuk gjeti shkelje sa i përket pretendimeve në lidhje me mungesën e neutralitetit të ekspertëve. Megjithatë, GJEDNJ vërejti se parashtuesi përkatës ishte i përjashtuar nga procedura e porositjes dhe nxerrjes së raportit të ekspertëve dhe ai mësoi për përmbajtjen e tij vetëm pas miratimit të vendimit që hodhi poshtë kërkesën e tij për kompensim. Në rrethana të tilla, GJEDNJ konstatoi se pozicioni i parashtuesit në procedurë ishte penguar seriozisht nga fakti se ai ishte i përjashtuar nga procedura e përgatitjes së raportit të ekspertëve, dhe kështu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për arsyetimin e GJEDNJ-së në lidhje me këtë rast, shih paragrafët 44 deri 68).

59. Nga ana tjetër, rasti *Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës*, përfshin një parashtuese të lindur me aftësi të kufizuara, që rezultoi në një proces gjyqësor të udhëhequr nga prindërit e saj, duke u ankuar se problemet e saj shëndetësore ishin rezultat i një trajtimi jo të duhur në spital. Gjykata respektive e rrethit konstatoi se shteti ishte përgjegjës dhe përcaktoi kompensimin përkatës. Por, ky vendim u hodh poshtë nga Gjykata Supreme, pasi kjo e fundit, kishte kërkuar dhe dëgjuar opinionin e një Bordi Shtetëror Mjeko-Ligjor (në tekstin e mëtejme: Bordi). Parashtuesit e kishin kontestuar vazhdimisht këtë opinion, duke iu drejtuar përfundimisht GJEDNJ-së. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 5 deri 25 të rastit *Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës*). Pretendimet e parashtuesit u përmblodhën nga GJEDNJ në dy kategori: paanshmëria e Gjykatës Supreme dhe ajo e Bordit, përkatësisht raportit/opinionit të ekspertizës. GJEDNJ nuk gjeti shkelje përkitazi me vendimin e Gjykatës Supreme për të kërkuar një opinion të Bordit përkatës, edhe pa pëlqimin e palëve. Megjithatë, konstatoi shkelje sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht Bordit dhe përbërjes së tij, duke marrë parasysh që katër anëtarët e saj ishin edhe mjekë në të njëjtin spital, ku pretendohet se kishte ndodhur neglizhenca mjekësore, për më tepër që, eprori i tyre kishte marrë qëndrim publik kundër vendimit të gjykatës që vendosi në lidhje me kompesimin. Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, anëtarët e Bordit kishin për detyrë të analizojnë dhe vlerësojnë punën e kolegëve të tyre në spital me qëllim që të ndihmojnë Gjykatën Supreme në përcaktimin e çështjes së përgjegjësisë së punëdhënësit të tyre. Prandaj, GJEDNJ theksoi se frika e parashtuesit për paanshmërinë e Bordit ishte legjitime dhe objektivist e justifikueshme në rrethana të këtij rasti. (Për arsyetimin e GJEDNJ-së përkitazi me këtë rast, shih paragrafët 31 deri 55).

60. Rasti *Mantovanelli kundër Francës*, përfshin parashtrues që pretenduan se spitali përkatës ishte përgjegjës për vdekjen e vajzës së tyre. Përgjatë procedurës administrative kundër spitalit, ata kërkuar caktimin e një eksperti për të përcaktuar rrethanat e vdekjes dhe përgjegjësinë e spitalit. Eksperti u caktua dhe opinioni i tij u paraqit në gjykatën përkatëse, megjithatë parashtruesit pretenduan se as ata dhe as avokati i tyre nuk ishin informuar për datat dhe hapat e ndërmarrë nga eksperti dhe se raporti i tij i referohej dokumenteve në të cilat atyre nuk u ishte mundësuar qasja. Ata rrjedhimisht pretenduan se procesi ishte në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe kërkuar që të caktohej një ekspert i ri. Gjykatat e rregullta e refuzuan një kërkesë të tillë. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 8 deri 23 të rastit *Mantovanelli kundër Francës*). GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë rast konkret. Ajo theksoi, ndër të tjera, se parashtruesve nuk u ishte mundësuar të merrnin pjesë në intervistat e ekspertëve me dëshmitarët dhe raporti iu referua dokumenteve në të cilat ata nuk kishin patur qasje. Në këtë drejtim, ajo gjithashtu theksoi se “kur një ekspert caktohet nga një gjykatë, palët duhet në të gjitha instancat të jenë në gjendje të marrin pjesë në intervistat e mbajtura prej tij ose të tregohen dokumentet që ai ka marrë parasysh”. Ajo që është thelbësore është që palët të jenë në gjendje të marrin pjesë siç duhet në procedurat para “gjykatës” dhe se në rastin përkatës, GJEDNJ theksoi se “nuk është e bindur se atyre u ishte dhënë një mundësi e vërtetë për të komentuar në mënyrë efektive lidhur me të [raportin e ekspertit]”. (Për arsyetimin në tërësinë e tij, shih paragrafët 30 deri 36 të rastit *Mantovanelli kundër Francës*).
61. Nga ana tjetër, dhe për krahasim, GJEDNJ nuk gjeti shkelje në rastin *Devinar kundër Sllovenisë*. Në këtë rast përfshihej një parashtruese e cila pretendonte se i ishte shkaktuar një paafësi e pjesshme gjatë punës si pastruese. Një komision publik i aftësisë së kufizuar lëshoi një raport duke kontestuar këtë pretendim. Parashtruesja kontestoi gjetjet e këtij komisioni dhe propozoi që të caktohej një ekspert mjekësor. Gjykatat refuzuan kërkesën e parashtrueses për caktimin e një eksperti mjekësor. Vendimet e gjykatave të rregullta u miratuan edhe nga Gjykata Kushtetuese. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 5 deri 21 të rastit *Devinar kundër Sllovenisë*). Në ngritjen e rastit të saj para GJEDNJ-së, parashtruesja theksoi se ishte shkelur parimi i barazisë së armëve, sepse asaj iu mohua mundësia për të pasur një ekspert të pavarur të caktuar nga gjykata. Ajo gjithashtu deklaroi që komisioni që lëshoi raportin nuk ishte i pavarur/neutral pasi u caktua nga pala kundërshtarë, përkatësisht shteti. Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtrueses, GJEDNJ fillimisht theksoi se duhet të merret parasysh se opinionet e ekspertëve të dhëna nga komisioni kishin një rol vendimtar dhe ndikim dominues në vlerësimin e gjykatës lidhur me

meritat e rastit. GJEDNJ gjithashtu pranoi që përderisa mund të ketë patur dyshime legjitime në mendjen e parashtrueses në lidhje me paanshmërinë e ekspertëve, duke pasur parasysh që ata ishin caktuar nga komisioni, përkatësisht kundërshtari i saj në procedurë, në rrethanat e këtij rasti, këto dyshime nuk ishin objektivisht të justifikueshme. Ndërsa, sa i përket kërkesës për një ekspert të pavarur, përkatësisht ekspertizë të re, GJEDNJ theksoi që parashtruesja kishte pasur mundësi që të kontestojë opinionin e komisionit në gjykata; që ajo kishte dijeni për të dhe pati mundësi që t'i kontestojë gjetjet përkatëse me shkrim, si dhe në seancën shqyrtuese para gjykatës. Gjykata gjithashtu vërejt se parashtruesja mund të kishte parashtruar kundërshtime specifike në lidhje me gjetjet e raportit të ekspertizës, por ajo dështoi të paraqesë argumente bindëse që do t'i vinte në dyshim gjetjet e raportit të ekspertizës, përveç kontestimit të tyre. Prandaj, parashtruesja nuk arriti të vërtetojë në shkallën minimale të nevojshme kërkesën e saj për caktimin e një eksperti të ri. (Për arsyetimin e rastit, shih paragrafët 37 deri 59 të rastit *Devinar kundër Sllovenisë*).

62. Thënë të lartcekurat, Gjykata gjithashtu vëren se, në rrethana të caktuara, GJEDNJ gjithashtu ka konstatuar shkelje, kur gjykata ka refuzuar kërkesat për caktimin e një eksperti të ri, dhe për këtë arsye, GJEDNJ gjithashtu pohon se në rrethana të caktuara, refuzimi për të lejuar një ekzaminim alternativ të ekspertëve mund të rezultoi në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Van Kück kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 12 qershorit 2003). Rasti *Van Kück kundër Gjermanisë*, është shembull në këtë drejtim. Ky rast përfshin një pretendim të një transgjinori kundër një kompanie të sigurimeve shëndetësore për pagesën e shpenzimeve mjekësore, përfshirë operacionin për ricaktimin gjinor. Gjykata përkatëse gjermane urdhëroi një raport të ekspertit lidhur me çështjet e transeksualitetit të parashtruesit të kërkesës dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes kirurgjike për ricaktimin gjinor. Raporti i ekspertit nuk ishte vendimtar dhe as përcaktues përkitazi me këtë të fundit. Megjithatë, gjykatat, si ato rajonale, ashtu edhe ato të apelit, refuzuan pretendimet e parashtruesit, duke theksuar se ndërhyrja kirurgjike nuk ishte trajtimi i vetëm i mundshëm sepse ekspertiza përkatëse nuk kishte konfirmuar qartë “domosdoshmërinë” e një operacioni. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 8 deri 38 të rastit *Van Kück kundër Gjermanisë*). GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në këtë rast konkret, duke u përqendruar në nevojën për sqarime shtesë në lidhje me ekspertizën përkatëse bazuar në të cilën gjykatat e rregullta morën vendimet e tyre. GJEDNJ konstatoi se ekspertiza në bazë të së cilës gjykatat refuzuan pretendimet e parashtruesit nuk ishte përcaktuese sa i përket çështjes kryesore të “domosdoshmërisë” të ndërhyrjes

kirurgjike, dhe për këtë arsye, do të duhet të ishin kërkuar sqarime shtesë dhe/ose të ishte urdhëruar një ekspertizë e re për çështjen specifike. (Për arsyetimin e rastit, shih paragrafët 38 deri 65 të rastit *Van Kuck kundër Gjermanisë*).

63. Pasi janë shtjelluar parimet thelbësore të zhvilluara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në lidhje me raportet e ekspertëve të urdhëruara në procedurat administrative dhe gjyqësore, Gjykata thekson përsëri se GJEDNJ, në parim, pohon se procedurat duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre në mënyrë që të përcaktohet pajtueshmëria e tyre me nenin 6 të KEDNJ-së. Më konkretisht, përkitazi me raportet e ekspertëve, në parim praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, pohon se (i) refuzimi për të urdhëruar një mendim të ekspertit nuk është, në vetvete, i padrejtë; (ii) refuzimi i tyre duhet të arsyetohet dhe duhet të jetë i arsyeshëm; (iii) nëse urdhërohet, palëve ndërgjyqëse duhet t'u jepet mundësi për t' i kontestuar në mënyrë efektive opinionet e ekspertëve dhe ato duhet të kenë mundësinë që përgjatë gjithë procesit të marrin pjesë në intervistat e mbajtura dhe dokumentet e përdorura për qëllime të ekspertizës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur raporti i ekspertëve konsiderohet të ketë një ndikimin dominues në vendimin përfundimtar të gjykatës; dhe që (iv) mungesa e neutralitetit nga ana e një eksperti, së bashku me pozicionin dhe rolin e tij/saj në procedurë, mund të ndikojë në ekuilibrin e procedurave në favor të njërës palë në dëm të palës tjetër, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve. Gjykata në vazhdim do të zbatojë këto parime, në rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

(ii) *Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret*

64. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se eksperti S.B. ka qenë i anshëm; që raporti i tij ka patur ndikim dominues në procedurat para gjykatave të rregullta, dhe që kërkesa e tij për një ekspertizë të re do të duhet të jetë miratuar, në të kundërtën, sipas parashtruesit të kërkesës, parimi i barazisë së armëve është shkelur në dëm të tij, duke rezultuar kështu në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
65. Përkitazi me ekspertizën, Gjykata fillimisht rikujton se bazuar në Aktgjykimin [IC. nr. 660/2013] e 31 marsit 2016 të Gjykatës Themelore, ajo është caktuar në seancën e 15 korrikut 2015. Aktgjykimi përkatës reflekton se (i) vendimi për nxerrjen e provës së ekspertizës së ndërtimatisë është nxjerrë sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse; (ii) për këtë ekspertizë ka përcaktuar ekspertin gjyqësor S.B.; dhe se (iii) raporti i tij është paraqitur në seancë dhe se palët kanë patur

mundësi të parashtrojnë pyetje dhe të dhënë sqarime shtesë. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se ekspertit përkatës i është caktuar detyra e (i) konstatimit nëse *“profilët e aluminit të montuara nga paditësi kanë qenë në përputhje me standardet ndërtimore”*; dhe (ii) *“e llogaritjes së vlerës së punëve të kryera në objektin banesor-afarist kolektiv”*.

66. Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore, në këtë kontekst thekson:

“Në seancën degjimore të datës 15.07.2015, gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka marrë vendim për nxjerrjen e provës së ekspertizës së ndërtimtarisë. Për ekspertizën e ndërtimtarisë, gjykata ka caktuar ekspertin gjyqësor z. Selman Buqolli. Eksperti gjyqësor e ka punuar raportin e ekspertizës dhe është dëgjuar në seancë ku është përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga palët dhe ka dhënë sqarime shtesë në çështjet e ngritura gjatë gjykimit”.

67. Nga shkresat e lëndës rezulton se ekspertiza është kundërshtuar nga parashtruesi i kërkesës në seancën e 3 shkurtit 2016 dhe është propozuar nxjerrja e një ekspertize tjetër të ndërtimtarisë. Ky propozim është refuzuar nga gjykata përmes Aktvendimit përkatës duke u bazuar në nenin 366 të LPK-së. Ky i fundit përcakton dy mundësi mbi bazën e të cilave mund të kërkohej sqarime plotësuese ose caktohet një ekspert i ri - nëse në vlerësimin e gjykatës raporti i ekspertit është *“i mangët ose i paqartë”* ose ka *“ndryshim mendimesh midis ekspertëve”*, respektivisht. Në vlerësimin e gjykatës ky nuk ishte rasti në rrethanat e rastit konkret. Gjukata Themelore në këtë aspekt, sqaroi:

“Në seancën e datës 03.02.2016, i autorizuari i kundër-paditësit ka propozuar nxjerrjen e një ekspertize tjetër të ndërtimtarisë, përmes grupit të ekspertëve të ndërtimtarisë, por gjykata me aktvendim e ka refuzuar një propozim të tillë. Me nenin 366 të LPK-së është përcaktuar se nëse raporti i ekspertizës është i mangët ose i paqartë, dhe eksperti nuk arrinë as pas thirrjes së gjykatës që t’i mënjanojë të metat e raportit të ekspertizës, gjykata cakton një ekspertizë tjetër. Pra, kushti ligjor për ekspertizë tjetër është që ekspertiza e punuar të jetë e mangët ose e paqartë. Në rastin konkret, gjykata ka vlerësuar se përmbajtja e raportit të ekspertizës së ndërtimtarisë dhe sqarimet e ekspertit të bëra gjatë seancës, kanë bërë që të kemi një ekspertizë gjyqësore të qartë, pa mangësi dhe pa ndonjë të metë që do të vënte në dyshim saktësinë e saj. Rrjedhimisht, nuk ka pasur kushte ligjore dhe ka qenë e panevojshme që procesi të ngarkohet me ekspertizë tjetër”.

68. Gjykata Themelore më tutje gjithashtu sqaroi se bazuar në nenin 356 të LPK-së, është në diskrecionin e saj, duke vlerësuar rrethanat e secilit rast, nëse ka nevojë për një ekspertizë apo edhe për përsëritjen e saj, duke theksuar se në rrethanat e rastit konkret *“gjykata ka vlerësuar se ekspertiza e ndërtimtarisë e punuar në këtë çështje kontestimore ka plotësuar kriteret ligjore për t'u trajtuar si provë, ndërsa lidhur me përmbajtjen e saj, gjykata ka bërë vlerësimin e lirë të sajë konform nenit 8.2 të LPK-së. Për arsyet dhe rrethanat e lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundimin se një ekspertizë tjetër e ndërtimtarisë, e propozuar nga kundërpaditësi, është e panevojshme, e tepërt dhe se vetëm e zvarritë procesin kontestimor”*.
69. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, shqyrtuan çështjen e ekspertizës së ngritur para tyre përmes ankesës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë respektivisht, dhe të dyja konfirmuan qëndrimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konfirmoi qëndrimin e kësaj të fundit se ekspertiza nuk ishte *“e mangët ose e paqartë”* dhe se për të gjitha çështjet kontestuese, eksperti përkatës kishte dhënë sqarimet e tij përtej ekspertizës, edhe në seancën e 24 dhjetorit 2015 e edhe në parashtresën e 28 janarit 2016, ku, sipas Gjykatës së Apelit *“i ka sqaruar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse konstatimet e tij, e të cilat konstatime kanë mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës”*. Në anën tjetër, Gjykata Supreme, gjithashtu specifikisht ka adresuar pretendimet e parashtresës të kërkesës përkitazi me refuzimin e Gjykatës Themelore për caktimin e një ekspertize të re. Ajo, përmes Aktgjykimit [IC.nr.660/2013] të 31 marsit 2016, në këtë aspekt, ndër të tjera, ka theksuar:

“Pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore procedurale të cilat sipas të paditurit qëndrojnë në atë se gjykata shkallës së parë nuk ka pranuar propozimin e të paditurit për nxjerrjen e provës së re nga ana tre ekspertëve të lëmisë përkatëse, gjykata e revizionit e refuzoi si të pabazuar, kjo ngase në këtë çështje juridike gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar propozimin për të nxjerr si provë të re ekspertizën nga tre ekspert, pasi që ekspertiza e ndërtimtarisë në shkresat e lëndës nuk ka qenë e paqartë dhe e mangët. Se përmbajtja e raportit të ekspertizës së ndërtimtarisë dhe sqarimet e ekspertit të dhëna në seancë gjyqësore, kanë bërë që ekspertiza gjyqësore nga lëmi i ndërtimtarisë të jetë e qartë, pa mangësi dhe pa ndonjë të metë që do të vinte në dyshim aprovimin e saj, dhe rrjedhimisht, me të drejtë e njëjta gjykatë ka konkluduar se nuk ka pasur kushte ligjore, dhe se ka qenë e panevojshme që të nxirret edhe një ekspertizë e re për të njëjtën çështje. Në kuptim të nenit 319.3 të

LPK-së, vetëm gjykata vendos se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare. Në këtë çështje juridike, eksperti i ndërtimtarisë është thirrur në seancë gjyqësore në të cilën ai ka dhënë sqarime plotësuese për mendimin e konstatimit të tij, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për vërtetimin dhe sqarimin e fakteve e rrethanave për të cilat gjyqtari i çështjes nuk ka dijeni profesionale”.

70. Gjykata në këtë kontekst, së pari rikujton se si parim i përgjithshëm, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së refuzimi për miratimin e kërkesës për një ekspertizë nuk është detyrues i padrejtë dhe nuk rezulton në vetvete në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, një refuzim i tillë duhet të jetë i arsyetuar dhe Gjykata, bazuar në sqarimet e mësipërme, konsideron se ky është rasti në rrethanat e rastit konkret. Duke u referuar në nenin 366 të LPK-së, Gjykata Themelore e mbështetur edhe nga Gjykata e Apelit dhe Supreme, ka konstatuar se në rrethanat e rastit konkret, dhe duke marrë parasysh se raporti i kontestuar i ekspertizës nuk “është i mangët dhe i paqartë”, nuk plotësohen rrethanat për caktimin e një ekspertize të re.
71. Megjithatë, dhe siç është theksuar më lart, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, anshmëria e ekspertit përkatës dhe pamundësia e njëres palë për të kontestuar në mënyrë efektive raportin e ekspertit mund të rezultojnë, në rrethana të caktuara, në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
72. Në kontekst të të parës, përkatësisht paanshmërisë së ekspertit e që përbën një ndër pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës në këtë rast, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe bazuar në të cilën mungesa e neutralitetit/paanshmërisë së ekspertit, analizuar në tërësinë e rolit të tij në proces, mund të favorizojë njërën palë në dëm të tjetrës. Në këtë kontekst, GJEDNJ po ashtu thekson se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përcakton shprehimisht që një ekspert i dëgjuar nga një gjykatë, duhet detyruesisht t'i plotësojë kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë të kërkuara për vet gjykatën. Megjithatë, ngjashëm me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkritazi me paanshmërinë e një gjykate, edhe në kontekst të ekspertëve të angazhuar në proces gjyqësor, GJEDNJ vlerëson nëse ka dyshime legjitime për paanshmërinë e ekspertit dhe nëse këto dyshime janë objektivist të justifikueshme.
73. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përkritazi me pretendimet që ndërlidhen me paanshmërinë e ekspertit, reflektohet edhe në rastet e GJEDNJ-së të cituara më lart, dhe posaqërisht rastin *Letinčić kundër*

Kroacisë dhe Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës. Në të parin, GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së përkitazi me paanshmërinë e ekspertit duke theksuar, ndër tjerash e në esencë, se vetëm fakti që eksperti ka qenë i punësuar në një institucion publik, dhe që në rrethanat e rastit, ka qenë pala kundërshtare e parashtruesit, nuk rezulton në shkelje të KEDNJ-së. GJEDNJ theksoi se përkundër që një fakt i tillë mund të ngritë dyshime legjitime për paanshmërinë e tij, nuk mjafton që të njëjtat të jenë objektivisht të justifikueshme. Në anën tjetër dhe për dallim, GJEDNJ gjeti shkelje lidhur me paanshmërinë e ekspertit në rastin *Sara Lind Eggertsdottir kundër Islandës*, por sepse, siç është sqaruar më lart, shumica e anëtarëve të Bordit dhe i cili kishte dhënë opinionin/raportin gjykatës përkatëse, ishin pjesë dhe vartës, të palës kundërshtare në procesin gjyqësor.

74. Parashtruesi i kërkesës në rrethanat e rastit konkret, nuk ngrit asnjë argument konkret që ndërlidhet me anshmërinë e pretenduar të ekspertit përkatës. Parashtruesi i kërkesës nuk argumenton dyshimet e tij legjitime lidhur me paanshmërinë e tij dhe as pse të njëjtat mund të jenë objektivisht të justifikueshme. Argumentet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me anshmërinë e ekspertit ndërlidhen në fakt me përmbajtjen e raportit të ekspertizës. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të shërbejnë për të konstatuar se eksperti përkatës nuk ka qenë i paanshëm në procesin gjyqësor. Por të njëjtat, mund të përdoren për të argumentuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi për të marrë pjesë efektivisht në procesin e përpilimit të raportit dhe as të kontestojë efektivisht gjetjet e tij.
75. Në këtë kontekst, Gjykata ndërlidhet me çështjen e dytë të indentifikuar më lart, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës ka patur mundësinë e pjesëmarrjes dhe të kontestimit në mënyrë efektive të gjetjeve të raportit të kontestuar të ekspertizës në përputhshmëri me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së.
76. Gjykata edhe një herë rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston përmbajtjen e raportit të ekspertizës dhe faktin që një ekspertizë e re nuk është miratuar nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me objektin e ekspertizës. Ai pretendon se ekspertiza e kontestuar dështon të vërtetojë faktin thelbësor përkitazi me çështjen kontestuese dhe përkatësisht nëse profilet e aluminit/mbajtëset e xhamave janë të përshtatshme për xhamat e kontraktuar dhe jo përputhshmëria e tyre me standardet e ndërtimit në Republikën e Kosovës.

77. Gjykata në këtë kontekst thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së palëve në procesin e caktimit, hartimit dhe shqyrtimit të një raporti të ekspertizës. Një gjë e tillë është e garantuar edhe përmes LPK-së, KEDNJ-së, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Kushtetutës.
78. Përkitazi më LPK-në, Gjykata vë theks në nenet 357, 361 dhe 367 të tij. Sipas tyre, palët përtej mundësisë për propozimin e ekspertizës, gjithashtu kanë mundësinë të propozojnë objektin, vëllimin e edhe personin përgjegjës për ekspertizën. Nga shkesat e lëndës dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës të ketë kontestuar objektin e lëndën e ekspertizës. Përkundrazi, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore reflekton se palët kanë patur pajtueshmëri në këtë aspekt në seancën e 15 korrikut 2015. Për më tepër, nga shkresat e lëndës dhe vet raporti i ekspertizës rezulton që palët kanë qenë të përfshira në procesin e hartimit të të njëjtit. Më tej, bazuar në nenin 367 të LPK-së, gjykata është e detyruar t'ua dërgon palëve konstatimin dhe mendimin e shkruar së paku 8 (tetë) ditë para se të filloj seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes. Parashtruesi i kërkesës nuk pretendon të mos ketë pasur qasje në raportin e ekspertizës apo të mos e ketë pranuar të njëjtin me kohë.
79. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që (i) një seancë shqyrtimi përkitazi me këtë raport të jetë mbajtur më 24 dhjetor 2015, në të cilën është diskutuar raporti i ekspertizës dhe palët kanë pasur mundësi të shtrojnë pyetje dhe ofrojnë sqarime; (ii) një parashtrësë shtesë është dorëzuar nga eksperti më 28 janar 2016; dhe (iii) më 3 shkurt 2016, është mbajtur edhe një seancë tjetër shqyrtimi në të cilin është diskutuar raporti i ekspertit përkatës.
80. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës ka patur mundësi të arsyeshme dhe efektive për të kontestuar gjetjet e raportit të ekspertizës. Një mundësi e tillë ndërlihet me përcaktimin e ekspertizës, përfshirë objektin e saj, procesin e hartimit të kësaj ekspertize dhe diskutimin e saj në seancat shqyrtuese në Gjykatën Themelore. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë se parashtruesi i kërkesës ka patur mundësi efektive të marrë pjesë në procesin e bërjes së tij dhe mundësi efektive për të kontestuar të njëjtin.
81. Gjykata në mbështetje të këtij konstatimi, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo e fundit, konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së në rastin *Letinčić kundër Kroacisë*, jo sepse argumentet e parashtruesit përkatës nuk ishin marrë parasysh në lidhje me raportin e ekspertizës përgjatë procedurave gjyqësore, por sepse parashtruesi përkatës nuk kishte pasur fare qasje në raportin e ekspertizës. Ngjashëm, në rastin *Mantovanelli kundër Francës*,

GJENDJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së sepse parashtuesit përkatës nuk kishin pasur qasje në raportin e ekspertizës para se i njëjti të prezentohej para gjykatës. Në të kundërtën, GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në rastin *Devinar kundër Sllovenisë*, sepse në këtë rast parashtuesi përkatës kishte patur qasje në raportin përkatës por nuk ishte pajtuar me gjetjet e tij dhe kishte kërkuar përcaktimin e një eksperti të ri, kërkesë kjo e cila ishte refuzuar. GJEDNJ në këtë rast, vuri theks në faktin që parashtuesja përkatëse kishte patur mundësi të kontestojë gjetjet e raportit të ekspertizës para gjykatës, me shkrim dhe gojarisht në shqyrtim gjyqësor. GJEDNJ theksoi se e njëjta kishte kontestuar raportin e ekspertizës por nuk kishte argumentuar mjaftueshëm kundërshtimin për raportin ekzistues dhe arsyeshmërinë për caktimin e një eksperti të ri. Rrethanat e parashtuesit të kërkesës përkojnë me rastin *Devinar kundër Sllovenisë* në këtë aspekt, dhe jo me ato të *Letinčić kundër Kroacisë* e *Mantovanelli kundër Francës* e në të cilat GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse parashtuesit përkatës nuk kishin pasur qasje fare në raportet përkatëse të ekspertizës dhe rrjedhimisht, u ishte pamundësuar kontestimi i gjetjeve të raporteve të ekspertizës në mënyrë efektive.

82. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mosmiratimi i kërkesës për një ekspertizë të re mund të rezultojë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Përtej rasteve të mungesës së vendimit të arsyetimit gjyqësor, shembull i një rrethane të tillë është rasti i sqaruar më lart, *Van Kück kundër Gjermanisë*. Gjykata thekson megjithatë se në këtë rast, ekspertiza kishte dështuar të jap një përgjegje përcaktuese për njërën nga çështjet përfshira në objektin e saj, përkatësisht “*nevojën për një operacion për ndërrim gjinie*”, çështje kjo e cila ishte thelbësore në refuzimin e kërkesës për kompenzim të parashtuesit përkatës.
83. Gjykata thekson se ky rast dallon nga rrethanat e rastit konkret. Kjo sepse përkundër pretendimeve të parashtuesit të kërkesës që thelbi i kontestit në rastin e tij është nëse profilet e aluminit/mbajtëset e xhamave ishin të përshtatshëm për xhamat e kontraktuar, dhe jo nëse të njëjtit ishin në përputhje me “*standardet e aplikueshme në Republikën e Kosovës*” dhe “*përgjithësisht në përputhje me standardet bashkëkohore të ndërtimit*”, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se këto të fundit janë pikërisht detyra e cila iu përcaktua ekspertit përkatës, detyrë kjo që, bazuar në shkresat e lëndës, nuk ishte kontestuar në seancën e përcaktimit të objektit të ekspertizës dhe ekspertit përkatës në Gjykatën Themelore. Më specikisht, dhe siç është cekur edhe më lart, nga shkresat e lëndës rezulton se ekspertit iu caktuan dy detyra: (i) “*konstatimi nëse profilet e aluminit të montuara nga paditësi, kanë*

qenë në përputhje me standardet ndërtimore”, dhe “llogaritja e vlerës së punëve të kryera në objektin banesoro-afarist kolektiv, ku investitor ishte N.T. “CEIKU ROLLERS” (I Padituri -Kundërpaditësi), ndërsa Punëkryes-Kontraktues ishte Paditësi -Kundërpadituri (N.P. “Vall AL-PVC”)”. Rrjedhimisht, kontestimi i raportit të ekspertizës ndërlidhet me objektin e ekspertizës, dhe të cilën parashtruesi i kërkesës, bazuar në dispozitat e lartcekura të LPK-së ka patur mundësi t’a kundërshtoj në fazën e përcaktimit të tij nga gjykata.

84. Për më tepër që, rasti *Dombo Beheer B.V kundër Holdandës*, cituar më lart, dhe të cilit parashtruesi i kërkesës i referohet në mbështetje të argumenteve të tij, nuk është i aplikueshëm për rrethanat e rastit konkret. Rasti *Dombo Beheer B.V kundër Holdandës*, është rast në të cilin GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të parimit të barazisë së armëve, por jo për çështje që ndërlidhen me ekspertizën, por sepse vetëm dëshmitari kyq i njëres palë ishte dëgjuar para gjykatës, duke e vendosur palën tjetër në disavantazh të dukshëm. (Shih arsyetimin e rastit përkatës në paragrafët 30 deri 35 të rastit *Dombo Beheer B.V kundër Holdandës* në raport më faktet e tij në paragrafët 7 deri 22).
85. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaston se në kontekst të (i) paanshmërisë së ekspertit, parashtruesi i kërkesës nuk argumenton dyshimet legjitime për paanshmërinë e ekspertit dhe as pse të njëjtat mund të jenë objektivisht të justifikueshme në rrethanat e rastit konkret, për më tepër që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të konkludohet se eksperti përkatës nuk ka qenë natural apo i paanshëm; (ii) procedurës së ndjekur për përpilimin e raportit të ekspertizës, parashtruesi i kërkesës ka patur mundësi efektive pjesëmarrjeje dhe kontestimi të gjetjeve të tij; dhe (iii) përcaktimit të ekspertizës së re, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar mjaftueshëm mangësitë dhe paqartësitë e raportit të kontestuar përgjatë seancave shqyrtuese dhe nuk ka argumentuar mjaftueshëm kërkesën e tij për të përcaktuar një ekspertizë të re.

II. Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me shqyrtimin e provave dhe mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor

86. Gjykata më tej do t’i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me (i) shkeljen e të drejtës së tij për t’u dëgjuar; dhe (ii) mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor.

(i) *Sa i përket pretendimeve për shkeljen e të drejtës për t’u dëgjuar*

87. Parashtruesi i kërkesës, në esencë, pretendon se drejta e tij për t'u dëgjuar është shkelur si rezultat i dështimit të gjykatave për të shqyrtuar provat e paraqitura nga ai përgjatë procesit gjyqësor. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës vë theks në detyrimin e gjykatave për të vlerësuar në mënyrë të duhur parashtresat, argumentet dhe provat e dorëzuara nga palët. Siç është sqaruar më lart, ai pretendon se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, kanë dështuar t' i shqyrtojnë provat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës në mbështetje të mangësive dhe paqartësive të raportit të kontestuar të ekspertizës së bërë në Gjykatën Themelore, dhe rrjedhimisht kërkesës së tyre për një ekspertizë të re. Parashtruesi i kërkesës specifikisht u referohet, deklaratës së përfaqësuesit gjeneral të “*Alumil*” dhe mendimit të ekspertit I. M. të dorëzuar në Gjykatë të Apelit dhe ekspertizës private të dorëzuar në Gjykatë Supreme.
88. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, vë theks në faktin se KEDNJ nuk përcakton rregulla mbi provat si të tilla dhe se pranueshmëria e provave dhe mënyra se si duhet të vlerësohen janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen me ligjin dhe nga gjykatat vendore. Megjithatë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së gjithashtu përcakton se detyra e Gjykatës, sipas KEDNJ-së, është të vërtetojë nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duke përfshirë mënyrën në të cilën ishin marrë provat. Qëllimi i KEDNJ-së, sipas GJEDNJ-së, është të garantojë jo të drejta që janë “*teorike ose iluzore*”, por të drejta që janë “*praktike dhe efektive*” dhe që kjo e drejtë mund të jetë efektive vetëm nëse këndvështrimet e palëve vërtetë “*dëgjohen*” dhe shqyrtohen në mënyrë të duhur nga gjykatat e fakteve. Prandaj, ajo duhet të përcaktoj vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që të garantojnë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. GJEDNJ gjithashtu thekson se është detyrë e gjykatave vendore të bëjnë një shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët. (Për më shumë përkritazi me administrimin e provave, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të rregullt (Aspekti civil) i 31 dhjetorit 2018,; IV. Kërkesat procedurale; A. Drejtësia; 6. Administrimi i provave).
89. Gjykata vëren se detyra e gjykatave të rregullta për të kryer një shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, u theksua, ndër të tjera, edhe në dy raste të GJEDNJ-së, *Kraska kundër Zvicrës* dhe *Perez kundër Francës*, aktgjykime të cilat janë referuar edhe nga parashtruesi i kërkesës në mbështetje të argumenteve të tij. Megjithatë, Gjykata vëren se, përderisa këto dy raste, vendosin parimet themelore që kanë të bëjnë me administrimin e provave dhe detyrën e gjykatave të rregullta të

shqyrtojnë ato, GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në asnjë nga këto dy raste.

90. Më konkretisht, rasti i GJEDNJ-së *Perez kundër Francës*, përfshin një parashtruese e cila pretendon se është sulmuar nga dy fëmijët e saj si pasojë e një mospagese në të cilën ajo kishte të drejtë për shkak të problemeve përkatëse shëndetërore. Në procedurën e shkallës së parë, gjyqtari hetues përcaktoi se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme në mbështetje të pretendimeve të saj dhe vendosi që nuk ishte praktike të intervistonte djalin e saj, përkatësisht të akuzuarin, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në faktin se ai jetonte jashtë vendit. Parashtruesja paraqiti ankesë. Gjykata e Apelit vendosi që ankesa e saj ishte e papranueshme me arsyetimin se ajo kishte humbur afatin ligjor për ankesë dhe nuk kishte nënshkruar njoftimin e ankesës. Ankesa e saj e mëtejshme gjithashtu u hodh poshtë nga Gjykata e Kasacionit. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 8 - 17 të rastit të GJEDNJ-së *Perez kundër Francës*).
91. Në shqyrtimin e rastit, GJEDNJ theksoi se e drejta për një gjykim të drejtë siç garantohet me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën e palëve të paraqesin dëshmitë/vërejtjet që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre. Qëllimi i KEDNJ-së, sipas arsyetimit të këtij rasti, është të garantojë, jo të drejta që janë “teorike ose iluzore”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive”, duke theksuar se efekti i nenit 6 të KEDNJ-së është, ndër të tjera, për ta vendosur “gjykatën” nën detyrimin të kryejë një shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e tyre nëse ato janë relevante. (Shih paragrafin 80 dhe referencat e tij në rastin *Perez kundër Francës*). Megjithatë, GJEDNJ nuk gjeti asnjë shkelje në këtë rast. Ajo theksoi se në rrethanat e rastit, nuk është funksioni i saj të merret me gabime të fakteve ose ligjit që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë vendore, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me KEDNJ dhe konstatoi se Gjykata e Kasacionit mori parasysh dhe adresoi në mënyrë efektive të gjitha bazat e ankesës së parashtrueses përkatëse. (Për arsyetimin, shih paragrafët 76 deri 84 të rastit *Perez kundër Francës*).
92. Në mënyrë të ngjashme, në rastin *Kraska kundër Zvicrës*, përfshihet një parashtrues, autorizimi i të cilit për të ushtruar profesionin e tij mjekësor u tërhoq sepse ai nuk jetonte më në kantonin përkatës. Ai ndërkohë kishte trajtuar një pacient dhe më pas ishte ngritur një ndjekje penale ndaj tij, ndër të tjera, për mashtrim, akuza që u hodhën poshtë më pas. Megjithatë, kërkesa e tij e ardhshme për një autorizim u refuzua, sepse ai nuk konsiderohej “i besueshëm” brenda kuptimit të

ligjit të aplikueshëm. Në procedurat para gjykatave, pretendimet e tij u hodhën poshtë. Megjithatë, gjatë diskutimeve në shqyrtim gjyqësor, njëri prej gjyqtarëve deklaroi, ndër të tjera, se ai nuk kishte qenë në gjendje të lexonte dhe analizonte tërë dosjen. Përkundër kësaj, vendimi përfundimtar i gjykatës u nxor. Më pas, parashtuesi kërkoi katër herë rihapjen e procedurave, duke u ankuar se vendimi kundër tij ishte marr pa njohuri të mjaftueshme të gjyqtarëve për dosjen. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 6 deri 17 të *Kraska kundër Zvicrës*). Në shqyrtimin e rastit, GJEDNJ gjithashtu theksoi se efekti i paragrafit 1 të nenit 6 përfshin qëllimin për të vendosur “gjykatën” nën detyrimin e shqyrtimit të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e tyre nëse ato janë relevante për vendimin e saj. Megjithatë, ajo gjithashtu konstatoi që, në rrethanat e rastit konkret, nuk kishte prova që sugjerorin që anëtarët e gjykatës nuk e shqyrtuan ankesën me kujdes të duhur para se të marrin vendimin e tyre, dhe për këtë arsye hodhi poshtë ankesën e parashtresit përkatës për shkak se nuk ishte e argumentuar mjaftueshëm, duke mos gjetur shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për arsyetimin e rastit, shih paragrafët 28 deri 34 të *Kraska kundrejt Zvicrës*).

93. Në kontekst të pretendimeve të parashtresit të kërkesës, Gjykata fillimisht thekson se nga shkresat e lëndës nuk rezulton, se përkundër kontestimit të raportit, ai të ketë prezentuar dëshmi para Gjykatës Themelore, për të kundërgargumentuar raportin e ekspertizës. Gjykata vëren se që nga seanca dëgjimore e 15 korrikut 2015, seanca e 16 tetorit 2015, ajo e 24 dhjetorit 2015, e deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës Themelore më 31 mars 2016, nga shkresat e lëndës dhe bazuar në pretendimet e parashtresit të kërkesës, nuk rezulton që parashtuesi i kërkesës të ketë ofruar dëshmi konkrete në kontestim të raportit të ekspertizës. Në ankesën e bërë në Gjykatën e Apelit, parashtuesi i kërkesës kishte përfshirë dy dëshmi në kundërshtim të raportit të ekspertizës, mendimin e ekspertit I.M. të 27 prillit 2016 dhe shkresës së përfaqësuesit gjeneral të “*Alumilit*” të Greqisë në Shqipëri, të 26 qershorit 2016, respektivisht, ndërsa përmes revizionit në Gjykatën Supreme kishte dorëzuar ekspertizën private të 2 qershorit 2017.
94. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae. nr. 133/2016] të 14 prillit 2017, kishte vlerësuar se Gjykata Themelore kishte vepruar drejt kur kishte bazuar vendimin e saj në raportin e ekspertizës, sqarimet e dhëna në seancën e 24 dhjetorit 2015 dhe parashtresën e 28 janarit 2016. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për shkak se, nga provat që gjenden

në shkresat e lëndës nuk është kontestuese se paditësi i ka kryer punët e kontraktuara, për të cilat është aprovuar shuma e borxhit nga gjykata e shkallës së parë. Kjo shumë është vërtetuar edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ndërtimtarisë z. Selman Boqolli, të dhënë në ekspertizën e tij të datës 27.09.2015, dhe sqarimet e të njëjtin në seancën e datës 24.12.2015 si dhe me parashtrësën e datës 28.01.2016, ku i ka sqaruar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse konstatimet e tij, e të cilat konstatime kanë mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës”.

95. Në anën tjetër, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, [E. Rev. nr 14/2017] të 14 shtatorit 2017, kishte sqaruar tri çështje: (i) konfirmoi vendimet e gjykatave më të ulëta se raporti i ekspertizës nuk ka qenë “i mangët dhe as i paqartë” dhe se i njëjti, duke përfshirë sqarimet që janë dhënë në seancat shqyrtuese ka qenë i mjaftueshëm për të vërtetuar gjendjen faktike; dhe se (ii) dëshmitë tjera përkitazi me saktësinë dhe konstatimet e raportit të ekspertizës e që nuk janë marrë në seancën për shqyrtimin e çështjes nuk mund të merrën parasysh bazuar në nenet 324 dhe 214 të LPK-së sepse, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

96. Më saktësisht, përkitazi me çështjen e parë, Gjykata Supreme theksoi:

“Pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore procedurale të cilat sipas të paditurit qëndrojnë në atë se gjykata shkallës së parë nuk ka pranuar propozimin e të paditurit për nxjerrjen e provës së re nga ana tre ekspertëve të lëmisë përkatëse, gjykata e revizionit e refuzoi si të pabazuar, kjo ngase në këtë çështje juridike gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar propozimin për të nxjerr si provë të re ekspertizën nga tre ekspert, pasi që ekspertiza e ndërtimtarisë në shkresat e lëndës nuk ka qenë e paqartë dhe e mangët. Se përmbajtja e raportit të ekspertizës së ndërtimtarisë dhe sqarimet e ekspertit të dhëna në seancë gjyqësore, kanë bërë që ekspertiza gjyqësore nga lëmi i ndërtimtarisë të jetë e qartë, pa mangësi dhe pa ndonjë të metë që do të vinte në dyshim aprovimin e saj, dhe rrjedhimisht, me të drejtë e njëjta gjykatë ka konkluduar se nuk ka pasur kushte ligjore, dhe se ka qenë e panevojshme që të nxirret edhe një ekspertizë e re për të njëjtën çështje. Në kuptim të nenit 319.3 të LPK-së, vetëm gjykata vendos se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare. Në këtë çështje juridike, eksperti i ndërtimtarisë është thirrur në seancë gjyqësore në të cilën ai ka dhënë sqarime plotësuese për mendimin e konstatimin e tij, të cilat kanë qenë të mjaftueshme

për vërtetimin dhe sqarimin e fakteve e rrethanave për të cilat gjyqtari i çështjes nuk ka dijeni profesionale”.

97. Ndërsa përkitazi me çështjen e dytë, ajo theksoi:

“Në këtë drejtim, gjithnjë rreth kësaj ekspertize, Gjykata Supreme refuzoi edhe pretendimet tjera të revizionit që i përkasin saktësisë së gjetjeve të kësaj ekspertize dhe aprovimit të saj, saktësinë e të cilës i padituri bënë përpjekje që ta vejë në dyshim me një ekspertizë tjetër të kryer në baza private dhe jashtë seancës gjyqësore, pasi që gjykata mbështet vendimin e vet vetëm mbi bazë të provave të administruara në seancën gjyqësore, në pajtim me nenin 324.1 të LPK-së”.

“Pretendimet tjera rreth kësaj ekspertize i përkasin gjendjes faktike, andaj si të tilla këto pretendime të revizionit nuk u vlerësuan fare, pasi që në kuptim të nenit 214.2 të LPK-së, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

98. Në këtë aspekt, dhe marrë parasysh sqarimet e dhëna më lart, Gjykata nuk mund të konstatojë se parashtresat, argumentet dhe dëshmitë e parashtresit të kërkesës nuk ishin shqyrtuar në mënyrë të duhur nga e ana e gjykatave të rregullta. Gjykata tashmë ka konstatuar se (i) refuzimi i kërkesës së parashtresit të kërkesës në Gjykatën Themelore ishte i arsyetuar; (ii) nuk mund të konstatohet, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së se kishte dyshime legjitime për paanshmërinë e ekspertit përkatës; dhe (iii) parashtresit të kërkesës nuk i ishte pamundësuar pjesëmarrja dhe kontestimi efektiv i raportit të ekspertizës përgjatë procedurës gjyqësore. Gjykata më tej gjithashtu thekson se rrethanat e rastit konkret nuk mbështesin një konstatim për shkeljen e të drejtës së parashtresit të kërkesës për t’u dëgjuar për shkak se parashtresat dhe dëshmitë e tij nuk ishin shqyrtuar nga gjykata. Një konstatim i tillë nuk gjen mbështetje në ligjin e aplikueshëm dhe as në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Siç është theksuar më lart, rastet relevante e të GJEDNJ-së e të cilave iu referohet edhe parashtresës i kërkesës në mbështetje të argumenteve të tij, nuk e mbështesin një konstatim të tillë. Që të dyja nuk kanë konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së përkitazi me vlerësimin e duhur të parashtresave të parashtresve përkatës, duke përfshirë rastin *Kraska kundër Zvicrrës*, ku një gjyqtar kishte theksuar shprehimisht se nuk kishte vlerësuar dosjen e rastit në tërësinë e saj. GJEDNJ, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, vlerëson procedurën në tërësinë e saj, dhe në rrethanat e rastit e konkret, në kontekst të shqyrtimit të provave, procedura gjyqësore në rastin e

parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e saj, në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezultoi të jetë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

(ii) *Sa i përket pretendimeve për mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor*

99. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019.
100. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
101. Për më tepër, GJEDNJ gjithashtu përdor konceptin e “*mjaftueshmërisë së arsyetimit*” edhe në rastet kur i dëshirueshëm do të mund të ishte një arsyetim më i gjërë dhe më i detajuar. (Shih rastin

Merabishvili kundër Gjeorgjisë, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017, paragrafi 227). Ndonëse rrethanat e rastit konkret nuk janë të njëjtat me ato të rastit të referuar të GJEDNJ-së, koncepti i “*mjaftueshmërisë së arsytimit*” përmes këtij rasti të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-në nënkupton që arsyetimi i vendimeve përkatëse të gjykatave të rregullta, në rrethanat të caktuara, edhe pse jo i dëshirueshëm, mund të jetë i mjaftueshëm. Në këtë aspekt, në Aktgjykimin e lartcekur të GJEDNJ-së, kjo e fundit kishte theksuar me sa vijon: “Përderisa një arsyetim më i detajuar do të ishte i dëshirueshëm, Gjykata [GJEDNJ] është e kënaqur që ky [arsyetim] ishte i mjaftueshëm në këto rrethana”. (Shih, gjithashtu rastin nr. KI48/18, me parashtues, *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019, paragrafi 186).

102. Gjykata rikuton pretendimet specifike të parashtuesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor e të reflektuara në paragrafin 35 të këtij Aktgjykimi. Gjykata thekson se pretendimet që ndërlidhen me raportin e ekspertizës, përkatësisht lartësinë e detyrimit të përcaktuar nga ky raport; konstatimin se kompensimi me banesë për gjysmën e vlerës së punëve të kontraktuara është shndërruar në kompensim në të holla; dhe mendimin e ‘*Alumi*’ dhe atë të ekspertit I.M. të dorëzuar në Gjykatën e Apelit dhe të ekspertizës private të dorëzuar në Gjykatën Supreme, ndërlidhen me përmbajtjen dhe procedurën e nxjerrjes së raportit të ekspertizës. Gjykata tashmë ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtuesit të kërkesës që ndërlidhen me ekspertizën e kontestuar, megjithatë, në vijim, ajo gjithashtu do të trajtojë pretendimet e mbetura të parashtuesit të kërkesës përkitazi me mungesën e pretenduar të vendimit të arsyetuar gjyqësor.
103. Në këtë kontekst, dhe sa i përket lartësisë së detyrimit, duke u bazuar në raportin e ekspertizës, Gjykata Themelore kishte konstatuar dhe arsyetuar, ndër tjerash, si në vijim:

“Nga të dhënat e sipërcituara në këtë aktgjykim, u konstatua se paditësi në cilësinë e zbatuesit të punimeve i ka përfunduar të gjitha punimet ndërtimore të maruara me marrëveshjen e datës 10.06.2013, që kanë të bëjnë me vendosjen e dritareve të plastikës në objektin afarist të kundërpaditësit. Po ashtu, paditësi ka kryer punë në vendosjen e fasadës dhe profileve të aluminit, në katin përdhese dhe katin e parë, si dhe punë që kanë të bëjnë me demolimin dhe montimin e serishëm të profileve prej aluminit. Vlera e përgjithshme e punimeve të kryera nga paditësi është në shumën prej 120,975.00 €. Kundërpaditësi i ka paguar paditësit shumën prej 38.000.00 €. Po ashtu në emër të vërejtjeve të

pasanuara, kësaj shume i zbritet 2 %, në shumën prej 1,659.50 €. Andaj gjykata ka ardhur në përfundimin se kundërpaditësi, është në borxh ndaj paditësit në shumën e përgjithshme prej 81,279.50 €, të cilën shumë e detyroj që t'ia paguaj paditësit me keë aktgjykim”.

“Pretendimet e kundërpaditësit, të parashtruara me kundërpadi se kundërpaditësi i ka paguar paditësit shumën prej 133,000.00 €, janë jo të provuara me prova materiale, pasi që nga provat e shqyrtuara gjatë rrjedhës së shqyrtonit gjyqësor është konstatuar se kundërpaditësi i ka paguar paditësit shumën prej 38,000.00 €. Ndërsa vlera e punëve të kryera nga paditësi është në shumën prej 120,875.00€. Gjykata vlerëson se edhe pretendimet në kundërpadi se materiali i përdorur ka qenë jo cilësor, dhe jo në përputhje me dimensionet e përdorura të profileve të aluminit, nuk janë provuar me asnjë provë. Nga raporti i ekspertizës ka rezultuar se materiali i përdorur është në përputhje me standardet profesionale nga fusha e ndërtimtarisë”.

104. Një qëndrim i tillë i Gjykatës Themelore ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. Për pasojë, Gjykata thekson se pretendimet përkitazi me lartësinë e kompensimit, përkatësisht detyrimit të parashtruesit të kërkesës, ishin të arsyetuara mjaftueshëm nga ana e gjykatave të rregullta.
105. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta nuk kishin vërtetuar se kompensimi me banesë për gjysmën e vlerës së punëve të kontraktuara është shndërruar në kompensim në të holla, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore në këtë aspekt, dhe i cili thekson:

*“Me datën 10.06.2013, kundërpaditësi, i ka ofruar marrëveshje me shkrim paditësit, me anë të së cilës:
Kundërpaditësi është i lirë ta shes banesën (pra është anuluar kompensimi me banesë si në kontratë);*

Është konstatuar se punët e kryera nga paditësi arrijnë vlerën prej 79,247.00 €;

Është konstatuar se kundërpaditësi i ka paguar paditësit shumën prej 38,000.00, ashtu që ka mbetur borxh në shumën prej 41,247.00 €.

Marrëveshja nuk është nënshkruar nga palët në procedurë por është pranuar në mënyrë konkludente nga palët dhe faktet e saj nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve. Përveç tjerash, paditësi ka hequr dorë nga banesa, pikërisht si është paraparë me këtë dokument”.

106. Gjykata në këtë aspekt, gjithashtu vëren se kjo çështje nuk ishte ngritur specifikisht më tej nga parashtruesi i kërkesës as përmes ankesës së dorëzuar në Gjykatën e Apelit dhe as përmes revizionit në Gjykatën Supreme. Ndërsa çështjet që ndërlidhen me mendimin e ‘Alumil’, atë të ekspertit I. M. dhe ekspertizës private, Gjykata tashmë i ka trajtuar në pjesët paraprake të këtij Aktgjykimi. Për pasojë, Gjykata thekson se pretendimet përkitazi me kompensimin në të holla në raport me kompensimin me banesë, ishin të arsyetuara mjaftueshëm nga ana e gjykatave të rregullta në ndërlidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura përmes ankesës dhe revizionit përkatës.
107. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon të mos ketë pasur arsyetim në vendimet e gjykatave të rregullta në lidhje me pretendimet e ngritura përmes kundërpadsisë përkitazi me vonesën e paditësit, shkaktimit të fitimit të munguar dhe kërkesës për caktimin e ekspertit ekonomik për llogaritjen e dëmit në fjalë.
108. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se çështjet e lartcekura ishin ngritur nga parashtruesi i kërkesës vetëm përmes kundërpadsisë në Gjykatën Themelore dhe të cilat kjo e fundit i kishte refuzuar. Të njëjta nuk janë ngritur më tej as para Gjykatës së Apelit përmes ankesës dhe as para Gjykatës Supreme para përmes kërkesës për revizion.
109. Gjykata në këtë kontekst thekson se gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës por se ky detyrim nuk nënkupton që gjykatat duhet të përgjegjen në secilin argument të parashtruar nga parashtruesit përkatës. Ky detyrim për më tepër nuk aplikohet përkitazi me pretendimet të cilat nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, përmes mjeteve përkatëse juridike. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës përgjatë vendimeve të gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, ishin mjaftueshëm të arsyetuara.

Përfundime

110. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 14/2017] i 14 shtatorit 2017 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më specifikisht në përputhje me (i) parimin e barazisë

së armëve; (ii) të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar; dhe (iii) parimet e përgjithme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

111. Gjykata përgjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka konstatuar se (i) raporti i kontestuar i ekspertizës nuk është nxjerrë nga një ekspert i anshëm, sepse përkitazi me anshmërinë e tij as nuk janë argumentuar dyshimet ligjitime dhe as pse të njëjtat mund të jenë objektivisht të justifikueshme; (ii) parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi efektive të pjesëmarrjes në procesin e përpilimit të raportit të ekspertizës dhe mundësi efektive për kontestimin e tij; (iii) refuzimi i kërkesës për përcaktimin e ekspertizës së re është mjaftueshëm i arsyetuar dhe i arsyeshëm; (iv) gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar dëshmitë e parashtruesit të kërkesës; (v) vendimet e gjykatave të rregullta janë mjaftueshëm të arsyetuara; dhe (vi) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, procedura, në tërësinë e saj, ka qenë e drejtë.
112. Për pasojë, Gjykata konstaton se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 14/2017] i 14 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [Ae. nr. 133/2016] e 14 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [IC. nr. 660/2013] e 31 marsit 2016 të Gjykatës Themelore, janë në përputhje me Kushtetutën dhe mbesin në fuqi.

Kërkesa për masë të përkohëshme

113. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohëshme nga Gjykata duke theksuar se nxjerrja e të njëjtës është në *“në interes publik”* dhe duke argumentuar ndër të tjera se, duhet të preventohen efektet juridike të Aktgjykimeve, sipas pretendimit, në kundërshtim me Kushtetutën dhe pasojat që ato kanë për palën në procedurë.
114. Gjykata në aspekt fillimisht thekson se bazuar në Ligjin, Rregulloren e punës, dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, kërkesat për masë të përkohëshme, refuzohen në rastet kur kërkesat shpallen të papranueshme ose edhe kur rastet vendosen në merita nga Gjykata, duke mos konstatuar shkelje të dispozitave Kushtetuese, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.
115. Rrjedhimisht, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 të Ligjit dhe rregullin 57 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me masën e përkohëshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, të nenit 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe të rregullave 39, 57 dhe 59 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur me 18 dhjetor 2019, me njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 14/2017] i 14 shtatorit 2017 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI14/18, Parashtrues, Hysen Kamberi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.241/2017, të 5 dhjetorit 2017

KI14/18, Aktgjykim i 15 janarit 2020, publikuar më 3 shkurt 2020

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, marrja në pyetje e dëshmitarëve, kërkesë e pranueshme, shkelje e të drejtave kushtetuese

Esenca e rastit përkatës ndërlidhet me pamundësinë e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës ose/dhe mbrojtjes së tij, për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, në ndonjë fazë të procedurës penale, përkundër garancisë për një të drejtë të tillë të përcaktuar përmes paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rrethanat e rastit konkret, ngërthejnë një proces penal kundër parashtruesit të kërkesës lidhur me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, për të cilën parashtruesi i kërkesës fillimisht, përmes një vendimi të Gjykatës së Qarkut, ishte shpallur fajtor, duke u dënuar me 3 (tri) vite burgim, vendim ky i cili përmes Gjykatës Supreme, ishte kthyer në rigjykim. Në gjykimin e ri, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur sërish fajtor për të njëjtën vepër penale, duke u dënuar më 2 (dy) vite burgim, përmes një Aktgjykimi të Gjykatës Themelore të vitit 2016, dhe i cili më pas u vërtetua nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në vitin 2017.

Fajësia e të akuzuarit ishte vërtetuar përmes deklaratave të lexuara nga 4 (katër) të dëmtuara/dëshmitare dhe një dëshmitari tjetër, dëshmitarë këta të cilët, në asnjë fazë të procedurës, i akuzuari dhe/ose mbrojtja e tij nuk kanë patur mundësinë të i marrin në pyetje. Gjykatat e rregullta iu kishin referuar edhe dëshmisë së një të akuzuari tjetër, përkatësisht të akuzuarit S.R, të dhënë në shqyrtim gjyqësor, duke theksuar se vendimet e tyre i kishin bazuar “pjesërisht” edhe në dëshminë e këtij të fundit.

Për të vlerësuar nëse një proces gjyqësor dhe i cili është zhvilluar pa praninë e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor por është bazuar vetëm në leximin e deklaratave të të njëjtëve, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë, Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me mungesën e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu shtjelloi parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e të njohura përmes testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, bazuar në të cilin, në rrethana të tilla, duhet të trajtohen tri çështjet në vijim: (i) nëse ka pasur arsye të qëndrueshme për mos-pjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe për pasojë,

pranimit të dëshmime jashtëgjyqësore të dëshmitarëve në mungesë si dëshmi në gjykatë; (ii) nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “vetme” ose “vendimtare” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) nëse ka “faktor të mjaftueshëm kundërbalancues”, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompensohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimit të dëshmisë jashtëgjyqësore. Gjykata gjithashtu shtjelloi dhe sqaroi raportin dhe radhën e shqyrtimit të tri çështjeve të lartcekura bazuar në praktikën gjyqësore relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe më pas, aplikoi këto parime, të mbështetur edhe me praktikë gjyqësore përkatëse, në rrethanat e rastit konkret.

Lidhur me kriterin e parë të testit, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, theksoi se arsyet që kanë rezultuar në mospjesëmarrjen e një dëshmitari në shqyrtim gjyqësor duhet të jenë të qëndrueshme dhe se vlerësimi i kësaj qëndrueshmërie, është pyetje paraprake, dhe rrjedhimisht është çështja e parë që duhet të shqyrtohet nga një gjykatë. Në këtë aspekt, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se, nuk ka një arsye të qëndrueshme për mospraninë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor, dhe se rrjedhimisht vetëm leximi i deklaratave të dhëna më parë, bazuar në arsyetimin se dëshmitarët “nuk gjinden në Kosovë” dhe “nuk dihet vendndodhja e tyre”, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe siç është shtjelluar detajisht në këtë Aktgjykim, nuk përmbush kriteret e përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht kriteri i parë të testit *Al-Khawaja dhe Tahery* nuk është përmbushur në rrethanat e rastit.

Lidhur me kriterin e dytë të testit të lartcekur, përkatësisht nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “vetme” ose “vendimtare” për dënimin e të akuzuarit, Gjykata konstatoi se dëshmitë e dëshmitarëve që nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, janë dëshmi të “vetme”, “vendimtare” dhe “bartin peshë të konsiderueshme” në dënimin e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, posaçërisht duke marrë parasysh faktin se dëshmitë tjera në proces gjyqësorë, e veçanërisht ajo e të akuzuarit S.R, dhe e cila, bazuar në vet vendimet e gjykatave vetëm “pjesërisht” kishte ndikuar vendimet e tyre, nuk bartë peshë “inkriminuese”. Gjykata gjithashtu sqaroi, se përtej praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, edhe vet kodet procedurale të Republikës së Kosovës, e të aplikuar në rrethanat e rastit konkret, nuk mundësojnë dënimin e një të akuzuari duke u bazuar në një provë vendimtare dhe e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij në ndonjë fazë të procedurës penale. Për më tepër që, gjykatat e rregullta asnjëherë nuk kishin trajtuar dhe as arsyetuar këtë çështje në vendimet e tyre. Rrjedhimisht as kriteri i dytë i testit *Al-Khawaja dhe Tahery* nuk është përmbushur në rrethanat e rastit.

Në fund, dhe lidhur me kriterin e tretë të testit, përkatësisht ekzistencën e “*faktorëve të mjaftueshëm kundërbalancues*”, Gjykata sqaroi se gjykatat e rregullta nuk kishin ndërmarrë dhe as aplikuar asnjë masë alternative për të siguruar besueshmërinë shtesë të dëshmive/deklaratave të lexuara të të dëmtuarve/dëshmitarëve në mungesë të tyre në shqyrtim gjyqësor, dhe se të njëjtat gjithashtu në asnjë mënyrë nuk kishin sqaruar raportin në mes dëshmive të dëshmitarëve në mungesë dhe provave tjera inkriminuese, dhe për më tepër, nuk kishin ndërmarrë asnjë masë procedurale, përfshirë arsyetim shtesë, e cila do të mund të kishte kompenzuar disavantazhin e krijuar për të akuzuarin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, në pamundësi për të marrë në pyetje në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëshmitarët kundër tij. Rrjedhimisht as kriteri i tretë i testit *Al-Khawaja dhe Tahery* nuk është përmbushur në rrethanat e rastit.

Në këtë aspekt, Gjykata sqaroi se në rrethanat e rastit konkret, Aktgjykimi [PML.nr.241/2017] e 5 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, ishin nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse përkundër këtyre garancive, dëshmitarët kundër të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor dhe parashtruesi i kërkesës dhe/ose mbrojtja e tij, në asnjë fazë të procedurës penale, nuk kanë patur mundësinë të marrin në pyetje dëshmitarët kundër tij, për më tepër që, vendimet e gjykatave të rregullta, në rrethanat e rastit konkret, dështojnë të i përmbushin të të tri kriteret e testit të njohur si *Al-Khawaja dhe Tahery*.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI14/18

Parashtrues

Hysen Kamberi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.241/2017,
të 5 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysen Kamberi, me banim në fshatin Slivovë, Komuna e Ferizajit, i përfaqësuar nga Selman Bogiqi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [PML.nr.241/2017] e 5 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 10 (E drejta për Dëgjim të ndershëm publik) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Deklarata Universale).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata që identiteti i tij të mos zbulohet.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata do të i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatës

7. Më 31 janar 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 5 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 9 shkurt 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzonte formën e plotësuar të kërkesës, autorizimin për përfaqësim dhe fletëkthesën e Aktgjykimit të cilin e konteston. Një kopje e kërkesës iu dërgua edhe Gjykatës së Apelit.
10. Më 28 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
11. Më 13 prill 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzoj në Gjykatë edhe dy vendimet e gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktvendimin [AP.nr.347/2003] e 24 shkurtit 2004 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [P.nr. 424/2002] e 17 janarit 2003 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut).
12. Më 27 prill 2018, parashtruesi i kërkesës, i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara si dhe Aktgjykimin [PML.nr.241/2017] e 5 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme.
13. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
14. Më 2 korrik 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzonte në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
15. Më 23 korrik 2018, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen përkatëse.
16. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Latifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
17. Më 14 maj 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH.KI14/18 për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi Peci.
18. Më 11 dhjetor 2019, Gjyqtarja raportuese prezentoj raportin paraprak para Kolegjit shqyrtues dhe njëzëri u vendos që të kërkohet nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që ta njoftoj Gjykatën lidhur me statusin e zbatimit të Aktgjykimit [P.nr.162/2004 PR1] të 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore. Më 13 dhjetor 2019, Gjykata

kërkoj nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, informatat e lartcekura.

19. Më 20 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë sqarimin e kërkuar duke theksuar se (i) parashtruesi i kërkesës kishte qenë në paraburgim prej 20 tetorit 2002 deri më 17 janar 2003; ndërsa (ii) *“nuk është ftuar në vuajtje të dënimit për pjesën e mbetur të aktgjykimit dënues”*.
20. Më 15 janar 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
21. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë votash se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe se (ii) Aktgjykimi [PML.nr.241/2017] i 5 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Gjyqtarja Selvete Gërzhaliu- Krasniqi votoi kundër pranueshmërisë së kërkesës dhe konstatimit të shkeljeve të lartcekura kushtetuese. Aktgjykimi do të plotësohet me mendimin e saj mospajtues.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 18 nëntor 2002, Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën [PP.nr.774/2002] kundër parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale trafikim me njerëz, të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 2 (Trafikimi me Njerëz) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 1 (Përkufizime) të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2001/4, mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut).
23. Më 17 janar 2003, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [P.nr. 424/2002] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh. Sipas shkresave të lëndës, rezultoi se deklaratat e të dëmtuarave/dëshmitarëve V.K; V.S; N.M; L.B; B.V; T.K, shtetase të Moldavisë dhe Ukrainës dhe A.M, janë marrë gjatë fazës së hetimeve, dhe se gjendja faktike është vërtetuar bazuar mbi deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur e të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.

24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin. Prokurori Publik, në anën tjetër, përmes shkresës [PPA.nr.347/2003] të 8 tetorit 2003, kishte propozuar që ankesat e mbrojtësve të refuzohen si të pabazuara, duke e vërtetuar për pasojë Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Qarkut.
25. Më 24 shkurt 2004, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [AP.nr.347/2003] prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe çështjen e ktheu në rigjykim, duke konsideruar se i njëjti përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj, ndër tjerash, kishte theksuar se *“përshkrimi faktik i përbashkët për të gjithë të akuzuarit, duke pas parasysh se ata nuk janë bashkëekzekutor”*, rezulton në një dispozitiv tëpaqartë të Aktgjykimit përkatës.
26. Më 2 dhjetor 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [P.nr.162/2004 PR1] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të trafikimit me njerëz, duke e dënuar me burgim prej dy (2) vitesh. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata Themelore Aktgjykimin e lartcekur e kishte bazuar në (i) dëshmitë e dëshmitareve V.K; V.S; N.M; dhe A.V, të dhëna para gjyqtarit hetues më 7 nëntor 2002 dhe deklaratën e dëshmitarit A.M të dhënë para gjyqtarit hetues më 17 tetor 2002; dhe (ii) *“pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit S.R të dhënë në shqyrtim gjyqësor”*. Dëshmitarët nuk kanë qenë prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur, e të dhëna në procedurë hetimore para gjyqtarit hetues, janë pranuar si dëshmi në shqyrtim gjyqësor bazuar në pikën 1 të paragrafit 1 të nenit 368 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPPK) e sipas të cilit, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve sipas vendimit të trupit gjykues, ndër të tjera, mund të lexohen kur personat e marrë në pyetje nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se (i) leximi i deklaratave të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor është në kundërshtim me nenin 368 të KPPK-së; dhe (ii) dëshmitë e të dëmtuarave/dëshmitareve nuk kanë mundur të kundërshtohen nga ai as gjatë procedurës hetimore dhe as në shqyrtim gjyqësor. Në fund, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se Prokurori i Shtetit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ndryshoi Aktakuzën [PP.nr.774/2002] e 18 nëntorit 2002,

duke e akuzuar parashtruesin e kërkesës dhe të tjerët, për veprën penale të trafikimit me njerëz në bashkëkryerje.

27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin që të anulohet Aktgjykimi i kontestuar dhe çështja të kthehet në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendoi se Aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me nenin 262 (Provat për përcaktimin e fajësisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK) sepse ishte shpallur fajtor mbi bazën e dëshmive të cilat ai nuk ka patur mundësi të i kundërshtoj në asnjë fazë të procedurës penale përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës. Në anën tjetër, Prokurori i Apelit përmes parashtresës [PPA/I.nr.67/2017], kishte propozuar që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
28. Më 13 korrik 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.55/2017] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me pamundësinë e kundërshtimit të dëshmive, Gjykata e Apelit theksoi se bazuar në nenin 368 të KPPK-së, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve mund të lexohen kur personat e marrë në pyetje nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur.
29. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR.nr.55/2017] të 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës i kishte përsëritur të njëjtat pretendime që i kishte paraqitur në ankesën e tij në Gjykatën e Apelit. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit, përmes parashtresës [KMLP.II. 166/2017] propozoi që ankesa e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, të refuzohet si e pabazuar.
30. Më 5 dhjetor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.241/2017] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj ndër të tjera theksoi se nuk ka pasur pengesa për leximin e dëshmive sepse procedura kundër parashtruesit të kërkesës ishte zhvilluar sipas Ligjit mbi Procedurën Penale të Ish-Jugosllavisë (Nr. 26/86) dhe bazuar në

nenin 333 të tij, dëshmitë e dëshimtarëve mund të lexohen nëse paraqitja e dëshimtarëve para gjykatës është e pamundur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të garantuara përmes neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ; si dhe nenin 10 (E drejta për Dëgjim të ndershëm publik) të Deklaratës Universale.
32. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se ai është dënuar mbi bazën e dëshmive të cilat nuk ka pasur mundësi të i kundërshtoj në asnjë fazë të procedurës penale, në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara përmes paragrafit 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së.
33. Më specifikisht parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimet e kontestuar janë nxjerrë në kundërshtim me (i) paragrafin 1.8 të nenit 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale) të KPPRK-së, sepse janë të bazuara në prova të papranueshme; (ii) paragrafin 1.3 të nenit 338 (Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë) të KPPRK-së, sepse në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit, procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme mund të lexohet vetëm kur palët pajtohen; dhe (iii) paragrafin 1 të nenit 262 të KPPRK-së e sipas të cilit gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur në dëshmi e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.
34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall kërkesën e pranueshme; të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar [PML.nr.241/2017] të 5 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj:

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML.nr.241/2017] e 5 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
39. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të Rregullit 39 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të Rregullit 39 të Rregullores së punës.
40. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

(...)

4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

(...)

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(...)

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

(...)

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i vitit 2012

Neni 260

Shqyrtimi i provave të pranueshme në shqyrtim kryesor

1. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të ketë përjashtuar provat në pajtim me nenin 249 të këtij Kodi, ato prova mund të shqyrtohen nga gjykata vetëm gjatë rigjykimit nëse aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për të përjashtuar provat ndryshohet pas ankesës.
2. Prova mund të shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor nëse nuk është përjashtuar sipas nenit 249 apo nëse nuk është e papranueshme sipas nenit 259 të këtij Kodi.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues apo anëtari i trupit gjykues, çmon besueshmërinë, rëndësinë dhe vlerën provuese të provës së pranuar nga paragrafi 2. I këtij neni.

Neni 262

Provat për përcaktimin e fajësisë

1. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*
2. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.*
3. *Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.*
4. *Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.*

Neni 338

Leximi i deklaratave të tjera të dhëna më parë

1. *Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:*
 - 1.1. *kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;*
 - 1.2. *kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor; ose*
 - 1.3. *kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejtë nëpyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.*
2. *Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmitarit nuk lexohen nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse*

kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme.

3. Arsyet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, e me rastin e leximit tregohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar.

Neni 384

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

(...)

1.8 aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

(...)

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2.1 nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht, ose;

2.2 kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjyqimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Kodi i përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës i vitit 2003

Neni 157

(1) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

(2) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit publik (neni 156, paragrafi 1 i këtij Kodi).

(3) Gjykata nuk e shpall të akuzurin fajtor vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.

(4) Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues (nenet 298 deri te 303 i këtij Kodi).

Neni 368

(1) Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklaratimet dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:

1) Kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;

2) Kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor ose

3) Kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.

(2) Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit (neni 160 i këtij Kodi) nuk lexohen, nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme. Neni 154 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht.

(3) Arsyet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, e me rastin e leximit tregohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar.

Ligji mbi Procedurën Penale i ish-Jugosllavisë (Nr.26/86)

Neni 333

(1) Përveç rasteve të parapara me këtë Ligj, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuzuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:

- 1) kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;*
- 2) kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor.*

(2) Me pëlqimin e palëve, kolegji mund të vendosë që procesverbali i seancës dëgjimore paraprahe të një dëshmitari ose dëshmitari ekspert ose gjetja dhe mendimi i tij me shkrim të lexohet edhe pse dëshmitari ose dëshmitari ekspert nuk është i pranishëm, pavarësisht nëse ai është thirrur në shqyrtimin gjyqësor. Si përjashtim, pa pëlqimin e palëve, por pasi të jenë dëgjuar, trupi gjykues mund të vendosë për leximin e procesverbalit të seancës dëgjimore të një dëshmitari ose eksperti në një proces gjyqësor të mëparshëm, i cili u mbajt para të njëjtit gjyqtar kryesues të kolegjit edhe pse periudha e përmendur në nenin 305 paragrafi 3 i këtij ligji ka skaduar, ose që gjetja dhe mendimi me shkrim i një institucioni të specializuar ose agjencie qeveritare të lexohet kur specialisti thirret nga ai institucion ose agjenci që ka kryer vlerësimin e ekspertit nuk është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, nëse duke pasur parasysh provat e tjera të paraqitura, gjykon se është e nevojshme të njoftohet me përmbajtjen e procesverbalit ose gjetjes dhe mendimit me shkrim. Pasi të jetë lexuar procesverbali ose konstatimi me shkrim dhe mendimi dhe komentet e palëve të jenë dëgjuar (neni 335), trupi gjykues, duke marrë parasysh prova të tjera të paraqitura gjithashtu, do të vendosë nëse do ta pyesë personalisht dëshmitarin ose ekspertin.

(3) Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit (neni 227) nuk lexohen, nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Pasi të ketë përfunduar procesi i provave, kolegji urdhëron që këto procesverbale të ndahen nga dosja e procesverbalit dhe të mbahen veçmas (neni 83). Kolegji do të procedojë në të njëjtën mënyrë me procesverbalet dhe informacionet e tjera të parapara në nenin 83 të këtij ligji, nëse nuk ka urdhëruar tashmë që ato të ndahen. Kundër

vendimit për ndarjen e procesverbaleve dhe informatave lejohet ankesë e veçantë. Sapo të hyjë në fuqi vendimi, procesverbalet dhe informacionet e ndara që janë hequr mbyllën në një zarf të veçantë dhe i dorëzohen gjyqtarit hetues për t'u mbajtur veçmas nga dokumentet e tjera; ato as nuk mund të ekzaminohen dhe as të përdoren në procedurë. Procesverbali dhe informacioni gjithashtu duhet të ndahen para se dokumentet të dërgohen në gjykatën më të lartë në lidhje me ankimin e aktgjykimit.

(4) Dispozita e paragrafit 3 të këtij neni nuk do të zbatohet në lidhje me procesverbalet që trupi gjykues ka vendosur në bazë të nenit 84 të këtij Ligji për t'i përdorur në shqyrtimin gjyqësor. Arsytet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, e me rastin e leximit tregohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar.

Meritat

41. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut. Bazuar në aktakuzën e ngritur në vitin 2002, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fillimisht i fajshëm përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, por i cili ishte anuluar përmes Aktvendimit përkatës të Gjykatës Supreme. Në rigjykim, parashtruesi i kërkesës sërish ishte shpallur fajtor përmes një Aktgjykimi të Gjykatës Themelore, Aktgjykim ky i cili pas refuzimit të ankesës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, respektivisht. Gjykata rikujton që edhe në rigjykim, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor mbi bazën e dëshmive të dëshmitarëve të cilët nuk ishin të pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ky fakt ishte kundërshtuar nga i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës përgjatë të gjitha procedurave gjyqësore. Gjykatat e rregullta kishin refuzuar pretendimet e tij duke u bazuar në dispozitat procedurale të aplikueshme përgjatë procedurës së tij gjyqësore, përkatësisht nenin 333 të Ligjit mbi Procedurën Penale të ish-Jugosllavisë; nenin 368 të KPPK-së dhe nenin 338 të KPPRK-së, e sipas të cilave leximi i dëshmive të dëshmitarëve mund të lejohet në shqyrtim gjyqësor me vendim të gjykatës, nëse dëshmitarët përkatës nuk mund të gjinden ose paraqitja e tyre para gjykatës është e pamundur. Parashtruesi i kërkesës i ngrit të njëjtat pretendime edhe para Gjykatës, duke theksuar se të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur sepse është shpallur fajtor nga gjykatat e rregullta, bazuar në dëshmi të dëshmitarëve në mungesë dhe rrjedhimisht, pa pasur mundësinë asnjëherë që të marrë të njëjtit në pyetje dhe të kundërshtoj argumentet e tyre.

42. Gjykata thekson se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu bërë pyetje dëshmitarëve kundër tij, e drejtë kjo e garantuar përmes paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës. E drejta e një të akuzuari për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij është po ashtu e garantuar përmes pikës d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për më detajisht përkritazi me të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët, shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Penal) të 30 prillit 2019; Pjesa VI. Garancionet Specifike; B. Të Drejtat e Mbrojtjes (Neni 6 paragrafi 3); 4. Marrja në Pyetje e Dëshmitarëve (Neni 6 paragrafi 3 (d)).
43. Gjykata me tej thekson se garancitë procedurale të mishëruara në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, reflektojnë aspekte specifike të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në shqyrtimin e tyre, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) vlerëson drejtësinë e procedurës në tërësinë e saj, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave, respektimin e të drejtave të mbrojtjes, por gjithashtu edhe interesin e publikut dhe të viktimave, dhe, kur është e nevojshme, edhe të drejtat e dëshmitarëve. (Shih, ndër të tjera, dhe në këtë aspekt, rastin e GJENJD-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2015, paragrafët 100-101). Përkritazi me këtë të fundit, përkatësisht dëshmitarët, Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, termi “dëshmitarë” ka kuptim autonom bazuar në KEDNJ dhe të pavarur nga klasifikimet e ligjit vendor. Sipas GJEDNJ-së, kur një deklaratë/parashtresë mund të shërbej si bazë për një dënim, ajo përbën provë për prokurorinë dhe i nënshtrohet garancive të përcaktuara përmes paragrafit 1 dhe pikës d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së.
44. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret përfshijnë (i) të drejtën e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij; dhe (ii) vendime të gjykatave të rregullta të cilat, sipas pretendimit, janë nxjerrë bazuar në dëshmitarë që kanë munguar në shqyrtim gjyqësor. Që të dy këto çështje, janë elaboruar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe posaqërisht në dy raste të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2011; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart.
45. Rrjedhimisht dhe në vijim, duke u bazuar edhe në detyrimin e saj të përcaktuar përmes nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat

e Njeriut] të Kushtetutës për të interpretuar të drejtat dhe liritë themelore në harmoni me praktikën gjyqësore të GJENDJ-së, Gjykata do të i (i) shtjelloj parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me mungesën e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor dhe pamundësisë përkatëse të të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij për të i marrë të njëjtit në pyetje, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ; dhe (ii) aplikoj të njëjtat parime në rrethanat e rastit konkret, për të vlerësuar nëse parashtruesi i kërkesës i është nënshtruar, në tërësinë e tij, një procesi të drejtë dhe të paanshëm gjyqësor.

(I.) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij

46. Gjykata fillimisht thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke pasur parasysh se pranueshmëria e dëshmimeve është në parim çështje e rregullimit me ligj dhe e gjykatave vendore, bazuar paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, ajo shqyrton vetëm nëse procedurat, në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të drejtë. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 12 shtatorit 2016, paragrafi 57). Këto dispozita, megjithatë ngërthejnë në vetvete prezumimin kundër përdorimit të dëshmimeve jashtëgjyqësore kundër të akuzuarit në një procedurë penale. E njëjta vlen edhe kur një dëshmi e tillë mund të jetë në favor të mbrojtjes.
47. Për më tepër, bazuar në pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha dëshmitë kundër tij duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë dëgjimore publike me qëllim të dhënies së mundësisë së kundërshtimit të argumenteve. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 57). Përjashtimet nga ky parim janë të mundshme, por në asnjë rrethanë, nuk mund të cenojnë të drejtat e mbrojtjes, e të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësi adekuate dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin kundër tij, qoftë kur ai dëshmitar e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurave. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Hümmer kundër Gjermanisë*,

Aktgjykim i 19 korrik 2012, paragrafi 38; *Lucà kundër Italisë*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2001, paragrafi 39; *Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105). GJEDNJ, megjithatë, gjithashtu ka theksuar se përdorimi i deklaratave të marra në fazën e hetimeve policore e gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, me kushtin që të drejtat e mbrojtjes të jenë respektuar. Si rregull i përgjithshëm, i akuzuari dhe mbrojtja e tij duhet të kenë mundësi adekuate për të kundërshtuar dhe pyetur dëshmitarin përkatës, ose kur i njëjti ka bërë deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurës gjyqësore. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Trampevski kundër ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 10 korrikut 2012, paragrafi 44; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105).

48. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se duke marrë parasysh rëndësinë e administrimit të drejtë të drejtësisë në një shoqëri demokratike, çdo masë që kufizon të drejtat e mbrojtjes duhet të jetë rreptësisht e nevojshme. Nëse një masë më pak kufizuese mund të mjaftojë, atëherë ajo duhet të zbatohet. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 23 prillit 1997, paragrafi 58). Mundësia e të akuzuarit që të përballlet me dëshmitarët në prani të një gjyqtari është një element qenësorë i një procesi gjyqësor të drejtë. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Tarău kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 shkurtit 2009, paragrafi 74).
49. Marrë parasysh rëndësinë e të drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, një praktikë e konsiderueshme gjyqësore e GJEDNJ-së është fokusuar në rastet kur dëshmitarët nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, duke i pamundësuar kështu të akuzuarit dhe mbrojtjes së tij, marrjen e tyre në pyetje dhe kundërshtimin e argumenteve përkatëse. Ndër të tjera, në rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, ajo ka përcaktuar parimet e përgjithshme të aplikueshme në rastet e tilla, dhe testin, të njohur si testi *Al-Khawaja dhe Tahery*, i cili duhet të aplikohet nga gjykatat, në të gjitha rastet kur dëshmitarët nuk kanë marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor.
50. Bazuar në këto raste, GJEDNJ ka zhvilluar parimet e aplikueshme në rrethana të mungesës së dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, por edhe testin e lartcekur, duke përfshirë edhe mënyrën e aplikimit të tij.

51. Përkitazi me parimet e përgjithshme, GJEDNJ ka theksuar se (i) gjykata përkatëse duhet së pari të shqyrtojë pyetjen paraprake, përkatësisht nëse ka pasur arsye të qëndrueshme për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë, duke pasur parasysh që, si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët duhet japin dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e tyre; (ii) kur dëshmitari nuk është marrë në pyetje në asnjë fazë të mëparshme të procedurës, pranimi i deklaratës së dëshmitarit në vend të dëshmive të drejtpërdrejta në proces gjyqësor duhet të jetë masa e fundit; (iii) pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve në mungesë rezulton në një disavantazh potencial për të akuzuarin, i cili, në parim, duhet të ketë mundësi efektive për të kundërshtuar dëshmitë kundër tij. Në veçanti, ai duhet të jetë në gjendje të testoj vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmive të dhëna nga dëshmitarët, duke siguruar marrjen e tyre në pyetje në praninë e tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës; (iv) sipas “*rregullit të vetëm ose vendimtar*” (sole or decisive rule), nëse dënimi i të akuzuarit bazohet vetëm ose kryesisht në dëshmi të siguruar nga dëshmitarë të cilët i akuzuari nuk ka patur mundësi t’i marr në pyetje në ndonjë fazë të procedurës, të drejtat e tij të mbrojtjes janë të kufizuara padrejtësisht; (v) megjithatë, duke marrë parasysh që pika d e paragrafit 3 të nenit 6 të i KEDNJ-së duhet të interpretohet në kuptim të rregullsisë së përgjithshme të procedurës - “*rregulli i vetëm ose vendimtar*” nuk duhet të zbatohet në mënyrë jofleksibile; dhe (vi) në veçanti, kur një deklaratë jashtëgjyqësore është dëshmia e “*vetme ose vendimtare*” kundër një të akuzuari, pranimi i saj si dëshmi nuk rezulton detyrimisht në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në një rast të tillë megjithatë, procedurat gjyqësore duhet të i nënshtrohen një kontrolli rigoroz procedural. Për shkak të rreziqeve të pranimi të dëshmive të tilla, gjykata përkatëse duhet të bazoj vendimin e saj në faktorë kundërbalancues, duke përfshirë masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së dëshmisë përkatëse. Kjo do të lejonte që një dënim të bazohet në dëshmi të tilla vetëm nëse ato janë mjaftueshëm të besueshme. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Penal) të 30 prillit 2019; Pjesa VI. Garancionet Specifike; B. Të Drejtat e Mbrojtjes (neni 6 paragrafi 3); 4. Marrja në Pyetje e Dëshmitarëve (neni 6 paragrafi 3 (d)); ii. Mos-Pjesëmarrja e dëshmitarëve në gjykim).
52. Ndërsa, përkitazi me testin e zhvilluar në rastin *Al-Khawaja and Tahery*, për të vlerësuar përpuethshmërinë me garancitë e mishëruara në pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, bazuar

në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është e nevojshme të shqyrtohen tri çështje themelore, në çdo rast kur deklaratat e dëshmitarëve që kanë munguar në shqyrtim gjyqësor janë pranuar si dëshmi në gjykatë. Gjykata duhet të shqyrtoj nëse (i) ka pasur arsye të qëndrueshme për mos-pjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe për pasojë, pranimin e dëshmive jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë si dëshmi në gjykatë; (ii) dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “*vetme ose vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompenzohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimit të dëshmisë jashtëgjyqësore dhe për të siguruar që gjykimi, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Penal) të 30 prillit 2019; Pjesa VI. Garancionet Specifike; B. Të Drejtat e Mbrojtjes (neni 6 paragrafi 3); 4. Marrja në Pyetje e Dëshmitarëve (neni 6 paragrafi 3 (d)); ii. Mos-Pjesëmarrja e dëshmitarëve në gjykim; dhe shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 107; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata në vijim do të i shtjelloj më detajisht të tri çështjet e identifikuara.

(i) *Arsyet e qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit në proces gjyqësor*

53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, arsyet që kanë rezultuar në mospjesëmarrjen e një dëshmitari në shqyrtim gjyqësor duhet të jenë të qëndrueshme. Arsyeshmëria e mungesës së dëshmitarit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konsiderohet të jetë pyetje paraprake, dhe rrjedhimisht është çështja e parë që duhet të shqyrtohet nga gjykata, dhe para çfarëdo shqyrtimi lidhur me atë nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë, është e “*vetme ose vendimtare*” bazuar në “*rregullin e vetëm ose vendimtarë*”. Sipas GJEDNJ-së, kur dëshmitarët nuk marrin pjesë për të dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë, është detyrë e gjykatës të verifikoj nëse mungesa e tyre është e qëndrueshme dhe e arsyetuar. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 120; dhe *Gabrielyan kundër Armenisë*, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 78, 81- 84).
54. Çështjet që ndërlidhen me arsyeshmërinë e mungesës së dëshmitarit janë sqaruar përtej rastit të GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, edhe në rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*. Sipas këtij të fundit, mungesa e një arsyeje të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e një dëshmitari

në shqyrtim gjyqësor nuk mund të jetë, në vetvete, vendimtare për mungesën e një procesi gjyqësor të drejtë, ndonëse është një faktor shumë i rëndësishëm që duhet peshuar gjatë bilancit me rastin e vlerësimit të drejtësisë së përgjithshme të procesit gjyqësor. Gjykata thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka evoluar në kuptim të konstatimit të shkeljeve në raste kur nuk ka pasur një arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit në proces gjyqësor. Përderisa fillimisht shkeljet janë konstatuar vetëm mbi këtë fakt, më vonë, arsyeshmëria e mungesës është konsideruar vetëm si një ndër faktorët që duhet të merren parasysh në vlerësimin e drejtësisë së procesit në tërësinë e tij. (Për një përshkrim sipërfaqësorë përkitazi me këtë çështje, shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 111-113).

55. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së njeh raste të ndryshme pse nuk mund të realizohet paraqitja e një dëshmitari në shqyrtim gjyqësor. Por, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në rast se pamundësia për të marrë në pyetje dëshmitarët ose për të kërkuar që të merren në pyetje, është për shkak të faktit që ata nuk mund të gjinden, autoritetet përkatëse duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar praninë e tyre në gjykatë. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Karpenko kundër Rusisë*, Aktgjykim i 13 marsit 2012, paragrafi 62; *Damir Sibgatullin kundër Rusisë*, Aktgjykim i 24 prillit 2012, paragrafi 51; *Pello kundër Estonisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2007, paragrafi 35; *Bonev kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 43; *Tseber kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 22 nëntorit 2012, paragrafi 48; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 119; *Bobeş kundër Rumanisë*, Aktgjykimi 9 korrikut 2013, paragrafi 39; dhe *Vronchenko kundër Estonisë*, Aktgjykim i 18 korrikut 2013, paragrafi 58). Fakti që një gjykatë nuk ka qenë në gjendje të lokalizojë dëshmitarin përkatës ose fakti që ky dëshmitarë nuk është gjendur në shtetin në të cilin zhvillohet procedura, nuk është arsye e majftueshme për të plotësuar kërkesat e pikës d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Gabrielyan kundër Armenisë*, cituar më lart, paragrafi 81; *Tseber kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 48 dhe 78; *Lučić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2014; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 120; *Seton kundër Mbretisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 61; *Tseber kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe *Kostecki kundër Polonisë*, Aktgjykim i 4 qershorit 2013, paragrafët 65 dhe 66). Kjo e fundit, kërkon që shtetet përkatëse duhet të ndërmarrin hapa konkret për të i mundësuar të akuzuarit marrjen në pyetje të dëshmitarit kundër tij. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili*

kundër Gjermanisë, cituar më lart, paragrafi 120; *Gabrielyan kundër Armenisë*, cituar më lart, paragrafi 78; *Tseber kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe *Kostecki kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 65 dhe 66).

56. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk i takon kësaj të fundit që të përpiloj një listë të masave specifike që gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin për të siguruar praninë e dëshmitarit përkatës, megjithatë, është e qartë që autoritetet përkatëse duhet të kenë kërkuar në mënyrë aktive dëshmitarin përkatës edhe nëpërmes autoriteteve përkatëse, duke përfshirë policinë, dhe duhet, të kenë përdorur ndihmën ndërkombëtare juridike atëherë kur një dëshmitarë jeton jashtë shtetit përkatës. Për më tepër, në mënyrë që të konsiderohet të jenë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar praninë e dëshmitarit, duhet të ketë pasur edhe kontroll e vlerësim të detajuar të arsyeve të dhëna dhe rrethanave specifike të një dëshmitari, për mospjesëmarrjen e tij/saj në një gjykim nga ana e gjykatës. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 120 dhe 121).
57. Nga perspektiva e një gjykate, arsye e qëndrueshme për mungesën e një dëshmitari mund të ketë atëherë kur gjykata përkatëse ka bazë të qëndrueshme faktike ose ligjore për të mos siguruar pjesëmarrjen e dëshmitarit në procesin gjyqësor. Në një rast të tillë, rezulton se ka pasur një arsye të qëndrueshme për gjykatën që të pranojë si dëshmi deklaratat e pavërtetuara të dëshmitarit në mungesë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 119 dhe 122).

(ii) Rëndësia e dëshmisë për dënimin

58. Pranimi i deklaratave të dëshmitarëve që nuk kanë marrë pjesë në gjykim si dëshmi, ngrihet si çështje e rëndësishme posaqërisht nëse deklarata e dëshmitarit është dëshmia “e vetme” ose “vendimtare” ose nëse e njëjta “bartë peshë të konsiderueshme” në dënimin e të akuzuarit. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 58; *Sitnevskiy dhe Chaykovskiy kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2016, paragrafi 125; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 123).
59. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dëshmia “e vetme” duhet të kuptohet si dëshmia e vetme kundër të akuzuarit. Termi “vendimtare” duhet të kuptohet, në kuptimin më të ngushtë, si dëshmi indikative e një domethënie ose rëndësie të tillë që ka mundësi të jetë përcaktuese për rezultatin e rastit. Kur dëshmia jashtëgjyqësore

e një dëshmitari mbështetet edhe nga dëshmi të tjera mbështetëse, vlerësimi nëse e njëjta është “*vendimtare*” do të varet nga forca e dëshmive mbështetëse: sa më e fortë të jetë dëshmia tjetër inkriminuese, aq më pak ka gjasa që dëshmia e dëshmitarit në mungesë të trajtohet si vendimtare. Dëshmitë që mbartin “*peshë të konsiderueshme*” janë ato pranimi i të cilave mund të shkaktoj disavantazh të mbrojtjes në procesin gjyqësor. (Shih, për më tepër në këtë aspekt, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Penal) të 30 prillit 2019; Pjesa VI. Garancionet Specifike; B. Të Drejtat e Mbrojtjes (neni 6 paragrafi 3); 4. Marrja në Pyetje e Dëshmitarëve (Neni 6 paragrafi 3 (d)); ii. Mos-Pjesëmarrja e dëshmitarëve në gjykim; b. Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit për dënimin; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 116 dhe 123).

60. Gjykata thekson se themelet e “*rregullit të vetëm ose vendimtarë*” janë vendosur në rastin *Unterpertinger kundër Austrisë* (Aktgjykim i 24 nëntorit 1986), i cili përcakton arsyeshmërinë e testit përkatës: nëse dënimi i të akuzuarit është i bazuar vetëm ose kryesisht në dëshminë e dëshmitarit të cilin i akuzuari nuk ka mundur të marrë në pyetje për shkak të mungesës së tij, të drejtat e tij të mbrojtjes janë kufizuar. Më tej, në rastin *Doorson kundër Holandës* (Aktgjykim i 26 marsit 1996), GJEDNJ e zhvilloi praktikën gjyqësore edhe më tej, duke theksuar se, edhe në rast kur gjykata konstaton se ka arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor, një dënim i bazuar në dëshmi “*të vetme ose vendimtare*” të këtij dëshmitari, nuk do të ishte i drejtë dhe do të rezultonte në shkelje të garancive procedurale të garantuara përmes paragrafit 1 dhe pikës d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, në rastin *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ konstatoi se pranimi si dëshmi i deklaratës të dëshmitarit në mungesë, edhe nëse kjo dëshmi është e “*vetme dhe vendimtare*” kundër të akuzuarit, nuk rezulton automatikisht në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128). Ajo arsyetoi se aplikimi i këtij rregulli në mënyrë jo-fleksibile do të ishte në kundërshtim me mënyrën tradicionale në të cilën ajo i qaset të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar përmes nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht vlerësimi të drejtësisë së procedurës në tërësinë e saj. Megjithatë, pranimi i një dëshmie të tillë, dhe duke marrë parasysh rreziqet që reflekton për një proces të drejtë, është faktorë shumë i rëndësishëm dhe i cili duhet të balancohet përmes faktorëve kundërbalancues. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 106;

dhe *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafët 126, 128 dhe 147).

61. Në këtë kontekst, duke marrë parasysh që nuk i takon Gjykatës të veproj si gjykatë e shkallës së katërt, pikënisja në vlerësimin e rëndësisë së dëshmisë së dëshmitarit në mungesë për dënimin e të akuzuarit, është gjykimi i gjykatave të rregullta. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së *Kostecki kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Horncastle dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 2014, paragrafët 141 dhe 150). Gjykata megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të (i) shqyrtoj vlerësimin e gjykatave të rregullta përkitazi me rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë dhe të vendos nëse ky vlerësim i gjykatave të rregulla është i papranueshëm ose arbitrar; dhe (ii) vlerësoj vet rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, nëse gjykatat e rregullta nuk e kanë sqaruar pozicionin e tyre përkitazi me këtë çështje apo nëse një sqarim i tillë është i paqartë. (Shih, në këtë aspekt, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (Aspekti Penal) të 30 prillit 2019; Pjesa VI. Garancionet Specifike; B. Të Drejtat e Mbrojtjes (neni 6 paragrafi 3); 4. Marrja në Pyetje e Dëshmitarëve (neni 6 paragrafi 3 (d)); ii. Mos-Pjesëmarrja e dëshmitarëve në gjykim; b. Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit për dënimin, paragrafi 466; dhe shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 124; *McGlynn kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 tetorit 2012, paragrafi 23; *Tseber kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 54 dhe 56; dhe *Fafrowicz kundër Polonisë*, Aktgjykim i 17 prillit 2012, paragrafi 58).

(iii) *Faktorët kundërbalancues*

62. Nevoja për ekzistimin e faktorëve kundërbalancues në mënyrë që të sigurohet vlerësimi i drejtë i besueshmërisë së dëshmisë në raste kur kjo e fundit është përcaktuese për dënimin e të akuzuarit, është shtjelluar gjithashtu në rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*. Shkalla e faktorëve kundërbalancues të nevojshëm në mënyrë që gjykimi të konsiderohet i drejtë, fillimisht varet nga pesha e dëshmive të dëshmitarit në mungesë. Sa më e rëndësishme të jetë dëshmia përkatëse, aq më shumë peshë duhet të mbartin faktorët kundërbalancues në mënyrë që procedura në tërësi të konsiderohet e drejtë. Këta faktorë kundërbalancues duhet të mundësojnë besueshmërinë e duhur të asaj dëshmie. (Shih rastin e GJEDNJ-së

Schatschaschwili kundër Gjermanisë, cituar më lart, paragrafët 126-131).

63. Në rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, GJEDNJ identifikoi një sërë elementesh që janë të rëndësishëm në këtë kontekst dhe si në vijim: (i) nëse gjykatat vendore i qasen me kujdes dëshmime jashtëgjyqësore të një dëshmitari në mungesë, duke pasur parasysh faktin se dëshmia e tillë mbartë më pak peshë dhe nëse kanë dhënë arsyetime të hollësishme se pse ata e kanë konsideruar atë dëshmi të besueshme, duke pasur parasysh gjithashtu dëshmitë tjera në dispozicion (shih rastet e GJEDNJ-së, *Przydział kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 majit 2016, paragrafi 53; dhe *Daştan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 10 tetorit 2017, paragrafi 31); (ii) ekzistenca e një video regjistrimi të marrjes në pyetje të dëshmitarit në mungesë në fazën e hetimit, në mënyrë që gjykata, prokuroria dhe mbrojtja të krijojnë përshtypjet përkatëse përkitazi me besueshmërinë e dëshmisë; (iii) disponueshmëria në gjykim e dëshmime mbështetëse që mbështesin dëshminë jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë, siç janë deklaratat e bëra në gjykim nga personat të cilëve dëshmitari në mungesë iu ka raportuar ngjarjet menjëherë pas ndodhjes së tyre; (iv) dëshmi të tjera faktike, prova mjeko-ligjore dhe ekspertiza; (v) përshkrimi i ngjarjeve nga dëshmitarë të tjerë, në veçanti nëse dëshmitarët e tillë merren në pyetje të tërthortë gjatë gjyqimit; (vi) mundësia që mbrojtja e të akuzuarit t'i parashtrojë pyetjet e veta ndaj dëshmitarit në mungesë në mënyrë të tërthortë, për shembull me shkrim, gjatë gjyqimit ose, sipas rastit, në fazën e procedurës paraprake (shih rastin e GJEDNJ-së, *Paić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 29 marsit 2016, paragrafi 47); dhe (vii) mundësia që i akuzuari ose mbrojtësi tij të merr në pyetje dëshmitarin gjatë fazës së hetimit. (Shih, në kontekst të këtij paragrafi, rastet e GJEDNJ-së, *Palchik kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 2 marsit 2017, paragrafi 50; *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 156; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 126-131; *Brzuszczyński kundër Polonisë*, Aktgjykim i 17 shtatorit 2013, paragrafët 85-89; *Chmura kundër Polonisë*, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 50; *D.T kundër Holandës*, Vendim i 3 prillit 2012, paragrafi 50; *Rosin kundër Estonisë*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2013, paragrafi 62; dhe *González Nájera kundër Spanjës*, Vendim i 11 shkurtit 2011, paragrafi 54).
64. Në thelb, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të akuzuarit duhet t'i jepet mundësia për të dhënë versionin e tij ose të saj të ngjarjeve dhe për të hedhur dyshime mbi besueshmërinë e dëshmitarit në mungesë. Megjithatë, kjo nuk mund të konsiderohet në vetvete si një faktor i mjaftueshëm kundërbalancues për të

kompensuar disavantazhin nën të cilin ka punuar mbrojtja. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Palchik kundër Ukrainës*, cituar më lart, paragrafi 48). Për më tepër, gjykatat vendore duhet të japin arsyetim të mjaftueshëm kur hedhin poshtë argumentet e parashtruara nga mbrojtja. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Prăjină kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 7 janarit 2014, paragrafi 58). Gjithashtu, në disa raste, mundësia efektive për të hedhur dyshime në besueshmërinë e dëshmitarëve të dëshmitarit në mungesë mund të varet nga ajo se a janë në dispozicion të mbrojtjes të gjitha materialet në dosjen që ka të bëjë me ngjarjet për të cilat dëshmon deklarata e dëshmitarit. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Yakuba kundër Ukrainës**, Aktgjykim i 12 shkurtit 2019, paragrafi 49-51; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 131).

(iv) *Raporti dhe radha e shqyrtimit të tri çështjeve të indentifikuara nga testi Al-Khawaja dhe Tahery*

65. Sa i përket marrëdhënies, GJEDNJ konsideron se zbatimi i parimeve të zhvilluara në rastin *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në praktikën e saj pasuese gjyqësore reflekton nevojën për të sqaruar marrëdhëniet midis tre hapave të sipërpërmendur të testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, posaqërisht kur është fjala për shqyrtimin e pajtueshmërisë me KEDNJ-në të një gjykimi në të cilin janë pranuar dëshmi jashtëgjyqësore të një dëshmitari në mungesë. Është e qartë se duhet të vlerësohen secili nga tre hapat e testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, në rastin kur pyetja e parë, përkatësisht nëse ka pasur një arsye të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe pyetja e dytë, përkatësisht, nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza “*e vetme*” ose “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit, janë të përgjigjura në mënyrë afirmative. Megjithatë, çështja e mbetur për sqarim është nëse që të tre hapat e testit duhet të ekzaminohen edhe në rastet kur pyetja e parë ose e dytë është e përgjigjur negativisht. (Shih, në këtë kontekst, dhe për më tepër, paragrafin 110 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*). Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka evoluuar në këtë aspekt, por në rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, ajo ka përcaktuar se në parim, të tri çështjet duhet të shqyrtohen në mënyrë që të vlerësohet drejtësia e një procedure në tërësinë e saj, rrjedhimisht që çështja e faktorëve kundërbalancues duhet të shqyrtohet edhe në rastet kur mund të ketë pasur një arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor apo edhe kur kjo dëshmi të mos ketë qenë “*e vetme*” ose “*vendimtare*”. (Shih për më tepër në këtë kontekst, sqarimin e GJEDNJ-së në paragrafët 110 deri më 116 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*).

66. Ndërsa sa i përket radhës, GJEDNJ thekson se në rastin *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa që të ekzistojë një arsye e qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitarit (hapi i parë), dhe për pranimin pasues të dëshmive të dëshmitarit në mungesë, është konsideruar si pyetje paraprake e cila duhet të vlerësohet gjithnjë fillimisht dhe para çdo vlerësimi nëse dëshmia e pranuar është “*e vetme*” ose “*vendimtare*”. Termi “*paraprak*”, në këtë kontekst, kuptohet në kuptim kohor: gjykata e fakteve së pari duhet të vendosë nëse ekziston një arsye e qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit dhe nëse po, si pasojë, dëshmia e dëshmitarit në mungesë mund të pranohet. Vetëm pasi të jenë pranuar këto dëshmi të dëshmitarit, gjykata e faktit duhet të vlerësojë, në përfundim të gjykimit dhe duke marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura, rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë dhe, veçanërisht, nëse kjo dëshmi është baza “*e vetme*” ose “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit (hapi i dytë). Pastaj do të varet nga pesha e dëshmive të dhëna nga dëshmitari në mungesë se sa peshë do të duhet të bartin faktorët kundër-balancues (hapi i tretë) në mënyrë që të sigurohet drejtësia e gjykimit në tërësinë e tij. (Shih, në këtë kontekst, dhe për më tepër, paragrafin 117 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*).
67. Rjedhimisht, në parim, do të jetë e rëndësishme të shqyrtohen të tre hapat e testit *Al-Khawaja dhe Tahery*. Ato janë të ndërlidhura dhe, të marra së bashku, shërbejnë për të përcaktuar nëse procedura penale, në tërësinë e saj, ka qenë e drejtë. Prandaj mund të jetë e përshtatshme që, në një rast të caktuar, të shqyrtohen hapat në një renditje të ndryshme, veçanërisht nëse një nga hapat rezultojnë të jetë veçanërisht vendimtar sa i përket drejtësisë ose padrejtësisë së procedurës. (Shih për më tepër, përkitazi me raportin dhe radhitjen e çështjeve të identifikuarra përmes testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafët 110-118).

(II.) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

68. Gjikata fillimisht rithekson se garancitë e mishëruara në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerësohen në kuptim të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm në tërësinë e tij. Për më tepër, siç është cekur më lart, çështjet që ndërlidhen me pranueshmërinë e provave, janë në parim, çështje të ligjit dhe rrjedhimisht, të vlerësimit të gjykatave të rregullta. Megjithatë, para se një i akuzuar të mund të dënohet, ai duhet të ketë

mundësinë që në një fazë të procedurës penale të i kundërshtoj dëshmitë dhe merr në pyetje dëshmitarët kundër tij. Përjashtimet janë të mundëshme, por duhet të jenë rreptësisht të nevojshme. Rrethanë në kuadër të cilës një përjashtim i tillë mund të jetë i nevojshëm dhe që është relevante për rrethanat e rastit konkret, është rasti kur dëshmitarët nuk mund të marrin pjesë në gjykim, sepse, ndër të tjera, nuk mund të gjinden. Megjithatë, në raste të tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjykata përkatëse duhet të ndërmerr hapa pozitiv dhe të ndërmerr masa të arsyeshme për të siguruar praninë e dëshmitarëve në process gjyqësor.

69. Për të vlerësuar nëse një process gjyqësor dhe i cili është zhvilluar pa praninë e dëshmitarëve, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë, siç është cekur më lart, GJEDNJ ka zhvilluar testin *Al-Khawaja dhe Tahery*, dhe bazuar në të cilin, duhet të trajtohen tri çështjet në vijim: nëse (i) ka pasur arsye të qëndrueshme për mos-pjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe për pasojë, pranimin e dëshmive jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë si dëshmi në gjykatë; (ii) dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “*vetme ose vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompenzohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimit të dëshmisë jashtëgjyqësore.
70. Në aplikimin e një testit të tillë në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton qëndrimin e GJEDNJ-së, se çështjet që ndërlidhen me dëshmitë në një shqyrtim gjyqësor janë në parim çështje ligji dhe të gjykatave të rregullta. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të (i) shqyrtoj vlerësimin e gjykatave të rregullta përkitazi me rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë dhe të vendos nëse ky vlerësim i gjykatave të rregullta është i papranueshëm ose arbitrar; dhe (ii) vlerësoj vet rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, nëse gjykatat e rregullta nuk e kanë sqaruar pozicionin e tyre përkitazi me këtë çështje apo nëse një sqarim i tillë është i paqartë.

(i) *Sa i përket arsyeve të qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit në proces gjyqësor*

71. Gjykata fillimisht rithekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, arsyet që kanë rezultuar në mospjesëmarrjen e një dëshmitari në shqyrtim gjyqësor duhet të jenë të qëndrueshme. Vlerësimi i arsyeshmërisë së mungesës së dëshmitarit, është pyetje paraprake, dhe rrjedhimisht është çështja e parë që duhet të shqyrtohet nga një gjykatë.

72. Siç është theksuar më lart, dhe relevante për rrethanat e rastit konkret, fakti që gjykatat nuk janë në gjendje të lokalizojnë dëshmitarin përkatës ose fakti që ky dëshmitarë nuk është gjendur në shtetin në të cilin zhvillohet procedura, nuk është arsye e majftueshme për të plotësuar kërkesat e paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në një rast të tillë, autoritetet përkatëse duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar praninë e tyre në gjykatë dhe duhet të ndërmarrin hapa konkret për të i mundësuar të akuzuarit marrjen në pyetje të dëshmitarit. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 120). Siç është cekur më lart, këto masa përfshiejnë por nuk janë të kufizuara në bashkëpunimin me policinë, dhe ndihmën ndërkombëtare juridike, atëherë kur, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, një dëshmitar jeton jashtë shtetit përkatës.
73. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret çështja e parashtruesit të kërkesës fillimisht ishte gjykuar në Gjykatën e Qarkut dhe e cila përmes Aktgjykimit [P.nr.424/2002] të 17 janarit 2003, ai ishte shpallur fajtor. Bazuar në shkresat e lëndës, gjendja faktike ishte vërtetuar bazuar në deklaratimet deponuara të shtatë (7) dëshmitarëve. Asnjëri prej tyre nuk kishte qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Ky Aktgjykim, ishte anuluar përmes Aktvendimit [Ap.nr.347/2003] të 24 shkurtit 2004 të Gjykatës Supreme, për çështje që nuk ndërliidhen me mungesën e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor, dhe çështja e parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim.
74. Në gjykimin e përsëritur, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor përmes Aktgjykimit [P.nr.162/2004 PR1] të 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore. Bazuar në shkresat e lëndës, gjendja faktike ishte vërtetuar bazuar në deklaratimet e deponuara të katër (4) dëshimtareve në mungesë; pjesërisht një dëshmitari tjetër, gjithashtu në mungesë; dhe pjesërisht në deklaratimet e të akuzuarit tjetër, përkatësisht, S.R.
75. Sipas Gjykatës Themelore, përdorimi i këtyre deklaratave si dëshmi në shqyrtimin gjyqësor ishte i mundshëm, bazuar në pikën 1 të paragrafit 1 të nenit 368 të KPPPK-së, në rastet kur personat e marrë në pyetje *“nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur”*. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit përkatës, më specifikisht theksoi:

“Dëshmitë e dëshmitarëve V.K, V.S, N.M, B.V dhe A.M, të dhëna në procedurë hetimore para gjyqtarit hetues u lexuan dhe si prova u përdorën në shqyrtim gjyqësorë në kuptim të nenit 368

par 1 nën par 1 të KPK-së, meqë sigurimi i pranisë të këtyre dëshmitarëve për të dëshmuar në shqyrtim gjyqësorë ishte i pamundur për faktin se katër dëshmitarët- të dëmtuarat janë shtetase të shtetit tjetër dhe nuk u dihet adresat e vendbanimeve, ndërkaq dëshmitari A.M është konstatuar se nuk gjindet në Kosovë”

76. Gjykata rikujton se pamundësia e të akuzuarit, përkatësisht parashtresit të kërkesës për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, ishte ngritur përmes ankesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë respektivisht, dhe rrjedhimisht ishte shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit e Gjykata Supreme.

77. Përkitazi me këtë çështje, e para, përkatësisht Gjykata e Apelit, arsyetoi si në vijim:

“është evidente se në kohën kur kanë filluar hetimet dhe kur kjo çështje është gjykuar për herë të parë është zbatuar ligji i procedurës penale i ish Jugosllavisë. ... Sipas këtij ligji procesverbalet mbi deklaratimet dëshmitarëve kanë mundur të lexohen kur ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur meqë, kjo çështje është kthyer në rigjykim konform dispozitave ligjore respektivisht dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2013, çështja është gjykuar sipas kodit procedural të vitit 2004, kurse gjykata konform dispozitës së nenit 368 par.1 të KPPK ka lexuar procesverbalet mbi deklaratimet e të dëmtuarave sigurimi i të cilave ka qene i pamundur në shqyrtimin gjyqësor për shkak se janë shtetase të shtetit tjetër dhe nuk u janë ditur adresat e vendbanimeve dhe në rastet kur sigurimi i tyre është i pamundur sipas par.1 të kësaj dispozite deklaratat e tyre mund të lexohen pa pëlqimin e palëve”

78. Ndërsa, e dyta, përkatësisht Gjykata Supreme, theksoi se:

“Nuk është i bazuar pretendimi i mbrojtësve të të dënuarve Hysen Kamberi [...] se deklaratat e të dëmtuarave [...] janë lexuar në kundërshtim me nenin 260 të KPPK, për faktin se siç janë dhënë arsye për këtë bazë juridike nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë procedura në këtë çështje penale ka fiksuar dhe është zhvilluar sipas ligjit të vjetër (të ish Jugosllavisë) prandaj këto deklarata kanë mundur të lexohen sipas nenit 333 par 1. Pika 1 të LPP(338 par 1 pika 1.1 të kodit të aplikueshëm), pra nuk ka pasur pengesa ligjore për leximin e tyre”.

79. Gjykata gjithashtu vëren së në gjykimin fillestar kundër parashtuesit të kërkesës ishin aplikuar dispozitat e Ligjit Penal të ish Jugosllavisë, mbi bazën e nenit 333 të të cilit, deklaratat e dëshmitarëve në mungesë mund të lexohen në shqyrtim gjyqësor vetëm me vendim të gjykatës, ndër të tjera, në rastet kur dëshmitarët nuk mund të gjinden ose paraqitja e tyre para gjykatës nuk është e mundur. Gjykimi i përsëritur ishte bazuar në dispozitat e KPPPK-së, i cili bazuar në nenin 368 të tij, përcakton të njëjtën mundësi. E njëjta vlen edhe për nenin 338 të KPPRK-së.
80. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se, ashtu siç kanë konstatuar gjykatat e rregulla, dispozitat përkatëse procedurale, mundësojnë pranimin e dëshmive të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor nëse paraqitja para gjykatës e këtyre dëshmitarëve është e pamundur. Megjithatë, bazuar në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikë d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të ketë një arsye të qëndrueshme përkitazi me këtë pamundësi të pjesëmarrjes së dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor dhe se gjykatat përkatëse duhet të ndërmarrin hapa konkret për të siguruar praninë e tyre në shqyrtim gjyqësor.
81. Arsyetimi i dhënë nga Gjykata Themelore, dhe vërtetuar nga Gjykata e Apelit dhe Supreme, respektivisht, thekson se *“prania e këtyre dëshmitarëve për të dëshmuar në shqyrtim gjyqësor ishte i pamundur për faktin se katër dëshmitarët-të dëmtuarat janë shtetase të shtetit tjetër dhe nuk u dihen adresat e vendbanimeve, ndërkaq dëshmitari A.M është konstatuar se nuk gjendet në shtetin e Kosovës”*.
82. Gjykata thekson se duke marrë parasysh rëndësinë të drejtës të një të akuzuari për të kundërshtuar dëshmitë kundër tij dhe marrë në pyetje në ndonjë fazë të procedurës gjyqësore dëshmitarët kundër tij, një arsyetim i tillë, nuk është i qëndrueshëm. Ky është rasti edhe përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe sipas të cilës, specifikisht, fakti që gjykata vendore nuk ka qenë në gjendje të lokalizoj dëshmitarin përkatës ose fakti që ky dëshmitarë nuk është gjendur në shtetin në të cilin zhvillohet procedura, nuk është arsye e majftueshme për të plotësuar kërkesat e paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së.
83. Për të ilustruar paqëndrueshmërinë e një konstatimi të tillë të gjykatave të rregullta, Gjykata në vijim do të e paraqes vlerësimin e GJEDNJ-së në dy raste të ngjashme, përkitazi me shqyrtimin nëse mungesa e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor bazohet në një arsye të

qëndrueshme. Në të parin GJEDNJ kishte konstatuar se kishte një të tillë, ndërsa në të dytin jo. Më specifikisht, si në vijim:

84. Në rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, GJEDNJ kishte konstatuar se kishte një arsye të qëndrueshme për mungesën e dy dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Në këtë rast, dëshmitaret O. dhe P., dy shtetase të Letonisë, kishin qenë viktimat dhe dëshmitare të një vjedhje të rëndë gjatë kohës kur jetonin përkohësisht në Gjermani, duke ushtruar aktivitete të prostitucionit. Në procedurën e hetimeve, ishin marrë disa herë në pyetje nga policia dhe prokuroria. Me fillimin e procedurës gjyqësore, gjykata përkatëse rajonale në Gjermani, fillimisht kishte kontaktuar me dëshmitarët përkatëse e të cilat kishin refuzuar paraqitjen në gjykatë duke u thirrur në arsye shëndetësore dhe gjendje të rënduar emocionale dhe psikologjike. Gjykata kishte refuzuar arsyetimet e tyre si të pabazuara dhe më tej, e njëjta gjykatë, u kishte dhënë disa alternativa si mundësi për tu paraqitur para gjykatës dëshmitareve përkatëse. Të njëjtat kishin refuzuar. Gjykata gjermane, duke u bazuar në mekanizmat e ndihmës ndërkombëtarë juridike, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të shtetit të Letonisë, kishte organizuar mundësinë që dëshmitaret të paraqiteshin dhe të merreshin në pyetje në një gjykatë në Letoni, në mënyrë që të sigurohej e drejta e të akuzuarit për të i marrë në pyetje dëshmitaret përkatëse. Seanca gjyqësore e caktuar ishte anuluar pak ditë para mbajtjes duke u bazuar në certifikata shëndetësore të dëshmitareve përkatëse. Gjykata gjermane më tej i kishte sugjeruar autoriteteve të Letonisë që të vërtetohet gjendja shëndetësore e dëshmitareve nga një zyrtarë shëndetësor publik ose të njëjtat të detyrohen që të dëshmojnë në procesin gjyqësor. Autoritetet e publike të shtetit në të cilin gjindeshin dëshmitaret nuk kishin bashkëpunuar më tej. Për pasojë, gjykata rajonale përkatëse në Gjermani, bazuar në dispozitat procedurale kodit të procedurës penale, kishte pranuar dëshmitë e dëshmitareve përkatëse të dhënë në fazën e hetimeve si provë në procesin gjyqësor. Në shqyrtimin e qëndrueshmërisë dhe arsyeshmërisë së mungesës së dëshmitareve O. dhe P. në këtë proces gjyqësor, në të cilin ato nuk ishin dëshmitaret e vetme, GJEDNJ konstatoi se gjykata përkatëse kishte ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar praninë e tyre në shqyrtim gjyqësor dhe se rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, kishte arsye të qëndrueshme për të pranuar dëshmitë e dëshmitareve O. dhe P. në shqyrtimin gjyqësor. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 53, ndërsa për vlerësimin nëse ka patur një arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitareve O. dhe P. në shqyrtim gjyqësor, shih paragrafët 132-140 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*). Gjykata vë theks në faktin që në këtë rast, GJEDNJ-në konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, duke konstatuar se (i) kishte arsye të

qëndrueshme për mungesën e dëshmitareve në shqyrtim gjyqësor, rrjedhimisht duke u përgjegjur në hapin e parë në mënyrë afirmative; (ii) dëshmia e dëshmitareve përkatëse ishte “*e vetme*” dhe “*vendimtare*”, duke u përgjigjur në mënyrë afirmative edhe në hapin e dytë; ndërsa (iii) nuk kishte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues në procesin gjyqësor për të kompenzuar disavantazhin në të cilin ishte vendosur mbrojtja si rezultat i dëshmime jashtëgjyqësore.

85. Në anën tjetër, në rastin *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ konstatoi se gjykata përkatëse nuk kishte ndërmarrë të gjitha masat e duhura, dhe rrjedhimisht nuk kishte arsye të qëndrueshme për mungesën dëshmitarit në shqyrtimin përkatës gjyqësor. Rasti ndërlidhet me një vrasje, i akuzuari për të cilën kishte refuzuar të dëshmonte, përderisa gjykata përkatëse kishte pranuar si dëshmi në gjykatë, ndër të tjera dhe në mes dëshmitarëve tjerë, edhe thirrjet dhe bisedat telefonike të të akuzuarit. Në këtë rast, gjykatës përkatëse i kishte mjaftuar për tu informuar nga zyrtarët e burgut që i akuzuari kishte refuzuar të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, dhe e njëjta nuk kishte ndërmarrë asnjë hap shtesë për të siguruar praninë e tij në procesin gjyqësor. GJEDNJ në këtë Aktgjykim gjithashtu kishte bërë dallimin në mes të drejtës për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor dhe të drejtës të marrë në pyetje dëshmitarët në raport me të drejtën për të mos inkriminuar vetveten dhe rrjedhimisht për të qëndruar i heshtur. Në një rrethanë të tillë, kur gjykata ishte mjaftuar vetëm me faktin që i akuzuari refuzon të merr pjesë në shqyrtim gjyqësor, dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër për të siguruar praninë e tij në shqyrtim gjyqësor, GJEDNJ kishte konstatuar se nuk kishte një arsye të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitarit/akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, duke theksuar se rrjedhimisht, rrethanat e rastit konkret dështojnë të përmbushin kushtin e parë të testit *Al-Khawaja dhe Tahery*. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 3 deri 38, ndërsa për vlerësimin e nëse ka patur një arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor, shih paragrafët 61 dhe 62 të rastit *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Gjykata vë theks në faktin që në këtë rast, GJEDNJ-në nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, edhe pse (i) nuk kishte arsye të qëndrueshme për mungesën e dëshmitareve në shqyrtim gjyqësor, rrjedhimisht duke u përgjegjur në hapin e parë në mënyrë negative; (ii) dëshmia e dëshmitareve përkatëse nuk ishte “*e vetme*” ose “*vendimtare*”, duke u përgjigjur negativisht në hapin e dytë; dhe se (ii) kishte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues në procesin gjyqësor për të kompenzuar disavantazhin në të cilin ishte vendosur mbrojtja si rezultat i dëshmime jashtëgjyqësore.

86. Për dallim nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, dhe rrethanat e rastit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, dhe ngjashëm me rrethanat e rastit *Seton kundër Mbretësisë së Bashkuar*, në rrethanat e rastit konkret, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se gjykatat e rregullta të kenë ndërmarr apo arsyetuar ndonjë hap konkret për të siguruar praninë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata thekson se përtej referimit në dispozitat përkatëse të kodeve të aplikueshme procedurale përgjatë shqyrtimit të rastit kundër parashtresit të kërkesës, vendimet e gjykatave të rregullta nuk rezultojnë që të njëjtat të kenë ndërmarr ndonjë hap konkret në mbështetje të konstatimit se nuk mund të sigurohet pranina e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Siç është cekur më lart, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që dëshmitarët janë jashtë shtetit në të cilin zhvillohet procedura gjyqësore nuk është i mjaftueshëm dhe nuk përbën arsye të qëndrueshme për mungesën e tyre në proces gjyqësor. Për më tepër, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që gjykatat e rregullta të kenë ndërmarrë ndonjë veprim për të kontaktuar policinë apo të i jenë qasur mekanizmave për ndihmë ndërkombëtare juridike, dhe as të kenë ofruar cfarëdo arsyetimi shtesë për mungesën e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, dhe rrjedhimisht kufizimin e të drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij. Siç është sqaruar më lart, GJEDNJ jodetyrmisht konstaton shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së vetëm mbi faktin se dëshmitarët nuk kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, por analizon nëse ka një arsye të qëndrueshme dhe të arsyetuar për mungesën e tyre.
87. Gjykata rithekson se, bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatoj se në rrethanat e rastit konkret, nuk ka një arsye të qëndrueshme për mospraninë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor, dhe rrjedhimisht rezulton që kushti i parë testit *Al-Khawaja dhe Tahery* nuk është përmbushur. Megjithatë, dhe siç është theksuar më lart, një konstatim i tillë, nuk rezulton detyrimisht në shkelje të paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së. Për të arritur në një konstatim të tillë, Gjykata duhet të shqyrtoj edhe dy aspektet tjera të testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, nëse (i) dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “vetme ose vendimtare” për dënimin e të akuzuarit; dhe (ii) ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompenzohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimi të dëshmisë të dëshmitarëve në mungesë.

(ii) Sa i përket rëndësisë së dëshmisë për dënimin

88. Gjykata fillimisht rikujton se pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve që nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, ngrihet si çështje posaqërisht e rëndësishme nëse deklarata e dëshmitarit është dëshmia “*e vetme*” ose “*vendimtare*” ose nëse e njëjta “*bartë peshë të konsiderueshme*” për dënimin e të akuzuarit. Në rrethana të tilla, dëshmitë tjera ose mbështetëse fitojnë peshë shumë domethënëse. Sa më e forta të jenë dëshmitë tjera inkriminuese, aq më pak ka gjasa që dëshmia e dëshmitarit në mungesë të trajtohet si “*e vetme*” ose “*vendimtare*”.
89. Gjykata gjithashtu rithekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e peshës së dëshmisë së dhënë nga dëshmitari në mungesë, dhe posaqërisht, nëse kjo dëshmi është “*e vetme apo vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit, Gjykata fillimisht duhet të ketë parasysh vlerësimin dhe qëndrimin e gjykatave të rregullta. Kjo qasje është në përpuethshmëri, ndër të tjera, me rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*. (Përkitazi me vlerësimin nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë ishte e vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit, shih paragrafët 141-144 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*). Në këtë rast, GJEDNJ, fillimisht shqyrtoi vlerësimin e gjykatave të rregullta, përkatësisht gjykatws respektive rajonale gjermane, e e cila kishte konsideruar dëshmitaret O. dhe P. si dëshmitare kyqe për prokurorinë, por vendimi i saj ishte bazuar edhe në dëshmi tjera. Nga ana tjetër, prokuroria kishte argumentuar se dëshmitë e dëshmitareve të lartcekura nuk ishin as “*të vetme*” dhe as “*vendimtare*”. GJEDNJ në këtë rast kishte theksuar se gjykatat vendore kishin përcaktuar se dëshmitë e dëshmitareve O. dhe P. nuk kishin qenë “*të vetme*”, por kishin dështuar të përcaktojnë nëse këto dëshmi ishin “*vendimtare*”, përkatësisht nëse këto dëshmi ishin të një rëndësie të tillë sa të jenë përcaktuese për rezultatin e rastit. Përtej shqyrtimit të vlerësimit të gjykatave vendore, GJEDNJ vet vlerësoi rëndësinë e dëshmive të dëshmitareve O. dhe P. për dënimin e të akuzuarit, dhe në këtë aspekt, ajo u fokusua në vlerësimin e fuqisë së dëshmive tjera inkriminuese. Përkitazi me këto të fundit, GJEDNJ vuri theks në (i) dëshminë e dëshmitareve E. dhe L., respektivisht fqinjës dhe shoqes së dëshmitareve e të cilat kishin qenë të informuara për ngjarjen; (ii) dëshminë e vet të akuzuarit; (iii) të dhënat gjeografike dhe inqizimet e bisedave telefonike; dhe (iv) të dhënat e GPS e të cilat tregojnë për lëvizjen e automjetit të të akuzuarit. Megjithatë, GJEDNJ theksoi se përkundër këtyre dëshmive, dëshmitë e dëshmitareve O. dhe P., marrja në pyetje e të cilave ishte e pamundur nga ana e të akuzuarit dhe mbrojtjes së tij përgjatë gjithë procesit gjyqësor, ishin “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit. Për më tepër, sipas

GJEDNJ-së, dëshmitë tjera të përdorura nga gjykatat vendore ishin *“ose jashtëgjyqësore ose teknike dhe jo konkluduese për grabitjen dhe detyrimin si të tillë”*. Në anën tjetër, në rastin *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykatat vendore si dhe GJEDNJ kishin konstatuar se mungesa e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor, përkatësisht mungesa e dëshmisë së tij në shqyrtim gjyqësor, nuk përbënte dëshminë as *“të vetme”* dhe as *“vendimtare”*, sepse dëshmitë tjera kundër tij ishin *“dërrmuese”*. (Përkitazi me vlerësimin nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë ishte e vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit, shih paragrafët 63-64 të rastit *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe referencat e përdorura aty).

90. Në vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, dëshmia e dëshmitarëve në mungesë është *“e vetme”* apo *“vendimtare”* për dënimin e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së fillimisht do të shqyrtoi vlerësimin dhe arsyetimin e gjykatave të rregullta, dhe me pas do të vazhdoj me vlerësimin e saj përkitazi me rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarëve në mungesë për dënimin e parashtruesit të kërkesës.
91. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që gjendja faktike në rigjykimin e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore ishte bazuar në (i) dëshmitë e dëshmitareve V.K; V.S; N.M; dhe B.A; të gjitha në mungesë në shqyrtimin gjyqësor; (ii) *“pjesërisht”* në dëshminë e dëshmitarit A.M, gjithashtu në mungesë në shqyrtim gjyqësor; dhe (iii) *“pjesërisht”* në dëshminë e të akuzuarit S.R, të dhënë në shqyrtim gjyqësor.
92. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se vet Gjykata Themelore ka konstatuar se dënimi i parashtruesit të kërkesës ishte bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë. E vetmja dëshmi tjetër, e të cilës i referohet Gjykata Themelore, dhe e dhënë në shqyrtim gjyqësor, është ajo e të akuzuarit S.R. Gjykata në këtë aspekt, gjithashtu rikujton që Gjykata Themelore vet kishte theksuar se vendimi i saj është vetëm *“pjesërisht”* i bazuar në këtë dëshmi. Marrë parasysh rëndësinë e saj, Gjykata do të citon të plotë dëshminë përkatëse të akuzuarit S.R, në vijim:

“Në deklaratën e tij të dhënë para gjyqtarit hetues me datë 05.11.2002, se pronar i lokalit "Arizona" ka qenë Hysen Kamberi e me vonë pronar i këtij lokali ishte[I.R], po ashtu ka deklaruar se sipas porosisë se [I.V]femrat që kanë punuar në këtë lokal me veturën e tij taksi i ka dërguar deri te ura në dalje të Ferizajit për të nënshkruar kontratën por gjatë rrugës prapë Ismeti ka thënë që ti dërgojë në drejtim të Brezovicës, por femrat nuk kanë

pranuar kështu që pas intervenimit të tyre i pa kthyer prapë në banesën e tyre në Ferizaj”.

93. Gjykata rikujton se i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, kishte ngritur pretendimet e tij për shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i pamundësisë së tij për të kundërshtuar dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë edhe para Gjykatës së Apelit përmes ankesës e edhe para Gjykatës Supreme përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe të dyja kishin hedhur poshtë pretendimet përkatëse, duke u thirrur në dispozita përkatëse të kodeve të aplikueshme procedurale, e bazuar mbi të cilat, ndër të tjera, pranimi i dëshmisë së dëshmitarit i cili nuk mund të gjindet është i mundshëm.
94. Megjithatë, bazuar në deklaratën e mësipërme, Gjykata thekson se (i) e njejta është dëshmia e vetme kundër të akuzuarit të dhënë në shqyrtim gjyqësor; (ii) të gjitha dëshmitë tjera kundër të akuzuarit ishin dhënë nga dëshmitarë të cilët nuk ishin të pranishëm në procesin gjyqësor dhe rrjedhimisht, dëshmitë e të cilëve, i akuzuari nuk ka mundur të i kundërshtoj në asnjë fazë të procedurës penale; (iii) Gjykata Themelore vet përcakton se ajo vendimin e saj e ka bazuar vetëm *“pjesërisht”* në dëshminë e të akuzuarit S.R; për më tepër që Gjykatat Themelore i referohet vetëm edhe një dëshmie tjetër, përkatësisht Mbrojtësit të Viktimave nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës, për të cilën vetëm thuhet se *“i bashkangjitet fjalës përfundimtare të paraqitur nga prokurori i shtetit”*.
95. Gjykata në këtë kontekst thekson se Gjykata Themelore, por as Gjykata e Apelit e ajo Supreme, nuk kanë përcaktuar as nëse dëshmia e dëshmitarëve në mungesë është *“e vetme”* dhe as nëse e njejta është *“vendimtare”* për dënimin e të akuzuarit. Arsyetimi i Gjykatës Themelore dhe i mbështetur nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, nuk vlerëson në asnjë mënyrë raportin në mes dëshmive të dëshmitarëve në mungesë dhe as peshën inkriminuese të dëshmisë së të akuzuarit tjetër S.R dhe deklaratës së Mbrojtësit të Viktimave. Dëshmia e parë në fakt vetëm i referohet parashtruesit të kërkesës si pronar i lokalit përkatës, ndërsa përkitazi me deklaratën e dytë, vendimi i Gjykatës Themelore vetëm thekson se e njejta i bashkangjitet deklartës së prokurorit, pa dhënë asnjë sqarim shtesë se si ajo është *“inkriminuese”* për të akuzuarin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës.
96. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar mbi të cilën, në rast se gjykatat e rregulla nuk kanë vlerësuar rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarëve në mungesë dhe peshën

inkriminuese të dëshmime tjera në proces gjyqësor për dënimin e të akuzuarit, vet Gjykata duhet të vlerësojë rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarëve të cilët nuk ka qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor dhe peshën inkriminuese të dëshmime tjera.

97. Gjykata rithekson se (i) i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës në asnjë fazë të procedurës penale nuk ka patur mundësinë të i kundërshtoj dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë; (ii) Gjykata Themelore vet ka konstatuar se dënimi i të akuzuarit është i bazuar vetëm “*pjesërisht*” në dëshminë e të akuzuarit S.R; (iii) Gjykata rikujton se pesha inkriminuese e dëshmime tjera duhet të ketë peshë të veçantë në raste kur dëshmitarët kryesorë nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, ndërsa dëshmia e të akuzuarit S.R dhënë në shqyrtim gjyqësor, në fakt nuk e akuzon parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar. Siç është cekur më lart, kjo dëshmi vetëm i referohet parashtruesit të kërkesës si pronar i lokalit “Arizona”; ndërsa (iv) në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore, përfshihen edhe deklaratat e në të cilat kontestohet pronësia faktike e lokalit përkatës të parashtruesit të kërkesës dhe çdo lidhje e tij me aktivitetet e këtij lokali, përfshirë deklaratën e I.R-së dhe vet parashtruesit të kërkesës. Gjykata nuk konsteston faktin se dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë e akuzojnë parashtruesin e kërkesës për veprën penale për të cilën është dënuar, por, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson rëndësinë e peshës së dëshmime tjera në rast se i akuzuari nuk ka pasur mundësinë të i kundërshtoj këto prova përgjatë procesit gjyqësor dhe është dënuar bazuar mbi dëshmitë jashtëgjyqësore e dhëna të këtyre dëshmitarëve.
98. Gjykata në këtë konteskt, gjithashtu rikujton rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* dhe në të cilin, siç është sqaruar më lart, përkundër një numri të madh të dëshmime tjera, Gjykata kishte shpallur dëshmitë e dëshmitarëve O. dhe P. si dëshmi “*të vetme dhe vendimtare*” për dënimin e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, sepse këto dëshmitare ishin të vetmet me njohuri të drejtëpërdrejtë për ngjarjet të cilat kishin rezultuar në akuzimin dhe dënimin e parashtruesit përkatës të kërkesës.
99. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se përtej praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, edhe vet dispozitat procedurale të Kodeve përkatëse penale përcaktojnë të njejtat kufizime sa i përket shpalljes së një të akuzuari fajtor duke u bazuar në një provë vendimtare dhe e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale. Ky kufizim është i përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 157 të KPPK-së dhe

paragrafin 1 të nenit 262 të KPPRK-së. Vendimet e gjykatave të rregullta, nuk kishin arsyetuar rrethanat e rastit të konkret nga këndvështrimi i këtyre neneve, dhe as nuk kishin sqaruar raportin në mes tyre dhe neneve 368 të KPPK-së dhe 338 të KPPRK-së, respektivisht. Për më tepër, gjykatat e rregullta gjithashtu nuk kishin marrë parasysh nenet 15 (Trajtimi i viktimave të trafikimit me njerëz gjatë hetimit dhe procedurës penale) e 19 (Sigurimi i viktimave apo dëshmitarëve) të Ligjit nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, dhe të cilat, përkundër faktit që vënë theks në trajtimin specifik që duhet dhënë këtyre viktimave/dëshmitarëve përgjatë procesit gjyqësor me qëllim të parandalimit të viktimizimit të sërishëm të tyre, dhe listimit të një numri mundësish procedurale për të arritur këtë qëllim, ligji i lartcekur nuk përcakton që këto viktimave/dëshmitarë në rastet e trafikimit nuk mund të merren në pyetje të paktën në mënyrë të tërthortë në ndonjë fazë të procedurës penale nga mbrojtja e të akuzuarit dhe se ky i fundit mund të shpallet fajtor duke u bazuar vetëm në deklaratat e lexuara të tyre edhe nëse të njëjtat janë dëshmi “*të vetme*” dhe “*vendimtare*” kundër tij.

100. Rrjedhimisht dhe në një linjë të njejtë argumentimi e posaqërisht duke marrë parasysh mungesën e dëshmive tjera me peshë inkriminuese në procesin gjyqësor, Gjykata duhet të konstatoj se dëshmitë e dëshmitarëve që nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, janë dëshmi “*vendimtare*” dhe “*bartin peshë të konsiderueshme*” në dënimin e të akuzuarit, përkatësisht parashtuesit të kërkesës.
101. Megjithatë, Gjykata rithekson, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, se pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve në mungesë, edhe nëse këto dëshmi janë të “*vetme*” ose “*vendimtare*” kundër të akuzuarit, nuk rezulton automatikisht në shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
102. GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se pranimi i një dëshmie të tillë, dhe duke marrë parasysh rreziqet që reflekton për një proces të drejtë, është faktorë shumë i rëndësishëm dhe i cili duhet të balancohet përmes faktorëve kundërbalancues. Rrjedhimisht, dhe në vijim, Gjykata do të e shqyrtoj çështjen e tretë të mbetur të testit *Al-Khawaja dhe Tahery*, përkatësisht faktorët kundërbalancues në procesin gjyqësor të parashtuesit të kërkesës.

(iii) *Faktorët kundërbalancues*

103. Gjykata fillimisht rithekson se shkalla e faktorëve kundërbalancues të nevojshëm në mënyrë që gjykimi të konsiderohet i drejtë fillimisht varet nga pesha e dëshmive të dëshmitarit në mungesë. Sa më e rëndësishme të jetë dëshmia përkatëse, aq më shumë peshë duhet të mbartin faktorët kundërbalancues në mënyrë që procedura, në tërësinë e saj, të konsiderohet e drejtë. Këta faktorë kundërbalancues duhet të mundësojnë besueshmërinë e duhur të asaj dëshmie. Prandaj, duke marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar se në rrethanat e rastit konkret, dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë, janë “*të vetme*” dhe “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kësës, ajo duhet të analizojë ekzistimin e faktorëve tjerë kundërbalancues në këtë process gjyqësor, në mënyrë që të sigurohet besueshmëria e dëshmive të dëshmitarëve në mungesë.
104. Gjykata rikujton në këtë kontekst, që GJEDNJ ka theksuar se edhe në rastet kur një dëshmi jashtëgjyqësore është e “*vetme*” dhe “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit, pranimi i kesaj dëshmie, jodetyrimisht rezulton në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, në raste të tilla, gjykata përkatëse duhet të i nënshtrohet garancive më të ashpra procedurale. Cëshjta më esenciale në secilin rast është nëse faktorët kundërbalancues mundësojnë besueshmërinë e dëshmive përkatëse. Kjo do të mundësonte që një dënim të jetë i bazuar në dëshmi të tilla vetëm nëse janë mjaftueshëm të besueshme. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 147).
105. Për më tepër, parimet e përgjithshme të elaboruara më lart identikojnë një sërë masash të rëndësishme në këtë kontekst, dhe që do të mund të shërbenin si faktorë kundërbalancues. Një ndër masat e para të rëndësishme është që gjykatat e rregullta, të i qasen me kujdes këtyre provave dhe të dhënë arsyeime të hollësishme përkitazi më besueshmërinë e këtyrë dëshmive. Masë tjetër e rëndësishme është ekzistimi i ndonjë video-inqizimi të këtyrë dëshmive. Për më tepër, ekzistenca e dëshmive shtesë e të cilat mund të konfirmonin në mënyrë të tërthort dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë është po ashtu relevante. Element tjetër me rëndësi është mundësia që mbrojtja e të akuzuarit të kontaktoj me shkrim me dëshmitarët në mungesë. Në fund, është tejet e rëndësishme që i akuzuari dhe mbrojtja e tij të kenë patur cfarëdo mundësie që të i kundërshtojnë dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë në cilëndo fazë të procedurës penale, duke përfshirë edhe fazën e hetimit. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 147).

106. Gjithashtu, në vlerësimin e faktorëve kundërbalancues, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të merr parasysh disa nga çështjet në vijim: (i) qasjen e gjykatës ndaj dëshmive jashtëgjyqësore; (ii) ekzistimin dhe peshën e dëshmive tjera inkriminuese; dhe (iii) masat dhe garancitë procedurale e të cilat kanë mundësuar kompenzimin e disavantazhit të krijuar nga pamundësia e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij. (Shih, në këtë aspekt, qasjen e GJEDNJ-në rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 120).
107. Përkitazi me çështjen e parë, Gjykata thekson se vendimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë asnjë arsyetim lidhur me dilgjencën e shtuar e të nevojshme në vlerësimin e këtyre dëshmive, duke marrë parasysh faktin që i akuzuari dhe mbrojtja e tij, por as vet trupi gjykues, nuk kanë patur mundësinë të shtrojnë pyetje dhe të analizojnë sjelljen e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor dhe të krijojnë një përshtypje të qartë në lidhje me kredibilitetin e dëshmitarëve. Për më tepër, vendimet e gjykatave të rregulla nuk përmbajnë arsyeime të hollësishme përkitazi me besueshmërinë e këtyre dëshmive.
108. Përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht ekzistencën dhe peshën e dëshmive tjera inkriminuese, Gjykata vënë në pah tri çështje. Së pari, siç është theksuar më lart, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është bazuar në dëshminë e pesë (5) dëshmitarëve të cilët nuk ishin të pranishme në gjykim, dhe të cilat, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, asnjëherë nuk kanë pasur mundësinë të i marrin në pyetje. Duke e marrë parasysh natyrën e veprës penale për të cilën akuzohet parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ gjithashtu mban se autoritetet përkatëse duhet të kenë pasur parasysh që dëshimtarët do të mund të mos ishin të pranishme në shqyrtim gjyqësor, dhe ato do të duhej të i kishin dhënë mundësinë mbrojtjes së të akuzuarit, të ballafaqohen me dëshmitarët në fazën e hetimeve. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 157; *Vronchenko kundër Estonisë*, cituar më lart, paragrafi 60; dhe *Rosin kundër Estonisë*, paragrafi 57). Së dyti, Gjykata vëren që Mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës, S.T, ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor dhe vetëm ka deklaruar se i bashkangjitet deklaratës së paraqitur nga Prokurori i Shtetit. Ndërsa së treti, Gjykata Themelore gjithashtu ka theksuar se vendimin e saj ka bazuar “*pjesërisht*” në dëshminë e të akuzuarit, S.R. Siç, është theksuar më lart, kjo dëshmi nuk është veçanërisht inkriminuese dhe gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë se si një dëshmi e tillë kundërbalancohet faktin që vendimet e tyre janë bazuar në dëshmi të dëshmitarëve në mungesë.

Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, në këtë kontekst ka theksuar si në vijim:

“Në vecanti gjykata ka vlerësuar deponimet e dëshmitareve të dëgjuara të cilat i ka vlerësuar si kredibile sepse gjejnë mbështetje edhe në provat tjera dhe pjesërisht edhe në mbrojtjet e të dënuarve, për çfarë në faqet 13 -17 janë dhënë arsye ligjore”

109. Megjithatë, siç është theksuar më lart, rezulton se (i) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, është bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve në mungesë; (ii) vet ka theksuar se është e bazuar vetëm në mënyrë “të pjesëshme” në dëshminë e të akuzuarit, S.R, e vetmja dëshmi që është dhënë në shqyrtim gjyqësor; (iii) asnjëherë nuk i referohet përmbajtjes së deklaratës së Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës; dhe (iv) gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme, nuk kanë sqaruar se si dëshmitë tjera të marra në shqyrtim gjyqësor i mbështesin dëshmitë jashtëgjyqësore mbi bazën e të cilave kanë shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor.
110. Në fund, dhe përkitazi me çështjen e tretë, përkatësisht masat dhe garancitë procedurale e të cilat kanë mundësuar kompenzimin e disavantazhit të krijuar nga pamundësia e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, Gjykata vëren që (i) i akuzuari përkatësisht parashtruesi i kërkesës ka patur mundësinë që të jap versionin e tij përkitazi me akuzën penale kundër tij; megjithatë (ii) i njëjti nuk ka patur mundësinë në asnjë fazë të procedurës penale të ballafaqohet me dëshmitarët kundër tij, dëshmi këto “vendimtare”, e mbi bazën e të cilave, është shpallur fajtor.
111. Gjykata, në aspekt të faktorëve kundërbalancues, vëren se Gjykata Themelore, përtej dëshmive të dëshmitarëve në mungesë, kishte disa dëshmi shtesë, përkitazi me veprën penale për të cilën parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në asnjë mënyrë nuk kishin sqaruar raportin në mes dëshmive të dëshmitarëve në mungesë dhe provave tjera inkriminuese, dhe për më tepër, nuk kishin ndërmarrë masa procedurale dhe as ofruar arsyetim shtesë gjatë shqyrtimit gjyqësor, veprime këto të cilat do të mund të kishin kompenzuar disavantazhin e krijuar për të akuzuarin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, në pamundësi për të marrë në pyetje në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëshmitarët kundër tij. Prandaj, Gjykata duhet të konstatoj se faktorët kundërbalancues nuk ishin të mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e drejtë të besueshmërisë së dëshmive jashtëgjyqësore mbi bazën e të cilave parashtruesi i kërkesës u dënua.

112. Përfundimisht, duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret, është konstatuar se (i) nuk ka pasur arsye të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitareve në shqyrtim gjyqësor duke i pamundësuar si pasojë, të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, kundërshtimin e dëshmive dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tij; (ii) dëshmia e dëshmitarëve në mungesë është baza e “vetme” dhe “vendimtare” për dënimin e të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) nuk ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, e të cilat do të mund të kompenzonin disavantazhin që i është krijuar të akuzuarit dhe mbrojtjes së tij, si rezultat i pamundësisë për të marrë në pyetje dëshmitarët përkatëse, Gjykata thekson se janë plotësuar të tri kushtet e testit të GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery*, dhe rrjedhimisht, nuk janë respektuar garancitë procedurale të mishëruara në paragrafin 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe si pasojë, procedura në tërësisë e saj, nuk ka qenë e drejtë, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjykata thekson se ky konstatim nuk ndërlidhet me dhe nuk paragjykon fajësinë apo pafajësinë e parashtruesit të kërkesës.

Përfundime

113. Aktgjykimi [PML.nr.241/2017] i 5 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse dëshmitarët kundër të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor dhe parashtruesi i kërkesës e mbrojtja e tij, në asnjë fazë të procedurës penale, nuk kanë pasur mundësi të marrin në pyetje dëshmitarët kundër tij.
114. Gjykata përgjatë këtij Aktgjykimi ka sqaruar se mospjesëmarrja e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor dhe pamundësia e një të akuzuari dhe mbrojtjes së tij për të marrë në pyetje dëshmitarët përkatës, përkundër rëndësisë vendimtare të këtyre dy aspekteve, jo detyrimisht rezulton në shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse drejtësia e një procedure, duhet të vlerësohet në tërësinë e saj. Megjithatë, marrë parasysh rëndësinë vendimtare të këtyre të drejtave, gjykatat, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së,

përkatësisht testin e njohur si *Al-Khawaja dhe Tahery* duhet të vërtetojnë nëse (i) ka pasur arsye të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor; (ii) nëse dëshmia e këtyre dëshmitarëve është baza “*e vetme*” ose “*vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) nëse ka pasur faktor të mjetueshëm kundërbalancues. Gjykata në këtë Aktgjykim ka sqaruar, që në rrethanat e rastit konkret, nuk është plotësuar asnjëri nga këto kushte.

115. Rrjedhimisht, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimi [PML.nr.241/2017] i 5 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, nuk janë në përpuethshmëri me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

116. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij kishte kërkuar gjithashtu që identiteti i tij të mos zbulohet.
117. Parashtruesi i kërkesës lidhur me kërkesën për mos-zbulim të identitetit arsyeton si në vijim “ *Arsyet janë personale të parashtruesit të kësaj kërkesë. Kërkesa është paraqitur nga avokati Selman Bogiqi*”.
118. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit të 6 të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(6) Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. Gjykata me shumicë votash autorizon moszbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet moszbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me iniciale ose me shkurtësi apo me një shkronjë të vetme”.

119. Duke u bazuar në arsyetimin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa për moszbulim të identitetit nuk është e arsyetuar dhe si tillë, nuk është bazë për miratimin e saj. (Shih rastin e Gjykatës, KI74/17, parashtrues *Lorenc Kolgjerraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017).

120. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 janar 2020, me shumicë votash.

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [PML.nr.241/2017] e 5 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- IV. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [PAKR.nr.55/2017] e 13 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit të Kosovës;
- V. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [P.nr.162/2004 PR1] e 2 dhjetorit 2016 të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj;
- VI. TA KTHEJË çështjen në rigjykim në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;
- VII. TË URDHËROJË Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Ferizaj që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI 193/18, Parashtrues i kërkesës: Agron Vula, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mospërmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008

KI 193/18, Aktgjykim i miratuar më 22 prill 2020, i publikuar më 12 maj 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete efektive juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, zgjidhje efektive, mos zbatim i vendimit të përmbarueshëm, kompensimi i dëmit.

Parashtruesi i kërkesës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit , Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018 në lidhje me mospërmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008, duke pretenduar shkelje të drejtave dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Gjykata konstatoi se aspektet thelbësore të kësaj kërkesë kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ), të drejtën për mjete juridike efektive dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave (nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ).

Gjendja faktike në rastin konkret paraqitet si në vijim: në vitin 2003 Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gjakovës nxori Aktvendimin 12 nr. 01-139, për “suspendimin e përkohshëm” të parashtruesit të kërkesës nga vendi i punës - duke filluar nga 20 gushti 2003 e deri në përfundimin e procedurës për konstatim të përgjegjësisë së tij disiplinore. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës u ankua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, KPMK). Më 25 shkurt 2008, KPMK-ja me Vendimin A 02 158/2005, aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe urdhëroi Komunën e Gjakovës që ta zhvillojë një procedurë disiplinore të re ndaj parashtruesit të kërkesës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. KPMK-ja kishte konstatuar: “Ky organ duke i shqyrtuar provat shkresore të prezantuar gjën se; Suspendimi i të përmendurit është

bërë në kundërshtim me procedurën e paraparë me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 lidhur me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës [...]”.

Ndërkohë, çështja e parashtruesit të kërkesës u zhvillua në procedura administrative, kontestimore dhe përmbarimore, ku u nxorën një mori vendimesh në dobi por edhe në dëm të parashtruesit të kërkesës. Vendimi i fundit në çështjen e parashtruesit të kërkesës ishte Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, që kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës e refuzoi të papranueshme për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (*litispendenca*).

Në shqyrtimin e saj, Gjykata theksoi posaçërisht faktin se Vendimi i KPMK-së ishte vërtetuar në procedurë përmbarimore nga Gjykata e Apelit, si shkallë e fundit, me aktvendimet Ac.nr.1459/15 dhe Ac. nr. 516/16, të 26 tetorit 2015, përkatësisht 4 dhjetorit 2017. Këto aktvendime të Gjykatës së Apelit po ashtu kishin vërtetuar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, me të njëjtin numër, E.nr.1100/12, të 31 tetorit 2014, përkatësisht 27 shkurtit 2015, të cilat kishin lejuar përmbarimin e Vendimit të KPMK-së, të 25 shkurtit 2008.

Për sa i përket përmbarimit të vendimit të KPMK-së dhe ndërlidhjes me nenin 31 të Kushtetutës Gjykata theksoi se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që janë në shpërputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë.

Për sa i përket zgjidhjes efektive të çështjes së parashtruesit të kërkesës, Gjykata u shpreh se mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive, për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-s (pavarësisht se cili do të ishte epilogu për parashtruesin nga përmbarimi i atij Aktvendimi), cenon të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me të drejtën për zgjidhje efektive, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.

Në fund, Gjykata konstatoi se mospërmbarimi i Aktvendimit të KPMK-së nga Komuna e Gjakovës, sidomos pas disa vendimeve të gjykatave të rregullta që lejuan përmbarimin e tij, kanë shkaktuar shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Gjykata theksoi se Vendimi i KPMK-së nuk ka përcaktuar që Komuna e Gjakovës duhej ta kthente parashtruesin e kërkesës në vendin e punës, por ka urdhëruar Komunën e Gjakovës që procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës ta zhvillonte në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për shërbyesit civilë. Prandaj, Gjykata nuk ka trajtuar çështjen nëse parashtruesi i kërkesës duhet të kthehet, ose jo, në vendin e punës, përkatësisht nëse është cenuar neni 49 i Kushtetutës.

Për sa i përket ndreqjes së shkeljeve të garancive kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit nën shqyrtim, vlerësoi se është detyruar të mjaftohet me konstatimin e shkeljes së neneve 31 dhe 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 13 të KEDNJ-së, duke udhëzuar parashtruesin e kërkesës në procedurë civile, pranë gjykatave të rregullta, për kompensim eventual të dëmit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI193/18

Parashtrues

Agron Vula

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së
Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me
mospërmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur
Mbikëqyrës të Kosovës, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agron Vula (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mospërmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK), A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008 dhe aktvendimeve gjegjëse të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, që kanë vërtetuar Vendimin e KPMK-së.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mospërmbarimin e Vendimit të KPMK-së, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008, nga Komuna e Gjakovës.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, përkitazi me mospërmbarimin e vendimit të lartpërmendur të KPMK-së nga Komuna e Gjakovës, i cenojnë atij të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 20 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu, gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 27 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 25 qershor 2019, Gjykata kërkoi dosjen e plotë të lëndës nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

10. Më 5 korrik 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë i dorëzoi Gjykatës dosjen e lëndës, e cila përmbante vetëm disa nga vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjykatat e rregullta në rastin në fjalë.
11. Më 27 nëntor 2019, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që kërkesa të shqyrtohet në një datë të mëtejme, pas pranimit të dokumenteve dhe sqarimeve shtesë nga Komuna e Gjakovës.
12. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata kërkoi nga Komuna e Gjakovës që ta njoftojë nëse është mbajtur ndonjë procedurë disiplinore ndaj parashtresit, duke pasur parasysh Vendimin e KPMK-së, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008.
13. Më 13 dhjetor 2019, Komuna e Gjakovës dorëzoi një përmbledhje dokumentesh të ndryshme lidhur me rastin, si dhe komentet e saj lidhur me pretendimet e parashtresit të kërkesës.
14. Më 11 mars 2020 dhe 22 prill 2020, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
15. Më 22 prill 2020, Gjykata njëzëri votoi dhe vendosi: (i) kërkesa është e pranueshme; dhe, (ii) mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së, A 02 158/2005, i 25 shkurtit 2008, i cili ishte vërtetuar në procedurë përmbarimore nga Gjykata e Apelit, si shkallë e fundit, me aktvendimet Ac.nr.1459/15 dhe Ac. nr. 516/16, të 26 tetorit 2015, përkatësisht 4 dhjetorit 2017, ka shkaktuar shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

16. Parashtresi për herë të tretë dorëzon në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për moszbatim të Vendimit të KPMK-së, të 25 shkurtit 2008. Në dy kërkesat e para, Gjykata kishte nxjerrë dy aktvendime për papranueshmëri, gjegjësisht Aktvendimin nr. KI57/09, të 14 dhjetorit 2010 dhe Aktvendimin nr. KI216/13, të 23 janarit 2014.
17. Në Aktvendimin nr. KI57/09, Gjykata kishte konstatuar se kërkesa e parashtresit ishte e parakohshme, sepse Komuna e Gjakovës ishte ankuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe se çështja ende nuk ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë. Rrjedhimisht, Gjykata e kishte refuzuar si të papranueshme kërkesën nr. KI57/09, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike (në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës).

18. Në Aktvendimin nr. KI216/13, Gjykata kishte shpallur kërkesën e parashtruesit qartazi të pabazuar, duke konstatuar se Vendimi i KPMK-së kishte urdhëruar Komunën e Gjakovës që ta zhvillojë procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës dhe jo që ta kthejë atë në vendin e punës.
19. Gjykata konsideron se kërkesa në shqyrtim është kërkesë e re, duke pasur parasysh se janë zhvilluar disa procedura dhe janë marrë vendime gjyqësore, lidhur me rastin në fjalë, pas nxjerrjes së dy aktvendimeve të saj (KI57/09 dhe KI 216/13).
20. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i vlerësojë posaçërisht të gjitha veprimet dhe procedurat që janë zhvilluar nga viti 2014 e tutje, duke pasur parasysh se procedurat që janë zhvilluar para vitit 2014 kanë qenë objekt trajtimi në dy aktvendimet e lartcekura të Gjykatës Kushtetuese.
21. Në këtë vazhde, Gjykata vëren se në gjykatat e rregullta janë zhvilluar paralelisht disa grupe të procedurave gjyqësore, të natyrës kontestimore, administrative dhe përmbarimore. Këto procedura janë zhvilluar të ndërlidhura me njëra-tjetrën, që nga viti 2003 deri në vitin 2018 dhe si të tilla janë paraqitur kronologjikisht më poshtë (me theks të veçantë në procedurat e zhvilluara që nga viti 2014).

PROCEDURAT E ZHVILLUARA PARA VITIT 2014

A. Procedurat administrative dhe kontestimore

22. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në Njësitin e Zjarrfikësve në Komunën e Gjakovës, si Shef i Preventivës dhe Hulumtimit të Zjarrit.
23. Më 19 gusht 2003, Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gjakovës nxori Aktvendimin 12 nr. 01-139, për “suspendimin e përkohshëm” të parashtruesit nga vendi i punës - duke filluar nga 20 gushti 2003 e deri në përfundimin e procedurës për konstatim të përgjegjësisë së tij disiplinore. Sipas këtij vendimi, gjatë tërë kohës së suspendimit, parashtruesit të kërkesës do t'i kompensoheshin ½ (gjysma) e të ardhurave të tij mujore.
24. Më 20 gusht 2003, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Kuvendin Komunal të Gjakovës, “për Kryeshefin Ekzekutiv”. Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës asnjëherë nuk ka vendosur përkitazi me ankesën e

parashtruesit. Po ashtu, parashtruesi nuk kishte marrë asnjëherë asnjë vendim nga Komuna e Gjakovës, lidhur me ankesën e tij.

25. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, kundër vendimit të lartpërmendur të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjakovës.
26. Më 17 janar 2005, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktgjykimin C. nr. 1357/04, kishte konstatuar se Vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjakovës ishte i pavlerë juridike, sepse nuk ishte në përputhje me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës dhe detyroi Komunën e Gjakovës që parashtruesin ta kthejë në vendin e tij të punës, si dhe t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 446.€, në afat prej 8 (tetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
27. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjakovës kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
28. Më 29 shtator 2005, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 113/05, me të cilin e ndryshoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe kërkesëpadinë e parashtruesit e refuzoi si të pa bazuar. Gjykata e Qarkut kishte arsyetuar se parashtruesi kishte krijuar marrëdhënie të punës të kontraktuar për kohë të caktuar, duke filluar prej 1 janarit 2003 deri më 30 qershor 2003. Rrjedhimisht, parashtruesit i kishte përfunduar marrëdhënia e punës pas skadimit të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës të përcaktuar me kontratë.
29. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut, duke theksuar mos zhvillimin e procedurës disiplinore.
30. Nga shkresat e lëndës vërehet se më 25 tetor 2006 Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 10/2006, kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit, duke vlerësuar se është fakt jorelevant që ndaj paditësit nuk është zhvilluar procedura disiplinore për vërtetimin e shkeljes serioze të detyrave nga marrëdhënia e punës.
31. Ndërkohë që zhvilloheshin procedurat në Gjykatën Supreme, **më 1 dhjetor 2005 parashtruesi ishte ankuar në KPMK** (ankesa ishte përcjellë përmes Ministrisë së Shërbimeve Publike).

32. Më 25 shkurt 2008, KPMK-ja nxori Vendimin A 02 158/2005, me të cilin vendosi si në vijim:

"I. APROVOHET pjesërisht ankesa e ankuesit Agron Vula A 02 158/2005 e datës 1.12.2005 dhe lënda i kthehet organit të punësimit për shqyrtim dhe vendosje.

II. OBLIGOHET organi i punësimit Komuna e Gjakovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të zbatoj procedurën ligjore dhe të miratoj vendimin në lidhje me këtë çështje administrative".

33. Për sa i përket procedurës së ndjekur për suspendimin e parashtruesit, pjesa relevante e Vendimit të KPMK-së konstatoi: *"Ky organ duke i shqyrtuar provat shkresore të prezantuar gjen se; Suspendimi i të përmendurit është bërë në kundërshtim me procedurën e paraparë me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 lidhur me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës [...]."*
34. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi kishte paraqitur në Gjykatën Komunale në Gjakovë propozim për përsëritje të procedurës, për shkak se ishin plotësuar kushtet ligjore nga neni 421 para. 1, pika 8 dhe 9 të LPK-së. Parashtruesi kishte arsyetuar se vendimi i lartpërmendur i KPMK-së përfaqëson fakt të ri.
35. Gjykata Komunale në Gjakovë kishte vendosur që çështjen për kërkesën për përsëritje të procedurës t'ia referojë për gjykim Gjykatës së Qarkut në Pejë.
36. Më 7 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin C. nr. 121/09, kishte vendosur që të: *"LEJOHET përsëritja e procedurës e përfunduar në mënyrë të plotfuqishme në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 113/05 të dt. 29.09.2005, dhe PRISHEN Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë i lartcekur dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Rev. nr. 10/2006 i dt. 25.10.2006 dhe HEDHET padia e paditësit në këtë çështje juridike si e parakohshme".*
37. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi kishte paraqitur padi kundër Komunës së Gjakovës, për pagimin e të ardhurave personale.
38. Më 23 shtator 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktgjykimin C. nr. 555/07 të nxjerrë në procedurën e përsëritur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, kishte pranuar padinë e parashtruesit duke

detyruar Komunën e Gjakovës që parashtruesit të ia paguante shumat përkatëse në të holla, në emër të kompensimit të të ardhurave.

39. Në një datë të paspecifikuar, Komuna e Gjakovës kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale të Gjakovës.
40. Ndërkohë, nga shkresat e lëndës vërehet se më 18 nëntor 2009, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përgjigje të një shkrese të parashtruesit të kërkesës, i dërgoi Kryetarit të Komunës së Gjakovës një “Kërkesë për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës”. Në këtë shkresë (të nënshkruar nga Ministri i MAPL), theksohej se vendimet e KPMK-së janë të detyrueshme dhe duhet të zbatohen dhe se shqyrtimi gjyqësor i vendimit në fjalë nuk e ndal ekzekutimin e tij.
41. Më 22 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 151/10, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Gjakovës (C. nr. 555/07) dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për ta detyruar Komunën e Gjakovës që atij t’ia paguajë shumat përkatëse në emër të kompensimit të të ardhurave personale.
42. Nga shkresat e lëndës vërehet se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 151/10, ndër të tjera, theksonte se: *“[...] në bazë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës të theksuar më lart nuk është vendosur në mënyrë meritore lidhur me çështjen e marrëdhënies së punës të paditësit, për shkak se ende nuk ka përfunduar procedura gjegjëse administrative tek komuna e paditur dhe nuk ka vendim lidhur me këtë çështje për krijimin e detyrimit të kompensimit të dëmit nuk janë plotësuar kushtet thelbësore, për shkak se deri më tani nuk është vërtetuar në mënyrë të sigurt dhe bindshëm se e paditura në bazë të aktvendimit të kundërligjshëm i ka shkaktuar dëm paditësit.”*
43. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.
44. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 22/2011, me të cilin e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit.

B. Procedurat përmbaremore

45. Sipas shkresave të lëndës rezulton se më 30 korrik 2009, Gjykata Komunale e Gjakovës, me Aktvendimin E. nr. 1268/09, e kishte lejuar përmbarimin e vendimit të KPMK-së (të 25 shkurtit 2008).
46. Më 30 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë kishte nxjerrë Aktvendimin E. nr. 1268/09, me të cilin ka miratuar prapësimin e Komunës së Gjakovës, kundër vendimit të 30 korrikut 2009.
47. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi, Gjykata Komunale kishte potencuar se Vendimi i KPMK-së nuk paraqiste titull ekzekutiv sipas Ligjit për procedurën përmbarimore, sepse kishte të bënte me një obligim procedural të organit të punësimit, e që është zhvillimi i procedurës disiplinore dhe nuk kishte të bënte me asnjë detyrim monetar.
48. Nga shkresat e lëndës vërehet se kundër këtij Aktvendimi të Gjykatës Komunale në Gjakovë, parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut.
49. Më 22 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte nxjerrë Aktvendimin Ac. nr. 139/10, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, të 30 dhjetorit 2009.

PROCEDURAT PËRMBARIMORE TË ZHVILLUARA NGA VITI 2014

50. Gjykata vëren se pas vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast (Aktvendimit KI 216/13), janë zhvilluar katër grupe të procedurave përmbarimore.

Grupi i parë i procedurave

51. Nga shkresat e lëndës rezulton se në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës i kishte parashtruar Gjykatës Themelore në Gjakovë propozim për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së, të 25 shkurtit 2008. Më 19 dhjetor 2012, Gjykata Themelore në Gjakovë kishte nxjerrë Aktvendimin E. nr. 1100/12, me të cilin lejojë përmbarimin e Vendimit të KPMK-së, nr. A 02-158/2007, duke detyruar debitorin (Komunën e Gjakovës), që “brenda 7 (shtatë) ditësh të veprojë dhe të përmbushë detyrimin e Vendimit përfundimtar të Këshillit”.
52. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjakovës paraqiti prapësim kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

53. Më 29 tetor 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë nxori Aktvendimin E. nr. 1100/12, me të cilin refuzoi si të pabazuar prapësimin e Komunës së Gjakovës. Gjykata Themelore arsyetoi se pretendimi i debitorit se Vendimi i KPMK-së nuk paraqet titull përmbarues është i paqëndrueshëm. Gjykata Themelore, më tej, shtoi se Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj gjyqësore, sikundër edhe Gjykata Supreme me qëndrimin e saj parimor, kanë vërtetuar se vendimet e KPMK-së që kanë të bëjnë me kthim të punëtorit në vend të punës paraqesin titull përmbarues për gjykatat.

54. Nga shkresat e lëndës vërehet se Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas parashtresës së të autorizuarit të parashtruesit, me datë 31 tetor 2014 kishte nxjerrë një Aktvendim (E. nr. 1100/12), duke vendosur që: *“DETYROHET debitori Komuna e Gjakovës, që në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të zbatoj vendimin e Këshillit të pavarur mbikëqyrës të Kosovës, A. 02 158/2005 të dt. 25.02.2008, sipas kërkesës së kreditorit Agron Vula nga Gjakova, i lejuar me aktvendim të kësaj Gjykate të dt. 19.12.2012”*.

55. Më 2 shkurt 2015, Komuna e Gjakovës parashtroi propozim duke kërkuar kthim në gjendje të mëparshme dhe që t'i lejohej parashtrimi i ankesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, të 29 tetorit 2014. Komuna e Gjakovës arsyetoi se më 25 mars 2104 kishte suspenduar nga puna Avokatin Publik Komunal, e në mungesë të tij kishte autorizuar një firmë të avokatëve me seli në Prishtinë që të ndërmarrin të gjitha veprimet në të gjitha kontestet. Firma e avokatëve nuk kishte ndërmarrë veprime për të cilat ka qenë e autorizuar, ngase në këtë çështje njëkohësisht kanë qenë të autorizuar edhe nga kreditori (parashtruesi i kërkesës).

56. Më 27 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë nxori Aktvendimin E. nr. 1100/12 dhe e hodhi poshtë propozimin e debitorit, Komuna e Gjakovës, me të cilin kishte kërkuar që t'i lejohet parashtrimi i ankesës kundër aktvendimit të asaj gjykate, E. nr. 1100/12, të 29 tetorit 2014 dhe 31 tetorit 2014.

57. Për sa i përket moslejimit të kthimit në gjendjen e mëparshme, Gjykata Themelore në Gjakovë arsyetoi se: *“Sipas dispozitës së nenit 130.2 të këtij Ligji është paraparë se propozimi duhet të paraqitet brenda afatit 7 ditor (afati subjektiv), nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, gjersa, sipas nenit 130. 3 të LPK-së, është paraparë se pas kalimit të 60 ditëve, nga dita e mosveprimit (nuk) mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme (afati objektiv).*

Vet fakti se avokatura publike në Gjakovë, me parashtresë të dt. 17.12.2014 ka njoftuar Gjykatën se procedura e përmbarimit të titullit përmbarues, pra Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës A 02 158/2007 të dt. 25.02.2008, është në fazën e përmbarimit, ashtu që Avokatura Publike ka kërkuar nga zyra e personelit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës që të vazhdojë procedurën e zbatimit sipas kërkesës së kreditorit, tregon se debitorja ka qenë në dijeni për rrjedhën e procedurës mirëpo, brenda afateve të parapara me nenin 130.1 dhe 2 të LPK-së, nuk ka parashtruar propozim për kthim në gjendje të mëparshme [...].”

58. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjakovës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të anulohet aktvendimi i goditur dhe të lejohej kthimi në gjendje të mëparshme.
59. Më 26 tetor 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 1459/15, duke vendosur që: *“REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të debitorës Komuna e Gjakovës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, E. nr. 1100/12 i dt. 27.02.2015, dhe Aktvendimi E. nr. 1100/12 i dt. 31.10.2014 VËRTETOHET”*.
60. Gjykata e Apelit shpjegoi se debitori (Komuna e Gjakovës) e kishte humbur afatin subjektiv dhe objektiv për kthim në gjendje të mëparshme dhe se për atë arsye Gjykata Themelore në Gjakovë ka hedhur poshtë propozimin për kthim në gjendje të mëparshme.
61. Pjesa relevante e Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit përcaktonte si në vijim: *“[...] sipas dispozitës së nenit 112 të LPK-së, refuzimi dhe mospranimi i parashtresës konsiderohet si komunikim i kryer në mënyrë të ligjshëm, që në rastin konkret aktvendimi mbi refuzimin e prapësimit të debitorit konsiderohet si pranim i rregullt dhe se nga data e refuzimit të pranimit të aktvendimit gjer me datën kur është dorëzuar propozimi për kthim në gjendje të mëparshme kanë kaluar 94 ditë, që do të thotë se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është ushtruar në gjykatë pas afatit [...]”*.

Grupi i dytë i procedurave

62. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë propozim për përmbarim të Vendimit

të KPMK-së, nr. A 02 158/2005, të 25 shkurtit 2008, kundër debitorit (Komuna e Gjakovës).

63. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendim E. nr. 1268/09 e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit. Gjykata Themelore në Gjakovë arsyetoi se: *"[...] pas analizimit të kërkesës për vazhdimin e procedurës ka konstatuar se një kërkesë e tillë në këtë fazë të procedurës, përkatësisht kur lënda është përfunduar pasi që gjykata me Aktvendim E. nr. 1268/09 e ka shfuqizuar vendimin me të cilin është lejuar propozimi për përmbarim i kreditorit Agron Vula, i cili aktvendim është bërë i plotfuqishëm sipas Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 139/10 të datës 22.10.2010 [...] Sipas nenit 64 të LPP-së i cili ndër të tjera parasheh që "përmbarimi i shtyrë mund të rifilloj me kërkesë [të] palës që ka kërkuar shtyrjen para skadimit [të] periudhës së shtyrë", andaj në rastin konkret nuk është shtyrë procedura përmbarimore sipas neneve të lartcekura, por është shfuqizuar aktvendimi me të cilin është lejuar përmbarimi, andaj si rrjedhojë në këtë çështje përmbarimore nuk mund të vazhdohet më tutje pasi që çështja ka përfunduar me aktvendim të formës së prerë".*
64. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
65. Më 28 gusht 2017, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin CA. nr. 380/2017, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë (të 22 dhjetorit 2016). Gjykata e Apelit shpjegoi se Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, E. nr. 1268/09, i 30 korrikut 2009, është anuluar dhe se anulimi i atij vendimi është vërtetuar dhe është bërë i formës së prerë me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 139/2010, të 22 tetorit 2010.
66. Për sa i përket natyrës dhe mospërmbarimit të Vendimit të KPMK-së, Gjykata e Apelit shpjegoi: *"Vendimi i KPMK-së ka të bëjë me dy aspekte: Vazhdimi i procedurës disiplinore të iniciuar me aktvendim për suspendim dhe pagesën e kompensimit në 1/2 e të ardhurave personale mujore [...] Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se me vendimin e KPMK-së të dt. 25.02.2008, me nr. A 02 158/2007 nuk është vendosur në mënyrë meritore, por çështja i është kthyer punëdhënësit në procedim të sërishëm për vendimmarrje, andaj vendimi i tillë nuk është i përshtatshëm për përmbarim, sepse në të*

nuk janë përcaktuar objekti i përmbarimit, shuma dhe koha e përmbarjes së detyrimit, ashtu siç është përcaktuar në nenin 27 të LPP-së [...] Meqenëse organi punëdhënës Komuna e Gjakovës, nuk ka vepruar sipas vendimit të KPMK-së, për nxjerrjen e vendimit përkatës në procedurë administrative, kreditori ka pasur mundësi që në kushtet e parapara me paragrafin 3 të nenit 29 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, nr. 03/L-202, t'i drejtohet me kërkesë të veçantë KPMK-së, përkatësisht në kushtet e parapara me këtë dispozitë ligjore të filloj konfliktin administrativ”.

Grupi i tretë i procedurave

67. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjakovës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12, me të cilin ishte lejuar përmbarimi i Vendimit të KPMK-së, nr. A 02 158/2007, i 25 shkurtit 2008. Komuna e Gjakovës kishte pretenduar se çështja është gjykuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 139/10, të 22 tetorit 2010.
68. Më 4 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 516/16, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e debitorit Komuna e Gjakovës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12. Gjykata e Apelit arsyetoi se pretendimet e debitorit janë të pabazuara sepse me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë është lejuar përmbarimi i Vendimit të KPMK-së, nr. A 02 158/2007, i 25 shkurtit 2008. Gjykata e Apelit shtoi se ai vendim është i formës së prerë dhe i përmbarueshëm.

Grupi i katërt i procedurave

69. Pas Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit (të 26 tetorit 2015), parashtruesi kishte paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, propozim për lejimin e përmbarimit sipas Vendimit të KPMK-së (të 25 shkurtit 2008).
70. Më 19 janar 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin E. nr. 1100/12, vendosi që: *“HEDHET POSHTË propozimi për lejimin e përmbarimit i kreditorit Agron Vula, nga Gjakova, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispendencës)”.*
71. Gjykata Themelore në Gjakovë arsyetoi se: *“Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, e më pas edhe shikimin e evidencës së lëndëve sipas detyrës zyrtare ka vërejtur se i njëjti kreditor ndaj të*

njëjtin debitor për të njëjtin objekt të përmbarimit paraprakisht me 30.07.2009 ka parashtruar të njëjtin propozim. Duke konstatuar se për të njëjtën çështje përmbarimore në këtë Gjykatë është duke u zhvilluar procedura ndaj palëve të njëjta, me të njëjtin objekt të përmbarimit, mbështetur në të njëjtin dokument përmbarues pra në Vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, nr. A 02 158/2005, i dt. 25.02.2008. Lënda në fjalë mban numrin e Gjykatës E.nr.1268/09 dhe është lejuar përmbarimi me dt. 30.07.2009”.

72. Ndërkohë, në një datë të pasaktësuar parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, E. nr. 1100/12, të 19 janarit 2016, që kishte hedhur poshtë propozimin për lejimin e përmbarimit të Vendimit të KPMK-së për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (litispændencës).
73. Më 18 shtator 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 227/18, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12, të 19 janarit 2016. Gjykata e Apelit arsyetoi, ndër të tjera, se në bazë të nenit 17 të LPP-së, në lidhje me nenin 262.3 dhe 262.4 të LPK-së, parashihet se: *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Nëse, prapëseprapë bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”*.
74. Më 30 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës i kishte paraqitur Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018.
75. Më 16 nëntor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk ishte aprovuar kërkesa e tij, sepse nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

76. Parashtruesi i kërkesës pretendon se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së, nr. A 02 158/07, i 25 shkurtit 2008, nga debitori Komuna e Gjakovës, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

77. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12, i 19 dhjetorit 2012 dhe 29 tetorit 2014, kanë vërtetuar se Vendimi i KPMK-së, A 02 158/07, i 25 shkurtit 2008, është i “formës së prerë dhe i përmbarueshëm”.
78. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i KPMK-së dhe i gjykatave i akordon atij të drejtën për t’u kthyer në vendin e punës: “... *jam fitues i të drejtës për t’u kthyer në vendin e mëparshëm të punës, sepse jashtëligjshëm isha suspenduar përkohësisht nga vendi i punës, dhe për këtë edhe më tutje trajtohem punëtor aktiv i të paditurës dhe e cila argumentohet nga vendimet e Këshillit dhe aktvendimet e gjykatave [...] argumentohet nga Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës në Prishtinë A 02 158/2007 i datës 25.02.2008 sepse me këtë vendim trajtohem punëtor aktiv i Kuvendit të Komunës së Gjakovës [...]”.*
79. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1459/15, i 26 tetorit 2015, ka refuzuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës dhe ka vërtetuar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12, të 19 dhjetorit 2012 dhe 29 tetorit 2014. Sipas parashtruesit të kërkesës, vendimet e sipërpërmendura të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë kanë vërtetuar se Vendimi i KPMK-së, A 02 158/07, i 25 shkurtit 2008, është i “formës së prerë dhe i përmbarueshëm”.
80. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i katërt i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, i 18 shtatorit 2018, ka prishur vendimin e formës së prerë të KPMK-së, që më herët ishte vërtetuar me aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 1100/12, të 19 dhjetorit 2012 dhe 29 tetorit 2014 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1459/15, i 26 tetorit 2015.
81. Parashtruesi, për t’i mbështetur pretendimet e tij, i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht rastit *Brumarescu kundër Rumanisë* (rasti nr. 28324/95, GJEDNJ, Aktgjykim i 28 tetorit 1999) dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përkatësisht rastit nr. KIO4/12 (parashtrues *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 20 korrikut 2014) dhe rastit nr. KI112/12 (parashtrues *Adem Meta*, Aktgjykimi i 5 korrikut 2013). Sipas parashtruesit të kërkesës, rastet e sipërcituara janë të rëndësishme për rastin e tij sepse “është paraqitur një situatë e ngjashme e mospërmbarimit të vendimeve administrative nga gjykatat”.

82. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe nenin 13 të Protokollit nr. 11 të KEDNJ-së; (iii) të deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, i cili “shkeli nenin 54 të Kushtetutës dhe 13 të KEDNJ-së”; dhe, (iv) ta kthejë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, “për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate, në përputhje me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, gjithashtu të merr parasysh se Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civilë të Kosovës në Prishtinë, duhet të përmbahet”.

Përgjigja e Komunës së Gjakovës

83. Në përgjigjen e saj të kërkuar nga Gjykata, Komuna e Gjakovës theksoi si në vijim: (i) ndaj parashtruesit të kërkesës nuk është zhvilluar procedurë disiplinore; (ii) duke qenë se parashtruesi kishte kontratë me afat të caktuar pune (prej datës 01.01.2003 deri me 30.06.2003), Komuna nuk pa pasur bazë ligjore për të zhvilluar procedurën, sepse procedura disiplinore nuk mund të zhvillohet ndaj punëtorëve të cilëve iu është “ndërprerë marrëdhënia e punës”; (iii) parashtruesi i kërkesës ishte ftuar nga Komandanti i Brigadës së Zjarrfikësve që të paraqitet në punë në postin zjarrfikës por ai nuk i ishte përgjigjur ftesës në fjalë; dhe, se (iv) parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar të gjitha mundësitë në procedurë administrative kundër heshtjes administrative të garantuara me ligj.
84. Lidhur me shterimin e të gjitha mundësive në procedurë administrative, Komuna e Gjakovës argumenton se: *“Komuna e Gjakovës ka qenë e detyruar të veprojë sipas ligjit gjithnjë duke u bazuar në provat dhe kompetencat e saj, ashtu që nga sqarimet u vërtetua se organi i punësimit-Komuna nuk ka mbajtur procedurë disiplinore siç e ka obliguar Këshilli i Pavarur me vendim A 02 158/2005, për shkak të situatës së krijuar (shkëputjes së marrëdhënies së punës), sipas shkresave të lëndës Agron Vula ka qenë i obliguar që të veprojë kundër heshtjes së administratës (për mos zbatimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur), e që një fakt i tillë vërtetohet se Agron Vula asnjëherë nuk ka ushtruar-vepruar sipas Ligjit për Konflikt Administrativ – heshtje administrative të organit të Komunës, ai nuk ka shtjerë të gjitha mundësitë e tij në procedurë administrative të garantuara me ligj, por ai në vazhdimësi ka vepruar me procedura gjyqësore, përmbaremore pa i shtjerë të gjitha procedurat-mjetet siç parashihi me procedurë administrative,*

andaj rrjedh se të gjitha kontestet i ka humbur dhe atë në të gjitha instancat Gjyqësore”.

85. Komuna gjithashtu vë në pah se parashtruesi “në vazhdimësi ka ushtruar ankesa të ndryshme sa herë që ndërrohet qeverisja lokale, por kjo çështje nuk ka të bëjë aspak me vullnetin e Kryetarit të Komunës apo të Avokatit Publik Komunal, siç pretendon parashtruesi”.

Dispozitat ligjore relevante

RREGULLORJA E UNMIK-ut PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, nr. 2001/36

*Neni 11
Apelimi*

11.3 Në rastet kur Këshilli bindet se vendimi i kundërshtuar ka shkelur parimin e parashtruar në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, ai urdhëron një mjet të përshtatshëm juridik me shkrim dhe një urdhëresë që i drejtohet sekretarit të përhershëm apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin e urdhrit të organit të punësimit.

11.4 Në rastet kur organi i punësimit përkatës nuk i përmbahet vendimit dhe urdhrit të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2003/2 ZBATIM I RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/36 MBI SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

*Neni 31
Procedurat disiplinore*

31.5 Në rastet e shkeljeve serioze, nëpunësi civil mund të suspendohet me pagesë derisa hetimet dhe ose procedurat disiplinore të jenë duke u zhvilluar. Urdhri i suspendimit me pagesë bëhet vetëm nga udhëheqësi kadrovik i organit të punësimit.

LIGJI Nr. 03/L-192 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Neni 12

Ankesat

4. Në rastet kur Këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar janë shkelur parimet apo rregullat e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, ai nxjerr vendim me shkrim i cili i drejtohet zyrtarit të nivelit të lartë drejtues apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin vendimit të Këshillit.

*Neni 13
Vendimi i Këshillit*

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

*Neni 15
Procedura në rast moszbatimi të vendimit të Këshillit*

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

86. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
87. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

88. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon të jetë viktimë e shkeljes kushtetuese, për shkak të mosekzekutimit të vendimit të një autoriteti publik, gjegjësisht KPMK-së. Prandaj, ai është palë e autorizuar.
89. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, për të mbrojtur të drejtat e tij, ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese.
90. Gjykata po ashtu u referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

91. Gjykata vëren se vendimi i fundit në këtë procedurë është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, i 18 shtatorit 2018, dhe se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 17 dhjetor 2018. Rezulton se kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatin ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
92. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesi i kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, pretendon se janë shkelur në dëm të tij, për shkak të mospërmbarimit të Vendimit të KPMK-së, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008.
93. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se ka respektuar kushtin e dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor; ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ka treguar cili është akti konkret i autoritetit publik që kontestohet.

94. Për më tepër, në dritën e pretendimeve të kërkesës dhe argumentimit të tyre, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe adresimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës, si dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.
95. Rrjedhimisht, Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Meritat e kërkesës

96. Gjykata fillimisht sjell në vëmendje, edhe një herë, se në rastin e parashtruesit tanimë ka nxjerrë dy aktvendime për papranueshmëri, me numrat KI57/09 dhe KI216/13. Në rastin nr. KI57/09, Gjykata kishte shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike. Kurse në rastin nr. KI216/13, Gjykata kishte shpallur kërkesën e parashtruesit qartazi të pabazuar, duke konstatuar se Vendimi i KPMK-së nuk kishte urdhëruar Komunën e Gjakovës që parashtruesin ta kthejë në vendin e punës, por që procedurën disiplinore ndaj tij ta zhvillojë në pajtim me ligjin për shërbyesit civilë në fuqi.
97. Gjykata gjithashtu përsërit se pas vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese për këtë rast (Aktvendimi KI 216/13, i 23 janarit 2014), në të njëjtën çështje janë zhvilluar katër grupe të tjera të procedurave dhe janë marrë disa vendime gjyqësore. Ato procedura kanë pasur të bëjnë me (mos)përmbarimin e vendimit të KPMK-së dhe si të tilla janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese në këtë rast.
98. Rrjedhimisht, në shqyrtimin e meritave të kërkesës, Gjykata vë në pah se kërkesa e parashtruesit ngre dy çështje themelore: (i) nëse vendimi i KPMK-së në rastin konkret ka qenë i detyrues dhe i ekzekutueshme; dhe, (ii) nëse mospërmbarimi i vendimit të KPMK-së ka shkaktuar shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), në ndërlidhje me të drejtën për mjete juridike (neni 32 i Kushtetutës) dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave (neni 54 i Kushtetutës).

(i) Lidhur me efektin e vendimeve të KPMK-së

99. Përkitazi me natyrën juridike të vendimeve të KPMK-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme që fillimisht t'i referohet nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës”.

100. Në dritën e këtyre dispozitave kushtetuese, Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se KPMK-ja është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutë, gjegjësisht në pajtim me nenin 101. 2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për të gjitha institucionet përkatëse, ku statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, KPMK-ja ka tiparet e një gjykate, gjegjësisht tribunali për shërbyesit civilë, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së.
101. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas të cilës *“gjykata’ karakterizohet në kuptimin thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë* (Shih, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987 në çështjen *H kundër Belgjikës*, Seria A. nr. 127, f. 34, § 50; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së *Belilos kundër Zvicrës*, ankesë nr. 10328/83, Aktgjykimi i 29 prillit 1988, § 64).
102. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Vendimi i KPMK-së i 25 shkurtit 2008 ishte nxjerrë në kohën kur themelimi i KPMK-së dhe përmbarimi i vendimeve të saj ishte rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, që kishin hyrë në fuqi më 22 dhjetor 2001, gjegjësisht më 25 janar 2003. Atëbotë, çështja e kompetencave, funksionimit, organizmit dhe zbatimit të vendimeve të KPMK-së ishte rregulluar me akte të nxjerra nga UNMIK-u (që kishte kompetenca ekskluzive legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë).
103. Në këtë drejtim, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsekuent që e ka mbajtur në të gjitha rastet e vendosura prej saj, që kanë pasur të bëjnë

me vendimet e KPMK-së, që nga viti 2012 e këndej. Gjykata në vazhdimësi ka vënë në pah se një vendim i KPMK-së prodhon efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet *KIO4/12 Esat Kelmendi*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012 dhe nr. *KI74/12, Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 prillit 2015 dhe referencat e cituara aty).

104. Gjykata sjell në vëmendje se ndër rastet e para ku ishte konstatuar se vendimet e KPMK-së janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për përmbarim është Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. *KIO4/12*, i 24 korrikut 2012. Në aktgjykimin në fjalë, Gjykata kishte trajtuar efektin e vendimit të KPMK-së të datës 18 mars 2011 – që do të thotë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për KPMK-në Nr.03/L-192, i cili më vonë, më datë 10 gusht 2018, u zëvendësua dhe u shfuqizua nga Ligji për KPMK-në 06/L-048. Që të dyja ligjet në fjalë, janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
105. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore, përveç kompetencës lëndore të KPMK-së për të zgjidhur mosmarrëveshjet e punës për nëpunësit civilë, paraqesin detyrim ligjor për institucionet gjegjëse për të respektuar dhe zbatuar vendimet e KPMK-së.
106. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore edhe lidhur me mospërmbarimin nga ana e gjykatave të vendimeve administrative – duke përfshirë edhe vendimet e KPMK-së – të cilat nuk kanë parashikuar në mënyrë ekskluzive një detyrim në të holla (Shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: *KI94/13*, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014; *KI112/12*, parashtrues *Adem Meta*, Aktgjykim i 2 gushtit 2018 dhe *KIO4/12*, parashtrues *Esat Kelmendi*, cituar më lart, Aktgjykim i 24 korrikut 2012). Në këto raste, Gjykata erdhi në përfundim se një vendim i nxjerrë nga një organ administrativ, i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët dhe, rrjedhimisht një vendim i tillë është një vendim administrativ i formës së prerë dhe i përmbarueshëm”.
107. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Vendimi i KPMK-së është i 25 shkurtit 2008. Por, Gjykata po ashtu vëren se ai vendim kishte mbetur objekt i procedurave gjyqësore, që nga viti 2008 deri në vitin 2018.
108. Për më tepër, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ka dispozicion, Gjykata thekson posaçërisht faktin se Vendimi i KPMK-së ishte vërtetuar në procedurë përmbarimore nga Gjykata e Apelit, si

shkallë e fundit, me aktvendimet Ac.nr.1459/15 dhe Ac. nr. 516/16, të 26 tetorit 2015, përkatësisht 4 dhjetorit 2017. Këto aktvendime të Gjykatës së Apelit kishin vërtetuar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, me të njëjtin numër, E.nr.1100/12, të 31 tetorit 2014, përkatësisht 27 shkurtit 2015, të cilat kishin lejuar përmbarimin e Vendimit të KPMK-së, të 25 shkurtit 2008.

109. Gjykata konsideron se trajtimi për më se dhjetë vite në procedura gjyqësore, i Vendimit të KPMK-së, të 25 shkurtit dhe, sidomos, vërtetimi i karakterit detyrues të tij nga gjykatat e rregullta, kanë bërë që vendimi në fjalë të mos ketë karakter të atëçastshëm por të vazhdueshëm.
110. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se vendimi i KPMK-së në rastin konkret ka qenë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

(ii) Nëse ka shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në ndërlidhje me të drejtën për mjete juridike efektive dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave

111. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
112. Në dritën e fakteve dhe pretendimeve të kërkesës, Gjykata konsideron se aspektet thelbësore të saj kanë të bëjnë me të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në ndërlidhje me të drejtën për mjete juridike efektive dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

113. Së pari, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], që përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

114. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe paragrafit 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, që parasheh:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

115. Gjykata po ashtu i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

116. Gjykata rithekson se, duke qenë zotëruese e karakterizimit të fakteve të rastit, nuk e konsideron vetveten të lidhur nga karakterizimi i dhënë nga parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juria novit curia*, Gjykata me vullnetin e vet mund të shqyrtojë ankesat duke u mbështetur në dispozita ose paragrafë në të cilat nuk janë thirrur shprehimisht palët. Në ndërlidhje me këtë, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, një ankesë karakterizohet nga faktet që përmban ajo dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet e referuara shprehimisht në të nga palët (Shih, *mutatis mutandis*, *Talpis kundër Italisë*, ankesë nr. 41237/14, GJEDNJ, Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e përmendura aty).

117. Në këtë sfond, Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje se (siç ka kishte konstatuar edhe në Aktvendimin KI 216/13), Vendimi i KPMK-së nuk ka përcaktuar se Komuna e Gjakovës duhet ta kthej parashtruesin e kërkesës në vendin e punës. Mirëpo, KPMK-ja ka urdhëruar Komunën e Gjakovës që procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës ta zhvillojë në pajtim me ligjin për shërbyesit civilë.

118. Prandaj, Gjykata dëshiron të vë theksin në faktin se përmbarimi i Vendimit të KPMK-së nuk ka pasur të bëjë me kthimin e parashtruesit në vendin e punës (nga ku është pezulluar), por me përfundimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

119. Më tutje, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ajo posedon, Gjykata vëren se përkundër përpjekjeve të pareshtura të parashtruesit të kërkesës që vendimi i KPMK-së të përmbahet, ai vendim nuk është zbatuar asnjëherë dhe as nuk është shfuqizuar. Pra, kanë kaluar më tepër se 10 (dhjetë) vite nga nxjerrja e Vendimit të KPMK-së (25 shkurt 2008) deri në vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit (Aktvendim Ac. nr. 227/18, i 18 shtatorit 2018).
120. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata vë në pah pretendimin kryesor të parashtruesit, përkitazi me cenimin e të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet aktgjykimit të saj në rastin nr. KI94/13, ku kishte theksuar se “përmbarimi i vendimit të prerë dhe të përmbarueshëm duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (Shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI94/13, parashtrues, *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014).
121. Gjykata vëren se një qëndrim i tillë mbështetet dhe në praktikën e GJEDNJ-së, e cila thekson se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ ka vënë në pah se përmbarimi i vendimit të formës së prerë është i një rëndësie edhe më të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të posaçme për të drejtat civile të palës në kontest (*Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafët 40-41). Në rastin në fjalë, GJEDNJ konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i përmbarimit të vendimit të formës së prerë, që ishte marrë në dobi të tyre.
122. Prandaj, Gjykata thekson se zbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm, është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
123. Në lidhje më këtë, Gjykata vëren se GJEDNJ-ja në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore ka konstatuar se duke u shmangur për më shumë se 5 (pesë) vite për ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatim të një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, autoritetet shtetërore kishin zhveshur dispozitat e nenit 6 nga tërë efekti i tyre i dobishëm (Shih *Hornsby kundër Greqisë*, paragrafi 45).

124. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se mosmarrëveshja e parashtruesit me Komunën e Gjakovës nuk ka qenë posaçërisht e ndërlikuar, sepse KPMK-ja kishte urdhëruar mbajtjen e procedurës disiplinore ndaj parashtruesit, në pajtim me ligjin në fuqi. Vendimi i KPMK-së ka mbetur i pazbatuar nga Komuna e Gjakovës edhe sot e kësaj dite.
125. Gjykata merr në konsideratë përgjigjen e Komunës së Gjakovës se, duke qenë se parashtruesit të kërkesës i kishte skaduar kohëzgjatja e kontratës së punës, ndaj tij nuk ka mundur ta zhvillohej procedura disiplinore. Sidoqoftë, Gjykata vë theksin në konstatimin e dhënë në Vendimin e KMPK-së, se suspendimi i parashtruesit nga vendi i punës, nga ana e Komunës së Gjakovës, ishte bërë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi. Prandaj, efekti i Aktvendimit jo-ligjor të Komunës së Gjakovës (i vitit 2003), për “suspendimin e përkohshëm” të parashtruesit të kërkesës nga vendi i tij i punës, do duhej të sanohej duke u zbatuar Vendimi i KPMK-së. Aq më tepër kur përmbarueshmëria e Vendimit të KPMK-së është konfirmuar me disa aktvendime të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe të Gjykatës së Apelit.
126. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që janë në shpërprthje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KIO4/12).

Përkitazi me pretendimet për cenim të së drejtës për mjete juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

127. Gjykata merr në konsideratë pretendimet e parashtruesit të kërkesës që kanë të bëjnë me të drejtën për mjete juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.
128. Së këndejmi, Gjykata i referohet nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

Neni 13 i KEDNJ-së [E drejta për zgjidhje efektive]

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

129. Gjykata fillimisht nënvizon se secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj (Shih, *mutatis mutandis*, *Voytenko kundër Ukrainës*, nr. 18966/02, Aktgjykimi i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).
130. Duke pasur parasysh konstatimet e saj lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, Gjykata konsideron se ankesat përkitazi me ato nene janë të "argumentueshme" për qëllime të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 prill 1998, paragrafi 52).
131. Gjykata rithekson se nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, përcaktojnë se sistemi juridik duhet të vë në dispozicion një mjet efektiv juridik që autorizon organin kompetent të adresojë thelbin e një pretendimi për shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih GJEDNJ, *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 81 dhe referencat e përmendura aty).
132. GJEDNJ në disa rast ka potencuar se efekti i nenit 13 është detyrimi për shtetet që të ofrojnë mjete juridike efektive, që mundësojnë shqyrtimin e thelbit të një kërkesë të argumentueshme sipas Konventës dhe për të mundësuar korrigjimin e dëhur (shih vendimet

e GJEDJ: *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykimi i 26 tetorit 2000; *Kaya v. Turqisë*, Aktgjykimi i 19 shkurt 1999). Më tutje, GJEDNJ ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë “efektiv” në ligj dhe në praktikë (shih, për shembull, *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 27 qershor 2000). GJEDNJ, poashtu, ka theksuar se “efektiviteti i mjetit juridik”, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, nuk është i kushtëzuar me garancinë për një zgjidhjeje të favorshme për parashtruesin e kërkesës (*Kudla kundër Polonisë*).

133. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, duke kërkuar përmbarimin e Vendimit të KPMK-së, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar disa herë gjykatave të rregullta si dhe Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata rithekson se, në procedurën përmbarimore, gjykatat e rregullta (të shkallës së parë dhe të dytë), kanë nxjerrë disa vendime në dobi të parashtruesit –që lejuan përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së – dhe disa vendime të kundërta.
134. Pra, parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së tij, ai Aktvendim nuk është përmbaruar, as nga organet kompetente të Komunës së Gjakovës dhe as nga gjykatat kompetente. Faktikisht, mjetet juridike të përdorura nga parashtruesi i kërkesës, sikundër edhe vendimet gjyqësore në dobi të tij, nuk kanë pasur ndonjë efekt praktik në situatën e tij.
135. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila në rastin *Klass kundër Gjermanisë* ka theksuar se “kur një person konsideron se është paragjykuar përmes një akti për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të këtë në dispozicion një mjet juridik para autoriteteve shtetërore, që do i mundësojë zgjidhjen e kërkesës së tij dhe, nëse duhet, ofrimin e kompensimit. Kështu, neni 13 duhet të interpretohet në atë mënyrë që të garantojë një mjet juridik efektiv para autoritetit shtetëror për secilin që pretendon se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Konventë janë shkelur” (Shih *Klass kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64).
136. Mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive, për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-s (pavarësisht se cili do të ishte epilogu për parashtruesin nga përmbarimi i atij Aktvendimi), cenon të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me të drejtën për zgjidhje efektive, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.

137. Ky qëndrim është në përputhje me praktikën e Gjykatës, e cila në rastin KI 94/13 ka theksuar se *“mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive, për përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë (Komunale), ndikon në të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së. Në bazë të këtyre dispozitave, secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrë në përcaktuar me ligj”* (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese: KI94/13, parashtres Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj, Aktgjykim i 16 prillit 2014, paragrafi 90; shih *mutatis mutandis*, *Voytenko kundër Ukrainës*, Nr. 18966/02, Aktgjykimi i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).

138. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme që gjykatat e rregullta dhe Komuna e Gjakovës, në kuadër të kompetencave që kanë, t'i gjejnë mekanizmat efikas për të përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet që përcaktohen me ligj dhe Kushtetutë.

139. Barra e përmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm të KPMK-së bie mbi gjykatat e rregullta dhe Komunën e Gjakovës. Mungesa e mekanizmave zbatues të këtij autoriteti publik, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë arsye për mohimin e të drejtës së parashtresit të kërkesës që vendimi i formës së prerë dhe i detyrueshëm të ekzekutohet në dobi të tij.

140. Së këndejmi, Gjykata konsideron se është e patolerueshme që parashtresë i kërkesës – pavarësisht nga përpjekjet e tij për më shumë se dhjetë vite – nuk i ka gëzuar të drejtat që i janë njohur atij me vendimin KPMK-së.

141. Gjykata po ashtu potencon se është e papranueshme që kërkesa e parashtresit nuk është trajtuar me seriozitetin dhe efikasitetin e duhur për më shumë se dhjetë vite, nga gjykatat e rregullta dhe Komuna e Gjakovës. Për më tepër, vendimet e gjykatave të rregullta rreth përmbarimit të Vendimit të KPMK-së janë kundërtshënës dhe kanë vënë barrë joproporcionale mbi parashtresin e kërkesës, duke kërkuar, për shembull, që ai ta përdorë një mjet juridik në vend të tjetrit. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah arsyetimin e Gjykatës së Apelit (Aktvendimi CA. nr. 380/2017 i 28 gushtit 2017), që, mes tjerash, kishte përcaktuar: *“Meqenëse organi punëdhënës Komuna e Gjakovës, nuk ka vepruar sipas vendimit të KPMK-së, për nxjerrjen e vendimit përkatës në procedurë administrative, kreditori ka pasur*

mundësi që në kushtet e parapara me paragrafin 3 të nenit 29 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, nr. 03/L-202, t'i drejtohet me kërkesë të veçantë KPMK-së, përkatësisht në kushtet e parapara me këtë dispozite ligjore të filloj konfliktin administrativ”.

142. Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila qartazi lë të kuptohet se nëse një ose më shumë mjete juridike potencialisht efektive janë në dispozicion, parashtruesi është i obliguar që ta përdorë vetëm njërin prej tyre (*Aquilina kundër Maltës*, [DHM], paragrafi 39). Në të vërtetë, kur një mjet juridik është përdorë, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër juridik që në thelb ka të njëjtin qëllim (*Micallef kundër Maltës* [DHM], paragrafi 58). Është e drejtë e parashtruesit që ta zgjedh mjetin që është më i përshtatshëm në rastin e tij (*O’Keeffe kundër Irlandës* [DHM], paragrafët 110-11). Pra, nëse e drejta vendore ofron paralelisht disa mjete juridike në sfera të ndryshme të së drejtës, një parashtrues që ka kërkuar korrigjim për një shkelje të pretenduar të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, përmes njërit nga ato mjete, nuk duhet që domosdo t’i përdorë mjetet tjera që në thelb kanë të njëjtin qëllim (*Jasinskis kundër Letonisë*, paragrafët 50 dhe 53-54).
143. Gjykata po ashtu e konsideron të nevojshme të potencojë se parashtruesit të kërkesës nuk mund t’i ngarkohet fajti për zvarritjen e procedurave dhe mospërmbarim të vendimit të KPMK-së, sepse ai vetëm kishte shfrytëzuar mjetet juridike dhe kishte ndjekur rrugët gjyqësore, në pajtim me ligjin në fuqi (shih, *mutatis mutandis*, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, paragrafi 68).
144. Prandaj, Gjykata arrin në përfundim se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së, paraqet gjithashtu shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.
145. Në fund, Gjykata konsideron se nuk duhet të merret më tej me pretendimet për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla janë konsumuar nga konstatimet e Gjykatës për shkelje të neneve 31 dhe 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 13 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rasti nr. KI65/15, parashtrues, *Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković, Zlatoj Jevtić*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 14 shtatorit 2016). Për më tepër, Gjykata përsëritë konstatimin e saj se Aktvendimi i KPMK-së nuk i njeh parashtruesit të drejtën për kthim në vendin e punës, por detyron Komunën e Gjakovës (si autoritet publik), që të zbatojë procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës.

Përfundim

146. Gjykata Kushtetuese vë në pah detyrimin e saj kushtetues që të sigurojë që procedurat që zhvillohen para autoriteteve publike, sidomos para gjykatave, duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
147. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se mospërbarimi i Aktvendimit të KPMK-së nga Komuna e Gjakovës, sidomos pas disa vendimeve të gjykatave të rregullta që lejuan përmbarimin e tij, kanë shkaktuar shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
148. Gjykata rithekson që Vendimi i KPMK-së nuk ka përcaktuar se debitori, gjegjësisht Komuna e Gjakovës, duhej ta kthente parashtruesin e kërkesës në vendin e punës. KPMK-ja ka urdhëruar Komunën e Gjakovës që procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës ta zhvillonte në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për shërbyesit civilë. Prandaj, Gjykata nuk ka trajtuar çështjen nëse parashtruesi i kërkesës duhet të kthehet, ose jo, në vendin e punës.
149. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se, mbështetur në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, sa herë që konstatohet shkelje e të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 i KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, për aq sa është e mundur, duhet të vihet në pozitë që të gëzojë të drejtat që ai do t'i kishte pasur nëse procedurat do ishin zhvilluar në pajtim me garancitë e KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 2002, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty).
150. Megjithatë, Gjykata konsideron se rasti në shqyrtim është i veçantë sepse, ndonëse moszbatimi i Vendimit të KPMK-së përbën shkelje të garancive procedurale të parapara me Kushtetutë dhe KEDNJ-së, zbatimin i tij mund të jetë i pamundur për arsye objektive. Pra, mund të jetë objektivisht e pamundur që të zhvillohet procedura disiplinore, siç është kërkuar me Vendimin e KPMK-së të vitit 2008, sidomos për shkak se parashtruesi i kërkesës ka pasur marrëdhënie të punës me kohëzgjatje të caktuar.
151. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit nën shqyrtim, Gjykata është e detyruar të mjaftohet me konstatimin e shkeljes së neneve 31 dhe 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 13 të KEDNJ-së, duke udhëzuar parashtruesin e kërkesës në procedurë civile, pranë gjykatave të

rregullta, për kompensim eventual të dëmit (shih praktikën e gjykatave të rregullta në rastin e *Gëzim Kastratit dhe Makfire Kastratit*, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C. nr. 1209/13, i datës 03.07.2019).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 59 (1) dhe 66 të Rregullores së punës, më 22 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së, A 02 158/2005, i 25 shkurtit 2008, ka shkaktuar shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së;
- III. TË UDHËZOJË parashtruesin e kërkesës në procedurë civile për kompensim eventual të dëmit;
- IV. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- V. TË SHPALLË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI123/19, Parashtrues "Suva Rechtsabteilung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019, Aktgjykim i miratuar më 13 maj 2020 dhe i publikuar më 18 qershor 2020

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, person juridik, shkelje e të drejtave kushtetuese, neni 31 - e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor, parimi i sigurisë juridike, divergjenca në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta

Si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga i siguruari i Byrosë Kosovare të Sigurimeve në vitin 2012, i siguruari i parashtruesit të kërkesës M.B. kishte pësuar lëndime. Në vitin 2013, i siguruari i parashtruesit të kërkesës kishte marrë trajtim mjekësor dhe kompensim për shkak të paaftësisë në punë për një periudhë të pacaktuar në Konfederatën e Zvicrës, të cilat ishin paguar nga parashtruesi i kërkesës. Më 13 janar 2015, parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në të drejtën e tij për subrogim, në Gjykatën Themelore në Prishtinë paraqiti padi për kompensim në shumë prej 8,918.61 euro. Më 25 janar 2015, BKS dhe i siguruari i parashtruesit të kërkesës kishin arritur marrëveshje jashtëgjyqësore [e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Pejë, C. Nr. 185/13, më 25 janar 2015], ku ky i fundit u kompensua nga BKS në shumën prej 1,000 eurove. Më 14 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [II.EK. nr. 8/15] refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore konstatoi se pas lidhjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore, i siguruari i parashtruesit të kërkesës e ka konsumuar të drejtën e tij, për të kërkuar kompensimin e dëmit. Më 26 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, [Aktgjykimi Ae. Nr. 146/17] refuzoi si të pa themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi [Ae. nr.146/17] i 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor, dhe në cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse sipas tij, Gjykata Supreme në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi kishte vepruar edhe në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore në të paktën gjashtë (6) raste të cilat ai i kishte dorëzuar në Gjykatë në mbështetje të argumenteve të tij.

Në shqyrtimin e meritave të rastit, Gjykata elaboroi (i) praktikën gjyqësore lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, si dhe kriteret përkatëse bazuar në të cilat, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vlerëson nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjenca në praktikën gjyqësore përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar

përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshirë nëse: (a) divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (b) ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla dhe (c) ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti.

I. Gjykata, duke i aplikuar parimet dhe kriteret e lartpërmendura, sa i përket pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, konstatoi se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Ae. nr.146/17] të 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit, Gjykata e Apelit ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe rrjedhimisht është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

II. Sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës përkitazi me parimin e sigurisë juridike si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, Gjykata pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të vendosur nga Gjykata dhe GJEDNJ në këtë aspekt, dhe zbatoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, konstatoi se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI123/19

Parashtrues

“SUVA Rechtsabteilung”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit
të Kosovës, Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimeve “*Suva Rechtsabteilung*” me seli në Lucern të Zvicrës, e përfaqësuar nga ICS Assistance LLC, përmes Visar Morinës dhe Besnik Z. Nikqit, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit). Vendimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 23 prill 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit pretendohet se

parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtare).
7. Më 9 shtator 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
8. Më 6 dhjetor 2019, Gjykata njoftoi Byronë Kosovare të Sigurimeve për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 7 shkurt 2020, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Pejë dorëzimin e kopjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore, të 25 janarit 2015.
10. Më 18 shkurt 2020, Gjykata Themelore në Pejë dorëzoi kopjen e kërkuar të marrëveshjes jashtëgjyqësore.
11. Më 13 maj 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën KI123/19 të pranueshme për shqyrtim dhe të vlerësojë meritat e saj.

12. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë votash konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr.146/17, i 26 shkurtit 2019, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 19 janar 2012, M.B., i siguruari i parashtruesit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: i siguruari i parashtruesit të kërkesës), kishte pësuar lëndime në një aksident trafiku të shkaktuar nga B.A. Për faktin se B.A. nuk kishte sigurim për dëmin e shkaktuar të palëve të treta sipas Ligjit për Sigurinë në Komunikacion, ky i fundit përfaqësohej nga Byroja Kosovare e Sigurimeve (në tekstin e mëtejme: BKS).
14. Në vitin 2013, i siguruari i parashtruesit të kërkesës kishte marrë trajtim mjekësor dhe kompensim për shkak të paaftësisë në punë për një periudhë të pacaktuar në Konfederatën e Zvicrës, të cilat ishin paguar nga parashtruesi i kërkesës.
15. Më 13 janar 2015, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) paraqiti padi për kompensim në shumë prej 8,918.61 euro, në kamatëvonesë prej 12%, duke filluar nga 24 dhjetori 2012 deri në pagesën definitive. BKS kishte paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës kishte theksuar se me të siguarin e parashtruesit të kërkesës kishte lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore, për të gjitha format e dëmit, në të cilin rast edhe kishte realizuar pagesën ndaj të siguararit të parashtruesit të kërkesës.
16. Më 25 janar 2015, BKS dhe i siguruari i parashtruesit të kërkesës arritën marrëveshje jashtëgjyqësore [e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Pejë, C. Nr. 185/13, më 25 janar 2015], ku ky i fundit u kompensua nga BKS në shumën prej 1,000 eurove.
17. Në bazë të pajtimit gjyqësor ishte:

“DETYRUAR e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë [...] që paditësit [i siguruari M.B.], [...] për të gjitha kategoritë e dëmit qoftë material qoftë jo material lidhur me aksidentin e ndodhur me dt. 19.01.2012 [...] t’ia paguaj shumën prej 1000 euro [...].”

[...]

“Megenëse gjykata konsideron se kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët ndërgjyqjësë mund të disponojnë lirisht dhe se kërkesa e tyre nuk është në kundërshtim me dispozita e nenit 3, par. 3 të LPK-së, gjykata pas kësaj në mbështetje të dispozitës së nenit 412 dhe 414 të LPK-së, bie:

AKTVENDIM

MIRATOHET pajtimi gjyqësor i arritur në seancën e sotme në mes të të autorizuarve të ndërgjyqjësve dhe i njëjti paraqet titull të vlefshëm përmbarimor.”

[...]

18. Më 14 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [II.EK. nr. 8/15] refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
19. Gjykata Themelore konstatoi se me marrëveshjen jashtëgjyqësore, të lidhur me 25 janar 2015 në Gjykatën Themelore në Pejë “[...] pajtim gjyqësor është lidhur në mes [të siguruarit të parashtruesit të kërkesës], dhe të paditurës [BKS]. Andaj, meqë kjo marrëveshje është lidhur për të gjitha kategoritë e dëmit material dhe jo material shumë kuartë nënkuptohet se është për të gjitha kërkesat e mundshme që rrjedhin nga kompensimi i dëmit për çka është lidhur kjo kontratë, po ashtu edhe e paditura [BKS] në kuptim të nenit 940 të LMD-së, ka qenë në detyrim që të siguruarit të [parashtruesit të kërkesës] dëmin e kërkuar t’ja kompensojë dhe është jo kontestuese se pas lidhjes së marrëveshjes së lartë përmendur [BKS] dëmin e kërkuar ia ka paguar, si dhe i siguruari i paditësit në kuptim të nenit 941 të LMD-së, në bazë të fajësisë së të siguruarit të paditurës direkt nga e paditura ka pasur të drejtë të kërkojë kompenzimin e dëmit. “
20. Gjykata Themelore në fund, konstatoi se pas lidhjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore, i siguruari i parashtruesit të kërkesës e ka konsumuar të drejtën e tij, për të kërkuar kompensimin e dëmit, ndërsa përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me bartjen e të drejtës sipas kësaj Gjykate janë të pabazuara. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore konstatoi se askush nuk mund të bartë te tjetri një të drejtë të cilën e ka realizuar më parë, dhe rrjedhimisht kjo e drejtë është shuar.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe

zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim. BKS parashtroi përgjigje në ankesë dhe propozoi që ankesa e parashtruesit të kërkesës të shpallet e pabazuar.

22. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij, në lidhje me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave kontestimore, kishte theksuar se *“aktgjykimi i goditur është i paqartë respektivisht se ekzistojnë kontradikta të theksuara në arsyetimin e aktgjyqimit përkitazi me përmbajtjen e provave mbi të cilat mbështetet vendimi e posaçërisht referuar fakteve vendimtare që kanë të bëjnë me legjitimitetin aktiv të paditësit dhe të siguruarit të tij me rastin e zgjidhjes së kërkesës e drejtpërdrejtë e cila i ka paraprirë procedimit të subrogimit. Kjo e bën vendimin e këtij aktgjykimi, në raport me arsyetimin konfuz, të pakuptueshëm dhe kontradiktor me provat e administruara.”*
23. Së dyti, në lidhje me pretendimin për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, parashtruesi në ankesën e tij kishte specifikuar si në vijim:

“Pasi që lidhur me këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë nuk ka arsyetim apo referim konkret në prova të cilat faktojnë një gjë të tillë, për paditësin mbetet e panjohur përgjigja në pyetjet; Cilat ishin kërkesat e të siguruarit të paditësit [M.B.] në kontestin civil C. Nr. 185/13 i cili ka përfunduar me pajtim gjyqësor dt. 25.02.2015?

Nëse eventalisht në kontestin civil C. Nr. 185/13 ishin objekt kërkesëpadie shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimi i paaftësisë për punë, në çfarë ato konsistojnë dhe me çfarë ishin provuar?

Pasi që kërkesat për rimbursim mbi bazën e subrogimit të [parashtruesit të kërkesës] në kontestin aktual i ishin parashtruar të paditurës që me dt. 24.12.2012, respektivisht të precizuara definitivisht me dt. 12.02.2013, si është e mundur që këto kërkesa të jenë objekt i pajtimit gjyqësor të datës 25.02.2015? Si është e mundur që për shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimin për paaftësinë e përkohshme për punë [...] paguara nga [parashtruesi i kërkesës] në vitin 2012/2013 të kishte ende legjitimitet aktiv i siguruari i saj [M.B.] për nënshkrimin e pajtimit gjyqësor me datë 25.02.2015?”

24. Duke u bazuar në atë si më lartë, parashtruesi i kërkesës theksoi se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, i cili rezulton në mohimin e të drejtës në subrogim të parashtruesit të kërkesës. Si rrjedhojë, parashtruesi i

kërkesës i drejtohet Gjykatës së Apelit me kërkesën për kthimin e rastit në rigjykim, ku Gjykata Themelore, në mënyrë që të vërtetojë çështjen e legjitimitetit aktiv të parashtruesit të kërkesës, duhet të bëjë rishqyrtimin e gjendjes faktike në lidhje me kompensimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor dhe pagesës për periudhën e paaftësisë në punë të të siguruarit të parashtruesit të kërkesës. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon të sqarohet se për çfarë është kompensuar i dëmtuari M.B. nga BKS, dhe nëse kjo e fundit ka qenë e njoftuar lidhur me shpenzimet mjekësore dhe të paaftësisë së punës, të paguara nga parashtruesi i kërkesës.

25. Së treti, në lidhje me pretendimin për zbatim të gabuar të drejtës materiale, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj i është referuar vetëm neneve 940 dhe 941 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), të cilat dispozita sipas parashtruesit të kërkesës përkufizojnë detyrimin e siguresit të përgjegjësisë dhe instalojnë të drejtën në "*actio directa*" të palës së dëmtuar, mirëpo kjo Gjykatë nuk është bazuar në dispozitat përkatëse që i referohen të drejtës në subrogim, respektivisht neneve 301 dhe 939 të LMD-së.
26. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se: "[...] një raport me karakter juridik detyrimor mes dy palëve mund të ketë efekt juridik jo vetëm "*Inter partes*" por edhe ndaj palëve të treta çështje kjo, që në një rast të ngjashëm, ku incidentalisht kishte mbërritur te trajtohej edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës."
27. Më 26 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ae. Nr. 146/17, refuzoi si të pa themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
28. Gjykatat e Apelit fillimisht konstatoi se aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave kontestimore dhe se Gjykata Themelore drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.
29. Gjykata e Apelit theksoi se Gjykata Themelore ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, duke konstatuar se mes tij dhe BKS ishte lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të dëmit që derivojnë nga aksidenti i komunikacionit. Gjykata e Apelit, duke u bazuar në këtë konstatim gjeti se i siguruari i parashtruesit të kërkesës ka realizuar të drejtën e tij për kompensim sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht nuk ka pasur të drejtë ligjore të kërkojë kompensim edhe nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata e Apelit, për më tepër, duke u bazuar në shkresat e

lëndës konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i njoftuar nga i siguruari i saj se këtë të drejtë ligjore për kompensim e ka realizuar në Republikën e Kosovës dhe atë përmes procedurave gjyqësore.

30. Në fund, Gjykata e Apelit duke iu referuar nenit 391, pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), konstatoi se pajtimi gjyqësor i ka karakteristikat e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar dhe si i tillë prodhon të njëjta efekte juridike sikurse aktgjykimi, dhe rrjedhimisht lidhur me çështjen juridike, për të cilët palët kanë arritur marrëveshje gjyqësore, nuk mund të zhvillohet kontest. Gjykata e Apelit, më tej, duke iu referuar nenit 418 të LPK-së, i cili përcakton që *“Pajtimi gjyqësor mund të goditet vetëm me anë të padisë” dhe “[...] se pajtimi gjyqësor anulohet, në qoftë se është përfunduar nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit apo dhunës”*, konstatoi se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim të dëmit sipas nenit 941 të LMD-së, pasi që i siguruari i parashtruesit të kërkesës e ka realizuar të drejtën e tij ligjore pranë gjykatave të Republikës së Kosovës. Gjykata e Apelit përfundoi se nëse Gjykata Themelore do ta aprovonte kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës do të cenohej *“siguri[a] juridike [n]ë Republikë[n] [e]Kosovës, duke i zhveshur nga efekti juridik vendimet gjyqësore të vendit.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike pretendon shkelje: (i) të së drejtës së tij në vendim të arsyetuar gjyqësor; dhe të (ii) parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

32. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të të drejtës së tij në vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar [Ae.Nr.146/2017] i Gjykatës së Apelit të Kosovës karakterizohet nga mungesa e arsytimit adekuat për arsye se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë fare arsyetim përkitazi me mohimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës në subrogim.
33. Sipas parashtruesit të kërkesës, mungesa e dhënies së arsytimit adekuat nga ana e Gjykatës së Apelit përben shkelje serioze të nenit 31

të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, respektivisht rastit KI55/09 [parashtrues i kërkesës, *N.T.SH. Meteorit*, Aktgjykim i 6 prillit 2011].

34. Parashtruesi i kërkesës, thekson se Gjykata e Apelit nuk ka analizuar pretendimet e tij në të gjitha çështjet e ngritura në ankesën e tij, në veçanti në çështjet lidhur me refuzimin e njohjes së të drejtës në subrogim. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *“Në vend që të analizoj në mënyrë të duhur dhe me analitike rrethanat e çështjes, të drejtën e aplikuar në Kosovë në rastin konkret si dhe praktikën relevante gjyqësore të vet Gjykatës së Apelit dhe njëkohësisht të Gjykatës Supreme në çështje të ngjashme, Gjykata e Apelit, në mënyrë arbitrarë i mohon të drejtën në zhdëmtim.”*
35. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit është marrë parasysh vetëm pajtimi gjyqësor në mes të siguruarit të tij dhe BKS *“[...] pa e analizuar fare se çfarë është objekt i kësaj Marrëveshje respektivisht cilit dëm të shkaktuar i referohet, nëse eventualisht shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimi për kohen e shërimit ishte objekt i kësaj Marrëveshje zhdëmtimi respektivisht a kishte i siguruari legjitimitet aktiv për të pretenduar një zhdëmtim të tillë apo ky legjitimitet i përket vetëm Parashtruesit të Kërkesës.”*
36. Për më tepër, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit nuk ofroi arsyetim se pse parashtruesi i kërkesës nuk mund të kërkojë kompensimin e dëmit të paguar për të siguruarin e tij konform dispozitave ligjore në fuqi, respektivisht neneve 300 dhe 939 të LMD-së.
37. Në lidhje me pretendimin për mos arsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës, në vijim i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), respektivisht rasteve *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007; *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykim, i 19 dhjetorit 1994; *Ruiz Torija kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18390/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykim, i 19 dhjetorit 1997; dhe *Gradinar kundër Moldavisë*, kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykim, i 8 prillit 2008.

38. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin konkret nuk është zbatuar praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me të drejtën për arsyetim të vendimit gjyqësor. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, respektivisht rastit KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, i cili rast kishte të bëjë me çështjen e së drejtës në subrogim, dhe ku Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërthënëse në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme

39. Parashtruesi i kërkesës po ashtu konsideron se me vendimin e kontestuar është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Kërkesa për qëndrueshmëri në praktiken gjyqësore është thelbësore dhe kontribuon në trajtimin e barabartë të individëve që sjellin të njëjtat ose, në aspekte të rëndësishme, kërkesa të ngjashme në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.”*
40. Parashtruesi i kërkesës, më tej specifikon se *“[...] dështimi i Gjykatës së Apelit për të shtjelluar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e Parashtruesit për kompensim dhe ndryshimi krejtësisht i kundërt me praktikën ekzistuese të kësaj Gjykate lidhur me subrogimin cenon drejtpërdrejtë parimin e sigurisë juridike në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane.”*
41. Parashtruesi i kërkesës po ashtu konsideron se: *“[...] nëse Gjykata e Apelit me vendimin e saj shmanget nga praktika e deritanishme e saj, duhet të ofrojë arsyetime të plota dhe të duhura juridike lidhur me këtë ndryshim të qëndrimit të saj juridik.”*
42. Parashtruesi në kërkesën e tij, në mbështetje të pretendimit të tij për cenim të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme i referohet një sërë vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, që sipas tij kanë të bëjnë me çështje të ngjashme si ajo e rastit në kërkesën e tanishme, respektivisht: Aktvendimi [Rev. Nr. 14/2015] i 14 majit 2015 i Gjykatës Supreme; Aktgjykimi [Ae. Nr. 84/2019] i 28 janarit 2019 i Gjykatës së Apelit; Aktgjykimi [Ae. Nr. 3/2017] i 28 dhjetorit 2018 i Gjykatës së Apelit; Aktgjykimi [Ae.Nr.

298/2016] i 26 shkurtit 2018 i Gjykatës së Apelit; Aktgjykimi [E. Rev. nr. 4/2018] i 17 majit 2018 i Gjykatës Supreme; dhe Aktgjykimi [E. Rev. nr. 27/2018] i 24 janarit 2018 i Gjykatës Supreme.

43. Në lidhje me këto vendime të lartcekura të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Nga krahassimi i këtyre aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit rezulton se kjo Gjykatë ka zbatuar në vazhdimësi dhe në mënyrë konsistente qëndrim të njëjtë juridik lidhur me përcaktimin e bazës juridike për të drejtën në subrogim.”* Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, vendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit *“[...] në mënyrë tërësisht të kundërt i shmanget praktikës së deritanishme gjyqësore, pa dhënë shpjegim se përse Gjykata largohet nga interpretimi i deritanishëm juridik lidhur me çështjen e njëjtë gjyqësore, duke mbështetur vendimin e saj në një Marrëveshje zhvenditimi me kualifikim të efektit juridik të saj jo vetëm "inter partes" por me efekt juridik edhe në raport me palët e treta - çfarë është në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës detyrimore.”*
44. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet edhe rastit KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, ku Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se: *“Gjykata Supreme si gjykatë e instancës së fundit për të vendosur në rastin konkret të parashtruesit, duke marrë një qëndrim të ndryshëm në Aktgjykimin e kontestuar në një rast i cili është plotësisht identik ose i ngjashëm me rastet e tjera, pa dhënë një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për këtë, ka shkelur të drejtën e parashtruesit për një vendim të arsytuar gjyqësor. Kjo çoi edhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike, si një nga komponentët themelor të sundimit të ligjit, i cili gjithashtu është një element i pandashëm i së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.”*
45. Parashtruesi i kërkesës përfundon se dështimi i Gjykatës së Apelit që të adresojë pretendimin e tij për t'i njohur të drejtën në subrogim pa dhënë arsyetim juridik dhe duke devijuar nga praktika e deritanishme e Gjykatës së Apelit në çështje të ngjashme përbën qartazi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovë, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
46. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë: (i) shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces te rregullt) të KEDNJ-së; (ii) të anulojë Aktgjykimin [Ae. Nr. 146/2017] e 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit; dhe (iii) rastin ta kthejë në rigjykim.

Dispozitat relevante ligjore**Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i 30 marsit 1978:****Subrogimi ligjor
Neni 300**

Kur detyrimin e përmbush një person që ka interes juridik në këtë, atëherë i kalohet këtij, në bazë të vetë të drejtës në momentin e përmbushjes kërkesa e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

**Subrogimi në rast të përmbushjes së pjesshme
Neni 301**

Në rast të përmbushjes së pjesshme të kërkesës së kreditorit, në përmbushësin kalojnë të drejtat aksesore me të cilat është siguruar përmbushja e kësaj kërkesë vetëm në qoftë se nuk nevojiten për përmbushjen e pjesës që ka mbetur të kërkesës së kreditorit. Mirëpo kreditori dhe përmbushësi mund të kontraktojnë se do të shfrytëzojnë garancitë në përpjesëtim me kërkesat e veta, ndërsa mund të kontraktojnë edhe se përmbushësi do të ketë të drejtë arkëtimi prioritar.

**KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ
PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN
(SUBROGIMI)****Neni 939**

Me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmin.

Në qoftë se për faj të të siguarit është bërë e pamundur ky kalim i të drejtave në sigurues, tërësisht ose pjesërisht, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguarit.

Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëmin e të siguarit, kështu që në qoftë se kompensimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e

kompensimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë bartë në të.

Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të sigurvearit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të sigurvearin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi, apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të sigurvearit, përveç në qoftë se këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje. Mirëpo, në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i sigurvear nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij kompensimin e shumës që i ka paguar të sigurvearit.

SIGURIMI NGA PËRGJEGJËSIA

Përgjegjësia e të sigurvearit Neni 940

Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, siguruesi përgjigjet për dëmin e lindur nga rasti i sigurvear, vetëm në qoftë se personi i tretë i dëmtuar kërkon kompensimin e tij. Siguruesi përballon, në kuadrin e shumës së sigurimit, shpenzimet e kontestit mbi përgjegjësinë e të sigurvearit.

E drejta vetiake e të dëmtuarit dhe padia direkte Neni 941

Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, personi i dëmtuar mund të kërkojë direkt nga siguruesi kompensimin e dëmit që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet siguruesi, por jo më tepër se deri në shumën e detyrimit të sigurvearit. Personi i dëmtuar ka që nga momenti kur ka ndodhur rasti i sigurvear, të drejtën vetiake në kompensimin nga sigurimi, kështu që çdo ndryshim i më vonshëm për të drejtat e të sigurvearit ndaj sigurvearit nuk ka ndikim në të drejtën e personit të dëmtuar në kompensim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

47. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

49. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
50. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

51. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtguesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtguesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
52. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit. Përkritazi me shterimin e mjeteve juridike, Gjykata vëren se vendimi i fundit, i nxjerrë në procedurë para gjykatave të rregullta është aktgjykim i kontestuar i Gjykatës së Apelit, kundër të cilit për shkak të vlerës së kontestit nuk ka qenë i lejuar revizioni. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
53. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtguesit të kërkesës gjithashtu i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
54. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj. (Shih gjithashtu, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, shih rastet e Gjykatës KI87/18, parashtgues *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 35, dhe KI35/18 parashtgues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 43).

Meritat e kërkesës

55. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike pretendon (i) shkelje të të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.
56. Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike pretendon se Gjykata e Apelit nuk ka analizuar pretendimet e tij në të gjitha çështjet e ngritura në ankesën e tij, në veçanti në çështjen përkitazi me refuzimin e njohjes të të drejtës në subrogim. Së dyti, parashtruesi i kërkesës po ashtu konsideron se me vendimin e kontestuar është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme.
57. Prandaj, Gjykata në vijim, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme do t'i elaborojë në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
58. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

59. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

I. Përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor

(i) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

60. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore, e cila është zhvilluar në pajtim me parimet themelore të vendosura në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim, i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim, i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykim, i 4 dhjetorit 2017; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019).
61. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës fillimisht theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet *“të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre”*. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi, i 16 dhjetorit 1992, shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/18, parashtrues *“IF Skadeforsikring”*, të cituar më lart, paragrafi 44).
62. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ thekson se neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së obligon gjykatat të ofrojnë arsye për vendimet e tyre, ky detyrim nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme për secilin pretendim. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26,

Jahne dhe Lenoble kundër Francës [DHM], Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 81, dhe shih rastin e Gjykatës KI97/16, *parashtrues IKK Classic*, paragrafi 47).

63. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih po rastin KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI 87/18 “*IF Skadeforsikring*”, të cituar më lart, paragrafi 48).
64. Rrjedhimisht, Gjykata rithekson se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 54).
65. Në fund, Gjykata duke ju referuar praktikës së saj gjyqësore rikujton se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, cituar më lart, paragrafi 61; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 58; KI 96/16 parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe KI87/18, parashtrues “*IF Skadeforsikring*” cituar më lartë, paragrafi 49).

(ii) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesës

66. Në rastin konkret, pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës është se Gjykata e Apelit ka marrë parasysh vetëm marrëveshjen jashtëgjyqësore për kompensim, të lidhur në mes të siguruarit të parashtruesit të kërkesës dhe BKS, duke dështuar të adresojë tërësisht çështjen e shpenzimeve mjekësore dhe kompensimit për paaftësi në punë të paguara nga parashtruesi i kërkesës për të siguruarin e saj M.B.
67. Për të konstatuar nëse arsyetimi i dhënë nga Gjykata e Apelit përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata

fillimisht rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit, ku theksohet si në vijim:

“Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ne raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa e [parashtruesit të kërkesës] është e pabazuar, për arsye se Gjykata shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme dhe bindëse, se e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, në procedure jashtë gjyqësore e ka shqyrtuar ankesën e të sigurvearit të paditëses dhe ka marr vendim SK-632/2012 e datës 13/11/2012, duke i paraqitur ofertë për kompensimin e dëmit në shumë prej 755.00 euro, me të cilën ofertë nuk është pajtuar i dëmtuari [M.B.] dhe i njëjti me datën 06/03/2013 ka paraqitur padi për kompensim demi në Gjykatën Themelore në Pejë, ndërsa me datën 25/02/2015, ka lidhur pajtim gjyqësor me të paditurën dhe atë në prezencën e avokatit të tij [I.I.], për të gjitha format e dëmit që derivojnë nga aksidenti i komunikacionit i datës 19/01/2012. Kjo është vërtetuar në bazë të procesverbalit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.185/ 13 e datës 25/02/2015, e të cilin pajtim gjyqësor e ka zbatuar e paditura në tërësi, duke përmbushur obligimin e saj financiar ndaj të sigurvearit të paditëses dhe në këtë mënyrë i sigurveari i paditëses e ka realizuar të drejtën e tij subjektive civile sipas legjislacionit vendor dhe nuk ka pasur të drejtë ligjore të kërkon kompensim edhe nga paditësja gjegjësisht nga shkresat e lëndës nuk rezulton se paditësja ka qenë e njoftuar nga i sigurveari i saj [M.B.], se të drejtën e tij ligjore për kompensim dëmit e ka realizuar në Republikën e Kosovës dhe atë përmes procedurave gjyqësore.”

68. Konkretisht, Gjykata e Apelit duke iu referuar dispozitave të LPK-së konstatoi se pajtimi gjyqësor i ka karakteristikat e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar dhe si i tillë prodhon të njëjta efekte juridike sikurse aktgjykimi, prandaj, si rrjedhojë lidhur edhe me çështjen juridike, për të cilët palët kanë arritur marrëveshje gjyqësore, nuk mund të zhvillohet kontest. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit nënvizoi se “[...] në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për rimbursim të dëmit sipas nenit 941 të LMD-së, pasi që i sigurveari i paditëses e ka realizuar të drejtën e tij ligjor pran organeve gjyqësore të Republikës së Kosovës dhe i njëjti nuk mundet që të bartet një kërkesë juridike inekzistente të paditësja, ndërsa në anën tjetër aprovimi eventual i kërkesëpadisë së [parashtruesit të kërkesës] drejtpërdrejt do të cenon sigurinë juridike të Republikës së Kosovës, duke i zhveshur nga efekti juridik vendimet gjyqësore të vendit.”

69. Duke u bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit nuk adresoi në mënyrë adekuate çështjen e kompensimit të parashtruesit të kërkesës, e cila çështje ishte kërkesë thelbësore e ngritur në kërkesëpadinë para Gjykatës Themelore. Në padinë e tij, të parashtruar në Gjykatën Themelore, si dhe në ankesën e tij të paraqitur në Gjykatën e Apelit, parashtruesi kërkesën e tij për kompensimin në bazë të drejtës për subrogim e kishte arsyetuar duke iu referuar dispozitave përkatëse të LMD, respektivisht nenet 300 dhe 939. Megjithatë, Gjykata e Apelit arsyetimin e saj për refuzimin e kërkesës së parashtruesit për kompensim në bazë të drejtës për subrogim e mbështet vetëm në marrëveshjen jashtëgjyqësore, pa ofruar arsyetim dhe interpretim përkatës edhe në lidhje me të drejtën e parashtruesit të kërkesës në subrogim, ashtu siç ishte specifikuar në kërkesëpadinë dhe ankesën e tij në Gjykatën e Apelit.
70. Gjykata po ashtu vëren se në qëndrimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit vërtetohet se marrëveshja jashtëgjyqësore anulon çështjen e kompensimit të parashtruesit të kërkesës, pa specifikuar: (i) se si kompensimi i paguar nga BKS ndaj të sigurvearit e liroi atë t'ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, marrë për bazë faktin që kjo marrëveshje jashtëgjyqësore ishte vërtetuar nga Gjykata Themelore në Pejë, pas kërkesës të sigurvearit të parashtruesi i kërkesës për kompensimin e trajtimit mjekësor dhe paaftësisë për punë, të realizuar në vitin 2013; si dhe (ii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të sigurvearit të parashtruesit të kërkesës dhe BKS ka afektuar të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje.
71. Gjykata rikujton se ajo kishte konstatuar shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, në një rast të ngjashëm, përkatësisht rastin KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, dhe përmes të cilit vlerësoi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: rasti KI134/15). Në këtë rast Gjykata Supreme kishte pranuar revizionin e të paditurës, Kompanisë së Sigurimeve SIGMA, i siguruari i të cilës në Republikën e Kosovës kishte shkaktuar aksidentin e trafikut në të cilin i siguruari i paditësit, përkatësisht Kompanisë së Sigurimeve në Republikën Federale të Gjermanisë (IKK Classic) kishte pësuar lëndime trupore. Përmes të njëjtit Aktgjykim, Gjykata Supreme kishte anuluar Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe ish-Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me arsyetimin se gjykata e shkallëve më të ulëta “gabimisht kanë pranuar si të bazuar kërkesëpadinë” e paditësit IKK Classic, të parashtruar në bazë të drejtës në subrogim për arsye se sipas Gjykatës Supreme i siguruari i tij përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore,

të 3 shkurtit 2009, të lidhur në mes tij dhe SIGMA-s kishte pranuar kompensimin në shumë prej 2.729 euro. Gjykata kishte konstatuar se “*dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota në lidhje me pyetjen kryesore përkitazi me të drejtën e parashtruesit të kërkesës [IKK Classic] për një kompensim, tu përcaktuar nga gjykatat e instancës më të ulët, paraqet shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për t’u dëgjuar dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.*”

72. Më 16 mars 2016, pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI135/14, Gjykata Supreme nxori aktgjykim të ri, respektivisht të dytë për rastin, Aktgjykimin E. Rev. nr. 15/2016 përmes të cilit përsëriti gjetjet e Aktgjykimit të parë [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014, duke vendosur se kërkesa për revizion e SIGMA është e bazuar. Pas këtij Aktgjykimi, *IKK Classic* sërish parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, në të cilin rast Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit KI97/16, të 14 dhjetorit 2017 (në tekstin e mëtejme: rasti KI97/16) konstatoi se Gjykata Supreme “[...] duke mos marrë parasysh dhe duke mos e arsyetuar të drejtën e pretenduar të parashtruesit të kërkesës për kompensim, për me tepër që nuk i ka adresuar konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14, me Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës u privua nga e drejta e tij për vendim të arsyetuar.”
73. Prandaj, në dritën e arsyetimit të lartcekur dhe bazuar në praktikën e saj gjyqësore në raste të ngjashme, Gjykata vlerëson se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk janë adresuar plotësisht dhe në mënyrë të qartë çështjet e kompensimit të shpenzimeve mjekësore të paguara nga parashtruesi i kërkesës, të cilat i kishte saktësuar në kërkesëpadinë e tij. (Shih *mutatis mutandis*, rastin KI135/14, paragrafi 52).
74. Për më tepër, kërkesa thelbësore e parashtruesit të kërkesës, që ishte parashtruar në bazë të të drejtës për subrogim nuk ishte arsyetuar as nga Gjykata Themelore.
75. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore kishte konstatuar se pas lidhjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore, i siguruari i parashtruesit të kërkesës e ka konsumuar të drejtën e tij, për të kërkuar kompensimin e dëmit, duke përfunduar se askush nuk mund të bartë te tjetri një të drejtë të

cilën e ka realizuar më parë, dhe rrjedhimisht kjo e drejtë sipas Gjykatës Themelore ishte shuar. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj vetëm kishte vërtetuar konstatimin e Gjykatës Themelore duke shtuar që në bazë të nenit 391, pika e) të LPK-së, pajtimi gjyqësor i ka karakteristikat e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përfundimtar dhe si i tillë prodhon të njëjta efekte juridike sikurse aktgjykimi, dhe si rrjedhojë lidhur edhe me çështjen juridike, për të cilët palët kanë arritur marrëveshje gjyqësore, nuk mund të zhvillohet kontest.

76. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, Ae. nr.146/17, i 26 shkurtit 2019, nuk i plotëson standardet e kërkuara për një vendim të arsyetuar, dhe rrjedhimisht shkel të drejtën e parashtresit të kërkesës, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
77. Pas konstatimit se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata në vijim do të shqyrtoj pretendimet e parashtresit të kërkesës përkitazi me cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

II. Për sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me parimin e sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërtënëse

- (i) *Parimet e përgjithshme siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës*
78. Përkitazi me parimin e sigurisë juridike si rezultat i mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore, GJEDNJ në praktikën e saj ka zhvilluar parime themelore dhe vendosur kriteret nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Kriteret e vendosura nga GJEDNJ, Gjykata gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtresve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërtënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore. (Shih, ndër të tjera, rastet e lartcekura të Gjykatës KI35/18 dhe KI87/18, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).
79. Lidhur me parimin e parë, GJEDNJ, ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata. (Shih, *mutatis mutandis*,

Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56).

80. Lidhur me parimin e dytë, GJEDNJ, megjithatë, ka specifikuar se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. (Shih rastin *Unédic kundër Francës*, kërkesa nr. 20153/04, paragrafi 74, 18 dhjetor 2008, shih rastin e cituar më lartë *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lartë të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 65, si dhe rastin KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33).
81. Lidhur me parimin e tretë, GJEDNJ, ka theksuar se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangje mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangje, në vetvete nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete. (Shih rastin *Santos Pinto kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 390005/04, paragrafi 41, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41, shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/17, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, të cituar më lartë, paragrafi 66 dhe rastin KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 67).
82. Megjithatë, GJEDNJ duke iu referuar parimeve të lartcekura ka vendosur tre kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjata” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lartë, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 67, KI35/18 parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 70).

(i) *Zbatimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret*

83. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.
84. Fillimisht, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet ti paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërtë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e cituar më lartë KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76).
85. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshe përkitazi me të drejtën në subrogim, duke vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Supreme. Në mbështetje të pretendimit të tij, ai iu referohet gjashtë (6) rasteve të tjera të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme si në vijim: Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 14/2015, i 14 majit 2015; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 84/2019, i 28 janarit 2019; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 3/2017, i 28 dhjetorit 2018; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 298/2016 i 26 shkurtit 2018; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 4/2018, i 17 majit 2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2018, i 24 janarit 2018.
86. Në lidhje me vendimet e lartcekura të Gjykatës së Apelit [Ae. Nr. 84/2019] i 28 janarit 2019 dhe [Ae. Nr. 3/2017] i 28 dhjetorit 2018] dhe asaj Supreme [E. Rev. nr. 27/2018] të 24 janarit 2018, Gjykata

vëren se këto vendime në mënyrë specifike i referohen çështjes së aplikimit të dispozitave që rregullojnë lartësinë e kamatëvonesës në kontekst të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Në vijim, Gjykata vëren se në këto tri vendime, gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kishin aplikuar edhe dispozitat e LMD-së, përkatësisht nenit 939, i cili i referohet të drejtës në subrogim. Megjithatë, Gjykata vlerëson se këto tri (3) vendime, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, të cilat në thelb shtjellojnë çështjen e përcaktimit të kamatëvonesës nuk përmbajnë ngjashmëri faktike dhe procedurale, si në rastin e parashtruesit të kërkesës.

87. Ndërsa tri vendimet në vijim, të cilat Gjykata do ti përmbledhë shkurtimisht, respektivisht Aktvendimet e Gjykatës Supreme [Rev. Nr. 14/2015] të 14 majit 2015 dhe [E. Rev. nr. 4/2018] të 17 majit 2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [Ae. Nr. 298/2016] i 26 shkurtit 2018 i referohen çështjes së vlerësimit të Gjykatës Supreme dhe asaj të Apelit përkitazi me efektet e marrëveshjeve jashtëgjyqësore për palët e treta, respektivisht kompanive të sigurimeve që të siguruarit e tyre i kanë kompensuar për dëmin e shkaktuar nga aksidentet dhe rrjedhimisht nuk kanë qenë as pjesë e këtyre marrëveshjeve jashtëgjyqësore.

a) *Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 14/2015, i 14 majit 2015*

88. Gjykata Supreme përmes këtij Aktvendimi pranoi revizionin e paditësit [Suva Wetzikon] dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim. I siguruari i paditëses, në cilësinë e viktimës kishte lidhur pajtim jashtëgjyqësor me Fondin e Garancisë, e cila përfaqësonte personin, i cili kishte shkaktuar aksidentin me automjet. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e një shume të caktuar, në emër të trajtimit mjekësor dhe pagesës për shkak të paaftësisë në punës si pasojë e aksidentit.
89. Gjykata Supreme, në Aktvendimin e saj kishte arsyetuar si në vijim: *“Marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të dëmtuarit në këtë aksident të komunikacionit në Fondin e Garancisë, a ka efekt në raport në mes të paditësit dhe të paditurit dhe a mund të konsiderohet se pagimi i shumës prej [...] nga fondi i Garancisë të dëmtuarit [M.G.], e paditura e ka kryer detyrimin ndaj paditësit. I dëmtuari a ka ditur për faktin se për dëmin e pësuar është paguar shpërblimi nga paditësja dhe se përkundër kësaj ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me Fondin e Garancisë. Prandaj, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë nëse marrëveshja jashtëgjyqësore lidhur mes Fondit të Garancisë dhe të dëmtuarit [M.G.] a ka efekt juridik ndaj paditësit dhe se i dëmtuari a ka pasur cilësinë e personit të tretë në automjetin i cili ka qenë i siguruar te e paditura dhe a ka bazë ligjore*

kërkesa e paditësit ndaj të paditurës për rimbursim të dëmit të cilin paditësi i ka paguar [M.G.]”

b) *Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 298/2016, i 26 shkurtit 2018*

90. Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë ankesën e të paditurës [Byroja Kosovare e Sigurimeve] duke arsyetuar si në vijim:

“Gjykata e Apelit i shqyrtoi pretendimet ankimore të paditurës [Byroja Kosovare e Sigurimeve] në lidhje me kompensimin e dëmit të dëmtuarit [R.M.], nga e paditura, i cili ka rrjedh nga Ujdia Jashtëgjyqësore dhe se për këtë arsye nuk ka atë drejtë të kërkoj rimbursim, mirëpo gjeti se të njëjta janë të pabazuara sepse duke u bazuar në nenin 190 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se “Gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit do të gjykojë kompensimin nën një shumë që nevojitet që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellët atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose ometim.” Në rastin konkret shuma e mbuluar me Ujdi Jashtëgjyqësore prej (...) nuk është shuma e përgjithshme e dëmit, andaj edhe ekziston obligimi i të paditurës në kompensimin pjesës së mbetur, gjegjësisht shumë prej (...) €.”

c) *Aktvendimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 4/2018 i 17 majit 2018 [rasti IKK Classic]*

91. D.H., i siguruari i parashtruesit të kërkesës në rastet KI134/15 dhe KI97/16, i cili kishte pësuar lëndime të rënda në një aksident trafiku të shkaktuar nga B.L., shfrytëzues i sigurimit në kompaninë e sigurimeve “SIGMA” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: SIGMA). D.H., kishte marrë trajtim mjekësor në Republikën Federale të Gjermanisë në shumë prej 18.985,36 Euro, e cila ishte paguar nga paditësi [IKK Classic]. (Shih, në vijim përmbledhjen e shkurtër të rasteve KI134/15 dhe KI97/16 në paragrafin 71 të këtij Aktgjykimi).
92. Si rrjedhojë e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (rasti KI97/16), Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E. Rev. nr. 4/2018] të 17 majit 2018, serish kishte pranuar revizionin e parashtruar nga e paditura [SIGMA], mirëpo lëndën e kishte kthyer në shkallë të parë për rigjykim. Gjykata Supreme duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16 konstatoi se “[...] në këtë çështje juridiko kontestimore ka mbetur pa u skjaruar faktet se cilat kanë qenë shpenzimet e domosdoshme për shërimin e siguruarit të paditësit D.H. si dhe shpenzimet tjera në kohën sa ka zgjatur shërimi i tij dhe të cilat ka të

drejtë paditësi ti rimbursojë te e paditura. Pas arritje së marrëveshjes jashtëgjyqësore në mes të paditurit KS Sigma dhe të siguruarit të paditësit D.H. a është keqësuar të njëjtit gjendja shëndetësorë e tij si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga ana e të siguruarit të paditurës dhe se shërimi i mëtejshëm i të siguruarit a është si pasojë e aksidentit të shkaktuar , gjegjësisht a është në lidhje kauzale me aksidentin e shkaktuar dhe cilat shpenzime kanë qenë të domosdoshme për shërimin e tij dhe të cilat mund të pranohen dhe të detyrohet i padituri ti rimbursojë. [...].”

93. Në dritën e vendimeve të lartcekura të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, të prezantuara nga parashtuesi në kërkesën e tij, Gjykata vëren se nuk ka praktikë uniforme të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme përkitazi me të drejtën në subrogim, në veçanti në rastet kur palët kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore pa përfshirjen e kompanisë së sigurimeve, të cilat kanë paguar trajtime mjekësore dhe kompensim për paafësinë në punë për të siguruarit e tyre, si rrjedhojë e aksidenteve të shkaktuara në Republikën e Kosovës.
94. Prandaj, bazuar në si më sipër, dhe në kontekst të detyrimit të përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës që parashtuesit e kërkesave duhet ti paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërtshënës në praktikën gjyqësore, Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Në këtë aspekt, Gjykata gjeti se tri (3) nga gjashtë (6) vendimet, e dorëzuara nga parashtuesi i kërkesës, të cilat në thelb shtjellojnë çështjen e përcaktimit të kamatëvonesës nuk përmbajnë ngjashmëri faktike dhe procedurale me ato në rastin e parashtuesit të kërkesës.
95. Në vijim, dhe përkitazi me tri (3) vendimet tjerat të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, të dorëzuara nga parashtuesi i kërkesës, dhe që i referohen rrethanave të ngjashme faktike dhe juridike si ato të rastit të parashtuesit, Gjykata ka sqaruar se kriteri kryesor për te vlerësuar nëse vendimet kundërtshënës janë "dukshëm arbitrare", është ekzistimi i "dallimeve të thella dhe të vazhdueshme" në praktikën gjyqësore përkatëse. Prandaj, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekzistojnë *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe asaj të Apelit, përkatësisht nuk ekziston praktikë gjyqësore dhe uniforme që i referohet njohjes së të drejtës në subrogim të kompanive të sigurimeve në rastet kur këto të fundit nuk ishin palë në marrëveshjet jashtëgjyqësore.

96. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigorisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse.

Përfundim

97. Gjykata, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke zbatuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe parimin e sigorisë juridike në aspektin e konsistencës së praktikës gjyqësore vjen në konstatimin si në vijim:
98. Sa i përket pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e Aktgjykimit Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019 të Gjykatës së Apelit, Gjykata e Apelit ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe rrjedhimisht është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
99. Sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës përkitazi me parimin e sigorisë juridike si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, Gjykata pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të vendosur nga Gjykata dhe GJEDNJ në këtë aspekt, dhe zbatoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, konstatoi se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigorisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 13 maj 2020, me shumicë votash:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 146/17, të 26 shkurtit 2019;
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae. Nr. 146/17, të 26 shkurtit 2019 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;
- VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimin me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Rasti nr. K38/19, Parashtrues: Avdi Mujaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 285/2018, të 1 tetorit 2018

Fjalët kyç: kërkesë individuale, kontest pronësor, përbërja e trupit gjykues, e drejta për gjykim të drejtë, paanshmëria e gjykatës

Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e blerësit, kishte lidhur një Kontratë të shitblerjes me H. D., me objekt të Kontratës shitblerja e pronës së paluajtshme që përbëhej nga një shtëpi dhe disa objekte të tjera përcjellëse të ndërtuara në ngastrën kadastrale [nr. 5393/18], me sipërfaqe prej 480 m².

Parashtruesit të kërkesës fillimisht i ishte pranuar në tërësi kërkesëpadia përmes Aktgjykimit [C. nr. 56/2008] të 12 janarit 2010, të Gjykatës Komunale në Pejë, duke vendosur që ai është pronar i ngastrës kontestuese kadastrale me sipërfaqe totale prej 480 m² dhe se të gjithë trashëgimtarët e rendit të parë të H. D-së, gjithsej tetë, duhet t'ia pranojnë parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë si dhe të lejojnë që prona në fjalë të regjistrohet në Zyrën Kadastrale Komunale në Pejë.

Në vijim, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011: (i) pjesërisht e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, duke vërtetuar se parashtruesi në bazë të parashkrimit fitues është pronar i ngastrës kadastrale [nr. 5393/18], në sipërfaqe prej 455 m² [e jo 480 m²]; dhe (ii) detyroi palët e paditura që parashtruesit t'ia pranojnë të drejtën e pronësisë si dhe të lejojnë regjistrimin e pronës në Zyrën Kadastrale Komunale në Pejë. Në përbërje të Kolegjit shqyrtues prej 3 anëtarëve të Gjykatës së Qarkut, ishte edhe gjyqtari I. K.

Ndaj Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të Gjykatës së Qarkut, parashtrojnë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Prokurori i Shtetit dhe kërkesën për revizion të cilën e dorëzoi parashtruesi i kërkesës.

Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev-Mlc. nr. 253/2011] të 27 gushtit 2013, vendosi që t'ia pranojë si të bazuara, që të dyja, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit dhe kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, ku urdhëroi prishjen e Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011, të Gjykatës së Qarkut dhe kthimin e lëndës në rivendosje tek Gjykata e Qarkut [e cila, më vonë, me ndryshime ligjore do të binte në kompetencë lëndore të Gjykatës së Apelit].

Në procesin e rivendosjes së rastit, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac. nr. 2749/13] e 10 prillit 2017, sërish aprovoi në mënyrë të pjesshme ankesën e B. D. ku vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i pjesës së ngastrës

kadastrale prej 455 m² e jo 480 m² siç kishte vendosur fillimisht Gjykata Komunale.

Më 1 tetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të *“pathemeltë”*. Pjesë e Kolegjit shqyrtues në këtë rast, në cilësinë e kryesuesit, ishte edhe gjyqtari I. K.

Lidhur me kërkesën KI38/19, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i referohet pjesëmarrjes të së njëjtit gjyqtar [I. K.] në dy instanca gjyqësore me ç ‘rast i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata konstatoi se kjo kërkesë i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe shqyrtoi meritat e saj.

Në shqyrtimin e meritave, Gjykata, ndër të tjera, elaboroi (i) parimet e përgjithshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; (iii) praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e *“dyshimeve legjitime”* dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë *“objektivisht të justifikueshme”* në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate; (iv) praktikën përkatëse gjyqësore përkitazi pjesëmarrjen e një gjyqtari në faza të ndryshme të të njëjtës çështje; dhe në fund, konstatoi se (v) Aktgjykimi [Rev. nr. 285/2018] i 1 tetorit 2018, i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse është nxjerrë nga përbërja e Kolegjit, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPK-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtari i cili edhe në faza të mëhershme të të njëjtës çështje, kishte marrë pjesë si anëtar i kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Pejë kur është vendosur për kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës e edhe si kryetar i Kolegjit kur është vendosur për kërkesën e tij për revizion në Gjykatën Supreme. Në rrethanat të tilla, Gjykata konstatoi se *“dyshimet legjitime”* për paanshmërinë e gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, janë *“objektivisht të justifikueshme”*.

Gjykata Kushtetuese, në rrethanat e rastit konkret, ka trajtuar ekskluzivisht dhe vetëm pretendimin për paanësi të gjykatës për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit I. K. në të njëjtin proces gjyqësor në dy instanca gjyqësore. Ky Aktgjykim i Gjykatës rrjedhimisht nuk paragjykon në asnjë mënyrë meritat përfundimtare të vendosjes së këtij rasti, pasi që i njëjti të kthehet për rigjykim në Gjykatën Supreme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI38/19

Parashtrues

Avdi Mujaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 285/2018, të 1 tetorit
2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Avdi Mujaj, me banim në Pejë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 285/2018] e 1 tetorit 2018, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin e ka pranuar më 29 tetor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me paragrafët 1

dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe paragrafin 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 shkurt 2019, nëpërmjet shërbimeve postare, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 12 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 25 mars 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar nga ai që: (i) të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur është pranuar Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme; (ii) të plotësojë formularin e kërkesës; si dhe (iii) të dorëzojë autorizimin e përfaqësuesit në rast se ka vendosur që të përfaqësohet në procedurat para Gjykatës.
8. Më 20 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi: (i) fletëkthesën që dëshmon se e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 29 tetor 2018; dhe (ii) formularin e kërkesës të plotësuar ku theksoi që në këtë rast nuk ka angazhuar përfaqësues dhe se në procedurat para Gjykatës do të vetpërfaqësohet.
9. Më 23 maj 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.

10. Më 15 janar 2020, Gjykata e njoftoi palën e interesuar B. D. për regjistrimin e kërkesës dhe i mundësoi që të dorëzojë komentet e tij lidhur me kërkesën, nëse ka, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i njoftimit të Gjykatës.
11. Më 3 shkurt 2020, pala e interesuar B. D. parashtroi disa komente në Gjykatë.
12. Më 1 korrik 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
13. Në të njëjtën ditë, më 1 korrik 2020, Gjykata vendosi njëzëri që (i) kërkesa është e pranueshme, dhe (ii) Aktgjykimi [Rev. nr. 285/2018] i 1 tetorit 2018 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 30 prill 1985, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e blerësit, kishte lidhur një Kontratë të shitblerjes me H. D., në cilësinë e shitësit (në tekstin e mëtejshëm: Kontrata e shitblerjes). Objekt i Kontratës së shitblerjes ishte një pronë e paluajtshme që përbëhej nga një shtëpi dhe disa objekte të tjera përcjellëse të ndërtuara në ngastrën kadastrale [nr. 5393/18], me sipërfaqe prej 480 m².
15. Në një datë të pacaktuar, H. D., që kishte nënshkruar Kontratën e shitblerjes në cilësi të shitësit me parashtruesin e kërkesës, kishte ndërruar jetë. Nga shkresat e lëndës rrjedh që parashtruesi i kërkesës, ndonëse e kishte lidhur këtë Kontratë të shitblerjes, ai nuk e kishte regjistruar pronën në fjalë në emrin e tij në organet publike përkatëse për regjistrim të të drejtave pronësore.
16. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga trashëgimtari i H. D., respektivisht B. D., që t'ia mundësojë atij që të bëjë regjistrimin e pronës në fjalë në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Pejës – por që, sipas kërkesëpadisë, pala e paditur, respektivisht pala e interesuar B. D. kishte refuzuar.
17. Për rrjedhojë, më 31 janar 2008, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi “për vërtetim të pronësisë” në Gjykatën Komunale në Pejë kundër B. D-së. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që të vërtetohet se ai është pronar i pronës kontestuese në bazë të Kontratës së lartcekur të shitblerjes të

lidhur në vitin 1985 në mes tij dhe babait të B. D-së. Ai kërkoi që të detyrohet B. D. që t'ia mundësojë evidentimin si pronar i paluajtshmërisë dhe, me qëllim të evitimit të rrezikut dhe shkaktimeve të dëmit të pariparueshëm, parashtruesi i kërkesës kërkoi caktimin e një mase të përkohshme përmes së cilës do të ndalohej themelimi i hipotekës mbi pronën në fjalë.

Vendimmarrja në shkallë të parë, pranë Gjykatës Komunale në Pejë [pa praninë e gjyqtarit I. K.]

18. Më 12 janar 2010, Gjykata Komunale në Pejë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 56/2008], e pranoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Me atë rast, ajo vendosi që parashtruesi i kërkesës është pronar i ngastrës kontestuese kadastrale me sipërfaqe totale prej 480 m² dhe se të gjithë trashëgimtarët e rendit të parë të H. D-së, gjithsej tetë, duhet t'ia pranojnë parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë si dhe të lejojnë që prona në fjalë të regjistrohet në Zyrën Kadastrale Komunale në Pejë.
19. Më 1 shkurt 2010, kundër Aktgjykimit të lartcekur, B. D. paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 9 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë duke theksuar se pretendimet ankimore të palëve të paditura janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa Aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Vendimmarrja e parë në shkallë të dytë, pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë [me praninë e gjyqtarit I. K., si anëtar i Kolegjit prej 3 anëtarëve]

21. Më 16 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] vendosi për aprovimin e pjesshëm të ankesës së B. D.
22. Përmes këtij aprovim, Gjykata e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut) e ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 56/2008] e 12 janarit 2010 të Gjykatës Komunale në Pejë, ashtu që tanimë parashtruesit të kërkesës ia njohu të drejtën e pronësisë së të njëjtës ngastër kadastrale por jo në sipërfaqe totale prej 480 m² por në sipërfaqe totale prej 455 m², respektivisht 25 m² më pak se sa që ia kishte njohur fillimisht gjykata e shkallës së parë.

23. Pra, Gjykata e Qarkut: (i) pjesërisht e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, duke vërtetuar se parashtruesi në bazë të parashkrimit fitues është pronar i ngastrës kadastrale [nr. 5393/18], në sipërfaqe prej 455 m² [e jo 480 m²]; dhe (ii) detyroi palët e paditura që parashtruesit t'ia pranojnë të drejtën e pronësisë si dhe të lejojnë regjistrimin e pronës në Zyrën Kadastrale Komunale në Pejë. Në përbërje të Kolegjit shqyrtues prej 3 anëtarëve të Gjykatës së Qarkut, ishte edhe gjyqtari I. K.
24. Më 21 prill 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut në Pejë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 2 maj 2011, krahas kërkesës për revizion, parashtruesi i kërkesës po ashtu parashtroi edhe një kërkesë tek Prokuroria e Shtetit, që në bazë të autorizimeve të saj ligjore të ushtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut.
26. Më 3 qershor 2011, Prokurori i Shtetit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë [KMLC. nr. 35/2011] për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011, të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Vendimmarrja e parë në shkallë të tretë, pranë Gjykatës Supreme [pa praninë e gjyqtarit I. K.]

27. Më 27 gusht 2013, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev-Mlc. nr. 253/2011] vendosi që t'i pranojë si të bazuara, që të dyja, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit dhe kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës.
28. Me këtë rast, Gjykata Supreme urdhëroi prishjen e Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011, të Gjykatës së Qarkut dhe kthimin e lëndës në rivendosje tek Gjykata e Qarkut [e cila, më vonë, me ndryshime ligjore do të binte në kompetencë lëndore të Gjykatës së Apelit].
29. Sipas Gjykatës Supreme, Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës së Qarkut *“është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n) lidhur me nenin 201 (c) të LPK-së”*. Shkelje në fjalë, sipas Gjykatës Supreme, ekzistonte sepse dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut *“është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit dhe nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare”*. Tutje, Gjykata Supreme arsyetoi se

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit dhe thëniet në revizion të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës janë të bazuara dhe për të tilla arsye Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut “u deshtë të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje të njëjtës gjykatë”.

Vendimmarrja e dytë në shkallë të dytë, pranë Gjykatës së Apelit [pa praninë e gjyqtarit I. K.]

30. Më 10 prill 2017, Gjykata e Apelit, në rivendosje sipas urdhrit të Gjykatës Supreme, e shqyrtoi sërish ankesën e B. D. të 1 shkurtit 2010 të parashtruar kundër Aktgjykimit [C. nr. 56/2008] të 12 janarit 2010 të Gjykatës Komunale.
31. Përmes vendimmarrjes së dytë në apel, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 2749/13] përmes së cilit sërish aprovoi në mënyrë të pjesshme ankesën e B. D. Me atë rast, Gjykata e Apelit: (i) vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale prej 0.04,55 ha (455 m² e jo 480 m² siç kishte vendosur fillimisht Gjykata Komunale); (ii) detyroi B. D. dhe trashëgimtarët e tjerë të H. D. që t’ia pranojnë të drejtën e pronësisë parashtruesit të kërkesës dhe t’ia lejojnë që pronën në fjalë ta regjistrojë në Zyrën Komunale për Kadastër në Pejë; (iii) refuzojë pjesën e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, me të cilën kërkoi që të vërtetohet se në bazë të Kontratës së shitblerjes është pronar edhe i pjesës së ngastrës kadastrale [nr. 5393/18], në sipërfaqe prej 0.00,25 ha (25 m²). [Sqarim: edhe Gjykata e Apelit vendosi njësoj sikurse Gjykata e Qarkut duke mos ia njohur pronësinë e plotë mbi 480 m² sipas kërkesëpadisë, por vetëm mbi 455 m² – pra minus 25 m²].
32. Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Vendimmarrja e dytë në shkallë të tretë, pranë Gjykatës Supreme [me praninë e gjyqtarit I. K. në Kolegj shqyrtues, si kryesues i Kolegjit]

33. Më 1 tetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion si të “*pathemeltë*”. Pjesë e Kolegjit shqyrtues në këtë rast, në cilësinë e kryesuesit, ishte edhe gjyqtari I. K.
34. Gjykata Supreme arsyetoi se, Gjykata e Apelit “*në gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë [Gjykata Komunale] drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës*

kontestimore dhe të drejtën materiale duke vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit të goditur. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban arsye të mjaftuara për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të pranueshme edhe për këtë Gjykatë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018, përmes të cilit kërkesa e tij për revizion është refuzuar, i janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me nenin 31, nenin 22 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
36. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron se është shkelur neni 67, pika (d) (përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi) i LPK-së për faktin se i njëjti gjyqtar (gjyqtari I. K.) i cili ka marrë pjesë në vendosjen e kësaj çështje kontestimore në Gjykatën e Qarkut në Pejë [shih Aktgjykimin Ac. nr. 101/10], kur është vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të shkallës së parë, është kryetar i Kolegjit të Gjykatës Supreme, e cila ka vendosur lidhur me revizionin e paditësit [shih Aktgjykimin Rev. nr. 285/2018]. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, mosrespektimi i kësaj ndalese paraqet shkelje flagrante të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, e cila sipas paragrafit 2 të nenit 22 të Kushtetutës zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.
37. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata e Qarkut, ku pjesë e panelit të gjyqtarëve kishte qenë edhe I. K. ia kishte njohur atij “*të drejtën e pronësisë në të njëjtën ngastër kadastrale por jo në sipërfaqe prej 480 m², por në sipërfaqe prej 455 m², që është më pak se 25 m² më pak se sa sipërfaqja e blerë nga parashtruesi i kërkesës dhe sipas këtij Aktgjykimi të kësaj gjykate baza për fitimin e të drejtës së pronësisë, nuk është Kontrata e shitblerjes – si punë juridike që paraqet bazë ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë [...] por është parashkrimi fitues si bazë ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë dhe si rezultat i kësaj zvogëlohet sipërfaqja e blerë për 25 m²”.* Më tutje, theksoi ai, “*me rastin e vendosjes së kësaj çështje si anëtar i Kolegjit ka qenë gjyqtari I. K., në atë kohë gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Pejë”.*
38. Në vazhdim, parashtruesi i kërkesës sqaron se pas anulimit të Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të Gjykatës së Qarkut, çështja tani i është kthyer për rivendosje Gjykatës së Apelit, si gjykatë kompetente, pas riorganizimit të sistemit gjyqësor sipas Ligjit për Gjykatat. Gjykata e Apelit, thekson parashtruesi i kërkesës, “*duke vendosur sipas ankesës, si gjykatë e shkallës së dytë, këtë çështje kontestimore e vendosi në*

mënyrë identike me Gjykatën e Qarkut në Pejë, duke ia njohur parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë në patundshmërinë kontestuese vetëm në sipërfaqe prej 455 m², të fituar në bazë të parashkrimit fitues, e jo në tërë sipërfaqen e blerë prej 480 m², sipas Kontratës së shitblerjes të hartuar me shkrim, siç ka qenë kërkesa e paditësit”.

39. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se ai, duke qenë i pakënaqur me vendimmarrjen identike të Gjykatës së Apelit në raport me atë të Gjykatës së Qarkut, ka paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme ku edhe kishte theksuar se *“nuk janë përfillur vërejtjet e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila e kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit dhe revizionit të parashtruesit”.*
40. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se, në rastin konkret ekziston shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm *“për faktin se i njëjti gjyqtar (I. K.) i cili ka marrë pjesë në vendosjen e kësaj çështje kontestimore në Gjykatën e Qarkut në Pejë, kur është vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjyimit të shkallës së parë, është anëtar i Kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka vendosur lidhur me revizionin e paditësit”.*
41. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se duke qenë se *“fjala është për shkelje të drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që nënkupton përjashtimin e mundësisë së gjyimit nga ana e të njëjtit gjyqtar, në dy instanca gjyqësore edhe pse kjo shprehimisht e ndaluar me dispozitën e nenit 67 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore e cila rregullon përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi në të cilin thuhet se gjyqtari nuk mund ta procedoj çështjen juridike nëse: “... në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit”.* Mosrespektimi i kësaj ndalese, pohon parashtruesi i kërkesës, *“paraqet shkelje flagrante”* të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe paragrafin 2 të nenit 22 të Kushtetutës.
42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të nxjerr Aktgjykim përmes të cilit: (i) pranohet si e bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) anulohet Aktgjykimin i kontestuar Gjykatës Supreme dhe çështja kthehet në rivendosje.

Komentet e palës së interesuar B. D.

43. Në komentet e tij lidhur me rastin, pala e interesuar B. D. theksoi se *“unë si palë e paditur nuk kam kontribuar në asnjë mënyrë, sepse nuk kam përzgjedhur se kush nga gjykatësit do të vendosin në mënyrë meritore për kërkesëpadinë në cilëndo instancë që ky rast ka kaluar, as nuk kam qenë në njohuri për promovimet në karrierën e tyre si mundësi e çështjes eventuale të paanësisë së tyre kur ata vendosin për rastet në kompetencën e tyre”*.
44. Më tutje, pala e interesuar B. D. theksoi me sa vijon: *“Ju bëj me dije se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 101/2010, i datës 23.03.2011 për të cilin gjyqtari I. K. ka vendosur në këtë çështje si anëtar i kolegjit, është anuluar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. MLC. nr. 253/2011 më datë 27.08.2013, pra si i tillë është nul – i paqenë, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 101/2010 nga ai moment nuk ka prodhuar kurrfarë efekti në të ardhmen as nuk është marr në parasysh në vendimet që kanë pasur, pra si i tillë ligjërisht është inekzistent për shqyrtim nga kushdo qoftë”*. Në këtë aspekt, pala e interesuar B. D. thekson se Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2749/2013, të 10 prillit 2018 në të cilën gjyqtari I. K. *“nuk ka marrë pjesë si anëtar i kolegjit, nga gjyqtarët tjerë është vendosur në mënyrë të njëjtë”*.
45. Pala e interesuar B. D. kërkon nga Gjykata që ta vlerësojë kushtetutshmërinë e këtij rasti *“në bazë të parimit të oportunitetit dhe të parimit të ekonomizimit të procedurave”* duke e refuzuar kështu kërkesën e parashtruesit *“si një përpjekje e kotë për ta penguar drejtësinë tani më të arritur”*. Kjo për faktin se, *“si pasojë e rrethanave që janë zhvilluar në institucionet gjyqësore, promovimi i I. K. [gjyqtari paanësia e të cilit kontestohet] në instancë më të lartë [në Gjykatë Supreme nga Gjykata e Apelit] dhe pakujdesisë së tij, për shkak të ngarkesës në punë nga shumë lëndë dhe moshës së arritur për pension, besojmë se pa qëllim është bërë ky lëshim, e që aspak nuk ka ndikim në vendosjen meritore të çështjes”*.
46. Gjithashtu, pala e interesuar B. D. konsideron se rasti konkret i ngritur nga parashtruesi i kërkesës *“nuk përkon me qëllimin e ligdhënësit, i caktuar me dispozitën e nenit 67 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe me aplikimin automatik të kësaj dispozite Ju do të legjitimoni një pasiguri totale të njohjes dhe realizimit të drejtave themelore të qytetarit në pronë nga institucione gjyqësore”*. Po ashtu, pala e interesuar B. D. theksoi se vendosja e rastit në fjalë ka zgjatë *“12 vite të plota me maltretim psikik personal dhe të familjes dhe humbje financiare për ta mbrojtur të drejtën legjitime që tani më në fund*

është realizuar duke i kaluar përmes të gjitha instancat gjyqësore, me të cilin tani së paku e kam arritur një satisfaksion moral”.

47. Në përfundim të komenteve, pala e interesuar B. D. kërkoi nga Gjykata si në vijim: *“Me mirësjellje, respekt dhe besim në Gjykatën Kushtetuese për vendosjen së këtij rasti, jam i bindur se Ju e keni në konsideratë se mund të më garantoni se neglizhencë si kjo e gjyqtarit I. K. nuk do të ndodhë prapë në të ardhmen nga ndonjë gjyqtarë tjetër, por me refuzimin e kësaj kërkesë jam i bindur se ju mund ta eliminoni këtë mundësi shumë reale e të pa dëshirueshme edhe për Ju që ajo të përsëritet”.*

Pranueshmëria e kërkesës

48. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

50. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

51. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 285/2018] e 1 tetorit 2018, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
52. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
53. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj. (Shih rastin e Gjykatës: KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 19 korrikut 2019, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat e kërkesës

54. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe paragrafi 2 i nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.
55. Gjykata, para së gjithash, vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i referohet pjesëmarrjes të së njëjtit gjyqtar [I. K.] në dy instanca gjyqësore me ç'rast i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
56. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, gjyqtari I. K. kishte qenë gjyqtar i Kolegjit prej 3 anëtarëve të formuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, përgjegjës për të vendosur mbi ankesën e të paditurit, respektivisht palës së interesuar, e cila u vendos përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011. Tutje, i njëjti gjyqtar, më pas kishte qenë pjesëmarrës edhe si kryesues i Kolegjit prej 3 anëtarëve të Gjykatës Supreme, kur me Aktgjykimin [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018, ishte vendosur për kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2749/13] të 10 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit. Pra, në rastin para Gjykatës, çështje thelbësore është përgjigja në pyetjen se a është shkelur paanësia e Gjykatës apo jo me marrjen pjesë të gjyqtarit I. K. në dy instanca të ndryshme gjyqësore ku është vendosur për themelin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës.
57. Në trajtimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme për paanësi të Gjykatës, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese

58. Paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të

GJEDNJ-së, duhet të përcaktohet sipas (i) *testit subjektiv*, rrjedhimisht në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar se një gjyqtar mund të ketë pasur paragjytime personale apo anshmëri në një rast të caktuar; dhe (ii) *testit objektiv*, rrjedhimisht konstatimit nëse vet gjykata, mes tjerash, përbërja e saj, ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. (Shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Miracle Europe KFT kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 12 prillit 2015, paragrafët 54 dhe 55; *Gautrin dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 58; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 58; *Thomann kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 10 qershorit 1996, paragrafi 30; *Wettstein kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2000, paragrafi 42; dhe rastet e Gjykatës: KI187/18 dhe KI11/19 me parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykim i 26 gushtit 2019, paragrafi 50; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 19 korrikut 2019, paragrafi 44; KI06/12, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Aktgjykim i 9 majit 2012, paragrafi 45).

59. Më specifikisht, sa i përket testit subjektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 30 nëntorit 2005, paragrafi 30; *Padovani kundër Italisë*, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 26; *Morel kundër Francës*, paragrafi 41; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 59; *Hauschildt kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989, paragrafi 47; *Driza kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 75; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, kërkesa nr. 56134/08, Aktgjykim i 10 janarit 2017, paragrafi 47).
60. Për sa i përket llojit të provave të nevojshme për të dëshmuar paanshmërinë personale të një gjyqtari, GJEDNJ është përpjekur që të vërtetojë nëse një gjyqtar ka treguar armiqësi ose vullnet të keq për arsye personale. Parimi në të cilin duhet të supozohet se gjykata është e liruar nga paragjykimet apo njëanshmëria personale, është i vendosur për një kohë të gjatë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Kyprianou kundër Qipros*, cituar më lart, paragrafi 119; *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 93-94; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 33).
61. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përderisa në disa raste mund të jetë e vështirë të gjenden faktet bazuar në të cilat mund të përmbysset prezumimi i paanësisë subjektive të një gjyqtari, kriteret dhe kërkesat për paanësinë objektive përcaktojnë një garanci shtesë për një gjykim

të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 95 dhe 101). Duhet të theksohet se në shumicën e rasteve që ndërlidhen me çështje të paanshmërisë, GJEDNJ është fokusuar dhe ka gjetur shkelje në aspektin e testit objektiv, i cili dhe do të shpjegohet më tutje. (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sa kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 146; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 48).

62. Sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur testi i tillë aplikohet mbi një trup gjykues, duhet të përcaktohet nëse ndaras nga sjellja personale e cilitdo gjyqtar, mund të ketë fakte të mjaftueshme të cilat mund të ngritin dyshime për paanshmërinë e gjykatës. Në këtë aspekt edhe dukja/perceptimi mund të ketë rëndësi, sepse "*drejtësia jo vetëm duhet të zbatohet, por ajo duhet të shihet që po zbatohet*". (Në këtë kontekst, ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së: *De Cubber kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 26 tetorit 1984, paragrafi 26). Çfarë është në diskutim është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik. Prandaj, cilitdo gjyqtar për të cilin mund të ketë arsye legjitime për të dyshuar në mungesë paanshmërie, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 98).
63. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngrihen çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë, mund të jenë: (i) të natyrës funksionale dhe (ii) personale.
64. E para, ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti person ose të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër, në mes gjyqtarit dhe akterëve tjerë në procesin e caktuar gjyqësor. Përkitazi me këto të fundit, niveli dhe natyra e kësaj lidhje duhet të ekzaminohet. Këto situata të natyrës funksionale, mund të përfshijnë shembuj të rasteve kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione: (i) këshillëdhënëse dhe gjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *Procola kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 8 shtatorit 1995, paragrafi 45; *Kleyn dhe të Tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 200; *Sacilor Lormines kundër Francës*, Aktgjykim i 9 nëntorit 2006, paragrafi 74); (ii) gjyqësore dhe jashtëgjyqësore (për këtë kontekst, shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Mc Connell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2000, paragrafët 52-57); dhe (iii) të ndryshme gjyqësore (shih, ndër të tjera rastin e GJEDNJ-së: *Pasquini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 2 majit 2009, paragrafi

148). Në këtë kontekst, GJEDNJ thekson se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procesit gjyqësor mund të ketë rezultuar në shkelje të kërkesave që ndërlidhen me paanësinë e gjykatës, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe varet nga rrethanat e secilit rast.

65. Çështja e dytë që duhet të trajtohet në lidhje me mungesën e paanshmërisë, përkatësisht, çështje të natyrës personale, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e sjelljes së një gjyqtari përkitazi me një rast ose ekzistencën e lidhjeve me njërin nga palët apo përfaqësuesit të tij/saj në një rast. (Shih për më tepër në këtë kontekst, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 gushtit 2019, për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë (aspekti civil), Pjesa III. Garancionet Institucionale, C. Pavarësia dhe Paanësia, 3. Gjykata e Paanshme, b. Situatat në të cilat mund të lindë çështja e mungesës së paanshmërisë gjyqësore, ii. Situatat natyrës personale).
66. Gjykata gjithashtu thekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerësimi i paanësisë së gjykatës në kuptim të vlerësimit subjektiv dhe objektiv nënkupton që duhet të përcaktohet nëse në një rast të caktuar mund të ketë dyshime legjitime për t'u frikësuar që një trupi të caktuar gjykues i mungon paanshmëria. Megjithatë, për të vendosur nëse në një rast konkret ka bazë të mjaftueshme për të përcaktuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e parashtruesit është e rëndësishme, por jo vendimtare. Ajo që ka rëndësi është vlerësimi i gjykatës nëse një dyshim i tillë mund të justifikohet objektivisht. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Mežnarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 44; *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 49 dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33).

Aplikimi i parimeve të përgjithshme për paanësi të Gjykatës në rrethanat e rastit konkret

67. Në aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon pikërisht ushtrimin e funksioneve të ndryshme të një gjyqtari brenda të njëjtit proces gjyqësor, përkatësisht faktin që gjyqtari I. K. kishte marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues në: (i) nxjerrjen e Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011, të Gjykatës së Qarkut në Pejë; si dhe në: (ii) nxjerrjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018, të Gjykatës Supreme në cilësinë e kryetarit

të Kolegjit. Sipas parashtruesit të kërkesës, pjesëmarrja e gjyqtarit I. K. në këto dy instanca gjyqësore ku është trajtuar padia e tij për vërtetim pronësie, ka rezultuar në shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

68. Bazuar në praktikën e lartpërmendur gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata së pari do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me paanësinë e gjykatës nën kriteret e testit subjektiv.
69. Gjykata rithekson se sa i përket testit subjektiv, paanshmëria personale e gjyqtarit I. K. duhet të prezumohet deri sa të vërtetohet e kundërta. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë apo dëshmi e cila do të mund të vinte në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit I. K. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, asnjë fakt nuk mund të mbështet konstatimin se Gjykata Supreme nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit subjektiv.
70. Gjykata në vijim, në përputhje me parimet e praktikës së lartpërmendur gjyqësore të GJEDNJ-së, do të vijojë me shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës nën kriteret e testit objektiv. Fillimisht, Gjykata do të shqyrtojë (i) nëse rrethanat e rastit konkret mund të ngrisin dyshime legjitime nga ana e parashtruesit të kërkesës në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës Supreme; dhe nëse ky është rasti (ii) nëse këto dyshime janë objektivisht të justifikueshme.
71. Përcaktimi i këtyre çështjeve dhe vendosja rreth tyre bëhet në secilin rast veç e veç edhe në nivel të GJEDNJ-së, e edhe në nivel të kësaj Gjykate. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Meznarić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 31; *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Aktgjykim i 7 gushtit 1996, paragrafi 58; *Wettstein kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 44; dhe *San Leonard Band Club kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 60; *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Tozicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 33).
72. Në këtë aspekt, ashtu siç është theksuar më lart, ushtrimi i funksioneve të ndryshme brenda të njëjtit proces gjyqësor nga gjyqtari i njëjtë dhe që ndërlidhet me rrethanat e rastit konkret, paraqet kategori çështjesh të natyrës funksionale dhe të cilat janë relevante në vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate. Në raste të tilla, GJEDNJ në parim ka mbajtur qëndrimin se ka dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 51 dhe 52). Të njëjtin qëndrim, për të tilla rrethana të rasteve, e mban edhe kjo

Gjykatë. Kjo për faktin se ushtrimi i funksioneve të ndryshme të gjyqtarit I. K., para dhe pas avancimit të tij në Gjykatë Supreme, ka ndodhur brenda të të njëjtit proces gjyqësor për vendosjen mbi padinë e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, gjyqtari I. K. ka vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës kur ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe më pas, kur gjyqtari I. K. ka kaluar në Gjykatën Supreme, ai ka vendosur për kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës **lidhur me të njëjtën çështje gjyqësore** të parashtruesit të kërkesës.

73. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse dyshimet e tilla në rrethanat e rastit konkret, të cilat veçse u konstatuan, mund të jenë objektivisht të justifikueshme.
74. Në kuptim të vlerësimit të *dyshimeve legjitime* në kontekst të rrethanave kur një gjyqtar ka ushtruar më shumë se një funksion në të njëjtën çështje gjyqësore, dy kategori çështjesh janë të rëndësishme.
75. Së pari, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet karakteristikave të ligjit dhe rregullave që janë të aplikueshme në një rast konkret. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Warsicka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 16 janarit 2007, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 50). Në këtë kontekst, GJEDNJ ka theksuar se të rëndësishme janë edhe çështjet organizative. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Piersack kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 1 tetorit 1982, paragrafi 30). Për shembull, ekzistenca e procedurave që e sigurojnë paanshmërinë, përkatësisht, rregullave dhe procedurave që e rregullojnë edhe tërheqjen/përrjashtimin e një gjyqtari, është faktor relevant. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Pfeifer dhe Plankl kundër Austrisë*, Aktgjykim i 25 shkurtit 1992, paragrafi 6; *Oberschlick kundër Austrisë (nr. 1)*, Aktgjykim i 23 majit 1991, paragrafi 50; dhe *Pescador Valero kundër Spanjës*, Aktgjykim i 24 shtatorit 2003, paragrafët 24-29).
76. Së dyti, është e nevojshme të vlerësohet nëse ndërlidhja në mes çështjeve përmbajtësore të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës është aq e afërt/dukshme sa që vë dyshim në paanësinë e gjyqtarit që ka marrë pjesë në vendimmarrje përgjatë këtyre fazave. Ky përcaktim gjithashtu bëhet nga rasti në rast dhe duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e veçanta të tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Warsicka kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 40; *Toziczka kundër Polonisë*, cituar më lart,

paragrafi 36; dhe *Korzeniak kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

77. Në këtë aspekt, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të elaboruar më lart, duhet të shtjellojë fillimisht çështjet ligjore dhe rregullative. Gjykata rikujton se procedurat të cilat e rregullojnë tërheqjen/përjashtimin e një gjyqtari nga vendimmarrja janë të një rëndësie të veçantë.
78. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që në rastin e parashtruesit të kërkesës në procedurat lidhur me kërkesën për revizion, Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat e LPK-së. Ky i fundit, në nenin 67 paragrafi (d) (Përjashtimi i Gjyqtarit nga Gjykimi) të tij, specifikisht rregullon çështjen dhe rrethanat në të cilat përjashtohen gjyqtarët nga vendimmarrja përkatëse. Gjykata thekson që paragrafi (d) i nenit 67 të LPK-së, shkeljen e të cilit parashtruesi i kërkesës e pretendon, përcakton që:

“Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

[...]

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit; [...].”

79. Gjykata duhet gjithashtu të thekson se në rrethanat e rastit konkret, në mes të marrjes pjesë të gjyqtarit I. K. në Kolegjin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, përkatësisht nxjerrjes së Aktgjykimit [Ac. nr. 101/10] të 16 marsit 2011 dhe pjesëmarrjes së tij në Kolegjin e Gjykatës Supreme në cilësinë e kryetarit të kolegjit, përkatësisht, nxjerrjes së Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018, përmes Aktvendimit [Rev-Mlc. nr. 253.2011] të 27 gushtit 2013 të Gjykatës Supreme, çështja e parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim. Në gjykimin e ri, gjyqtari I. K. kishte marrë pjesë në cilësinë e kryetarit të Kolegjit të Gjykatës Supreme i cili ka shqyrtuar kërkesën për revizion kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2749/13] të 10 prillit 2017 të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata thekson, se përmbajtja e paragrafit (d) të nenit 67 të LPK-së, përkatësisht *“në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët [...].”*, dhe e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret ngase kjo normë është gjithëpërfshirëse dhe e ka detyruar gjyqtarin I. K. që të përjashtohet nga vendimmarrja në kolegjin përkatës të Gjykatës Supreme.

80. Gjykata gjithashtu thekson se në rrethana të tilla, përjashtimi i gjyqtarit nuk është i varur detyrimisht nga kërkesa e palëve në procedurë. Bazuar në dispozitat e LPK-së, gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike kur “*në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët*”. Kjo është e përcaktuar në nenin 67 të LPK-së dhe gjithashtu mbështetet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e cila duke theksuar rëndësinë e perceptimit dhe besimit që gjykatat duhet të reflektojnë në publik në një shoqëri demokratike, në mënyrë të vazhdueshme kanë theksuar se cilido gjyqtar që beson që pjesëmarrja e tij ose saj në një çështje gjyqësore, mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e gjykatës, duhet të përjashtohet nga vendimmarrja.
81. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton se në procedurat që kanë të bëjnë me kërkesën për revizion, vendoset vetëm në bazë të shkresave në dosjen e lëndës. Andaj, për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi i kërkesës dhe as mbrojtësi i tij, nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se i njëjti gjyqtar që ishte pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut mori pjesë edhe në Kolegjin e Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për revizion. Prandaj, përgjegjësia për mospërjashtimin e gjyqtarit përkatës nuk mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës dhe të konkludohet që ai ka hequr dorë nga e drejta që çështja e tij të vendoset nga një gjykatë e paanshme. (Shih, në këtë kontekst edhe rastet e Gjykatës: KI187/18 dhe KI11/19 me parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktgjykimi i 26 gushtit 2019, paragrafi 67; KIO6/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 36; shih gjithashtu edhe rastin e GJEDNJ-së, *Oberschlick kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 51).
82. Gjykata rikujton se çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për revizion, është çështje krejtësisht nën juridiksion dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe organeve tjera përgjegjëse. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon institucioneve relevante dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. (Në këtë kontekst, shih rastet e Gjykatës: KI187/18 dhe KI11/19 me parashtrues *Muhamet Idrizi*, cituar më lart, paragrafi 68; KIO6/12, parashtrues: *Bajrush Gashi*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe rastin KO4/11 parashtrues: Gjykata Supreme e Kosovës, Vlerësimi kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nr. 03/L-139, Aktgjykimi i 1 marsit 2012).

83. Rrjedhimisht dhe në rrethanat e tilla, Gjykata konstaton se “*dyshimet legjitime*” për paanshmërinë e gjykatës e që rrjedhin si rezultat i ushtrimit të funksioneve të ndryshme të gjyqtarit I. K. brenda të njëjtit proces gjyqësor janë objektivisht të justifikueshme. Gjykata, në këtë drejtim konstaton se në nxjerrje të Aktgjykimit [Rev. nr. 285/2018] të 1 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, gjykata, në këtë rast Gjykata Supreme, nuk ka qenë e paanshme në kuptimin e testit objektiv dhe se rrjedhimisht, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një gjykatë e paanshme, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
84. Gjykata, siç është cekur me lart, rikujton që në kontekst të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përtej çështjeve ligjore dhe rregullative, ndërlidhja në mes çështjeve përmbajtësore të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës, është po ashtu relevante. Megjithatë, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar se në rrethanat e rastit konkret, dyshimet legjitime për paanshmërinë janë objektivisht të justifikueshme, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen aspektet tjera përkitazi me paanshmërinë e gjykatës në kuptimin e testit objektiv.
85. Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin [Rev. nr. 285/2018] e kontestuar të Gjykatës Supreme të 1 tetorit 2018, për nga këndvështrimi i paanësisë së gjykatës në kuptimin e testit objektiv dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet dhe as nuk paragjykon në asnjë mënyrë rezultatin e meritave të rastit përkitazi me çështjen e pronësisë që ka qenë objekt shqyrtimi nga gjykatat e rregullta.

Përfundime

86. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimi [Rev. nr. 285/2018] i 1 tetorit 2018 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse është nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPK-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtari, I. K., i cili gjithashtu ishte pjesë e vendimmarrjes në fazat e mëhershme të çështjes së njëjtë, përkatësisht kishte marrë pjesë si anëtar i Kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Pejë kur është vendosur për kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës e edhe si kryetar i Kolegjit kur është vendosur për kërkesën e tij për revizion në Gjykatën Supreme. Në rrethana të tilla, Gjykata konstatoi se dyshimet legjitime për mungesën e paanësisë së gjykatës janë objektivisht të justifikueshme.

87. Gjykata Kushtetuese, në rrethanat e rastit konkret, ka trajtuar ekskluzivisht dhe vetëm pretendimin për paanësi të gjykatës për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit I. K. në të njëjtin proces gjyqësor në dy instanca gjyqësore. Ky Aktgjykim i Gjykatës rrjedhimisht nuk paragjykon në asnjë mënyrë meritat përfundimtare të vendosjes së këtij rasti, pasi që i njëjti të kthehet për rigjykim në Gjykatën Supreme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 1 korrik 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 285/2018, të 1 tetorit 2018;
- IV. TA KTHEJË çështjen në rishqyrtim në Gjykatën Supreme në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme, që në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën, jo më vonë se më 30 nëntor 2020, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me këtë urdhër;
- VII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VIII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI56/18, Parashtrues: Ahmet Frangu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ.UZVP.nr.67/2017, të 22 dhjetorit 2017

KI 56/18, Aktgjykim i miratuar më 22 korrik 2020, i publikuar më 10 gusht 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, e drejta për zgjidhje efektive, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, regjistri themeltar i të vdekurve, qasje formale e autoriteteve publike, seancë publike dëgjimore, statusi i viktimës, shkelje e të drejtës për jetë private dhe familjare, shkelje e të drejtës për zgjidhje efektive.

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e birit të tij të ndjerë I.F., në regjistrin themeltar të të vdekurve (në tekstin e mëtejme: RTHV). I biri i ndjerë i parashtruesit të kërkesës kishte udhëtuar në Suedi me qëllim të shërimit nga një sëmundje e rëndë. Gjatë qëndrimit të tij në Suedi, i biri i parashtruesit të kërkesës kishte aplikuar për azil, por duke e përdorur një emër tjetër, përkatësisht emrin A.H. Autoritetet suedeze ia kishin lëshuar kartelën që vërtetonte se i biri i parashtruesit të kërkesës është azil kërkues, përkatësisht kartën LMA-kort në emrin me të cilin kishte aplikuar, përkatësisht A.H. I biri i parashtruesit të kërkesës, vdiq në një institucion shëndetësorë në Suedi. Raporti mjekësor lidhur me vdekjen e tij u lëshua në emër të A.H. Pas vdekjes së tij, Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi lëshoi parashtrësën [nr.09/13] përmes të cilës (i) sqaroi se ka informuar autoritetet e Republikës së Kosovës për vdekjen e shtetasit I.F; (ii) konfirmoi se nuk ka asnjë pengesë për riatdhesimin e të ndjerit I.F. në Republikën e Kosovës; dhe (iii) kërkoi nga kompania përgjegjëse për shërbimet funerale në Linkoping për të mundësuar transportimin në Kosovë për të ndjerin I.F. I ndjeri u varros në Prishtinë më 16 qershor 2013.

Parashtruesi i kërkesës iu drejtua Komunës së Prishtinës, me kërkesë që i biri i tij i ndjerë I.F., të regjistrohet në RTHV bazuar në Ligjin nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjendjen Civile). Komuna e Prishtinës përmes Vendimit [Nr.01-203-194645] të 16 tetorit 2013 e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, me arsyetimin se dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përkojnë me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës, sepse të parat përkojnë me personin A.H., ndërsa të dytat me personin I.F. Parashtruesi i kërkesës e kontestoi Vendimin e lartcekur, pa sukses, në Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta të të tri instancave e vërtetuan: (i) Vendimin [Nr.01-203-

194645] të 16 tetorit 2013 të Komunës së Prishtinës; dhe (ii) refuzuan kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrim të birit të ndjerë I.F. në RTHV me arsyetimin se dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përkojnë me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar se Vendimet e autoriteteve publike, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Në rrethanat e rasti konkret, Gjykata vendosi të mbajë seancë dëgjimore në mënyrë që të sqarohen çështjet e faktit dhe të ligjit, dhe në të njëjtën, Komuna e Prishtinës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Punëve të Jashtme sqaruan se mungesa e raportit të mjekësorë në emër të I.F. e ka pamundësuar regjistrimin e I.F.-së në RTHV, ndërsa parashtruesi i kërkesës sqaroi se autoritetet publike nuk kanë marrë parasysh faktet dhe veçoritë e rastit të tij dhe për më tepër, si rezultat i mosregjistrimit të lartcekur, kanë mbetur me status të pazgjidhur civil edhe bashkëshortja dhe i biri i mitur i të ndjerit.

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa është e pranueshme, pasi konstatoi se parashtruesit të kërkesës duhet t'i pranohet statusi i viktimës indirekte apo të tërthortë, konstatim ky të cilin e arriti pasi shtjelloi dhe aplikoi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ).

Ndërsa, në shqyrtimin e meritave të rastit, Gjykata fillimisht sqaroi se rrethanat e rastit konkret e të cilat ndërlidhen me refuzimin e autoriteteve publike për të regjistruar të birin e vdekur të parashtruesit të kërkesës në RTHV, ngërthejnë çështje që ndërlidhen me të drejtën në jetë private të parashtruesit të kërkesës dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive, siç janë garantuar me nenet 36 [E Drejta e Privatësisë] e 54 të Kushtetutës dhe 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, respektivisht.

Përkitazi më çështjet që ndërlidhen me të drejtën në jetë private, Gjykata, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për aq sa është relevante për rrethanat e rastit, ndër tjerash, sqaroi (i) detyrimet e shtetit për mbrojtjen e jetës private siç është e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ; (ii) dallimin në mes detyrimeve negative dhe pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen e kësaj të drejte; (iii) faktin se në rrethanat e rastit konkret, shteti jo detyrimisht ka “ndërhyrë” në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, por ka dështuar të veprojë për të mbrojtur të njëjtat, duke rezultuar për pasojë në

vlerësimin e rrethanave të këtij rasti nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit; (iv) se detyrimet pozitive të shtetit, ndër tjerash, kërkojnë që autoritetet publike të shqyrtojnë veçoritë e një rasti dhe të ndërmarrin masa për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave për jetë private, ose përmes sigurimit të një kornize ligjore që mbron të drejtat e individëve ose përmes përcaktimit e zbatimit të masave të veçanta të përshtatshme për rrethanat e një rasti; dhe (v) se në raste të tilla, autoritetet publike, janë të detyruara të shqyrtojnë ekuilibrin apo balancën më mes interesave të individit, përfshirë natyrën e pretendimeve dhe nëse të njëjtat ndërlidhen me *“aspekte thelbësore”* të jetës private dhe detyrimeve të shtetit, përfshirë nëse të njëjtat ndërlidhen me detyrime *“të ngushta dhe të sakta”* apo *“të gjëra dhe të papërcaktueshme”* dhe barrën e mundshme që ato ia imponojnë shtetit.

Ndërsa përkitazi me çështjet që ndërlidhen me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive, Gjykata, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për aq sa është relevante për rrethanat e rastit, ndër tjerash, ka sqaruar (i) se këto të drejta nënkuptojnë ekzistencën e një mjeti juridik i cili shqyrton thelbin e përmbajtjes së kontestit, përkatësisht pretendimeve të një parashtruesi dhe mundëson korrigjimin e duhur; (ii) nocionin e pretendimit *“të argumentueshëm”* për qëllime të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së; dhe (iii) faktin se në kontekst të pretendimeve për mbrojtje të të drejtës private, mjeti juridik duhet të mundësojë shqyrtimin e thelbit të pretendimeve përkatëse dhe vlerësimin e ekuilibrit në mes interesave konkurruese. Në të dyja rastet, është i rëndësishëm qëllimi i Kushtetutës dhe i KEDNJ-së, që të garantojnë të drejta *“praktike dhe efektive”* dhe jo *“teorike ose iluzore”*.

Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret, përkitazi me nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata ka theksuar se autoritetet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, përtej konstatimit se përkitazi me vdekjen e të birit të parashtruesit të kërkesës mungon raporti mjekësor që e konfirmon vdekjen e tij, konstatim ky që ka rezultuar në refuzimin e regjistrimit të birit të parashtruesit të kërkesës në RTHV, me pasojën serioze të lënies së pazgjidhur përfundimisht të statusit civil të bashkëshortes dhe të birit të mitur të të ndjerit, nuk kanë marrë parasysh faktin se (i) nuk është kontestuese se i biri i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur; dhe (ii) një fakt të tillë e kishin konfirmuar edhe vet autoritetet publike të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ambasada e Kosovës në Suedi, ku kishte ndodhur vdekja. Për më tepër, autoritetet publike, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e vdekjes së të birit të tij në RTHV, përkundër faktit që e njëjta vdekje nuk ishte kontestuese, (i) jo vetëm që kishin aplikuar në mënyrë skajshmërisht formale ligjin e aplikueshëm, duke mos konsideruar kështu, as mundësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me shtetin Suedez dhe as mundësitë e dhëna përmes dispozitave të procedurës jokontestimore, por (ii) në

kundërshtim me kërkesat kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, nuk kishin shqyrtuar ekuilibrin apo balancën në mes interesave konkurruese, përkatësisht thelbit dhe veçorive të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe detyrimeve të shtetit për mbrojtjen e të drejtës në jetë private.

Gjykata ka sqaruar se shqyrtimi i një ekuilibri të tillë, do të rezultonte në konstatimin se pretendimet dhe kërkesa e parashtruesit të kërkesës është “*e ngushtë dhe e qartë*” dhe nuk rezulton në detyrime joproporcionale për shtetin. Për më tepër që, përmes një refuzimi të tillë në mungesë të një raporti mjekësor, duke mos marrë parasysh asnjë nga rrethanat dhe veçoritë që ngërthen rasti konkret, vendimet e autoriteteve publike, kishin rezultuar në të drejta kushtetuese vetëm “*teorike dhe iluzore*” për parashtruesin e kërkesës dhe jo të drejta kushtetuese “*praktike dhe efektive*”, siç kërkohet me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për pasojë, Gjykata konstatoi se procedurat e ndjekura të sistemit administrativ e gjyqësor në kundërshtim me detyrimet pozitive të shtetit, nuk kanë rezultuar në realizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

Ndërsa, përkritazi me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, Gjykata theksoi se marrë parasysh konstatimin e mësipërm, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, janë qartësisht “*të argumentueshme*”, siç është përcaktuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së. Më tej, Gjykata theksoi se në kundërshtim me kërkesat e neneve të lartcekura dhe praktikën relevante gjyqësore, mjetet juridike, në rrethanat e rastit konkret, nuk kishin rezultuar as në shqyrtimin e thelbit të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe as nuk kishin mundur korrigjimin e duhur. Gjykata ritheksoi se shqyrtimi i kufizuar dhe skajshmërisht formal i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në izolim prej veçorive të rastit dhe pasojave përkatëse, kishte rezultuar dhe në mungesë të mbrojtjes praktike dhe efektive të të drejtave gjyqësore dhe të asaj për zgjidhje efektive të parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe Vendimet e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Komunës së Prishtinës, nuk janë në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht të njëjtat duhet të shpallen të pavlefshme. Gjykata gjithashtu përmes këtij Aktgjykimi e urdhëroi Agjencinë e Regjistrimit Civil, që deri më 30 tetor 2020, ta regjistrojë vdekjen e I.F., përkatësisht të birit të parashtruesit të kërkesës, në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI56/18

Parashtrues

Ahmet Frangu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr.67/2017, të 22 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ahmet Frangu nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.67/2017] të 22 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.333/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr. 1185/2014] e 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 prill 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 7 maj 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 14 maj 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që t'i dorëzojë të gjitha shkresat e lëndës.

10. Më 15 maj 2018, Gjykata Themelore dorëzoi të gjitha shkresat e lëndës në Gjykatë.
11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
13. Më 20 nëntor 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH.56/18, për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.
14. Më 21 janar 2020, pasi bazuar në paragrafin 2 të nenit 42 (E drejta në dëgjim dhe heqja dorë) të Rregullores së punës, Gjykata kishte vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret kishte konsideruar se është i nevojshëm qartësimi i çështjeve që ndërlidhen me provat dhe ligjin e aplikueshëm, ajo iu dërgoi ftesat për pjesëmarrje në seancën publike dëgjimore, parashtruesit të kërkesës, Agjencisë së Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: Agjencia e Regjistrimit Civil), Drejtoratit të Administratës të Sektorit të Gjendjes Civile të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Komuna e Prishtinës) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Punëve të Jashtme).
15. Më 29 janar 2020 dhe 3 e 7 shkurt 2020, respektivisht, parashtruesi i kërkesës, Agjencia e Regjistrimit Civil, Komuna e Prishtinës dhe Ministria e Punëve të Jashtme e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, konfirmuan pjesëmarrjen në seancën publike të lartcekur dëgjimore.
16. Më 10 shkurt 2020, u mbajt seanca dëgjimore publike. Parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesit e Agjencisë së Regjistrimit Civil, Komunës së Prishtinës dhe Avokaturës Shtetërore, ishin të pranishëm në seancë.
17. Më 14 shkurt 2020, Gjykata kërkoi nga Komuna e Prishtinës dhe Avokatura Shtetërore që të dorëzojnë dokumentacion shtesë për sqarimin të disa aspekteve faktike lidhur me rastin nr. KI56/18.

18. Më 19 dhe 21 shkurt 2020, Komuna e Prishtinës dhe Avokatura Shtetërore, respektivisht, dorëzuan sqarimet e kërkuara në Gjykatë.
19. Më 22 prill 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës, ndërsa u përcaktua që vendimi përkitazi me meritat e rastit do të merrej në seancat e radhës.
20. Më 22 korrik 2020, Gjykata votoi me shumicë votash se Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr.67/2017] i 22 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.333/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit; Aktgjykimin [A.nr.1185/2014] e 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore; Vendimin [nr. 30/2014] e 24 qershorit 2014 të Agjencisë së Regjistrimit Civil; Vendimin [nr.86/013] e 18 nëntorit 2013 të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Vendimin [nr.01-203-194645] e 16 tetorit 2013 të Komunës së Prishtinës, nuk janë në përputhshmëri me (i) nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta në jetë private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ); dhe (ii) nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

Përmbledhje e fakteve

21. Më 30 prill 2013, i biri i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht i ndjeri I.F. udhëtoi drejt Suedisë për qëllime të shërimit nga një sëmundje e rëndë. Bazuar në sqarimet e dhëna nga parashtruesi i kërkesës në seancën publike dëgjimore, i ndjeri I.F., në Suedi udhëtoi me pasaportën e tij. Bazuar në shkresat e lëndës, viza e tij schengen ishte e vlefshme prej 17 dhjetorit 2012 deri më 17 qershor 2013.
22. Në një datë të paspecifikuar, dhe gjatë qëndrimit të tij në Suedi, i ndjeri kishte aplikuar për azil, por duke e përdorur një emër tjetër, përkatësisht emrin A.H. Tashmë të ndjerit, autoritetet Suedeze ia kishin lëshuar dokumentin që vërtetonte se është azil kërkuar, përkatësisht kartën LMA-kort në emrin me të cilin kishte aplikuar, përkatësisht A.H. Arsyet mbi bazën e të cilave, i ndjeri nuk ka aplikuar për azil në Suedi në emrin e tij personal, por në atë të A.H., mbeten të paqarta edhe pas seancës dëgjimore publike. Në këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon se i biri tij *“ka imagjinuar një emër A.H. Por në realitet A.H është I.F.”*
23. Më 7 qershor 2013, I.F. vdiq në një institucion shëndetësorë në Suedi. Raporti mjekësorë lidhur me vdekjen e tij u lëshua në emër të A.H.

24. Më 8 qershor 2013, Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi lëshoi parashtrësën [nr.09/13] përmes të cilës (i) sqaroi se autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës janë informuar në lidhje me vdekjen e tij; (ii) konfirmoi se nuk ka asnjë pengesë për riatdhesimin e të ndjerit I.F. në Republikën e Kosovës; dhe (iii) i kërkon kompanisë përgjegjëse për shërbimet funerale në Linkoping për të mundësuar transportimin në Kosovë për të ndjerin I.F.
25. Më 16 qershor 2013, kufoma e të ndjerit arriti në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës dhe u transportua në Prishtinë përmes N.SH.T “Dardania”. Ceremonia e varrimit u mbajt në të njëjtën ditë.
26. Më 10 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Komunës së Prishtinës, me kërkesë që i biri i tij i ndjerë, përkatësisht I.F., të regjistrohet në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve (në tekstin e mëtejme: RTHV) bazuar në Ligjin nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjendjen Civile).
27. Më 16 tetor 2013, Komuna e Prishtinës përmes Vendimit [Nr.01-203-194645] e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar, ndër të tjera, se (i) kërkesa nuk është e kompletuar në përputhje me dispozitat ligjore për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes në regjistrin themeltar; dhe (ii) shkresat e lëndës, përkatësisht, të dhënat personale të I.F., certifikata e lindjes, letërnjoftimi dhe certifikata e martesës të Republikës së Kosovës nuk përputhen me të dhënat e lëshuara nga autoritetet e vendit ku ka ndodhur vdekja, përkatësisht në Suedi. Ky Vendim, në arsyetimin e tij, specifikisht kishte theksuar se në dokumentacionin e vdekjes të lëshuar nga institucioni shëndetësorë në Suedi figuron emri i të vdekurit A.H., i lindur më 19 shtator 1979, ndërsa në dokumentet e lëshuara nga Republika e Kosovës, figuron emri I.F., i lindur më 2 shtator 1978.
28. Në një datë të paspecifikuar, kundër Vendimit të lartpërmendur të Komunës së Prishtinës, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Agjencinë e Regjistrimit Civil.
29. Më 18 nëntor 2013, Agjencia e Regjistrimit Civil përmes Vendimit [nr.86/013] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit të Komunës së Prishtinës. Agjencia e Regjistrimit Civil, ndër të tjera kishte arsyetuar se (i) dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përkojnë me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës, sepse të parat përkojnë me personin A.H., ndërsa të dytat me personin I.F.; dhe (ii) pala, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, nuk kishte dëshmuar pretendimin e tij se A.H. është në fakt I.F.

30. Më 12 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi kundër Vendimit të lartpërmendur të Agjencisë së Regjistrimit Civil në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që të lejohet regjistrimi i I.F. në RTHV dhe të anulohet Vendimi i kontestuar i Agjencisë së Regjistrimit Civil. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se si pasojë e mos regjistrimit të të birit, I.F. në RTHV, statusi civil i bashkëshortes dhe të birit të këtij të fundit, kishte ngelur i pazgjidhur. Agjencia e Regjistrimit Civil, në cilësinë e të paditurës, më 21 mars 2014, parashtroi përgjigje në padi, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.
31. Më 16 maj 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [Nr. 1652/13] miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Vendimin e 18 nëntorit 2013 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, duke e kthyer çështjen në rivendosje. Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se Vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurë Administrative (në tekstin e mëtejme: LPA) dhe specifikisht neneve 84 dhe 85 të tij. Gjykata Themelore, për më tepër, theksoi se Agjencia e Regjistrimit Civil kishte dështuar të vërtetojë të gjitha dëshmitë, duke përfshirë parashtruesin [nr.09/13] e 8 qershorit 2013 të lëshuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi. Në kontekst të kësaj parashtrëse, Gjykata Themelore, specifikisht kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata vëren se çështja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në organin e shkallës së parë, të njëjtën gjë e ka bërë edhe organi i shkallës së dytë cili vendimin e shkallës së parë e ka lënë ne fuqi me vendimin e kundërshtuar me padi, për faktin se nuk është marrë për bazë fare parashtrëse nr.09/13 e dt. 08.06.2013, e lëshuar nga Ambasada në Stokholm-Seksioni konsullor, e cila vërteton se Ambasada e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë, vërteton se i ndjeri IF i lindur me datë 02.09.1978 në Prishtinë, Kosovë, me numër personal 1001193615 me numër pasaporte K00488071 ishte shtetas i Republikës së Kosovës, si dhe me anë të kësaj parashtrëse i ka kërkuar kompanisë përgjegjëse për shërbime funerale në Linkoping, për të mundësuar transportimin e kufomës së IF në Kosovë. Ku me të njëjtën parashtrëse theksojnë se janë informuar edhe autoritetet e Republikës së Kosovës në lidhje me vdekjen e IF dhe Ambasada e Kosovës konfirmon se nuk ka asnjë pengesë për riatdhesimin e tij në Republikën e Kosovës (theks i shtuar).”

32. Më 24 qershor 2014, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Departamentin për Regjistrime dhe Gjendje Civile të Agjencisë së Regjistrimit Civil, përmes Vendimit [nr.30/2014], kishte refuzuar

sërish kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e I.F. në RTHV, duke e vërtetuar Vendimin [Nr. 01-203-194645] e 16 tetorit 2013 të Komunës së Prishtinës. Përmes Vendimit të saj, Agjencia e Regjistrimit Civil, ndër të tjera, arsyetoi se regjistrimi i I.F. në RTHV do të ishte në kundërshtim me nenin 15 (Kriteret për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve në regjistrin e të vdekurve) të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Regjistrimet e Mëvonshme në Regjistrat e Gjendjes Civile (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ), sepse dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përputhen me dokumentet e lëshuara në Republikën e Kosovës. Agjencia për Regjistrimin Civil gjithashtu shtoi se *“dokumentacioni nga shteti Suedeze është në emër të A.H., ndërsa dokumentacioni i Kosovës është për I.F.”* dhe se pala, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, nuk *“ka sjellë dëshmi për ta argumentuar pretendimin e tij se djali i tij I.F. është i njëjti me A.H.”*, për më tepër që, Komisioni duke iu referuar Udhëzimit Administrativ 05/2012 për Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ për Komisionin e Ankesave), theksoi se i njëjti *“ka kompetencë që të merr vendime në bazë të fakteve (provave) dhe dëshmive të cilat parashtruesi i ankesës i paraqet para Komisionit”*.

33. Më 15 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës sërisht ushtroi padi për konflikt administrativ kundër Vendimit e lartpërmendur të Agjencisë së Regjistrimit Civil në Gjykatën Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kërkoj që të anulohet Vendimi përkatës dhe që I.F. të regjistrohet në regjistrin e vdekjes, përkatësisht në RTHV. Parashtruesi i kërkesës specifikisht theksoi se Vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me (i) nenet 46 (Akti i Vdekjes), 47 (Deklarimi i Vdekjes), 48 (Vërtetimi i Faktit Juridik të Vdekjes), 49 (Vërtetimi i Vdekjes) dhe 50 (Leja e Varrimit) të Ligjit për Gjendjen Civile; (ii) me Aktgjykimin [A.nr.1652/13] e 16 majit 2014 të Gjykatës Themelore; dhe (iii) me pikën 7 të nenit 7 [Procedurat e punës së komisionit] të Udhëzimit Administrativ për Komisionin e Ankesave, sepse nuk janë shqyrtuar provat dhe dëshmitë përkatëse. Parashtruesi i kërkesës theksoi se çdo paqartësi përkitazi me personin A.H., është sqaruar përmes parashtrësës [nr.09/2013] të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Suedi.
34. Më 10 shtator 2014, 7 shtator 2015, 29 shkurt 2016, dhe 26 tetor 2016, respektivisht, përmes përfaqësuesit të tij, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore me kërkesën për zgjidhjen me prioritet të çështjes së tij, duke theksuar se (i) Gjykata Themelore përmes

Aktgjykimit [Nr. 1652/13] të 16 majit 2014 ka miratuar kërkesëpadinë e tij, por nuk e ka detyruar Agjencinë e Regjistrimit Civil që të bëjë regjistrimin e të ndjerit I.F. në RTHV; dhe (ii) zgjidhja e çështjes së tij ndikon drejtpërdrejtë në rregullimin e çështjeve statusore të familjes së të ndjerit I.F., përkatësisht bashkëshortes dhe të birit të tij.

35. Në një datë të paspecifikuar, Ministria e Drejtësisë përmes Avokaturës Shtetërore paraqiti përgjigje në padi, përmes të cilës theksoi se nuk mund të bëhet regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes në RTHV sepse në rrethanat e rastit, dokumentacioni i lëshuar nga shteti suedez nuk përkon me dokumentacionin e Republikës së Kosovës, dhe nuk ka dëshmi që personi A.H. është në fakt I.F.
36. Më 5 qershor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A.nr.1185/2014] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulim të Vendimit të lartpërmendur të Agjencisë së Regjistrimit Civil. Në vlerësimin e kërkesës së paditësit, Gjykata Themelore u bazua në nenin 15 të Udhëzimit Administrativ për kriteret për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve në RTHV. Gjykata ndër të tjera theksoi se regjistrimi i personit I.F. në RTHV është në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ sepse dokumentacioni i lëshuar nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përkon me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se në fakt personi A.H. është I.F. dhe rrjedhimisht bëhet fjalë për të njëjtin person, Gjykata theksoi si në vijim:

“Gjykata nga provat të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit kryesor, gjen se qëndron arsyetimi i paditurisë si në aktin e kontestuar se pasi janë administruar provat nga i padituri është konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar për faktin se dokumentacionet që janë bashkangjitur kërkesës për regjistrimin e vdekjes për I.F. në LTHV nuk përputhen me dokumentacionet e lëshuara nga R. e Kosovës. Krejt kjo për faktin se dokumentet mbi bazën e të cilave kërkohet të regjistrohet vdekja e që janë të lëshuara nga autoritet suedeze pas administrimit të provave si më lart konstatohet se që të gjitha janë në emër të A.H. përderisa regjistrimi i vdekjes kërkohet të bëhet për I.F. Kjo gjykatë ka vlerësuar dhe pretendimet e paditësit se fjala është për të njëjtin person dhe pasi i ndjeri I.F. ka jetuar në Suedi dhe vdekja ka ndodhur atje por si të tilla këto pretendime nuk munda ti aprovoj si të bazuara për regjistrimin e vdekjes në LTHV pasi konstatoi se të tilla janë në kundërshtim me nenin 15 të UA 02/2012 të MPB i cili qartë përcakton kriteret që duhet të plotësohen nga kërkuesi.”

37. Më 10 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që kërkesëpadia e tij të miratohet ose që Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës në këtë ankesë gjithashtu nënvizoi rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së tij dhe efektin që e njëjta ka në statusin civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit I.F.

38. Më 20 tetor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.333/2017], refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se (i) regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes në RTHV të personit I.F. nuk i përmbush kriteret e nenit 15 të Udhëzimit Administrativ; (ii) dokumentacioni i lëshuar nga institucionet shëndetësore në Suedi nuk përputhet me dokumentacionin e lëshuar nga Republika e Kosovës; dhe (iii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, *“nuk ka sjell dëshmi bindëse për të argumentuar pretendimet e tij se djali i tij I.F. është i të njëjtit emër me atë të A.H.”*.

39. Më 20 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti (i) revizion; dhe (ii) kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të anulohen vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

40. Më 22 dhjetor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr. 67/2017] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe rrjedhimisht vërtetoi Aktgjykimin [AA.nr.333/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [A.nr. 1185/2014] e 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore.

41. Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se regjistrimi i vdekjes së personit I.F., në RTHV është në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ sepse dokumentacioni i lëshuar nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përputhet me dokumentacionin e lëshuar nga Republika e Kosovës. Të parat janë në emër të personit A.H., ndërsa të dytat në emër të personit I.F. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton si në vijim:

“Kjo Gjykatë gjatë vlerësimit konstaton se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vërtetuar se dokumentacioni që është bashkangjitur kërkesës për regjistrimin e vdekjes së IF në LTHV nuk përputhet me dokumentacionin e lëshuar nga R. e Kosovës. Krejt kjo për faktin se dokumentet mbi bazën e të cilave kërkohet të regjistrohet vdekja e që janë të lëshuara nga autoritetet suedeze, janë konstatuar që të gjitha janë në emër të AH, për deri sa regjistrimi i vdekjes kërkohet të bëhet në emër të IF. Kjo Gjykatë ka vlerësuar dhe pretendimet e paditësit se fjala është për të njëjtin person pasi i ndjeri IF ka jetuar në Suedi dhe vdekja ka ndodhur atje, por si të tilla këto pretendime nuk mund të aprovohen si të bazuara për të regjistruar vdekjen në LTHV, pasi që janë në kundërshtim me nenin 15 të UA 02/2012 i cili qartë përcakton kriteret që duhen të plotësohen nga kërkuesi.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes KEDNJ-së.
43. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës i referohet dëshmimeve që vërtetojnë vdekjen e të birit të tij dhe pretendon se të njëjtat nuk janë marrë parasysh nga gjykatat e rregullta, dhe të cilat, përtej refuzimit të regjistrimit të vdekjes së të birit të tij në RTHV, gjithashtu kanë afektuar statusin civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit I.F.
44. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij të shpallet e pranueshme dhe të shpallen të pavlefshme Aktgjykimet e gjykatave të rregullta, duke e kthyer çështjen në rivendosje ose të urdhërohet Agjencia e Regjistrimit Civil që ta regjistrojë vdekjen e birit të tij I.F. në RTHV, *“në mënyrë që bashkëshortes dhe birit të këtij të fundit t’iu rregullohet statusi civil”*.

Sqarimet e dhëna nga parashtruesi i kërkesës dhe palët tjera pjesëmarrëse në seancën dëgjimore publike

45. Në seancën dëgjimore publike të 10 shkurtit 2020, parashtruesi i kërkesës sqaroi se (i) emri i A.H. ishte imagjinuar nga I.F. për qëllime të azil-kërkimit në Suedi, dhe se nuk i din arsytet që e kanë shtyrë të

birin e tij të regjistrohet me identitet tjetër në Suedi; (ii) raporti mjekësor *“është lëshua prej Suedie në emër të A.H”*; (iii) përkitazi me lejen e varrimit, theksoi se *“E kam faturën do t’ju bashkëngjis, krejt i kom këtu, e kom edhe të fesë islame që kam shkua, dërrasat, hoxhën që e kam pagua, janë këto krejt, edhe pastrimi i kufomës, edhe Kompania faturën që e ka transportua, kurrëgjë këtu nuk ka vetëm është problem që ai ka ra me atë emër”*; (iv) përkitazi me statusi civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit, parashtruesi i kërkesës theksoi se në regjistrin civil i biri i tij figuron i gjallë dhe për pasojë *“djali i tij është në shkollë Joni në klasën e V, është i regjistruar në një ekip për të rinjtë në futboll, po dojna me e qitë përjashta, e spo mundet pasaportën me e nxjerr e as dokument tjetër nuk mundet me nxjerr. E tash pa kanë dy prindërit nuk mundet me dal, nuk po i lëshojnë ato dokumente, edhe shoqja e vet, bashkëshortja nuk mundet me realizua asnjë të drejtë të statusit civil, trashëgimia e punët tjera”*; (v) theksoi faktin se Aktgjykimi [A.nr. 1652/13] i Gjykatës Themelore në vitin 2014 kishte miratuar kërkesëpadinë e tij duke e kthyer çështjen në rivendosje në Agjencinë e Regjistrimit Civil, mirëpo *“në diapozitivin e këtij aktgjykimi, nuk detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme që ta bëjë regjistrimin në librin amzë të vdekjes”*; dhe (vi) theksoi rëndësinë e parashtrësës [nr.09/13] të 8 qershorit 2013 të lëshuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi përmes të cilës *“u njoftuan autoritetet kosovare, se ka vdekë shtetasi i Kosovës z. I.F.”*

46. Komuna e Prishtinës dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, në esencë, ndër të tjera, theksuan se (i) vendimet respektive të tyre janë të bazuara në ligjin e aplikueshëm, si pasojë e të cilit nuk mund të regjistrohet një vdekje në RTHV, në mungesë të një raporti mjekësorë, ndërsa në rrethanat e rastit konkret, *“dokumentacioni i Republikës së Kosovës nuk përkon me dokumentacionin e lëshuar nga shteti i Suedisë”* dhe se *“dokumentacioni i vdekjes, i lëshuar nga institucioni, ku ka ndodhur vdekja, i cili nuk është certifikate e vdekjes, respektivisht të dhënat personale të cilat figurojnë në ato, nuk përputhen me të dhënat personale të cilat figurojnë në certifikatën e lindjes, martesës dhe ID së Republikës së Kosovës”*, dhe se rrjedhimisht, rrethanat e rastit ngërthejnë *“dy identitete dhe me të dhëna kontradiktore”*; dhe (ii) përkundër faktit që Aktgjykimi [A.nr.1652/13] i Gjykatës Themelore kishte miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke e kthyer çështjen në rivendosje në Agjencinë e Regjistrimit Civil, në *“dispozitivin e këtij aktgjykimi, nuk detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme që ta bëjë regjistrimin në librin amzë të vdekjes”*. Pas këtij vendimi dhe refuzimit të sërishëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil për të regjistruar të ndjerin në RTHV, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, e kanë vërtetuar qëndrimin e Komunës së Prishtinës dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil, përmes Aktgjykimeve [A.nr.1185/2014]

të 5 qershorit 2017 dhe [AA. nr. 333/2017] të 20 tetorit 2017, respektivisht. Të njëjtat më pas u vërtetuan nga Gjykata Supreme.

47. Gjatë seancës dëgjimore publike gjithashtu, ndër të tjera, u sqaruan çështjet që ndërlidhen me (i) lejen e varrimit; (ii) certifikatën ndërkombëtare të vdekjes; (iii) statusin civil të A.H.; dhe (iv) bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë.
48. Përkitazi me çështjen e parë, përfaqësuesja e Komunës së Prishtinës theksoi se *“Në shkresat e lëndës nuk ekziston një leje nga Komuna e Prishtinës, e vetmja donë me thënë dëshmi për varrimin janë faturat e bashkësisë islame të cilat pala i ka marrë për varrimin e të ndjerit dhe Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë leje që i ka dhënë këtij për varrim”*. Në kërkesën e Gjykatës drejtuar Komunës së Prishtinës më 14 shkurt 2020 lidhur me sqarimet e nevojshme përkitazi me lejen e varrimit të të ndjerit, Komuna përmes përgjegjës së saj të 19 shkurtit 2020, sqaroi edhe një herë se ajo *“nuk mund të sigurojë asnjë dokument lidhur me vdekjen/varrimin e I.F., pasi që në sistemin e gjendjes civile ky person figuron si i gjallë”*.
49. Përkitazi me çështjen e dytë, u sqarua nga Avokatura Shtetërore se në rrethanat e rastit, përkundër parashtresës së Ambasadës së Kosovës në Suedi, nuk ekziston certifikata ndërkombëtare e vdekjes. Ndërsa përkitazi me çështjen e tretë, Komuna e Prishtinës edhe Avokatura Shtetërore, lidhur me statusin e A.H. sqaruan se (i) *“asnjëherë nuk është kërkuar vërtetimi i identitetit të A.H.”*; dhe (ii) se i njëjti nuk është regjistruar si i vdekur, sepse *“këtu kemi të bëjmë me dy identitete dhe me një kërkesë e cila është paraqitur për regjistrim edhe ka pas donë me thënë diskrepancë në mes këtyre dyve, dy identiteteve dhe për atë arsye nuk është regjistrua, nuk kam informata nëse është regjistrua”*. Ndërsa, në fund dhe përkitazi me çështjen e katërt, Agjencia e Regjistrimit Civil, por edhe Avokatura Shtetërore, vënë theks në rolin e shtetit Suedez duke theksuar, ndër të tjera, se përmes komunikimit me këtë shtet do të mund të kërkohej korrigjimi i raporti mjekësorë, mbi bazën e të cilit korrigjim, pastaj do të mund të bëhej regjistrimi në RTHV. Sipas tyre (i) përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, do të mund të shkëmbeheshin të dhënat biometrike të personit, edhe përmes krahasimit të dhënave biometrike dhe gjurmëve të gishtërinjve, do të mund të identifikohesh saktë se personi nuk është A.H. por është I.F., duke rezultuar kështu në përmbylljen e këtij rasti; por (ii) gjithashtu konfirmuan se gjykatat e rregullta asnjëherë nuk kanë iniciuar ndonjë procedurë përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtarë juridik.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
51. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës; rregullin 39 dhe rregullin 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës, do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar; (ii) kontestohet një akt i autoritetit publik; (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; (iv) janë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendohet se janë shkelur; (v) janë respektuar afatet kohore; (vi) kërkesa është qartazi e pabazuar; dhe (vii) ka ndonjë kriter shtesë të pranueshmërisë, sipas paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që nuk është plotësuar.

(i) *Lidhur me palën e autorizuar dhe aktin e autoritetit publik*

52. Gjykata në këtë aspekt fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë, si në vijim:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

53. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. [...].”

54. Gjykata po ashtu i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

55. Gjykata i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 të Rregullores së punës i cili, ndër të tjera, përcakton: “(2) *Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet*”.
56. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret duhet të përcaktohen dy çështje (i) nëse kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar; dhe (ii) nëse kontestohet një akt i autoritetit publik. Çështja e dytë, përkatësisht akti i autoritetit publik, nuk është kontestuese në rrethanat e rastit konkret sepse parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.UZVP. nr. 67/2017] e 22 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme. Ndërsa, çështja e parë, ajo që ndërlidhet me palën e autorizuar, bazuar në dispozitat e lartcituara të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, duhet të vlerësohet në kuptim të “*statusit të viktimës*” të parashtruesit të kërkesës.
57. Më specifikisht, bazuar në dispozitat e cituara më lart, një parashtrues për t’u kualifikuar si palë e autorizuar para Gjykatës duhet të ngrejë shkelje të pretenduara “*të të drejtave dhe lirive të tij/saj individuale*”, përkatësisht të ketë statusin e viktimës. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Gjykatës në lidhje me regjistrimin e vdekjes së të birit të tij në RTHV. Në këtë kontekst dhe para konstatimit nëse parashtruesi i kërkesës mund të cilësohet si palë e autorizuar para Gjykatës, kjo e fundit duhet të përcaktojë nëse në rrethanat e rastit konkret, mund të parashtrojë kërkesë individuale babai për të birin e tij, përkatësisht nëse mund t’i pranohet statusi i “*viktimës*” i parashtruesit të kërkesës. Për të përcaktuar nëse ky i fundit mund të ketë këtë status para Gjykatës, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet themelore të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) përkritazi me statusin e viktimës, për të i aplikuar ato, më pas, në rrethanat e rastit konkret.
58. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nocioni i “*viktimës*” interpretohet në mënyrë autonome dhe pavarësisht nga dispozitat vendore siç janë interesi dhe zotësia juridike për të paraqitur padi (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 27 prillit 2004, paragrafi 35), edhe pse, gjykatat përkatëse duhet të marrin

parasysh faktin nëse parashtruesi përkatës ka qenë palë në procedurë para gjykatave të rregullta (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Aksu kundër Turqisë*, Aktgjykim i 15 marsit 2012, paragrafi 52; dhe *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48). GJEDNJ gjithashtu thekson se interpretimi i konceptit “viktimë” duhet të bëhet pa formalizëm të tepruar (shih, në këtë kontekst, dhe ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 38) dhe që në këtë vlerësim, ndërlidhshmëria me meritat e rastit mund të jetë e rëndësishme (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Siliadin kundër Francës*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 63; dhe *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2012, paragrafi 111).

59. Për më tepër, dhe relevante për rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, termi “viktimë”, në kontekst të kërkesave individuale, nënkupton personat që janë afektuar në mënyrë direkte ose indirekte nga shkelja e pretenduar. Prandaj, termi “viktimë” nënkupton jo vetëm viktimën direkte të shkeljes së pretenduar, por edhe viktimat indirekte të cilave shkelja mund t’iu shkaktojë dëm ose të cilat do të kishin interes personal dhe të vlefshëm në ndaljen e shkeljes së pretenduar. (Shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykim i 7 nëntorit 2013, paragrafi 47). Më saktësisht, Gjykata thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, njeh rrjedhimisht statusin e viktimës direkte, indirekte apo të tërthortë dhe potenciale. (Për më tepër përkitazi me këto tri kategori, shih Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019; 3. Statusi i Viktimës). Përderisa, viktimat direkte janë të gjithë ata të drejtat e të cilëve janë cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes shkeljes së pretenduar, dhe rrjedhimisht pranimi i statusit të viktimës të tyre para Gjykatës nuk është çështje kontestuese, situata qëndron ndryshe në rast të viktimave indirekte/të tërthorta apo potenciale, sepse pranimi i statusit të viktimës së tyre para Gjykatës është i kushtëzuar në plotësimin e disa kriterëve, dhe të cilat janë të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
60. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, statusi i viktimës indirekte apo të tërthortë i është njohur vetëm personave të afërm e të cilët kanë interes ligjor për të paraqitur një kërkesë individuale, në rast të vdekjes ose zhdukjes të personave në emër të të cilëve veprojnë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 18 shtatorit 2009, paragrafi 112).

61. Megjithatë, dhe për më tepër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e ka ndërlidhur pranimin e statusit të viktimës indirekte apo të tërthortë me natyrën e shkeljes së pretenduar dhe rëndësinë e zbatimit efektiv të njërës nga të drejtat më themelore të sistemit të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Fairfield kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 8 marsit 2005). Më specifikisht, GJEDNJ ka përcaktuar, se të “*transferueshme*” janë vetëm të drejtat më thelbësore të garantuara përmes KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht ajo përmes praktikës së saj gjyqësore, ka pranuar statusin e viktimës familjarëve vetëm atëherë kur kanë pretenduar shkelje të (i) nenit 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së, përkatësisht kur vdekja është pretenduar të përfshijë përgjegjësinë e shtetit (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2012, paragrafi 86; dhe *Tsalikidis dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2017, paragrafi 64); (ii) nenit 3 (Ndalimi i torturës) e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, me kushtin që shkelja e pretenduar të jetë ngushtësisht e ndërlidhur me nenin 2 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Khayrullina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2017, paragrafët 91-92 dhe 100-107); dhe (iii) nenit 8 (E drejta për Jetë Private), nëse është dëshmuar interesi moral i familjes që viktimë e ndjerë të shkarkohej nga çdo konstatim apo asocim me fajësinë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 25 gushtit 1987, paragrafi 33 dhe *Grădinar kundër Moldavisë*, Aktgjykim i 8 prillit 2008, paragrafët 95 dhe 97-98) apo nevoja për mbrojtjen e reputacionit të tyre dhe të familjes së tyre (shih rastet e GJEDNJ-së, *Brudnicka dhe të tjerët kundër Polonisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2005, paragrafët 27-31; *Armonienë kundër Lituanisë*, Aktgjykim i 25 nëntorit 2008, paragrafi 29; dhe *Polanco Torres dhe Movilla Polanco kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 shtatorit 2010, paragrafët 31-33).
62. Në të kundërtën, në raste kur shkelja e pretenduar e KEDNJ-së nuk ka qenë ngushtësisht e ndërlidhur me vdekjen ose zhdukjen e viktimës direkte, GJEDNJ ka zbatuar një qasje shumë më të kufizuar në njohjen e statusit të viktimës indirekte apo të tërthortë. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Karpylenko kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 11 shkurtit 2016, paragrafi 104). Për shembull, përkundër parashtrimin të kërkesave në emër të një të vdekuri, GJEDNJ ka theksuar se të drejtat e garantuara përmes nenit 6 të KEDNJ-së, në parim, janë të drejta të “*patransferueshme*”. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Bic dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2006, paragrafët 17-24). Gjykata njëjtë ka konstatuar dhe rrjedhimisht ka refuzuar pranimin e statusit të viktimës të njërit nga parashtruesit në rastet e bashkuara nr. KI149/18, KI150/18, KI151/18, KI152/18, KI153/18 dhe KI154/18, me parashtrues *Xhavit Aliu dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për

Papranueshmëri i 9 gushtit 2019 - përkitazi me vlerësimin e statusit të viktimës, shih paragrafët 62 deri më 75 e këtij rasti). Megjithatë, GJEDNJ përjashtimisht ka njohur statusin e viktimës edhe parashtruesve të cilët kanë pretenduar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, nëse kanë arritur të demonstrojnë një efekt direkt në të drejtat e tyre. (Shih, në këtë kontekst, mes të tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 33).

63. Rrjedhimisht dhe në parim, përtej pranimi të statusit të viktimës në raste kur kërkesat parashtrohen nga familjarë të një të vdekuri, vdekja e të cilit mund t'i atribuohet shtetit në kundërshtim me nenin 2 të KEDNJ-së, pranimi i statusit të viktimës familjarëve të caktuar bëhet vetëm përjashtimisht, dhe vetëm nëse mund të vërtetohet një interes ligjor dhe që ndërlidhet drejtpërdrejt me të drejtën e cenuar; vërtetohet një interes i rëndësishëm moral; apo është arritur të demonstrohet një efekt direkt në të drejtat e parashtruesve përkatës.
64. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret është babai i të ndjerit I.F., i cili parashtron kërkesë në Gjykatë. Vdekja e të ndjerit I.F. është vdekje natyrale dhe nuk ndërlidhet me përgjegjësinë e shtetit. Procedurat gjyqësore në fakt kanë filluar dhe janë udhëhequr nga parashtruesi i kërkesës vetëm pas vdekjes së të birit të tij dhe ndërlidhen me regjistrimin e vdekjes së tij në RTHV, regjistrim ky i cili është refuzuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil si dhe të gjitha gjykatat e rregullta. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës përtej pretendimit për cenimin e të drejtave të tij, pretendon se janë cenuar edhe ato të nipit të tij dhe të bashkëshortes së birit të tij, përkatësisht të ndjerit I.F.
65. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu nuk mund të mos vë theks në specifikat e veçanta të këtij rasti e të ndërlidhura me një kontest civil që është iniciuar në lidhje me të ndjerin dhe vetëm pas vdekjes së tij, përfundimet e të cilit rezultojnë në pamundësinë e regjistrimit të tij si i vdekur në regjistrin themeltar të vdekjes, duke pasur për pasojë jo vetëm vuajtjen e vazhdueshme të familjes së tij, por edhe statusin e pazgjidhur civil të bashkëshortes dhe të birit të tij.
66. Në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin fleksibil dhe pa formalizëm të tepruar të konceptit të “viktimës” dhe rëndësinë e meritave që ngrit një çështje e caktuar, dhe duke vënë theks në specifikat e këtij rasti, Gjykata rikujton se (i) është babai i të ndjerit i cili parashtron kërkesën para Gjykatës, dhe se bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës, me kushtin që të plotësohen kriteret tjera, në parim, atij i pranohet statusi i viktimës të tërthortë apo indirekte para Gjykatës; (ii) parashtruesi i kërkesës ka

qenë palë para të gjitha autoriteteve publike në kontestin në fjalë; (iii) interesi ligjor, përkatësisht zgjidhja e statusit civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit, është dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës; (iv) rrethanat e rastit konkret, përfshijnë interesat të rëndësishme shumë të madhe për të ardhmen e familjes së të ndjerit, përkatësisht bashkëshortes dhe të birit të tij, nga këndvështrimi i zgjidhjes së statusit të tyre civil, dhe në të kundërtën, e ardhmja e tyre do të mbetet peng e mosregjistrimit të të ndjerit I.F. në RTHV; dhe (v) rrethanat e rastit konkret gjithashtu ngërthejnë edhe çështje të jetës private të ndërlidhura me aspekte të integritetit psikologjik e moral të parashtruesit të kërkesës dhe familjes së tij, siç është e garantuar përmes nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht dhe për këto arsye, Gjykata pranon statusin e viktimës indirekte apo të tërthortë të parashtruesit të kërkesës.

67. Prandaj dhe në fund, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar; dhe (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës; në paragrafin 1 të nenit 47 të Ligjit; pikën (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 dhe paragrafin (2) të rregullit 76 të Rregullores së punës.

(ii) *Lidhur me shterimin e mjeteve juridike*

68. Përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

[...]

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Rregulli 39

[Kriteret e pranueshmërisë]

“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

69. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr.67/2017] e 22 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, dhe rrjedhimisht ajo konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka plotësuar kriterin e pranueshmërisë që ndërlidhet me shterimin e mjeteve juridike të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafi (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(iii) *Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin*

70. Në vazhdim, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

71. Gjykata rikujton që të njëjtat kritere janë të specifikuara më tej në pikat (c) dhe (d) të paragrafit 1 të rregullit 39 dhe paragrafët (2) dhe (4) të rregullit 76 të Rregullores së punës.
72. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar saktësisht se cilat të drejtat dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar dhe ka specifikuar aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës si dhe, e ka parashtruar kërkesën brenda afatit

prej katër (4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës.

(iv) *Lidhur me kushtet e tjera të pranueshmërisë*

73. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese siç parashihet përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk ka asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme, meqë asnjë nga kushtet e përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, nuk janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

74. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar, sepse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka pranuar “*statusin e viktimës indirekte ose të tërthortë*” të parashtruesit të kërkesës; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik; (iii) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; (iv) ka saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë e të cilat pretendon se i janë shkelur; (v) ka dorëzuar kërkesën brenda afatit; (vi) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese; dhe (vii) nuk ka asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar.
75. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën të pranueshme.

Dispozitat relevante Kushtetuese e Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

[...]

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 8
(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

LIGJ PËR GJENDJEN CIVILE Nr. 04/L-003

KREU VII
REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 46
Akti i vdekjes

1. Akti i vdekjes vërteton ligjërisht vdekjen e personit.
2. Akti i vdekjes është procesverbali, që mbahet për çdo të vdekur, i nënshkruar nga zyrtari i gjendjes civile dhe deklaruesi.
3. Akti i vdekjes përmban:
 - 3.1. zyrën e gjendjes civile, ku mbahet akti i vdekjes;
 - 3.2. numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
 - 3.3. vendin e vdekjes dhe orën;
 - 3.4. shkakun e vdekjes, sipas raportit mjekësor;

- 3.5. identitetin dhe numrin personal të të vdekurit, ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura e pa identitet;
- 3.6. numrin personal, emrin personal te mjekut ose të ekspertit ligjor, që ka lëshuar raportin;
- 3.7. numrin personal, emrin personal te deklaruesit;
- 3.8. numrin datën e shkresës së prokurorisë, që ka autorizuar veprimin për rastet e përcaktuara në këtë ligj;
- 3.9. emrin personal, te zyrtarit të gjendjes civile

Neni 47 **Deklarimi i vdekjes**

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar madhor i familjes ose nga personat më të afërt të familjes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa të afërm, nga zyrtari i autorizuar në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi ka vendbanimin/vendqëndrimin ose ku është gjetur kufoma.
2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.
3. Deklarimi i vdekjes bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga vdekja ose gjetja e kufomës dhe brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.
4. Drejtuesit e spitaleve, të burgjeve, të institucioneve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë Zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda pesë (5) ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre.
5. Kur vdekja ndodh ditëve të pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarin e vdekjes në Zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.
6. Me deklarin e vdekjes, Zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.
7. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas paragrafit 4. të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit lokal, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.
8. Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në Regjistrin e gjendjes civile, mund të bëjë padi në gjykatë kundër subjekteve që janë të

obliguara të bëjnë kërkesë për të vërtetuar vdekjen, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative.

9. Agjencia është e detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri i gjendjes civile, listën e shtetasve që kanë mbushur moshën njëqind (100) vjeçare dhe për çdo datë 5 të muajit të ardhshëm shpërndan listën, sipas Zyrës së gjendjes civile.

Neni 48

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

1. Shtetasi konsiderohet se ka vdekur, në fakt kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi dhe shkaku i vdekjes së tij.

2. Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore sipas Ligjit për procedurën jokontestimore.

3. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin e gjendjes civile, në kolonën e vërejtjeve, pa u mbajtur akti i vdekjes.

5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në aeroplan, anije në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 49

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku kompetent, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër e mjekësisë familjare, spital, emergjencë etj.). Kur kufomës i bëhet autopsia vdekja vërtetohet nga mjeku që e ka bërë autopsinë. Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe urdhrin e dhënë nga gjykata.

Neni 50

Leja e varrimit

1. Varrimi mund të bëhet vetëm pas marrjes së lejes nga Zyra e gjendjes civile.

2. Në rastet kur nuk mund të veprohet sipas paragrafit 1. të këtij neni, atëherë duhet të bëhet njoftimi për varrimin në Zyrën e gjendjes civile brenda tri (3) ditëve të punës.

3. Dokumentet që vërtetojnë vdekjen me rastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në regjistrin themeltar, janë edhe dëshmitë sipas paragrafit 1. të këtij neni.

4. Leja për varrimin nuk duhet të lëshohet pa vërtetim të mjekut që konfirmon vdekjen apo pa urdhër të gjykatës siç është përcaktuar në Ligjin për mjekësinë ligjore.

5. Për rastet kur varrimi nuk bëhet në vendin, ku i vdekuri ka regjistrin themeltar dhe leja e varrimit jepet nga subjektet e përcaktuara me këtë ligj nga një zyrë tjetër e gjendjes civile, zyra që e lëshon lejen e varrimit njofton për lejen e lëshuar zyrën e gjendjes civile, që mban regjistrin themeltar të qytetarit të vdekur.

Neni 52

Regjistrimi i vdekjes së një shtetasi kosovar me vendbanim jashtë Kosovës

1. Regjistrimi i vdekjes së shtetasit të Kosovës që ka ndodhur jashtë vendit, bëhet në regjistrin themeltar ku ata e kanë pasur vendbanimin në Kosovë.

2. Regjistrimi i vdekjes së shtetasit të Kosovës jashtë vendit, bëhet përmes shërbimit të gjendjes civile të përfaqësisë diplomatike të Kosovës në atë shtet, duke sjellë këto dëshmi: certifikatën ndërkombëtare të vdekjes, ose certifikatën e vdekjes të lëshuar nga regjistri civil i vendit të vdekjes të përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës, të vërtetuar, dokumentacionin e shtetësisë ose të vendbanimit, me të cilin dëshmohet vendbanimi ose shtetësia kosovare, letërnjoftimin ose pasaportën.

3. Nëse nuk ekzistojnë kushtet për regjistrim sipas paragrafit 2. të këtij neni, atëherë regjistrimi bëhet drejtpërdrejt në shërbimin e regjistrit civil.

KREU VIII

REGJISTRIMI I MËVONSHËM DHE RIREGJISTRIMI

Neni 54

Regjistrimi i mëvonshëm

1. Në rastet kur lindja apo vdekja nuk paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh atëherë regjistrimi bëhet me vendim të Zyrës së gjendjes civile.

2. Kriteret, forma, mënyra dhe procedura e regjistrimit të mëvonshëm rregullohet me akt nënligjor nga Ministri.
3. Dispozitat e këtij neni vlejnë edhe për personat e lindur në territorin e Republikës së Kosovës, që mbushin kushtet për të marrë shtetësinë sipas nenit 29 të Ligjit për shtetësinë dhe të cilët nuk janë regjistruar kurrë në regjistrat e gjendjes civile.

Neni 55 **Riregjistrimi**

1. Çdo regjistrim i lindjeve, vdekjeve dhe/ose martesave, i cili paraprakisht është regjistruar në librat e regjistrit të gjendjes civile në komunë riregjistrohet nëse aplikanti është në gjendje të vërtetojë regjistrimin paraprak në bazë të dokumenteve të lëshuara nga regjistri themeltar i gjendjes civile dhe/ose regjistrit qendror të gjendjes civile apo dokumentet e lëshuara nga Ministria e punëve të brendshme, të cilat përmbajnë regjistrimin origjinal dhe të cilat më vonë kanë humbur dhe/ose janë shkatërruar.
2. Kriteret, forma, mënyra dhe procedura e riregjistrimit rregullohet me akt nënligjor nga Ministri.
3. Dispozitat e këtij neni vlejnë edhe për personat e lindur në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët plotësojnë kushtet për të marrë shtetësinë sipas nenit 29 të Ligjit për shtetësinë dhe të cilët kanë qenë të regjistruar më parë në regjistrat e gjendjes civile.

KREU IX **SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE**

Neni 56 **Natyra dhe funksioni**

Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes lokale. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrat e gjendjes civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2012 – MPB PËR REGJISTRIMET E MËVONSHME NË REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE

Neni 15**Kriteret për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve në regjistrin e të vdekurve**

1. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim të mëvonshëm të vdekjeve në regjistrin e të vdekurve, duhet të plotësohen këto kritere:

- 1.1. vërtetimi mbi vdekjen nga institucioni shëndetësor, nëse vdekja ka ndodhur në institucionin shëndetësor publik ose privat;*
- 1.2. certifikata e lindjes;*
- 1.3. certifikata e martesës për ata që kanë qenë të martuar;*
- 1.4. fotokopja e dokumentit të identifikimit ose dokumenti i udhëtimit i personit për të cilin kërkohet certifikata;*
- 1.5. dëshmia e dy dëshmitarëve që e kanë parë me sy të vdekurin ose e kanë bërë identifikimin e kufomës pa ndonjë dyshim nëse vdekja ka ndodhur jashtë institucionit shëndetësor;*
- 1.6. certifikata e vdekjes internacionale, apo dokumenti i barasvlefshëm i lëshuar, nga shteti ku ka ndodhur vdekja;*
- 1.7. fletëpagesa që dëshmon pagesën e gjobës ashtu siç përcaktohet në nenin 63 të Ligjit për Gjendjen Civile.*

Meritat e kërkesës

- 76. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në shkresat e lëndës, i biri i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht I.F., kishte vdekur në një institucion shëndetësor në Suedi më 7 qershor 2013. Bazuar në shkresat e lëndës, i njëjti ishte transportuar nga Suedia në Kosovë, më 16 qershor 2013 dhe ishte varrosur në Prishtinë në të njëjtën datë. Bazuar në po këto shkresa, gjithashtu rezulton se në dokumentacionin e lëshuar nga Suedia përkitazi me këtë vdekje, është i shënuar personi A.H., ndërsa në dokumentacionin e Republikës së Kosovës, personi I.F. Kjo mospërputhje në dokumentacionin përkatës të vdekjes, i kishte pamundësuar parashtruesit të kërkesës që të regjistrojë të birin e tij në RTHV. Ai i ishte drejtuar fillimisht Komunës së Prishtinës dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe më pas gjykatave të rregullta dhe vendimet e të gjithave kishin rezultuar në refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e vdekjes së të birit në RTHV.
- 77. Komuna e Prishtinës e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes në RTHV, fillimisht përmes Vendimit [Nr.01-203-194645] të 16 tetorit 2013. Ky vendim ishte konfirmuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil përmes Vendimit [Nr.86/013] të 18 nëntorit 2013. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [Nr. 1652/13] të 16 majit 2014 e kishte anuluar këtë të

fundit, duke e kthyer çështjen në rivendosje, duke theksuar ndër të tjera por specifikisht, se parashtresa [nr.09/13] e 8 qershorit 2013 e lëshuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi, nuk ishte marrë parasysh përgjatë vendimmarrjes. Gjykata Themelore megjithatë nuk kishte urdhëruar regjistrimin e vdekjes përkatëse në RTHV, por vetëm kishte kthyer çështjen në rivendosje.

78. Agjencia e Regjistrimi Civil përmes Vendimit [nr. 30/2014] të 24 qershorit 2014 sërish kishte vërtetuar vendimmarrjen e saj paraprake dhe kishte lënë në fuqi vendimin e parë të Komunës së Prishtinës, përkatësisht Vendimin e 16 tetorit 2013, duke refuzuar kështu përfundimisht regjistrimin e vdekjes së mëvonshme në RTHV. Procedurat gjyqësore në vijim, kishin rezultuar në vërtetimin e këtij vendimi. Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme, kishin refuzuar padinë, ankesën dhe kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, respektivisht, duke arsyetuar se bazuar në dokumentacionin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës, regjistrimi i vdekjes së mëvonshme të të birit, përkatësisht I.F. në RTHV, ishte në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ mbi kriteret për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve në RTHV.
79. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24, 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës. Ai thekson se refuzimi i autoriteteve publike për të regjistruar vdekjen e të birit të tij në RTHV, ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në statusin civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit I.F., duke kërkuar nga Gjykata që t'i urdhërojë të njëjtat të bëjnë regjistrimin e vdekjes përkatëse në RTHV.
80. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht thekson se neni 53 i Kushtetutës nuk përmban në vetvete të drejta dhe liri themelore, por përcakton detyrimin e autoriteteve publike, që të njëjtat të i interpretojnë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata përgjatë trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, do e aplikojë të njëjtën. Përkritazi me pretendimet tjera për shkelje të të drejtave dhe lirive të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht atyre të garantuara përmes neneve 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se refuzimi i autoriteteve publike për të regjistruar të birin e tij në RTHV, ka afektuar gjithashtu statusin civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit, në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata konsideron se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ngërthen aspekte të së drejtës së parashtruesit të kërkesës në (i) jetë private të garantuar

përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive të garantuar përmes nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

81. Në aspekt të trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në kuadër të fushëveprimit të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata, duke u referuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se ajo nuk është kushtëzuar nga karakterizimi i shkeljeve të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juris novit curia*, Gjykata është vet zotëruese e karakterizimit të çështjeve kushtetuese që mund të ngërthej një rast, dhe me vullnetin e vet mund të shqyrtojë ankesat përkatëse, duke u mbështetur në dispozita ose paragrafë në të cilat nuk janë thirrur, shprehimisht, palët. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një ankesë karakterizohet nga faktet që përmban ajo dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet e referuara shprehimisht në të nga palët. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Talpis kundër Italisë*, Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e përmendura aty). Prandaj, dhe në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga këndvështrimi i drejtave të garantuara përmes paragrafit 1 të nenit 36 dhe nenit 54 të Kushtetutës si dhe neneve 8 dhe 13 të KEDNJ-së, respektivisht.
82. Në këtë aspekt dhe me qëllim të trajtimit të thelbit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, për respektim të jetës private, Gjykata së pari do të shtjellojë: (I) parimet e përgjithshme të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret, në mënyrë që të vlerësohet aplikueshmëria e këtyre neneve, për të vazhduar me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret; dhe (II) parimet e përgjithshme të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret, në mënyrë që të vlerësohet aplikueshmëria e këtyre neneve, për të vazhduar më pas me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret.

I. Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare dhe aplikimi i tyre në rrethanat e rastit konkret

Parimet e përgjithshme

83. Gjykata fillimisht thekson se ndonëse fushëveprimi i nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, nuk është i pakufizuar,

GJEDNJ e ka përkufizuar fushëveprimin e nenit 8 të KEDNJ-së, në mënyrë të gjerë, duke përfshirë edhe rastet kur një e drejtë specifike nuk është specifikisht e theksuar në këtë nen. (Shih Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ-së të 31 dhjetorit 2019, E drejta për respektim të jetës private dhe familjare; Pjesa A. Fushëveprimi i nenit 8, pika 2). Qëllimi parësor i nenit të 8 të KEDNJ-së, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është që të mbrojë individët nga “ndërhyrjet” arbitrare në jetën e tyre (i) private; (ii) familjare; (iii) të vendbanimit; ose (iv) të korrespondencës. (Shih, në këtë kontekst e ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *P. dhe S. kundër Polonisë*, Aktgjykim i 30 tetorit 2012, paragrafi 94; dhe *Nunez kundër Norvegjisë*, Aktgjykim i 28 qershorit 2011, paragrafi 68). Disa çështje, padyshim që mund prekin më shumë se një nga interesat e mbrojtura me nenet e lartcekura. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 8 të KEDNJ-së, E drejta për respektim të jetës private dhe familjare, Pjesa I. Struktura e nenit 8, pika 1). Këto të drejta, bazuar në sistemin e KEDNJ-së dhe praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, sigurohen përmes (i) detyrimeve negative, përkatësisht detyrimit të shtetit për të mos “ndërhyrë” në jetën private dhe familjare; dhe (ii) detyrimeve pozitive, përkatësisht detyrimit të shtetit për t’u siguruar që këto të drejta të gëzohen në mënyrë efektive.

84. Më saktësisht, përderisa, GJEDNJ thekson se qëllimi parësorë i nenit 8 të KEDNJ-së është të ofrojë mbrojtje kundër “ndërhyrjeve” arbitrare në jetën private, familjare, të vendbanimit dhe korrespondencën nga një autoritet publik, detyrim ky i llojit klasik negativ, shtetet anëtare kanë gjithashtu detyrime pozitive për të siguruar që të drejtat e nenit 8 të KEDNJ-së, të respektohen madje edhe ndërmjet palëve private. (Shih, në këtë kontekst dhe ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Bărbulescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 5 shtatorit 2017, paragrafët 108-111). Këto detyrime pozitive mund të përfshijnë miratimin e masave të nevojshme për të siguruar respektimin e jetës private, duke përfshirë edhe sigurimin e një kornize ligjore që mbron të drejtat e individëve dhe kur është e përshtatshme, edhe përcaktimin e zbatimit e masave të veçanta, përfshirë ato që ndërlidhen me respektimit efektiv të integritetit fizik dhe psikologjik të parashtruesve përkatës. (Shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 prillit 2007, paragrafi 75 dhe referencat e përdoruara aty dhe rastin *R.R kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 majit 2011, paragrafët, 184 dhe 185 dhe referencat e përdoruara aty).
85. Në secilin rast para GJEDNJ-së dhe i cili ngërthen pretendime që ndërlidhen me nenin 8 të KEDNJ-së, GJEDNJ pasi të ketë vlerësuar dhe konstatuar aplikueshmërinë e nenit 8 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit përkatës, vlerëson nëse këndvështrimi i saj në shqyrtimin e rastit

përkatës duhet të jetë nga aspekti i detyrimit negativ apo pozitiv të shtetit. Përderisa vet GJEDNJ ka theksuar se dallimi në mes këtyre dy aspekteve nuk është gjithëherë i qartë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së vënë në pah disa rregulla mbi të cilat GJEDNJ bazohet në përcaktimin e këtij këndvështrimi. (Shih Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ, Pjesa I. Struktura e nenit 8, pika B). Në parim, është e rëndësishme të vlerësohet nëse shteti ka vepruar, përkatësisht “ndërhyrë”, apo shteti ka dështuar të veprojë, më saktësisht nëse shteti përkatës, ka dështuar që përmes sistemit të tij ligjor ose administrativ të sigurojë të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare në rrethanat e këtij rasti. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 41).

86. Në rast se GJEDNJ vlerëson se rasti përkatës ngërthen aspekte të detyrimeve negative, GJEDNJ fillimisht vlerëson nëse në rrethanat e tij, ka një “ndërhyrje” në të drejtat e garantuara përmes nenit 8 të KEDNJ-së, dhe në rast të një vlerësimi afirmativ, GJEDNJ më tej vlerëson nëse kjo “ndërhyrje”, (i) është bërë në përputhje me ligjin, përkatësisht nëse e njëjta është e “përcaktuar në ligj”; (ii) ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht ato qëllime të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së; dhe (iii) është “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”. (Për një sqarim të detajuar lidhur me këto tri kritere, shih Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ-së, Pjesa I. Struktura e nenit 8, pikat C, D dhe E).
87. Ndërsa, në rast se GJEDNJ vlerëson se rasti përkatës ngërthen aspekte të detyrimeve pozitive, ajo duhet të marrë parasysh nëse rëndësia e interesit të parashtruesit përkatës kërkon imponimin e një detyrimi pozitiv të shtetit, p.sh. që shteti të bëjë diçka apo të ndërmarrë ndonjë veprim të caktuar ashtu që parashtruesi përkatës të mund të gëzojë të drejtën e tij të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, janë disa faktorë të rëndësishëm të cilët duhet të vlerësohen, përkatësisht ato që ndërlidhen me parashtruesin përkatës, dhe ato që ndërlidhen me rolin e shtetit përkatës. Përkitazi me të parin, është e rëndësishme të vlerësohet rëndësia e interesave të parashtruesit përkatës dhe nëse të njëjtat ndërlidhen me “vlerat themelore” ose “aspektet thelbësore” të jetës së tij/saj private, ndërsa përkitazi me të dytin, është e rëndësishme të vlerësohet nëse detyrimi i pretenduar i shtetit është “i ngushtë dhe i saktë” apo “i gjerë dhe i papërcaktueshëm” dhe cila është barra që detyrimi do t’ia impononte shtetit përkatës. (Shih Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ-së, Pjesa I. Struktura e nenit 8, B. pika 5; shih, po ashtu, rastin e GJEDNJ-së *Hämäläinen kundër*

Finlandës, Aktgjykim i 16 korrikut 2014, paragrafi 66 dhe referencat në të).

88. Thënë këtë, në të dy rastet, vëmendje duhet t'i kushtohet tri çështjeve vijuese (i) ekuilibrit të drejtë që duhet të arrihet midis interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi (shih rastet e GJEDNJ-së, *Dickson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2007, paragrafi 70; *Evans kundër Mbretësisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 75; *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 40; *Hamalainen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 65; dhe *Odievre kundër Francës*, Aktgjykim i 13 shkurtit 2003, paragrafi 40 dhe referencat e përdorura në to). Në këtë aspekt, GJEDNJ, gjithashtu ka theksuar, se në arritjen e këtij ekuilibri, në rast të detyrimeve pozitive të shtetit, qëllimet legjitime të përmendura në paragrafin e dytë të nenit 8 të KEDNJ-së mund të jenë të një relevance të caktuar, përkundër faktit që ky paragraf i referohet vetëm qëllimeve legjitime në kontekst të “*ndërhyrjeve*” në të drejtën e mbrojtur nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, përkatësisht detyrimeve negative të një shteti (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 42); (ii) qëllimit të KEDNJ-së që të garantojë të drejta që nuk janë “*teorike ose iluzore*”, por të drejta që janë “*praktike dhe efektive*” (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *R.R kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 191 dhe referencave të përdorura aty); dhe (iii) procesit të drejtë të vendimmarrjes dhe i cili ngërthen garancitë e nevojshme për respektimin e interesave të individit të mbrojtura me nenin 8 të KEDNJ-së, përkundër faktit që ky i fundit nuk përmban kërkesa të qarta procedurale (shih në këtë aspekt dhe ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Buckley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 29 shtatorit 1996, paragrafi 76; *Tanda Muzinga kundër Francës*, Aktgjykim i 10 korrikut 2014, paragrafi 68; dhe *M.S. kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 70).
89. Në fund, gjithashtu duhet të theksohet se, shtetet gëzojnë një “*margjinë të caktuar të vlerësimit*” për përcaktimin e gjerësisë së të cilës një numër faktorësh duhet të merren parasysh. Për shembull, kur një aspekt i rëndësishëm i ekzistencës dhe identitetit të individit është në pyetje, margjina e lejuar e vlerësimit për shtetin është më e kufizuar. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *X dhe Y kundër Holandës*, Aktgjykim i 26 marsit 1985, paragrafët 24 dhe 27; *Christine Goodëin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 90; dhe *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 29 prillit 2002, paragrafi 70-71). Megjithatë, në rastet kur nuk ka konsensus brendapërbrenda Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, as për sa i takon rëndësisë së interesit në pyetje e as mënyrës

më të mirë për të mbrojtur atë interes, e sidomos në rastet që ngrehin çështje të ndjeshme të moralit apo të etikës, margjina e vlerësimit do të jetë më e gjerë. (Shih rastet e GJEDNJ-së, X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykim i 22 prillit 1997, paragrafi 44; Frette kundër Francës, Aktgjykim i 26 shkurtit 2002, paragrafi 41; dhe Christine Goodëin kundër Mbretërisë së Bashkuara, cituar më lart, paragrafi 85).

Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

90. Në vijim, Gjykata, duke u bazuar në parimet e lartcekura përkitazi me nenin 8 të KEDNJ-së, do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës duke e aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata, rrjedhimisht, së pari do të trajtojë, çështjen e aplikueshmërisë së nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së për sa i përket çështjeve konkrete të këtij rasti, respektivisht, refuzimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e të birit të ndjerë I.F. në RTHV nga autoritet publike në Republikën e Kosovës. Pas përcaktimit të aplikueshmërisë së neneve relevante të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, Gjykata më tutje, do të shqyrtojë dhe përcaktojë nëse kërkesa duhet trajtuar nga këndvështrimi i detyrimit negativ apo pozitiv të Republikës së Kosovës. Në rast se duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit negativ, ajo do të vlerësojë nëse ka pasur “ndërhyrje” në të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe nëse “ndërhyrja” e tillë: (i) ka qenë “në përputhje me ligjin” ose “e përcaktuar me ligj”; (ii) ka “ndjekur një qëllim legjitim”; dhe (iii) ka “qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike.” Ndërsa, në rast se çështja specifike duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit pozitiv, Gjykata do të ekzaminojë nëse, në rrethanat e rastit konkret, shteti ka pasur detyrim të ndërmarrë masa përmes të cilave do të sigurohej realizimi efektiv i të drejtës së parashtruesit të kërkesës për një jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

(i) *Aplikueshmëria e nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ në rrethanat e rastit konkret*

91. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rithekson se e drejta për jetë private është e përfshirë në (i) paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës, i cili nen shprehimisht përcakton se: “Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private [...]” dhe, siç është cekur më lart, (ii) paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ-së, dhe i cili shprehimisht përcakton se “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private [...]”.

92. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në interpretimin e kësaj të drejte përfshinë edhe integritetin fizik, psikologjik dhe moral të një personi. (Shih Udhëzuesin e për nenin 8 të KEDNJ-së; Pjesën II. Jeta Private; B. Integriteti Fizik, Psikologjik dhe Moral). Në kuadër të kësaj të drejte, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ngërthen edhe rastet që ndërlidhen me çështje të vdekjes, përfshirë mënyrën e saj, por edhe ato që ndërlidhen me varrimin, çështje këto që para GJEDNJ-së janë ngritur kryesisht nga familjarët e të ndjerëve. Më saktësisht, kategoria e jetës private të nenit 8 të KEDNJ-së përfshin praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si në lidhje me çështjet e përfundimit të jetës ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me varrimin. Praktika gjyqësore që ka të bëjë me të parën, kryesisht përbëhet nga rastet që lidhen me të drejtën për të vendosur mënyrën e vdekjes së një personi. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 67; *Haas kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 20 janarit 2011, paragrafi 51; *Koch kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 19 korrikut 2012, paragrafi 52; dhe *Gard dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 27 qershorit 2017, paragrafët 118-124). Ndërsa, praktika gjyqësore që ka të bëjë me të dytën, përkatësisht çështjet lidhur me varrimin, kryesisht ka të bëjë me rastet që ndërlidhen me mënyrën e trajtimit të trupit të një të afërmi të ndjerë, si dhe mundësinë për të marrë pjesë në varrim dhe për të shprehur respekt në varrin e një të afërmi. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Solska dhe Rybicka kundër Polonisë*, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2018, paragrafët 106-108; dhe *Hadri-Vionnet kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 14 shkurtit 2008, paragrafët 51-52).
93. Gjykata vë theks në faktin që rasti i parashtruesit të kërkesës dallon nga rastet e GJEDNJ-së të vendosura në këtë kontekst sepse nuk përfshin drejtpërdrejtë një çështje që ndërlidhet me mënyrën e varrimit të të ndjerit I.F. Gjykata rikujton që, bazuar në shkresat e lëndës, i ndjeri I.F. është varrosur më 16 qershor 2013 dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk ndërlidhen me mënyrën e varrimit të tij, por me faktin që shteti, përkatësisht autoritet publike në Republikën e Kosovës, kanë refuzuar që të ndjerin të regjistrojnë si të vdekur në RTHV.
94. Megjithatë, Gjykata vëren që mos regjistrimi i të ndjerit të RTHV ndërlidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vdekjen e të ndjerit dhe përkatësisht edhe me integritetin psikologjik e moral të familjes së tij, e për më tepër edhe me statusin civil të bashkëshortes dhe të birit si rezultat i vdekjes së tij. Familja e parashtruesit të kërkesës është vënë në pamundësi për të përmbyllur procesin psikologjik të vdekjes së të birit në aspektin formal dhe juridik sepse në regjistrat civil të shtetit ai figuron i gjallë.

95. Në këtë kontekst, Gjykata duhet të konstatojë se rrethanat e parashtruesit të kërkesës hyjnë në fushëveprimin e të drejtës në jetë private e familjare dhe rrjedhimisht, paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, e të cilët, për pasojë, janë të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret. Si rezultat, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse refuzimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës nga autoritetet publike për regjistrimin e vdekjes së të birit të tij I.F. në RTHV, fillimisht nga Agjencia e Regjistrimit Civil, dhe më pas nga gjykatat e rregullta, është në përputhshmëri ose jo me të drejtat e garantuara përmes neneve të lartcekura. Thënë këtë, dhe siç është sqaruar më lart, paraprakisht, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse rrethanat e rastit konkret, duhet të vlerësohen nga këndvështrimi i detyrimit negativ apo pozitiv të Republikës së Kosovës.

(ii) *Natyra e detyrimit të Shtetit – nëse rasti ngërthen një “ndërhyrje” ose detyrim pozitiv*

96. Siç u theksua më lart, pas vlerësimit të aplikueshmërisë së nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duhet të trajtohet nga perspektiva e detyrimeve negative apo pozitive të shtetit. Përderisa, siç ka theksuar edhe vet GJEDNJ, dallimi në mes këtyre dy kategorive detyrimesh nuk është gjithnjë i prerë, në parim kategoria e parë ndërlidhet me detyrimin e shtetit për të mos “ndërhyrë” në të drejtat dhe liritë themelore, përderisa kategoria e dytë, ndërlidhet me detyrimin e shtetit për ndërmarrjen e masave përmes të cilave sigurohet garantimi i të drejtës së parashtruesit përkatës për jetë private.
97. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes së të birit të tij në RTHV ishte refuzuar nga Komuna e Prishtinës, refuzim ky i cili ishte vërtetuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Kjo e fundit, kishte konfirmuar të njëjtin vendim edhe pas Aktgjykimit fillestar të Gjykatës Themelore, përkatësisht Aktgjykimit [Nr. 1652/13] të 16 majit 2014. Vendimi i Agjencisë së Regjistrimit Civil ishte kontestuar sërish në gjykatat e rregullta, të cilat, siç është cekur më lart, kanë vërtetuar të njëjtin, duke refuzuar përfundimisht regjistrimin e mëvonshëm të të ndjerit në RTHV. Për pasojë, që nga fillimi i procedurave përkatëse, përkatësisht kërkesa e parë e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e mëvonshëm të të birit në RTHV në tetor të vitit 2013 dhe deri në vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të 22 dhjetorit 2017, kanë kaluar pesë (5) vjet në kuadër të të cilave i ndjeri I.F. nuk është regjistruar në RTHV, duke e lënë të cenuar

integritetin psikologjik e moral të familjes së tij edhe të pazgjidhur statusin civil të bashkëshortes dhe birit të të ndjerit.

98. Në rrethanat të tilla, Gjykata konsideron se autoritetet publike, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e të birit të tij të ndjerë në RTHV, jodetyrimisht kanë “*ndërhyrë*” në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për jetë private, por të njëjtat kanë dështuar të veprojnë. Më saktësisht, procedurat e ndjekura të sistemit administrativ e gjyqësor, nuk kanë rezultuar në realizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private. (Shih, për një konstatim të ngjashëm përkundër dallimit në rrethanat faktike, rastin e GJEDNJ-së, *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 41). Për pasojë, Gjykata konsideron që rrethanat e rastit konkret, kërkojnë vlerësimin nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit, përkatësisht nëse shteti ka pasur detyrim që të ndërmarrë masa përmes të cilave do të sigurohej realizimi efektiv i të drejtës së parashtruesit të kërkesës për një jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.
99. Për të përcaktuar nëse autoritetet publike kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, përkatësisht kanë vepruar në përputhshmëri me detyrimet e tyre pozitive për respektimin e jetës private të parashtruesit të kërkesës, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata duhet të analizojë ekuilibrin e drejtë në mes interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi, përkatësisht interesave private dhe publike. Në përcaktimin e këtij ekuilibri duhet të merret parasysh (i) rëndësia e interesit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht rëndësia e regjistrimit të të birit të tij të ndjerë në RTHV dhe rregullimi i statusit civil i bashkëshortes dhe të të birit të të ndjerit dhe nëse kjo çështje ndërlidhet me “*ulerat themelore*” ose “*aspektet thelbësore*” të jetës së tij private; dhe (ii) natyra e detyrimit të autoriteteve publike, përkatësisht nëse detyrimi i pretenduar i shtetit është “*i ngushtë dhe i saktë*” apo “*i gjerë dhe i papërcaktueshëm*” dhe barra që detyrimi përkatës do t’ia impononte shtetit. Përgjatë këtij vlerësimi gjithashtu duhet të ketë parasysh nëse procesi i vendimmarrjes përkritazi me të drejtat e parashtruesit të kërkesës për jetë private ka qenë i drejtë dhe ka rezultuar në realizimin e të drejtave “*praktike dhe efektive*” për parashtruesin e kërkesës dhe jo thjeshtë “*teorike ose iluzore*”, sepse një rezultat i tillë nuk do të ishte në përputhje as me Kushtetutën dhe as KEDNJ-në. Prandaj, në vijim, Gjykata, do të shtjellojë nëse në rrethanat e rastit konkret, është arritur ekuilibri i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të parashtruesit të kërkesës për respektimin e të drejtës së tij për një jetë private.

(iii) *Ekulibri në mes të interesave konkurruese – e drejta e parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës private dhe detyrimet e shtetit*

100. Bazuar në parimet e lartcekura e të cilat janë relevante për përcaktimin e ekuilibrit të drejtë në mes interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi, Gjykata fillimisht vë theks në rëndësinë e interesit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht rëndësinë e regjistrimit të të birit të tij të ndjerë në RTHV.
101. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht thekson se, në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese se (i) I.F. ka vdekur në Suedi më 7 qershor 2013; (ii) se vdekja e tij është konfirmuar përmes parashtrësës [nr.09/13] të 8 qershorit 2013 të lëshuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi përmes të cilës “*Autoritetet përkatëse të Republikë së Kosovës janë informuar lidhur me vdekjen e tij*” dhe u konfirmua se “*nuk ka asnjë pengesë për riatdhesimin e tij në Republikën e Kosovës*”; dhe (iii) se i njëjti është varrosur më 16 qershor 2013 në Prishtinë. Vdekja e tij nuk është kontestuar nga asnjëri nga autoritetet publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, të njëjtat autoritete, kanë refuzuar regjistrimin e shtetasit I.F. si të vdekur në RTHV, duke marrë parasysh që nuk ekziston një raport mjekësorë në emër të I.F. dhe i cili konfirmon vdekjen e tij, kërkesë kjo për regjistrimin e një të vdekuri në RTHV, e përcaktuar përmes Ligjit për Gjendjen Civile dhe Udhëzimin përkatës Administrativ.
102. Gjykata gjithashtu thekson se nuk është kontestuese që regjistrimi i vdekjes së të ndjerit I.F. në RTHV është i një rëndësie të madhe për parashtruesin e kërkesës dhe familjen e tij. Gjykata tashmë ka pranuar statusin e viktimës të tij duke vënë theks në faktin se (i) pamundësia e regjistrimit të të birit të tij si të vdekur në RTHV edhe pas shtatë (7) vitesh prej vdekjes së tij, ka rezultuar për pasojë në vuajtjen e vazhdueshme të familjes së tij në cenim të integritetit psikologjik e moral si një ndër aspektet e mbrojtura në kuadër të së drejtës për jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) statusi i pazgjidhur civil i bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit mbetet peng i refuzimit të regjistrimit të I.F.-së si të vdekur në RTHV. Më saktësisht, në regjistrat civil, I.F. figuron si i gjallë, duke i pamundësuar bashkëshortes dhe të birit të tij të mitur rregullimin e gjendjes së tyre civile. Refuzimi nga autoritetet publike për të regjistruar të ndjerin I.F. në RTHV, pamundëson rregullimin e këtij statusi civil, duke afektuar, ndër të tjera, edhe mundësinë e lëvizjes së të birit të mitur jashtë shtetit të Kosovës, vetëm me të ëmën e tij. Prandaj, rrethanat e rastit

reflektojnë rëndësinë e madhe për parashtruesin e kërkesës dhe të familjes së tij, për regjistrimin e vdekjes së të ndjerit I.F. në RTHV. Këto rrethana padyshim ngërthejnë “*aspekte thelbësore*” për realizimin e të drejtës për jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, përkundër dallimit në rrethanat faktike të rastit, vlerësimin e GJEDNJ-së në rastin *Dickson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 72).

103. Siç është sqaruar më lart, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, rëndësia e çështjeve që ngërthen një rast, duhet të balancohet dhe ekuilibrohet me detyrimet e shtetit. Në këtë aspekt, fillimisht është shumë e rëndësishme të vlerësohet (i) nëse detyrimi i pretenduar i shtetit është “*i ngushtë dhe i saktë*” apo “*i gjerë dhe i papërcaktueshëm*”; dhe (ii) cila është barra që detyrimi përkatës do t’ia impononte shtetit. Gjykata në këtë kontekst rithekson se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është regjistrimi i të birit të tij të ndjerë në RTHV. Kjo kërkesë në raport me detyrimin e shtetit në kontekst të së drejtës së tij për jetë private është (i) në fakt “*e ngushtë dhe e saktë*” dhe jo “*e gjerë dhe e papërcaktueshme*”; dhe (ii) kërkesa e parashtruesit të kërkesës për veprimet që duhet të ndërmerret shteti, nuk paraqet barrë joproporcionale për shtetin. Këto dy konstatime të Gjykatës, janë të bazuara në shqyrtimin e rasteve të ngjashme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, dhe në të cilat ndër të tjera, është shqyrtuar natyra e pretendimeve dhe e barrës që të njëjtat ia imponojnë shtetit. Për shembull, për dallim nga rrethanat e rastit konkret, në rastin *Botta kundër Italisë*, GJEDNJ kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesit përkatës për qasje në mjetet e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara gjatë pushimeve të tij në një resort larg vendbanimit të tij, ishin të një natyre kaq “*të gjerë dhe të papërcaktueshme*” sa që nuk do të mund të rezultonin në lidhje të drejtpërdrejtë midis masave që shteti do të duhej t’i ndërmerrete për të siguruar kërkesat për jetën private të parashtruesit përkatës. (Shih, rastin *Botta kundër Italisë*, Aktgjykim i 24 shkurtit 1998, dhe veçanërisht paragrafin 35 të tij për konstatimin përkatës të GJEDNJ-së). Në anën tjetër, po ashtu për dallim nga rrethanat e rastit konkret, në rastin *Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ kishte konstatuar se realizimi i kërkesës së parashtruesit përkatës do të kërkonte ndryshime shumë substanciale në mënyrën e menaxhimit të regjistrave të lindjeve me pasoja të natyrës administrative edhe për pjesën tjetër të popullsisë, prandaj kërkesa e parashtruesit përkatës, do të impononte detyrime joproporcionale për shtetin, dhe do të tejkalonte ekuilibrin e nevojshëm të interesave të parashtruesit dhe interesave të të tjerëve, duke theksuar se shtrirja e garancive të nenit

8 të KEDNJ-së, nuk mund të shkojë aq larg. (Shih, rastin *Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 17 tetorit 1986, dhe veçanërisht paragrafin 43 të tij për konstatimin përkatës të GJEDNJ-së).

104. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet si më sipër, Gjykata duhet të konstatojë se aspektet që ngërthen çështja në rrethanat e rastit konkret janë të një rëndësie të madhe për parashtruesin e kërkesës dhe se të njëjtat janë “*të ngushta dhe të sakta*” dhe si të tilla, nuk ngarkojnë shtetin me detyrime joproporcionale. Thënë këtë, dhe në këtë kontekst, Gjykata në vijim duhet gjithashtu të vlerësojë nëse veprimet e ndërmarra nga autoritet publike, përkatësisht Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta, janë në përputhshmëri me detyrimet e shtetit për respektimin e jetës private të parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht, nëse të njëjtat kanë garantuar një ekuilibër të drejtë në mes interesave konkurruese të parashtruesit të kërkesës dhe të komunitetit në tërësi.
105. Në këtë aspekt, dhe fillimisht Gjykata rikujton që Komuna e Prishtinës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta, kanë refuzuar regjistrimin e të ndjerit I.F. në RTHV, me arsyetimin se mungon raporti mjekësor i cili vërteton vdekjen e I.F., dhe se raporti i lëshuar nga autoritetet shëndetësore suedeze është në emër të A.H. dhe jo I.F. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nuk është kontestuese se (i) raporti i institucionit shëndetësor, përkatësisht institucionit shëndetësor në Suedi, konstaton vdekjen e personit A.H. dhe jo I.F.; (ii) dokumentacioni i Republikës së Kosovës për të ndjerin është në emër të I.F., në emër të të cilit, nuk rezulton të ketë asnjë raport mjekësor që konstaton vdekjen e tij; dhe (iii) për më tepër, është gjithashtu e saktë, që parashtruesi i kërkesës, si para gjykatave të rregullta, ashtu edhe në seancën dëgjimore publike, ka dështuar të sqarojë ndërlidhjen e të birit të tij I.F. me personin A.H., dhe i cili, sipas parashtruesit të kërkesës është emër “*i imagjinuar*”, dhe mund të jetë bërë për arsye të procedurës së azil-kërkimit.
106. Gjykata në këtë aspekt më tej thekson se regjistrimi i aktit të vdekjes është i rregulluar përmes Kreut VII për Regjistrim të Aktit të Vdekjes të Ligjit për Gjendjen Civile. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 47 (Deklarimi i Vdekjes) të këtij ligji, deklarimi i vdekjes bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga vdekja ose gjetja e kufomës dhe brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit. Kur vdekjet raportohen pas afatit, ato kualifikohen në kategorinë e regjistrimeve të mëvonshme të rregulluara përmes nenit 54 (Regjistrimi i mëvonshëm) në kuadër të Kreut VIII mbi Regjistrimin e Mëvonshëm dhe Riregjistrimin të ligjit të lartcekur. Bazuar në paragrafin 2 të këtij neni, kriteret, forma, mënyra dhe procedura e

regjistrimit të mëvonshëm rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përkatëse. Ky akt nënligjor, në rrethanat e rastit konkret, është Udhëzimi i referuar Administrativ, dhe i cili në nenin 15 të tij përcakton kriteret për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve në regjistrin e të vdekurve dhe të cilat përfshijnë: (i) vërtetimin mbi vdekjen nga institucioni shëndetësor, nëse vdekja ka ndodhur në institucionin shëndetësor publik ose privat; (ii) certifikatën e lindjes; (iii) certifikatën e martesës për ata që kanë qenë të martuar; (iv) fotokopjen e dokumentit të identifikimit ose dokumenti i udhëtimit i personit për të cilin kërkohet certifikata; (v) dëshminë e dy dëshmitarëve që e kanë parë me sy të vdekurin ose e kanë bërë identifikimin e kufomës pa ndonjë dyshim nëse vdekja ka ndodhur jashtë institucionit shëndetësor; (vi) certifikatën e vdekjes internacionale, apo dokumentin e barasvlershëm të lëshuar nga shteti ku ka ndodhur vdekja; dhe (vii) fletëpagesën që dëshmon pagesën e gjobës të specifikuar në këtë Udhëzim.

107. Në rrethanat e rastit konkret, dhe siç është përcaktuar edhe sipas arsytimit të gjykatave të rregullta, dokumentacioni i kërkuar përmes pikës 1.1 dhe 1.6 të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ, nuk përkojnë dhe janë në kundërtënie me ato të përcaktuara përmes pikave 1.2, 1.3 dhe 1.4 të të njëjtit Udhëzim. Më specifikisht, vërtetimi mbi vdekjen nga institucioni shëndetësor nuk përkon me certifikatën e lindjes, certifikatën e martesës dhe dokumentin e identifikimit të personit I.F.
108. Gjykata rikujton se duke u bazuar edhe në sqarimet e lartcekura, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta, kanë argumentuar se regjistrimi i të ndjerit I.F. në RTHV, do të ishte në kundërshtim me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ përkitazi me regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Gjendjen Civile, sepse dokumentacioni mbi vdekjen i lëshuar nga institucioni shëndetësor, përkatësisht institucioni shëndetësor suedez, nuk përkon me dokumentacionin e lëshuar nga Republika e Kosovës.
109. Gjykata rikujton arsyetimin e vendimit të kontestuar, përkatësisht Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr. 67/2017] të 22 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme, dhe i cili në këtë aspekt, thekson si në vijim:

“Kjo Gjykatë gjatë vlerësimit konstatoj se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vërtetuar se dokumentacioni që është bashkangjitur kërkesës për regjistrimin e vdekjes së IF në LTHV nuk përputhet me dokumentacionin e lëshuar nga R. e Kosovës. Krejt kjo për faktin se dokumentet mbi bazën e të cilave kërkohet të regjistrohet vdekja e që janë të lësuara nga autoritetet suedeze, janë

konstatuar që të gjitha janë në emër të AH, për deri sa regjistrimi i vdekjes kërkohej të bëhet në emër të IF. Kjo Gjykatë ka vlerësuar dhe pretendimet e paditësit se fjala është për të njëjtin person pasi i ndjeri IF ka jetuar në Suedi dhe vdekja ka ndodhur atje, por si të tilla këto pretendime nuk mund të aprovohen si të bazuara për të regjistruar vdekjen në LTHV, pasi që janë në kundërshtim me nenin 15 të UA 02/2012 i cili qartë përcakton kriteret që duhen të plotësohen nga kërkuesi.”

110. Thënë këtë, dhe përderisa nuk është kontestuese se ekzistenca e një raporti mjekësor për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes në RTHV është kriter dhe kërkesë e Udhëzimit përkatës Administrativ, Gjykata thekson se interpretimi dhe aplikimi skajshmërisht formal i ligjit të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, duke mos marrë parasysh rrethanat e veçanta të parashtruesit të kërkesës dhe pasojat e refuzimit të regjistrimit të të birit të tij të ndjerë në RTHV, autoritetet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, nuk kanë reflektuar “*kujdesin e duhur*” për ta respektuar jetën private dhe familjare të parashtruesit të kërkesës të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së.
111. Ky konstatim fillimisht sepse përtej Gjykatës Kushtetuese, dhe e cila bazuar në nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës është autoriteti përfundimtarë në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës, është po ashtu detyrim kushtetues i organeve administrative dhe gjykatave të rregullta që pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, t’i vlerësojnë dhe interpretojnë bazuar në të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky detyrim buron nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, sipas të cilit, ndër të tjera, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut “*janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës*”.
112. Në kuadër të këtyre të drejtave dhe lirive themelore hyjnë edhe ato të garantuara me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës. Gjykata rikujton që marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të garantuara përmes nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, përfshijnë edhe KEDNJ-në. Gjykata gjithashtu rikujton që të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare (i) janë të garantuara edhe me Kushtetutë; (ii) zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës; dhe (iii) kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj

dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Gjykata më tej thekson se interpretimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore, të gjitha organet administrative, gjykatat e rregullta si dhe Gjykata Kushtetuese, janë të detyruara të bëjnë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Një detyrim i tillë buron nga neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku specifikisht përcaktohet që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

113. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se tashmë është e qartë se praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së, kërkon që në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me të drejtën për jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, (i) duhet të merren parasysh rrethanat e një parashtruesi të kërkesës dhe rëndësia e pretendimeve përkatëse për respektimin efektiv të jetës private; dhe (ii) se procesi i vendimmarrjes përkitazi me të njëjtat pretendime duhet të jetë në tërësinë e tij i drejtë dhe të rezultojë në realizimin e të drejtave *“praktike dhe efektive”* për parashtruesin e kërkesës, dhe jo thjeshtë *“teorike ose iluzore”*, sepse një rezultat i tillë nuk do të ishte në përputhje as me Kushtetutën dhe as me KEDNJ-në.
114. Në rrethanat e rastit konkret, dhe në kundërshtim me këto parime, Gjykata thekson se përtej interpretimit dhe aplikimit skajshmërisht formal të ligjit të aplikueshëm, autoritet publike nuk kanë marrë parasysh as rrethanat e veçanta të parashtruesit të kërkesës dhe as pasojat e vendimmarrjes së tyre për të drejtën për jetë private e familjare të parashtruesit të kërkesës. Kjo sepse, përkundër faktit që nuk është kontestuese që në rrethanat e rastit konkret nuk ekziston një raport mjekësor në emër të I.F., nuk është gjithashtu kontestuese se I.F. ka vdekur dhe se mosregjistrimi i tij si i tillë në RTHV, ka pasojat të rënda për bashkëshorten dhe të birin e mitur të të ndjerit I.F., duke i lënë të parët, me status të pazgjidhur civil dhe gjithashtu pa asnjë mundësi për të zgjidhur të njëjtin në të ardhmen.
115. Për më tepër, përkundër detyrimeve që ngërthen paragrafi 1 i nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së dhe praktika respektive gjyqësore e GJEDNJ-së, autoritetet publike përfshirë gjykatat e rregullta, në kufizimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet e lartcekura, nuk kanë ndërmarrë asnjë analizë lidhur me ekuilibrin e drejtë që duhet të arrihet midis interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi dhe për më tepër, nuk kanë përfshirë në vendimet e tyre asnjë arsyetim të

vetëm lidhur me qëllimet legjitime mbi bazën e të cilave mund të kufizohen të drejtat e garantuara për jetë private dhe familjare. Gjykata rikujton që në kuptim të vlerësimit të realizimit të këtyre të drejtave nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit, qëllimet legjitime mbi bazën e të cilave mund të kufizohen të drejtat dhe liritë përkatëse, siç janë përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së, nuk janë përcaktuese sepse të njëjtat në parim ndërliken me vlerësimin e detyrimeve negative të shtetit, përkatësisht ato të detyrimit të mos “*ndërhyrjes*”, megjithatë të njëjtat, duhet të merren gjithashtu parasysh sepse bazuar në praktikën gjyqësorë të GJEDNJ-së, kanë një relevancë të caktuar edhe në kontekst të vlerësimit të detyrimeve pozitive të shtetit.

116. Në rrethanat e rastit konkret, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, Agjencia për Regjistrimin Civil dhe gjykatat e rregullta, respektivisht, përkundër (i) zbatimit të drejtpërdrejtë të KEDNJ-së në Republikën e Kosovës dhe prioritetit të saj, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, siç është përcaktuar në nenin 22 të Kushtetutës; dhe (ii) detyrimit që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së, siç është përcaktuar në nenin 53 të Kushtetutës, përtej aplikimit të Ligjit për Gjendjen Civile, nuk kanë shqyrtuar dhe as arsyetuar, ekuilibrin e drejtë të nevojshëm në mes interesave konkurruese të individit dhe komunitetit dhe as qëllimet legjitime mbi bazën e të cilave e drejta për jetë private dhe familjare do të mund të kufizohet, siç kërkohet lidhur me të drejtën për jetë private të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.
117. Për më tepër, Gjykata vëren që përderisa autoritetet publike kanë refuzuar regjistrimin e të ndjerit I.F. në RTHV, me arsyetimin se mungon raporti mjekësor në emrin e tij, të njëjtat nuk kanë marrë parasysh (i) faktin që po autoritetet publike të Republikës së Kosovës, kanë konfirmuar vdekjen dhe kanë lehtësuar kthimin e të ndjerit I.F. nga Suedia në Kosovë; (ii) mundësinë e përdorimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në këtë çështje, në mënyrë që të sqarohen rrethanat që ndërliken me raportin mjekësor dhe rrjedhimisht, të mundësohet regjistrimi i të ndjerit në RTHV; dhe (iii) mundësinë që shpallja e të ndjerit si të vdekur dhe regjistrimi përkatës në regjistrat civil, të bëhet bazuar në dispozitat relevante të procedurës jokontestimore.
118. Më saktësisht dhe përkitazi me çështjen e parë, nuk është kontestuese që I.F. ka vdekur në Suedi më 7 qershor 2013. Këtë e ka konfirmuar parashtresa [nr.09/13] e 8 qershorit 2013 e Ambasadës së Republikës

së Kosovës në Suedi. Kufoma është transportuar në Kosovë përmes kompanisë përgjegjëse për shërbimet funerale në Linköping. I ndjeri është varrosur në Prishtinë më 16 qershor 2013. Thënë këtë, dhe përkundër këtyre fakteve, në rrethanat e rastit konkret, nuk ekziston (i) një certifikatë ndërkombëtare e vdekjes ose certifikatë e vdekjes e lëshuar nga regjistri civil i vendit të vdekjes të përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës; dhe (ii) nuk ka asnjë leje zyrtare varrimi të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile. Përkundër mungesës së këtij dokumentacioni, shteti ka lehtësuar kthimin e kufomës nga Suedia në Republikën e Kosovës dhe ka lejuar varrimin e të njëjtit, ndërsa në të njëjtën kohë, ka refuzuar regjistrimin e tij në RTHV.

119. Më specifikisht, dhe përkitazi me certifikatën ndërkombëtare të vdekjes, Gjykata vëren se përkundër kërkesave të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 52 (Regjistrimi i vdekjes së një shtetasi kosovar me vendbanim jashtë Kosovës) të Ligjit për Gjendjen Civile, nuk ka një certifikatë ndërkombëtare të vdekjes ose certifikatë të vdekjes të lëshuar nga regjistri civil i vendit të vdekjes të përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës për të ndjerin I.F. Megjithatë, përkundër mungesës së certifikatës së lartcekur, dhe mungesës së një raporti mjekësor në emrin e të ndjerit I.F., vdekja e tij është konfirmuar përmes parashtresës [nr.09/13] të 8 qershorit 2013 të lëshuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi, dhe rrjedhimisht, i njëjti është transferuar nga Suedia në Republikën e Kosovës, përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Ndërsa përkitazi me lejen e varrimit, Gjykata vëren se përkundër faktit që paragrafi 1 i nenit 50 të Ligjit për Gjendjen Civile, përcakton se varrimi mund të bëhet vetëm pas marrjes së lejes nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe se bazuar në paragrafin 4 të këtij neni, leja për varrim nuk mund të lëshohet pa vërtetim të mjekut që konfirmon vdekjen apo pa urdhër të gjykatës, në rrethanat e të ndjerit I.F., nuk ka asnjë leje zyrtare varrimi. Kjo e fundit, konfirmohet edhe nga Komuna e Prishtinës përgjatë diskutimit në seancën publike dëgjimore, por edhe përmes shkresës sqaruese të dorëzuar në Gjykatë më 19 shkurt 2020, përmes së cilës specifikisht sqarohet se Komuna e Prishtinës *“nuk mund të sigurojë asnjë dokument lidhur me vdekjen/varrimin e I.F., pasi që në sistemin e gjendjes civile ky person figuron si i gjallë”*. Megjithatë, I.F. është varrosur më 16 qershor 2013 në Prishtinë.
120. Rrjedhimisht, përkundër faktit që autoritetet publike të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ambasada e Kosovës në Suedi, e njeh faktin që I.F. ka vdekur; se të njëjtit i mundësohet kthimi në Republikën e Kosovës dhe në këtë aspekt, nuk paraqitet asnjë pengesë, dhe përkundër faktit që nuk ka asnjë kontest lidhur me faktin nëse I.F. ka vdekur dhe se i njëjti është i varrosur në Prishtinë para shtatë (7)

vjetësh, autoritetet përkatëse publike të Republikës së Kosovës, kanë refuzuar regjistrimin e vdekjes së tij në RTHV, me arsyetimin se për të njëjtin nuk ka një raport mjekësor që vërteton vdekjen e tij, përkundër faktit që mungesa e këtij raporti, e për më tepër, edhe mungesa e certifikatës ndërkombëtare e vdekjes, nuk e ka penguar konfirmimin e vdekjes dhe kthimin e kufomës nga Suedia në Kosovë dhe varrimin e tij në Prishtinë më 16 qershor 2013. Veprime të tilla të pakoordinuara dhe të shkëputura nga njëra tjetra nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës, kanë rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për jetën e tij private të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

121. Në anën tjetër dhe përkitazi me çështjen e dytë të identifikuar më lart, Gjykata gjithashtu vë në pah faktin se, përtej sugjerimeve të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Avokaturës Shtetërore, në seancën dëgjimore publike përkitazi me mundësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në rrethanat e rastit konkret, gjykatat e rregullta, prej fillimit të procedurave gjyqësore në vitin 2014 e deri në nxjerrjen e vendimit të kontestuar në 2017, nuk i janë qasur kësaj mundësie për të tentuar sqarimin e ndërlidhjes në mes të ndjerit I.F. dhe atë A.H. apo edhe mungesës së raportit mjekësor në emër të I.F. nga institucioni shëndetësor suedez.
122. Gjykata në këtë aspekt vëren se (i) Ligji i vetëm që rregullon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në Republikën e Kosovës është ai që ndërlidhet me çështjet penale, përkatësisht Ligji nr.04/L-213 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, e që nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret; (ii) në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nuk është e publikuar asnjë Marrëveshje Ndërkombëtare me shtetin Suedez përkitazi me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar; por megjithatë thekson se (iii) Ministria e Drejtësisë, më 30 shtator 2009, ka nxjerrë Udhëzim Administrativ nr. 2009/1-09 për Procedurën e Ofrimit të Ndhmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile që ka për qëllim adresimin e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet civile dhe penale, dhe i cili, përkundër faktit që është i karakterit të përgjithshëm, do të mund të kishte shërbyer si bazë për iniciimin e procedurave për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në rrethanat e rastit konkret. Gjykatat nuk iu kanë qasur kësaj mundësie dhe as nuk kanë arsyetuar mungesën e një iniciative të tillë.
123. Njëjtë, dhe përkitazi me çështjen e tretë, autoritetet publike kanë vepruar edhe lidhur me mundësinë e shpalljes së vdekjes së të ndjerit I.F., përmes paragrafit 2 të nenit 48 të Ligjit për Gjendjen Civile në lidhje me nenet 73 e 74 të Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën

Jokontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPJ). Pjesa c) e këtij të fundit, përkatësisht “*Procedura e të provuarit të vdekjes së një personi*”, në nenet 73 dhe 74 të tij, përcakton mundësinë e konstatimit të vdekjes së një personi përmes aktvendimit, në qoftë se vdekja faktike e një personi nuk mund të provohet me anë të dokumentit të parashikuar me ligjin për librat amzë. Bazuar në po të njëjtin ligj, përkatësisht nenin 4 të tij, kjo procedurë përpos propozimit të personit fizik apo juridik, mund të inicohet edhe me anë të propozimit të organit shtetëror. Gjykatat nuk iu kanë qasur kësaj mundësie dhe as nuk kanë arsyetuar mungesën e një iniciative të tillë.

124. Rrjedhimisht, autoritet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, përtej qasjes skajshmërisht formale të aplikimit dhe interpretimit mekanik të ligjit, nuk kanë marrë parasysh të gjitha rrethanat që ngërthen rasti dhe pasojat e rënda për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin e nenit 8 të KEDNJ-së, duke rezultuar kështu në një situatë në të cilin të drejtat kushtetuese dhe ato të garantuara me KEDNJ për parashtruesin e kërkesës, janë thjeshtë të drejta “*teorike dhe iluzore*” dhe jo të drejta “*praktike dhe efektive*”, siç kërkon Kushtetuta, KEDNJ dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, por edhe vetë ajo e kësaj Gjykate. (Shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Nada kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 12 shtatorit 2012, paragrafi 182; *Emonet dhe të tjerët kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2007, paragrafi 86; dhe *Artico kundër Italisë*, Aktgjykim i 13 majit 1980, paragrafi 33).
125. Për pasojë, Gjykata konsideron se qasja skajshmërisht formale e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe gjykatave të rregullta, në interpretimin dhe aplikimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjendjen Civile dhe Udhëzimit Administrativ, në rrethanat komplekse dhe të veçanta të rastit konkret, pa konsideratë për efektet juridike që do të prodhonin vendimet e tyre përkitazi me statusin civil të bashkëshortes dhe të birit të të ndjerit I.F., ka pamundësuar realizimin “*praktik dhe efektiv*” të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë të parashtruesit të kërkesës. Një qasje e tillë bie ndesh me detyrimin e autoriteteve publike në kuadër të nenit 8 të KEDNJ-së për të pasur “*kujdesin e duhur*” që të drejtat që ndërlidhen me jetën private, duhet të respektohen si përmes detyrimeve negative apo të vetëpërmbytjes së autoriteteve publike, po ashtu edhe përmes detyrimeve pozitive. Në të dy rastet, ndërmarrja e veprimeve duhet të jetë e justifikuar dhe proporcionale në rrethanat individuale të rastit. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Ploski kundër Polonisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002 paragrafët 35-39; dhe *Nada kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 182).

126. Prandaj dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, refuzimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e të birit të ndjerë në RTHV, nuk reflekton ekuilibrin e drejtë në mes interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi. Përkundër faktit që autoritet publike nuk kanë “*ndërhyrë*” në të drejtat e parashtruesit të kërkesës për jetë private, të njëjtat, nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive, kanë dështuar të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin efektiv të të drejtave të parashtruesit të kërkesës për jetë private. Më saktësisht, procedurat e ndjekura të sistemit administrativ e gjyqësor, nuk kanë rezultuar në realizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private, siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Përkundrazi, të njëjtat kanë rezultuar në të drejtat thjeshtë “*teorike dhe iluzore*” për parashtruesin e kërkesës, përkundër faktit që në rrethanat e rastit (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të një natyre shumë serioze dhe ndërlidhen me “*aspektet thelbësore*” të jetës private; ndërsa (ii) kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e një natyre “*të ngushtë dhe të saktë*” dhe barra, përkatësisht detyrimi i shtetit në realizimin e kësaj kërkeje, nuk është joproporcionale.
127. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se refuzimi i autoriteteve publike për të regjistruar të ndjerin I.F. në RTHV, në rrethanat e rastit konkret, nuk ngërthen një ekuilibër të drejtë midis interesit privat e publik, duke rezultuar kështu në shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. (Shih, përkundër dallimit në rrethanat faktike të rastit, vlerësimin e ngjashëm të GJEDNJ-së në rastin *Dickson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 85; dhe *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 49). Për pasojë, Gjykata gjithashtu konkludon që autoritetet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, kanë dështuar t'i zbatojnë detyrimet e tyre pozitive për t'i siguruar parashtruesit të kërkesës të drejtat për jetën e tij private duke rezultuar në shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. (Shih, përkundër dallimit në rrethanat faktike të rastit, vlerësimin e ngjashëm të GJEDNJ-së në rastin, *R. R. kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 214).
128. Bazuar në sqarimin e mësipërm, Gjykata duhet të konstatojë se Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr.67/2017] i 22 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.333/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit, Aktgjykimin [A.nr.1185/2014] e 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Vendimin [Nr.30/2014] e 24 qershorit 2014 dhe [Nr.86/013] të 18 nëntorit 2013 të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe atë të Komunës së Prishtinës [nr.01-203-194645] të 16 tetorit

2013, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

129. Në dritën e këtij konstatimi, Gjykata në vijim gjithashtu do të shqyrtojë përputhshmërinë me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së të vendimeve të kontestuara. Për këtë qëllim, Gjykata do të shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së përkitazi me nenet e lartcekura dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

II. Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtat për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për zgjidhje efektive dhe aplikimi i tyre në rrethanat e rastit konkret

Parime e Përgjithshme

130. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson që neni 54 i Kushtetutës, përbëhet nga dy rregulla por të cilat duhet lexuar së bashku dhe në ndërvlerësi me njëra-tjetrën. Rregulli i parë është i përgjithshëm dhe thekson se “*çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj.*” Në parim, ky rregull nënkupton që mbrojtja gjyqësore është e drejtë e garantuar për secilin individ, fizik apo juridik, të cilit mund t'i jetë “*shkelur*” një e drejtë ekzistuese e garantuar me Kushtetutë, KEDNJ ose me ligj apo mund t'i jetë “*mohuar*” e drejta për të fituar apo për të gëzuar ndonjë të drejtë të garantuar me të njëjtat. Rregulli i dytë i këtij neni flet dhe garanton të drejtën për “*mjete efektive ligjore*” në rastet kur konstatohet se një e drejtë e mbrojtur me Kushtetutë apo me ligj është shkelur. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 195).
131. Neni 54 i Kushtetutës gjithashtu plotësohet dhe duhet të lexohet ngushtë dhe në lidhshmëri me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së. Neni 13 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një “*zgjidhje efektive*” në rast të shkeljes së të drejtave të garantuara me KEDNJ nga një autoritet publik. (Shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 197).

132. Rrjedhimisht, në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 i Kushtetutës për mbrojtën gjyqësore të të drejtave dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iii) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ. (Shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 198).

133. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, qëllimi i nenit 13 të KEDNJ-së është të ofrojë një mjet juridik përmes të cilit individët mund të arrijnë një zgjidhje efektive për shkeljet e të drejtave të tyre të garantuara përmes KEDNJ-së në nivelin vendor, përpara se të vihet në lëvizje makineria e ankesave para GJEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152). Në të kundërtën, mungesa e ekzistencës së mjeteve juridike përkatëse, do të dobësonte dhe do t'i bënte iluzore garancitë e nenit 13 të KEDNJ-së, ndërsa kjo e fundit, siç është theksuar tashmë, nuk synon të garantojë të drejta “*teorike ose iluzore*”, por të drejta që janë “*praktike dhe efektive*”. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ, *Scordino kundër Italisë* (nr. 1), Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 192).

134. Për më tepër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, kjo praktikë gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, thekson se kur një individ ka një pretendim “*të argumentueshëm*” se është viktimë e një shkeljeje të të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, ai/ajo duhet të ketë një mjet juridik përpara një “*autoriteti kombëtar*”, dhe i cili i mundëson vendosjen mbi thelbin e pretendimit përkatës por dhe, nëse është e përshtatshme, të i mundëson realizimin e korrigjimit të duhur.

135. Gjykata vëren se përkitazi me nocionin e “*argumentueshmërisë*”, GJEDNJ nuk ka formuluar një përkufizim të saktë. Megjithatë, ajo ka theksuar se “*kur një individ ka një pretendim të argumentueshëm se është viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në KEDNJ, ai/ajo duhet të ketë një mjet juridik përpara një autoriteti kombëtar për të dyja, që të vendoset mbi pretendimin e tij/saj dhe nëse është e përshtatshme të arrij korrigjimin e duhur*”. (Shih, ndër të tjera, GJEDNJ, *Leander kundër Suedisë*, Aktgjykim i 26 marsit 1987, paragrafi 77). Ajo gjithashtu ka shtuar se nëse kërkesa është “*e argumentueshme*”, duhet të përcaktohet në dritën e fakteve të veçanta dhe të natyrës së çështjes juridike ose çështjeve të ngritura në secilin

rast të veçantë. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 55; dhe *Plattform "Arzte für das Leben" kundër Austrisë*, Aktgjykim i 21 qershorit 1988, paragrafi 27). Në parim, kur "argumenteshmëria" e një ankese mbi meritat nuk është në diskutim, GJEDNJ e konstaton nenin 13 të aplikueshëm në rrethanat e atij rasti. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Vilvarajah dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 121; dhe *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 15 nëntorit 1996, paragrafi 147). GJEDNJ ka theksuar megjithatë, se neni 13 i KEDNJ-së, nuk mund të interpretohet që kërkon një mjet juridik në të drejtën vendore për sa i përket secilës ankese të supozuar që një individ mund të ketë, pa marrë parasysh se sa jomeritore mund të jetë ankesa përkatëse: ankesa/pretendimi në çdo rast duhet të jetë "e argumentueshme" për sa i përket KEDNJ-së. (Shih, mes tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe *Maurice kundër Francës*, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 106).

136. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 13 i KEDNJ-së nuk ka ekzistencë të pavarur; ai thjesht plotëson dispozitat e tjera thelbësore të KEDNJ-së dhe protokolleve të saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Zavoloka kundër Letonisë*, Aktgjykim i 7 korrikut 2009, paragrafi 35 (a)). Ky nen mund të zbatohet vetëm në kombinim me, ose në dritën e, një ose më shumë neneve të tjera të KEDNJ-së ose protokolleve përkatëse, për të cilat është pretenduar një shkelje. Sidoqoftë, neni 13 i KEDNJ-së mund të dalë në pah edhe pa u shkelur një dispozitë tjetër e KEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64). Si pasojë, nuk mund të jetë parakusht për zbatimin e nenit 13 të KEDNJ-së, fakti që një e drejtë tjetër të jetë shkelur. Kësisoj, edhe nëse GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të një dispozite, ankesa mund të mbetet "e argumentueshme" për qëllimet e nenit 13 të KEDNJ-së. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Valsamis kundër Greqisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 47; dhe *Ratushna kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 2 dhjetorit 2010, paragrafi 85).
137. Për sa i përket ndërlidhjes së nenit 13 me nenin 8 të KEDNJ-së, e që është e rëndësishme për rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se GJEDNJ ka gjetur shkelje ose jo të nenit 13 në lidhje me ose në dritën e nenit 8 të KEDNJ-së në raste të ndryshme. Në të gjitha këto raste ishte theksuar se një mjet efektiv juridik në kontekst të rasteve që ngërthejnë pretendime përkitazi me nenin 8 të KEDNJ-së, nënkupton që autoritetet përkatëse duhet të shqyrtojnë ekuilibrin/balancën në

mes të interesave të individit dhe detyrimet të shtetit. (Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Gorlov dhe të Tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2019, paragrafi 108).

138. Për shembull, Gjykata vëren se GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 8 dhe 13 të KEDNJ-së, ndër të tjera, në të gjitha rastet në vijim: *Gorlov dhe të Tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart; *B.A.C kundër Greqisë*, Aktgjykim i 13 tetorit 2016; *Keegan kundër Mretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; *Reiner kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 23 majit 2006; dhe *T.P dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2001. Shkelja e nenit 8 të KEDNJ-së, në disa raste ishte konstatuar nga këndvështrimi i detyrimeve negative të shtetit, ndërsa në disa të tjera, nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit. Duke marrë parasysh shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së në këto raste, GJEDNJ kishte konstatuar edhe shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së. Kjo e fundit, në të gjitha këto raste ishte arsyetuar përmes argumenteve vijuese: (i) marrë parasysh konstatimin e shkeljes përkitazi me nenin 8 të KEDNJ-së, GJEDNJ kishte konstatuar se parashtruesit përkatës kishin një pretendim të “*argumentueshëm*” para saj përkitazi me nenin 13 të KEDNJ-së; (ii) arsyetimet e Aktgjyqimeve përkatëse kishin theksuar se e drejta për zgjidhje efektive e garantuar përmes nenit 13 të KEDNJ-së, kërkon që pretendimet e parashtruesve të shqyrtohen në thelbin e përmbajtës së tyre dhe duke marrë parasysh që rastet përkatëse nuk kishin shqyrtuar ekuilibrin apo balancën e nevojshme në mes të interesit të parashtruesve përkatës dhe detyrimeve të shtetit, kishin konstatuar se mjetet juridike në nivel vendor nuk ishin efektive, dhe rrjedhimisht ishte shkelur neni 13 i KEDNJ-së; dhe (iii) në raste të caktuara, gjithashtu kishte vënë theks në analizën skajshmërisht formale dhe të kufizuar të gjykatave vendore dhe anashkalimin e veçorive të rastit, duke konstatuar për pasojë se nuk ishin përmbushur kriteret e nenit 13 të KEDNJ-së.

Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

139. Bazuar në parimet e përgjithshme të lartcekura, Gjykata në vijim duhet të vlerësoj nëse në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës ka një pretendim të “*argumentueshëm*” para Gjykatës përkitazi me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; dhe nëse ky është rasti, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse parashtruesi i kërkesës ka patur në dispozicion mjete juridike të cilat i kanë mundësuar “*zbatimin e substancës së të drejtave të Konventës...*”. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Keegan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 41 dhe referencat e përdorura aty).

140. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata thekson se duke marrë parasysh konstatimin e shkeljes së paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, janë qartësisht “*të argumentueshme*”. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Gorlov dhe të Tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 104; dhe *Keegan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 41; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, nr. KI193/18, me parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 130). Prandaj, në vijim, duhet të vlerësohet nëse mjetet juridike në dispozicionin e parashtruesit të kërkesës, i kanë mundësuar të njëjtit shqyrtimin e thelbit të përmbajtjes së pretendimeve dhe kërkesave të tij.
141. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se ajo tashmë ka konstatuar se refuzimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e të birit të tij të ndjerë në RTHV nga autoritetet publike, është bërë në shkelje të të drejtës së tij për jetë private të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Gjithashtu, Gjykata tashmë ka konstatuar se autoritet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kanë pasur një qasje skajshmërisht formale të interpretimit dhe aplikimit të ligjit, dhe nuk kanë adresuar thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe veçoritë e rastit të tij, duke rezultuar kështu në pamundësi për realizmin e korrigjimit të nevojshëm për respektimin e të drejtave të tij për jetë private, dhe se rezultati i procedurave para të njëjtave autoritete publike, në tërësinë e tyre, ka rezultuar në të drejta vetëm “*teorike ose iluzore*”, jo “*praktike dhe efektive*” për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.
142. Për më tepër, dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 dhe 13 të KEDNJ-së, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta, përpos që nuk kanë trajtuar thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ato as nuk kanë shtjelluar ekuilibrin apo balancën e duhur në mes interesave konkurruese, dhe as çështje që ndërlidhen me veçoritë e rastit konkret dhe arsyeshmërinë dhe proporcionalitetin e refuzimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e të birit të tij të ndjerë në RTHV.
143. Gjykata në këtë aspekt rithekson se qasja skajshmërisht formale e interpretimit dhe e aplikimit të ligjit dhe shqyrtimi i kufizuar i kërkesave të parashtruesve përkatës, duke anashkaluar thelbin dhe përmbajtjen e pretendimeve të një parashtruesi përkatës, në mungesë

të çfarëdo përpjekje për të gjetur ekuilibrin apo balancën e duhur në mes interesave konkurruese, përtej shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së, duke pamundësuar korrigjimin e duhur po ashtu rezulton edhe në shkeljen e nenit 13 të KEDNJ-së bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, përkundër dallimeve në rrethanat faktike të rastit, konstatimin dhe arsyeshmërinë e njëjtë të GJEDNJ-së, ndër tjerash, në rastin, *Reiner kundër Bullgarisë*, cituar më lart, paragrafët 141, 142 dhe 143)

144. Në rrethana të tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të konstatojë se parashtruesi i kërkesës nuk kishte në dispozicion mjete efektive juridike për të korrigjuar shkeljet e të drejtës së tij për jetë private të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Prandaj, për arsyet e sqaruara në këtë Aktgjykim, Gjykata duhet gjithashtu të konstatojë se në rrethanat e rastit konkret, ka pasur edhe shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. (Shih, përkundër dallimeve në rrethanat faktike të rastit, konstatimin dhe arsyeshmërinë e njëjtë të GJEDNJ-së, ndër tjerash, në rastin *Keegan dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafët 42 dhe 43).

Përfundime

145. Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr. 67/2017] i 22 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.333/2017] e 20 tetorit 2017 të Gjykatës së Apelit, Aktgjykimin [A.nr.1185/2014] e 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Vendimin [Nr.30/2014] e 24 qershorit 2014 e Vendimin [Nr.86/013] e 18 nëntorit 2013 të Agjencisë së Regjistrimit Civil e atë të Komunës së Prishtinës [nr.01-203-194645] të 16 tetorit 2013, janë nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
146. Për të arritur në konstatimin e lartcekur, Gjykata fillimisht ka sqaruar se rrethanat e rastit konkret, përkatësisht refuzimi i autoriteteve publike për të regjistruar të birin e vdekur të parashtruesit të kërkesës në RTHV, ngërthejnë çështje që ndërlidhen me të drejtën në jetë private të parashtruesit të kërkesës dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive, siç janë garantuar me nenet 36 e 54 të Kushtetutës dhe 8 e 13 të KEDNJ-së, respektivisht. Në këtë kontekst dhe përgjatë shqyrtimit të këtij rasti, Gjykata ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e

Gjykatës dhe e GJEDNJ-së përkitazi me nenet e lartcekura dhe më pas ka aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

147. Përkitazi më çështjet që ndërlidhen me të drejtën në jetë private, Gjykata, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për aq sa është relevante për rrethanat e rastit, ndër tjerash, ka sqaruar (i) detyrimet e shtetit për mbrojtjen e jetës private siç është e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ; (ii) dallimin në mes detyrimeve negative dhe pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen e kësaj të drejte; (iii) faktin se në rrethanat e rastit konkret, shteti jo detyrimisht ka “*ndërhyrë*” në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, por ka dështuar të veprojë për të mbrojtur të njëjtat, duke rezultuar për pasojë në vlerësimin e rrethanave të këtij rasti nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit; (iv) se detyrimet pozitive të shtetit, ndër tjerash, kërkojnë që autoritetet publike të shqyrtojnë veçoritë e një rasti dhe të ndërmarrin masa për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave për jetë private, ose përmes sigurimit të një kornize ligjore që mbron të drejtat e individëve ose përmes përcaktimit e zbatimit të masave të veçanta të përshtatshme për rrethanat e një rasti; dhe (v) se në raste të tilla, autoritetet publike, janë të detyruara të shqyrtojnë ekuilibrin apo balancën më mes interesave të individit, përfshirë natyrën e pretendimeve dhe nëse të njëjtat ndërlidhen me “*aspekte thelbësore*” të jetës private dhe detyrimeve të shtetit, përfshirë nëse të njëjtat ndërlidhen me detyrime “*të ngushta dhe të sakta*” apo “*të gjera dhe të papërcaktueshme*” dhe barrën e mundshme që ato ia imponojnë shtetit.
148. Ndërsa përkitazi me çështjet që ndërlidhen me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive, Gjykata, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për aq sa është relevante për rrethanat e rastit, ndër tjerash, ka sqaruar (i) se këto të drejta nënkuptojnë ekzistencën e një mjeti juridik i cili shqyrton thelbin e përmbajtjes së kontestit, përkatësisht pretendimeve të një parashtruesi dhe mundëson korrigjimin e duhur; (ii) nocionin e pretendimit “*të argumentueshëm*” për qëllime të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së; dhe (iii) faktin se në kontekst të pretendimeve për mbrojtje të të drejtës private, mjeti juridik duhet të mundësojë shqyrtimin e thelbit të pretendimeve përkatëse, dhe vlerësimin e ekuilibrit në mes interesave konkurruese. Në të dyja rastet, është i rëndësishëm qëllimi i Kushtetutës dhe i KEDNJ-së, që të garantojnë të drejta “*praktike dhe efektive*” dhe jo “*teorike ose iluzore*”.
149. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret, përkitazi me nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata

ka theksuar se autoritetet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, përtej konstatimit se përkitazi me vdekjen e të birit të parashtruesit të kërkesës mungon raporti mjekësor që e konfirmon vdekjen e tij, konstatim ky që ka rezultuar në refuzimin e regjistrimit të birit të parashtruesit të kërkesës në RTHV, me pasojën serioze të lënies së pazgjidhur përfundimisht të statusit civil të bashkëshortes dhe të birit të mitur të të ndjerit, nuk kanë marrë parasysh faktin se (i) nuk është kontestuese se i biri i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur; dhe (ii) një fakt të tillë e kishin konfirmuar edhe vet autoritetet publike të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ambasada e Kosovës në Suedi, ku kishte ndodhur vdekja. Për më tepër, autoritetet publike, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e vdekjes së të birit të tij në RTHV, përkundër faktit që e njëjta vdekje nuk ishte kontestuese, (i) jo vetëm që kishin aplikuar në mënyrë skajshmërisht formale ligjin e aplikueshëm, duke mos konsideruar kështu, as mundësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me shtetin Suedez dhe as mundësitë e dhëna përmes dispozitave të procedurës jokontestimore, por (ii) në kundërshtim me kërkesat kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, nuk kishin shqyrtuar ekuilibrin apo balancën në mes interesave konkurruese, përkatësisht thelbit dhe veçorive të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe detyrimeve të shtetit për mbrojtjen e të drejtës në jetë private.

150. Gjykata ka sqaruar se shqyrtimi i një ekuilibri të tillë, do të rezultonte në konstatimin se pretendimet dhe kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *“e ngushtë dhe e qartë”* dhe nuk rezulton në detyrime joproporcionale për shtetin. Për më tepër që, përmes një refuzimi të tillë në mungesë të një raporti mjekësor, duke mos marrë parasysh asnjë nga rrethanat dhe veçoritë që ngërthen rasti konkret, vendimet e autoriteteve publike, kishin rezultuar në të drejta kushtetuese vetëm *“teorike dhe iluzore”* për parashtruesin e kërkesës dhe jo të drejta kushtetuese *“praktike dhe efektive”*, siç kërkohet me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për pasojë, Gjykata konstatoi se procedurat e ndjekura të sistemit administrativ e gjyqësor në kundërshtim me detyrimet pozitive të shtetit, nuk kanë rezultuar në realizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.
151. Ndërsa, përkitazi me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, Gjykata theksoi se marrë parasysh konstatimin e mësipërm, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, janë qartësisht *“të argumentueshme”*, siç është përcaktuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së. Më tej, Gjykata theksoi

se në kundërshtim me kërkesat e neneve të lartcekura dhe praktikën relevante gjyqësore, mjetet juridike, në rrethanat e rastit konkret, nuk kishin rezultuar as në shqyrtimin e thelbit të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe as nuk kishin mundësuar korrigjimin e duhur. Gjykata ritheksoi se shqyrtimi i kufizuar dhe skajshmërisht formal i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në izolim prej veçorive të rastit dhe pasojave përkatëse, kishte rezultuar edhe në mungesë të mbrojtjes praktike dhe efektive të të drejtave gjyqësore dhe të asaj për zgjidhje efektive të parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

152. Rrjedhimisht, Gjykata ka gjetur se Aktgjykimet e lartcekura të gjykatave të rregullta dhe vendimet e lartcekura të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Komunës së Prishtinës, nuk janë në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht të njëjtat duhet të shpallen të pavlefshme. Gjykata gjithashtu përmes këtij Aktgjykimi e urdhëroi Agjencinë e Regjistrimit Civil, që deri më 30 tetor 2020, ta regjistrojë vdekjen e I.F., përkatësisht të birit të parashtruesit të kërkesës, në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 59 (1), 64 (2) dhe 66 të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020, me shumicë,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- IV. TË SHPALLË të pavlefshëm vendimet, si vijon:

- a) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.nr. 67/2017] të 22 dhjetorit 2017;
 - b) Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AA.nr.333/2017] të 20 tetorit 2017;
 - c) Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [A.nr.1185/2014] të 5 qershorit 2017;
 - ç) Vendimet e Agjencisë së Regjistrimit Civil [Nr.30/2014] të 24 qershorit 2014 dhe [Nr.86/013] të 18 nëntorit 2013; dhe
 - d) Vendimin e Sektorit të Gjendjes Civile të Komunës së Prishtinës [Nr. 01-203-194645] të 16 tetorit 2013;
- V. TË URDHËROJË Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Sektorin e Gjendjes Civile të Komunës së Prishtinës që deri më 30 tetor 2020, ta regjistrojë vdekjen e I.F. në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve;
- VI. TË URDHËROJË Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Sektorin e Gjendjes Civile të Komunës së Prishtinës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;
- VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;
- VIII. TË NJOFTOJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve;
- IX. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- X. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI214/19 Parashtrues: Murteza Koka, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.195/2019, të 23 korrikut 2019

KI214/19 - Aktgjykim i datës 29 korrik 2020, i publikuar më 24 gusht 2020

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, kontest pronësor, lejueshmëria e revizionit, parimi res judicata#

Çështja kryesore që ishte ngritur nga parashtruesi në kërkesën e tij para Gjykatës Kushtetuese ishte nëse Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.195/2019] e kishte rihapur çështjen e parashtruesit të kërkesës të vendosur me Aktgjykimin [AC. nr. 3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr. 38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore, me të cilën ishte aprovuar padia e parashtruesit të kërkesës dhe ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës është pronar i pronës që ishte objekt i kontestit.

Lidhur me këtë, pas Aktgjykimit [AC.nr.3332/2013] të Gjykatës së Apelit, Komuna e Gjakovës, përmes Gjykatës Themelore, parashtroi revizion në Gjykatën Supreme. Ndërsa, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje në revizion duke kontestuar lejueshmërinë e revizionit pasi, sipas tij, vlera e kontestit ishte 200.00 euro ndërsa sipas nenit 211, paragrafit 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore revizioni nuk lejohet nëse vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumën prej 3000.00 euro. Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.38/2012], hodhi poshtë revizionin e Komunës së Gjakovës si të palejuar me arsyetimin se vlera e kontestit të padisë dhe kërkesëpadisë lëndore ka qenë nën shumën prej 3000.00 euro.

Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac.nr.3860/18], pas ankesës së Komunës së Gjakovës, e ktheu në rigjykim dhe rivendosje rastin pasi vlerësoi se Gjykata e shkallës së parë është dashur që në zbatim të nenit 36 të LPK-së sipas detyrës zyrtare ta verifikojë vlerën e kontestit të treguar në padi dhe pastaj të marrë aktvendim për caktimin e vlerës së kontestit. Gjykata Themelore pas Aktvendimit [Ac.nr. 3860/18] të Gjykatës së Apelit, ia kishte përcjellë shkresat e lëndës Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me revizionin. Ndërsa, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr.195/2019] e pranoi si të bazuar revizionin, e prishi Aktgjykimin [AC.nr.3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C.nr. 38/2012] të 30 prillit 2013, të Gjykatës Themelore me të cilat ishte vërtetuar e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesë për pronën e kontestuar, dhe lëndën e ktheu në rigjykim.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme me të cilin rasti i vendosur përmes Aktgjykimit [C. nr. 38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore i cili është bërë përfundimtar përmes Aktgjykimin [AC.nr. 3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, është rikthyer sërish për vendosje në merita në Gjykatën Themelore pa një arsyetim mbi lejueshmërinë e revizionit sipas pretendimeve të paraqitura në përgjigjen e parashtruesit të kërkesës në revizion, dhe me këtë ai pretendoi se atij i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ si dhe e drejta për barazi para ligjit dhe e drejta për mbrojtje të pronës të garantuara me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, bazuar edhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të saj, si dhe në atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, erdhi në përfundim se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar ka rihapur rastin e parashtruesit të kërkesës të vendosur me Aktgjykimin [AC.nr.3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore dhe të cilat ishin bërë *res-judicata*, duke pasur parasysh vlerën e kontestit e cila, sipas vendimeve gjyqësore, ishte nën shumën për të cilën është i lejuar revizioni, ndërsa vlera e objektit të kontestit me asnjë vendim të gjykatave të rregullta nuk ishte kontestuar dhe korrigjuar.

Andaj, duke prishur Aktgjykimin [AC.nr. 3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore, pa e vlerësuar lejueshmërinë e revizionit, Gjykata Supreme kishte shkelur parimin e sigurisë juridike dhe i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafit 2 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së.

Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës dhe të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 46, respektivisht nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh që Gjykata konkludoi se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, dhe shpalli të pavlefshëm Aktvendimit Rev. nr. 195/2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 korrikut 2019, Gjykata nuk e kishte parë të nevojshme të trajtojë ndaras pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës dhe të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 46, respektivisht nenin 24 të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI214/19

Parashtrues

Murteza Koka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2019, të 23 korrikut 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Murteza Koka nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Prenk Pepaj, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimi e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr.195/2019 të 23 korrikut 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 24 [Barazia

para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon që Gjykata mos ta zbulojë identitetin e tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 nëntor 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 21 nëntor 2019.
7. Më 27 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani (anëtarë).
8. Më 20 dhjetor 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë formularin e kërkesës të Gjykatës si dhe autorizimin që dëshmon që ai përfaqëson parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.
9. Më 13 janar 2020, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, përmes postës, formularin e kërkesës, disa dokumente të cilat ishin dorëzuar me kërkesën fillestare si dhe një autorizim të përgjithshëm me të cilin parashtruesi i kërkesës autorizonte përfaqësuesin e tij *“që në mënyrë gjenerale të më përfaqësoi, në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative”*.
10. Më 27 janar 2020, Gjykata sërish i kërkoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin që dëshmon që ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.

11. Më 5 shkurt 2020, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, një autorizimin i cili nuk ishte valid për përfaqësimin e parashtruesit para Gjykatës, pasi dokumenti ishte kopje e autorizimit të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ku shihej numri personal i parashtruesit të kërkesës, por nuk tregohet dokumenti i identifikimit të tij.
12. M 27 shkurt 2020 Gjykata i kërkoi përfaqësuesit të kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin e vërtetuar te noteri me të cilin vërtetohet pa dyshim që përfaqësuesi është i autorizuar të përfaqësojë parashtruesin e kërkesës para Gjykatës si dhe kopjen e një dokumenti identifikues të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 16 mars 2020, Gjykata pranoi autorizimin valid të vërtetuar te noteri me të cilin vërtetohet që përfaqësuesi është i autorizuar të përfaqësojë parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.
14. Më 26 mars 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
15. Po atë ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të njoftoj Gjykatën *“për veprimet e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Gjakovë, pasi rasti lidhur me parashtruesin e kërkesës [lidhur me lejueshmërinë e revizionit] ishte rikthyer në Gjykatën Themelore në Gjakovë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktvendimit [Ac.nr. 3860/18] të 12 marsit 2019”*.
16. Më 5 maj 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës C.nr.38/2020, që ndërlidhet me kërkesën KI214/20, por nuk u përgjigj në pyetjen e parashtruar nga Gjykata.
17. Më 10 qershor 2020, Gjykata i ktheu dosjen e lëndës Gjykatës Themelore dhe sërish kërkoi nga kjo e fundit që:

“të njoftoni Gjykatën Kushtetuese për veprimet e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Gjakovë, pasi rasti ishte rikthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3860/18] të 12 marsit 2019.

Konkretisht, nëse pasi rasti ishte rikthyer në rigjykim nga Gjykatën e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3860/18], Gjykata Themelore në Gjakovë:

- 1) *ka nxjerr ndonjë vendim sipas gjetjeve të Aktvendimit [Ac. nr. 3860/18] Gjykatës së Apelit e Kosovës; apo*

2) *vetëm ka proceduar lëndën si të tillë për shqyrtim sipas Revizionit në Gjykatën Supreme të Kosovës.”*

18. Po atë ditë, Gjykata njoftoi Komunën e Gjakovës për regjistrimin e kërkesës dhe njoftoi këtë të fundit se mund të paraqesë komente, nëse ka, lidhur me kërkesën e parashtruesit.
19. Më 2 korrik 2020, Gjykata pranoi komentet e Komunës së Gjakovës lidhur me kërkesën.
20. Më 3 korrik 2020, Gjykata pranoi nga Komuna e Gjakovës një parashtrësë me korrigjime të komenteve të pranuar nga Gjykata më 2 korrik 2020.
21. Më 7 korrik 2020, Gjykata Themelore duke iu përgjigjur shkresës së Gjykatës së 10 qershorit 2020, njoftoi Gjykatën se pasi lënda C.nr.38/2012 është kthyer nga Gjykata e Apelit, seanca është caktuar më 05.08.2020.
22. Më 13 korrik 2020, Gjykata sërish kërkoi nga Gjykata Themelore që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga Gjykata në shkresën e 10 qershorit 2020, si dhe të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës në fjalë.
23. Më 20 korrik 2020, Gjykata Themelore, dorëzoi përgjigjen e saj në Gjykatë duke theksuar se *“në këtë çështje nuk është nxjerr ndonjë vendim nga ana e Gjykatës Themelore në Gjakovë, sipas gjetjeve të aktvendimi[t] AC.nr. 380/18 të Gjykatës së Apelit [...], por vetëm është bërë caktimi i shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç ju kam njoftuar edhe me shkresën e datës 06.07.2020”*.
24. Më 29 korrik 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
25. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme dhe se: i) ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ii) nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 24 dhe nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; iii) Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.195/2019 i 23 korrikut 2019 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr. 3860/18 i 12 marsit 2019, shfuqizohen; iv) Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AC.nr.3332/2013 i 26 prillit 2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C.nr.38/2012 i 30 prillit 2013, janë

përfundimtarë dhe të detyrueshëm, dhe si të tillë *res judicata*; v) refuzohet kërkesa për moszbulim të identitetit.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 8 mars 2006, parashtruesi i kërkesës, parashtroi padi kundër Komunës, në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), për vërtetimin e të drejtës së pronësisë lidhur me paluajtshmërinë me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0-06-92 ha, themeleve në sipërfaqe prej 0-00-090 ha dhe shfrytëzues i përhershëm i paluajtshmërisë me kulturë oborr në sipërfaqe prej 0-06-46 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0-08-28 ha, pjesë e paluajtshmërisë së evidentuar si parcelë nr.4380/2, sipas fletës poseduese nr.856, ZK Gjakovë-J. qytet (në tekstin e mëtejme: prona kontestuese). Në padi cekej se vlera e kontestit është 200.00 euro.
27. Më 16 korrik parashtruesi i kërkesës kishte zgjeruar padinë duke shtuar si të paditur edhe personin M.U.B.
28. Më 4 qershor 2010, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [C.Nr.124/06], miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i pronës së kontestuar.
29. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C.nr.124/06], Komuna parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
30. Më 10 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë përmes Aktvendimit [Ac.nr.9/2011] prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr.124/06] dhe lëndën e ktheu në rivendosje.
31. Me 30 prill 2013, në procedurën e përsëritur Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.Nr.38/12], sërish aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i pronës së kontestuar. Vlera e kontestit e shënuar në këtë Aktgjykim ishte 200.00 euro.
32. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Komuna parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

33. Më 24 prill 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AC.nr. 3332/2013], e refuzoi ankesën e Komunës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr.38/12]. Vlera e kontestit të shënuar në këtë Aktgjykim ishte 200.00 euro.

Procedura lidhur me revizionin e Komunës së Gjakovës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AC.nr.3332/2013] dhe Aktgjykimit [C.nr.38/12] të Gjykatës Themelore

34. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AC. nr. 3332/2013], Komuna, përmes Gjykatës Themelore, parashtroi revizion në Gjykatën Supreme.
35. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje në revizion duke kontestuar mes tjerash, lejueshmërinë e revizionit pasi sipas tij, vlera e kontestit ishte 200.00 euro ndërsa sipas nenit 211, paragrafit 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, revizioni nuk lejohet nëse vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumë prej 3000.00 euro.
36. Më 19 korrik 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.38/2012], hodhi poshtë revizionin e Komunës si të palejuar me arsyetimin se vlera e kontestit të padisë dhe kërkesëpadisë lëndore ka qenë e caktuar 200.00 euro, e jo mbi vlerën e paraparë në nenin 211, paragrafi 3 të LPK-së, 3000.00 euro.
37. Ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr.38/2012], të 19 korrikut 2019, Komuna parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
38. Më 12 mars 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac.nr. 3860/18], e aprovoi si të themeltë ankesën e Komunës dhe lëndën e ktheu në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata e Apelit, arsyetoi se Gjykata e shkallë së parë është dashur që në zbatim të nenit 36 të LPK-së sipas detyrës zyrtare ta verifikojë vlerën e kontestit të treguar në padi dhe pastaj të marrë aktvendim për caktimin e vlerës së kontestit. Në rastin konkret, vlera e kontestit, e kërkuar sipas padisë dhe kërkesëpadisë, është shumë më e vogël se sa që është realisht. Gjykata e Apelit më tej arsyeton se Gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me nenin 36 të LPK-së ka vazhduar procedurën me shumë e vogël të kontestit, në krahasim me shumë reale, ndërsa Komunës i është pamundësuar që të paraqes mjetin e jashtëzakonshëm juridik, revizionin. Gjykata e Apelit theksoi se “gjykata e shkallës së parë në procedurën e

përsëritur udhëzohet që të veprojë konform nenit 219 të LPK-së dhe pastaj revizionin së bashku me shkresat e lëndës brenda afatit ligjor t'ia përcjellë Gjykatës Supreme [...]”.

39. Nga dosja originale e lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që Gjykata Themelore kishte vepruar sipas urdhrit të Gjykatës së Apelit “*që të nxjerrë aktvendim për vlerën e kontestit*” ose që kishte nxjerrë ndonjë vendim pas Aktvendimit [Ac.nr. 3860/18], por ia ka përcjellë shkresat e lëndës Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me revizionin.
40. Më 23 korrik 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit Rev. nr.195/2019 e pranoi si të bazuar revizionin, e prishi Aktgjykimin AC. nr. 3332/2013, të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin C. nr. 38/2012 të 30 prillit 2013, të Gjykatës Themelore dhe lëndën e ktheu në rigjykim, mes tjerash, “*për arsye se diapozitivi i Aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e Aktgjykimit dhe se arsyetimi nuk përmban arsye të mjaftuara bindëse, faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare për të vendosur në këtë çështje juridike. Po ashtu, për shkak të hetimit të parregullt gjykata e shkallës së parë gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale.*” Gjykata Supreme, nuk kishte trajtuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës të ngritur në përgjigjen e tij ndaj revizionit lidhur me paligshmërinë e revizionit për shkak të shumës së caktuar të padisë prej 200,00 euro.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar Gjykata Supreme ka bërë shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenet 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, të drejtën për barazi para ligjit si dhe të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës.
42. Parashtruesi i kërkesës thekson se “*Gjykata e Apelit [...], me [vendimin e kontestuar], e aprovon si të themeltë ankesën e [Komunës] dhe lenden ja kthen Gjykatës [Themelore] në rishqyrtim dhe Rivendosje. [...] Gjykata Themelore [...], ja dërgon shkresat e lëndës Gjykatës Supreme [...], pasi që nuk ka mundë të veprojë sipas sugjerimeve të gjykatë së Apelit, meqenëse i njëjti Aktvendim ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore, meqenëse çdo veprim i Gjykatës Themelore në Gjakovë, sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit do të ishte kundërligjorë*”.
43. Andaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se “*Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është kundërligjorë, meqenëse [...] është marrë në kundërshtim me nenin 211.3 të Ligjit mbi procedurën*

kontestimore, meqenëse në rastin konkret vlera e kontestit ka qenë 200.00(Dyqindë)Euro, andaj duke u bazuar në nenin 211.3 të LPK-ës decidivisht është paraparë se: Revizioni nuk lejohet në kontestet pasuroro juridike ... , poqëse vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000.00(Tremijë)Euro”.

44. Lidhur me këtë, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme nuk kishte të drejtë të trajtonte revizionin pasi i njëjti ishte i palejuar dhe nuk kishte arsyetuar pretendimin e tij të paraqitur në përgjigjen në revizion, lidhur me vlerën e kontestit, duke theksuar se “*Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin e atakuar nuk deklarohet lidhur me pretendimet [e parashtruesit të kërkesës] në përgjigje në Revizion, të datës 11 Qershor 2018*”.
45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë se e drejta e tij për një gjykim të drejtë, e drejta për barazi para ligjit dhe e drejta për mbrojtje të pronës janë shkelur nga Gjykata Supreme si dhe të anulojë vendimin e kontestuar.

Komentet e Komunës së Gjakovës

46. Komuna e Gjakovës në përgjigjen e saj lidhur me kërkesën thekson se sipas Aktvendimit të kontestuar, çështja e parashtruesit është rikthyer në Gjykatën Themelore dhe se deri më tani kjo e fundit nuk ka vendosur sipas sugjerimeve të Gjykatës Supreme andaj, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.
47. Ndërsa lidhur me shumën e kontestit, Komuna e Gjakovës thekson se ndalesa për të paraqitur revizionin për shkak të shumës së vogël është e kundërligjshme pasi kjo është bërë për shkak të veprimeve jo të drejta të parashtruesit të kërkesës, pasi në rastin konkret bëhet fjalë për një sipërfaqe prej gjithsej 8 ari, atëherë vihet në dyshim se gjykatat kanë lejuar që të zhvillohet procedura gjyqësore me këtë vlerë të vogël të kontestit. Sipas komunës së Gjakovës gjykatat e rregullta kanë pasur për obligim sipas detyrës zyrtare që të mos lejojnë që të zhvillohet procedura përderisa nga ana e paditësit nuk bëhet precizimi – rritja e vlerës së kontestit. Andaj, Komuna pretendon se për shkak të veprimeve të parashtruesit të kërkesës nuk mund të dëmtohet Komuna, dhe ti humbet e drejta e revizionit.
48. Rrjedhimisht, Komuna kërkon që kërkesa e parashtruesit të shpallet e papranueshme.

Dispozitat Relevante Ligjore**Ligji nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i
Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-118****“Neni 36**

Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të kësaj gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.

[...]

Neni 211

[...]

211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.

[...]

Neni 218

- 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.*
- 2. Revizioni është i palejueshëm nëse:*
 - a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;*
 - b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;*
 - c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;*
 - d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet.*

Neni 219

219.1 Një ekzemplar të revizionit të paraqitur me kohë dhe që është i plotë dhe i lejueshëm, gjykata e shkallës së parë, brenda afatit shtatë ditor, ia dërgon palës kundërshtare.

219.2 Pala kundërshtare ka të drejtë që, brenda afatit shtatë ditor, nga dita në të cilën i është dorëzuar revizioni, në gjykatën e shkallës së parë ta paraqes përgjigjen në revizion.

219.3 Pasi të arrijë përgjigja në revizion apo pas skadimit të afatit për përgjigje, revizionin dhe përgjigjen, nëse është paraqitur, gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së revizionit, bashkë me dosjen e lëndës, brenda afatit shtatë ditor, nëpërmjet gjykatës së shkallës së dytë.

[...]

Neni 221

Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligji).

[...]"

Pranueshmëria e kërkesës

49. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
50. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

51. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

52. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2019, të 23 korrikut 2019 si dhe ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar me vendimin e kontestuar, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë.
53. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, Gjykata rikujton se Komuna e Gjakovës thekson se çështja e parashtruesit është rikthyer në Gjykatën Themelore dhe se deri më tani kjo e fundit nuk ka vendosur sipas sugjerimeve të Gjykatës Supreme andaj, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.
54. Megjithatë, Gjykata thekson se lidhur me çështjen thelbësore për të cilën ankohet parashtruesi i kërkesës e që ka të bëjë me lejueshmërinë e revizionit si rezultat i vlerës së kontestit, parashtruesi lidhur me vendimin e Gjykatës Supreme nuk ka mjet tjetër juridik që mund të ankohet.

55. Kjo për faktin se pasi Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.195/2019] ka rikthyer rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore, Gjykata Themelore ka për obligim të rishqyrtojë rastin sa i përket të drejtës së pronësisë lidhur me pronën e kontestuar dhe nuk mund të shqyrtojë sërish lejueshmërinë e revizionit të paraqitur nga Komuna në Gjykatën e Apelit, Gjykata Themelore nuk është me kompetente të adresojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me lejueshmërinë e revizionit të paraqitura në përgjigjen e tij në revizion.
56. Gjykata Themelore, ka pasur mundësi të bëjë një vlerësim të tillë pasi rasti ishte rikthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3860/18] të 12 marsit 2019. Mirëpo në atë rast, Gjykata Themelore ka vendosur që revizionin ta përcjellë në Gjykatën Supreme dhe të mos vendos lidhur me lejueshmërinë e saj, ashtu si kishte sugjeruar Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3860/18]. Gjithashtu, as Gjykata Supreme nuk ka vendosur lidhur me lejueshmërinë e revizionit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në përgjigjen e tij në revizion
57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës lidhur me kërkesën e tij i ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj.
58. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
59. Për më tepër, Gjykata po ashtu vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht ajo duhet deklaruar e pranueshme (shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat e kërkesës

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga Komuna e Gjakovës ka prishur Aktgjykimin [AC.nr.3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C.nr.38/2012] të 30 prillit 2013, të Gjykatës Themelore të cilat i kishin vërtetuar të drejtën e pronësisë mbi pronën e

kontestuar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Megjithatë, ai pretendon se ndaj Aktgjykimit [AC. nr. 3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, revizioni nuk ka qenë i lejuar duke pasur parasysh se vlera e kontestit sipas vendimeve gjyqësore të gjykatave të rregullta ishte 200.00 euro, pra nën shumën prej 3000.00 euro të paraparë në nenin 211, paragrafi 3 të LPK-së.

61. Andaj, ai pretendon se Vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme me të cilin rasti i vendosur përmes Aktgjykimit [C. nr. 38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore i cili është bërë përfundimtar përmes Aktgjykimin [AC.nr. 3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, është rikthyer sërish për vendosje në merita në Gjykatën Themelore pa një arsyetim mbi lejueshmërinë e revizionit sipas pretendimeve të paraqitura në përgjigjen e parashtresit të kërkesës në revizion, dhe me këtë ai pretendon se atij i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ si dhe e drejta për barazi para ligjit dhe e drejta për mbrojtje të pronës të garantuara me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës.
62. Gjykata thekson se sipas praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e më tejme: GJEDNJ), sipas së cilës bazuar në nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] Gjykata ka për obligim të interpretojë të drejtat e njeriut, i takon vetë Gjykatës të karakterizojë faktet e rastit *vis-à-vis* normave kushtetuese dhe se nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtresuesi i kërkesës (shih rastin e Gjykatës KO171/18, parashtres, *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimi i 25 prillit 2019, paragrafi 148; shih po ashtu, rastin e GJEDNJ, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).
63. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtresuesi i kërkesës në thelb ankohet se Gjykata Supreme, përmes vendimit të kontestuar ka rihapur Aktgjykimin [C. nr. 38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore i cili ishte bërë përfundimtar – *res judicata*, përmes Aktgjykimit [AC.nr. 3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, pasi ndaj tij nuk lejohej paraqitja e revizionit për faktin se shumica e kontestit e paraqitur në vendime gjyqësore ishte 200.00 euro ndërsa revizioni konform nenit 211, paragrafi 3 të LPK-së nuk lejohet nëse

shuma e kontestit është nën shumë prej 3000.00 euro, dhe për këtë nuk ka dhënë asnjë arsyetim.

64. Ndërsa Komuna e Gjakovës në anën tjetër, si palë e afektuar më vendimin e kontestuar, mban qëndrimin se në rastin konkret bëhet fjalë për pronën kontestuese në sipërfaqe totale prej 8 ari, dhe është a padiskutueshme se vlera e pronës së kontestuar është mbi shumën prej 3000.00 euro, dhe kjo e bënë revizionin të lejuar. Komuna nuk vë në dyshim faktin që gjatë gjithë procedurës shuma e kontestit që ka figuruar në vendimet gjyqësore ka qenë 200.00 euro, por thekson se gjykatat e rregullta kanë pasur për obligim *ex-officio* që të përmirësojnë shumën e kontestit dhe Komuna nuk mund të penalizohet që të përdorë mjetin juridik të revizionit për shkak të veprimeve të parashtruesit të kërkesës që ka paraqitur në padi vlerën joreale të pronës së kontestuar dhe gjykatave të rregullta të cilat nuk e kanë përmirësuar *ex-officio* shumën e kontestit gjatë procedurës para tyre.
65. Në këtë aspekt, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në lidhje me sigurinë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm, dhe i cili është bërë *res judicata*.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, siç është zhvilluar nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe GJEDNJ-së

66. Gjykata rikujton që e drejta për gjykim të drejtë kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e Gjykatës KO122/17, parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017, Aktgjykimi i 18 prill 2018, paragrafi 149; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999).
67. Gjykata rikujton se Gjykata dhe GJEDNJ ka dhënë përkufizimin e konceptit *res judicata* duke theksuar se: “Sipas raportit shpjegues për Protokollin nr. 7, i cili i referohet Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, “një vendim është final, ‘nëse, sipas shprehjes tradicionale, ka fituar fuqinë e *res judicata*. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të

thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë shteruar këto mjete ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa i shfrytëzuar ato” (shih rastin e Gjykatës KO122/17, cituar më lart, paragrafi 150; shih edhe rastin *Nikitin kundër Rusisë*, kërkesa nr. 50178/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2004, paragrafi 37).

68. Gjykata dhe GJEDNJ ka theksuar se parimi i sigurisë juridike presupozon respektimin e parimit *res judicata* duke shtuar se “[...] e drejta për një gjykim të drejtë para një tribunali siç garantohet me nenin 6 [paragrafi] 1 të Konventës duhet të interpretohet në dritën e preambulës së Konventës, e cila deklaron, në pjesën e saj përkatëse, që sundimi i ligjit të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit *res judicata*, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. [...] Një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose bindës” (shih rastin e Gjykatës KO122/17, cituar më lart, paragrafi 151; shih edhe rastin e GJEDNJ-së *Ponomaryov kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 3236/03, Aktgjykimi i 3 prillit 2008, paragrafi 40).
69. GJEDNJ ka shtjelluar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë edhe në raste të tjera. Në rastin *Ryabykh kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, GJEDNJ theksoi sa më poshtë: “Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të *res judicata* [...], që është parimi i formës së prerë të aktgjykimeve. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të detyrueshëm vetëm për qëllim të fitimit të një rishqyrtimi dhe një dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. Duhet të ushtrohet kompetenca e gjykatave më të larta për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë, por jo për të kryer një shqyrtim të ri. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një ankesë e maskuar dhe mundësia e thjeshtë për të pasur dy pikëpamje mbi këtë temë nuk është një bazë për rishqyrtim. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial bindës dhe detyrues. [...] Gjykata konsideron se e drejta e palës ndërgjyqëse në një gjykatë do të ishte po aq iluzore nëse sistemi ligjor i një Shteti Kontraktues lejon një vendim gjyqësor, i cili ishte bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t’u anuluar nga një gjykatë më e lartë sipas një kërkesë të bërë nga një zyrtar shtetëror” (shih rastin e Gjykatës KO122/17, cituar më lart, paragrafi 153; dhe rastin e GJEDNJ *Ryabykh kundër Rusisë*,

kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafët 52 dhe 56).

70. Gjykata Kushtetuese, gjithashtu, i referohet edhe Aktgjykimit të 17 dhjetorit 2010 në rastin nr. KIo8/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj, ku Gjykata theksoi: *“Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002 VII). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. [...] (shih rastin e Gjykatës KIo8/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK Feriza, Aktgjykimit i 17 dhjetorit 2010 paragrafi 62).*

71. Për më tepër, në Aktgjykimin e 12 shkurtit 2016 në rastin nr. KI132/15, parashtrues Manastiri i Deçanit, Gjykata theksoi *“Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime që rasti i tij të ishte vendosur në instancën e fundit nga Paneli i pronësisë dhe se ajo nuk ka mundur të rihapet para Kolegjit të Apelit. Si i tillë, parashtruesi duhet të ketë pare aktgjykimet e Kolegjit të Pronësisë të ekzekutuara. [...] Duke u bazuar në këto konsiderata dhe në praktikën e vet gjyqësore, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se aktgjykimet e Kolegjit të Apelit, të 27 dhjetorit 2012 (nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227), ishin bërë res judicata në bazë të vendimit të mëparshëm të formës së prere dhe të detyrueshëm të Kolegjit të Apelit, të 24 korrikut 2010, në lidhje me palët e autorizuar. [...] Duke përdorur procedurën e ankesës për të anuluar këto aktgjykime të Panelit të Pronësisë dhe për të referuar kontestin origjinal të pronësisë përsëri në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se, me vendimet e tij të 12 qershorit 2015 (nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009), Kolegji i Ankesave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe i ka mohuar parashtruesit një gjykim të drejte dhe të paanshëm për të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së” (shih rastin e Gjykatës KI132/15, parashtrues Manastiri i Deçanit, Aktgjykimin e 12 shkurtit 2016, paragrafët 95-97).*

72. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e përmendur më sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite, theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës përfshin parimin e sigurisë juridike, i cili përfshin parimin që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave.

(ii) Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rastin e tanishëm

73. Në kërkesën e parashtruesit të kërkesës çështja kryesore që duhet vlerësuar është nëse Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.195/2019] e ka rihapur çështjen e parashtruesit të kërkesës të vendosur me Aktgjykimin [AC. nr. 3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr. 38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore, me të cilën ishte aprovuar padia e parashtruesit të kërkesës dhe u vërtetua se parashtruesi i kërkesës është pronar i pronës së kontestuar.
74. Pas Aktgjykimit [AC.nr.3332/2013] të Gjykatës së Apelit, Komuna, përmes Gjykatës Themelore, parashtroi revizion në Gjykatën Supreme. Ndërsa parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje në revizion duke kontestuar lejueshmërinë e revizionit pasi sipas tij, vlera e kontestit ishte 200.00 euro ndërsa sipas nenit 211, paragrafit 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore revizioni nuk lejohet nëse vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumën prej 3000.00 euro. Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.38/2012], hodhi poshtë revizionin e Komunës si të palejuar me arsyetimin se vlera e kontestit të padisë dhe kërkesëpadisë lëndore ka qenë nën shumën prej 3000.00 euro.
75. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac.nr.3860/18], pas ankesës së Komunës, e ktheu në rigjykim dhe rivendosje rastin pasi vlerësoi se Gjykata e shkallë së parë është dashur që në zbatim të nenit 36 të LPK-së sipas detyrës zyrtare ta verifikojë vlerën e kontestit të treguar në padi dhe pastaj të marrë aktvendim për caktimin e vlerës së kontestit. Në rastin konkret, sipas Gjykatës së Apelit, Komunës i është pamundësuar që të paraqesë mjetin e jashtëzakonshëm juridik, revizionin. Gjykata e Apelit theksoi se *“gjykata e shkallës së parë në procedurën e përsëritur udhëzohet që të veprojë konform nenit 219 të LPK-së dhe pastaj revizionin së bashku me shkresat e lëndës brenda afatit ligjor t’ia përcjellë Gjykatës Supreme [...]”*.

76. Nga dosja e lëndës vërehet se Gjykata Themelore pas Aktvendimit [Ac.nr. 3860/18] të Gjykatës së Apelit, ia përcjellë shkresat e lëndës Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me revizionin. Ndërsa, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr.195/2019] e pranoi si të bazuar revizionin, e prishi Aktgjykimin [AC.nr.3332/2013] të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C.nr. 38/2012] të 30 prillit 2013, të Gjykatës Themelore me të cilat ishte vërtetuar e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesë për pronën e kontestuar, dhe lëndën e ktheu në rigjykim.
77. Gjykata vëren se, as Gjykata Themelore, pas kthimit të rastit nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3860/18] lidhur me lejueshmërinë e revizionit, e as Gjykata Supreme nuk e kishte trajtuar pretendimin e parashtruesit lidhur me paligjshmërinë e revizionit për shkak të shumës së caktuar të padisë prej 200,00 euro dhe vendimin e saj e arsyeton duke u bazuar në përmbajtjen e thënieve të kontestuar.
78. Në këtë kontekst, nuk është kontestues fakti se nëse vlera e kontestit është nën shumën 3000.00 euro, sipas paragrafit 3 të nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kur revizioni nuk është i lejuar. Gjithashtu, Gjykata nuk do të lëshohet në çështjen se cila është vlera reale e kontestit në procedurë. Çështja kryesore që paraqitet para Gjykatës është se deri në cilën pikë është e mundur të kundërshtohet vlera e kontestit gjatë procedurës.
79. Gjykata vëren se kontestuese është nëse vlera e kontestit e cila është paraqitur në vendimet gjyqësore deri sa rasti i parashtruesit është vendosur nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 3332/2013] ishte e saktë dhe nëse kjo është dashur të korrigjohet gjatë procedurë gjyqësore. Gjithashtu, kontestues është edhe fakti nëse pavarësisht shumës së cekur në padi dhe vendimeve gjyqësore, ajo që është me rëndësi kur të vlerësohet lejueshmëria e revizionit është vlera reale e objektit të kontestit apo vlera e paraqitur në padi dhe vendime gjyqësore.
80. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton nenin 36 të Ligjit të Procedurës Kontestimore që përcakton se:

“[n]ë qoftë se paditësi [...] vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, [...] e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se

të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi.”

81. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se lidhur me shumën e kontestit, dhe nëse shumë e objektit të kontestit nuk është e saktë, gjykata ose sipas *“detyrës zyrtare”* ose *“sipas prapësimit të palës së paditur”* por *“para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore”* do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rastin konkret, gjatë gjithë procedurës së zhvilluar shumë e objektit të kontestit ishte 200.00 euro. Kjo shumë nuk ishte kontestuar as *ex-officio* nga gjykata dhe as Komuna nuk e kishte kontestuar që kjo shumë nuk ishte e saktë në mënyrë që Gjykata Themelore të vendos para shqyrtimit gjyqësor lidhur me shumën e saktë të objektit të kontestit.
82. Andaj, Gjykata thekson se bazuar në gjuhën e qartë të neni 36 të Ligji të Procedurës Kontestimore, çështja e shumës së kontestit, pavarësisht se sa ishte ajo në realitet duhej të ishte korrigjuar deri në fillimin e shqyrtimit të çështjes kryesore. Gjykata vëren se ky korrigjim i mundshëm i vlerës së kontestit nuk është bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor.
83. Komuna thekson se Gjykata Themelore ka pasur për obligim *ex-officio* që të verifikojë vlerën e objektit të kontestit dhe se Komuna si palë nuk mund t’i bartë pasojat e gabimeve të gjykatave. Megjithatë, Gjykata vëren se Komuna ka pasur të drejtë sipas ligjit që të ngrejë këtë çështje para Gjykatës Themelore por një gjë të tillë nuk e ka bërë. Për më tepër, një gjë e tillë nuk është bërë as nga Gjykata Themelore pasi rasti i parashtruesit të kërkesës lidhur me lejueshmërinë e revizionit ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3860/18] dhe as nga Gjykata Supreme e cila kishte shqyrtuar revizionin e Komunës dhe përgjigjen në revizion të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës e ku ai ngrit çështjen e lejueshmërisë së revizionit.
84. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe nenit 221 të Procedurën Kontestimore që përcakton se *“Revizionin [...] të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligji). [...]”*
85. Andaj, ka qenë obligim i Gjykatës Supreme që si instancë e fundit që para se të vlerësojë revizionin lidhur me objektin e çështjes

kontestuese, të vlerësojë nëse revizioni është i lejuar, bazuar në dispozitat juridike të cekura më lart nga Gjykata.

86. Rrjedhimisht, dhe bazuar në këto vlerësime si dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të saj, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar ka rihapur rastin e parashtruesit të kërkesës të vendosur me Aktgjykimin [AC.nr.3332/2013], të 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore dhe të cilat ishin bërë *res-judicata*, duke pasur parasysh vlerën e kontestit e cila sipas vendimeve gjyqësore ishte nën shumën për të cilën është i lejuar revizioni, ndërsa vlera e objektit të kontestit me asnjë vendim të gjykatave të rregullta nuk ishte kontestuar dhe korrigjuar.
87. Rrjedhimisht, duke prishur Aktgjykimin [AC.nr. 3332/2013] e 26 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit, e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin [C.nr.38/2012] të 30 prillit 2013 të Gjykatës Themelore, pa e vlerësuar lejueshmërinë e revizionit, Gjykata Supreme kishte shkelur parimin e sigurisë juridike dhe i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafit 2 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së.
88. Andaj, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të mbrojtur me nenin 31 paragrafi 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.
89. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës dhe të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenet 46, respektivisht 24 të Kushtetutës, duke pasur parasysh që Gjykata sapo konkludoi se Vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, dhe shpall të pavlefshëm Aktvendimit Rev. nr. 195/2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 korrikut 2019, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të trajtojë ndaras pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës dhe të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenet 46, respektivisht 24 të Kushtetutës.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

90. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohet.

91. Ne këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. [...]".

92. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar dhe nuk ka paraqitur dëshmi me të cilat do të kishte justifikuar kërkesën e tij për mos zbulimin e identitetit të tij, dhe rrjedhimisht, kjo kërkesë e parashtruesit hidhet poshtë si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 29 korrik 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 24 dhe nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.195/2019 i 23 korrikut 2019 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr. 3860/18 i 12 marsit 2019, shfuqizohen;
- V. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AC.nr.3332/2013 i 26 prillit 2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C.nr.38/2012 i 30 prillit 2013, janë përfundimtarë dhe të detyrueshëm, dhe si të tillë *res judicata*;
- VI. Të REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;

- VII. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta informojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se më 23 dhjetor 2020, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate, në pajtim me rregullin 66 (4) të Rregullores së punës;
- VIII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhri;
- IX. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- X. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI27/20 Parashtrues: Lëvizja Vetëvendosje!, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A-U.ZH.nr.16.2019] të 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës

KI27/20 Aktgjykimi i datës 22 korrik 2020, i publikuar më 07 shtator 2020

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, fushatë zgjedhore, liria e shprehjes, kufizimet e të drejtave të njeriut#

Personi E.B kishte ushtruar ankesë në Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (në tekstin e mëtejme: PZAP) kundër parashtruesit të kërkesës, me pretendimin se me datë 4 tetor 2019, kandidati i parashtruesit të kërkesës për deputet M.B. për zgjedhjet e 6 tetorit 2020, kishte publikuar/shpërndarë një video incizim në rrjetin social facebook, ku, mes tjerash, në video incizim i) ishte përdorur hapësirat e objektit të Policisë së Kosovës; si dhe ii) ishte përdorur fotoja e tij pa lejen e tij duke përdhos, sipas personit E.B., emrin, dinjitetin dhe pozitën e tij si drejtor në Policinë e Kosovës. Ai pretendonte se këto veprime binin ndesh me rregullat e zgjedhore.

PZAP përmes Vendimit [nr.233/2019], kishte miratuar si të bazuar ankesën e palës E.B, dhe parashtruesit të kërkesës i shqiptoi gjobë në lartësi prej 9,500.00 (nëntë mijë e pesëqind) euro, për shkak të: i) publikimit në spotin e fushatës zgjedhore të objektit të Policisë së Kosovës në Prishtinë; dhe ii) përfshirjen e personit privat E.B., pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 [Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike] të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Vendimi i lartcekur i PZAP-së ishte konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [nr.A.A-U.ZH.nr.16/2019], me të cilin ishte refuzuar si e pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A-U.ZH.nr.16/2019] të 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supremes, përmes të cilit pretendohet se është gjobitur në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, mes tjerash, për shkak se spoti i fushatës zgjedhore është publikuar jashtë fushatës zgjedhore. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës si dhe nenet 10 [Liria e Shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese pasi konstatoi se kërkesa e parashtruesit plotëson kriteret e pranueshmërisë, gjatë vlerësimit të meritave të rastit, fillimisht

vlerësoi pretendimin kryesor të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhej me lirinë e shprehjes të garantuar më nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ. Lidhur me këtë Gjykata Kushtetuese elaboroi parimet e përgjithshme të lirisë së shprehjes të përcaktuara edhe në praktiken gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në aplikimin e këtyre parimeve në rastin konkret gjeti se kufizimi i lirisë së shprehjes i pretenduar nga parashtruesi i kërkesës ka qenë i paraparë me ligj, ka pasur qëllim legjitim mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe fer, si dhe ka plotësuar parimin e proporcionalitetit. Prandaj, Gjykata konstatoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se në rastin konkret është shkelur e drejta për lirinë e shprehjes e garantuar më nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ. Për më tepër, Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet për shkelje të të drejtave tjera të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës dhe gjeti se me Aktgjykimin [A.A-U.ZH.nr.16.2019] të 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme, po ashtu nuk jetë shkelur të drejtat e përcaktuara në nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI27/20

Parashtrues

Lëvizja VETËVENDOSJE!

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A-U.ZH.nr.16.2019] i 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, e përfaqësuar nga Blerim Sallahu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [A.A-U.ZH.nr.16/2019] e 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 7

[Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) si dhe nenet 10 [Liria e shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) si dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 6 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin, me të cilin autorizon Blerim Sallahun nga Prishtina, ta përfaqësojë parashtruesin e kërkesës në Gjykatë.
7. Më 11 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese) Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 20 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, po ashtu një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme si dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (në tekstin e mëtejshëm: PZAP).
9. Më 10 qershor 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë ankesën që e kishte dorëzuar në Gjykatën Supreme.

10. Më 18 qershor 2020, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës ankesën e kërkuar më 10 qershor 2020.
11. Më 22 korrik 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
12. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë votash, se nuk ka pasur shkelje të neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, neneve 10 [Liria e shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 26 gusht 2019, Presidenti i Republikës së Kosovës nxori Dekretin [nr.236/2019] për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat u caktuan për datën 6 tetor 2019.
14. Më 27 gusht 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshme: KQZ) nxori Vendimin [nr.824-2015] për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Pika I) e këtij Vendimit parashihte se *“Fushata Zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore fillon më 25 shtator dhe përfundon më 4 tetor 2019”*.
15. Më 5 tetor 2019, E.B. kishte ushtruar ankesë në PZAP kundër parashtruesit të kërkesës me pretendimin se më 4 tetor 2019, kandidati i tyre për deputet M.B. kishte publikuar/shpërndarë një video incizim në rrjetin social Facebook, ku, mes tjerash, në video incizim i) ishin përdorur hapësirat e objektit të Policisë së Kosovës; si dhe ii) ishte përdorur fotoja e tij pa lejen e tij duke përdhosur, sipas tij, emrin, dinjitetin dhe pozitën e tij si drejtor në Policinë e Kosovës. Ai pretendonte se këto veprime binin ndesh me rregullat e KQZ-së.
16. Më 6 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar përgjigje ndaj ankesës së E.B. drejtuar PZAP-së duke theksuar se: (i) ankesa është e palejuar dhe e pabazuar me arsyetimin se E.B., nuk ka legjitimitet aktiv, për ushtrimin e ankesës sa i përket procesit zgjedhor sipas nenit 19 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshme: LZP);

(ii) fotoja e publikuar e ankuesit E.B. ishte publikuar më parë në një faqe të gazetës kallxo.com dhe nuk përdorej përherë të parë (iii) paraqitësi i ankesës nuk ka bërë një përshkrim të hollësishëm të datës, kohës dhe vendit të shkeljes së pretenduar ashtu siç parashihet me rregullat zgjedhore; dhe publikimi i videos në fjalë, është bërë më datë 19 shtator 2019, jashtë periudhës së fushatës, jashtë afatit të heshtjes zgjedhore dhe jashtë objektit të Policisë së Kosovës, respektivisht ne trotuar dhe jo në objektin e Policisë së Kosovës.

17. Më 6 tetor 2019, PZAP përmes Vendimit [nr.233/2019], kishte miratuar si të bazuar ankesën e palës E.B., dhe parashtuesit të kërkesës i shqiptoi gjobë në lartësi prej 9,500.00 (nëntë mijë e pesëqind) euro, për shkak të: i) publikimit në spotin e fushatës zgjedhore të objektit të Policisë së Kosovës në Prishtinë; dhe ii) përfshirjen e personit privat E.B., pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike] të LZP-së. PZAP në vendimin [nr.233/2019], lidhur me pretendimet e parashtuesit të kërkesës në përgjigjen në ankesë ka arsyetuar si vijon:

- (i) Për sa i përket pretendimeve të parashtuesit se E.B. nuk ka legjitimitet aktiv për parashtrimin e ankesës, Kolegji ka vlerësuar se ky pretendim nuk qëndron për faktin se me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht me nenin e tij 119, paragrafi 1 përcaktohet që: “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të KZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë KZAP-it”. Se personi në fjalë ka legjitimitet që në këtë çështje të paraqesë një ankesë lidhet me faktin se fotografia e tij është përdorur gjatë promovimit të një subjekti politik, dhe duke marrë për bazë që fotografia në fjalë përdoret në një konotacion negativ dhe pa pëlqimin e të njëjtit, më ç’rast cenohet dinjiteti i tij.
- (ii) Lidhur me pretendimet e ankuesit se fotografia e Emin Beqirit ishte publikuar më parë në një faqe të gazetës kallxo.com, Kolegji vlerësoi se kjo nuk përbën justifikim për përdorimin e fotografive të përmendura nga të tjerët pa lejen e tij. Fotografia në media përdoret me qëllim të informimit të publikut, që është detyra kryesore e mediave rreth një ngjarjeje, ndërsa përdorimi nga ana e kandidatit për deputet, si në këtë rast, është bërë gjatë promovimit të kandidatit M.F. në fushatën zgjedhore.

- (iii) Në lidhje me pretendimet për mos specifikimin e vendit, kohës dhe datës kur ka ndodhur shkelja, Kolegji vlerëson se afati kohor për ankuesin fillon që nga momenti kur ankuesi bëhet i vetëdijshëm për shkeljen e kryer, në kuptimin e nenit 5 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP nr. 02/2015, në këtë rast ankuesi kuptoi për shkeljen më 04.10.2019. në orët e mbrëmjes, nga e cila rrjedh se kjo ishte gjatë fushatës zgjedhore.
18. Përveç këtij që u tha më sipër, PZAP gjithashtu mori parasysh faktin se subjektit politik në fjalë iu dha mundësia që t'i përgjigjet ankesës dhe të korrigjonte shkeljen e kryer, megjithatë, si përgjigje ndaj ankesës, subjekti politik në fjalë theksoi se procedura e tyre nuk përmban shkelje sipas dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi, pa ofruar asnjë dëshmi nga ana e tyre se janë ndërmarrë veprime për të shmangur shkeljen, siç kërkohet nga neni 120, paragrafi 1, pika c) e LZP-së, dhe këto janë veprime që kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, si në dispozitivin e këtij vendimi e në kuptim të nenit 120, paragrafi 1, pika c) e LZP-së.
19. Më 9 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit [nr.233/2019] të 6 tetorit 2019, ku kontestoi ligjshmërinë e vendimit në fjalë duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të ligjit, duke argumentuar, mes tjerash, se spoti i publikuar është bërë jashtë fushatës zgjedhore dhe si pasojë nuk aplikohen dispozitat e LZP-së të cilat janë të aplikuara vetëm gjatë fushatës zgjedhore, andaj, veprimi i sanksionuar nga PZPAP, ka qenë i kundërligjshëm.
20. Më 10 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [nr.A.A-U.ZH.nr.16/2019] refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ku theksoi se:

“Neni 33.1 (b) LZP përcakton se është e ndaluar që subjektet politike, kandidatet, mbështetësit e tyre gjatë periudhës së fushatës të vendosin njoftimet pllakatet dhe posterët, ose përndryshe, vendosjen e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.

Nisur nga dispozitat e më sipërme, Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i [kërkesës], subjekti politik (LVV), gjatë fushatës, për qëllime elektorale, në kundërshtim me ligjin (neni 33 pika b LZP), për shkak të publikimit e një video-spoti, objektin publik të Policisë së Kosovës në Prishtinë dhe përfshirjen e personit tjetër pa lejen e tij. Gjykata Supreme, po ashtu konstatoi se është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike dhe se PZAP ka vërtetuar dhe zbatuar drejtë ligjin, duke e miratuar si të bazuar ankesën e E.B nga Lipjani, duke ia shqiptuar subjektit politik (LVV) dënimin me gjobë në vlerë prej 9.500 euro, konform neneve 33.1(b) dhe 120.1(c) të LZP.”

Pretendimet e parashtruesit së kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktgjykimi [nr.A.A-U.ZH.nr.16/2019] i 10 tetorit 2019 i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, nenet 10 [Liria e shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së, si dhe nenin 7 i DUDNJ-së.
22. Gjykata vëren së në esencë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet mund të përmbliidhen me sa vijon:
 - i. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e lirisë së shprehjes e cila është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së;
 - ii. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimin e mosdiskriminimit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 DUDNJ-së;
 - iii. Pretendimet në lidhje me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës;
 - iv. Pretendimet në lidhje me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.
- (i) **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së**
23. Sa i përket përmbajtjes së video incizimit të publikuar nga kandidati i parashtruesit të kërkesës, ai thirret në lirinë e shprehjes së garantuar

me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së, duke theksuar se veprimi i kandidatit të tij për deputet kualifikohet në kornizat e lirisë së shprehjes.

24. Parashtruesi i kërkesës thekson se liria e shprehjes është e drejtë themelore kushtetuese dhe ndërkombëtare, e cila mbron jo vetëm informacionin ose idetë që preferohen në mënyre të favorshme ose që konsiderohen si jo ofensive, ose si indiferente, por edhe ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë. Shprehja, e mbrojtur me nenin 10, nuk kufizohet me fjalët, si të shkruara apo të folura, por shtrihet edhe në vizatime, imazhe dhe veprime që kanë si qëllim të shprehin një ide ose të prezantojnë informacion. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe në rastin e tij ka të bëjë me shpërndarje të informacionit, ku dhe kjo hynë në kornizat e lirisë së shprehjes. Pra parashtruesi i kërkesës thekson se liria për të dhënë informacion dhe ide është e rëndësishme madhore për jetën politike dhe strukturën demokratike të një vendi, dhe se zgjedhjet e lira nuk mund të mbahen demokratikisht në mungesë të kësaj lirie.
25. Parashtruesi i kërkesës tutje duke iu referuar nenit 10 të KEDNJ-së thekson se ky nen mbron mendimet, kritikën dhe spekulimet të cilat mund të mos provohen si të vërteta. Sipas tij neni 10 i KEDNJ-së garanton edhe mendimet e shprehura në gjuhë të ekzagjeruar në fushata elektorale, për qëllime të interesit publik, debateve publike, ku mendimet dhe kritikën e dhëna për autoritete publike shprehen në formë të ashpër. Në lidhje me këto pretendime ai iu referohet disa rasteve të GJEDNJ-së si p.sh.: *Thorgeirson kundër Islandës*, Aktgjykim i 25 qershorit 1992; *Dalban kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 28 shtatorit 1999; *Narodni List D.D kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 8 nëntorit 2018; si dhe *Groppera Radio AG dhe të tjerat kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 28 marsit 1990, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 1976.
26. Parashtruesi i kërkesës pohon se kandidati për deputet M.B., më 19 shtator 2019, ka publikuar një videospot jashtë objektit të policisë, në të cilin janë shfaqur dy fotografi të huazuara nga portali kallxo.com. Më këtë ai pretendon se kandidati i tyre për deputet vetëm ka rishfaqur një informacion të marrur nga portali në fjalë, dhe se kjo sipas tij përbën dhënie të informacionit të mbrojtur me lirinë e shprehjes të përcaktuar me nenin 40 të Kushtetutës paragrafi 2 lidhur me nenin 10 paragrafi 2 të KEDNJ-së, si dhe është në harmoni me vendimet e GJEDNJ-së. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i PZAP dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia kanë cenuar lirinë e shprehjes kandidatit të tyre për deputet, për arsye se publikimi i video incizimit në fjalë ka pasur për qëllim informimin lidhur me

“veprat e korrupsionit dhe dështimin e sistemit të drejtësisë për të ndjekur dhe gjykuar vepra penale të korrupsionit, të kryera nga policë të caktuar brenda policisë së Kosovës” dhe atë jashtë periudhës së fushatës zgjedhore. Gjithashtu videoincizimi ka transmetuar një çështje të interesit publik. Rrjedhimisht, ky video incizim në tërësi kualifikohet brenda konceptit të lirisë së shprehjes.

(ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimin e mosdiskriminimit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ

27. Parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së thekson se PZAP dhe Gjykata Supreme kanë nxjerrë vendime arbitrare në kundërshtim të plotë me të drejtën materiale, duke shtuar se *“në asnjë rast tjetër përveç këtij rasti, PZAP nuk ka sanksionuar subjekte politike sipas LZP, për veprime të cilat janë kryer dhe publikuar jashtë fushatës zgjedhore”*.
28. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se vlerësimi i rastit, i cili ka ndodhur jashtë fushatës zgjedhore është kualifikuar gabimisht nën kornizat e legjislacionit zgjedhor, dhe se vendimi i PZAP-së dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme *“përbën pabarazi ligjore dhe diskriminim për shkak të mendimeve politike ose mendimeve tjera të cilat i përfaqëson Lëvizja Vetëvendosje”*. Lidhur me këtë ai pretendon se nuk janë trajtuar njëjtë në krahasim me subjektet e tjera politike, për shkak se subjektet e tjera politike janë sanksionuar vetëm gjatë fushatës zgjedhore.
29. Sa i përket këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës përmend dy raste të tjera ku PZAP ka sanksionuar subjektet politike për publikimin e video incizimeve dhe fotove, mirëpo vetëm gjatë fushatës zgjedhore, konkretisht (i) Vendimin e PZAP-it [A.nr.93/2019] të 27 shtatorit 2019 ku PZAP i kishte shqiptuar gjobë Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në shumë prej 3.100 për shkak se një kandidate e partisë kishte publikuar një fotografi të kryetarit të Komunës së Shtimes i cili njëkohësisht ishte edhe kandidat për deputet nga PDK, i cili i përket partisë së saj, në zyrën e tij në komunë, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së dhe (ii) Vendimin e PZAP-së [Anr/108/2019] të 30 shtatorit 2019 me të cilin PZAP i shqiptoi gjobë në vlerë prej 9500 euro subjektit politik AAK-PSD për shkak se kandidati i tyre për kryeministër kishte publikuar ne Facebook një video ku shihen pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe kishte shkruar *“2000 policë shtesë deri në fund të mandatit”*, ku me këtë ishte shkelur

rregulla zgjedhore nr.13/2013 e ndryshuar dhe plotësuar me rregullën zgjedhore nr.20/2019. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet edhe Vendimit të PZAP [A.181/2019] të 4 tetorit 2019, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e paraqitur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent kundër parashtruesit të kërkesës pasi ankuesi nuk kishte paraqitur prova dhe nuk kishte bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me pretendimet për shkelje të rregullave zgjedhore nga parashtruesi i kërkesës. Andaj, parashtruesi pretendon se janë trajtuar ndryshe në situata relativisht të ngjashme.

(iii) Pretendimet lidhur me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës

30. Parashtruesi i kërkesës fillimisht ankohet lidhur me interpretimin e PZAP dhe Gjykatës Supreme të aplikimit kohor të rregullave zgjedhore. Ai pretendon se *“fushata zgjedhore ka filluar me 25 shtator 2019, ndërsa publikimi i video incizimit në Facebook është bërë më 19 shtator 2019, pra jashtë fushatës zgjedhore”* të përcaktuar me Vendimin e KQZ-së[nr.824-2919]. Lidhur me këtë ai shton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës konkretisht me sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike për arsye se Gjykata Supreme dhe PZAP *“kanë vepruar arbitrarisht duke nxjerrë vendime kundër kushtetuese për veprime të cilat nuk janë paraparë dhe nuk janë ndaluar me ligj në kohën e kryerjes”*.
31. Kjo pasi PZAP fillon të veprojë nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore, më 25 shtatorit 2019, dhe çdo veprim i ndaluar i subjekteve politike apo publikim gjatë kësaj periudhe konsiderohet shkelje e LZP-së. Këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e mbështet duke u bazuar edhe në nenin 33 të LZP-së që përcakton se *“Gjatë periudhës së fushatës subjektet politike, mbështetësit ose kandidatët e tij ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim [...]”*.
32. Parashtruesi i kërkesës më tej shton se nëse video incizimet e kandidatëve për deputet vazhdojnë të qëndrojnë në rrjetet sociale të tyre dhe vihen re nga persona të caktuar në fushatën e ardhshme zgjedhore edhe atëherë do mund t'i nënshtrohen sanksioneve të ngjashme. Këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës e ndërlidh edhe me vendimin e PZAP-së Anr:181/2019, të 4 tetorit 2019, në të cilin PZAP kishte refuzuar kërkesën e një ankuesi pikërisht për faktin që ankuesi në atë rast nuk kishte saktësuar kohën kur është xhiruar dhe publikuar spoti në fjalë. Andaj, në këtë rast PZAP kishte vlerësuar se kusht i domosdoshëm për të kualifikuar një rast nëse është veprim i kryer ose i ndaluar gjatë fushatës zgjedhore është data e publikimit të video incizimit dhe jo data e vënies re të tij.

33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet edhe Rregullës nr.02/2015 Rregullat dhe Procedurat, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (në tekstin e mëtejshëm: Rregulla nr.02/2015 të PZAP), përkatësisht neni 5 paragrafi 7 që përcakton kriteret formale të cilat duhet t'i plotësojë një ankesë duke theksuar se një ankesë duhet të përmbajë *“një përshkrim të hollësishëm duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar”*. Sipas parashtruesit të kërkesës, personi E.B. me rastin e paraqitjes së ankesës në PZAP nuk e ka respektuar Rregullin nr.02/2015 të PZAP, mirëpo PZAP *“qëllimisht i ka ikur zbatimit të tërësishëm të nenit 5 të kësaj rregulle, duke zbatuar gabimisht paragrafin, që si pasojë ka prodhuar shkelje të dispozitave kushtetuese, akteve ndërkombëtare dhe ligjeve vendore”*. Pra, parashtruesi i kërkesës thekson se *“data, koha dhe shkelja e pretenduar si dhe shikimi i veprimit të supozuar si i ndaluar me LZP, duhet të ndodhë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në mënyrë që të respektohet në tërësi hierarkia e akteve juridike”* duke përfshirë nenin 5, paragrafi 5 të Rregullit nr.02.2015 të PZAP që përcakton se *“për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZP-it brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar”*.

(iv) Pretendimet në lidhje me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës

34. Parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton mënyrën se si ka ardhur deri tek shkelja e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës, ai vetëm se konstaton se *“... përmbajtja e aktgjykimit nën shenjen A.A.-U.zh.nr.16/2019 e Gjykatës Supreme e përmban cenimin...” dhe këto dy nene*.
35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta shpallë të pranueshme kërkesën dhe Aktgjykimin [A.A-U.ZH.nr.16/2019] e Gjykatës Supreme ta shpallë në kundërshtim me Kushtetutën.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

38. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

39. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

40. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtguesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridikë (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI41/09, parashtguesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, në paragrafin 14; *Partia për shoqëri demokratike dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 3840/10, Aktgjykimi i 12 janarit 2016).
41. Për më tepër, dhe në këtë kuptim, Gjykata thekson gjithashtu se GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore i ofron garanci gjithashtu edhe partive politike sikur personave juridikë dhe se ato mund të ankohen në mënyrë të pavarur nga kandidatët e tyre (shih, për shembull, *Partia Laburiste e Gjeorgjisë kundër Gjeorgjisë*, nr. 9103/04, GJEDNJ, Aktgjykimi i 8 korrikut 2008, paragrafët 72-74 dhe referenca të tjera të cituara në atë vendim). Prandaj, Gjykata konkludon se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar të paraqesë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
42. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [A.A.-U.ZH.nr 16/2019] e 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
43. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës dhe se nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër, të përcaktuar me Rregulloren e punës. Rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

Meritat e kërkesës

44. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohej para Gjykatës lidhur me Aktgjykimin e kontestuar duke pretenduar shkelje të drejtave të tij kushtetuese. Andaj, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës si në vijim:
- i. Pretendimet e parashtruesit në lidhje me shkeljen e lirisë së shprehjes e cila është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së;
 - ii. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimin e mosdiskriminimit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 DUDNJ-së;
 - iii. Pretendimet në lidhje me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës;
 - iv. Pretendimet në lidhje me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.
45. Prandaj, Gjykata do të analizojë dhe shqyrtojë në mënyrë të detajuar secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës dhe do t'i përgjigjet secilit nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës veç e veç.

(i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së

46. Gjykata fillimisht do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aq sa ato ndërlidhen me lirinë e shprehjes së garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ.

Parimet e përgjithshme të lirisë së shprehjes duke përfshirë edhe gjatë kohës së fushatës zgjedhore

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.

2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe

provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”

48. Gjykata më tej i referohet nenit 10 [Liria e shprehjes] të KEDNJ-së, i cili përcakton:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.”

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

49. Gjykata fillimisht thekson se neni 10 i KEDNJ-së, është interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 40 të Kushtetutës në lidhje me nenin 10 të KEDNJ-së, Gjykata do t’i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

50. Në lidhje me këtë, GJEDNJ-ja ka përsëritur se “*liria e shprehjes përbën bazën kryesore të një shoqërie demokratike edhe njërën nga kushtet kryesore për progresin dhe përmbushjen individuale*” (shih rastin e GJEDNJ *Scharsach and News Verlagsgesellschaftmbh kundër Austrisë*, Kërkesa nr. 39394/98, Aktgjykimi i 13 shkurtit 2004, paragrafi 30; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ *Feldek kundër Sllovakisë*, Kërkesa nr. 29032/95; Aktgjykimi i 12 tetorit 2001, paragrafi 72). Në këtë aspekt, fushëveprimi i lirisë së shprehjes është interpretuar në mënyrë të gjerë nga GJEDNJ, për të përfshirë jo vetëm substancën e informatave apo ideve, por gjithashtu mënyrat e ndryshme përmes të cilave ato manifestohen, transmetohen dhe pranohen (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Sokolowski*

kundër Polonisë, Kërkesa nr. 75955/01, Aktgjykimi i 29 qershorit 2005, paragrafi 44).

51. GJEDNJ po ashtu ka theksuar se liria e shprehjes nuk është absolute për nga natyra dhe si e tillë mund të kufizohet. Ashtu siç është paraparë me paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNJ, kjo liri është subjekt i përjashtimeve apo kufizimeve, të cilat, megjithatë, duhet të parashihen qartësisht, dhe nevoja për çdo kufizim duhet të vendoset në mënyrë bindëse. Por, GJEDNJ ka sqaruar se me gjithë kufizimet e paragrafit 2 të nenit 10 të KEDNJ, liria e shprehjes aplikohet jo vetëm lidhur me “informatat” apo “idetë” që janë të favorshme, jo fyese apo indiferente, por gjithashtu të atyre që ofendojnë, trondisin apo shqetësojnë (shih rastin e GEDNJ *Scharsach and NewsVerlagsgesellschaftmbh kundër Austrisë*, Kërkesa nr. 39394/98, Aktgjykimi i 13 shkurtit 2004, paragrafi 30; shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Feldek kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi i 12 tetorit 2001, paragrafi 72 - 76).
52. Andaj, sipas GJEDNJ, testi “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” kërkon që GJEDNJ të vendosë nëse “ndërhyrja” për të cilën ankohen parashtruesit korrespondon më “nevojën e domosdoshme shoqërore”, nëse ka qenë e nevojshme për qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet shtetërore për të arsyetuar kufizimin janë relevante dhe të mjaftueshme. Gjatë vlerësimit nëse një nevojë e tillë ekziston dhe cilat masa duhet të nxjerrën, autoritetet shtetërore kanë një margjinë të vlerësimit të lirë, përkatësisht një hapësirë diskrecionale të vlerësimit. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së kjo hapësirë e vlerësimit nuk është e pakufizuar por duhet të jetë në harmoni me mbikëqyrjen Evropiane nga GJEDNJ, detyra e së cilës është të japë vendimin përfundimtar nëse kufizimet janë të pajtueshme me lirinë e shprehjes ashtu si mbrohet kjo liri me nenin 10 të KEDNJ. GJEDNJ ka sqaruar se detyra e saj gjatë ushtrimit të funksionit të saj mbikëqyrës, nuk është që të zëvendësojë autoritetet shtetërore por sipas nenit 10 të KEDNJ, në bazë të rastit si tërësi, të rishikojë vendimet e autoriteteve shtetërore, bazuar në hapësirën e tyre të vlerësimit. Në këtë aspekt, GJEDNJ duhet të bindet se autoritetet shtetërore kanë aplikuar standardet të cilat janë në pajtueshmëri me parimet e mishëruara në nenin 10, dhe për më tepër, që ato bazojnë vendimet e veta në vlerësimin e pranueshëm të fakteve vendimtare (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Feldek kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 73; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ *Vogt kundër Gjermanisë*, Kërkesa nr. 17851/91, Aktgjykimi i 26 shtatorit 1995, paragrafi 52).

53. Gjithashtu, GJEDNJ thekson se parimet e përgjithshme lidhur me lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ, vlejnë po ashtu edhe për lirinë e shprehjes politike. Në fakt, GJEDNJ i ka dhënë “rëndësi të veçantë” debatit të lirë politik dhe shprehjes politike (shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Féret kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 15615/07, Aktgjykimi i 10 dhjetorit 2009, paragrafi 63). Gjithashtu, GJEDNJ ka deklaruar se ka hapësirë të vogël sipas nenin 10, paragrafi 2 të KEDNJ për të kufizuar lirinë e shprehjes politike (shih rastin e GJEDNJ *Perinçek kundër Zvicrës*, Kërkesa nr. 27510/08, Aktgjykimi i 15 tetorit 2015, paragrafi 197). Në këtë kontekst, GJEDNJ ka sqaruar se nëse lejohen kufizime të gjera për fjalime politike në raste individuale, kjo pa dyshim do të ndikonte në respektimin e lirisë së shprehje në përgjithësi në shtetin në fjalë (shih rastin e GJEDNJ *Feldek kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 83).
54. Sa i përket internetit si mënyrë e shprehjes dhe shpërndarjes së qëndrimeve politike, GJEDNJ nuk ka vendosur standarde esencialisht të ndryshme në nenin 10 të KEDNJ në raport me standardet e përgjithshme të lirisë së shprehjes të cekura më lart sipas parimit “*çka aplikohet offline aplikohet edhe online*”. Megjithatë, në rastin *Delfi AS kundër Estonisë*, GJEDNJ ka theksuar se “*për shkak të natyrës së veçantë të internetit, “detyrat dhe përgjegjësitë” që u jepen portaleve të lajmeve për qëllime të nenin 10 të KEDNJ, mund të jenë të ndryshme deri në një nivel nga ato të publikuesve tradicional sa i përket përmbajtjes së palës së tretë*” (shih rastin e GJEDNJ *Delfi AS kundër Estonisë*, Kërkesa nr. 64569/09, Aktgjykim i 16 qershorit 2015, paragrafi 113). Kjo për arsye se, rreziku që mund të shkaktohet nga përmbajtja e komunikimeve në internet sa i përket gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut është më i madh se në publikimet përmes mënyrave të tjera.
55. Në këtë aspekt, liria e shprehjes përfshin publikimin e deklaratave politike, programeve të subjekteve politike dhe të fotografive si dhe gjithashtu edhe shprehjen e opinioneve politike duke përfshirë postimin e përmbajtjes politike në internet (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Mariya Alekhina dhe të tjerët kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 38004/12, Aktgjykimi i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 251).
56. Për më tepër, GJEDNJ, në kontekst të zgjedhjeve, ka theksuar se liria e shprehjes duhet të balancohet me parimet e nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ që ka për qëllim krijimin dhe ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë të udhëhequr nga sundimi i ligjit. (shih rastin e GJEDNJ *Davydov dhe të tjerët kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 75947/11, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 274).

57. GJEDNJ ka theksuar se zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku formojnë themelin e sistemit demokratik. Këto të drejta janë të ndërlidhura dhe operojnë duke përfunduar njëra tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga “kushtet” e nevojshme për të siguruar shprehjen e lirë të opinionit të popullit në zgjedhjen e legjislaturës. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme që gjatë periudhës para zgjedhjeve, opinionet dhe informatat e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirshëm. Në kontekst të debateve zgjedhore, ushtrimi i lirisë së fjalës në mënyrë të papenguar nga kandidatët ka një rëndësi të veçantë (shih rastin e GJEDNJ *Orlovskaya Iskra kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 42911/08, Aktgjykim i 21 shkurtit 2017, paragrafi 110).
58. Në këtë kontekst, GJEDNJ ripërsërit se në rrethana të caktuara, ashtu si është sqaruar më lart, të drejtat e garantuara me nenin 10 dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, mund të vihen në konflikt dhe mund të jetë e nevojshme, gjatë periudhës para ose gjatë zgjedhjeve, të vendosen disa kufizime të tilla që zakonisht nuk do të ishin të pranueshme për lirinë e shprehjes, por këto kufizime bëhen për të siguruar “shprehjen e lirë të opinionit të popullatës gjatë zgjedhjeve të legjislaturës” (shih rastin e GJEDNJ *Orlovskaya Iskra kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 111).
59. Në këtë drejtim, GJEDNJ u ka njohur shteteve një margjinë të vlerësimit të lirë sa i përket sistemit elektoral. Rrjedhimisht, duke vendosur balancin në mes të të drejtave të nenit 10 të KEDNJ dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, shtetet kanë margjinë të vlerësimit, për aq sa ato kanë përgjithësisht diskrecion në përcaktimin e sistemit të tyre elektoral. Në një rast lidhur me fushatat e natyrës politike, GJEDNJ ka theksuar se natyra politike e fushatave të cilat ishin ndaluar gjatë zgjedhjeve, kanë kërkuar kontroll strikt dhe vlerësim po ashtu korrespondues kufizues sa i përket këtyre ndalesave (shih rastin e GJEDNJ *Orlovskaya Iskra kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 111).
60. Andaj, Gjykata thekson, duke u bazuar edhe në atë që u tha më lart, se nuk i takon asaj të shpreh pikëpamjen e saj lidhur me metodën e duhur të zgjedhur nga ligjvënësi për të rregulluar një fushë të caktuar. Detyra e saj është të vlerësojë vetëm nëse metoda e zgjedhur dhe efektet që ato përmbajnë janë në pajtim me Kushtetutën dhe KEDNJ.
61. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, liria e shprehjes, duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes politike përmes internetit, është e garantuar. Megjithatë, kufizimet në

lirinë e shprehjes, veçanërisht duke përfshirë lirinë e shprehjes gjatë procesit zgjedhor, mund të vendosen nga shtetet të cilat kanë një hapësirë diskrecionale të vendosjes, nëse plotësohen përjashtimet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNJ dhe paragrafin 2 të nenit 40 të Kushtetutës.

62. Në këtë aspekt kufizimi i lirisë së shprehjes, duke përfshirë periudhën gjatë fushatës zgjedhore, mund të bëhet nëse: 1) një gjë e tillë parashihet me ligj, 2) ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se masa e përcaktuar ndjek një qëllim legjitim, dhe 3) kur ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatësisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Mariya Alekhina dhe të tjerët kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 199).
63. Në dritën e këtyre kriterëve dhe praktikës së GJEDNJ-së lidhur me nenin 10 të KEDNJ-së, në rastin në fjalë Gjykata do të analizojë kriteret e poshtëshënuara të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative:
 - 1) Nëse ekziston ndërhyrja/kufizimi në lirinë e shprehjes, dhe nëse po, atëherë:
 - a. nëse kufizimi i të drejtave, konkretisht të drejtës për lirinë e shprehjes gjatë fushatës zgjedhore është i paraparë me ligj;
 - b. nëse kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihet me kufizim; dhe
 - c. nëse ndërhyrja “është e nevojshme në një shoqëri demokratike” apo nëse kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të të drejtave dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

Aplikimi i këtyre standardeve në rastin konkret

1) Nëse ka ekzistuar ndërhyrja në lirinë e shprehjes

64. Gjykata vëren që video incizimi lidhur me të cilin parashtruesi i kërkesës është gjobitur është shpërndarë nga kandidati për deputet i parashtruesit të kërkesës përmes faqes së tij të rrjetit social Facebook. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart tek parimet e përgjithshme që liria e shprehjes përfshinë publikimin e deklaratave politike, programeve të subjekteve politike dhe të fotografive duke përfshirë postimin e përmbajtjes politike në internet, ndalimi i këtyre veprimeve

përbën ndërhyje në të drejtën e parashtruesit të kërkesës në lirinë e shprehjes e cila duhet të arsyetohet mbi bazën e kriterëve të lartcekura.

65. Sa i përket përfshirjes së fotos të personit E.B. në spotin zgjedhor as PZAP as Gjykata Supreme nuk e kishte kontestuar faktin që fotografia e tij ishte shpërndarë më herët nga mediumi kallxo.com, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ishte autor i fotos dhe as nuk e publikonte foton për herë të parë. Megjithatë, ashtu si është sqaruar në parimet e përgjithshme më lart, liria e shprehjes nuk aplikohet vetëm në përmbajtjen e informatave por edhe në shpërndarjen e tyre, pasi çdo kufizim në këtë të fundit domosdoshmërisht ndërhyr në të drejtën për të pranuar dhe shpërndarë informata (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Magyar Ketzfarku Kutya Part kundër Hungarisë*, Kërkesa nr. 201/17 Aktgjykim i 20 janarit 2020, paragrafi 87).
66. Andaj, publikimi i spotit zgjedhor duke përfshirë edhe shpërndarjen e fotos së personit të tretë që ishte publikuar më herët nga mediumi kallxo.com, mund të cenojë lirinë e shprehjes nëse nuk përmbushen përjashtimet e parapara në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNJ dhe paragrafin 2 të nenit 40 të Kushtetutës dhe nenin 53 të Kushtetutës. Kufizimi i lirisë së shprehjes në këtë rast ka pasur si pasojë vendosjen e një gjobe të caktuar ndaj parashtruesit të kërkesës pasi spoti është shpërndarë në rrjetet sociale dhe nuk ka kufizuar në mënyrë direkte publikimin e spotit apo kërkesa që spoti në fjalë, të largohet nga rrjeti social. Andaj, kufizimi është bërë me vendim të PZAP-së i cili është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme.
67. Rrjedhimisht, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë nëse një kufizim i tillë i vendosur përmes vendimeve të kontestuarra të PZAP dhe Gjykatës Supreme kishte bazë ligjore dhe nëse po, nëse kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihet me kufizim, si dhe nëse ndërhyrja “është e nevojshme në një shoqëri demokratike” apo nëse kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të të drejtave dhe qëllimit legjitim të ndjekur.
 - a) *Nëse ndërhyrja ka qenë e paraparë me Ligj*
68. Sa i përket parimit të “përcaktueshmërisë me ligj”, Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë, fillimisht kuptimin e termit “ligj” nga pikëpamja e kufizimit të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se sipas praktikës së GJEDNJ, kjo e fundit gjithmonë e ka kuptuar termin “ligj” në kuptimin “përmbajtësor”, dhe jo në atë “formal”. Në këtë kontekst, termi “ligj” përfshin ligjet dhe aktet më të ulëta se ligjet, apo aktet nënligjore, si dhe masat e ndërmarra nga autoritetet

rregullatore profesionale bazuar në kompetencat e tyre të deleguara nga Kuvendi. Për më tepër, sipas GJEDNJ “ligji” duhet kuptuar që të përfshijë ligjet “statutore” por gjithashtu edhe “precedentët gjyqësorë”. Si përmbledhje, termi “ligj” janë dispozitat në fuqi ashtu si i kanë interpretuar gjykatat (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Gülcü kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 17526/10, Aktgjykim i 19 janarit 2016, paragrafi 104 dhe rastin *Leyla Şahin kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 44774/98, Aktgjykim i 10 nëntorit 2005, paragrafi 84).

69. Gjykata gjithashtu, rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ “përcaktueshmëria me ligj” që përfshihet në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNJ-së, jo vetëm që kërkon që masa e ndërmarrë të ketë bazë ligjore në legjislacionin shtetëror por i referohet edhe cilësisë së ligjit që duhet të jetë i parashikueshëm, i qasshëm, duhet të ketë masa mbrojtëse nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike dhe duhet të jetë i formuluar me precizitetin e duhur që tu mundësojë subjekteve që iu drejtohet që të rregullojnë sjelljen e tyre bazuar në atë ligj (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Magyar Kétfarkú Kutya Partja kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 93 dhe 94).
70. Në kontekstin e vlerësimit të të drejtave dhe lirive themelore, Gjykata vëren që kufiri në mes të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nuk është gjithmonë saktësisht i definuar. Gjykata Kushtetuese por edhe gjykatat e rregullta janë shpesh në pozicion të bëjnë interpretimin e ligjit, Kushtetutës por edhe instrumenteve ndërkombëtare, siç janë ato të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës. Është parimi i subsidiaritetit dhe doktrina e shkallës së katërt, të cilat në parim, por varësisht nga rrethanat e veçanta të secilit rast, e bëjnë këtë dallim.
71. Në këtë aspekt, duke pasur parasysh rolin e Gjykatës Kushtetuese si dhe parimin e subsidiaritetit, Gjykata në vijim do të shqyrtoj vlerësimin e PZAP dhe Gjykatës Supreme, kur kanë vlerësuar nëse veprimet e parashtruesit të kërkesës kanë shkelur dispozitat ligjore dhe me këtë rast, nëse këto të gjetura përbëjnë shkelje kushtetuese sipas parimeve dhe standardeve të elaboruara më lart.
72. Gjykata rikujton edhe njëherë se kandidati për deputetet i parashtruesit të kërkesës më 25 shtator 2019 kishte publikuar në rrjetin social Facebook një videoincizim të filmuar para ndërtesës së Policisë së Kosovës, ku, mes tjerash, ishte përdorur edhe fotoja e zyrtarit policor E.B. Pas ankesës së parashtruar nga E.B., PZAP përmes Vendimit [nr.233/2019], i shqiptoi gjobë parashtruesit të kërkesës në lartësi prej 9,500.00 (nëntë mijë e pesëqind) euro.

73. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës lidhur me këtë kufizim pretendon se legjislacioni zgjedhor sipas së cilit parashtuesi i kërkesës është gjobitur, nuk ka qenë i zbatueshëm në kohën kur është publikuar videoincizimi duke argumentuar se rregullat zgjedhore zbatohen vetëm gjatë fushatës zgjedhore e cila kishte filluar më 25 shtator 2019, përderisa publikimi i video incizimit është bërë më 19 shtator 2019. Andaj, sanksionimi i këtij veprimi, nuk ka qenë i paraparë me ligj në kohën kur është ndërmarrë veprimi dhe kjo përbën shkelje të lirisë së shprehjes si dhe të parimit të sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike. Gjithashtu, parashtuesi i kërkesës pretendon se publikimi i spotit, nga kandidati i tij për deputet, mbrohet nga liria e shprehjes dhe nuk mund të kufizohet nga PZAP.
74. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës përsërit para Gjykatës të njëjtat argumente që kishte parashtuar në procedurat pranë PZAP dhe Gjykatës Supreme, në veçanti lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe aplikueshmërinë e ligjit zgjedhor në rastin konkret (shih paragrafët 12,13 dhe 14).
75. Gjykata rikujton se PZAP vendimin e tij e kishte bazuar në LZP dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky i fundit, konkretisht nenin 33 paragrafët (b) dhe (l) dhe nenin 119, paragrafi 4 të LZP që përcaktojnë si në vijim:

Neni 33

Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

[...]

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;

[...]

l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të

*tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose
qfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë;
[...]*

Neni 119 [Ankesat]

*119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda
juridiksionit të KZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa
i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose
rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë KZAP-
it.
[...]*

76. Si dhe nenin 5 [Ankesat] paragrafi 5 të Rregullës nr.02/2015 të PZAP që përcakton se:

Neni 5 [Ankesat]

[...]

*5.5 Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin
dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet në PZAP brenda
njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar.*

77. Lidhur me zbatimin e dispozitave të lartcekura, Gjykata rikujton se PZAP përmes Vendimit [nr.233/2019], kishte miratuar si të bazuar ankesën e palës E.B., dhe parashtruesit të kërkesës i shqiptoi gjobë në lartësi prej 9,500.00 (nëntëmijë e pesëqind) euro, për shkak të: i) publikimit në spotin e fushatës zgjedhore të objektit të Policisë së Kosovës në Prishtinë; dhe ii) përfshirjen e personit tjetër E.B., pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike] të LZP-së. Sa i përket pretendimit për mos precizimin, nga ana e E.B., e vendit, datës dhe kohës kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, pretendim të cilin parashtruesi i kërkesës e ngrit edhe para Gjykatës, PZAP arsyetoi se E.B. kishte rënë në dijeni, lidhur me shkeljen, më 4 tetor 2019, dhe se afati për parashtruesin e kërkesës fillon nga momenti kur ankuesi bie në dijeni për shkeljen e bërë, që në rastin konkret rezulton të jetë brenda fushatës zgjedhore.
78. Pas paraqitjes së ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [nr.A.A-U.ZH.nr.16/2019] refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se vendimi i PZAP është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmbante arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat ishin të pranuar edhe për Gjykatën Supreme duke konstatuar se edhe e drejta materiale ishte aplikuar drejtë. Gjykata Supreme rikonfirmoi edhe njëherë se parashtruesi i kërkesës gjatë fushatës, për qëllime elektorale, në

kundërshtim me ligjin (neni 33, pika b, i LZP-së), kishte publikuar një videospot, ku paraqitej objekti i Policisë së Kosovës në Prishtinë dhe përfshinte personin tjetër pa lejen e tij.

79. Ndërsa, lidhur me pretendimin se videoincizimi ishte publikuar më 19 shtator 2019, ndërsa fushata zgjedhore kishte filluar më 25 shtator 2019, andaj, gjoba e shqiptuar është shqiptuar në kundërshtim me LZP-së i cili zbatohet vetëm gjatë fushatës zgjedhore, Gjykata vlerëson se Vendimi i PZAP i konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme, ishte i bazuar në Rregullën nr.02/2015 të PZAP e cila përcakton se ankesa duhet të parashtrohet në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar, duke interpretuar këtë afat që fillon të rrjedhë jo në momentin kur është bërë publikimi i spotit televiziv, por në kohën kur ankuesi ka rënë në dijeni për shkeljen e supozuar, me kushtin që kjo të bëhet brenda fushatës zgjedhore, dhe ky ishte rasti me shpërndarjen e spotit zgjedhor të kandidatit për deputet të parashtruesit të kërkesës.
80. Andaj, Gjykata pajtohet me vlerësimin e PZAP dhe Gjykatën Supreme se kufizimi ishte paraparë me ligj, konkretisht me nenin 33 paragrafët (b) dhe (l) dhe nenin 119, paragrafi 4 të LZP si dhe nenin 5 [Ankesat] paragrafi 5 të Rregullës nr.02/2015 të PZAP dhe nuk sheh arsye të devijojë nga ky arsyetim.
81. Gjykata, për me tepër, rikujton edhe nenin 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike], paragrafin 1 të LZP ku parashihet se:

“gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidati i tij, ndalohen të bëjnë si në vijim [...]”
82. Andaj LZP e ka përcaktuar në mënyrë të qartë se veprimet e ndaluara më nenin 33 të LZP-së ndërlidhen me periudhën e fushatës.
83. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 3 [Përkufizimet] të LZP-së që përcakton se:

“Periudha e fushatës” do të thotë periudhën prej tridhjetë (30) ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike e cila përfundon (1) ditë para ditës së zgjedhjeve.”
84. Sipas definicionit të “Periudhës zgjedhore” të përcaktuar në nenin 3 [Përkufizimet] të LZP, për qëllim të LZP-së, neni 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike] i LZP-së zbatohet 30 ditë para mbajtës së zgjedhjeve.

85. Andaj, Gjykata vlerëson se pa marrë parasysh dhe pa paragjykim ndaj datës së shpalljes së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës dhe datës së fillimit të fushatës zgjedhore sipas pikës 1) të Vendimit [nr.824-2015] për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019 që përcakton se “Fushata Zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore fillon më 25 shtator dhe përfundon më 4 tetor 2019”, 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, ka qenë relevante për zbatueshmërinë e nenit 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike] të LZP.
86. Rrjedhimisht, duke marrë për bazë faktin që zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë janë mbajtur më 6 tetor 2019, ndërsa, parashtruesi i kërkesës deklaroi se videoincizimi është publikuar më 19 shtator 2019, pa marrë parasysh faktin se kur personi E.B. kishte paraqitur ankesë në PZAP, publikimi i videoincizimit po ashtu është shpërndarë brenda periudhës kohore gjatë së cilës neni 33 [Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike] i LZP ka qenë i zbatueshëm. Andaj, Gjykata nuk mund të pajtohet me parashtruesin e kërkesës se, gjatë kohës së publikimit, neni 33 i LZP nuk ka qenë në fuqi.
87. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se pretendimi i parashtruesit të kërkesës, se kufizimi i lirisë së shprehjes nuk ka qenë i paraparë me ligj pasi LZP nuk ka qenë i aplikuar në kohën kur është publikuar spoti zgjedhor, nuk është i bazuar.
88. Për më tepër, Gjykata gjen se legjislacioni i aplikuar në rastin konkret, ka qenë i qasshëm dhe i parashikueshëm për parashtruesin e kërkesës aq më tepër duke pasur parasysh që, parashtruesi i kërkesës kishte marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe iu kishte nënshtruar të njëjtave rregulla zgjedhore.
89. Andaj, si përfundim, Gjykata gjen se kufizimi i lirisë së shprehjes ka qenë i “*paraparë me ligj*”. Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse kufizimi ka pasur qëllim legjitim dhe nëse masa e ndërmarrë ka qenë proporcionale.
- b) Nëse kufizimi ka pasur qëllim legjitim*
90. Sa i përket qëllimit legjitim dhe testit të proporcionalitetit të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që një kufizim të jetë i justifikueshëm, Gjykata thekson se edhe pse parashtruesi i kërkesës përveç argumenteve lidhur me atë nëse masa e paraparë nuk është paraparë me ligj, nuk e ka kontestuar në mënyrë specifike, Gjykata do të vlerësojë, nëse kjo masë - kufizimi i lirisë së shprehjes, ka qëllim

legjitim dhe nëse është proporcional për të arritur qëllimin legjitim të ndjekur.

91. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, ndalimi i veprimeve të caktuara gjatë fushatës zgjedhore mund të ketë si qëllim legjitim mbrojtjen e reputacionit dhe të të drejtave të të tjerëve si dhe interesin publik për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të lira dhe fer (shih, *mutatis mutandis*, rastin GJEDNJ *Nataliya Mykhaylivna Vitrenko dhe të tjerët kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 23510/02, Vendim i 16 dhjetorit 2008).
92. Në rastin konkret, PZAP kishte vlerësuar se spoti zgjedhor ishte xhiruar para objektit të Policisë së Kosovës si dhe kishte përfshirë foton e personit tjetër E.B., pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor, me ç'rast të njëjtit i cenon dinjitetin, personit E.B. respektivisht.
93. Andaj, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë së shprehjes në rastin konkret ka qëllim legjitim - mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve, në këtë rast të personit E.B. si dhe interesin publik për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të lira dhe fer.
94. Duke pas parasysh që kufizimi i lirisë së shprehjes ishte i paraparë me ligj dhe ka qëllim legjitim, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse ndërhyrja “është e nevojshme në një shoqëri demokratike”, respektivisht nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur.

c) nëse ndërhyrja “është e nevojshme në një shoqëri demokratike” apo nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur
95. Për të vlerësuar këtë kriter, është e nevojshme të vlerësohet se si PZAP dhe Gjykata Supreme kanë trajtuar rastin e parashtresit të kërkesës dhe nëse masa e paraparë me ligj ka qenë proporcionale për të arritur qëllimin e ndjekur.
96. Ashtu si u sqarua tek parimet e përgjithshme më lart, liria e shprehjes është subjekt i përjashtimeve të cilat duhet të interpretohen ngushtë dhe nevoja për kufizim duhet të vendoset në mënyrë bindëse. Ajo që është në pyetje janë limitet e kritikës së pranueshme në kontekst të debatit publik dhe çështjeve politike të interesit të përgjithshëm, dhe ku Gjykata, si autoriteti përfundimtar për interpretimin e të drejtave kushtetuese, duhet të bindet që PZAP dhe Gjykata Supreme kanë zbatuar standarde që janë të pajtueshme, dhe për më tepër, gjatë kryerjes së këtij funksioni janë bazuar në vlerësim të pranueshëm të fakteve relevante (shih, *mutatis mutandis*, rastin GJEDNJ *Nataliya*

Mykhaylivna Vitrenko dhe të tjerët kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 23510/02, Vendim i 16 dhjetorit 2008, faqe 11).

97. Gjykata vlerëson se PZAP kishte gjobitur parashtruesin e kërkesës për faktin që publikimi i spotit të fushatës zgjedhore ishte bërë para objektit të Policisë së Kosovës në Prishtinë dhe faktin që në spotin e publikuar të aktivitetit promovues zgjedhor ishte përfshirë fotoja e personit tjetër E.B., pa lejen e tij dhe ku PZAP kishte konsideruar se kjo kishte shkelur dinjitetin e tij.
98. Për me tepër, për të përcaktuar shumën e gjobës, PZAP kishte marrë për bazë, natyrën e shkeljes dhe ndikimin në procesin zgjedhor, faktin që parashtruesi i kërkesës ka marrë pjesë edhe në zgjedhje të mëhershme dhe ka qenë i njoftuar për rregullat zgjedhore dhe faktin që parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të tilla edhe më herët.
99. Gjykata po ashtu vëren se gjoba që i është dhënë parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar në nenin 120 [Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve] ku në pikën (c) përcakton se në rast të shkeljes së LZP ose rregullave zgjedhore PZAP mund “të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizate vëzhguese në një vlerë deri në dyqind mijë euro (€200,000)”. Megjithatë, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ishte gjobitur me shumën prej 9.500 eurosh që është shumë e ulët në krahasim me shumën që PZAP është e lejuar të shqiptojë.
100. Andaj, nën dritë e këtyre të gjeturave, nuk mund të thuhet se PZAP dhe Gjykata Supreme, kanë tejkaluar marginën e vlerësimit të cilën ata e gëzojnë për të vendosur nëse masa e ndërmarrë është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” konkretisht nëse ka pasur një raport të arsyeshëm të proporcionaliteti në mes të masës së ndërmarrë dhe qëllimit të ndjekur (shih, *mutatis mutandis*, rastin GJEDNJ *Nataliya Mykhaylivna Vitrenko dhe të tjerët kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 23510/02, Vendim i 16 dhjetorit 2008, faqe 12).
101. Andaj, kufizimi i lirisë së shprehjes i paraparë me ligj, ka qenë proporcional për të arritur qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve dhe sigurimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe fer.
102. Si përfundim, Gjykata konstaton se liria e shprehjes së parashtruesit të kërkesës është kufizuar, megjithatë, kufizimi ka qenë i paraparë me ligj, ka qëllim legjitim dhe ka plotësuar kriterin e proporcionalitetit.
103. Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata konstaton se janë të pabaza pretendimet e parashtruesit të kërkesës se i është shkelur e

drejta në lirinë e shprehjes e garantuar më nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së.

(ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me parimin e mosdiskriminimit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ dhe nenin 7 të DUDNJ

104. Lidhur me parimin e mosdiskriminimit, parashtruesi i kërkesës ankohet se PZAP ka nxjerrë vendime kontradiktore, pasi në situata të ngjashme ka nxjerrë vendime të ndryshme sa i përket kohës së kryerjes së një veprimi të ndalur zgjedhor pasi në rastin e parashtruesit të kërkesës ka marrë për bazë kohën e paraqitjes së ankesës nga personi E.B., ndërsa në rastet e tjera kohën kur është publikuar spoti zgjedhor. Në esencë parashtruesi i kërkesës konteston gjendjen faktike dhe mënyrën e interpretimit të gjendjes faktike nga ana e PZAP.
105. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose status, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, shih, po ashtu, rastet e GJEDNJ-së *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, 16 mars 2010, paragrafi 61).
106. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon se sipas cilës karakteristikë të identifikueshme, ose status, ai ishte i diskriminuar në procedurat para Gjykatës Supreme.
107. Megjithatë, lidhur me pretendimin rreth çështjes së vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme, Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, rikujton se GJEDNJ në parim çështjen e rëndësisë së përputhshmërisë së praktikës gjyqësore e ka ndërlikuar me parimin e sigurisë juridike dhe të besimit të publikut në sistemin gjyqësor (shih *mutatis mutandis*, *Brumărescu kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; shih *Păduraru kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 63252/00, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 1 dhjetorit 2005; paragrafi 98;

Ştefăniţă dhe të tjerët kundër Rumanisë, Kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38; *Balažoski dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Kërkesa nr. 45117/08 Aktgjykim i GJEDNJ-së i 25 prillit 2013, paragrafi 29; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 13279/05, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 20 tetorit 2011, paragrafi 52; shih, gjithashtu, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 34796/09, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 10 majit 2012, paragrafi 34).

108. Në këtë kontekst, GJEDNJ, përmes praktikës gjyqësore të saj, ka pohuar gjithashtu se kërkesat e parimit të sigurisë juridike dhe mbrojtjes legjitime të besimit të publikut nuk japin dhe as nuk garantojnë një të drejtë të fituar për përputhshmëri të praktikës gjyqësore (shih *Unédic kundër Francës*, Kërkesa nr. 20153/04, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 18 dhjetorit 2008, paragrafi 74; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 20 tetorit 2011; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 58; *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 34; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI142/15, *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 tetorit 2016, paragrafi 38).
109. GJEDNJ, në mënyrë specifike ka nënvizuar se “*në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave, edhe nëse nxirren në procedura dukshëm të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave [...]*” (shih rastin *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më sipër, paragrafi 118, si dhe rastin *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50 dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI29/17, *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 tetorit 2017, paragrafi 47).
110. Sidoqoftë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e kushteve në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave të shkallës së fundit janë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Në këtë kuptim, GJEDNJ thekson se duhet vërtetuar: a) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjata në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit; b) nëse ligji i vendit parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve; dhe, c) nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, deri në çfarë mase (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 23530/02; Aktgjykim i 2 tetorit 2009, paragrafët 49-52; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI29/17, *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 tetorit 2017, paragrafi 51).

111. Gjykata vëren që në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kriteri i ekzistencës së “dallimeve të thella dhe afatgjata” është themelor në vlerësimin e konsistencës të praktikës gjyqësore (shih, *mutatis mutandis*, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116-135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 23530/02; cituar më sipër, paragrafët 49-52; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53). Në këtë kontekst, GJEDNJ po ashtu ka konstatuar se duhet vlerësuar edhe efektin e një dallimi të tillë në raport me numrin e rasteve të tjera (shih rastin *Abu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 10 qershorit 2012, paragrafi 38).

112. Gjykata nënvizon se nuk është detyrë e saj që të krahasojë vendime të ndryshme të Gjykatës Supreme dhe se ajo respekton plotësisht pavarësinë e gjykatave të rregullta.

113. Gjykata rikujton se lidhur me këtë pretendim parashtruesi i kërkesës i referohet fillimisht Vendimit të PZAP [A.181/2019] të 4 tetorit 2019, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e paraqitur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent kundër parashtruesit të kërkesës pasi ankuesi nuk kishte paraqitur prova dhe nuk kishte bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me pretendimet për shkelje të rregullave zgjedhore nga parashtruesi i kërkesës. PZAP më konkretisht kishte arsyetuar se ankuesi nuk kishte “saktësuar kohën kur ishte xhiruar dhe publikuar spoti në fjalë”.

114. Parashtruesi i kërkesës i referohet edhe Vendimit të PZAP [A.nr.93/2019], të 27 shtatorit 2019, ku PZAP kishte pranuar si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Partisë Demokratike të Kosovës me ç’rast PZAP kishte konstatuar se ankesa e parashtruesit të kërkesës e 26 shtatorit 2019 me të cilën pretendohet se asambleistja e Komunës së Shtimes nga Partia Demokratike e Kosovës më 25 shtator 2019, kishte publikuar në rrjetin social Facebook një fotografi me Kryetarin e Komunës së Shtimes si kandidatin për deputet të kësaj partie për zgjedhjet e 6 tetorit 2020, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së.

115. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet edhe Vendimit të PZAP [Anr.108/2019], të 30 shtatorit 2019, me të cilin PZAP pranoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të një organizate joqeveritare kundër koalicionit AAK-PSD të parashtruar më 27 shtator 2019, pasi kandidati i AAK-PSD për Kryeministër më 26 shtator 2019 përmes llogarisë së tij në Facebook, kishte përfshirë pjesëtarët e Policisë së Kosovës në spotin e tyre zgjedhor ku kishte shkruar “2000

policë shtesë deri në fund të mandatit”, ku me këtë ishte shkelur rregulla zgjedhore nr.13/2013 e ndryshuar dhe plotësuar me rregullën zgjedhore nr.20/2019.

116. Megjithatë, Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së vlerëson se rastet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës të cilat ai i ndërlidh me rastin e tij nuk janë të njëjta me rastin konkret.
117. Lidhur me Vendimin e PZAP [A.181/2019] të 4 tetorit 2019, PZAP nuk kishte trajtuar fare çështjen e datës së publikimit të spotit në raport me datën kur ankuesit kishin vërejtur një gjë të tillë pasi ankuesit në atë rast nuk i kishin bashkangjitur ankesës së tyre asnjë dëshmi lidhur me pretendimet e tyre.
118. Ndërsa lidhur me Vendimin e PZAP A.nr.93/2019, të 27 shtatorit 2019, dhe Vendimin e PZAP Anr.108/2019, të 30 shtatorit 2019, në të dy këto raste publikimi i spotit zgjedhor është bërë pas datës 25 shtator 2019 - pasi fushata zgjedhore kishte filluar zyrtarisht dhe ankesat janë paraqitur ditën vijuese pasi spotet zgjedhore ishin publikuar ne rrjetet sociale. Andaj, PZAP nuk ka trajtuar fare çështjen e publikimit të spotit zgjedhor në raport me datën se kur spoti zgjedhor është vërejtur nga ankuesi, pasi kjo nuk ishte çështje që ishte shtruar para tyre.
119. Ndërsa, lidhur me rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se spoti zgjedhor është publikuar para 25 shtatorit 2019, ndërsa PZAP ka konstatuar se është nga ana e personit i cili ka interes ligjor (ankuesja) E.B., data e 4 tetorit 2019.
120. Andaj, Gjykata vlerëson se rrethanat e rastit konkret dhe rastet lidhur me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se PZAP ka vendosur ndryshe, nuk janë të njëjta.
121. Rrjedhimisht, kjo e bënë të panevojshme vlerësimin a) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjata në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit; b) nëse ligji i vendit parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve; dhe, c) nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, deri në çfarë mase.
122. Për më tepër, Gjykata thekson se vendimet në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, janë vendime të PZAP ndaj të cilave palët në procedurë kanë pasur të drejtë ankese në Gjykatën Supreme dhe të cilat bëhen përfundimtare vetëm nëse nuk paraqitet ankesë ndaj tyre brenda afatit të caktuar ose pasi të vendoset lidhur me to nga Gjykata Supreme. Parashtruesi i kërkesës, nuk ka sqaruar dhe nuk ka

paraqitur prova me të cilat dëshmohej se këto vendime të PZAP janë vërtetuar si të tilla edhe nga Gjykata Supreme.

123. Rrjedhimisht, Gjykata, duke iu referuar praktikës së saj dhe asaj të GJEDNJ-së dhe standardeve të vendosura përmes kësaj praktike, të cilat parime kjo Gjykatë i zbaton, e ka të pamundur të konstatojë se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë plotësuar kriteret e ekzistencës së vendimeve kundërtëhënëse.
124. Prandaj, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se janë të pabaza pretendimet e parashtruesit të kërkesës se i është shkelur e drejta e barazisë para ligjit përkatësisht e drejta që të mos jetë i diskriminuar e cila është garantuar më nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së.

(iii) Pretendimet lidhur me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës

125. Gjykata vëren, së pari, se parashtruesi i kërkesës shkeljen e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës përpiket ta arsyetojë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të ligjit material dhe procedural, duke i përsëritur në thelb pretendimet e bëra në përgjigje ndaj ankesës të parashtruar para PZAP-it.
126. Parashtruesi i kërkesës e ndërlidh vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike me momentin kur është kryer shkelja përkatësisht me datën në të cilën është kryer shkelja, më tej, ai i përsërit pretendimet në lidhje me kriteret formale që ankesa duhet të plotësojë, dhe mbi këtë bazë konkludon se e drejta materiale dhe vlerësuese nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë.
127. Për sa i përket këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës e të cilat kanë të bëjnë me gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe aplikimin e gabuar të ligjit material dhe procedural, Gjykata vëren se PZAP në mënyrë thelbësore arsyetoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës dhe shpjegoi se si e ka konstatuar gjendjen faktike dhe si e ka aplikuar ligjin material dhe ligjin procedural, shih paragrafët 12, 13 dhe 14.
128. Gjykata rikujton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për aplikim dhe interpretim të gabuar të ligjit, Gjykata rithekson në radhë të parë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet në gjendjen faktike ose me aplikimin e gabuar të ligjit që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç nëse gabimet dhe zbatimi i gabuar i ligjit është i tillë që shkel të drejtat dhe liritë e

mbrojtura me Kushtetutë (shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, 28 §, KEDNJ 1999-I).

129. Gjykata vëren se të gjitha përgjigjet e PZAP dhe Gjykatës Supreme janë të qarta dhe të arsyetuara, dhe se të gjitha pretendimet e parashtruesit, të cilat ishin të rëndësishme për vendosjen e çështjes, u dëgjuan dhe u shqyrtuan siç duhet nga PZAP dhe Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata konkludon që procedurat e ngritura para PZAP dhe Gjykatës Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96. paragrafët 29 dhe 30).
130. Tutje, lidhur me vet nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore nuk kane efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për "gëzimin e të drejtave dhe lirive" që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, ky nen në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohet nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njëres ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me "gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut" (shih, rastin e Gjykatës Kl136/16, parashtrues i kërkesës: *Vllaznim Bytyqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 18 tetorit 2017, paragrafi 40).
131. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se pretendimet që ndërlidhen me çështjet e parimit të sundimit të ligjit dhe të sigurisë juridike i ka trajtuar lidhur me lirinë e shprehjes.
132. Prandaj, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se, me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjit, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës e cila është e garantuar me nenin 7 [vlerat] të Kushtetutës, janë të pabaza.

(iv) Pretendimet lidhur me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës

133. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton shkeljet e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës, por thjesht konstaton se "... përmbajtja e aktgjykimit nën shenjën A.A. - U.ZH. nr.16/2019 të Gjykatës Supreme përbën cenim ..." të këtyre këto dy neneve.

134. Lidhur me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, Gjykata thekson se këto nene, në vetvete nuk ngërthejnë një të drejtë ose liri themelore.
135. Neni 21 në përmbajtjen e tij i referohet karakterit të pandashëm, të patjetërsueshëm dhe të pacenueshëm të të drejtave të njeriut; mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut; detyrimit për respektimin e të drejtave të njeriut, duke përcaktuar edhe se të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, për aq sa është e mundur, vlejné edhe për personat juridikë.
136. Përderisa neni 22 i Kushtetutës përcakton statusin e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të cekura në nenin 22, në sistemin juridik të Kosovës, si të drejta që garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
137. Andaj, nenet e lartcekura, nuk janë nene që mund të interpretohen në mënyrë të pavarur nga dispozitat e tjera kushtetuese relevante për këtë rast. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtij rasti, Gjykata ka marrë parasysh parimet e theksuara në nenin 21 të Kushtetutës por edhe marrëveshjet dhe instrumenteve ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës.
138. Prandaj, mbi bazën e asaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës as nuk arsyetoi e as nuk shpjegoi se në çfarë mënyre ka ardhur deri tek shkeljet e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës. Për këtë arsye, janë të pabaza pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me Aktgjykimin e kontestuar është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës e garantuar me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

Përfundim

139. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojné se procedurat në gjykatat e rregullta, në çfarëdo mënyre, shkelén të drejtat e tij kushtetuese, dhe në përputhje me këtë si përfundim:
 - (i) Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se atij i është shkelur e drejta për lirinë e

shprehjes e cila është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ janë të pabazuara;

- (ii) Gjykata konstaton se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se atij i është shkelur e drejta për barazi para ligjit përkatësisht e drejta e tij për të mos u diskriminuar, e cila është e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së;
- (iii) Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjit i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, janë të pabazuara;
- (iv) Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk arsyetoi e as nuk shpjegoi se si ka ardhur deri tek shkelja e neneve 21 dhe 22 të Kushtetutës dhe se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me Aktgjykimin e kontestuar është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës e garantuar me nenin 21 dhe 22 të Kushtetutës.

140. Rrjedhimisht, dhe bazuar në atë si më sipër, Gjykata, mbështetur në karakteristikat e veçanta të rastit, faktet e paraqitura, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, arsyetimin e Gjykatës Supreme, si dhe bazuar në standardet e vendosura dhe parimet e përcaktuara në praktikën e vet gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, nuk gjen që me Aktgjykimin [A.A-U.ZH.nr.16.2019] e 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të jenë shkelur nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenet 10 [Liria e shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 7 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se nuk ka pasur shkelje të neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, neneve 10 [Liria e shprehjes] dhe 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI209/19, Parashtrues i kërkesës: Memli Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. Nr.664/2019, të 5 gushtit 2019

KI209/19, Aktgjykim i miratuar më 5 nëntor 2020, publikuar më 26 nëntor 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, barazia e armëve, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, konflikt i interesit

Në rrethanat e rastit konkret, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) paraqiti kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nën dyshimin e bazuar se-parashtruesi i kërkesës-në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, njëkohësisht ushtron funksionet Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Nënpresident i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK).

Gjykata Themelore vendosi se për shkak të mungesës së provave përfundon procedura e kundërvajtjes me pezullim kundër parashtruesit të kërkesës. Ndërkohë, AKK-ja paraqiti ankesë kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit duke përsëritë se ekziston dyshimi se parashtruesi i kërkesës si zyrtar i lartë, ka rënë në konflikt interesi sepse si deputet i Kuvendit të Kosovës në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e Nënpresidentit të parë të KOK.

Gjykata e Apelit aprovoi të bazuar ankesën e AKK-së dhe ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore ashtu që parashtruesit të kërkesës për kundërvajtjen nga neni 14 paragrafi 1 e sanksionuar sipas nenit 23 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit, i shqiptohet gjoba prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Gjykata e Apelit nuk kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës lidhur me ankesën e AKK-së kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe si rrjedhojë, Gjykata Apelit kishte shqyrtuar vetëm pretendimet ankimore të AKK-së por jo edhe argumentet e parashtruesit të kërkesës.#

#

Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë duke pretenduar: (i) se nuk ka qenë i njoftuar se ndaj vendimit të gjykatës themelore, i cili ka qenë i favorshëm për të, pala kundërshtare (AKK) ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit; (ii) Gjykata e Apelit ka dëgjuar vetëm pretendimet e njërës palë (AKK), ndërsa parashtruesit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia për t'i paraqitur provat dhe argumentet e tij lidhur me objektin e kërkesës dhe pretendimeve të palës tjetër në gjykim (AKK). Parashtruesi i kërkesës pretendoi se parimi i barazisë së armëve ishte shkelur në kundërshtim me

garancitë procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkoi caktimin e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Në rastin konkret, Gjykata vërejtí se Gjykata e Apelit (i) ka lexuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të paraqitur në Gjykatën Themelore kundër vendimit të AKK-së; (ii) deklaratën e dhënë nga parashtruesi i kërkesës në seancën e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore; (iii) dëshminë e dëshmitarit BH, President i KOK-ut; (iv) dëshminë e dëshmitarit DA, zyrtar në AKK. Gjykata e Apelit e ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës pa dyshim se parashtruesi i kërkesës është Deputet i Kuvendit të Kosovës, në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e Nënpresidentit të parë të Organizatës joqeveritare të KOK, duke rënë ndesh me nenin 14.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Ushtrimin e Funksionit Publik. Gjykata po ashtu vërejtí se nga dosja e plotë e kërkesës por as nga përmbajtja e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk ka ndonjë dokument që tregon se parashtruesi i kërkesës është njoftuar për seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën e Apelit, të vënë në lëvizje nga ankesa e AKK-së.

Gjykata vlerësoi se duke qenë se Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Themelore që ka qenë i favorshëm për parashtruesin e kërkesës, ajo konsideroi se Gjykata e Apelit ka pasur obligim ligjor dhe kushtetues që parashtruesin e kërkesës ta njoftojë për gjykimin e rastit të tij, në mënyrë që këtij të fundit t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj ankesës së AKK-së. Gjykata konsideroi se është e papranueshme që njëra palë AKK të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit pa dijeninë e palës tjetër, parashtruesit të kërkesës, dhe ndaj të cilës ky i fundit nuk ka pasur mundësi të komentojë.[#] Gjykata po ashtu vlerësoi se parashtruesi i kërkesës është dashur të thirret në seancë gjyqësore nga Gjykata e Apelit jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore.

Në fund, Gjykata konstatoi se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Gjykata po ashtu refuzoi kërkesën për caktim të masës së përkohshme sepse vlerësoi se nga përmbajtja e kërkesës rezulton se nuk plotësohen kushtet për rrezik apo dëm të pariparueshëm apo se bëhet fjalë për interes publik.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI209/19

Parashtrues

Memli Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit
të Kosovës, Ka. Nr.664/2019, të 5 gushtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Memli Krasniqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) përfaqësuar nga Artan Qerkini avokat në Shoqërinë e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” sh.p.k nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka.nr.664/2019, të 5 gushtit 2019 në lidhje me Vendimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit nr.AKK-03-02-821/18, të 15 gushtit 2018.
3. Parashtruesi i kërkesës kërkon caktimin e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka.nr.664/2019, të 5 gushtit 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 27 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës.
9. Më 17 qershor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që ta dorëzon dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI209/19.
10. Më 29 korrik 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI209/19.
11. Më 5 nëntor 2020, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e

kërkesës si dhe shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 15 gusht 2018, Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: AKK) me Vendim AKK-03-02-821/18, konstatoi: (i) Ekziston konflikt i interesit në rastin e trajtuar me nr. AKK-03-02-821/18, për parashtruesin e kërkesës, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Nën-President i Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KOK); (ii) AKK njofton Kryetarin e Kuvendit dhe kërkon fillimin e proceduarve ligjore ndaj tij; (iii) AKK do të kërkoj fillimin e procedurës për kundërvajtje nga Gjykata kompetente; (iv) të gjitha vendimet që i nxjerrë AKK lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb-faqen zyrtare të AKK-së.
13. Në Vendimin e lartpërmendur AKK kishte arsyetuar: (i) se parashtruesi i kërkesës e ushtron pozitën e deputetit konform Ligjit Nr.03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ndërsa pozitën Nën-President i Parë i Komitetit Olimpik të Kosovës e ushtron në bazë të Komitetit Olimpik, i cili funksionon sipas dispozitave të Ligjit 2003/24 për Sport, Ligji Nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport; (ii) AKK i ka dërguar shkresë paralajmëruese parashtruesit të kërkesës (AKK-DPK-03-02/1642/18) me të cilën është konstatuar se ushtrimi njëkohësisht i funksionit të Deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe Nën-Presidentit i parë i Komitetit Olimpik është i ndaluar me Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik; (iii) nga parashtruesi i kërkesës është kërkuar që të heqë dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjor, përndryshe AKK është e obliguar të veproj konform Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; dhe, se (iv) përkundër afatit ligjor të dhënë nga AKK, parashtruesi i kërkesës nuk ka ndërmarrë veprime me qëllim të evitimit të gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
14. Më 22 gusht 2018, AKK-ja paraqiti kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nën dyshimin e bazuar se-parashtruesi i kërkesës-në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, njëkohësisht ushtron funksionet Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Nën-President i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës.

15. Më 5 qershor 2019, Gjykata Themelore me Aktvendim K.nr.2608/19, vendosi se për shkak të mungesës së provave përfundon procedura e kundërvajtjes me pezullim kundër parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, mes tjerash, arsyetoi: (i) në pajtim me nenin 6 të ligjit nr.06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit, konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari privat ka interes privat që ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare; (ii) parashtruesi i kërkesës është anëtar i organit drejtues të KOK-ut por nuk ka prova se personalisht ka pozitë ekzekutive; dhe se, (iii) nuk ka argumente se KOK merr fonde direkt nga Kuvendi, prandaj në mungesë provash pezullohet procedura e kundërvajtjes.
16. Në një datë të paspecifikuar, AKK-ja paraqiti ankesë kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit duke theksuar: (i) se ekziston dyshimi se parashtruesi i kërkesës si zyrtar i lartë, ka rënë në konflikt interesi sepse si deputet i Kuvendit të Kosovës në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e Nën-Presidentit të Parë të KOK-ut; (ii) AKK-ja i ka dërguar shkresë paralajmëruese parashtruesit të kërkesës me ç ‘rast ishte informuar se kishte rënë në konflikt interesi, sipas nenit 14 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit; dhe se, (iii) nga parashtruesi i kërkesës është kërkuar që të heqë dorë prej njërit funksion, porse ai nuk kishte ndërmarrë veprimet e kërkuara nga AKK-ja.
17. Më 5 gusht 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykim Ka.nr.664/2019 e aprovoi të bazuar ankesën e AKK-së dhe ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore K.nr.2609/2018 të 5 qershorit 2019, ashtu që të pandehurit (parashtruesit të kërkesës) për kundërvajtjen nga neni 14 paragrafi 1 e sanksionuar sipas nenit 23 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit, i shqiptohet gjoja prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjoja e shqiptuar do të arkëtohet konform nenit 164.3 të LK-së.
18. Gjykata e Apelit, mes tjerash, arsyetoi: (i) Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar drejtë provat e nxjerra dhe të deponuara nga palët në procedurë; (ii) arsyetimi i Gjykatës Themelore është kontradiktor dhe konfuz sepse çështje gjykimi nuk është lidhja e kontratave apo marrja e fondeve; (iii) çështje gjykimi është nëse i pandehuri (parashtruesi i kërkesës) ka rënë në konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksioneve të tij; (iv) konstatohet pa dyshim se parashtruesi i kërkesës është Deputet i Kuvendit të Kosovës, në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e Nënpresidentit të parë të Organizatës joqeveritare të KOK; (v)

ndërkaq, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit me kryetitull [Bordi Ekzekutiv] përbëhet prej: pika i) Presidentit, pika ii) Nën-President i Parë (pozita e parashtruesit të kërkesës), padyshim se i pandehuri (parashtruesi i kërkesës) në KOK mban pozitë udhëheqëse, e duke qenë në të njëjtën kohë edhe Deputet i Kuvendit të Kosovës, ai me veprimet e tij ka rënë ndesh me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit.

19. Gjykata e Apelit shtoi se *“Si rrjedhojë e të cekurave më lartë Kolegji e NDRYSHOI aktvendimin e goditur, ashtu që për veprën e kryer kundërvajtëse nga neni 14 par. I e sanksionuar sipas nenit 23 par. I pika 1.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, konform të nenit 31 të LK-së, ia shqiptoj gjobën në shumë prej 1500 € (njëmijë e pesëqind) €, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra Kundërvajtëse, të bindur se edhe me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit, ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme”*.
20. Gjykata e Apelit nuk kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës lidhur me ankesën e AKK-së kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë K.nr.2608/19, të 5 qershorit 2019, dhe si rrjedhojë, Gjykata e Apelit kishte shqyrtuar vetëm pretendimet ankimore të AKK-së por jo edhe argumentet e parashtruesit të kërkesës.
21. Gjykata e Apelit po ashtu përcaktoi se kundër aktgjykimit të saj nuk lejohet ankesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit ka gjetur gjerësisht shprehje në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese jo vetëm në çështjet penale por edhe në çështjet civile dhe kundërvajtëse. Kështu jurisprudenca në fjalë ka theksuar se parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e GJEDNJ kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim me*

qëllim që t'i krijohen mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur”.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Në këtë rast, Gjykata e Apelit ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtën e parashtruesit që në raport me palën kundërshtare të jetë e barabartë dhe po ashtu ka shkel të drejtën e parashtruesit që të dëgjohet në lidhje me pretendimet ankimore të palës kundërshtare. Në lëndën e Parashtruesit, Gjykata e Apelit fare nuk e njoftuar atë se pala kundërshtare në procedurën kundërvajtëse (Agjencioni Kundër Korrupsion) ka parashtruar ankesë ndaj Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tyre, e për më shumë Parashtruesit nuk i është dhënë mundësia fare që të përgjigjet në pretendimet ankimore të palës së kundërt (AKK)”.*
25. Parashtruesi i kërkesës më tej shton: *“Gjykata e Apelit ka dëgjuar vetëm pretendimet e njëres palë, ndërsa kërkuarit nuk i është dhënë mundësia të bënte mbrojtjen e tij para gjykatës duke paraqitur provat e argumentet e veta rreth objektit të kërkesës si dhe rreth pretendimeve të palës tjetër në gjykim”.*
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon: (i) se nuk ka qenë i njoftuar se ndaj vendimit të gjykatës themelore, i cili ka qenë i favorshëm për të, pala kundërshtare (AKK) ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit; (ii) Gjykata e Apelit ka dëgjuar vetëm pretendimet e njëres palë (AKK), ndërsa parashtruesit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia për t'i paraqitur provat dhe argumentet e tij lidhur me objektin e kërkesës dhe pretendimeve të palës tjetër në gjykim (AKK); dhe se, (iii) e drejta për proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare.
27. Për të mbështetur pretendimet e tij, parashtruesi i kërkesës iu referohet aktgjytimeve të Gjykatës në rastet KI103/10 dhe KI108/10.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatojë se Gjykata e Apelit ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit; (iv) të urdhërojë kthimin e rastit në rivendosje; dhe, (v) të përcaktojë çfarëdo mase tjetër juridike që vlerësohet juridikisht e bazuar dhe e arsyeshme.

Dispozitat Relevante Ligjore

Ligji për Kundërvajtje Nr. 05/L-087

KAPITULLI XVII DËRGIMI I SHKRESAVE

Neni 79

Mënyra e dërgimit

2. Letërthirrjet për marrjen në pyetje ose për hetim, respektivisht për dhënien e mbrojtjes me shkrim, si dhe të gjitha vendimet nga dërgimi i të cilave rrjedhë afati për ankesë, i dërgohen personalisht të pandehurit. Në të njëjtën mënyrë i dërgohen vendimet të dëmtuarit për të cilët nga data e dërgimit rrjedhë afati për ankesë.

Neni 77

Llojet dhe komunikimi i vendimeve

1. Vendimet në procedurën e kundërvajtjes gjykata i merr në formë të:

1.1. aktgjykimit;

1.2. aktvendimit, dhe;

1.3. urdhëresës.

Neni 124

Nxjerrja e aktgjykimit

1. Procedura e kundërvajtjes përfundon me marrjen e aktgjykimit dënues ose lirues, të aktvendimit me të cilin pezullohet procedura ose të aktvendimit me të cilin kryesit të mitur të kundërvajtjes i shqiptohet masa edukuese.

Neni 126

Aktvendimi për përfundimin e procedurës së kundërvajtjes

1. Procedura e kundërvajtjes do të përfundoj me aktvendim kur konstatohet se:

[...]

1.8. nuk ka prova që i pandehuri e ka bërë kundërvajtjen;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

32. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ka.nr.664/2019 të 5 gushtit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
33. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

34. Pas ekzaminimit të ankesave dhe vërejtjeve të parashtruesit, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Kërkesa, prandaj, nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 (2) të Rregullores, dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (Shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *A dhe B kundër Norvegjisë*, Aktgjykimi i 25 nëntorit 2016, paragrafi 55).
35. Rrjedhimisht, Gjykata shpall kërkesën të pranueshme.

Meritat e kërkesës

36. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
37. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se parimi i “barazisë së armëve” është cenuar në dëm të tij për shkak: (i) se nuk ka qenë i njoftuar se ndaj vendimit të gjykatës themelore, i cili ka qenë i favorshëm për të, pala kundërshtare (AKK) ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit; (ii) Gjykata e Apelit ka dëgjuar vetëm pretendimet e njëres palë (AKK), ndërsa parashtruesit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia për t’i paraqitur provat dhe argumentet e tij lidhur me objektin e kërkesës dhe pretendimeve të palës tjetër në gjykim (AKK); dhe se, (iii) e drejta për proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare.
38. Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*
39. Gjykata po ashtu i referohet nenit 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:
- “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.*
40. Gjykata thekson se e drejta për barazi të armëve garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të

rregullt) të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ). Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës ka obligim kushtetues që të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

41. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet parimeve të përgjithshme të konsoliduara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme për “barazinë e armëve” siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

42. Parimi i barazisë së armëve është i qenësishëm në konceptin më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit (shih rastin e GJEDNJ-së *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146). Kriteri i “barazisë së armëve”, në kuptim të “ekuilibrit të drejtë” ndërmjet palëve, në parim zbatohet në rastet civile sikurse edhe penale (shih rastin e GJEDNJ-së *Feldbrugge kundër Holandës*, Aktgjykim i 7 korrikut 1987, paragrafi 44).
43. Barazia e armëve nënkupton se secilës palë duhet dhënë mundësia e arsyeshme për ta prezantuar rastin e tij-përfshirë dëshmitë e tij- nën kushte që nuk e vënë atë në situatë konsiderueshëm të pafavorshme (*substantial disadvantage*) karshi palës tjetër (shih rastin e GJEDNJ-së, *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).
44. Në rreshtat në vijim, do të prezantohen disa situata ku GJEDNJ-ja kishte konstatuar shkelje të parimit të barazisë së armëve:
 - a) Ankesa e palës nuk i ishte dërguar palës tjetër, e cila rrjedhimisht, nuk kishte pasur mundësi të përgjigjej (shih rastin e GJEDNJ-së, *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19);
 - b) Afati ishte ndërprerë vetëm kundrejt njëres palë, duke e vënë kështu, palën tjetër në një situatë konsiderueshëm të pafavorshme (shih rastin e GJEDNJ-së *Platakou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2001, paragrafi 48);

c) Vetëm njërit nga dy dëshmitarët kryesorë i ishte dhënë leja për t'u dëgjuar (shih *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 34-35);

ç) Pala kundërshtarë kishte gëzuar favor të konsiderueshëm sa përket qasjes ndaj informatave relevante, kishte zënë pozitë dominuese në procedurë dhe kishte ushtruar influencë të konsiderueshme për sa i përket vlerësimit të gjykatës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 prillit 2003, paragrafi 37).

d) Mos dhënia e ndihmës ligjore të njëres prej palëve u kishte pamundësuar atyre që në mënyrë efektive ta prezantojnë rastin e tyre përballë një kundërshtari shumë më të pasur (shih rastin e GJEDNJ-së, *Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 15 shkurtit 2005, paragrafi 72).

45. GJEDNJ-ja ka përcaktuar se kriteret e “drejtësisë” siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së mbulon procedurat në tërësi, dhe çështja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht i një incident i veçantë ose mangësi procedurale, si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih, për shembull, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafët 55-70).
46. Është e papranueshme që njëra palë të paraqesë parashtresat (*submissions*) në një gjykatë pa dijeninë e palës tjetër dhe ndaj të cilave kjo e fundit nuk ka pasur mundësi të komentojë. Është çështje vetëm e palëve për të vlerësuar nëse një parashtresë meriton përgjigje (*reaction*). (Shih rastin e GJEDNJ-së, *APEH Üldözötteinek Szövetsége dhe të tjerët kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 5 tetorit 2005, paragrafi 42).
47. Sa u përket rasteve ku ballafaqohen autoritetet ndjekëse me një individ privat, autoritetet ndjekëse mund të gëzojnë pozitë të privilegjuar që justifikohet me mbrojtje të rendit juridik. Megjithatë, kjo nuk duhet të rezultojë ashtu që një palë në procedurë civile ta vë në mënyrë të tepruar në situatë të pafavorshme karshi autoriteteve ndjekëse (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Stankiewicz kundër Polonisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2006, paragrafi 68).

(i) Zbatimi i parimeve të përgjithshme ndaj rrethanave të rastit konkret

48. Gjykata vë sërish në spikamë pretendimin qendror të parashtruesit të kërkesës: (i) se nuk ka qenë i njoftuar se ndaj vendimit të gjykatës themelore, i cili ka qenë i favorshëm për të, pala kundërshtare (AKK) ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit; (ii) Gjykata e Apelit ka dëgjuar vetëm pretendimet e njëres palë (AKK), ndërsa parashtruesit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia për t'i paraqitur provat dhe argumentet e tij lidhur me objektin e kërkesës dhe pretendimeve të palës tjetër në gjykim (AKK); dhe se, (iii) e drejta për proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare.
49. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se nuk është detyrë e saj që të vlerësojë *in abstracto* dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të vlefshme për zgjidhjen e rastit të parashtruesit të kërkesës. Detyrë kryesore e Gjykatës në këtë rast, është që të konstatojë nëse është respektuar parimi i “barazisë së armëve” dhe nëse procedurat në tërësi kanë qenë të drejta dhe në pajtim me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
50. Për më tepër në këtë çështje, si rregull i përgjithshëm, vlerësimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë çështje vetëm për gjykatat e rregullta, vlerësimet dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në diskutim. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, Aktgjykim i 15 janarit 2007, para. 89).
51. Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar drejtë ligjin e zbatueshëm (ligjshmëria), por do të shqyrtojë nëse gjykatat në fjalë me vendimet e tyre kanë shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria), (Shih, për shembull, Rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI72/14, *Parashtruese Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, paragrafi 65).
52. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit (i) ka lexuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të paraqitur në Gjykatën Themelore kundër vendimit të AKK-së; (ii) deklaratën e dhënë nga parashtruesi i kërkesës në seancën e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore; (iii) dëshminë e dëshmitarit BH, President i KOK-ut; (iv) dëshminë e dëshmitarit DA, zyrtar në AKK. Gjykata e Apelit e ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore K. nr. 2609/2018 i 5 qershorit 2019, duke konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës pa dyshim se

parashtruesi i kërkesës është Deputet i Kuvendit të Kosovës, në të njëjtën kohë ushtron edhe detyrën e Nënpresidentit të parë të Organizatës joqeveritare të KOK, duke rënë ndesh me nenin 14.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Ushtrimin e Funkcionit Publik (shih paragrafi 5 i Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit Ka. nr. 664/2019 i 5 gushtit 2019).

53. Gjykata po ashtu vëren se nga dosja e plotë e kërkesës nr. KI209/19 por as nga përmbajtja e Aktgjyimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nuk ka ndonjë dokument që tregon se parashtruesi i kërkesës është njoftuar për seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën e Apelit, të vënë në lëvizje nga ankesa e AKK-së.
54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në dijeni për ankesën e AKK në Gjykatën e Apelit dhe se atij nuk i është dhënë mundësia që të jetë i pranishëm në seancën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, me qëllim që të përgjigjet ndaj ankesës së AKK-së.
55. Duke qenë se Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Themelore që ka qenë i favorshëm për parashtruesin e kërkesës, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit ka pasur obligim ligjor dhe kushtetues që parashtruesin e kërkesës ta njoftojë për gjykimin e rastit të tij, në mënyrë që këtij të fundit t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj ankesës së AKK-së.
56. Mos thirrja e parashtruesit të kërkesës që të jetë i pranishëm në seancën gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe pamundësia e tij që të përgjigjet ndaj ankesës së AKK-së, ka bërë që parashtruesi i kërkesës të vihet në pozitë të pabarabartë karshi palës kundërshtare AKK, çka ka rezultuar me cenimin të parimit të barazisë së armëve në dëm të parashtruesit të kërkesës.
57. Gjykata konsideron se është e papranueshme që njëra palë AKK të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit pa dijeninë e palës tjetër parashtruesit të kërkesës dhe ndaj të cilës ky i fundit nuk ka pasur mundësi të komentojë. (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *APEH Üldözötteinek Szövetsége dhe të tjerët kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 42).
58. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesi i kërkesës është dashur të thirret në seancë gjyqësore nga Gjykata e Apelit jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI108/10,

Parashtrues Fadil Selmanaj, Aktgjykim i 6 tetorit 2011, paragrafi 66 dhe referencat e përmendura aty).

59. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

60. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon caktimin e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ka. nr. 664/2019 të 5 gushtit 2019 me arsyetim: *“[...] kërkohet nga kjo Gjykatë e nderuar që të lëshojë masë të përkohshme, vlerësojë këtë Kërkesë si të pranueshme, të konstatojë shkeljet, të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të sfiduar me këtë Kërkesë, dhe ta kthejë rastin në rivendosje.”*

61. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parasheh:

“1.Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë ë nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2.Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale”.

62. Gjykata vlerëson se nga përmbajtja e kërkesës rezulton se nuk plotësohen kushtet për rrezik apo dëm të pariparueshëm apo se bëhet fjalë për interes publik. Veç kësaj, Gjykata ka konstatuar shkelje të natyrës procedurale dhe nuk ka vendosur nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur konflikt interesi ose jo.

63. Gjykata refuzon kërkesën për caktim të masës së përkohshme.

Përfundim

64. Gjykata përfundon se në rastin konkret ka konstatuar shkelje të parimit të barazisë së armëve si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

65. Gjykata thekson se konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së nuk paragjykon zgjidhjen materiale të këtij rasti, pra nëse parashtruesi i kërkesës ka rënë në konflikt interesi ose jo. Ajo çështje bie në fushëveprimin dhe duhet të zgjidhet nga gjykatat e rregullta
66. Megjithatë, konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në dëm të parashtruesit të kërkesës obligon Gjykatën e Apelit që në rigjykim të kësaj çështje ta ftojë parashtruesin e kërkesës dhe që atij t'i akordojë mundësi efektive që të përgjigjet ndaj ankesës së AKK-së-duke gjetur kështu- balancën e drejtë ndërmjet palëve ndërgjyqëse në pajtim me parimin e barazisë së armëve (shih rastin e GJEDNJ-së, *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2001, paragrafi 51).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) dhe 66 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, [Ka. nr. 664/2019], të 5 gushtit 2019;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, [Ka. nr. 664/2019], të 5 gushtit 2019 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës jo më larg se më 3 maj 2021;
- VI. TA REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;
- VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me këtë urdhër;
- VIII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'i kumtohet Palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- IX. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI80/19, Parashtrues: Radomir Dimitrijević, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-18-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019

KI80/19, Aktgjykim i miratuar më 10 nëntor 2020 dhe i publikuar më 9 dhjetor 2020

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta në pronë, kërkesë e pranueshme, shkelje e nenin 31 të Kushtetutës*

Parashtruesit i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kontestonte kushtetutshmërinë e Aktvendimit AC-I-18-0547-A0001 të Kolegjit të Apelit, të 21 shkurtit 2019, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Kolegji i Apelit shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejte] të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, sepse: “Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka marrë vendim të parakohshëm me të cilën e konsideron ankesën e parashtruesit të kërkesës të tërhequr sepse paraprakisht KADhPGJS është dashur të vendosë për kërkesën e parashtruesit të kërkesës me të cilin ka kërkuar afat shtesë ose shtyrje të pagesës së taksës gjyqësore sipas ankesës.”

Gjykata fillimisht vlerësoi se kërkesa i plotësoi kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim meritore të kërkesës, siç janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të saktësuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës. Në përmbushje të kriterëve të mësipërme që rrjedhin nga e drejta për qasje në gjykatë, Gjykata vërejti se, në rrethanat e këtij rasti, kishim të bënim me një “kontest” dhe një të “drejtë civile” mes parashtruesit të kërkesës dhe AKP-së, përkatësisht lidhur me realizimin e pagave të pretenduara në shumën prej 16,420.00 euro, për periudhën kohore qershor 1999-2007, si dhe pagesën e 20% nga fondi i mjeteve të privatizimit të ndërmarrjes NSH Fabrika për prodhimin e gypave dhe profileve të çelikut në Ferizaj.

Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës i ndodhur para rrethanave faktike dhe juridike të tilla, nga 29 nëntori 2018

ishte në pritje të shqyrtimit të kërkesës së tij dhe të dhënies së një përgjigjeje të arsyetuar nga ana e Kolegjit të Apelit. Megjithatë ky i fundit, pa e marrë fare në shqyrtim kërkesën e tij të 29 nëntorit 2018, e kishte konsideruar ankesën e tij të tërhequr. I ndodhur para një rrethane të tillë, Kolegji i Apelit ka qenë i detyruar ta shqyrtonte kërkesën e parashtruesit të kërkesë, në pajtueshmëri me paragrafin 5 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për unifikimin e taksës gjyqësore, para se ta konsideronte ankesën e parashtruesit të kërkesës si të tërhequr. Nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstatoi se mos shqyrtimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës nga Kolegji i Apelit përbënte një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila ishte në kundërshtim me të drejtën për qasje në drejtësi, që u garantohet individëve me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Si përfundim, Gjykata gjeti se Aktvendimi i kontestuar [AC-I-0547-A0001] i Kolegjit të Apelit, i 21 shkurtit 2019, me të cilin është konsideruar e tërhequr ankesa e parashtruesit të kërkesës, nuk ka respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për “qasje në gjykatë”. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI80/19

Parashtrues

Radomir Dimitrijević

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të
Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit,
AC-I-18-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Radomir Dimitrijević (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga Ferizaj, i cili përfaqësohet nga avokatët Vladimir Petrović, Vasil Arsić, Dejan Vasić dhe Žarko Gajić, Projekti për ndihmë juridike falas, me seli në Graçanicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) AC-I-18-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 maj 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 19 qershor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të saj ia dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DhPGjS).
8. Më 19 nëntor 2019, Gjykata kërkoi informata shtesë nga DhPGjS, përkitazi me parashtruesin e 29 nëntorit 2019 dhe parashtruesin e 13 marsit 2019.
9. Më 26 nëntor 2019, DhPGjS dorëzoi në Gjykatë një shkresë përmes së cilës informon Gjykatën se përkitazi me ankesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, e 13 marsit 2019, Kolegji i Apelit i DhPGjS, më 28 mars 2019, nxori Aktvendimin AC-I-19-0037, me të cilën është hedhur poshtë si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës.

10. Më 16 janar 2020, Kolegji shqyrtues propozoi që shqyrtimi i kërkesës të shtyhet për plotësime me informata shtesë.
11. Më 10 nëntor 2020, Kolegji e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 21 mars 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të DhPGjS (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Specializuar), kundër vendimit nr. GJI053-172, të AKP-së, përkatësisht të Autoritetit të likuidimit, të 8 shkurtit 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për paga të papaguara në shumën prej 16,420.00 euro, për periudhën kohore, qershor 1999-2007, si dhe pagesën e 20%, nga fondi i mjeteve të privatizimit të ndërmarrjes NSH Fabrika për prodhimin e gypave dhe profileve të çelikut, në Ferizaj.
13. Më 7 shtator 2016, Kolegji i Specializuar, një kopje të ankesës ia dërgoi AKP-së për të parashtruar përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
14. Më 16 shtator 2019, AKP-ja e dorëzoi përgjigjen ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, me propozimin që Kolegji i Specializuar të refuzojë, si të pabazuar, ankesën dhe të vërtetojë vendimin nr. GJI053-172, të 8 shkurtit 2013, të Autoritetit të Likuidimit, me arsyetimin se ankesa ishte parashkruar, ngase parashtruesi i kërkesës e kishte humbur afatin për t'iu drejtuar gjykatës në kohë për realizimin e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës.
15. Më 28 shtator 2016, Kolegji i Specializuar, përgjigjen e AKP-së ia kishte përcjellur parashtruesit të kërkesës për parashtrim të përgjigjes, i cili më 27 tetor 2016 e dorëzoi përgjigjen e tij ndaj pretendimeve të AKP-së, me propozimin që ankesa e tij të aprovohej si e bazuar.
16. Më 22 tetor 2018, Kolegji i Specializuar, me Aktgjykimin C-IV-13-0298, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin nr. GJI053-017 të Autoritetit të likuidimit, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në bazë të pikës II të dispozitivit, parashtruesi i kërkesës ishte obliguar të paguajë taksën gjyqësore në vlerën monetare prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga

plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Me 12 nëntor 2018, kjo taksë gjyqësore ishte paguar nga parashtruesi i kërkesës.

17. Më 2 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit, kundër Aktgjykimit C-IV-13-0298 të Kolegjit të Specializuar, të 22 tetorit 2018.
18. Më 12 nëntor 2018, Kolegji i Apelit, urdhëron parashtruesin e kërkesës që në afat prej 15 ditësh ta paguajë taksën gjyqësore, në lartësinë prej 30 eurove.
19. Më 29 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Kolegjin e Apelit për zgjatjen e afatit për pagesën e taksës gjyqësore.
20. Më 21 shkurt 2019, Kolegji i Apelit, me Aktvendimin AC-I-0547-A0001, ankesën e parashtruesit të kërkesës e konsideroi të tërhequr për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore, me arsyetimin se taksa nuk ishte paguar në afatin e kërkuar dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte kërkuar lirim nga taksa.
21. Më 13 mars 2019, parashtruesi i kërkesës, paraqet serish ankesë në Kolegjin e Apelit, për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të ankesës së tij të 28 nëntorit 2018 për zgjatjen e afatit të pagesës së taksës, me propozimin që Aktvendimi i saj AC-I-0547-A0001 i 26 shkurtit 2019, të anulohet.
22. Më 28 mars 2019, Kolegji i Apelit, me Aktvendimin AC-I-19-0037, e hedhë poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin: *“E vërteta është se ai kishte parashtruar një parashtrësë me të cilën, ndër të tjera, kërkonte zgjatjen e afatit për pagesën e taksës gjyqësore, por përkundër pritjes në heshtje të gjykatës, nga momenti i parashtrimi të kësaj parashtrëse deri në datën e vendimmarrjes kishin kaluar gati tre muaj, ankuesi nuk e ka paguar pagesën e taksës, e as që ka parashtruar kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë], të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, sepse: *“Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka marrë vendim të parakohshëm me të cilën e konsideron ankesën e parashtruesit të kërkesës të tërhequr sepse paraprakisht KADhPGjS është dashur të vendosë për kërkesën e parashtruesit të kërkesës me të cilin ka kërkuar afat shtesë ose shtyrje të pagesës së taksës gjyqësore sipas ankesës”*.

24. Si rrjedhojë, parashtuesi i kërkesës thekson që: *“...dispozitat e udhëzimit administrativ nr. 01/2017 për barazimin e taksave gjyqësore iu lejojnë palëve në procedurë që në përputhje me nenin 8 par. 8.5 nënpar. 8.5.1 dhe 8.5.2 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2017 për barazimin e taksave gjyqësore, i cili parasheh që: “Gjyqtari ose kryetari i Dhomës gjyqësore të cilit i është caktuar lënda, mund ti japë kohë shtesë palës E CILA KËRKON ZGJATJEN E AFATIT për pagesën e taksës gjyqësore në vlerën e përgjithshme ose një pjese të saj [...], të kërkojnë nga gjykata afat shtesë për pagesën e taksës gjyqësore”.*
25. Për më tepër parashtuesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit, *“...nuk e ka marrë parasysh e as shqyrtuar kërkesën për shtyrjen e pagesës së taksës, e që mund të konstatohet nga arsyetimi i dhënë në Aktvendimin AC-I-18-0547-A0001 të 21.02.2019, ku fare nuk thuhet që paditësi ka parashtruar kërkesë në gjykatë për shtyrje të pagesës së taksës dhe kërkesës së afatit shtesë. Në këtë mënyrë parashtuesi i kërkesës mendon që Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) e në lidhje me nenin 6 dhe 1 të protokollit 1 të Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, sepse më parë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e paditësit/parashtuesit të kërkesës mbi kërkesën shtesë të afatit për pagesën e taksës gjyqësore e që gjithsesi do të ishte me ndikim thelbësor procedural që gjykata të mos marrë aktvendim me të cilin ankesën e paditësit ta konsiderojë të tërhequr, por paditësi edhe më tej do të mbetej aktiv në procedurën e ankesës në dy mënyra”.*
26. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Kolegji i Apelit, shkeli të drejtën e tij të garantuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës duke i ndërlidhur këto shkelje kushtetuese me nenin 10 të Ligjit për DhPGjS dhe nenin 2.8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe me nenin 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
27. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“...të vërtetojë që ka ardhur deri te shkelja e dispozitave të lartpërmendura me propozim që Gjykata Kushtetuese të anulojë Aktvendimin AC-I-18-0547-A0001 të 22.02.2019 dhe të urdhërojë Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të rishikojë procedurën ankimore në pjesën që ka të bëjë me parashtuesin e kërkesës Radomir Dimitrijević”.*

Dispozitat relevante***Udhëzimi Administrativ nr.01/2017 për unifikimin e taksës gjyqësore*****Neni 8****Lirimi nga pagesa e taksave***“(…)**8.5 Gjykatësi apo kryetari i trupit gjykues të cilit i është caktuar lënda, mund t'i jap kohë shtesë palës e cila ka kërkuar zgjatjen e afatit të pagesës së taksës në shumën e tërësishme apo të një pjese të saj, nëse gjene se:**8.5.1 ajo pale nuk kualifikohet si pale që lirohet nga pagesa e taksave sipas nenit 8.1, dhe**8.5.2 se zgjatja e afatit për të paguar shumën e tërësishme ose një pjesë të taksave është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të palës.”***Pranueshmëria e kërkesës**

28. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.**[...]**7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.**[...].”*

30. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

31. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar, si dhe ka dorëzuar kërkesën në kohë.
32. Më tej, Gjykata shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 39

[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) *“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

33. Gjykata konsideron se kërkesa ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie*, ndërkohë që ajo nuk është qartazi e pabazuar, në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

34. Fillimisht, Gjykata përsërit se kërkesa e nenit 53 të Kushtetutës përcakton që interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë të jetë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
35. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-18-0547-A0001] të Kolegjit të Apelit, të 21 shkurtit 2019, me të cilin ankesa e tij u konsiderua e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Ai pretendon se ky vendim ka rezultuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenet 31, 54 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të saj.
36. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave kushtetuese të tij, ka të bëjë me faktin se Kolegji i Apelit nuk e kishte trajtuar kërkesën e tij për zgjatje të afatit për pagesën e taksës gjyqësore, të cilën e kishte parashtruar më 29 nëntor 2018.
37. Duke qenë se pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me procesin e rregullt gjyqësor, përkatësisht me të drejtën për qasje në drejtësi, Gjykata në vazhdim do vlerësojë nëse Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është në pajtueshmëri me standardet e kërkuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së
38. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, përcaktojnë:

Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i
Kushtetutës

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

[...]

Neni 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] i Konventës

1. *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”*

[...]

39. Për të përcaktuar aplikueshmërinë e garancive të përcaktuara me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ). Analiza vijuese do të bëhet në harmoni me kërkesat e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës

Parimet e përgjithshme përkitazi me të “drejtën për gjykatë”

40. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6 të KEDNJ-së është definuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36). Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GJEDNJ-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në gjykatë” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së. (Përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta në Gjykatë dhe gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë*, Aktgjykim

i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile” para një gjykate (shih rastin e GJEDNJ-së, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).

41. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që u mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).
42. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë ‘padi’ lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse, tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.
43. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti, të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve, duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë* (nr.2), Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). “Kontesti”, megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të jetë (i) i “vërtetë dhe serioz” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe, (ii)

rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë “vendimtare” për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, “lidhjet e paqëndrueshme” ose “pasojat e largëta” në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Lovrić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51 dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të).

44. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një “të drejtë civile” dhe një “kontest”, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së i garantojnë individit të drejtën “që ajo çështje të zgjidhet nga një tribunal” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykitimit të drejtë dhe të paanshëm, kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih rastin e GJEDNJ-së *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).
45. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, KEDNJ nuk synon të garantojë të drejta që janë “teorike dhe të rreme”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive”, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e GJEDNJ-së *Kutić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).
46. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kutić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).

47. Parimet e lartpërmendura megjithatë nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNJ-së e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkitazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në Gjykatë, A. E drejta dhe në qasja në Gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit ashtu që të cenohet vetë thelbi i të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim” dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Lupeni Greek Catholic Parish kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe Marković dhe të tjerët kundër Italisë, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

48. Bazuar në si më sipër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se e drejta në gjykatë, në parim, është e garantuar përkitazi me “kontestet” në lidhje me një “të drejtë civile”.
49. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me dy çështje esenciale për të përcaktuar aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së. E para ndërlihet me “të drejtën civile”, ndërsa e dyta me ekzistencën e një “kontesti”.
50. Gjykata, rikujton që parashtuesi i kërkesës ishte punëtor i ndërmarrjes NSH Fabrika për prodhimin e gypave dhe profileve të çelikut, në Ferizaj. Në ndërkohë ndërmarrja në fjalë ishte privatizuar. Pas një kohe, parashtuesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë tek Autoriteti i likuidimit, në kuadër të AKP-së, ku objekti i ankesës ishte realizimi i pagave të papaguara në shumën prej 16,420.00 euro, për periudhën kohore, qershor 1999-2007, si dhe pagesën e 20%, nga fondi i mjeteve të privatizimit të ndërmarrjes NSH Fabrika për

prodhimin e gypave dhe profileve të çelikut, në Ferizaj. Më 8 shkurt 2013, ankesa e tij ishte refuzuar nga AKP, për shkak të parashkrimit. Parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Kolegjin e Specializuar, i cili më 22 tetor 2018, e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit dhe e kishte lënë në fuqi si të drejtë vendimin e AKP-së, të 8 shkurtit 2013. Kundër vendimit të Kolegjit të Specializuar, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Kolegjin e Apelit.

51. Kolegji i Apelit, para se të shqyrtonte meritat e ankesës së parashtruesit të kërkesës, më 12 nëntor 2018, kishte kërkuar nga ai që në afat prej 15 ditësh ta paguante taksën gjyqësore në lartësinë prej 30 eurove. Parashtruesi i kërkesës në përgjigje të këtij urdhri, më 29 nëntor 2018, parashtroi kërkesë për zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore. Kolegji i Apelit, pa e trajtuar fare kërkesën për zgjatje të afatit të pagesës së taksës, më 21 shkurt 2019, kishte nxjerrë Aktvendimin AC-I-0547-A0001, përmes të cilit e konsideronte ankesën e parashtruesit të kërkesës të tërhequr, me arsyetimin se parashtruesi: *“nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar..., përmes njoftimit (vërejtjes) së datës 22 nëntorit 2018, e cila i është dorëzuar përfaqësuesit të ankuesit, më 27 nëntor 2018”* dhe, për më tepër ai *“nuk ka paraqitur kërkesë për t’u liruar nga taksa gjyqësore”*.
52. Më tej, Gjykata verën se, parashtruesi i kërkesës, më 13 mars 2019, i ishte drejtuar serish me ankesë Kolegjit të Apelit, nëpërmjet së cilës kërkoj anulimin e Aktvendimit të kontestuar [AC-I-0547-A0001] të 21 shkurtit 2019, duke pretenduar në shkelje të dispozitave procedurale për shkak të mos shqyrtimit të kërkesës për zgjatje të afatit të pagesës së taksës, e cila i pamundësoi atij shqyrtimin meritator të ankesës. Kolegji i Apelit, më 28 mars 2019, nxjerrë Aktvendimin AC-I-19-0037, me të cilin hedhet poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin e njëjtë, sikurse me Aktvendimin e kontestuar të 21 shkurtit 2019, duke theksuar se: *“...nga momenti i parashtrimit të kësaj parashtrëse deri në datën e vendimmarrjes kishin kaluar gati tre muaj, ankuesi nuk e ka paguar pagesën e taksës, e as që ka parashtruar kërkesë për lirimin nga taksa gjyqësore”*.
53. Në përmbushje të kritereve të mësipërme që rrjedhin nga e drejta për qasje në gjykatë, Gjykata verën se, në rrethanat e këtij rasti kemi të bëjmë me një “kontest” dhe një të “drejtë civile” mes parashtruesit të kërkesës dhe AKP-së, përkatësisht lidhur me realizimin e pagave të pretenduara në shumën prej 16,420.00 euro, për periudhën kohore, qershor 1999-2007, si dhe pagesën e 20%, nga fondi i mjeteve të privatizimit të ndërmarrjes NSH Fabrika për prodhimin e gypave dhe profileve të çelikut, në Ferizaj.

54. Pasi që janë përmbushur dy kushtet e mësipërme, Gjykata më tej vlerëson se nga buronte e drejta e parashtruesit të kërkesës për të ushtruar kërkesë për zgjatje të afatit të pagesës së taksës dhe nëse një kërkesë e tillë do të duhej shqyrtuar nga ana e Kolegjit të Apelit, para se të vendoste përfundimisht për ankesën.
55. Sipas shkresave të lëndës, Gjykata konstaton se e drejta e parashtruesit të kërkesës për të ushtruar të drejtën e parashtrimit të kërkesës për zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore buron nga neni 8, paragrafi (5) i Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për unifikimin e taksës gjyqësore, i cili parasheh që:

*“8.5 Gjykatësi apo kryetari i trupit gjykues të cilit i është caktuar lënda, mund t’i jap kohë shtesë **palës e cila ka kërkuar zgjatjen e afatit të pagesës së taksës** në shumën e tërësishme apo të një pjese të saj, nëse gjen se:*

8.5.1 ajo palë nuk kualifikohet si palë që lirohet nga pagesa e taksave sipas nenit 8.1, dhe

8.5.2 se zgjatja e afatit për të paguar shumën e tërësishme ose një pjesë të taksave është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të palës.”

56. Në vlerësimin e Gjykatës, kërkesa e parashtruesit të kërkesë ishte plotësisht legjitime dhe e bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2017, të cituar më lartë, me të cilin parashihen hapat procedural për ushtrimin e të drejtave për: 1) lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, dhe 2) zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore. Qëllimi i këtyre rregullimeve, të cilat janë të vëna në dispozicion të palëve që ushtrojnë padi apo ankesa, është që t’ua mundësojë palëve qasjen në gjykatë, kur plotësohen kushtet e përcaktuara me Udhëzimin e sipërtheksuar. Në të kundërtën, përfshirja e rregullimeve të tilla do të ishte pa asnjë efekt dhe vetvetiu do ta bënte normën të pakuptimtë.
57. Gjykata, përsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar drejtë rregulltat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale. Megjithatë, në rastet kur një pretendim ngritë çështje kushtetuese, përkatësisht parregullsi të procesit gjyqësor, Gjykata është e detyruar të ndërhyjë dhe të riparojë shkeljet e shkaktuara nga gjykatat e rregullta, për t’i siguruar individit një gjykim të drejtë në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
58. Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ndodhur para rrethanave faktike dhe juridike të tilla, nga 29 nëntori 2018 ishte në pritje të shqyrtimit të kërkesës së tij dhe të

dhënies së një përgjigje të arsyetuar nga ana e Kolegjit të Apelit. Megjithatë ky i fundit, pa e marrë fare në shqyrtim kërkesën e tij të 29 nëntorit 2018, e kishte konsideruar ankesën e tij të tërhequr. I ndodhur para një rrethane të tillë, Kolegji i Apelit ka qenë i detyruar ta shqyrtonte kërkesën e parashtruesit të kërkesë, në pajtueshmëri me paragrafin 5 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për unifikimin e taksës gjyqësore, para se ta konsideronte ankesën e parashtruesit të kërkesës si të tërhequr.

59. Vetëm pas shqyrtimit të kërkesës për zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore dhe dhënies së një përgjigjeje të argumentuar ndaj kësaj kërkesë, mund të thuhet se Kolegji i Apelit ka respektuar të drejtën e qasjes në drejtësi të parashtruesit të kërkesës. Gjykata, po ashtu thekson se pavarësisht përfundimit në të cilin do të kishte arritur Kolegji i Apelit, pasi do ta shqyrtonte kërkesën për zgjatjen e afatit të pagesës së taksës dhe dhënies së një përgjigjeje të argumentuar kësaj kërkesë, e drejta e parashtruesit të kërkesës për t'iu drejtuar gjykatës do të konsiderohej e realizuar efektivisht. Në këtë situatë, Kolegji i Apeli as nuk e kishte marrë në shqyrtim kërkesën e tij dhe as nuk kishte dhënë ndonjë arsyetim se përse kjo kërkesë e tij nuk duhej trajtuar.
60. Nga shtjellimet e mësipërme Gjykatës konstaton se mos shqyrtimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës nga Kolegji i Apelit, përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila është në kundërshtim me të drejtën për qasje në drejtësi, që u garantohet individëve me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.
61. Gjykata, duke konstatuar se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, i 21 shkurtit 2019 është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, e konsideron të panevojshme që në këtë fazë të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
62. Si përfundim, Gjykata gjen se Aktvendimi i kontestuar [AC-I-0547-A0001] i Kolegjit të Apelit, i 21 shkurtit 2019, me të cilin është konsideruar e tërhequr ankesa e parashtruesit të kërkesës, nuk ka respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për “qasje në gjykatë”.
63. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 10 nëntor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË shkelje të nenit 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019 dhe KTHEN të njëjtin për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës;
- IV. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të DHPGJS që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës jo më larg se më 10 maj 2021;
- V. URDHËRON që Aktgjykimi i saj KI80/19 t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, Parashtrues: Et-hem Bokshi dhe të Tjerët; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, publikuar më 29 dhjetor 2020

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mungesa e seancës dëgjimore, shkëlqje e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes N.Sh. “Agimi” në Gjakovë dhe të drejtat respektive të punëtorëve për t’iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe paragrafin 4 të nenit 10 (Të Drejtat e të Punësuarëve) të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45.

Parashtruesit e kërkesës nuk u përfshinë në Listën e Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH “Agimi”. Të njëjtat në mënyrë individuale parashtruan ankesa pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto ankesa u refuzuan. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës iniciuan padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kontestuar Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkitazi me vërtetimin e fakteve si dhe interpretimin e ligjit, duke pretenduar gjithashtu se ishin diskriminuar. Të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar.

Kolegji i Specializuar, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se “*faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta*”, duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të dy prej tyre, dhe duke konstatuar se ishin diskriminuar, prandaj të njëjtat duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke vepruar mbi bazën e ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit kundër këtij Aktgjykimi, në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të

Privatizimit dhe e kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke hequr “nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së “Agimi” Gjakovë” të gjithë parashtruesit e kërkesës. Këtë Aktgjykim, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata u fokusua në ato që ndërlidhen me mungesën e një seancë dëgjimore para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe në këtë kontekst, (i) fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe më pas, (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, duke u bazuar ndër të tjerash, në Aktgjykimin të Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, sqaroi parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Për më tepër, Gjykata në mënyrë specifike shqyrtoi dhe aplikoi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut bazuar mbi të cilën bëhet vlerësimi nëse mungesa e një kërkesë për seancë dëgjimore, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e palëve nga një e drejtë e tillë.

Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore, ndër të tjerash, sepse (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij

domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar *“çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike”*, çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar *“rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”*; (iv) Kolegji i Apelit, në fakt, kishte shqyrtuar çështje *“fakti dhe ligji”*, çështje këto shqyrtimi i të cilave, në parim, kërkon mbajtjen e një seance dëgjimore; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar *“heqjen dorë nga seanca gojore”*.

Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjykata gjithashtu vuri theksin në faktin se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e një seance dëgjimore, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

AKTGJYKIM

**në rastet nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19,
KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19,
KI157/19 dhe KI159/19**

Parashtrues

Et-hem Bokshi dhe të Tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit
të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për
Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KI145/19 është dorëzuar nga Et-hem Bokshi; kërkesa KI146/19 është dorëzuar nga Agim Muhaxhiri; kërkesa KI147/19 është dorëzuar nga Isa Hoti; kërkesa KI149/19 është dorëzuar nga Gëzime Zhubi-Buza; kërkesa KI150/19 është dorëzuar nga Nanije Deva-Hasi; kërkesa KI151/19 është dorëzuar nga Valbonë Krelani-Elezi; kërkesa KI152/19 është dorëzuar nga Rafet Zhubi; kërkesa KI153/19 është dorëzuar nga Fakte Thaçi-Dina; kërkesa KI154/19 është dorëzuar nga Jakup Morina; kërkesa KI155/19 është dorëzuar nga Burbuqe Shala; kërkesa KI156/19 është dorëzuar nga Shkelzen Krelani; kërkesa KI157/19 është dorëzuar nga Bukuriye Bordoniqi; dhe kërkesa KI159/19 është dorëzuar nga Agim Haxhibeqiri, të gjithë me banim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) në lidhje me Aktgjykimin [SCEL-11-0075] e 4 shtatorit 2013 të Kolegji i Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkëlqen e të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 shtator 2019, parashtruesit e kërkesës Et-hem Bokshi dhe Agim Muhaxhiri i dorëzuan përmes postës kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës Isa Hoti e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatë.
7. Më 18 shtator 2019, parashtruesit e kërkesës: Gëzime Zhubi-Buza, Valobonë Krelani-Elezi, Rafet Zhubi, Fakete Thaqi-Dina, Jakup Morina, Burbuqe Shala, Shkelzen Krelani dhe Bukuriye Bordoniqi, i dorëzuan përmes postës kërkesat e tyre në Gjykatë.

8. Më 19 shtator 2019, parashtruesit e kërkesës: Nanije Deva-Hasi dhe Agim Haxhibeqiri i dorëzuan përmes postës kërkesat e tyre në Gjykatë.
9. Më 30 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi për rastin KI145/19 gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
10. Më 30 shtator 2019, në pajtim me paragrafin (1) të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19 dhe KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 me kërkesën KI145/19.
11. Më 23 tetor 2019, Gjykata njoftoi (i) parashtruesit e kërkesës për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave; dhe (ii) DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.
12. Më 19 dhjetor 2019, Gjykata e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës Et-hem Bokshi se i njëjti ka dorëzuar dy kërkesa të njëjta në Gjykatë, duke kontestuar të njëjtin Aktgjykim, të regjistruara si kërkesat KI145/19 dhe KI208/19, respektivisht, duke kërkuar sqarim nëse parashtruesi i kërkesës ka patur për qëllim të parashtrojë një rast të vetëm apo jo. Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, së në rast të mospranimit të përgjegjës përkatëse, ajo do të vazhdojë me procedimin e kërkesës bazuar në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj në shkresën e Gjykatës.
13. Më 23 nëntor 2020, Gjykata kërkoi dosjen e plotë të lëndës nga DHPGJS.
14. Më 30 nëntor 2020, DHPGJS dorëzoi dosjen e lëndës në Gjykatë.
15. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
16. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe konstatoi se (ii) Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 15 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin në vijim: AKP) kishte privatizuar ndërmarrjen shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: NSH "Agimi"). Në të njëjtën datë, përmes shkresës [nr.1065], parashtruesit e kërkesës ishin njoftuar se *"pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj"* dhe se i njëjti *"përfundon menjëherë"*. Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punëtorë të ndërmarrjes përkatëse në intervale të caktuara kohore.
18. Bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë parasysh që parashtruesit e kërkesës nuk ishin pjesë e Listës së Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi", të njëjtit në mënyrë individuale parashtruan ankesa pranë AKP-së. Kjo e fundit, më 13 dhjetor 2011, refuzoi si të pabazuara ankesat përkatëse. Përkritazi me parashtruesit e kërkesës Fakete Thaqi-Dina dhe Et-hem Bokshi, theksoi se nuk kanë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme, ndërsa përkritazi me parashtruesit e kërkesës Agim Muhaxhiri, Nanije Deva-Hasi, Shkelzen Krelani, Rafet Zhubi dhe Isa Hoti, theksoi se të njëjtit kanë dorëzuar librezën e punës, por se e njëjta është mbyllur dhe rrjedhimisht *"punëtorët nuk kanë qenë të punësuar në NSH në kohën kur ajo është privatizuar"*.
19. Më 22 dhjetor 2011, përmes mjeteve të informimit publik: (i) u publikua Lista e Përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi" (në tekstin e mëtejme: Lista Përfundimtare); si dhe (ii) u përcaktua 14 janari 2012 si datë e fundit për dorëzimin e ankesave në DHPGJS kundër Listës Përfundimtare.
20. Ndërmjet 28 dhjetorit 2011 dhe 13 janarit 2012, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, për shkak të mospërfshirjes në Listën Përfundimtare. Në parim, të gjithë kishin pretenduar se nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë që ishin përfshirë në Listën Përfundimtare, dhe rrjedhimisht ishin diskriminuar. Për më tepër, një pjesë e parashtrueseve të kërkesës kishin dorëzuar dokumentet shtesë si në vijim: (i) Fakete Thaqi-Dina, kishte bashkangjitur vërtetimin për përvojën e punës dhe të ardhurat personale të datës 10 maj 2010; (ii) Gëzime Zhubi-Buza, kishte bashkangjitur librezën e punës me datë të hapjes 1 maj 1985 dhe datë të mbylljes 8 janar 1996; (iii) Rafet Zhubi, kishte bashkangjitur vërtetimin për marrëdhënien e punës të datës 2 nëntor 2009 dhe

librezën e punës me datë të hapjes 1 janar 1970 dhe datë të mbylljes 31 tetor 1996; dhe (iv) Valbonë Krelani-Elezi, kishte bashkangjitur Aktvendimin për pushim të përkohshëm të punësimit nr. 158/1 të datës 01 shkurt 1996 dhe librezën e punës me datë të hapjes 10 dhjetor 1980 dhe të mbylljes 31 korrik 1994.

21. Ndërmjet 1 marsit 2012 dhe 18 prillit 2012, AKP paraqiti përgjigje në ankesat e parashtruesve të kërkesës, duke theksuar se parashtruesit përkatës nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 (Të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e të Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin në vijim: Rregullorja nr. 2003/13), për arsye se (i) nuk kanë ofruar dëshmi për vërtetimin e kontinuitetit të marrëdhënies së punës; (ii) në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, parashtruesit përkatës nuk ishin të regjistruar si punëtorë në NSH “Agimi”; dhe (iii) nuk i kanë mbështetur pretendimet për diskriminim.
22. Ndërmjet 3 prillit 2012 dhe 3 majit 2012, përmes përgjigjes në ankesën e AKP-së, disa nga parashtruesit e kërkesës, paraqitën shkresa me informata plotësuese lidhur me statusin e punëtorit në NSH “Agimi”, si në vijim: (i) Jakup Morina, theksoi se nuk ka qasje në librezën e punës sepse *”objekti është djegur”*, duke theksuar se ka punuar për NSH “Agimi” që nga vitit 1969 pa ndërprerje; (ii) Isa Hoti, dorëzoi librezën e punës me datë të hapjes 13 shtator 1973 dhe datë të mbylljes 30 prill 1995; (iii) Burbuqe Shala, dorëzoi librezën e punës me datë të hapjes 1 nëntor 1986 dhe të mbylljes 20 mars 1993; dhe (iv) parashtruesja e kërkesës Fakete Thaçi-Dina dorëzoi ankesën mbi të drejtën për punësim të 29 gushtit 1996, Vendimin për pushimin vjetor të 15 korrik 1994 si dhe kontratën mbi vepër nr. 2278. Të gjithë të lartcekurit, duke përfshirë dhe parashtruesit Agim Muhaxhiri, Nanije Deva-Hasi, Gëzime Zhubi-Buza, Agim Haxhibeqiri dhe Rafet Zhubi, theksuan se (i) i gjithë *“dokumentacioni është në disponim të zyrtarëve të ndërmarrjes”*; dhe (ii) kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore.
23. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0075] përmes së cilit (i) në pikën II të dispozitivit miratoi si të bazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës, Jakup Morina, Et-hem Bokshi, Agim Haxhibeqiri, Isa Hoti, Bukuriye Bordoniqi, Agim Muhaxhiri, Nanije Deva-Hasi, Fakete Thaçi-Dina, Gëzime Zhubi-Buza, Burbuqe Shala, dhe Rafet Zhubi, respektivisht, duke përcaktuar që të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH

"Agimi"; ndërsa (ii) refuzoi si të pabazuara ankesat e Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi, respektivisht.

24. Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit të lartcekur, fillimisht kishte përcaktuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Shtojca e Ligjit për DHPGJS-në), seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta"*. Ndërsa, përkitazi me parashtruesit e kërkesës, ankesat e të cilëve ishin miratuar si të bazuara, Kolegji i Specializuar kishte theksuar se (i) parashtruesit përkatës, po të mos ishin diskriminuar, do të i plotësonin kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, duke theksuar se *"të njëjtëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjate viteve 1990 dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtor serb"*, dhe se ky konstatim është pasojë e *"ngjarjeve botërisht të njohura pas vitit 1990 e në vazhdimësi"*; dhe (ii) në rastet kur pretendohet diskriminimi, bazuar në nenin 8 (Barra e Provave) të Ligjit nr.2004/3 kundër Diskriminimit (në tekstin e mëtejme: Ligji kundër Diskriminimit), i takon palës së paditur, përkatësisht AKP-së, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, dëshmi këto që nuk janë ofruar nga AKP. Në fund, përkitazi me refuzimin e ankesave të Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi, respektivisht, përmes pikës III të dispozitivit të Aktgjykimit përkatës, Kolegji i Specializuar kishte theksuar se të njëjtit nuk kishin dorëzuar dëshmi për të vërtetuar plotësimin e kriterëve të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 për Ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 Mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin e mëtejme: Rregullorja nr. 2004/45).
25. Më 26 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [SCEL-11-0075] përmes së cilit korrigjoi Aktgjykimin e lartcekur, pasi që kopja e dorëzuar e Aktgjykimit në gjuhën angleze ishte versioni preliminar dhe jo ai përfundimtarë, përderisa versioni në gjuhën shqipe mbeti i pandryshuar.
26. Më 24 dhe 30 shtator 2013, Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi parashtruan ankesa individuale kundër pikës III të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit përkatësisht paragrafit (j) të nenit 4 (Fusha e Zbatimit të Ligjit) të Ligjit kundër Diskriminimit dhe paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores

nr. 2003/13. Të njëjtit pretenduan se janë diskriminuar duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë me punëtorët e tjerë dhe të cilët janë përfshirë në Listën Përfundimtare. Më specifikisht, Shkelzen Krelani përmes ankesës përkatëse kishte paraqitur edhe provat në vijim: (i) vërtetimin e lëshuar nga ish drejtori i NSH "Agimi" me datë 25 shtator 2013; (ii) deklaratën e datës 8 prill 2005; (iii) vërtetimin për përvojën e punës si dhe të ardhurat personale të datës 17 janar 2009; (iv) ekstraktin nga fletëparaqitja e të dhënave mbi përcaktimin e të ardhurave personale dhe stazhin e sigurimit të datës 18 janar 2012; dhe (v) vërtetimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga AKP me 15 shtator 2012. Ndërsa, Valbonë Krelani-Elezi përmes ankesës përkatëse kishte paraqitur edhe provat në vijim: (i) vërtetimin e lëshuar nga ish drejtori i NSH "Agimi" me datë 27 shtator 2013; (ii) vërtetimin për përvojën e punës si dhe të ardhurat personale të datës 17 janar 2009; (iii) ekstraktin nga fletëparaqitja e të dhënave mbi përcaktimin e të ardhurave personale dhe stazhin e sigurimit të datës 18 janar 2012; dhe (iv) vërtetimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga AKP-ja më 15 shtator 2012. AKP-ja nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesave të Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi, respektivisht.

27. Më 30 shtator 2013, AKP parashtroi ankesë kundër pikës II të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, përmes të cilit ishte miratuar ankesa e parashtrueseve të kërkesës Jakup Morina, Et-hem Bokshi, Agim Haxhibeqiri, Isa Hoti, Bukurije Bordoniqi, Agim Muhaxhiri, Nanije Deva-Hasi, Fakete Thaçi-Dina, Gëzime Zhubi-Buza, Burbuqe Shala dhe Rafet Zhubi, respektivisht, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që pika II e dispozitivit të këtij Aktgjykimi të anulohet. Sipas AKP-së asnjë ankues i cili me Aktgjykimin e atakuar është përfshirë në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi" nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të cilave kishte për ta vërtetuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe arsyetimin për diskriminim direkt apo të tërthortë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit.
28. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008], përmes së cilit (i) duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedurat e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji nr.06/L-086 për DHPGJS-në), Kolegji përkatës *"vendosi të heq dorë nga pjesa e seancës gojore"*; (ii) refuzoi si të

pabazuara ankesat e Shkelzen Krelanit dhe Valbonë Krelani-Elezi; ndërsa (iii) pranoi si të bazuar ankesën e AKP-së, përkitazi me parashtruesit e tjerë të kërkesës, përkatësisht Jakup Morina, Et-hem Bokshi, Agim Haxhibeqiri, Isa Hoti, Bukurije Bordoniqi, Agim Muhaxhiri, Nanije Deva-Hasi, Fakete Thaçi-Dina, Gëzime Zhubi-Buza, Burbuqe Shala dhe Rafet Zhubi, duke përcaktuar se *“të njëjtit hiqen nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së “Agimi” Gjakovë”*.

29. Përkitazi me parashtruesin Shkelzen Krelani, Kolegji i Apelit arsyetoi se (i) i njëjti nuk ka deponuar dëshmi për ta provuar kërkesën e tij; dhe (ii) nga librezja e punës rezulton se i njëjti është inkuadruar në punë më 1 qershor 1983, ndërsa përfundimi i marrëdhënies së punës ka ndodhur më 31 korrik 1994, *“për shkak të fillimit të punës si ndërmarrës i pavarur”*. Ndërsa përkitazi me parashtruesen Valbonë Krelani-Elezi, Kolegji i Apelit arsyetoi se (i) e njëjta nuk ka deponuar dëshmi për ta provuar kërkesën e saj; dhe (ii) nga librezja e punës rezulton se e njëjta është inkuadruar në punë më 10 dhjetor 1980, ndërsa përfundimi i marrëdhënies së punës ka ndodhur më 5 janar 1983 si dhe përsëri ka filluar punën më 15 shkurt 1984, ndërsa ka përfunduar marrëdhënien e punës më 31 korrik 1994, *“për shkak të fillimit të punës si ndërmarrës i pa varur”*. Në rastin e të dy parashtrueseve të lartcekur, Kolegji i Apelit theksoi se kriteret ligjore në bazë të paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr.2004/45, nuk janë plotësuar sepse *“punëtori konsiderohet si legjitim nëse është regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo me pak se tri (3) vite”*.
30. Ndërsa, përkitazi me miratimin si të bazuar të ankesës së AKP-së, Kolegji i Apelit, ndër tjerash, theksoi se parashtruesit e kërkesës (i) me asnjë provë nuk e dëshmojnë faktin se kanë qenë të punësuar në NSH "Agimi" apo se kanë qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, kushte këto që kërkojnë të plotësohen bazuar në paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, për t'u njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare të NSH "Agimi" për përfitim të njëzet përqindëshit (20%-it) nga shitja e ndërmarrjes; dhe se (ii) nuk pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar lidhur me diskriminimin e punëtorëve përkatës *“sepse sipas praktikës së krijuar nga Dhoma e Posaçme sa i përket interpretimit të diskriminimit ky punëtor pasi është i nacionalitetit shqiptar nuk mund të ketë qenë i diskriminuar pas qershorit të vitit 1999”*.

31. Për sa i përket pretendimeve për diskriminim, Kolegji i Apelit gjithashtu theksoi se e “*drejta precedente*” e DHPGJS-së, bazuar në Aktgjykimet [ASC-11-0069] dhe [AC-I-12-0012], përcakton që të diskriminuar mund të llogariten: (i) “*punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, rome, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillet prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.*”; dhe (ii) “*punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqitën në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve*”.
32. Për më tepër, përkitazi me parashtruesin e kërkesës (i) Rafet Zhubi, sqaroi se i njëjti si provë e kishte dorëzuar kopjen e librezës së punës, bazuar në të cilën vërtetohet fakti se “*i njëjti ka filluar punën në NSH "Agimi" nga 1 janari 1970, ndërsa ka përfunduar marrëdhënien e punës më 31 tetor 1996. Ankuesi ka pohuar se ky parashtrues ka lindur më 7 dhjetor 1938 dhe nga kjo gjykata konstaton faktin se ankuesi në kohën e privatizimit të ndërmarrjes ka arritur moshën e pensionimit andaj ankuesi nuk i plotëson kushtet e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes*”; (ii) Gëzime Zhubi-Buza, sqaroi se e njëjta kishte paraqitur si dëshmi kopjen e librezës së punës, “*nga e cila gjykata vërteton faktin se e njëjta ka filluar punën në NSH "Agimi" nga 1 maj 1985 ndërsa ka përfunduar punën më 8 janar 1996 po ashtu nga librezja e punës vërtetohet fakti se ankuesja nga 9 janari 1996 ka krijuar marrëdhënie të re pune në NSH "Printeks", Prizren dhe të njëjtën e ka përfunduar me 1 tetor 1998*”, dhe se për pasojë, asaj nuk i takojnë të drejtat e pretenduara nga NSH "Agimi"; (iii) Burbuqe Shala, sqaroi se e njëjta kishte paraqitur si dëshmi kopjen e librezës së punës, “*nga e cila gjykata vërteton faktin se e njëjta ka filluar punën në NSH "Agimi" nga 1 nëntori 1986 ndërsa ka përfunduar punën më 20 mars 1993 po ashtu nga librezja e punës vërtetohet fakti se ankuesja nga 20 marsi 1993 ka krijuar marrëdhënie të re pune në NT "DEMOS" dhe të njëjtën e ka përfunduar më 20 maj 1993, po ashtu nga librezja e punës shihet se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune në NSH "TIKI Comerc" nga 21 maji 1993 dhe të njëjtën e ka përfunduar më 31 mars 1995*”, dhe se për pasojë, të njëjtës nuk i takojnë të drejtat e pretenduara nga NSH "Agimi"; dhe (iv) Fakete Thaçi-Dina, sqaroi se e njëjta kishte paraqitur si dëshmi “*një vërtetim të lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale për përvojën e punës si dhe të ardhurat personale të realizuara*”, por se i njëjti nuk përbën dëshmi relevante.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

33. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që përmes Aktgjykimit [AC-I-13-0181-A0008] të 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
34. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se të gjithë kanë qenë punëtorë të NSH “Agimi”, dhe se kjo vërtetohet edhe përmes shkresës së AKP-së e cila u është drejtuar më 15 shtator 2010, përmes të cilës janë njoftuar se si rezultat i privatizimit të ndërmarrjes në fjalë, janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet përkatëse të punës, dhe se rrjedhimisht të njëjtit, i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/03 për të përfutur nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes përkatëse. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata kanë dorëzuar provat në dispozicion, por që *“prova përkatëse kanë qenë në disponim të Zyrës kadrovike të Sh.A. “Agimi” në Gjakovë e më pastaj të stafit të emëruar nga AKP-ja, punëtor të ish-Sh.A. ose N.SH “Agimi” Gjakovë”*.
35. Të njëjtit, në esencë, pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes neneve të lartcekura sepse i njëjti (i) ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe i cili ka qenë në favor të parashtrueseve të kërkesës, pa një seancë dëgjimore, duke mos u mundësuar të njëjtëve për tu deklaruar rreth fakteve kontestuese, duke theksuar se *“është e vërtetë që Dhoma e Posaçme ka mundësi të mban gjykim edhe pa prezencën e palëve, por është gjithashtu e vërtetë se ka të drejtë që të caktoj seancë publike dhe në atë do të i epej mundësia Gjykatës dhe palëve të ballafaqojnë parashtrimet dhe provat, do të bëhej një gjykim i hapur, i drejtë dhe transparent që do të argumentoheshin faktet relevante”*; (ii) për dallim prej Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, ngërthen interpretim arbitrar përkitazi me diskriminimin sepse barra e të provuarit lidhur me pretendimet për diskriminim bazuar në nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit i takon AKP-së; (iii) nuk është i arsyetuar; dhe (iv) ka shkelur të drejtat e tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.
36. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata nuk janë trajtuar në mënyrë

të barabartë me punëtorët e tjerë të NSH “Agimi”, “*situata juridike dhe faktike*” e të cilëve është identike me parashtruesit e kërkesës, ndërsa Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, i ka trajtuar pretendimet e tyre në kuptim të diskriminimit etnik, duke u referuar në të “*drejtën precedente*”.

37. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) t'i deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe të njëjtin ta kthejë për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

40. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe i kanë dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
42. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë

kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]

11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht:
11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegji i specializuar, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtresat e tij/saj me shkrim.

[...]

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36

Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]

3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të

paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 68 **Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime**

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.

2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.

[...]

6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.

[...]

11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkesë me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seance gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji

Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t'i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.

[...]

14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Neni 64 **Procedurat e ankesës me gojë**

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

[...]

Neni 65 **Paraqitja e provave të reja**

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t'i lejoj një palë paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t'i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t'i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Rregullore nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10 **Të Drejtat e të Punësuarve**

[...]

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë

nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqëror

**Neni 1
Ndryshimet**

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,

[...]

B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:

[...]

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.

[...]

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

**Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë**

- 1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashttrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*

[...]

Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit

Neni 8 Barra e Provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Meritat

43. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se ndërmarrja e lartcekur shoqërore ishte privatizuar më 15 shtator 2010, datë kjo në të cilën gjithashtu parashtruesit e kërkesës përmes shkresave individuale ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Parashtruesit e kërkesës më pas kishin kontestuar mospërfshirjen e tyre në Listën e Përkohshme të AKP-së për punëtorët me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Këto ankesa ishin refuzuar. Në vijim, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar, duke kontestuar Vendimin e AKP-së, edhe përkitazi me vërtetimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit. Të njëjtit kishin pretenduar se ishin diskriminuar dhe të gjithë kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar. Ky i fundit, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se "*faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta*", dhe u kishte dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të parashtruesve të kërkesës Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi, duke konstatuar se të njëjtit ishin diskriminuar. Kolegji i Specializuar, gjithashtu ndër të tjera, kishte theksuar se në mungesë të diskriminimit, parashtruesit e

kërkesës, do t'i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr.2003/13, si punëtorë me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi".

44. Pas nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, fillimisht ankesë në Kolegj të Apelit kishin paraqitur (i) Shkelzen Krelani dhe Valbonë Krelani-Elezi, të vetmit parashtrues ankesën e të cilëve Kolegji i Specializuar e kishte refuzuar si të pabazuar, duke paraqitur para Kolegjit të Apelit dokumente shtesë; dhe (ii) AKP-ja. As të parët as i dyti, nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e AKP-së dhe kishte refuzuar ankesën e Shkelzen Krelani-t dhe Valbonë Krelani Elezi-t, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë, duke hequr *"nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë"*, të gjithë parashtruesit e kërkesës. Kolegji i Apelit, fillimisht kishte theksuar se kishte vendosur të *"heq dorë nga pjesa e seancës gojore"*, duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedura e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Ndërsa, përkitazi me meritat e çështjes, (i) kishte konstatuar se provat e paraqitura nga palët përkatëse nuk dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 për t'iu njohur të drejtat përkatëse; dhe (ii) kishte theksuar se interpretimi i diskriminimit nga Kolegji i Specializuar është në kundërshtim me *"të drejtën precedentale"* të DHPGJS-së. Këto konstatime të Kolegjit të Apelit, parashtruesit e kërkesës i kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, siç është sqaruar më lart, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.
45. Këto kategori pretendimesh, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

46. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesëve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore*

47. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesorë përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 381 deri 404 dhe referencat e përdorura aty).
48. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për atë sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seancë dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse.
49. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastet e

GJEDNJ-së, *Fredin kundër Suedisë* (nr. 2), Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (nr. 2), Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; *Göç kundër Turqisë*, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe *Selmani dhe të tjerët kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39). Përfshirje nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat “ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do të justifikojnë mungesën e një seance dëgjimore” në shkallën e parë dhe të vetme. (Shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, *Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë*, Vendim i 17 majit 2001; dhe *Mirovni Institut kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36; e shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 382 dhe referencat e përdorura aty). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ndërthrin një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

50. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Salomonsson kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 383 dhe referencat e përdorura aty). Thënë këtë, dhe në parim, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes “ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme”, siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të kundërtën një e tillë është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 386 dhe referencat e përdorura aty).

51. Për sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së: *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë*, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Varela Assalino kundër Portugalisë*, Vendim i 25 prillit 2002); (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parastresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Döry kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37; dhe *Saccoccia kundër Austrisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).
52. Në të kundërtën, bazuar në Aktgjykimin e lartpërmendur, një seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 60; dhe *Fischer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44); dhe (ii) kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohej të njëjtëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale, personalisht ose përmes përfaqësuesit përkatës. Shembuj të kësaj situate përbëjnë rastet kur gjykata duhet të dëgjojë prova nga palët në lidhje me vuajtjet personale në mënyrë që të përcaktojë nivelin e dhur të kompensimit (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe *Lorenzetti kundër Italisë*, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 33) ose duhet të sigurojë informacion në lidhje me karakterin, sjelljen dhe rrezikshmërinë e një pale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *De Tommaso kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 167).

53. Për sa i përket çështjes së katërt, përkatësisht mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kriterëve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lart. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 384 dhe referencat e përdorura aty).
54. Përfundimisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë. (Për më shumë, lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 dhe 402 dhe referencat e përdorura aty). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafi 403 dhe referencat e përdorura aty).
- (ii) *Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret*
55. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë në dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me

çështjet e faktit dhe të ligjit. Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse *“ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”*, dhe të cilat GJEDNJ, siç është sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

56. Bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim fillimisht duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar një seancë dëgjimore në Kolegjin e Apelit, mund të rezultojë në konstatimin se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një seancë dëgjimore. Nëse përgjigja në këtë çështje rezulton të jetë negative, atëherë Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret *“ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”* në të dy shkallët e vendimmarrjes, para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit, respektivisht. Këtë vlerësim Gjykata do të bëjë duke u bazuar edhe në parimet e vendosura përmes Aktgjykimit të Dhomës së Madhe *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*.

a) *Nëse parashtruesit e kërkesës kanë hequr dorë nga e drejta e një seance dëgjimore*

57. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht rikujton që përmes ankesave individuale të parashtruara në Kolegjin e Specializuar, të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e të njëjtës, duke theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse *“faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta”*. Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, bazuar në këto *“fakte dhe prova”*, kishte vendosur se parashtruesit e kërkesës, me përjashtim të parashtruesve Valbonë Krelani-Elezi dhe Shkelzen Krelani, ishin diskriminuar duke vendosur gjithashtu se të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të AKP-së si punëtorë me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH “Agimi”.
58. Në Kolegjin e Apelit ishin ankuar vetëm AKP dhe Valbonë Krelani-Elezi e Shkelzen Krelani sepse të njëjtëve iu ishte refuzuar ankesa përmes Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Apelit kishte vendosur në favor të AKP-së, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke refuzuar ankesat e të gjithë parashtruesve

përkitazi me mospërfshirjen në Listën Përfundimtare të AKP-së si rezultat i diskriminimit. Siç është sqaruar më lart, Kolegji i Apelit kishte vendosur të *“heq dorë nga pjesa e seancës gojore”*, duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Parashtruesit e kërkesës, përkatësisht Valbonë Krelani-Elezi dhe Shkelzen Krelani, të vetmit parashtrues që ishin ankuar në Kolegj të Apelit për shkak të Aktgjykimit refuzues në shkallë të parë, nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Pjesa e parashtruesve të kërkesës, e të cilët kishin paraqitur dokumente shtesë në përgjigje të ankesës së AKP-së ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, gjithashtu nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore.

59. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, jodetyrimisht do të thotë se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një kërkesë e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkesë jodetyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seance të tillë.
60. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, GJEDNJ, ndër tjerash vlerëson nëse mungesa e një kërkesë të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi nga e drejta për një seancë dëgjimore. Thënë këtë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që determinon domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seance dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti. (Shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 deri 404 dhe referencat e përdorura aty). Në vijim, Gjykata do të vlerësojë këto dy kategori çështjesh.
61. Së pari, përkitazi me specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 (Procedurat e ankesës me gojë) të të njëjtit ligj, *“Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse”*, në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita rrjedhimisht, mbajtja e një

seance dëgjimore në nivel apeli, jodetyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtresve të kërkesës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit, në dëm të parashtresve të kërkesës. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegji të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkesë nga palët në procedurë, posaçërisht marrë parasysh faktin që parashtresit e kërkesës nuk janë ankuar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, i cili ishte në favor të tyre. Siç është sqaruar më lart, bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në dhe neni 69 të Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, është detyrim i Kolegjit të Apelit që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seance dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetoj mos-mbajtjen e së njëjtës.

62. Së dyti, përkitazi me rrethanat e një rasti, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkesë për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.
63. Më specifikisht, në rastet kur një palë përkatëse nuk ka bërë një kërkesë për seancë dëgjimore, GJEDNJ ka vlerësuar nëse mungesa e një kërkesë të tillë mund të konsiderohet sikur heqje dorë e nënkuptuar nga një seancë dëgjimore, gjithmonë në dritën e ligjit të aplikueshëm dhe rrethanave të një rasti. Për shembull (i) në rastin *Miller kundër Suedisë* (Aktgjykim i 6 majit 2005), në të cilin, parashtresja përkatëse nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të apelit, por e njëjta kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të shkallës së parë, kishte rezultuar në konstatimin e GJEDNJ-së që kërkesa për seancë dëgjimore ishte bërë në fazën “*më të duhur e procedurave*” dhe për pasojë, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të konstatohet se pala ka hequr dorë nga kërkesa për seancë

dëgjimore në mënyrë të nënkuptuar. Për më tepër, në kombinim me konstatimin se në nivel apeli ishin shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji, dhe për pasojë natyra e çështjeve në shqyrtim nuk ishte ekskluzivisht ligjore e as teknike, GJEDNJ, konstatoi se nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së: *Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 28-37); gjithashtu (ii) në rastin *Salomonsson kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilin, parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në asnjërën nga instancat, GJEDNJ edhe pse konstatoi se parashtruesi përkatës mund të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta në një seancë dëgjimore (shih, paragrafin 35 të rastit *Salomonsson kundër Zvicrës*), megjithatë konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, sepse konkludoi që në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, posaçërisht marrë parasysh faktin që niveli i apelit shqyrtoi edhe çështje fakti dhe jo vetëm ligji. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafët 36-40).

64. Në anën tjetër, në rastin *Goç kundër Turqisë*, GJEDNJ gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, duke refuzuar pretendimet e Qeverisë Turke se (i) rasti ishte i thjeshtë dhe se mund të trajtohej me shpejtësi vetëm në bazë të shkresave të lëndës, veçanërisht për shkak se parashtruesi përkatës përmes ankesës nuk kërkoji sjelljen e ndonjë prove të re; dhe se (ii) parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 26 të rastit të GJEDNJ-së *Goç kundër Turqisë*). Në shqyrtimin e rastit përkatës, dhe pas vlerësimit nëse në rrethanat e tij ekzistonte ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që do të justifikonte mungesën e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër të tjerash, se (i) përkundër faktit që parashtruesi përkatës nuk kishte bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, nga rrethanat e rastit nuk rezulton se një kërkesë e tillë do të kishte ndonjë perspektivë suksesi; për më tepër që (ii) nuk mund të konsiderohet se parashtruesi përkatës ka hequr dorë nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore duke mos kërkuar një të tillë para gjykatës së apelit pasi që kjo e fundit nuk kishte juridiksion të plotë për të përcaktuar shumën e kompensimit; (iii) parashtruesit përkatës nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohet as para shkallës më të ulët dhe e cila kishte kompetencë edhe për vlerësimin e fakteve edhe të ligjit; dhe (iv) çështja thelbësore, në rrethanat e këtij rasti, ishte nëse parashtruesit përkatës duhet t'i ofrohej një seance dëgjimore para një gjykate e cila

ishite përgjegjëse për vërtetimin e fakteve të rastit. (Për arsyetimin e rastit përkatës, shih paragrafët 43 deri 52 të rastit *Goç kundër Turqisë*).

65. Për dallim, në raste tjera, GJEDNJ ka konstatuar se fakti që një parashtrues nuk ka kërkuar një seancë dëgjimore mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar nga kjo e drejtë, mirëpo gjithmonë së bashku me vlerësimin nëse, në rrethanat e një rasti, ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore. Për shembull, në rastet *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 24 qershorit 1993) dhe *Dory kundër Suedisë* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilat, parashtruesit përkatës nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, GJEDNJ kishte vlerësuar se të njëjtit kishin hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta për një seancë dëgjimore. Megjithatë, këtë konstatim GJEDNJ e kishte arritur, vetëm në ndërlidhje me konstatimin se rrethanat e rastit përkatës ishin të “natyrës teknike”, dhe rrjedhimisht ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që e justifikojnë mungesën e një seance dëgjimore, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 28-37; *Dory kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 36-45). Ngjashëm, GJEDNJ kishte vepruar edhe në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* (Aktgjykimi i 19 prillit 2007), në të cilin nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për arsyetimet përkitazi me seancën dëgjimore, shih paragrafët 73 deri 75 në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*).
66. Gjykata gjithashtu bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se fakti që para gjykatave përkatëse ka mbizotëruar praktikë e zhvillimit të procedurës më shkrim dhe pa seanca dëgjimore, nuk është marrë parasysh nga GJEDNJ si fakt i vetëm bazuar në të cilin mund të anashkalohet një seancë dëgjimore, pa marrë parasysh rrethanat specifike të një rasti. Për shembull, në rastin *Madamus kundër Gjermanisë* (Aktgjykim i 9 qershorit 2016), GJEDNJ kishte shqyrtuar edhe pretendime bazuar në të cilat, ligji i aplikueshëm parashihte mbajtjen e seancave dëgjimore si përjashtim dhe jo si rregull, për më tepër që bazuar në praktikën përkatëse, gjykata vendimi i së cilës kontestohej para GJEDNJ-së, asnjëherë nuk kishte mbajtur një seancë dëgjimore. Përkundër këtij fakti, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi vlerësoi dhe konstatoi që në rrethanat e këtij rasti nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e mbajtjes së një seance dëgjimore. (Shih, paragrafët 25 deri më 33 të rastit *Madamus kundër Gjermanisë*).

67. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesve të kërkesës nuk iu është dhënë mundësi të dëgjohen para Kolegjit të Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit, përkundër kërkesës së tyre; (ii) parashtruesit e kërkesës nuk ishin ankuar në Kolegjit e Apelit sepse vendimi i Kolegjit të Specializuar ishte në favor të tyre; (iii) procedura në Kolegjin i Apelit ishte iniciuar përmes ankesës së AKP-së; (iv) Kolegji i Apelit, kishte *“hequr dorë nga seanca”*, duke u referuar në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në, nen ky identik me nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, të cilët thjeshtë përcaktojnë se *“Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse”*; dhe (v) Kolegji i Apelit, kishte shqyrtuar të gjitha faktet e rastit, duke përfshirë ankesat e parashtruesve të dorëzuara në shkallë të parë, dhe duke theksuar se nuk pajtohet as me vlerësimin e fakteve dhe as me interpretimin e ligjit nga gjykata e shkallës më të ulët, kishte ndryshuar në tërësi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke i hequr të gjithë parashtruesit e kërkesës nga Lista e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfutur nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH “Agimi”.
68. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të konstatoj se mungesa e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tyre nga e drejta për një seancë dëgjimore. Gjykata rikujton se në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim i tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht *“ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”*. Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, *“ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”*, përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si *“ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike”*.
- b) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore
69. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo

e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Thënë këtë, përjashtim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*”. Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me “*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*”.

70. Për shembull, çështjet që ndërlidhen me sigurime sociale, GJEDNJ, kryesisht, i ka klasifikuar si çështje të natyrës teknike, në të cilat, jodetyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore. Sigurisht, nga ky rregull ka përjashtime. Në çdo rast, shqyrtohen rrethanat konkrete të një rasti. Për shembull, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje në rastet *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës* dhe *Dory kundër Suedisë*, por kishte konstatuar shkelje në rastin *Miller kundër Suedisë* dhe *Salomonsson kundër Zvicrës*, edhe pse të gjitha ndërlidheshin me çështje të sigurimeve sociale.
71. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë vlerësimin e fakteve kontestuese. Për shembull, në rastin *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin çështje fakti, por vetëm çështje të limituar të natyrës ligjore (*Saccoccia kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 78), ndërsa në rastin *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (no. 2) (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998), gjithashtu GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin as çështje ligji e as fakti. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (no. 2), cituar më lart, paragrafi 49).

72. Përkundrazi në raste tjera e në të cilat, GJEDNJ përcaktoi se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për shembull, në rastet *Malhous kundër Republikës Çeke* (Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin *Koottummel kundër Austrisë* (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi se çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafët 20 dhe 21).
73. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të ngritin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja.
74. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes (i) ankesës fillestare të parashtruesve të kërkesës në Kolegjin e Specializuar dhe përgjigjet në ankesë të AKP-së; dhe (ii) ankesës së AKP-së dhe të Shkelzen Krelanit dhe Valbonë Krelani-Elezi-t në Kolegjin e Apelit dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesve të kërkesës. Përkundër faktit që Kolegji i Specializuar kishte vlerësuar se provat “*janë të qarta*” duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, Kolegji i Apelit kishte konstatuar të kundërtën bazuar në po të njëjtat prova.
75. Gjykata gjithashtu rikujton që bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit është i kufizuar në ndërrimin e vlerësimit të gjendjes faktike të bërë nga Kolegji i Specializuar, përpos

nëse përcakton që gjetjet faktike të gjykatës më të ultë janë “*qartësisht të gabueshme*”, rregull ky që sipas të njëjtit nen duhet të “*respektohet fuqimisht*”. Një arsyetim i tillë, nuk gjendet në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Ky i fundit, thjesht nuk ishte pajtuar me vlerësimin e provave nga Kolegji i Specializuar, dhe gjithashtu kishte konstatuar se interpretimi të cilin Kolegji i Specializuar ia ka bërë pretendimeve përkitazi me diskriminim, është në kundërshtim me “*të drejtën precedente*”.

76. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkesë të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Por, rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminim. Në rast të pretendimeve të tilla, barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e Provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesit e kërkesës.
77. Në rrethana të tilla, në të cilat (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) në të cilat përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesit e kërkesës, ndërsa barra e të provuarit lidhur me diskriminimin bie mbi AKP-në; dhe (iii) Kolegji i Apelit interpreton të njëjtat fakte të paraqitura nga palët në mënyrë të ndryshme nga mënyra se si i ka interpretuar Kolegji i Specializuar, duke ndryshuar Aktgjykimin në dëm të palëve, përkundër faktit që një mundësi e tillë bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS-në, i është njohur vetëm përjashtimit, me kushtin që të argumentojë që autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar, ka bërë interpretim “*qartësisht të gabueshëm*”, Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore.
78. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore

është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.

79. Në fakt, në disa raste GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së kur një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur në një gjykatë me juridiksion apeli, edhe atëherë kur një seancë dëgjimore ishte mbajtur në instancën më të ulët, përkundër faktit se vlerësimi i domosdoshmërisë së seancës dëgjimore në nivel apeli është më pak rigoroz atëherë kur një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë. Për shembull, në Aktgjykimin *Helmers kundër Suedisë*, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin parashtruesit përkatës i ishte mundësuar një seancë dëgjimore në shkallën e parë, por jo në nivelin e apelit, e cila kishte kompetencë të vlerësonte edhe ligjin edhe faktet në rrethanat e rastit përkatës. Në këtë rast, GJEDNJ kishte ritheksuar se (i) garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, jodetyrimisht garantojnë një seancë dëgjimore në nivel apeli, nëse një e tillë është mbajtur në shkallën e parë; dhe (ii) në marrjen e këtij vendimi, gjykata përkatëse duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojën për trajtimin ekspeditiv të rasteve si dhe të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, duke vënë theks në faktin se një përcaktim i tillë varet nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast dhe nevojë për ekzistimin e rrethanave të jashtëzakonshme në mënyrë që të justifikohet mungesa e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Për arsyetimin përkatës të rastit, shih paragrafët 31 deri 39 të rastit *Helmers kundër Suedisë*).
80. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar *“heqjen dorë nga seanca”*, por ishte mjaftuar vetëm me referimin në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të *“hequr dorë nga seanca”*. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërliken me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar. Për shembull në rastin e GJEDNJ-së *Pönkä kundër Estonisë*, (Aktgjykimi i 8 nëntorit 2016), e që ndërlikej me zhvillimin e një procedure të thjeshtuar (e rezervuar për padi të vogla), GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së,

sepse gjykata përkatëse nuk kishte arsyetuar mungesën e një seance dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pönkä kundër Estonisë*, cituar më lart, paragrafët 37-40). Gjithashtu, në rastin e GJEDNJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, ndër të tjerash edhe pse gjykata përkatëse nuk kishte dhënë shpjegim për mosmbajtjen e një seance dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, paragrafi 44). Në kontekst të mungesës së arsytimit të mosmbajtjes së një seance dëgjimore, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme, ndër të tjerash, ka theksuar se mungesa e arsytimit rreth domosdoshmërisë së mbajtjes së një seance dëgjimore, i pamundëson gjykatës më të lartë, të vlerësojë nëse një mundësi e tillë thjeshtë është neglizhuar, apo cilat janë argumentet bazuar në të cilat gjykata ka anashkaluar një mundësi të tillë në raport me rrethanat që ngre një rast i caktuar. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, paragrafi 44 dhe referencat e përdorura aty).

81. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton se të njëjtit në mënyrë të nënkuptuar kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që të njëjtit nuk e kanë iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu se mungesa e kësaj kërkesë, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore; (ii) përkundër kërkesës specifike të parashtruesve përkatës për seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, një e tillë nuk ishte mbajtur dhe rrjedhimisht, standardet që aplikohen për domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore para Kolegjit të Apelit janë më rigorozë, sepse, në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore të paktën para një instance gjyqësore; (iii) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit; (iv) Kolegji i Apelit kishte vlerësuar mënyrën se si instanca më e ultë, përkatësisht Kolegji i Specializuar kishte bërë vlerësimin e fakteve, duke e ndryshuar Aktgjykimin e tij në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar “*heqjen dorë nga seanca*”, konstaton se në rastin konkret nuk kanë “*ekzistuar rrethanat të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore*”, dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

82. Gjykata, në fund gjithashtu thekson se, duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë.
83. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlihet ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlihet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundimi

84. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore, e drejtë kjo e garantuar, sipas sqarimeve të këtij Aktgjykimi, përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
85. Në vlerësimin e pretendimeve përkatëse, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar ndër tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*. Gjykata ka sqaruar, ndër tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe se vlerësimi i ndikimit të mungesës së një kërkesë të tillë varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse “ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”, e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlihen me raste në të cilat shqyrtohen “çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike”.

86. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar *“çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike”*, çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar *“rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”*; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje *“fakti dhe ligji”* për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar *“heqjen dorë nga seanca gojore”*. Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.
87. Përfundimisht, Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2020, me shumicë votash:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;
- IV. TË KTHEJË çështjen në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;
- V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 14 qershor 2021;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI224/19, Parashtrues: Islam Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019 për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KI224/18, Aktgjykim i miratuar më 10 dhjetor 2020 dhe i publikuar më 29 dhjetor 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta në pronë, kërkesë e pranueshme, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës

Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimet e tyre, instancat e DhPGjS-së shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës, sepse: i) Aktvendimi (urdhri) i parë i DhPGjS-së, siç e quan ai, i 18 korrikut 2017 nuk ka mbërritur asnjëherë në adresën e tij, nga papërgjegjësia e Postës së Kosovës; dhe ii) se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, nuk ka shqyrtuar dhe administruar parashtresat e dorëzuara nga ai, të cilat i ishin bashkëngjitur ankesës së ushtruar pranë këtij kolegj, më 26 korrik 2019, siç janë: 1) Vendimi i Agjencisë për ndihmë juridike falas, dhe 2) kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Si rezultat, ai pretendon se i është mohuar e drejta në gjykim të drejtë.

Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata konstatoi se barra e përgjegjësisë për mosadministrimin e parashtresave të parashtruesit të kërkesës i takon Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, sepse parashtruesi i kërkesës ka bërë çdo veprim që i është kërkuar me dispozitat ligjore në fuqi, për t'u siguruar se ankesa e tij e ushtruar kundër Aktvendimit [C-III-14-0151] të Kolegjit të Specializuar, do të shqyrtohej meritorisht. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për shkak të papërgjegjësisë së Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së në administrimin e dy parashtresave të parashtruesit të kërkesës, të cilat ishin relevante për vendosjen e meritave të ankesës së 26 korrikut 2019. Gjykata shtoi se vetëm pas shqyrtimit të mirëfilltë të parashtresave të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të mund të konstatonte se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka respektuar të drejtën e tij për qasje në drejtësi, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

Si përfundim, Gjykata gjeti se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit [AC-I-19-0114], i 19 shtatorit 2019, me të cilin është konsideruar e tërhequr ankesa e parashtruesit të kërkesës, nuk ka respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI224/19

Parashtrues

Islam Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të
Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019 për çështjet
që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Islam Krasniqi, me vendbanim në fshatin Grashticë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DhPGjS-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar AC-I-19-0114, të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, me të

cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 dhjetor 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 20 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI224/19. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së.
8. Më 21 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së informacion shtesë, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 23 tetor 2020, DhPGjS dorëzoi përgjigjen e saj në Gjykatë, përmes së cilës thekson: *“... pas kontrollimit edhe të dosjes të shkallës së I-rë C-III-14-0151, është gjetur se ankuesi me datë 08 gusht 2019, e ka dorëzuar në DHPGJS një formular të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore të datës 11.07.2019, së bashku me vendimin e Agjencisë Për Ndihmë Juridike Falas, A.nr.133/19-01 i datës 11.05.2019, por që këto dokumente nga zyra e regjistrimit janë futur gabimisht në dosjen e shkallës së parë, C-III-14-0151, dhe këto dokumente nuk i ka vërejtur Kolegji i Apelit, kur e ka shqyrtuar ankesën e ankuesit”*.

10. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri/me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 16 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës në DhPGjS parashtrroi kërkesë për lëshimin e urdhërit paraparak gjyqësor, kundër NSH “Urata” duke kërkuar ndalimin e shitjes ose të tjetërsimit, nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), të mbindërtimit (objektit të banimit) që ndodhej sipër lokalit afarist nr. 98, me sipërfaqe prej 111 m² (metra katror), rruga “Edmond Hoxha” - Prishtinë, duke pretenduar se i njëjti është pronë private e tij, i cili është shfrytëzuar për objekt banimi nga personi Sh.R.P., dhe më pas është blerë nga ai në vitin 2002 në shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.
12. Më 18 korrik 2019, gjyqtarja e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, parashtruesën e parashtruesit të kërkesës të 16 qershorit 2017 ia ka përcjellur Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Të njëjtën ditë, parashtruesit të kërkesës i është dërguar urdhri për parashtrimin e padisë, pranë këtij kolegji.
13. Më 25 korrik 2017, AKP, në Kolegjin e Specializuar të DhPGjS-së, dorëzon përgjigjen e saj, me propozimin që kërkesa për lëshimin e urdhrit të hedhet poshtë si i pathemeltë, në kuptim të nenit 399.2 të LPK-së, sepse i njëjti bie në kundërshtim me nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit të DhPGjS-së.
14. Më 4 korrik 2019, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, përmes Aktvendimit C-III-17-0151, hedhë poshtë, si të papranueshme, parashtruesën e parashtruesit të kërkesës për caktimin e urdhrit paraparak gjyqësor (masës së përkohshme), duke arsyetuar se shkresa përkitazi me një urdhër paraparak gjyqësor, duhet dorëzuar së bashku me padi, ose nëse një kërkesë e tillë dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë, atëherë ajo duhet t’i referohet së njëjtës kërkesë, duke konstatuar se në këtë rast nuk është parashtruar asnjë padi.
15. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë në Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së, kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, të 4 korrikut 2019, me propozimin që Aktvendimi të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje, ose t’i kthehet e drejta e tij për ushtrim të padisë, pasi që shërbimi i postës dhe dërguesit e gjykatës janë përgjegjës që nuk ia kanë sjellë urdhrin e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, të 18 korrikut 2017 në adresën e

tij. Tutje, parashtruesi i kërkesës përmes ankesës arsyetoi se kolegji në fjalë ka pasur qasje të gabuar gjatë marrjes së vendimit për kërkesën tij, ngase ai nuk ka kërkuar ndalimin e shitjes së lokalit nr. 98 me sipërfaqe 111m², që është në pronësi të NSH “Urata” në Prishtinë, që ndodhet në rrugën “Edmond Hoxha”, por ka kërkuar ndalimin e shitjes së mbindërtimit të ndërtuar para lufte sipër lokalit nr. 98.

16. Më 29 korrik 2019, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, përmes një shkrese/urdhri kërkoi nga parashtruesi i kërkesës, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të paguante taksën gjyqësore në shumën prej 100 euro, ose të parashtronte kërkesë për lirim nga taksa, nëse i përmbushte kushtet ligjore.
17. Më 8 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës sërish ia dorëzoi DhPGJS-së, kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore dhe Vendimin A. nr. 133/19-01 të Agjencisë për ndihmë juridike falas, si dëshmi që ai i plotëson kushtet për lirim nga taksa gjyqësore.
18. Më 19 shtator 2019, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte paguar taksën gjyqësore, sipas urdhrit të 29 korrikut 2019 dhe as nuk kishte bërë kërkesë për lirim nga taksa. Për më tepër, në një pjesë relevante nga arsyetimi i Aktvendimit të Kolegjit të Apelit theksohet:

“Pasi ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai me njoftimin (vërejtjen) e datës 29 korrik 2019, i cili është dorëzuar te ankuesi më 13 gusht 2019, dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirimin nga taksa gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr. Sipas nenit 12 të Ligjit të DHPGJS-së pala e pasuksesshme paguan shpenzimet procedurale përfshirë edhe tarifën gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi është palë e pasuksesshme në këtë çështje prandaj shpenzimet gjyqësore janë barrë e tij”.

Dispozitat relevante

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 01/2017 PËR UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE, hyrë në fuqi më 1 maj 2017

Neni 8

Lirimi nga pagesa e taksave gjyqësore

*8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim:
[...]*

8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai;

[...]

8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për t'u liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova:

[...]

8.3.2 dëshmi se ai/ajo është duke marrë ndihmë Ligjore nga Zyra për Ndihmë juridike falas;

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e tyre, instancat e DhPGjS-së shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës, sepse: i) Aktvendimi (urdhri) i parë i DhPGjS-së, siç e quan ai, i 18 korrikut 2017 nuk ka mbërritur asnjëherë në adresën tij, nga papërgjegjësia e Postës së Kosovës; dhe ii) se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, nuk ka shqyrtuar dhe administruar parashtruesat e dorëzuara nga ai, të cilat i ishin bashkëngjitur ankesës së ushtruar pranë këtij kolegji, më 26 korrik 2019, siç janë: 1) vendimi i Agjencisë për ndihmë juridike falas, dhe 2) kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Si rezultat, ai pretendon se i është mohuar e drejta në gjykim të drejtë.
20. Më tutje, parashtruesi i kërkesës shton se: *“Vendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e konsiderojmë shkelje të Ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendim skandaloz me të cilin nuk janë administruar asnjë provë që dëshmojnë të kundërtën e kërkesës dhe ankesës time me mbrojtje ligjore dhe-mbrojtje kushtetuese që të realizohet e drejta ime nga ky institucion gjyqësor. Duke ju referuar shkresave të lëndës përgjegjësinë për shkelje e bart Administrata e DHPGJS-së e cila nuk e ka dorëzuar Vendimin e Agjencionit për Ndihmë Juridike, që dëshmon se unë jam i liruar nga taksa gjyqësore”.*
21. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: 1) vërtetimin e shkeljes së Kushtetutës nga ana e DhPGjS-së, respektivisht të neneve të lartcekura të saj; 2) të ndalojë AKP-në, në uzurpimin e mbindërtimit të cilën e kishte të blerë nga Sh.R.P.; dhe 3) të detyrojë Gjykatën Themelore në Prishtinë për verifikimin e pronësisë në lidhje me mbindërtimin (objektit të banimit) sipër lokalit nr. 98, në pronësi të NSH “Urata”, në rrugën “Edmond Hoxha” në Prishtinë.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Për më tepër, Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

25. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin AC-I-19-0114, të 19 shtatorit, pasi i ka shterur mjetet juridike në kuptimin formal. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
26. Më tej, Gjykata shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(3) “Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(4) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

27. Gjykata konsideron se kërkesa ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie*, ndërkohë që ajo nuk është qartazi e pabazuar, në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
28. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC.-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019]

të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, me të cilin ankesa e tij u konsiderua e tërhequr për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore. Ai pretendon se ky vendim ka rezultuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenet 24, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës.

30. Në lidhje me këtë rast, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave kushtetuese të tij, ka të bëjë me faktin se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, nuk i kishte administruar dhe trajtuar fare parashtruesat në vijim: 1) Vendimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas; dhe 2) Kërkesën e tij për lirim nga taksa gjyqësore, të cilat ia kishte bashkëngjitur ankesës së tij të dorëzuar pranë këtij kolegji, më 26 korrik 2019.
31. Duke qenë se pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me procesin e rregullt gjyqësor, përkatësisht me të drejtën për qasje në drejtësi, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së është në pajtueshmëri me standardet e kërkuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
32. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, përcaktojnë:

Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i
Kushtetutës

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

2. “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

Neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës

1. “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

[...]

33. Për të përcaktuar aplikueshmërinë e garancive të përcaktuara me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ). Analiza vijuese do të bëhet në harmoni me kërkesat e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për “qasje në drejtësi”

34. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6 të KEDNJ-së është definuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36. Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GjEDNJ-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në gjykatë” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së (përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GjEDNJ-së, të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta në proces të rregullt gjyqësor, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta për qasje në gjykatë, dhe gjithashtu, rastin e GjEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë*, Aktgjykimi i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Sipas GjEDNJ-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile” para një gjykate (shih rastin e GjEDNJ-së, *Lupeni, Greek, Catholic, Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).
35. Gjykata në këtë kontekst thekson se e “drejta në gjykatë”, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GjEDNJ-së, *Béleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).
36. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse, në një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka

pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, duke u thirrur në të drejtën për qasje në gjykatë.

37. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti, duhet të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definimi i këtyre dy koncepteve duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, në këtë aspekt, rastet e GjEDNj-së *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). “Kontesti”, megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, duhet të jetë: (i) i “vërtetë dhe serioz” (shih, në lidhje me këtë, rastet e GjEDNj-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe, (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë “vendimtare” për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, “lidhjet e paqëndrueshme” ose “pasojat e largëta” në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave gjyqësore, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNj-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GjEDNj-së, *Lovrić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51 dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të).
38. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një “të drejtë civile” dhe një “kontest”, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së i garantojnë individit të drejtën që ajo çështje të zgjidhet nga një tribunal, respektivisht gjykatë (shih GjEDNj, *Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë themelore procedurale të gjykimit të drejtë, kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih GjEDNj, *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).
39. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, KEDNj nuk synon të garantojë të drejtat që janë “teorike dhe të rreme”, por të

drejtat që janë “*praktike dhe efektive*” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive”, Udhëzuesin e GjEDNj-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6.1 të KEDNj-së, E drejta në proces të rregullt gjyqësor, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e *Kutić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni, Greek, Catholic, Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).

40. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedurën gjyqësore, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih GjEDNj, *Kutić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
41. Megjithatë, parimet e lartpërmendura nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së (shih Udhëzuesin e GjEDNj-së, të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNj-së, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkitazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në gjykatë, A. E drejta për qasje në gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit, duke cenuar vetë thelbin e të drejtës (shih GjEDNj, *Baka kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi i tillë prekë thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim”, si dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GjEDNj-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Lupeni Greek Catholic Parish kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe *Marković dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

Zbatimi i këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

42. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës fillimisht në DhPGjS kishte ushtruar kërkesë për caktimin e “urdhrit paraprak gjyqësor” për ta parandaluar shitjen ose tjetërsimin, nga ana e AKP-së, të paluajtshmërisë, e cila ndodhej në rrugën “Edmond Hoxha”. Më 18 korrik 2019, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së ia kishte dërguar parashtruesit të kërkesës një urdhër për parashtrimin e padisë, pranë këtij kolegji. Tutje, Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, më 4 korrik 2019, nëpërmjet Aktvendimit C-III-17-0151, kishte hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës për caktimin e “urdhrit paraprak gjyqësor” (masës së përkohshme), me arsyetimin se kërkesa përkritazi me një “urdhër paraprak gjyqësor”, duhet dorëzuar së bashku me “padi”, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë, atëherë ajo duhet t’i referohet së njëjtës kërkesë, duke konstatuar se në këtë rast nuk është parashtruar asnjë padi nga parashtruesi i kërkesës.
43. Si rezultat, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, më 26 korrik 2019, parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së, kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, të 4 korrikut 2019, me propozimin që Aktvendimi të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje, ose t’i kthehet e drejta e tij për ushtrim të padisë, pasi që sipas tij, shërbimi i postës dhe dërguesit e gjykatës janë përgjegjës që nuk ia kanë sjellë urdhrin e Kolegjit të Specializuar të DhPGjS-së, të 18 korrikut 2017, në adresën e tij.
44. Më pas më 29 korrik 2019, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, duke vendosur në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, të 26 korrikut 2019, lëshon një urdhër, nëpërmjet të cilit kërkoi nga parashtruesi i kërkesës, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të paguante taksën gjyqësore në shumën prej 100 euro, ose të parashtronte kërkesë për lirim nga taksa, nëse nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare për të paguar taksën gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës më 8 gusht 2019, sërish ia kishte vënë në dispozicion Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së shkresat e dorëzuara të 26 korrikut 2019 së bashku me ankesën. Përfundimisht, më 19 shtator 2019, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte paguar taksën gjyqësore, sipas urdhrin të 29 korrikut 2019 dhe as nuk kishte bërë kërkesë për lirim nga taksa.

45. Në vazhdim, Gjykata bazuar në parimet e përgjithshme, përkritazi me të drejtën për qasje në drejtësi, siç është përcaktuar nga GjEDNj, rikujton se çdokush ka të drejtë për të paraqitur “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” nëse konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, dhe përkritazi me këtë t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.
46. Në këtë kontekst, siç u përmend dhe më sipër, e drejta për qasje në drejtësi është e garantuar përkritazi me një “kontestet” në lidhje me një “të drejtë civile”. Në këtë linjë, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, janë përmbushur të dy komponentët e sipërtheksuara, ngase kemi të bëjmë me një të “drejtë civile” dhe me ekzistimin e një “kontesti” të natyrës civile-pronësore, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe AKP-së, përkatësisht lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, objektin e banimit, ndërtuar mbi lokalin afarist nr. 98, në rrugën “Edmond Hoxha”-Prishtinë dhe me pretendimin se përkritazi me paluajtshmërinë kontestuese është paguar një shumë e konsiderueshme e parave nga parashtruesi i kërkesës. Andaj, e drejta e kërkuar e parashtruesit të kërkesës bie në të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht të së drejtës për qasje në drejtësi.
47. Meqë pretendimi i parashtruesit të kërkesës, ndërlidhet me “procesin e rregullt gjyqësor” respektivisht me mosshqyrtimin dhe administrimin e parashtrësive të parashtruesit të kërkesës dorëzuar Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, më 26 korrik 2019 dhe 8 gusht 2019, Gjykata, më 21 tetor 2020, nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, kërkoj informacion shtesë, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Më 23 tetor 2020, DhPGjS informon Gjykatën si në vijim:

“Rrjedhimisht pasi që në dosjen AC-I-19-0114, nuk ka pasur Kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, Kolegji i Apelit vendimin e Agjencisë Për Ndihmë Juridike Falas, A.nr.133/19-01 i datës 11.05.2019, nuk e ka administruar. Mirëpo pas kontrollimit edhe të dosjes të shkallës së I-rë C-III-14-0151, është gjetur se ankuesi me datë 08 gusht 2019, e ka dorëzuar në DHPGJS-e një formular të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore të datës 11.07.2019, së bashku me vendimin e Agjencisë Për Ndihmë Juridike Falas, A.nr.133/19-01 i datës 11.05.2019, por që këto dokumente nga zyra e regjistrimit janë futur gabimisht në dosjen e shkallës së parë, C-III-14-0151, dhe këto dokumente nuk i ka vërejtur Kolegji i Apelit, kur e ka shqyrtuar ankesën e ankuesit”.

48. Bazuar në dispozitat relevante në fuqi, Gjykata gjen se e drejta e parashtruesit të kërkesës për të ushtruar të drejtën e parashtrimit të “Kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore”, buron nga neni 8 i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për unifikimin e taksës gjyqësore, ku përcaktohet:

Neni 8

Lirimi nga pagesa e tasave gjyqësore

8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim:

[...]

8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga a

[...]

8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për t’u liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova:

[...]

8.3.2 dëshmi se ai/ajo është duke marrë ndihmë Ligjore nga Zyra për Ndihmë juridike falas;

[...]

49. Në vlerësimin e Gjykatës, dispozitat e nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017, në mënyrë të qartë përcaktojnë hapat procedural që pala duhet t’i ndërmarrë për ushtrimin e të drejtës për “lirim nga pagesa e taksës gjyqësore”, nëse ai/ajo konsideron se përmbush kriteret sipas dispozitave të sipërcituara në fjalë. Përmbushja e kriterëve të kërkuara si më sipër është parakusht që parashtruesit të kërkuara nga palët të shqyrtohen në substancë nga gjykatat në pajtueshmëri me të drejtën për “qasje në gjykatë”. Në të kundërtën, përfshirja e rregullimeve ligjore të tilla do të ishte pa asnjë efekt dhe vetvetiu do ta bënte normën të pakuptimtë. (shih, në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese, rasti KI80/19 parashtrues: *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykimi i 10 nëntorit 2020, paragrafi 56)
50. Gjykata, përsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar drejtë rregulltat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale. Megjithatë, në rastet kur një pretendim ngritet çështje kushtetuese, përkatësisht parregullsi të procesit gjyqësor, Gjykata është e detyruar të ndërhyjë dhe të riparojë shkeljet e shkaktuara nga gjykatat e rregullta, për t’i siguruar individit

një gjykim të drejtë, në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

51. Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ndodhur para rrethanave faktike dhe juridike të tilla, nga 26 korriku 2019 ishte në pritje të shqyrtimit të meritave të ankesës së tij, të cilës ia kishte bashkëngjitur si dëshmi: 1) Vendimin e Agjencisë për përfitimin e ndihmës juridike falas, ashtu siç kërkonte neni 8.3.2 i Udhëzimit Administrativ të sipërcekur; dhe 2) kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.
52. Megjithatë, Gjykata gjeti se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, në përgjigjen e saj, dorëzuar Gjykatës, pranon se parashtruesi i kërkesës, më 8 gusht 2019, ka dorëzuar në DhPGjS: 1) Kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore; dhe 2) Vendimin A. nr. 133/19-01 të Agjencisë për ndihmë juridike falas, që nënkupton se parashtruesat janë dorëzuar para lëshimit të urdhrit të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, për të paguar taksën gjyqësore, dhe pas këtij urdhri. Për më tepër, kolegji në fjalë pranon që Kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, gabimisht ishte futur, nga zyra e regjistrimit, në dosjen e shkallës së parë [C-III-14-0151] dhe këtë fakt nuk e ka vërejtur Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, kur e ka shqyrtuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
53. I ndodhur në një situatë të tillë, Gjykata konsideron se barra e përgjegjësisë për mosadministrimin e parashtrësive të parashtruesit të kërkesës i takon Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, sepse parashtruesi i kërkesës ka bërë çdo veprim që i është kërkuar me dispozitat ligjore në fuqi, për t'u siguruar se ankesa e tij e ushtruar kundër Aktvendimit [C-III-14-0151] të Kolegjit të Specializuar, do të shqyrtohej meritorisht. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për shkak të papërgjegjësisë së Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së në administrimin e dy parashtrësive të parashtruesit të kërkesës, të cilat ishin relevante për vendosjen e meritave të ankesës së 26 korrikut 2019. Vetëm pas shqyrtimit të mirëfilltë të parashtrësive të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të mund të konstatonte se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka respektuar të drejtën e tij për qasje në drejtësi, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Përfundim

54. Nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se mosshqyrtimi i parashtrësive relevante të parashtruesit të kërkesës nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme, e cila është në kundërshtim me të drejtën për qasje

në drejtësi, që u garantohet individëve me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

55. Gjykata, duke konstatuar se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, i 21 shkurtit 2019, është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, e konsideron të panevojshme që tutje të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24, 46 dhe 54 të Kushtetutës.
56. Si përfundim, Gjykata gjen se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit [AC-I-19-0114], i 19 shtatorit 2019, me të cilin është konsideruar e tërhequr ankesa e parashtruesit të kërkesës, nuk ka respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë.
57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 10 dhjetor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË shkelje të nenit 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019 dhe KTHEN të njëjtin për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës;
- IV. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës jo më larg se më 15 qershor 2021;
- V. URDHËRON që Aktgjykimi i saj KI224/19 t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI227/19, Parashtrues: N.T. “Spahia Petrol”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr. 94/2019, të 1 gushtit 2019

KI227/19, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, publikuar më 29 dhjetor 2020

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, procedurë administrative, rivlerësim i tatimit, vendim i paarsyetuar

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një biznes, të cilit në vitin 2014, si rezultat i hetimeve penale, i ishte sekuestruar dokumentacioni financiar nga Policia e Kosovës. Më pas, kishte pasuar një kontroll nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila përmes Njoftimit për Rivlerësimet, në mes tjerash, kishte përcaktuar tatimin shtesë dhe atij në vlerë të shtuar për periudhat përkatëse. Parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar këtë Njoftim për Rivlerësim në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe kjo e fundit e kishte vlerësuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si pjesërisht të bazuar. Pjesa refuzuese e Vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës, kryesisht ndërlidhej me transaksionet të cilat parashtruesi i kërkesës i kishte realizuar më kompaninë “S”, dhe të cilat nuk kishte arritur që t’i dëshmojë. Parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Prokurorisë së Shtetit dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë me kërkesë për kthimin e dokumentacionit financiar, në mënyrë që të kishte mundësi t’i dëshmonte transaksionet e tij në procedurën e ankesës në Administratën Tatimore dhe në gjykata të rregullta. Bazuar në shkresat e lëndës, i njëjti nuk kishte marrë ndonjëherë përgjigje lidhur me këtë kërkesë. Në ndërkohë, procedurat para gjykatave të rregullta kishin rezultuar në refuzimin e padisë, ankesës dhe kërkesës për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimi gjyqësor të parashtruesit të kërkesës të dorëzuar në Gjykatën Themelore, atë të Apelit dhe Supreme, respektivisht. Para të njëjtave, parashtruesi i kërkesës në mënyrë të vazhdueshme, kishte theksuar, ndër të tjerash, se mungesa e dokumentacionit financiar i ka pamundësuar të provuarit e transaksioneve kontestuese, duke pretenduar shkelje të (i) nenit 9 (Parimi i Publicitetit) të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, sipas të cilit, ndër tjerash, organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për qasje në dosjen dhe dokumentet e tij; (ii) paragrafit 6 të nenit 14 (Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave) të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore, sipas të cilit, ndër tjerash, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar i cili merr dhe mban regjistrat sipas këtij neni do të bëjë një kopje të regjistrit dhe do të kthejë origjinalin në kohën më të shkurtër nga ana praktike; dhe (iii) shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës për mjet juridik efektiv, të garantuara përmes neneve 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta në Mjete Juridike] të Kushtetutës, respektivisht.

Gjykata Supreme, duke vendosur si instancë më e lartë gjyqësore lidhur me këtë rast, përmes Aktgjykimit të kontestuar, kishte refuzuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit. Gjykata Supreme kishte arsyetuar qëndrimin e saj, duke u bazuar (i) në nenin 22 (Transaksionet mbi Pesëqind Euro) të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, sipas të cilit, *“të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, në mes të personave, më të larta se 500 (pesëqind) euro pagesa e transaksionit duhet të bëhet përmes llogarisë bankare”*, duke theksuar rrjedhimisht se të gjitha dëshmitë e nevojshme do të mund të siguroheshin përmes bankës përkatëse nga parashtruesi i kërkesës; dhe (ii) në nenin 23 (Anulimi i Dokumenteve Tatimore) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13 (De-aktivizimi i një Biznesi), 14 (Anulimi i Dokumenteve Përfshirë Numrin Fiskal) dhe 16 (Publikimi i Emrave dhe Numrave të Tatimpaguesëve) të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010.

Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës kontestoi konstatimet e Gjykatës Supreme, duke ngritur pretendime që ndërlidhen me (i) nenin 31 të Kushtetutës, në kuptim të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe cenimit të parimit të barazisë së armëve; dhe (ii) nenit 32 të Kushtetutës, në kuptim të pamundësisë së ushtrimit të së drejtës së tij në mjet juridik efektiv, sepse në mungesë të dokumentacionit financiar, parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur në mënyrë efektive të kontestojë as Vendimin e Administratës Tatimore, dhe më pas, as vendimet e gjykatave të rregullta. Gjykata fillimisht shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata fillimisht (i) shtjelloi parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

Përgjatë këtij vlerësimi, Gjykata konstatoi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] i 1 gushtit 2019, ishte nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse Gjykata Supreme kishte dështuar të adresojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 9 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) shkeljen e Kushtetutës, përkatësisht neneve 31 dhe 32 të saj, si pasojë e cenimit të pretenduar për barazi të armëve në procedurë dhe pamundësisë së ushtrimit efektiv të mjeteve juridike në dispozicion. Për më tepër që

Gjykata Supreme konstatimin e saj përfundimtarë, lidhur me shpalljen e pabazuar të kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e kishte bazuar në dispozita të Ligjit për Administratën Tatimore dhe të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, dhe të cilat, nuk ndërlidheshin në asnjë mënyrë me rrethanat e rastit konkret.

Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu sqaroi, se përkundër faktit që kur gjykatat me juridiksion apeli, konfirmojnë vendimet e gjykatave më të ulëta, nuk janë të detyruara të arsyetojnë secilin argument, ato megjithatë janë të detyruara që të tregojnë konsideratë të mjaftueshme në shqyrtimin e vendimit të shkallës më të ulët, edhe në dritën e pretendimeve të ngritura para saj. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në të gjitha sqarimet e dhëna në këtë Aktgjykim, konsideroi se ky nuk është rasti, sepse, jo vetëm që Gjykata Supreme nuk kishte adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, po gjithashtu kishte bazuar konstatimin e saj përfundimtarë në dispozita, e të cilat nuk kishin asnjë ndërlidhje me rrethanat e rastit konkret duke i bartur të njëjtat nga vendimet e gjykatave më të ulta, pa shqyrtim dhe konsideratë të mjaftueshme në çështjen që ishte para saj.

Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, dhe rrjedhimisht duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën Supreme. Gjykata gjithashtu vuri theksin në faktin se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI227/19

Parashtrues

N.T. “Spahia Petrol”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr.
94/2019,
të 1 gushtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania N.T. “Spahia Petrol”, të cilin e përfaqëson Florin Lata, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.501/2018] e 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr.548/16] e 29 majit 2018 të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] e 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.
7. Më 10 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën që dëshmon datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
8. Më 14 janar 2020, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën e kërkuar, bazuar në të cilën, parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 22 gusht 2019.
9. Më 24 nëntor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.

10. Më 25 nëntor 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.
11. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
12. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe konstatoi se (ii) Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

13. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës është biznes individual i cili nga viti 2000 ushtron veprimtarinë primare të tregtimit me karburante dhe veprimtari sekondare të restorantit.
14. Më 10 dhjetor 2014, Policia e Kosovës, pas kontrollove lidhur me hetime penale, kishte sekuestruar një numër të dokumenteve financiare të kontabilitetit tek parashtruesi i kërkesës.
15. Në një datë të pasaktësuar, Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ATK) kishte zhvilluar kontroll tatimor në biznesin e parashtruesit të kërkesës, ku kishte evidentuar një numër parregullsish të cilat i kishte reflektuar në Raportin e Kontrollit të 26 tetorit 2015. Bazuar në pikën 7 të këtij raporti, (i) një kopje e tij i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës; ndërsa (ii) detyrimi i sigurimit të provave për të kontestuar të njëjtin, ishte në anën e tatimpaguesit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës.
16. Më 17 nëntor 2015, ATK i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës Vendimin mbi Njoftimin për Rivlerësimet për pagesën e tatimit shtesë në (i) Tatimin në të Ardhurat Personale për periudhat 2011, 2012, 2013; dhe (ii) Tatimin e Vlerës Shtuar për periudhat 06/2012 dhe 03/2013 (në tekstin e mëtejshëm: Njoftimi për Rivlerësimet).
17. Më 26 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, kishte paraqitur *“kërkesë për lejimin e kthimit të përkohshëm të dokumenteve apo kopjeve të të njëjtave”*, duke theksuar se (i) *“pas kontrollimeve nga Policia e Kosovës, na janë marrë përkohësisht edhe dokumentet financiare”*; (ii) në ndërkohë,

nga inspektorët e ATK-së, “për mungesë të dokumentacionit financiar i cili është marrë gjatë kontrollit, subjekti është ngarkuar me detyrime tatimore edhe pse subjekti posedon fletë dërgesa dhe faktura por të cilat janë të ndaluara nga Policia dhe Prokurorija”; dhe (iii) “ndaj njoftimit të Inspektorve të Administratës Tatimore kemi të drejtë ankimi deri me dt. 09.12.2015, [dhe] për parashtrim të ankesës ne duhet të bazohemi në prova, andaj ju drejtohem me kërkesë që të na lejoni kopjet e dokumenteve financiare kopjet apo eventualisht dokumentet origjinale, për qëllime ankimi”. Kjo kërkesë për njoftim, i ishte adresuar edhe Policisë së Kosovës dhe ATK-së. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe shkresave të lëndës, ai asnjëherë nuk ka marrë asnjë përgjigje përkritazi me kërkesën e tij.

18. Më 16 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Njoftimit për Rivlerësimet në Departamentin e Ankesave të ATK-së duke kontestuar, mes tjerash, konstatimet e ATK-së lidhur me (i) mënyrën e vlerësimit të qarkullimit shtesë në shumën prej 178,368.43 euro, duke mos i marrë parasysh fletë dërgesat e furnizimeve të mallit; (ii) mospranimin e shpenzimeve operative për periudhën 2011/2012, përkundër dëshmive që vërtetojnë këto shpenzime; dhe (iii) mosnjohjen e faturave nga ATK për shitblerjet me kompaninë “S”.
19. Më 10 mars 2016, Departamenti i Ankesave i ATK-së përmes Vendimit [455/2015] (i) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës si dhe ndryshoi Njoftimin për Rivlerësimet, duke njohur një pjesë të shpenzimeve operative për periudhën 2011 si dhe një pjesë të qarkullimit shtesë lidhur me subjektet “N.B” dhe “G.B”; ndërsa (ii) refuzoi faturat lidhur me transaksionet me kompaninë “S”, duke i kualifikuar ato si fiktive. Përkritazi me pjesën refuzuese të Vendimit të lartcekur, ATK kishte arsyetuar, ndër të tjera, se (i) bazuar në paragrafin 7 të nenit 13 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Administratën Tatimore) dhe nenit 22 (Transaksionet mbi Pesëqind Euro) të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ nr.15/2010), subjektet ekonomike janë të detyruara që transaksionet me vlerë më të madhe se pesëqind (500) euro t’i bëjnë përmes llogarive bankare, dëshmi të cilat përkritazi me faturat e kontestuar parashtruesi i kërkesës nuk i kishte ofruar; dhe (ii) bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 (Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm për Tatimin) të Ligjit për Administratën Tatimore, barra për të provuar se vlerësimi tatimor është i gabuar bie mbi tatimpaguesit, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, ndërsa ky i fundit nuk kishte dëshmuar se

konstatimet e Njoftimit për Rivlerësimet lidhur me faturat për kompaninë “S” ishin të pasakta, për më tepër që *“transaksionet në mes dy subjekteve kanë qenë fiktive, sepse edhe pala ka dhënë deklaratë që nuk kanë kryer asnjë shërbim apo shit-blerje të mallit, por vetëm kanë lëshuar faktura fiktive”*.

20. Më 13 prill 2016, kundër Vendimit të lartcekur të ATK-së, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të anulohet Vendimi [455/2015] i 10 marsit 2016 të Departamenti të Ankesave të ATK-së.
21. Më 13 prill 2018, dhe përderisa çështja e tij ishte ende në pritje në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për *“kthimin e dokumentacionit të konfiskuar me rastin e bastisjes”*. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe shkresave të lëndës, ai asnjëherë nuk ka marrë asnjë përgjigje përkritazi me kërkesën e tij.
22. Më 29 maj 2018, në shqyrtimin e mbajtur në Gjykatën Themelore, bazuar në procesverbalin e kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se i ishte pamundësuar të vërtetuarit e transaksioneve, duke përfshirë ato me subjektin “S.” Parashtruesi i kërkesës theksoi se (i) *“më datë 10.12.2014 Policia e Kosovës, ka bërë sekuestrimin e gjithë dokumentacionit financiar të paditësit, kompjuterive, për çka gjykatës ia prezantojmë si provë dëshminë e sekuestrimit nga Policia e Kosovës. Pas sekuestrimit të dokumentacionit ATK, dorëzon draft-raportin e kontrollit ku paditësi nuk mund të paraqet vërejtje konkrete në mungesë të dokumenteve.”*; (ii) *“më 26 nëntor 2015, kishte kërkuar nga Prokuroria, ATK-ja dhe Policia që ti ofroreshin dokumentet financiare”*, por nuk i ishin ofruar; (iii) si pasojë e mungesës së dokumentacionit, *“më shumë vështirësi ka arritur që ti siguron disa prova nga subjektet me të cilat kishte bashkëpunuar”*; dhe (iv) si rezultat i pamundësimit të qasjes së tij në këtë dokumentacion, është shkelur neni 9 (Parimi i publicitetit) i Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (në tekstin e mëtejshëm: LPA) dhe të drejtat e tij kushtetuese të garantuara përmes nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës.
23. Më 29 maj 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.548/16] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke vërtetuar Vendimin [455/2015] e ATK-së. Gjykata Themelore (i) përkritazi me pretendimet për sekuestrimin dhe për pasojë mungesën e dokumentacionit financiar, theksoi se *“paditësja*

ka mundur ti siguroj provat nga banka apo tek subjekti që ka lëshuar faturat kontestuese, se është bërë pagesave e këtyre fakturave”; dhe (ii) përkitazi me faturat kontestuese me kompaninë “S” theksoi se “paditësja nuk ka arritur ti vërtetoj pagesat apo deklarin e blerjeve mbi pesëqind (500) euro, sikurse që parashihet në dispozitën e nenit 22 [Transaksionet mbi Pesëqind Euro] par. 2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010”. Përfundimisht, Gjykata Themelore konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për tu njohur faturat përkatëse bazuar në nenin 23 (Anulimi i Dokumenteve Tatimore) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13 (De-aktivizimi i një Biznesi), 14 (Anulimi i Dokumenteve Përfshirë Numrin Fiskal) dhe 16 (Publikimi i Emrave dhe Numrave të Tatimpaguesve) të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010.

24. Më 9 gusht 2018, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përmes ankesës së tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të të drejtave të tij të garantuara përmes (i) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, me theks në faktin se Gjykata Themelore nuk kishte marrë parasysh nenin 9 (Parimi i publicitetit) të LPA-së dhe paragrafin 6 të nenit 14 (Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave) të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) nenit 32 të Kushtetutës, me theks në faktin se, si rezultat i mungesës së dokumentacionit financiar, i ishte pamundësuar ushtrimi efektiv i mjetit juridik kundër Njoftimit për Rivlerësimet të ATK-së.
25. Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.501/2018], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
26. Më 7 korrik 2019, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër tjerash, edhe në kontekst të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, lidhur me pretendimet që kishte ngritur para Gjykatës së Apelit për (i) shkeljen e nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) shkeljen e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës.

27. Më 1 gusht 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.94/2019], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke e konfirmuar këtë të fundit. Gjykata Supreme (i) përkitazi me pretendimet për sekuestrimin dhe për pasojë, mungesën e dokumentacionit financiar, theksoi se *“paditësi ka mundur ti siguroj provat nga banka apo tek subjekti që ka lëshuar faturat kontestuese se i njëjti i ka paguar këto faktura”*; (ii) përkitazi me faturat kontestuese me kompaninë “S” theksoi se *“paditësi nuk ka arritur ti vërtetoj pagesat apo deklarimin e blerjeve mbi pesëqind (500) euro, sikurse që parashihej në dispozitën e nenit 22 par. 2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010”*; ndërsa (iii) përfundimisht, miratoi konstatimet e gjykatave më të ulëta, se në rrethanat e rastit konkret, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për tu njohur faturat përkatëse bazuar në nenin 23 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] e 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
29. Për sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon (i) mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) shkelje të parimit të barazisë së armëve.
30. Përkitazi me të parën, përkatësisht mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë dështuar të arsyetojnë pretendimet thelbësore të tij lidhur me shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese si rezultat i pamundësisë në qasjen në dokumentacionin e tij financiar. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht thekson se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë dështuar t'i adresojnë pretendimet e tij të ngritura përmes ankesës dhe kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendim gjyqësor, respektivisht lidhur me (i) shkeljen e nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore, bazuar në të cilin kjo e fundit *“do të kthejë origjinalin në kohën më të shkurtër nga ana*

praktike"; dhe (ii) cenimin e të drejtave të tij kushtetuese, dhe në veçanti ato të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës sepse *"është cenuar parimi i barazisë sa armëve"* dhe nenit 32 sepse ai *"nuk ka pasur mundësi që ti ushtrojë mjetet juridike në mënyrë efektive në mungesë të dokumentacionit financiar"*. Në mbështetje të pretendimeve të tij në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastet KI72/12, me parashtrues Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2012; KI135/14, parashtrues IKK Claissc, Aktgjykim i 8 shkurtit 2016; dhe KI18/16, me parashtrues Bedri Salihu, Aktgjykim i 15 korrikut 2016.

31. Ndërsa përkitazi me të dytën, përkatësisht parimin e barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës pretendon se në procesin gjyqësor kundër tij *"ai nuk ka qenë asnjëherë i barabartë me palën kundërshtare"*, duke theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe i cili *"nënkupton që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj – duke përfshirë provat e saj – në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh të konisderueshëm vis-a-vis palës tjetër"*, në rrethanat e rastit të tij nuk është respektuar. Parashtruesi i kërkesës rithekson se (i) bazuar në paragrafin 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore, ATK ka qenë e detyruar që origjinalin t'ia kthente në posedim parashtruesit të kërkesës; (ii) bazuar në nenin 9 të LPA-së, garantohej e drejta e palëve që të kenë në posedim të të gjithë dokumentacionin që zotëron pala tjetër; dhe (iii) në mungesë të këtij dokumentacioni, atij i është pamundësuar paraqitja e provave të tij dhe ankesa efektive kundër Vendimit të ATK-së të 10 marsit 2016 dhe padisë, ankesës dhe kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe asaj Supreme, respektivisht. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës sepse *"asnjëherë gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka qenë i barabartë kundrejt palës kundërshtare"*. Në mbështetje të pretendimeve të tij në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastin KI31/17, me parashtrues Shefqet Berisha, Aktgjykim i 14 qershorit 2017.
32. Në fund, duke theksuar se procesi gjyqësor në tërësinë e tij *"ka qenë i padrejtë dhe është zhvilluar në kundërshtim me Kushtetutën"*, parashtruesi i kërkesës thekson se e *"gjithë procedura duhet të deklarohet jo kushtetuese ab initio (që nga fillimi)"*. Për pasojë, ai kërkon nga Gjykata që ta (i) deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të neneve 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.501/2018] e 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit dhe

Aktgjykimin [A.nr.548/16] e 29 majit 2018 të Gjykatës Themelore dhe Vendimin [nr.455/2015] e 10 marsit 2016 të ATK-së ; dhe (iv) të kthejë çështjen e tij në rivendosje në ATK.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative

Neni 9
(Parimi i publicitetit)

9.1. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.

9.2. Çdo person fizik dhe juridik, pa qenë e nevojshme të tregojë interes specifik, në raportet me organet e administratës publike, ka të drejtat procedurale që vijojnë:

- a) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike,
- b) brenda një kohe të arsyeshme,
- c) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër,
- d) me mjete të përshtatshme dhe efektive.

9.3. Përjashtimisht nga paragrafi 2, informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me Ligje përkatëse.

9.4. Për refuzimin e qasjes në informacion, organi i administratës publike merr vendim me shkrim, i cili vendim duhet të përmbajë arsyet e vendimit dhe udhëzimet për ankesë.

Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Neni 13
(Krijimi dhe mbajtja e regjistrave)

[...]

7. Çdo transaksion mbi pesëqind (500) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

[...]

Neni 14

(Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave)

[...]

6. Duke iu nënshtruar të drejtës për të mbajtur një dokument si provë për vepër penale, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar i cili merr dhe mban regjistrat sipas këtij neni do të bëjë një kopje të regjistrit dhe do të kthejë origjinalin në kohën më të shkurtër nga ana praktike.

[...]

Neni 19

(Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm për Tatimin)

[...]

6. Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë.

[...]”

Udhëzimi Administrativ Nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr. 03/l-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat

Neni 22

(Transaksionet mbi Pesëqind Euro)

1. Paragrafi 7 i Nenit 13 të Ligjit, përcakton se të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, në mes të personave, më të larta se 500 (pesëqind) euro pagesa e transaksionit duhet të bëhet përmes llogarisë bankare.

2. Për transaksionet e bëra nga 1 janari i vitit 2009 deri më 17 gusht 2010, paragrafi 1 i këtij Neni do të aplikohet nga Personat e tatueshëm që nënkupton personat që kërkohet të regjistrohen apo janë të regjistruar për TVSH. Kurse për transaksionet e bëra me datën 18 gusht 2010 apo pas asaj date, paragrafi 1 i këtij Neni do të aplikohet nga të gjithë personat.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

35. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtguesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridik. (Shih, rastin e Gjykatës KI41/09, me parashtgues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, me parashtgues *“Bayerische Versicherungsverband”*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
38. Ndërsa, për sa i përket përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata thekson se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
39. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtguesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafi (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

40. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, dokumentacioni financiar i parashtguesit të kërkesës ishte sekuestruar në vitin 2014 nga Policia e Kosovës. Më pas, kishte pasuar një kontroll nga ATK, e cila përmes Njoftimit për Rivlerësimet, në mes tjerash, kishte rezultuar në përcaktimin e tatimit shtesë në të ardhurat personale dhe tatimit në vlerën e shtuar për periudhat përkatëse. Parashtguesi i

kërkesës e kishte kontestuar këtë Njoftim për Rivlerësim në ATK, dhe kjo e fundit e kishte vlerësuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si pjesërisht të bazuar. Pjesa refuzuese e Vendimit të AKT-së, kryesisht ndërlidhet me transaksionet të cilat parashtruesi i kërkesës i kishte realizuar më kompaninë “S”. ATK kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës, e të cilit bazuar në nenin 19 të Ligjit për ATK-në, i takon barra e të provuarit se vlerësimi tatimor është i gabuar, nuk ka dëshmuar vlefshmërinë e këtyre transaksioneve, për më tepër që gjithashtu kishte konsideruar se të njëjtat janë fiktive. Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar (i) Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës; dhe më vonë (ii) Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke kërkuar kthimin e të paktën kopjeve të dokumentacionit të sekuestruar për qëllime të ankesave në ATK dhe gjykatat e rregullta lidhur me Vendimin [455/2015] e 10 marsit 2016 të AKT-së. Bazuar në shkresat e lëndës dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nuk rezulton që i njëjti të ketë marrë ndonjëherë ndonjë përgjigje.

41. Procedurat para gjykatave të rregullta kishin rezultuar në refuzimin e padisë, ankesës dhe kërkesës për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimi gjyqësor të parashtruesit të kërkesës të dorëzuar në Gjykatën Themelore, atë të Apelit dhe Supreme, respektivisht. Para të njëjtave, parashtruesi i kërkesës në mënyrë të vazhdueshme, kishte theksuar, ndër të tjerash, se mungesa e dokumentacionit financiar i ka pamundësuar të provuarit e transaksioneve kontestuese, duke pretenduar shkelje të (i) nenit 9 të LPA-së, sipas të cilit, ndër tjerash, organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij; (ii) paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore, sipas të cilit, ndër tjerash, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar i cili merr dhe mban regjistrat sipas këtij neni do të bëjë një kopje të regjistrit dhe do të kthejë origjinalin në kohën më të shkurtër nga ana praktike; dhe (iii) shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës për mjet juridik efektiv, të garantuar përmes nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës, respektivisht.
42. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar, kishte refuzuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, respektivisht. Gjykata Supreme kishte arsyetuar qëndrimin e saj, duke u bazuar (i) në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, sipas të cilit, *“të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, në mes të personave, më të larta se 500 (pesëqind) euro pagesa e transaksionit duhet të bëhet përmes llogarisë bankare”*, duke theksuar rrjedhimisht së të

gjitha dëshmitë e nevojshme do të mund të siguroheshin përmes bankës përkatëse nga parashtruesi i kërkesës; dhe (ii) në nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010.

43. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës konteston konstatimet e Gjykatës Supreme, duke ngritur pretendime që ndërlidhen me (i) nenin 31 të Kushtetutës, në kuptim të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe cenimit të parimit të barazisë së armëve; dhe (ii) nenit 32 të Kushtetutës, në kuptim të pamundësisë së ushtrimit të së drejtës së tij në mjet juridik efektiv, sepse në mungesë të dokumentacionit financiar, parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur në mënyrë efektive të kontestojë as Vendimin e AKT-së, dhe më pas, as vendimet e gjykatave të rregullta.
44. Këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, dhe në vijim, Gjykata fillimisht do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
 - (i) *Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor*
45. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj

Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; dhe KI35/18, me parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, cituar më lart.

46. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; gjithashtu për më shumë detaje në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së të 30 prillit 2020, E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil), IV. Kërkesat Procedurale, 7. Arsyetimet e Vendimeve Gjyqësore, paragrafët 369 deri 380 dhe referencat e përdoruara aty). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Magnin kundër Francës*, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; dhe *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73). Për më tepër, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih, rastin e GJEDNJ *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).
47. Thënë këtë, neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. (Shih, rastet e GJEDNJ *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim i 29 gushtit 2000; dhe *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27). Për shembull, një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e

vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Ruisë*, cituar më lart, paragrafi 62).

48. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ dhe Protokollin e saj (shih rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të).

(ii) *Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret*

49. Gjkata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsytimit përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme konsistojnë në (i) shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore, që sipas parashtruesit të kërkesës i mundësojnë atij që të ketë qasje në dokumentacionin e tij financiar; dhe (ii) shkeljen e Kushtetutës, përkatësisht neneve 31 dhe 32 të saj, që sipas parashtruesit të kërkesës, në mungesë të këtij dokumentacioni, ia ka cenuar të drejtën për barazi të armëve në procedurë dhe i ka pamundësuar ushtrimin efektiv të mjeteve juridike në dispozicion.
50. Për të konstatuar nëse arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme përmbush standardet e një vendimi të arsytuar gjyqësor, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin e kontestuar [ARJ.UZVP.nr. 94/2019], ku theksohet si në vijim:

“Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, kjo gjykatë konstaton se e paditura ka vepruar drejtë kur e aprovoi pjesërisht ankesën e paditësit dhe pjesërisht e ndryshoi vendimin për Njoftim rivlerësimit për pagesën e tatimit shtesë në Tatimin në të Ardhura Personale periudha 2011, 2012, 2013 dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar periudhat 06/2012 dhe 03/2013, dhe paditësi ka mbetur obligues lidhur me rritjen e KMSH-se dhe rritjes se

qarkullimit shtesë për TVSH (12/2011) dhe TAP (2011) dhe mospranimin e faturave nga subjekti NTP [S]. Sipas mendimit të kësaj gjykate, në arsyetimin e vendimit kontestues e paditua me te drejte thekson se qarkullimi shtese rrjedh nga fletë-dërgesat e padeklaruara dhe të panënshkruara mes palëve dhe se faturat e deklaruar nuk korrespondojnë me flete-dërgesat, ndërsa faturat kontestuese nga subjekti NTP [“S”] nuk i ka pranuar sepse paditësi nuk ka arritur t'i vërtetoj pagesat apo deklarimin e blerjeve mbi 500 Euro, sikurse qe parashihet me dispozitën e nenit 22. paragrafi 2 te Udhëzimit Administrativ 15/2010.

Kjo gjykate ka konstatuar se në raportin e kontrollit janë dhënë arsye konkrete dhe të qarta që argumentojnë rritjen e shitjeve për periudhën 2011, si pasoje e diferencës materiale dhe faktit se në librat e shitjes flete-dërgesat janë të padeklaruara. Edhe përkundër konstatimeve të kontrollit se është përpjekur kontakti me subjektin NTP [S], por nuk është arritur, dhe se i njëjti subjekt është futur në listën e subjekteve të cilët merren me transaksione të dyshimta, paditësi nuk ka provuar ti dëshmoj gjykatës me asnjë argument se si është bërë pagesa për këto fatura blerëse kontestuese. Edhe pse organi kompetent i hetuesisë e kontrollloi paditësin, që ka rezultuar me sekuestrimin e dokumentacionit financiar, paditësi ka mundur të siguroj provat nga banka apo nga subjekti që ka lëshuar fatura kontestuese se i njëjti i ka paguar këto faturat. Gjithashtu, paditësi nuk ka provuar t'i siguroj flete-dërgesat e mallit të padeklaruar nga subjektet të cilët kanë nënshkruar të njëjtat fletëdërgesa nga të cilat rrjedh qarkullimi shtesë për shkak se ato nuk korrespondojnë me faturat. Kjo gjykatë i pranon konstatimet të cekura në arsyetimin e vendimit kontestues që, në mungesë të transaksioneve, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'i pranuar faturat sipas nenit 23 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenit 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ 15/2010.”

51. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se e njëjta përkitazi me pretendimet që ndërliiden me mungesën e dokumentacionit financiar ka miratuar qëndrimin e gjykatave më të ulëta se (i) përkundër faktit që organi kompetent i hetuesisë e kontrollloi paditësin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës dhe që ka rezultuar me sekuestrimin e dokumentacionit financiar, i njëjti ka mundur të sigurojë provat nga banka apo nga subjekti që ka lëshuar faturat kontestuese; dhe (ii) faturat kontestuese, përfshirë ato me subjektin “S”, kanë mundur të arsyetohen përmes vërtetimeve bankare, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010. Për më tepër, Gjykata Supreme, ka

miratuar qëndrimin e gjykatave më të ulëta, që në rrethanat e rastit konkret, *“në mungesë të transaksioneve, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'i pranuar faturat sipas nenit 23 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenit 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ 15/2010”*.

52. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, duket se arsyeton se mungesa e dokumenteve financiare të parashtruesit të kërkesës, si pasojë e sekuestrimit të tyre, nuk janë me ndikim në vendimmarrjen ndryshe në rrethanat e rastit konkret, sepse bazuar në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, parashtruesi i kërkesës ka qenë i detyruar të bëjë të gjitha transaksionet mbi pesëqind (500) euro përmes bankës, dhe për pasojë, ka mundur t'i sigurojë dëshmitë e nevojshme përmes transaksioneve bankare. Megjithatë, Gjykata vëren se pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) shkeljen e Kushtetutës, përkatësisht neneve 31 dhe 32 të saj, që sipas parashtruesit të kërkesës, në mungesë të këtij dokumentacioni, ia ka cenuar të drejtën për barazi të armëve në procedurë dhe i ka pamundësuar ushtrimin efektiv të mjeteve juridike në dispozicion, nuk janë adresuar dhe as arsyetuar nga Gjykata Supreme.
53. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Supreme, është pajtuar dhe ka vërtetuar vendimin e Gjykatës së Apelit, bazuar në të cilin, *“në mungesë të transaksioneve, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'i pranuar faturat sipas nenit 23 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenit 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ 15/2010.”* Megjithatë, Gjykata vëren që neni 23 i Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, nuk ndërlidhen me *“kushtet ligjore për t'i pranuar faturat”*. Më specifikisht, neni 23 (Anulimi i Dokumenteve Tatimore) i Ligjit për Administratën Tatimore ndërlidhet me anulimin e dokumenteve tatimore dhe procedurën që duhet ndjekur, ndërsa nenet 13 (De-aktivizimi i një Biznesi), 14 (Anulimi i Dokumenteve Përfshirë Numrin Fiskal) dhe 16 (Publikimi i Emrave dhe Numrave të Tatimpaguesve) të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, ndërlidhen kryesisht me zbatimin e nenit 23 të Ligjit për Administratën Tatimore, përkatësisht de-aktivizimin e bizneseve si rezultat i aktivitetit të tyre ose jo ekonomik, anulimin e dokumenteve përfshirë numrin fiskal dhe publikimin e emrave dhe numrave të tatimpaguesve, por në asnjë mënyrë nuk ndërlidhen me kontestin dhe specifikat në rrethanat e rastit konkret.

54. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjykatat me juridiksion apeli janë të detyruara të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. Ato munden, në parim, të refuzojnë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruesit të kërkesës, duke miratuar qëndrimin dhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit. Thënë këtë, bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, edhe vendimet e tilla, duhet të përmbajnë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse, në këtë rast Gjykata Supreme, nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët, përkatësisht Gjykata e Apelit, pa një konsideratë të mjaftueshme.
55. Përkitazi me konsideratën e mjaftueshme që duhet të tregojnë gjykatat me juridiksion apeli kur miratojnë vendimet e gjykatave më të ulëta dhe masën e nevojshme të arsyetimit të vendimit gjyqësor në rrethana të tilla, Gjykata rikujton rastin e GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë* (Aktgjykim i 22 shkurtit 2007), në të cilin GJEDNJ kishte vlerësuar një rast që ndërlidhej me kërkesën e një parashtruese për regjistrim të banimit. Të gjitha shkallët administrative dhe gjykatat respektive i kishin refuzuar pretendimet e parashtrueses përkatëse. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 7 deri më 19 të rastit të GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë*, cituar më lart). GJEDNJ kishte konstatuar, ndër tjerash, shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe cenimit të së drejtës në një gjykim të drejtë, sepse gjykata përkatëse e cila ishte përgjegjëse për të vlerësuar vendimin e gjykatës më të ultë, thjeshtë, në mënyrë përmbledhëse dhe pa konsideratë të mjaftueshme, kishte miratuar arsyetimin e gjykatës më të ultë, pa i adresuar pretendimet përkatëse të parashtrueses, duke dështuar kështu të korrigjojë të metat e vendimit paraprak. (Për arsyetimin përkatës, shih paragrafët 55 deri më 63 të rastit të GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë*, cituar më lart).
56. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme specifikisht kishte pretenduar se Gjykata e Apelit kishte dështuar të ofrojë arsyetim përkitazi me shkeljet e pretenduara lidhur me ligjin e aplikueshëm, përkatësisht nenin 9 të LPA-së dhe paragrafin 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe shkeljen e Kushtetutës, përkatësisht neneve 31 dhe 32 të saj. Përkundër këtyre pretendimeve, Gjykata Supreme, thjeshtë kishte adoptuar arsyetimin e Gjykatës së Apelit lidhur me dy pika kryesore. Përkitazi, me pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, kishte arsyetuar se “*paditësi nuk ka arritur t’i vërtetoj pagesat apo deklarinimin e*

blerjeve mbi 500 euro, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 22. paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010”, ndërsa, gjithashtu e kishte bazuar konkludimin se kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit ishte e pabazuar, sepse në rrethanat e rastit konkret “nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t’i pranuar faturat sipas nenit 23 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore neneve 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ 15/2010.” Gjykata në vijim do të shqyrtojë nëse këto dy argumente të Gjykatës Supreme reflektojnë vendim të arsyetuar gjyqësor në rrethanat e rastit konkret, respektivisht konsideratë të mjaftueshme nga Gjykata Supreme në refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës dhe miratimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i cili ishte kontestuar para saj.

57. Fillimisht, dhe përkitazi me të referuarit në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, sipas të cilit të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik më të larta se pesëqind (500) euro, duhet t’i bëjnë të njëjtat përmes llogarisë bankare, siç është theksuar më lart, arsyetimi i Gjykatës Supreme në mënyrë indirekte implikon që pretendimet e parashtruesit të kërkesës për pamundësinë e sigurimit të dëshmive të nevojshme si rezultat i mungesës së dokumentacionit financiar, nuk mund të ndikojnë në marrjen e një vendimi tjetër nga ana e gjykatës. Gjykata nuk do të vlerësojë vlefshmërinë apo saktësinë e një konstatimi të tillë, por megjithatë thekson se një arsyetim i tillë nuk zëvendëson nevojën për adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e LPA-së, Ligjit për Administratën Tatimore dhe neneve 31 e 32 të Kushtetutës, të cilat i njëjti i kishte ngritur përgjatë gjithë gjykatave të rregullta, pa paragjykuar nëse janë relevante apo jo. Këto janë pretendime thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe si të tilla, e detyrojnë gjykatën përkatëse që t’i trajtojë dhe t’i arsyetojë, duke i miratuar ose jo si të bazuara.
58. Heshtja e gjykatave përkitazi me pretendime me rëndësi të parashtruesëve përkatës është shqyrtuar specifikisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Për shembull, në rastet, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, GJEDNJ, përtej parimeve të përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, gjithashtu kishte adresuar rrethanat në të cilat gjykatat përkatëse kishin heshtur lidhur me argumentet, të cilat GJEDNJ i cilësoi si thelbësore. Në të dy rastet, GJEDNJ shqyrtoi nëse heshtja e gjykatës përkatëse mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme si një refuzim i nënkuptuar i argumenteve të palëve. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Megjithatë, në mungesë të

arsyetimit përkatës, GJEDNJ theksoi se është e pamundur të konstatohet nëse gjykatat përkatëse thjesht kanë neglizhuar të merren me pretendimet përkatëse apo kanë nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi i saj, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28; dhe *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29 dhe 30). Në të dy rastet, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

59. Për më tepër, siç është sqaruar përgjatë shtjellimit të parimeve të përgjithshme, GJEDNJ, specifikisht ka mbajtur që pretendimet që ndërlidhen me shkelje të KEDNJ-së dhe Protokolleve të saj, duhet të adresohen nga gjykatat përmes përgjigjeve specifike dhe të qarta. E njëjta vlen për pretendimet për shkelje kushtetuese.
60. Për shembull, në rastin e GJEDNJ-së *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, cituar më lart, GJEDNJ shqyrtoi një rast që kishte të bënte me një vendim të një gjykate familjare në Peru që konfirmonte birësimin e fëmijës së parashtrueses përkatëse. Procedurat e mëvonshme në Luksemburg kishin të bënin me kërkesën e parashtrueses për ta deklaruar këtë vendim të zbatueshëm në shtetin e Luksemburgut. Procedurat brenda gjykatave të këtij të fundit, përfunduan në favor të pozicionit të Departamentit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe kundër parashtrueses përkatëse. (Për faktet e rastit, shih rastin e GJEDNJ-së *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, cituar më lart, paragrafët 5 deri 40). Gjatë gjithë procedurave në gjykatat e rregullta, parashtruesja, ndër të tjera, kishte pretenduar edhe shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata përkatëse në Luksemburg në lidhje me këtë pretendim, kishte pohuar se “*natyra e tij e dyshimtë, e paqartë dhe e pasaktë, nuk përbënte një bazë për ankesë që kërkon përgjigje*”. Parashtruesja u ankua në GJEDNJ, duke pretenduar, ndër të tjera, shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së si rezultat i një vendimi gjyqësor të paarsyetuar, duke pohuar në mënyrë specifike se gjykatat e rregullta nuk i kanë adresuar pretendimet e saj për shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. Përkundër faktit që gjykatat vendëse e kishin kualifikuar këtë pretendim si “*të paqartë dhe të pasaktë*”, GJEDNJ, konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të një vendimi të paarsyetuar të gjykatës, duke theksuar se pretendimet që ndërlidhen me shkelje të KEDNJ-së duhet të marrin një përgjegje të saktë dhe precize. (Për arsyetimin e rastit, shih rastin e GJEDNJ-së *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, cituar më lart, paragrafët 117-136). Më saktësisht, GJEDNJ theksoi, ndër të tjera, se (i) efekti i nenit 6 të KEDNJ-së është, ndër të tjera, të vendos gjykatën përkatëse nën detyrimin për të shqyrtuar në mënyrë të mirëfilltë parashtruesat, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët, pa

paragjykuar nëse të njëjtat janë relevante apo jo (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, cituar më lart, paragrafi 89 dhe referencat në të); dhe (ii) kur kërkesat kanë të bëjnë me “të drejtat dhe liritë” e garantuara përmes KEDNJ-së dhe Protokolleve të saj, nga gjykatat përkatëse vendore kërkohet që t’i shqyrtojnë ato me rigorozitet dhe kujdes të veçantë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, cituar më lart, paragrafi 96 dhe referencat në të).

61. Në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës ka pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si pasojë e cenimit të barazisë së armëve dhe shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, si pasojë e pamundësisë për të ushtruar mjetin juridik në mënyrë efektive, dhe Gjykata e Apelit ashtu edhe ajo Supreme, nuk kanë adresuar këto pretendime me asnjë fjali të vetme. Gjykata rikujton që në kontekst të vendimit të arsyetuar gjyqësor, pretendimet thelbësore, dhe posaçërisht ato që ndërlidhen me shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, duhet të arsyetohen pavarësisht relevancës së tyre për vendimmarrjen përkatëse. Heshtja e një gjykate përkitazi me pretendime të tilla, siç është përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e pamundëson konstatimin nëse gjykatat përkatëse thjesht kanë neglizhuar të merren me këto pretendime apo kanë nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë.
62. Ndërsa, përkitazi me konstatimin e Gjykatës Supreme se “*nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t’i pranuar faturat*”, duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, Gjykata thekson se këto dispozita në të cilat Gjykata Supreme e ka bazuar konstatimin e saj përfundimtar për refuzimin e kërkesës së parashtuesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret. Siç është sqaruar më lart, neni 23 i Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, ndërlidhen, ndër të tjera, me anulimin e dokumenteve tatimore, de-aktivizimin e bizneseve si rezultat i aktivitetit të tyre ose jo ekonomik, anulimin e dokumenteve përfshirë numrin fiskal dhe publikimin e emrave dhe numrave të tatimpaguesve. Gjykata nuk mund të paragjykojë nëse konstatimi i Gjykatës Supreme se kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar, duke u referuar në këto dispozita, është thjeshtë një gabim teknik ose jo. Megjithatë, një konstatim i tillë, i cili është bartur nga vendimet e gjykatave më të ulëta, reflekton mungesën e konsideratës së mjaftueshme të Gjykatës Supreme në vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, pa i shqyrtuar me

kujdesin e duhur pretendimet e parashtguesit të kërkesës dhe konstatimet përkatëse të Gjykatës së Apelit.

63. Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI135/14, parashtgues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 58; KI96/16 parashtgues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 52; KI87/18 parashtgues *“IF Skadeforsikring”*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 49; dhe KI35/18, me parashtgues *“Bayerische Versicherungsverband”*, cituar më lart, paragrafi 52).
64. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] i 1 gushtit 2019, është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtguesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse ka dështuar të adresojë pretendimet thelbësore të parashtguesit të kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) shkeljen e Kushtetutës, përkatësisht neneve 31 dhe 32 të saj, si pasojë e cenimit të pretenduar për barazi të armëve në procedurë dhe pamundësisë së ushtrimin efektiv të mjeteve juridike në dispozicion.
65. Gjykata në fund gjithashtu thekson, se duke marrë parasysh që ajo tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtguesit të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtguesit të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përgjatë rishqyrtimit të Aktgjykimit të saj, (i) në raport me kërkesën e parashtguesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, përkatësisht Aktgjykimit [AA.nr.501/2018] të 16 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) konstatimet e këtij Aktgjykimi.
66. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, siç është sqaruar në këtë

Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundime

67. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, trajtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, garanci kjo, e përcaktuar përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
68. Përgjatë këtij vlerësimi, Gjykata ka konstatuar se në nxjerrjen e Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] të 1 gushtit 2019, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht LPA-së dhe Ligjit për Administratën Tatimore dhe shkeljen e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës. Përkitazi me këto dy të fundit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar vazhdimisht se mungesa, përkatësisht pamundësia për të pasur qasje në dokumentacionin e tij financiar, kishte rezultuar në cenimin e barazisë së armëve para gjykatave të rregullta dhe pamundësinë e ushtrimit të mjeteve juridike në mënyrë efektive. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër të tjera, vuri theks në faktin që gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet thelbësore të parashtruesëve të kërkesës, përfshirë ato që ndërlidhen me shkelje të të drejtave kushtetuese dhe atyre të garantuara përmes KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu sqaroi, se përkundër faktit që kur gjykatat me juridiksion apeli, konfirmojnë vendimet e gjykatave më të ulëta, nuk janë të detyruara të arsyetojnë secilin argument, ato megjithatë janë të detyruara që të tregojnë konsideratë të mjaftueshme në shqyrtimin e vendimit të shkallës më të ulët, edhe në dritën e pretendimeve të ngritura para saj. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në të gjitha sqarimet e dhëna në këtë Aktgjykim, konsideron se nuk është rasti. Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhshmëri me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, dhe rrjedhimisht duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën Supreme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] të 1 gushtit 2019;
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] të 1 gushtit 2019 për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 14 qershor 2021, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI193/19, Parashtrues: Salih Mekaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019

KI193/18, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2020 dhe i publikuar më 31 dhjetor 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë, kërkesë e pranueshme, shkelle e nenit 31 të Kushtetutës

Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kontestoi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i kërkesës në Gjykatë pretendoi se Gjykata Supreme shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë] të Kushtetutës, nenin 6.1 të Konventës, sepse: “[...] më rastin e vendosjes lidhur me Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme ka qenë e detyruara që [...] krahas Kërkesës së Prokurorit të Shtetit ta shqyrtoj edhe Përgjigjen time si palë kundërshtare në procedurë, pasi edhe unë si i pandehur kam pas të drejtë t'i paraqes argumentet e mia kundër Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjykata ka qenë e detyruar që t'i shqyrtoj me të njëjtën vëmendje, sikurse argumentet e palës tjetër e që në këtë rast është Prokuroria e Shtetit, mirëpo Përgjigjja ime jo vetëm që nuk është shqyrtuar fare por në gjithë Aktgjykimin e kontestuar as që përmendet se unë kam paraqitur përgjigje në Kërkesën e Prokurorisë së Shtetit dhe kjo jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë, por paraqet edhe një sjellje arbitrare nga ana e Gjykatës”.

Gjykata fillimisht vlerësoi se kërkesa i plotëson kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim meritore të kërkesës, siç janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të saktësuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës. Gjykata, pas vlerësimit të meritave të kërkesës erdhi në përfundim se detyrimi i njoftimit të palës kundërshtare, nga gjykatat, për ushtrimin e mjeteve juridike kundër tyre, nuk është qëllim në vetvete. Ky detyrim është hap i domosdoshëm procedural për t'ua mundësuar palëve që të trajtohen në mënyrë të barabartë, të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe të paraqesin rastin e tyre në mënyrë efektive. Tutje, Gjykata shtoi se gjykatat e rregullta nuk duhet të mjaftohen vetëm me faktin se palët kanë pranuar njoftimin për ushtrimin e mjetit juridik kundër tyre, por që ato (gjykatat e rregullta) duhet t'i sigurojnë palët që pikëpamjet dhe argumentet e tyre janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të rregullt, ashtu që t'iu garantohet një mbrojtje sa më

efektive ndaj pretendimeve të ngritura kundër tyre. Në të kundërtën, mosmarrja në shqyrtim e kundërshtimeve dhe argumenteve të tyre, me automatizëm i vendos ato në një disavantazh të konsiderueshëm kundruall palës kundërshtare (shih, GJEDNj, në rastet *Ofrer dhe Hopfinger*, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680, ku theksohet që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis à vis* palës kundërshtare).

Në këtë kuptim, Gjykata konsideroi se Gjykata Supreme ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, sepse parashtruesi i kërkesës është vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* Prokurorit të Shtetit, duke u privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtjesor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si palë kundërshtare në procedurë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është marrë në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, si rrjedhojë e kësaj Gjykata gjeti se është shkelur dhe parimi i palës së dëgjuar dhe i së drejtës së një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI193/19

Parashtrues

Salih Mekaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Salih Mekaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019, i cili i është dorëzuar atij më 28 qershor 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar [Pml. nr. 36/2019] të Gjykatës Supreme, të 5 qershorit 2019, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në

tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 14 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI193/19. Të njëjtën ditë, Gjykatës Themelore në Prishtinë iu kërkuar dosja origjinale e lëndës së parashtruesit të kërkesës, si dhe një kopje e kërkesës iu dorëzua Gjykatës Supreme.
8. Më 18 nëntor 2019, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë dosjen origjinale (PKR. nr. 338/2016).
9. Më 22 nëntor 2019, Gjykata kërkoi informata shitesë nga Gjykata Supreme. Më konkretisht, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që të njoftonte Gjykatën Kushtetuese se a e ka pranuar Gjykata Supreme përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të ushtruar ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit? Nëse po, a i ishte dorëzuar kërkesa në fjalë në mënyrë ligjore dhe brenda afateve procedurale?
10. Më 21 janar 2020, dosja origjinale iu kthye Gjykatës Themelore në Prishtinë (pas analizimit të saj).

11. Më 29 shtator 2020, Gjykata përsëriti dhe njëherë kërkesën e saj, dërguar Gjykatës Supreme, përmes shkresës së 22 nëntorit 2020.
12. Më 2 tetor 2020, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë si dëshmi përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të ushtruar ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme konfirmoi se përgjigja e parashtruesit të kërkesës ishte dërguar në Gjykatën Supreme nëpërmjet postës (rekomandë nr. R 6806967), më 21 shkurt 2019 dhe ishte pranuar dhe protokolluar nga kjo gjykatë, më 26 shkurt 2019.
13. Më 25 nëntor 2020, Gjykata në përbërje të plotë shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.
14. Më 17 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që të deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 30 maj 2016, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Speciale), ngriti aktakuzën PPS. nr. 38/2015 kundër parashtruesit të kërkesës dhe personave V. G., M. S. dhe A. S. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast akuzohej për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1 i KPRK-së; e akuzuara V. G., për kryerjen e veprës penale “shtytje në kryerjen e veprës penale” dhe “ushtrim të ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1 në lidhje me nenin 32 të KPRK-së, V. G., M. S. dhe A. S. për kryerjen e veprës penale “dhënie e ryshfetit në tentativë”, ndërsa në bashkëkryerje, nga neni 429, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1, dhe në lidhje me nenin 28 dhe 31, të KPRK-së.
16. Prokuroria Speciale, përgjatë shqyrtimit kryesor, e kishte ndryshuar aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës, nga vepra penale “ushtrim i ndikimit” në veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare”.
17. Më 28 maj 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit PKR. nr. 338/16, vendosi t’i lirojë nga aktakuza, për të gjitha veprat e ngarkuara penale, parashtruesin e kërkesës dhe të akuzuarit e tjerë, V. G., M. S. dhe A. S., sepse nuk u vërtetua se të njëjtit kishin kryer veprat penale për të cilat akuzoheshin. Gjykata Themelore në Prishtinë, urdhëroi gjithashtu që shuma e konfiskuar prej 15.500,00 euro, t’i kthehej të pandehurës V. G.

18. Më 13 gusht 2018, Prokuroria Speciale parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 338/16, të 28 majit 2018, me pretendimin se ka pasur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
19. Më 8 tetor 2018, Prokurori i Apelit kërkoi nga Gjykata e Apelit aprovimin e ankesës së Prokurorisë Speciale, anulimin e Aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes në rigjykim.
20. Më 23 tetor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 476/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Prokuroria Speciale dhe konfirmoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 28 majit 2018, duke arsyetuar: *“Gjykata e Apelit e vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të pretenduara në ankesë nga Prokuroria e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare”*.
21. Më 28 dhjetor 2018, Prokurori i Shtetit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe të shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet e pretenduara të konstatohen ose lënda të kthehet në rivendosje.
22. Në një datë të pasaktësuar, sipas detyrës zyrtare, Gjykata Supreme një kopje të kërkesës, ua kishte dërguar parashtruesit të kërkesës dhe personave V. G., M. S. dhe A. S., për t’ua mundësuar atyre ushtrimin e përgjigjes ndaj pretendimeve të Prokurorit të Shtetit.
23. Më 26 shkurt 2019, u dorëzua në Gjykatën Supreme përgjigja e parashtruesit të kërkesës kundër pretendimeve të Prokurorit të Shtetit (e cila ishte dërguar me postë nga ana e tij, më 21 shkurt 2019), me propozimin që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 476/2018 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. nr. 338/16, i 28 majit 2018, të vërtetohen.
24. Më 5 qershor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml. 36/2019, vendosi si në vijim: I. Aprovoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, duke konstatuar shkelje të ligjit penal nga neni 385, pika 4, i KPPRK-së, në pjesën që i përkiste parashtruesit të kërkesës, për veprën penale të

“ushtrimit të ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1, i KPRK-së dhe të pandehurës V. G., për vepër penale “shtytje në ushtrimin e ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1, në lidhje me nenin 32 të KPRK-së; dhe **II.** Refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që kishte të bënte me të pandehurit V. G., M. S. dhe A. S., për veprën penale “dhënie e ryshfetit në tentativë”, nga neni 429, paragrafi 3, në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

25. Në Aktgjykimin Pml. nr. 36/2019, Gjykata Supreme, ndër të tjera, theksoi:

“(…)

“Kundër këtyre aktgjykimeve [të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë] kërkesë për mbrojtjen e Ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen apo që lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurës V. G., avokati Besnik Berisha nga Prishtina në të cilën ka shpjeguar se kërkesa nuk është e bazuar dhe ka propozuar që si e tillë të refuzohet me arsyetim se kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilën bazë kërkesa me ligj nuk është e lejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe atë në përgjigjen e dhënë dhe konstatoi se: - kërkesa është pjesërisht e bazuar.

“(…)

Gjykata Supreme gjeti se këto pretendime nuk janë të bazuara sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse aktgjykimet përmbajnë arsye ligjore për konstatimet e veta, por janë të bazuara sa i përket shkeljes së ligjit penal. Përkundër asaj që, siç theksohet edhe në përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ky mjet juridik konform dispozitës së nenit 432.par.2.të KPPK-së nuk lejohet për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë të njëjtën e vlerësojë sepse ndërlidhej me shkeljen e pretenduar të ligjit penal. Siç do të përshkruhet më poshtë, u konstatua se në faktet e vërtetuara në mënyrë të drejt, gabimisht është aplikuar ligji penal në dobi të

pandehurve Salih Mekaj dhe V. G., sepse janë nxjerr përfundimet e gabuara për ekzistimin e veprave penale”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Pretendimi themelor i parashtruesit të kërkesës është se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është cënuar parimi i barazisë së armëve dhe, rrjedhimisht, atij i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së.

27. Në këtë vazhdë, parashtruesi i kërkesës pretendon se:

“[...] më rastin e vendosjes lidhur me Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme ka qenë e detyruara që [...] krahas Kërkesës së Prokurorit të Shtetit ta shqyrtoj edhe përgjigjen time si palë kundërshtare në procedurë, pasi edhe unë si i pandehur kam pas të drejtë t'i paraqes argumentet e mia kundër Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjykata ka qenë e detyruar që t'i shqyrtoj me të njëjtën vëmendje, sikurse argumentet e palës tjetër e që në këtë rast është Prokuroria e Shtetit, mirëpo Përgjigjja ime jo vetëm që nuk është shqyrtuar fare por në gjithë Aktgjykimin e kontestuar as që përmendet se unë kam paraqitur përgjigje në Kërkesën e Prokurorisë së Shtetit dhe kjo jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë, por paraqet edhe një sjellje arbitrare nga ana e Gjykatës”.

28. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se:

“...Me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 36/2019, i datës 05.06.2019, është shkelë parimi 'barazisë së armëve' i garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nenin 31, par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin është garantuar mbrojtja e barabartë e të drejtave të palëve në procedurë para gjykatës, sepse është shqyrtuar dhe është vendosur vetëm lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit, ndërsa nuk është shqyrtuar fare Përgjigjja ime si palë në procedurë e paraqitur kundër kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë edhe pse ajo është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit ligjor”.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon pranimin si të bazuar të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe anulimin e

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019.

Dispozitat e rëndësishme ligjore

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, i hyrë në fuqi më 1 janar 2013

Neni 395 Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Neni 435 Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Kolegji i Gjykatës Supreme

1. Për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme e Kosovës në seancë të kolegjit.

2. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hudh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse kërkesa është e papranueshme ose është paraqitur jashtë afatit nga neni 434, paragrafi 2. i këtij Kodi. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës kundërshtare, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.

[...]

Neni 436 Favoret e të pandehurit përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të pandehurit ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkakuzuarit që nuk ka paraqitur kërkesë për

mbrojtjen e ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë.

3. Kur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur në dobi të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.

Neni 438

Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

32. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

33. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin Pml. nr. 36/2019 të Gjykatës Supreme, të 5 qershorit 2019, pasi i ka shteruar mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata tutje shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (1) (d) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

- (1) *“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

- (2) *Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

35. Në dritën e fakteve dhe argumenteve të paraqitura me këtë kërkesë, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese, të cilat kërkojnë që trajtimi i tyre të varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Për më tepër, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk ekziston asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.
36. Rrjedhimisht, Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Meritat e kërkesës

37. Gjykata, fillimisht, vë në pah se në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
38. Në këtë sfond, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, duke u mbështetur në praktikën e saj dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNj).

39. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton përmbajtjet e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës
[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*
2. *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

Neni 6 i Konventës
[E Drejta për një Proces të Rregullt]

1. *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.*
40. Nga kërkesa dhe shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës e argumenton shkeljen e të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, me mosmarrjen në shqyrtim nga ana e Gjykatës Supreme të përgjigjes së tij – kundër pretendimeve dhe argumenteve të ngritura nga Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Në këtë vazhdë, parashtuesi i kërkesës pretendon se në këtë rast “... është shqyrtuar dhe është vendosur vetëm lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit, ndërsa nuk është shqyrtuar fare Përgjigjja ime si palë në procedurë e paraqitur kundër kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë edhe pse ajo është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit ligjor [...] dhe kjo jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë, por paraqet edhe një sjellje arbitrare nga ana e Gjykatës”.
41. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se thelbi i pretendimeve të parashtuesit të kërkesës ka të bëjë me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit procedural. Gjykata thekson se këto dy parime të ndërlydhura, janë elemente qenësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlydhje me nenin 6 të KEDNj-së.

Përkitazi me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural sipas praktikës së GJEDNj-së

42. Fillimisht, Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, neni 6 i KEDNj-së detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësve, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih GJEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, Seria A. nr. 254-B, f. 49, § 30).
43. Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuadër, GJEDNj ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih, rastin e GJEDNj-së *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).
44. Në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, të cilën e ka ndjekur me konsistencë edhe Gjykata Kushtetuese, është theksuar në vazhdimësi se parimi i **barazisë së armëve** kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*”, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, gjegjësisht disavantazh thelbësor kundruall palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNj-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, *Feldbrugge kundër Holandës*, Aktgjykim i 7 korrikut 1987, paragrafi 44 rastet *Ofrer dhe Hopfinger kundër Austrisë*, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696, shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140; shih po ashtu rastet e Gjykatës Kushtetues, KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
45. Duke u mbështetur në praktikën e GJEDNj-së, parimi i barazisë së armëve është i rëndësishëm sidomos në çështjet penale dhe ky parim zbatohet në të gjitha fazat e gjykimit, duke përfshirë edhe procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, siç është “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë”. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet vendimit të GJEDNj-së, në rastin *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21510/03, të 31 majit 2007. Në këtë

rast, një kompani që ishte palë kundërshtare në procedurë me parashtruesin e kërkesës, sikundër edhe prokurori publik, kishin paraqitur ankesë përkatësisht “kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë” në Gjykatën Supreme, kundër një vendimi të gjykatës së shkallës më të ulët. Pala tjetër (parashtruesi i kërkesës) nuk ishte njoftuar lidhur me atë kërkesë. Sipas GJEDNj-së, ankesa dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë çoi në vendimin e Gjykatës Supreme i cili ishte tërësisht i pafavorshëm ndaj palës tjetër (parashtruesit të kërkesës). Rrjedhimisht, GJEDNj-ja konsideroi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër (parashtruesin e kërkesës) e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme. GJEDNj, më tutje, theksoi se *“respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6.1 të Konventës, kërkon që parashtruesi të ketë mundësinë që të ketë njohuri dhe të mund të komentojë apelin e kompanisë dhe kërkesën [për mbrojtje të ligjshmërisë] të prokurorit publik”*.

46. GJEDNj ka theksuar në vazhdimësi se i takon asaj gjykate për të vendosur se a janë zhvilluar procedurat e kontestuarra, si tërësi, në përputhje me Konventën – duke përfshirë edhe nenin 6 të saj. Në këtë sfond, sipas GJEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtrësive, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GJEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barberà, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988).
47. Ndërsa parimi i kontradiktoritetit procedural nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqitën gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Brandstetter v. Austria*, nr. 11170/84, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996).
48. Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, Gjykata potencon se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhur ngushtë dhe në shumë raste GJEDNj i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së, *Rowe and Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18990/91; Aktgjykimi i vitit 2000, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, Aktgjykimi i vitit 2000; *Zahirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013).

49. Më tutje, GJEDNj ka theksuar se, sidomos në rastet penale, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti procedural përbëjnë elemente të rëndësishme dhe thelbësore të një procesi të rregullt gjyqësor. Prandaj, respektimi i tyre kërkon përmbushjen me rigorozitet të një sërë detyrimesh, ndër të cilat rëndësi të posaçme përbën edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për zhvillimin e një procedure, për akuzën, ankimin apo mjetin e jashtëzakonshëm të ushtruar nga pala kundërshtare. Në lidhje me këtë, në rastin *Zahirović kundër Kroacisë* (nr. 58590/11; Aktgjykimi i 23 prillit 2012), GJEDNj, përcaktoi si në vijim: “*Gjykata përsëritë se parimi i barazisë së armëve është një element i konceptit të gjerë të gjykimit të drejtë, i cili gjithashtu përfshinë të drejtën themelore që shqyrtimi gjyqësor në raste penale duhet të jetë kontradiktor. E drejta për një shqyrtim kontradiktor, në procedura penale, nënkupton që prokuroria dhe mbrojtja duhet të kenë mundësi që të jenë në dijeni dhe të komentojnë pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër*”.
50. Qëllimi kryesor i respektimit të këtyre parimeve është zhvillimi i një ballafaqimi real dhe përmbajtësor ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes, gjë e cila ndikon drejtpërdrejtë në zbardhjen e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë objektive nga gjykatat. Kërkesa të këtilla kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar nga prokurori i cili paraqet dhe mbron akuzën e paraqitur kundër të pandehurit. GJEDNj ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykimit (shih, ndër të tjera, GJEDNj, rastin *Alimena kundër Italisë*, vendimi i 19 shkurt 1991).

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin konkret

51. Ajo çfarë është thelbësore për Gjykatën në rastin konkret është fakti nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi reale të paraqesë pikëpamjet dhe argumentet e tij, kundër pretendimeve të Prokurorit të Shtetit dhe nëse ato janë shqyrtuar dhe kanë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata Supreme.
52. Gjykata fillimisht rikujton se roli i Gjykatës Supreme, si shkallë e fundit në hallkën e sistemit të rregullt gjyqësor, në parim është kontrolli i zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e shkallës më të ulët gjyqësore. Në çështjet penale, siç është rasti konkret, realizimi i mbrojtjes efektive i personit të akuzuar në radhë të parë është interes i të pandehurit, por edhe i dhënies së drejtësisë në përgjithësi.

53. Gjykata rikujton se, sipas ligjit në fuqi, palët kanë të drejtën e ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme kundër aktgjytimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, përmes së cilave është vendosur për fajësinë ose pafajësinë e tyre. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se aktgjykimet (e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë) ishin të favorshme për parashtruesin e kërkesës, pasi e shpallën atë të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohej. Megjithatë, Gjykata vëren se Prokurori i Shtetit, i pakënaqur me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, kishte ushtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve të tjerë, V. G., M. S. dhe A. S., duke kërkuar ndryshimin e aktgjytimeve ose rivendosjen e lëndës, për shkak të shkeljeve të ligjit penal.
54. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në pajtueshmëri me dispozitat e KPPRK-së, kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe të pandehurit e tjerë për ushtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit, duke u vënë atyre në dispozicion dhe nga një kopje të kërkesës në fjalë.
55. Nga shkresat e lëndës vërehet se parashtruesi i kërkesës, ka dorëzuar përgjigje në Gjykatën Supreme (nëpërmjet Postës së Kosovës dhe brenda afatit ligjor), kundër pretendimeve të Prokurorit të Shtetit, të paraqitura në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Meqë pretendimi i vetëm i parashtruesit të kërkesës ndërlidhej me shkeljen e parimit të barazisë së armëve, në ndërlidhje me parimin e kontradiktoritetit procedural, për shkak se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e kontestuar nuk e trajton fare faktin që parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar përgjigje kundër pretendimeve të Prokurorit të Shtetit, Gjykata fillimisht më 22 nëntor 2019 dhe më pas më 29 shtator 2020, kërkoi nga Gjykata Supreme përgjigje të shkruar nëse parashtrësia (përgjigjja) e parashtruesit të kërkesës ishte pranuar nga kjo gjykatë. Gjykata Supreme, përmes shkresës se saj dorëzuar Gjykatës Kushtetuese, më 2 tetor 2020, konfirmoi se përgjigja e parashtruesit të kërkesës është pranuar më 26 shkurt 2019, nëpërmjet postës.
56. Në dritën e këtyre fakteve dhe rrethanave, Gjykata thekson se neni 433 i KPPRK-së është në vijë me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës, përkitazi me respektimin e standardeve të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, ku njëri nga elementet thelbësore në një proces gjyqësor të rregullt është zbatimi i parimit të barazisë së armëve dhe i parimit të kontradiktoritetit procedural. Respektimi i kërkesave dhe standardeve që rrjedhin nga këto dy parime është në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i

përfaqësuar nga Prokurori, i cili paraqet dhe mbron akuzën e tij kundër të pandehurit (siç u theksua në paragrafin 48 të cituar më lart).

57. Qëllimi i nenit 31 të Kushtetutës dhe i nenit 433, paragrafi (2) i KPPRK-së nuk kërkon vetëm përmbushjen e aspekteve formale-procedurale, por edhe përmbushjen e aspekteve përmbajtësore, të standardit të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Kjo nënkupton jo vetëm që palëve, në këtë rast të pandehurit në procedurë penale, t'i jepet mundësia për të paraqitur në objektin e gjykatës përgjigje me shkrim në pretendimet e Prokurorit të Shtetit, por edhe shqyrtimin e asaj parashtrëse dhe dhënien e mundësisë së ballafaqimit të argumenteve dhe kundërgjyqësive, në pajtueshmëri me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, në atë mënyrë që palët në procedurë të vendosën në situatë të barabartë kundruall njëra-tjetrës (shih GJEDNj, rastin *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, aktgjykimi i 27 tetorit 1993, Seria A, nr. 274, ku përcaktohet se “barazia e armëve” nënkupton që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj - duke përfshirë provat e saj - në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* kundërshtarit të saj”).
58. Në këtë këndvështrim, vërehet qartë se Gjykata Supreme u mjaftua vetëm në përmbushjen e aspekteve formale-procedurale, domethënë vetëm me dërgimin e njoftimit parashtruesit të kërkesës për ushtrimin e mjetit juridik kundër tij, duke mos e trajtuar fare, përkatësisht duke mos e bërë pjesë të procedurës përgjigjen e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës ndaj “kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë” të Prokurorit të Shtetit. Për më tepër, Gjykata Supreme nuk ka dhënë ndonjë arsyetim në Aktgjykimin e saj se pse përgjigjja e parashtruesit të kërkesës nuk është marrë në shqyrtim. Veç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka vepruar ndryshe ndaj të pandehurës tjetër në këtë rast (V. G.), përgjigjja e së cilës ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme dhe përmendet si fakt procedural, në vendimin e kontestuar.
59. Gjykata konsideron se detyrimi i njoftimit të palës kundërshtare, nga gjykatat, për ushtrimin e mjeteve juridike kundër tyre, nuk është qëllim në vetvete. Ky detyrim është hap i domosdoshëm procedural për t'ua mundësuar palëve që të trajtohen në mënyrë të barabartë, të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe të paraqesin rastin e tyre në mënyrë efektive. Prandaj, gjykatat nuk duhet të mjaftohen vetëm me faktin se palët kanë pranuar njoftimin për ushtrimin e mjetit juridik kundër tyre, por gjykatat duhet t'i sigurojnë palët që pikëpamjet dhe argumentet e tyre janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të rregullt, ashtu që t'iu garantohet një mbrojtje sa më efektive ndaj pretendimeve të ngritura

kundër tyre. Në të kundërtën, mosmarrja në shqyrtim e kundërshtimeve dhe argumenteve të tyre, me automatizëm i vendos ato në një disavantazh të konsiderueshëm kundruall palës kundërshtare (shih, GJEDNj, në rastet *Ofrer dhe Hopfinger*, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680, ku theksohet që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis à vis* palës kundërshtare).

60. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të barazisë se armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, sepse parashtuesi i kërkesës është vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* Prokurorit të Shtetit, duke u privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtësor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si palë kundërshtare në procedurë.
61. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është marrë në kundërshtim me parimin e barazisë se armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural.
62. Tutje, Gjykata qartëson se kur ajo shqyrton procedurën në tërësi – në ndërlidhje me nenin 31 të Kushtetutës – para së gjithash ajo vlerëson: 1) nëse parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideron relevante për rastin e tij; 2) nëse atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare, dhe nëse të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; 3) nëse arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; 4) nëse në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI118/17, parashtues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNj, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
63. Në dritën e kësaj, Gjykata dëshiron të potencojë se shkelja e dy parimeve të lartcekura shkakton edhe cenimin e elementeve të tjera të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, gjegjësisht parimin e palës së dëgjuar dhe të së drejtës së një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

Përfundim

64. Si përmbledhje, Gjykata rithekson se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural-si elemente qenësore të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm-kërkojnë që gjykatat të vendosin një ekuilibër të drejtë në mes të palëve në procedurë, si dhe t'iu mundësohet atyre që të kenë një ballafaqim përmbajtësor të pretendimeve dhe argumenteve.
65. Duke mos marrë në shqyrtim përgjigjen e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, Gjykata Supreme ka cënuar parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, si rrjedhojë dhe të parimit të palës së dëgjuar dhe të vendimit të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.
66. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se ky lëshim i Gjykatës Supreme përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme, sepse parashtruesi i kërkesës është privuar nga e drejta e tij për një proces të rregullt gjyqësor, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.
67. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019, është shkaktuar shkelje e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 17 dhjetor 2020, me shumicë votash:

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË shkelje të nenit 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019, dhe KTHEN të njëjtin për rivendosje, në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës;
- IV. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme, që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës jo më larg se më 21 qershor 2021;
- V. URDHËRON që Aktgjykimi i saj KI193/19 t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI131/19, Parashtrues i kërkesës: Sylë Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AML.nr.1/2019, të 16 prillit 2019

KI131/19, Aktvendim i miratuar më 12 mars 2020, i publikuar më 22 prill 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, e drejta për vendim të arsyetuar, përfitimet e ish- zyrtarëve të lartë, ushtrues detyre, kërkesë e papranueshme

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të drejtën e përfitimit të statusit të ish- funksionarit të lartë, siç është përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish- Zyrtarëve të Lartë dhe Ligjin nr. 04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish- Zyrtarëve të Lartë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përfitimin e ish- Zyrtarëve të Lartë), të atyre funksionarëve të cilët, kanë ushtruar njërin nga funksionet e përcaktuara përmes ligjit të lartcekur, përkatësisht funksionin e ish- Kryetarit të Kuvendit, ish-Kryeministrit, ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, ish-Kryeprokurorit të Shtetit dhe ish-Kryetarit të Gjykatës Supreme. Rasti konkret, ndërlidhet me të drejtën ose jo të ish-ushtresit të detyrës së Prokurorit të Shtetit për të përfituar nga statusi i ish-zyrtarit të lartë publik, duke realizuar të drejtën për pagë mujore në lartësi prej shtatëdhjetë përqind (70%) të pagës të funksionit përkatës. Ish-ushtresi i detyrës së Prokurorit të Shtetit, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, dhe i cili kishte ushtruar këtë funksion me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës prej 5 gushtit 2014 deri më 21 prill 2015, përkatësisht pas pensionimit të Kryeprokurorit paraprak dhe deri në zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe dekretimit të tij nga Presidentit i Republikës, pretendon se i takon një e drejtë e tillë. Realizimin e kësaj të fundit e kishte kërkuar fillimisht përmes kërkesës drejtuar Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe i cili e refuzoi kërkesën e tij. Vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më pas u konfirmua nga të gjitha gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme e cila shqyrtoi çështjen përkatëse, pas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit.

Të gjitha gjykatat, në esencë, kishin vënë theks në dallimin në mes “*ushtrimit*” të një funksioni dhe “*zgjedhjes*” ose “*dekretimit*” në një funksion bazuar në dispozitat përkatëse kushtetuese e ligjore, duke refuzuar për pasojë, pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe duke sqaruar se (i) ai ka ushtruar këtë funksion në bazë të vendimit përkatës të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe nuk është zgjedhur/emëruar në këtë funksion bazuar në procedurën e përcaktuar sipas paragrafit 7 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit]

të Kushtetutës; dhe (ii) për pasojë, nuk mund të fitojë statusin e ish-funksionarit të lartë bazuar në Ligjin për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.

Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuar përmes neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në aspektin e të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, mungesën e të cilës e pretendon parashtruesi i kërkesës para Gjykatës, kjo e fundit aplikoi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe konstatoi se vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta, ishin mjaftueshëm të arsyetuara në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, Gjykata sqaroi se gjykatat e rregullta, kishin të drejtë në mënyrën e aplikimit të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, duke theksuar se (i) ky i fundit, u njeh të drejtën e përfitimit të statusit të ish-funksionarit të lartë dhe rrjedhimisht edhe të drejtën për përfitimet përkatëse, vetëm ish-funksionarëve të lartë të shtetit të emëruar përmes procedurave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje të aplikueshme përkatëse, me kushtin që të njëjtit të kenë ushtruar funksionin përkatës për së paku gjashtë (6) muaj; (ii) përfitimet e përcaktuara përmes këtij ligji nuk u takojnë zyrtarëve të tjerë dhe të cilët mund të kenë “*ushtruar*” këtë funksion, por të mos jenë “*emëruar*” në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligjet përkatëse të aplikueshme, pa marrë parasysh nëse këtë funksion e kanë ushtruar për periudhën gjashtë (6) muajore të referuar në këtë ligj, dhe kanë ushtruar kompetencat e plota të funksionit përkatës; (iii) se numërimi specifik i pesë (5) kategorive të funksioneve në ligjin e lartcekur, lexuar së bashku me dispozitat e tjera të këtij ligji, nënkupton qëllimin e ligjvënësit për të kushtëzuar përfitimin e këtyre të drejtave në zgjedhjen/emërimin e një funksionari të lartë në pajtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore dhe ushtrimin e këtij funksioni për të paktën gjashtë (6) muaj. Gjykata gjithashtu sqaroi se dallimin në mes “*zgjedhjes*” dhe “*ushtrimit*” të një funksioni të lartë e kishte bërë edhe në rastin KO97/10, me parashtrues *Jakup Krasniqi*, Aktgjykimi i 28 dhjetorit 2010.

Përfundimisht, Gjykata konstatoi që pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para gjykatave të rregullta përkitazi me interpretimin e gabuar të nenit 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, ishin arsyetuar mjaftueshëm nga të njëjtat, duke rezultuar kështu në një procedurë e cila, në tërësinë e saj dhe përkitazi me pretendimet për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, i përmbush kriteret e përcaktuara përmes praktikës përkatëse gjyqësore në interpretimin e nenit 31 të Kushtetutës në

lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata i shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Ndërsa, në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës, respektivisht, Gjykata përkitazi me (i) të parën sqaroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar asnjë pretendim përkitazi me ndonjë dallim në trajtim dhe rrjedhimisht nuk ka arsyetuar dhe as mbështetur pretendimet e tij për shkelje të këtij neni të Kushtetutës; dhe (ii) të dytin, sqaroi se ato pretendime, në thelb, janë të njëjta me ato për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të cilat tashmë Gjykata i kishte refuzuar si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Rrjedhimisht, kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI131/19

Parashtrues

Sylë Hoxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, AML.nr.1/2019, të 16 prillit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sylë Hoxha nga Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AML.nr.1/2019] të 16 prillit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.333/2018] e 31 tetorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr.1750/15] e 16 prillit 2018 të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 maj 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 2 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme, Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe Gjykatës Themelore, me kërkesë për dorëzim të fletëkthesës që tregon ditën e pranimin të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
9. Më 10 shtator 2019, Gjykata Themelore dorëzoi dokumentin e lartpërmendur në Gjykatë.

10. Më 11 mars 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se KPK, përmes Vendimit [Nr. 833/2014] të 29 korrikut 2014, kishte caktuar parashtruesin e kërkesës ushtrues detyre të Kryeprokurorit të Shtetit. Pozitën në fjalë parashtruesi i kërkesës e kishte ushtruar deri më 21 prill 2015, kur Aleksandër Lumezi ishte dekretuar Kryeprokurori i Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
12. Më 19 maj 2015, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh dhe Kryesuesit të KPK-së me qëllim të realizimit të të drejtave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë dhe Ligji nr. 04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë), bazuar në nenin 3 (Përfitimi Monetar, Personeli mbështetës, dhe Hapësirë Zyre) të të cilit “*ish-zyrtarë të lartë*” konsiderohen ish-Kryeministri, ish-Kryeprokurori i Shtetit dhe ish-Kryetarët e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme, respektivisht.
13. Bazuar në shkresat e lëndës dhe duke qenë se KPK-ja nuk kishte nxjerrë ndonjë vendim në lidhje me parashtruesin e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës, kishte dorëzuar në KPK edhe një parashtrësë të re, por me të njëjtën përmbajtje, duke kërkuar që t’i njihet e drejta në përfitimet e caktuara përmes Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë në cilësinë e “*ish-zyrtarit të lartë*”, përkatësisht të ish-ushtruesit të detyrës së Prokurorit të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës kishte mbajtur se ai i plotëson të gjitha kushtet ligjore për njohjen e të drejtave si “*ish-zyrtar i lartë*” sepse gjatë ushtrimit të funksionit të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për më shumë se gjashtë (6) muaj, ai i kishte kryer të gjitha obligimet e përgjegjësitë dhe kishte ushtruar të drejtat sikurse të ishte emëruar Kryeprokuror i Shtetit me dekret presidencial.
14. Më 11 shtator 2015, KPK-ja përmes Vendimit [KPK/Nr.258/2015] e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës. KPK-ja arsyetoi se parashtruesi i kërkesës ishte caktuar ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Shtetit me Vendim të KPK-së dhe nuk ishte emëruar nga Presidenti

i Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 7 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht nuk e kishte fituar statusin e ish-zyrtarit të lartë, siç përcakton neni 3 i Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.

15. Më 13 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore, duke kërkuar miratimin e padisë së tij dhe anulimin e Vendimit të kontestuar të KPK-së. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore kishte theksuar se (i) duke marrë parasysh që ai kishte ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit për më shumë se gjashtë (6) muaj, ai plotësonte kriteret e përcaktuara përmes nenit 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë dhe rrjedhimisht kishte fituar të drejtën për të realizuar pagë mujore në lartësi prej shtatëdhjetë përqind (70%) të pagës aktuale të funksionit përkatës si dhe përfitimet tjera të parapara me këtë ligj; dhe (ii) përkundër arsytimit të KPK-së, neni 3 i Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë përcakton vetëm kushtin e “*ushtrimit*” të detyrës të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit prej gjashtë (6) muajsh dhe jo atë të “*emërimit*” në pajtim me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës. Në fund, parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se si ushtrues detyre ai kishte ushtruar të gjitha funksionet e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte mbikëqyrë punën e të gjitha prokurorive themelore, kishte nxjerrë rregullore, vendime e udhëzime të ndryshme dhe kishte pranuar pagën e Kryeprokurorit të Shtetit për aq kohë sa kishte qenë ushtrues detyre i funksionit në fjalë.
16. Në një datë të paspecifikuar, KPK-ja kishte paraqitur përgjigje ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës duke theksuar se parashtruesi i kërkesës ishte caktuar ushtrues detyre me vendim të KPK-së dhe jo në pajtim me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht atij nuk mund t’i njihet e drejta e fitimit të statusit të ish-zyrtarit të lartë bazuar në nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.
17. Më 16 prill 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.1750/15] refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Themelore kishte vlerësuar se KPK-ja kishte vendosur drejtë kur kishte refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke marrë parasysh që nuk ishte dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës sipas procedurës së përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës; dhe rrjedhimisht, nuk e kishte fituar statusin e ish-zyrtarit të lartë bazuar në paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.

18. Më 23 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Aktgjykimi i kontestuar të prishet dhe t'i njihet e drejta për përfitimin përkatës sipas Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë. Në ankesën e tij parashtruesi i kërkesës specifikisht kishte pretenduar se (i) Ligji për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë "*në mënyrë taksative*" përcakton se ish-zyrtarët që kanë ushtruar së paku gjashtë (6) muaj njërin nga funksionet e përcaktuara me këtë ligj e fitojnë statusin e ish-zyrtarit të lartë për të realizuar pagë mujore në lartësi prej shtatëdhjetë përqind (70%) të pagës aktuale të pozitës përkatëse; dhe (ii) Gjykata Themelore në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar nuk e kishte kontestuar faktin se paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, e ka përmbushur kriterin ligjor të përcaktuar me Ligjin për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, dhe se rrjedhimisht, përderisa gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë, ishte e drejta materiale që ishte zbatuar gabimisht në rrethanat e rastit të tij.
19. Më 31 tetor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AA. nr. 333/2018], e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.
20. Më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës, duke u thirrur në shkelje të dispozitave të procedurës dhe shkelje të së drejtës materiale, i propozoi Zyres së Kryeprokurorit të Shtetit paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
21. Më 5 shkurt 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kishte miratuar propozimin e tij për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Të njëjtën datë, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit paraqiti kërkesën [KMLA. Nr. 1/2019] për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [AA.nr.333/2018] të 31 tetorit 2018 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [A.nr.1750/15] e 16 prillit 2018 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale në kontekst të pikës b) të paragrafit 1 të nenit 247 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.
22. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit theksoi se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-

Zyrtarëve të Lartë sepse parashtuesi i kërkesës për periudhën gusht 2014 deri më prill 2015 si ushtrues detyre kishte kryer të gjitha veprimet dhe kishte marrë të gjitha vendimet që ishin në kompetencë të Kryeprokurorit të Shtetit, bazuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe ndryshimet e plotësimet përkatëse, duke theksuar se kjo gjendje faktike *“shpie tek përfundimi ligjor dhe logjik se parashtuesi i kërkesës ka fituar statusin e ish-zyrtarit të lartë, sepse në të kundërtën, çdo veprim e vendim i parashtuesit të kërkesës për periudhën sa ka qenë ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Shtetit do të ishte i jashtëligjshëm”*.

23. Më 16 prill 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [AML.nr.1/2019] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme theksoi se caktimi i parashtuesit të kërkesës ushtrues detyre është bërë përmes vendimit të KPK-së, por i njëjti nuk është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe për pasojë, parashtuesi i kërkesës, nuk e ka fituar statusin e ish-zyrtarit të lartë, siç është përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Ligjit për Përfitimimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës

24. Parashtuesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
25. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtuesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar mjaftueshëm sepse nuk kanë treguar dallimin ndërmjet caktimit të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit përmes vendimeve të KPK-së dhe emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës. Më specifikisht sipas parashtuesit të kërkesës, përderisa gjykatat e rregullta ligjshmërinë e refuzimit të së drejtës të parashtuesit të kërkesës për t’iu njohur statusi i ish-zyrtarit të lartë publik e kanë arsyetuar me mungesën e një dekreti presidencial, ato kanë dështuar të arsyetojnë kushtin e vetëm të përcaktuar përmes Ligjit për Përfitimimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, përkatësisht *“ushtrimin së paku gjashtë muaj të njërit nga funksionet e përcaktuara në nenin 2 pika 3 të këtij ligji”* në rrethanat e rastit konkret. Parashtuesi i kërkesës vë

theks në dallimin në mes “*ushtrimit*” dhe “*emërimit*” në funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit, dallim ky i cili sipas tij nuk është arsyetuar nga gjykatat e rregullta. Në mbështetje të pretendimeve të tij për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), përkatësisht rasteve *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1999; *Higgings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998; *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987 dhe rasteve të Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14, parashtrues *Shyqyri Sylja dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 8 korrikut 2014 (në tekstin e mëtejme: rastet KI99/14 dhe KI100/14); KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; dhe KI87/18, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim i 15 prillit 2019.

26. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta kanë dështuar t’i marrin parasysh rrethanat e veçanta të rastit të tij, dhe posaçërisht faktin se (i) ai ishte caktuar ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Shtetit me vendim të KPK-së në një situatë urgjente kur Republika e Kosovës kishte mbetur pa Kryeprokuror të Shtetit dhe kishte ushtruar këtë detyrë prej 5 gushtit 2014 deri më 21 prill 2015; (ii) emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit të ri do t’i nënshtrohej procedurës së gjatë të shpalljes së konkursit publik çka mund të rrezikonte administrimin e drejtësisë dhe në mbështetje të rëndësisë së urgjencës së emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14; (iii) gjatë ushtrimit të detyrës, ai kishte ushtruar të gjitha kompetencat e Kryeprokurorit të Shtetit të përcaktuara përmes ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës; dhe (iv) përmes mosnjohjes së statusit të ish-zyrtarit të lartë të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, çështja e statusit juridik të vendimeve të nxjerra përgjatë kësaj periudhe kohore “*vë në pikëpyetje edhe parimin e sigurisë juridike*”.
27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës.
28. Përkitazi me të parin, përkatësisht nenin 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se “*Gjykata Supreme dhe Gjykatat e instancave të tjera, përmes mohimit të së drejtës ligjore, që buron nga neni 3.1 i Ligjit NR. 03/L-001 PËR PËRFITIMIN E ISH ZYRTARËVE TË LARTË, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës e ka*

ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit, mbi tetë (8) muaj, i kanë shkelur të drejtën për barazi para ligjit”.

29. Ndërsa përkitazi me të dytin, përkatësisht nenin 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme dhe gjykatat e instancave të tjera, duke mos arritur që të arsyetojnë vendimin e tyre, kanë dështuar ta garantojnë një të drejtë ligjore të parashtruesit të kërkesës, e cila buron nga neni 3.1 i Ligjit NR. 03/L-001 PËR PËRFITIMIN E ISH ZYRTARËVE TË LARTË dhe kështu kanë shkelur nenin 54 të Kushtetutës”.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatojë se në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme ka shkelur nenet 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin [AML.nr.1/2019] e 16 prillit 2019 të Gjykatës Supreme dhe ta kthejë të njëjtin në rivendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 16

[Epërsia e Kushtetutës]

1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.
3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.
4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Neni 109
[Prokurori i Shtetit]

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.

[...]

7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

Ligji nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë

Neni 2
Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e mëposhtme, kur përdoren në këtë ligj, i kanë kuptimet si vijon:

“Përfitim” nënkupton pagesë monetare që i takon ish-zyrtarit të lartë nga Buxheti i Republikës së Kosovës;

“Një ish Zyrtar i Lartë” sipas këtij ligji Ish-funksionarë të lartë të Republikës së Kosovës konsiderohen: ish-Kryetari i Kuvendit, ish-Kryeministri dhe ish Kryetari i Gjykatës Supreme;

“Institucion Përgjegjës” nënkupton Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, Kuvendin e Kosovës, ose Gjykatën Supreme të Kosovës.

Neni 3
Përfitimi Monetar, Personeli mbështetës, dhe Hapësirë Zyre

3.1 Ish-funksionarët e lartë që kanë ushtruar së paku gjashtë muaj njërin nga funksionet e përcaktuara në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, e fitojnë statusin e ish-funksionarit të lartë për të realizuar pagë mujore në lartësi prej 70% të pagës aktuale të funksionit përkatës.

Ligji nr. 04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë

Neni 3

Neni 2 i ligjit bazik përkufizimi 2 dhe 3 ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

“Ish Zyrtar i Lartë” sipas këtij ligji konsiderohen: ish-Kryetari i Kuvendit, ish-Kryeministri, ish Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ish Kryeprokurori i Shtetit dhe ish Kryetari i Gjykatës Supreme.

“Institucione Përgjegjëse” nënkupton Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryeministrit, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Prokurorin e Shtetit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

34. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [AML.nr.1/2019] e 16 prillit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
35. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

36. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pas vendimit përkatës të KPK-së kishte ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit prej 5 gushtit 2014 deri më 21 prill 2015,

përkatësisht pas pensionimit të Kryeprokurorit paraprak dhe deri në zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri nga KPK dhe dekretimin e tij nga Presidentit i Republikës. Pas fillimit të ushtrimit të funksionit të këtij të fundit, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar KPK-së me kërkesën për njohjen e të drejtave të përcaktuara përmes Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, bazuar në të cilin (i) ish-Zyrtar të Lartë konsiderohen ish-Kryetari i Kuvendit, ish-Kryeministri, ish Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ish Kryeprokurori i Shtetit dhe ish Kryetari i Gjykatës Supreme; dhe (ii) të njëjtit fitojnë këtë status dhe kanë të drejtën të realizojnë pagë mujore në lartësi prej shtatëdhjetë përqind (70%) të pagës aktuale të funksionit përkatës me kushtin që të kenë ushtruar njërin nga këto funksione së paku gjashtë (6) muaj. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës fillimisht u refuzua nga KPK, përmes Vendimit [KPK/Nr.258/2015] të 11 shtatorit 2015, dhe i njëjti më pas u konfirmua nga të gjitha gjykatat e rregullta. Të gjitha, në esencë, kishin vënë theks në dallimin në mes “*ushtrimit*” të këtij funksioni dhe “*zgjedhjes*” ose “*dekretimit*” në këtë funksion bazuar në dispozitat përkatëse kushtetuese e ushtrimit vijues të të njëjtit për së paku gjashtë (6) muaj. Të gjitha instancat, duke përfshirë Gjykatën Supreme, kishin theksuar se (i) parashtruesi i kërkesës ka ushtruar këtë funksion në bazë të vendimit përkatës të KPK-së, dhe nuk është zgjedhur bazuar në procedurën e përcaktuar sipas paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës; dhe (ii) për pasojë, nuk mund të fitojë statusin e ish-zyrtarit të lartë bazuar në Ligjin për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.

37. Parashtruesi i kërkesës konteston këtë konstatim të gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe neneve 24 e 54 të Kushtetutës. Të parën, përkatësisht shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës e pretendon për shkak të mungesës së një vendimi të arsyetuar gjyqësor dhe më saktësisht mungesës së lidhjes logjike ndërmjet konkluzioneve të gjykatave dhe KPK-së në njërën anë dhe provave dhe fakteve e rrethanave të rastit të tij në anën tjetër, specifikisht përkitazi me dallimin në mes “*ushtrimit*” të një funksioni dhe “*emërimit*” në një funksion, me vetëm kushtin e parë, përkatësisht “*ushtrimin*” për periudhën gjashtë (6) mujore të përcaktuar në Ligjin për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë e të nevojshëm sipas parashtruesit të kërkesës, për njohjen e statusit të ish-Zyrtarit të Lartë, dhe rrjedhimisht fitimit të së drejtës për përfitimet përkatëse.
38. Gjykata, në vijim, do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me (i) shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje

me nenin 6 të KEDNJ-së, sa i përket mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor; dhe (ii) shkeljen e neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

39. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi të 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtguesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih rastet e Gjykatës, KI104/16, parashtgues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtgues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
40. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do të fokusohet në pretendimet për mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata në këtë aspekt, thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtgues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtgues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17 parashtgues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 24 korrikut 2019; dhe

KI49/19, parashtues *Limak Kosovo International Airport*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 tetorit 2019.

41. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsytet në të cilat ato bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtuesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
42. Gjykata rikujton që pretendimet e parashtuesit të kërkesës për mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor ndërlidhen me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i cili ishte nxjerrë si rezultat i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të ngritur nga Prokurori i Shtetit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Ky i fundit, përkatësisht Prokurori i Shtetit në Gjykatën Supreme kishte pretenduar shkelje të pikës b) të paragrafit 1 të nenit 247 të LPK-së, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, e më saktësisht, aplikimin e gabuar të nenit 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë. Sipas Prokurorit të Shtetit, fakti që parashtuesi i kërkesës ka “*ushtruar*” funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit për më shumë se gjashtë (6) muaj, siç është përcaktuar në nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, dhe i cili bazuar në të njëjtin është kriter i vetëm për përfitimin e statusit të ish-zyrtarit të lartë, është i mjaftueshëm për miratimin e kërkesës së parashtuesit të kërkesës për përfitimin e të drejtave që burojnë nga njohja e statusit të ish-zyrtarit të lartë. Pretendimet e Prokurorit të Shtetit para Gjykatës Supreme, në esencë ngërthejnë dhe reflektojnë edhe pretendimet thelbësore të parashtuesit të kërkesës përgjatë procedurave në gjykatat e rregullta.
43. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se KPK përmes Vendimit [KPK/Nr.258/2015] të 11 shtatorit 2015 dhe Gjykata Themelore e ajo e Apelit, përmes Aktgjykimeve përkatëse, kishin sqaruar: (i) dallimin ndërmjet caktimit ushtrues detyre të Kryeprokurorit të Shtetit me vendim të KPK-së dhe emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit me dekret presidencial në pajtim me paragrafin 7 të nenit 109 të Kushtetutës; dhe (ii) kushtet që duhen plotësuar për t'i realizuar përfitimet e ish-zyrtarit të lartë në pajtim me ligjet për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë. Në parim, në refuzimin e kërkesës, padisë dhe ankesës së

parashtruesit të kërkesës, respektivisht, gjykatat e rregullta, duke vënë theks në mënyrën e “emërimit” të zyrtarit të lartë, përkatësisht dhe në rrethanat e rastit konkret, Kryeprokurorit, kishin sqaruar se “ushtrimi” i funksionit përkatës të përcaktuar në Ligjin për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë është i kushtëzuar në mënyrën e “emërimit” të tij të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës. Gjykata Supreme, miratoi një qëndrim të tillë të instancave më të ulëta. Ajo, duke i adresuar pretendimet e Prokurorit të Shtetit, gjithashtu vuri theks në faktin që parashtruesi i kërkesës nuk është emëruar në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit siç është përcaktuar në Kushtetutë, por ishte përcaktuar ushtrues detyre me vendim të KPK-së për një periudhë të përkohshme.

44. Në këtë drejtim, Gjykata vë në spikamë pjesën relevante të arsytimit të Gjykatës Supreme, që përcakton:

“Neni 109, paragrafi 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi. Më tej, neni 3 i Ligjit nr.04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë përcakton se ish Zyrtar të Lartë sipas këtij ligji konsiderohen: ish-Kryetari i Kuvendit, ish-Kryeministri, ish Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ish Kryeprokurori i Shtetit dhe ish Kryetari i Gjykatës Supreme.

Nga sa u tha me sipër rezulton se caktimi i paditësit Sylë Hoxha, si ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës, por jo edhe i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, e që nënkupton se paditësi nuk e ka fituar statusin e ish zyrtarit të lartë siç është përcaktuar me nenin 3 të Ligjit nr.04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë dhe nenin 109, paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke u nisur nga sa u tha më sipër, Gjykata Supreme gjeti se në këtë çështje

administrativo-juridike gjykata e shkallës së dyte ka zbatuar drejtë dispozitat e konfliktit administrativ, dispozitën e Ligjit nr. 04/L-038 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë dhe dispozitën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe se pretendimet në kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të

pabazuara, për shkak se nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendje tjetër faktike nga ajo se çfarë vërtetoi gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjyqimit të kontestuar janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.”

45. Gjykata, në këtë kontekst, vëren se Gjykata Supreme ka interpretuar nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë (i) duke u njohur të drejtën e përfitimit të statusit të ish-zyrtarit të lartë dhe rrjedhimisht edhe të drejtën për përfitimet përkatëse, vetëm ish-zyrtarëve të lartë të shtetit të emëruar përmes procedurave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje të aplikueshme përkatëse, me kushtin që të njëjtit të kenë ushtruar funksionin përkatës për së paku gjashtë (6) muaj; dhe (ii) duke përcaktuar se përfitimet e përcaktuara përmes këtij ligji, nuk u takojnë zyrtarëve tjerë dhe të cilët mund të kenë “ushtruar” këtë funksion, por të mos jenë “emëruar” në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligjet përkatëse të aplikueshme, pa marrë parasysh nëse kanë ushtruar këtë funksion për gjashtë (6) muaj dhe kanë ushtruar kompetencat e plota të funksionit përkatës gjatë kësaj periudhe kohore.
46. Gjykata thekson se kushtëzimi i “ushtrimit” të funksionit përkatës me mënyrën e “emërimit”, përkatësisht emërimin sipas procedurës të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës, është në përputhshmëri me (i) hierarkinë e normave dhe epërsinë e Kushtetutës; dhe (ii) vet nenin 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë.
47. Përkitazi me të parën, Gjykata thekson, se në rastin konkret, gjykatat e rregullta dhe KPK-ja kanë respektuar hierarkinë e normave juridike dhe epërsinë e Kushtetutës të përcaktuar në nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të saj, duke u mbështetur në formulimin e paragrafit 7 të nenit 109 të Kushtetutës për të vënë theks në dallimin ndërmjet caktimit “ushtrues” detyre i Kryeprokurorit të Shtetit me vendim të KPK-së dhe “emërimit” Kryeprokuror i Shtetit nga Presidenti i Republikës, pas propozimit nga KPK-ja.
48. Ndërsa përkitazi me të dytën, Gjykata thekson se përkundër faktit që neni 3 i Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë i referohet vetëm dy kushteve për përfitimin e të drejtave që burojnë nga ky ligj, përkatësisht “ushtrimit” të funksionit dhe atë për një periudhë (6)

gjashtë mujore, këto kushte duhet interpretuar në lidhje me nenin 2 dhe ndryshimeve përkatëse të të njëjtit ligj dhe sipas të cilit këtë të drejtë, e kanë vetëm një numër shumë i limituar i ish-zyrtarëve publik, përkatësisht ish-Kryetari i Kuvendit, i Gjykatës Kushtetuese, dhe i Gjykatës Supreme dhe ish-Kryeministri e ish-Kryeprokurori.

49. Njohja e kësaj të drejte e një liste kaq të ngushtë dhe specifike funksionarësh, nënkupton “*emërimin*” e tyre në përputhshmëri me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore, dhe më pas edhe kushtin e ushtrimit të këtij funksioni për të paktën gjashtë (6) muaj. Prandaj, të drejtën e përfitimit të statusit të “*ish-zyrtarit të lartë*” kanë vetëm pesë (5) kategoritë e pozitive të referuara specifikisht në nenin 2 të ligjit të lartcekur, me kushtin që përtej “*emërimin*” bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, të plotësojnë edhe kushtin e të “*ushtruarit*” të këtij funksioni për të paktën gjashtë (6) muaj. Në të kundërtën, të drejtat që burojnë nga njohja e statusit të “*ish-zyrtarit të lartë*”, nuk do t’u takojnë as pesë (5) kategorive të cekura specifikisht në nenin 2 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, nëse të njëjtit nuk kanë “*ushtruar*” këtë funksion së paku gjashtë (6) muaj. Rrjedhimisht, “*emërimi*” nuk rezulton në mënyrë automatike në përfitimin e këtyre të drejtave, por kushtëzohet edhe nga “*ushtrimi*” për të paktën një periudhe gjashtë (6) mujore.
50. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se dallimi në mes të “*zgjedhjes*” dhe “*ushtrimit*” të funksionit është bërë edhe në rastin e Presidentit të Republikës, përmes ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 06/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Presidentin) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastin nr. KO97/10, me parashtrues *Jakup Krasniqi*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2010 (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës nr. KO97/10).
51. Gjykata thekson se Kreu II lidhur me të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit të Ligjit për Presidentin, përcakton ndër të tjerash edhe të drejtën e Presidentit në pension, shuma e të cilit është shtatëdhjetë përqind (70%) e pagës të cilën e merr Presidenti i Republikës së Kosovës. Por realizmi i këtyre të drejtave është i kushtëzuar në nenin 18 të këtij ligji, përkatësisht “*në përfundimin e mandatit për të cilin është zgjedhur*”. Neni i lartcekur, rrjedhimisht kushtëzon përfitimin e këtyre të drejtave nga ana e Presidentit me kushtin që (i) është “*zgjedhur*” President i Republikës bazuar në dispozitat përkatëse të Kushtetutës; dhe (ii) ka përfunduar mandatin e tij, me përjashtim nëse ky mandat ka përfunduar si pasojë

e shkarkimit siç është përcaktuar në nenin 10 (Shkarkimi i Presidentit) të Ligjit për Presidentin.

52. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se neni 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit] i Kushtetutës, përcakton kushtet nën të cilat ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës mund të jetë Kryetari i Kuvendit, për jo më shumë se gjashtë (6) muaj dhe se Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, përkatësisht rastit nr. KO97/10, ka vënë theks në dallimin në mes zgjedhjes/emërimit në një funksion dhe caktimit në detyrën e ushtrimit të këtij funksioni, duke mbajtur qëndrimin se “*ushtruesi i detyrës*” së Presidentit nuk është President i zgjedhur i Republikës së Kosovës. (Shih rastin e Gjykatës nr. KO97/10, paragrafët 23-25).
53. Rrjedhimisht, dhe në këtë kontekst, Gjykata rithekson se përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht të Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata konsideron se bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe ato të Prokurorit të Shtetit janë adresuar dhe arsyetuar nga Gjykata Supreme. Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para gjykatave të rregullta përkitazi me interpretimin e gabuar të nenit 3 të Ligjit për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë, ishin arsyetuar mjaftueshëm nga të njëjtat, duke rezultuar kështu në një procedurë e cila, në tërësinë e saj dhe përkitazi me pretendimet për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, i përmbush kriteret e përcaktuara përmes praktikës përkatëse gjyqësore në interpretimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
54. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimit të tij për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, i referohet një numri rastesh të GJEDNJ-së dhe Gjykatës. Gjykata, në këtë aspekt, thekson se të gjitha parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të përfshira në praktikën e Gjykatës tashmë siç është reflektuar në paragrafin 40 të këtij Aktvendimi dhe janë aplikuar në rrethanat e rastit konkret.
55. I vetmi rast i referuar nga parashtruesi i kërkesës dhe i cili nuk ndërlihet me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor është rasti i Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur këtë

vendim, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tij, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret, detyrë kjo që, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i takon parashtruesit të kërkesës. Gjykata ka theksuar vazhdimisht që arsyetimet e vendimeve të tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë. (Shih, ndër të tjera në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI 119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80). Megjithatë dhe pa marrë parasysh faktin që parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar ndërlidhjen e rastit të tij me atë KI99/14 dhe KI100/14, Gjykata thekson faktin se rastet përkatëse nuk kanë asnjë ngjashmëri dhe se “rëndësia” apo “urgjenca” e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit dhe të cilës i referohet parashtruesi i kërkesës, në rastin KI99/14 dhe KI100/14 është aplikuar në kontekst të vlerësimit të shterimit të mjeteve juridike e të cilat nuk janë kontestuese në rrethanat e rastit konkret. (Shih paragrafët 50 deri më 54 të rastit të Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14).

56. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore sa i përket vendimit të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Gjykata më tej rithekson se, në parim, “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substancial*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Suta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat e tjera të përmendura aty; KI118/18, parashtrues *Eco Construction sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
58. Kjo nënkupton, se palëve duhet mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; duhet akorduar mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe

dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shqyrtuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29). Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.

59. Gjykata në fund thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, cituar më lart, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
60. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta dhe KPK nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, rastin e kësaj Gjykate KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
61. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës. Lidhur me këto pretendime, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës: KIo2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36 dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).

62. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë, pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
63. Megjithatë, Gjykata përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me (i) nenin 24 të Kushtetutës, thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, në mënyrë që një çështje të ngritët në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës dhe atë 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, duhet të ekzistojë dallimi në trajtim ndërmjet personave në situata të ngjashme ose të krahasueshme. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98). Për më tepër që, jo çdo dallim në trajtim përbën shkelje të neneve të lartcekura. Në parim, dallimi në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv apo i arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që synohet të arrihet. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 69 dhe referencat tjera të përmendura aty). Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar asnjë pretendim përkitazi me ndonjë dallim në trajtim dhe rrjedhimisht nuk ka arsyetuar dhe as mbështetur pretendimet e tij për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës; dhe (ii) nenin 54 të Kushtetutës, thekson se ato në thelb janë të njëjta me pretendimet për shkelje të nenit 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nuk ngrehin çështje tjera që tashmë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar asnjë pretendim përkitazi me shkelje të së drejtës së tij në mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për pasojë, nuk ka arsyetuar dhe as mbështetur pretendimet e tij për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.
64. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të nenit 24 dhe 54 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, edhe këto pretendime, në vazhden e pretendimeve të tjera në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të cilat u shtjelluan dhe u sqaruan më lart, duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

65. Prandaj, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe nenet 24 e 54 të Kushtetutës.
66. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 mars 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI231/19, Parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila përfaqëson NSH-në „Kosova-Export”, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-15-0212-A0001 të 22 gushtit 2019

KI231/19, Aktvendim për papranueshmëri i 26 shkurtit 2020, publikuar më 22 prill 2020

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta pronësore, masë e përkohshme, qartazi e pabazuar, aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, pasi ai konsideroi se vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së pretendohet se ia ka shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 3 paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 paragrafi 1 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të vendos masë të përkohshme.

Në të vërtetë, Gjykata vëren se esenca e kontestit ka të bëjë me faktin se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori aktgjykim të formës së prerë, me të cilin kishte zgjidhur objektin e çështjes së kontestit për konfirmimin e të drejtave pronësore mbi disa parcela të pronës, të parashtruar nga personi Z. Rr. H. me padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se një pjesë e këtyre pretendimeve parashtruesi i kërkesës i ngre në nivelin e ligjshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ndërsa pjesën tjetër të pretendimeve ai i ngre dhe ndërton në nivel të kushtetutshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Prandaj, pikërisht për shkak të këtyre konstatimeve, Gjykata e sheh të nevojshme të ndajë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në **i)** pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në nivel të ligjshmërisë në lidhje me shkeljet kushtetuese, si dhe **ii)** pretendimet e ngritura nga

parashtruesi i kërkesës në nivel të kushtetutshmërisë në lidhje me shkeljet kushtetuese.

Duke analizuar pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në nivelin e ligjshmërisë, Gjykata përfundoi se nuk kishte gjetur asgjë që do të çonte në konkludimin se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar ose arbitrare, duke çuar në përfundimin se nuk ka as shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në lidhje me pjesën e parë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në nivelin e kushtetutshmërisë përkritazi me shkeljet kushtetuese, Gjykata konstatoi se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në arsyetimin e aktgjykimit, ka dhënë shpjegime të hollësishme lidhur me të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Nga kjo rrjedh se edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara.

Gjykata në bazë të analizës, si të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me çështjen e ligjshmërisë, po ashtu dhe pretendimeve që kanë të bëjnë me çështjen e kushtetutshmërisë, nuk ka gjetur se procedurat në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare për ta bindur Gjykatën Kushtetuese që parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar ndonjë garanci procedurale, e cila do të cenonte të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës përkatësisht nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka as shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilat parashtruesi i kishte theksuar në kërkesë.

Gjykata gjithashtu refuzoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme si të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI231/19

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila përfaqëson NSH “Kosova-Export”

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0212-A0001, të 22 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) që përfaqëson NSH “Kosova-Export”. Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Vjollca Haliti, juriste e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0212-A0001 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të DHPGJS-së), të 22 gushtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 3, paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24, paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54, paragrafi 1 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102, paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon gjithashtu vendosjen e masës së përkohshme të sigurisë mbi pronën në fjalë, më konkretisht mbi parcelat kadastrale nr. 1740 në sipërfaqe prej 0.24,41 ha, p.k. 1741 në sipërfaqe prej 0.78,03 ha, p.k. 1742 në sipërfaqe prej 0.78,03 ha, p.k. 1743 në sipërfaqe prej 2.88,29 ha, p.k. 1744 në sipërfaqe prej 0.32,72 ha, p.k. 1745 në sipërfaqe prej 0.80,68 ha, p.k. 1899 në sipërfaqe prej 3.56,71 ha, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9.76,27 ha.
5. Me këtë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, *“ndalohet çdo tjetërsim i pronës, shpërndarja e paluajtshmërisë ose ngarkimi, me të cilën do të hiqej mundësia të shkaktohej dëm i pariparueshëm”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 18 dhjetor 2019, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 20 janar 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen ligjore të parashtrueses për regjistrimin e kërkesës dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
10. Më 26 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese, njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 gusht 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP), shpalli tenderin për privatizimin e pronës së NSH “Kosova-Export”.
12. Më 9 dhjetor 2014, Z. Rr. H., parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: DHPGJS), për vërtetimin e të drejtave pronësore në lidhje me ngastrën kadastrale nr. 1740, plani 31, fleta 50, sipas kulturës kullosë e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 0.24,41 ha, me ngastrën kadastrale nr. 1741, plani 31, fleta 50, me kulturë tokë e punueshme e klasës së 7-të, në sipërfaqe prej 0.65,63 ha, ngastrën kadastrale nr. 1742, plani 31, fleta 50, tokë e punueshme e klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 0.78,03 ha dhe ngastër kadastrale nr. 1743, plani 31, fleta 50, me kulturë kullosë e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 2.88,29 ha, e gjithë kjo në vendin e quajtur “Veternik” në sipërfaqen e përgjithshme prej 9.76,27 ha, të patundshmërisë së kontestuar. Në padi, Z. Rr. H. kërkoj, që kjo e drejtë t’i njëhej *“sepse konsideron se gabimisht kjo pronë është regjistruar në emrin e të paditurës”*.
13. Paditësja Z.Rr.H., përveç padisë për përcaktimin e të drejtave pronësore, parashtroi edhe kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme - pezullimin e tenderit, i cili ishte shpallur nga AKP-ja më 11 gusht 2014.
14. Më 29 dhjetor 2014, AKP-ja (e paditura) ka parashtruar mbrojtje në padi, duke pohuar *“se e kundërshton në tërësi padinë dhe pretendimet në padi të paditësës si të pabazuara në ligj. Sipas të paditurës, paditësja padinë e ka parashtruar në kundërshtim me parimin “Legitimacio ad causam” pasi që të njëjtës i mungon legjitimacioni aktiv për procedim të çështjes gjyqësore dhe paditësja nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën mbështetet kërkesëpadija; Sipas AKP-së, “të drejtën e pronësisë në parcelat kontestuese e ka fituar mbi bazën e parashkrimit fitues, sepse është mbajtëse me mirëbesim dhe*

të ligjshëm, dhe se nga padia e parashtruar rezulton se është parashkruar afati i të drejtës për paditësen për të kërkuar kthimin e sendit, pasi që paditësja nuk është interesuar për pronën që nga vitit 1965 e deri në parashtrimin e padis në vitin 2014, dhe propozon të hidhet poshtë padia si e papranueshme ose ta refuzohet si e pabazuar”.

15. Gjykata vëren nga shkresat e lëndës, se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së) dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së zhvilluan dy procedura gjyqësore të ndara. Procedura e parë gjyqësore ishte mbajtur sipas kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, ndërsa procedura e dytë gjyqësore u zhvillua sipas kërkesëpadisë kryesore për kthimin e të drejtave pronësore.

Procedura gjyqësore sipas kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme

16. Më 3 shkurt 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin C-II-14-0140-C0001, me të cilin aprovoi kërkesën e Z.Rr.H., për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësor, me të cilin e ndaloi AKP-në të ndërmarre ndonjë veprim juridik në lidhje me privatizimin e ngastrave kadastrale të regjistruara aktualisht si pronë e NSH “Kosova Export“, në sipërfaqen e përgjithshme prej 9.76,27 ha.
17. Në arsyetimin e aktvendimit për vendosjen e masës së përkohshme, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së deklaroi: *“Dhoma e Posaçme konsideron se mundësia e dëmtimit, humbjes ose dëmit mund të ndodhë në këtë rast. Në rast se rezultati përfundimtar i padisë kryesore është se paditësi ka të drejtë me kërkesën/padinë e saj, atëherë ajo nuk mund të kompensohet arsyeshëm me çmim të arsyeshëm, pasi që kemi të bëjmë me pasuri të paluajtshme dhe se dëmet materiale do të ishin të mëdha. Veç kësaj, kompensimi financiar nuk do të ishte i arsyeshëm pasi që çmimi mund të mos jetë ai i tregut, por edhe sikur të jetë, pagesa do të mund të vonohej pa arsye. Pronarët do të mohoheshin që të disponojnë me tokën dhe të ardhurat e saj”.*
18. Më 18 shkurt 2015, e paditura (AKP) parashtroi ankesë pranë Kolegjit Apelit të DHPGJS-së kundër Aktvendimit C-II.-14-0140-C0001 të 3 shkurtit 2015, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Në ankesën e saj, AKP-ja deklaroi se *“konsideron se nuk ka pasur legjitimitet aktiv për parashtrimin e padisë nga paditësja, sepse nuk është dëshmuar se paditësja është trashëgimtare ligjore e paraardhësit të saj. Sipas AKP-së me asnjë provë materiale paditësja nuk ka dëshmuar kërkesën e saj për ta lëshuar një masë të përkohshme. Se paditësja nuk është interesuar asnjëherë për pronën e saj që nga viti 1965”*.
20. Më 26 mars 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin AC-I-15-0041-A0001, me të cilin e refuzoi ankesën e AKP-së si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së, thuhet: *“Me vlerësimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së që duhet të vendoset masa e përkohshme është pajtuar edhe Kolegji i Apelit, edhe për faktin se pala paditëse ka ofruar dëshmi të shumta që provojnë probabilitet të lartë të ekzistimit të të drejtës së, pretenduar, si: Lista poseduese nga viti 1957 dhe 1960, Vendimin e Këshillit Popullor të vitit 1961 me të cilin i është marrë prona paditëses, me arsyetimin se ajo nuk mund ta punojë këtë tokë, sepse nuk ka fuqi të mjaftueshme punëtore, Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Raporteve Pronësore, i datës 21 korrik 1965, me të cilin i është kthyer paditëses prona e marrë, ndërsa e paditura me asnjë dëshmi nuk e ka provuar të kundërtën, andaj konform nenit 55.1 të Shtojcës 519 LDHPGJS-së, Kolegji i Apelit konsideron se një masë e tillë e përkohshme është e domosdoshme, deri në zgjidhjen e padisë në meritat e saj”*.

Procedura gjyqësore sipas padisë për vërtetimin e të drejtave pronësore

21. Më 1 shtator 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së lëshoi Urdhrin C-II-14-0140-C0001, duke theksuar se **“i) Kolegji i Specializuar njofton palët se është duke shqyrtuar mundësinë e nxjerrjes së një urdhri për heqjen dorë nga mbledhja e provave të mëtejshme; ii) Ftohen palët që nëse kanë, të paraqesin parashtrësia dhe argumente mbi këtë fazë të procedurës, brenda 7 (shtatë) ditësh nga marrja e këtij njoftimi; iii) Parashtrësat dhe gjithë dokumentet bashkëngjitur duhet të dorëzohen, një kopje për lëndën paditësore të Gjykatës, dhe një kopje për t’ia dorëzuar palës kundërshtarë”**.
22. Më 11 shtator 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, lëshoi një urdhrë të ri C-II-14-0140-C0001, me të cilin njofton palët se *“pasi përcakton që në procedurën, nuk ka çështje në kontest për t’u sqaruar më tej për sa i përket fakteve materiale të nevojshme për të vendosur në lëndën ose çështjen në fjalë, Paneli i Specializuar II vendos të çlirojë procedurën nga mbledhja e provave të mëtejshme”*.

23. Më 14 shtator 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-II-14-0140-C0001, me të cilin aprovoi padinë për njohjen e të drejtave pronësore të Z.Rr.H., mbi ngastrat për të cilat ajo kishte pretenduar në kërkesëpadi, në sipërfaqen e përgjithshme prej 9.76,27 ha.
24. Me të njëjtin aktgjykim, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e obligoi AKP-në që t'ia transferojë paditëses pronësinë e plotë të pronës së përshkruar në pikën I të dispozitivit, si dhe t'i sigurojë asaj të gjitha dokumentet e nevojshme për të mundësuar regjistrimin e tokës në emër të saj në zyrat kadastrale.
25. Në arsyetimin e Aktgjykimit C-II-14-0140-C0001 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së thuhet:

“Gjyqtari raportues i Panelit të Specializuar II ka lëshuar një urdhër siç parashikohet nga neni 34. paragrafi 4, duke i njoftuar palët për mundësinë eventuale të lëshimit nga Gjykata të një urdhri për përjashtimin e mbledhjes së provave të mëtejshme. Në lidhje me këtë hap procedural, asnjëra nga palët dorëzoi parashtrësia ose argumente brenda afatit të caktuar, asnjëra nga palët kërkoi për seancë me gojë, as për mbledhje provash të mëtejshme ...”.

Sa i përket çështjes së ekzistencës së legjitimitetit aktiv për paraqitjen e padisë nga paditësja, në të gjitha certifikatat e fletëve poseduese, të lëshuara nga Zyrat Kadastrale më 8 prill 1957, 25. prill 1957, 18 nëntor 1961 dhe 26 qershor 1969, ngastrat e kontestuara janë të regjistruara në emrin e paditëses Z.Rr.H., si pasojë, duket lehtësisht e kuptueshme se ajo e ka legjitimitetin aktiv të plotë, për të vepruar për drejtat e saj lidhur me ngastrat e kontestuara të tokës.

Personi R. A. P., paraardhësi i paditëses Z.Rr.H., ishte pronar i ngastrave kadastrale si në vijim: 9/31, 9/32, 9/33, 9/34, 9/35, 9/36 dhe 9/80, Zona Kadastrale Prishtinë, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 9.76,27 ha.

Paditësja Z.Rr.H., si trashëgimtare ekskluzive e babait të saj të ndjerë, ka trashëguar pronat dhe ngastrat e tokës janë regjistruar në emrin e saj, dhe ajo filloi të paguaj taksa mbi këtë pronë.

Të gjitha dokumentet e paraqitura në gjykatë nga paditësi janë kopje të certifikuara te noteri të dokumenteve origjinale që gjinden në arkivat përkatëse të Komunës së Prishtinës”.

26. Më 8 tetor 2015, AKP-ja parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit C-II-14-0140-C0001 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së. Në ankesën e saj, AKP theksoi, ndër të tjera *“se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit dhe dispozitave ligjore për faktin se fare nuk ka mbajtur seancë dëgjimore, se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit dhe se nuk përmban fare arsyetimet për faktet vendimtare-aktgjykimin nuk përmban fare arsyetim lidhur me posedimin, se si në fakt paditësja a i posedon pronat kontestuese, a është mbajtur me mirëbesim dhe sa kohë i posedon pronat kontestuese”.*
27. Më 22 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin AC-I-15-0212-A0001, me të cilin refuzoi ankesën e AKP-së si të pabazuar. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit theksohet:

“Sa i përket pretendimit ankimor të AKP-së se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit dhe dispozitave ligjore për faktin se fare nuk ka mbajtur seancë dëgjimore, Kolegji i Apelit mendon se Kolegji i Specializuar në rastin konkret ka vepruar konform Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, gjegjësisht nenit 34, paragrafit 3 dhe 4. Me urdhrin e datës 01 shtator 2015 Kolegji i Specializuar i kishte njoftuar palët në procedurë se është duke shqyrtuar mundësinë e nxjerrjes së një urdhri për heqje dorë nga mbledhja e provave të mëtutjeshme dhe ka ftuar palët nëse kanë, të paraqesin parashtresa dhe argumente mbi këtë fazë të procedurës brenda 7 ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Asnjëra palë nuk kishte dërguar ndonjë provë, por as që e kishin kundërshtuar një mundësi të tillë, andaj as ky pretendim ankimor i AKP-së nuk është i mbështetur.

Nga provat e administruara nga Kolegji i Specializuar dhe të cilat janë në shkresat e lëndës, konfirmohet se këto prona kontestuese, asnjëherë që nga viti 1957 nuk kanë qenë në emër të NSH-së, por në emër të paraardhësit të paditëses dhe në emër të paditëses.

Me ankesë AKP nuk ka ofruar asnjë provë shtesë që do të mund ta ndryshonte gjendjen faktike të vërtetuar nga Kolegji i Specializuar me aktgjykimin e ankimuar. Ajo gjithë arsyen e kundërshtimit e ka fokusuar në mosmbajtjen e seancës dëgjimore, pa dhënë asnjë argument që do të mund të rrëzonte

provat e ofruara nga paditësja. Edhe pa mbajtje të seancës dëgjimore, AKP-së i është dhënë mundësia që të ofrojë dëshmi dhe argumente shtesë që do të ishin në favor të saj, sepse ishte paralajmëruar se nuk do të mbahet seancë gjyqësore konform ligjit, gjegjësisht nenit 34 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme. Të vetmen provë, e që ishte edhe në dosje para Kolegjit të Specializuar, AKP ka përmend certifikatën e pronësisë e cila është në emër të NSH-së, por nuk dëshmoi se në çfarë baze kjo pronë kishte kaluar në emër të NSH-së, kur të gjitha provat dëshmojnë se kjo pronë gjithnjë ishte në emër të paditëses”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me aktgjykimet e tyre, i kanë shkelur atij të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 3, paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 paragrafi 1 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54, paragrafi 1 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102. 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
29. Më konkretisht, për sa i përket shkeljes së nenit 3, paragrafi 1 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson *“Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 3, paragrafi 1, për shkak të shkeljes së parimit fundamental të respektimit të plotë të sundimit të ligjit. Gjithashtu kemi të bëjmë me shkelje të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, të cilat drejta janë cenuar nga organi gjyqësor, që sipas Kushtetutës së Kosovës është gardiani i fundit dhe i vetmi i mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe vendosjes së ligjshmërisë”.*
30. Në vijim, sa i përket shkeljes së nenit 24, paragrafi 1 dhe nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Dhoma e Posaçme (shkalla e parë dhe e dytë) ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 4.7.1 e Ligjit për Dhomën si dhe të nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive. Kjo për faktin se, gjykata ka manifestuar njëanshmëri duke e përshpejtuar përfundimin e procedurës kur kanë vendosur pa përfunduar procedura me shkrim dhe pa mbajtjen e seancës dëgjimore. Sipas nenit 40 al.l par.1.3, procedura me shkrim përfundon me dorëzimin e kundërpërgjigjes, ndërsa në rastin konkret gjykata ka vendosur vetëm me padi dhe përgjigje në padi”.*

31. Parashtruesi i kërkesës më tutje thekson se “Gjykata ka vazhduar me procedim të çështjes në kundërshtim me nenin 47 “Procedurat gjatë seancës” al. 3, 4, 5, 6, 7. Nuk është caktuar fare seancë, por është vendosur vetëm me një veprim procedural për dallim nga rastet tjera duke mos i administrimin (leximin dhe vlerësimin e tyre) ashtu siç e përcakton ligji. Gjithashtu, veprimi i tillë është në kundërshtim edhe me vet praktikën e gjykatës, sepse në rastet kur kemi të bëjmë me padi për vërtetim pronësie, e posaçërisht si në rastin konkret (sipërfaqe prej 9.76.27ha), gjykata me konkretisht Dhoma e Posaçme e ka krijuar një praktikë gjyqësore si vijon: Sipas Shtojcës së Ligjit për AKP, më konkretisht neni 10, përcakton pezullimin e të gjitha veprimeve qoftë administrative apo gjyqësore”.
32. Parashtruesi gjithashtu deklaron se “Dhoma ka vazhduar me shqyrtimin e rastit e cila është në kundërshtim me praktikën gjyqësore edhe të Gjykatës Kushtetuese (ref. Aktgjykimi në rastin nr. KG 142/16). Tutje, Gjykata mos mbajtjen e seancës gjyqësore e arsyeton me bindje se, e paditura është ajo e cila është dashur të kërkojë që të mbahet seancë gjyqësore”! Ky qëndrim i gjykatave nuk gjen mbështetje dhe nuk përkon me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Ligjit Për Procedurën Kontestimore”.
33. Në lidhje me shkeljen e nenit 54, paragrafi 1 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se “çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.
34. Në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se mohimi i së drejtës për mbrojtje juridike ka çuar në shkelje të nenit 102.3 të Kushtetutës, me anë të të cilit përcaktohet që gjykatat duhet të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit. Sipas parashtruesit “a) Paditëses i është kthyer e drejta e pronësisë mbi tokën, pa mbështetje në bazë ligjore, për kthimin e paluajtshmërisë. Në Kosovë ende nuk ekziston Ligji për kthimin e pronave. b) Shkelja tjetër ligjore ka të bëjë me faktin se, gjykata ka nxjerrë vendim pa mbajtur fare shqyrtim gjyqësor (në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit për Dhomën), që paraqet shkelje thelbësore, e në kundërshtim me nenin 182.2, i), të LPK-së, që shihet nga vendimi i Kolegjit të Specializuar, C-II-14-0140-C-0001, i datës 03. 02. 2015. c) Vendimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0212-A0001 i datës 22 gusht 2019, është në shkelje flagrante të ligjit të aplikueshëm të LPK-së neni 277, aJ, si dhe ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-006, për procedurën kontestimore, nr. 04/L-118, sepse paditësja ka ndërruar jetë me 23. 9.2015, (certifikata e vdekjes, e

datës 27.8.2015), ndërsa gjykata ka vendosur me aktgjykim me 22. 8. 2019, si organ i shkallës së dytë në mungesë të legjitimitetin aktiv të palës”.

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje te nenit 6, duke deklaruar se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, *“është informuar kronologjikisht për të gjitha shkeljet procedurale dhe ligjore nga ana e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, ndër të tjera edhe për shkeljet kushtetuese. Mirëpo, nga vendimi i Gjykatës së Apelit shihet qartë se, të gjitha pretendimet ankimore nuk janë shqyrtuar/vërtetuar dhe janë neglizhuar”.*
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës i përfundon pretendimet e tij me një deklaratë *“Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së me Aktgjykimin nr. AC-I-15-021- A00012, ka vendosur në shkelje të nenit 7, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë vlerat e shoqërisë duke i respektuar parimin e barazisë, pa cenuar të drejtat dhe liritë e njeriut dhe sundimit të ligjit”.*
37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, e cila do të parandalonte tjetërsimin, shpërndarjen ose ngarkimin e pronës në fjalë, për të parandaluar dëmet që mund të ndodhin gjatë procedurës në Gjykatë.
38. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të nxjerrë një aktgjykim, me të cilin do ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe ta anulojë Aktgjykimin AC-I-15-0212-A0001 e 22 gushtit 2019, të nxjerrë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, dhe Aktgjykimin C-II-14-0140- C0001, të 14 shtatorit 2015, të nxjerrë nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, ose përndryshe ta kthejë rastin për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

41. Gjykata konsideron se në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili parasheh që *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave të zbatueshme për individët, si dhe për personat juridikë (shih: *mutatis mutandis*, aktvendimi i 27 janarit 2010, kërkesa KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Republikës së Kosovës*).
42. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

*2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

43. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së

autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin AC-I-15-0212-A0001 e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të 22 gushtit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

44. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

45. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja thelbësore në kërkesën e parashtruesit ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme, me këtë rast gjykatat e rregullta iniciuan dy procedura gjyqësore, njëra prej të cilave sipas kërkesës për masë të përkohshme dhe tjetra me rastin e zgjidhjes së të drejtave pronësore mbi pronën në fjalë.
46. Prandaj, duke marrë parasysh rezultatin e dy procedurave gjyqësore, Gjykata vëren se procedura gjyqësore në lidhje me masën e përkohshme ka mbetur pa objekt në rrethanat e tanishme, me arsyetimin se çështja kryesore në këtë padi ishte zgjidhur me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit dhe për këtë arsye pushuan së ekzistuari të gjitha pasojat juridike të përcaktuara nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I.-15-0041-A00010. Për këto arsye, Gjykata nuk do të merret me këtë pjesë të procedurës gjyqësore.
47. Në lidhje me procedurën gjyqësore të zhvilluar sipas padisë për përcaktimin e të drejtave pronësore mbi pronën në fjalë, Gjykata, përveç faktit se parashtruesi i kërkesës përmendi shkelje të disa neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së në kërkesën e tij, është e mendimit se si shkelje parësore, parashtruesi i kërkesës thekson nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat ai i vë në lidhje me aplikimin e gabuar të dispozitave të caktuara të ligjit, si dhe mosmbajtjes së seancës dëgjimore në të cilën ishte zgjidhur çështja e pronës në fjalë. Sipas parashtruesit të kërkesës, një qëndrim i tillë i gjykatave të rregullta ishte i njëanshëm dhe i ndryshëm nga praktika gjyqësore (nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës) sepse ai nuk pati mbrojtje efektive juridike dhe gjyqësore (nenet 54 dhe 102 të Kushtetutës).

48. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se një pjesë e këtyre pretendimeve parashtuesi i kërkesës i ngre në nivelin e ligjshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ndërsa pjesën tjetër të pretendimeve ai i ngre dhe ndërtton në nivel të kushtetutshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
49. Prandaj, pikërisht për shkak të këtyre konstatimeve, Gjykata e sheh të nevojshme të ndajë pretendimet e parashtuesit të kërkesës në i) pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës në nivel të ligjshmërisë në lidhje me shkeljet kushtetuese; dhe ii) pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës në nivel të kushtetutshmërisë në lidhje me shkeljet kushtetuese.

i) pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës në nivelin e ligjshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

50. Sipas mendimit të Gjykatës, pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës në nivelin e ligjshmërisë me qëllim të ndërtimit të shkeljeve të pretenduara, janë pretendime që ai i lidh me faktin se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kanë shkelur dispozitat ligjore të nenit 4.7.1 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), se ata kanë aplikuar gabimisht nenin 40.1.3 të Ligjit, dhe gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike në lidhje me pronësinë e pronës në fjalë, që është kthyer e drejta e pronësisë pa mbështetje në bazë ligjore, për kthimin e paluajtshmërisë pasi që në Kosovë ende nuk ekziston Ligji për kthimin e pronave, që procedura ka vazhduar edhe pse paditësja nuk ka pasur legjitimitet aktiv, gjë që ka përshpejtuar përfundimin e procedurës në lidhje me pronën në fjalë.
51. Në mbështetje të shkeljeve të lartpërmendura, parashtuesi i kërkesës shton se, në procedurën e apelit në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, ai në mënyrë kronologjike tregoi të gjitha lëshimet e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, por që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk iu përgjigj asnjërit prej këtyre pretendimeve. E gjithë kjo, sipas parashtuesit të kërkesës, çoi në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
52. Më konkretisht, në lidhje me kategorinë e parë të pretendimeve, përkatësisht pretendimet në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale, Gjykata rikujton se gjithmonë ka theksuar se këto pretendime nuk janë në juridiksionin e Gjykatës dhe, prandaj, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, në

lidhje me këtë, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35, KI154/17 dhe 05/18 parashtrues të kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva* dhe *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"* Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, KI192/18, parashtrues *Kompania Kosovare për Distribuium dhe Furnizim me Energji, KEDS sh.a.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 49).

53. Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, KI154/17 dhe 05/18 parashtrues të kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva* dhe *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"* Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 61, KI192/18, parashtrues *Kompania Kosovare për Distribuium dhe Furnizim me Energji, KEDS sh.a.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 50).
54. Është detyrë e Gjykatës që të shqyrtojë procedurën në tërësi, që në rastin konkret përfshin edhe aktvendimin e gjykatave të apelit (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmerts kundër Suedisë* të 29 tetorit 1991, Seria A, nr. 212, faqja 15, paragrafi 31). Më tutje, nuk bie në kompetencën e GJEDNJ-së që në vend të vlerësimit vetanak të fakteve të merr përsipër interpretimin e gjykatës vendore, përderisa është rregull i përgjithshëm që gjykata vendore t'i vlerësojë dëshmitë të cilat i paraqiten asaj. Është detyrë e Gjykatës të konstatojë nëse procedura në tërësi ka qenë e drejtë, përfshirë edhe mënyrën e paraqitjes së dëshmive (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtrës nr. 79/1991/331-404, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, paragrafi 34).

55. Duke iu kthyer rastit konkret dhe kategorisë së parë të pretendimeve ankimore, Gjykata vëren se për parashtruesin e kërkesës ishte kontestues aplikimi i nenit 4.7.1 të Ligjit nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së. Gjykata rikujton nenin 4.7.1 të Ligjit:

“Neni 4 Juridiksioni

1. Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim

[...]

7.1 përmbajtja e asaj kërkesë, lënde, procedure apo rasti është brenda kompetencës ekskluzive të Dhomës së Posaçme, siç përcaktohet me paragrafin 1 të këtij neni; ose”

56. Në bazë të një shikimi të nenit 4 të Ligjit, Gjykata vëren se ai rregullon çështjen e kompetencës së Dhomës së Posaçme për t'u marrë me kërkesat në fjalë. Në pajtim me Ligjin, Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit përbëjnë një pjesë integrale të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të cilat si të tilla gjykojnë në dy instanca gjyqësore. Prandaj, Gjykata nuk e konteston çështjen e juridiksionit të Dhomës së Specializuar të DHPGJS-së, as të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për t'u marrë me këtë kërkesë. Për më tepër, Gjykata nuk konstatoi në kërkesë që në ndonjë fazë të procedurës, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar ose vënë në dyshim në ndonjë mënyrë juridiksionin e tyre, që vetvetiu çon në përfundimin se pretendimet për shkelje të nenit 4.7.1 të Ligjit, të cilin parashtruesi e sjell në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së janë të pabazuara.
57. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së kanë zbatuar gabimisht nenin 40, paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit. Në mbështetje të kësaj, ai përmendi se *“procedura me shkrim përfundon me dorëzimin e kundërpërgjigjes, ndërsa në rastin konkret, gjykata ka vendosur vetëm me padi dhe përgjigje në padi”*.
58. Gjykata rikujton se neni 40, paragrafi 1 pika 3 i Ligjit, thekson:

Neni 40 Kundërshtimet ndaj dëshmitarëve dhe ekspertëve

1. “Cilado palë mund të kundërshtojë të drejtën dhe kompetencën profesionale të ndonjë dëshmitari apo eksperti të propozuar, duke kërkuar nga gjyqtari(ët) të gjykojë për çështjen në fjalë apo të vazhdojë me ndalimin e dëshmitarit apo ekspertit nga dhënia e dëshmisë, ose plotësisht, ose pjesërisht për çështjen e veçantë.

[...]

3. Pala që paraqet kundërshtimin duhet të deklarojë arsyet e saj për kundërshtimin e tillë. Secila palë tjetër ka mundësinë për ta mbështetur apo për ta kundërshtuar dhe për të ofruar arsyet për qëndrimin e tyre; megjithatë, me kusht që kundërshtimi paraqitet gjatë zhvillimit të dëgjimit verbal dhe që kjo mundësi t'i jepet vetëm palëve që janë të pranishme gjatë seancës dëgjimore”.

59. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se, në kohën kur ishte paraqitur kërkesëpadia e paditësit për përcaktimin e së drejtës pronësore, parashtuesi i kërkesës, në rastin konkret, ka pasur mundësi të paraqet kundërshtimet e tij, si dhe argumentet dhe provat me të cilat ai kishte kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, edhe atë që nga momenti i procedurës së parë gjyqësore kur gjykatat kishin zgjidhur çështjen nëse kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme ishte e bazuar. Po kështu, parashtuesi i kërkesës në procedurën e ankesës, me rastin e vendosjes për masë të përkohshme, madje edhe gjatë procedurës së dytë gjyqësore, kur gjykatat vendosën për thelbin e padisë, pati mundësinë, dhe ajo që bëri ai ishte të paraqiste të gjitha argumentet dhe provat ankimore para gjykatave të instancës më të lartë, të cilat gjykatat i kanë shqyrtuar në mënyrë të detajuar.
60. Në lidhje me pretendimin e parashtuesit se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike në lidhje me pronësinë e pronës në fjalë, që është kthyer e drejta e pronësisë pa mbështetje në bazë ligjore, për kthimin e paluajtshmërisë pasi që në Kosovë ende nuk ekziston Ligji për kthimin e pronave, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së në Aktgjykimin AC-I-15-0212-A0001 arsyetoi: *“Nga provat e administruara nga Kolegji i Specializuar dhe të cilat janë në shkresat e lëndës, konfirmohet e këto prona kontestuese, asnjëherë nga viti 1957 nuk kanë qenë në emër të NSH-së, por në emrin e paraardhësit të paditëses dhe në emër të paditëses, Me ankesë AKP nuk ka ofruar asnjë provë shtesë që do të mund ta ndryshonte gjendjen faktike të vërtetuar nga Kolegji i Specializuar me aktgjykimin e ankimuar. Ajo gjithë arsyen e kundërshtimit e ka fokusuar në mosmbajtjen e seancës dëgjimore, pa dhënë asnjë argument që do të mund të rrëzonte provat e ofruara nga paditësja. Edhe pa mbajtjen e seancës dëgjimore, AKP-së, i është dhënë mundësia që të ofroj dëshmi dhe argumente shtesë që do të ishin në favor të saj, sepse ishte paralajmëruar se nuk do të mbahet seancë gjyqësore e konform ligjit, gjegjësisht nenit 34 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme. Të vetmen provë e që ishte edhe në dosje para Kolegjit të Specializuar, AKP ka përmend certifikatën e pronësisë e cila është në emër të NSH-së, por nuk dëshmoi se në çfarë baze kjo*

pronë kishte kaluar në emër të NSH-së, kur të gjitha provat dëshmojnë se kjo pronë gjithnjë ishte në emër të paditësës”.

61. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, në ankesën pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në procesin e vendosjes lidhur me kërkesën për masë të përkohshme kishte ngritur çështjen e legjitimitetit aktiv për parashtrimin e padisë nga paditësja, sepse nuk është dëshmuar se paditësja është trashëgimtare ligjore e paraardhësit të saj.
62. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përveç përgjigjeve të tjera nga ankesa, i kishte dhënë parashtruesit të kërkesës gjithashtu përgjigje në lidhje me çështjen e legjitimitetit aktiv. Me këtë rast, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konkludoi: *“Pretendimi ankimor i AKP-së se nuk është dëshmuar se paditësja është trashëgimtare ligjor i paraardhësit të saj, është i pabazuar, sepse nga provat në shkresat e lëndës, duket qartë se paditësja, Z. H. ka qenë pronare e këtyre pronave që nga viti 1957, ndërsa edhe padia është parashtruar nga vetë ajo”.*
63. Rrjedhimisht, Gjykata pretendon se pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës në lidhje me faktin se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk i ka shqyrtuar në mënyrë kronologjike dhe nuk i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të tij i gjen të pabazuara, nga kjo rrjedh se Gjykata në vendimet e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk kishte gjetur asgjë që do të çonte në konkludimin se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar ose arbitrare, duke çuar në përfundimin se nuk ka as shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në lidhje me pjesën e parë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

ii) pretendimet e ngritura nga parashtruesi në nivelin e kushtetutshmërisë në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

64. Sipas mendimit të Gjykatës, pretendimet e ngritura nga parashtruesi në nivelin e kushtetutshmërisë me qëllim të ndërtimit të shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë pretendime që ai i sjell në lidhje me faktin se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së kanë nxjerrë aktgjykime me të cilat kanë zgjidhur çështjen e pronës në fjalë, megjithëse nuk ka pasur seancë publike.

65. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se “e drejta për seancë publike” si një nga elementët e së drejtës për një gjykim të drejtë nënkupton të drejtën e një pale të jetë e pranishme në gjykatë. Më konkretisht, koncepti i një gjykimi të drejtë kërkon që të zhvillohet e ashtuquajtura procedurë shqyrtuese kur palët në procedurën kontestimore kanë të drejtë të dinë dhe të paraqesin komente lidhur me opinionet ose provat e paraqitura nga pala tjetër. Në procedurën penale, respektimi i këtij parimi nënkupton që të dyja palët, edhe prokurori edhe mbrojtja duhet të jenë në gjendje të kenë njohuri të plotë dhe japin mendime dhe komente lidhur parashtrësas dhe provat e palës kundërshtare (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Brandstetter kundër Austrisë*, kërkesa nr. 11170/84, 112876/87 13468/87 e 28 gushtit 1991, Aktgjykimin *Bricmont kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 10857/84, e 7 korrikut 1989).
66. Kur bëhet fjalë për këtë element, kjo e drejtë do të thotë që parashtruesi i kërkesës duhet të marrë pjesë personalisht në seancë. Duhet të theksohet se praktika e GJEDNJ-së në bazë të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së nuk bën ndonjë ndryshim domethënës midis rasteve kur parashtruesi nuk ishte personalisht i pranishëm, por përfaqësohej përmes avokatit të tij, dhe atyre rasteve në të cilat në gjykatat e brendshme procedura u zhvillua në bazë të provave me shkrim pa dëgjuar përfaqësuesit e palëve. Në kontekstin e të drejtës për një dëgjim publik, GJEDNJ vuri theksin në dallimin midis rasteve në të cilat parashtruesi ishte në gjendje të merr pjesë në seancë personalisht dhe në ato ku ai nuk kishte një mundësi të tillë. Megjithëse prania e një avokati në gjykatë mund të jetë e rëndësishme në kontekstin e shkeljes të disa të drejtave të tjera të garantuara me nenin 6 (siç janë të drejtat e garantuara në pikat (b) dhe (c) të paragrafit 3), në qendër të vëmendjes sipas nenit 6 paragrafi 1 duhet të jetë prania personale e parashtruesit të kërkesës në gjykatë (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Göç kundër Turqisë*, kërkesa nr. 36590/97, e 11 korrikut 2002).
67. Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se, si koncept i nenit 6 të Konventës, GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore, ka konstatuar se është gjithashtu e mundur të heqësh dorë nga shumica e të drejtave sipas nenit 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht edhe nga e drejta për një dëgjim publik. Në rastin *Poitrinol kundër Francës*, GJEDNJ konsideroi se një person mund të heqë dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë, qoftë në kontest penal apo civil. Megjithatë, kjo heqje dorë duhet të jetë e qartë dhe duhet të respektohen masat minimale mbrojtëse të përshtatshme për rëndësinë e atij akti (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Poitrinol kundër Francës*, kërkesa nr. 14032/88 e 23 nëntorit 1993).

68. Në këtë kontekst, Gjykata dëshiron të shtojë se e drejta për të marrë pjesë në një shqyrtim nuk nënkupton edhe detyrimin e autoriteteve për të sjellë palët në gjykim nëse ato vetë nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të marrë pjesë në procedurë (shih *mutatis mutandis* Aktgjykimin e GJEDNJ-së në *Nunes Dias kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13 të 6 nëntorit 2018). Autoritetet janë të obliguara t'i njoftojnë ato për seancat e ardhshme; megjithatë, neni 6 nuk u jep palëve në kontest të drejtën automatike që gjykata në mënyrë të veçantë t'i detyrojë të marrin pjesë në procedurë. (shih *Nikolay Bogonos kundër Rusisë*, kërkesa nr. 68798/01, e 5 shkurtit 2004).
69. Duke marrë parasysh pretendimin konkret të parashtruesit të kërkesës për mosmbajtjen e seancës publike sipas parimeve të lartpërmendura të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, në procedurën para mbajtjes së seancës shqyrtuese sipas kërkesëpadisë për përcaktimin e të drejtave pronësore, nxori urdhrin C-II-14-0140-C0001, në të cilin njoftoi palët në procedurë se ai vetë nuk do të vazhdojë të mbledhë prova në rastin konkret. Për më tepër, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ftoi palët të paraqesin parashtrësia, argumente ose kërkesa shtesë në këtë fazë të procedurës brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.
70. Gjykata vëren se një qëndrim të tillë Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e mori për arsye se palët në procedurë (paditësi dhe parashtruesi i kërkesës) i kishin ofruar atij prova dhe argumente para fillimit të procedurës së parë gjyqësore, përkatësisht para se ai kishte vendosur lidhur me kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme, të cilat, si të tilla, ishin të mjaftueshme për të vendosur edhe për çështjen e padisë për përcaktimin e të drejtave pronësore.
71. Më konkretisht, në padinë e tij për përcaktimin e të drejtave pronësore, paditësi solli prova me të cilat mbështeti pretendimet e tij se atij si pronar i pronës në fjalë, i takojnë gjithashtu të drejtat pronësore mbi pronën në fjalë.
72. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës në cilësi të palës së paditur parashtrroi përgjigje në padi, me të cilën u përpoq të kontestojë kërkesëpadinë e paditësit, duke përmendur ndër të tjera çështjen e legjitimitetit të të paditurës si dhe çështjen e pronësisë së pronës në fjalë.
73. Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke pasur parasysh se brenda afatit të caktuar palët nuk paraqitën argumente

plotësuese, prova ose kërkesë për mbajtjen e një seance dëgjimore, lëshoi një urdhër të ri C-II-14-0140-C0001, duke njoftuar palët që *“pasi përcakton që në procedurën, nuk ka çështje në kontest për t’u sqaruar më tej për sa i përket fakteve materiale të nevojshme për të vendosur në lëndën ose çështjen në fjalë, Paneli i Specializuar II vendos të çlirojë procedurën nga mbledhja e provave të mëtejshme”*.

74. Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, ka marrë një qëndrim të tillë në bazë të neneve 34.3 dhe 5 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS, që parashohin:

Neni 34 Raporti paraprak i gjyqtarit të vetëm

[...]

3. Në bazë të raportit paraprak, Kolegji i Specializuar mund të vendosë që të heqë dorë nga mbledhja e provave nëse vlerëson që nuk ka ndonjë kontest të mirëfilltë mes fakteve materiale e që janë të domosdoshme për të vendosur mbi atë lëndë apo çështje në fjalë.

[...]

5. Nëse vendimi për të hequr dorë nga mbledhja e provave është marrë në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, atëherë dispozitat e nenit 11 të kësaj shtojce nuk do të zbatohen për lëndën apo rastin që i nënshtrohen një urdhri të tillë”.

75. Sipas mendimit të kësaj gjykate, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së duke njoftuar palët në procedurë që, brenda afatit të përcaktuar se ato mund të dorëzojnë prova të reja ose të paraqesin argumente të reja, si dhe pasojat e mundshme ligjore që mund të paraqiten nëse nuk e bëjnë këtë, ka përmbushur detyrimet ligjore ndaj palëve në procedurë.
76. Pikërisht parashtuesi i kërkesës si palë që pretendon dhe pohon se ka të drejtën pronësore mbi pronën në fjalë, duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore të parapara me ligj, të cilat do t’i mundësonin që ato të arsyetohen dhe argumentohen në detaje në gjykatë, në të vërtetë parashtuesi i kërkesës duhet që para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të merr pjesë aktive në vetë procedurë.
77. Gjykata dëshiron të theksojë se pjesëmarrja aktive e palëve në procedurë është një tjetër element i së drejtës për një dëgjim publik, që nënkupton se një person kundër të cilit është parashtuar padi në një kontest civil duhet, jo vetëm të jetë i pranishëm në gjykatë, por përveç kësaj ky person duhet të jetë në gjendje të marrë pjesë në mënyrë aktive në procedurë pa kufizime.

78. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se pikërisht parashtruesi i kërkesës ka vepruar në kundërshtim me këtë parim duke mos u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar ndaj urdhrit të autoriteteve kompetente dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme nga të cilat ndoshta do të varej edhe rrjedha dhe vetë rezultati i procedurës gjyqësore. Mungesa e veprimit të tij në procedurë nuk është paraqitur si rezultat i disa kufizimeve ose ndalimeve nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së. Në fakt, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, sipas shkresave të lëndës, bëri përpjekje të mjaftueshme dhe i mundësoi parashtruesit të marrë pjesë aktive në procedurë. Megjithatë, parimi për të marrë pjesë në një shqyrtim publik gjithashtu nuk nënkupton një detyrim të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së për të sjellë fizikisht palët në gjykim nëse ato vetë nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të marrë pjesë në procedurë (shih vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Nunes Dias kundër Portugalisë*).
79. Në dritën e sa më sipër, Gjykata nuk mund të mos paraqesë edhe vërejtjet e saj, dhe ajo është se parashtruesi i kërkesës në supozimin se brenda afatit të caktuar ka paraqitur prova të reja, argumente ose kërkesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së për të mbajtur një dëgjim publik, që do ta mbështeste me argumente dhe prova të vlefshme, mund të rezultojë, që Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e sheh të nevojshme, në bazë të tyre, të thërrasë një seancë publike, ku e paditura dhe paditësi do të kishin mundësinë që para gjykatës të paraqesin dhe shkëmbejnë edhe gojarisht argumente.
80. Me një veprim të tillë joaktiv, parashtruesi gjithashtu edhe në aspektin formal “*vullnetarisht ka hequr dorë nga e drejta*” për një seancë dëgjimore publike si një segment i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
81. Duke pasur parasysh praktikën e sipërpërmendur të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së respektoi “*masat mbrojtëse minimale*” të kërkuara me praktikën gjyqësore e GJEDNJ-së (shih rastin e sipërpërmendur *Poitrimol kundër Francës*). Përveç kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë në veçanti se nuk është obligim i gjykatave të rregullta të bëjnë “*përpjekje të veçantë*” për të detyruar një palë të marrë një pjesë aktive në procedurë ose t'i sjellë ata të jenë të pranishëm gjatë gjykimit, një vendim i tillë i lihet vetë palës që ta marrë (shih rastin e lartpërmendur *Nikolay Bogonos kundër Rusisë*).
82. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se *Kolegji i ankesave i DHPGJS-së në procedurën e ankesës ka vendosur në shkelje të nenit 7, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,*

me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë vlerat e shoqërisë duke i respektuar parimin e barazisë, pa cenuar të drejtat dhe liritë e njeriut dhe sundimin e ligjit, pa dhënë ndonjë shpjegim dhe provë konkrete për të justifikuar pretendimet e tij.

83. Për më tepër, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, në arsyetimin e aktgjykimit, ka dhënë shpjegime të hollësishme lidhur me të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Nga kjo rrjedh se edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë gjithashtu të pabazuara.
84. Gjykata në bazë të analizës, si të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me çështjen e ligjshmërisë, po ashtu dhe pretendimeve që kanë të bëjnë me çështjen e kushtetutshmërisë, nuk ka gjetur se procedurat në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare për ta bindur Gjykatën Kushtetuese që parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar ndonjë garanci procedurale, e cila do të cenonte të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka as shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së të cilat parashtruesi i kishte theksuar në kërkesë.
85. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij dhe të paraqesë prova *prima facie* për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ-së. (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
86. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

87. Gjykata rikujton që parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, “*në mënyrë që të parandalojë tjetërsimin, shpërndarjen ose ngarkimin ligjor të pronës në fjalë*”.
88. Megjithatë, Gjykata sapo konkludoi që kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.

89. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, pasi e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit pasi kërkesa u shpall e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI158/19, Parashtrues: Fatos Dervishaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosveprimeve të autoriteteve publike në lidhje me kërkesat e parashtruesit të kërkesës

KI158/19 Aktvendim për papranueshmëri, i 10 qershor 2020, publikuar më 24 korrik 2020

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mosndërmarrja e veprimeve e autoriteteve publike, barazia para ligjit, mjetet efektive juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës, kërkesë e papranueshme

Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kontestoi kushtetutshmërinë e mosveprimeve të autoriteteve publike, përkatësisht të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurorisë së Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Supreme, në lidhje me kërkesat e tij për paraqitjen e kallëzimit penal, përjashtimin e prokurores M.LL. dhe përgjegjësitë disiplinore të prokurorëve, dërgimin e lëndës në kompetencë të Prokurorisë Speciale dhe heshtjeve administrative të këtyre autoriteteve.

Gjykata, pasi vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje kallëzimin penal, konsideroi se kërkesa e tij sa i përket këtij pretendimi duhej shpallur e pasafatshme pasi qe nga dita e pranimi të vendimit të fundit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë kishin kaluar me tepër se katër (4) muaj deri në parashtrimin e kërkesës. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e prokurores së rasti M.LL. dhe përgjegjësiive disiplinore të prokuroreve, Gjykata konstatoi se nuk qëndronte fakti që autoritetet publike nuk kanë vepruar sepse të gjitha shkresave të tij iu ishin përgjigjur si Prokurori Themelor në Prishtinë ashtu edhe Gjykata Supreme. Përkitazi me pretendimin se autoritetet publike nuk e kishin dërguar lëndën penale [PP.nr.65/17] për trajtim në Prokurorinë Speciale, Gjykata konsideroi se çështja e dërgimit të lëndës penale në fjalë në kompetencë të Prokurorisë Speciale për trajtim, ishte në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Tutje, Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, verëjti se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për dërgimin e lëndës penale [PP. nr. 65/17] në kompetencë të Prokurorisë Speciale, bazohej thjeshtë në dyshimin e tij se prokurorja M.LL., e cila ishte e ngarkuar me lëndën, po e zvarriste zhvillimin e hetimeve dhe ngritjen e aktakuzës ndaj të dyshuarve M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-SH. Për me tepër, në lidhje me këtë pretendim parashtruesi i kërkesës pretendonte shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe Gjykata vërejti se ai vetëm i është referuar diskriminimit, duke mos shpjeguar se si kishte ardhur deri tek shkelja e kësaj të drejte, duke mos shpjeguar se çfarë ishte *"trajtimi i ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional, i personave në situata relativisht të ngjashme"*. Tutje, parashtruesi

i kërkesës ankohej edhe për mosveprimet e Avokatit të Popullit, duke pretenduar në shkelje të nenit 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenit 45 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata, pasi vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën e zhvilluar pranë Avokatit të Popullit, gjeti se nenet 54 dhe 132 të Kushtetutës nuk janë nene që në vete përmbajnë një të drejtë ose liri. Të dy nenet e mësipërme nuk janë pra nene që mund të interpretohen në mënyrë të pavarur nga dispozitat e tjera kushtetuese, të rëndësishme për këtë çështje. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohej shkeljes së nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike], por nuk arsyetoi në asnjë mënyrë se nga çfarë mjeti juridik ishte privuar dhe kundër cilit vendim ai nuk pati mundësinë të paraqiste ndonjë mjet juridik, por i ndërlidhi të njëjtat pretendime me nenin 45 të KEDNJ-së, ku Gjykata konstatoi se neni 45 i KEDNJ-së, i cili bën pjesë në Titullin II [Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] të KEDNJ-së, nuk mund të shërbejë si bazë për të ngritur një pretendim për shkelje të të drejtave të garantuara me KEDNJ para Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se ky nen i referohet kompetencave të GJEDNJ-së përkitazi me procedurat e vendimmarrjes dhe jo kompetencave të gjykatave vendore, pjesë anëtare të mekanizmit mbrojtës të garantuar me KEDNJ (shih, ngjashëm Gjykata Kushtetuese, rasti KI108/18, parashtrues: *Blerta Morina*, Aktvendimi për papranueshmeri, i 5 shtatorit 2019, paragrafi 195).

Si përfundim, Gjykata në pajtueshmëri me nenet 20 dhe 49 të Ligjit, dhe rregullave 39 (1) (c), 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, vendosi të shpallë kërkesën e parashtruesit të kërkesës të papranueshme në të gjitha pjesët e saj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI158/19

Parashtrues

Fatos Dervishaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosveprimeve
të autoriteteve publike në lidhje me kërkesat e parashtruesit të
kërkesës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyhtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatos Dervishaj (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e mosveprimit të autoriteteve publike, përkatësisht të Prokurorisë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: PThP), Prokurorisë së Shtetit (në tekstin e mëtejshëm: PSh), Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK), Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Supreme, në lidhje me kërkesat e tij për paraqitjen e kallëzimit penal, përjashtimin e prokurorës M.LL. dhe përgjegjësitë disiplinore të prokurorëve, dërgimin e lëndës në kompetencë të Prokurorisë Speciale dhe heshtjeve administrative të këtyre autoriteteve.

Objekti i çështje

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosveprimeve dhe akteve të autoriteteve publike të sipërcekura, duke pretenduar se te njëjtat mohuan të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e te Drejtave] dhe 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 45 (Arsyetimi i vendimeve) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përberë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 26 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet postes elektronike kërkoi nga Gjykata të marrë në shqyrtim Njoftimin e Gjykatës Supreme të 4 shtatorit 2019.
8. Më 8 tetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI158/19.
9. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet postes elektronike kërkoi nga Gjykata që të njoftohet për çdo shkresë të dorëzuar nga palët kundërshtare.

10. Më 25 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës serish dorëzoi informata shtesë në Gjykatë. Specifikisht, ai kërkoi nga Gjykata që ta shqyrtojë edhe Vendimin e Avokatit të Popullit nr. 2033/2019, të 20 nëntorit 2019.
11. Më 26 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që kërkesa e tij të trajtohet me interes publik.
12. Më 20 dhjetor 2019, Gjykata në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës njoftoi Avokatin e Popullit, KPK-në, Prokurorinë e Shtetit dhe Gjykatën Supreme. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të informohet lidhur me komentet ose përgjigjet e palëve kundërshtare dhe të mos i trajtojë ato nëse janë parashtruar jashtë afatit ligjor.
13. Më 23 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e plotësoi kërkesën e tij me argumente shtesë.
14. Më 10 qershor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesi i kërkesës është duke parashtruar për herë të dytë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Më parë, ai kishte dorëzuar kërkesën KI19/17 për të cilën Gjykata me Aktvendimin e 20 shkurtit 2018, vendosi ta deklarojë të njëjtën të papranueshme. Faktet juridike të kërkesës KI19/17 nuk ndërlidhen me kërkesën e parashtruar tani, e cila është regjistruar me numër KI158/19.
16. Në rastin KI158/19, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar një numër të madh të procedurave para autoriteteve të ndryshme publike, andaj, gjendja faktike do të paraqitet për secilin autoritet publik veç e veç.

Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën kontestimore

17. Më 29 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë me të cilën e paditi ndërmarrjen “Wurth Kosova” sh.p.k., nga shkaku se ndërmarrja në fjalë kishte larguar nga puna parashtruesin e kërkesës dhe 20 punëtorë të tjerë të së njëjtës ndërmarrje.
18. Më 5 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit C. nr. 428/12 e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar.

19. Më 30 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 428/12.
20. Më 31 tetor 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ca. nr. 858/2016, aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 428/12 dhe e ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore.
21. Më 20 qershor 2017, Gjykata Themelore në riprocedurë nxori Aktgjykimin C. nr. 189/17, me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
22. Më 14 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 189/17, të 20 qershorit 2017.
23. Parashtruesi i kërkesës nuk ofron prova nëse Gjykata e Apelit kishte vendosur për këtë ankesë të tij.

Përmbledhja e fakteve lidhur me kallëzimin penal

24. Më 19 maj 2017, parashtruesi i kërkesës lidhur me provat e administruara në lëndën civile C. nr. 189/17, paraqiti kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: PThP), për shkak të dyshimit se një numër më i madh i personave, dhe atë: M.G., V.I., D.R., M.B., N.H. dhe G.X., kishin kryer veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së dhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 434 i KPRK-së. Parashtruesi i kërkesës në kallëzimin penal theksoi se në bazë të dokumenteve zyrtare të falsifikuara, ai është larguar nga puna dhe kishte humbur kontestin juridik për kthimin në vendin e punës.
25. Më 1 qershor 2017, PThP autorizoi Policinë e Kosovës për grumbullimin e informatave lidhur me kallëzimin penal, ashtu që do të dëgjojë parashtruesin e këtij kallëzimi penal, duke urdhëruar që:

“Pas marrjes së kësaj deklarate nga Fatos Dervishaj, dhe verifikimit dhe sigurimit të provave të duhura, dhe pas analizës së tyre, sipas nevojës të ndërmerren masa hetimore dhe në një afat të arsyeshëm të na njoftoni me shkrim për të gjitha procedurat e ndërmarra.”

26. Më 14 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në PThP plotësimin e kallëzimit penal, duke kërkuar që përveç personave M.G., V.I., D.R., M.B., N.H. dhe G.X., që tashmë janë të përfshirë me kallëzimin penal të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës më 19 maj 2017, procedura penale të zgjerohet edhe ndaj gjyqtarës së instancës së parë S.B-Sh., për shkak të dyshimit për keqpërdorim të detyrës zyrtare.
27. Më 13 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti përsëri një plotësim të ri të kallëzimit penal në PThP, duke kërkuar që të gjithë personat që janë dyshuar më parë, M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-SH., përveç veprave penale të mëparshme, të ngarkohen edhe me veprën penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 i KPRK-së.
28. Më 9 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti në PThP kërkesë për shqyrtim të shpejtë të lëndës [PP. nr. 65/2017], për shkak të rrezikut të parashkrimit, duke kërkuar nga prokuroria që: *“...të bëjë administrimin e të gjitha provave, përfshirë edhe procesverbalet e datës 05.11.2015, datës 17.05.2017, Aktgjykimet: C. nr. 428/12 dhe C. nr. 189/17, të të pandehurit t'i akuzojë në gjykatë dhe të dënohen sipas ligjit”*.
29. Më 4 maj 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit PPN. nr. 66/18, informoi parashtruesin e kërkesës se nga Kryeprokurori i PThP-së është njoftuar se prokurorja e rastit M.LL., më 1 qershor 2017, ka autorizuar organet e hetuesisë për të grumbulluar informata rreth të dyshuarve dhe se kjo çështje është duke u trajtuar.
30. Më 30 tetor 2018, PThP autorizoi Policinë e Kosovës që me qëllim të kompletimit të gjithmbarshëm të këtij rasti në lidhje me gjendjen e fakteve të prezantuara në këtë kallëzim penal t'i intervistojë të dyshuarit M.G., V.I., D.R., M.B., N.H. dhe G.X., për shkak të dyshimit të kryerjes së veprave penale nga nenet 422 dhe 434 të KPRK-së.
31. Më 25 janar 2019, parashtruesi i kërkesës i drejtohet me ankesë Kryeprokurorit të PThP-së, përmes se cilës kërkoj ndërmarrjen e masave dhe vazhdimin e hetimeve penale kundër M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X., dhe S.B-Sh., sipas KPRK-së dhe KPPRK-së.
32. Më 28 shkurt 2019, prokurorja e rastit e njoftoi (PP. I. nr. 65/17) parashtruesin e kërkesës se: *“Konform nenit 82 par.3. të KPPRK-së ju njoftojmë se kjo Prokurori ka hedhur poshtë kallëzimin penal të ushtruar kundër: M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-Sh., në drejtim të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1. i KPRK, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 të KPRK-së, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve*

gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, Manipulimi me prova nga neni 397 të KPRK-së, kjo nga shkak se edhe pas ndërmarrjes se të gjitha veprimeve hetimore në drejtim të ndriçimit të plotë të kësaj çështjeje penale me ç'rast ju keni ushtruar kallëzim penal, me asnjë prove nuk kemi arritur që të argumentojmë se të lartcekurit janë kryes të këtyre veprave penale”.

33. Më 4 mars 2019, parashtruesi i kërkesës, kundër njoftimit PP. I. 65/17 të 28 shkurtit 2019, nëpërmjet postes elektronike, kërkoi nga KPK-ja dhe Prokuroria e shtetit shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë; prishjen e Vendimit të 28 shkurtit 2019, me të cilin prokurorja e kishte hedhur poshtë kallëzimin penal si të pabazuar; delegimin e çështjes në Prokurorinë Speciale të Kosovës; si dhe, që pas shqyrtimit të lëndës, të ngritët aktakuza kundër personave të lartcekur; si dhe kërkoi dënimin e tyre sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesën e parashtruesit për përjashtim të prokurorit dhe kërkesën për përgjegjësi disiplinore të prokurorit

34. Më 26 mars 2018, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ndërmarrjen e masave kundër prokurores së rastit M.LL., duke kërkuar përjashtimin e saj nga lënda penale, sipas kallëzimit penal [PP. nr. 65/17] dhe fillimin hapjen e procedurës së përgjegjësisë disiplinore kundër saj, për shkak të dyshimit se e njëjta po e zvarriste shqyrtimin e fillimin e hetimeve dhe ngritjen e aktakuzës penale kundër të dyshuarve siç janë përmendur me sipër.
35. Më 18 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që ankesa e tij të shqyrtohet në pajtim me nenin 15, paragrafi 3, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për shkak të heshtjes së PThP-së dhe KPK-së, nga të cilët kishte kërkuar ndërmarrjen e masave për përjashtimin e prokurores së rastit M.LL., dhe dërgimin e lëndës për trajtim në kompetencë të Prokurorinë Speciale.
36. Më 13 shkurt 2019, Kryetari i Gjykatës Supreme, duke iu përgjigjur ankesës së parashtruesit të kërkesës, të 18 janarit 2019, e njofton atë se Gjykata Supreme “Pas analizimit të pretendimeve në lidhje me sjelljen e papërshtatshme të mundshme, ne kemi konstatuar se në këtë fazë ne nuk jemi një organ i autorizuar për të shqyrtuar pretendimet tuaja, dhe në përputhje me nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më 13 shkurt 2019 ne e kemi dërguar atë në kompetencë

të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë si një autoritet i autorizuar për procedim të mëtejshëm”.

37. Më 16 korrik 2019, Kryeprokurori i PThP-së, njofton Kryetarin e Gjykatës Supreme se më 13 shkurt 2019 e ka pranuar shkresën e tij lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte ushtruar kundër prokurores M.LL., dhe pasi e ka trajtuar atë me kujdes, arrin të konstatojë se nuk ka bazë të mjaftueshme për hapjen e procedurës disiplinore kundër prokurores në fjalë.
38. Më 23 korrik 2019, PThP-ja me njoftimin AD. nr. 04/19, informon parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij për përjashtimin e prokurores M.LL., dhe fillimin e procedurës në lidhje me përgjegjësitë disiplinore të prokurores është refuzuar si e pabazuar. Përveç kësaj, në letër është shkruar: *“Pretendimet dhe pakënaqësitë nga parashtrësja, që kanë të bëjnë me procesin e vendimmarrjes mund ti dërgoni në kompetencë, në Komisionin për shqyrtim të performancës së prokuroreve në Këshillin Prokurorial të Kosovës”.*
39. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës, kundër njoftimit në fjalë, parashtrroi ankesë në KPK, përmes së cilës kërkoi: *“...që brenda afatit ligjor të bëjë shqyrtimin e këtyre 6 pikave (të marrë parasysht dhe shkresat tjera të dërguara më herët në KPK, për të njëjtën çështje) dhe të marrë një vendim merit-origjor”.*
40. Më 26 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës, për shkak të heshtjes së KPK-së në lidhje me ankesën e tij të 23 korrikut 2019, i drejtohet serish me ankesë Gjykatës Supreme, duke kërkuar: *“...që kjo gjykatë, brenda afatit ligjor, të bëjë shqyrtimin në detaje të këtyre 6 pikave (të merre parasysht dhe shkresat tjera të dërguara më herët në Gjykatën Supreme, për të njëjtën çështje me datë 18.01.2019, duke përfshirë edhe Shqyrtimin për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë dt. 04.03.2019 drejtuar KPK), dhe Gjykata Supreme të merre një vendim merit-origjor”.*
41. Më 4 shtator 2019, Gjykata Supreme, nëpërmjet postes elektronike, njofton parashtruesin e kërkesës si ne vijim: *“Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj të pranuar përmes postes elektronike me datë 26.08.2019, me të cilën Ju jeni ankuar në lidhje me heshtjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK ndaj ankesës tuaj të datës 23.07.2019, kemi konstatuar se, bazuar në ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve nr. 06/L-057, Neni 12, pika 3 dhe Neni 15 pika 1 - “Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës”, dhe Nenit 15 pika 3 - “si dhe ne rastet e parapara me nenin 12 par. 3 të këtij*

Ligji, Avokati i Popullit, mund të ushtrojnë ankese pranë Gjykatës Supreme për mosveprimin nga ana e Këshillit përkatës", në rastin konkret ankesa juaj nuk është e drejtuar ndaj një Vendimi disiplinor të Këshillit përkatës, dhe se ju si palë nuk jeni kompetent të ushtroni ankesë ndaj mosveprimit nga ana e Këshillit përkatës, andaj ju njoftojmë se ankesa juaj për Gjykatën Supreme nuk paraqet bazë lëndore për trajtim".

Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesën e parashtruesit për dërgimin e lëndës penale në kompetencë të Prokurorisë Speciale

42. Më 14 maj 2018, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga KPK-ja që lënda [PP. nr. 65/17], sipas kallëzimit penal të parashtruesit të kërkesës, të bartet në kompetencë të Prokurorisë Speciale, për trajtim të mëtejshëm.
43. Më 16 maj 2018, parashtruesi i kërkesës e dërgoi të njëjtën kërkesë edhe në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke kërkuar që lënda [PP. nr. 65/17], sipas kallëzimit penal të parashtruesit të kërkesës, të bartet në kompetencë të Prokurorisë Speciale, për trajtim të mëtejshëm.
44. Më 21 maj 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit PPN. nr. 66/18, informon parashtruesin e kërkesës se: *"...nuk jemi kompetent të vendosim qe një rast të dërgohet në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, këtë mund ta bëjë vetëm prokurori i ngarkuar me rast, në pajtim me kryeprokurorin e vet, ndërsa vlerësimin përfundimtar e bënë Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës."* Për këtë arsye, ne i kemi dërguar kërkesën tuaj Prokurorit të çështjes me një kërkesë për të vlerësuar nëse janë përmbushur kushtet për dërgimin e çështjes në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës".
45. Më 12 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës i drejtohet me kërkesë Kryeprokurorit të PThP-së, nga i cili kërkon: *"...që bazuar në dispozita ligjore dhe udhëzime administrative, të shqyrtojnë këtë Kërkesë, dhe brenda një afati të arsyeshëm ligjor, të Aprovojnë kërkesën, që lënda PP. nr. 65/2017, të bartet në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës"*.
46. Më 4 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përmes së cilës kërkoj edhe më tej që lënda [PP. nr. 65/17], sipas kallëzimit penal të parashtruesit të kërkesës, të dërgohet në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për trajtim të mëtejshëm.

Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesat e parashtruesit të drejtuar Avokatit të Popullit

47. Më 26 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë pranë Avokatit të Popullit, nga i cili kërkoi që i njëjti të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme, për shkak të heshtjes administrative dhe mos ndërmarrjes së veprimeve nga Kryeprokurori i PThP-së dhe KPK-ja, prej të cilëve kishte kërkuar përjashtimin e prokurores se çështjes M.LL. dhe dërgimin e lëndës [PP. nr. 65/17] për trajtim në Prokurorinë Speciale.
48. Më 12 shkurt 2019, Avokati i Popullit, nxori Vendimin A. nr. 926/208, dhe pas shqyrtimit të ankesës, ndërmori veprimet, si në vijim: *“Me 16 janar 2019, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi prokuroren e ngarkuar me lëndën e ankuesit. Qëllimi i takimit ishte që të merrte informata për fazën në të cilën ndodhej procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që janë ndërmarrë apo që do të ndërmerren nga Prokuroria, në mënyrë që rasti i ankuesit të procedohet brenda afatit kohor, në pajtim me Ligjin. Prokurorja njoftoi se rastin është duke e trajtuar sipas procedurave ligjore dhe për veprimet e saj prezantoi shkresat e lëndës. Më 16 janar 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi ankuesin dhe e njoftoi për takimin me prokurën e rastit të tij. Po ashtu, ankuesi është njoftuar se kërkesa e tij është jashtë kompetencës së Avokatit të Popullit. Duke marrë parasysh rrethanat e paraqitura më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 21, paragrafi 1.3, nënparagrafi 1.3.1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka vendosur t'i ndërpresë hetimet përkitazi me çështjen e lartpërmendur”.*
49. Më 3 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës ushtroi sërish ankesën (nr. 672/2019) pranë Avokatit të Popullit, kundër PThP-së dhe KPK-së. Thelbi i ankesës kishte të bënte me mos ndërmarrjen e veprimeve nga të lartcekurat si dhe heshtjen e kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Për me tepër, nga Avokati i Popullit parashtruesi kërkoi që ky rast të trajtohet në përputhje me Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
50. Më 13 shtator 2019, Avokati i Popullit, nëpërmjet postes elektronike, njofton parashtruesin e kërkesës, si me poshtë: *“Ju njoftojmë se kemi pranuar ankesën tuaj të cilën e kemi evidentuar me nr. 672 12019, dhe i kemi shqyrtuar me kujdes pretendimet tuaja ankimore. Ankesa juaj nuk mund të trajtohet në përputhje me Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, për faktin se konsiderojmë që i tejkalon kompetencat e Avokatit të Popullit në këtë ligj. Po ashtu, ky ligj edhe sa i përket çështjes së vendosjes e*

konsideron vendimin e kryeprokurorit si vendim të formës së prerë dhe ligji nuk jep të drejtë ankese, përveç në raste tjera të specifikuara. Në kuptimin e mirë administrimit, Avokati i Popullit do të kërkojë nga Këshilli Prokurorial të njoftohet për arsyet pse nuk keni pranuar përgjigje (cilado qofte ajo) për pretendimet tuaj dhe ju do të mbaheni të informuar në lidhje me këtë”.

51. Më 25 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se më 22 nëntor 2019 e pranoi nga Avokati i Popullit, Vendimin nr. 2033/2019, të nxjerrë më 20 nëntor 2019, i cili thotë:

“Pas analizimit të ankesës, me 13 shtator 2019, nëpërmjet postes elektronike zyrtare, z. Dervishaj u njoftua se ankesa lidhur me Vendimin AD. nr. 04/19, e pranuar nga PThP-ja, nuk mund të trajtohet në përputhje me Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, ngase i tejkalon kompetencat e Avokatit të Popullit, bazuar në këtë ligj, për arsye se e konsideron vendimin e kryeprokurorit si vendim të formës së prerë, përveç në rastet e tjera të specifikuara dhe kur Ligji nuk jep të drejtë ankese. Ndërsa lidhur me pretendimet për heshtje, z. Dervishaj u njoftua se, në kuptimin e miradministrimit, do ta kontaktojë autoritetin përgjegjës për të marrë informata lidhur me rastin e ankuesit.

Më 13 shtator 2019, z. Dervishaj, nëpërmjet postes elektronike, shprehu pakënaqësinë duke mos u pajtuar me qëndrimin e Avokatit të Popullit dhe theksoi se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shkeljet procedurale të PThP-së dhe të Avokatit të Popullit, duke u përcaktuar në këtë mënyrë në rrugën të cilën do ta ndjekë.

Duke pasur parasysh rrethanat e paraqitura më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka vendosur t'i ndërpresë hetimet lidhur me çështjen e lartpërmendur.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të mosveprimit të autoriteteve publike (Prokurorit Themelor, Kryeprokurorit të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Supreme) sipas kërkesave të parashtruesit të kërkesës për paraqitjen e kallëzimit penal ndaj disa individëve; përjashtimin e prokurores së rastit M.L.L.; përgjegjësitë disiplinore të prokuroreëve, ka pasur shkelje procedurale me të cilat atij i janë mohuar të drejtat e tij kushtetuese si në vijim:

- i. Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, sepse ai është diskriminuar për arsye të mostrajtimimit të ankesave dhe kërkesave të tij për përjashtimin e prokurores së rastit dhe mos dërgimin e lëndës së tij për trajtim në Prokurorinë Speciale nga ana e Kryeprokurorit të shtetit, KPK-ja dhe PThP-ja;
- ii. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës, sepse: *“Autoritetet kompetente të cilat janë ligjërish të thirrura dhe obliguara të veprojnë sipas dispozitave ligjore, derisa ata duke mos vepruar fare, siç është Heshtja e Këshillit Prokurorial dhe mosveprimi i Avokati të Popullit, që rastin ta shqyrton dhe nxjerrë një Vendim të Arsjetuar, dhe rastin ta dërgoj në Gjykatën Supreme. Fakt, që me këtë shkelje Procedurale, veprim-mosveprim, nuk është mundësuar, që lënda të shqyrtohet nga Gjykata Supreme”*;
- iii. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës, sepse nuk është mundësuar që rasti të trajtohet në Gjykatën Supreme: *“pasi që, Avokati i popullit i ka shkelur Proceduarat e parapara në dispozita të qarta ligjore, Ligji Nr. 06/L-057, PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE, Neni 9 pika 3 dhe pika 5, Neni 12 pika 3 dhe Neni 15 pika 3, dhe LIGJI Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Neni 1 dhe 16, por edhe të interpretuara nga Gjykata Supreme, më datë 04.09.2019. Duke pretenduar me tej se në bazë të nenit 15 paragrafit 1 të ligjit në fjalë: “Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtareve dhe prokuroreve. Në rast se Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, paragrafin 6, gjyqtari apo prokurori dhe Autoriteti Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, si dhe në rastet e parapara me nenin 12 par. 3 të këtij Ligji, Avokati i Popullit, mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës Supreme për mosveprim nga ana e Këshillit përkatës. Dhe me këtë rast nuk ka Vendim nga Këshilli Prokurorial dhe nuk ka Veprim nga Avokati i Popullit sipas interpretimit të Gjykatës Supreme, me datë 04.09.2019”*;
- iv. Neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] i Kushtetutës, sepse Avokati i Popullit nuk e ka mbrojtur atë nga mosveprimet e autoriteteve të tjera publike, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe dispozitat e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë

Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se arsyetimi dhe konstatimi i Avokatit të Popullit, se sipas Ligjit nr. 06/L-057, vendimi i Kryeprokurorit të PThP në këtë çështje konsiderohet i formës së prerë, është qartazi i pabazuar dhe i njëanshëm sepse kërkesën për përjashtimin e prokurores së rastit, sipas tij, nuk e ka trajtuar asnjë autoritet prokurorial dhe se prokurorja M.LL., ende pa e pritur vendimin e Kryeprokurorit të PThP-së për përjashtim, e kishte hedhur poshtë kallëzimin penal si të pabazuar;

v. Neni 45 i KEDNJ-se, “...sepse, autoritetet Prokuroriale dhe Avokati i Popullit, janë të obliguara të nxjerrin Vendime të Arsjetuara, e jo ti Heshtin ose ti bëjnë shkel e shko pa i Arsjetuar fare Ankesat, ashtu siç e parasheh edhe ligji se çdo Vendim duhet Arsjetuar për çështjen kryesore dhe atë aksesore, e jo siç ka bërë Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe Avokati i Populli...për refuzim të ankesës të dt. 16.07.2019 dhe Vendimi i Avokatit të Popullit, dt. 12.02.19, hera e parë dhe Njoftimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit, dt. 13.09.2019,...se e mbyllë këtë çështje... ”

53. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të vërtetojë si në vijim:

1. Të konstatojë se ka pasur shkelje procedurale nga autoritetet prokuroriale, që nga ajo e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit - Kryeprokurori.
2. Të konstatojë se ka pasur shkelje procedurale nga Avokati i Popullit.
3. Të priset Vendimi mbi hedhjen e kallëzimit penal PP. I. nr. 65/17 të datës 28.02.2019, si i pabazuar.
4. Të dërgohet lënda në Prokurorinë Speciale me qëllim që pas shqyrtimit të kallëzimit penal dhe të gjeturave të hetuesisë të procedohet në gjykatën kompetente.
5. Të kërkohet nga autoritetet kompetente që të zbatohen dispozitat ligjore në mënyrë që mos të vihet deri te Gjykata Kushtetuese.
6. Të merr një vendim meritator dhe të arsyetuar për çështjet kryesore dhe aksesore, si shembull edhe për rastet e tjera.

Dispozitat relevante ligjore

**LIGJI Nr. 06/L-057 PËR PËRGJEGJËSINË
DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE**

Neni 9

Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore

1. Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejshëm: “Autoriteti Kompetent”):

1.1. Kryetari i Gjykatës Themelore dhe të Apelit në të cilën shërben gjyqtari për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të atij gjyqtari;

1.2. Kryetari i Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit; 1.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme;

1.4. Kryeprokurori i Shtetit për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryeprokurorëve;

1.5. Kryeprokurori për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorëve të punësuar në prokurorinë për të cilën është përgjegjës Kryeprokurori. 1.6. Këshilli Prokurorial i Kosovës për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të Kryeprokurorit të Shtetit.

[...]

6. Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Lidhur me vendimin e marrë, Autoriteti Kompetent njofton menjëherë me shkrim personin që ka paraqitur ankesë. Një kopje e vendimit i dorëzohet

Neni 12

Procedura hetimore

1. Këshilli fillon procedurat disiplinore mbi bazën e kërkesës të dorëzuar në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të këtij Ligji.

2. Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të

arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.

3. Avokati i Popullit mund të kërkojnë nga Këshilli që të filloj hetimet disiplinore ndaj një Kryetari të Gjykatës ose Kryeprokurorit nëse kanë arsye të besojnë se ai/ajo ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 9, paragrafit 7 i këtij Ligji. Në rast të pranimi të ankesës Avokati i Popullit gjithashtu mund të kërkojnë nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori nëse konsiderohet se Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës ndaj atij gjyqtari ose prokurori në kundërshtim me nenin 9, paragrafin 5, me ç' rast ai/ajo duhet të ofrojnë arsyetim se pse ankesa nuk duhet të ishte hedhur poshtë.

[,,,]

Neni 15

Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

1. Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

[...]

LIGJI Nr.05/L-019 PËR AVOKATIN E POPULLIT

Neni 21. Procedura pas pranimi të ankesës

1. Pas pranimi të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej dhjetë (10) ditë pune vendos për pranueshmërinë e çështjes si në vijim:

1.1. të shqyrtojë në procedurë të përsheptuar rastin;

1.2. të fillojë hetimin e plotë; 1.3. të hedh poshtë ankesën për shkak se:

1.3.1. nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji;

[...]

Neni 22. Rastet e refuzimit të shqyrtimit të ankesës

1. Avokati i Popullit refuzon kërkesën për shkak të arsyeve si në vijim:

- 1.1. kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

54. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafët 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

56. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

57. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston kushtetutshmërinë e mosveprimit të disa autoriteteve publike, përkatësisht të PThP-së, KPK-së, Gjykatës Supreme dhe Avokatit të Popullit, përfshirë aktet e tyre, si njoftime dhe vendime.
58. Marrë parasysh se parashtruesi në esencë i konteston pesë procedura të ndryshme që i ka zhvilluar para autoriteteve publike, Gjykata do të shqyrtojë nëse janë përmbushur kushtet e parapara me nenet 47,48, dhe 49 të Ligjit në lidhje me secilën procedurë.
59. Përveç kësaj Gjykata për secilën procedurë do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur, gjithashtu, kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, përkatësisht me paragrafët 1, pika (c) dhe 2 të rregullit 39 të Rregullores, që përcaktojnë:

“ (1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit juridik i është dorëzuar parashtruesit [...]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e mosveprimeve të disa autoriteteve publike, përkatësisht të PThP, KSh, KPK, Gjykatës Supreme dhe Avokatit të

Popullit, duke pretenduar se të njëjtit mohuan të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24, 32, 54, dhe 132 të Kushtetutës dhe 45 të KEDNJ-së, për shkak të mosveprimeve dhe mostrajtimit të ankesave/kërkesave të tij të parashtruara para këtyre autoriteteve.

61. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës vëren se kemi të bëjmë me pesë (5) grupe të procedurave: 1) me procedurën kontestimore, përkatësisht kontestin e punës; 2) me procedurën në lidhje me paraqitjen e kallëzimit penal të ngritur kundër M.G., V.I., D.R., M.B., N.H. dhe G.X.; 3) me procedurën për përjashtimin e prokurores së rastit M.L.L. dhe përgjegjësitë disiplinore të prokurorëve; 4) me kërkesat e parashtruesit të kërkesës për dërgimin e lëndës [PP. nr. 65/2017] për trajtim në kompetencë të Prokurorisë Speciale, dhe 5) me kërkesat e parashtruesit të kërkesës të dërguara Avokatit të Popullit. Andaj, Gjykata do i analizojë dhe trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës në lidhje me këto procedura.

1) Sa i përket procedurës kontestimore (kontestit të punës)

62. Për sa i përket kësaj procedure, Gjykata vëren se procedura nuk ka përfunduar, por se ajo gjendet para Gjykatës së Apelit, sipas ankesës së dorëzuar nga ana e parashtruesit të kërkesës më 14 gusht 2017, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 189/17 të 20 qershorit 2017.
63. Megjithatë, në lidhje me procedurën kontestimore (kontestin e punës), Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur asnjë pretendim për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese sa i përket kësaj procedure. Andaj, Gjykata nuk do e vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta sa i përket procedurës kontestimore.

2) Sa i përket procedurës në lidhje me kallëzimin penal

64. Sa i përket procedurës lidhur me kallëzimin penal, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kundër një numri të caktuar të personave, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës nuk i është referuar në mënyrë specifike ndonjë dispozite konkrete të Kushtetutës. Në lidhje me këtë procedurë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata “Që të anuloh vendimin për hedhjen poshtë si të pabazuar të kallëzimit penal PP. I. nr. 65/17 të datës 02/28/2019”.
65. Gjykata, duke iu referuar shkresave të lëndës, rikujton se parashtruesi i kërkesës më 19 maj 2017 në PThP kishte paraqitur kallëzim penal, kundër M.G., V.I., D.R., M.B., N.H. dhe G.X., për shkak të dyshimit se

të njëjtit kanë kryer disa vepra nga neni 422 dhe neni 434 i KPRK-së. Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës më 14 gusht 2017 dhe 13 shtator 2017, kishte plotësuar kallëzimin penal në PThP, duke kërkuar: 1) që përveç personave të lartcekur, të zhvillohej hetim edhe ndaj gjyqtarës së instancës së parë S.B-Sh., për shkak të dyshimit të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, dhe 2) që kundër të dyshuarve, M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-SH, të ngarkohej edhe vepra penale “legalizimi i përmbytjes së rreme” nga neni 403 i KPRK-së.

66. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson, para së gjithash është në diskrecionin e prokurorive themelore, që në bazë të ligjeve në fuqi të vlerësojnë, nëse janë përmbushur të gjithë elementët e kryerjes së ndonjë vepre, ose disa veprave penale për të ngritur një aktakuzë kundër personave të caktuar. Për më tepër, Gjykata konstaton se procedura në fjalë i përket kategorisë së procedurave hetimore, ku parashtruesi i kërkesës nuk akuzohet për një vepër penale, por është një palë që i kërkon PThP-së të ngre aktakuzë kundër disa palëve të treta, duke kërkuar dënimin e tyre për veprat e mësipërme penale.
67. Gjykata, në lidhje me këtë çështje, verën se PThP, pasi kishte administruar të gjitha provat, më 28 shkurt 2019 vendosi ta hedhë poshtë si të pabazuar kallëzimin penal, përkatësisht lëndën penale [PP.nr.65/2017], kundër të dyshuarve M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-SH., duke arsyetuar se: “...me asnjë provë nuk kemi arritur që të argumentojmë se të lartcekurit janë kryes të këtyre veprave penale”. Sipas, vlerësimit të Gjykatës, procedura lidhur me kallëzimin penal [PP.I.65/17] konsiderohet e përfunduar me vendimin e PThP-së të 28 shkurtit 2019.
68. Gjykata fillimisht i referohet datës në të cilën është dorëzuar vendimi i fundit dhe datës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatë për të vlerësuar nëse parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda periudhës së caktuar prej 4 (katër) muajsh.
69. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk deklaroi se kur e ka pranuar vendimin për hedhjen e kallëzimit penal [PP.I.65/17] të 28 shkurtit 2019. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës, më 4 mars 2019, ishte i njoftuar për të njëjtën, dhe përmes postës elektronike. Për më tepër, Gjykata vëren se ai kishte kërkuar nga KPK-ja dhe Prokuroria e Shtetit që të revokohej vendimi për hedhjen poshtë të kallëzimit penal PP. I. 65/17, të 28 shkurtit 2019, me të cilin prokurorja e hodhi poshtë kallëzimin penal si të pabazuar.

70. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kundërshtuar më së voni më 4 mars 2019, ndërsa kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 20 shtator 2019, që do të thotë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës *“Për anulimin e vendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal PP . I. nr. 65/17 të datës 02/28/2019, si i pabazuar.”* është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
71. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është të ruajë sigurinë ligjore duke siguruar se rastet që ngrenë çështje të caktuara të Kushtetutës trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, për të parandaluar që autoritetet dhe palët e tjera të interesuara të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë* [VV], nr. 27396/06, paragrafi 39, Aktgjykimi i 29 qershorit 2012; *El Masri kundër “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”* [VV], nr. 39630/09, paragrafi 135, dhe *Bayram dhe Yıldırım kundër Turqisë* (vendimi), Nr. 38587/97, GJEDNJ 2002-III).
72. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës *“Për anulimin e vendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal PP. I. nr. 65/17 të datës 02/28/2019”* nuk ishte parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë në nenin 49 të ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme sepse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
- 3) *Sa i përket procedurës për përjashtimin e prokurores së rastit, M.LL., dhe përgjegjësi disiplinore të prokurorëve*
73. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të mosveprimit të autoriteteve publike (Prokurori i PThP-së, Kryeprokurori i Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Avokati i Popullit dhe Gjykata Supreme), për përjashtimin e prokurores M.LL. dhe përgjegjësitë disiplinore të prokurores i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24, 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të KEDNJ-së, sepse nuk i trajtuan ankesat dhe kërkesat e tij për hapjen e procedurës disiplinore kundër prokurores M.LL. dhe përjashtimin e saj nga shqyrtimi i lëndës së tij.
74. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të prokurores dhe përjashtimin e prokurores së rastit, më 26 mars 2018 së pari iu drejtua Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që të marrë masa kundër prokurores së rastit, ndërsa më 18 janar 2019, në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të prokurores dhe

përjashtimin e prokurores së rastit parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme.

75. Më 13 shkurt 2019, Kryetari i Gjykatës Supreme iu përgjigj parashtruesit të kërkesës se *“pas analizimit të pretendimeve për sjellje të papërshtatshme të mundshme, u konstatua, se në këtë fazë ne nuk jemi autoriteti i autorizuar për të shqyrtuar pretendimet tuaja, dhe në përputhje me nenin 9 pika 2 të Ligjit Nr. 06 / L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më 13 shkurt 2019, ne i kemi referuar ato në kompetencën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë si një autoritet i autorizuar për procedim të mëtejshëm”*.
76. Duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, më 23 korrik 2019, PThP me njoftimin AD. nr. 04/19, e informoi atë se kërkesa e tij për përjashtimin e prokurores M.LL. dhe fillimin e procedurave në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të prokurores, i është refuzuar si i pabazuar. Përveç kësaj letra thotë: *“Ju mund t'i referoni pretendimet dhe pakënaqësitë nga parashtrësja në lidhje me procesin e vendimmarrjes në Komisionin për shqyrtim të performancës së prokuroreve në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Në zbatim të nenit 9, paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, autoriteti kompetent ju informon se tani për tani ankesa juaj ka rezultuar e pabazuar”*.
77. Tutje, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës, kundër njoftimi të 23 korrikut 2019 i ishte drejtuar me ankesë KPK-së, nga e cila kishte kërkuar shqyrtimin e ankesave në merita. Të njëjtën ankesë parashtruesi i kërkesës, më 26 gusht 2019, ia kishte drejtuar Gjykatës Supreme e cila, më 4 shtator 2019, e njofton të njëjtin, si në vijim: *“Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj të pranuar përmes postes elektronike me datë 26.08.2019, me të cilën Ju jeni ankuar në lidhje me heshtjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës - KPK ndaj ankesës tuaj të datës 23.07.2019, kemi konstatuar se, bazuar në ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve nr. 06/L-057, Neni 12, pika 3 dhe Neni 15 pika 1- "Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës", dhe Neni 15 pika 3 - "si dhe ne rastet e parapara me nenin 12 par. 3 të këtij Ligji, Avokati i Popullit, mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjykatës Supreme për mosveprimin nga ana e Këshillit përkatës", në rastin konkret ankesa juaj nuk është e drejtuar ndaj një Vendimi disiplinor të Këshillit përkatës, dhe se ju si palë nuk jeni kompetent të ushtroni ankesë ndaj mosveprimit nga ana e Këshillit përkatës, andaj ju njoftojmë se ankesa juaj për Gjykatën Supreme nuk paraqet bazë lëndore për trajtim”*.

78. Në këtë këndvështrim, Gjykata verën se ankesa e parashtuesit të kërkesës kishte rezultuar e pasuksesshme për shkaqe thjesht procedurale me arsyetimin se: *“...në rastin konkret ankesa juaj nuk është e drejtuar ndaj një Vendimi disiplinor të Këshillit përkatës, dhe se ju si palë nuk jeni kompetent të ushtroni ankesë ndaj mosveprimit nga ana e Këshillit përkatës, andaj ju njoftojmë se ankesa juaj për Gjykatën Supreme nuk paraqet bazë lëndore për trajtim”*.
79. Nga si me sipër, Gjykata vlerëson se nuk qëndron fakti se ankesat e parashtuesit të kërkesës nuk u morën në shqyrtim nga autoritetet publike, sepse nga shkresat e lëndës është e qartë se procedura në lidhje me kërkesën për përjashtimin e prokurores M.LL. dhe hapjen e procedurës disiplinore kundër së njëjtës ishte shqyrtuar dhe vendosur nga PThP me vendimin [AD. nr.04/19] e PThP-së të 23 korrikut 2019. Gjykata gjithashtu vë në pah se edhe Gjykata Supreme iu ishte përgjigjur ankesave të parashtuesit të kërkesës, të ushtruara kundër vendimit të PThP dhe heshtjes së KPK, duke dhënë arsyetim të detajuar për shkakun e refuzimit të tyre. Pra, në këtë aspekt, Gjykata konstaton se nuk qëndron fakti që autoritetet publike nuk kanë vepruar dhe rrjedhimisht në rrethana të rastit konkret nuk kemi të bëjmë me mosveprim të autoritetet publike.
80. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se arsyet e refuzimit të një ankese për shkaqe procedurale nuk duhet kuptuar me automatizëm si shkelje e të drejtave kushtetuese. Gjykata konsideroi se në shkresat e lëndës nuk ka asgjë që tregon se autoritetet publike që kanë shqyrtuar çështjen e parashtuesit të kërkesës në lidhje me këtë procedurë, nuk kanë qenë të paanshme apo se procedura në ndonjë mënyrë tjetër ka qenë e padrejtë. Gjykata, nga si me sipër, konsideron se parashtuesi i kërkesës thjesht është i pakënaqur me rezultatin dhe përgjigjet e autoriteteve publike. Megjithatë, Gjykata përsërit se pakënaqësia e tij me rezultatin e procedurës së zhvilluar nga autoritetet publike, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Vízgazdálkodási Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
81. Prandaj, bazuar nga si me sipër, Gjykata konstaton se janë të pabazuara pretendimet e parashtuesit të kërkesës se për shkak të mosveprimit nga ana e autoriteteve publike (Prokurori i PTh, Kryeprokurori i Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Avokati i Popullit dhe Gjykata Supreme) sipas kërkesave të parashtuesit të kërkesës për përjashtimin e prokurores dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurores,

atij i është shkelur e drejta e cila është garantuar me nenet 24, 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të KEDNJ-së. Prandaj, ato duhen shpallur qartazi të pabazuara, në pajtim me rregullin 39 (2) sepse parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

4) *Sa i përket dërgimit të lëndës për trajtim në kompetencë të Prokurorisë Speciale*

82. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtuesit të kërkesës përkitazi me mos dërgimin e rastit për shqyrtim në juridiksionin e Prokurorisë Speciale, konsiston në shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës: *“sepse ai ishte i diskriminuar për shkakun se ankesat e tij dhe kërkesat për përjashtimin e prokurores në këtë çështje nuk u shqyrtuan dhe për shkak se Kryeprokurori i Shtetit, KPK dhe PThP nuk e dërguan rastin e tij në Prokurorinë Speciale për procedura të mëtejshme”*.
83. Gjykata, në këtë drejtim, rikujton se parashtuesi i kërkesë, më 14 maj 2018, kishte kërkuar nga KPK-ja që lënda [PP. nr. 65/17] të dërgohej në kompetencë të Prokurorisë Speciale për trajtim të mëtejshëm. Të njëjtën kërkesë, më 16 maj 2018, ia kishte dërguar edhe Kryeprokurorit të Shtetit.
84. Më 21 maj 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes njoftimit PPN. nr. 66/18, e informon parashtuesin e kërkesës se ata nuk janë kompetentë të vendosin *“që një rast të dërgohet në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale të Kosovës, këtë mund ta bëjë vetëm prokurori i ngarkuar me rastin, në pajtim me kryeprokurorin e vet, ndërsa vlerësimin përfundimtar e bënë Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës”*. Për këtë arsye, ne i kemi dërguar kërkesën tuaj Prokurorit të rastit me një kërkesë që të vlerësoj nëse janë përmbushur kushtet për dërgimin e çështjes në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës”.
85. Gjykata fillimisht thekson se nuk është juridiksion i gjykatave të rregullta dhe as i Gjykatës Kushtetuese që të përcaktojë nëse një lëndë penale (kallëzim penal) bie në juridiksionin e një prokurorie themelore apo Prokurorisë Speciale. Juridiksioni i Prokurorisë Speciale përcaktohet saktësisht me Ligjin Nr. 03 /L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe amendamentet përkatëse. Ky ligj në nenin 5 përcakton kompetencën e veçantë të Prokurorisë Speciale, ndërsa neni 9 i këtij ligji përcakton kompetencën plotësuese të Prokurorisë Speciale.

86. I përket vet përfaqësuesve të sistemit prokurorial, përkatësisht prokurorive themelore përkatëse, që të përcaktojnë nëse një lëndë penale, bie brenda kompetencës së tyre lëndore për tu trajtuar apo jo. Ky juridiksion megjithatë nuk varet nga kërkesa apo vullneti i personit i cili e parashtron kallëzimin penal.
87. Në rastin konkret, çështja e dërgimit të lëndës penale [PP.nr.65/17] në kompetencë të Prokurorisë Speciale për trajtim ishte në kompetencën ekskluzive të PThP-së. Tutje, Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, verën se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për dërgimin e lëndës penale [PP. nr. 65/17] në kompetencë të Prokurorisë Speciale, bazohej thjeshtë në dyshimin e tij se prokurorja M.LL., e cila ishte e ngarkuar me lëndën e tij, po e zvarriste zhvillimin e hetimeve dhe ngritjen e aktakuzës ndaj të dyshuarve M.G., V.I., D.R., M.B., N.H., G.X. dhe S.B-SH.
88. Duke u rikthyer tek pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai ishte *“diskriminuar për shkak se ankesat dhe kërkesat e tij për përjashtimin e prokurores në këtë çështje nuk u shqyrtuan dhe për shkak se Kryeprokurori i Shtetit, KPK dhe PThP nuk e kanë dërguar çështjen e tij në Prokurorinë Speciale për procedura të mëtejshme”*, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me nenin 24 të Kushtetutës, i cili thotë se *“diskriminimi përbën një trajtim të ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional, të personave në situata relativisht të ngjashme”* (shih *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 marsit 2006).
89. Në mënyrë që pretendimet e parashtruesve për shkelje të së drejtës së diskriminimit të jenë të suksesshme, parashtruesit duhet të dëshmojnë, ndër të tjera, që pozita e tyre mund të konsiderohet se është e ngjashme me atë të një personi tjetër që ka pasur një trajtim më të mirë (shih *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 18 shkurtit 1991).
90. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk sqaron në asnjë mënyrë e as nuk *“vërteton se pozicioni i tij mund të konsiderohet se është i ngjashëm me atë të një personi tjetër që ka pasur trajtim më të mirë”*.
91. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm se i është referuar diskriminimit, duke mos shpjeguar se si kishte ardhur deri tek diskriminimi dhe duke mos shpjeguar se çfarë ishte *“trajtimi i*

ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional, i personave në situata relativisht të ngjashme”.

92. Për shkak të gjithë asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës janë qartazi të pabazuara në pajtim me rregullin 39 (2), për shkakun se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
- 5) *Sa i përket procedurave në lidhje me kërkesat e parashtruesit të kërkesës të dërguara Avokatit të Popullit*
93. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të të drejtave të tij kushtetuese që kanë të bëjnë me procedurat në lidhje me kërkesat e parashtruesit drejtuar Avokatit të Popullit të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës kanë rezultuar në shkelje të neneve 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenit 45 të KEDNJ në esencë përmbledhet në atë se “... Avokati i Popullit nuk e mbrojt atë nga mosveprimi i organeve të tjera publike, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05 / L-019 për Avokatin e Popullit dhe dispozitat e Ligjit nr. 06 / L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”. Si dhe që “... “...Avokati i Popullit i ka shkelur procedurat e parashikuara në dispozitat e qarta ligjore, Ligji Nr. 06 / L-057 PËR PËRGJEGJËSINË DISCIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE, neni 9, pika 3 dhe pika 5, neni 12, pika 3 dhe neni 15, pika 3 dhe Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit , neni 1 dhe 16 ... ”.
94. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i është drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit dy herë, së pari më 26 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kërkesë tek Avokati i Popullit, nga i cili kërkoi që të paraqesë ankesë në Gjykatën Supreme për shkak të heshtjes administrative dhe mosveprimit nga ana e Kryeprokurorit të PTh-së dhe KPK-së, nga të cilët kërkoi që Prokurorja M.LL. të përjashtohet, ndërsa lënda [PP. nr. 65/17] t'i dërgohet Prokurorisë Speciale.
95. Më 12 shkurt 2019, Avokati i Popullit nxori Vendimin A. nr. 926/208, dhe pas shqyrtimit të ankesës, ndërmoi këto veprime: *“Më 16 janar 2019, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi prokurorin e ngarkuar me rastin e ankuesit. Qëllimi i takimit ishte marrja e informacionit në lidhje me fazën në të cilën ndodhet çështja e ankuesit dhe për veprimet e ndërmarra ose që do të ndërmerren nga Prokuroria, në mënyrë që çështja e ankuesit të procedohet brenda*

afatit ligjor, në përputhje me ligjin. Prokurori e informoi atë se rasti po procedohej sipas procedurave ligjore dhe i paraqiti veprimet e tij në shkresat e lëndës. Më 16 janar 2019, një përfaqësuesja e Avokatit të Popullit e kontaktoi ankuesin dhe e informoi atë për takimin me prokurorin e rastit të tij. Ankuesi, gjithashtu u informua se kërkesa e tij ishte jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit. Marrë parasysh rrethanat e paraqitura më lartë, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 21, paragrafi 1. 3, nën paragrafi 1. 3. 1. i Ligjit Nr. 05 / L - 019 për Avokatin e Popullit, vendosi të ndërpresë hetimin në lidhje me çështjen e mësipërme”.

96. Më tej, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me ankesë për herë të dytë Avokatit të Popullit i cili, më 13 shtator 2019, në lidhje me mosveprimet dhe heshtjet administrative të PThP dhe KPK, nëpërmjet postes elektronike e kishte njoftuar paraprakisht parashtruesin e kërkesës: *“Ju njoftojmë se kemi pranuar ankesën tuaj të cilën e kemi evidentuar me nr. 672 12019, dhe i kemi shqyrtuar me kujdes pretendimet tuaja ankimore. (...) Në kuptimin e mirë administrimit, Avokati i Popullit do të kërkojë nga Këshilli Prokurorial të njoftohet për arsyet pse nuk keni pranuar përgjigje (cilado qofte ajo) për pretendimet tuaj dhe ju do të mbaheni të informuar në lidhje me këtë”.*
97. Tutje, në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se më 22 nëntor 2019, Avokati i Popullit, kishte marrë Vendimin nr. 2033/2019 me të cilin i ishte përgjigjur të njëjtit për dy çështje:

1) e para kishte të bënte me ankesën e tij ndaj vendimit AD. nr. 04/19 të PThP, me të cilën ishte hedhur poshtë ankesa e tij për përjashtimin dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurores M.LL. Në lidhje me këtë ankesë, Avokati i Popullit arsyetoi: *“Pas analizimit të ankesës, më 13 shtator 2019, nëpërmjet postes elektronike zyrtare, z. Dervishaj u njoftua se ankesa lidhur me Vendimin AD. nr. 04/19, e pranuar nga PThP-ja, nuk mund të trajtohet në përputhje me Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, ngase i tejkalon kompetencat e Avokatit të Popullit, bazuar në këtë ligj, për arsye se e konsideron vendimin e kryeprokurorit si vendim të formës së prerë, përveç në rastet e tjera të specifikuara dhe kur Ligji nuk jep të drejtë ankese”;* dhe

2) e dyta ndërlidhej me ankesën e parashtruesit të kërkesës për heshtjen e PThP-së dhe KPK-së, për mosdërgimin e lëndës penale për trajtim në Prokurorinë Speciale, për të cilën Avokati i Popullit, arsyetoi: *“...lidhur me pretendimet për heshtje, z. Dervishaj u njoftua se, në kuptimin e miradministrimit, do ta kontaktojë*

autoritetin përgjegjës për të marrë informata lidhur me rastin e ankuesit. Më 13 shtator 2019, z. Dervishaj, nëpërmjet postes elektronike, shprehu pakënaqësinë duke mos u pajtuar me qëndrimin e Avokatit të Popullit dhe theksoi se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shkeljet procedurale të PThP-së dhe të Avokatit të Popullit, duke u përcaktuar në këtë mënyrë në rrugën të cilën do ta ndjekë. Duke pasur parasysh rrethanat e paraqitura më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka vendosur t'i ndërpresë hetimet lidhur me çështjen e lartpërmendur”.

98. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga Vendimi nr. 2033/2019 i Avokatit të Popullit, i 20 nëntorit 2019, Gjykata verën se parashtuesi i kërkesës duke u ndarë i pakënaqur me përgjigjen e Avokatit të Popullit të 13 shkurtit 2019, të njëjtën ditë e kishte njoftuar atë, se në lidhje me heshtjen e autoriteteve publike dhe mosveprimet e vetë Avokatit të Popullit do t'i drejtohet me ankesë Gjykatës Kushtetuese. Si rrjedhojë, Gjykata verën se Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, vendosi t'i ndërpresë hetimet lidhur me heshtjen e autoriteteve publike në fjalë.
99. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës, në masën më të madhe, këtu ka sqaruar shkeljen e neneve 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës. Gjykata thekson se nenet 54 dhe 132 të Kushtetutës nuk përmbajnë të drejta që mund të interpretohen në mënyrë abstrakte, nëse nuk ekziston lidhja edhe me nenet e tjera të Kapitullit II të Kushtetutës.
100. Në këtë drejtim, Gjykata sqaron se nenet 54 dhe 132 të Kushtetutës nuk janë nene që në vete përmbajnë një të drejtë ose liri. Të dy nenet e mësipërme nuk janë, pra, nene që mund të interpretohen në mënyrë të pavarur nga dispozitat e tjera kushtetuese, të rëndësishme për këtë çështje.
101. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu i referohet shkeljes së nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike], por nuk arsyeton në asnjë mënyrë se nga çfarë mjeti juridik ishte privuar dhe kundër cilit vendim ai nuk pati mundësinë të paraqiste ndonjë mjet juridik, por i lidh të njëjtat pretendime me nenin 45 të KEDNJ-së.
102. Gjykata vëren dhe konstaton se neni 45 i KEDNJ-së, i cili bën pjesë në Titullin II [Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] të KEDNJ-së, nuk mund të shërbejë si bazë për të ngritur një pretendim për shkelje të të drejtave të garantuara me KEDNJ para Gjykatës Kushtetuese,

duke qenë se ky nen i referohet kompetencave të GJEDNJ-së përkitazi me procedurat e vendimmarrjes dhe jo kompetencave të gjykatave vendore, pjesë anëtare të mekanizmit mbrojtës të garantuar me KEDNJ (shih, ngjashëm, Gjykata Kushtetueses, rasti KI108/18, parashtrues: *Blerta Morina*, Aktvendimi për Papranueshmeri, i 5 shtatorit 2019, paragrafi 195).

103. Duke iu rikthyer pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se një pjesë e pretendimeve ka të bëjë me mosveprimin e Avokatit të Popullit, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga ana e Avokatit të Popullit.
104. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se Avokati i Popullit nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për çështjen e tij, Gjykata konsideron se këto pretendime janë plotësisht të pabazuara, sepse bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur lehtësisht mund të konstatohet se Avokati i Popullit ka vepruar në lidhje me çdo kërkesë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
105. Për sa i përket pjesës së dytë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit dhe interpretimin e gabuar të ligjit, Gjykata rithekson, në radhë të parë, se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet se janë kryer nga autoritetet publike apo gjykatat e rregullta, përveç, dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, 28 §, KEDNJ 1999-I).
106. Gjykata vëren se të gjitha përgjigjet e Avokatit të Popullit ishin të qarta dhe të arsyetuara, dhe se të gjitha pretendimet e parashtruesit, të cilat ishin relevante për vendimmarrjen në këtë rast, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar si duhet nga Avokati i Popullit. Prandaj, Gjykata konkludon se procedurat e ngritura para Avokatit të Popullit, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).
107. Gjykata rithekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e përgjigjeve të autoriteteve publike dhe vetëm përmendja e një neni relevant të Kushtetutës, pa e shtjelluar shkeljen e pretenduar nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohet një shkelje e tillë e Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse

(shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

108. Prandaj, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Avokati i Popullit nuk e ka mbrojtur atë nga mosveprimet e autoriteteve të tjera publike dhe se me mosveprimin e vet Avokatit të Popullit ka ardhur deri tek shkelja e të drejtave të tij të garantuara me nenet 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij, në lidhje me këto dispozita konkrete. Rrjedhimisht, kërkesa në lidhje me këto pretendime, duhet të shpallet qartazi e pabazuar dhe e papranueshme në pajtim me rregullin 39 paragrafin (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

109. Si përmbledhje, sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, nga ana e autoriteteve publike, Gjykata konstaton se kërkesa:

- i. Në lidhje me procedurën kontestimore, ose me kontestin e punës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij kushtetueses përkitazi me këtë procedurë. Prandaj, Gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta sa i përket kësaj procedure civile;
- ii. Në lidhje me procedurën e paraqitjes së kallëzimit penal, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës *“Për anulimin e vendimin për hedhjen e kallëzimit penal të PP.I.nr.65/17 të datës 02/28/2019”* nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme për shkak se është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor;
- iii. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e prokurores dhe përgjegjësive disiplinore të prokurorëve, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se me mosveprimet e autoriteteve publike, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuar me nenet 24, 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës nuk

ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në lidhje me këto dispozita konkrete. Rrjedhimisht, kërkesa në lidhje me këto pretendime duhet të shpallët qartazi e pabazuar dhe e papranueshme, në pajtim me rregullin 39, paragrafi (2) të Rregullores së punës;

- iv. Në lidhje me kërkesat e parashtruesit të kërkesës, që ndërlidhën me dërgimin e çështjes [PP.nr. 65/2017] për shqyrtim në kompetencën e Prokurorisë Speciale, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, janë po ashtu qartazi të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij, në lidhje me këtë nen konkret. Rrjedhimisht, kërkesa në lidhje me këto pretendime, duhet të shpallët qartazi e pabazuar dhe e papranueshme, në pajtim me rregullin 39, paragrafin (2) të Rregullores së punës;
- v. Në lidhje me kërkesat e parashtruesit të kërkesës të parashtruara Avokatit të Popullit, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se Avokati i Popullit nuk e mbrojti atë nga mosveprimet e autoriteteve të tjera publike, dhe se vetë mosveprimi i Avokatit të Popullit i shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 32, 54 dhe 132 të Kushtetutës dhe nenin 45 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij për shkeljen e këtyre dispozitave konkrete. Rrjedhimisht, kërkesa në lidhje me këto pretendime, duhet të shpallët qartazi e pabazuar dhe e papranueshme, në pajtim me rregullin 39, paragrafin (2) të Rregullores

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (1) (c), 39 (2) si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 qershor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI122/19, Parashtruesi i kërkesës: F.M., Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.49/2019 të 7 marsit 2019 lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.358/2018, të 19 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.927/14, të 15 janarit 2018

KI122/19, Aktvendim për papranueshmëri, i miratuar më 9 korrik 2020, i publikuar më 31 gusht 2020

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, barazia e armëve, administrimi i provave, mbrojtja në heshtje, moszbulim i identitetit.*

Më 15 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë parashtruesin e kërkesës, i cili me qëllim të ndërprerjes së shtatzënisë të dëmtuarës X, dhe si pasojë e dhunës fizike të ushtruar ndaj saj e kishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale “Ndërprerje e palejuar e shtatzënisë” në tentativë duke e dënuar me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila ishte refuzuar si e pabazuar nga kjo Gjykatë. Tutje, parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, ndër të tjera duke pretenduar se aktgjykimet e kundërshtuara ishin bazuar në dëshminë e palës së dëmtuar, e cila dëshmi ishte në kundërshtim me provat materiale dhe se Gjykata Themelore nuk kishte marrë parasysh faktin që në seancën e shqyrtimit kryesor pranë kësaj ishte mbrojtur në heshtje. Gjykata Supreme, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e kishte refuzuar si të pabazuar duke konstatuar se Gjykata Themelore kishte marrë për bazë edhe provat e tjera, dhe se kishte respektuar të drejtën e mbrojtjes së parashtruesit në heshtje gjatë shqyrtimeve gjyqësore të kësaj Gjykate.

Parashtruesi i kërkesës i konteston këto konstatime para Gjykatës, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ), nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës së tij për

gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës i referohen: (i) administrimit të provave nga gjykata dhe parimit të barazisë së armëve; (ii) mbrojtjes në heshtje; dhe (iii) arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës duke aplikuar edhe standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi se kërkesa është e papranueshme, sepse (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe me nenin 7 të DUDNJ-së janë të papranueshme sepse janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç është përcaktuar përmes nenit 47 e 48 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.; dhe (ii) pretendimet për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe nenit 54 të Kushtetutës janë të e papranueshme sipas nenit 48 të Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Në fund, Gjykata në pajtim me Rregullin 32 të Rregullores së Punës dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe marrë për bazë ndjeshmërinë e rastit, vlerësoi që me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës dhe të fëmijës së mitur moszbulimi i identitetit të parashtruesit të kërkesës konsiderohet të jetë i domosdoshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI122/19

Parashtrues

F.M.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.49/2019 të 7 marsit 2019 lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.358/2018 të 19 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.927/14, të 15 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga F.M., (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Flutra Hoxha, avokate në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit PML. nr. 49/2019, të 7 marsit 2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin PA1. nr. 358/2018 e 19 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin P.nr.927/14, e 15

janarit 2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML.nr.49/2019, të 7 marsit 2019 e ka pranuar më 30 mars 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuarra, për të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ), nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuarra] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 31 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

8. Më 19 gusht 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë fletëkthesën, e cila dëshmon se kur e ka pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme. Një kopje të kërkesës, të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi edhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 30 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës ia dorëzoi Gjykatës fletëkthesën, e cila dëshmon se ai vendimin e kontestuar e ka pranuar më 30 mars 2019.
10. Më 24 janar 2020, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës dorëzimin e dokumenteve shtesë, respektivisht kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kopjen e ankesës, të dorëzuar në Gjykatën e Apelit, si dhe kopjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
11. Më 3 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
12. Më 12 shkurt 2020, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës informatë lidhur me statusin e kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale.
13. Më 26 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë informatën e kërkuar dhe dokumentet përkatëse përkitazi me kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale.
14. Më 9 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë shqyrtoi dhe vendosi për mosbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 13 shkurt 2012, ish-Prokuroria Publike e Qarkut, përmes Aktakuzës PP. nr. 510/05/2011 e akuzoi parashtruesin e kërkesës për kryerjen e dy veprave penale, përkatësisht (i) *“Ndërprerje e palejuar e shtatzanisë në tentativë”* nga neni 152 paragrafi 2, lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK) ; dhe (ii) *“Lëndim i lehtë trupor”* nga neni 153 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 1 të KPK-së. Sipas shkresave të lëndës, në këtë rast, parashtruesi i kërkesës akuzohej që këtë vepër penale e kishte kryer ndaj personit X, me të cilën për një kohë të caktuar kishte qenë në lidhje.

16. Në shqyrtimin kryesor pranë Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës ishte mbrojtur në heshtje. Megjithatë, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor kishte kërkuar që të merrej aktgjykim lirues me arsyetimin se për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” ishte arritur parashkrimi absolut ndërsa përkitazi me veprën tjetër penale “*Ndërprerje e palejuar e shtatzënisë në tentativë*” në bazë të sqarimit plotësues të ekspertizës mjeko- ligjore nuk ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës e kishte kryer këtë veprë penale. Në bazë të shkresave të lëndës, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës kishte paraqitur kundërshtimin lidhur me dëshminë e personit X, e cila në procedurë kishte cilësinë e palës së dëmtuar si dhe provat tjera të administruara nga kjo Gjykatë.

17. Më 15 janar 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit P.nr.927/14:
 - (i) parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale “*Ndërprerje e palejuar e shtatzënisë në tentativë*” nga neni 152 paragrafi 2, lidhur me nenin 20 të KPK-së, duke e dënuar me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti; (ii) refuzoi aktakuzën lidhur me veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 153 paragrafi 1 lidhur me nën-paragrafin 1 të KPK-së për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale: dhe (iii) personin X, në cilësinë e palës së dëmtuar e udhëzoi në kontest civil.

18. Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi i kërkesës “*me qellim të ndërprerjes së shtatzënisë, e ka keqtrajtuar fizikisht te dëmtuarën [person X] me të cilën ka qenë në lidhje dashurie ashtu që duart i'a ka lidhur me pranga, këmbët me rrip, ndërsa gojën ia ka mbyllur me shami, e me pas e ka goditur me grushte ne pjese te ndryshme te trupit duke përfshi edhe pjesën fundore të shpinës, me qellim të ndërprerjes së shtatzënisë e cila ka qenë e padëshiruar për të, e pa pëlqimin e të dëmtuarës të cilën fillimisht dhe përmes telefonit e kishte kërcënuar me qellim që e dëmtuara te abortoj fëmijun, mirëpo kjo ndërprerje ka mbetur në tentativë*”. Si përfundim, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi i kërkesës me qëllim të ndërprerjes së shtatzënisë, dhe si pasojë e dhunës fizike të ushtruar ndaj të dëmtuarës X kishte kryer veprën penale ndërprerje e shtatzënisë e cila kishte mbetur në tentativë.

19. Gjykata Themelore, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të rastit kishte administruar provat si në vijim: (i) dëshminë e të dëmtuares (personi X); (ii) raportin e Qendrës Emergjente me nr. 20158, të 6 korrikut 2011; (iii) Raportin nga QKUK, Klinika e Gjinekologjisë, të 6 korrikut 2011 (iv) raportin mbi ekzaminimin fizik, të 6 korrikut 2011 i

përgatitur nga eksperti mjeko-ligjor A.G.; (v) raportin me nr. PP-510/5/2011, të 23 dhjetorit 2011, i përgatitur nga eksperti mjeko-ligjor A.G; (vi) foto-dokumentacionin; (vii) fotodokumentacionin konfidencial, të bërë gjatë kontrollit mjeko-ligjor, të 6 korrikut 2011; dhe (viii) sms-ët nga raporti i Post Telekomit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PTK), i 8 gushtit 2011.

20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit P.nr.927/14, të 15 janarit 2018, të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe shkelje të ligjit penal.
21. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij, në lidhje me (i) pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kishte specifikuar se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte i pakuptueshëm dhe kundërthënës me arsyetimin e dhënë nga kjo Gjykatë. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është bazuar vetëm në dëshminë e të dëmtuarës X, e cila është në kundërshtim me mbrojtjen e parashtruesit të kërkesës, dhe me provat materiale të institucioneve mjekësore dhe atyre mjeko-ligjore, përfshirë edhe raportin e sms-ve të PTK-së. Ndërsa në lidhje me (ii) pretendimet për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, parashtruesi theksoi se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Parashtruesi i kërkesës, në vijim kishte insistuar se Gjykata Themelore i ka administruar provat në mënyrë të njëanshme dhe subjektive, dhe rrjedhimisht kjo Gjykatë ka shkelur edhe ligjin penal.
22. Më 19 nëntor 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1. nr. 358/2018 refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 927/14, të 15 janarit 2018.
23. Fillimisht, Gjykata e Apelit vërtetoi se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave penale, me arsyetimin se aktgjykimi është i qartë, përmban arsyetim bindës në lidhje me faktet vendimtare, në veçanti në lidhje me vërtetimin e ekzistimit të veprës penale. Gjykata e Apelit, më tej konstatoi se aktgjykimi i kundërshtuar arsyetimin dhe vlerësimin e tij e mbështeti në dëshminë e palës së dëmtuar, ekspertizën e mjekësisë ligjore, si dhe prova dhe dëshmi të tjera, të administruara nga Gjykata Themelore, të cilat kjo e fundit i ka listuar në aktgjykimin e saj.

24. Së dyti, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, Gjykata e Apelit vërtetoi se pretendimet e tij janë të pabazuara. Në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike, Gjykata e Apelit arsyetoi se: *”Nga të gjitha këto prova të administruara dhe drejt të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë por edhe nga dëshmia e dëshmitares nuk vihet në dyshim kryerja e veprës penale nga [parashtruesi i kërkesës], megjë [parashtruesi i kërkesës] natën kritike ka përdorë dhunë por edhe kanosje ndaj të dëmtuarës me pretendim të ndërprerjes së shtatzanisë, andaj pretendimet ankimore të mbrojtësit se gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar drejt nuk qëndron”.*

25. Së treti, në lidhje me pretendimin për shkelje të ligjit penal, Gjykata e Apelit duke vërtetuar faktin që parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale *“Ndërprerja e palejuar e shtatzanisë”* në tentativë, vlerësoi se Gjykata Themelore drejtë ka zbatuar ligjin penal. Për me tepër, në lidhje me pretendimin specifik të parashtruesit se këtë vepër penale mund ta kryejnë vetëm personat e autorizuar, respektivisht mjekët specialistë apo mamitë, Gjykata e Apelit vërtetoi se *“[...] sipas dispozitave ligjore në fuqi pos punëtorëve shëndetësor kryes i veprës penale mund të jete çdo person tjetër i cili tenton të bëjë ndërprerjen e shtatzanisë pa pëlqimin e gruas”.*

26. Në fund, në lidhje me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit konstatoi se me dënimin e shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës nga Gjykata Themelore për kryerjen e veprës penale, për të cilën në bazë të dispozitave të KPK-së është paraparë dënimi nga një (1) deri në tetë (8) vjet burgim, do të arrihet qëllimi i ndëshkimit, i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

27. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit P. nr. 927/14 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit PA1. nr. 358/2018 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

28. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës penale, theksoi se aktgjykimet e kundërshtuara janë bazuar në dëshminë e palës së dëmtuar, e cila dëshmi është në kundërshtim me provat materiale. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikon se në aktgjykimin e Gjykatës Themelore nuk është cekur mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, e paraqitur në Prokurori më 7 shtator 2011, dhe po ashtu nuk është

cekur fakti se parashtruesi në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës Themelore është mbrojtur në heshtje. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendoi se Gjykata e Apelit nuk i ka dhënë rëndësi mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës dhe raportit të ekspertit mjekoligjor.

29. Ndërsa, në lidhje me pretendimin për shkelje të ligjit penal, parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata Themelore ka shpallur fajtor për veprën *“Ndërprerja e pa lejuar e shtatzanisë në tentativë”* nga neni 152, paragrafin 2 lidhur me nenin 20 të KPK-së, edhe pse me këtë dispozitë sipas tij sanksionohen veprimet e personave të cilët janë të autorizuar për ndërprerjen e shtatzanisë, përkatësisht mjekët apo mamitë.
30. Më 15 shkurt 2019, Prokurori i Shtetit përmes parashtrësës KLMP. II. nr. 36/2019, i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
31. Më 7 mars 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit PML.nr.49/2019 refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës si të pabazuar.
32. Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të procedurës penale arsyetoi se *“[...] Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është bazuar vetëm në deklaratën e të dëmtuarës [X], por edhe në provat tjera që ishin në shqyrtim gjyqësor[...]. Në arsyetim janë vlerësuar të gjitha provat e administruara dhe nuk qëndron fakti se të dy aktgjykimet janë të bazuara në vetëm një dëshmi-deklaratën e të dëmtuarës.”* Sipas Gjykatës Supreme, Gjykata Themelore kishte marrë për bazë edhe provat e tjera, përkatësisht raportet e institucioneve përkatëse të specializuara mjekësore dhe ekspertizës mjeko-ligjore, përfshirë edhe provat materiale të komunikimit elektronik, ku dëshmohej se shtatzënia e të dëmtuarës ishte e padëshiruar. Në vijim, Gjykata Supreme po ashtu arsyetoi se Gjykata Themelore nuk e kishte marrë parasysh mbrojtjen e tij në Prokurori për arsye se Gjykata Themelore në pajtim me nenin 346, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) kishte respektuar të drejtën e mbrojtjes së parashtruesit në heshtje gjatë shqyrtimeve gjyqësore të kësaj Gjykate.
33. Ndërsa, përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht nenit 152 [Ndërprerja e palejuar e Shtatzanisë], paragrafi 2 lidhur me nenin 20 [Tentativa] të KPK-së,

Gjykata Supreme arsyetoi: “[...] nuk janë të vetmit mjekët dhe mamitë personat të cilët mund ta kryejnë këtë vepër penale ashtu siç pretendohet në kërkesë, por këtë vepër penale mund ta kryej kushdo, e në rastin konkret [parashtruesi i kërkesës], ka tentuar ta ndërprejë shtatzaninë e padëshiruar për të, e pa pëlqimin e të dëmtuarës[...] Kjo vërtetohet nga lëndimet e shkaktuara [...] të shkaktuara nga goditjet e furishme me mjet të fortë [mbrojtës] [...]”.

34. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës, në momentin e dorëzimit të kërkesës ishte duke e vuajtur dënimin me burg, të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në një qendër korrektuese në Republikën e Kosovës.
35. Për më tepër, në bazë të parashtrësive të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës rezulton që më 9 gusht 2019, ky i fundit kishte parashtruar kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Përmes njoftimit të parashtruesit më 26 shkurt 2020, dhe dorëzimin e kopjes së Aktvendimit KP. Nr. 1472/2019, të 20 shtatorit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë kërkesën e parashtruesit për rishikim të procedurës penale e kishte refuzuar si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 358/2018, të 19 nëntorit 2018 dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.927/14, të 15 janarit 2018, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së, nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe me nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përveç Aktgjykimit të fundit të Gjykatës Supreme, në mënyrë specifike konteston edhe Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
38. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se nuk është zhvilluar në mënyrë të drejtë administrimi i provave penale në rastin e parashtruesit të kërkesës. Së dyti, parashtruesi i kërkesës thekson se

në procedurë para Gjykatës Themelore parashtruesi është mbrojtur në heshtje.

39. Përkitazi me pretendimin për administrimin e provave, parashtruesi i kërkesës thekson se çështja e *“marrj[es] [s]e provave në mënyrë të ligjshëm përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga Kushtetuta dhe nga neni 6 i KEDNJ-së”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), përkatësisht rasteve *Bykov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, dhe *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, kërkesat nr.21363/93, 21364/93, 21427/93, dhe 22056/93, Aktgjykim i 23 prillit 1997.
40. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës *“[...] kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve procedurale lidhur me provat penale, marrjen, administrimin, verifikimin dhe çmuarja e tyre, mjetet e kërkimit të provave dhe në tërësi procesi i të provuarit, janë parashikuar me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, të cilat burojnë dhe në tërësi procesi i të provuarit, janë parashikuar nga dispozita e Kodit Penal të Kosovës, të cilat burojnë dhe janë në përputhje të plotë me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare”*.
41. Përkitazi me pretendimin për mbrojtjen në heshtje, parashtruesi i kërkesës *“[...] vlerësimi i gjykatës për heshtjen e pandehurit gjatë mbrojtjes (edhe pse avokati kishte mohuar kryerjen e veprës penale vazhdimisht) duhet të bëhet me të njëjtën shkallë besueshmërie dhe pa asnjë paragjykim, por duke u bazuar në elementet që rezultojnë nga provat që disponohen”*.
42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit nuk i ka marrë në konsideratë provat shfajësuese të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës, specifikon se *“Gjykata e Apelit, gjatë vendosjes në lidhje me ankesën e të mbrojtësit të pandehurit, nuk e pa të udhës që të hynte në më shumë detaje lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, ajo nuk ka marrë si fakt shumë të rëndësishëm provat shfajësuese të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës penale. [...]”*.
43. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht thekson se: *“Duke filluar nga procedura në shkallën e parë e deri në Aktgjykimin e shkallës së tretë-Gjykatës Supreme [parashtruesit të kërkesës] i janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt gjyqësor [...]”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“parimi i procesit të rregullt*

përfshinë gjithashtu të drejtën që secilës palë t'i jepet mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, nën kushtet që nuk vendosin atë në një pozitë të pafavorshëm vis-a-vis një pale tjetër”.

44. Në vijim, parashtruesi i kërkesës, pretendon se: *”Gjykata Supreme duke vepruar si gjykatë e shkallës së tretë nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko kushtetuese lidhur me faktet relevante për dhënien e një vendimi të ligjshëm, por shumë shkurtimisht ka vlerësuar si të pabazuara vendimet ankimore të parashtruesit të kësaj kërkesë”.*
45. Parashtruesi i kërkesës po ashtu specifikon se: *“Gjykata Supreme ka vendosur njëjtë si Gjykata e Apelit, duke mos përfillë shkeljet e pretenduara të procedurës penale dhe nuk ka përfillë shkeljet të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Bazuar në qëllimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet juridik i parashtruar nga mbrojtja e kërkuarit, gjykata Supreme ka qenë e obliguar të mënjanojë shkeljet ligjore nga vendimi i plotfuqishëm mbi dënimin e kërkuarit. Pasi që të kishte vërtetuar shkeljet procedurale në procedurën e zhvilluar gjyqësore, gjykata Supreme ka mundur të anulojë vendimin për dënimin dhe të urdhërojë mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të ri (neni 439 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës)”.*
46. Në fund, parashtruesi i kërkesës rithekson se gjatë procedurës penale para gjykatave të rregullta *“Gjykata më shumë ka mbrojtur të dëmtuarën [personin x] dhe ky kujdes për ta mbrojtur atë në jetën publike është vërejtur edhe nga pikëpamja institucionale gjegjësisht me dënimin e [parashtruesit të kërkesës] dhe diskriminim gjinor që atij që nga fillimi ja ka bërë gjykata dhe prokuroria gjatë tërë procedurës”.*
47. Parashtruesi i kërkesës thekson se *”[...] e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu siç garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës-neni 31, pastaj me KEDNJ-neni 5 dhe 6, dhe neni 14”.*
48. Sipas parashtruesit të kërkesës në rastin e tij, Gjykata Supreme ka shkelur barazinë e armëve në procedurë, sepse i ka mbi-peshuar argumentet e njëres palë. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës nënvizon se pretendimi i tij kryesor ka të bëjë me *“provat për caktimin e fajësisë”* sidomos në procedurën paraprake dhe *“stërzgjatjen e procedurës prej 7 viteve- e një veprë të tillë”.*
49. Parashtruesi i kërkesës, duke pretenduar shkeljen e neneve të lartcekura të Kushtetutës, dhe KEDNJ-së sqaron se *”Janë shkelur nenet e pretenduar, për shkak të marrjes së një Aktgjykimi jo të drejtë nga Gjykata vendore, cenimin e të drejtave të parashtrimit të*

provave relevante, ndershmërisë së procedurës, se ndërhyrja e kësaj natyre nuk është proporcionale dhe e mjaftueshme që të sigurojë kërkuesin për garancitë procedurale që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe respektimit të mbrojtjes të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe aktet ndërkombëtare”.

50. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që çështjen e tij ta trajtojë me urgjencë dhe kërkon që: (i) kërkesën ta deklarojë të pranueshme; (ii) të konstatojë shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24, 29, 31, 53 e 54 të Kushtetutës; nenin 5, 6, 14 të KEDNJ-së; dhe nenin 7 të DUDNJ-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 14 (Ndalimi i diskriminimit)

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo

mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK/RREG/2003/25)

Neni 20
TENTATIVA

(1) Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.

Neni 152
NDËRPRERJA E PALEJUAR E SHTATZËNËSISË

(1) Kushdo që në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e shtatzënësisë dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë ndërpret shtatzaninë, fillon ta kryejë ndërprerjen e shtatzanisë ose i ndihmon që ta ndërprejë shtatzaninë dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

(2) Kushdo që e ndërpreu ose fillon ta ndërprejë shtatzaninë pa pëlqimin e gruas shtatzënë dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni rezulton në lëndim të rëndë trupor, me dëmtim të rëndë të shëndetit ose me vdekje të gruas shtatzënë, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose më së paku tre vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 2.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 28 dhjetor 2012

Neni 9
Barazia e palëve

Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.
 2. *I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.*

Neni 346
Marrja në pyetje e të akuzuarit

1. I akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë. Nëse ai zgjedh që të deklarojë, marrja e tij në pyetje zbatohet në pajtim me paragrafin 2. deri 4. të këtij neni.

2. Mbrojtësi kryesor merr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 333 të këtij Kodi.

3. Prokurori i shtetit merr në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.

4. Nëse ka të bashkëpandehur, ata mund të marrin në pyetje të pandehurin në pajtim me nenin 334 të këtij Kodi.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
52. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:
 1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

53. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

54. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik përkatësisht Aktgjykimin Pml.nr.49/2019, të 7 marsit 2019 të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1.nr.358/2018, të 19 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P.nr.927/14, të 15 janarit 2018. Gjykata vëren, se

parashtruesi pas nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme kishte parashtruar kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila kërkesë me Aktvendimin, KP. Nr. 1472/2019, e 20 shtatorit 2019 ishte refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se vendimi i fundit dhe i kontestuar në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml.nr.49/2019, i 7 marsit 2019.

55. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në afatin kohor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
56. Në këtë rast, Gjykata do të shqyrtojë gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

57. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1.nr.358/2018, të 19 nëntorit 2018 dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore P.nr.927/14, të 15 janarit 2018, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe me nenin 7 të DUDNJ-së, nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe me nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
58. Gjykata, megjithatë vëren se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, të ngritura në kërkesën e tij i referohen të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së respektivisht.
59. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, që ndërlidhen me pretendimin e tij përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe pretendimin e tij të dytë se është

diskriminuar gjatë procedurës penale Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e së cilës, Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuar me Kushtetutë.

I. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ

60. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës i referohen: (i) administrimit të provave nga gjykata dhe parimit të barazisë së armëve; (ii) mbrojtjes në heshtje; dhe (iii) arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme.

(i) Për sa i përket parimit të barazisë së armëve dhe administrimit të provave nga gjykatat e rregullta dhe barazisë së armëve

61. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në Gjykatën Themelore nuk është zhvilluar në mënyrë të drejtë administrimi i provave penale në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Gjykata e Apelit nuk i ka marrë në konsideratë provat shfajësuese të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.

62. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës “[...] kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve procedurale lidhur me provat penale, marrjen, administrimin, verifikimin dhe çmuarja e tyre, mjetet e kërkimit të provave dhe në tërësi procesi i të provuarit, janë parashikuar me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, të cilat burojnë dhe në tërësi procesi i të provuarit, janë parashikuar nga dispozita e Kodit Penal të Kosovës, të cilat burojnë dhe janë në përputhje të plotë me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare.”

63. Gjykata, në vijim rikujton se në kontekst të pretendimit të tij përkitazi me administrimin e provave, parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e barazisë së armëve për arsye se sipas tij gjykatat e rregullta në vazhdimësi “i kanë mbi-peshuar argumentet e njëres palë”, duke nënvizuar se pretendimi i tij kryesor ka të bëjë me “provat për caktimin e fajësisë” sidomos në procedurën paraprake dhe “stërzgjatjen e procedurës prej 7 viteve- e një veprë të tillë”. Në këtë aspekt, respektivisht përkitazi me çështjen e stërzgjatjes, parashtruesi i kërkesës përveç përmendjes së këtij pretendimi në

kërkesë dhe në kontekst të shkeljes së parimit të barazisë së armëve, këtë nuk e elaboron dhe arsyeton më tej në kërkesë. Për më tepër, Gjykata vëren se ky pretendim nuk është ngritur apo përmendur në mënyrë specifike edhe në parashtresat e tij para gjykatave të shkallëve më të ulëta.

64. Megjithatë Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës vetëm specifikon se në procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta atij i është shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, që sipas tij *“parimi i procesit të rregullt përfshinë gjithashtu të drejtën që secilës palë t’i jepet mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, nën kushtet që nuk vendosin atë në një pozitë të pafavorshëm vis-a-vis një pale tjetër”*.
65. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës është theksuar se parimi i *“barazisë së armëve”*, kërkon *“ekuilibër të drejtë midis palëve”* ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, shih rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtgues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtgues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
66. Ndërsa në vijim, dhe në kontekst të pretendimit specifik përkitazi me administrimin e provave nga gjykatat, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në parim ka theksuar se *“Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare”* (shih rastin GJEDNJ-së *Schenk kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 10862/84, Aktgjykim, 12 korrikut 1988 paragrafët 45-46).
67. Megjithatë, GJEDNJ ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këso raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastet e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35394/97, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 44787/98, Aktgjykim, i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 48539/99, Aktgjykim, i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).

68. Rrjedhimisht, nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës kishte mundësi ta kontestoj ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-se, *Szilagyi kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 30164/04, të 17dhjetorit 2013; shih po ashtu rastin e Gjykatës KI34/18, parashtrues *Albert Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 majit 2018, paragrafi 63).
69. Më saktësisht, GJEDNJ ka nënvizuar se kur prova është shumë e qëndrueshme dhe nuk vihet fare në dyshim, nevoja për prova të tjera në mbështetje të saj bëhet më e vogël (shih rastet *Bykov kundër Rusisë* [DhM], kërkesa nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, paragrafi 89, dhe referencat tjera të përmendura aty; *Jalloh kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 54810/00 [DhM], Aktgjykim i 11 korrikut 2006, paragrafi 96). Rrjedhimisht, GJEDNJ ka theksuar se i kushton gjithashtu rëndësi pikës nëse prova në fjalë ka qenë apo jo përcaktuese për rezultatin e procesit penal (shih rastin *Gäfgen kundër Gjermanisë* [DhM], kërkesa nr. 22978/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2010, paragrafi 164).
70. Duke u bazuar në atë si më sipër dhe duke iu referuar procedurave të zhvilluara para gjykatave të rregullta, në veçanti në lidhje me administrimin e provave nga këto gjykata, Gjykata fillimisht i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila vendimin e saj për shpallje fajtor të parashtruesit të kërkesës e kishte mbështetur në dëshminë e personit X në cilësinë e të dëmtuarës në procedurë penale, raportet mjekësore, të lëshuara nga institucione të ndryshme të shëndetësisë, raportet mjeko-ligjore, foto-dokumentacione, të realizuara gjatë ekzaminimit nga ekspertët mjekësorë dhe ata mjeko-ligjorë, dhe komunikimin përmes sms-vë nga raporti i PTK-së.
71. Gjykata, në bazë të parashtresave të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës vëren se atij në Gjykatën Themelore, përmes përfaqësuesit të tij ligjor i ishte dhënë mundësia e kundërshtimit të provave. Në këtë kontekst, në Aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore në lidhje me kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës për administrimin e provave të lartcekura kishte theksuar se “Gjykata nuk munda ta pranojë qëndrimin e mbrojtësit të të akuzuarit [...] se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale Ndërprerje e palejuar e shtatzanisë në tentativë nga neni 152 par. 2, lidhur me nenin 20 të KPK-së, pasi që nuk ka prova që e vërtetojnë këtë, por e vlerësoi këtë mbrojtje si të pabazuar dhe të drejtuar në ikje të përgjegjësisë penale, pasi që kjo mbrojtje ishte në kundërshtim me dëshminë e dëshmitares – të dëmtuarës [personi X] dhe provat tjera materiale si: raporti i Qendrës Emergjente me nr. 20158, i dt. 06.07.2011, Raporti i QKUK-së Klinika e Gjinekologjisë, i

dt. 06.07.2014, raporti mbi Ekzaminin Fizik, i dt. 06.07.2011, i përgatitur nga eksperti mjeko-ligjor Dr. A. G., foto – dokumentacioni dhe foto-dokumentacioni konfidencial i bërë gjatë kontrollit mjeko-ligjor dt. 06.07.2011, si dhe nga sms dhe raporti i PTK-së i dt. 08.09.2011, të cilat ishin në përputhje me njëra tjetrën”.

72. Si përfundim, pas elaborimit të secilit kundërshtim të parashtruesit të kërkesës ndaj provës së administruar nga Gjykata Themelore, kjo e fundit konstatoi se gjykata, sipas vlerësimit të saj ka autoritet që të mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë, dhe të vlerësojë rëndësinë e secilës provë për marrjen parasysh gjatë zhvillimit të procedurës penale. Gjykata Themelore, në vazhdim theksoi se gjykata gjatë administrimit të provave *“Në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave, arsyen e miratimit të tyre si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së kësaj çështje penalo-juridike në rastin e vërtetimit të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarve”.*
73. Si përfundim, Gjykata Themelore përkritazi me provat materiale të administruara gjatë zhvillimit të procedurës penale konkludoi se *“Deklaratën e të dëmtuarës – dëshmitares të theksuar si ma lartë dhe provat materiale gjykata i vlerësoi si bindëse, reale dhe objektive ashtu që iu fali besimin duke u mbështetur në to aktgjykimin në këtë çështje penale, ndërsa mbrojtja materialo-juridike ashtu edhe formalo-juridike në rastin konkret kishte për qëllim justifikimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit për t’iu shmangur përgjegjësisë penale.”*
74. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet edhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit ishte konstatuar se aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore arsyetimin dhe vlerësimin e mbështeti në dëshminë e palës së dëmtuar, ekspertizën e mjekësisë ligjore dhe provave dhe dëshmime të tjera, të administruara nga Gjykata Themelore, të cilat i ka listuar në aktgjykimin e saj. Gjykata e Apelit, përfundoi se Gjykata Themelore ka shqyrtuar mbrojtjen e parashtruesit të kërkesës, duke dhënë arsyetim përkatës se përse nuk ia ka falur besimin mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës në këtë rast.
75. Në fund, Gjykata Supreme duke iu referuar pretendimit specifik përkritazi me administrimin e provave nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë konstatoi se: *“[...] Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është bazuar vetëm në deklaratën e të dëmtuarës [X], por edhe në provat tjera që ishin në shqyrtim gjyqësor[...]. Në arsyetim janë vlerësuar të gjitha provat e administruara dhe nuk qëndron fakti*

se të dy aktgjykimet janë të bazuara në vetëm një dëshmi-deklaratën e të dëmtuarës”.

76. Në rastin konkret, Gjykata Supreme kishte vërtetuar se Gjykata Themelore kishte marrë për bazë edhe provat e tjera, përkatësisht raportet e institucioneve përkatëse të specializuara mjekësore dhe ekspertizës mjeko-ligjore, përfshirë edhe provat materiale të komunikimit elektronik, në bazë të të cilave ka mbështetur qëndrimin juridik të gjykatave më të ulëta.
77. Në dritën e parimeve të përgjithshme të GJEDNJ-së, të elaboruara më lartë dhe arsyetimin e gjykatave të rregullta, Gjykata fillimisht vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje me standardet e kërkuara për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe vendimmarrjen e tyre nuk e kanë bazuar vetëm në një provë por në një mori provash, të cilat që të gjitha Gjykata Themelore i kishte listuar në Aktgjykimin e saj.
78. Së dyti, Gjykata po ashtu vëren, se procedura penale ndaj parashtruesit të kërkesës kishte qenë e rregullt në tërësinë e saj, pasi që gjykatat kishin respektuar të drejtën e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës në procedurë para gjykatave të rregullta përmes përfaqësuesit të tij ligjor i është dhënë mundësia e kundërshtimit të provave, përkatësisht për ta kundërshtuar dëshminë e të dëmtuarës dhe provat materiale, të cilat ishin paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës penale.
79. Së treti, Gjykata po ashtu vëren se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit respektivisht kishin arsyetuar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme se pse ato nuk i kanë falur besimin mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës.
80. Dhe së fundi, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj kishte dhënë arsyetimin konkret, rrjedhimisht duke konkluduar se të gjitha provat e administruara nga kjo gjykatë, dhe të listuara në Aktgjykimin e saj kishin qenë përcaktuese për shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale, për të cilën rrjedhimisht edhe ishte dënuar.
81. Prandaj, bazuar në arsyetimin si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se në rastin e tij gjykatat e rregullta nuk kanë administruar provat në pajtim me parimet e vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së, të cilat janë të mishëruara edhe në dispozitat përkatëse të procedurës penale.

82. Në vijim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, përveç përmendjes së pretendimit për shkelje të parimit të barazisë së armëve në procedurë, të cilin e ngritë në kontekst të administrimit të provave, nuk ka ofruar argumente shtesë dhe dëshmuar bazueshmërinë e këtij pretendimi në kërkesën e tij.
83. Gjykata në këtë aspekt thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim, i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
84. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mos administrimit të duhur të provave nga gjykatat e rregullta dhe po ashtu nuk ka ofruar arsyetim dhe argumente në lidhje me bazueshmërinë e pretendimit të tij për shkelje të parimit të barazisë së armëve në procedurë, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij janë të pabazuara në baza kushtetuese.

(ii) *Për sa i përket të drejtës për tu mbrojtur në heshtje*

85. Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij thekson se gjatë procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta, përkatësisht para Gjykatës Themelore është mbrojtur në heshtje.
86. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se “[...] vlerësimi i gjykatës për heshtjen e pandehurit gjatë mbrojtjes (edhe pse avokati kishte mohuar kryerjen e veprës penale vazhdimisht) duhet të bëhet me të njëjtën shkallë besueshmërie dhe pa asnjë paragjykim, por duke u bazuar në elementet që rezultojnë nga provat që disponohen.” Në kontekst të këtij pohimi, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës çështjen e mbrojtjes në heshtje përpiqet që deri në një masë ta ndërlidhë edhe me parimin e prezumimit të pafajësisë, të cilin megjithatë nuk vazhdon ta elaborojë dhe saktësojë më tej në kërkesën e tij.
87. Fillimisht dhe në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje dhe në kontekst të zhvillimit të procedurës penale para gjykatave, Gjykata i referohet nenit 346 të KPPK-së, i cili përcakton se: “1. I akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë. Nëse ai zgjedh që të deklarojë, marrja e tij në pyetje zbatohet në pajtim me paragrafin 2. deri 4. të këtij neni”.

88. Gjykata në vijim, gjithashtu rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, siguron disa garanci minimale për çdo person të akuzuar për një vepër penale, e cila përfshin të drejtën për tu mbrojtur në heshtje dhe të drejtën e lirisë nga vetëfajësimi, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-se, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, te 17 dhjetorit 1996, si dhe *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 18731/91, i 8 shkurtit 1996 paragrafi 45, shih po ashtu rastin e lartcekur të Gjykatës, KI34/18, parashtrues *Albert Berisha*, paragrafi 59).
 89. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, për sa i përket mbrojtjes së tij në heshtje në procedurë para gjykatave të rregullta, Gjykata bazuar në parashtruesat e dorëzuara me kërkesë vëren se Gjykata Themelore e kishte respektuar të drejtën e parashtruesit për tu mbrojtur në heshtje.
 90. Në këtë drejtim, duke u bazuar edhe në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, kjo e fundit po ashtu kishte vërtetuar se Gjykata Themelore në pajtim me nenin 346 të KPPK-së kishte respektuar të drejtën e mbrojtjes së parashtruesit për tu mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimeve gjyqësore të kësaj gjykate.
 91. Për më tepër, gjatë zhvillimit të procedurës penale para gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës gjatë gjithë kohës kishte mundësinë e përfaqësimit të tij ligjor përmes avokatit. Në këtë aspekt, Gjykata, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore ri-përsërit se mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës në shqyrtimet e kësaj gjykate kishte pasur mundësinë e kundërshtimit të dëshmisë së personit X dhe provave materiale, të paraqitura para saj.
 92. Gjykata vëren, se bazuar në procedurat e ndjekura para gjykatave të rregullta dhe arsyetimet e dhëna nga këto të fundit, nuk mund të konkludohet se gjatë mbrojtjes së tij në heshtje gjykatat e rregullta kanë paragjykuar fajësinë apo trajtuar parashtruesin e kërkesës si të ishte fajtor para se këto të fundit të vendosnin në lidhje me fajësinë e tij.
 93. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje janë të pabazuara në baza kushtetuese.
- (iii) *Për sa i përket të drejtës në vendim të arsyetuar të vendimit gjyqësor*
94. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj ka vlerësuar shkurtimeisht

pretendimet e tij në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke mos ofruar arsyetim të hollësishëm lidhur me faktet relevante.

95. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike, pretendoi se *“Gjykata Supreme ka vendosur njëjtë si Gjykata e Apelit, duke mos përfillë shkeljet e pretenduara të procedurës penale dhe nuk ka përfillë shkeljet të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Bazuar në qëllimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet juridik i parashtruar nga mbrojtja e kërkuarit, gjykata Supreme ka qenë e obliguar të mënjanojë shkeljet ligjore nga vendimi i plotfuqishëm mbi dënimin e kërkuarit. [...]”*.
96. Në dritën e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e tij të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe më pas Gjykata Supreme e kishte refuzuar edhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit gjatë vendimmarrjes kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.
97. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj kishte konkluduar se *“[...] pasi shqyrtoi pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjeti se as një nga pretendimet nuk është i bazuar. Kjo nga fakti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është bazuar vetëm në deklaratën e të dëmtuarës [...], por edhe në provat tjera të cilat janë shqyrtuar në shqyrtim gjyqësor e për të cilat janë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore në aktgjykim. Gjykata po ashtu gjen se dispozitivet e aktgjykimeve janë të qarta dhe në të përfshihen të gjitha arsyetimet ligjore për faktet vendimtare mbi bazën e të cilave është marr vendimi meritor, e te cilat arsye i merr si të ligjshme dhe të drejta edhe kjo gjykatë”*.
98. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, kur parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën e kryer penale, ankesën e tij të parashtruar në Gjykatë të Apelit dhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme.
99. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, në refuzimin e një kërkeje për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatave më të ulëta, në këtë rast

Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore (shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59-60).

100. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore – me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte shkelje esenciale të procedurës penale dhe ligjit penal (shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106).
101. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25, shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 107). Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të vet kësaj Gjykate.
102. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, dhe rrjedhimisht është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.
103. Në fund, duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e tij të lartcekura, të paraqitura në kërkesën e tij dhe që i referohen të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm dhe parimet e vendosura nga

kjo Gjykatë dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në raste të ngjashme, konstaton se kërkesa e tij në lidhje me pretendim është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

II. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ dhe nenin 7 të DUDNJ-së, si dhe nenin 29 të Kushtetutës

104. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë procedurës penale para gjykatave të rregullta *“Gjykata më shumë ka mbrojtur të dëmtuarën [personin x] dhe ky kujdes për ta mbrojtur atë në jetën publike është vërejtur edhe nga pikëpamja institucionale gjegjësisht me dënimin e [parashtruesit të kërkesës] dhe diskriminim gjinor që atij që nga fillimi ja ka bërë gjykata dhe prokuroria gjatë tërë procedurës”*.
105. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës këtë pretendim e ndërlidhë edhe me çështjen e administrimit të provave nga gjykatat e rregullta dhe barazinë e armëve në procedurë. Në lidhje me çështjen e administrimit të provave, parashtruesi i kërkesës në vazhdimësi kishte pretenduar se gjykatat e rregullta aktgjykimet e tyre i kishin mbështetur kryesisht në dëshminë e personit X. Megjithatë në lidhje me këtë, Gjykata në elaborimin e pretendimit të tij dhe arsyetimin e gjykatave të rregullta, duke i zbatuar edhe parimet e GJEDNJ-së konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës ishte qartazi i pabazuar, në baza kushtetuese. Ndërsa në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve, Gjykata rikujton se këtë pretendim parashtruesi i kërkesës nuk e kishte mbështetur me arsyetime dhe dëshmi përkatëse.
106. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, *ose status*, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, shih, po ashtu, rastet e GJEDNJ-së *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976, paragrafi 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, Aktgjykim i 16 mars 2010, paragrafi 61). Për më tepër që, jo çdo dallim në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv dhe i arsyeshëm; thënë ndryshe nëse

nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse i mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit dhe referencat e tjera të përmendura aty).

107. Prandaj, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij se si ishte diskriminuar në bazë gjinore për më tepër duke pasur parasysh faktin që parashtuesi i kërkesës dhe personi X në procedurën penale para gjykatave të rregullta nuk kanë qenë në situata të njëjta faktike, për arsye se në procedurën e zhvilluar penale njëri ishte në cilësinë e të dyshuarit dhe tjetri ishte në cilësinë e dëshmitares dhe të dëmtuares.
108. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.
109. Në fund, në lidhje me pretendimin e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument se si këto dispozita kushtetuese, në lidhje me dispozitat ekuivalente të KEDNJ-së, janë shkelur nga gjykatat e rregullta gjatë nxjerrjes së aktgjykimeve të tyre në procedurë penale. Parashtuesi i kërkesës i ka cekur këto nene të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së pa ofruar arsyetim përkatës për mbështetjen e pretendimeve të tij.
110. Në këtë drejtim, Gjykata duke rikujtuar edhe praktikën e saj gjyqësore thekson që vetëm citimi neneve të Kushtetutës apo të KEDNJ-së nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit që rrjedh nga neni 48 i Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës ku kërkohet nga parashtuesit e kërkesës të qartësojnë “*saktësisht dhe në mënyrë adekuate [...] pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*”
111. Në kontekst të pretendimit të tij për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, parashtuesi i kërkesës nuk ka saktësuar dhe sqaruar se si zbatimi i këtij neni ka qenë i aplikueshëm në rastin e tij, përkatësisht në procedurën e zhvilluar penale para gjykatave të rregullta, aktgjykimet e të cilave i ka kontestuar në kërkesën e tij para Gjykatës.
112. Në këtë aspekt, dhe në linjë me praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, kjo e fundit, pretendimin e parashtuesve të kërkesës për shkelje të

nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe nenit 54 nuk do t'i trajtojë më tutje duke qenë se parashtuesi i kërkesës nuk ka qartësuar me saktësi dhe ofruar arsyetim përkatës përkitazi me bazueshmërinë e pretendimeve të tij për shkeljen e këtyre dispozitave (shih, në këtë aspekt, rastet KIO2/18, parashtues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, paragrafët 40-41, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019; dhe KIO1/18, parashtues *Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shtatorit 2019, paragrafët 52-54).

113. Rrjedhimisht, dhe bazuar në atë si më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtuesit të kërkesës përkitazi me pretendimet e tij për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe nenit 54 të Kushtetutës është e papranueshme sipas nenit 48 të Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

114. Për arsyet e paraqitura më lartë, Gjykata përfundon se bazuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtuesit të kërkesës, përkitazi me pretendimet e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe me nenin 7 të DUDNJ-së, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
115. Ndërsa, kërkesa e parashtuesit të kërkesës përkitazi me pretendimet e tij për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe nenit 54 të Kushtetutës është e papranueshme sipas nenit 48 të Ligjit në lidhje me pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Moszbulimi i identitetit

116. Në fund, Gjykata fillimisht vë në pah se parashtuesi i kërkesës nuk ka parashtuar kërkesë për moszbulim të identitetit. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton që *"[...] Gjykata me shumicë votash autorizon mos-zbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet mos-zbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me iniciale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme"*.

117. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë ndjeshmërinë e rastit, vlerëson që me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës dhe të fëmijës së mitur moszbulimi i identitetit të parashtruesit të kërkesës konsiderohet të jetë i domosdoshëm. Rrjedhimisht, Gjykata, parashtruesit të kërkesës në këtë Aktvendim i është referuar me initiale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 32 (6), 39 (1) (d) dhe (2) dhe 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 9 korrik 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË MOS ZBULOJË identitetin e parashtruesit të kërkesës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu - Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI243/19, Parashtruesi i kërkesës: Muhamet Idrizi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 290/2019, të 21 tetorit 2019

KI243/19, Aktvendim për papranueshmëri, i miratuar më 16 shtator 2020, i publikuar më 06 tetor 2020

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, procedurë penale, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Idrizi, me vendbanim në Komunën e Vitisë.

Parashtruesi i kërkesës e konteston, rrjedhimisht, Aktgjykimin e lartcekur duke pretenduar në esencë shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Parashtruesi i kërkesës në esencë kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; të anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe, ta kthejë çështjen e tij në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, si dhe ankohet se nuk është përfaqësuar në mënyrë të duhur nga avokati i tij.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit dhe ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjë vlerësime se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

Mbështetur në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatave të rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare.

Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me mbrojtësin e tij, ku sipas parashtruesit të kërkesës mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin e Avokatisë duke dëmtuar interesat e tij, çka në të vërtetë nuk përbën argument të vlefshëm për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, aq më tepër,

kur vetë parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në të gjitha fazat e procedurës ta revokojë mbrojtësin e tij, gjë që vërtetohet që nuk e ka bërë deri tash. Gjykata thekson, se sjellja para gjykatave e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi i kërkesës është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet parashtruesit të kërkesës.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI243/19

Parashtrues

Muhamet Idrizi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 290/2019,
të 21 tetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Idrizi, me vendbanim në Komunën e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [PML. nr. 290/2019] i 21 tetorit 2019 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe

të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 30 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 9 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu Krasniqi dhe Gresa Caka Nimani.
7. Më 9 janar 2020, avokati Shemsedin Pira dorëzoi në Gjykatë një kërkesë në emër të parashtruesit të kërkesës.
8. Më 30 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi sqarim nëse përfaqësohet nga avokati Shemsedin Pira apo jo.
9. Më 5 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës njoftoi Gjykatën se ai nuk përfaqësohet nga asnjë avokat përfshirë këtu dhe avokatin Shemsedin Pira, këtë e dëshmoi duke bashkëngjitur revokimin e autorizimit të noterizuar.
10. Gjykata e njoftoi dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme, gjithashtu njoftoi edhe avokatin Shemsedin Pira, për revokimin e tij nga ana e parashtruesit të kërkesës.
11. Më 15 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një urgjencë.

12. Më 16 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 29 dhjetor 2008, Prokuroria e Qarkut në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria e Qarkut), ngriti Aktakuzën [PP. nr. 168/08] ndaj parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se ai në bashkëveprim me Sh. I. dhe i ndihmuar nga E. I., kishte kryer veprën penale të përcaktuar në nenin 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenet 20 (Tentativa) e 23 (Bashkëkryerja) dhe nenin 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), pasi më 2 shtator 2008, kishte tentuar të privojnë nga jeta R. E. dhe Sh. E.
14. Më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Qarkut) përmes Aktgjykimit [P. nr. 25/2009] e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuzat e cekura më lart, ndërsa personin që pretendohet se kishte ndihmuar kryerjen e veprës penale, përkatësisht, E. I. e liroi nga akuza për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 147 i KPPK-së, ndërsa e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 328 të KPPK-së.
15. Prokuroria e Qarkut parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që çështja të rikthehet për rigjykim. Parashtruesi i kërkesës dhe E. I. paraqitën përgjigje në ankesën e Prokurorisë së Qarkut, duke kërkuar që ajo të refuzohet si e pabazuar.
16. Më 7 mars 2012, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [AP. nr. 393/2012] e aprovoi ankesën e Prokurorisë së Qarkut si të bazuar dhe e anuloi Aktgjykimin [P. nr. 25/2009] e Gjykatës së Qarkut sa i përket parashtruesit të kërkesës dhe çështjen e ktheu në rigjykim.
17. Më 22 nëntor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 107/2012], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 147 (Vrasje e rëndë) në lidhje me nenin 20 (Tentativa) dhe 23 (Bashkëkryerja) të KPPK-së dhe e dënoi me 3 (tri) vite burgim. Ndërsa, akuza për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me nenin 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) të KPPK-së u refuzua. Përmes të njëjtit Aktgjykim, i akuzuari E. I., u lirua nga akuza.

18. Ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur parashtuan edhe parashtuesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore në Gjiçan (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore). I pari, përkatësisht parashtuesi i kërkesës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal; ndërsa i dyti, përkatësisht Prokuroria Themelore, për pjesën liruese të Aktgjykimit për të akuzuarin E.I., dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në lidhje me sanksionin penal për veprën penale për të cilën parashtuesi i kërkesës ishte shpallur fajtor.
19. Më 19 prill 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018], refuzoi ankesat e Prokurorisë Themelore dhe të parashtuesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, përkatësisht Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e 22 nëntorit 2017.
20. Parashtuesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij, ndaras, parashtuan kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal. Në kërkesat e tyre ata pretenduan, ndër të tjera, se Gjykata Themelore, duke ndryshuar përshkrimin e veprës penale dhe duke konstatuar se parashtuesi i kërkesës veprën penale e *“ka kryer me persona tani për tani të panjohur”*, ka tejkaluar akuzën në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK). Prokurori i Shtetit përmes parashtresës [KMLP. nr. 155/2018], paraqiti përgjigje në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, duke propozuar që ato të refuzohen si të pabazuara.
21. Më 18 tetor 2018, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtuar nga mbrojtësi i parashtuesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [PML.nr.226/2018] e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 107/2012] e Gjykatës Themelore.
22. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtuar nga i dënuari, përkatësisht parashtuesi i kërkesës, përmes Aktgjykimit [PML. nr. 293/2018] gjithashtu e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [PKR.nr.107/2012] e Gjykatës Themelore.

23. Më 30 nëntor 2018 përkatësisht më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij dorëzuan në Gjykatë kërkesat e tyre, të cilat u regjistruan si KI187/18 dhe KI11/19.
24. Më 29 korrik 2019, Gjykata vendosi që kërkesën KI187/18 ta shpallë të papranueshme, ndërsa kërkesën KI11/19 e shpalli të pranueshme për shqyrtim në merita dhe konstatoi se në Aktgjykimin PML. Nr.293/2018, të 3 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
25. Më 21 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.290/19] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi në kërkesën pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr. 290/2019] të 21 tetorit 2019, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se të drejtat e tij të garantuara me nenin 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë shkelur sepse përfaqësuesi i tij nuk e ka mbrojtur në mënyrën e duhur gjatë procesit gjyqësor dhe sipas parashtruesit të kërkesës, mbrojtjen e ka bërë në kundërshtim me paragrafin 7 të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-117 për Avokatinë të 25 marsit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatinë), sepse ka pasur konflikt interesi, fakt ky për të cilin, parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i informuar. Sipas parashtruesit të kërkesës, avokati i çështjes Sh. P., ka qenë gjithashtu mbrojtës i personit R. E. në një çështje tjetër penale, por i cili gjithashtu ka qenë dëshmitari kryesor në procesin penal kundër parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, avokati në fjalë ka reflektuar neglizhencë të dukshme dhe të vazhdueshme gjatë mbrojtjes së tij.
28. Më tej parashtruesi i kërkesës thekson se (i) avokati i tij nuk është angazhuar mjaftueshëm dhe nuk ka përgatitur argumentim ligjor bindës, gjë për të cilën ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, që kanë të bëjnë me mbrojtje të efektshme

gjatë procesit gjyqësor, dhe (ii) se angazhimi i avokatit të tij ka qenë minimal, si dhe nëpër shumë seanca gjyqësore ka dërguar ndonjë avokat tjetër që ta zëvendësojë dhe se nuk ka prezantuar fare gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktgjykimet e Gjykatave të rregullta, janë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 dhe 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPRK-së.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; të anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe, ta kthejë çështjen e tij në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija

individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 290/2019] e 21 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se, përkundër rishikimit të rastit të tij nga Gjykata Supreme, me vendimin e kontestuar

është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon i janë shkelur të drejtat e tij të garantuar me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës, për arsye se nuk është mbrojtur mirë nga ana e avokatit të tij.

37. Gjykata fillimisht rikujton se në Aktgjykimin e saj në rastin KI187/18 dhe KI11/19, kishte gjetur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. nr. 293/2018, i 3 dhjetorit 2018, i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse (i) është nxjerrë nga përbërja e një Kolegji, në të cilin në kundërshtim me dispozitat përkatëse të procedurës penale, dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e të Gjykatës, kishte marrë pjesë gjyqtari i cili gjithashtu ishte pjesë e vendimmarrjes në fazat e mëhershme të çështjes së njëjtë penale, përkatësisht kishte marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut kur është vendosur për akuzën penale të parashtruesit të kërkesës e edhe si anëtar i Kolegjit kur është vendosur për kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme; dhe në rrethana të tilla, (ii) dyshimet legjitime për mungesën e paanësisë së gjykatës janë objektivisht të justifikueshme.
38. Gjykata thekson së përmes Aktgjykimit në rastin KI187/18 dhe KI11/19, kishte shpallur të pavlefshëm vetëm njërin nga Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, përkatësisht, Aktgjykimin [PML. nr. 293/2018] e 3 dhjetorit 2018, të nxjerrë si rezultat i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së të pandehurit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 108/2018] të 19 prillit 2018 të Gjykatës së Apelit. Ndërsa nuk ka trajtuar pretendimet përkitazi me Aktgjykimin [PML. nr. 226/2018] e 18 tetorit 2018 të Gjykatës Supreme, sepse kërkesën përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së të njëjtës, e ka shpallur të papranueshme. Ky rezultat i shqyrtimit të kushtetutshmërisë së dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme që trajtojnë kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë kundër të njëjtit Aktgjykim të Gjykatës së Apelit, buron nga fakti që Gjykata Supreme, në rrethanat e rastit konkret, ka trajtuar ndaras kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, duke vendosur përmes dy Aktgjykimeve.
39. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ka qenë detyrë e Gjykatës Supreme ta rishqyrtojë vendimin e saj në përputhje me gjetjet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ta njoftojë Gjykatën lidhur me zbatimin e vendimit të saj.
40. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës, kishte rishqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit

të kërkesës në bazë të gjetjeve të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI187/18 dhe KI11/19, respektivisht në lidhje me pretendimet përkitazi me përbërjen e kolegjit të trupit gjykues. Gjykata Supreme pasi eliminoj shkeljen e gjetur me Aktgjykimin e Gjykatës, rishqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që ti shpallë të pa bazuara.

41. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme kishte eliminuar shkeljen sipas gjetjeve me Aktgjykimin KI187/18 dhe KI11/19 të Gjykatës, dhe me këtë ka përmbushur obligimin e saj lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.
42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngre pretendime tjera përkitazi me Aktgjykimin [PML. nr. 290/2019] të 21 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës i referohet shkeljes së nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës, ndërsa përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjithashtu dhe siç është cekur më lartë, pretendon që (i) mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë, duke dëmtuar rrjedhimisht interesat e tij; dhe (ii) Aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e caktuara të procedurës penale.
43. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 30 të Kushtetutës, Gjykata thekson se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
44. Lidhur me pretendimet se (i) Aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e caktuara të procedurës penale; (ii) mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë, duke dëmtuar rrjedhimisht interesat e tij, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e gabuar të fakteve, për sa i takon përfaqësimit të tij nga ana e mbrojtësit të tij, si dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta.
45. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me mënyrën sesi Gjykatat e rregullta kanë konstatuar faktet e rastit dhe kanë bërë interpretimet përkatëse ligjore. Si të tilla, ato pretendime hyjnë në fushën e ligjshmërisë dhe, parimisht, nuk hyjnë në domenin e Gjykatës Kushtetuese (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).

46. Në këtë drejtim, Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit dhe ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjnë vlerësime se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (Shih rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
47. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces gjyqësor, provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë.
48. Mbështetur në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatave të rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare.
49. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, pasi që kishte eliminuar shkeljen e gjetur me Aktgjykimin KI187/18 dhe KI11/19 të Gjykatës Kushtetuese, e kishte hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës si të pa bazuar, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata vëren se në Aktgjykimin [Pml.nr. 290/2019] të 21 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme, gjyqtari R.R nuk ishte pjesë e kolegjit shqyrtues pra nuk ishte pjesë e vendimmarrjes. Pjesë e kolegjit shqyrtues në Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme ishin gjyqtarët: E.P kryetar, A.M dhe M.M anëtarë. Pra me këtë Gjykata Supreme kishte eliminuar shkeljen e gjetur nga ana e Gjykatës përmes Aktgjykimit KI187/18 dhe KI11/19.
50. Kështu, Gjykata Supreme, pasi rishqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Aktgjykimin [Pml.nr. 290/2019] të 21 tetorit 2019, kishte theksuar si në vijim:

“

“Gjykata Supreme e Kosovës, pasi eliminoj shkeljen e theksuar ne aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese te Republikës se Kosovës, serish rishqyrtoi pretendimet e paraqitura ne kërkesë.

Gjykata Supreme e Kosoves në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndes ne kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 te KPPK-se dhe pas vleresimit te pretendimeve ne kerkesë, gjeti se: kërkesa nuk eshte e bazuar.

Sipas vleresimit te Gjykatës Supreme te Kosoves, pretendimi i të denuarit është i pabazuar, ngase aktgjykimet kunder te cilave ka parashtruar kerkese, nuk permbajne shkelje për të cilat pretendohet.

Ne dispozitivin e aktgjykimit te gjykatës se shkalles se pare qëndron përshkrimi se i dënuari ka vepruar me persona tjerë tani për tani te paidentifikuar, megjithatë, kjo nuk e bën dispozitivin e pakuptueshëm meqë është evidente se me këtë aktgjykim vetëm i dënuari Muhamet Idrizi është shpallur fajtor dhe është dënuar meqë ka përdorur pushkën automatike e i cili konstatim është ne harmoni edhe me ekspertizën balistike nga e cila është vërtetuar se ne vend in e ngjarjes janë gjetur 26 gëzhoja te kalibrit 7.26x39 mm dhe te shkrepura nga e njëjta arme dhe kjo ishte pikërisht edhe arsyeja se gjykata e shkalles se pare e ka liruar nga akuza te pandehurin tjetër Enver Idrizi për veprën penale te vrasjes se rende ne tentative. Ne rastin konkret rezulton se nuk është kontestues fakti se me arme te gjate ka shtënë vetëm i dënuari Muhamet Idrizi e te cilin e vërtetojnë edhe te dëmtuarit dëshmitarët Reshat dhe Shaip Emerllahu siç e thekson edhe gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e saj ne [faqen 5-7 e qe këtë arsyetim e aprovon ne tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykimi i gjykatës se shkalies se pare përkatësisht dispozitave është i qarte dhe konkret dhe ne te janë përfshirë te gjitha te dhënat përkitazi me kohen, vendin dhe mënyrën e kryerjes se veprës penale, kurse ne arsyetimin e saj janë dhëne arsye te qarta për faktet vendimtare e te cilat janë konfirmuar edhe nga gjykata e shkalies se dyte.

Pretendimet e theksuara ne kërkesë përkitazi me alibinë e te dënuarit Muhamet Idrizi përkatësisht rrethanën se ne kohen kur është kryer vepra penale ka qene ne tjetër vend tjetër nuk ishin te bazuara. Sipas vlerësimit te Gjykatës Supreme te Kosovës pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal, meqë ne rastin konkret nuk është vërtetuar fakti se vepra penale është kryer për motive te hakmarrjes se paskrupullt, po ashtu nuk ishin pretendime te bazuara. Duke u bazuar ne mënyrën dhe rrethanat e kryerjes se kësaj vepre penale përkatësisht zënia e pusisë dhe

duke i pritur te dëmtuarit, paraqet pa dyshim aspekt te dinakërisë dhe e cila është ndërlidhur edhe me motivin e hakmarrjes si rezultat i vrasjes qe paraprakisht familjari i te dëmtuarve përkatësisht djali i axhës se tyre i kishte bere familjarit te tani te dënuarit Muhamet Idrizi. Se behet fjale për motive te hakmarrjes vërtetohet edhe përmes vazhdimit te zingjirit te- dhunës mes te këtyre familjeve përkatësisht vrasjes se kryer nga anëtar i familjes se te dënuarit Muhamet Idrizi ndaj familjarit te te dëmtuarve tregon qarte motivin e hakmarrjes ne këtë çështje. Prandaj, bazuar ne konkludimet e gjykatave te instancave me te ulëta rreth zhvillimit te ngjarjes, motivit dhe cilësimit juridik janë rezultat i vlerësimit te drejte te provave te administruara dhe rrjedhimisht ne mënyrë te drejte është aplikuar ligji penal.”

51. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat pranë Gjykatës Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (Shih, *mutatis mutandis*, rastet: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lush taku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
52. Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me mbrojtësin e tij, ku sipas parashtruesit mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin e Avokatisë duke dëmtuar interesat e tij, çka në të vërtetë nuk përbën argument të vlefshëm për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, aq më tepër, kur vetë parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në të gjitha fazat e procedurës që ta revokojë mbrojtësin e tij, gjë që vërtetohet që nuk e ka bërë deri tash.
53. Gjykata thekson , se sjellja para gjykatave e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi është përgjegjësi e parashtruesit. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet parashtruesit të kërkesës (Shih *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, Nr. 14102/02 GJEDNJ, aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis*, dhe *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë*, Nr. 58511/13 GJEDNJ, aktvendim i 27 janarit 2014; Shih rastet e Gjykatës : Rasti nr. KIO2/10, *parashtrues Roland Bartecko*, Aktvendim për

papranueshmëri, , paragrafët 25-28, 21 mars 2011; KI61/15, *parashtrues Islam Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 shtatorit 2015, , paragrafi 33).

54. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
55. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI71/20, Parashtrues, Etem Arifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 380/2019, të 30 janarit 2020

KI71/20, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 shtatorit 2020, publikuar më 28 tetor 2020

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siguria juridike, qaratzi e pabazuar

Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit PKR.740/16 kishte shpallë parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerje, në bashkëkryerje, të veprës penale “Mashttrim me subvencione” nga neni 336 paragrafi 3 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve me kusht, në qoftë se brenda afatit kohor prej 3 (tri) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Gjykata Themelore në Prishtinë, gjithashtu e obligoi parashtruesin e kërkesës dhe të dënuarin tjetër [B.G] që në mënyrë solidare t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar prej: (i) 22.900 Euro - Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; dhe (ii) 2.749 Euro - Zyrës së Kryeministrit. Kompensimi u urdhërua të bëhet me këste në afat prej 6 (gjashtë) muajsh. Sa i përket akuzës për kryerjen e veprës penale “*ushtrim i ndikimit*”, nga neni 431, paragrafi i KPRK-së, Gjykata Themelore në këtë pikë e liroi nga akuza parashtruesin e kërkesës. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykata e Apelit kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pjesën gjyqesore sa i përket vendimit për dënimin dhe detyrimin përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që Gjykata e Apelit gjeti se në veprimet e të akuzuarve, formohen elementet e veprës penale mashtrimi me subvencione, nga neni 336 par 3. lidhur me par 2 e 1 të nenit 31 të KPRK-së dhe për këtë vepër penale e gjykon parashtruesin me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim, ndërsa lidhur me pjesën liruese përkitazi me parashtruesin e kërkesës, e anuloi vendimin dhe vendosi që çështja të kthehet te e njëjta Gjykatë në rigjykim. Pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe duke e kthyer rastin në rivendosje, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarës e cila është dashur të përjashtohet. Arsyeja bazë mbi të cilën Gjykata Supreme vendosi të pranoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar ishte pikërisht pjesëmarrja e gjyqtarës e cila në procedurën për konfirmimin të aktakuzës në Gjykatën e Apelit është dashur të përjashtohet.

Gjykata e Apelit duke vepruar në rigjykim vendosi njëjtë sikur në aktgjykimin saj të parë, përveç pikës II përmes të cilit vendosi se parashtruesi i kërkesës dhe [B. G.], obligohen t’i kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies

Sociale në emër të dëmit të shkaktuar shumë prej 22.900 Euro, ndërsa Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës-Zyra për Komunitete shumë prej 2.749 Euro, të gjitha në afat prej 3 (tre) muajve. Pas kërkesës së dytë për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga parashtruesi, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Parashtruesi në Gjykatë pretendoi se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut .

Në thelb, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ka ndodhur si pasojë e: (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike (ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor; (iii) mos prezencës së parashtruesit të kërkesës në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit.

Parashtruesi para Gjykatës gjithashtu kërkoi edhe vendosjen e masës së përkohshme.

Së pari, lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit për cenim të parimit të sigurisë juridike, dhe që ka të bëjë me pretendimin e tij për shkeljen të parimit *Reformato in Peius*, nga Gjykata e Apelit, e cila me Aktgjykimin PAKR. nr. 328/19 të 20 gushtit 2019, e cila afatin për kompensimin e dëmit të shkaktuar, e zvogëlon nga 6 muaj në 3 muaj, Gjykata konstatoi se këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e ngriti për herë të parë para Gjykatës. Gjithashtu lidhur me pretendimin se parashtruesit të kërkesës të cilin e ka ngritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër vendimeve të Gjykatave të shkallëve më të ulëta, me pretendimin se është bërë shkelje të ligjit penal kur është fjala tek koha e kryerjes së veprës penale, si element qenësor i figurës së veprës penale dhe përdorimin e gabuar të ligjit, Gjykata vlerësoi se Gjykata Supreme ka sqaruar qartësisht këtë pretendim të parashtruesit, në arsytimin e Aktgjykimit Pml. nr. 380/2019 të 30 janarit 2020.

Lidhur me pretendimin për mosarsyetim të vendimin, Gjykata duke u bazuar në praktikën e saj dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes aktgjykimit të kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Së treti, lidhur me pretendimin e parashtruesit për mos prezencën e parashtruesit të kërkesës në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit, Gjykata konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar.

Rrjedhimisht, Gjykata në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) dhe 57 (5) të Rregullores së punës vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI71/20

Parashtrues

Etem Arifi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 380/2019, të 30 janarit
2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Etem Arifi, të cilin e përfaqëson Kujtim Kërveshi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Pml.nr.380/19, të 30 janarit 2020. Përmes Aktgjykimit të kontestuar ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.740/2016 të 20 prillit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.328/19 të 20 gushtit 2019. [Sqarim: Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, numri

i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.328/19 të 20 gushtit 2019, rezulton të jetë i shënuar gabim, duke u thirrur në Aktgjykimin e parë të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.328/2018 të 28 marsit 2019. Kjo vërehet nga përmbajtja e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 380/19, të 30 janarit 2020 si dhe nga Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë e parashtruar në Gjykatën Supreme nga parashtruesi i kërkesës.]

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Në të njëjtën kohë parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon edhe vendosjen e masës së përkohshme duke theksuar se: *“jemi afër datës e cila është caktuar që Parashtruesi të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit e që është 04.05.2020, caktimi i masës së përkohshme nga ana e Gjykatës Kushtetuese është i domosdoshëm dhe me rëndësi jetike për Parashtruesin e kërkesës”.*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 prill 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët:

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).

8. Më 29 maj 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 3 qershor 2020, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrim të rastit dhe kërkoi nga ajo që në afat prej shtatë (7) ditësh të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
10. Më 5 qershor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
11. Më 1 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë *“Kërkesë për trajtim me urgjencë të kërkesës për masë të përkohshme”*.
12. Më 23 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.
13. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 9 dhjetor 2016, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ngriti Aktakuzë PPS.nr.158/2014 kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale *“Mashtrim me subvencione”* nga neni 336, paragrafi 3 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) si dhe veprën penale *“ushtrim i ndikimit”*, nga neni 431, paragrafi 1 i KPRK. Me të njëjtën Aktakuzë për veprën penale *“Mashtrim me subvencione”* nga neni 336, paragrafi 3 në lidhje me nenin 31 të KPRK, në bashkëkryerje ishte akuzuar edhe personi B.G.
15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për hedhjen poshtë të Aktakuzës dhe kundërshtimin e provave në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), duke pretenduar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

16. Më 28 qershor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit PKR.nr.740/16, refuzoi kërkesën e parashtruesit për hedhjen e Aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.
17. Më 18 shtator 2017, parashtruesi i kërkesë, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit PKR.nr.740/16 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës, *inter alia*, në ankesë kishte theksuar se “Gjykata [Themelore] e ka anashkaluar faktin e rëndësishëm të paraqitur në aktakuzën në fjalë. Pretendimet e Prokurorisë Speciale të përshkruara në aktakuzë përshkojnë periudhën dhjetor të vitit 2012 deri në korrik të vitit 2013 brenda së cilës sistemi juridik në Kosovë ka pësuar reformin radikal. [...] është shumë e rëndësishme përcaktimi i saktë i kohës dhe vendit të kryerjes së veprës penale ngase ato e determinojnë veprën, sanksionin penal dhe mbi të gjitha zbatimin e ligjit”.
18. Më 5 tetor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit PN.nr.779/2017 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vlerësuar se pretendimet e tij nuk ishin të bazuara. Lidhur me pretendimin specifik të lartpërmendur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit në Aktvendimin PN.nr.779/2017 arsyetoi me sa vijon: “pretendimet ankimore nuk janë të bazuara. Qëndron fakti se koha e kryerjes së veprës penale dhe vendi i kryerjes janë tipare të veprës penale, mirëpo pretendimet në këtë drejtim janë të pabazuara ngase në dispozitiv të aktakuzës ceket edhe koha edhe vendi i kryerjes ku pretendohet se janë kryer veprat. Po ashtu është evidente se sipas akuzës pretendohet se i pandehuri nga muaji dhjetor i vitit 2012 deri në korrik të vitit 2013 i ka keqpërdorur subvencionet e pranuar, por nga kjo nuk mund të konkludohet se ligji penal është zbatuar gabimisht, ngase veprimet e fundit janë ndërmarrë gjatë vitit 2013(veprimet inkriminuese janë ndërmarrë nga 20.12.2012 deri me 30.07.2013) dhe vepra penale është cilësuar sipas Kodit Penal që ka hyrë në fuqi po këtë vit (viti 2013), ndërsa cili ligj është më i favorshëm është në përdorim mbetet çështje që Gjykata do ta vlerësoj [...]”.
19. Më 20 prill 2018, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR.740/16, përmes së cilit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerje, në bashkëkryerje, të veprës penale “*Mashtrim me subvencione*” nga neni 336.3 i KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Me atë rast, Gjykata Themelore e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, me kusht në qoftë se brenda afatit kohor prej tri (3) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Gjykata Themelore, gjithashtu e obligoi parashtruesin e kërkesës dhe të

dënuarin tjetër që në mënyrë solidare t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar prej: (i) 22.900 euro - Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS); dhe (ii) 2.749 euro - Zyrës së Kryeministrit. Kompensimi u urdhërua të bëhet me këste në afat prej gjashtë (6) muajsh.

20. Sa i përket akuzës për kryerjen e veprës penale “*ushtrim i ndikimit*”, nga nenin 431.1 i KPRK, Gjykata Themelore e liroi nga akuza parashtuesin e kërkesës me arsyetimin se “*nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet barrë*”.
21. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e lartcekur dënues [PKR.740/16] ndër të tjera theksoi “[...]Në bazë të marrëveshjes paraprake dhe në bashkryerje, nga muaji dhjetor i vitit 2012 e deri në korrik të vitit 2013, kanë përdorur në kundërshtim me ligjin subvencionet e pranuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për tri projekte për edukimin dhe integrimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian në shumë të përgjithshme prej 22.900,00 si dhe subvencionin nga Zyra e Kryeministrit për integrim shumë prej 2,749.00 € [...] i pandehuri Etem Arifi [parashtuesi i kërkesës] ka ushtruar ndikim te zyrtarët të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për dhënien e subvencioneve, edhe pse ka ditur që kjo OJQ është organizatë fiktive [...]. Kështu bazuar në provat e siguruar me aplikimin e masave të fshehta regjistrimin e hyrje daljeve dhe përmbajtjet e SMS-ve për numrat e telefonit të të akuzuarve [B.G] dhe Etem Arifi është vërtetuar se të akuzuarit Etem Arifi dhe [B.G] kanë bashkëpunuar për marrjen e donacioneve nga MPMS si dhe u vërtetua se i akuzuari Etem Arifi ka ndikuar drejtpërdrejtë me mesazhe tek zyrtarët e MPMS-së për të ju ndarë këto donacione OJQ-së [...]”.
22. Më 19 qershor 2018, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar, se sa i përket pjesës fajësuese të Aktgjykimit të lartpërmendur lidhur me sanksionin penal, “*Aktgjykimi i shkallës së parë është i paqëndrueshëm nga aspekti i sanksioneve penale të shqiptuara*” ndërsa lidhur me pjesën liruese të Aktgjykimit të lartpërmendur, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.
23. Më 26 qershor 2018, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [PKR.740/16] parashtuesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të

plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij ndër të tjera kishte argumentuar se: *“zt. Arifi nuk ka qenë personi përgjegjës lidhur me themelimin dhe operimin me buxhetin e OJQ "Zëri i Ashkalinjëve" (ZAI) dhe Gjykata në mënyrë selektive ka bërë vlerësimin duke ja falë besmin dëshmitarëve (sipas zgjedhjes së vet) dhe që në dukje lë përshtypjen se pavarësisht nga provat, dëshmitë dhe ligji e ka mbështetur pretendimin e Prokurorisë se Zt. Arifi domosdo DUHET të dënohet në këtë proces gjyqësor edhe pse, Prokuroria nuk ka ofruar prova për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë ngase, i akuzuari nuk ka pasë rol themeluesi, menxhuesi, personi të autorizuar, për më tepër asnjëherë nuk ka qenë i autorizuar për llogarinë bankare të hapur në emër të ZAI dhe rrjedhimisht nuk ka mund as të tërheqë para nga e njëjta”.*

24. Më 28 mars 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR.nr.328/2018 vendosi që të:

”I. ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore [...] në pjesën gjyqësore sa i përket vendimit për dënimin dhe detyrimin përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale ashtu që kjo Gjykatë [e Apelit] gjen se në veprimet e të akuzuarve Etem Arifi dhe [B.G] të përshkruara në dispozitivin nën I të aktgjykimit formohen elementet e veprës penale mashtrimi në subvencione, nga neni 336 par 3, lidhur me par 2 e 1 të nenit 31 të KPRK dhe për këtë veprë penale i gjykon të akuzuarin me (1) vit e (3) muaj burgim [...] [Pjesa për kërkesën pasurore, Gjykata e Apelit thekson se mbetet e njëjte si në Aktgjykimin PKR.740/16, të 20 prillit 2018, të Gjykatës Themelore].

II. Kurse, aktgjykimi i lartcekur në pjesën liruese përkitazi me të akuzuarin Etem Arifi anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës Gjykatë në rigjykim

III. Ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve refuzohen si të pabazuara.”

25. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj arsyetoi se, Gjykata Themelore me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese, mirëpo ato rrethana nuk mund të konsiderohen të asaj natyre që e arsyetojnë dënimin me kusht, marrë parasysh peshën e veprës penale, dëmin e shkaktuar, dhe faktin se parashtruesi i kërkesës është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sa i përket pjesës liruese të Aktgjykimit PKR.740/16, Gjykata e Apelit theksoi se kjo pjesë kthehet në rigjykim pasi që Gjykata Themelore nuk e ka arsyetuar faktin se pse e ka liruar parashtruesin e kërkesës nga akuza

për kryerjen e veprës penale “*ushtrim i ndikimit*”, nga neni 431.1 i KPRK.

26. Më 14 maj 2019, Gjykata Themelore i kishte dërguar Zyrës së Sanksioneve Penale propozimin për ekzekutimin e dënimit me burg për parashtruesin e kërkesës.
27. Më 22 maj 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit PAKR.nr.328/2018, të Gjykatës së Apelit. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendonte se Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës së Apelit është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale pasi që në përbërjen e Kolegjit të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtarja e cila ka marrë pjesë në përbërje të Kolegjit të Gjykatës së Apelit me rastin e vendosjes sipas Aktvendimit PN.nr.779/2017 të 5 tetorit 2017, lidhur me ankesën përkitazi me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave. Gjithashtu, parashtruesi pretendoi vërtetim të gabuar të fakteve, duke theksuar se Aktgjykimi PAKR.nr.328/2018 është kundërthënësi si dhe pretendoi shkelje të ligjit penal.
28. Më 20 qershor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml.nr.168/2018 miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e anuluar Aktgjykimin PAKR.nr.328/2018 e Gjykatës së Apelit dhe duke e kthyer rastin në rivendosje. Arsyeja bazë mbi të cilën Gjykata Supreme vendosi të pranojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar ishte pikërisht pjesëmarrja e gjyqtarës e cila është dashur të përjashtohet, sipas Gjykatës Supreme dhe sipas pretendimit të parashtruesit. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme theksoi se “*nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet, e që kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar.1.2 te KPPK-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë*”.
29. Më 20 gusht 2019, Gjykata e Apelit, duke vepruar në rigjykim, nxori Aktgjykimin PAKR.nr.328/19. Përmes tij, Gjykata e Apelit vendosi me sa vijon:

“I. Me aprovimin e ankesë së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR-ne Prishtine, PKR.nr.740116 i datës 20.04.2018 në pjesën gjyquese sa i përket vendimit mbi dënimin [...], dhe për këtë vepër penale [...] gjykon të akuzuarin Etem Arifi me 1 vit e 3 muaj burgim [...].

II. *Të akuzuarit Etem Arifi e [B.G], obligohen ti kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ne emër te dëmit të shkaktuar shumën prej 22.900 Euro, ndërsa Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës-Zyra për Komunitete shumën prej 2.749 Euro, të gjitha në afat prej 3 muajve.*

III. *Me aprovimin e ankesë[s] së PSRK-së, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi në pjesën lirues[e] përkitazi me të akuzuarin Etem Arifi anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore DKR-në Prishtinë në rigjykim.*

IV. *Ankesat te mbrojtësve e te akuzuarve, refuzohen si te pabazuara.”*

30. Lidhur me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit theksoi se *“aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesën e të akuzuarit Etem Arifi [...] e as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin për të kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsyet e mjaftueshme dhe të qarta në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, në veçanti me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale e të akuzuarve për të cilën janë shpallë dhe kjo gjykatë i pranon si të drejta arsyet e paraqitura përkitazi me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor”*.
31. Më 1 nëntor 2019, Gjykata Themelore i kishte dërguar sërish Zyrës së Sanksioneve Penale propozimin për ekzekutimin e dënimit me burg për parashtruesin e kërkesës.
32. Më 18 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij të dytë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Në këtë rast, ai parashtroi kërkesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR.nr.740/16 të 20 prillit 2018 dhe Aktgjykimit PAKR. nr. 328/19 të Gjykatës së Apelit të 20 gushtit 2019, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Në kërkesën e tij të dytë për mbrojtje të ligjshmërisë parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike pretendoi si në vijim:
 - (i) Aktgjykimet të cilat i konteston janë të pakuptueshme kundërthënës dhe se të njëjtat nuk janë të arsyetuara dhe se nuk janë paraqitur arsyet në lidhje me faktet vendimtare;

- (ii) Veprimet e tij në asnjë mënyrë nuk përbëjnë vepër penale për arsye se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë fare pjesë përbërëse e OJQ-së “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim” as nuk ka kërkuar, nënshkruar, shfrytëzuar përfitimet etj. Nga mjetet monetare të cilat i ka kërkuar dhe përfituar OJQ “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim” me destinimin e definuar me kërkesën e dorëzuar në MPMS, por konstatimi se ka pasur rol bazuar në provat materiale është i paqëndrueshëm;
 - (iii) Vendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, janë bërë me shkelje të ligjit penal kur është fjala tek koha e kryerjes së veprës penale, si element qenësor i figurës së veprës penale. Në këtë aspekt, specifikisht u pretendua se *“çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penale, është e rëndësishë së posaçme praktike ngase nga ky fakt varet se cili ligj do të aplikohet përkatësisht të zbatohet ligji më i favorshëm”*. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta e kanë anashkaluar faktin e rëndësishëm të paraqitur në aktakuzë i cili *“përshkon periudhën dhjetor të vitit 2012 deri në korrik të vitit 2013 brenda së cilës sistemi juridik në Kosovë ka pësuar reformim radikal”*. Ai më tutje pretendon se në aktgjykimet e kontestuar, nuk ka asnjë referencë e cila do ta përcaktonte qartë kohën e kryerjes së veprës penale dhe se cili ligj është zbatuar në rastin konkret;
 - (iv) Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë më tej kishte theksuar *“Parimi i legalitetit i njohur me sintagmën “Nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege” është parim themelor i Kushtetutës së Kosovës, Kodit Penal dhe e përshkon gjithë sistemin juridik të vendit. Andaj, ky parim nuk do të duhej të anashkalohej nga askush [...]”*;
33. Më 27 dhjetor 2019, Prokurori i Shtetit, përmes parashtrësës KMLP.II.nr.263/2019, propozoi që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
 34. Më 30 janar 2020, Gjykata Supreme me Aktgjykimin PML. nr. 380/2019 e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
 35. Së pari Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se veprimet e tij në asnjë mënyrë nuk përbëjnë vepër penale arsyetoi se *“Se i dënuari Etem Arifi, ishte ne dijeni për të gjitha këto, flet fakti se i njëjti kishte komunikuar me telefon dhe personalisht*

gjatë gjithë periudhës prej muajit dhjetor 2012 deri ne korrik te 2013, me te dënuarin [B.G], çka vërtetohet nga transkriptet e "sms-ve" dhe nga vet deklarata e dëshmitares [A.R] si dhe me shikimin ne listën e transaksioneve bankare nga llogaria e OJQ-së. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, ne këtë gjendje faktike drejtë të vërtetuar, drejtë kanë konkluduar se ne veprimet e të dënuarit Etem Arifi formohen elementet e veprës penale mashtrimi ne subvencione nga neni 336 par.3 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenit 31 te KPK, ngase për te kryer këtë vepër penale mjafton qe subvencionet e përfituara me paraqitjen e rreme të fakteve lidhur me selinë, punëtorët dhe programin e OJQ-se, te përdoren për qëllime për te cilat nuk janë dhënë".

36. Së dyti, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se janë bërë me shkelje të ligjit penal kur është fjala tek koha e kryerjes së veprës penale, si element qenësor i figurës së veprës penale, Gjykata Supreme arsyetoi *"Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjën se dispozitivët e aktgjykimeve janë të qartë, nuk kanë kundërthënë as me vetveten as me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë janë të paraqitura të gjitha arsyet të duhura faktike dhe juridike mbi bazën e të cilave është marrë vendimi meritor e te cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Në arsyetim janë dhënë arsye te mjaftueshme ligjore lidhur me të gjitha provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore duke, vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i merr të provuara ose si te paprovuara dhe duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore e konform dispozitës së nenit 370 par. 7 te KPPK-se. Nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari Etem Arifi dhe [B.G] janë shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi me subvencione në bashkëkryerje nga neni 336 par.3 lidhur me nenin 2 dhe nenin 31 të KPK, dhe se të njëjtit nga muaji dhjetor i vitit 2012 e deri ne korrik 2013, pasi që me parë kanë qenë në raporte miqësore, njëkohësisht i dënuari Etem Arifi ishte Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Kryetar i Partisë se Ashkalinjëve, kanë vendosur që të themelojnë OJQ " Zëri i Ashkalinjeve për Integritet [...] Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, në këtë gjendje faktike drejtë të vërtetuar, drejtë kane konkluduar se në veprimet e të dënuarit Etem Arifi formohen elementet e veprës penale mashtrimi me subvencione nga neni 336 par.3 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenit 31 te KPK, ngase për të kryer këtë vepër penale mjafton që subvencionet e përfituara me paraqitjen e rreme të fakteve lidhur me selinë, punëtorët dhe programin e OJQ-se, të përdoren për qëllime për të cilat nuk janë dhënë. Pra nuk është i bazuar pretendimi se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit kur është shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi në subvencione*

nga neni 336 par.3 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenit 31 të KPK. Po ashtu kjo gjykate gjen se drejt është aplikuar Kodi Penal i Kosovës i cili ka hyrë në fuqi me 01.01.2013, sepse vepra penale është kryer nga muaji dhjetor i vitit 2012 deri në korrik të vitit 2013. Tek veprat penale të cilat kryhen në vazhdim, si kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet veprimi i fundit i inkriminuar, e konform nenit 9 të KPK, kjo edhe merret si bazë për përcaktimin se cili ligj do të zbatohet. Në rastin konkret meqenëse veprimi i fundit është kryer në korrik të vitit 2013, me të drejtë është zbatuar Kodi Penal i Kosovës i cili ka hyrë në fuqi me 01.01.2013”.

37. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë një kërkesë për shtyerjen e ekzekutimit të sanksionit penal/dënimit me burg për shkak të problemeve shëndetësore.
38. Më 4 mars 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit Ed. nr. 2035/19, aprovoi kërkesën e parashtruesit dhe vendosi që të shtyhet fillimi i ekzekutimit të dënimit ndaj parashtruesit, deri më 4 maj 2020.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi PML. nr. 380/2019 i Gjykatës Supreme i 30 janarit 2020, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ.
40. Parashtruesi i kërkesës konsideron se shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ka ndodhur si pasojë e: (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike; (ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor; (iii) mos prezencës së parashtruesit të kërkesës në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit.

i) Sa i përket cenimit të parimit të sigurisë juridike

41. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se “*në kundërshtim me parminin Reformato in Peius, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktgjykimin PAKR.nr.328/19 të datës 20.08.2019, afatin për kompensimin e dëmit të shkaktuar, e zvogëlon nga 6 muaj në 3 muaj. Pra në këtë rast, mjet juridik kundër Aktgjykimit (me 6 muaj afat pagese) kishte paraqitur vetëm z. Etem Arifi dhe pasi që i ishte aprovuar Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë dhe gjykata e Apelit kishte ndryshuar vendimin në dëm të tij.*” Parashtruesi i

kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar dënimin në dëm të tij, dhe sipas parashtruesit kjo mënyrë e veprimit nga ana e Gjykatës së Apelit e cenon parimin e sigurisë juridike.

42. Në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve: *Beian kundër Rumanisë*, Aktgjykimin i 6 dhjetorit 2007, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimin i 29 nëntorit 2016.

ii) Sa i përket mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor

43. Lidhur me këtë pretendim, para së gjithash, parashtruesi i kërkesës konsideron se në vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme “*nuk është bërë sqarimi ndërmjet gjetjeve në merita dhe vlerësimeve lidhur me provat e propozuara nga Prokurori i Shtetit dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës nga ana tjetër*”.
44. Më specifikisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare “*ka anashkuar pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës në Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të datës 18.11.2019.*” Sipas tij, Gjykata Supreme “*fare nuk arsyeton pretendimet e mbrojtjes lidhur me kuptimin e shprehjes “Subvencion”*”.
45. Më tutje, ai thekson se Gjykata Supreme nuk i ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me plotësimin e elementeve të veprës penale me të cilën është dënuar. Kjo sepse sipas parashtruesit, KPRK parashihet që vepra penale nga neni 336 “*Mashtrimi me subvencion*” mund të kryhet nëse informacionet që i jep me rastin e aplikimit për subvencion janë të pasakta, fsheh ndonjë informacion ose e shpërdorë subvencionin e tillë. Sipas parashtruesit këto veprime mund t’i kryejë vetëm personi që ushtron veprimtari afariste. Parashtruesi i kërkesës thekson faktin se Gjykata Supreme nuk e bën dallimin në mes të shprehjes së subvencionit dhe grant/transfer, pretendim të cilin ai pohon ta ketë ngritur edhe në gjykatat e rregullta pararendëse.
46. Parashtruesi më tej pretendon se shprehja “Subvencion” në KPRK nuk ka për qëllim përfshirjen e çdo lloji financimi të bërë nga fondet publike. KPRK në nenin 337, theksoi ai, përcakton veprën penale të Mashtimit lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian, apo në nenin 335 përcakton veprën penale të mashtimit. Lidhur me këtë parashtruesi thekson se “*në këtë rast, vepra penale nga neni 336 Mashtrim me subvencion ka qëllim shumë specifik, përkatësisht që të*

mbrojtë kategorinë e Subvencioneve nga keqpërdorimet e mundshme [...]”.

47. Parashtruesi shton se edhe sikur Gjykata Supreme në vendimin e saj të argumentonte lidhur me çështjen e subvencioneve, ai nuk do të mund të ishte kryes i veprës penale të mashtrimit me subvencione, pasi që i njëjti nuk ka aplikuar për marrjen, vazhdimin ose modifikimin e kushteve për marrjen e subvencionit, po që këtë gjë e ka bërë Drejtori i Organizatës Joqeveritare “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim”.
48. Parashtruesi më tej shton se ai *“nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë pozitë në kuadër të OJQ “Zëri i Ashkëlinjëve për Integrim” si dhe aplikimin e ka bërë drejtori i kësaj OJQ [B.G]. Gjithashtu edhe elementet tjera të kësaj vepre penale janë plotësuar nga [B.G] pasi që ai është personi që ka paraqitur të dhëna të pa sakta apo jo të plota dhe pastaj nuk ka zbuluar të dhënat lidhur me shpenzimin e transferit/grantit [...]”. Pra në këtë rast, dështimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për të arsyetuar dallimin e elementeve të veprës penale dhe faktin se kush mund të jetë kryerës i asaj vepre penale përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të paanshëm”.*
49. Në mbështetje të pretendimeve të tij, lidhur me mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore, parashtruesi i kërkesës i është referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht rasteve: KI 146/17, 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe KI 1590/17, me parashtrues *Isni Thaqi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku dhe Jahir Demaku*, Aktgjykim i 30 majit, 2018; KI 135/14, me parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2015; KI 172/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012. Më tej, ai iu është referuar edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), përkatësisht rastit, *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i i 22 shkurtit 2007,; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Papon kundër Francës*, Aktgjykimi i 7 qershorit 2001.

ii) Sa i përket mos prezencës së parashtruesit të kërkesës në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit

50. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta për një proces të rregullt në parim nënkupton të drejtën e palëve për të qenë personalisht të pranishëm në gjykim të rastit të tyre.

51. Ai thekson se *“me rastin e nxerrjes së Aktgjykimit PAKR. 328/2018 të datës 28.03. 2019, Gjykata e Apelit kishte bërë shkelje të nenit 390 të KPPRK-së [Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës] pasi që Etem Arifi[n] nuk e kishte ftuar fare në seancë të kolegjit të apelit. Sipas këtij vendimi z. Etem Arifi dënimi me kusht ju kishte ndryshuar në dënim me burg efektiv [...]”*.
52. Në mbështetje të pretendimeve të tij, lidhur me mos prezencën e parashtruesit në shqyrtimin e rastit të tij në Gjykatën e Apelit, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të kësaj Gjykate: KI104/16, me parshtrues Miodrag Pavić, Aktgjykim i 21 tetorit 2016; si dhe rasteve të GJEDNJ-së: *Fredin kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994; dhe *Ekbatani kundër Suedisë*, Aktgjykim i 26 majit 1988.

Pretendimet përkitazi me masën e përkohshme

53. Siç u theksua dhe më lart, përveç kërkesës kryesore, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur edhe një kërkesë për caktimin e masës së përkohshme nga ana e Gjykatës. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme parashtruesi i kërkesës thekson se duke marrë parasysh *“se jemi afër datës e cila është caktuar që Parashtruesi të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit e që është 04.05.2020, caktimi i masës së përkohshme nga ana e Gjykatës Kushtetuese është i domosdoshëm dhe me rëndësi jetike për Parashtruesin e kërkesës”*.
54. Më tutje, ai theksoi se gjithashtu Gjykata duhet *“vlerësuar statusin të cilin Parashtruesi i kërkesës mban në komunitet si deputet i Republikës së Kosovës për herë të katërt me radhë”*. Në këtë aspekt, ai thekson se *“një zbatim i këtij aktgjykimi [të kontestuar të Gjykatës Supreme] i nxjerre nën shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese, do të bënte që i njëjti të humb mandatin e deputetit si dhe do të privonte Parashtruesin nga liria me muaj e ndoshta edhe me vite dhe si pasojë do të shkaktonte dëme të pariparueshëm për Parashtruesin pasi që asnjë vendim gjyqësorë nuk do të mund të kthente mandatin e deputetit. Për më tepër që shkeljet e të drejtave dhe lirive të Parashtruesit të Kërkesës janë evidente dhe janë paraqitur në arsyetim të kërkesës”*.
55. Lidhur me kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, thekson se Gjykata Themelore me Aktvendimin Ed. nr.2035/19 të 4 marsit 2020, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore të parashtruesit kishte aprovuar kërkesën e tij për shtyrjen edhe për 2 muaj të fillimit të ekzekutimit të dënimit, specifikisht deri më 4 maj 2020.

Kërkesa përfundimtare e parashtruesit të kërkesës drejtuar Gjykatës

56. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë me sa vijon:

- I. TA DEKLAROJ KERKESEN E PRANUESHME;
- II. TE KONSTATOJ se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TE SHPALLE se Aktgjykimi PML.nr. 380/2019 i datës 30.01.2020 i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktgjykimi PAKR.nr. 328/19 i datës 20.08.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës janë të pavlefshëm sepse këto Aktgjykime nuk janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
- IV. TA KTHEJE rastin në Gjykatën e Apelit të Kosovës në rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese
- V. TE URDHEROJE Gjykatën e Apelit të Kosovës që ta informoj Gjykatën Kushtetuese sa më shpejtë që është e mundur, por jo me larte se 6 muaj, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës;
- VI. TE MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhëri;
- VII. T'UA KUMTOJ këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJ këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 24 (4) të Ligjit;
- IX. TE DEKLAROJ se ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të

arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

5. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Kodi i Përkohshëm i Republikës së Kosovës R 2003/25

Neni 262

MASHTRIMI LIDHUR ME SUBVENCIONET

Kushdo që i jep informacion të pasaktë ose jo të plotë një organi kompetent që është thelbësore për të dhënë subvencion nga organi kompetent, e fsheh informacionin e tillë në kundërshtim me detyrimin për t'ia zbuluar informacionin e tillë autoritetit kompetent ose e shpërdoron një subvencion të tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kodi Penal Nr. 04/L-082 i Republikës së Kosovës (KPRK)

Neni 3

Zbatimi i ligjit më të favorshëm

1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

[...]

Neni 9

Koha e kryerjes së veprës penale

Vepra penale kryhet në kohën kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja

Neni 336

Mashtrimi me subvencione

1. Kushdo që në lidhje me aplikimin për marrjen, vazhdimin ose modifikimin e kushteve për marrjen e një subvencionit, i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta apo jo të plota, e që është kusht për aprovimin, vazhdimin apo modifikimin e subvencionit, ose fsheh të dhënat e tilla në kundërshtim me detyrimin për të zbuluar të dhënat e tilla organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që përdor subvencionin e tillë në shkelje të ligjit ose për tjera qëllime nga ato për të cilat është dhënë subvencioni nga dhënësi i subvencionit, dënohet me gjobe ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1.ose 2.i këtij neni rezulton në dobi pasurore ose në dëm pasuror që tejkalon shumë prej njëzetepesëmijë (25.000)Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë(8) vjet.

4. Për qëllim të këtij neni, shprehja “subvencion” do të thotë dobi nga fondet publike sipas ligjit të Republikës së Kosovës, që së paku

pjesërisht jepet pa konsiderata që lidhen me tregun dhe që synon stimulimin e ekonomisë.

Neni 435

Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme

1. Personi zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se që është dashur, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

2. Nëse vlera e pagesës apo dërgesës nga paragrafi 1.i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000)Euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1.i këtij neni është e dënueshme.

Neni 436

Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Pranueshmëria e kërkesës

57. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
58. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

59. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

60. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 380/19 të 30 janarit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i ka sqaruar pretendimet e tij për ato të drejta dhe liri që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet që kërkojnë nga neni 48 i Ligjit. Ai po ashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
61. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të

pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

62. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ.
63. Në thelb, parashtruesi i kërkesës ngritë tre pretendime kyçe që ndërlidhen me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Së pari, ai pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike, ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor, dhe (iii) mos prezencës së tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit.
64. Thënë këtë, Gjykata në vijim do t'i elaborojë pretendimet e lartcekura në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat janë interpretuar tashmë në detaje përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Përkritazi me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike

65. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“në kundërshtim me parimin Reformato in Peius, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. Nr. 328/19 të datës 20.08.2019, afatin për kompensimin e dëmit të shkaktuar, e zvogëlon nga 6 muaj në 3 muaj.”* Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar dënimin në dëm të tij, dhe sipas parashtruesit kjo mënyrë e veprimit nga ana e Gjykatës së Apelit e cenon parimin e sigurisë juridike.

66. Gjykata pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe dosjes së plotë të rastit, vëren se parashtruesi po e ngritë këtë pretendim për herë të parë para Gjykatës Kushtetuese.
67. Gjykata vëren se në kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar në Gjykatën Supreme janë pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Megjithatë, asnjëra prej pretendimeve në fjalë nuk ngritë as formalisht e as në substancë çështje që ndërlidhen me pretendimin për shkeljen e parimit *Reformatio in Peius*.
68. Lidhur me këtë pretendim specifik të parashtruesit, Gjykata vëren së në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, lidhur me këtë pretendim ishte theksuar se *“Tutje e vërteton pjesën e dytë të paragrafit nën I Aktgjykimimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.740/16 të 20.04.2018 (shkalla e parë) sa i përket detyrimit për kompenzimin në mënyrë solidare në afat prej (3) muajve”*.
69. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta duhet t'u jepet mundësia që të vendosin për çështjen që është duke u shqyrtuar nga ato. Kjo do të thotë që një shkelje e pretenduar kushtetuese, në parim, nuk duhet të lejohet të arrijë në Gjykatën Kushtetuese, pa u shqyrtuar më parë nga gjykatat e rregullta.
70. Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në *“substancë”* para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dy kuptimet, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 94).
71. Marrë parasysh rrethanat në të cilat sipas shkresave të lëndës rezulton se ky pretendim specifik i parashtruesit të kërkesës është ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës

nuk u ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, në mënyrë specifike Gjykatës Supreme, të adresojnë këto pretendime dhe me këtë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngritë drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39).

72. Gjithashtu, Gjykata në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës të cilin e ka ngritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta, me pretendimin se është bërë shkelje e ligjit penal kur është fjala tek koha e kryerjes së veprës penale, si element qenësor i figurës së veprës penale dhe përdorimin e gabuar të ligjit, Gjykata rikujton nenin 9 të KPRK-së, i cili përcakton si në vijim:

Neni 9

Koha e kryerjes së veprës penale

Vepra penale kryhet në kohën kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja.

73. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka sqaruar qartësisht në arsyetimin e Aktgjykimit PML.nr.380/2019 të 30.01.2020, ku mes tjerash kjo Gjykatë gjen dhe evidenton, se drejtë është aplikuar Kodi Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013, ngase vepra penale është kryer nga muaji dhjetor 2012 deri në korrik 2013, dhe rrjedhimisht te veprat penale që kryhen në vazhdim, si kohë e kryerjes së veprës penale konsiderohet veprimi i fundit inkriminues, e konform nenit 9 të KPK-së, ky veprim merret si kohë e kryerjes së veprës penale.
74. Prandaj, nën dritën e asaj që u tha më lart, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur këtë pretendim të tij.
75. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij dhe të paraqesë prova *prima facie* për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, e 5 dhjetorit 2013).

Përkitazi me pretendimin për mos-arsyetim të vendimit gjyqësor

76. Fillimisht, Gjykata rikujton përmbajtjen e pjesëve relevante të nenit të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së që garantojnë të drejtën e çdo parashtruesi për vendim të arsyetuar gjyqësor:

77. Neni 31, i Kushtetutës përcakton:

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. [...]

78. Neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së parasheh që:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë. [...].”

79. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk i ka adresuar pretendimet e tij të paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me plotësimin e elementeve të veprës penale me të cilën është dënuar. Kjo sepse, sipas parashtruesit, KPRK parasheh që vepra penale nga neni 336 “*Mashtrimi me subvencion*” mund të kryhet nëse informacionet që i jep me rastin e aplikimit për subvencion janë të pasakta, fsheh ndonjë informacion ose e shpërdorë subvencionin e tillë, dhe e njëjta mund të kryhet vetëm nga personi që ushtron veprimtari afariste. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës nuk mund të jetë kryes i veprës penale të mashtrimit me subvencione, pasi që i njëjti nuk ka aplikuar për

marrjen, vazhdimin, modifikimin e kushteve për marrjen e subvencionit, por këtë e ka bërë Drejtori i Organizatës Joqeveritare “Zëri i Ashkalinjëve për Integritim”. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës nënvizon se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshinë edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

80. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ, e cila ka vlerësuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ, gjykatat e tyre duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*” (shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45, shih rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 majit 2018, paragrafi 54).
81. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ, edhe kjo Gjykatë, në një mori rastesh, ka theksuar se megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit, gjykatat kanë për obligim të adresojnë pretendimet qendrore për rastet para tyre (shih, *mutatis mutandis*, rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53). Në këtë aspekt, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih *mutatis mutandis* rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).
82. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vëren që Gjykata Supreme e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Arsyet për refuzim të kërkesë së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme i kishte bazuar në dispozita përkatëse të KPRK që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe përkitazi me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
83. Së pari, përkitazi me pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme nuk i ka adresuar pretendimet e tij të paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me plotësimin e elementeve të veprës penale me të cilën është dënuar,

Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme e cila arsyeton:

“Nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari Etem Arifi dhe [B.G.] janë shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi ne subvencione në bashkëkryerje nga neni 336 par.3 lidhur me nenin 2 dhe nenin 31 të KPK, dhe se të njëjtit nga muaji dhjetor i vitit 2012 e deri ne korrik 2013, pasi që me parë kanë qenë në raporte miqësore, njëkohësisht i dënuari Etem Arifi ishte Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Kryetar i Partisë së Ashkalinjëve, kanë vendosur që të themelojnë OJQ "Zëri i Ashkalinjeve për Integritim". [...]
Në momentin që Zyra e Kryeministrit kishte kërkuar një raport rreth shpenzimeve te subvencioneve te pranuar kishin filluar hetimet për keqpërdorimin e këtyre fondeve. Nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari Etem Arifi dhe [...] , kishin biseduar për hapjen e kësaj OJQ-je dhe se OJQ-ja ishte fiktive, meqenëse asnjëherë nuk kishte funksionuar konform statutit të saj për me tepër nuk kishte seli, nuk kishte punëtor të cilët punonin, edhe pse deshmitarja [A.R.] dhe vajza e te dënuarit, [A.A.] janë paguar si punëtorë te kësaj OJQ.

Se i dënuari Etem Arifi, ishte ne dijeni për te gjitha këto, flet fakti se i njëjti kishte komunikuar me telefon dhe personalisht gjatë gjithë periudhës prej muajit dhjetor 2012 deri ne korrik te 2013, me te dënuarin [B.G.], çka vërtetohet nga transkriptet e "sms-ve" dhe nga vet deklarata e dëshmitares [A.R.] si dhe me shikimin ne listën e transaksioneve bankare nga llogaria e OJQ-së.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, ne këtë gjendje faktike drejtë të vërtetuar, drejtë kanë konkluduar se ne veprimet e të dënuarit Etem Arifi formohen elementet e veprës penale mashtrimi ne subvencione nga neni 336 par.3 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenit 31 te KPK, ngase për te kryer këtë vepër penale mjafton qe subvencionet e përfituara me paraqitjen e rreme të fakteve lidhur me selinë, punëtorët dhe programin e OJQ-se, te përdoren për qëllime për te cilat nuk janë dhënë.”

84. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet edhe Aktgjykimit PAKR.nr.328/19 të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit ishte konstatuar se Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjithashtu, në arsyetimin e saj Gjykata e Apeli kishte konstatuar se Gjykata

Themelore ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta në të cilat e ka bazuar zgjidhjen e rastit dhe se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike. Në veçanti, përkritazi me çështjen e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale, Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktgjykimit ndër të tjera kishte theksuar se: *“pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën mbështet në tërësi përfundimin e drejt dhe logjik të gjykatës së shkallës së parë për vërtetimin e drejt dhe të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjen e të akuzuarve penalisht përgjegjës për veprimet e tyre për kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe arsye të dhëna në këtë drejtim, por detyrimisht konstaton se gabimisht është zbatuar ligji penal kur të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar janë shpallur fajtor për veprën penale mashtrim me subvencione nga neni 336 par 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Kjo për faktin se siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe dispozitivi i aktgjykimimit të ankimuar te akuzuarit Etem Arifi dhe[B.G], subvencionet e dhëna në emër të OJQ-se "ZAI" , nuk i kanë përdorur për qëllimet për të cilat janë dhëna prandaj, në veprimet e tyre përmbushen elementet qenësore të veprës penale nga neni 336 par.3 lidhur me par.2 dhe 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-se, e jo vetëm te veprës penale nga neni 336 par.3, por edhe dashur të ndryshohet cilësimi juridik në harmoni me ligjin penal. Sa i përket vendimit mbi dënimin Prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka vlerësuar rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese dhe me këtë rast për të akuzuarit ka vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se të akuzuarit nuk kanë qenë të dënuar më parë, rrethanat familjare, qëndrimin e tyre korrekt në gjykatë. Mirëpo, gjykata me asnjë fjalë të vetme nuk e ka arsyetuar shqiptimin e dënimit nën kufirin e paraparë me ligj gjegjësisht shqiptimin e dënimit me kusht pasi që vepra penale Mashtrimi me subvencione është e dënueshme me burg prej 1 deri 8 vite gjë që tregon për intensitetin e rrezikshmërisë të veprës për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, në rastin konkret rrezikshmëria e veprës se kryer manifestohet nga cilësia e kryerësve të veprës penale në shoqëri, motivi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale”.*

85. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 380/19, i 30 janarit 2020 është i qartë dhe adreson pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Nuk ka ndonjë argument thelbësor të cilin Gjykata Supreme e ka lënë mënjanë si të paarsyetuar, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

86. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, kur parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën e kryer penale; ankesën e tij të parashtruar në Gjykatë të Apelit; ankesën e Prokurorisë Speciale; arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit; si dhe kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme.

87. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme plotëson të gjitha standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.

88. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, në refuzimin e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatave më të ulëta, në këtë rast Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore (shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59-60).

89. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore – me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte shkelje esenciale të procedurës penale dhe ligjit penal (shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106).

90. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës për sa i përket zbatimit të të drejtës materiale dhe procedurale (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr.

63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25, shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 107). Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të vetë kësaj Gjykate.

91. Në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata vëren se në pretendimet e tij, të parashtruara në Gjykatë, kryesisht ngrit çështje të ligjshmërisë.
92. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz* kundër *Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
93. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat* kundër *Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
94. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vetë gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat

pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktgjykimit të kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ.

Përkitazi me pretendimin për mos prezencën e parashtruesit të kërkesës në seancën e shqyrtimit në Gjykatën e Apelit

95. Sa i përket këtij pretendimi, Gjykata rikujton pohimin e parashtruesit se *“me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit PAKR. 328/2018 të datës 28.03. 2019, Gjykata e Apelit kishte bërë shkelje të nenit 390 të KPPRK-së pasi që Etem Arifi nuk e kishte ftuar are në seancë të kolegjit të apelit. Sipas këtij vendimi z. Etem Arifi dënimi me kusht ju kishte ndryshuar në dënim me burg efektiv”*.
96. Nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se kundër Aktgjykimit PAKR nr.328/2018, të Gjykatës së Apelit, të 28 marsit 2019 parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
97. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml.nr. 1628/2018, kishte aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe e kishte anuluar Aktgjykimin PAKR. nr.328/2018 e Gjykatës së Apelit, për shkak të përbërjes së trupit gjykues.
98. Rrjedhimisht, Aktgjykimi PAKR. nr.328/2018 i Gjykatës së Apelit, ishte bërë i pavlefshëm.
99. Gjykata vëren se, Gjykata e Apelit, duke vepruar në rigjykim me anë të Aktgjykimit PAKR.nr.328/19, të 20 gushtit 2019, në seancën e mbajtur shqyrtuese ishte prezent edhe parashtruesi i kërkesës. Në këtë pikë, Gjykata i referohet Aktgjykimit PAKR.nr.328/19, të 20 gushtit 2019 të Gjykatës së Apelit ku ndër të tjera theksohet se *“Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit me datë 20.08.2019 në të cilën ishin prezent i akuzuari Etem Arifi me mbrojtësen Av. Merita Stublla-Emini”*.
100. Në dritën e krejt kësaj që u sqarua më lart, nga ajo që del nga dosja e rastit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte i ftuar dhe ishte prezent në seancën shqyrtuese të mbajtur në Gjykatën e Apelit.
101. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit lidhur me mos prezencën e tij në Gjykatën e Apelit, në shqyrtimin e rastit të tij është i pabazuar.

102. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

103. Gjykata rikujton që parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, duke theksuar *“jemi afër datës e cila është caktuar që Parashtruesi të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit e që është 04.05.2020, caktimi i masës së përkohshme nga ana e Gjykatës Kushtetuese është i domosdoshëm dhe me rëndësi jetike për Parashtruesin e kërkesës.*
Po ashtu duhet vlerësuar statusin të cilin parashtruesi i kërkesës mban në komunitet si deputet i Republikës së Kosovës për herë të katërt me radhë, konsiderojmë se një zbatim i këtij aktgjykimi i nxjerrë nën shkeljen të drejtave dhe lirive kushtetuese, do të bënte që i njëjti të humb mandatin e deputetit si dhe do të privonte Parashtruesin nga liria me muaj e ndoshta edhe me vite dhe si pasojë do shkaktonte dëme të pariparueshme për Parashtruesin pasi që asnjë vendim gjyqësorë nuk do të mund ti kthente mandatin e deputetit“.
104. Megjithatë, Gjykata sapo konkludoi që kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.
105. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, pasi e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit pasi kërkesa u shpall e papranueshme.

Përfundim

106. Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se procedurat përkatëse të ndjekura nga gjykatat e rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. Ai po ashtu nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se Aktgjykimi PML. nr. 380/2019 i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
107. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Kjo për faktin, se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë

pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkeljet e pretenduara kushtetuese.

108. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me Rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Në të njejtën linjë arsyetimi, Gjykata refuzoi edhe kërkesën për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, më 23 shtatorit 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

**KI88/20, Parashtrues i kërkesës: Klubi i Futbollit “Liria”,#
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komitetit Ekzekutiv
të Federatës së Futbollit të Kosovës, nr. 272/2, të 2 qershorit 2020**

KI88/20, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 shtatorit 2020, publikuar më 28 tetor 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, mosshërim i mjeteve juridike, parimi i subsidiaritetit, kërkesë e papranueshme

Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, nr. 272/2, të 2 qershorit 2020, për të cilin, sipas parashtruesit të kërkesës, pretendohet se është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

Gjykata vërejtë se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesë kushtetuese e që paraprakisht nuk ka ushtruar ankesë në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik të Kosovës.

Gjykata vërejtë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të parakohshme dhe se Gjykata, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, nuk mund t'i vlerësojë këto pretendime pa qenë paraprakisht të ngritura dhe të vlerësuara nga gjykatat e rregullta.

Gjykata po ashtu vërejtë se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë çdo gjë që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tij në lidhje me shërimin e mjeteve juridike apo se ekzistojnë rrethana të veçanta që e lirojnë parashtruesin e kërkesës nga obligimi për shërimin e të gjitha mjeteve juridike.

Gjykata konkludoi se kërkesa në baza kushtetuese për shkak të mosshërimit të të gjitha mjeteve juridike, duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI88/20

Parashtrues

Klubi i Futbollit “Liria”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komitetit Ekzekutiv
të Federatës së Futbollit të Kosovës,
272/2, të 2 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Klubi i Futbollit “Liria” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Robert Gjeraj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës 272/2, të 2 qershorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta)

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 16 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Federatën e Futbollit të Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.
8. Më 30 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 maj 2020, Komitetit Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Komitetit Ekzekutiv i FFK-së) vendosi që të lejohen aktivitetet për vazhdimin e procesit stërvitor dhe të zhvillohen garat e Superligës në futboll. Gjithashtu, Komitetit Ekzekutiv i FFK-së ndaloj zhvillimin e ndeshjeve të Ligës së Parë dhe ligave të tjera futbollistike, duke lejuar kështu vetëm zhvillimin e ndeshjeve të Superligës.

10. Më 29 maj 2020, parashtruesi i kërkesës paraqit ankesë tek Komitetit Ekzekutiv i FFK-së, kundër vendimit të lartëcekur, me arsyetimin se ky i fundit ka diskriminuar Ligën e Parë në raport me Superligën, duke shkelur kështu statutin e FFK-së dhe rregulloren e garave. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që vendimi i 27 majit 2020 i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, të anulohet dhe të aprovohet ankesa e tyre, ashtu që të rifillojë kampionati i Ligës së Parë.
11. Më 2 qershor 2020, Komitetit Ekzekutiv i FFK-së, përmes vendimit 272/2, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin paraprak të 27 majit 2020.
12. Në arsyetimin e Vendimit të tij, Komitetit Ekzekutiv i FFK-së arsyetoi se:

“[...] Ministria e Shëndetësisë, më datë 18.05.2020, duke u bazuar në rekomandimet e IKSHPK ka nxjerrë Vendim nr. 495/2/V/2020, me numër protokolli 05-2698/2, me te cilin ka vendosur që të lejohen aktivitetet për vazhdimin e procesit stërvitor të ekipeve të Supër ligës së Federatës së Futbollit të Kosovës, dhe ka obliguar Federatën e Futbollit të Kosovës, që t'i përmbahet Udhëzuesit të Përkohshme për aplikimin të masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet publike dhe private. Me anë të Vendimit nr. 495/2/V/2020, numër protokolli 05-2698/2, të datës 18.05.2020, Ministria e Shëndetësisë, ka shfuqizuar Vendimin nr.495/v/2020, me numër protokolli 05-2698 të datës 17.05.2020. Nisur nga kjo gjendje faktike, Komitetit Ekzekutiv ka ardhur në përfundim se Vendimi i Atakuar nga ana e Ankuesit është vendimi i ligjshëm, dhe i njëjti nuk është i përfshire në asnjë shkelje të dispozitave juridike. Kompetenca e Komitetit Ekzekutiv, për të vendosur në lidhje me çështjen e garave dhe kalendarit të garave në Republikën e Kosovës, ashtu siç e parasheh nenin 34 pika b e Statutit të FFK-së, e cila parasheh se: ‘Komitetit Ekzekutiv aprovon sistemin e garave dhe kalendarin e garave për Kosovën që duhet të jetë në harmoni me kalendarin e FIFA-së dhe UEFA-së.’”

13. Në fund të arsyetimit, Komitetit Ekzekutiv i FFK-së këshilloi parashtruesin e kërkesës si në vijim:

“Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur, brenda afatit prej 15 ditësh mund të parashtroj ankesë pranë Komisionit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik të Kosovës.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, 272/2, i 2 qershorit 2020, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
15. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Komitetit Ekzekutiv i FFK-së me vendimin e 27 majit 2020 ka shkelur nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, *“duke diskriminuar futbollistët e Ligës së Parë ndaj atyre të Superligës. Vendimi i FFK-se nuk na sheh te barabarte duke e vazhduar vetëm ndeshjet e Superligës, ndërsa ndeshjet e ligës së Parë e ndalon pa arsye dhe duke na shkelur të drejtat tona. Po ashtu Federata e Futbollit të Kosovës ka bërë shkelje edhe të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 32 thotë; Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Këtu vendimi i FFK-se i datës 27.05.2020 nuk e njehe të drejtën e mjetit juridik, pra ankesës. Vendimi i FFK -se nuk le vende për ankesë duke e shkelur njërin nga të drejtat e njeriut, pra nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

18. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

"4. Te drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridike, për aq sa janë të zbatueshme."

19. Fillimisht, Gjykata vë në pah se parashtuesi i kërkesës (si person juridik) ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridike (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtuesi i kërkesës *Universiteti AABRIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).

20. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç parashikohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parasheh:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngrit kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

21. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar."

22. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i obligon personat fizikë dhe juridikë që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive që janë të disponueshme, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
23. Në këtë mënyrë, organeve administrative dhe gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të parandalojnë dhe korrigjojnë shkeljet eventuale kushtetuese përmes procedurave të rregullta administrative dhe gjyqësore, para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete juridike efektive për parandalimin, përkatësisht korrigjimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të mekanizmit të drejtësisë kushtetuese (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI67/19, parashtgues *Hajrije Rina Zhitija Ajeti*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafi 34; KI09/19, parashtgues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 marsit 2020, paragrafi 36; KI30/17, parashtgues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; dhe KI94/14, parashtgues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
24. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje qëndrimin konsistent se mekanizmi mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese ka karakter subsidiar, në raport me sistemin e rregullt gjyqësor (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI15/16, parashtguesi i kërkesës *Ramadan Muja*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 marsit 2016, paragrafi 42).
25. Në këtë sfond, Gjykata thekson se në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtguesi i kërkesës duhet të ketë mundësi të shfrytëzojë mjetet juridike të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të korrigjuar shkeljet e pretenduara kushtetuese. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm. Kjo është në përputhje edhe me praktiken e GJEDNJ, lidhur me detyrimin e parashtguesëve të kërkesave për të shterruar mjetet juridike (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 19 shkurtit 1998).

26. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse mjetet juridike janë shteruar dhe, nëse jo, a kishte parashtruesi i kërkesës në dispozicion mjet juridik efektiv, në teori dhe praktikë. Pra, Gjykata duhet të sigurojë që mjeti juridik ka qenë i qasshëm dhe ka ofruar mundësi të arsyeshme të korrigjohë shkeljet eventuale kushtetuese të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (shih, po ashtu, rastin e lartcekur të Gjykatës nr. KI41/20, parashtrues i kërkesës *Shaqir Krasniqi*, paragrafi 23; dhe shih, *inter alia*, *Civet kundër Francës*, paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
27. Megjithatë, në rastet kur mjeti juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të provojë që mjeti juridik i parashikuar me ligj ishte shteruar, apo për ndonjë arsye ishte i pa qasshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, apo se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shkak të të cilave parashtruesi lirohet nga kërkesa e shterimit të mjeteve juridike.
28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kundër Vendimit të kontestuar të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, 272/2, të 2 qershorit 2020, ekziston mundësia e ushtrimit të ankesës, si mjetit efektiv juridik. Kështu, Gjykata vë në dukje se Vendimi i kontestuar, në udhëzimin juridik, sqaron se “*kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur brenda afatit prej 15 ditësh mund të parashtrojë ankesë pranë Komisionit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik të Kosovës*”.
29. Gjykata vëren pohimin e parashtruesit se “*Vendimi i FFK-së nuk le vend për ankesë duke shkelur njërin nga të drejtat e njeriut, pra nenin 32 të Kushtetutës*”.
30. Por, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se mjeti juridik i referuar në Vendimin e kontestuar – gjegjësisht ankesa pranë Komisionit të Arbitrazhit Sportiv të Komitetit Olimpik të Kosovës – nuk ka qenë i qasshëm dhe efektiv në rastin e tij.
31. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI232/19, Parashtrues i kërkesës: Xhemajl Bajraktari, Kërkesë për për interpretim të nenit 35 pikat 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës

KI232/19, Aktvendim për Papranueshmëri miratuar më 11 nëntor 2020, publikuar më 7 dhjetor 2020

Fjalët kyç: kërkesë individuale, interpretim abstrakt, palë e paautorizuar, kërkesë e papranueshme

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës kërkoi interpretim të nenit 35 pikat 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.

Gjykata theksoi se Kushtetuta nuk parasheh mundësi që individët të mund të ankohen në Gjykatën Kushtetuese, *in abstracto*, për jo-kushtetutshmëri të një Ligji. Individët mund të parashtrojnë kërkesë kushtetuese, sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, që kërkon që parashtruesit të dëshmojnë se janë: (1) palë të autorizuara, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret i një autoriteti publik ose mosveprimi i autoritetit publik, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk është palë e autorizuar, dhe në bazë të nenit 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenit 47.1 të Ligjit dhe të rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës, kërkesa u shpall e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI232/19

Parashtrues

Xhemajl Bajraktari

**Kërkesë për interpretim të nenit 35 pikat 8 dhe 9 të Kontratës
Kolektive të Arsimit të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Xhemajl Bajraktari nga Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston ndonjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për interpretim të nenit 35 pikat 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kontrata Kolektive) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme: MASHT) dhe

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në tekstin e mëtejshëm: SBASHK).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, neni 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin Shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 23 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 prill 2017, MASHT dhe SBASHK nënshkruan Kontratën Kolektive.
10. Kontrata Kolektive është e zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.

Pretendimet e parashtruesit

11. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, por pretendon se atij i janë “shkelur rëndë” të drejtat kushtetuese sepse të drejtat e tij kufizohen për shkak të obligimit të anëtarësimit në SBASHK.

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Anëtarësimi në Sindikatën e Arsimit të Kosovës, bëhet në mënyre vullnetare e jo i obliguar. Në bazë të formulimit të Nenit 35 pika 8 dhe 9, ekzistojnë elemente tendencioze të detyrimit të mësimdhënësve që të njëjtit të anëtarësohen dhe të bëjnë pagesën e anëtarësisë, që më pastaj ti kenë të garantuara të drejtat e parapara në nenin e cituar”*.
13. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë *“Me kërkesën time, kërkoj një INTERPRETIM dhe informim mbi të drejtat e mija, më konkretisht a do t’i gëzoj edhe unë të drejtat e mija si mësimdhënës, pasi që unë të pensionohem, pasi që disa prej të drejtave të shënuara në nenin 35 pika 8 dhe 9, plotësohen pas pensionimit dhe të drejtave të tjera, të cilat janë të shënuara decidivisht në nenin 35 pika 8 dhe 9”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, që përcakton:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

16. Gjykata i referohet neneve 47.1 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që parashikojnë:

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje Juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 39 (1) (a) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.”

18. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nga *“autoritetet publike”*, pasi të kenë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kriter është po ashtu i përcaktuar në nenin 47 të Ligjit.
19. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt të një autoriteti publik që mund të ketë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon t'i jenë cenuar nga ndonjë akt i autoritetit publik, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
20. Në fakt, parashtruesi kërkon interpretim *in abstrakto* të Kontratës Kolektive në lidhje me të drejta e tij si *“mësimdhënës pas pensionimit”* dhe nëse ai mund t'i gëzojë *“disa prej të drejtave të shënuara në nenin 35 pika 8 dhe 9”* të Kontratës Kolektive.
21. Megjithatë, Gjykata bazuar në paragrafin 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
22. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se individët (personat fizikë dhe juridikë), sipas kuptimit të nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nuk kanë të drejtë t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese dhe të

kërkojnë nga ajo të vlerësojë *in abstracto* kushtetutshmërinë e një norme ligjore, apo të ngrenë para saj çështje hipotetike të interpretimit të ligjeve për të cilat nuk janë të autorizuar, sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI60/17, *Parashtrues: KRU “Radoniqi” Gjakovë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 tetorit 2017, paragrafi 30; KI21/19 *Parashtrues Pjetër Boçi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 majit 2019, paragrafi 25).

23. Në këtë drejtim, Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, përkitazi me interpretimin e nenit 113 të Kushtetutës, e cila vë në pah se personat, fizikë apo juridikë, nuk kanë të drejtë të kontestojnë *in abstracto* akte normative të karakterit të përgjithshëm (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI05/17 *Parashtrues Osman Syllanaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 nëntorit 2017; KI102/17 *Parashtrues Meleq Ymeri*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 janarit 2018; KI196/18 *Parashtrues Dardan Bunjaku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 prillit 2019 dhe KI113/19 *Parashtrues Islam Qerimi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 9 korrikut 2020).
24. Pra, sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, Kushtetuta nuk parasheh mundësi që individët të mund të ankohen në Gjykatën Kushtetuese, *in abstracto*, për jo-kushtetutshmëri të një Ligji. Individët mund të parashtrojnë kërkesë kushtetuese, sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, që kërkon që parashtruesit të dëshmojnë se janë: (1) palë të autorizuar, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret i një autoriteti publik ose mosveprimi i autoritetit publik, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (Shih KI113/19 *Parashtrues Islam Qerimi*, cituar më lart, paragrafi 29 dhe referencat e përmendura aty).
25. Gjykata rithekson se kërkesat të cilat në thelb ngrenë çështje të ligjshmërisë, siç është rasti konkret, si rregull, bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me pretendimin dhe interpretimin e legjislacionit relevant për të përcaktuar nëse parashtruesi i kërkesës, si “*mësimdhënës, pas pensionimit, mund t’i gëzojë të drejtat e tij bazuar në dispozitat përkatëse të Kontratës Kolektive*” (shih, KI21/19, *Parashtrues Pjetër Boçi*, cituar më lart, paragrafi 26; dhe po ashtu shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI27/17, *Parashtrues Maliq Zeqiri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 13 nëntorit 2017, paragrafi 24).

26. Gjykata mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë argumentohen në baza kushtetuese dhe bien brenda juridiksionit të saj të përcaktuar me Kushtetutë, pasi që të jenë përmbushur të gjitha kriteret formale dhe procedurale të kërkuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të shtjelluara më lart (shih KI27/17, *Parashtrues Maliq Zeqiri*, cituar më lart, paragrafi 25).
27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e Kontratës Kolektive *in abstrakto* e as të kërkojë interpretim të saj, dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij duhet të shpallet e papranueshme.
28. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi nuk është palë e autorizuar, dhe në bazë të nenit 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenit 47.1 të Ligjit dhe të rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (a) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT		NUMRI I FAQEVE
	A	
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)		7, 464, 467, 469, 470, 565, 628, 629, 669, 717, 1163, 1165, 1167, 1176, 1177, 1187, 1188, 1189, 1190, 1191, 1193, 1201, 1202, 1207, 1208, 1212, 1214, 1215, 1225, 1227, 1234, 1235, 1315, 1317, 1319, 1320, 1321, 1322, 1323, 1324, 1325, 1332, 1333.
Agjencia e Regjistrimit Civil		599, 624, 1023, 1024, 1029, 1031, 1033, 1036, 1037, 1038, 1043, 1053, 1060, 1064, 1065.
Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese		806, 847, 889, 938, 971, 1001, 1023, 1027, 1085, 1109, 1146, 1165, 1184, 1223, 1243, 1271.
Aktvendim për Papranueshmëri		13, 730, 784, 1293, 1317, 1342, 1374, 1405, 1421, 1453, 1462.
<i>Autoritete(t) publike</i>		92, 93, 94, 108, 110, 532, 589, 662, 667, 676, 765, 816, 855, 896, 936, 954, 962, 967, 983, 1010, 1023, 1024, 1025, 1026, 1039, 1044, 1053, 1060, 1061, 1062, 1066, 1067, 1068, 1069, 1070, 1071, 1072, 1077, 1078, 1079, 1080, 1094, 1115, 1119, 1122, 1128, 1153, 1170, 1194, 1228, 1254, 1278, 1302, 1327, 1340, 1342, 1343, 1344, 1351, 1352, 1356, 1357, 1360, 1362, 1367, 1368, 1369, 1370, 1388, 1410, 1438, 1456, 1461, 1464, 1465, 1466.
Avokati i Popullit		5, 9, 58, 59, 60, 61, 62, 75, 77, 90, 108, 109, 134, 137, 148, 153, 155, 156, 157, 171,, 181, 221, 222, 250, 270, 273, 326, 327, 335, 360, 473, 477, 482, 487, 493, 496, 498, 515, 527, 529, 530, 531, 532, 546, 556, 557, 559, 560, 563, 569, 573, 474, 575, 579, 586, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 598, 612, 615, 618, 619, 622, 658, 659, 660, 661, 662, 664, 665, 667, 674,

		677, 679, 689, 690, 699, 702, 705, 710, 714, 723, 775, 1097, 1349, 1350, 1351, 1352, 1353, 1355, 1356, 1360, 1361, 1362, 1365, 1366, 1367, 1368, 1369.
	B	
Barazia para Ligjit		482, 519, 555, 563, 574, 588, 594, 603, 642, 644, 660, 664, 795, 890, 895, 1024, 1028, 1036, 1085, 1107, 1108, 1109, 1111, 1114, 1142, 1143, 1182, 1185, 1193, 1196, 1202, 1221, 1224, 1244, 1249, 1291, 1294, 1298, 1300, 1315, 1318, 1324, 1340, 1343, 1352, 1363, 1365, 1372, 1375, 1381, 1389.
	C	
COVID-19		9, 25, 28, 32, 34, 36, 43, 44, 49, 53, 54, 56, 57, 58, 60, 63, 64, 81, 82, 92, 100, 117, 118, 121, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 132, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 145, 146, 150, 154, 155, 156, 157, 158, 177, 182, 138, 184, 187, 196, 199, 200, 203, 205, 206, 208, 209, 210, 211, 213, 217, 218, 220, 221, 223, 224, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 233, 234, 238, 240, 248, 249, 275, 277, 280, 307, 308, 745, 761, 762, 764, 766, 769, 770, 772, 779, 1455.
	D	
Deputetët		9, 63, 132, 222, 258, 267, 270, 286, 304, 311, 317, 319, 320, 366, 367, 369, 371, 373, 374, 375, 376, 383, 389, 395, 398, 400, 401, 417, 421, 423, 425, 451, 565, 650, 707, 717, 754, 756, 759, 763, 779.
Dorëheqje		295, 260, 264, 285, 287, 291, 298, 299, 305, 308, 318, 319, 323, 328, 330, 334, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 348, 349, 350, 351, 352, 355, 356, 358, 360, 362, 363, 364, 365, 366, 394, 399, 401, 403, 404, 407, 408, 410, 411, 413, 4155, 422, 428, 429, 430, 432, 434, 439, 440, 441,

		445, 453, 454, 458, 625, 641, 670, 760, 764, 765, 769, 773.
	DH	
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS)		5, 462, 1163, 1166, 1167, 1169, 1180, 1185, 1186, 1187, 1188, 1189, 1190, 1192, 1193, 1194, 1195, 1201, 1202, 1207, 1208, 1209, 1212, 1214, 1215, 1216, 1218, 1219, 1221, 1223, 1224, 1225, 1226, 1227, 1230, 1234, 1235, 1237, 1239, 1315, 1316, 1317, 1318, 1319, 1320, 1321, 1322, 1323, 1324, 1325, 1328, 1329, 1331, 1332, 1333, 1335, 1336, 1337, 1338.
	E	
E Drejta		
<i>e punës dhe ushtrimit të profesionit</i>		935, 939, 950, 959.
<i>për jetë private</i>		25, 26, 32, 72, 73, 80, 116, 119, 122, 124, 139, 220, 226, 233, 795, 1023, 1024, 1030, 1042, 1046, 1047, 1055, 1058, 1062, 1082,
<i>në pronë</i>		594, 645, 715, 795, 1084, 1097, 1102, 1163, 1190, 1221, 1315, 1325, 1329, 1332,
<i>për gjykim të drejtë dhe të paanshëm</i>		11, 13, 15, 23, 795, 803, 807, 809, 811, 843, 844, 849, 856, 860, 876, 886, 890, 892, 895, 897, 934, 935, 939, 950, 959, 969, 973, 977, 980, 985, 998, 999, 1000, 1002, 1003, 1012, 1015, 1022, 1024, 1028, 1036, 1084, 1086, 1092, 1097, 1098, 1099, 1101, 1144, 1145, 1147, 1150, 1155, 1162, 1163, 1164, 1166, 1167, 1168, 1169, 1173, 1175, 1182, 1189, 1190, 1193, 1196, 1202, 1220, 1221, 1222, 1224, 1227, 1230, 1238, 1239, 1240, 1244, 1245, 1249, 1251, 1268, 1269, 1271, 1273, 1276, 1281, 1289, 1294, 1298, 1315, 1318, 1324, 1372, 1375, 1381, 1383, 1384, 1389, 1396, 1405, 1409,

		1412, 1418, 1419, 1422, 1431, 1435, 1440, 1444, 1449.
<i>për mjete juridike</i>		556, 576, 750, 935, 936, 939, 950, 956, 959, 962, 963, 964, 965, 1240, 1244, 1249, 1251, 1341, 1343, 1352, 1367, 1452, 1453, 1456.
<i>për proces të rregullt</i>		807, 809, 811, 820, 824, 843, 844, 848, 849, 852, 857, 861, 875, 880, 885, 890, 892, 895, 897, 934, 935, 950, 959, 960, 972, 973, 977, 980, 985, 986, 998, 1002, 1003, 1012, 1022, 1086, 1145, 1147, 1150, 1151, 1155, 1162, 1163, 1164, 1166, 1173, 1178, 1182, 1183, 1185, 1189, 1190, 1193, 1198, 1202, 1204, 1206, 1208, 1220, 1222, 1230, 1231, 1233, 1238, 1239, 1241, 1244, 1245, 1249, 1251, 1258, 1268, 1269, 1272, 1281, 1288, 1289, 1306, 1315, 1318, 1324, 1372, 1375, 1381, 1385, 1389, 1391, 1406, 1409, 1419, 1422, 1431, 1433, 1435, 1436, 1440.
<i>për vendim të arsyetuar</i>		969, 1290
	F	
Forumi i Komisionit të Venecias		390, 617, 665, 672, 680, 686.
	G	
Grupet parlamentare		321,330,344,350,360, 361, 1469
Gjuhë		41,52,244,244,269,269,269,301,301,301, 310, 360, 368,368,384, 384, 409, 415, 415,445,645,645,739,1050,1069,1069, 1103, 1115, 1129, 1189, 1189, 1196, 1300, 1385, 1385, 1469
Gjykatë e (pa)anshme		1019, 1020

	GJ	
Gjykata		
<i>e Apelit</i>		1390, 1397, 1408, 1418, 1424, 1426, 1427, 1428, 1431, 1432, 1434, 1440, 1445, 1446, 1449
<i>Themelore</i>		5, 11, 13, 468, 790, 803, 806, 808, 809, 818, 847, 848, 849, 850, 851, 852, 853, 368, 369, 870, 877, 881, 891, 893, 924, 925, 926, 929, 939, 940, 945, 946, 947, 948, 949, 969, 972, 974, 976, 977, 989, 990, 994, 1028, 1029, 1033, 1034, 1037, 1053, 1083, 1087, 1088, 1090, 1091, 1096, 1101, 1102, 1103, 1144, 1147, 1149, 1244, 1245, 1247, 1248, 1272, 1273, 1294, 1296, 1297, 1306, 1344, 1345, 1372, 1377, 1378, 1379, 1380, 1381, 1392, 1393, 1394, 1396, 1408, 1418, 1423, 1424, 1425, 1426, 1427, 1428, 1431, 1434, 1445, 1446, 1447
<i>Supreme</i>		22, 95, 542, 559, 579, 695, 804, 842, 847, 889, 1091, 1109, 1242, 1243, 1288, 1293, 1362, 1405, 1432, 1449
	M	
Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave		890, 895, 935, 939, 950, 959, 963, 965, 1023, 1024, 1028, 1030, 1036, 1047, 1081, 1163, 1166, 1169, 1221, 1224, 1291, 1294, 1298, 1315, 1318, 1324, 1340, 1352, 1372, 1375, 1381, 1389, 1400
Mendim Mospajtues		233,
	I	
Institucionet e Pavarura		493, 614, 619, 674, 675
	K	

Kërkesë e papranueshme		727, 1290, 1340, 1403, 1452, 1461
Kërkesë e pranueshme		886, 1023, 1083, 1163, 1221, 1269
Kërkesë individuale		803, 808, 844, 886, 935, 969, 999, 1023, 1040, 1041, 1083, 1107, 1144, 1163, 1181, 1221, 1240, 1269, 1290, 1315, 1340, 1372, 1403, 1418, 1452, 1461
Kërkesë institucionale		11, 25, 123, 255, 482, 727, 753, 782
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë		791, 1005, 1275, 1277, 1278, 1283, 1408
Kërkesë qartazi e pabazuar		782, 1372, 1403
Kontroll incidental		11
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)		484, 526, 533, 549, 552, 569, 582, 591, 674, 723, 726, 761, 762, 1111
Kompetencat		
<i>e Qeverisë</i>		33, 50, 67, 97, 159, 176, 308, 462, 464, 527, 650, 739,
<i>e Kuvendit</i>		257, 310, 332, 419, 451, 650
<i>e Presidentit</i>		35, 75, 243, 246, 255, 268, 273, 284, 293, 294, 295, 313, 314, 376, 377, 381, 385, 449, 461, 753, 757, 763, 772, 774, 777
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut		71, 73, 161, 643, 648, 857, 897, 1047, 1196, 1251, 1384, 1436
Kryeministri i Republikës së Kosovës		31, 78, 152, 153, 179, 202, 222, 248, 249, 260, 287, 288, 295, 299, 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 315, 317, 318, 323, 334, 338, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 349, 350, 351, 353, 358, 360, 362, 363, 364, 365, 381, 399, 400, 401, 403, 407, 408, 413, 421, 423, 439, 441, 454, 593, 680, 766, 1301, 1309,

Kryetar Komune		765,766,771
Kufizim i të drejtave		25, 26, 30, 32, 33, 37, 51, 66, 80, 81, 84, 85, 86, 87, 89, 94, 95, 97, 112, 116, 119, 122, 123, 124, 130, 139, 160, 181, 204, 220, 226, 231, 233, 555, 563, 574, 589, 645, 660, 664, 1126
Kuvendi i Republikës së Kosovës		127,133,221,229,271,282,283, 294, 331, 332, 483, 492, 548, 553, 602, 650, 673, 835, 958
	L	
Liria e lëvizjes		25, 26, 30, 32, 38, 40, 60, 71, 73, 80, 116, 119, 122, 123, 124, 130, 139, 149, 160, 161, 181, 207, 208, 220, 226, 231, 232, 233, 240
Ligji		
<i>për Pagat në Sektorin Publik</i>		573, 583, 585, 592, 603, 616, 617, 621, 631, 660, 666, 667, 680, 709
<i>për Zyrtarët Publikë</i>		473, 552
	M	
Masa e Përkohshme		39, 46, 118, 151, 153, 247, 248, 252, 253, 255, 273, 448, 449, 715, 1321
Mbrojtja e pronës		555, 558, 563, 574, 577, 644, 648, 660, 664, 795, 1086, 1182, 1185, 1193, 1202, 1221, 1224,1340
Mendim mospajtues		233
Ministria (ministri)		28,33, 34, 52, 68, 99, 100,112, 121,124, 125, 126, 130, 132, 138, 139, 140, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 151, 162,163, 164, 165, 166, 171, 175, 180, 181, 189, 191, 192, 197, 200, 203, 205, 207, 209, 211, 213, 217, 218, 219, 221, 226, 227, 228, 229, 237, 238, 240, 241, 462, 464, 471, 475, 509, 531, 556, 566, 575, 579, 580, 581, 582,

		583,584, 587, 596, 627, 628, 629, 630, 631, 633, 634, 635, 637, 641, 651, 653, 668, 669, 670, 671, 699, 705, 709, 710, 719, 727, 728, 730, 732, 734, 735, 736, 737,746, 760, 761, 944, 1024, 1029, 1034, 1037, 1051, 1065, 1070, 1192, 1312, 1401, 1425, 1455
Mjet juridik efektiv		964, 1240, 1241, 1256, 1257, 1458
Mospërmbarim		935, 936, 938, 939, 940, 948, 950, 951, 955, 956, 958, 966, 967, 968
	N	
Ndalimi i diskriminimit		588, 594, 648, 1107, 1108, 1110, 1111,1114, 1142, 1143, 1313, 1372, 1375, 1381,1385, 1389,
Ndarja e pushtetit		243, 246, 255, 257, 268, 284, 293, 308, 310, 331, 451, 520, 552, 555, 563, 573, 574, 582, 660, 664, 674, 677, 726, 768
	P	
Paanshmëria e gjykatës		864, 999
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)		1107, 1110, 1111, 1112, 1113, 1114, 1115, 1116, 1117, 1118, 1127, 1128, 1129, 1130, 1131, 1132, 1133, 1134, 1135, 1137, 1138, 1139, 1140
Pandemi		9, 25, 28, 32, 34, 44, 45, 49, 52, 53, 54, 57, 58, 60, 63, 81, 82, 90, 92, 102, 103, 107, 113, 114, 117, 118, 121, 123, 124, 127, 128, 137, 138, 155, 156, 157, 158, 180, 183, 183, 190, 191, 199, 203, 205, 206, 208, 210, 220, 233, 224, 226, 229, 230, 233, 234, 239, 247, 248, 249, 279, 308, 321, 581, 761, 762, 764, 766, 769, 778, 779
Paraburgim(i)		892

Parashkrim		999, 1005, 1007, 1008, 1177, 1320, 1346, 1377,
<i>Parimi</i>		
<i>i Proporcionalitetit</i>		54, 86, 1108
<i>i Sigurisë Juridike</i>		502, 546, 547, 564, 588, 666, 676, 699, 705, 710, 714, 715, 716, 720, 803, 804, 811, 819, 824, 825, 827, 828, 829, 830, 836, 840, 841, 842, 969, 970, 977, 979, 980, 985, 991, 997, 1084, 1098, 1099, 1100, 1101, 1104, 1129, 1135, 1136, 1140, 1299, 1419, 1431, 1432, 1440
<i>i subsidiaritetit</i>		1128, 1441, 1452,
Pension/pensionimi		95, 605, 620, 621, 647, 680, 693, 734, 735, 736, 740, 742, 743, 1009, 1192, 1290, 1304, 1309, 1464, 1465, 1466
Person(a) Juridik(ë)		194, 728, 749, 803, 844, 969, 1457,
Përbërja e trupit gjykues		999, 1449
Përmbarim		936, 940, 941, 944, 947, 948, 949, 950, 952, 956, 957, 958, 959, 960, 961, 964, 965, 966, 967, 974
Presidenti i Republikës së Kosovës		25, 29, 37, 58, 75, 76, 130, 139, 145, 171, 250, 293, 302, 306, 320, 322, 323, 331, 332, 333, 334, 335, 362, 364, 387, 516, 647, 650, 658, 768, 771, 772, 774, 775, 808, 849, 891, 1029, 1111, 1295, 1296, 1298, 1301, 1307, 1309
Pritje(t) legjitime		589, 621, 1100
Privatizimi		22, 463, 464, 467, 564, 629, 630, 654, 712, 717, 754, 780, 799, 1163, 1165, 1167, 1169, 1176, 1177, 1181, 1182, 1184, 1185, 1187, 1188, 1189, 1190, 1191, 1192, 1193, 1197, 1199, 1200, 1201, 1202, 1207, 1212, 1214, 1221, 1223, 1225, 1315, 1317, 1319, 1320

Procedura		
<i>Administrative</i>		64, 99, 191, 862, 867, 936, 941, 949, 952, 958, 962, 965, 1032, 1240
<i>Civile</i>		937, 967, 968, 1157, 1163, 1221
<i>Penale</i>		793, 794, 795, 905, 1269, 1286, 1387, 1392, 1400, 1403
Prokurori i Shtetit		521, 552, 555, 563, 574, 582, 593, 594, 647, 656, 657, 661, 664, 726, 792, 793, 893, 894, 900, 925, 929, 999, 1005, 1006, 1269, 1270, 1274, 1275, 1276, 1281, 1285, 1287, 1290, 1295, 1296, 1301, 1302, 1304, 1306, 1307, 1353, 1354, 1360, 1362, 1363, 1364, 1380, 1387, 1408, 1429, 1432
Prokurori Publik		893, 1283
	Q	
<i>Qasja në gjykatë</i>		827, 1163, 1164, 1175, 1176, 1177, 1179, 1222, 1231, 1232, 1233, 1236, 1238
Qeveria e Republikës së Kosovës		66, 135, 136, 145, 159, 331, 376, 490, 520, 583, 637, 638, 639, 640, 652, 653, 673, 734, 740, 1312, 1401
Qëllim legjitim		53, 86, 87, 88, 91, 92, 125, 149, 154, 181, 182, 201, 202, 203, 208, 217, 218, 227, 228, 240, 543, 619, 1056, 1057, 1058, 1068, 1108, 1126, 1127, 1132, 1133, 1134, 1176, 1233, 1313, 1400
	R	
<i>Ratione materiae</i>		330, 770
<i>Res judicata</i>		1083, 1089, 1097, 1098, 1099, 1100, 1101, 1105,
Rigjykim		854, 886, 893, 894, 895, 898, 903, 917, 918, 924, 934, 975, 976, 980, 994, 995, 1000, 1018, 1021, 1083, 1087, 1090, 1091,

		1096, 1097, 1101, 1102, 1103, 1161, 1274, 1278, 1326, 1345, 1379, 1407, 1418, 1426, 1427, 1428, 1449
	S	
Seancë dëgjimore		340, 447, 751, 905, 1024, 1181, 1182, 1183, 1189, 1193, 1199, 1200, 1201, 1202, 1203, 1204, 1205, 1206, 1207, 1208, 1209, 1210, 1211, 1212, 1213, 1216, 1217, 1218, 1219, 1323, 1337
Sundimi i Ligjit		128, 230, 374, 563, 569, 618, 672, 722, 1099, 1100, 1124
	SH	
Shëndeti Publik		33, 43, 60, 91, 138, 153, 156, 208
Shërbimi Civil		499, 534, 632, 669, 956
	T	
Taksë gjyqësore		1168, 1177, 1224, 1226, 1227, 1230, 1235, 1237
Të drejtat		
<i>e fëmijëve</i>		71, 208, 644
<i>zgjedhore dhe të pjesëmarrjes</i>		312, 753, 757, 763, 766, 772, 777
	V	
Vendim për Refuzim		462, 463
	Z	
Zgjedhjet lokale/ komunale		765, 766, 769, 770, 771, 774

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi	Numri i faqes
KAPITULLI I DISPOZITAT THEMELORE		
4	Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit	243, 246, 255, 257, 268, 284, 293, 308, 310, 331, 451, 520, 552, 555, 563, 573, 582, 660, 664, 674, 677, 726, 768.
7	Vlerat	206, 225, 230, 266, 287, 295, 331, 372, 374, 403, 426, 433, 461, 485, 520, 549, 552, 555, 563, 566, 567, 568, 569, 574, 582, 587, 594, 603, 605, 616, 643, 660, 664, 668, 672, 701, 707, 710, 715, 718, 719, 721, 722, 726, 753, 757, 763, 772, 777, 1056, 1061, 1107, 1108, 1109, 1111, 1114, 1117, 1121, 1139, 1140, 1142, 1143, 1315, 1318, 1324, 1452, 1453, 1456.
KAPITULLI II TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE		
21	Parimet e përgjithshme	372, 402, 502, 521, 530, 542, 552, 555, 563, 569, 574, 582, 588, 643, 646, 647, 648, 660, 664, 665, 672, 684, 722, 726, 745, 748, 753, 763, 772, 777, 794, 807, 816, 819, 824, 844, 848, 855, 860, 861, 886, 905, 906, 907, 928, 972, 983, 986, 991, 1010, 1012, 1054, 1055, 1066, 1073, 1076, 1079, 1098, 1108, 1109, 1111, 1114, 1118, 1119, 1121, 1123, 1126, 1127, 1133, 1140, 1141, 1142, 1143, 1156, 1163, 1166,

			1169, 1173, 1182, 1203, 1218, 1231, 1235, 1241, 1244, 1254, 1257, 1291, 1310, 1315, 1318, 1324, 1454, 1457.
22	Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare		25, 29, 71, 80, 201, 555, 563, 574, 643, 660, 664, 776, 860, 1002, 1012, 1067, 1108, 1109, 1111, 1114, 1118, 1121, 141, 1142, 1143.
24	Barazia para ligjit		482, 519, 555, 563, 574, 588, 595, 603, 642, 644, 660, 664, 795, 890, 895, 1024, 1028, 1036, 1085, 1086, 1107, 1108, 1109, 1111, 1114, 1142, 1143, 1182, 1185, 1193, 1202, 1221, 1224, 1244, 1249, 1291, 1294, 1298, 1300, 1315, 1318, 1324, 1340, 1343, 1352, 1363, 1365, 1372, 1375, 1381, 1389.
29	E drejta e lirisë dhe sigurisë		1372, 1375, 1381, 1390, 1400.
30	Të drejtat e te akuzuarit		41, 782, 785, 792, 1405, 1409, 1412, 1413.
31	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm		11, 13, 15, 23, 795, 803, 807, 809, 811, 843, 844, 849, 856, 860, 876, 886, 890, 892, 895, 897, 934, 935, 939, 950, 959, 969, 973, 977, 980, 985, 998, 999, 1000, 1002, 1003, 1012, 1015, 1022, 1024, 1028, 1036, 1084, 1086, 1092, 1097, 1098, 1144,
32	E drejta për mjete juridike		556, 576, 750, 935, 936, 939, 950, 956, 959, 962, 963, 964, 965, 1240, 1244, 1249, 1251, 1341, 1343, 1352, 1367, 1452, 1453, 1456.
40	Liria e shprehjes		1107, 1110, 1111, 1114, 1115, 1121, 1122, 1123, 1124, 1125, 1126, 1127, 1129, 1133, 1134, 1142, 1143.
43	Liria e Tubimit		25, 26, 30, 32, 38, 40, 60, 72, 73, 80, 90, 116, 119, 122, 124, 139, 220, 226, 233.

45	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes		312, 753, 757, 763, 772, 777.
46	Mbrojtja e pronës		1084, 1092,
49	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit		935, 939, 950, 959,
53	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut		80, 201, 542, 777, 819, 860, 904, 960, 985, 1012, 1024, 1028, 1036, 1067, 1097, 1122, 1156, 1173, 1202, 1231, 1257, 1280, 1305, 1372, 1375, 1381, 1389, 1390, 1440.
54	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave		890, 895, 935, 939, 950, 959, 963, 965, 1023, 1024, 1028, 1030, 1036, 1047, 1073, 1081, 1163, 1166, 1169, 1221, 1224, 1291, 1294, 1298, 1315, 1318, 1324, 1340, 1343, 1352, 1372, 1375, 1381, 1389, 1400.
55	Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore		25, 26, 30, 32, 33, 37, 51, 66, 80, 81, 84, 85, 86, 87, 89, 94, 95, 97, 112, 116, 119, 122, 123, 124, 130, 139, 160, 181, 204, 220, 226, 231, 233, 555, 563, 574, 589, 645, 660, 664.
KAPITULLI IV KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
65	Kompetencat e Kuvendit		257, 310, 332, 419, 451, 650.
67	Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve		403, 427,
82	Shpërndarja e Kuvendit		243, 246, 255, 259, 260, 265, 268, 273, 275, 276, 284, 286, 287, 297, 304, 313, 318, 324, 328, 330, 332, 348, 349, 360, 361, 366, 367, 369, 370, 371, 372, 375, 381, 387, 393,

			394, 397, 413, 436, 446, 449, 453, 454, 459, 461.
KAPITULLI V PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
83	Statusi i Presidentit		285, 320, 333.
84	Kompetencat e Presidentit		35, 75, 243, 246, 255, 268, 273, 284, 293, 294, 295, 313, 314, 333, 376, 377, 381, 385, 449, 461, 753, 757, 763, 772, 774, 777.
KAPITULLI VI QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
92	Parimet e Përgjithshme		66, 159, 345
93	Kompetencat e Qeverisë		67, 159, 341, 650
95	Zgjedhja e Qeverisë		243, 246, 247, 255, 261, 263, 268, 273, 284, 305, 323, 333, 372, 398, 418, 449, 455, 457, 461
101	Shërbimi Civil		956
KAPITULLI VII SISTEMI I DREJTËSISË			
102	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor		521, 552, 555, 563, 574, 582, 646, 660, 664, 726, 1163, 1166, 1169, 1315, 1318, 1324
108	Këshilli Gjyqësor i Kosovës		18, 521, 552, 582, 591, 622, 726, 1354
109	Prokurori i Shtetit		646, 1301, 1307
KAPITULLI VIII GJYKATA KUSHTETUESE			
115	Organizimi i Gjykatës Kushtetuese		552, 582, 726

Kapitulli IX MARËDHËNIET EKONOMIKE

119

Parimet e Përgjithshme

647

Kapitulli XII INSTITUCIONET E PAVARURA

132

Roli dhe Kompetencat e
Avokatit të Popullit474, 478, 482, 484, 488, 526, 549,
552, 582, 726, 1343, 1352

136

Auditori i Përgjithshëm i
Kosovës484, 526, 532, 549, 552, 569, 582,
674, 723, 726

140

Banka Qendrore e Kosovës

484, 526, 533, 549, 552, 569, 591,
674, 723

141

Komisioni i Pavarur i
Medieve

526, 591

142

Agjencitë Pavarura

598, 647, 674

SHKELJE TË NENEVE 4, 7, 31, 32, 35, 36, 43, 54, 55, 102, 103, 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139, 140 dhe 141 TË KUSHTETUTËS

4

Forma e qeverisjes dhe
ndarja e pushtetit

552, 726,

7

Vlerat

552, 726,

31

E Drejta për Gjykim të
Drejtë dhe të Paanshëm843, 943, 968, 998, 1022, 1105,
1162, 1180, 1220, 1239, 1268,
1289

32

E Drejta për Mjete Juridike

968,

35

Liria e Lëvizjes

122, 231,

36

E Drejta e Privatësisë

122, 1081,

43

Liria e Tubimit

122,

54	Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave		968, 1081
55	Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore		122, 231,
102	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor		552, 726,
103	Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave		726,
108	Këshilli Gjyqësor i Kosovës		552, 726,
109	Prokurori i Shtetit		552, 726,
110	Këshilli Prokurorial i Kosovës		552, 726,
115	Organizimi i Gjykatës Kushtetuese		552, 726,
132	Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit		552, 726,
136	Auditori i Përgjithshëm i Kosovës		552, 726
139	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		552, 726
140	Banka Qendrore e Kosovës		552,
141	Komisioni i Pavarur i Medieve		552, 726